

V E N D I M E
TË GJYKATËS KUSHTETUESE

**Me objekt fushën e zgjedhjeve
1992 – 2015**

Tiranë, 2016

© Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

ISBN: 978-9928-4311-2-7

Ky botim u realizua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese.



Shënim:

Ky botim nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Versioni elektronik i këtij botimi gjendet në faqen e internetit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri
www.osce.org/albania

Dizenjimi grafik dhe shtypi, Graphic Line-01,
info@graphicline01.com, www.graphicline01.com

Përmbajtja e lëndës

Hyrje

Faqja

Gjykata Kushtetuese	7
Prezenca e OSBE-së në Shqipëri	11
1. Vendim nr. 6, datë 18.07.1994.....	13
2. Vendim nr. 4, datë 02.04.1996.....	22
3. Vendim nr. 10, datë 10.05.1996.....	25
4. Vendim nr. 11, datë 10.05.1996.....	27
5. Vendim nr. 12, datë 13.05.1996.....	30
6. Vendim nr. 13, datë 14.05.1996.....	33
7. Vendim nr. 14, datë 15.05.1996.....	36
8. Vendim nr. 15, datë 15.05.1996.....	38
9. Vendim nr. 17, datë 17.05.1996.....	40
10. Vendim nr. 20, datë 17.05.1996.....	42
11. Vendim nr. 21, datë 21.05.1996.....	43
12. Vendim nr. 22, datë 21.05.1996.....	46
13. Vendim nr. 23, datë 22.05.1996.....	49
14. Vendim nr. 24, datë 15.06.1996.....	52
15. Vendim nr. 30, datë 16.07.1996.....	55
16. Vendim nr. 34, datë 24.09.1996.....	58
17. Vendim nr. 35, datë 10.10.1996.....	60
18. Vendim nr. 38, datë 15.10.1996.....	62
19. Vendim nr. 39, datë 16.10.1996.....	64
20. Vendim nr. 16, datë 07.06.1997.....	67
21. Vendim nr. 27, datë 19.07.1997.....	72
22. Vendim nr. 28, datë 19.07.1997.....	74
23. Vendim nr. 29, datë 19.07.1997.....	76
24. Vendim nr. 30, datë 19.07.1997.....	78
25. Vendim nr. 32, datë 21.07.1997.....	80
26. Vendim nr. 33, datë 21.07.1997.....	82
27. Vendim nr. 34, datë 21.07.1997.....	85
28. Vendim nr. 35, datë 21.07.1997.....	86
29. Vendim nr. 36, datë 21.07.1997.....	89
30. Vendim nr. 40, datë 05.08.1997.....	92
31. Vendim nr. 42, datë 22.08.1997.....	95
32. Vendim nr. 59, datë 16.12.1997.....	97

33.	Vendim nr. 40, datë 17.05.2001.....	100
34.	Vendim nr. 57, datë 03.07.2001.....	107
35.	Vendim nr. 58, datë 03.07.2001.....	108
36.	Vendim nr. 59, datë 04.07.2001.....	109
37.	Vendim nr. 60, datë 04.07.2001.....	110
38.	Vendim nr. 62, datë 05.07.2001.....	111
39.	Vendim nr. 63, datë 05.07.2001.....	112
40.	Vendim nr. 64, datë 03.07.2001.....	112
41.	Vendim nr. 65, datë 06.07.2001.....	113
42.	Vendim nr. 66, datë 06.07.2001.....	114
43.	Vendim nr. 67, datë 12.07.2001.....	115
44.	Vendim nr. 68, datë 13.07.2001.....	116
45.	Vendim nr. 69, datë 12.07.2001.....	117
46.	Vendim nr. 70, datë 11.07.2001.....	118
47.	Vendim nr. 71, datë 06.07.2001.....	119
48.	Vendim nr. 72, datë 13.07.2001.....	120
49.	Vendim nr. 73, datë 17.07.2001.....	121
50.	Vendim nr. 74, datë 17.07.2001.....	122
51.	Vendim nr. 75, datë 18.07.2001.....	123
52.	Vendim nr. 76, datë 18.07.2001.....	124
53.	Vendim nr. 77, datë 18.07.2001.....	125
54.	Vendim nr. 78, datë 13.07.2001.....	126
55.	Vendim nr. 79, datë 18.07.2001.....	127
56.	Vendim nr. 80, datë 12.07.2001.....	127
57.	Vendim nr. 81, datë 07.07.2001.....	129
58.	Vendim nr. 82, datë 18.07.2001.....	129
59.	Vendim nr. 83, datë 20.07.2001.....	130
60.	Vendim nr. 84, datë 12.07.2001.....	131
61.	Vendim nr. 85, datë 10.07.2001.....	132
62.	Vendim nr. 86, datë 18.07.2001.....	133
63.	Vendim nr. 87, datë 11.07.2001.....	134
64.	Vendim nr. 88, datë 10.07.2001.....	135
65.	Vendim nr. 89, datë 14.07.2001.....	136
66.	Vendim nr. 91, datë 12.07.2001.....	137
67.	Vendim nr. 92, datë 20.07.2001.....	137
68.	Vendim nr. 93, datë 23.07.2001.....	138
69.	Vendim nr. 94, datë 26.07.2001.....	139
70.	Vendim nr. 98, datë 27.07.2001.....	141
71.	Vendim nr. 99, datë 31.07.2001.....	142
72.	Vendim nr. 100, datë 31.07.2001.....	142

73.	Vendim nr. 101, datë 31.07.2001.....	143
74.	Vendim nr. 102, datë 28.07.2001.....	144
75.	Vendim nr. 103, datë 10.08.2001	146
76.	Vendim nr. 104, datë 31.07.2001.....	147
77.	Vendim nr. 107, datë 06.08.2001.....	147
78.	Vendim nr. 111, datë 13.08.2001.....	149
79.	Vendim nr. 112, datë 13.08.2001.....	150
80.	Vendim nr. 114, datë 27.08.2001.....	151
81.	Vendim nr. 115, datë 28.08.2001.....	152
82.	Vendim nr. 116, datë 28.08.2001.....	153
83.	Vendim nr. 117, datë 28.08.2001.....	154
84.	Vendim nr. 117, datë 06.06.2002.....	155
85.	Vendim nr. 169, datë 26.07.2002.....	159
86.	Vendim nr. 3, datë 13.02.2003.....	162
87.	Vendim nr. 1, datë 30.01.2004.....	173
88.	Vendimi nr. 1, datë 07.01.2005.....	179
89.	Vendim nr. 40, datë 16.11.2007	193
90.	Vendim nr. 32, datë 21.06.2010.....	202
91.	Vendim nr. 28, datë 09.05.2012.....	216
92.	Vendim nr. 11, datë 13.03.2015.....	242
93.	INDEKS	269

HYRJE

I nderuar lexues,

Zhvillimet politike pas viteve '90, ndërtimi i një shteti demokratik dhe pluralist, nevoja e garantimit të lirive dhe të drejtave të njeriut shtruan si domosdoshmëri hartimin e një legjislacioni demokratik dhe krijimin e një infrastrukture për realizimin në praktikë të këtyre të drejtave, ku një vend të veçantë zënë të drejtat politike. Miratimi i Kushtetutës së vitit 1998, hartimi i Kodit Zgjedhor, krijimi i institucioneve përkatëse për administrimin e procesit zgjedhor janë disa arritje pozitive në fushën e realizimit të të drejtave politike, sidomos të së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

Zgjedhjet përcaktojnë nivelin e demokracisë në një shoqëri demokratike, pasi ato ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në sistemin e qeverisjes, prandaj zhvillimi i zgjedhjeve përbën një standard të rëndësishëm të legjitimitetit demokratik dhe të progresit kombëtar të një vendi. Mënyra e zhvillimit dhe e verifikimit të zgjedhjeve kërkon një proces kontrolli, i cili kërkon përbushjen e detyrimeve ligjore si dhe respektimin e standardeve nga të gjithë faktorët politikë dhe shtetëror, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në to, por që edhe kontribuojnë në zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe demokratike.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në pjesën e parimeve themelore, i referohet sistemit të zgjedhjeve, dhe po ashtu, në nenin 131 shkronja "e" parashikon Gjykatën Kushtetuese si organin kushtetues që, midis të tjerash, vendos *"për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës dhe të deputetëve, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre"*. Gjykata Kushtetuese ushtron kontrollin e saj në lidhje me papajtueshmërinë e funksionit të deputetit si dhe verifikon zgjedhjen e tij. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje nga Kuvendi i Shqipërisë kur ai konstaton rastet e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të deputetit ose rastet e pazgjedhshmërisë së

tij. Në lidhje “*me verifikimin e zgjedhjes së deputetëve*”, ndonëse kjo kompetencë i është dhënë Gjykatës Kushtetuese nga Kushtetuta, kjo e fundit nuk e sqaron në mënyrë të detajuar këtë diskrecion kushtetues, duke ia lënë për zgjidhje Kodit Zgjedhor.

Zbatimi i kësaj kompetence të Gjykatës Kushtetuese ka qenë i ndryshëm në kohë. Me Kodin Zgjedhor të vitit 2000, Gjykata Kushtetuese u vendos në një pozicion disi të dyshimtë për rolin që asaj i ka ngarkuar Kushtetuta. Asaj iu imponua funksioni i gjykatës së vetme kompetente, pra të gjykatës së faktit dhe të ligjit, për të zgjidhur të gjitha çështjet që lidheshin me pavlefshmëritë e zgjedhjeve dhe të rezultateve të tyre. Kjo zgjidhje solli disa probleme të diskutueshme si dhënia Gjykatës Kushtetuese me ligj të kompetencës tej atyre që parashikonte Kushtetuta, pra, shndërrimi i Gjykatës Kushtetuese në një gjykatë themeli që e shqyrtonte çështjen në substancë dhe në procedurë; shqyrtimi kryesisht i ligjshmërisë dhe jo kushtetutshmërisë; krijimi i një kolizioni ligjor ndërmjet Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Në një situatë të tillë, kur Kodi Zgjedhor përcaktonte Gjykatën Kushtetuese si të vetmin organ që kontrollonte dhe shqyrtonte vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe, duke qenë se ky Kod ishte hartuar nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të organizmave ndërkombëtare, atëherë e vetmja zgjidhje mbetej ushtrimi i funksionit të saj sipas rregullave të përcaktuara në Kushtetutë, në ligjin organik dhe në Kodin Zgjedhor. Por respektimi në mënyrë strikte kryesisht i dispozitave të Kodit Zgjedhor krijoi probleme jo të pakta për këtë autoritet kushtetues, duke i dhënë padrejtësisht imazhin e një gjykate të sistemit të zakonshëm gjyqësor.

Gjatë zgjedhjeve të vitit 2001, Gjykata Kushtetuese mbështetur në nenin 107 pika 2 të Kodit Zgjedhor, me kërkesë të subjekteve zgjedhore në disa raste ka urdhëruar hapjen e kutive të votimit të qendrave që pretendohet se kishin sjellë një rezultat të pavlefshëm. Për shkak të natyrës së këtij gjykimi, pra të shqyrtimit të fakteve mbi të cilat kërkuesi bazonte pretendimet e tij për shpalljen të pavlefshme të procesit të votimit, Gjykata Kushtetuese ka dalë jashtë funksionit të saj, atij të kontrollit kushtetues.

Kodi Zgjedhor i vitit 2003 solli ndryshime të rëndësishme për pozicionin që duhet të ketë Gjykata Kushtetuese në procesin zgjedhor. Tashmë, organi kompetent që merret me pavlefshmërinë e zgjedhjeve pas vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është një kolegji zgjedhor i ngritur pranë Gjykatës së Apelit të Tiranës, i cili

e shkarkoi Gjykatën Kushtetuese nga shqyrtimi i ankesave që nuk i takonin juridiksionit të saj.

Pajisja e Gjykatës Kushtetuese me kompetencat e trajtuara më lart nuk ka qenë pa qëllim, pasi verifikimi i rezultatit të zgjedhjes së një deputeti kërkon garanci shumë më të mëdha, sepse për të kanë shprehur vullnetin e tyre zgjedhësit nëpërmjet votës dhe një gjykatë siç është Gjykata Kushtetuese krijonte më shumë premisat për një gjykim të drejtë. Por kjo kompetencë e njohur në Kodin Zgjedhor e përfshiu Gjykatën Kushtetuese në një proces që nuk i përkiste asaj duke e shndërruar atë në një gjykatë fakti.

Megjithatë, përfshirja e Gjykatës Kushtetuese në procesin zgjedhor mundësoi trajtimin e disa standardeve zgjedhore, që bashkë me evoluimin e jurisprudencës kushtetuese shqiptare ndër vite, u perfeksionuan edhe më shumë. Kuadri ligjor zgjedhor në fuqi, i hartuar me kontributin e përfaqësuesve të partive politike dhe mbështetjen e ekspertizës ndërkombëtare, mbetet një përpjekje pozitive për të përmirësuar procesin zgjedhor dhe për arritjen e standardeve ndërkombëtare të përcaktuara në Dokumentin e Kopenhagenit të OSBE-së dhe, veçanërisht, në Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, i cili përbën një dokument strategjik në njohjen e zgjedhjeve të lira, të barabarta dhe periodike si veçori të demokracive moderne europiane.

Nisur jo vetëm nga numri i konsiderueshëm i vendimeve që ka zënë shqyrtimi i konflikteve zgjedhore, por edhe efektet që ka pasur ky proces në Shqipëri, vlerësoj se ky botim edhe pse përbën një kontribut modest por të qëndrueshëm në realizimin e reformës zgjedhore në Shqipëri, do të jetë orientues dhe një mundësi për personat e interesuar të njihen me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese veçanërisht me kufijtë e kompetencës së saj në fushën zgjedhore.

Në përfundim, dua të falënderoj Prezencën e OSBE-së në Shqipëri për kontributin në realizimin e këtij botimi dhe angazhimin në zbatimin e këtij projekti që nxit zhvillimin dhe konsolidimin e një sistemi ligjor dhe demokratik në Shqipëri.

Bashkim Dedja

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

I dashur lexues,

Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë baza e demokracisë. Të gjitha Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, përfshirë Shqipërinë, janë shprehur për vlera dhe angazhime të përbashkëta në fushën e zgjedhjeve dhe të shtetit të së drejtës. Përgjatë viteve, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka ndihmuar institucionet shqiptare që të përmirësojnë proceset zgjedhore dhe i ka fuqizuar ato për t'i organizuar zgjedhjet në mënyrë të pavarur, transparente dhe profesionale, siç i kërkojnë qytetarët.

Në këtë kontekst, Prezenca e OSBE-së në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese përgatitën këtë përmbledhje me vendime të Gjykatës Kushtetuese me objekt fushën e zgjedhjeve të marra që nga krijimi i saj në vitin 1992, me qëllim që të shërbejë si mjet praktik referimi për gjyqtarët, ekspertët dhe profesionistët e kësaj fushe.

Ky botim është pjesë e një serie me tre vëllime me vendime për zgjedhjet dhe referendumet. **Vëllimi i parë** përmban vendime të Gjykatës Kushtetuese për zgjedhjet që prej vitit 1992. **Vëllimi i dytë** përmban jurisprudencën e Kolegjit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013 dhe zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015. **Vëllimi i tretë** përmban vendime të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe vendime të gjykatave për referendumet që nga viti 1992.

Kjo seri, e para e këtij lloji në Shqipëri, synon t'i bëjë vendimet e këtyre institucioneve lehtësisht të arritshme për një sërë aktorësh. Ajo jo vetëm informon publikun për vendimet e institucioneve përkatëse lidhur me zgjedhjet dhe referendumet, por edhe ndihmon aktorët kryesorë të zgjedhjeve - përfshirë Kuvendin, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, shoqërinë civile dhe studiuesit - në punën e tyre. Të interesuarit mund të gjejnë kopje të kësaj serie, ndër të tjera, në Kuvend, në Bibliotekën Kombëtare, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës. Atë mund ta gjeni edhe në faqen e internetit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri (www.osce.org/albania).

U jam mirënjohës, si gjithmonë, Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese dhe administratës së kësaj gjykate për partneritetin dhe bashkëpunimin në finalizimin e procesit të përgatitjes së këtij botimi. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri vazhdon të jetë partnere dhe mbështetëse e institucioneve shqiptare në realizimin e aspiratave të vendit.

Robert Wilton

***Kryetar në detyrë
i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri***

Vendim nr. 6, datë 18.07.1994

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Manol Konomi, Hilmi Dakli, Veli Budo, Franc Jakova, Natasha Sheshi, Ylvi Myrtja, anëtarë, me sekretare Drita Filto, në datë 18.07.1994, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.10 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: SELFO DYRMISHI

O B J E K T I: Kërkohet të shpallet antikushtetues vendimi datë 03.08.1992, i Komisionit të Zgjedhjeve të Komunës së Dushkut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relacionin përkatës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Nga materialet e paraqitura para kësaj Gjykate, rezulton se në datë 2 gusht 1992 janë zhvilluar zgjedhjet e raundit të dytë për kryetar komune të Dushkut të Rrethit të Lushnjes, ku si kandidat i Partisë Socialiste ka qenë kërkuesi Selfo Dyrmishi dhe kandidat i Partisë Demokratike Nasibi Bakiasi.

Komisioni i zgjedhjeve të komunës së Dushkut në zbatim të shkronjës “e” të nenit 25 të ligjit nr.7573, datë 16.06.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, me procesverbalin datë 03.08.1992 ka shpallur kryetar të komunës së Dushkut Nasibi Bakiasi.

Vlefshmërinë e mandatit të kryetarit të komunës së Dushkut, Nasibi Bakiasi e ka vërtetuar gjyqtari i Gjykatës së Rrethit të Lushnjes, Artan Gjermani, me vendimin datë 14.08.1992, në zbatim të nenit 29 të ligjit nr.7572, datë 10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”.

Kërkuesi ka parashtruar se komisioni i zgjedhjeve të komunës së Dushkut pa të drejtë i ka quajtur të pavlefshme vletë-votimet e qendrës së votimit nr.8 (sektori Zhamë) dhe si rezultat ka shpallur kryetar të komunës së Dushkut, Nasibi Bakiasi, duke ju shkelur kështu e drejta kërkuesit për t’u zgjedhur, e parashikuar në nenin 3 të ligjit nr.7573, datë 16.06.1992 “Për zgjedhjet e organeve

të pushtetit lokal” dhe në nenin 19 të ligjit nr.7692, datë 31.03.1993 “Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

Gjykata çmon se nuk gjen mbështetje ligjore pretendimi i kërkuesit Selfo Dyrmishi, se veprimet e parregullta të konstatuara gjatë zhvillimit të zgjedhjeve dhe në mënyrë të veçantë, deklarimi pa të drejtë si të pavlefshme të fletë-votimeve të qendrës së votimit nr.8, me pasojë moszgjedhjen e tij si kryetar i komunës së Dushkut, përbëjnë shkelje të së drejtës së tij të parashikuar nga neni 19 i ligjit nr.7692, datë 31.03.1993 “Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

Neni 19 i ligjit të lartpërmendur i siguron çdo shtetasi të drejtën e zgjedhjes, dmth., të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet në të gjitha organet e pushtetit shtetëror. Kjo e drejtë nuk i është mohuar kërkuesit, gjë që vërtetohet me faktin se Partia Socialiste e ka paraqitur dhe është pranuar si kandidat për kryetar në komunën e Dushkut.

Pretendimet se gjatë zgjedhjeve janë kryer veprime të parregullta ose në kundërshtim me ligjin “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, nuk kanë të bëjnë me të drejtat e parashikuara nga neni 19 i ligjit “Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”. Sipas ligjit “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, legjitimohen të bëjnë ankim në organet e parashikuara nga ky ligj vetëm subjektet elektorale - partitë politike që kanë paraqitur kandidatët e tyre dhe personat që kanë vënë kandidaturë të pavarur, të cilët në këtë rast marrin cilësinë e subjektit elektorale.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 26 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

MENDIMI I PAKICËS

Ne anëtarët e Gjykatës Kushtetuese Veli Budo e Ylvi Myrtja,

duke mos u pajtuar me mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga shumica e gjyqtarëve, parashtrijmë mendimet tona si më poshtë:

Në muajin qershor të vitit 1993, shtetasi Selfo Dyrmishi ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese anulimin e vendimit të Komisionit të Zgjedhjeve të Komunës së Dushkut të datës 03.08.1992 si akt të kundërligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat kryesore kushtetuese, dhe ka marrë përgjigjen administrative, ku ndërmjet të tjerash thuhet: "... Letra e juaj nuk shoqërohet me asnjë lloj dokumenti. Kjo na bën të pamundur për të njohur plotësisht problemin. Për të konkluduar a është shkelur në një rast e drejta kushtetuese e zgjedhjes (neni 19) çdo subjekt i interesuar duhet të paraqesë krahas kërkesës së qartë e të plotë edhe të gjitha provat e nevojshme".

Në zbatim të porosive të theksuara në përgjigje në 28.12.1993 ankuesi e ka përsëritur kërkesën duke e plotësuar me disa prova shpresore që i ka konsideruar të nevojshme, siç janë ankimet drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, gjykatës së rrethit, Gjykatës së Kasacionit dhe përgjigjet e marra prej tyre.

Krahas materialeve të paraqitura nga ankuesi u muarr për nevoja gjykimi, nga Gjykata e Rrethit Lushnje, dosja civile nr.788, me objekt kundërshtimi i vendimit datë 24.08.1992, të gjyqtarit Artan Gjermani për vërtetimin e mandatit të kryetarit të Komunës së Dushkut.

Nga studimi i materialeve të paraqitura nga ankuesi dhe të marra nga vetë gjykata, rezulton se: Në datë 03.08.1992 janë zhvilluar zgjedhjet e raundit të dytë për kryetarin e Komunës së Dushkut të Rrethit Lushnje, ku konkurronin kandidati i Partisë Demokratike Nasibi Bakiasi me atë të Partisë Socialiste Selfo Dyrmishi.

Komisioni i Zgjedhjeve të zonës së Dushkut me procesverbalin e datës 03.08.1992 ka shpallur si kryetar të komunës së Dushkut Nasibi Bakiasin.

Komiteti Drejtues i Partisë Socialiste të Rrethit Lushnje e ka konsideruar të paligjshëm vendimin e Komisionit të Zonës së Dushkut me arsyetimin: "... se Komisioni i Zgjedhjeve të Komunës në kundërshtim me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr.7573, datë 16.06.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal", ka deklaruar të pavlefshme votimet në qendrën e votimit nr.8 të fshatit Zhamë, se në listat e zgjedhësve nuk ishin numrat e dokumenteve identifikues, në një kohë që në ligjin "Për zgjedhjet e organeve të

pushtetit lokal” parashikohen shprehimisht rastet kur fletët e votimit janë të pavlefshme (neni 68/4 e 75)”.

Në datë 05.08.1992 Partia Socialiste në Lushnje duke u bazuar në nenin 39 të ligjit “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, e ka kundërshtuar vendimin e Komisionit të zonës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vërtetimin e datës 14.08.1992 është përgjigjur: “Në bazë të dokumentacionit që disponon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për komunën e Dushkut të Rrethit të Lushnjes ka shpallur kryetar komune Selfo Riza Dyrmishi të Partisë Socialiste”.

Pasi ka marrë përgjigjen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Partia Socialiste në Rrethin e Lushnjes ka mësuar se në datë 14.08.1992, gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Artan Gjermani pa e përfillur përgjigjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në bazë të nenit 29 të ligjit nr.7572, datë 10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” ka lëshuar vendimin e vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të komunës Dushk për Nasibi Bakiasin të Partisë Demokratike.

Kundër vendimit të gjyqtarit të vetëm, Partia Socialiste, në bazë të neneve 10 e 29 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, është ankuar në gjykatën e rrethit dhe ka kërkuar anulimin e mandatit dhënë Nasibi Bakiasit. Gjykata e Rrethit Lushnje me vendimin nr.547, datë 03.09.1992 ka rrëzuar kërkesën e ankuesit si të palegjitimuar. Në pjesën përshkruese Gjykata e Rrethit Lushnje arsyeton: “... Në rastin konkret në bazë të ligjit për zgjedhjet, Partia Socialiste në qoftë se do të kishte ndonjë pretendim për rregullshmërinë e zgjedhjeve duhej të ankohej brenda 3 ditëve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, i cili brenda 3 ditëve duhet të merrte vendim, gjë e cila nuk është bërë. Vetëm vërtetimi i lëshuar nga kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dërguar seksionit të organizimit Lushnje në mënyrë të njëanshme dhe jo vendim i Komisionit nuk bën të mundur anulimin e mandatit të Nasibi Bakiasit e të ligjërojë atë të Selfo Dyrmishit”.

Kundër vendimit të gjykatës së rrethit, Partia Socialiste është ankuar në Gjykatën e Kasacionit dhe ka marrë këtë përgjigje: “Lidhur me kërkesën tuaj drejtuar kësaj Gjykate ju njoftojmë se çështjen e shqyrtuam dhe nuk e shohim me vend që të ushtrojmë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë”.

Vendimin e Komisionit të Zgjedhjeve të Zonës Dushk,

veprimet e seksionit të organizimit Lushnje, vendimet e gjykatës së rrethit dhe qëndrimin e Gjykatës së Kasacionit, kërkuesi i quan shkelje flagrante të të drejtave të zgjedhësve të sektorit Zhamë dhe të gjithë atyre që kanë votuar për të si dhe shkelje të nenit 19 të ligjit kushtetues nr.7692, datë 31.03.1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese t'i njohë dhe garantojë të drejtën e sanksionuar nga neni 19 i ligjit kushtetues nr.7692, datë 31.03.1993.

Përsa parashtron kërkuesi Selfo Dyrmishi, ne gjyqtarët në pakicë çmojmë se Gjykatës Kushtetuese në fakt i është paraqitur për shqyrtim një çështje konkrete, ku pretendohet se në mënyrë të paligjshme është shpallur kryetar komune një person tjetër, duke iu shkelur kërkuesit një e drejtë e mbrojtur nga ligji kushtetues nr.7692, datë 31.03.1993 (neni 19).

Objekti i kërkesës është e drejta themelore e zgjedhjes. Në bazë të kësaj të drejte çdo shtetas ka të drejtën dhe mundësinë që, pa asnjë diskriminim dhe pa kufizime të paarsyeshme “të votojë dhe të zgjidhet, gjatë zgjedhjeve periodike të ndershme, me votim të përgjithshëm, të barabartë e të fshehtë, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të popullit”. (Neni 25/6 i Paktit Ndërkombëtar Për të Drejtat Civile dhe Politike)

E drejta për t'u zgjedhur nuk do të thorrë vetëm paraqitja dhe pranimi i kandidaturës siç është arsyetuar e vendosur nga shumica. Kjo e drejtë është shumë më e gjerë. E drejta dhe mundësia për t'u zgjedhur kalon nëpër disa faza. Së pari, vënies dhe pranimit të kandidaturës; së dyti, zhvillimit të zgjedhjeve dhe së treti, nxjerrjes së rezultateve të zgjedhjeve. Këto faza janë të parashikuara shprehimisht në ligjin nr.7573, datë 16.06.1992 “Për zgjedhjen e organeve të pushtetit lokal”.

Kërkuesi Selfo Dyrmishi nuk ka paraqitur ankesë as për fazën e parë dhe as për fazën e dytë, por vetëm për atë të fundit dhe konkretisht nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve. Ai pretendon se vendimi i Komisionit të Zgjedhjeve të Komunës së Dushkut, të datës 03.08.1992, është i kundërligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat kryesore kushtetuese dhe konkretisht me nenin 19 të ligjit kushtetues “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, sepse votimet i ka fituar ai dhe jo kandidati i Partisë Demokratike. Sipas kërkuesit dhe provave të paraqitura nga ai këtë e konfirmoi edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pavarësisht nga forma e

përgjigjes “Vendim” apo “Vërtetim”. Nga përmbajtja e saj rezulton se “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për Komunën e Dushkut, të Rrethit të Lushnjes ka shpallur kryetar komune Selfo Riza Dyrmishi të Partisë Socialiste”.

Në këto rrethana del se janë shpallur kryetarë dy persona për të njëjtën komunë, njëri nga komisioni i zgjedhjeve të zonës dhe tjetri nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Për këto çështje në ligjin “Për zgjedhjet e organeve lokale të pushtetit”, është përcaktuar organi kompetent dhe afati për paraqitjen e ankimit kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (neni 40), që është Gjykata e Kasacionit.

Në bazë të dispozitës së lartpërmendur çdo subjekt i interesuar që do të kishte pretendime për mënyrën e zgjidhjes të kësaj çështje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhej të ankohej në Gjykatën e Kasacionit dhe jo të shpejtonte procedurën e vërtetimit të vlefshmërisë së një mandati të ankimit. Respektimi i përpiktë i formës procedurale siguron zbatimin e drejtë të detyrave për shqyrtimin dhe zgjidhjen në përputhje me qëllimet e ligjit të çdo pretendimi.

Në bazë të nenit 10/a, b të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, organet që kanë shqyrtuar këtë çështje mbi bazë ankimi kishin për detyrë të verifikonin ligjshmërinë e zgjedhjes së kryetarit të komunës së Dushkut, se mos ai ishte zgjedhur me mashtrim, falsifikim ose mënyra të tjera të kundërligjshme.

Vendimi i Komisionit të Zgjedhjeve të komunës së Dushkut i datës 03.08.1992, nuk i është nënshtruar kontrollit të ligjshmërisë. Këtë ka kërkuar edhe Partia Socialiste dhe kandidati i saj Selfo Dyrmishi në të gjitha ankimet e bëra. Nuk është faji i ankuesit që nuk është respektuar ligji nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe hallkat e tjera gjyqësore.

Për zgjidhjen e kësaj çështje, është e domosdoshme të analizohen dy probleme: 1. A legjitimohet shtetasi Selfo Dyrmishi për ngritjen e një kërkesë të tillë dhe, 2. A është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese shqyrtimi i kësaj çështje?

Në ligjin “Për zgjedhjen e organeve lokale të pushtetit”, janë parashikuar organet kompetente dhe afatet për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankimeve, por nuk thuhet se kush ka të drejtë të bëjë ankim. Në nenin 10, shkronja “b”, paragrafi i katërt, të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, parashikohet

se ankimi për anulimin e mandatit bëhet nga personi i interesuar. Siç shihet nga kjo dispozitë, rezulton se për të parashtruar një kërkesë ankimore është e nevojshme që personi të ketë interes që të kërkojë nga organet shtetërore kompetente ose gjykata njohjen dhe rivendosjen e një të drejte. E parë kjo dispozitë në lidhje edhe me paragrafin e dytë të nenit 1 të ligjit për zgjedhjet ku thuhet se "... Kryetarët e komunave dhe të bashkive zgjidhen me sistem mazhoritar ...", nuk mund të pranohet se persona të interesuar janë vetëm "Subjektet elektorale - Partitë Politike që kanë paraqitur kandidatët e tyre", siç është pranuar e vendosur nga shumica.

Vënia e kandidaturës nga çdo shtetas nëpërmjet ndonjë subjekti politik dhe pranimi nga kjo e fundit të konkurrojë në fushatën elektorale me atë kandidat është rruga juridike me anën e së cilës, kandidati dhe subjekti synojnë të realizojnë ato të drejta që u garanton ligji për zgjedhjet. Edhe kur kandidatura është vënë nëpërmjet ndonjë subjekti politik, shtetasi nuk e humbet të drejtën për të kërkuar njohjen dhe garantimin e një të drejte ligjore në mënyrë të detyrueshme. Si shtetasi që ka vënë kandidaturën nëpërmjet një partie politike, ashtu edhe partia që ka vendosur të marrë pjesë në fushatën elektorale me këtë kandidat janë njëloj të interesuara. Qëllimi kryesor i tyre është finalizimi i fushatës së zgjedhjeve.

Megjithatë në rastin konkret kërkuesi Selfo Dyrmishi nuk kërkon njohjen dhe garantimin e një të drejte të sanksionuar në ligjin elektorale, por njohjen dhe garantimin e një të drejte themelore të sanksionuar në ligjin kushtetues "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut". Ligjet e zakonshme nuk mund të zhveshin subjekte të ndryshme nga gëzimi i të drejtave që u garanton paketa e ligjeve kushtetuese.

Mjeti për mbrojtjen e të drejtave themelore kushtetuese është kërkesa e të interesuarve drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Sipas nenit 25 të ligjit kushtetues nr.7561, datë 29.04.1992 "Për fillimin e procedurës kanë të drejtë të bëjnë kërkesë: Presidenti i Republikës, një grup parlamentar, 1/5 e deputetëve, Këshilli i Ministrave, gjykatat, organet lokale të pushtetit si dhe çdo person, lidhur me shkeljen e lirive dhe të drejtave të tij të parashikuara nga Kushtetuta". Siç shihet në këtë dispozitë përmenden në mënyrë taksative subjektet që legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

Vlen të theksohet se personat qofshin juridikë ose fizikë legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese jo vetëm se subjekte të tilla janë përcaktuar në nenin 25/2, por edhe se

legjitimimi i këtyre personave përcaktohet nga disa kushte, së pari nga lloji i çështjes, nëse është ose jo kushtetuese dhe së dyti nga lidhjet dhe interesi që ka me çështjen personi kërkues.

Duke analizuar çështjen objekt shqyrtimi arrijmë në përfundimin se kërkuesi Selfo Dyrmishi ka të drejtë të iniciojë në Gjykatën Kushtetuese një gjykim konkret për të kërkuar rivendosjen e të drejtave të tij themelore të cenuara nga aktet e paligjshme. Që të justifikohet juridikisht kërkimi duhet të bëhet vetëm nga personi që i përket e drejta. Një e drejtë e tillë i përket ekskluzivisht kërkuesit. Kjo del nga përmbajtja e nenit 19/1 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, ku thuhet: “Çdo shtetas që ka mbushur moshën 18 vjeç ka të drejtën e zgjedhjes...”. Nga leximi, studimi dhe interpretimi i kësaj dispozite kushtetuese rezulton se subjekte që kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për fillimin e procedurës në Gjykatën Kushtetuese janë shtetasit që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe kanë pranuar të konkurrojnë në zgjedhjet e organizuara për organet lokale të pushtetit.

Juridiksioni është kushtetues, kur, sipas ligjit kushtetues, e drejta dhe detyra për shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes i është njohur Gjykatës Kushtetuese. Në dispozitat e ligjit kushtetues nr.7561, datë 29.04.1992 (Organizimi i Drejtësisë dhe Gjykata Kushtetuese), është përcaktuar juridiksioni për çdo çështje të veçantë që ka lidhje me të drejtat themelore dhe interesat e mbrojtura nga ligji kushtetues. Pikërisht për këtë arsye në pikën 9 të nenit 24 të ligjit të sipërpërmendur parashikohet dhe përcaktohet: “Gjykata Kushtetuese ... zgjidh përfundimisht ankesat e personave të paraqitura në rrugën e kontrollit kushtetues për shkeljen e të drejtave të tyre themelore nga aktet e paligjshme”.

Nga ka dyshim se e drejta për t’u zgjedhur është një e drejtë themelore kushtetuese, që nuk mund të mohohet. Siç e theksuam edhe më lart, ajo kalon nëpër disa faza të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr.7573, datë 16.06.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, që fillon me vënien e kandidaturës dhe përfundon me zgjedhjen ose jo të kandidatit.

Pika 9 e nenit 24 të ligjit kushtetues nr.7561, datë 29.04.1992, në mënyrë të shprehur parashikon se Gjykata Kushtetuese zgjidh përfundimisht ankesat e personave për shkeljen e të drejtave të tyre themelore nga aktet e paligjshme. Prej këtij rezulton në mënyrë të qartë e pa ekuivoke se juridiksioni i kësaj Gjykate, për këto kategori çështjesh konkrete, nuk është juridiksion fillestar, por juridiksion

përfundimtar, dmth, i fundit. Në një përfundim të tillë Gjykata Kushtetuese ka arritur edhe në arsyetimin që i ka bërë vendimit të saj nr.5, datë 15.04.1994 “Për garantimin dhe respektimin e së drejtës për tubime paqësore në vendet dhe sheshet e kalimit publik”.

Kjo do të thotë se Gjykata Kushtetuese mund të investohet për çdo shkelje të të drejtave kushtetuese, nga aktet e paligjshme vetëm pasi shqyrtimi i saj të ketë përfunduar në të gjitha organet e tjera shtetërore të përcaktuara me ligj, si dhe në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të të gjitha shkallëve. Kështu është vepruar edhe në rastin që po analizojmë. Kërkuesi pretendon se është shkelur një e drejtë e tij mbrojtur nga ligji kushtetues. Ai kërkon nga Gjykata Kushtetuese rivendosjen e kësaj të drejte. Është kompetencë funksionale e Gjykatës Kushtetuese të përcaktojë në se është shkelur ose jo një e drejtë e mbrojtur nga ligji kushtetues. Sipas kësaj kompetence Gjykatës Kushtetuese i njihet e drejta me ligj kushtetues mbi kërkesën e personave lidhur me shkeljen e lirive dhe të drejtave të tyre të parashikuara nga kushtetuta të ushtrijë funksione të veçanta duke shqyrtuar dhe kontrolluar veprimet e organeve të ndryshme shtetërore dhe gjykatave që e kanë gjykuar çështjen.

Këtë qëndrim Gjykata Kushtetuese e ka mbajtur me vendimin nr.3, datë 28.02.1994, me anën e të cilit janë shpallur si antikushtetues vendimet nr.370, datë 29.04.1993 të Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe nr.152, datë 11.08.1993 të këshillit gjyqësor të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit. Gjatë gjithë periudhës që nga krijimi i Gjykatës Kushtetuese e në vazhdim nuk është paraqitur ndonjë argument i kundërt për ndryshimin e këtij precedenti.

Arsyetimi i mësipërm na detyron të themi se shtetasi Selfo Dyrmishi legjitimohet në paraqitjen e kërkesës dhe Gjykata Kushtetuese është kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje. Shumica e gjyqtarëve që vendosën rrëzimin e kërkesës kanë vepruar në kundërshtim me pikat 1, 3, 9, 10/2 e 3 të neneve 24 dhe 25/2 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. (Organizimi i Drejtësisë dhe Gjykata Kushtetuese)

Anëtarë: Ylvi Myrtja, Veli Budo

* * *

Vendim nr. 4, datë 02.04.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Manol Konomi, Veli Budo, Zija Vuci, Franc Jakova, Alfred Karamuço, Metush Saraçi, anëtarë, me sekretare Drita Filto, në datat 11.03.1996 dhe 15.03.1996, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.11 Akti, që u përket:

K Ë R K U E S: **GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE,**
përfaqësuar nga Fehmi Abdiu,
Ndre Legisi dhe Pandeli Majko.

O B J E K T I: Shpalljen antikushtetues në tërësi të ligjit nr.8055, datë 01.02.1996 “Për ndryshimet në ligjin nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”” si dhe të neneve 16, paragrafi i dytë e 42 shkronja “ç” të këtij ligji.

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste ka parashtruar këto shkaqe:

a) Në kundërshtim me nenin 23 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, nuk është marrë në shqyrtim projektligji i paraqitur nga një grup deputetësh, për disa shtesa e ndryshime në ligjin e zgjedhjeve nr.7556, datë 04.02.1992 dhe nuk është përfshirë në kohën e duhur në programin e punës të Kuvendit Popullor;

b) Shkronja “ç” e nenit 42 të ligjit nr.8055, datë 01.02.1996, prek një të drejtë të fituar në bazë të ligjit kushtetues, duke shtrirë efektin e saj në të kaluarën;

c) Paragrafi i dytë i nenit 16 të këtij ligji vjen në kundërshtim me nenin 28 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, sepse kjo dispozitë nuk i njeh Presidentit të Republikës kompetencën që parashikohet në këtë paragraf.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relacionin përkatës,

V Ë R E N:

1. Pretendimi i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste se ligji nr.8055, datë 01.02.1996 është në tërësi antikushtetues për arsye se është shkelur përmbajtja e nenit 23 (paragrafi i parë) i ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, është pa vend.

Neni 23 i ligjit kushtetues, cakton se kush ka të drejtën e iniciativës legjislative dhe në bazë të këtij neni, këtë të drejtë e ka, përveç Presidentit të Republikës e Këshillit të Ministrave dhe çdo deputet ose grup deputetësh.

Vënia në programin e punës të Kuvendit Popullor e një projekti ose propozim ligji, afati për përfshirjen e tij në këtë program, dhënia ose jo prioritet atij projekti që është paraqitur më parë, nuk kanë asnjë lidhje me nenin 23 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me iniciativën legjislative.

Iniciativa legjislative dhe neni 23 që e parashikon atë, do të cënoheshin në rast se një projekt ose propozim ligji nuk do të merrej fare në shqyrtim në kohën e përcaktimit të programit të punimeve për një periudhë të caktuar, të Kuvendit Popullor. Iniciativa legjislative do të cenohej gjithashtu në qoftë se, në përcaktimin e këtij programi nuk do të respektohej procedura e parashtruar nga rregullorja e Kuvendit Popullor dhe konkretisht nga normat e neneve 9 e 10.

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste në kërkesën që i ka drejtuar kësaj Gjykate nuk pretendon se është shkelur procedura e rregullores, por mbron pikëpamjen se iniciativa e ndërmarrë nga një grup deputetësh të grupeve të ndryshme parlamentare që në muajin dhjetor të vitit të kaluar, duhej të përfshihej me kohë në programin e punimeve të Kuvendit Popullor dhe, me kohë ai duhej të ishte marrë në shqyrtim prej tij.

Gjykata Kushtetuese çmon se nuk është në kompetencën e saj të shqyrtojë përse Kryesia e Kuvendit Popullor nuk e vuri me kohë projektin në fjalë në programin e punimeve, sikundër nuk është në kompetencën e saj të shqyrtojë përse në mbledhjen e Kryesisë me kryetarët e grupeve parlamentare dhe në mbledhjet e tjera, është vendosur me shumicë votash, përfshirja në programin e punës e projektit të paraqitur nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe jo ai i grupit të deputetëve.

Nga shqyrtimi i dokumentave vërtetohet se programi i punës të Kuvendit Popullor në të gjitha fazat është bërë në respektim të plotë të Rregullores së Kuvendit Popullor (nenet 9 e 10), duke patur

parasysh edhe propozimin e pakicës. Përveç kësaj, mospërfshirja e projektit të grupit të deputetëve në programin përfundimtar nuk e privonte këtë grup nga e drejta për të paraqitur propozimet e veta në formë amendamentesh kur do të kalohej në miratimin nën për nen të projektit të paraqitur nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike.

2. Në kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, thuhet tekstualisht: “Humbja e së drejtës për t’u zgjedhur deputet për në Kuvendin Popullor, sipas shkronjës “ç” të nenit 42 ka të bëjë me zgjedhjet që do të bëhen pas kësaj, pra në të ardhmen. Ajo nuk ka fuqi prapavepruese”.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së sipërme të kërkesës dhe i pretendimit për të shpallur antikushtetuese, shkronjën “ç” të nenit 42, del e qartë se këtu kërkuesi mban dy qëndrime diametralisht të kundërta; nga njëra anë duke u mbështetur në kuptimin e shkronjës “ç” të nenit 42 mbrohet teza se ajo zbatohet në të ardhmen dhe nga ana tjetër, pretendon se ajo prek një të drejtë të fituar me ligj kushtetues dhe si e tillë është e papajtueshme me të.

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste do të legjitimohej të ngrinte përpara Gjykatës Kushtetuese, antikushtetutshmërinë e shkronjës “ç” të nenit 42 të ligjit nr.8055, datë 01.02.1996 vetëm po të ishte se ligji, do të shprehej mbi veprimin e saj ose ajo do të interpretohej e zbatohet në kundërshtim me pikëpamjen e tij dhe jo duke u mbështetur në hipoteza të mundshme, të cilat nuk mund të formojnë objekt shqyrtimi nga kjo Gjykatë.

3. Në lidhje me përmbajtjen e nenit 28 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, Gjykata e çmon të nevojshme të verë në dukje se ajo nuk ka siç pretendon pala kërkuese, karakter absolutisht kufizues.

Në krye të këtij neni, i cili cakton kompetencat e Presidentit të Republikës, thuhet: “Presidenti i Republikës ka këto kompetenca kryesore”, gjë që do të thotë se kjo dispozitë kushtetuese e le të lirë ligjvënësin t’i japë të drejtën Presidentit të Republikës të nxjerrë akte për çështje që nuk parashikohen nga kjo dispozitë (neni 28), që nuk përbëjnë një largim dhe nuk vijnë në kundërshtim me kompetencat që ky nen përmend. Këtë tagër ligjvënësi e ka përdorur edhe në disa ligje të miratuara përpara ligjit nr.8055, datë 01.02.1996.

Paragrafi i parë i nenit 16 të ligjit nr.8055, datë 01.02.1996 parashikon në pajtim me ligjin kushtetues (neni 17 paragrafi i parë i ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”) krijimin e 115

zonave të zgjedhjeve dhe njëkohësisht cakton kriteret precize për ndërtimin e këtyre zonave, të kenë një numër afërsisht të barabartë zgjedhësish, të jenë kompakt, të kenë vazhdimësi gjeografike, të mos bëhet coptimi i komunave. Këto janë kriteret bazë që ligjvënësi i ka rregulluar vetë, me ligjin e sipërm, kurse caktimi i zonave kufijtë dhe renditja e tyre do të bëhet, duke respektuar rigorozisht këto kriteret. Edhe në ligjin nr.7556, datë 04.02.1992, neni 29 paragrafi i dytë, parashikohej se kufijtë e zonave të zgjedhjeve dhe renditja e tyre bëhej me akt të Presidentit të Republikës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 24 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””, njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, për shfuqizimin e ligjit nr.8055, datë 01.02.1996 “Për ndryshimet në ligjin nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”” dhe nenit 16 paragrafi i parë e nenit 42 shkronja “ç” të këtij ligji, si të pabazuar.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

* * *

Vendim nr. 10, datë 10.05.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Manol Konomi, Feti Gjilani, Veli Budo, Franc Jakova, Zija Vuci, Alfred Karamuço, anëtarë, asistuar nga sekretarja Drita Filto, në datë 08.05.1996 mori në shqyrtim çështjen që i përket:

K Ë R K U E S: **KOMISIONI I ZONËS ELEKTORALE NR.26,**
i përfaqësuar nga kryetari i saj Jonuz Muça.

O B J E K T I: Shfuqizimin e vendimit nr.351, datë 04.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi shqyrtoi materialet e paraqitura,

V Ë R E N:

Komisioni i zonës elektorale nr.26, në datën 29.04.1996 ka marrë vendimin që të refuzojë regjistrimin si kandidat për deputet në Kuvendin Popullor të Luan Mersin Rama, të paraqitur nga Partia Socialiste si subjekt elektoral.

Në datën 04.05.1996, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shqyrtuar ankimin e Luan M.Rama dhe me vendimin 351 ka vendosur pranimin e ankesës dhe prishjen e vendimit të Komisionit të zonës nr.26.

Kundër këtij vendimi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 07.05.1996 ka paraqitur ankesë në Gjykatën Kushtetuese, në emër të komisionit të zonës, kryetari i saj Jonuz Muça.

Gjykata Kushtetuese, pa i hyrë shqyrtimit në themel të çështjes, konstaton se në bazë të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 "Për zgjedhjet në Kuvendin Popullor" ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 01.02.1996, Komisionet e zonave nuk legjitimohen të paraqesin ankime në këtë Gjykatë ndaj vendimeve të Komisionit Qendror. Në bazë të dispozitave të mësipërme, e konkretisht të neneve 36, 38 e 50 të ligjit, instituti i ankimit është mjet ekskluziv i subjekteve elektorale dhe i të kandiduarve prej tyre për të garantuar respektimin e të drejtave që burojnë nga ligjet kushtetuese e ato elektorale e për pasojë vetëm ato mund të venë në lëvizje me ankim qoftë komisionet e zonave apo atë qendror, ashtu edhe Gjykatën Kushtetuese.

Në këtë kushte, bazuar në nenin 24 pika 7 e ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"", Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës për mungesë legjitimimi.
- Ky vendim është i formës së prerë, dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 11, datë 10.05.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Manol Konomi, Feti Gjilani, Zija Vuci, Franc Jakova, Alfred Karamuço, Veli Budo, anëtarë, me sekretare Drita Filto, në datë 08.05.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.17 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA DEMOKRISTIANE E SHQIPERISE,**
përfaqësuar nga Mitër Mysliu.

O B J E K T I: **Prishjen e Vendimeve nr.342 dhe nr.353,**
datë 02.05.1996 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve për mospranimin për regjistrim
të kandidatëve për deputetë të Z.Z. Mati
Pal Pepa në zonën e zgjedhjeve nr.2 dhe
Hasan Abdurrahim Kuta në zonën e
zgjedhjeve nr.28.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin e tij nr.353, datë 02.05.1996, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Partisë Demokratike të Shqipërisë për prishjen e vendimit të komisionit të zonës së zgjedhjeve nr.28, me të cilin është vendosur refuzimi i regjistrimit të Hasan Kuta, si kandidat për deputet në Kuvendin Popullor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka quajtur të drejtë vendimin e komisionit të zonës me arsyetimin se kërkesa është paraqitur nga subjekti elektoral jashtë afatit ligjor.

Gjatë shqyrtimit të çështjes ka rezultuar se kërkesa për regjistrim së bashku me dokumentet e nevojshme të parashikuara në ligjin për zgjedhjet, është dorëzuar pranë zyrës së PTT-së në

datë 27.04.1996. Ky fakt u vërtetua me dëftesën e zyrës postare me datën e sipërme.

Gjykata çmon se dorëzimi i kërkesës në zyrën postare përsa i përket afatit ligjor është i barazvlershëm me dorëzimin e saj në komisionin e zgjedhjeve të zonës.

Në këto kushte vendimi nr.353, datë 02.05.1996 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duhet të shfuqizohet si i pabazuar në ligj.

I pabazuar është vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve edhe përsa i përket mospranimit të ankimit që ka ushtruar ky subjekt elektoral kundër qëndrimit që ka mbajtur komisioni i zonës elektorale nr.2, i cili ka refuzuar ta regjistrojë si kandidat për deputet Mati Pal Pepa.

Në vendimin e tij ky komision ka pranuar se shkak i vetëm që e ka çuar atë në këtë përfundim ka qenë mosparaqitja për regjistrim e të lartpërmendurit në komisionin e zonës elektorale, brenda afatit ligjor.

Një konkluzion i tillë nuk është i bazuar. Përfaqësuesi i Partisë Demokristiane ngriti përpara kësaj Gjykate disa pretendime dhe i shoqëroi këto edhe me prova shkresore. Nga këto prova rezulton se ndryshe nga ç'ka pranuar në vendimin e tij Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shkaqet e vërteta të mosregjistrimit si kandidat për deputet të Mati Pal Pepa, kanë qenë disa pengesa të tjera që i janë krijuar atij padrejtësisht nga vetë ky komision deri në datën 26.04.1996.

Veç kësaj Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pa bërë asnjë hetim ka rrëzuar pretendimin kryesor se Mati Pal Pepa në datën 27.04.1996 është paraqitur në zonën elektorale nr.2 dhe për orë të tëra nuk ka mundur të kontaktojë me komisionin jo për faj të tij.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.11.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me nenin 27 të ligjit nr.8055, datë 01.02.1996 "Për ndryshimet në ligjin nr.7556, datë 04.02.1992 "Për zgjedhjet në Kuvendin Popullor të Republikës së Shqipërisë"", me shumicë votash,

V E N D O S I:

Shfuqizimin e vendimeve nr.353 dhe nr.342, datë 02.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Kuvendit Popullor.

Urdhërohet regjistrimi i Hasan Abdurrahman Kuta si kandidat për deputet në zonën nr.28 dhe Mati Pal Pepa në zonën nr.2 të paraqitur nga Partia Demokristiane e Shqipërisë si subjekt elektoral.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër vendimit të shumicës vetëm për a i përket ankimit lidhur me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.352, datë 02.05.1996 për mosregjistrimin e kandidatit për deputet, Mati Pal Pepa.

Nuk ka rezultuar asnjë provë bindëse që mosregjistrimi i këtij kandidati të ketë ardhur për faj të komisionit të zonës së zgjedhjeve nr.2. Subjektit kërkues nuk i është krijuar asnjë lloj pengese për regjistrimin e kandidatit ose për paraqitjen e dokumenteve.

Kryetar: Rustem Gjata

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër vendimit të shumicës vetëm për a i përket pjesës së dytë të tij dhe që ka lidhje me kandidatin për deputet në zonën e zgjedhjeve nr.2 Mati Pal Pepa, për arsyet që vijojnë:

I përmenduri ka pretenduar se në pasditen e datës 27.04.1996, është paraqitur me të gjitha dokumentet e kërkuara nga ligji për zgjedhjet në qendrën e zonës së zgjedhjeve nr.2, ka nderuar aty në pritje me orë të tëra, por nuk ka mundur të kontaktojë me komisionin, mbasi nuk kanë qenë aty asnjë nga anëtarët e komisionit.

Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të çështjes, ai ka pretenduar se faktin që atje në atë kohë, nuk ka qenë asnjë nga komisioni i zgjedhjeve, e vërteton me një dokument të firmosur nga personat që kanë qenë të pranishëm dhe kanë vërejtur një gjë të tillë. Ky dokument, sipas tij ndodhet bashkë me materialet e tjera në dosjen e tij për vënien e kandidaturës.

Pretendimi i tij se në pasditen e datës 27.04.1996 në qendrën e zonës së zgjedhjeve nr.2 nuk ka qenë asnjë nga anëtarët e komisionit, nuk duhej pranuar si i provuar pa bërë më parë verifikimet e nevojshme.

Për këto arsye i qëndroj mendimit se vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Kuvendit Popullor, përsa i përket kandidatit për deputet në zonën e zgjedhjeve nr.2, Mati Pal Pepa duhej të prishej dhe çështja t'i kthehej përsëri Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të bërë verifikimet përkatëse përsa ka pretenduar kërkuesi dhe pastaj të vendoste nëse duhej ose jo të regjistrohej si kandidat për deputet.

Anëtar: Veli Budo

* * *

Vendim nr. 12, datë 13.05.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Feti Gjilani, Veli Budo, Franc Jakova, Alfred Karamuço, Zija Vuci, anëtarë, me sekretare Drita Filto, në datë 11.05.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.19 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA BASHKIMI SOCIAL DEMOKRAT I SHQIPERISE,**
përfaqësuar nga Shaqir Rexhvelaj.

SUBJEKT
I INTERESUAR: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Genc Bektashi.

O B J E K T I: **Shfuqizimi i vendimeve nr.342, datë 04.05.1996 dhe nr.353, datë 06.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që i përkasin zonave të zgjedhjeve nr.17 Lezhë dhe nr.19 Pogradec.**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Partia e Bashkimit Socialdemokrat të Shqipërisë, si subjekt elektoral në zgjedhjet e 26 majit të vitit 1996 ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese shfuqizimin e dy vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke parashtruar se kandidaturat e saj për deputetë në Kuvendin Popullor, të paraqitura, njëra në zonën elektorale nr.17 Lezhë për Pjerin Pal Ivanaj dhe tjetra në zonën elektorale nr.99 Pogradec për Valentina Zylfi Bregu, padrejtësisht janë quajtur të parregullta për t'u regjistruar në listat njëemërore.

Kërkesa e këtij subjekti elektoral është e drejtë vetëm përsa i përket kandidaturës për deputet të Pjerin Ivanaj.

U vërtetua se kërkesa për regjistrimin e kësaj kandidature së bashku me dokumentacionin përkatës është depozituar në Komisionin e zonës elektorale nr.17 në datën 26.04.1996. Ky fakt rezultoi nga vetë përmbajtja e vendimit nr.343, datë 04.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si edhe nga procesverbali datë 30.04.1996 i mbajtur në Komisionin e Zonës.

Në të dy këto akte është pasqyruar në mënyrë të përgjithshme dhe të papërcaktuar se si shkak i vetëm i mosregjistrimit të Pjerin Ivanaj si kandidat për deputet, ka qenë "parregullsia e dokumentacionit të paraqitur në komisionin e zonës". Megjithatë, as ky as Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk kanë treguar se ku konsistojnë konkretisht këto parregullsi.

Është kërkesë ligjore që Komisioni Qendror të verifikojë pretendimet e subjekteve kundër vendimeve ose veprimeve të komisioneve të zonave dhe të japë vendim të motivuar.

Meqënëse këto kërkesa nuk janë zbatuar, vendimi i tij nr.343, datë 04.05.1996, duhet të shfuqizohet, dhe kërkesa për regjistrimin e këtij kandidati t'i dërgohet komisionit të zonës nr.17 Lezhë.

Përsa i përket kërkesës për shfuqizimin e vendimit nr.373, datë 06.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që i përket zonës nr.99 Pogradec, shkaqet e parashtruara nga Partia e Bashkimit Socialdemokrat, janë të pabazuara.

Në zbatim të shkronjës "d" të nenit 20 të ligjit nr.8055, datë 01.02.1996, i cili ka ndryshuar nenin 36 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka ushtruar kontroll për regjistrimet e kandidatëve të bëra në zonën nr.17 Pogradec. Gjatë këtij kontrolli ai ka konstatuar se Valentina Bregu është regjistruar si kandidate për deputete, në

datë 03.05.1996, pra tej afatit të parashikuar nga neni 13 i ligjit “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor”.

Në këto rrethana, ai duke e shqyrtuar çështjen kryesisht me të drejtë ka vendosur shfuqizimin e vendimit të komisionit të kësaj zone.

Valentina Bregu është propozuar nga ky subjekt elektoral si zëvendësuese e një personi tjetër që kishte hequr dorë nga kandidatura për deputet, por ashtu siç ka pranuar me të drejtë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, komisioni i zonës elektorale nr.99, nuk ka pasur parasysh faktin se kandidati që hoqi dorë, nuk ishte regjistruar deri në datën 26.04.1996, dmth., 30 ditë përpara zgjedhjeve. Për rrjedhojë mosrespektimi i këtij kushti, kur janë rastet e parashikuara nga neni 18 i ligjit të sipërpërmendur, i heq të drejtën subjektit elektoral për të regjistruar si zëvendësues kandidatë të tjerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.11.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me nenin 27 të ligjit nr.8055, datë 01.02.1996 “Për ndryshimet në ligjin nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet në Kuvendin Popullor të Republikës së Shqipërisë””, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Shfuqizimin e vendimit nr.343, datë 04.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe detyrimin e komisionit të zonës elektorale nr.17 Lezhë, të marrë në shqyrtim kërkesën e Partisë së Bashkimit Socialdemokrat për regjistrimin si kandidat të tij për deputet në Kuvendin Popullor të Pjerin Pal Ivanaj.

Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e vendimit nr.373, datë 06.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 13, datë 14.05.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Manol Konomi, Feti Gjilani, Veli Budo, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Franc Jakova, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, në datë 13.05.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.22 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA ALEANCA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE,**
përfaqësuar nga Arben Demeti.

SUBJEKT
I INTERESUAR: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE,**
në mungesë.

O B J E K T I: **Shfuqizimi i vendimit nr.341 Prot., datë 05.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për mosregjistrimin Eldriz Basha si kandidat për deputet i Partisë Aleanca Demokratike në zonën elektorale nr.9 dhe shfuqizimi i vendimit nr.348 Prot., datë 02.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për mosregjistrimin e Arben Saraçi si kandidat për deputet i Partisë Aleanca Demokratike në zonën elektorale nr.87.**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

1.Në datë 26.04.1996 Partia Aleanca Demokratike si subjekt elektoral i ka dorëzuar komisionit të zonës elektorale nr.9 dokumentet për regjistrimin e Idriz Basha si kandidat për deputet të saj në këtë zonë. Sipas parashtrimeve të palës kërkuese në kërkesën e paraqitur pranë kësaj Gjykate dhe gjatë shqyrtimit të

çështjes, Idriz Basha, shtetas shqiptar, qysh para disa dekadash është larguar nga Shqipëria dhe është vendosur në Belgjikë; në Republikën e Shqipërisë ka qëndruar vetëm në muajt tetor-nëntor 1995 dhe ka vajtur përsëri në Belgjikë, ku më 19 dhjetor 1995 ka pësuar një aksident të rëndë dhe ka qëndruar atje në spital e nën kontrollin e mjekut deri në 30.04.1996.

Në komisionin e zonës, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe, së fundi, gjatë shqyrtimit të çështjes në këtë Gjykatë pala kërkuese nuk paraqiti prova që Idriz Basha gjatë 6 muajve të ketë pasur vendbanim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese vendimin datë 30.04.1996 të komisionit të zonës nr.9 dhe vendimin nr.Prot.341, datë 05.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për mosregjistrimin e Idriz Basha si kandidat për deputet i gjen të mbështetura në nenin 2 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 01.02.1996, i cili përcakton, ndër të tjera, edhe kushtin e domosdoshëm për të pasur të drejtën për t'u zgjedhur deputet në Kuvendin Popullor - vendbanimin e përhershëm në Republikën e Shqipërisë për një periudhë kohe jo më pak se 6 muaj.

Në kërkesën e saj Partia Aleanca Demokratike ka parashtruar gjithashtu se kërkesa e nenit 2 të ligjit të sipërcituar që ve kusht vendbanimin e përhershëm në Republikën e Shqipërisë jo më pak se 6 muaj për të fituar të drejtën për t'u zgjedhur si deputet, vjen në kundërshtim me nenin 19 të ligjit kushtetues nr.7692, datë 31.03.1993 "Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut". Lidhur me këtë kërkesë Gjykata konstaton se pala kërkuese si parti politike nuk hyn në subjektet e parashikuara në nenin 25 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"", të cilat kanë të drejtë të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Edhe sigla e vënë nga Idriz Basha në kërkesën e Partisë Aleanca Demokratike, pa u paraqitur vetë dhe parashtruar kërkimet e tij për shkelje të të drejtave kushtetuese, nuk e investon Gjykatën për të shqyrtuar kushtetutshmërinë e nenit 2 të ligjit të sipërcituar.

2. Në datë 26.04.1996 Partia Aleanca Demokratike si subjekt elektoral i ka dorëzuar komisionit të zonës elektorale nr.87 dokumentet për regjistrimin e Arben Saraçi si kandidat për deputet të saj në këtë zonë.

Komisioni i zonës me vendimin datë 30.04.1996 ka refuzuar

regjistrimin e Arben Saraçi si kandidat për deputet me arsyetimin se 18 nga personat që kanë nënshkruar listën prej 406 zgjedhësish që përkrahin paraqitjen e kandidatit nuk janë banorë të fshatit Poshnje, pra nuk është respektuar kërkesa e shkronjës “ç” të nenit 13 të ligjit “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”. Po me këtë arsyetim Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.348 Prot., datë 02.05.1996 ka rrëzuar kërkesën e Partisë Aleanca Demokratike për prishjen e vendimit të komisionit të zonës.

Gjykata konstaton se të dy këto vendime janë marrë pa u respektuar procedura e parashikuar në paragrafin e tretë të nenit 14 të ligjit “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, në të cilin thuhet: “Kur komisioni i zgjedhjeve i zonës vëren parregullsi në kërkesën dhe dokumentet për regjistrimin e kandidatëve, njofton subjektet elektorale për ndreqjen e tyre brenda dy ditëve nga konstatimi. Në rast të kundërt, komisioni i zgjedhjeve i zonës merr vendimin përkatës”.

Rrjedhimisht, Gjykata çmon se vendimi i komisionit të zonës nr.87 dhe vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhen shfuqizuar; komisioni i zonës nr.87 duhet t’i japë dy ditë afat palës kërkuese për ndreqjen e parregullsive që konstaton në dokumentet për regjistrimin e kandidatit dhe vetëm pastaj të marrë vendimin përkatës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 01.02.1996, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës së Partisë Aleanca Demokratike për shfuqizimin e vendimit nr.341 Prot., datë 05.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për mosregjistrimin e Idriz Basha si kandidat për deputet i Partisë Aleanca Demokratike në zonën elektorale nr.9;
2. Shfuqizimin e vendimit datë 30.04.1996 të komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.87 dhe vendimit nr.348 Prot., datë 02.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për mosregjistrimin e Arben Saraçi si kandidat për deputet i Partisë Aleanca Demokratike në

zonën elektorale nr.87.

Detyrimin e komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.87 t'i japë subjektit elektorale Partia Aleanca Demokratike 2(dy) ditë afat për ndreqjen e parregullsive të konstatuara në dokumentet për regjistrimin e kandidatit për deputet Arben Saraçi dhe në përfundim të marrë vendimin përkatës.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 14, datë 15.05.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Manol Konomi, Feti Gjilani, Veli Budo, Franc Jakova, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Hilmi Dakli, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, në datat 13.05.1996 dhe 14.05.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.20 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA SOCIALPUNETORE SHQIPTARE,**
përfaqësuar nga Fehmi Luca dhe Fatmir
Braka.

SUBJEKT
I INTERESUAR: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE TE**
REPUBLIKES SE SHQIPERISE,
përfaqësuar nga Genci Bektashi.

O B J E K T I: **Mosregjistrimi i kandidaturës për deputet**
të Bashkim Merkaj në zonën elektorale
nr.84 Mallakastër, në bazë të ligjit nr.7556,
datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit
Popullor të Republikës së Shqipërisë”,
ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 01.02.1996.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Partia Social Punëtore në zonën 84 Mallakastër ka paraqitur si kandidat të saj in Bashkim Merkaj. Për këtë qëllim kandidati në fjalë më datë 25.04.1996 i ka dorëzuar komisionit elektoral të zonës dokumentet e nevojitura dhe konkretisht: kërkesën e Partisë Social Punëtore, dy kopje të deklaratës të vetë kandidatit, vendimin e komisionit shtetëror për kontrollin e figurës morale dhe listën e zgjedhjeve të nënshkruar nga 470 zgjedhës, sipas formës së kërkuar. Në datë 26.04.1996 në orën 20.30 kandidati është paraqitur në komision, ku ishin kryetari dhe anëtarët e komisionit dhe i është kërkuar kryetarit të pajiseshin me dokumentin e dorëzimit, por nga ana e tij iu tha se nuk ishte i nevojshëm. Për këtë shkak anëtarët e komisionit që ishin përfaqësues të subjekteve elektorale, mbajtën një procesverbal të përbashkët me të cilën vërtetohet dorëzimi i dokumentave të 6 partive pjesëmarrëse ndër të cilët edhe ai i Partisë Social Punëtore.

Në datë 29.04.1996, partia ankuese u informua nga përfaqësuesi i saj se mungonin dokumentet e kandidatit. Për t'u siguruar më mirë më datë 30.04.1996 u dërgua në zonë sekretari i përgjithshëm i kësaj partie i cili mori përgjigjen se dokumentet mungonin. Për këtë partia iu drejtua Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me një notë të shkruar rekomande datë 30.04.1996 dhe morën prej tij vetëm një përgjigje gojore, se pranë atij komisioni nuk ndodheshin të paraqitura dokumentet.

Rrethanat e sipërme i provon me kopjen e procesverbalit datë 26.04.1996, me kopjen e notës datë 30.04.1996, një dëftesë postare si edhe me kopjen e shkresës tjetër drejtuar po Komisionit Qendror nr.18 Prot., datë 26.04.1996 me të cilën i është dërguar lista me 6 emra, ndër të cilët edhe kandidati Bashkim Merkaj.

Gjykata nga të dhënat e sipërme konkludon se dokumentet janë paraqitur dhe mungesa e tyre rrjedh për fajin e komisionit të zonës, duke iu mohuar kështu e drejta ligjore e kandidimit. Për rivendosjen e asaj të drejte, palës ankuese i duhet dhënë mundësia e ribërjes së dokumenteve.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit

Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 01.02.1996, si dhe në bazë të nenit 24 pika 10 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, njëzëri,

V E N D O S I:

Detyrimin e komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.84 Mallakastër t'i japë Partisë Social Punëtore një afat të nevojshëm për përgatitjen rishitazi dhe paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar nga neni 13 i ligjit “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor” dhe si të jenë paraqitur në rregull dhe në afatin e caktuar prej tij, të marrë vendimin përkatës.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 15, datë 15.05.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Manol Konomi, Feti Gjilani, Veli Budo, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Franc Jakova, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, në datë 14.05.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.21 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA “BASHKIMI PER TE DREJTAT E NJERIUT”, përfaqësuar nga Maksim Liço.**

SUBJEKT
I INTERESUAR: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE,**
përfaqësuar nga Genci Bektashi.

O B J E K T I: **Mosrregjistrimi i Gjyste Dushku si kandidate për deputete nga komisioni i zgjedhjeve të zonës nr.17**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Partia “Bashkimi për të Drejtat e Njeriut” si subjekt elektoral ka paraqitur pranë komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.17 dokumentet e Gjyste Dushku për ta regjistruar si kandidate për deputete në zgjedhjet për deputetë të Kuvendit Popullor.

Siç rezulton nga pika 8 e Protokollit nr.3, datë 30.04.1996 të komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.17, dokumentet e Gjyste Dushku ky komision i ka gjetur të rregullta, me përjashtim të vendimit datë 24.04.1996 të Komisionit Shtetëror për Kontrollin e Figurës së Zyrtarëve dhe Personave të tjerë, në të cilin mbiemri i shënuar “Dusha” nuk përputhet me mbiemrin “Dushku” të dokumenteve të tjera të paraqitura. Nisur nga ky fakt, komisioni i zgjedhjeve të zonës nr.17, nuk e ka regjistruar Gjyste Dushkun si kandidate për deputete dhe pa pasur asnjë bazë ligjore ka lënë që çështjen ta zgjidhë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Megjithë ndërhyrjet e palës kërkuese, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk e ka zgjidhur këtë problem.

Gjykata çmon se në rastin konkret komisioni i zgjedhjeve të zonës nr.17 ishte i detyruar të zbatonte kërkesën e paragrafit të tretë të nenit 14 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 01.02.1996, sipas të cilit: “Kur komisioni i zgjedhjeve i zonës vëren parregullsi në kërkesën dhe dokumentet për regjistrimin e kandidatëve, njofton subjektet elektorale për ndreqjen e tyre brenda dy ditëve nga konstatimi. Në rast të kundërt, komisioni i zgjedhjeve i zonës merr vendimin përkatës”.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 01.02.1996, njëzëri,

V E N D O S I:

Detyrimin e komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.17 t'i kthejë Partisë “Bashkimi për të Drejtat e Njeriut” dokumentet e Gjyste Dushkut dhe t'i japë 2 (dy) ditë afat për ndreqjen e parregullsisë së

konstatuar dhe pas riparaqitjes së tyre të marrë vendimin përkatës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të vërë menjëherë në dispozicion të komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.17 dokumentet që i përkasin Gjyste Dushku.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 17, datë 17.05.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Manol Konomi, Feti Gjilani, Franc Jakova, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Veli Budo, anëtarë, me sekretare Drita Filto, në datë 16.05.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.25 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: SINAN HYSEN TAFAJ

SUBJEKT

**I INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE TE
REPUBLICES SE SHQIPERISE,
përfaqësuar nga Genci Bektashi.**

O B J E K T I: Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të caktojë anëtar të komisionit të zonës nr.22 përfaqësuesin e propozuar prej Sinan Tafaj si kandidat i pavarur.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Kërkuesi Sinan Hysen Tafaj, është regjistruar si kandidat i pavarur për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të 26 Majit 1996 në zonën e zgjedhjeve nr.22, më datë 26.04.1996. Po atë ditë ai është paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe në zbatim të nenit 37 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të

Republikës së Shqipërisë”, ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të tij në komisionin e zonës përkatëse të zgjedhjeve.

Kërkuesi pretendon se ka marrë përgjigje gojore se kërkesa nuk merret parasysh mbasi është paraqitur jashtë afatit të caktuar nga ky Komision.

Lidhur me këtë përfaqësuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve pranoi se ky komision ka vendosur që afati brenda të cilit subjektet elektorale do të propozonin anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ishte data 22.04.1996.

Gjykata çmon se afati i caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për paraqitjen e propozimeve të përfaqësuesve të subjekteve elektorale për komisionet e zonave deri në datën 22.04.1996, është bërë në përputhje të plotë me përmbajtjen e nenit 37 të ligjit “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor”. Respektimi i këtij afati është i detyrueshëm për partitë politike si subjekte elektorale, kurse për kandidatët e pavarur afati i sipërm nuk mund të zbatohet për vetë faktin se komisioni i zgjedhjeve të zonës fillon nga veprimtaria pas datës 22.05.1996 dhe personat që kërkojnë të kandidohen si të pavarur ende nuk e kanë fituar cilësinë e subjektit elektoral.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 01.02.1996 si dhe në bazë të nenit 24 pika 10 të ligjit “Për Gjykatën Kushtetuese”, njëzëri,

V E N D O S I:

Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të caktojë si anëtar të komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.22 personin e kërkuar si përfaqësues nga kandidati për deputet të pavarur, Sinan Tafaj.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 20, datë 17.05.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Manol Konomi, Veli Budo, Franc Jakova, Alfred Karamuço, Zija Vuci, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, në datë 17.05.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.27 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA E DJATHTE DEMOKRATE,**
përfaqësuar nga Petrit Kalakulla.

SUBJEKT
I INTERESUAR: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Kreshnik Spahiu.

O B J E K T I: **Shfuqizimi i vendimit nr.474, datë**
14.05.1996 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Partia e Djathtë Demokrate, me shkresën nr.2/6, datë 04.05.1996 i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duke u ankuar për veprime të parregullta të disa komisioneve të zgjedhjeve të zonave e që sipas saj kanë konsistuar në mospranimin për shqyrtim të dokumenteve të disa kandidatëve për deputetë e mosdhënien e dokumentit të regjistrimit të kandidatit.

Në datë 14.05.1996, Partisë së Djathtë Demokrate i është paraqitur një njoftim që mban numër 474 Protokollit dhe nënshkruar nga kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas të cilit ankesa nuk është marrë në shqyrtim me arsyetimin se është paraqitur jashtë afateve ligjore.

Ushtrimi i një kompetence të tillë nga ana e kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve bie ndesh me dispozitat ligjore. Në bazë të shkronjës "c" të nenit 36 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 "Për zgjedhjet në Kuvendin Popullor", ndryshuar me ligjin nr.8055,

datë 01.02.1996, të drejtën për të shqyrtuar ankimet ndaj akteve dhe veprimeve të paligjshme e të parregullta të komisioneve të zgjedhjeve të zonave, e ka Komisioni Qendror.

Prandaj, është e drejtë dhe detyrë e vetë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të shqyrtojë ankimin e Partisë së Djathhtë Demokrate dhe të vendosë sipas dispozitave ligjore.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pikat 7 e 9 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” si dhe të nenit 36 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 01.02.1996, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të shqyrtojë ankimin e Partisë së Djathhtë Demokrate të paraqitur në datë 04.05.1996.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 21, datë 21.05.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Manol Konomi, Feti Gjilani, Veli Budo, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Franc Jakova, anëtarë, me sekretare Drita Filto, në datë 20.05.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.28 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA ALEANCA DEMOKRATIKE,**
përfaqësuar nga Arben Demeti.

SUBJEKT

**I INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
në mungesë.**

O B J E K T I: Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të caktojë anëtarë të komisioneve të zgjedhjeve të zonave nr.5, 90, 113 e 115 personat e propozuar nga Partia Aleanca Demokratike.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Partia Aleanca Demokratike në datë 26.04.1996 ka kërkuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që të caktojë në komisionet e zonave të përmendura më lart përfaqësuesit e saj Brahim Lahi, Bashkim Zaimi, Pano Gjiçali, Lulëzim Kaçupaj.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është përgjigjur gojarisht se kërkesa e Partisë Aleanca Demokratike është paraqitur jashtë afatit të caktuar prej tij (22.04.1996) dhe për rrjedhojë nuk mund të bëjë emërimet e personave të propozuar prej saj në zonat përkatëse.

Partia Aleanca Demokratike dhe përfaqësuesi i saj, gjatë seancës gjyqësore, në kundërshtim me përmbajtjen e normës të nenit 37 paragrafi i dytë të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 01.02.1996”, mbrojnë tezën se afati i fundit për emërimin e komisioneve të zgjedhjeve të zonave nga Komisioni Qendror është 26.04.1996, i cili është dhe afati i fundit i caktuar nga ligji i zgjedhjeve (neni 19 paragrafi i katërt) për regjistrimin e kandidatëve për deputetë në Kuvendin Popullor. Pra, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sipas kësaj pikëpamje nuk ka të drejtë të caktojë afate të ndryshme nga ato që parashikon ligji.

Gjykata e quan të nevojshme të theksojë se përmbajtja e nenit 37 paragrafi i dytë i ligjit “Për zgjedhjet”, është e qartë dhe nuk le vend për interpretime. Në këtë nen thuhet shprehimisht: “Komisioni i zgjedhjeve të zonës emërohet si më lart nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve jo më vonë se 30 ditë para ditës së zgjedhjeve”.

Në bazë të kësaj dispozite, Komisioni Qendror nuk mund të emërojë komisionet e zgjedhjeve të zonave më vonë se 30 ditë para ditës së zgjedhjeve (29 ditë), por ai, në mbështetje po të kësaj norme, ka plotësisht të drejtën të emërojë këto komisione edhe para 30 ditëve në një kohë që do shohi të nevojshme dhe gjithnjë para mbarimit të afatit të parashikuar nga ligji për zgjedhjet lidhur me regjistrimin e kandidatëve në Kuvendin Popullor (26.04.1996). Në këto rrethana, Gjykata çmon - këtë pikëpamje ajo e ka shprehur dhe në një vendim të saj të mëparshëm - se afati 22.04.1996 i caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për paraqitjen nga ana e subjekteve elektorale, të përfaqësuesve të tyre në zonat elektorale, është bërë në përputhje të plotë me urdhërimin e nenit 37 paragrafi i dytë i ligjit për zgjedhjet, dhe për pasojë respektimi i këtij afati është i detyrueshëm për partitë politike si subjekte elektorale.

Nga ana tjetër, pretendimi i përfaqësuesit të palës kërkuese se afati 22.04.1996 nuk u është bërë i njohur në mënyrë të rregullt, subjekteve elektorale (partisë politike) është pa vend, sepse nga shqyrtimi i akteve vërtetohet se Partia Aleanca demokratike i ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve propozimet e saj për shumicën e zonave brenda afatit të caktuar (22.04.1996).

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 37 paragrafi i dytë të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 01.02.1996, njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës së Partisë Aleanca Demokratike të Shqipërisë, për caktimin si anëtarë të komisioneve të zgjedhjeve të zonave nr.5, 90, 113 e 115 të personave të propozuar prej saj.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 22, datë 21.05.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Manol Konomi, Feti Gjilani, Veli Budo, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Franc Jakova, anëtarë, me sekretare Drita Filto, në datë 20.05.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.29 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA ALEANCA DEMOKRATIKE,**
përfaqësuar nga Arben Demeti.

SUBJEKT
I INTERESUAR: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
në mungesë.

O B J E K T I: **1. Shfuqizimi i vendimeve nr.459 Prot., datë**
11.05.1996 dhe nr.460 Prot., datë 11.05.1996
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që i
përkasin kandidatëve për deputetë të
Partisë Aleanca Demokratike,
Arban Hasani dhe Jakup Mehmetaj;

2. Shfuqizimin e vendimit nr.452 Prot., datë
10.05.1996 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve që i përket kandidatit për
deputet të Partisë Aleanca Demokratike,
Zeqir Veliu.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

1. Komisionet e Zgjedhjeve të Zonave nr. 8 dhe 1, pasi i kanë gjetur në pajtim me ligjin nr. 7556, datë 04.02.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 01.02.1996, dokumentet e paraqitura nga Partia Aleanca Demokratike për Arban Hasani dhe Jakup Mehmetaj, kanë marrë vendimet përkatëse dhe i kanë regjistruar ata si kandidatë

për deputetë - të parin në zonën e zgjedhjeve nr.8 dhe të dytin në zonën e zgjedhjeve nr.1.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke ushtruar kontroll për regjistrimin e kandidatëve në zona sipas shkronjës “d” të nenit 36 të ligjit, me vendimet nr. 459 prot. dhe nr. 460 prot., datë 11 maj 1996 ka vendosur shfuqizimin e vendimeve të komisioneve të zonave nr.8 dhe nr.1, me arsyetimin se në dokumentacionin e paraqitur për të dy kandidatët “mungon vendimi i komisionit të verifikimit”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Gjykata konstaton se egzistojnë vendimet datë 9 prill 1996 për kandidatin për deputet Arben Hasani dhe datë 18 prill 1996 për kandidatin për deputet Jakup Mehmetaj, të lëshuar nga Komisioni Shtetëror për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë, por Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka quajtur ato të paqena për shkak se nuk janë paraqitur në origjinal, por në kopje të vërtetuara nga noteret.

Kopjet e vendimeve të paraqitura nga pala kërkuese, të vërtetuara rregullisht nga noteria janë të barazvlefshme me origjinalet, dhe përbëjnë dokumente zyrtare me vlerë të plotë. Sipas shkronjës “f” të nenit 39 të ligjit nr.7829, datë 01.06.1994 “Për Noterinë”, noteri “vërteton se kopjet ose shkurtimet e dokumenteve janë të njëjta me origjinalin e paraqitur nga të interesuarit”.

Në këto rrethana, Gjykata e gjen të bazuar kërkesën e Partisë Aleanca Demokratike për shfuqizimin e vendimeve nr.459 Prot., datë 11.05.1996 dhe nr.460 Prot., datë 11.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

2. Me vendimin datë 30.04.1996 komisioni i zgjedhjeve i zonës nr.107 ka refuzuar regjistrimin e Zeqir Veliu si kandidat për deputet i Partisë Aleanca Demokratike me arsyetimin se “në listat e zgjedhësve janë vërejtur parregullsi të theksuara, si psh., firma të falsifikuara, firma të vëna nga persona që nuk janë firma të tyre, veprime si emra të shkruara dy herë si dhe veprime të tjera që nuk janë në përshtatje me ligjin”.

Mbi ankimin e Partisë Aleanca Demokratike, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.452 Prot., datë 10.05.1996 ka vendosur “rrëzimin e ankimit duke lënë në fuqi vendimin e komisionit të zonës nr.107”. Në këtë vendim Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shprehet se: “nga komisioni i zonës janë konstatuar parregullsi në listat e 400 përkrahësve ndonëse është respektuar afati 48 orë për t’i korrigjuar”.

Në listat e përkrahësve të kandidatit Zeqir Veliu, janë krejt

të dukshme shumë raste që një person ka firmosur për dy ose më shumë persona të tjerë, ç'ka tregon jo vetëm parregullsi në plotësimin e listave, por edhe veprime që vijnë në kundërshtim me përmbajtjen e paragrafit të parë të nenit 14 të ligjit, i cili përcakton se çdo zgjedhës duhet të vërë vetë nënshkrimin në listë.

Përsa i përket vërtetimit nr.4, datë 26.04.1996 për regjistrimin e Zeqir Veliu si kandidat për deputet i Partisë Aleanca Demokratike në zonën nr.107, Gjykata çmon se kryetari dhe sekretari i komisionit të zonës e kanë lëshuar atë në kuptimin e pranimit të dokumenteve për shqyrtim. Ky konkluzion rrjedh nga fakti, se nuk mund të merrej nga komisioni i zonës në datë 26.04.1996 vendim për regjistrimin e kandidatëve për deputetë, kur mbledhjen për marrjen e vendimit komisioni e ka zhvilluar në 30.04.1996.

Në këto rrethana Gjykata çmon se kërkesa e Partisë Aleanca Demokratike për shfuqizimin e vendimit nr.452 Prot., datë 10.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet rrëzuar si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 01.02.1996, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin e vendimeve nr.459 Prot., datë 11.05.1996 dhe nr.460 Prot., datë 11.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

Komisioni i zgjedhjeve i zonës nr.8 të regjistrojë dhe të shpallë menjëherë si kandidat për deputet të Partisë Aleanca Demokratike Arban Hasani;

Komisioni i zgjedhjeve i zonës nr.1 të regjistrojë dhe të shpallë menjëherë si kandidat për deputet të Partisë Aleanca Demokratike Jakup Mehmetaj.

2. Rrëzimin e kërkesës së Partisë Aleanca Demokratike për shfuqizimin e vendimit nr.452 Prot., datë 10.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Jemi kundër vendimit, vetëm përse i përket çështjes së kandidatit për deputet Zeqir Veliu, të zonës elektorale nr.107, për këto arsye:

Gjatë shqyrtimit gjyqësor u administruan si prova shkresore një sërë dokumentash (të komisionit të zonës e atij qendror) të cilat për shkak parregullsish e shkeljesh të theksuara duhej të konsideroheshin nul nga Gjykata.

Kështu, komisioni i zonës nr.107 ka lëshuar një vërtetim regjistrimi për kandidatin për deputet, që mban datën 26.04.1996 e që nuk i përgjigjet aspak realitetit - sepse regjistrimi i kandidatëve është bërë më vonë.

Subjekti elektoral paraqiti një procesverbal regjistrimi, që mban datën 30.04.1996, i cili është i plotësuar në të dy rubrikat (regjistrimin si kandidat dhe mosregjistrimin si kandidat), ndërsa në dosjen e Komisionit Qendror procesverbali është plotësuar vetëm në pjesën e dytë, për mosregjistrim, duke përmendur edhe arsyet. Midis pjesës arsyetuese të këtij procesverbali dhe atij që ka subjekti, edhe pse nga i njëjti komision, arsyet nuk janë të njëjta.

Për më tepër, Komisioni Qendror vendimin për refuzimin e kërimit të subjektit elektoral e ka me datë të korrigjuar.

Në këto kushte, dokumentet e administruara nuk mund të vlerësohen si refuzim, siç bëri shumica, ato janë të pavlefshme si për refuzimin ashtu dhe për pranimin e për pasojë Gjykata Kushtetuese e kishte për detyrë të vendoste: "Shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror e të komisionit të zonës, kthimin e dokumenteve komisionit të zonës për t'i shqyrtuar e për të vendosur sipas ligjit".

Anëtarë: Veli Budo; Alfred Karamuço.

* * *

Vendim nr. 23, datë 22.05.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Feti Gjilani, Alfred Karamuço, Franc Jakova, Zija Vuci, Veli Budo, anëtarë, me sekretare Drita Filto, në datë 22.05.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me

dyer të hapura çështjen nr.30 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA E DJATHTE DEMOKRATE,**
përfaqësuar nga Agim Zeka.

SUBJEKT

I INTERESUAR: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga sekretari i Komisionit,
Kreshnik Sahiu dhe Genci Bektashi anëtar
i Komisionit.

O B J E K T I: **Shfuqizimin e vendimit nr.568 Prot.,**
datë 18.05.1996 të Komisionit Qendror
të Zgjedhjeve.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.568 Prot., datë 18.05.1996, ka vendosur rrëzimin e ankesës së Partisë së Djathtë Demokrate për mosregjistrimin e kandidatëve për deputetë të kësaj partie në zonat elektorale nr.115, 17, 113, 33 dhe 31, pasi është paraqitur jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 48 të ligjit "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor".

Kundër këtij vendimi është ankuar në Gjykatën Kushtetuese Partia e Djathtë Demokrate, duke kërkuar prishjen e tij si të pabazuar në ligj.

Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përsa i përket shpalljes së ankesës së subjektit elektoral jashtë afatit ligjor, është vetëm pjesërisht i drejtë dhe i bazuar. Nga shqyrtimi në tërësi i çështjes ka rezultuar se vetëm për kandidatin e zonës nr.17 është marrë vendim mosregjistrimi nga komisioni i zonës me datën 30.04.1996. Për këtë rast ankimi i bërë në Komisionin Qendror me datën 04.05.1996, me të drejtë është rrëzuar për shkak të paraqitjes së ankesës jashtë afatit të parashikuar nga neni 49 i ligjit për zgjedhjet.

Përsa u përket rasteve të zonave të zgjedhjeve nr.31, 33, 113 dhe 115, ankimi i subjektit elektoral është bërë vetëm për

veprime të parregullta të komisioneve përkatëse të zonave. Për këto veprime të komisioneve ligji u ka njohur subjekteve elektorale të drejtën e ankimit në Komisionin Qendror pa e kufizuar këtë të drejtë me ndonjë afat. Si rrjedhojë, Komisioni Qendror ishte i detyruar të shqyrtonte në themel ankimet e paraqitura (neni 36 shkronja “c”).

Në këto kushte Gjykata Kushtetuese merr në shqyrtim pretendimet e parashtruara lidhur me parregullsitë e komisioneve të zonave dhe arrin në këto përfundime:

1. Në zonën elektorale nr.113, komisioni i zonës pa të drejtë nuk ka pranuar për të regjistruar si kandidate për deputete Fiqirete Qoku. Nga procesverbali i mbajtur në komisionin e zonës në datë 27.04.1996 rezulton se dokumentat janë paraqitur brenda kësaj date dhe nuk ka patur asnjë shkak të ligjshëm për mospranimin e tyre.

Prandaj, Gjykata çmon se duhet të detyrohet komisioni i zonës të regjistrojë si kandidate të sipërpërmendurën.

2. Në zonat 115, 33 dhe 31 dokumentet për regjistrimin e kandidatëve janë paraqitur tej afatit ligjor (27.04.1996). Kështu vetë pala kërkuese ka pranuar se në zonën 115 dokumentet i ka paraqitur me datë 29.04.1996, kurse në zonën nr.33 dokumentet i ka paraqitur pas orës 20.00 të datës 27.04.1996. Përsa i përket pretendimit se në zonën nr.31 dokumentet i ka paraqitur brenda afatit ligjor, pala kërkuese deklaroi para Gjykatës se nuk dispononte asnjë lloj prove për ta vërtetuar atë.

Pretendimi se vonesat në paraqitjen e dokumenteve kanë ardhur për shkak të marrjes me vonesë të vendimeve nga Komisioni Shtetëror i Kontrollit të Figurës së Zyrtarëve (datë 26.04.1996), nuk përbën argument ligjor në favor të kërkuësit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pikat 7 e 9 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” si dhe të nenit 36 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 01.02.1996, me shumicë votash,

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Partia Aleanca Demokratike dhe Partia Socialdemokrate, si subjekte elektorale në zgjedhjet e përgjithshme për deputetë të Kuvendit Popullor, të datës 26 Maj 1996, në kërkesën e tyre të përbashkët drejtuar kësaj Gjykate kanë parashtruar:

1. Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për anulimin e vendimit të tij të mëparshëm për 14 zona elektorale të shpallura të ligjshme, është në kundërshtim me ligjin dhe jashtë kompetencave të tij. I vetmi institucion që e ka konstitucionalisht të drejtën formale të shqyrtimit të ankesave lidhur me zgjedhjet është Gjykata Kushtetuese. Si rrjedhim edhe Dekreti i Presidentit të Republikës është i pambështetur në ligj;

2. Përsëritja e zgjedhjeve nuk është vazhdim i zgjedhjeve, por janë zgjedhje të reja, për të cilat duhet të zbatohen procedurat e ligjit për zgjedhjet;

3. Të vendoset pezullimi i zbatimit të Dekretit të Presidentit të Republikës deri në dhënien e vendimit.

Në datë 29.05.1996, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bazë të procesverbaleve të paraqitura nga komisionet e zonave, ka lëshuar komunikatën për rezultatet e votimit të zgjedhjeve për deputetë të Kuvendit Popullor. Në këtë komunikatë është bërë gjithashtu njoftimi se është vendosur shfuqizimi i rezultateve të votimit në tre zona, duke u urdhëruar përsëritja e tyre.

Mbi ankimin e subjekteve të ndryshme elektorale dhe nga kontrolli i bërë kryesisht, më datë 30.05.1996 Komisioni Qendror ka shfuqizuar vendimin e komisionit të një zone dhe më datë 07.06.1996 ka shfuqizuar edhe vendimet e komisioneve të 13 zonave të tjera elektorale.

Gjykata arrin në konkluzionin se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet që ka marrë në datat 30.05.1996 dhe 07.06.1996, nuk ka anuluar ndonjë vendim të mëparshëm të tij. Komunikimi i rezultateve të zgjedhjeve në bazë të procesverbaleve të zonave elektorale, nuk ka karakterin e vendimit të Komisionit Qendror. Ai është vetëm një njoftim zyrtar sipas dokumentave të paraqitura nga zonat, që ka shërbyer edhe si bazë dhe pikënisje për

ushtrimin e ankimit nga subjektet elektorale brenda afatit tre ditor.

Por, pavarësisht nga ky fakt, argumenti i parashtruar nga ana e kërkuese se një organ që ka marrë një herë një vendim nuk mund ta anulojë vetë vendimin, nuk mbështetet ligjërisht. Në radhë të parë nuk mund të bëhet paralelizëm midis një vendimi gjyqësor dhe një vendimi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Nuk ekziston asnjë arsye ligjore që të ndalojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me një vendim të mëparshëm, të mbajë qëndrim të kundërt, kur konkurrojnë shkaqe të rëndësishme.

Në bazë të nenit 36 (shkronjat “a” dhe “c”) dhe nenit 49 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor”, ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 01.02.1996, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kujdeset për zbatimin e përpiktë dhe të njëllojtë të ligjit të zgjedhjeve dhe shqyrton ankimet kundër akteve e veprimeve të paligjshme ose të parregullta dhe vendimeve të komisioneve të zgjedhjeve të zonave.

Përmbajtja e këtyre dispozitave, si dhe ajo e nenit 50, ku në mënyrë të hollësishme parashikohet se vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, shqyrtohen në rrugën ankimore nga Gjykata Kushtetuese, nuk vijnë në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 24 pika 7 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Përkundrazi, si norma të një ligji të posaçëm ato e plotësojnë dhe konkretizojnë pikën 7 të nenit 24 të ligjit të lartpërmendur kushtetues, duke treguar mënyrën e realizimit të saj.

Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet e tij ka vepruar në pajtim të plotë me kërkesat e ligjit dhe brenda kompetencave. Dhe subjektet elektorale apo kandidatët për deputetë të interesuar, kundër vendimeve të këtij organi kanë patur të drejtën e ankimit në Gjykatën Kushtetuese brenda 3 ditëve.

Edhe përsa i përket përsëritjes së zgjedhjeve Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vepruar në pajtim me ligjin, duke iu drejtuar Presidentit të Republikës për caktimin e datës së zgjedhjeve për zonat ku janë shfuqizuar votimet. Në këto raste janë shfuqizuar vetëm aktet e komisioneve të zonave për rezultatit e zgjedhjeve për shkaqe të vërtetuara gjatë votimit e nxjerrjes së rezultatit.

Si rrjedhojë nuk kemi të bëjmë me procesin e zgjedhjeve të reja, por vetëm me atë të votimit për kandidatët e paraqitur dhe subjektet elektorale.

Në këto kushte, Gjykata nuk e gjen me vend edhe kërkesën për pezullim të Dekretit të Presidentit të Republikës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pika 9, 25 dhe 26 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës së Partisë Aleanca Demokratike dhe Partisë Socialdemokrate.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 30, datë 16.07.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Manol Konomi, Franc Jakova, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Veli Budo, anëtarë, me sekretare Drita Filto, në datat 12.06.1996 dhe 04.07.1996, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.32 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: GAFUR HALIM MAZRREKU

SUBJEKT

I INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga Kreshnik Spahiu,
Ilir Rusmali e Genc Bektashi.

O B J E K T I: Shfuqizimin e vendimit nr.905,
datë 07.06.1996 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve, i cili ka lënë në fuqi vendimin
e komisionit të zgjedhjeve të zonës
elektorale nr.14, lidhur me rezultatet
përfundimtare të votimit të 26 majit 1996.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Kërkuesi Gafur Mazrreku, i regjistruar si kandidat për deputet i subjektit elektoral Partia Socialiste e Shqipërisë në zonën e zgjedhjeve nr.14 Has, i është drejtuar kësaj Gjykate, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ka lënë në fuqi vendimin e komisionit të zgjedhjeve të zonës.

Kërkuesi, në ankimin e tij ka parashtruar se: procesi i votimit në disa qendra votimi ka vazhduar për mbi 1 orë dhe janë nxjerrë rezultatet e votimit në 33 qendra votimi pa qenë i pranishëm përfaqësuesi i subjektit elektoral; 75 zgjedhës kanë votuar 2 herë; figurojnë se kanë votuar 160 emigrantë të larguar, 6 ushtarë me shërbim ushtarak në rrethe të tjera, 8 të burgosur që vuajnë dënimin në rrethe të tjera, 4 persona të vdekur dhe 6 persona nën 18 vjeç; figurojnë të kenë votuar persona të paregjistruar; janë futur shumë fletë votimi falso në kutitë e votimit; ushtarët kanë votuar nën diktat; nga krahasimi midis procesverbaleve të komisioneve të qendrave të votimit me procesverbalin e komisionit të zonës, del mospërputhje për shkak të pakësimit të numrit të votave të dhëna për kërkuesin duke i shtuar pa të drejtë për kandidatin e Partisë Demokratike; dhe 108 votues figurojnë të kenë votuar për 15 minutat e fundit në qendrën e votimit nr.18.

Për të arritur në një përfundim të bazuar lidhur me ligjshmërinë e zgjedhjeve në zonën elektorale nr.14, Gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes nuk u kufizua vetëm në verifikimin e dokumentacionit të qendrave të votimit të pretenduara prej kërkuesit, por e pa të nevojshme të shtrijë kontrollin e saj në dokumentacionin e të gjitha qendrave të votimit të zonës.

Nga ky kontroll del se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara për shkak se është provuar e kundërta ose kanë mbetur të paprovuara.

Kështu, pretendimi se 75 persona kanë votuar 2 herë në qendra të ndryshme votimi, u rrëzua plotësisht, pasi nga verifikimi një për një del se ata kanë votuar vetëm një herë. Lidhur me pretendimin se kanë votuar 160 persona të emigruar pa ardhur në vendbanimin e tyre, u vërtetua se prej tyre kanë votuar vetëm 21

vetë, ndërsa të tjerët ose nuk kanë marrë pjesë në zgjedhje ose nuk janë regjistruar fare në listat e zgjedhësve.

Po kështu, nuk u provua pretendimi se kanë votuar ushtarë me shërbim në rrethe të tjera, të burgosur që vuajnë dënimin në rrethe të tjera, persona nën 18 vjeç dhe të vdekur.

Eshtë krejt i pabazuar pretendimi se në qendrën e votimit nr.18, për 15 minutat e fundit kanë votuar 108 vetë. Nga verifikimi i listës së personave të paraqitur nga kërkuesi doli se nga ky numër kanë votuar vetëm 4 vetë.

Nuk rezultojnë të provuara pretendimet e kërkuesit se janë futur fletë votimi falso në kutitë e votimit, se kanë votuar persona të paregjistruar dhe se disa ushtarë kanë votuar me diktat.

I pambështetur mbetet edhe pretendimi, se të dhënat e procesverbaleve të qendrave të votimit nuk përputhen me të dhënat e procesverbalit të zonës, duke rritur numurin e votave pro kandidatit të Partisë Demokratike dhe duke pakësuar votat pro tij.

Nga kontrolli që bëri kjo Gjykatë doli se nuk ka ndryshim ndërmjet rezultateve të pasqyruara në procesverbalet e qendrave të votimit me rezultatin përmbledhës të zonës nr.14, si përsa i përket pjesëmarrjes në votime, ashtu edhe shpërndarjes së votave. Shifrat e këtyre procesverbaleve përsa i përket votave të vlefshme rakordojnë plotësisht me shpërndarjen e votave sipas kandidatëve e sipas subjekteve.

Gjykata vërejt kryesisht se në listat e qendrave të votimit nr.15 dhe 25, janë lejuar parregullsi, pasi mungojnë shënimet për dokumentat e identifikimit dhe firmat e personave që kanë votuar.

Të thirrur para Gjykatës, kryetari i komisionit të qendrës së votimit nr.15 dhe kryetari e sekretari i komisionit të qendrës së votimit nr.25, deklaruan se meqënëse anëtarët e komisioneve i njohin personalisht si bashkëfshatarë të gjithë votuesit e qendrave të tyre të votimeve, ata me konsensus nuk kanë mbajtur shënime për dokumentat e identifikimit të votuesve dhe as u kanë marrë atyre firmat.

Vendimi i marrë nga komisionet e këtyre qendrave të votimit, qoftë dhe me konsensus të plotë, përbën parregullsi, por u provua plotësisht se në këto dy qendra votimi kanë votuar vetëm zgjedhësit e regjistruar në listat përkatëse të zgjedhjeve.

Duke u nisur nga sa sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e Gafur Mazrrekut është e pabazuar dhe si e tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pika 7 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, si dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 01.02.1996 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës së kandidatit për deputet Gafur Halim Mazrreku.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

* * *

Vendim nr. 34, datë 24.09.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Manol Konomi, Veli Budo, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Franc Jakova, anëtarë, me sekretare Drita Filto, në datë 24.09.1996 shqyrtoi me nismën e saj në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.40 Akti.

O B J E K T I: **Kushtetueshmëria e nenit 16 të ligjit nr.8151, datë 12.09.1996 “Për ndryshime në ligjin nr.7573, datë 16.06.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”.**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë, me nenin 16 të ligjit nr. 8151, datë 12.09.1996 “Për ndryshime në ligjin nr.7573,

datë 16.06.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal” ka ndryshuar nenin 40 të ligjit nr.7573, datë 16.06.1992, duke zëvendësuar në paragrafët e parë dhe të dytë të tij, fjalët “Gjykata e Kasacionit” me fjalët “Gjykata Kushtetuese”, duke e përcaktuar këtë të fundit si organ që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për organet e pushtetit lokal.

Gjykata Kushtetuese konstaton se dispozita e nenit 16 të ligjit të sipërpërmendur, i cili është një ligj i zakonshëm, vjen në kundërshtim me pikën 7 të nenit 24 të ligjit kushtetues nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””, në të cilën përcaktohet në mënyrë taksative se Gjykata Kushtetuese “Zgjidh çështjet për ligjshmërinë e zgjedhjes së Presidentit të Republikës, të deputetëve si dhe të referendumit popullor, duke shpallur rezultatet përfundimtare”.

Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ndryshohen, ngushtohen ose zgjerohen, përveçse me ligj kushtetues.

Rrjedhimisht, Gjykata çmon se neni 16 i ligjit nr.8151, datë 12.09.1996 “Për ndryshime në ligjin nr.7573, datë 16.06.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal” duhet të shfuqizohet si antikushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 24,25 dhe 26 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin si antikushtetues të nenit 16 të ligjit nr.8151, datë 12.09.1996 “Për ndryshime në ligjin nr.7573, datë 16.06.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”.

2. Neni 40 i ligjit nr.7573, datë 16.06.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, mbetet siç ka qenë me këtë përmbajtje: “Kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mund të bëhet ankim në Gjykatën e Kasacionit brenda 3 ditëve nga shpallja e tyre.

Gjykata e Kasacionit shqyrton ankimin dhe brenda 3 ditëve jep vendimin e formës së prerë”.

3. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi të nesërmen e shpalljes së tij në Fletoren Zyrtare.

* * *

Vendim nr. 35, datë 10.10.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Franc Jakova, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Veli Budo, anëtarë, me sekretare Drita Filto, në datën 09.10.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.43 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE,**
përfaqësuar nga Elmaz Sherifi.

SUBJEKT
I INTERESUAR: **KOMISIONI QENDROR I PERHERSHEM I**
ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga Pëllumb Çela.

O B J E K T I: **Ankim kundër vendimit datë 03.10.1996 të**
Komisionit Qendror të Përhershëm të
Zgjedhjeve për miratimin e “Rregullores
për pjesëmarrjen në zgjedhjet e organeve
të pushtetit lokal të vëzhguesve të huaj e
të brendshëm”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Partia Socialiste e Shqipërisë si subjekt elektoral në zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal, ka kërkuar shfuqizimin e paragrafit të dytë të nenit 2 dhe paragrafit të tretë të nenit 10 të Rregullores

datë 03.10.1996 të miratuar me vendim të Komisionit Qendror të Përhershëm të Zgjedhjeve “Për pjesëmarrjen në zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal të vëzhguesve të huaj e të brendshëm”, në të cilat vihen kushtet që vëzhguesit e huaj të kenë eksperiencë vëzhgimi dhe moshë 22 vjeç e lart, ndërsa vëzhguesit e brendshëm të kenë eksperiencën në të paktën një zgjedhje dhe moshë 25 vjeç e lart.

Vendimin për nxjerrjen e rregullores së sipërpërmendur, Komisioni Qendror i Përhershëm i Zgjedhjeve e ka marrë duke u mbështetur në nenin 30, shkronja “d” të ligjit nr.7573, datë 16.06.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, sipas të cilit ky komision “vendos rregulla për pjesëmarrjen në zgjedhje të vëzhguesve të brendshëm dhe të huaj...”.

Në bazë të nenit 40 të ligjit të mësipërm, kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mund të bëhet ankim në Gjykatën e Kasacionit.

Si rrjedhojë, pala kërkuese ankimin e saj mund ta paraqesë në Gjykatën e Kasacionit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 40 të ligjit nr.7573, datë 16.06.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, si dhe në bazë të nenit 26 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Mungesën e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 38, datë 15.10.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Franc Jakova, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Veli Budo, anëtarë, me sekretare Drita Filto, në datë 10.10.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.44 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **NERITAN CEKA**

SUBJEKT

I INTERESUAR: **KESHILLI I MINISTRAVE,**
përfaqësuar nga Nderim Muja, me autorizim

O B J E K T I: **Shpallja antikushtetues e paragrafit të dytë të nenit 87 të ligjit nr.7573, datë 16.06.1992 me ndryshimet e mëvonshme të ligjit “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”.**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Kërkuesi Neritan Ceka, kandidat për kryetar bashkie të qytetit të Tiranës në zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal që do të bëhen më 20 tetor 1996, ka kërkuar shpalljen antikushtetues të nenit 87 të ligjit nr.7573, datë 16.06.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, që parashikon: “Bojkotimi i detyrës nga ana e anëtarit të komisionit të zgjedhjeve të çdo niveli në ditën e zgjedhjeve dënohet me heqje lirie nga 1 deri 3 vjet”, duke parashtruar këto arsye:

- Neni 4 i ligjit nr.7692, datë 31.03.1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, ndalon punën e detyruar me përjashtim të rasteve të ekzekutimit të një vendimi të gjykatës, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme ose fatkeqësie natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve.

- Dispozita e sipërme e ligjit është edhe një mjet presioni psikologjik kundër anëtarit të komisionit që do të përfaqësojë

kandidatin dhe ka natyrë politike e represive se i mungon objekti juridik, përderisa gëzon imunitet dhe veprimtaria e tij është shtetërore.

Gjykata vëren se në ligjin “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal” (nenet 23-37) është përcaktuar pozita juridike e anëtarit të komisionit të zgjedhjeve të të gjitha niveleve dhe paprekshmëria e tij në kryerjen e detyrës si veprimtari shtetërore. Nga ana tjetër, është parashikuar edhe përgjegjësia penale e tij në rast të bojkotimit të detyrës (neni 87 paragrafi i dytë).

Neni 4 i ligjit kushtetues “Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, ashtu si edhe aktet ndërkombëtare, me termin “punë e detyruar”, ka parasysh vetëm detyrimin e njeriut për të kryer punë në kundërshtim me vullnetin e tij, të cilën “nuk pranon ta bëjë me dashje”.

Në aktet ndërkombëtare janë parashikuar posaçërisht rastet kur puna ose shërbimi nuk quhet punë e imponuar me dhunë ose me detyrim dhe është përcaktuar kuptimi i termit “punë e detyruar ose e detyrueshme”. Kështu sipas nenit 4.3 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, nuk quhet si “punë e imponuar me dhunë dhe me detyrim”, ndër të tjera, edhe “çdo punë ose shërbim që bën pjesë në detyrimet qytetare normale”(shkronja “d”). Ndërsa lidhur me kuptimin e termit “punë e detyruar ose e detyrueshme”, organizmat ndërkombëtare (Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut) janë referuar në konventat përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Sipas nenit 2 të Konventës “Mbi punën e detyruar”, termi “punë e detyruar ose e detyrueshme”, tregon çdo punë apo shërbim që i kërkohet një individ duke e kërcënuar atë me një dënim të çfarëdoshëm dhe që individ në fjalë nuk e ka pranuar me dëshirë.

Në këtë dispozitë, siç shihet, për t’u quajtur “punë e detyruar”, kërkohen dy kushte: mospranimi me dëshirë për ta kryer punën ose shërbimin dhe parashikimi i një sanksioni penal.

Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se parashikimi në nenin 87 të ligjit “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal” i përgjegjësisë penale për anëtarin e komisionit të zgjedhjeve në rast bojkotimi të detyrës në ditën e zgjedhjeve, nuk përbën “punë të detyruar”, pasi emërimi në detyrën e anëtarit të komisionit të zgjedhjeve të çdo niveli bëhet vetëm me pëlqimin e tij dhe, për më tepër, ai mund të largohet nga kjo detyrë në çdo kohë, para ditës së zgjedhjeve.

Veç sa sipër, parashikimi në nenin 87 të ligjit “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, i sanksioneve penale vetëm në rast të bojkotimit të detyrës ditën e zgjedhjeve nga ana e anëtarit të komisionit të zgjedhjeve nuk del jashtë kuadrit të veprimtarisë normale të tij dhe përbën një mjet për të garantuar kryerjen e një detyrimi qytetar për nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve të zhvilluara.

Pretendimi se dispozita e nenit 87, paragrafi i dytë të ligjit të sipërm për zgjedhjet, nuk ka “objekt juridik”, përderisa anëtari i komisionit gëzon imunitet, nuk qëndron. Eshtë e vërtetë se anëtari i komisionit gëzon paprekshmërinë gjatë kryerjes së detyrës, por kjo nuk e përjashton atë nga përgjegjësia penale, si çdo subjekt që e gëzon paprekshmërinë sipas ligjit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 24 e vijuesa të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””, njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 39, datë 16.10.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Veli Budo, Franc Jakova, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Hilmi Dakli, anëtarë, me sekretare Drita Filto, në datë 14.10.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.45 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA E DJATHTË DEMOKRATE,**
përfaqësuar nga Agim Zeka.

SUBJEKT

**I INTERESUAR: KËSHILLI I MINISTRAVE,
në mungesë.**

O B J E K T I:

- Partia e Djathtë Demokrate, fillimisht është përjashtuar nga propaganda televizive, ndësa më vonë nuk i është kompensuar koha e kësaj propagande;
- Është përjashtuar pa të drejtë nga përfitimi prej fondit të shtetit për fushatën elektorale parashikuar nga neni 49 i ligjit “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”;
- Kërkohet shpallja si antikushtetuese e antiligjore pjesëmarrja e organeve shtetërore dhe e personave të huaj në propagandën elektorale.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Përhershëm i Zgjedhjeve me shkresën nr. 251, datë 08.10.1996, ka urdhëruar Drejtorinë e RTV-së për planifikimin e transmetimit të aktiviteteve të partive pjesëmarrëse në zgjedhje, ku përfshihet edhe PDD-ja.

Përsa i përket pretendimit për kompensimin e kohës së kaluar para datës 08.10.1996 çështja nuk përbën objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese. Kërkuesi ka të drejtën t'i drejtohet Komisionit Qendror të Përhershëm të Zgjedhjeve, aktet e të cilit ankimohen në Gjykatën e Kasacionit.

Pretendimi se përjashtimi nga fondi i shtetit për fushatën elektorale, bie në kundërshtim me nenin 49 të ligjit “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, nuk është i bazuar. Sipas kësaj dispozite, shuma e akorduar nga buxheti i shtetit për partitë politike, që marrin pjesë në zgjedhje, jepet në përputhje me përqindjen e votave që do të fitojë secila parti në zgjedhjet për Këshillin e rrethit. Nuk do të përfitojnë nga kjo ndihmë, ato parti politike që në shkallë vendi nuk arrijnë të fitojnë 2 % të votave për këshillin e rrethit.

Kriteret e mësipërme për ndihmat financiare janë caktuar në harmoni me dispozitën e nenit 22 të ligjit “Për partitë politike”.

Edhe përsa i përket shumave në të holla që u jepen në formë paradhënie partive politike, janë caktuar kriteret në paragrafin e fundit të nenit 49 të ligjit të mësipërm. Këtë paradhënie e përfitojnë vetëm ato parti të cilat në zgjedhjet e fundit të pushtetit lokal kanë fituar më shumë se 1 % të votave të këshillit të rrethit, duke u detyruar këto t’i kthejnë shumat e marra nëqoftëse nuk i përmbushin kushtet e parashikuara në paragrafin e mësipërm.

Caktimi i këtyre kriterëve dhe kushteve për përfitimin dhe kthimin e shumave të marra në formë paradhënie nuk cenon ndonjë të drejtë kushtetuese të kërkuesit si subjekt elektoral. Paradhënia nuk përbën ndihmë në kuptim të ligjit “Për partitë politike” dhe atij “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”.

Si rrjedhojë, kufizimi në dhënien e shumave si paradhënie nuk cenon të drejtat e partive politike për ndihmë nga shteti.

Lidhur me kërkesën për shpalljen antikushtetuese e antiligjore të pjesëmarrjes së disa organeve shtetërore në propagandën elektorale për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal, Gjykata e çmon të nevojshme të theksojë se për pjesëmarrjen e Presidentit të Republikës, e Kryetarit të Kryesisë së Kuvendit Popullor, Kryetarit të Këshillit të Ministrave, si dhe e deputetëve, në propagandën e elektorale nuk ka ndalim kushtetues ose ligjor.

Me ligjet kushtetuese dhe me ligje të veçanta janë përcaktuar organet dhe subjektet shtetërore që janë të depolitizuara e të departizuara e që si rrjedhojë, u ndalohet të marrin pjesë aktive në fushatën elektorale.

Kështu, sipas nenit 6 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” nenit 26, paragrafi i fundit , i ndryshuar me ligjin kushtetues nr.7558, datë 09.04.1994 si dhe dispozitave të ligjit nr.7492, datë 08.06.1991 “Për departizimin dhe depolitizimin e disa organeve shtetërore”, nuk ka asnjë ndalim që organet e subjektet shtetërore të sipërpërmendura të marrin pjesë në propagandën zgjedhore me cilësinë e përfaqësuesve të forumeve të ndryshme politike.

Përsa i përket pretendimit për pjesëmarrjen aktive të të huajve në propagandën zgjedhore, në kundërshtim me nenin 46, paragrafi i parë, të ligjit “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, pala kërkuese duhet t’i drejtohet Komisionit Qendror të Përhershëm të Zgjedhjeve, i cili është ngarkuar me mbikqyrjen e zbatimit të përpiktë të këtij ligji (neni 30) .

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 24 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës së Partisë së Djathtë Demokratike.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 16, datë 07.06.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Veli Budo, Franc Jakova, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Halil Kopani, anëtarë, me sekretare Drita Filto, Në datat 02.06.1997 dhe 03.06.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.19 Akti që u përket:

K Ë R K U E S: **GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE,**
përfaqësuar nga avokat Vladimir Bineri
dhe Ilir Boçka.
KËSHILLI I MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË,
përfaqësuar nga Spartak Ngjela,
Ministër i Drejtësisë.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: PARTIA DEMOKRATIKE,
në mungesë.
PARTIA REPUBLIKANE,
përfaqësuar nga Fatmir Mediu.
PARTIA “BASHKIMI PËR TË DREJTAT E
NJERIUT”,

përfaqësuar nga Vasil Melo, kryetar.
PARTIA SOCIALDEMOKRATE,
në mungesë.
PARTIA BASHKIMI SOCIALDEMOKRAT,
në mungesë.
PARTIA E BALLIT KOMBËTAR,
përfaqësuar nga Xhevdet Libohova.
PARTIA LËVIZJA E LEGALITETIT,
në mungesë.
PARTIA ALEANCA DEMOKRATIKE,
në mungesë
PARTIA DEMOKRISTIANE,
përfaqësuar nga Gaspër Madhi.

O B J E K T I: Shpalljen antikushtetues të shkronjave “a” dhe “b” të nenit 4 të ligjit nr.8218, datë 16.05.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8143, datë 11.09.1996, duke parashtruar:

I. Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste:

1. Me shkronjat “a” dhe “b” të nenit 4 të ligjit nr.8218, datë 16.05.1997, që ndryshon nenin 11 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 me ndryshimet e mëvonshme, për ndarjen e mandateve shtesë, nuk respektohet parimi i konkurrimit në kushte barazie midis subjekteve të ndryshme politike, që është parim i rëndësishëm elektoral, për shkak se:

- Rëndon partitë e mëdha, të cilave votuesit u japin votën e tyre të lirë;

- Votat që zgjedhësit japin për një parti, grabiten nga parti të tjera të vogla;

- Krijohet një parlament fiktiv që nuk përfaqëson vullnetin e lirë të shtetasve, se votat e tyre për një subjekt të caktuar u kalojnë subjekteve të tjera.

2. Përmbajtja e normës së lartpërmendur bie ndesh me parimet bazë të së drejtës së zgjedhjeve, të sanksionuara nga neni 3 paragrafi i tretë i ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, dhe nenet 19 paragrafi i tretë e 25 të ligjit

nr.7692, datë 31.03.1993 për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

II. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë:

Në kërkesën e tij krahas shkaqeve të sipërpërmendura, ka parashtruar edhe:

1. Dy partitë më të mëdha marrin vetëm 25 përqind të 40 mandateve shtesë të sistemit përpjestimor, ndërsa 75 përqind të këtyre mandateve marrin partitë e tjera, gjë që shkel barazinë e shtetasve në sensin dyfish të Kushtetutës;

2. Kjo normë cenon barazinë në ligj e para ligjit, ku përfshihet edhe barazia në konkurrim dhe kur kjo mungon, vetvetiu ligji është diskriminues.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji përfaqësuesit e kërkuësve dhe të subjekteve të interesuara, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Duke qenë se objekti dhe shkaku ligjor i kërkesave të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe të Këshillit të Ministrave është në thelb i njëjtë, Gjykata Kushtetuese duke u mbështetur edhe në pëlqimin e kërkuësve, vendosi t'i shqyrtojë ato bashkërisht dhe të jepet për të dy kërkesat një vendim i vetëm.

Sipas shkronjave “a” dhe “b” të nenit 4 të ligjit nr.8218, datë 16.05.1997 që ndryshon nenin 11 të ligjit “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndarja e 40 mandateve shtesë për subjektet që në shkallë vendi kanë fituar jo më pak se 2 përqind të votave, bëhet në këtë mënyrë: dy partitë që kanë fituar numrin më të madh të votave, pjestojnë ndërmjet tyre 10 mandate. Subjektet e tjera pjestojnë ndërmjet tyre 30 mandate, duke marrë secili subjekt në bazë të numrit të votave të fituara vendet që i takojnë nga pjestimi.

Gjykata çmon se përmbajtja e shkronjave “a” dhe “b” të kësaj dispozite është antikushtetuese, sepse bie ndesh me parimet themelore të sistemit të zgjedhjeve, të sanksionuara në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe në ligjin nr.7692, datë 31.03.1993 për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”

Mënyra e ndarjes që bëhet me ligjin nr.8218, datë 16.05.1997, duke paracaktuar 10 vende (25 përqind) për dy subjektet që fitojnë numrin më të madh të votave dhe 30 vende (75 përqind) për subjektet e tjera elektorale, është arbitrar, pasi shkel parimet kushtetuese të barazisë së votave në zgjedhje dhe të barazisë së shtetasve në ligj dhe para ligjit, të sanksionuar me nenet 3 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe 19 e 25 të ligjit nr.7692, datë 31.03.1993 për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”. Kuptimi i këtyre parimeve qëndron vetëm në atë se vlera e çdo vote është e njëjtë (e barabartë) dhe çdo vlerësim tjetër i votës përbën cenim të tyre.

Sipas sistemit përpjestimor, secili subjekt elektoral duhet të fitojë në parlament aq vende sa i takojnë në përpjesëtim me numrin e votave që ka fituar, duke ju siguruar kështu të gjithëve pozita e barabartë para ligjit.

Argumentat e tjera për shfuqizimin e dispozitës ligjore në fjalë si rëndimi i partive të mëdha, krijimi i parlamentit fiktiv, etj., të ngritura në kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Gjykata nuk i merr për bazë, pasi ato nuk kanë të bëjnë me parimet themelore të zgjedhjeve të organeve përfaqësuese, por vetëm me pasojat që ana kërkuese i quan të mundshme nga shkelja e atyre parimeve.

Për këto arsye Gjykata arrin në përfundimin se shkronjat “a” dhe “b” të nenit 4 të ligjit nr.8218, datë 16.05.1997, duhet të shfuqizohen. Nga ky shfuqizim nuk krijohet boshllëk ligjor, pasi nga përmbajtja e ligjit del qartë se për të nxjerrë vendet e fituara nga ndarja e mandateve shtesë, numri i votave të vlefshme për secilin nga subjektet elektorale që plotësojnë kushtin e paragrafit të parë të këtij neni, pjesëtohet me shumën e votave të vlefshme të tyre dhe thyesa që del shumëzohet me numrin 40. Secili nga këto subjekte merr fillimisht aq vende sa është numri i plotë që del nga veprimet e kryera më sipër. Vendet që ngelen deri në plotësimin e numrit 40 u shpërndahen këtyre subjekteve sipas madhësisë të pjesës dhjetore. Në rast barazimi përdoret shorti. Për të parandaluar mundësinë e ardhjes së pasojave negative nga dispozita e shfuqizuar, deri në botimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare, Gjykata çmon se duhet të urdhërohet pezullimi i menjëhershëm i zbatimit të shkronjave “a” dhe “b” të nenit 4 të ligjit nr.8218, datë 16.05.1997.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24 e vijuesa të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Shfuqizimin e shkronjave “a” dhe “b” të nenit 4 të ligjit nr.8218, datë 16.05.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8143, datë 11.09.1996.

Pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të shkronjave “a” dhe “b” të shfuqizuara deri në botimin e vendimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesat duhej të rrëzoheshin si të pambështetura në dispozitat kryesore kushtetuese dhe në ligj.

Në ndryshimet e plotësimet që Kuvendi Popullor i bëri ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 me ligjin nr.8218, datë 16.05.1997 krahas problemeve të tjera, kanë pësuar ndryshime edhe kriteret e zbatimit të sistemit proporcional në zgjedhje si përsa i përket kualifikimit të subjekteve fituese për mandatet shtesë ashtu dhe për vendosjen e proporcioneve në shpërndarjen e tyre (nenet 4 e 6 të ligjit nr.8218, datë 16.05.1997).

Duke i parë në tërësinë e tyre këto rregullime ligjore mendojmë se qëllimi i legjislatorit ka qenë që në përputhje e në zbatim të parimit të pluralizmit politik si një ndër parimet bazë të ndërtimit të shtetit tonë (neni 2 i dispozitave kryesore kushtetuese) dhe si një ndër kushtet themelore të demokracisë (neni 6 i dispozitave kryesore kushtetuese), të zgjerojë bazën e përfaqësimit të vullnetit politik të popullit në parlament.

Në të dy kërkesat objekt gjykimi është pretenduar se ndryshimet e nenit 11 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992, cenojnë barazinë në votime (neni 3 paragrafi i tretë i dispozitave kryesore

kushtetuese) si dhe barazinë në ligj e para ligjit (neni 25 i ligjit për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”). Sipas kërkuesave preket parimi i konkurrimit në kushtet e barazisë midis subjekteve të ndryshme politike, dhe se votat e një subjekti padrejtësisht i kalojnë subjekteve të tjera.

Këto pretendime të kërkuesave për mendimin tonë nuk qëndrojnë:

Së pari: Barazia në votime si element përbërës i zgjedhjeve në një shtet demokratik ka të bëjë me të drejtën e votës dhe jo me kushtet e konkurrimit të subjekteve elektorale. Nga kjo pikëpamje dispozita e kontestuar nuk prek të drejtën e votës e as “grabitjen e votave nga partitë e vogla”, ashtu siç pretendohet, por përcakton mbi bazën e votave të çdo subjekti elektoral, ndarjen e mandateve shtesë.

Së dyti: Në tërësi fryma dhe përmbajtja e ligjit elektoral përshkohet nga parimi kushtetues i barazisë në konkurrim. Edhe dispozita e kontestuar ruan brenda vetë elementët e barazisë në kuptimin se: përfitimi nga mandatet shtesë nuk caktohet a priori për “partitë e mëdha” e për “partitë e vogla”, ashtu siç pretendohet, por për atë ç’ka do rezultojë konkretisht nga konkurrimi; se të gjitha subjektet pa asnjë dallim vihen për ndarjen e mandateve shtesë para alternativave të barabarta (të skualifikohen për mosarritje limiti të hyjnë në grupin e 10 mandateve apo në atë të tridhjetë mandateve).

E ritheksojmë edhe një herë, se këto janë kritere ligjore, ashtu siç është edhe vendosja e limiteve në konkurrim (2 %) etj., nga të cilat në përfundim të votimit mund të mos përfitojnë një sërë subjektsh elektorale, por kjo s’do thotë kurrësesi se në tërësi janë shkelur të drejtat e barabarta në konkurrim.

Anëtarë: Kristofor Peçi, Alfred Karamuço, Hilmi Dakli.

* * *

Vendim nr. 27, datë 19.07.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Veli Budo, Halil Kopani, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Hilmi Dakli, anëtarë, me sekretare Drita

Filto, në datë 11.07.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.37 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA SOCIALISTE,**
përfaqësuar nga Bashkim Caka e
Vladimir Metani.

SUBJEKT
I INTERESUAR: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Thimjo Kondi, sekretar.

O B J E K T I: **Anullimi i vendimit nr.1280, datë 07.07.1997**
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për
zonën 61, sipas nenit 50 të ligjit nr.7556,
datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit
Popullor”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi shqyrtoi pretendimet dhe provat e kërkuarit, subjektin e interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Sipas procesverbalit të komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.61, datë 01.07.1997, rezultoi se ka fituar kandidati i Partisë Demokratike. Vendimi i këtij komisioni është lënë në fuqi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.1280, datë 07.07.1997.

Pala kërkuuese ka kërkuar anulimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke pretenduar se:

Nuk janë patur parasysh dhe nuk janë llogaritur rezultatet e pesë qendrave të votimit dhe konkretisht ato me nr.25, 28, 29, 31 dhe 32; ka patur presione në qendrat e votimit nr.2, 4 e 27 të fshatrave Sfilje, Greth, Kazije, Damës e Sharrdushk, procesvrabet janë fiktive.

Gjykata mori parasysh dhe llogaritë edhe rezultatet e 5 qendrave të votimit që nuk ishin patur parasysh nga komisioni i zonës dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe përsëri rezultati doli po në favorin e kandidatit që kishin pranuar komisionet.

Gjithashtu mori në shqyrtim dhe analizoi edhe shkaqet e tjera dhe konstatoi se mungonin vërejtjet nëpër procesverbalet si e kërkon ligji.

Në përfundim konkludohet se nuk ka vend për pranimin e kërkesës as dhe për balotazh.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24 e vijues të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””, dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor”, njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 28, datë 19.07.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Manol Konomi, Halil Kopani, Zija Vuci, Kristofor Peçi, Veli Budo, anëtarë, me sekretare Drita Filto, në datë 09.07.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.31 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA ALEANCA DEMOKRATIKE,**
përfaqësuar nga Arben Demeti dhe avokat
Aldo Zadrima.

SUBJEKT
I INTERESUAR: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Thimjo Kondi, sekretar.

O B J E K T I: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe deklarimin e pavlefshëm të zgjedhjeve të kryera në datë 29 qershor në zonën elektorale nr.16 Kukës dhe përsëritjen e tyre, sipas nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor” me ndryshimet.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji përfaqësuesit e palës kërkuese, subjektin e interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni i zgjedhjeve të zonës nr.16 Kukës, me vendimin e tij nr.8, datë 01.07.1997, njëzëri ka vendosur që të drejtën për shpalljen e kandidatit fitues apo për përsëritjen e zgjedhjeve t’ia lërë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin e tij nr.1106/2, datë 02.07.1997 ka shpallur fitues kandidatin e Partisë Demokratike, Jemin Gjana.

Ana kërkuese, në ankimin e saj ka pretenduar se ka patur parregullsi në listat e zgjedhësve të 20 qendrave të votimit, ku mungojnë shumë firma, nuk janë shënuar dokumentet e identifikimit të zgjedhësve, si dhe në 17 qendra votimi të zonës së Fanit nuk janë shvilluar zgjedhjet për mungesë të bazës materiale.

Nga shqyrtimi i procesverbaleve të qendrave të votimit, është vërtetuar se zgjedhjet janë zhvilluar rregullisht në të gjitha qendrat e votimit dhe se në këto procesverbale nuk janë bërë vërejtje nga pjesëtarët e komisioneve.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 26 e vijues të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””, dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor”, me shumicë votash,

08.07.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që kanë lënë në fuqi vendimin e komisioneve të zgjedhjeve të zonave nr.73 e 74, duke kërkuar deklarin e pavlefshëm të rezultatit të zgjedhjeve në këto zona dhe përsëritjen e tyre.

Gjykata Kushtetuese, duke marrë parasysh se pretendimet për shkeljet e ligjit, janë paraqitur nga i njëjti subjekt (Partia Socialiste), dhe se Partia Aleanca Demokratike ka bërë një kërkesë për të dy zonat, vendosi që t'i shqyrtojë ato bashkërisht.

Kërkuesit kanë pretenduar se në këto zona, zgjedhjet janë kryer me parregullsi për shkak të dhunës dhe kërcënimit me armë nga banda të armatosura, të cilat kanë futur në kuti të votimit sasi të mëdha fletëvotimesh. Po kështu pretendohet se gjatë numërimit të votave anëtarët e komisioneve janë detyruar me dhunë që të hartojnë procesverbale fiktive.

Për të vërtetuar këto pretendime nga Partia Socialiste, kërkesës i bashkëngjiten disa deklarata të nënshkruara nga nënkryetarët ose ndonjë anëtar socialist të disa qendrave të votimit, ku thuhet se grupe të armatosura kanë dhunuar këto qendra dhe numërimi i votave nuk është bërë në rregull. Këto deklarata janë pëpiluar pas përfundimit të procesverbaleve të votimit ndërsa në këto të fundit në asnjë qendër votimi nuk është bërë asnjë vërejtje. Edhe në procesverbalet e komisioneve të zonave nuk ka asnjë vërejtje përsa pretendohet.

Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkuesit nuk provuan pasaktësinë e rezultateve të pasqyruara në procesverbalet e qendrave të votimit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 24 e 25 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"", dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor", njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesave.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

që i përket Rrethit të Malësisë së Madhe, i cili ka shpallur fitues kandidatin për deputet të Partisë Demokratike.

Palët në kërkesat e tyre dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë pretenduar se disa qendra votimi janë caktuar në lokale private, se nga shumica e zgjedhësve nuk është kryer votimi, se në edicionet e lajmeve të mjeteve të informimit publik është njoftuar se zgjedhjet në zonën 2 do të shtyhen, se janë regjistruar zgjedhës më shumë se sa kanë qenë në të vërtetë në atë zonë, se janë falsifikuar firmat e anëtarëve të komisionit në procesverbalet e qendrave të votimit, si dhe janë larguar nga komisionet e zgjedhjeve zëvendëskryetarët e këtyre komisioneve.

Në kundërshtim me pretendimet e sipërme, u provua se caktimi i disa qendrave të votimit në lokale private është vendosur nga organet kompetente të pushtetit lokal, për shkaqe objektive dhe kjo nuk vjen në kundërshtim me nenin 32 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, pasi nuk ndalon caktimin e qendrave të votimit edhe në lokale private.

Gjithashtu, ndryshe nga sa pretendohet, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk ka marrë vendim për shtyrjen e zgjedhjeve të zonës nr.2 dhe as Radiotelevizioni Shqiptar në edicionet e lajmeve të datës 29.06.1997 nuk ka njoftuar shtyrjen e zgjedhjeve në këtë zonë. Përkundrazi, zgjedhjet janë zhvilluar me një pjesëmarrje të gjerë të votuesve. Sipas procesverbaleve të qendrave të votimit rezulton se në zgjedhje ka marrë pjesë mbi 70 % e votuesve të kësaj zone.

Përsa i përket pretendimit se janë regjistruar më shumë zgjedhës se kanë qenë në të vërtetë në atë zonë dhe se janë falsifikuar firmat e anëtarëve të komisionit në procesverbalet e qendrave të votimit, kërkuessit nuk paraqitën prova për vërtetimin e tij.

Eshtë e vërtetë se në 22 qendra votimi, procesverbalet e komisionit të qendrës së votimit nuk janë firmosur nga zëvendëskryetarët e këtyre komisioneve, por kjo nuk mund t'i bëjë ato të pavlefshme, mbasi sikurse pasqyrohet në disa nga këto procesverbale, ata janë larguar vetë nga detyra, pa shkaqe të motivuara.

Duke u nisur nga sa sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesat janë të pabazuara dhe si të tilla duhen rrëzuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji përfaqësuesin e kërkuesit, të subjektit të interesuar si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin datë 10.07.1997, ka lënë në fuqi vendimin e komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.4, datë 07.07.1997, sipas të cilit është shpallur fitues kandidati i Partisë Socialiste.

Ankuesi i është drejtuar kësaj Gjykate, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të mësipërme për shkak se zgjedhjet e raundit të dytë, në këtë zonë janë zhvilluar në kundërshtim të hapur dhe flagrant me dispozitat e ligjit "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", për arsye se, veç parregullsive të shumta, në 14 qendra votimi, nuk janë zhvilluar votime në datë 06.07.1997, për shkak të mosshpërndarjes së materialeve të votimit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetuan pretendimet e kërkuesit se nga nga 58 qendra votimi të zonës së zgjedhjeve nr.4, në 14 prej tyre dhe konkretisht në ato me numër 10, 12, 19, 20, 21, 22, 23, 27, 28, 33, 43, 53, 54 dhe 58, nuk janë zhvilluar votimet.

Ky fakt është njohur dhe pranuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve por, me arsyetimin se kjo përbën një parregullsi të së njëjtës natyrë për të dy kandidatët dhe nuk ndikon në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, ka shpallur fitues kandidatin e Partisë Socialiste, i cili ka marrë 129 vota më shumë se kandidati i Partisë Demokratike.

Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se moszhvillimi i zgjedhjeve në 14 qendra votimi të zonës nr.4, për shkak të faktorëve të paligjshëm që penguan votimin nuk është thjeshtë një parregullsi, por përbën një cenim të rëndë të së drejtës së përgjithshme të shtetasve për të marrë pjesë në zgjedhje. E drejta e zgjedhjeve përfaqëson një nga të drejtat themelore më të rëndësishme kushtetuese të shtetasve në fushën e veprimtarisë së tyre politike dhe çdo mohim apo cenim i kësaj të drejte është antikushtetuese, prandaj vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.4 duhet të shfuqizohen.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon se në 14 qendrat e votimit të sipërpërmendura të zonës së zgjedhjeve nr.4

duhet të zhvillohen zgjedhjet e raundit të dytë dhe rezultatet e votimit në këto qendra votimi duhet t'i bashkohen rezultateve të nxjerra të 44 qendrave të tjera të votimit.

Duke u nisur nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e Partisë Demokratike është e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24, pika 7 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"", si dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

Shfuqizimin e vendimeve datë 10.07.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe datë 07.07.1997 të komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.4.

Urdhërohet zhvillimi i zgjedhjeve të raundit të dytë në qendrat e votimit nr.10, 12, 19, 20, 21, 22, 23, 27, 28, 33, 43, 53, 54 dhe 58 të zonës së zgjedhjeve nr.4.

Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Komisionit të Mandateve të Kuvendit të Ri Popullor.

* * *

Vendim nr. 33, datë 21.07.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Manol Konomi, Veli Budo, Franc Jakova, Halil Kopani, Kristofor Peçi, Zija Vuci, anëtarë, me sekretare Drita Filto, në datat 14.07.1997 dhe 19.07.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.41 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA SOCIALISTE,**
përfaqësuar nga avokat Fatmir Gjika.

SUBJEKT
I INTERESUAR: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Thimjo Kondi, sekretar.

O B J E K T I: **Shfuqizimi i vendimit nr.1297, datë**
05.07.1997 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve, për zonën elektorale nr.77.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi përfaqësuesin e kërkuarit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin datë 01.07.1997 komisioni i zgjedhjeve të zonës nr.77 Fier, ka vendosur të shpallë fitues në zgjedhjet e Kuvendit Popullor të zhvilluara në 29 qershor 1997, kandidatin për deputet të Partisë Socialiste dhe asaj Socialdemokrate, Nazmir Ali Bilani.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.1297, datë 05.07.1997 ka vendosur prishjen e vendimit të komisionit të zonës nr.77 dhe kalimin në balotazh për zgjedhjen për deputet të zonës të Nazmir Ali Bilani dhe kandidatit të të Djathtës së Bashkuar Shqiptare, Fatmir Ali Mediu.

Në vendimin e tij Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka parashtruar shkaqet e prishjes së vendimit të komisionit të zonës. Gjatë shqyrtimit të çështjes në këtë Gjykatë, përfaqësuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sqaroi se prishja e këtij vendimi është bërë vetëm për shkak se në të mungon firma e kryetarit të komisionit të zonës.

Nga shqyrtimi dhe përllogaritjet që i bëri kjo Gjykatë një për një të gjitha procesverbaleve të qendrave të votimit të zonës nr.77 Fier, rezultoi se janë plotësisht të sakta të dhënat përfundimtare të pasqyruara në procesverbalin e komisionit të zgjedhjeve të kësaj zone. Sipas këtij procesverbali, numuri i votave të vlefshme të hedhura për të gjitha subjektet elektorale rezultoi të jetë 15075 (pesëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e shtatëdhjetë e pesë) nga të

cilat Nazmir Ali Bilani ka marrë 7641 (shtatëmijë e gjashtëqind e dyzet e një) vota; Fatmir Ali Mediu ka marrë 3215 (tremijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) vota, kurse votat e tjera janë shpërndarë ndërmjet kandidatëve për deputet të tetë subjekteve të tjera elektorale.

Nga këto të dhëna të pakontestueshme rezulton se Nazmir Ali Bilani ka marrë mbi 50 % të votave të vlefshme.

Rrjedhimisht, sipas nenit 7 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet e mëvonshme, Nazmir Ali Bilani ka fituar të drejtën të quhet i zgjedhur deputet në zonën 77 Fier qysh me përfundimin e zgjedhjeve të raundit të parë.

Në këto rrethana Gjykata çmon se vendimi nr.1297, datë 05.07.1997 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet të priset dhe të lihet në fuqi vendimi datë 01.07.1997 i Komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.77 Fier, sipas të cilit është zgjedhur deputet i kësaj zone, Nazmir Ali Bilani. Për pasojë zhvillimi i balotazhit për këtë zonë zgjedhjesh, në datë 13.07.1997 dhe rezultatet e tij janë të pavlefshme.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 24 e 25 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””, si dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Prishjen e vendimit nr.1297, datë 05.07.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

2. Lënien në fuqi të vendimit datë 01.07.1997 të komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.77 Fier, sipas të cilit është zgjedhur deputet i kësaj zone, kandidati i subjektit elektoral, Partia Socialiste dhe Partia Socialdemokrate, Nazmir Ali Bilani.

3. Të deklarohen të pavlefshme zhvillimi i balotazhit të datës 13.07.1997 në zonën e zgjedhjeve nr.77 Fier dhe rezultatet e tij.

Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Komisionit të Mandateve të Kuvendit të Ri Popullor.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

* * *

Vendim nr. 34, datë 21.07.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Veli Budo, Franc Jakova, Halil Kopani, Zija Vuci, Kristofor Peçi, Alfred Karamuço, anëtarë, me sekretare Drita Filto, në datë 14.07.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.39 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA SOCIALISTE,**
përfaqësuar nga avokat Fatmir Gjika.

SUBJEKT
I INTERESUAR: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Thimjo Kondi, sekretar.

O B J E K T I: **Shfuqizimi i vendimit nr.1320, datë**
05.07.1997 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve, për zonën elektorale nr.6.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi përfaqësuesin e kërkuarit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Partia Socialiste ka kërkuar pranë Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimin e vendimit nr.1320, datë 05.07.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të komisionit të zonës nr.6 dhe shpalljen e paligjshme të zgjedhjeve në këtë zonë, ku ka fituar kandidati i Partisë Demokratike.

Kërkesa e Partisë Socialiste i konsideron të paligjshme zgjedhjet në zonën 6 për shkak se pretendon se janë lejuar shkelje lidhur me listat e zgjedhësve, janë bërë zgjedhje në tre lokale private si dhe ka pasur manipulime me fletët e votimit dhe me procesverbalet e votimit.

Përsa i përket pretendimeve për manipulime në fletët e

O B J E K T I: **Shfuqizimi i vendimit nr.1216, datë
04.07.1997 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve, për zonën elektorale nr.22.**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji përfaqësuesin e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Partia Socialiste, në kërkesën e saj drejtuar kësaj Gjykate ka parashtruar disa shkaqe për prishjen e vendimit datë 30.06.1997 të komisionit të zgjedhjeve nr.22 të Rrethit Kurbin dhe atij me nr.1216, datë 04.07.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas të cilave është quajtur i zgjedhur deputet në këtë zonë, kandidati për deputet i Partisë Demokratike.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë Gjykatë, përfaqësuesja e palës kërkuese, i kufizoi kërkimet e saj dhe insistoi që të deklarohet i pavlefshëm vetëm procesverbali i rezultateve të votimit, të paraqitur në emër të qendrës së votimit nr.8 të kësaj zone. Ajo pretendoi se përmbajtja e këtij procesverbali, i cili është konsideruar i mirëqenë dhe është marrë për bazë si nga komisioni i zgjedhjeve të zonës nr.22 ashtu edhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk i përgjigjet realitetit.

Për verifikimin e këtij pretendimi, Gjykata bëri krahasimin e këtij procesverbali, me atë që paraqiti kërkuesi dhe konstatoi se ata nuk përputhen me njëri-tjetrin. Shifrat e pasqyruara në këto dokumente dhe nënshkrimet që kanë vënë aty kryesia e komisionit të kësaj qendre votimi, nuk janë të njëjta. Për më tepër, në procesverbalin që i ka shkuar zonës, ka nënshkruar për zëvendëskryetarin e kësaj qendre votimi një person me emër B. Diku, por siç del nga vendimi nr.7, datë 20.06.1997, ky person nuk është caktuar fare në përbërjen e komisionit të qendrës së votimit nr.8. Sipas këtij vendimi me detyrën e zëvendëskryetarit në këtë komision është ngarkuar Besim Mzhika, i cili deklaroi se personi që ka nënshkruar për të, procesverbalin e sipërm është krejtësisht i panjohur në fshatin e tyre.

Vetëm kjo mangësi, pa përmendur këtu edhe parregullsitë e tjera që vërehen në pasqyrimin e të dhënave në këtë akt e bëjnë atë

të pavlefshëm. Ai është lëshuar nga persona të cilët nuk kanë qenë të autorizuar me ligj ta nënshkruajnë atë.

Në këto rrethana, Gjykata çmon se realitetin lidhur me rezultatin e zgjedhjeve në këtë qendër votimi e pasqyron vetëm procesverbali që ka paraqitur si provë Partia Socialiste. Ky akt përveç formës dhe ngjyrës, ka edhe karakteristika të tjera të kërkuara nga ligji. Ndryshe nga i pari, ku të dhënat me shifra janë kontradiktore, ky është nënshkruar rregullisht si nga kryesia ashtu dhe anëtarët e komisionit të qendrës së votimit nr.8.

Të dy këto procesverbale iu paraqitën për njohje dëshmitarit Besim Mzhika, i cili deklaroi se në procesverbalin e paraqitur nga kërkuesi, jo vetëm firmën, por edhe emrin e zëvendëskryetarit të komisionit, i ka shkruar me dorën e tij.

Përsa i përket procesverbalit tjetër, i cili është fotokopje e procesverbalit të dorëzuar në zonë, ai tha se nuk është nënshkruar prej tij dhe se të dhënat që pasqyrohen aty nuk janë reale.

Veç sa sipër, ai shtoi se ky procesverbal së bashku me gjithë dokumentacionin tjetër të qendrës së votimit nr.8, janë dorëzuar në komisionin e zonës nga kryetari i qendrës së votimit më datë 30.06.1997, pa qenë ky i shoqëruar edhe nga ai si zëvendëskryetar komisioni.

Për të dhënë shpjegime rreth kësaj çështje u thirrën nga kjo Gjykatë edhe kryetari e sekretari i kësaj qendre votimi, por këta nuk u paraqitën.

Në këto rrethana, Gjykata çmon se procesverbali i qendrës së votimit nr.8, sipas të cilit kandidati për deputet i Partisë Demokratike ka marrë 511 vota, duhet të deklarohet i pavlefshëm. Në vend të tij duhet të merret për bazë procesverbali tjetër që ka paraqitur kërkuesi, sipas të cili ky kandidat i sipërm ka marrë vetëm 179 vota. Duke bërë përlogaritjen, rezulton se diferenca e votave që ai ka marrë tepër padrejtësisht, është 332. Po të zbritet kjo shumë nga totali i votave që ai ka marrë në krejt zonën 22, del se ai ka fituar gjithsej 5296 (pesëmijë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë) vota.

Ky numër votash nuk arrin as 50 % të numrit të përgjithshëm të votave që janë deklaruar të vlefshme nga komisioni i zgjedhjeve të zonës nr.22. Sipas procesverbalit të tij datë 30.06.1997, shuma e këtyre votave është gjithsej 11.135 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e pesë), ndërsa gjysma e tyre 5.568 vota.

Për rrjedhojë, në bazë të dispozitave të ligjit "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor", kandidati për deputet i Partisë Demokratike Pal

Ndue Dajçi nuk quhet i zgjedhur deputet në këtë zonë.

Ai do të konkurrojë përsëri në garën zgjedhore, por kësaj radhe në balotazh me kandidatin tjetër të Partisë Socialiste Gëzim Sulejman Dika, i cili në krahasim me kandidatët e tetë subjekteve të tjerë elektorale, ka fituar numurin më të madh të votave, që arrin shifrën 3860 vota, pa llogaritur këtu edhe 108 vota të tjera që atij i janë hequr padrejtësisht me procesverbalin e falsifikuar të dorëzuar në komisionin e zonës 22 dhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 24 pika 7 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, si dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin e vendimeve datë 30.06.1997 të komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.22 Kurbin si edhe datë 04.07.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të caktojë datën për zhvillimin e balotazhit në zonën nr.22, ndërmjet Pal Ndue Dajçi, kandidat për deputet i Partisë Demokratike dhe Gëzim Sulejman Dika, kandidat për deputet i Partisë Socialiste.

Nga një kopje e këtij vendimi u dërgohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Komisionit të Mandateve të Kuvendit të Ri Popullor.

Ky vendim është i formës së prerë.

* * *

Vendim nr. 36, datë 21.07.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Manol Konomi, Veli Budo, Franc Jakova, Halil Kopani, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Zija

të cilët iu kanë marrë me forcë dhe kanë grisur pjesën më të madhe të këtyre procesverbaleve, me përjashtim të 6 copëve që këto më vonë i janë dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në këtë gjendje të provave, Gjykata arrin në përfundim se ky procesverbal i komisionit të zgjedhjeve të kësaj zone, nuk pasqyron realitetin dhe si i tillë duhet të deklarohet i pavlefshëm.

Në vend të tij duhet të merren për bazë procesverbalet e qendrave të votimit që janë paraqitur si prova nga pala kërkuese. Nga këqyrja e tyre rezulton se ato janë plotësuar, nënshkruar dhe vulosur në rregull, sipas të gjitha kërkesave të ligjit mbi zgjedhjet e Kuvendit Popullor. Prandaj Gjykata, duke iu referuar përmbajtjes së tyre dhe duke marrë vetë përsipër nxjerrjen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën nr.75, si dhe duke përlogaritur një për një të dhënat që përmbajnë të gjitha këto procesverbale del me konkluzionin se fitues është kandidati për deputet i Partisë Socialdemokrate dhe Partisë Socialiste, Haxhi Esat Aliko. Ky në këtë zonë, nga 13378 (trembëdhjetëmijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë) vota të vlefshme gjithsej ka marrë 9697 (nëntëmijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) vota ose 72.5 % të tyre, kundrejt 2014 (dymijë e katërbëdhjetë) votave ose 15.1 % që ka marrë kandidati i Partisë Demokratike Sami Seit Sharka.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 24 pika 7 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””, si dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

Shfuqizimin e vendimeve datë 30.06.1997 të komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.75 Lushnje dhe datë 06.07.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe quan të zgjedhur deputet për në Kuvendin Popullor në atë zonë, kandidatin e Partisë Socialdemokrate dhe Partisë Socialiste, Haxhi Esat Aliko.

Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Komisionit të Mandateve të Kuvendit të Ri Popullor.

Ky vendim është i formës së prerë.

* * *

Vendim nr. 40, datë 05.08.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Veli Budo, Franc Jakova, Halil Kopani, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, në datë 31.07.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.45 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA BASHKIMI SOCIALDEMOKRAT,**
DEPUTETI TEODOR LAÇO,
përfaqësuar nga Shaqir Rexhvelaj.
PARTIA DEMOKRISTIANE,
DEPUTETI ZEF BUSHATI,
përfaqësuar nga Arben Gazheli
dhe Shqipe Koçiu.

SUBJEKT
I INTERESUAR: **KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS SË**
SHQIPËRISË,
përfaqësuar nga Zamira Caka
dhe Spartak Braho.

O B J E K T I: **Shfuqizimi i vendimit datë 24.07.1997 të**
Kuvendit Popullor të Republikës së
Shqipërisë, me të cilin vërtetimi apo
anullimi i mandatit të deputetëve
Teodor Laço dhe Zef Bushati, i është
kaluar për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese
të Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi përfaqësuesit e kërkuësve dhe të subjektit të interesuar si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Pas përfundimit të zgjedhjeve të 29 qershorit 1997 të deputetëve të Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u ka lëshuar Teodor Laço dhe Zef Bushati, vërtetimet respektivisht nr.1390/31 Prot., dhe nr.1390/32 Prot., datë 21.07.1997 për zgjedhjen e tyre deputetë të Kuvendit Popullor nga lista e mandateve shtesë e subjektit elektoral, Partia Demokratike.

Në seancën plenare të sesionit të parë të Kuvendit Popullor, Komisioni i Mandateve të këtij Kuvendi, pasi ka shqyrtuar mandatet e deputetëve në tërësi, nuk i ka quajtur të rregullt mandatet e deputetëve Teodor Laço dhe Zef Bushati dhe i ka propozuar Kuvendit Popullor mosmiratimin e mandateve të këtyre deputetëve. Në po atë seancë plenare, Kuvendi Popullor me votim ka vendosur që çështjen e vërtetimit ose anulimit të mandateve të deputetëve Teodor Laço dhe Zef Bushati ta kalojë për t'u vendosur nga Gjykata Kushtetuese.

Në paragrafin e dytë të nenit 20 të ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", thuhet shprehimisht: "Kuvendi Popullor në sesionin e tij të parë zgjedh një komision për shqyrtimin e mandateve të deputetëve. Me propozimin e këtij komisioni, Kuvendi Popullor vërteton ose anulon mandatet e deputetëve".

Kuvendi Popullor duke mos vendosur vetë vërtetimin apo anulimin e mandatit të deputetëve Teodor Laço dhe Zef Bushati nuk ka kryer detyrën e tij kushtetuese me të cilën e ngarkon dispozita e sipërcituar.

Detyrën e shprehur në ligjin kushtetues për vërtetimin apo anulimin e mandateve, Kuvendi Popullor nuk ka të drejtën t'ia kalojë për shqyrtim një organi tjetër, përfshi këtu edhe Gjykatën Kushtetuese.

Përfundimisht, Gjykata konkludon se Kuvendi Popullor duhet të kryejë detyrën e tij kushtetuese dhe të marrë një vendim për vërtetimin ose anulimin e mandatit të deputetëve Teodor Laço dhe Zef Bushati sipas kërkesave të nenit 20 të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Gjithashtu, përderisa Teodor Laço dhe Zef Bushati kanë mandatin e deputetit të lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Gjykata çmon se ata gëzojnë të drejtën të marrin pjesë në Kuvendin Popullor gjatë shqyrtimit të mandatit të tyre.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 24 e vijues të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin e vendimit datë 24.07.1997 të Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, me të cilin çështja e vërtetimit apo anulimit të mandatit të deputetëve Teodor Laço dhe Zef Bushati i është kaluar për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese.

2. Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë në seancën më të afërt të radhës të marrë vendim për vërtetimin apo anulimin e mandatit të deputetëve Teodor Laço dhe Zef Bushati.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Nuk jemi dakord me vendimin e shumicës për këto arsye:

Çështja duhej të shqyrtohej në themel nga Gjykata Kushtetuese si organ i vetëm që vendos përfundimisht për ligjshmërinë e zgjedhjes së deputetëve.

Në këtë përfundim arrihet nga kuptimi dhe zbatimi i drejtë i dispozitave kushtetuese dhe konkretisht të nenit 20 të ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 dhe nenit 24 pika 7 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992.

Sipas këtyre dispozitave Kuvendi Popullor me propozim të komisionit për shqyrtimin e mandateve të deputetëve, vërteton ose anulon mandatet e tyre. Por, kur ka kontestim për ligjshmërinë e këtyre mandateve, kompetente është Gjykata Kushtetuese, që vendos përfundimisht.

Anëtarë: Hilmi Dakli, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi.

* * *

Ky fakt është njohur dhe pranuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili, megjithatë, me vendimin e tij datë 12.08.1997, ka nxjerrë rezultatin e zgjedhjeve, duke shpallur fitues kandidatin e Partisë Socialiste.

Gjykata çmon se vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i pabazuar në ligj. Sipas rezultatit të nxjerrë nga ky komision del se kandidati për deputet i Partisë Socialiste ka fituar me një diferencë prej 187 vota më tepër se kandidati i Partisë Demokratike. Numri i zgjedhësve në katër qendrat e votimit ku nuk u votua është disa herë më i madh (916). Në këto kushte ligjërisht nuk mund të nxirrej asnjë lloj rezultati, pasi votimi në këto katër qendra votimi është përcaktues për rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon se në katër qendrat e votimit të sipërpërmendura të zonës së zgjedhjeve nr.4, duhet të zhvillohen zgjedhjet e balotazhit dhe rezultatet e votimit në këto qendra votimi duhet t'i bashkohen rezultateve të nxjerra në qendrat e tjera të votimit.

Votimet e balotazhit në këto qendra votimi duhet të organizohen nga organet kompetente shtetërore dhe të zhvillohen në kohën kur të krijohen kushtet që do të çmohen prej tyre.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pika 7 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"", si dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

Shfuqizimin e vendimit datë 12.08.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që ka nxjerrë rezultatin e votimeve të balotazhit në zonën e zgjedhjeve nr.4.

Urdhërohet zhvillimi i zgjedhjeve të balotazhit në qendrat e votimit nr.10, 23, 27 dhe 28 të zonës së zgjedhjeve nr.4.

Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Komisionit të Mandateve të Kuvendit Popullor.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: PARTIA SOCIALISTE,
përfaqësuar nga Spartak Braho.
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga Kristaq Kume, kryetar.

O B J E K T I: Shfuqizimi i vendimit datë 31.08.1997 të Komisionit të Zgjedhjeve të Zonës nr.4.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin nr.42, datë 22.08.1997 Gjykata Kushtetuese ka urdhëruar zhvillimin e zgjedhjeve të balotazhit në qendrat e votimit nr.10, 23, 27 dhe 28 të zonës së zgjedhjeve nr.4, në të cilat do të votohej për kandidatin e Partisë Demokratike Ali Spahia dhe kandidatin e Partisë Socialiste Lekë Çukaj. Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi Gjykata i ka pranuar të mirëqena rezultatet e votimit në 54 qendrat e tjera të votimit të kësaj zone, duke u shprehur se Lekë Çukaj ka marrë 187 vota më tepër se Ali Spahia (të dokumentuara në pasqyrën datë 15.08.1997 që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka dorëzuar në Gjykatë).

Gjatë shqyrtimit të çështjes objekt gjykimi është vërtetuar se në datë 31.08.1997 zgjedhjet e balotazhit janë zhvilluar vetëm në qendrat e votimit nr.10 dhe 28, ndërsa nuk janë zhvilluar fare në qendrat e votimit nr.23 dhe 27, për shkak të mosmarrjes së masave organizative dhe kundërshtive që kanë patur në komisionet e zgjedhjeve anëtarët e të dy palëve.

Sipas procesverbaleve të qendrave të votimit nr.10 dhe 28, rezulton se në datë 31.08.1997 në këto dy qendra votimi kanë votuar për Lekë Çukaj 302 zgjedhës dhe për Ali Spahia 112 zgjedhës. Duke i mbledhur këto rezultate me 5099 votat që kishte më parë Lekë Çukaj dhe 4912 votat që kishte Ali Spahia, rezulton se në 56 qendrat e votimit ku janë zhvilluar zgjedhjet (nga 58 qendra votimi që kishte zona e zgjedhjeve nr.4), Lekë Çukaj ka marrë 5401 vota, ndërsa Ali Spahia ka marrë 5024 vota, pra diferenca ndërmjet tyre

është 377 vota në favor të Lekë Çukaj.

Meqënëse në qendrat e votimit nr.23 dhe 27 ku nuk janë zhvilluar zgjedhjet numuri i zgjedhësve të regjistruar në listat e zgjedhjeve është 310 zgjedhës, pra më i vogël se diferenca prej 377 votash në favor të Lekë Çukaj në 56 qendrat e votimit ku janë zhvilluar zgjedhjet, Gjykata çmon se kërkesa e palës kërkuese për zhvillimin e zgjedhjeve edhe në qendrat e votimit nr.23 dhe 27 duhet refuzuar, sepse çdo rezultat i mundshëm në këto dy qendra votimi nuk ndikon në rezultatin përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24, pika 7 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”” si dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Nuk pajtohemi me mendimin e shumicës për shkak se:

Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes u provua se në qendrat e votimit nr.23 dhe 27 të zonës nr.4 të zgjedhjeve, nuk është zhvilluar asnjëherë votimi për deputet në Kuvendin Popullor, qoftë në raundin e parë qoftë në raundin e dytë të zgjedhjeve, për shkak se nga organet kompetente shtetërore nuk janë hapur asnjëherë këto qendra për votim.

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.42, datë 22.08.1997, ka urdhëruar zhvillimin e zgjedhjeve të raundit të dytë edhe në këto dy qendra votimi, të cilat përsëri nuk janë hapur më datën 31.08.1997, kur do të zhvillohej raundi i dytë i zgjedhjeve.

Mosparaqitja e komisionit të qendrës së votimit për hapjen e saj dhe mosdeklarimi i fillimit të votimit në qendrën e votimit në orën

dhe datën e caktuar nga kryetari i komisionit të qendrës, përbën shkelje të rënda dhe vjen në kundërshtim me nenin 64 të ligjit “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”.

Nga ana tjetër kjo gjithashtu përbën cënim të lirisë së individit për të shfaqur vullnetin e tij politik me anë të votës dhe të së drejtës themelore kushtetuese të parashikuar nga neni 19 i ligjit Kushtetues “Të Drejtat dhe Liritë themelore të Njeriut”, që gëzon shtetasi madhor për të votuar për njërin nga kandidatët për deputet të paraqitur në zonën e zgjedhjeve dhe vetëm për njërin nga subjektet elektorale që marrin pjesë në shpërndarjen e mandateve shtesë në shkallë vendi.

Për shkaqet e lartpërmendura vendimi i komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.4 që ka shpallur fitues kandidatin e Partisë Socialiste, është i pasaktë dhe si i tillë duhet të shfuqizohet dhe njëkohësisht të zhvillohen rregullisht zgjedhjet në qendrat e votimit nr.23 dhe 27 dhe, pasi të nxirret rezultati përfundimtar dhe i plotë i votimit, të shpallet kandidati fitues. Vetëm kështu do të gjente zbatim ligji kushtetues dhe ai për zgjedhjet e deputetëve të Kuvendit Popullor si dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese të lartpërmendur, në bazë të të cilit është urdhëruar zhvillimi i zgjedhjeve edhe në qendrat e votimit nr.23 dhe 27. Vetëm pas zhvillimit të zgjedhjeve në të gjitha qendrat e votimit të zonës, mund të bëhet vlerësim i drejtë dhe i plotë dhe të nxirret rezultati i saktë e përfundimtar.

Kryetar: Rustem Gjata; Anëtar: Halil Kopani.

* * *

Vendim nr. 40, datë 17.05.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Sabri Rrapi, Zija Vuci, Hajredin Fuga, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Sokol Sadushi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 30.04.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.41 Akti që i përket:

KËRKUESE: PARTIA REPUBLIKANE E SHQIPËRISË,
përfaqësuar nga zotërinjtë Maksim Begeja,
nënkryetar i Partisë dhe Arben Ristani,
avokat.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: 1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
në mungesë.
2. KOMISIONI I KUFIJVE TË ZONAVE
ZGJEDHORE,
pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,
në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të ligjit nr.8746, datë 28.02.2001 “Për përcaktimin e zonave zgjedhore”.

Për shfuqizimin si antikushtetues të ligjit të sipërcituar, kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe kryesore:

- Ndarja e zonave zgjedhore është kryer në kundërshtim me nenin 64, pika 1 të Kusht - etutës, që parashikon si kriter kryesor numërin e përafërt të zgjedhësve për çdo zonë;
- Në rreth 40% të zonave zgjedhore, Kuvendi ka lejuar devijime që tejkalojnë kufirin ligjor plus ose minus 5% të numrit mesatar të zgjedhësve, të parashikuar nga neni 71 i Kodit Zgjedhor.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuesit dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Pretendimin kryesor për të argumentuar antikushtetutshmërinë e ligjit nr.8746, datë 28.02.2001 “Për përcaktimin e zonave zgjedhore”, kërkuesi e bazon në mosrespektimin nga ligjvënësi të kriterit ligjor që ka parashikuar neni 71, pika 5 e Kodit Zgjedhor.

Sipas kësaj dispozite, Komisioni i Kufijve të Zonave Zgjedhore “rishikon kufijtë e të gjitha zonave në mënyrë që diferenca mes numrit të zgjedhësve në çdo zonë dhe numrit mesatar të jetë,

për aq sa është e mundur, brenda intervalit plus ose minus 5 përqind të numrit mesatar”.

Gjykata Kushtetuese çmon se ky pretendim i kërkuesit për shpalljen në tërësi të ligjit si antikushtetues, nuk qëndron. Mosrespektimi i kriterit ligjor në kufijtë plus ose minus 5 përqind që duhet të ruhet ndërmjet numrit të zgjedhësve në çdo zonë dhe numërit mesatar, i parashikuar nga Kodi Zgjedhor, nuk është argument për të vërtetuar shkeljen apo moszbatimin e koncepteve dhe parimeve kushtetuese në ligjin “Për përcaktimin e zonave zgjedhore”. Nëse midis ligjeve të ndryshme ka mospërputhje në tërësi apo në dispozita të veçanta, shqyrtimi i këtyre çështjeve nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, pasi sipas nenit 131, shkronja “a” të Kushtetutës, ajo ka të drejtë të vendos për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare.

Kërkuesi i është referuar gjithashtu edhe nenit 64, pika 1 të Kushtetutës, por pa analizuar dhe arsyetuar në kërkesë dhe në seancë gjyqësore shkeljet e konceptit kushtetues të numrit të përafërt të zgjedhësve.

Pavarësisht nga këndvështrimi apo mënyra që ka zgjedhur kërkuesi për të parashtruar argumentat për çështjen, objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese çmon se paraqitet e nevojshme t’i jepet një zgjidhje e plotë të gjitha pretendimeve të tij, duke e analizuar dhe interpretuar në aspektin kushtetues konceptin “numër të përafërt zgjedhësish”, të parashikuar në nenin 64, pika 1 të Kushtetutës.

Nga një interpretim literal i kësaj shprehjeje të krijohet përshtypja se Kushtetuta nuk ka vendosur korniza, apo kritere strikte, por ka lejuar hapësirë për përcaktimin e zonave zgjedhore, pasi edhe sipas nenit 68 pika 2 të saj, rregullat e hollësishme për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve si dhe për ndarjen e zonave zgjedhore rregullohen me ligjin për zgjedhjet. Mbi këtë bazë është Kodi Zgjedhor, që rregullon në mënyrë të veçantë të gjitha problemet që lidhen me zgjedhjet.

Koncepti kushtetues numër i përafërt zgjedhësish, nuk është i njëjlojtë dhe as nuk mund të konfondohet me numrin e barabartë të zgjedhësve, siç pretendon kërkuesi. Një koncept i tillë do të ishte i pakuptimtë për t’u përdorur në ndarjen e zonave zgjedhore, por edhe i pamundur njëkohësisht. Koncepti numër i përafërt zgjedhësish, sigurisht që e përmban në vetvete kriterin numerik, por nuk mund të

konkludohet se ai është i vetmi kriter që shërben për përcaktimin e zonave zgjedhore.

Në Kushtetutë janë sanksionuar disa parime, kritere, apo vlera të tjera kushtetuese, si tradita historike, nevojat e interesat e përbashkëta ekonomike, bashkëjetesa fetare, respektimi i pakicave kombëtare etj, të cilat krahas shumë parimeve të tjera duhet të respektohen dhe të mbrohen nga shteti. Gjithashtu janë të pranueshme dhe të nevojshme për t'u vlerësuar në këtë drejtim edhe kritere të tjera si kompaktësia, kufijtë dhe barrierat natyrore, linjat e transportit dhe të komunikimit etj.

Koncepti “numër i përafërt zgjedhësish” është një kriter kushtetues që duhet ta kenë parasysh organet përkatëse kur propozojnë apo miratojnë ndarjen e zonave zgjedhore. Megjithatë, në aspektin e interpretimit gjuhësor, ky term përmban në vetvete edhe përjashtimin. Përderisa vetë Kushtetuta njeh ndarjen e zonave me numër të përafërt zgjedhësish, ajo nënkupton se barazitizmi ndërmjet tyre bëhet objektivisht i pamundur, si dhe diferencimi në numër të pranueshëm zgjedhësish që mund të krijohet ndërmjet zonave në raport me numurin mesatar të zgjedhësve, është i lejueshëm dhe nuk mund të përbëjë shkak për antikushtetutshmëri. Kjo përafërsi në numër, sigurisht që duhet të përmbushet nga organi përkatës, por nëse nuk ka mundësi realizimi në praktikë, atëherë detyrimisht janë kriteret e tjera, të cilat jo vetëm që nuk duhet të çenohen, por duhet të ndërthuren njëkohësisht me njëri-tjetrin për aq sa është e mundur për të patur një ndarje të drejtë të zonave zgjedhore.

Ky koncept kushtetues që duhet respektuar nga ligjvënësi në ndarjen e zonave zgjedhore, i analizuar nga ky këndvështrim, merr një kuptim edhe më të gjerë. Të kuptuarit e këtij koncepti kushtetues vetëm si kriter aritmetik si dhe zbatimi i tij në mënyrën strikte numerike në ndarjen e zonave zgjedhore, sigurisht që mund të sjell edhe çenimin e parimeve apo vlerave të tjera kushtetuese. Pikërisht koncepti numër i përafërt zgjedhësish e merr kuptimin e drejtë vetëm pasi vlerësohet në kompleks me të gjitha parimet dhe kriteret e tjera kushtetuese.

Prandaj, marrja në konsideratë dhe vlerësimi në tërësinë e tyre për aq sa është e mundur, nga ana e Komisionit të Kufijve të Zonave Zgjedhore dhe të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë e këtyre kritereve kushtetuese dhe ligjore, të cilat janë zbërthyer më tej në nenin 71 të Kodit Zgjedhor, nuk përbëjnë shkelje të nenit 64,

pika 1 të Kushtetutës dhe as devijim nga parimet dhe fryma që ajo përcjell për ndarjen e zonave zgjedhore.

Nga sa parashtruar më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuarit për antikushtetutshmëri të ligjit nr.8746, datë 28.02.2001 “Për përcaktimin e zonave zgjedhore”, nuk janë të bazuara në Kushtetutë dhe për rrjedhojë kërkesa e tij nuk duhet pranuar.

PER KETO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 dhe 132 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë si dhe në nenin 72 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Pakica ka mendimin se ligji nr.8746, datë 28.02.2001 “Për përcaktimin e zonave zgjedhore”, vjen në kundërshtim me nenin 64 të Kushtetutës e për rrjedhim duhet të shfuqizohet. Ndërkohë pakica ka mendimin se me qëllim që të mos pengohen zgjedhjet e caktuara për në datën 24 qershor 2001, vendimi për shfuqizimin e ligjit të mësipërm, bazuar në nenin 132, pika 2 e Kushtetutës, të hyjë në fuqi pas konstituimit të Kuvendit të ri.

Shkaqet për shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr.8746, datë 28.02.2001 i gjejmë:

- Në bazë të nenit 64, pika 1 e Kushtetutës “Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë. 100 deputetë zgjidhen drektpërdrejt në zona njëemërore, me numër të përafërt zgjedhësish, 40 deputetë zgjidhen nga listat shumëemërore të partive dhe/ose të koalicioneve të partive, sipas renditjes në to”. Nga ana tjetër Kushtetuta në nenin 68, pika 2, parashikon rregullimin nga ligji për zgjedhjet i një sërë problemesh e midis tyre dhe përcaktimin e zonave zgjedhore. Në

zbatim të kësaj dispozite, Kodi Zgjedhor, në një sërë dispozitash (nenet 67-75) trajton problemet që kanë të bëjnë me zonat zgjedhore njëemërore. Në nenin 71 të Kodit, janë përcaktuar një sërë kriteresh për caktimin e kufijve të zonave zgjedhore. Pikërisht detyra kryesore e Gjykatës Kushtetuese në shqyrtimin e kësaj çështje ishte që të vlerësonte se cilat kritere kishin karakter kushtetues e duhej të zbatoheshin rigorozisht nga ligji. Pakica ka mendimin se Kushtetuta përsa i përket formimit të zonave zgjedhore ka vetëm një kriter bazë, kriterin numerik. Ai është e mbetet kriter e s'mundet të zëvendësohet me kritere të tjera të cilat mund të kenë rëndësinë e tyre por kurrësesi jo atë kushtetuese.

Për Gjykatën Kushtetuese zgjidhja e problemit objekt shqyrtimi lidhej me interpretimin e zbatimin e këtij kriteri kushtetues e jo të kritereve të tjera ligjore sepse do të ishte paradoks të shqyrtohej gjyqësisht përputhja e një ligji me kriteret e një ligji tjetër. Me të drejtë kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka refuzuar për shqyrtim një kërkesë të Partisë Republikane lidhur me mosrespektimin e kritereve të Kodit Zgjedhor në formimin e një zone zgjedhje, me arsyetimin se ato janë kritere ligjore e për pasojë Gjykata Kushtetuese nuk ka si të shqyrtojë përputhjen e ligjit me ligjin (vendimi nr.32, datë 08.05.2001).

Duke u bazuar në nenin 64, pika 1 të Kushtetutës, Kodi Zgjedhor bën interpretimin e kriterit bazë “numër të përafërt zgjedhësish” nga ku përcakton që diferenca mes numrit të zgjedhësve në çdo zonë dhe numrit mesatar të jetë “pët aq sa është e mundur, brenda intervalit plus ose minus 5 % të numrit mesatar”.

Eshtë detyrë parësore e një shteti demokratik që për të realizuar zgjedhje sa më demokratike, krijimi i mundësive të barabarta qytetarëve për të zgjedhur e për t'u zgjedhur. Në këtë drejtim rolin e vet luan edhe ndarja racionale e zonave të zgjedhjeve. Do të ishte absurditet të pretendohet për ndarje ideale, me numër të barabartë, prandaj ideja e Kushtetutës për numër të përafërt zgjedhësish si kriter bazë në ndarjen e zonave është rezultat i një arsytimi e analize normale. Po aq i arsyeshëm e i pranueshëm është për ne interpretimi që i bën këtij problemi Kodi Zgjedhor, duke vënë “atje ku është e mundur” kufijtë plus numër 5 %. Edhe sikur ky kriter kushtetues nuk do të ishte zbërthyer nga ligji, i takon Gjykatës Kushtetuese që për të arritur në përfundime të drejta, të bënte ajo interpretimin.

Parë në këtë këndvështrim, ligji për ndarjen e zonave të zgjedhjeve, ka dalë jashtë frymës dhe përmbajtjes së Kushtetutës. Për çfarë zbatimi të Kushtetutës mund të bëhet fjalë kur në 50 zona zgjedhore (gjysma e të gjithëve) ka kapërcim të limiteve (mbi ose nën 5 %); për çfarë “numër të përafërt” mund të bëhet fjalë kur në 16 zona diferenca është mbi ose nën 10 % të mesatares të zgjedhësve (zonat 5, 9, 13, 20, 21, 33, 47, 51, 60, 61, 63, 66, 73, 75, 84, 90); kur në tre zona diferenca shkon në mbi ose nën 15 % ose kur diferenca midis zonës më të madhe e asaj më të vogël në ligj është 33,48 % e zgjedhësve (zonat 9, 63).

Këto të dhëna, të cilat nuk kanë nevojë për koment, tregojnë në mënyrë të plotë se në ligjin nr.8746, datë 28.02.2001 “Për përcaktimin e zonave zgjedhore”, është shkelur haptazi kriteri bazë kushtetues i ndarjes së zonave mbi bazën e “numrit të përafërt të zgjedhësve”.

Në vendimin e saj, shumica ruan mendimin se në krijimin e zonave, krahas kriterit numerik, duhej të kihen parasysh edhe kriteret e tjerë të parashikuar në Kodin Zgjedhor (pika 8 e nenit 71). Pa përsëritur argumentin sipas të cilit Gjykata Kushtetuese nuk merret me përputhjen e ligjit me ligjet, duhet theksuar se edhe pakica ka mendimin se kriteret e ligjit duhen marrë parasysh, por deri sa ato të mos çenojnë kriterin kushtetues. Me tablonë e shifrave që u paraqitën është zor të mendohet që për hir të këtyre kriterëve të mënjanohet (e për më tepër të denatyrohet) kriteri bazë kushtetues, në formimin e zonave të zgjedhjeve.

Anëtar: Alfred Karamuço

* * *

Shënim: Vendimet nga nr. 57, datë 03.07.2001 deri tek nr. 117, datë 28.08.2001 paraqiten në mënyrë të përmbledhur (kërkuesi, subjekti i interesuar, objekti dhe dispozitivi i vendimit). Ato gjenden të arsyetuara në botimin e Gjykatës Kushtetuese “Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, procesi zgjedhor 2001” (Tiranë 2001).

Vendim nr.57, datë 03.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Kujtim Puto, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 3.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.69 Akti që u përket:

KËRKUES: **AGRON DUKA,**
kandidat i pavarur në zonën zgjedhore
nr.25, Shijak, përfaqësuar nga avokat
Arben Vani, me prokurë.
OSMAN METALLA,
kandidat i Bashkimit për Fitore,
përfaqësuar nga avokat Arben Ristani,
me prokurë.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.25
SHIJAK,
përfaqësuar kryetari Edmond Isaku.

O B J E K T I: **Shfuqizimi i vendimit nr.981, datë 29.6.2001**
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit nr.981, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.25.

- Urdhërimin për zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve midis kandidatëve për deputetë Agron Duka, i pavarur dhe Osman Metalla, Bashkimi për Fitore.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr.58, datë 03.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 03.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.70 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **ELMAZ SHERIFI**

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.57,
përfaqësuar nga kryetari, zoti Zylyftar Coku.
ZAMIR BALLIU,
përfaqësuar nga avokat Shaqir Hasani.

O B J E K T I: **Shfuqizimin e vendimit nr.008, datë 30.05.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, nenet 113 e 141 të Kodit Zgjedhor.**

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit nr.008, datë 30.06.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Dërgimin e çështjes pranë atij organi për ta shpallur kërkuetin fitues.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr.59, datë 04.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Kristofor Peçi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 04.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.72 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: MENTOR BUNGURI

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj, me
autorizim.

KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.20,
në mungesë.

ILIR GJONI,
kandidat për deputet, përfaqësuar me
prokurë nga avokatët Ilir Panda e Mirash
Martini.

O B J E K T I: **Pavlefshmëria e rezultatit përfundimtar të
zgjedhjeve për zonën zgjedhore nr.20 Dibër
të shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
me vendimin nr.970, datë 29.06.2001**

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr.60, datë 04.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Petrit Pllloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Gjergj Sauli, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 04.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.73 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: MUHAMET BELA

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.31,
përfaqësuar nga kryetari Korab Lita.
SHABAN MEMIA,
përfaqësuar nga avokat Arben Ristani.

O B J E K T I: Shfuqizimin e vendimit nr.949, datë
28.06.2001 të Komisionit Qendror
të Zgjedhjeve, për shpalljen e rezultatit
përfundimtar të zgjedhjeve në zonën
zgjedhore nr.31.

BAZA LIGJORE: Nenet 131 e 141/1 të Kodit Zgjedhor.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr.62, datë 05.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Petrit Pllloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 05.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.76 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: THOMA MIÇO

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.98,
në mungesë.
THEODHORI BEJ,
përfaqësuar nga avokat Ardian Nuni.
LEONARD DEMI,
përfaqësuar nga avokat Kreshnik Spahiu.

O B J E K T I: Shfuqizimin e vendimit nr.971, datë 29.06.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, nenet 113 e 141 të Kodit Zgjedhor.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr.63, datë 05.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Zija Vuci, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 05.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.77 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA SOCIALISTE, DEGA LEZHË**
PARTIA SOCIALDEMOKRATE,
DEGA LEZHË
RAMADAN HASANAJ,
përfaqësuar nga avokat Qemal Stafa

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
ZEF GJOKA

O B J E K T I: **Pavlefshmërinë e vendimit nr.928, datë**
27.06.2001 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve si dhe vendimit datë 26.06.2001
të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.12 Lezhë.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr.64, datë 03.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuco, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 03.07.2001, mori

në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.68
Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **DURIM HUSHI,**
kandidat për deputet i Partisë Socialiste,
përfaqësuar nga avokat Ilia Olldashi.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
OMER STRINGA,
kandidat për deputet i koalicionit Bashkimi
për Fitoren.

O B J E K T I: **Shfuqizimin e Vendimit nr.925, datë**
27.06.2001 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve dhe shpalljen fitues të
kandidatit Durim Hushi.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr.65, datë 06.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Gjergj Sauli, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Kujtim Puto, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 05.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.79 Akti që i përket:

K Ë R K U E S E: **ARTA DADE,**
kandidate për deputete në zonën zgjedhore
nr.63 Lushnje, përfaqësuar nga avokat

Mirash Martini, me prokurë.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
AGIM RREDHI,
kandidat për deputet i pavarur.

O B J E K T I: Shfuqizimin e vendimit nr.987, datë
29.06.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.987, datë 29.06.2001;

- Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të shpallë fituese kandidaten për deputete të Partisë Socialiste, znj. Arta Dade;

- Anullimin e raundit të dytë të zgjedhjeve në zonën nr.63;

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr.66, datë 06.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Zija Vuci, Kristofor Peçi, Petrit Pllloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Kujtim Puto, Alfred Karamuço, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 06.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.83 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **FILIP ÇAKULI,**
kandidat për deputet në zonën zgjedhore
nr.100, përfaqësuar nga avokat Virgjil Karaj.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
STEFAN ÇIPA,

në mungesë.
ANDREA MIÇO,
në mungesë.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.100,
përfaqësuar nga Resmi Iljazi.

O B J E K T I: Shfuqizimi i vendimit nr.932, datë 28.06.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

V E N D O S I:

- Pushimin e çështjes.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 67, datë 12.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Gjergj Sauli, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Tefta Zaka, Petrit Pllloçi, Sokol Sadushi, Kristofor Peçi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 12.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.94 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **ZIHNI BEQIRAJ,**
kandidat për deputete në zonën zgjedhore nr.27, përfaqësuar me deklaram nga avokat Nikolla Kondakçi.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
PËLLUMB BERISHA,
përfaqësuar me deklaram nga avokat Halil Kopani.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.27,
përfaqësohet nga Mehmet Berisha, kryetar.

O B J E K T I: Pavlefshmëria e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për zonën zgjedhore nr.27.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 68, datë 13.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Tefta Zaka, Petrit Plloçi, Sokol Sadushi, Alfred Karamuço, anëtarë, me sekretare Drita Panda, më datë 09.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.71 Akti që u përket:

K Ë R K U E S: **ARBEN LIKA,**
kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.1, përfaqësuar me prokurë nga avokate Denisa Daka.
RUZHDI DULAJ,
kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.1, përfaqësuar me prokurë nga avokatët Denisa Daka e Vasil Plaku.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
GJOVALIN BZHETA,
kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.1, përfaqësuar me prokurë nga avokat Adnor Shameti.

O B J E K T I: Shfuqizimi i vendimit nr.960, datë 29.06.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 69, datë 12.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Tefta Zaka, Petrit Plloçi, Sokol Sadushi, Zija Vuci, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 11.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.90 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **BASHKIMI PER FITOREN, VISAR ZHITI,**
kandidat për deputet në zonën zgjedhore
nr.34, përfaqësuar nga avokat Halil Kopani.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
SPARTAK POÇI,
kandidat për deputet në zonën zgjedhore
nr.34, përfaqësuar me prokurë nga avokatët
Ilir Panda e Mirash Martini.

O B J E K T I: Shpallja e pavlefshmërisë së vendimit
nr.932, datë 28.06.2001 të Komisionit
Qendror të Zgjedhjeve dhe rishikimin e
procesit zgjedhor deri në përsëritjen e
zgjedhjeve në zonën elektorale nr.34.

BAZA LIGJORE: Nenet 134 pika 1, shkronja “f” të
Kushtetutës dhe nenit 141 pika 1 e Kodit
Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 70, datë 11.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Tefta Zaka, Petrit Pllaçi, Sokol Sadushi, Kristofor Peçi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 05.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.81 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **LEKE ÇUKAJ,**
kandidat për deputet në zonën zgjedhore
nr.2, përfaqësuar me deklaram nga avokat
Gjin Progni.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
MARK KROQI,
kandidat për deputet në zonën zgjedhore
nr.2, përfaqësuar me prokurë nga avokat
Adnor Shameti.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.2,
përfaqësuar nga kryetari Ndue Dodaj.

O B J E K T I: Shfuqizimi i pjeshëm i vendimit nr.007,
datë 30.06.2001 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve.

V E N D O S I:

- Pranimin e pjesëshëm të kërkesës për shfuqizimin e vendimit

nr.007, datë 30.06.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për pjesën që ka shpallur të pavlefshme rezultatet e zgjedhjeve në pesë qendra votimi të zonës nr.2 Shkodër dhe konkretisht në qendrat e votimit nr.11 dhe 13 të Komunës Shkrel, 1 dhe 6 të Komunës Pult dhe 8 të Komunës Temal.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* *
* *

Vendim nr. 71, datë 06.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 11.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.93 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **MEHDI ALIMEHMETI,**
kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitoren”, përfaqësuar me prokurë nga Vladimir Mulaj.

SUBJEKTE
TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
SPARTAK BRAHO

O B J E K T I: **Shfuqizimin e Vendimit nr.003, datë**
29.06.2001 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve, duke shpallur të pavlefshme
zgjedhjet në zonën zgjedhore nr.24 si dhe
zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 72, datë 13.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Petrit Pllloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Gjergj Sauli, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 13.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.96 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **BUJAR LAKO,**
kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi
për Fitoren”.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
ERMELINDA MEKSI,
përfaqësuar me prokurë nga Bujar Xhafa.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.42,
përfaqësuar nga zv/kryetare Mamica Shehu.

O B J E K T I: Shfuqizimin e Vendimit nr.977, datë
29.06.2001 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve, që ka shpallur rezultatin
përfundimtar të zgjedhjeve në zonën
zgjedhore nr.42.

BAZA LIGJORE: **Nenet 107/b,c, 141 të Kodit Zgjedhor dhe
68/2 të Kushtetutës**

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 73, datë 17.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Gjergj Sauli, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 17.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.99 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **HAJDAR KOVAÇI,**
kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitoren”, përfaqësuar me deklaram nga avokatët Ilir Panda e Mirash Martini.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
GJERGJ KOJA,
përfaqësuar me deklaram nga avokat Nikolla Kondakçi.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.28,
përfaqësuar nga kryetari Shpëtim Beqiraj.

O B J E K T I: Shfuqizimin e Vendimit nr.129, datë 09.07.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.28.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 113, 141/I të ligjit nr.8609, datë 08.05.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 74, datë 17.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Alfred Karamuço, anëtarë, me sekretare Drita Panda, më datë 09.07.2001 dhe 14.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.82 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË,**
përfaqësuar me prokurë nga avokatët
Fatmir Gjika e Kujtim Bara.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA:KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
SALI SHEHU,
përfaqësuar me prokurë nga avokat Artan
Zeneli.
SHEFQET HOTI,
zv/kryetar i Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.21.

O B J E K T I: **Shfuqizimin e Vendimit nr.997, datë**
29.06.2001 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve, duke parashtruar këto shkaqe:

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.997, datë 29.06.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duke shpallur të pavlefshme zgjedhjet në 17 qendra votimit të zonës zgjedhore nr.21 Dibër dhe konkretisht:

Në komunën Kastriot në qendrat e votimit nr.3, 4, 5, 10, 11, 14 dhe 15;

Në komunën Kala e Dodës në qendrat e votimit nr.4, 5, 6 dhe 7;
Në komunën Tomina Qendër në qendrat e votimit nr.1 dhe 4;
Në komunën Arras në qendrën e votimit nr.3;
Në komunën Fushë-Çidhën në qendrën e votimit nr.4;
Në komunën Sllövë në qendrën e votimit nr.5;
Në komunën Lurë në qendrën e votimit nr.1.

2. Urdhëron zhvillimin e zgjedhjeve të raundit të parë vetëm për listën njëemërore në qendrat e votimit të lartpërmendura.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 75, datë 18.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Petrit Pllloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datat 05.07.2001 dhe 07.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.80 Akti që i përket:

K Ë R K U E S E: **MAKBULE ÇEÇO,**
kandidate për deputete e Partisë Socialiste,
përfaqësuar nga avokat Arben Hakani.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Sokol Lamaj
ROLAND BEJKO,
kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi
për Fitoren”, përfaqësuar nga juristi
Vladimir Mulaj.

O B J E K T I: Shfuqizimin e Vendimit nr.984, datë 29.06.2001
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S I:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 76, datë 18.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Kristofor Peçi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datën 16.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.98 Akti që i përket:

K Ë R K U E S E: **LIRI DIBRA,**
përfaqësuar me deklaram nga avokat
Kreshnik Spahiu.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA:**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
BARDHYL AGASI
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.29,
përfaqësuar nga kryetari Lluqa Kuqi.

O B J E K T I: Shfuqizimin e Vendimit nr.166, datë 12.07.2001
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 77, datë 18.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Zija Vuci, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 12.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.91 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **DEGA E PARTISË SOCIALISTE MAT,**
përfaqësuar nga kryetari i komitetit
drejtues, zoti Agim Hysa.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj,
me autorizim.
HALIL LALAJ,
kandidat për deputet i Partisë Socialiste,
përfaqësuar me deklaram nga avokatët Ilir
Panda e Mirash Martini.
GANI HOXHA,
kandidat për deputet i pavarur mbështetur
nga koalicioni “Bashkimi për Fitoren”, në
mungesë.

O B J E K T I: Shpalljen e pavlefshmërisë së Vendimit
nr.968, të datës 29.06.2001 të Komisionit
Qendror të Zgjedhjeve në zonën zgjedhore
nr.17 Mat.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës dhe neni 141 i Kodit
Zgjedhor.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 78, datë 13.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Petrit Pllloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, anëtarë, me sekretare Drita Panda, më datë 09.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.84 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **NIKOLLË LESI,**
kandidat për deputet i pavarur, përfaqësuar
me prokurë nga avokat Përparim Sanxhaku.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj,
me autorizim.
LLESH KOLA,
kandidat për deputet i pavarur, përfaqësuar
me deklaram nga avokat Baftjar Rusi.

O B J E K T I: **Shfuqizimi i Vendimit nr.012, të datës**
01.07.2001 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.13 Lezhë.

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit nr.012, datë 01.07.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultateve përfundimtare të votimit në zonën zgjedhore nr.13 Lezhë për shkak të konstatimit të parregullsive serioze gjatë procesit zgjedhor zonal.

- Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.13 vetëm për listën njëemërore.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 79, datë 18.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Petrit Pllloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 16.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.97 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **PËLLUMB VLADI,**
 kandidat për deputet i Partisë Socialiste,
 përfaqësuar nga avokat Arben Hakani.

SUBJEKTE
TË INTERESUARA:KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
 përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
 BRAHIM BRUKA

O B J E K T I: **Shfuqizimin e Vendimit nr 158, dt 10.07.2001**
 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 80, datë 12.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Petrit Pllloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Gjergj Sauli, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 05.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.78 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **ARIAN STAROVA,**
 përfaqësuar me deklaram nga avokat
 Arben Ristani.

SUBJEKTE
TË INTERESUARA: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
 përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
 ET'HEM RUKA,
 përfaqësuar me prokurë nga avokat
 Përparim Sanxhaku.

O B J E K T I: **- Shfuqizimi i Vendimit nr.007, datë 30.06.2001**
 të Komisionit Qendror të zgjedhjeve, që ka
 shpallur rezultatin përfundimtar të
 zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.40 dhe të
 vendimit nr.16, datë 27.06.2001 të
 Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.40.
 Urdhërimin e raundit të dytë të zgjedhjeve
 për zhvillimin e balotazhit në zonën
 zgjedhore nr.40.

BAZA LIGJORE: **Nenet 3. 113 dhe 141 të Kodit Zgjedhor**

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit nr.007, datë 30.06.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit përfundimtar në zonën zgjedhore nr.40;

- Urdhërimin e zhvillimit të raundit të dytë të zgjedhjeve midis kandidatit për deputet Et'hem Ruka dhe kandidatit për deputet Arian Starova.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 81, datë 07.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Kujtim Puto, anëtarë, me sekretare Drita Panda, më datë 07.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.92 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **NDREKË RUKAJ,**
kandidat për deputet i Partisë Socialiste,
përfaqësuar me deklaram nga avokat
Arben Hakani.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga Sokol Lamaj
VALENTIN PALAJ
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.4,
përfaqësuar nga kryetari Ernest Rukaj.

O B J E K T I: **Shfuqizimin e Vendimit nr.096, datë**
03.07.2001 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve.

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* *
* *
*

Vendim nr. 82, datë 18.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Kujtim Puto,

anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 17.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.102 Akti që i përket:

K Ë R K U E S A: **LEKË ÇUKAJ,**
kandidat për deputet i Partisë Socialiste.
MARK KROQI,
përfaqësohet me deklaram nga av. Bujar Hoti.

SUBJEKT
I INTERESUAR: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.

O B J E K T I: **Shfuqizimi i pjesëshëm i Vendimit nr.171,**
datë 13.07.2001 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve.

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesave.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 83, datë 20.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Tefta Zaka, Petrit Pllloçi, Sokol Sadushi, Alfred Karamuço, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 19.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.104 Akti që u përket:

K Ë R K U E S: **LUAN HAJDARAGA,**
kandidat për deputet në zonën zgjedhore
nr.36, përfaqësuar nga avokat Artan Tabaku.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
në mungesë.
EDI PALOKA,
kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.36,
përfaqësuar nga avokat Arben Ristani.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.36,
përfaqësuar nga kryetarja Suela Morina

O B J E K T I: Shfuqizimi i vendimit nr.178, datë 17.07.2001
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 84, datë 12.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Petrit Pllloçi, Sokol Sadushi, Tefta Zaka, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 12.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.89 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **NDUE LAZËR PJETRA,**
kandidat për deputet i Partisë
Socialdemokrate, përfaqësuar me deklaram
nga avokat Lazër Preng Zefi.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
PJETËR ARBNORI,

**kandidat për deputet, i pavarur,
mbështetur nga PD+BF, në mungesë.**

O B J E K T I: Shfuqizimi i vendimit nr.988, datë 29.06.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përsëritjen e zgjedhjeve në 5 qendra votimi.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 85, datë 10.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Gjergj Sauli, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Petrit Pilloçi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 10.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.86 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **AGRON AGALLIU,**
kandidat për deputet i subjektit politik
“Bashkimi për Fitoren”, përfaqësuar me
prokurë nga Ilir Rusmajli.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
YLLI BUFI,
kandidat për deputet i Partisë Socialiste,
përfaqësuar nga avokatët Ilir Panda e
Mirash Martini, me prokurë.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.67,
përfaqësohet nga zonja Vjollca Bita.

O B J E K T I: Shfuqizimi i vendimit nr.946, datë 28.06.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE: Nenet 113 e 141 të Kodit Zgjedhor.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 86, datë 18.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Gjergj Sauli, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Petrit Pllloçi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 17.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.101 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **NDRE LEGISI,**
kandidat për deputet i subjektit zgjedhor
Partia Socialiste, përfaqësuar me deklaram nga Fatmir Gjika.
KOLIN HIL GJOKA,
kandidat për deputet i subjektit zgjedhor
“Bashkimi për Fitoren”, përfaqësuar me prokurë nga juristi Vladimir Mulaj.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.14,
përfaqësuar nga zoti Zef Prenga.

O B J E K T I: Shfuqizimi i vendimit nr.172, datë 13.07.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE: Neni 141 i Kodit Zgjedhor.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 87, datë 11.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Gjergj Sauli, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Petrit Plloçi, Sokol Sadushi, Tefta Zaka, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 11.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.87 Akti që i përket:

K Ë R K U E S E: ESMERALDA URUÇI,
kandidate për deputete e Partisë Socialiste,
përfaqësuar me prokurë nga avokat
Përparim Sanxhaku.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
ASTRIT BUSHATI,
përfaqësuar me deklaram nga avokat Bujar Hoti.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE,
përfaqësuar nga zv/kryetari Sulejman Sulaj.

O B J E K T I: Shfuqizimi i vendimit nr.956, datë 29.06.2001
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe
deklarimi i pavlefshëm i zgjedhjeve në
Zonën Zgjedhore nr.5 Shkodër.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 88, datë 10.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Gjergj Sauli, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Petrit Pllaçi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 10.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.85 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **MERO BAZE,**
kandidat për deputet i subjektit elektoral
“Bashkimi për Fitoren”, përfaqësuar me
prokurë nga avokat Kreshnik Spahiu.

SUBJEKTE
TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
GAZMIR BIZHGA,
përfaqësuar me deklaram nga avokat
Nikolla Kondakçi.

O B J E K T I: **Shfuqizimi i vendimit nr.010, datë 30.06.2001**
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 89, datë 14.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Gjergj Sauli, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Petrit Plloçi, Kujtim Puto, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 13.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.95 Akti që i përket:

K Ë R K U E S E: **MIMOZA AHMETI,**
kandidate për deputete e koalicionit
“Bashkimi për Fitoren” në zonën zgjedhore nr.43.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
MONIKA KRYEMADHI,
kandidate për deputete e Partisë Socialiste,
përfaqësuar me prokurë nga avokat Agim
Muça.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.43,
në mungesë.

O B J E K T I: **Shfuqizimi i vendimit nr.944, datë 28.06.2001**
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 91, datë 12.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Petrit Plooçi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datat 05.07.2001 dhe 12.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.74 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **GAFURR MUKA,**
kandidat për deputet në zonën zgjedhore
nr.19, i subjektit elektorale "Bashkimi për
Fitoren", përfaqësuar me prokurë nga
avokat Neshat Fana.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
ISMAIL LLESHI,
përfaqësuar me prokurë nga avokat Baftjar Rusi.

O B J E K T I: **Shfuqizimi i Vendimit nr.006, datë 29.06.2001**
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE: **Nenet 113 e 141 të Kodit Zgjedhor**

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* *
* * *

Vendim nr. 92, datë 20.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Petrit Plooçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi,

anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 18.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.103 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **SHPËTIM KATESHI,**
kandidat për deputet i Partisë Socialiste,
përfaqësuar nga avokat Ilir Panda.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
HALIT SHAMATA,
kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi
për Fitoren”, përfaqësuar me prokurë nga
Vladimir Mulaj.

O B J E K T I: **Shfuqizimin e Vendimit nr.170, datë 13.07.2001**
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e pjesëshëm të vendimit nr.170, datë 13.07.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Lënien në fuqi të Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe zhvillimin e raundit të dytë në qendrat e votimit nr.11, 12 të Komunës Karinë; në qendrat e votimit nr.14, 15, 16, 19 të Komunës Gjocaj; në qendrat e votimit nr.32, 34, 36 të Komunës Përparim si dhe në 19 qendrat e votimit të Komunës Pajovë e të Bashkisë Peqin, ku nuk është zhvilluar votimi.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 93, datë 23.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kristofor

Peçi, Kujtim Puto, Petrit Pllloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Zija Vuci, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 19.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.100 Akti që i përket:

K Ë R K U E S E: **SAEMIRA GJIPALI,**
kandidate për deputete e Partisë Socialiste,
përfaqësuar me prokurë nga avokat Arben
Hakani.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
SPARTAK NGJELA,
përfaqësuar me autorizim nga Vladimir Mulaj
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.38,
përfaqësuar nga zv/kryetari, Tonin Alimëhilli,

O B J E K T I: Shfuqizimin e Vendimit nr.163, datë 17.07.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në këtë zonë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131 shkronja “e” e Kushtetutës; 141 pika 1; 113 shkronja “a” dhe pika 5 e Kodit Zgjedhor.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 94, datë 26.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Kristofor

Peçi, Kujtim Puto, Petrit Pllloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Gjergj Sauli, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 24.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.105 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **ALFRED OLLI,**
kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitoren”, përfaqësuar nga avokat Arben Ristani.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
RAHMI MEHMETLLARI,
kandidat për deputet i Partisë Socialiste,
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.82,
përfaqësuar nga Pëllumb Kulla.

O B J E K T I: **Shfuqizimin e Vendimit nr.183, datë 19.07.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.82 dhe të Vendimit nr.13, datë 15.07.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore, ose konstatimin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendrat e votimit nr.16, 17, 30, 32, 33, 34, 35 dhe 36 të zonës zgjedhore nr.82.**

BAZA LIGJORE: **Neni 141 i Kodit Zgjedhor.**

V E N D O S I:

- Të shpallë pjesërisht të pavlefshëm Vendimet nr.183, datë 19.07.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nr.13, datë 15.07.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.82;

- Të shpallë të pavlefshme aktet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për rinumërimin e fletëve të votimit në qendrat e votimit nr.16, 17, 30, 34, 35 dhe 36 të Zonës Zgjedhore nr.82;

- Të përsëritet rinumërimi i fletëve të votimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë në qendrat e votimit nr.16, 17, 30, 34, 35 dhe 36 të Zonës Zgjedhore nr.82.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 98, datë 27.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Petrit Pllloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Kujtim Puto, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 27.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.108 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **NDREKË RUKAJ,**
kandidat për deputet i Partisë Socialiste, në
zonën zgjedhore nr.4, përfaqësuar me
prokurë nga avokat Preng Zefi.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
VALENTIN PALAJ,
përfaqësuar me prokurë nga avokat Arben
Ristani.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.4,
përfaqësuar nga Njac Çapaliku

O B J E K T I: **Shfuqizimi i Vendimit nr.200, datë 25.07.2001**
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 99, datë 31.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Alfred Karamuço, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 30.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.100 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **AVNI SHEHU,**
kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.18

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
LUAN RAMA,
kandidat për deputet në zonën zgjedhore
nr.18, përfaqësuar nga avokat Mirash Martini.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.18,
në mungesë.

O B J E K T I: **Shfuqizimin e Vendimit nr.196, datë 24.07.2001**
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 100, datë 31.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Kristofor Peçi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 30.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.110 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **MARK KRROQI,**
përfaqësuar nga avokat Bujar Hoti.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **LEKË ÇUKAJ,**
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga Sokol Lamaj, me autorizim
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE Nr.2,
përfaqësuar nga kryetari Ndue Dodaj.

O B J E K T I: **Shfuqizimi i vendimit nr.203, datë 25.07.2001**
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe
shpalljen të pavlefshme të votimeve të
22.07.2001 në qendrat e votimit Nr.5 Abat;
Nr.7 Nikaj; Nr.9 Menmavriq; Nr.14 Prekal;
Nr.6 Benë dhe Nr.9 Toplan të Zonës
Zgjedhore Nr.2.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 101, datë 31.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Petrit Pllloçi, Sokol Sadushi, Tefta Zaka, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 26.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.107 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **BAMIR TOPI,**
kandidat për deputet i koalicionit
“Bashkimi për Fitoren”, përfaqësuar nga
avokat Roland Samarxhi, me prokurë.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
ZAMIRA ÇAKA,
kandidate për deputete e Partisë Socialiste,
përfaqësuar nga avokat Mirash Martini.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.35,
përfaqësuar nga kryetari, Bujar Nishani.

O B J E K T I: **Shfuqizimi i vendimeve nr.192, datë**
23.07.2001 dhe nr.193, datë 23.07.2001 të
Komisionit Qendor të Zgjedhjeve.

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit nr.192, datë 23.07.2001 të Komisionit Qendor të Zgjedhjeve dhe lënien në fuqi të vendimit nr.40, datë 09.07.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.35 që ka shpallur fitues zotin Bamir Topi, kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitoren”.

- Detyrimin e Komisionit Qendor të Zgjedhjeve të shpallë rezultatin përfundimtar.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 102, datë 28.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Petrit Pllloçi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 26.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.106 Akti që i përket:

K Ë R K U E S : **SUBJEKTI ZGJEDHOR “BASHKIMI PËR**
FITOREN”,
përfaqësuar me prokurë nga Ilir Rusmajli.

MUSLIM MURRIZI,
kandidat për deputet i koalicionit
“Bashkimi për Fitoren”, përfaqësuar nga
Irir Rusmajli.
PARTIA SOCIALDEMOKRATE,
përfaqësuar nga avokat Mirash Martini.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
PARTIA SOCIALISTE,
përfaqësuar nga Sokol Hazizi.
PARTIA DEMOKRATE,
përfaqësuar nga Sali Kelmendi.
PARTIA AGRARE,
përfaqësuar nga Resmi Osmani.
PARTIA BASHKIMI PER TE DREJTAT E
NJERIUT,
në mungesë.

O B J E K T I: -Shfuqizimi i Vendimit nr.191, datë
22.07.2001 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve “Për mosshpalljen e rezultateve
të zgjedhjeve për Kuvendin në zonën
zgjedhore nr.60.
-Shfuqizimi i pjeshëm i vendimit nr.191,
datë 22.07.2001 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE: Neni 113 i Kodit Zgjedhor.

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës të kërkuësve Koalicionit “Bashkimi për Fitoren” dhe kandidatit për deputet Muslim Murrizi për shfuqizimin e vendimit nr.191, datë 22.07.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si të pabazuar.

2. Rrëzimin e kërkesës së Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë për shfuqizimin e pjeshëm të vendimit nr.191, datë 22.07.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si të pabazuar.

3. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 103, datë 10.08.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Sokol Sadushi, Petrit Pllloçi, Tefta Zaka, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 10.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.88 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **GËZIM GOÇI,**
kandidat për deputet i Partisë Socialiste,
përfaqësuar nga avokat Myrteza Myftari.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
MUHAMET UKPERAJ,
kandidat i pavarur për deputet i mbështetur
nga PD+BF.

O B J E K T I: **Shfuqizimi i vendimit nr.996, datë 29.06.2001**
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe
përsëritjen e zgjedhjeve në zonën
zgjedhore nr.10

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 104, datë 31.07.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Sokol Sadushi, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, Zija Vuci, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 31.07.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.111 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **TRITAN SHEHU,**
 përfaqësuar nga avokat Artan Hajdari.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **PARTIA DEMOKRATE,**
 përfaqësuar nga Sali Kelmendi.
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
 përfaqësuar nga Sokol Lamaj, me autorizim.

O B J E K T I: **Kundërshtimi i Vendimit të Komisionit**
 Qendror të Zgjedhjeve nr.206, datë 27. 06. 2001

BAZA LIGJORE: **Neni 141 i Kodit Zgjedhor.**

V E N D O S I:

- Pranimin e kërkesës.
- Urdhërimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të hapë kutitë e votimit të raundit të parë të zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore nr.35, të verifikojë vlefshmërinë e votave të pavlefshme të kandidatit për deputet Tritan Shehu e të Partisë Demokratë si dhe në përfundim të shpallë rezultatin përfundimtar.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 107, datë 06.08.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi,

Kujtim Puto, Petrit Pilloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 04.08.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.113 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA REPUBLIKANE E SHQIPËRISË,**
përfaqësuar nga Spartak Ngjela.
MUSLIM MURRIZI,
kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi
për Fitoren”,
përfaqësuar nga Ferdinand Pone.
PARTIA DEMOKRATE E SHQIPËRISË,
përfaqësuar nga Sali Kelmendi.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
ASLLAN HAXHIU,
kandidat për deputet i Partisë Socialiste.
PARTIA ALEANCA DEMOKRATIKE,
në mungesë.
PARTIA AGRARE,
në mungesë
PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E
NJERIUT, në mungesë.
PARTIA SOCIALISTE,
në mungesë.
PARTIA SOCIALDEMOKRATE,
në mungesë.

O B J E K T I: Shfuqizimin si të pavlefshëm të vendimeve
nr.209 dhe nr.211 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve, për shpalljen e rezultatit
përfundimtar të zgjedhjeve të kandidatit për
deputet dhe të listës shumëemeroze për
zonën zgjedhore nr.60

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë, hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 111, datë 13.08.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Petrit Pllloçi, Zija Vuci, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 11.08.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.117 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **RAHMI MEMETLLARI,**
kandidat për deputet i Partisë Socialiste,
përfaqësuar nga Sokol Hazizi.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **ALFRED OLLI,**
kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi
për Fitoren”, përfaqësuar
nga avokat Ilir Rasmajli.
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE nr.82,
përfaqësuar nga Pëllumb Kulla.

O B J E K T I: Shfuqizimi i vendimeve nr.219, datë 08.08.2001
dhe nr.221, datë 09.08.2001 të Komisionit
Qendror të Zgjedhjeve dhe përsërtijen e
zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.10.

BAZA LIGJORE: Neni 141 i Kodit Zgjedhor.

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit nr.219, datë 08.08.2001 të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve me të cilin është urdhëruar të mos përfshihen në tabelën e rezultatit përfundimtar për zonën zgjedhore nr.82, qendrat e votimit 17, 34, 35 e 36.

- Shfuqizimin e vendimit nr.221, datë 09.08.2001 të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve lidhur me nxjerrjen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.82.

- Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve në qendrat e votimit nr.17, 34, 35 e 36 të zonës zgjedhore nr.82, vetëm për listën njëemërore.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 112, datë 13.08.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Gjergj Sauli, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, më datë 11.08.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.118 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **LLESH KOLA,**
kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitoren” në zonën zgjedhore nr.13
Lezhë, përfaqësuar nga avokatët
Mirash Martini e Agim Ibrahimimi.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
NIKOLLË LESI,
përfaqësuar nga avokat
Përparim Sanxhaku, me prokurë.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.13
LEZHË, në mungesë.

O B J E K T I: Shfuqizimi i vendimit nr.220, datë 08.08.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.13.

BAZA LIGJORE: Neni 141 i Kodit Zgjedhor.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 114, datë 27.08.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Gjergj Sauli, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Zija Vuci, anëtarë, me sekretare Drita Panda, më datë 27.08.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.120 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **LIGORAQ KARAMELO,**
përfaqësuar nga avokat Bastri Mane.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: ARBEN BROJA,
kandidat për deputet i Partisë Bashkimi
për të Drejtat e Njeriut, përfaqësuar nga
avokat Përparim Sanxhaku.
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
PARTIA BASHKIMI PER TE DREJTAT E
NJERIUT,
përfaqësuar nga Zana Pihiku.

O B J E K T I: **Shfuqizimi i vendimit nr.233, datë 21.08.2001**
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE: Neni 64 i Kushtetutës dhe nenet 81, 82 e 83
të Kodit Zgjedhor.

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit nr.233, datë 21.08.2001 të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve në pjesën që shpall deputet për Kuvendin e Shqipërisë zotin Arben Broja dhe detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që në vend të tij të shpallë deputet zotin Ligoraq Karamelo.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 115, datë 28.08.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, Petrit Plloçi, anëtarë, me sekretare Drita Panda, më datë 27.08.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.121 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **BARDHYL LONDO,**
kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitoren” në listën shumëemërore, përfaqësuar nga avokat Ilir Rasmajli.

SUBJEKTE
TË INTERESUARA: **LUAN MYFTIU,**
kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitoren”, përfaqësuar nga avokate Aldona Sulaj.
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.

O B J E K T I: Shfuqizimi i vendimit nr.232, datë 21.08.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shpalljen e listës së deputetëve të koalicionit “Bashkimi për Fitoren”, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese”.

BAZA LIGJORE: Neni 141 i Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit nr.232, datë 21.08.2001 të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve në pjesën që shpall deputet të Kuvendit të Shqipërisë zotin Luan Myftiu dhe detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që në vend të tij të shpallë deputet zotin Bardhyl Londo.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 116, datë 28.08.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Sokol Sadushi, Petrit Plloçi, Tefta Zaka, anëtarë, me sekretare Drita Panda, më datë 28.08.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.122 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: BESNIK ALLAMANI,
kandidat për deputet i Partisë Demokratë.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
PARTIA DEMOKRATE

O B J E K T I: Shfuqizimi i vendimit nr.230, datë 21.08.2001
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE: Nenet 81 e 141/1 të Kodit Zgjedhor dhe neni
64 i Kushtetutës.

V E N D O S I:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 117, datë 28.08.2001

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Petrit Pllloçi, Tefta Zaka, Sokol Sadushi, anëtarë, me sekretare Drita Panda, më datë 28.08.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.123 Akti që i përket:

K Ë R K U E S E: **PARTIA SOCIALDEMOKRATË SHQIPËRISË,**
përfaqësuar nga Engjëll Bejtaj dhe Mirash Martini.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
KOALICIONI “BASHKIM PËR FITOREN”,
përfaqësuar nga Ferdinand Pone dhe
Vladimir Mulaj, me prokurë.

O B J E K T I: Shfuqizimi i pjesëshëm i vendimeve nr.227 dhe nr.228, datë 21.08.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si të papajtueshëm me nenin 64/2 të Kushtetutës.

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 117, datë 06.06.2002

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Petrit Pllloçi, Sokol Sadushi, Kristofor Peçi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, në datën 03.06.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.119 Akti që i përket:

- K Ë R K U E S:** **ARBEN BROJA,**
përfaqësuar nga avokat Mirash Martini,
me deklaram.
- SUBJEKT**
I INTERESUAR: **KRISTO GOÇI,**
përfaqësuar nga avokate Hanëme Bakia,
me deklaram.
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga juristja Dëshira Mataj,
me autorizim.
- O B J E K T I:** **Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit**
nr.44, datë 23.05.2002 të Komisionit
Qendror të Zgjedhjeve.
- BAZA LIGJORE:** **Nenet 81 dhe 141 të Kodit Zgjedhor.**

Për shfuqizimin e këtij vendimi kërkuesi parashtron:

- Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që shpall deputet zotin Kristo Goçi është në kundërshtim me nenin 81/2 të Kodit Zgjedhor, që përcakton se në rast dorëheqje të një kandidati, vazhdohet me kandidatin pasues në renditje;
- Heqja dorë nga kandidimi i zotit Kristo Goçi, provohet me deklaratën e nënshkruar prej tij.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kuvendi i Shqipërisë me shkresën nr.1263, datë 15.05.2002, në mbështetje të nenit 11 pikat 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor ka kërkuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të kryhen të gjitha procedurat për plotësimin e vendit vakant të një deputeti nga lista shumëemërore e PBDNj-së.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.44, datë 23.05.2002, ka vendosur që vendi vakant të plotësohet nga kandidati Kristo Goçi, i cili renditej i katërti në listën shumëemërore të PBDNj-së.

Kërkuesi Arben Broja, pretendon se është ai kandidati pasues në listë meqënëse kanë hequr dorë nga kandidimi 23 kandidatë dhe është përpiluar me renditje sipas numurit më të madh të votave të marra në votimin e drejtpërdrejtë një listë e dytë, në të cilën ai figuron i treti.

Gjykata Kushtetuese çmon se ky pretendim i kërkuesit nuk ka asnjë bazë. Sipas neneve 76 e 81/1 të Kodit Zgjedhor, lista shumëemërore paraqitet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se 22 ditë para datës së zgjedhjeve dhe vendimi për pranimin ose mospranimin merret jo më vonë se 19 ditë para datës së zgjedhjeve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në datën 04.06.2001 ka pranuar listën shumëemërore të dorëzuar nga PBDNj-ja, në të cilën kandidati Kristo Goxhi renditet i katërti, ndërsa kërkuesi Arben Broja ka numurin rendor 25. Në datën 01.08.2001, PBDNj-ja paraqet një listë të dytë, në të cilën kërkuesi renditet i treti. Së bashku me këtë listë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dorëzohen edhe 23 deklaratatë të kandidatëve që kanë hequr dorë nga kandidimi. Mbi këtë bazë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.233, datë 21.08.2001, ka shpallur listën e deputetëve të PBDNj-së, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese, duke caktuar në vendin e tretë kandidatin Arben Broja. Ky vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.114, datë 27.08.2001. Sipas këtij vendimi, paligjshmëria e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve konsiston në disa drejtime:

Së pari, tërheqja nga kandidimi nuk i jep të drejtë askujt të bëjë ndryshime në listat shumëemërore të vërtetuara;

Së dyti, me miratimin e këtyre listave kandidatët e regjistruar në to fitojnë cilësinë e subjektit zgjedhor. Pra, janë vetë ata që disponojnë

mbi të drejtën për t'u zgjedhur dhe jo partitë politike. Dorëheqja e tyre nga e drejta e kandidimit është një akt personal, prandaj është vetë kandidati që duhet t'i drejtohet me kërkesë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe jo partitë politike;

Së treti, kriteri për ndarjen e mandateve shtesë që kandidatët të shpallen fitues sipas numurit të votave të fituara në votimin e drejtpërdrejtë, është i paligjshëm, sepse jo vetëm që nuk rezulton të jetë pasqyruar në ndonjë akt shkresor, por nuk i është kërkuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve brenda afateve të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

Eshtë parim i mirënjohur se rregullat e administrimit të zgjedhjeve nuk mund të ndryshohen gjatë procesit zgjedhor. Ky parim është zbatuar nga Gjykata Kushtetuese edhe në vendimin nr.115, datë 28.08.2001, ku trajtohet çështja e paraqitjes së listave dhe renditjes së kandidatëve në to. Duke iu referuar neneve 81 e vijues të Kodit Zgjedhor, në vendim arsyetohet se: "Sipas këtyre dispozitave, renditja e kandidatëve në listë caktohet nga subjekti zgjedhor që e paraqet atë dhe se emrat e listës shumëemërore nuk mund të ndryshohen". Gjithashtu, në këtë vendim arsyetohet se marrëveshja e partive ka efekt për hartimin e listës shumëemërore para se të vërtetohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Pas kësaj, asnjë marrëveshje e partive nuk mund të ketë efekt mbi listën.

Këto arsyetime ligjore të bëra nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, me të drejtë janë marrë në konsideratë dhe janë zbatuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vendimin e tij nr.44, datë 23.05.2002 që përbën edhe objektin e këtij gjykimi. Në këtë vendim përmendet se në mbështetje të urdhërimeve të Gjykatës Kushtetuese të bëra me vendimin e saj nr.114, datë 27.08.2001, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të respektojë renditjen e listës shumëemërore të depozituar nga partitë ose koalicioni i partive. Në këto rrethana, duke zbatuar kriteret ligjore për renditjen e kandidatëve në listën shumëemërore Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur që vendi vakant i deputetit të plotësohet nga kandidati Kristo Goçi që renditej i katërti në listë dhe jo nga kërkuesi Arben Broja, i cili mban numurin rendor 25.

Këtë vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Gjykata Kushtetuese e gjen të bazuar në dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe në praktikën e saj. Duke konfirmuar qëndrimin e mbajtur në vendimet e saj të mëparshme, kjo Gjykatë thekson se përveç argumenteve të mësipërme, për çështjen në shqyrtim u vërtetua se personi

i interesuar Kristo Goçi në datat 03.07.2001 dhe 03.08.2001, ka deklaruar para noterit se nuk ka hequr dorë nga kandidimi. Ky deklarim i tij, i bërë para marrjes së vendimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për plotësimin e vendit vakant nga kandidati i radhës në listë, e bën të pavlefshme çdo dorëheqje të mëparshme edhe sikur të ketë të tillë.

Përsa i përket pretendimit të kërkuesit për dorëheqje të kandidatëve që janë më përpara në listë, Gjykata Kushtetuese, çmon se nga dokumentacioni i administruar nuk vërtetohet një dorëheqje e tillë në kuptim të nenit 81/2 të Kodit Zgjedhor, por në fakt është një veprim për ndryshimin e renditjes së kandidatëve në listë, duke u dhënë përparësi kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në zgjedhjet e drejtpërdrejta. Megjithëse nga përmbajtja e deklaratave (të cilat janë në një format tip) del se tërhiqet kërkesa për të kandiduar për deputet në listën shumëemërore të PBDNJ-së, në fakt nuk ka ndodhur kështu, por është hartuar një listë tjetër në të cilën marrin pjesë edhe 23 kandidatët që kanë deklaruar dorëheqjen. Kjo listë i është dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr.508, datë 01.08.2001 dhe është mbajtur parasysht e vlerësuar nga ky i fundit në vendimin e tij nr.233, datë 21.08.2001, duke shpallur deputet të listës kërkuesin Arben Broja.

Prandaj, edhe në këtë aspekt, deklarata e paraqitur nga kërkuesi në emër të Kristo Goxhit për të vërtetuar heqjen dorë të këtij të fundit nga kandidimi, nuk ka asnjë vlerë sepse ajo nuk përbën dorëheqje në kuptim të nenit 81/2 të Kodit Zgjedhor dhe nuk i jep mundësinë kandidatit pasues në listë për të fituar mandatin e deputetit.

Duke marrë në konsideratë argumentet si më sipër, Gjykata Kushtetuese, arrin në përfundimin se vendimi nr.44, datë 23.05.2002 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i drejtë dhe i bazuar, prandaj kërkesa për shfuqizimin e tij duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës, neneve 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, neneve 113 e 141 të Kodit Zgjedhor, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës;
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 169, datë 26.07.2002

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Petrit Plloçi, Kujtim Puto, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, në datën 23.07.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.171 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **GAFUR MUKA,**
kandidat për deputet i subjektit elektoral
PD+BF, përfaqësuar nga avokat Ilirjan
Rusmajli, me deklaram.
PARTIA KONSERVATORE E SHQIPËRISË,
përfaqësuar nga kryetari Armando Ruço
e Denis Selimi, me autorizim.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **ARDIT KAJA,**
kandidat për deputet i PS-së, përfaqësuar
nga avokat Baftjar Rusi, me prokurë.
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar nga sekretari Sokol Shazi e
juristja Dëshira Mataj, me autorizim.
PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE,
përfaqësuar nga avokat Shpëtim Baçi,
me prokurë.
PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE,
në mungesë.
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.19,
përfaqësuar nga kryetari Selim Daci.

O B J E K T I: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.93, datë 10.07.2002 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE: Nenet 141/1 e 113/1 të Kodit Zgjedhor.

Për shfuqizimin e këtij vendimi kërkuesit kanë parashtruar:
Kërkuesi Gafur Muka:

- Në qendrat e votimit nr.19, 21, 22, 27 e 41 të Zonës Zgjedhore nr.19, anëtarë të veçantë të familjeve kanë votuar në emër të gjithë familjes. Kjo procedurë votimi është në kundërshtim të hapur me parimin “një zgjedhës një votë”;

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve iu shmang hetimit të rrethanave e fakteve që shoqëronin kërkesën për deklarimin e pavlefshëm të votimit.

Kërkuesi Partia Konservatore:

- Nuk korrespondojnë procesverbalet e komisioneve të qendrave të votimit me votat në kutitë e votimit dhe janë falsifikuar firmat e votuesve në listat e zgjedhësve;

- Janë lejuar individë të paautorizuar të qëndrojnë pranë kutive të votimit dhe të diktojnë në favor të kandidatit të Partisë Socialiste;

- Janë futur në kutitë e votimit fletë-votimi për persona të cilët nuk kanë marrë pjesë në votime.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Kujtim Puto, kërkuesit e përfaqësuesit e tyre, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në zgjedhjet e pjeshme të datës 07.07.2002, Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.19, ka shpallur fitues kandidatin e Partisë Socialiste, Ardit Kaja, me 6579 vota pro (50.57 % të votave të vlefshme) kundrejt 5761 të votave të hedhura në favor të kërkuesit Gafur Muka, kandidat i subjektit elektoral PD+BF.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.54, datë 10.07.2002, ka rrëzuar si të pambështetur në ligj, kërkesën ankimore

të kërkuesit Gafur Muka.

Si kërkuesi Gafur Muka ashtu edhe Partia Konservatore e Shqipërisë, i reduktuan kërkesat gjatë gjykimit në pavlefshmërinë e zgjedhjeve në të njëjtat qendra votimi.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese, doli se komisionet e qendrave të votimit nr.19, 21, 22, 27 e 41 të zonës nr.19 të zgjedhjeve, kanë lejuar shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit, shkelje që konsiston në votimin e një personi në emër të familjarëve. Kjo i bën zgjedhjet të pavlefshme, në kuptim të nenit 113/1 të Kodit Zgjedhor.

Megjithëse komisionerët e qendrave të votimit dhe të Zonës Zgjedhore nuk kanë pasqyruar në tabelat e rezultateve vërejtjet për këtë shkelje ligji, kërkuesi Gafur Muka, paraqiti në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe në Gjykatën Kushtetuese vendimin nr.10, datë 08.07.2002, të Komisionit të Zonës Zgjedhore, duke kërkuar shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në ato qendra. Ekzistenca e këtij vendimi nuk është kontestuar nga palët dhe për më tepër, pakica prej tre anëtarësh ka pasqyruar në të mendimin e vet.

Kërkuesi paraqiti gjithashtu një procesverbal të Komisionit të Qendrës së Votimit nr.19 Boçevë, të mbajtur ditën e votimit, në të cilin 6 nga 7 anëtarët e Komisionit kanë pranuar të “votohet edhe për anëtarë të familjes, përjashtuar emigrantët”.

Gjykata Kushtetuese administroi si prova listat e zgjedhësve të përdorura gjatë votimit, të cilat kanë vlerë vendimtare provuese për çështjen. Kjo Gjykatë konstatoi se në një shumicë rastesh dhe në mënyrë të dukshme kishte nënshkrime të njëjta për votues të një familje, gjë që bën bindës pretendimin e kërkuesit se ka votuar një person edhe për anëtarët e tjerë të familjes. Votimi i një personi për të tjerët çënon parimin e votës vetiake, parashikuar në nenin 45/4 të Kushtetutës. Si Kushtetuta edhe nenet 6 e 98/1 të Kodit Zgjedhor, mbajnë qëndrim rigoroz kundër çdo shkelje të këtij parimi dhe përcaktojnë rregulla të detajuara për të shmangur çënimin e kësaj të drejte politike. Çdo shmangie prej tyre të çon në pasoja për gjithë procesin zgjedhor.

Nga gjykimi i çështjes rezultoi se komisionet e lartpërmendura të qendrave të votimit, në kundërshtim me ligjin, kanë lejuar me marrëveshje të komisionerëve, që zgjedhësit të votojnë në emër të familjarëve të tyre. Jo vetëm kaq, por Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka bërë verifikime e nuk ka mbajtur qëndrim ndaj kësaj shkelje të rëndë të ligjit, aq në tepër që ishin mundësitë sepse

listat e zgjedhësve ndodheshin jashtë kutive të votimit, siç e pohon vetë ky komision në shkresën nr.666/2, datë 25.07.2002 që i ka dërguar Gjykatës Kushtetuese.

Duke marrë parasysh rezultatet e zgjedhjeve në atë zonë dhe sidomos numrin e votave që kanë marrë kandidatët për deputetë të subjekteve elektorale PS e PD+BF, del se shkeljet e mësipërme kanë lidhje të drejtpërdrejtë me rezultatin përfundimtar në zonë dhe kanë ndikuar në fitimin e mandatit ose në moskalimin në raundin e dytë të zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 113/5 të Kodit Zgjedhor si dhe nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit nr.93, datë 10.07.2002 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjeshme të datës 07.07.2002, për deputet të drejtpërdrejtë në zonën zgjedhore nr.19”, duke shpallur të pavlefshme zgjedhjet në qendrat e votimit nr.19 Boçevë, nr.21 Okshatinë, nr.22 Kovashicë, nr.27 Gjuras e nr.41 Okshtun i Vogël;

- Urdhërohet zhvillimi i raundit të parë të zgjedhjeve për deputet të drejtpërdrejtë në qendrat e mësipërme të votimit;

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Vendim nr. 3, datë 13.02.2003

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Xhezair Zaganjori, Petrit Pilloçi, Sokol Sadushi, Gjergj Sauli, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica në datë 13.02.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.13 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: **FAHRI BALLIU,**
kandidat për deputet i Partisë
Demokratike+Bashkimi për Fitore,
përfaqësuar nga avokat Adnor Shameti,
me prokurë.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar nga Dëshira Mataj dhe
Kleonard Pipa, juristë.
VALENTINA LESKAJ,
përfaqësuar nga avokat Arben Hakani,
me prokurë.

O B J E K T I: **Shfuqizimi i Vendimit nr.1, datë 03.01.2003**
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kërkuesi për shfuqizimin e vendimit të mësipërm ka
parashtruar këto shkaqe:

- Kandidatja për deputete, Valentina Leskaj dhe stafi i saj
kanë kryer veprime për blerjen e votës në mënyrë masive nëpërmjet
shpërndarjes së ndihmave në zonën zgjedhore nr.52, duke cënuar
kështu parimin e votës së lirë;

- Gjykata e faktit nuk ka shqyrtuar kërkesat për shtesat në
listat e zgjedhësve dhe për këtë shkak, mbetën pa votuar me qindra
zgjedhës;

- Bashkia e qytetit Elbasan, nuk ka marrë masa për pajisjen
e zgjedhësve me çertifikatat e zyrës së gjendjes civile, gjë që ka
penguar pjesëmarrjen e tyre në votim.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin Gjergj Sauli, përfaqësuesit e kërkuesit, të
subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kandidatja për deputete e Partisë Socialiste, Valentina
Leskaj është shpallur deputete me vendimin nr.2, datë 29.12.2002,
të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.52, Elbasan.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.1 datë 03.01.2003, ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në këtë zonë, ku sipas të cilit, Valentina Leskaj ka marrë 5179 vota, duke qenë kështu fituese, kurse Fahri Balliu 4607 vota.

Në kërkesën e paraqitur për shfuqizimin e Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkuesi ka pretenduar se gjatë raundit të dytë të zgjedhjeve të datës 29.12.2002, janë kryer shkelje të ligjit, që kanë cënuar parimin e votës së lirë, të parashikuar nga neni 3 i Kodit Zgjedhor. Sipas tij, këto shkelje bëjnë të pavlefshme zgjedhjet në kuptim të nenit 113 shkronja “a” të këtij Kodi.

Gjykata Kushtetuese, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e paraqitura gjatë gjykimit të çështjes arriti në përfundimin se kërkuesi nuk mundi të provojë pretendimet e parashtruara në kërkesë.

Sipas kërkuesit, kandidatja për deputete Valentina Leskaj dhe stafi i saj, kanë kryer veprën penale të blerjes së votës në mënyrë masive në zonën zgjedhore nr.52, Elbasan me anën e shpërndarjes së ndihmave ushqimore.

Në kohën e paraqitjes së kërkesës pranë kësaj Gjykate, nga Prokuroria, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Elbasan, kishte filluar procedimi penal, për veprën penale të parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal. Duke qenë se çështja e ardhur në gjykim kishte lidhje me çështjen penale e nuk mund të përfundonte para saj dhe nisur nga kërkesa e nenit 48 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” që detyron shqyrtimin e çështjes brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të, Gjykata Kushtetuese pezulloi gjykimin deri në përfundimin e hetimit.

Prokuroria, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, pushoi hetimin e çështjes penale me vendimin e datës 24.01.2003, dhe Gjykata Kushtetuese rifilloi gjykimin e çështjes të pezulluar prej saj. Sipas vendimit të pushimit të ndjekjes penale, konstatohet fakti se “Programi Botëror i Ushqimit”, dërgoi në Elbasan ndihma ushqimore për familjet e varfëra ekonomikisht dhe se 160 familje të zonës zgjedhore nr.52 i kanë marrë ato një ditë para zgjedhjeve. Këtë fakt, prokuroria e ka quajtur të pamjaftueshëm për të nxjerrë përgjegjësi penale. Gjithashtu ajo arsyeton se gjatë hetimit të zhvilluar si nga pyetja e qytetarëve që kishin përfituar ndihma ushqimore ashtu dhe nga administrimi i provave të tjera, vepra penale e parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal, nuk u provua jo vetëm për stafin e kandidatës për deputete, por as për persona të tjerë.

Veç sa sipër, në bazë të vendimit të prokurorisë, pretendimet e kërkuesit nuk u provuan as edhe me videokasetën e paraqitur prej tij si provë, pasi ajo përmbante pamje filmike të ndarjes së ndihmave dhe jo pamje ku të tregohej prania e Kastriot Shehut, vëllait të kandidates për deputete apo drejtues të stafit të saj elektorale.

Në rrethanat kur prokuroria nuk gjeti elementet e fajësisë së kandidates për deputete apo të stafit të saj dhe kur nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezultojnë vërejtje nga anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit ishte detyrë e kërkuesit të provonte se dhënia e ndihmave ushqimore 160 familjeve të zonës, ka ndikuar në cënimin e parimit të votës së lirë dhe se ky cënim ka qenë i një shkalle të tillë që ka ndikuar në dhënien e mandatit.

Gjykata Kushtetuese në shqyrtimin e këtyre çështjeve zbaton rregullat e përgjithshme procedurale sipas të cilave barra e provës i përket kërkuesit, që në rastin konkret, nuk paraqiti provat e nevojshme në këtë drejtim.

Edhe pretendimet e tjera të kërkuesit që lidhen me mohimin e të drejtës së votës të zgjedhësve për shkak të refuzimit të bërë nga gjykata për shtesat në listat e zgjedhësve ose për shkak të mosmarrjes së masave për pajisjen e zgjedhësve me çertifikata të gjendjes civile nuk qëndrojnë. Ankimet për listat e zgjedhësve janë paraqitur jashtë afatit dhe me listë nga subjekti zgjedhor, në kushtet kur sipas nenit 56 të Kodit Zgjedhor, këto ankime ka të drejtë t'i paraqesë në gjykatën e faktit çdo zgjedhës që nuk është regjistruar në listat e zgjedhësve, sipas procedurës të caktuar dhe afatit ligjor. Veç sa sipër, këto pretendime nuk u shoqëruan me asnjë provë për të krijuar bindjen e gjykatës për vërtetësinë e parregullsive të tilla.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese, arrin në përfundimin se kërkesa nuk gjen mbështetje në prova dhe në ligj, prandaj duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “e” dhe 132 të Kushtetutës, në nenet 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” si dhe në nenin 113 të Kodit Zgjedhor, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Vendimi nr.1, datë 03.01.2003 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhej të shfuqizohej jo vetëm si i marrë në kundërshtim me ligjin e faktet, por mbi të gjitha si antikushtetues.

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte detyrën kushtetuese (neni 153) e ligjore (neni 18 i Kodit Zgjedhor) të verifikonte ankesën e kërkuesit lidhur me pretendimet e tij për shkelje të një karakteri shumë të rëndë të ndodhur në prag të votimeve në zonën zgjedhore nr.52. Nga provat e administruara, ka dalë plotësisht e provuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka bërë asnjë verifikim. Thirrja e biseda me anëtarët e Komisionit të Zonës Zgjedhore, nuk mund të zëvendësojnë veprimet konkrete, praktika që mund dhe duhej të krijonte ky organ para se ai, nëpërmjet rrëzimit të kërkesës, të konfirmonte mungesën e shkeljeve të ligjit.

Në kushtet kur ky komision e ka detyrim të shqyrtojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve të Komisionit të Zonës Zgjedhore, mungesa e verifikimit dhe prononcimi nëpërmjet vendimit të atakuar për mungesë të shkeljeve, e bën këtë vendim të cënueshëm përse i përket bazueshmërisë së tij.

2. Është vërtetuar plotësisht se në vigjilje të zgjedhjeve, në datën 28.12.2002, në zonën zgjedhore nr.52, janë kryer veprime haptazi të kundërligjshme, të cilat kanë kompromentuar votën e lirë e kanë cënuar integritetin e lirisë në zgjedhje.

Nga vendimi i pushimit të çështjes nga prokuroria e rrethit Elbasan si dhe nga dokumentet e paraqitura nga kërkuesi është vërtetuar plotësisht se:

a) Ndhimat kanë ardhur për t'u shpërndarë kundrejt punës në gjelbërim, por janë shpërndarë pa u kryer kjo punë e duke falsifikuar listat, fakt për të cilin prokuroria ka filluar çështje penale;

b) ndihmat janë shpërndarë nga strukturat në varësi direkte të kandidatës tjetër për deputete;

c) mbi 90 % e familjeve që kanë përfitur nga shpërndarja e ndihmave banojnë në zonën zgjedhore nr.52;

d) furnizimet, kryesisht, janë bërë ditën e heshtjes zgjedhore, në datën 28.12.2002.

Këto forma nuk kundërshtohen as nga pala e interesuar megjithëse pretendohet se ushqimet janë shpërndarë në kuadrin e programit të ndihmave.

Duke u bërë shpërndarja e ndihmave në pjesën më të madhe në zonën nr.52 dhe brenda 24 orëve të fundit para votimit, mund të thuhet se vota e zgjedhësve që kanë përfiturar prej tyre nuk ka qenë e lirë. Në bazë të ligjit edhe propaganda që bëhet gjatë fushatës së zgjedhjeve, lejohet deri në 24 orë para votimit. Shpërndarja e ndihmave jo vetëm që ishte kryer brenda afatit prej 24 orësh para votimit, kur nuk lejohej propaganda, por për më tepër, kjo veprimtari ishte e kundërligjshme sepse ka patur për qëllim blerjen e votës.

Si e tillë, ajo edhe po të kryhej në një kohë të mëparshme, përsëri do të konsiderohej shkelje, sepse i kalon caqet e propagandës zgjedhore dhe përbën në vetvete vepër penale. Neni 328 i Kodit Penal ka si qëllim parandalimin e këtyre veprave sepse ato çënojnë direkt votën e lirë. Në këtë aspekt, është paradoksale të pranohet vetëm shkelja si e rëndë nga njëra anë (sepse në fakt ajo ishte e tillë përderisa përbën vepër penale) dhe, nga ana tjetër, të deklarohet se një shkelje e tillë nuk ka ndikuar në rezultatin zgjedhor.

Është e qartë se kryerja e një veprimi të tillë ka dëmtuar rëndë procesin zgjedhor. Nga ana tjetër, në rastin konkret, kur diferenca mes dy kandidatëve ishte rreth 500 vota dhe në atë zonë, të paktën 250 familje kanë përfiturar ndihma, del se ndikimi i votës së tyre në rezultatin e zgjedhjeve ka qenë i dukshëm.

Veprimet e kryera për shpërndarjen e ndihmave dhe që kanë patur për qëllim blerjen e votës, kanë prekur esencën e konceptit kushtetues të votës së lirë, kanë dëmtuar procesin e votimit si një formë e shprehjes së vullnetit të lirë e të pakushtëzuar të zgjedhësve. Ato bien ndesh me parimet e shtetit ligjor dhe të zgjedhjeve të lira që qëndrojnë në themel të tij. Lejimi dhe pranimi i tyre kanë degjeneruar zgjedhjet në zonë dhe kanë krijuar imazhin negativ për organet që i administrojnë ato.

Normat kushtetuese e ligjore të standarteve bashkëkohore përbëjnë bazën për realizimin e zgjedhjeve të lira e demokratike. Por, që të garantohen plotësisht këto zgjedhje të lira, duhet që normat kushtetuese e ligjore të zbatohen pa asnjë lëshim, përndryshe vlera dhe qëllimi i tyre do të kompromentohej.

Në nenin 21 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, është përcaktuar se: “Vullneti i popullit, është themeli i autoritetit të pushtetit publik; ky vullnet duhet të shprehet përmes zgjedhjeve të lira, që duhet të zhvillohen periodikisht me votim të përgjithshëm, të barabartë, të fshehtë ose sipas një procedure të barazvlefshme që të sigurojë lirinë e votës”.

Duke iu referuar kësaj dispozite, por edhe atyre kushtetuese e ligjore që u përmendën më lart, shtrohet pyetja se si mund të quhet votë e lirë ajo që është dhënë nën ndikimin dhe për shkak të përfitimit material në vigjilje të kryerjes së votimit?

Përderisa shkeljet kushtetuese e ligjore janë të tilla që kanë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve siç parashikohet edhe në nenin 113 të Kodit Zgjedhor, përsëritja e tyre është e vetmja rrugë për të garantuar zgjedhje të lira e demokratike.

Anëtarë: Kristofor Peçi, Alfred Karamuço.

MENDIMI I PAKICËS

Në çështjen me kërkues zotin Fahri Balliu, ne kemi mendim të ndryshëm nga ai i shumicës, vetëm për pretendimin e tij lidhur me cënimin e lirisë së zgjedhjeve për këto arsye:

Zgjedhjet parlamentare janë një moment tepër i rëndësishëm dhe delikat për demokracinë si formë e qeverisjes. Vetëm përmes tyre bëhet e mundur legjitimimi në formë zinxhiri i pushtetit shtetëror, pasi ato transformojnë drejtpërsëdrejti vullnetin politik të popullit në organin qendror kushtetues. Pra, vullneti politik i populli si bartës i sovranitetit shtetëror, shqetësimet dhe kërkesat e tij në shoqërinë demokratike, bëhen të realizueshme kryesisht përmes përfaqësimit në Parlament. Pikërisht, për këtë arsye është mëse e domosdoshme që ky përfaqësim të jetë rezultat i një procesi të lirë që mbështetet në kërkesat kushtetuese dhe në barazinë e të gjithë shtetasve pa përjashtim.

Sigurisht që gjatë fushatës elektorale subjektet zgjedhore kanë të drejtë që me mjete e mënyra të ligjshme, me programin dhe alternativat që ofrojnë, të përpiqen të ndikojnë sa më shumë tek zgjedhësit për të siguruar votën e tyre. Por, ky proces duhet të jetë i lirë dhe i hapur, pa presione dhe pa u imponuar nga faktorë të jashtëm që nuk lidhen direkt me zgjedhjet, sepse në përfundim të këtij procesi, çdo zgjedhës krijon vullnetin e tij politik dhe merr

vendimin përkatës për të votuar. Për më tepër, në funksion të garantimit të kësaj lirie në marrjen e vendimit për votim, në përputhje me vullnetin politik parashikohet që 24 orë para votimit të ndërpritet çdo lloj propagande apo fushate elektorale në favor të kandidatëve apo partive politike. Nga ana tjetër, organet shtetërore kanë për detyrë të qëndrojnë sa më neutrale në ballafaqimin politik gjatë fushatës së subjekteve zgjedhore si dhe të marrin masat e duhura që garantojnë realisht lirinë e zgjedhjeve.

Këto kërkesa të rëndësishme evidentohen qartë në një sërë aktesh ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe për rrjedhojë edhe në kushtetutat dhe legjislacionet zgjedhorë bashkëkohorë të vendeve demokratike ose që janë në rrugën e demokracisë mes të cilëve, edhe në Kushtetutën dhe në legjislacionin zgjedhor të vendit tonë. Konkretisht, ndër të tjera mund të përmendim nenet 1/3 i Kushtetutës (Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira...); 2/1 e 2 të Kushtetutës (Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit. Populli e ushtron sovranitetin përmes përfaqësuesve të tij...); neni 18 i Kushtetutës (Barazia e të gjithë shtetasve para ligjit); neni 3 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (E drejta për zgjedhje të lira); Akti Final i Helsinkit (Parimi VII – Respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore); Karta e Parisit për një Evropë të Re (Preambula – Qeverisja demokratike mbështetet në vullnetin e popullit, të shprehur ... me anë të zgjedhjeve të lira e të ndershme”); neni 45/4 i Kushtetutës (Vota është vetiake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë); neni 3 paragrafi 1 i Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë (Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë...); nenet 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë (Fushata zgjedhore dhe të drejtat e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës); neni 328 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (Dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve ... për të votuar “pro” ose “kundër”...), etj..

Duke patur parasysh edhe sa më sipër, për çështjen në shqyrtim kemi mendimin se me veprimet e kryera nga stafi elektoral ose njerëz në varësi të ish-kandidates Valentina Leskaj, në datën 28.12.2002, pra një ditë para zhvillimit të raundit të dytë të zgjedhjeve të pjesëshme për deputetë në Kuvend për Zonën Zgjedhore nr.52, është cënuar ndjeshëm parimi i rëndësishëm i lirisë së zgjedhjeve, dhe në mënyrë të veçantë nenet 1/3 e 45/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 3 i Protokollit 1 të KEDNJ (Konventë që sipas nenit 122 të Kushtetutës përbën pjesë të sistemit të

brendshëm juridik të Republikës së Shqipërisë); neni 3/1 dhe neni 129/2 i Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, sepse:

1. Siç rezulton edhe nga vendimi për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr.740/2002, marrë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, në datë 24.01.2003, është fakt se ditën e shtunë më datën 28.12.2002, për 250 familje të qytetit të Elbasanit janë planifikuar dhe shpërndarë si ndihmë ekonomike sasira të konsiderueshme me miell, vaj dhe kripë. Nga verifikimi i listave, Prokuroria arrin në përfundimin se nga 250 familjet përfituese, rreth 90% e tyre janë familje që banojnë në zonën zgjedhore nr.52, Elbasan.

2. Ndihamat në fjalë janë dhënë në emër të “Programit Botëror të Ushqimit”, por janë planifikuar dhe administruar nga Zyra Rajonale e Shërbimit Social Elbasan, e cila është në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, aty ku është ministre vetë ish-kandidatja për deputete e zonës nr.52, Valentina Leskaj.

3. Ndihamat duhej t'i përfitonte si shpërblim një kategori e caktuar njerëzish, konkretisht familjet e atyre personave që kishin realizuar 15 ditë pune vullnetare në “Gjelbërimi” ShPK, Elbasan. Nga vendimi i Prokurorisë rezulton se asnjë nga përfituesit nuk ka punuar për qëllimin e mësipërm. Për këtë arsye, personat përgjegjës po hetohen për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve.

4. Veprimet e mësipërme nuk janë të rastësishme. Ndihamat u shpërndanë ditën e shtunë datë 28.12.2000, një ditë para zhvillimit të raundit të dytë të zgjedhjeve në zonën nr.52, aq më tepër që në këtë ditë, ligjërisht, ndalohet çdo lloj fushate apo propagande elektorale për subjektet zgjedhore që janë në konkurim. Ndihamat janë planifikuar dhe shpërndarë nga një mekanizëm në varësi të drejtpërdrejtë të ish-kandidates socialiste Valentina Leskaj, Ministre e Punës dhe Çështjeve Sociale. Nga kjo ndihmë përfitojnë jashtë kritereve të përcaktuara për këtë lloj ndihme pikërisht një numër i konsiderueshëm familjesh të zonës zgjedhore nr.52.

Sa më sipër, planifikimi dhe shpërndarja e ndihmave është bërë qëllimisht për të ndikuar në vullnetin politik të një numri të konsiderueshëm të zgjedhësve të Zonës Zgjedhore nr.52. Mjetet dhe mënyra e përdorur çënojnë dukshëm parimin e rëndësishëm të lirisë së zgjedhjeve aq më tepër që këto veprime bëhen një ditë para zhvillimit të tyre. Këto veprime janë kryer me synimin për të ndikuar tek zgjedhësit dhe duke patur parasysh numrin e përfituesve dhe diferencën ndërmjet kandidatëve, mendojmë se ky veprim ka

ndikuar potencialisht në rezultatin përfundimtar për shpalljen e kandidatit fitues.

Në këto rrethana, në bazë të nenit 141/1 të Kodit Zgjedhor, duhej të ishte pranuar kërkesa për anullimin e vendimit nr.1, datë 03.01.2003 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe shpallja si e pavlefshme e raundit të dytë të zgjedhjeve të pjesëshme për deputet të zhvilluara në datë 29.12.2002, në Zonën Zgjedhore nr.52.

Anëtarë: Xhezair Zaganjori, Petrit Pllloçi.

ARSYETIM PARALEL

Bashkohem me shumicën vetëm për zgjidhjen e dhënë në dispozitivin e vendimit, por mendimi im ndryshon nga arsyetimi i vendimit të saj. Thelbi i mendimit ndryshe qëndron në konceptet jo të njëjta që ne kemi për përfshirjen e kësaj çështjeje në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

Kërkuesi, nëpërmjet çështjes së ngritur përpara kësaj gjykate, kërkon pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.52, gjë e cila ka lidhje të drejtpërdrejtë me shpalljen të pavlefshëm të mandatit të fituar të deputetit.

Çështja, në fazën në të cilën ndodhet, paraqet një specifike, për arsye se deputetja e shpallur me vendim të Komisionit të Zgjedhjeve të Zonës, ka bërë betimin në Kuvend, ndërkohë që Gjykata Kushtetuese shqyrtonte kërkesën e paraqitur nga kandidati i subjektit zgjedhor “Bashkimi për Fitore”.

Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet kërkesës së paraqitur, i kërkohet pavlefshmëria e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ka shpallur rezultatin përfundimtar për një deputete të Kuvendit, e cila e ka filluar ushtrimin e mandatit. Kërkesa e paraqitur, pretendimin kryesor për pavlefshmërinë e zgjedhjeve e ka mbështetur në shkeljen e lirisë së votës dhe në asnjë nga pikat e nenit 71 të Kushtetutës. Në këto kushte, çështja shtrohet nëse Gjykata Kushtetuese ka të drejtë të heqë apo të shpallë të pavlefshëm mandatin e deputetit tej kufijve të nenit 71 të Kushtetutës.

Në këto kushte, referimi tek kjo dispozitë e Kushtetutës që parashikon rastet se kur mandati i deputetit mbaron apo shpallet i pavlefshëm, merr rëndësi për zgjidhjen e çështjes. Sipas nenit 71 të Kushtetutës, mandati i deputetit është i pavlefshëm vetëm në rastet kur vërtetohet një nga kushtet e pazgjedhshmërisë të parashikuar

në nenin 69 të Kushtetutës, ndërsa për rastet e tjera ai konsiderohet se mbaron përpara afatit.

Për mendimin tim, neni 113 i Kodit Zgjedhor që parashikon pavlefshmërinë e zgjedhjeve duhet parë i lidhur ngushtë me nenet 71 dhe 72 të Kushtetutës. Betimi është një moment i rëndësishëm kushtetues, me të cilin lidhet fillimi i ushtrimit të mandatit të deputetit. Moskryerja vullnetarisht e betimit përbën njëkohësisht edhe çastin e mbarimit të mandatit të deputetit.

Duke iu referuar rastit në shqyrtim rezulton se pas shpalljes së vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kuvendi i Shqipërisë, pavarësisht se çështja ishte paraqitur për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, organizoi ceremoninë e kryerjes së betimit të deputetes, duke përfituar nga ometimi ligjor apo kushtetues në këtë drejtim. Pikërisht në kushtet kur deputetja ka kryer betimin dhe ka filluar ushtrimin e mandatit mendoj se çështja del jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë nuk mund të shpallet i pavlefshëm, ndërkohë që neni 71 i Kushtetutës nuk e parashikon rastin e pavlefshmërisë së mandatit si rrjedhojë e shpalljes së pavlefshmërisë së zgjedhjeve.

Ndryshe janë paraqitur rastet për shqyrtim në këtë gjykatë gjatë periudhës zgjedhore, sepse Kuvendi ende nuk ishte konstituuar dhe nuk kishte filluar ushtrimin e veprimtarisë së tij. Megjithatë, pavarësisht nga ky fakt, i qëndroj mendimit se jurisprudenca kushtetuese nuk mund të bëhet pengesë për evoluim në pikëpamjet e gjyqtarëve të saj. Do ta konsideroja më të drejtë përsosjen dhe avancimin e pikëpamjeve, duke e harmonizuar me konceptet që njeh Kushtetuta në këtë drejtim, se sa të zbatohet mekanikisht qëndrimet e mbajtura deri vonë në praktikën kushtetuese, e cila është konsideruar në polemikat doktrinare si tejkalim i kompetencave të saj.

Çështja duket sikur përbën një problem kushtetutshmërie përsa i përket të drejtës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që në bazë të nenit 113 të Kodit Zgjedhor të shpall të pavlefshme zgjedhjet, por kjo nuk është aktualisht objekt shqyrtimi. Në fakt pavlefshmëria e zgjedhjeve që shpall Komisioni Qendror i Zgjedhjeve heq apo bën të pavlefshëm mandatin e deputetit që e ka dhënë KZZ-ja. Pra, Kodi Zgjedhor e parashikon heqjen e mandatit të një deputeti për efekt të pavlefshmërisë së zgjedhjeve. Me këtë konstatim nuk dua të vë në diskutim kushtetutshmërinë e nenit 113 të Kodit Zgjedhor, sepse kjo dispozitë është ende në fuqi dhe prezumohet kushtetutshmëria e saj,

por jam i mendimit se Gjykata Kushtetuese në zgjidhjen e çështjes duhet t'i referohet dhe të orientohet nga konceptet kushtetuese të pavlefshmërisë apo të heqjes së mandatit të deputetit, të cilat janë tepër të kufizuara.

Verifikimi i zgjedhjes së deputetit që parashikohet në nenin 131, shkronja "e" e Kushtetutës është një kompetencë e kësaj gjykate, por ajo duhet parë e lidhur ngushtë me konceptin e pavlefshmërisë dhe të heqjes së mandatit të deputetit. Ajo që parashikohet në Kushtetut lidhet me pamundësinë e Gjykatës Kushtetuese, që tej rasteve të nenit 71 të shpall pavlefshmërinë e mandatit të një deputeti të zgjedhur. Mandati i deputetit të zgjedhur nuk mund të preket në tejkalim të neneve apo dhe të koncepteve të Kushtetutës. Prandaj për këto arsye, çështja objekt shqyrtimi mbetet jashtë juridiksionit kushtetues dhe për rrjedhojë kërkesa, me këtë arsyetim, konsiderohet e rrëzuar.

Anëtar: Sokol Sadushi.

* * *

Vendim nr. 1, datë 30.01.2004

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fehmi Abdiu, Kryetar, Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kujtim Puto, Xhezair Zaganjori, Petrit Plloçi, Sokol Sadushi, Kristofor Peçi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, në datën 3.12.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.42 Akti që i përket:

KËRKUES: NJË GRUP PREJ 1/5 E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
përfaqësuar nga deputeti Lekë Çukaj.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
në mungesë.
KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

**përfaqësuar nga zoti Sokol Shazi,
me autorizim.**

OBJEKTI: -Shfuqizimi si i papajtueshëm me
Kushtetutën i pikës 3 të nenit 14 të ligjit
nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i
Republikës së Shqipërisë”.
- Interpretimi i nenit 64/1 të Kushtetutës së
Republikës të Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 124 e 131/c të Kushtetutës, si dhe neni
49 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin
e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesi ka paraqitur dy kërkesa në të cilat parashtron këto
shkaqe:

- Neni 64/1 i Kushtetutës përcakton përpjesëtimin e përbërjes
së Kuvendit në varësi të mënyrës së përfaqësimit të sovranitetit
të popullit sipas mënyrës së zgjedhjes: 100 deputetë drejtpërdrejt
nga zonat njëemërore dhe 40 nga listat shumëemërore në bazë të
rezultatit proporcional.

- Duke u zbatuar pika 3 e nenit 14 të Kodit Zgjedhor në një rast
praktik, ndryshoi përbërja e Kuvendit për mënyrën e përfaqësimit,
me 99 deputetë të zgjedhur nga zonat njëemërore dhe 41 nga
listat proporcionale, gjë që vjen në kundërshtim me nenin 64/1 të
Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e
kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesi, në seancë gjyqësore, duke konfirmuar shkaqet e
kërkesës, e kufizoi objektin e saj vetëm për fjalinë e parë të pikës 3 të
nenit 14 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës
së Shqipërisë”, që ka këtë përmbajtje: “Kur mandati i një deputeti
të zgjedhur në një zonë zgjedhore njëemërore mbaron në mënyrë
të parakohshme, vendi i tij plotësohet nga kandidati i radhës i listës

shumemërore të subjektit zgjedhor përkatës”.

Gjykata Kushtetuese, para fillimit të seancës gjyqësore, për shkak të lidhjes së drejtpërdrejtë të dy kërkesave të paraqitura nga grupi i deputetëve bëri, me një vendim të veçantë, bashkimin e tyre në një çështje të vetme. Në këtë mënyrë, kërkesa për interpretim abstrakt të nenit 64/1 të Kushtetutës merr zgjidhje nëpërmjet shqyrtimit e kontrollit të kushtetutshmërisë së pikës 3 të nenit 14 të Kodit Zgjedhor.

Nga përmbajtja e kërkesës dhe shqyrtimi i çështjes në seancë rezulton se Kuvendi i Shqipërisë, në zbatim të pikës 3 të nenit 14 të Kodit Zgjedhor, pas mbarimit në mënyrë të parakohshme të mandatit të një deputeti për shkak të dorëheqjes, ka filluar procedurat për zëvendësimin e tij. Me shkresën nr.1974, datë 19.9.2003, Kuvendi i Shqipërisë ka vënë në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kandidaturën zëvendësuese nga lista shumemërore e koalicionit “Bashkimi për fitore” dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka shpallur atë me vendimin nr.1846, datë 24.9.2003. Deputeti i shpallur ka bërë betimin në seancën plenare të datës 14.10.2003.

Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme që në shqyrtimin e kushtetutshmërisë së dispozitës ligjore të përcaktuar në objektin e kërkesës të analizojë disa aspekte që lidhen me sistemin zgjedhor, me mënyrën dhe procedurat e zgjedhjes së deputetëve dhe të zëvendësimit të tyre në rastet e mbarimit të parakohshëm të mandatit, si dhe rregullimin juridik të tyre në periudhën postkomuniste si para, ashtu edhe pas miratimit të Kushtetutës.

Sipas ligjit të zgjedhjeve të vitit 1992, Kuvendi përbëhej nga jo më pak se 140 deputetë, nga të cilët 100 zgjidhen drejtpërdrejt në zonat njëemërore, kurse mandatet shtesë kompensuese, sipas një formule të caktuar, u jepeshin kandidatëve në listat e subjekteve sipas proporcionit të votave të fituara në raundin e parë.

Ligji i zgjedhjeve i vitit 1997 ndryshoi atë të vitit 1992 në përcaktimin e numrit të deputetëve nga jo më pak se 140 në 115 deputetë, ndryshim që çoi në rritjen e numrit të deputetëve që zgjidhen nga listat njëemërore në 115. Ndryshoi edhe përqindja e minimumit të votave për proporcionalin nga 4 % në 2 %.

Ligjet e mëvonshme, të dala pas miratimit të Kushtetutës, në formën e kodeve zgjedhore që janë ai nr.8609, datë 8.5.2000 dhe nr.9087, datë 19.6.2003, i përmbahen sistemit zgjedhor të përcaktuar në nenin 64 të Kushtetutës, pra sistemit të përzier.

Duke e parë problemin e sistemit zgjedhor në mënyrë

kronologjike sipas ligjeve zgjedhore të dala për një periudhë mbi 10-vjeçare, rezulton se pavarësisht nuancave të veçanta, përgjithësisht është zbatuar sistemi i përzier, ku elementet maxhoritare janë më të dukshme, kurse elementet e sistemit proporcional kanë synuar të zbusin ndonjë shpërpjesëtim të shkaktuar nga sistemi maxhoritar.

Lidhur me zëvendësimin e një deputeti për shkak të mbarimit të parakohshëm të mandatit, zgjidhjet ligjore, në periudha të ndryshme, kanë veçoritë e tyre. Në nenin 81 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 parashikohet se në rast të mbarimit para afatit të mandatit të deputetit, Komisioni i Mandateve shpall të zgjedhur kandidatin e radhës në listën në shkallë vendi. Kur deputeti nuk përfaqëson një subjekt që ka lista në shkallë vendi, në zonën e tij kryhen zgjedhje brenda 3 muajve. Kur deputeti merr përsipër një detyrë tjetër që nuk pajtohet me mandatin e tij, zëvendësohet nga kandidati i radhës në listën përkatëse në shkallë vendi.

Kurse Kodi Zgjedhor i vitit 2000, në nenin 11, parashikonte plotësimin e vendit vakant të deputetit në dy mënyra, në varësi të zgjedhjes së tij. Kur deputeti ishte zgjedhur nga lista shumemërore, plotësimi bëhej nga kandidati i radhës në listë, ndërsa për deputetin e zgjedhur në zonën njëemërore, zëvendësimi bëhej nga një deputet i ri i zgjedhur nga zgjedhjet e së njëjtës zonë. Sipas pikës 4 të këtij neni, kur mandati i një deputeti të zgjedhur në një zonë njëemërore mbaron në mënyrë të parakohshme gjatë 6 muajve të fundit të mandatit të Kuvendit, plotësimi bëhet nga kandidati i radhës i listës shumemërore të subjektit zgjedhor përkatës.

Në nenin 14 të Kodit të ri Zgjedhor, i cili është edhe objekt i kërkesës, ka një rregullim të ndryshëm për sa i përket plotësimit të vendit të deputetit të zgjedhur në një zonë njëemërore. Në këtë rast, vendi i tij plotësohet nga kandidati i radhës i listës shumemërore të subjektit zgjedhor përkatës.

Krahasimi i përmbajtjes së këtyre dy dispozitave ligjore evidenton qartë një dallim thelbësor mes tyre. Në rastin e parë janë përcaktuar zgjidhje të ndryshme të plotësimit të vendit të deputetit në varësi të mënyrës së zgjedhjes, kurse në rastin e dytë, pavarësisht nga mënyra e zgjedhjes, zëvendësimi është i njëjtë: nga listat shumemërore.

Duke bërë të qartë këtë dallim, çështja shtrohet nëse përmbajtja e fjalisë së parë në pikën 3 të nenit 14 të ligjit nr.9087,

datë 19.6.2003 vjen në kundërshtim me nenin 64 të Kushtetutës, apo formulimi i ri është më i përshtatshëm dhe nuk cenon raportet kushtetuese të përfaqësimit brenda sistemit të përzier zgjedhor.

Sistemi i zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, i përcaktuar në nenin 64 të Kushtetutës, është një sistem i përzier me elemente të maxhoritarit që janë mbizotëruese dhe i plotësuar me elemente proporcionale. Kjo për faktin se nga numri i përgjithshëm prej 140 deputetë, 100 prej tyre zgjidhen drejtpërdrejt në zonat njëemërore dhe 40 nga listat shumëemërore të partive ose të koalicioneve të partive. Zgjedhja e mbi 2/3 të deputetëve në zonat njëemërore dhe marrja për bazë e këtyre rezultateve në ndarjen e mandateve plotësuese, përcaktimi i numrit maksimal të deputetëve pa lejuar rritjen e tij dhe mënyra e ndarjes së mandateve plotësuese, sipas paragrafit të dytë të nenit 64 të Kushtetutës, në një raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra në të gjithë vendin, përbëjnë elementet e një sistemi të përzier zgjedhor, në të cilin ndikimin më të madh e kanë elementet maxhoritare. Për të plotësuar kuadrin e këtij sistemi të përzier, në pikën 3 të nenit 64 të Kushtetutës, është parashikuar përjashtimi nga përfitimi prej listave shumëemërore i partive dhe i koalicioneve që marrin përkatësisht më pak se 2.5 % dhe 4 % të votave të vlefshme në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve.

Në përcaktimin e një sistemi zgjedhor duhet të merren në konsideratë shumë faktorë, siç janë ata historikë, politikë, etnikë, kulturorë, shoqërorë ose gjeografikë. Çdo sistem zgjedhor në një shoqëri demokratike synon të sigurojë stabilitet dhe qeverisje efektive e të qëndrueshme dhe njëkohësisht të sigurojë një përfaqësim sa më të gjerë të popullit dhe një shprehje sa më të plotë të vullnetit të tij. Në parim, çdo sistem zgjedhor konsiderohet në tërësinë e tij demokratik, në qoftë se nëpërmjet tij respektohen të gjitha rregullat e një konkurrimi të drejtë e të barabartë.

Në radhë të parë, sistemi zgjedhor dhe procedurat që lidhen me zbatimin e tij duhet të garantojnë e të vënë në zbatim përfaqësimin real të komunitetit dhe ushtrimin adekuat të sovranitetit të popullit.

Neni 2 i Kushtetutës, duke sanksionuar sovranitetin e popullit si një parim të rëndësishëm kushtetues, në pikën 2, përcakton edhe mënyrën e ushtrimit të tij nëpërmjet përfaqësuesve ose drejtpërsëdrejti. Përfaqësimi i popullit në Kuvend bëhet sipas nenit 64 të Kushtetutës me zgjedhjen e drejtpërdrejtë të deputetëve në

çdo zonë zgjedhore. Fitues është ai që ka marrë numrin më të madh të votave, të cilat shprehin dëshirën dhe vullnetin e popullit. Kandidatët e listës zgjidhen sipas renditjes që bën subjekti zgjedhor.

Në zbatim të nenit 64 të Kushtetutës, i gjithë vendi është ndarë në 100 zona zgjedhore me numër të përafërt zgjedhësish dhe çdo zonë ka përfaqësuesin e vet si deputet në Kuvend. Zëvendësimi, qoftë edhe i një deputeti të zgjedhur në zonën njëemërore me një tjetër të listës proporcionale, cenon raportin e përcaktuar nga Kushtetuta. Vlerësimi i elementeve që i përkasin aspektit proporcional në një sistem zgjedhor të përzier nuk duhet të prekë në mënyrë thelbësore elementin tjetër bazë të sistemit, prandaj është kusht “sine qua non” që në çdo dispozitë ligjore të bëhen rregullimet e nevojshme, pa prekur kriteret dhe raportet e vendosura nga Kushtetuta. Përmbajtja e fjalisë së parë të pikës 3 të nenit 14 të Kodit Zgjedhor prek pikërisht ato raporte të vendosura në Kushtetutë, prandaj është e papajtueshme me të.

Meqënëse me shfuqizimin e dispozitës objekt kërkesë krijohet boshllëk ligjor, lidhur me mënyrën e zëvendësimit të deputetit të zgjedhur në zonën njëemërore, i takon Kuvendit të Shqipërisë të bëjë plotësimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/a e 134/c të Kushtetutës, si dhe të neneve 49, 72 e 76 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të fjalisë së parë në pikën 3 të nenit 14 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, me këtë përmbajtje: “Kur mandati i një deputeti të zgjedhur në një zonë zgjedhore njëemërore mbaron në mënyrë të parakohshme, vendi i tij plotësohet nga kandidati i radhës i listës shumëmemërore të subjektit zgjedhor përkatës.”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

* * *

Vendimi nr. 1, datë 7.01.2005

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Gjergj Sauli, Kryetar, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Vjollca Meçaj, Xhezair Zaganjori, Petrit Pllloçi, Sokol Sadushi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, në datat 06.12.2004 dhe 10.12.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.28/8 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: **PARTIA SOCIALDEMOKRATE E SHQIPËRISË,**
përfaqësuar nga Kryetari i saj,
zoti Skënder Gjinushi.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KUVENDI I REPUBLIKES SE SHQIPËRISË,**
përfaqësuar nga zoti Idar Bistri,
me autorizim.
PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË,
përfaqësuar nga zoti Ilir Rusmajli,
me autorizim.
PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË,
përfaqësuar nga zotërinjtë Ilir Roqi e
Fatmir Muçaj, me dokument
PARTIA E UNITETIT KOMBËTAR,
përfaqësuar nga zoti Idajet Beqiri.

O B J E K T I: Shpallja e papajtueshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të shprehjes “që kanë marrë pjesë në votime” në fjalinë e parë dhe të tretë të nenit 73, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, në cilësinë e kërkuarit ka pretenduar përpara Gjykatës Kushtetuese se formulimi i nenit 73, pika 1 e ligjit nr.9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i

Republikës së Shqipërisë” është në kundërshtim me nenin 64, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke parashtruar këto shkaqe:

- Kriteri ligjor i “numrit të zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votime” që duhet të përdoret për ndarjen e zonave zgjedhore, i parashikuar në nenin 73, pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, kundërshton kriterin e parashikuar në nenin 64, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

- Neni 73, pika 1 e Kodit Zgjedhor i ndan zonat zgjedhore në bazë të numrit të pjesëmarrësve në votime, duke mos respektuar kriterin kushtetues të numrit të zgjedhësve që kanë të drejtë vote. Sipas këtij kriteri ligjor, territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në rajone me peshë më të madhe elektorale, që nxjerrin më shumë deputetë për banorë dhe në rajone me peshë më të ulët;

- Zbatimi i nenit 73, pika 1 të Kodit Zgjedhor prek parimin e barazisë midis shtetasve si dhe përjashton nga e drejta e përfaqësimit ata që nuk kanë marrë pjesë në votime;

- Fjalja e parë dhe e tretë e nenit 73, pika 1 të Kodit Zgjedhor nuk është në unitet me fjalinë e dytë, sepse përdoren të dy konceptet, “zgjedhës” dhe “zgjedhës që kanë marrë pjesë në votime.”

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Partia Demokratike e Shqipërisë, paraprakisht, pretendoi përpara Gjykatës Kushtetuese se në rastin konkret, kërkuesi nuk ka legjitimitet për të inicuar një gjykim të kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës ligjore. Ai parashtrroi se kërkuesi ka detyrimin të provojë interesin e vet për të ushtruar këtë të drejtë, si një ndër subjektet e parashikuara nga neni 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Dispozita ligjore, objekt shqyrtimi nuk e ka sjellë ende produktin e vet, pra përcaktimin e zonave zgjedhore dhe për rrjedhojë interesi i kërkuesit në këtë fazë të procesit është i parakohshëm.

Lidhur me shqyrtimin në thelb të çështjes, përfaqësuesi i subjektit të interesuar pretendoi se kriteri ligjor i parashikuar në nenin 73, pika 1 të Kodit Zgjedhor është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ky është një ndër kriteret që parashikohen edhe në Kodin e praktikës së mirë në çështjet zgjedhore, miratuar nga Komisioni i Venecias.

Përfaqësuesit e subjekteve të tjera të interesuara i bashkuan qëndrimet e tyre me pretendimet e kërkuesit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Sadushi, kërkuesin, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Gjykata Kushtetuese përpara se të shqyrtojë pretendimet e palëve mbi thelbin e çështjes dhe të shprehet për pajtueshmërinë ose jo me Kushtetutën të dispozitës ligjore të sipërcituar, çmon të domosdoshme të analizojë kërkesën paraprake të parashtruar në seancë gjyqësore nga përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Partia Demokratike për moslegjitimimin e kërkuesit.

Këtë pretendim të subjektit të interesuar, kërkuesi e kundërshtoi duke arsyetuar se nga mënyra e formulimit të nenit 73, pika 1 të ligjit nr.9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” preken të drejtat themelore të zgjedhësve, si dhe të drejtat e partive politike, të cilat paraqiten si aktorët kryesor të procesit zgjedhor. Kjo dispozitë ligjore, duke vendosur kritere që sipas kërkuesit cilësohen antikushtetuese, prek parimin e barazisë së votës si dhe parimin e konkurrencës së ndershme ndërmjet partive. Ajo deformon ndarjen e zonave zgjedhore dhe ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në qëllimin dhe synimin kryesor që kanë këto subjekte politike për të marrë sa më shumë vota dhe nëpërmjet votave të fitojnë më shumë deputet për në organin përfaqësues.

Çështjen e legjitimitetit të kërkuesit, (*locus standi*) Gjykata Kushtetuese e vlerëson si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet inicuese që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet funksionit e veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Partitë politike janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Ato kanë legjitimitet kushtetues vetëm për ato çështje që lidhen me interesat e tyre.

Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, partitë politike paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve e pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të ndikojnë në

jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit. Partitë politike në sistemin e zgjedhjeve e veçanërisht në procesin zgjedhor, që nga fushata parazgjedhore, paraqitja e kandidatëve, formimi i trupave zgjedhore, ndjekja e zgjedhjeve e deri tek ndarja e mandateve, paraqiten si një faktor përcaktues shumë i rëndësishëm. Prandaj, demokracia përfaqësuese, ashtu si dhe sistemi i zgjedhjeve, nuk mund të paramendohen pa ekzistencën dhe funksionimin e partive politike. Ky pozicion specifik që partitë politike kanë në raport me zgjedhjet përcakton njëkohësisht dhe interesin e tyre për të patur një legjislacion dhe rregulla sa më të qarta e të drejta.

Dispozita ligjore objekt shqyrtimi, parashikon kriterin që duhet të përdoret për caktimin e kufijve të zonave zgjedhore. Pretendimi i kërkuesit për antikushtetutshmërinë e pikës 1 të nenit 73 të Kodit Zgjedhor dhe për lidhjen që kjo dispozitë ligjore ka me qëllimin e partisë politike për të qenë një subjekt i barabartë dhe konkures në zgjedhje, e mbart në vetvete interesin për t'u konsideruar në kuptim të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si një subjekt inicues i gjykimit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës juridike.

Pretendimi i subjektit të interesuar, Partia Demokratike se një dispozitë e tillë është hipotetike, për arsye se nuk ka sjell ende një produkt konkret, nuk është i drejtë. Neni 73 i Kodit Zgjedhor, në tërësi, është një dispozitë e zbatueshme që sjell domosdoshmërisht një produkt konkret, për arsye se vendos përpara detyrimit ligjor Komisionin e Kufijve të Zonave Zgjedhore dhe Kuvendin e Shqipërisë për të miratuar ndarjen e re të zonave zgjedhore jo më vonë se 6 muaj përpara përfundimit të mandatit të Kuvendit.

Për Gjykatën Kushtetuese është i njohur rregulli i pranuar në doktrinë dhe në jurisprudencën kushtetuese, se gjatë kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së një norme juridike nuk kërkohet ardhja e pasojës për të legjitimuar kërkuesin. Tipari dallues i një kërkese të tillë është se ajo vë në lëvizje një kontroll abstrakt e objektiv të ligjit, pasi interesi që kërkohet të mbrohet nuk është thjesht individual, por është një interes që lidhet me respektimin e parimeve kushtetuese dhe me funksionimin e rregullt të shtetit të së drejtës. Qëllimi i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve është njëkohësisht edhe parandalimi i pasojave negative që mund të vijnë nga zbatimi i tyre. Ky është dhe një qëndrim i mbajtur edhe në jurisprudencën tonë kushtetuese. Nga ky këndvështrim i problemit,

Gjykata Kushtetuese e konsideron Partinë Socialdemokrate, në cilësinë e kërkesit, si një subjekt të legjitimuar dhe që ka interes për çështjen në shqyrtim.

2. Në lidhje me objektin e kërkesës së paraqitur, Gjykata Kushtetuese vlerëson se është e nevojshme një analizë e hollësishme e çështjes në aspektet thelbësore që karakterizojnë kontrollin e kushtetutshmërisë së një norme juridike.

Në nenin 73, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” parashikohet:

“Ndarja e zonave zgjedhore bëhet sipas kriterëve të mëposhtme:

3. Numrit të zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votime në çdo njësi zgjedhore në zgjedhjet e fundit që i paraprijnë mbledhjes së Komisionit. Asnjë zonë zgjedhore nuk lejohet të ketë devijim më të madh ose më të ulët se 5 për qind nga numri mesatar i zgjedhësve në shkallë Republike, përveç rasteve që detyron zbatimimi i pikës 7 të këtij neni. Numri mesatar përcaktohet nga pjestimi i numrit të përgjithshëm të zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votime me numrin 100 të zonave të zgjedhjeve...” .

Formulimi ligjor i parashikuar në këtë dispozitë të Kodit Zgjedhor paraqet një ndryshim duke e krahasuar me legjislacionin zgjedhor të mëparshëm. Në këtë kod përdoret për herë të parë kriteri *zgjedhës që kanë marrë pjesë në votime* në ndryshim nga Kodi Zgjedhor i vitit 2001 dhe i gjithë legjislacioni i mëparshëm që njihnte kriterin *zgjedhës të regjistruar*.

Çështja që shtrohet për shqyrtim përpara Gjykatës Kushtetuese lidhet me pajtueshmërinë ose jo me Kushtetutën të kriterit ligjor *zgjedhës që kanë marrë pjesë në votime*. Për të konkluduar mbi kushtetutshmërinë e dispozitës objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të analizojë sipas metodave të interpretimit historik, teleologjik dhe zgjerues kriterin ligjor të *numrit të zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votime*, në raport me nenin 64, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe me dispozita të tjera që sanksionojnë parimet dhe konceptet që lidhen me të drejtën e zgjedhjes dhe me barazinë e votës.

E drejta e zgjedhjes është një ndër të drejtat kushtetuese të shtetasve që luan një rol kryesor në procesin zgjedhor. Kjo e drejtë që sanksionohet në nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë njihet si e drejtë e votës së barabartë dhe si barazi e shtetasve në zgjedhje. Si barazia e votës, ashtu dhe barazia e

konkuresve në zgjedhje, që është konkretizimi i shanseve politike të barabarta, janë të domosdoshme për realizimin e një procesi zgjedhor të drejtë. Subjekte përfituese të këtij parimi janë zgjedhësit nga njëra anë, si dhe konkuresit në zgjedhje nga ana tjetër, ku përfshihen partitë politike, koalicionet e partive, kandidatët e tyre si dhe kandidatët e pavarur. Koncepti i votës së barabartë u jep të drejtë zgjedhësve, sa të jetë e mundur, të ndikojnë në mënyrë të njëllojtë dhe me të njëjtën peshë në rezultatin e zgjedhjeve.

Parimi kushtetues i barazisë së votës lidhet në mënyrë të pandashme dhe me sistemin zgjedhor. Nisur nga lloji i sistemit zgjedhor, barazia e peshës së çdo vote nuk nënkupton barazinë e saktë matematike të kontributit të çdo vote në rezultatin final të zgjedhjeve. Pesha e çdo vote është e lidhur me mekanizmat e sistemit zgjedhor dhe është e pashmangshme ekzistenca e dallimeve në influencën që mund të ketë çdo votë në varësi nga mekanizmat e adoptuar. Kështu, në sistemin mazhoritar, ky parim kuptohet si mundësi e barabartë për të patur sukses, për arsye se votat e dhëna për kandidatin që nuk ka marrë shumicën nuk llogariten dhe në këtë kuptim nuk marrin vlerën e duhur. Në sistemin mazhoritar mjafton që të garantohet vlera numerike e votës dhe zgjedhësve t'u jepet shansi i barabartë, pavarësisht se vetëm një pjesë e votave vlerësohet ose ndikon në rezultat. Ndërsa në sistemin proporcional formalizimi i barazisë së votës shkon më tej, që do të thotë jo vetëm vlerë numerike e njëjtë, por edhe vlerë e njëjtë suksesi ose ndikim i njëjtë në rezultat.

Krahas këtyre koncepteve teorike-doktrinare, ligjvënësi gjatë hartimit të ligjeve duhet të vlerësojë edhe faktorë të tjerë që mund të kërkohen nga kushte të ndryshme specifike, me qëllim krijimin e një mekanizmi të përshtatshëm zgjedhor që të sigurojë një përfaqësim të drejtë dhe efektiv. Duke u nisur nga parimet demokratike mbi të cilat janë ndërtuar kushtetutat moderne, është e kuptueshme edhe tendenca e ligjvënësit për t'i kushtuar rëndësinë e duhur trajtimit të barabartë të shtetasve në procesin e shprehjes së vullnetit politik. Në sistemin e zgjedhjeve të pranuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, që është një përzierje e dy sistemeve të mësipërme, parimi i barazisë së votës synon që në procesin e votimit për ndarjen e vendeve në parlament, parimisht, votat të kenë të njëjtën peshë në rezultatin e zgjedhjeve.

Në realizimin e këtij parimi, përcaktimi i drejtë i kufijve të zonave zgjedhore ka një ndikim të drejtpërdrejtë. Ndarja e zonave

zgjedhore nuk duhet konceptuar si një ndarjeje e thjeshtë e natyrës tekniko-administrative. Ajo përbën një proces me rëndësi kushtetuese dhe është pjesë integrale e parimit të barazisë së votës.

Në nenin 64, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet : “Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë. 100 deputetë zgjidhen drejtpërdrejt në zona njëemërore *me numër të përafërt zgjedhësish...*” Njëpërmjet kësaj dispozite të Kushtetutës njihet dhe pranohet parimi i fuqisë së barabartë në votim që nënkupton, se vota e çdo shtetasi ka vlerë të njëjtë dhe askush në zgjedhje nuk mund të ketë më tepër përparësi dhe privilegj në raport me zgjedhësit e tjerë. Barazia e votës kërkon që kufijtë ndërmjet zonave zgjedhore të hartohen në një mënyrë të tillë që mandatet në parlament të shpërndahen në mënyrë të barabartë dhe në përputhje me kriterin specifik të proporcionalitetit.

Kodi i praktikës së mirë në çështjet zgjedhore, miratuar nga Komisioni i Venecias, në pikën 2.2 pranon se fuqia e barabartë e votës *konsiston në shpërndarjen e qartë dhe të balancuar të mandateve midis zonave zgjedhore mbi bazën e një prej kriterëve të mëposhtme të ndarjes së mandateve : popullsia, numri i banorëve lokalë (duke përfshirë minorenët), numri i zgjedhësve të regjistruar, dhe, mundësisht numri i njerëzve që faktikisht votojnë*¹.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Partia Demokratike i mbështeti pretendimet e tij për të argumentuar kushtetutshmërinë e nenit 73, pika 1 të Kodit Zgjedhor në kriterin e pjesmarrësve në votim, të njohur nga Kodi i praktikës së mirë të çështjeve zgjedhore. Në kundërshtim me të, kërkuesi pretendoi se për të konkluduar mbi papajtueshmërinë me Kushtetutën të pikës 1 të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, duhet të nisemi nga kriteri i numrit të zgjedhësve të regjistruar, i pranuar në nenin 64, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që i ndan zonat zgjedhore në numër të përafërt zgjedhësish.

Gjykata Kushtetuese në analizën e këtyre pretendimeve nuk gjykon se duhen vënë në diskutim vlerat demokratike që përmbajnë në vetvete gjithsecili nga kriteret e sipërcituara, për arsye se ato janë kritere të njohura dhe të zbatueshme për shtete të ndryshme. Duke marrë parasysh se legjislacioni për këtë çështje ndryshon

1. Kodi i praktikës së mirë në çështjet zgjedhore, -Udhëzime dhe Raporti shpjegues - miratuar nga Komisioni i Venecias në mbledhjen e tij të 51 –të dhe të 52-të. (Venecia, 5-6 Korrik dhe 18-19 Tetor 2002).

nga vendi në vend dhe nga koha në kohë²“, sisteme të ndryshme demokratike përdorin ato kritere që burojnë në rradhë të parë nga kushtetutat e vendeve të tyre.

Prandaj, Gjykata Kushtetuese çmon se është tepër e rëndësishme për çdo shtet të së drejtës që zbaton rregullat e një shoqërie demokratike, të gëzojë hapësira të konsiderueshme për të përcaktuar rregulla dhe kritere të drejta brenda rendit të tij kushtetues, në përputhje me kushtet konkrete si dhe me faktorët e ndryshëm politikë, historik, social, kulturor, tradicional, të cilët janë tepër përcaktues.

Ligjvënësi ka hapësirë veprimi për të vlerësuar vet duke parashikuar në ligj kritere të tilla që i përgjigjen në realitet dhe objektivisht parimit të barazisë së votave dhe përfaqësimit të barabartë. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese nuk është që të vihet në rolin e ligjvënësit pozitiv dhe të përcaktojë rregullimet ligjore, por të kontrollojë nëse zgjidhja që jep ligjvënësi nëpërmjet përcaktimeve të kritereve ligjore për ndarjen e zonave zgjedhore është ose jo në përputhje me dispozitat e Kushtetutës.

Nga ky këndvështrim, Gjykata Kushtetuese vlerëson të domosdoshme, se për të konkluduar mbi kushtetutshmërinë ose jo të kriterit *“zgjedhës që kanë marrë pjesë në votime”*, parashikuar nga neni 73, pika 1 e Kodit Zgjedhor, duhet të analizohet kuptimi i qartë dhe i plotë i kriterit *“zgjedhës”* në raport me kriterin *“numër i përafërt zgjedhësish,”* si dhe me dispozita të tjera të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Janë disa dispozita në Kushtetutë, ku përmendet shprehimisht termi zgjedhës. Në nenin 64, pika 1 të Kushtetutës përmendet shprehja *“numër i përafërt zgjedhësish”*. Në nenin 68, pika 1 thuhet : *“Kandidatët për deputetë mund të paraqiten vetëm nga partitë politike, nga koalicionet e partive, si dhe nga zgjedhësit.”* Në nenin 81, pika 1 thuhet : *“Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës.”* Në nenin 150, pika 1 parashikohet : *“Populli, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, ka të drejtën e referendumit ..”*.

Kuptimi i termit zgjedhës në dispozitat e sipërcituara duhet analizuar në lidhje të ngushtë me të drejtën themelore të shtetasve të sanksionuar në nenin 45 të Kushtetutës, në të cilën thuhet : *“Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet.”* Në termin

2. Çështja Mathieu-Mohin dhe Clerfayt kundër Belgjikës nr 9/1985/95/143) - Vendim i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

kushtetues zgjedhës, që është shumë i gjerë, përfshihen të gjithë shtetasit shqiptar, që kanë mbushur moshën e caktuar dhe që nuk janë të përjashtuar sipas ligjit, të cilët kanë të drejtën për të zgjedhur (e drejta aktive), si dhe të drejtën për t'u zgjedhur (e drejta pasive). Si zgjedhës, në aspektin kushtetues përfshihen edhe ata shtetas të cilët për arsye të ndryshme objektive apo subjektive nuk e ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes. Pjesmarrja në votime nuk është detyrim për shtetasit dhe për rrjedhojë mos ushtrimi i të drejtës së zgjedhjes nga shtetasit është një e drejtë vetëm e tyre, e cila nuk mund të paragjykohet. Kjo është një çështje subjektive personale e shtetasve, që përcaktohet në bazë të vullnetit të tyre të lirë. E drejta e zgjedhjes, së bashku dhe me të drejtën për të paraqitur kandidatët për deputet, për të ushtruar iniciativën legjislativë, për të kërkuar kryerjen e një referendumi etj, burojnë nga e drejta e shtetasve për të qenë zgjedhës.

Nga ky këndvështrim i problemit, çdo lloj kuptimi tjetër që mund t'i jepej këtij termi me ligj, në aspektin ngushtues apo përjashtues do të përbënte një çështje të kufizimit kushtetues dhe për rrjedhojë, do të kishte një ndikim të drejtpërdrejtë mbi të drejtën themelore të zgjedhjes.

Mbi bazën e këtij kuptimi që merr nga Kushtetuta kriteri zgjedhës, Gjykata Kushtetuese thekson se edhe shprehja *“numër i përafërt zgjedhësish”*, e parashikuar në nenin 64, pika 1 të Kushtetutës për ndarjen e zonave zgjedhore, përfshin të gjithë zgjedhësit me të drejtë vote. Interpretimin kushtetues të këtij koncepti e gjejmë të trajtuar hollësisht edhe në jurisprudencën e mëparshme kushtetuese. Në vendimin nr. 40, datë 17.5.2001, Gjykata Kushtetuese i ka bërë një interpretim kësaj fraze dhe e ka analizuar të lidhur me numrin e shtetasve me të drejtë vote, duke konkluduar ndërmjet të tjerave se *“koncepti numër i përafërt zgjedhësish është një kriter kushtetues që duhet ta kenë parasysht organet përkatëse kur propozojnë apo miratojnë ndarjen e zonave zgjedhore...”*³

Në nenin 73, pika 1 të Kodit Zgjedhor rezulton se ligjvënësi për ndarjen e zonave zgjedhore nuk ka përdorur si kriter numerik kriterin kushtetues zgjedhës, por i është referuar një kriteri tjetër që lidhet me pjesmarrësit në votime. Në ndryshim nga të gjitha dispozitat e tjera të Kodit Zgjedhor, si neni 2, pika 28, neni 3, neni

3. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 40, datë 17.5.2001. Përmbledhje vendimesh - viti 2000-2001, fq.224.

50, 72, 73, 94, 96 etj, që e trajtojnë kriterin *zgjedhës* në kuptimin e shtetasve me të drejtë vote, në dispozitën objekt shqyrtimi përdoret kriteri kufizues *i numrit të zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votime*. Ky është një kriter i ri që përdoret në legjisllacionin tonë zgjedhor dhe paraqitet i ndryshëm nga kriteri zgjedhës, si në aspektin sasior, ashtu edhe në drejtim të sjelljes së ndryshimeve cilësore në konceptet kushtetuese.

Ligjvënësi, duke përdorur një kriter tjetër dhe të ndryshëm nga kriteri zgjedhës në përcaktimin e ndarjes së zonave zgjedhore, ka zëvendësuar konceptin tërësor me një koncept pjesor, i cili përmban në vetvete kuptimin e ngushtë dhe veçues. Në përcaktimin e kriterëve, ligjvënësi duhet të nisët nga respektimi në rradhë të parë i koncepteve kushtetuese.

Ligjvënësi duke parashikuar për ndarjen e zonave zgjedhore kriterin e numrit të zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votime, i jep atij një kuptim përcaktues, duke e ngushtuar në mënyrë të paarsyeshme kriterin kushtetues. Përrjashtimi nga neni 73, pika 1 të Kodit Zgjedhor të kriterit kushtetues të zgjedhësve dhe parashikimi nga ligjvënësi të një kriteri tjetër, është një shmangie nga neni 64, pika 1 e Kushtetutës, që kërkon ndarjen e zonave zgjedhore *në numër të përafërt zgjedhësish*. Për rrjedhojë, një formulim i tillë i kësaj dispozite të Kodit Zgjedhor që çënon pa të drejtë përmbajtjen e dispozitave kushtetuese, përbën antikushtetushmëri.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se fraza “*që kanë marrë pjesë në votime*” e përdorur në fjalinë e parë dhe të tretë të nenit 73, pika 1 të Kodit Zgjedhor duhet të shfuqizohet si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimi i kësaj fraze nga formulimi i nenit 73, pika 1 të Kodit Zgjedhor krijon një paqartësi dhe boshllëk ligjor, në veçanti për fjalinë e parë, duke e bërë atë praktikisht të pazbatueshme. Në këto kushte, është e drejtë e Kuvendit të Shqipërisë të vlerësojë në tërësi përmbajtjen e kësaj dispozite të Kodit Zgjedhor në harmoni me të gjitha dispozitat e tjera ligjore dhe me këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “a”; 132; 134, pika 1, shkronja “f” dhe pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në nenet 26, 49 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe

funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të frazës “*që kanë marrë pjesë në votime*” në fjalinë e parë dhe të tretë të nenit 73, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e shpalljes.

MENDIMI I PAKICËS

Në çështjen me kërkues Partia Socialdemokrate e Shqipërisë dhe objekt deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të shprehjes: “*që kanë marrë pjesë në votime*”, në fjalinë e parë dhe të tretë të nenit 73, pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, ne kemi qëndrim të ndryshëm nga ai i shumicës. Mendojmë se kërkesa e Partisë Socialdemokrate duhej të ishte rrëzuar për këto arsye:

1. As në kërkesë dhe as në seancë gjyqësore, kërkuesi nuk paraqiti argumente për të provuar interesin e tij konkret dhe të drejtpërdrejtë për këtë çështje, ashtu siç kërkon paragrafi i dytë i nenit 134 të Kushtetutës. Thjesht fakti i të qenit parti politike është i pamjaftueshëm për të justifikuar automatikisht interesin e kërkuesit për të kërkuar në Gjykatën Kushtetuese të deklarojë si antikushtetues çdo lloj dispozite ligjore lidhur me procesin zgjedhor. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të kërkojë vetë argumente për ta gjetur këtë interes. Për më tepër, pretendimet kushtetuese të partive politike për çështjet zgjedhore në tërësi, fokusohen kryesisht në të drejtën e pjesëmarrjes së tyre të lirë në procesin e formimit të vullnetit politik si dhe në garantimin e parimit të rëndësishëm të shanseve të barabarta në konkurrimin e të gjitha partive politike. Asnjë interes i tillë nuk shfaqet në kërkesën e paraqitur. Argumenti i kërkuesit për cënimin ose jo në këtë rast të parimit kushtetues të barazisë midis shtetasve, është hipotetik dhe nuk përbën interes të drejtpërdrejtë të tij si parti politike.

2. Zgjedhjet parlamentare janë ndër përbërësit më thelbësorë të demokracisë si formë e qeverisjes. Vetëm përmes tyre

mund të bëhet realitet parimi i rëndësishëm i sovranitetit të popullit, i cili garantohet që në nenin 2 të Kushtetutës, si dhe konstituimi demokratik i pushtetit shtetëror. Prandaj është e domosdoshme që ato të jenë të lira dhe në përputhje të plotë me kërkesat kushtetuese dhe satandartet ndërkombëtare bashkëkohore. Të gjitha organet dhe mekanizmat kushtetues dhe shtetërorë kanë për detyrë të garantojnë me prioritet dhe realisht këto kërkesa, duke qëndruar njëkohësisht sa më të paanshëm dhe objektivë gjatë gjithë këtij procesi.

3. Një nga parimet kryesore të zgjedhjeve të lira e demokratike është edhe ai i zgjedhjeve të barabarta. Në thelbin e tij, ky parim, kërkon ndër të tjera të garantojë edhe peshën apo ndikimin e barabartë që normalisht duhet të ketë vota e secilit zgjedhës në rezultatin përfundimtar pjesor apo tërësor të zgjedhjeve. Filozofi i shquar francez Ruso, që në fundin e shekullit 18, thekson në kryeveprën e tij “Kontrata Sociale” se “Populli, si tërësi e bashkuar në të ashtuquajturën kontratë sociale, është mbajtësi dhe titullari origjinal i sovranitetit; se çdo individ formon një pjesë të barabartë të këtij sovraniteti, prandaj dhe duhet të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në drejtimin apo qeverisjen e shtetit....”.

Barazia e votës buron nga parimi i rëndësishëm i barazisë së njerëzve, pavarësisht nga veçoritë, aftësitë apo karakteristikat individuale. Prandaj me të drejtë thuhet se në demokraci, si formë e qeverisjes, votat nuk peshohen, por numërohen. Nga ana tjetër, ky parim bën të mundur të garantohen realisht shanse të barabarta në konkurrim për të gjithë kandidatët apo partitë politike që marrin pjesë në zgjedhje.

Në zbatim të parimit të barazisë së votës, i cili deklarohet edhe në nenin 45/4 të Kushtetutës, rrjedh edhe detyrimi i përcaktimit të kriterëve të sakta e të përshtatëshme për një ndarje sa më të barabartë të të gjithë zonave zgjedhore. Sigurisht që një barazi ideale është e pamundur të arrihet në praktikë. Megjithatë, ka shumë rëndësi që ndarja të jetë e tillë që në asnjë mënyrë të mos favorizojë kandidatët apo forca të caktuara politike. Në këtë kuptim, me rëndësi të veçantë është që numri i zgjedhësve që do të votojnë, mundësisht të jetë sa më i përafërt në të gjithë zonat zgjedhore. Disproporcionet e mëdha, të shpeshta dhe që mund të evitohen nga Ligjvënësi, janë në kundërshtim me parimin e barazisë.

4. Neni 64/1 i Kushtetutës bën një deklaram të përgjithshëm. Konkretisht aty theksohet se “Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë.

100 deputetë zgjidhen drejtpërdrejt në zona njëemërore me numër të përafërt zgjedhësish.....”. Mbetet detyrë e Ligjvënësit që në bazë e për zbatim të këtij deklarimi kushtetues, përmes Kodit Zgjedhor të përzgjedhë kriterin më të përshtatshëm për ndarjen e 100 zonave njëemërore “me numër të përafërt zgjedhësish”, por duke patur parasysh gjithnjë edhe parimin e barazisë së votës, të deklaruar në nenin 45/4 të Kushtetutës.

Në Kodin Zgjedhor të vitit 2000, konkretisht në nenin 71 të tij, Ligjvënësi për këtë qëllim iu referua numrit të përgjithshëm të individëve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve. Në kushte normale kjo është një zgjidhje e njohur, e drejtë dhe mëse e pranueshme nga të gjithë. Megjithatë, zgjedhjet e vitit 2001 provuan se zbatimi ekskluziv i këtij kriteri solli praktikisht një pabarazi të theksuar ndërmjet numrit të zgjedhësve që votuan në zona të ndryshme zgjedhore. Në raste të caktuara ky raport ishte deri edhe në 1 me 3. Për pasojë, edhe pesha e votës së çdo votuesi në zona të ndryshme zgjedhore, ishte jo rrallë, krejt e ndryshme. Si shkaqe kryesore për këtë situatë aspak normale dhe kushtetuese u evidentuan kryesisht pasaktësitë e theksuara në listat e zgjedhësve si dhe numri tepër i madh i shtetasve shqiptarë të larguar jashtë Shqipërisë (rreth 1 milion). Për këtë qëllim, forca të caktuara politike si dhe mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë, të specializuara në çështjet zgjedhore, përfshi këtu edhe OSBE/ODIHR-in, me të drejtë kërkuan rishikimin e këtij kriteri, në mënyrë që duke patur parasysh realitetin në Shqipëri, në zgjedhjet e radhës të mund të caktojë një kriter tjetër që do të mund të garantonte një ndarje sa më të barabartë të zonave zgjedhore, lidhur ngushtë kjo edhe me parimin e rëndësishëm kushtetues të barazisë së votës. Sigurisht që me këtë rast, siç kemi theksuar, garantohet edhe parimi i rëndësishëm i barazisë së shanseve për të gjithë kandidatët dhe forcat politike pjesëmarrëse në zgjedhje.

Mbi këtë bazë dhe mbështetur në kompromisin e arritur me monitorimin e OSBE-së për këtë çështje ndërmjet dy forcave politike kryesore në vend, Ligjvënësi (Kuvendi) bëri ndryshimet e nevojshme, duke përcaktuar në nenin 73/1 të Kodit Zgjedhor një kriter të ri për ndarjen e zonave zgjedhore. Sipas këtij kriteri, në ndarjen e këtyre zonave merret parasysh numri i zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votime në çdo njësi zgjedhore në zgjedhjet e fundit. Në gjetjen e kësaj zgjidhje u muar parasysh edhe Kodi i Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore, miratuar nga Komisioni i Venecias

të Këshillit të Evropës në tetor të vitit 2002. Në pikën 2.2 të këtij Kodi, aty ku flitet për barazinë në çështjet elektorale, rekomandohet ndër të tjera që në funksion të parimit të barazisë së votës, të bëhet një ndarje sa më e barabartë e zonave zgjedhore, duke përdorur për këtë qëllim në përputhje me çdo realitet konkret një nga katër kriteret e mëposhtme: 1) numrin e popullsisë; 2) numrin e banorëve rezidentë, përfshirë këtu edhe fëmijët; 3) numrin e zgjedhësve të regjistruar dhe 4) numrin e personave që kanë votuar faktikisht. Sigurisht që gjithnjë në funksion të kësaj barazie, rekomandohet se mund të bëhet edhe ndonjë zgjidhje tjetër që kombinon kriteret e mësipërme. Por, natyrisht që nuk duhet zbatuar ai kriter që sjell pabarazi në përfaqësim.

5. Ne mendojmë se kriteri i ri ligjor i vendosur në nenin 73 të Kodit Zgjedhor është jo vetëm i drejtë, por edhe në harmoni të plotë me Kushtetutën. Duke patur parasysh problemet që ekzistojnë ende me saktësinë e listave të zgjedhësve si dhe numrin tepër të madh të shtetasve shqiptarë të larguar nga Shqipëria, Ligjvënësi ka synuar të përzgjedhë atë kriter që siguron më mirë barazinë e votës (neni 45/4 i Kushtetutës) dhe nuk cënon konkurrencën e lirë të partive politike në procesin zgjedhor. Përkundrazi, ai garanton shanse sa më të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje. Ai (Ligjvënësi) ka qenë i ndërgjegjshëm se aktualisht, për realizimin sa më mirë të kësaj barazie, ky është mekanizmi më i drejtë dhe më i përshtatshëm për Shqipërinë. Argumenti që përdor kërkuesi se kriteri i ri krijon mundësi për një përfaqësim më të madh me deputetë për banorë të popullsisë së komunave në krahasim me popullsinë e qytetit (meqënëse sipas tij pjesëmarrja në votim e popullsisë së qytetit është deri në 50% më pak se ajo e komunave), është jo vetëm hipotetik dhe i padrejtë, por edhe antikushtetues.

Nga ana tjetër mendojmë se kjo zgjidhje është në përputhje të plotë edhe me nenin 64/1 të Kushtetutës. Ne vlerësojmë se në konceptin “numër i përafërt zgjedhësish” që përmend ky nen, përfshihen si individët e regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve (kriteri i mëparshëm), ashtu edhe zgjedhësit që kanë marrë pjesë në votime në çdo njësi zgjedhore në zgjedhjet e fundit (kriteri i ri – neni 73/1 i Kodit Zgjedhor). Për më tepër, në kundërshtim me konkluzionet e shumicës, ne theksojmë se koncepti i ri nuk ka aspak karakter kufizues apo përjashtues. Ai nuk zëvendëson asnjë koncept tërësor me koncept pjesor dhe nuk cënon asnjë të drejtë, as të drejtën individuale të votës dhe asnjë dispozitë kushtetuese. Çdo

shtetas me të drejtë vote, si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë, është i regjistruar dhe e gëzon lirisht këtë të drejtë si në rastin e parë (në bazë të kriterit të vjetër), ashtu edhe në rastin e dytë (kriteri i ri). Ligjvënësi ka për detyrë që në bazë të frymës së Kushtetutës dhe standarteve ndërkombëtare mbi zgjedhjet, brenda mundësive, të garantojë barazinë e votës së tij dhe përmes saj barazinë e shanseve për të gjithë kandidatët dhe forcat politike pjesëmarrëse në zgjedhje. Dhe këtë e realizon dukshëm më së miri kriteri i ri, pra neni 73/1 i Kodit Zgjedhor.

Anëtarë: Petrit Pllloçi, Xhezair Zaganjori.

* * *

Vendim nr. 40, datë 16.11.2007

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Vladimir Kristo, Kryetar, Gjergji Sauli, Fehmi Abdiu, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Petrit Pllloçi, Sokol Sadushi, Sokol Berberi, Xhezair Zaganjori, anëtarë, me sekretare Brunilda Bara, në datë 19.06.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çëshjen me nr.40 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: **AVOKATI I POPULLIT,**
 përfaqësuar nga Ervin Karamuço,
 me autorizim.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KUVENDI I SHQIPËRISË,**
 përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj,
 me autorizim.
KËSHILLI I MINISTRAVE,
 përfaqësuar nga Edmond Dunga,
 me autorizim.

O B J E K T I: **Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetu-**
 tën i fjalës “vendbanim” në nenin 63 pika 3
 të ligjit 9087, datë 19.06.2003, ndryshuar me

ligjin nr.9297, datë 21.10.2004 dhe ligjet nr.9341, datë 10.01.2005; nr.9371, datë 14.04.2005 si dhe ligjin nr.9676 datë 13.01.2007 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Kërkuesi ka pretenduar papajtueshmërinë e fjalës “vendbanim” me Kushtetutën, të parashikuar nga neni 63/3 i Kodit Zgjedhor, pasi kjo fjalë kushtëzon ushtrimin e të drejtës së votës me faktin që të burgosurit ose të paraburgosurit të jenë banorë në zonën ku vuajnë dënimin. Në këtë mënyrë, sipas kërkuesit, të burgosurit që kanë vendbanim të ndryshëm nga ai i vuajtjes së dënimit vendosen në pamundësi për të ushtruar të drejtën e votës, duke cenuar kështu një të drejtë të parashikuar nga neni 45/3 i Kushtetutës.

Sa i përket legjitimitit të tij, kërkuesi e argumenton të drejtën për t’iu drejtuar me këtë kërkesë Gjykatës Kushtetuese me faktin se neni 60 i Kushtetutës dhe ligji për Avokatin e Popullit janë në përputhje me nenin 49/2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Sipas kërkuesit, nuk ka asnjë pengesë kushtetuese ose ligjore për legjitimitimin e Avokatit të Popullit, në kuptim të nenit 134/1, shkronja “dh”.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, ***Kuvenditë Shqipërisë***, është shprehur se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, duke parashtruar se:

- Kërkesa është paraqitur tej afateve ligjore të parashikuara nga neni 50 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”;

- Të burgosurit nuk privohen nga e drejta e tyre për të votuar pasi ata janë të regjistruar në listat e zgjedhësve të vendbanimeve të tyre. Çështja e realizimit konkret të kësaj të drejte nga të burgosurit nuk të çon detyrimisht në përfundimin se dispozita e Kodit Zgjedhor është antikushtetuese;

- Të burgosurit ndodhen në të njëjtën pozitë si edhe personat me shtetësi shqiptare dhe vendbanim jashtë Shqipërisë, studentët, ushtarakët, etj., të cilët vetëm për zgjedhjet parlamentare kanë të drejtë të votojnë në vendqëndrimet e tyre, kurse për zgjedhjet vendore duhet të votojnë pranë vendbanimit të tyre. Kjo dispozitë është formuluar në këtë mënyrë për shkak të lidhjes së drejtpërdrejt

që ka zgjedhësi me drejtuesit e njësisë vendore.

Përfaqësuesi i **Këshillit të Ministrave** kundërshtoi pretendimet e kërkuesit me këto argumente:

- Kërkuesi nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pasi nuk ndodhemi para rastit kur janë cenuar të drejtat liritë apo interesat e ligjshme të individëve nga veprime apo mosveprime të organeve të administratës publike. Sipas subjektit të interesuar, ligji nuk është akt i administratës publike dhe për këtë arsye kërkuesi nuk mund të kërkojë papajtueshmërinë e tij me Kushtetutën para kësaj Gjykate për mungesë legjitimimi;

- Kërkuesi nuk duhet ta mbështesë pretendimin e tij mbi nenin 3 të Protokollit Shtesë nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi kjo dispozitë e shtrin efektin vetëm për zgjedhjet e përgjithshme dhe jo për ato vendore;

- Të burgosurve nuk u është mohuar e drejta e votës, ajo thjesht është lidhur me konceptin e vendbanimit, pasi vetë karakteri i zgjedhjeve vendore e kushtëzon këtë lidhje midis zgjedhësve dhe të zgjedhurve. Mungesa e parashikimeve ligjore përkatëse për ta bërë efektiv ushtrimin e të drejtës së votës për të burgosurit që nuk kanë vendbanimin në vendin e vuajtjes së dënimit, nuk do të thotë se dispozita e nenit 63/3 të Kodit Zgjedhor është antikushtetuese.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Xhezair Zaganjori, përfaqësuesin e kërkuesit, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me ligjin nr.9341, datë 01.10.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, është ndryshuar, midis të tjerave, edhe dispozita e nenit 63 e këtij Kodi, e cila thotë: “Në burgjet dhe në vendet e paraburgimit, për zgjedhjet dhe referendimet vendore, 40 ditë para datës së votimit, drejtuesi i institucionit përgatit listën e zgjedhësve me vendbanim në njësinë zgjedhore, ku ndodhet institucioni dhe ia dorëzon atë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.”

Ndryshimet që iu bënë kësaj dispozite kishin për qëllim realizimin e të drejtës së votës të personave të ndodhur në

institucione të posaçme, pra të burgosurve dhe të paraburgosurve. Duke iu referuar nenit 50 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se kërkesat para Gjykatës Kushtetuese për papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare paraqiten brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e tyre, rezulton se kërkesa e paraqitur nga Avokati i Popullit është brenda afatit ligjor të parashikuar për këtë qëllim.

Gjykata Kushtetuese vlerëson si të nevojshme që së pari të shprehet mbi legjitimitimin e kërkuarit. Lidhur me këtë Gjykata çmon se Avokati i Popullit legjitimohet në paraqitjen e kërkesës së tij para kësaj Gjykate. Siç është theksuar edhe në praktikën e mëparshme të kësaj Gjykate, Avokati i Popullit, si një nga subjektet që mund ta vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në bazë të nenit 134/2 të Kushtetutës, duhet të justifikojë interesin e tij në çështjen konkrete. Interesi i tij duhet të lidhet me funksionin kushtetues që ushtron kur si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, aktit normativ nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike, janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individëve. Këto shkelje duhet të evidentohen në procesin e veprimitarisë së Avokatit të Popullit, gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij.¹

Gjykata Kushtetuese e sheh me vend të ndalet edhe një herë në përcaktimin e konceptit “interes” në çështjen me kërkuar Avokatin e Popullit, sipas nenit 134/2 të Kushtetutës, ku parashikohet se ky organ mund të bëjë kërkesë para kësaj Gjykate vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tij.

Sipas nenit 60 të Kushtetutës, Avokati i Popullit është organ kushtetues i krijuar për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e ligjshme të individit ngaveprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të administratës publike. Një nga mënyrat me të cilat ky organ realizon funksionin e tij është edhe vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e akteve normative të nxjerra nga administrata publike dhe që nga evidentimi i Avokatit të Popullit rezultojnë të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën. Avokati i Popullit mund të arrijë në këtë përfundim përmes hetimeve, vëzhgimeve apo informacioneve që ai mbledh, kur individët i drejtohen atij me anë të ankesës ose kërkesës. Nëse ky organ

1. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 49 datë 31.07.2000, Përmbledhja e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese 2000-2001, fq. 122.

vlerëson se si rrjedhim i veprimtarisë së administratës publike janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të individit, atëherë ai ndërmerr hapa konkretë për verifikimin e mëtejshëm të shkaqeve që kanë çuar në këtë shkelje dhe rast pas rasti rekomandon marrjen e masave të karakterit normativ, nëse është e nevojshme.

Gjykata Kushtetuese konstaton se kompetenca e Avokatit të Popullit për t'iu drejtuar kësaj Gjykate konsiderohet si një garanci shtesë që i është dhënë në mënyrë indirekte individit për të vënë në vend të drejtën e cenuar nga aktet e administratës publike. Nuk është detyra kryesore e Avokatit të Popullit t'i drejtohet gjykatave në tërësi dhe Gjykatës Kushtetuese në veçanti. Megjithatë në legjislationet e vendeve ku nuk është parashikuar ekzistenca e mjeteve të tilla si kundërshtimi i drejtpërdrejt i akteve normative para Gjykatës Kushtetuese, Avokati i Popullit mund të luajë një rol të rëndësishëm në verifikimin e shkeljeve të të drejtave themelore të individit deri në investimin e Gjykatës Kushtetuese². Në raste të tilla, Avokati i Popullit duhet të argumentojë shkeljen konkrete dhe interesin në çështjen që kërkon të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese.

Kur Avokati i Popullit krijon bindjen se shkelja ka ardhur si pasojë e përmbajtjes së një ligji ose akti tjetër normativ, pra nga vetë formulimi i vullnetit të organit që e ka nxjerrë atë, atëherë ai mund të investojë Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin e aktit si antikushtetues. Në një rast të tillë mund të thuhet se çështja konkrete lidhet me interesin e këtij organi kushtetues për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e individit. Në këtë këndvështrim, interesi i Avokatit të Popullit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me qëllim shfuqizimin si antikushtetues të aktit të ligjvënësit duhet të shqyrtohet rast pas rasti, pasi ky është edhe kuptimi i nenit 134/2 të Kushtetutës, i cili e ka renditur këtë organ në grupin e subjekteve që i drejtohen Gjykatës Kushtetuese vetëm nëse justifikojnë interesin e tyre në çështjen konkrete.

Ashtu siç është shprehur edhe në praktikën e mëparshme të kësaj Gjykate, interesi i një subjekti në një çështje në kuptim të shkronja “dh”, “e” “ë”, “f” të nenit 134 të Kushtetutës do të quhet i justifikuar nëse ai arrin të provohet nga vetë kërkuesi se pasoja është e drejtpërdrejt pra rrjedh direkt nga akti objekt shqyrtimi,

2. Ky qëndrim ka qenë një nga konkluzionet përfundimtare të Konferencës së Ombudsmenëve të vendeve të Evropës Juglindore me temë: *Marrëdhëniet ndërmjet Ombudsmenëve dhe organeve gjyqësore, organizuar në Ljubjanë, Slloveni nga Këshilli i Evropës. Janë të njohura ndryshe edhe si “Konkluzionet e Ljubjanës”.*

është aktuale dhe sipas rasti, është e lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e institucionit ose organizatës respektive. Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkuesi i plotëson të tre këto kritere, pasi kërkesa lidhet me përmbajtjen e aktit normativ, i cili, sipas tij, sjell pasoja direkte në një të drejtë kushtetuese themelore siç është e drejta e votës. Gjithashtu, cenimi është aktual dhe jo potencial, pasi, sipas kërkuetit, të burgosurit janë penguar realisht të ushtrojnë të drejtën e votës si rrjedhim i përmbajtjes së dispozitës së nenit 63/3 të Kodit Zgjedhor. Edhe elementi i tretë, pra lidhja e drejtpërdrejt me subjektin, ekziston, pasi, siç u shpreh më lart, është në funksionin e Avokatit të Popullit të mbrojtë interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike.

Në kërkesën para kësaj Gjykate kërkuesi ka parashtruar se ai është vënë në lëvizje për këtë shkelje nga vetë të burgosurit, të cilët nuk kanë pasur mundësi të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës. Avokati i Popullit, në ushtrim të kompetencave të veta, ka krijuar mendimin se shkak për mosushtrimin e kësaj të drejte është përmbajtja e dispozitës së Kodit Zgjedhor, eliminimi i së cilës mund të sjellë si pasojë vendosjen në vend të së drejtës së shkelur. Gjykata Kushtetuese çmon se vënia në lëvizje nga Avokati i Popullit është në përputhje me funksionin e tij kushtetues dhe me filozofinë e krijimit të këtij institucioni, si një mekanizëm efektiv në mbrojtje të të drejtave kushtetuese të shtetasve, të drejta të cilat përbëjnë bazën e rendit tonë juridik.

Lidhur me thelbin e kërkesës, pra për të arritur në përfundimin nëse termi “vendbanim” që përmban dispozita e nenit 63/3 e Kodit Zgjedhor është apo jo në përputhje me Kushtetutën, Gjykata Kushtetuese vlerëson se duhet të ndalet në konceptin e zgjedhjeve në përgjithësi e sidomos tek zgjedhjet vendore në veçanti.

E drejta e votës është një nga të drejtat themelore politike që gëzon individi. Kjo e drejtë ushtrohet nëpërmjet ngritjes së një sistemi zgjedhor që garanton fshehtësinë, lirinë dhe barazinë e votës duke i siguruar shtetasve qenien e tyre politikisht aktiv duke formuar në këtë mënyrë thelbin e rolit që duhet të kenë ata në një sistem demokratik. E drejta e votës është një element qendror i demokracisë dhe i shtetit të së drejtës. Kontributi kryesor i saj është garantimi i mundësisë për të gjithë zgjedhësit, pa bërë dallime mbi baza shtresash apo përkatësie në grupe të caktuara shoqërore ose mbi baza të tjera, që të ndikojnë në formimin e vullnetit politik në një shoqëri demokratike. Nga ushtrimi i të drejtës së votës nuk duhet

përrjashtuar asnjë pjesë sado e vogël e popullsisë, përveç rasteve të përcaktuara në ligjin themeltar të shtetit.

Megjithatë e drejta e votës nuk është absolute, ajo mund të bëhet objekt i kufizimeve. Në këtë këndvështrim, për vetë rëndësinë që merr kjo e drejtë në një shoqëri demokratike, kufizimet që i duhen bërë kësaj të drejte jo vetëm duhet të jenë të pakta, por ato duhen zbatuar brenda kufijve kushtetues³. E rëndësishme është që kufizimet të mos jenë të tilla që ta bëjnë jo efektiv ushtrimin e kësaj të drejte ose ta cenojë atë në thelbin e saj⁴, pasi e drejta e votës nuk është një privilegj që pushteti shtetëror ua njih shtetasve, por një instrument për të zgjedhur mënyrën dhe personat që do të qeverisin vetë ata. Duke ushtruar të drejtën e votës zgjedhësit i krijohet mundësia të ndikojë në mënyrën dhe cilësinë e funksionimit të rendit juridik duke e bërë shtetasin më të përgjegjshëm për rolin që ai ka në drejtimin e jetës së vendit. Ky është në fakt edhe thelbi i demokracisë.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 45 të saj, parashikon të drejtën e çdo individi mbi 18 vjeç të zgjedhë e të zgjidhet. Përrjashtim bëjnë personat të cilëve u është hequr kjo e drejtë me vendim gjyqësor të formës së prerë për paaftësi mendore. Gjithashtu, paragrafi 3 i këtij neni parashikon se të dënuarit që janë duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë kanë vetëm të drejtën për të zgjedhur. Ky parashikim kushtetues është brenda standardeve demokratike dhe bashkëkohore.

Gjykata Kushtetuese thekson se teoria e së drejtës kushtetuese si dhe praktika gjyqësore evropiane e quan të pranueshme dhe të justifikuar vendosjen e kriterëve të tilla si, mosha minimum ose vendbanimi në një zonë të caktuar, përfshirja në lista zgjedhësish apo pasja e shtetësisë së vendit ku zhvillohen zgjedhjet si dhe aftësia mendore për të shprehur vullnetin politik. Duke iu referuar edhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dispozita e nenit 1 Protokollit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vendet anëtare kanë një hapësirë të gjerë në hartimin e legjislacioneve të tyre për zgjedhjet natyrisht duke respektuar thelbin e së drejtës. Kufizimet që mund t'i vendosen kësaj të drejte

3. *Vendim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aziz kundër Qipros, Nr. 69949/01 (2004).*

4. *Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Matthews kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 24833/94, (1999); Labita kundër Italisë Nr. 26772/95, (2000).*

duhet t'i përgjigjen një qëllimi legjitim dhe të mos jenë arbitrare apo joproportionale.⁵

Neni 45/3 i Kushtetutës sonë ka shkuar tej parashikimeve minimale si detyrime që rrjedhin dhe nga aktet ndërkombëtare⁶. Këto akte, që synojnë garantimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike, u lënë shteteve anëtare një hapësirë të gjerë vlerësimi të mekanizmave që kanë në dispozicion për ta bërë ushtrimin e të drejtës së votës efektive edhe për grupe të posaçme⁷. Në këtë aspekt i është lënë vetë shteteve anëtare të vlerësojnë, midis të tjerave, edhe grupet e individëve që mund të përjashtohen nga e drejta e votës, psh., vendosja e një moshe më të lartë për të ushtruar të drejtën e votës ose vendosja e kriterëve të tilla si shtetësia.

Në rastin konkret, ligjvënësi ynë ka vendosur minimumin e kriterëve kufizuese duke iu njohur të burgosurve të drejtën aktive të zgjedhjes. Pra, nga pikëpamja e garancisë kushtetuese formale e drejta e votës së të burgosurve është arritur nga dispozita e nenit 45/3 të Kushtetutës. Parashikimi i të drejtës së votës në përgjithësi dhe i grupeve të posaçme, siç konsiderohen të burgosurit, në veçanti, është shprehje e një demokracie politike dhe paraqet rëndësi për pjesëmarrjen e gjerë të votuesve në një proces të rëndësishëm.

Gjykata Kushtetuese konstaton se neni 63 i Kodit Zgjedhor vendos rregullat e ushtrimit të drejtës së votës për të burgosurit në zbatim të detyrimit që rrjedh nga dispozita e nenit 45/3 të Kushtetutës. Konkretisht, paragrafi 2 i nenit 63 parashikon votimin për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, kurse paragrafi 3 i këtij neni i referohet votimit në zgjedhjet për pushtetin vendor. Një nga dallimet midis këtyre dy dispozitave është se për zgjedhjet vendore ligjvënësi e ka lidhur ushtrimin e të drejtës së votës me vendbanimin, ndërsa për zgjedhjet e përgjithshme jo. Arsyeja e këtij dallimi duhet kërkuar tek fakti se në zgjedhjet e përgjithshme votohet për anëtarët e organit ligjvënës, të cilët i përkasin të gjithë popullit. Një nga parimet kryesore të përfaqësimit popullor është edhe mungesa e mandatit detyrues të deputetit, pra deputeti përfaqëson jo zonën zgjedhore ku ai votohet por të gjithë zgjedhësit.

Ndryshe ndodh në rastin e zgjedhjeve vendore. Këtu synohet

5. *Vendimi cituar më lart Labita kundër Italisë.*

6. *Shih nenin 3 të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe nenit 25 të Paktit për të Drejtat Civile dhe Politike të OKB-së.*

7. *Frowein/Peukert, Europäische Menschenrechtskonvention-Kommentar (1996) fq. 838.*

një lidhje më e ngushtë midis zgjedhësit dhe të zgjedhurit për vetë natyrën e organizimit dhe kompetencave të pushtetit lokal. Është pushteti vendor që kujdeset për zgjidhjen e problemeve aktuale të qytetarëve që lidhen me çështje të tilla si punësimi, kujdesi shëndetësor, arsimi parashkollor, pastrimi dhe gjelbërimi i mjediseve të njësisë vendore, etj. Për këtë arsye, votimi në zgjedhjet vendore trajtohet si pjesë e strukturës së demokracisë nga posht lart duke u mundësuar zgjedhësve pjesëmarrjen në qeverisje edhe në forumet më të vogla, përveç parlamentit kombëtar⁸. Në këtë këndvështrim, pranohet se pushteti lokal është më afër qytetarëve dhe këta të fundit janë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në drejtimin e njësisë vendore ku ata kanë vendbanimin.

Sipas nenit 12 të Kodit Civil, banimi është "...vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qendron zakonisht ose të shumtën e kohës." Në këtë kuptim, vendbanimi është pika qendrore e marrëdhënieve jetësore të një njeriu. Është kërkesë ligjore që një person të ketë një vendbanim kryesor, brenda një juridiksioni të caktuar, me qëllim që të votojë, të punësohet ose të presë përfitime të tjera brenda këtij juridiksioni. Kushti për të pasur vendbanimin në zonën zgjedhore është një nga kufizimet e të drejtës së votës, e cila bashkë me kriterin e shtetësisë synojnë të vendosin një lidhje direkte, qoftë edhe minimale, midis votuesit dhe rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Në këtë mënyrë sigurohet legjitimiteti i votës në një zonë të caktuar⁹.

Në këtë këndvështrim, duket me vend që neni 63/3 i Kodit Zgjedhor e lidh ushtrimin e të drejtës së votës për të burgosurit me konceptin e vendbanimit dhe jo me vendin e vuajtjes së dënimit ose vendqendrimin. Gjykata Kushtetuese çmon se kushtëzimi i të drejtës së votës me konceptin e "vendbanimit" në përmbajtjen e dispozitës së nenit 63/3 të Kodit Zgjedhor nuk e bën atë antikushtetuese, përkundrazi ai garanton shprehjen direkte të vullnetit të zgjedhësit për drejtuesit e njësisë vendore ku ai banon.

Si përfundim, në vijim të arsyetimit të mësipërm, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese konstaton se mosushtimi i të drejtës së votës nga të burgosurit dhe të paraburgosurit nuk është rrjedhojë e antikushtetutshmërisë së dispozitës së nenit 63/3

8. Klaus Stern, *Das Staatsrecht der Bundesrepublik Deutschland*, fq.424.

9. *Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, BVerfGE 36, 139/142.*

të Kodit Zgjedhor.

Për arsyet e paraqitura më lart, Gjykata Kushtetuese çmon se dispozita e paragrafit 3 të nenit 63 të Kodit Zgjedhor është në përputhje me nenin 45/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 49/2 e 51 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

* * *

Vendim nr. 32, datë 21.06.2010

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Vladimir Kristo, Fehmi Abdiu, Kujtim Puto, Xhezair Zaganjori, Petrit Pilloçi, Vitore Tusha, Sokol Berberi, Admir Thanza, Sokol Sadushi, anëtarë, me sekretare Blerina Çinari, në datën 15.12.2009 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.31/19 Akti, që i përket:

KËRKUES: **PARTIA BASHKIMI POPULLOR I
PENSIONISTËVE SHQIPTARË (PBPSH),
e përfaqësuar nga kryetari Selami
Jenishehri.**

SUBJEKTE

**TË INTERESUARA: KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj,
me autorizim.**

**KËSHILLI I MINISTRAVE,
përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari,
me autorizim.**

O B J E K T I: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i nenit 68 dhe nenit 71 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Neni 1/3, 3, 131/a dhe 134/1/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 49, 50 dhe 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuar që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

1.Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 ka miratuar Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Neni 68 i Kodit Zgjedhor, parashikon: “Listat e kandidatëve për Kuvendin, të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, duhet të mbështeten nga jo më pak se 10000 zgjedhës. Në rastin e koalicionit zgjedhor listat duhet të kenë marrë mbështetjen e jo më pak se 15000 zgjedhësve. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit.” Në nenin 71 parashikohet: “1.Zgjedhësit depozitojnë në mënyrë individuale nënshkrimet e tyre për mbështetjen e kandidatit të propozuar nga një grup zgjedhësish apo për partitë dhe koalicionet e parashikuara në nenet 68 dhe 69 të këtij Kodi në KQZ apo përpara noterit. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, sipas nenit 70 të Kodit, nënshkrimet depozitohen

përpara nëpunësit të KZAZ-së ose noterit. 2. Nënshkrimi shoqërohet me të dhënat e plota të zgjedhësit, ku përfshihet emri dhe mbiemri, vendbanimi i përhershëm dhe numri i dokumentit të identifikimit. Zgjedhësi duhet të jetë i regjistruar në zonën zgjedhore përkatëse dhe nuk mund të mbështesë më shumë se një kandidat, parti apo koalicion. 3. KQZ-ja miraton dhe vë në dispozicion formularin për depozitimin individual të nënshkrimit jo më vonë 90 ditë para datës së zgjedhjeve.”

2. Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë (PBPSH) është një person juridik i regjistruar sipas ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike” me vendimin nr.3378, datë 24.04.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës. Sipas kërkesës së paraqitur në Gjykatën Kushtetuese, ky subjekt politik ka deklaruar se ka pasur vullnetin të marrë pjesë aktivisht në zgjedhjet politike të zhvilluara më 28.06.2009, por nuk ka mundur të regjistrohet si subjekt pjesëmarrës në zgjedhje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, pasi (sipas tij) ka qenë praktikisht “i pakapërcyeshëm” sigurimi i 10.000 nënshkrimeve të mbështetësve të tij, procedurë e cila në bazë të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” duhet të kryhet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) apo përpara noterit.

3. **Kërkuesi**, përmes përfaqësuesit të tij, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe ka kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të dispozitave të sipërcituara të Kodit Zgjedhor, duke pretenduar se:

3.1 Është cenuar e drejta kushtetuese e barazisë përpara ligjit, parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës. Pretendimi i mësipërm, i paraqitur fillimisht në kërkesë, është përpunuar gjatë seancës plenare, se e drejta kushtetuese e cenuar ishte ajo e “barazisë në zgjedhje”, e sanksionuar nga neni 1, pika 3 e Kushtetutës.

3.2 Sipas kërkuesit, rregullimi i parashikuar nga nenet 68 dhe 71 të Kodit Zgjedhor krijon një barrierë të pakapërcyeshme për subjektet e reja politike që dëshirojnë të marrin pjesë në zgjedhje, pasi ajo e kushtëzon pjesëmarrjen e tyre në garën zgjedhore me mbështetjen e 10.000 personave që duhet të nënshkruajnë përpara noterit ose pranë KQZ-së. Sipas përlllogaritjeve të kërkuesit, rezulton se për të marrë nënshkrimet e 10.000 zgjedhësve përpara noterit duhen të paktën 15 milion lekë të reja, vetëm për pagesën te noterit. Gjithashtu, edhe në lidhje me depozitimin e kërkesave

në KQZ, duhet që 10.000 zgjedhës të vijnë nga dhjetëra kilometra larg për të nënshkruar listën përkatëse. Duke qenë se një pjesë e mirë e zgjedhësve potencialë të kësaj partie gjendet me banim në zonat rurale të vendit, ardhja e tyre për të nënshkruar pranë noterit në qytet ose përpara KQZ-së në Tiranë është një shpenzim i konsiderueshëm dhe i papërbalueshëm, po të merret parasysh edhe se shtresa e pensionistëve është një ndër shtresat më në nevojë aktualisht.

3.3 Duke vendosur një parakusht të tillë, ligjvënësi ka bërë një diskriminim ndërmjet partive që përfaqësohen me deputetë në Kuvend (të cilëve nuk iu kërkohet plotësimi i këtyre kushteve) dhe atyre që nuk përfaqësohen. Në diferencimin ndërmjet subjekteve politikë ndikon edhe fakti që partitë parlamentare, pikërisht për shkak të përfaqësimit në Kuvend, ndihmohen edhe financiarisht me fonde publike nga shteti me rastin e nisjes së fushatës zgjedhore.

3.4 Rregullim ligjor ka efekte kufizuese për pluralizmin politik në vend, pasi konsolidon pushtetin e një grupi partish aktuale, ndërsa vështirëson zhvillimin e subjekteve të reja politike.

4. *Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë*, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke pretenduar se:

4.1 Pamundësia për të marrë pjesë në zgjedhje për kërkuesin nuk ka ardhur për sa ai pretendon, por për shkak se është regjistruar si parti politike në datë 24.04.2009. Për këtë arsye, ky subjekt politik nuk është regjistruar brenda afatit 60 ditor të parashikuar nga neni 64 i Kodit Zgjedhor. Rrjedhimisht, në mungesë të shkakut të pretenduar, kërkuesi nuk legjitimohet të ngrejë kërkesë si subjekt i parashikuar nga shkronja "f" e nenit 134, pika 1 e Kushtetutës.

4.2 Detyrimi për mbledhjen e një numri të caktuar nënshkrimesh për të paraqitur kandidaturën është sanksionuar në frymën e Udhëzimeve të Raportit Shpjegues të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, sipas të cilit ky detyrim është në pajtueshmëri me parimin e votimit të përgjithshëm dhe, si rrjedhojë, edhe me parimin e sovranitetit popullor, i cili buron nga parimi i zgjedhjeve të përgjithshme. Sipas këtyre udhëzimeve, mbështetja nga nënshkrimet e mbledhura duhet të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të barabartë për të gjitha subjektet dhe përjashtimet duhet të jenë të bazuara në suksesin e mëparshëm zgjedhor, qoftë dhe me një mandat të fituar.

4.3 Pretendimi se nënshkrimi në KQZ ose përpara noterit përbën një kufizim është i gabuar, pasi kryerja e nënshkrimit në një nga format e mësipërme është një detyrim ligjor, përmbushja e të cilit zhduk mundësinë e manipulimit dhe të falsifikimit të dokumentacionit, për të mos cenuar standardet për zgjedhje të ndershme.

4.4 Detyrimi ligjor për depozitimin e nënshkrimit individualisht përpara një noteri ose në KQZ vendoset në ligjin zgjedhor në kushtet e procesit të integritit në Bashkimin Europian, si një domosdoshmëri për përmbushjen e detyrimit për dokumentacion të rregullt me çdo kusht dhe pa asnjë pretendim, aq më tepër kur gjithçka bëhet në pajtueshmëri dhe në zbatim të ligjeve.

5. *Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave*, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke pretenduar se:

5.1 Kërkuesi nuk legjitimohet për të iniciuar këtë gjykim kushtetues, pasi partitë janë subjekte që në respekt të nenit 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës kanë legjitimitet të kufizuar, vetëm në lidhje me çështje që lidhen me interesat e tyre. Një gjë e tillë nuk rezulton e provuar për këtë subjekt politik.

5.2 Kodi Zgjedhor parashikon se depozitimi në mënyrë individuale i nënshkrimit mund të bëhet edhe përpara KQZ-së, procedurë kjo që nuk ka kosto financiare. Gjithashtu, deklarata noteriale përpara noterit mund të bëhet në mënyrë të grupuar nga ana e zgjedhësve, çka do t'i reduktonte shpenzimet noteriale vetëm në vlerën e një akti të vetëm;

5.3 Pretendimi për shkelje të barazisë përpara ligjit (neni 18/1 i Kushtetutës) është i pabazuar. Në nenin 71 të Kodit Zgjedhor nuk ka diskriminim për arsye ekonomike pasi procedura e nënshkrimit nuk ka kosto financiare. Kriteri i pjesëmarrjes në Kuvend, i pretenduar nga kërkuesi, nuk përbën shkak për diskriminim të padrejtë, sepse lidhet me aftësitë dhe meritat e një partie politike. Parimi i mosdiskriminimit nuk mund të nënkuptojë barazi absolute trajtimi, sepse ligji zgjidh në mënyrë të ndryshme situata të ndryshme.

5.4 Parashikimi ligjor për mbështetjen e listës së kandidatëve nga 10000 zgjedhës është rrjedhojë e ndryshimit të sistemit zgjedhor.

II

A.Pretendimi në lidhje me legjitimitimin e kërkuesit.

6. Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) vlerëson që, përpara se të ndalet dhe të analizojë pretendimet e kërkuarit në lidhje me thelbin e çështjes, duhet t'i japë përgjigje pretendimit të përfaqësuesve të subjekteve të interesuar për legjitimitimin e kërkuarit.

7. Gjykata vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*. Ai është person juridik i regjistruar si parti politike në bazë të ligjit. Sipas nenit 134/f të Kushtetutës, "*partitë politike*" janë subjekte që mund të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për çështje që lidhen me interesat e tyre. Në këtë rast bëhet fjalë për pjesëmarrje në kërkuarit në zgjedhjet e përgjithshme, çka është plotësisht në misionin, qëllimin dhe interesin kryesor të një partie politike, pasi vetëm përmes pjesëmarrjes në procesin zgjedhor një parti mund të marrë mbështetjen formale nga zgjedhësit dhe të mundësojë pjesëmarrjen e kandidatëve të saj në Kuvend. Në këtë mënyrë ajo mund të realizojë që programi i saj politik të jetë një program qeverisës.

8. Kërkuari legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur këtu brenda afatit të parashikuar nga ligji organik i kësaj Gjykate nr.8577, datë 10.02.2000.

9. Përsa i përket legjitimitit *ratione materiae*, Gjykata vlerëson se është rasti të ritheksojë qëndrimin e saj se në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet funksionit e veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Partitë politike janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës si një ndër subjektet që e ushtrojë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Ato kanë legjitimitet kushtetues vetëm për ato çështje që lidhen me interesat e tyre. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, partitë politike paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit. Partitë politike në sistemin e zgjedhjeve e veçanërisht në procesin zgjedhor, që nga fushata parazgjedhore, paraqitja e kandidatëve, formimi i trupave zgjedhore, ndjekja e zgjedhjeve e deri te ndarja e

mandateve, paraqiten si një faktor përcaktues shumë i rëndësishëm. Prandaj, demokracia përfaqësuese, ashtu edhe sistemi i zgjedhjeve nuk mund të paramendohen pa ekzistencën dhe funksionimin e partive politike. Ky pozicion i veçantë që partitë politike kanë në raport me zgjedhjet, përcakton njëkohësisht dhe interesin e tyre për të pasur një legjislacion dhe rregulla sa më të qartë e të drejtë (*Shih vendimin nr.1, datë 07.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi bazën e këtij arsyetimi, Gjykata vlerëson legjitimitimin e kërkuarit në rastin në shqyrtim.

B. Në lidhje me pretendimet e kërkuarit

10. Kërkuari pretendon se nenet 68 dhe 71 të Kodit Zgjedhor cenojnë të drejtën e tij kushtetuese *për zgjedhje të barabarta*, të sanksionuar nga neni 1, pika 3 e Kushtetutës dhe parimin e pluralizmit, si një nga bazat e shtetit, sanksionuar nga neni 3 i Kushtetutës. Në rastin në shqyrtim, duke qenë se, sipas kërkuarit rregullimi ligjor në fjalë ka efekte kufizuese për pluralizmin politik në vend, pasi konsolidon pushtetin e një grupi të caktuar partish aktuale dhe vështirëson zhvillimin e subjekteve të reja politike, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit duhet të analizohen të pashkëputura nga njëri-tjetri.

11. Gjykata thekson se pluralizmi është një tërësi rrethanash ku pushteti politik është i shpërndarë në atë mënyrë që asnjë grup interesi ose klasë e caktuar shoqërore të mos mbizotërojë mbi të tjerët. Kushti bazë për pluralizmin janë zgjedhjet e lira, shumësia e interesave, lejimi i hapësirave për organizimin e mekanizmave të presionit ndaj organeve të pushtetit dhe një shtet që është i përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve. Në çdo sistem demokratik, përfaqësuesit e popullit në qeverisje zgjidhen përmes zgjedhjeve shumëpartiake, *të lira, të barabarta dhe të ndershme*. Pushteti i përfaqësuesve kufizohet nga kushtetuta dhe mekanizma të tjerë të balancimit dhe kontrollit të pushteteve. Problemet e përfaqësimit të drejtë janë çështje të shanseve të barabarta që zëri i gjithkujt të dëgjohet apo të jetë i përfaqësuar. Sidoqoftë, është e lejueshme që një shtet demokratik, nëse ekzistojnë arsye serioze, të vendosë në mekanizmat e procesit zgjedhor disa elemente nxitëse të integritetit shoqëror. Nga ana tjetër, një sistem zgjedhor proporcional i pakufizuar mund të rezultojë në ndarjen e votave të qytetarëve ndërmjet një numri shumë të madh partish politike dhe,

për pasojë, në një kërcënim për funksionimin dhe vazhdimësinë e sistemit parlamentar, në kuptim të kapaciteteve për të arritur në një vendimmarrje brenda tij (Shih më gjerë vendimin e Gjykatës Kushtetuese Çeke (CZE-2005-1-001– referuar nga baza e të dhënave *Codices* të Komisionit të Venecias).

12. Neni 3 i Kushtetutës parashikon *pluralizmin* si një nga bazat e shtetit, ndërsa neni 1, paragrafi 3 i saj sanksionon *parimin e barazisë së votës*. Ky parim ka komponentin e tij *aktiv* (e drejta për të votuar) dhe atë *pasiv* (e drejta për t'u votuar/zgjedhur). Gjykata thekson se parimi i barazisë së të drejtës për t'u votuar/zgjedhur ndalon shtetin të diskriminojë ose të privilegjojë kandidatë të caktuar, parti politike ose grupe të tjera politike në përballjen konkurruese për të tërhequr votën e zgjedhësit. Sipas Udhëzimeve të Raportit Shpjegues të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias barazia në çështjet zgjedhore përfshin shumë aspekte (Shih më gjerë Dokumentin CDL-AD (2002) 23 rev. Miratuar nga Komisioni i Venecias në Mbledhjen e tij të 52-të Plenare (Venecia, 18-19 Tetor 2002). Parimet që duhen respektuar në të gjitha rastet janë *barazia në votën numerike, barazia për sa i përket fuqisë zgjedhore dhe mundësive të barabarta*.

13. Duke iu referuar këtyre standardeve të gjithëpranuara, Gjykata çmon se *barazia në të drejtat për votim* kërkon që çdo votues të ketë normalisht të drejtën e një vote dhe të votojë vetëm njëherë. *Barazia në fuqinë për votim*, në rastin kur zgjedhjet nuk zhvillohen vetëm në një zonë të vetme zgjedhore, kërkon që kufijtë midis zonave zgjedhore të hartohen në një mënyrë të tillë që mandatet në *dhomën më të ulët*, që përfaqëson popullin, të shpërndahen në mënyrë të barabartë midis zonave zgjedhore, në përputhje me kriterin e veçantë të proporcionalitetit, p.sh. numri i banorëve në zonën zgjedhore, numri i banorëve vendas (duke përfshirë minorenët), numri i zgjedhësve të regjistruar ose mundësisht numri i njerëzve që kanë votuar faktikisht. Mund të jetë i mundur edhe një kombinacion i përshtatshëm i këtyre kriterëve. Të njëjtat rregulla zbatohen edhe për zgjedhjet rajonale dhe vendore.

14. Gjykata vlerëson se midis partive dhe kandidatëve duhet të krijohen shanse të barabarta dhe shteti duhet të jetë i paanshëm ndaj tyre, duke zbatuar ligjet në mënyrë të njëjtë për

të gjithë. Në veçanti, kërkesa për asnjësi zbatohet për fushatën zgjedhore dhe mbulimin nga media, veçanërisht media publike, si dhe për financimin publik të partive dhe fushatave, e cila mund të realizohet si në formën e një barazie “strikte”, ashtu dhe të barazisë “proporcionale”. Sipas barazisë “strikte”, partitë politike trajtohen pa marrë në konsideratë forcën e tyre aktuale në Kuvend ose të zgjedhësve, ndërsa sipas barazisë “proporcionale”, trajtimi i partive bëhet në raport me numrin e votave. Parimi i shanseve të barabarta (strikte dhe/ose proporcionale) zbatohet në veçanti për mbulimin në radio dhe televizion, fondet publike dhe forma të tjera mbështetjeje. Disa forma mbështetjeje mund t’u nënshtrohen, nga një anë, barazisë strikte dhe, nga ana tjetër, barazisë proporcionale.

15. Në koncept, parimi i konkurrimit të lirë të partive politike përfshin detyrimin e shtetit për të respektuar shanset e barabarta të të gjitha partive dhe zbatohet në legjislacionin që rregullon kushtet e këtij konkurrimi, si dhe në konfliktet ndërmjet pjesëmarrësve në të. Duke qenë se një efekt i tillë ndikon në respektimin e parimit të barazisë, Gjykata vlerëson se çfarëdolloj ndërhyrjeje nga ligjvënësi mbi këto kushte duhet të udhëhiqet nga interesi publik. Ligjvënësi e ka të ndaluar të trajtojë palët në mënyrë të dallueshme nga njëra-tjetra, përveçse kur ekzistojnë arsye të forta përjashtimore për ta bërë këtë.

16. Neni 68 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” parashikon që *listat e kandidatëve për Kuvendin, të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, duhet të mbështeten nga jo më pak se 10000 zgjedhës* (bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit). Sipas rregullimit të prezantuar nga Kodi Zgjedhor, përveç rritjes së numrit të nënshkruesve nga 7000 zgjedhës, që parashikonte Kodi Zgjedhor pararendës në 10000 të tillë, është ndryshuar edhe procedura e mbledhjes së nënshkrimeve, e cila më parë, realizohej nga vetë partitë kandidate, përmes anëtarëve ose simpatizantëve të tyre. Aktualisht, sipas nenit 71 të ligjit të ankimuar, *zgjedhësit depozitojnë në mënyrë individuale nënshkrimet e tyre për mbështetjen e kandidatit të propozuar nga një grup zgjedhësish apo për partitë dhe koalicionet në KQZ apo përpara noterit.*

17. Nga përfaqësuesit e subjektit të interesuar, Kuvendit, në parashtrimet dërguar Gjykatës, ndërsa nuk argumentohet në vetvete në mënyrë të detajuar arsyeja e rritjes së numrit të nënshkruesve nga njëri Kod Zgjedhor në tjetrin, mbahet qëndrimi se “detyrimi për mbledhjen e një numri të caktuar firmash për të paraqitur kandidaturën është sanksionuar në frymën e Udhëzimeve dhe Raportit Shpjegues të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, sipas të cilit ky detyrim është në pajtim me parimin e votimit të përgjithshëm dhe, si rrjedhojë, edhe me parimin e sovranitetit popullor nga i cili buron parimi i zgjedhjeve të përgjithshme. Sipas këtyre udhëzimeve, mbështetja nga nënshkrimet e mbledhura duhet të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të barabartë për të gjitha subjektet dhe përjashtimet duhet të jenë të bazuara në suksesin e mëparshëm zgjedhor, qoftë dhe me një mandat të fituar.”

18. Duke iu referuar Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore (Udhëzime dhe Raporti Shpjegues) rezulton i parashikuar formulimi: “8. Detyrimi për të mbledhur një numër të caktuar *firmash* për të paraqitur kandidaturën është teorikisht në përputhje me parimin e votimit universal. Në praktikë, vetëm partitë shumë të vogla duket se kanë vështirësi për të mbledhur numrin e caktuar të nënshkrimeve. Ky detyrim nuk duhet të pengojë kandidatët të vendosin kandidaturat e tyre. Me qëllim që të parandalohet një manipulim i tillë, është e preferueshme që ligji të caktojë një kërkesë maksimale firmash prej 1%. Procedura e verifikimit të nënshkrimeve duhet të bëhet mbi bazën e rregullave të qarta, veçanërisht për sa i përket afateve kohore, dhe duhet zbatuar për të gjitha nënshkrimet dhe jo vetëm për një kampion të tyre; megjithatë, kur nga verifikimi është vërejtur, përtej çdo dyshimi, se numri i kërkuar i nënshkrimeve është arritur, nuk është e nevojshme të verifikohen nënshkrimet e tjera.” (Shih më gjerë në *CDL-INF (2000) 17, f. 4-5; CDL (99) 67, f 7-8.*)

19. Në analizën e këtyre dokumenteve dhe të Kodit Zgjedhor (2008) (Shih matricat që pasqyrojnë numrin e zgjedhësve në zonat e administrimit zgjedhor bashkëngjitur këtij Kodi, si dhe nga dokumentacioni statistikor i shfaqur në faqen zyrtare në internet të KQZ-së), Gjykatës i rezulton se shifrës së sipërcituar prej 1% i

korrespondon një numër që varion nga zona në zonë, si p.sh., në qarkun e Tiranës do të ishte për afërsisht 7000 zgjedhës/nënshkrues.

20. Nga një vështrim krahasues i legjislacioneve të vendeve të tjera, Gjykatës i rezulton se, sipas Ligjit Zgjedhor Federal të R.F.Gjermane (*Bundewahlgesetz*), (neni 27) “në rastin e partive politike të përmendura në nenin 18/2, ato duhet të jenë nënshkruar nga 1/1000 të personave me të drejtë vote në Land në zgjedhjet e fundit të Bundestag-ut, por jo më shumë se 2.000 persona me të drejtë vote.” Pra, në rastin gjerman, minimumi i nënshkrimeve është 0.1% (1/1000,) ndërsa maksimumi 2.000 vetë. Nënshkrimet nuk realizohen përpara ndonjë autoriteti (kushdo qoftë), ndërkohë që ka një përjashtim për partitë që përfaqësojnë minoritetet. Për numrin e nënshkrimeve të nevojshme për regjistrimin e partive politike në zgjedhjet parlamentare në Republikën Italiane, ligji n. 270, 21 dhjetor 2005 “Ndryshime në normat për zgjedhjen e Dhomës së Deputetëve dhe të Senatit të Republikës” parashikon: “Deklarata sipas paragrafit 1 duhet të jetë e nënshkruar: c) nga të paktën 3.500 dhe jo më shumë se 5.000 zgjedhës të regjistruar në listat zgjedhore të bashkive të përfshira në rajonet me më shumë se 1.000.000 banorë.” Sipas legjislacionit italian, listat, duke qenë se janë strukturuar sipas rajoneve, paraqiten për autentifikim “për çdo rajon në sekretarinë e gjykatës së apelit ose të gjykatës ku ka selinë zyra zgjedhore rajonale” dhe jo në një strukturë qendrore. Në zyrat e mësipërme që verifikojnë ligjshmërinë e listave, verifikohet vetëm nënshkrimi i përfaqësuesit partiak (qoftë ky presidenti, sekretari i partisë ose i grupit politik, ose një nga përfaqësuesit e tjerë sipas ligjit) dhe jo ajo e zgjedhësve. Sipas legjislacionit zgjedhor të Mbretërisë së Spanjës (Ley Orgánica 5/1985, de 19 de Junio, Del Régimen Electoral General), rregullimi, për sa më sipër, është shumë i ngjashëm me atë italian, ku listat mbështetëse të partive konkurruese nënshkruhen në bazë rajoni dhe variojnë nga 100 deri në 8000 nënshkrues (këta të fundit në zona me mbi 1.000.000 banorë).

21. Në të dy rastet e parashikuara nga Kodi Zgjedhor, si përpara noterit ashtu edhe në KQZ, rezulton se është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e aktit paraqitja individuale e personit nënshkrues. Sipas nenit 55 të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për Noterinë”: “Vërtetimi i nënshkrimeve bëhet për akte private që nuk

përmbajnë lidhjen e një kontrate ose kryerjen e një veprimi tjetër juridik. Vërtetimi bëhet në fund të aktit, pas nënshkrimeve, duke u bërë shënimi nga noteri se personat u paraqitën personalisht dhe nënshkruan në prani të tij ose pranuan se nënshkrimet janë të tyre. Vërtetimi i nënshkrimeve në kushte të caktuara me ligj mund të bëhet edhe nga organe shtetërore.” Kushti për depozitimin e nënshkrimeve individualisht përpara një noteri ose në KQZ argumentohet nga përfaqësuesit e subjektit të interesuar, Kuvendit, me proceset e integritimit në Europë si një domosdoshmëri për “përmbushjen e detyrimit për dokumentacion të rregullt me çdo kusht dhe pa asnjë pretendim, aq më tepër kur gjithçka bëhet në përputhje dhe në zbatim të ligjeve të shtetit.” Edhe në hipotezën e sugjeruar nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, se të 10.000 nënshkruesit do të paraqiteshin përpara të njëjtit noter – situatë që do të shmangte problemin financiar të PBPSH-së, pasi pagesa do të ishte vetëm një (1500 lekë me tarifat aktuale të miratuara nga Ministria e Drejtësisë), Gjykata thekson se mbetet i pazgjidhur problemi i organizimit, kostoja e transportit dhe kosto të tjera që detyron një kusht i tillë, pasi nënshkruesit do të duhet të udhëtojnë nga zona të ndryshme, çka e barasvlerëson këtë zgjidhje me atë të paraqitjes në KQZ. Nga ana tjetër, Gjykata vlerëson se ka një disproporcion nga pikëpamja e interesit, ndërmjet rregullimit të parashikuar nga Kodi Zgjedhor dhe ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike”, i cili në nenin 10 parashikon: “Kërkesa për regjistrimin e një partie politike duhet të nënshkruhet nga jo më pak se 500 shtetas shqiptarë, anëtarë themelues të saj, me vendbanim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.”

22. Gjykata çmon se nga ana e përfaqësuesve të subjektit të interesuar, Kuvendit, nuk u ofruan argumente të qëndrueshme lidhur me interesin publik që ka nxitur ligjvënësin të rrisë numrin e individëve nënshkrues/mbështetës nga 7000 që parashikohej në Kodin Zgjedhor të vitit 2003, në 10000 në Kodin Zgjedhor, objekt shqyrtimi. Në një aspekt, kjo rritje justifikohet me bashkëpunimin e partive të vogla (të reja) me ato të mëdha (të vjetra), të cilat kanë mjaftueshëm deputetë në Kuvend, për të mundur edhe regjistrimin e partive që e kanë të pamundur ose të vështirë mbledhjen e një numri kaq të lartë nënshkrimesh. Kjo lëvizje mund të ketë nga njëra anë efektin e vet pozitiv, në drejtim të formatimit të koalicioneve parazgjedhore, të cilat mund të sjellin një trupë

legjislative më të qëndrueshme, por nga ana tjetër, në vlerësimin e Gjykatës, *de facto* përbën një formë detyrimi ndaj partive të vogla për t'iu nënshtruar partive të mëdha.

23. Gjykata vlerëson se zgjedhjet kanë si objektiv të mundësojnë zgjedhësit të zgjedhin përfaqësuesit e tyre, por edhe të sjellin një Kuvend me shumicë të qëndrueshme, që në vijim të mund të prodhojnë legjislacion dhe të mundësojnë një qeverisje efektive. Një sistem proporcional, tërësisht i pakufizuar përballë partive të vogla, mund të ketë potencialisht pasoja destabilizuese¹. Trajtimi i pabarabartë i partive, duke dalluar ndërmjet tyre partitë brenda dhe jashtë Kuvendit, bëhet për mbrojtjen e votuesit nga shpërdorimi i votës. Gjykata vlerëson se është “një vullnet i ligjshëm i legjislatorit të kërkojë mbrojtjen e votuesit, në mënyrë që ai të mos ia japë votën një kandidati ose oferte të pashpresë. Një sistem zgjedhor që mundëson oferta zgjedhore mund të funksionojë vetëm nëse paraqitja e një oferte nuk është thjesht e drejta e gjithkujt, pa asnjë përgjegjësi të mëtejshme. Vetëm një ofertë që merret seriozisht është një ofertë me kuptim. Numri i nënshkrimeve që duhet të mblidhen sigurisht që mbetet një atribut i ligjvënësit për ta përcaktuar, por ky përcaktim duhet të jetë i drejtë. Gjykata vlerëson se ky numër nënshkruesish nuk duhet të jetë “aq i ulët sa të lejojë gjithkënd të marrë pjesë në konkurrim..., por edhe të mos jetë aq i lartë sa ta bëjë praktikisht të pamundur apo të vështirë për një parti të re pjesëmarrjen në zgjedhje” (Shih më gjerë vendimin e shkurtit të vitit 1956 për ligjin zgjedhor të Baden-Württemberg, të Gjykatës Kushtetuese Gjermane; *Entscheidungen des Bundesverfassungsgerichts*. Volume 4, pp.381-384.) Konkurrimi i lirë ndërmjet partive është një shfaqje e drejtpërdrejtë e natyrës pluraliste të shoqërisë demokratike dhe është pikërisht mbrojtja e pluralizmit në jetën politike që ka kuptim për vetë ekzistencën e kësaj shoqërie. Gjykata thekson se çdo kufizim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë mbi barazinë e partive në konkurrimin zgjedhor nuk duhet të ketë një pasojë diferencuese ose të përbëjë një trajtim preferencial për disa parti, ose të ndalojë pjesëmarrjen e partive politike në konkurrimin zgjedhor².

24. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar: “ ... është tepër e rëndësishme për çdo shtet të së drejtës që zbaton rregullat e një shoqërie demokratike, të gëzojë hapësira të konsiderueshme

1. *Entscheidungen des Bundesverfassungsgerichts*. Volume 1, pp.247-248.

2. CZE-2000-1-002(Codices).

për të përcaktuar rregulla dhe kritere të drejta brenda rendit të tij kushtetues, në përputhje me kushtet konkrete si dhe me faktorët e ndryshëm politikë, historik, social, kulturor, tradicional, të cilët janë tepër përcaktues. [...]. Ligjvënësi ka hapësirë veprimi për të vlerësuar vet duke parashikuar në ligj kritere të tilla që i përgjigjen në realitet dhe objektivisht parimit të barazisë së votave dhe përfaqësimit të barabartë. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese nuk është që të vihet në rolin e ligjvënësit pozitiv dhe të përcaktojë rregullimet ligjore, por të kontrollojë nëse zgjidhja që jep ligjvënësi nëpërmjet përcaktimeve të kritereve ligjore [...] është ose jo në përputhje me dispozitat e Kushtetutës” (Shih më gjerë vendimin nr.1, datë 07.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

25. Nga analiza e dispozitave objekt shqyrtimi, Gjykata arrin në përfundimin se gjendemi përpara një kufizimi të pjesëmarrjes në mënyrë të barabartë të partive në zgjedhje. Ky kufizim, për rrjedhojë, ka ndikimin e tij negativ edhe për funksionimin e pluralizmit, parim i mbrojtur nga neni 3 i Kushtetutës. Gjykata vlerëson se nuk ka asnjë arsye të dukshme kushtetuese për të krijuar një dallim të këtij dimensionit (joproporcional) ndërmjet partive politike, kandidatët e të cilave janë zgjedhur në Kuvend (partitë parlamentare) dhe partive të tjera (joparlamentare), çka realisht bëhet përmes neneve 68 e 71 të Kodit Zgjedhor (2008).

Gjykata vlerëson se një rregullim i tillë, duke qenë joproporcional, nuk mund të justifikohet me ndonjë interes publik, me pengimin e fragmentarizmit të tepruar të partive politike, por dhe as me synimin për të siguruar kandidatura serioze në zgjedhje ose përjashtimin e atyre që nuk kanë mundësi suksesi. Përmes këtij rregullimi, ligjvënësi krijon pabarazi ndërmjet partive politike për një konkurrim të drejtë ndërmjet tyre.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar te neni 131, shkronja “a” i Kushtetutës, si dhe te nenet 49, 50, 51, 72 e 76 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1.Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 68 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të fjalisë: “Listat e kandidatëve për Kuvendin, të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, duhet të mbështeten nga jo më pak se 10000 zgjedhës.”

2.Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 71 të Kodit Zgjedhor, të fjalisë: “Zgjedhësit depozitojnë në mënyrë individuale nënshkrimet e tyre për mbështetjen e kandidatit të propozuar nga një grup zgjedhësish apo për partitë dhe koalicionet e parashikuara në nenet 68 dhe 69 të këtij Kodi në KQZ apo përpara noterit.”

3.Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

* * *

Vendim nr. 28, datë 09.05.2012

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Vladimir Kristo, Xhezair Zaganjori, Petrit Pllloçi, Vitore Tusha, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Admir Thanza, Altina Xhoxhaj, anëtarë, me sekretare Enina Mullaj, në datën 14.07.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 31/9 Akti, që i përket:

KËRKUES: **PARTIA BASHKIMI POPULLOR I
PENSIONISTËVE SHQIPTARË,
përfaqësuar nga kryetari i saj
Selami Jenishehri.**

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KUVENDI I REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË,**
përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj dhe Arjeta
Çefa, me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE,
përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari,
me autorizim.

O B J E K T I:

- Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i neneve 69, 70 dhe 87 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”;
- Pezullimi i ekzekutimit të zbatimit të neneve 68, 70 dhe 87 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 1/3, 3, 131/a dhe 134/1/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 49, 50 dhe 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes Altina Xhoxhaj, përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, ka miratuar Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Në nenin 69 të këtij Kodi parashikohet se: *“1. Një grup zgjedhësish në një zonë zgjedhore kanë të drejtë të propozojnë një kandidat për atë zonë zgjedhore, i cili përmbush kushtet e përcaktuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës dhe ato të përcaktuara në këtë Kod, jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve. 2. Kandidati i propozuar nga një grup zgjedhësish nuk mund të jetë pjesë e asnjë partie apo koalicioni që konkurron në zgjedhje dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurron në zgjedhje. 3.*

Për paraqitjen e një kandidati nga zgjedhësit, krijohet një komitet nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë të ngarkuar të organizojnë punën për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin, sipas këtij Kodi. Jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve komiteti nismëtar regjistrohet në KQZ, duke paraqitur emrat e anëtarëve të komitetit. Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për deputet vetëm në rast se ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon jo më pak se 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, sipas procedurave të përcaktuara në Kod.”

2. Në nenin 70 të Kodit Zgjedhor parashikohet se: “1. Një grup zgjedhësish me banim në zonën zgjedhore kanë të drejtë të propozojnë një kandidat për kryetar të bashkisë apo komunës dhe/ose një kandidat për këshillin vendor, jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve. 2. Kandidati i propozuar nga një grup zgjedhësish nuk mund të jetë pjesë e asnjë partie apo koalicioni që konkurren në atë zonë zgjedhore dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurren në atë zonë zgjedhore. 3. Për paraqitjen e kandidatit nga zgjedhësit, krijohet një komitet nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë të ngarkuar për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin. Jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, komiteti nismëtar regjistrohet në KZAZ, duke paraqitur emrat e anëtarëve të komitetit. Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për kryetar të bashkisë apo komunës vetëm nëse ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon jo më pak se 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, sipas procedurave të përcaktuara në këtë Kod. 4. Kandidatët e partive politike për kryetar të njësisë të qeverisjes vendore apo listat shumemërore të partive për këshillat vendorë, përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nëse të paktën një anëtar i partisë përkatëse zotëron një mandat në Kuvend ose në këshillin, për të cilin partia politike kandidon në zgjedhje. Për qëllim të këtij Kodi, partia politike paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësisia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit. 5. Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nëse janë kryetarë bashkie a komune. 6. Partitë politike përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3

të këtij neni, nëse partia përkatëse zotëron një mandat në Kuvend ose në këshillin, për të cilin partia politike kandidon në zgjedhje. Për qëllim të këtij Kodi, partia politike paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit.”

3. Në nenin 87 të Kodit Zgjedhor parashikohet se: “1. Subjektet zgjedhore përfitojnë financime nga fondet publike, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod. Sasia e fondeve publike që do t’u shpërndahen subjekteve zgjedhore caktohet me vendim të Kuvendit së bashku me buxhetin e zgjedhjeve, sipas nenit 86 të këtij Kodi. 2. Sasia e fondeve publike që i shpërndahet secilit prej subjekteve zgjedhore caktohet me vendim të KQZ-së, sipas rregullave të mëposhtme: a) 50 për qind e shumës ndahet ndërmjet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore dhe që kanë mandate në Kuvend, e përcaktuar kjo sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve pararendëse. Kjo shumë u jepet këtyre partive politike nga KQZ-ja jo më vonë se 5 ditë pas regjistrimit të tyre si subjekt zgjedhor dhe paraqitjes së listës shumëmemërore për çdo zonë zgjedhore. Shuma shpërndahet mbi bazën e numrit të mandateve të fituara në zgjedhjet për Kuvendin; b) 50 për qind e shumës së përgjithshme ndahet midis partive politike të regjistruara si subjekt zgjedhor dhe që në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin kanë marrë jo më pak se 2 vende në Kuvend, në raport me votat e marra prej tyre në shkallë kombëtare, sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve pararendëse. 3. Partia që ka përfituar fonde publike, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni dhe që nuk fiton asnjë mandat nga zgjedhjet e radhës, duhet të kthejë shumën përkatëse të përfituar. Depozitimi i këtyre shumave bëhet në llogarinë bankare të KQZ-së. Kthimi i fondeve bëhet jo më vonë se 30 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Në rast të mospërmbushjes së këtij detyrimi, pa shkaqe të përligjura, KQZ-ja i kërkon Ministrin të Financave që të urdhërojë Zyrën e Thesarit që këto shuma t’i mbajë nga fondet e tjera buxhetore që përfitojnë këto parti dhe t’i kalojë ato në buxhetin e KQZ-së. 4. Partia, e cila nuk kthen fondet përkatëse sipas pikës 3 të këtij neni, humbet të drejtën e financimeve të tjera nga fondet publike për një periudhë kohe jo më pak se 5 vjet, si dhe nuk regjistrohet si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e radhës, pavarësisht llojit të tyre, as vetëm dhe as si

pjesëtare e ndonjë koalicioni. 5. Fondet e kthjera, sipas pikës 3 të këtij neni, me vendim të KQZ-së, u rishpërndahen partive politike, të cilat kanë marrë vende në Kuvend. Shpërndarja bëhet në përqindje të njëjtë me përqindjen e vendeve të fituara në zgjedhjet e radhës. Vendimi merret nga KQZ-ja jo më vonë se 30 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. 6. Në rast se fondi, sipas pikës 4 të këtij neni, nuk është kthyer plotësisht nga subjektet zgjedhore, ky fond i kompensohet KQZ-së nga Buxheti i Shtetit. 7. KQZ-ja nxjerr udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij neni.”

4. Dispozitat e sipërcituara janë kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) nga kërkuesi, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë (PBPPSH), i cili parashtrohet, në thelb, këto shkaqe për të mbështetur kërkesën e tij:

i. Nenet 69 dhe 70 të Kodit Zgjedhor mbajnë një qëndrim favorizues ndaj partive që përfaqësohen me deputetë në Kuvend dhe qëndrim diskriminues ndaj partive të reja që nuk përfaqësohen, gjë që bie në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës. Kjo sepse një parti që hyn për herë të parë në zgjedhje, të përgjithshme ose vendore, ose që nuk zotëron mandat në Kuvend, i nënshtrohet një procedure jo vetëm të gjatë por dhe që kërkon fonde, duke krijuar disavantazh për këto subjekte zgjedhore.

ii. Bazuar në nenet 69 dhe 70 të Kodit Zgjedhor, partitë e reja nuk mund të garojnë të vetme por detyrimisht duhet të bëjnë pjesë në një koalicion zgjedhor. Këto kushtëzime apo kufizime që i bëhen pjesëmarrjes së një subjekti të ri politik në garën elektorale janë barriera për çdo subjekt të ri politik dhe cenojnë të drejtën kushtetuese të barazisë në zgjedhje, të parashikuar në nenin 1/3 të Kushtetutës. Kufizimet e pjesëmarrjes së barabartë të partive në zgjedhje kanë ndikimin e tyre negativ edhe për funksionimin e pluralizmit, të sanksionuar në nenin 3 të Kushtetutës.

iii. Neni 87 i Kodit Zgjedhor parashikon përfitimin e financimeve nga fondet publike vetëm për partitë politike parlamentare, duke krijuar një situatë diskriminuese për subjektet e tjera zgjedhore që nuk janë parti parlamentare. Për shpërndarjen e fondeve, për përgatitjen e zhvillimit të zgjedhjeve, nuk parashikohen fare partitë e vogla, në një kohë që në nenin 86/2 të Kodit Zgjedhor përcaktohet qartë qëllimi i këtij fondi për përgatitjen, zhvillimin, mbikëqyrjen dhe çdo aspekt të procesit zgjedhor. Edhe ky kufizim që i bëhet një subjekti të ri politik në garën elektorale bie në kundërshtim me

të drejtën kushtetuese të barazisë në zgjedhje, të parashikuar në nenin 1/3 të Kushtetutës.

5. Subjekti i interesuar, Kuvendi, parashtrroi në mënyrë të përmbledhur se:

5.1 Për legjitimitimin e kërkuarit:

- Në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës kërkuari ka detyrimin kushtetues të provojë lidhjen e domosdoshme ndërmjet funksionit dhe veprimtarisë që kryen dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Në rastin objekt shqyrtimi kërkuari kërkon shfuqizimin e dy neneve (69 dhe 70) që nuk kanë lidhje me regjistrimin e partive politike, por që përcaktojnë procedurat e regjistrimit të kandidatëve të pavarur dhe, në këto kushte, ky objekt i kërkesës nuk ka lidhje me interesat e kërkuarit.

5.2 Për themelin e kërkesës

- Në rastin në shqyrtim ndodhemi para "gjësës së gjykuar". Me vendimin nr.32, datë 21.06.2010 Gjykata ka trajtuar kushtetutshmërinë e neneve 68 dhe 71 të Kodit Zgjedhor dhe ka shprehur qëndrimin e saj lidhur me to, duke konstatuar se është cenuar parimi i barazisë në zgjedhje, si rrjedhojë e përcaktimit të numrit të zgjedhësve që duhej të mbështesnin kandidatin e pavarur ose listën e kandidatëve të partive politike që nuk zotëronin asnjë mandat në Kuvend. Në kërkesën objekt shqyrtimi kundërshtohet pikërisht përcaktimi i vendosur nga ligjvënësi në lidhje me numrin e zgjedhësve të zonës zgjedhore për efekt të regjistrimit të subjekteve zgjedhore, në nenet 69 dhe 70 të Kodit Zgjedhor. Nga krahasimi i dy kërkesave konstatohet se pretendimet dhe baza ligjore e tyre janë identike. Qëllimi është i njëjtë dhe bëhet fjalë për nene të të njëjtit kapitull, atij "Regjistrimi i subjekteve zgjedhore". Edhe në lidhje me nenin 87 të kundërshtuar, Gjykata është shprehur po në atë vendim, kur ka arsyetuar në lidhje me shpërndarjen e fondeve publike.

- Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë në zgjedhje nuk qëndron. Përcaktimi i numrit të zgjedhësve (jo më pak se 1%) në nenet 69 dhe 70 të Kodit Zgjedhor lidhet më shumë me aftësitë, meritat, ndikimin apo popullaritetin që ka çdo kandidat për deputetë apo kryetar bashkie/komune me zgjedhësit. Qëllimi i ligjvënësit, përmes këtyre dy neneve dhe këtij ligji në tërësi, ka qenë pikërisht respektimi i parimit të barazisë së zgjedhjeve dhe kjo vërtetohet nga fakti se përmes këtyre dy neneve ligjvënësi i ka dhënë mundësi, në mënyrë të barabartë, kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit që të kandidojnë për deputetë, apo kryetar bashkie/komune.

- Përcaktimi i mbështetjes nga një numër zgjedhësish që përbëjnë jo më pak se 1% të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore është përcaktuar në frymën e Udhëzimeve dhe Raportit Shpjegues të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, i miratuar nga Komisioni i Venecias.

- Sistemi proporcional i zgjedhjeve i jep çdo partie të vogël një mundësi për t'u përfaqësuar në parlament, por ky sistem vendos edhe përcaktimin e votave të nevojshme për t'u përfaqësuar. Përcaktimet e neneve 69, pika 3 dhe 70, pika 3 të Kodit Zgjedhor janë rrjedhojë e këtij sistemi.

- Në lidhje me nenin 87 të Kodit Zgjedhor nuk jemi në kushtet e nenit 18/2 të Kushtetutës, pasi ai nuk ka të bëjë me gjendjen ekonomike të kërkuesit dhe nuk sjell kosto financiare për të. Përmes këtij neni ligjvënësi ka pasur në konsideratë ndarjen e fondit për zgjedhjet sipas partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, ndërkohë që neni 18 i Kushtetutës parashikon se subjekti nuk mund të diskriminohet për shkak të gjendjes së tij ekonomike.

6. *Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, parashtroi në mënyrë të përmbledhur se:*

6.1 *Për legjitimitimin e kërkuesit:*

- Kërkuesi nuk legjitimohet racione materiae për t'iu drejtuar Gjykatës. Nenet 69/3 dhe 70/3 të Kodit Zgjedhor nuk përcaktojnë rregulla mbi mënyrën e kandidimit të kandidatëve të propozuar nga partitë politike, sikundër është kërkuesi, por të kandidatëve të propozuar nga një numër i caktuar zgjedhësish. Regjistrimi i partive politike dhe kandidatëve të tyre bëhet sipas neneve 64 dhe 67 të Kodit Zgjedhor. Në kushtet kur këto dispozita zbatohen ndaj kandidatëve të pavarur dhe nuk i shtrijnë efektet mbi kërkuesin, ai nuk ka asnjë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në çështjen e ngritur.

6.2 *Për themelin e kërkesës*

- Në përputhje me hapësirën kushtetuese të veprimit dhe në përmbushje të funksionit të tij ligjvënës, Kuvendi ka përcaktuar në Kodin Zgjedhor se një kandidat që synon të marrë pjesë në zgjedhje dhe që nuk mbështetet nga asnjë parti politike duhet të mbështetet nga një numër zgjedhësish që i korrespondon 1% të numrit të votuesve në atë zonë zgjedhore. Ky rregullim është proporcional dhe justifikohet nga interesi publik, për pengimin e fragmentarizmit

të tepruar të partive politike dhe kandidatëve në zgjedhje por edhe me synimin për të garantuar kandidatura serioze ose në përjashtimin e atyre që nuk kanë mundësi suksesi.

- Përmes këtij rregullimi ligjvënësi nuk krijon pabarazi ndërmjet partive politike apo kandidatëve për një konkurrim të lirë ndërmjet tyre. Kjo për faktin se parimi i mosdiskriminimit nuk mund të nënkuptojë barazi absolute trajtimi, sepse ligji trajton në mënyrë të ndryshme në situata të ndryshme.

- Në lidhje me nenin 87 të Kodit Zgjedhor, ky parashikim lidhet me faktin se partitë politike kanë nevojë për financim të përshtatshëm për të përmbushur funksionet e tyre, si gjatë ashtu edhe ndërmjet periudhave zgjedhore. Sistemet e financimit publik synojnë t'i sigurojnë të gjitha partive mundësinë për të konkurruar në zgjedhje në përputhje me parimin e mundësive të barabarta. Për këtë qëllim, shpenzimet e fushatës elektorale duhet të kufizohen tek një tavan, në përputhje me situatën e vendit dhe të fiksuar me numrin e votuesve respektivë. Shteti duhet të marrë pjesë në shpenzimet e fushatës nëpërmjet financimit të barabartë të një përqindjeje të caktuar në tavanin e mësipërm, ose proporcional me numrin e votave të marra, megjithatë ky kontribut mund të refuzohet për partitë të cilat nuk marrin një prag të caktuar votash.

II

A. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të neneve 69, 70 dhe 87 të Kodit Zgjedhor

7. Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të neneve 69, 70 dhe 87 të Kodit Zgjedhor deri në dhënien e një vendimi përfundimtar prej saj. Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim, për arsye se nuk gjeti argumente bindëse për cenimin e interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve, si rrjedhojë e zbatimit të dispozitave objekt kërkese.

B. Për legjitimitimin e kërkuesit për të iniciuar kontrollin kushtetues të neneve 69, 70 dhe 87 të Kodit Zgjedhor

8. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet racione personae në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës.

Kërkuesi është një person juridik i regjistruar sipas ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, me vendimin nr.3378, datë 24.04.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

9. Kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 3 vjeçar të parashikuar nga neni 50 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

10. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata rithekson se në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës kanë detyrimin të provojnë lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet funksionit dhe veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Partitë politike janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës si një ndër ato subjekte që e ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar kësaj Gjykate, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Gjykata ka theksuar se, në kuptimin kushtetues dhe ligjor, partitë politike paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve dhe pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit. Bazuar në nenin 2 të ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, ato marrin pjesë në formimin e vullnetit politik të popullit në të gjitha fushat e jetës publike dhe kryesisht nëpërmjet: a) ndikimit në krijimin e opinionit publik dhe të edukatës politike; b) nxitjes së pjesëmarrjes aktive të shtetasve në jetën politike dhe evidentimin e aftësisë së shtetasve për të marrë përsipër përgjegjësi publike; c) pjesëmarrjes në zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore. Partitë politike në sistemin e zgjedhjeve dhe veçanërisht në procesin zgjedhor, që nga fushata parazgjedhore, paraqitja e kandidatëve, formimi i trupave zgjedhore, ndjekja e zgjedhjeve e deri te ndarja e mandateve, paraqiten si një faktor përcaktues shumë i rëndësishëm. Prandaj, demokracia përfaqësuese, ashtu edhe sistemi i zgjedhjeve nuk mund të paramendohen pa ekzistencën dhe funksionimin e partive politike. Ky pozicion i veçantë që partitë politike kanë në raport me zgjedhjet, përcakton njëkohësisht dhe interesin e tyre për të pasur një legjislacion dhe rregulla sa më të qarta e të drejta (*shih vendimet nr.1, datë 07.01.2005 dhe nr.32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në lidhje me legjitimimin e partive politike, Gjykata ka vlerësuar se ato mund ta venë këtë Gjykatë në lëvizje atëherë kur kundërshtojnë dispozitat e akteve normative, të cilat cenojnë statusin e tyre kushtetues dhe bashkë me të edhe pjesëmarrjen në ushtrimin e vullnetit shtetëror. Për këtë arsye, Gjykatës i takon të shqyrtojë nëse një organ kushtetues ka cenuar të drejtat e partive politike nëpërmjet aktit normativ të nxjerrë prej tij. Në këtë rast, partia politike legjitimohet në kërkimet e saj nëse bëhet fjalë për respektimin nga ana e një organi kushtetues të statusit të saj që rrjedh nga Kushtetuta, gjatë procesit zgjedhor, si p.sh. financimi i partive politike nga shteti, dhënia e shansit të barabartë të gjitha partive për të marrë pushtetin, etj. Për partinë politike, si subjekt i cilësuar nga dispozita e nenit 134/1/f, lidhen me interesat e tyre të gjitha ato akte përmbajtja e të cilave sjell pasoja negative për veprimtarinë e tyre kushtetuese në kuadër të formimit të vullnetit politik (*shih vendimin nr.15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se dispozitat objekt kërkese cenojnë të drejtën kushtetuese të barazisë në zgjedhje. Duke iu referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor të kundërshtuara, objekt i kërkesës, Gjykata vëren se kërkuesi ka arritur të provojë interesin e tij vetëm në lidhje me nenet 70 dhe 87 të Kodit Zgjedhor, dispozita këto që rregullojnë dhe pra ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në veprimtarinë e partive politike, duke ndikuar në këtë mënyrë në pjesëmarrjen e tyre në formimin e vullnetit politik. Në lidhje me nenin 69 të Kodit Zgjedhor, Gjykata vëren se ai rregullon procedurën për regjistrimin në zgjedhjet e përgjithshme të kandidatit të propozuar nga një grup zgjedhësish, duke parashikuar se ky subjekt zgjedhor nuk mund të jetë pjesë e asnjë partie apo koalicioni që konkurren në zgjedhje. Në kushtet kur kjo dispozitë, në ndryshim nga neni 70 i Kodit Zgjedhor, shprehet vetëm për kandidatët e pavarur dhe nuk bën asnjë rregullim për kandidatët e partive politike, qofshin ato parti parlamentare ose jo, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet për kundërshtimin e saj, pasi ajo nuk rregullon, dhe në këtë mënyrë as nuk prek, në mënyrë të drejtpërdrejtë veprimtarinë e partisë politike si subjekt zgjedhor. Pra, në lidhje me nenin 69 të Kodit Zgjedhor kërkuesi nuk ka arritur të justifikojë interesin e tij në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës.

C. Për pretendimin për ndërhyrjen e parimit të gjësë së gjykuar

13. Përpara vlerësimit në themel të pretendimeve të kërkuarit, Gjykata çmon të ndalet në pretendimin e subjektit të interesuar, Kuvendi, se në rastin në shqyrtim gjendemi para *gjësë së gjykuar*. Kuvendi pretendon se me vendimin nr.32, datë 21.06.2010 Gjykata ka trajtuar kushtetutshmërinë e disa prej dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe se, në thelb, kërkimet e kërkuarit në kërkesën objekt shqyrtimi dhe baza ligjore e referuar janë të njëjta me ato për të cilat Gjykata e ka shprehur tashmë qëndrimin e saj.

14. Gjykata ka theksuar se në gjykimin kushtetues “*res judicata*” njihet si një nga tre format e efekteve që merr vendimi gjyqësor në procedurën abstrakte të kontrollit të kushtetutshmërisë së normave juridike. Në aspektin formal e procedural ajo nënkupton përfundimin, në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit, ndërsa, në atë substancial, nënkupton fuqinë e detyrueshme të vendimit. Ky parim është i zbatueshëm jo vetëm ndaj palëve në gjykim, por edhe ndaj të gjitha autoriteteve publike brenda juridiksionit që janë të interesuara ose të përfshira në përmbajtjen e vendimit të gjykatës. Tipar karakteristik i gjësë së gjykuar është se kur në vendimin e parë çështja e ngritur është konsideruar e pabazuar në themel, ajo nuk mund të shqyrtohet më tej. Në rastet kur nuk është shprehur pajtueshmëria kushtetuese e normës juridike, kërkuari nuk ndalohet të bëjë përsëri të njëjtën kërkesë me motiv rishikimin e normës për pajtueshmëri me Kushtetutën (*shih vendimin nr.29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata vëren se me vendimin nr.32, datë 21.06.2010, i është dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit lidhur me pajtueshmërinë me Kushtetutën të neneve 68 dhe 71 të Kodit Zgjedhor, ndërkohë që me kërkesën objekt shqyrtimi asaj i është kërkuar të shprehet lidhur me dispozita të ndryshme nga ato të marra në shqyrtim në vendimin e mësipërm, konkretisht nenet 69, 70 dhe 87 të Kodit Zgjedhor. Edhe pse këto dispozita përfshihen në të njëjtin kapitull të Kodit Zgjedhor, në kushtet kur vendimi i mëparshëm nuk rezulton të ketë pasur një efekt çfarëdo mbi dispozitat e kundërshtuara, ai nuk përbën asnjë pengesë të aspektit kushtetues. Për sa kohë që kërkuarit kanë paraqitur një kërkesë me objekt të ndryshëm, edhe

pse për të njëjtat shkaqe dhe me të njëjtën bazë ligjore, Gjykata nuk ka asnjë pengesë ligjore për të marrë në shqyrtim këtë kërkesë.

Ç. Për pretendimin për shfuqizimin e neni 70 të Kodit Zgjedhor

16. Kërkuesi pretendon se neni 70 i Kodit Zgjedhor cenon të drejtën e tij kushtetuese për *zgjedhje të barabarta*, të sanksionuar nga neni 1/3 i Kushtetutës dhe *parimin e pluralizmit*, të sanksionuar nga neni 3 i Kushtetutës.

17. Gjykata rithekson se kushti bazë për pluralizmin janë zgjedhjet e lira, shumësia e interesave, lejimi i hapësirave për organizimin e mekanizmave të presionit ndaj organeve të pushtetit dhe një shtet që është i përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve. Në çdo sistem demokratik, përfaqësuesit e popullit në qeverisje zgjidhen përmes zgjedhjeve shumëpartiake, të lira, të barabarta dhe të ndershme. Pushteti i përfaqësuesve kufizohet nga Kushtetuta dhe mekanizma të tjerë të balancimit dhe kontrollit të pushteteve. Problemet e përfaqësimit të drejtë janë çështje të shanseve të barabarta, që zëri i gjithkujt të dëgjohet apo të jetë i përfaqësuar. Sidoqoftë, është e lejueshme që një shtet demokratik, nëse ekzistojnë arsye serioze, të vendosë në mekanizmat e procesit zgjedhor disa elemente nxitëse të integritit shoqëror. Nga ana tjetër, një sistem zgjedhor proporcional i pakufizuar mund të rezultojë në ndarjen e votave të qytetarëve ndërmjet një numri shumë të madh partish politike dhe, për pasojë, në një kërcënim për funksionimin dhe vazhdimësinë e sistemit parlamentar, në kuptim të kapaciteteve për të arritur në një vendimmarrje brenda tij (*shih vendimin nr.32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Neni 3 i Kushtetutës parashikon pluralizmin si një nga bazat e shtetit, ndërsa neni 1, paragrafi 3 i saj sanksionon parimin e barazisë së votës, i cili ka komponentin e tij aktiv (e drejta për të votuar) dhe atë pasiv (e drejta për t'u votuar/zgjedhur). Gjykata rithekson se parimi i barazisë së të drejtës për t'u votuar/zgjedhur ndalon shtetin të diskriminojë ose të privilegjojë kandidatë të caktuar, parti politike ose grupe të tjera politike në përballjen konkurruese për të tërhequr votën e zgjedhësit. Barazia në zgjedhje përfshin shumë aspekte dhe parimet që duhen respektuar në të gjitha rastet janë barazia në votën numerike, barazia për sa i përket fuqisë zgjedhore

dhe mundësive të barabarta, ku kjo e fundit kërkon që midis partive dhe kandidatëve duhet të krijohen shanse të barabarta dhe shteti duhet të jetë i paanshëm ndaj tyre, duke zbatuar ligjet në mënyrë të njëjtë për të gjithë (*shih vendimin nr.32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata ka theksuar se është e rëndësishme për çdo shtet të së drejtës që zbaton rregullat e një shoqërie demokratike, të gëzojë hapësira të konsiderueshme për të përcaktuar rregulla dhe kriteret e drejta brenda rendit të tij kushtetues, në përputhje me kushtet konkrete si dhe me faktorët e ndryshëm politikë, historikë, socialë, kulturorë, tradicionalë, të cilët janë përcaktues. Në koncept, parimi i konkurrimit të lirë të partive politike përfshin detyrimin e shtetit për të respektuar shanset e barabarta të të gjitha partive dhe zbatohet në legjislacionin që rregullon kushtet e këtij konkurrimi, si dhe në konfliktet ndërmjet pjesëmarrësve në të. Ligjvënësi ka hapësirë veprimi për të vlerësuar vetë, duke parashikuar në ligj kriteret e tilla që i përgjigjen në realitet dhe objektivisht parimit të barazisë së votave dhe përfaqësimit të barabartë, por çfarëdoq ndërhyrjeje nga ligjvënësi duhet të udhëhiqet nga interesi publik. Ligjvënësi e ka të ndaluar të trajtojë palët në mënyrë diskriminuese, përveçse kur ekzistojnë arsye të forta përjashtimore për ta bërë këtë. Gjykata rithekson gjithashtu se detyra e saj nuk është që të vihet në rolin e ligjvënësit pozitiv dhe të përcaktojë rregullimet ligjore, por të kontrollojë nëse zgjidhja që jep ligjvënësi nëpërmjet përcaktimeve të kriterëve ligjore është ose jo në përputhje me dispozitat e Kushtetutës (*shih vendimet nr.1, datë 07.01.2005 dhe nr.32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata vëren se, edhe pse kërkuesi në objekt të kërkesës kundërshton të gjithë përmbajtjen e nenit 70 të Kodit Zgjedhor, pretendimet e tij, në thelb, i referohen pikave 4 dhe 6 të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, në të cilat parashikohet se: “4. *Kandidatët e partive politike për kryetar të njësisë të qeverisjes vendore apo listat shumemërore të partive për këshillat vendore, përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nëse të paktën një anëtar i partisë përkatëse zotëron një mandat në Kuvend ose në këshillin, për të cilin partia politike kandidon në zgjedhje. Për qëllim të këtij Kodi, partia politike paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e*

qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit. 6. Partitë politike përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nëse partia përkatëse zotëron një mandat në Kuvend ose në këshillin, për të cilin partia politike kandidon në zgjedhje. Për qëllim të këtij Kodi, partia politike paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësisia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit.”

21. Duke ju referuar, në tërësi, dispozitave të Kodit Zgjedhor rezulton se procedura e regjistrimit të subjektit zgjedhor parti politike ose koalicion partish politike, rregullohet nga nenet 63 – 67 të këtij Kodi, kurse nenet 69 dhe 70 të tij rregullojnë procedurën për regjistrimin e kandidatëve të propozuar nga një grup zgjedhësish, respektivisht për zgjedhjet në Kuvend dhe ato për organet e qeverisjes vendore. Këto dy dispozita parashikojnë se ky subjekt zgjedhor (kandidati i propozuar nga zgjedhësit) nuk mund të jetë pjesë e asnjë partie apo koalicioni që konkurren në zgjedhje dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurren në zgjedhje dhe se ky kandidat mund të regjistrohet vetëm nëse ka marrë mbështetje nga një numër zgjedhësish që i korrespondon jo më pak se 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore. Ndërkohë që në nenin 70, në pikat 4 dhe 6 të tij, në ndryshim nga neni 69, janë parashikuar edhe disa përjashtime nga ky detyrim për kandidatët që vijnë nga partitë politike që kanë të paktën një mandat në Kuvend ose në këshillin për të cilin partia kandidon. Gjykata vëren se, edhe pse në thelb neni 70 i Kodit Zgjedhor i drejtohet dhe rregullon regjistrimin e kandidatëve të pavarur, pra që nuk vijnë nga partitë politike por që kërkojnë të marrin pjesë në zgjedhje me anë të mbështetjes së zgjedhësve, nga një interpretim a contrario i pikave 4 dhe 6 të kësaj dispozite rezulton se, duke parashikuar përjashtimin nga ky detyrim vetëm të kandidatëve që vijnë nga partitë politike me të paktën një mandat në Kuvend ose në këshillat përkatës, kërkesa për të siguruar mbështetjen e një numri zgjedhësish që i korrespondon jo me pak se 1% të listës së zgjedhësve zbatohet, përveç se për kandidatët e pavarur, edhe për ata kandidatë që vijnë nga partitë politike të cilat nuk kanë mandate në Kuvend ose në këshillat përkatës. Ky rezultat të jetë edhe interpretimi që vetë KQZ-ja i ka bërë kësaj dispozite, e cila në rastin e kandidatëve të propozuar nga këto të fundit, kërkon që ata të provojnë mbështetjen nga një

numër zgjedhësish që i korrespondojnë jo më pak se 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, për efekt të regjistrimit të tij në listën e kandidatëve që konkurrojnë për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore.

22. Bazuar në përmbajtjen e pikave 4 dhe 6 të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, Gjykata vlerëson se gjendet përpara një kufizimi të pjesëmarrjes së barabartë të partive në zgjedhje dhe, në këto kushte, detyrë e saj është të vlerësojë nëse ky kufizim është proporcional me qëllimin që kërkohet të arrihet. Ajo rithekson se parashikimi i kriterëve të tilla apo dhe përcaktimi i numrit të nënshkrimeve që duhet të mbledhen mbetet një atribut i ligjvënësit, por ky përcaktim duhet të jetë i drejtë. Detyrimi për të mbledhur një numër të caktuar firmash për të paraqitur kandidaturën është teorikisht në përputhje me parimin e votimit universal, por ky detyrim nuk duhet të pengojë kandidatët të vendosin kandidaturat e tyre. Konkurrimi i lirë ndërmjet partive është një shfaqje e drejtpërdrejtë e natyrës pluraliste të shoqërisë demokratike dhe është pikërisht mbrojtja e pluralizmit në jetën politike që ka kuptim për vetë ekzistencën e kësaj shoqërie.

Gjykata thekson se çdo kufizim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë mbi barazinë e partive në konkurrimin zgjedhor nuk duhet të ketë një pasojë diferencuese ose të përbëjë një trajtim preferencial për disa parti, ose të ndalojë pjesëmarrjen e partive politike në konkurrimin zgjedhor. Bazuar në standardet e trajtuara më sipër, ajo vlerëson se nuk rezultojnë arsye të përligjura kushtetuese për të krijuar një dallim të këtij dimension ndërmjet partive politike, kandidatët e të cilave janë zgjedhur në Kuvend (partitë parlamentare) dhe partive të tjera (joparlamentare), çka realisht bëhet përmes nenit 70 të Kodit Zgjedhor. Një rregullim i tillë nuk justifikohet me ndonjë interes publik, me pengimin e fragmentarizmit të tepruar të partive politike dhe as me synimin për të siguruar kandidatura serioze në zgjedhje ose përjashtimin e atyre që nuk kanë mundësi suksesi dhe, për pasojë, është joproporcional.

Për sa më sipër Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit në lidhje me nenin 70, pika 4 dhe 6, të Kodit Zgjedhor janë të bazuara dhe këto dispozita duhet të shfuqizohen si të papajtueshme me Kushtetutën.

D. Për pretendimin për shfuqizimin e nenit 87 të Kodit Zgjedhor

23. Në lidhje me nenin 87 të Kodit Zgjedhor, kërkuesi pretendon se edhe përmbajtja e kësaj norme është në kundërshtim me parimin e barazisë së partive politike përbërë shtetit dhe parimin e shanseve të barabarta në konkurrimin politik.

24. Gjykata vëren se, duke qenë se qëllimi kryesor i partive politike është marrja e pushtetit me mjete dhe mënyra demokratike, elementi kryesor që karakterizon veprimtarinë politike të partive është konkurrenca midis tyre. Konkurrimi i lirë është shprehje e drejtpërdrejtë e natyrës pluraliste të një shoqërie demokratike dhe bazohet edhe në faktin që për të gjitha partitë politike zbatohen të njëjtat rregulla të përcaktuara më parë. Këto rregulla bazohen në parimin e mosdiskriminimit, të mostrajtitimit preferencial të disa partive ndaj disa të tjerave, duke u dhënë atyre mundësi të njëjta në konkurrimin politik. Çdo kufizim në barazinë e palëve në konkurrimin elektorale nuk mund të arrijë deri në atë masë që të bëjë të pamundur vetë pjesëmarrjen e partive politike në konkurrim. Gjykata vlerëson se midis partive dhe kandidatëve duhet të krijohen shanse të barabarta dhe shteti duhet të jetë i paanshëm ndaj tyre, duke zbatuar ligjet në mënyrë të njëjtë për të gjithë. Në veçanti, kërkesa për asnjësi zbatohet për fushatën zgjedhore dhe mbulimin nga media, veçanërisht media publike, si dhe për financimin publik të partive dhe fushatave, e cila mund të realizohet si në formën e një barazie “strikte”, ashtu dhe të barazisë “proporcionale”. Sipas barazisë “strikte”, partitë politike trajtohen pa marrë në konsideratë forcën e tyre aktuale në Kuvend ose të zgjedhësve, ndërsa sipas barazisë “proporcionale”, trajtimi i partive bëhet në raport me numrin e votave (*shih vendimin nr.32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata rithekson se partitë politike luajnë një rol të rëndësishëm në sistemin demokratik pluralist pasi kontribuojnë në shfaqjen e vullnetit politik të popullit përmes pjesëmarrjes në zgjedhje dhe ndihmojnë në realizimin e sovranitetit të tij. Për shkak të këtyre funksioneve ato kanë status kushtetues dhe konsiderohen elementë të domosdoshëm të jetës politike. Në mënyrë që të kryejnë këto funksione, partitë politike kanë burime financiare që përbëhen si nga të ardhura private ashtu edhe të ardhura nga buxheti i shtetit. Financimi i partive politike nga buxheti i shtetit përbën vetëm një pjesë të të ardhurave të tyre. Bazuar në nenin 17 të ligjit

nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” (të ndryshuar), burimet financiare dhe materiale të partive politike përbëhen nga kuotat e anëtarësisë, nga fondet publike, duke përfshirë edhe ndihmën financiare në masën e caktuar në Buxhetin e Shtetit të miratuar me ligj nga Kuvendi, fondet jopublike, të cilat janë dhurimet financiare, dhurimet në natyrë, shërbimet, sponsorizimet, kreditë apo garancitë e ndryshme, si edhe çdo transaksion tjetër financiar. Financimi i partive politike nga shteti nuk është një parim kushtetues, megjithatë atje ku zbatohet ai duhet të respektojë parimin e konkurrimit të lirë të subjekteve, në kuptim të hyrjes së lirë të tyre në garën zgjedhore. Financimi i shtetit për partitë politike është thelbësor për të garantuar pavarësinë e tyre nga burimet e tjera financiare dhe për t’i siguruar mundësinë për të konkurruar nga një pozicion i barabartë. Sa më shumë partitë politike subvencionohen nga shteti aq më pak ato ndjejnë nevojën të kërkojnë ndihmë për veprimtarinë e tyre nga burime të tjera. Në lidhje me buxhetin e miratuar për mbështetjen financiare të partive politike gjatë periudhës zgjedhore, në nenin 87 të Kodit Zgjedhor është parashikuar se këto fonde shpërndahen në këtë mënyrë:

- 50 për qind e shumës ndahet ndërmjet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore dhe që kanë mandate në Kuvend, e përcaktuar kjo sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve pararendëse. Shuma shpërndahet mbi bazën e numrit të mandateve të fituara në zgjedhjet për Kuvendin;

- 50 për qind e shumës së përgjithshme ndahet midis partive politike të regjistruara si subjekt zgjedhor dhe që në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin kanë marrë jo më pak se 2 vende në Kuvend, në raport me votat e marra prej tyre në shkallë kombëtare, sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve pararendëse.

26. Sipas Kodit të Praktikës së Mirë në Fushën e Partive Politike (*miratuar nga Komisioni i Venecias në Mbledhjen e tij të 77-të Plenare, Venecia 12-13 dhjetor 2008, shih më gjerë dokumentin CDL-AD(2009)002*), atje ku legjislati parashikon financimin publik, partitë politike duhet të kenë akses dhe të jenë subjekte të kërkesave/kritereve minimale, të cilat duhet të jetë të arsyeshme dhe jo diskriminuese. Bazuar në Direktivat për Financimin e Partive Politike (*miratuar nga Komisioni i Venecias në Mbledhjen e tij të 46-të Plenare, Venecia 9-10 mars 2001, shih më gjerë dokumentin*

CDL-INF (2001)008), financimi publik duhet t'i drejtohet secilës parti të përfaqësuar në Kuvend. Në mënyrë, megjithatë, që të sigurohet barazia e mundësive për forcat e ndryshme politike, financimi publik mund të shtrihet gjithashtu në subjektet politike që përfaqësojnë një pjesë domethënëse të trupës zgjedhore dhe që paraqet kandidatë për zgjedhje dhe se niveli i financimit mund të përcaktohet nga ligjvënësi mbi një bazë periodike, bazuar në kritere objektive.

27. Gjykata vëren se, edhe pse në parim mbështetja financiare e shtetit ndaj partive politike ka rëndësi në një shtet të së drejtës, kjo megjithatë nuk nënkupton që ajo nuk ka kufij, ajo nuk mund të tejkalojë një masë që respekton parimin e ndarjes së partive politike nga shteti. Gjykata vlerëson se kjo mbështetje financiare e shtetit mund të kufizohet mbi bazën e kontributit të partive politike, duke e vlerësuar atë në termat e *“seriozitetit të përpjekjeve të partive konkurruese”* ose të *“seriozitetit të qëllimeve elektorale të partive”* që shpreh një shkallë të përfaqësimit të tyre. Qëllimi i financimit nuk mund të jetë kufizimi i konkurrencës të lirë por ai duhet të sigurojë seriozitetin e kësaj gare. Ai nuk është një instrument për integrimin e partive politike, por thjesht një përcaktues i faktit nëse programet zgjedhore kanë pasur qëllime serioze, nëse ato janë orientuar ekskluzivisht drejt suksesit të zgjedhjeve dhe jo ndaj qëllimeve të tjera (*shih vendimet Pl. US 30/98, datë 13.10.1999; Pl. US 42/00, datë 24.01.2001; Pl. US 10/03, datë 19.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese të Çekisë*).

28. Siç u theksua edhe më sipër në këtë vendim, ligjvënësi ka hapësirë për të parashikuar në ligj kritere të tilla që i përgjigjen në realitet dhe objektivisht parimit të barazisë së votave dhe përfaqësimit të barabartë, por çfarëdolloj ndërhyrjeje nga ligjvënësi duhet të udhëhiqet nga interesi publik. Ligjvënësi, kur rregullon fushën e krijimit të vullnetit politik, duhet të mbajë parasysh faktin se në këtë fushë kufijtë e hapësirës së tij të veprimit janë më të ngushtë dhe se nuk pranohet një trajtim i diferencuar i partive që nuk mbështetet në baza veçanërisht serioze. Gjykata vlerëson se zgjedhjet kanë si objektiv të mundësojnë zgjedhësit të zgjedhin përfaqësuesit e tyre, por edhe të sjellin në Kuvend një shumicë të qëndrueshme, që në vijim të mund të prodhojë legjislacion dhe të mundësojë një qeverisje efektive. Një sistem proporcional, tërësisht i pakufizuar përballë partive të vogla, mund të ketë, potencialisht,

pasoja destabilizuese. Trajtimi i pabarabartë i partive, duke dalluar ndërmjet tyre partitë brenda dhe jashtë Kuvendit, bëhet për mbrojtjen e votuesit nga shpërdorimi i votës. Gjykata vlerëson se është një vullnet i ligjshëm i ligjvënësit të kërkojë mbrojtjen e votuesit, në mënyrë që ai të mos ia japë votën një kandidati ose oferte të pashpresë. Një sistem zgjedhor që mundëson oferta zgjedhore mund të funksionojë vetëm nëse paraqitja e një oferte nuk është thjesht e drejta e gjithkujt, pa asnjë përgjegjësi të mëtejshme. Vetëm një ofertë që merret seriozisht është një ofertë me kuptim (*shih vendimin nr.32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata vëren se shpërndarja e fondeve sipas parashikimit të nenit 87 të Kodit Zgjedhor de facto kufizon partitë e reja, që marrin pjesë për herë të parë në zgjedhje, apo partitë e vogla që nuk kanë arritur të sigurojnë mjaftueshëm vota në zgjedhjet pararendëse për të siguruar vende në Kuvend dhe paraqet avantazhe financiare për partitë që përfaqësohen me deputetë në Kuvend. Për këtë arsye, është e nevojshme të shqyrtohet me kujdes nëse një parashikim i tillë udhëhiqet nga interesi publik.

30. Gjykata thekson se është e drejtë e ligjvënësit të përcaktojë me ligj sasinë e buxhetit të shtetit që do të ketë destinacion financimin e partive politike. Ligjvënësi e ka lidhur shpërndarjen e këtyre fondeve me rezultatin e zgjedhjeve dhe numrin e mandateve përfaqësuese në Kuvend, sepse kjo reflekton pozicionin real të një partie politike dhe veçanërisht shkallën e pjesëmarrjes në pushtetin legjislativ. Ky është një kriter i mjaftueshëm për të ndarë partitë politike në ato që kanë një domethënie reale për veprimtarinë politike në vend, bazuar në vullnetin e votuesve që ato përfaqësojnë, dhe në ato që nuk arrijnë të përfaqësojnë një pjesë domethënëse të zgjedhësve duke rezultuar të pasuksesshme në zgjedhje. Ky parashikim ka si qëllim të kufizojë ekzistencën e entiteteve që marrin pjesë në zgjedhje kryesisht me qëllimin për të përfituar fonde nga buxheti i shtetit por që nuk kanë një influencë reale në jetën politike të vendit dhe as një mbështetje domethënëse nga zgjedhësit. Gjykata vlerëson se kufizimet e parashikuara nga neni 87 i Kodit Zgjedhor, për përfitimin e financimit nga buxheti i shtetit përbëjnë, në vlerësimin e saj, provë të mjaftueshme të seriozitetit të përpjekjeve të këtyre partive në konkurrimin zgjedhor. Partitë politike kryejnë funksionin e përfaqësimit të interesave të ndryshme dhe synojnë realizimin/

përmbushjen e këtyre interesave përmes mjeteve demokratike, pra përmes përfaqësimit në asambljetë përfaqësuese. Ato parti që nuk marrin pjesë në zgjedhje, ose nuk marrin mjaftueshëm mbështetje publike, qartësisht nuk japin të njëjtin kontribut në përcaktimin e vullnetit politik të popullit.

Gjykata vëren se një rregullim i tillë do të konsiderohej jokushtetues vetëm në rast se nuk do të ekzistonte një lidhje racionale ndërmjet këtij rregullimi ligjor dhe qëllimit që ai kërkon të arrijë. Financimi i shtetit për partitë politike shtrihet ndaj të gjitha partive politike që duke marrë një numër të konsiderueshëm votash, i përkthyer më pas në mandate, që tregojnë mbështetjen e një mase zgjedhësish aktivë, arrijnë të tregojnë se plotësojnë kushtin e *“seriozitetit të përpjekjeve të partive konkurruese”* ose të *“seriozitetit të qëllimeve elektorale të partive”* për të marrë pjesë në konkurrimin elektoral.

Për këto arsye, Gjykata vlerëson se parashikimi i nenit 87 të Kodit Zgjedhor, nuk bie në kundërshtim me parimin e barazisë së partive politike përballë shtetit dhe as me parimin e shanseve të barabarta në konkurrimin politik.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “a”, 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e pikave 4 dhe 6 të nenit 70 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. (votuan kundër gjyqtarët V. Kristo dhe F. Hoxha)
3. Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të nenit 87 të Kodit Zgjedhor. (votuan kundër gjyqtarët P. Pllloçi dhe S. Berberi)
4. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIM PAKICE

Ne, gjyqtarët në pakicë, jemi kundër vendimit të shumicës, vetëm për pjesën që ka rrëzuar pretendimin e kërkuarit për shfuqizimin e nenit 87 të Kodit Zgjedhor (KZ), që parashikon shpërndarjen dhe rishpërndarjen e fondeve publike për subjektet zgjedhore.

Shumica në këtë çështje ka vlerësuar se parashikimi i nenit 87 të KZ-së, nuk bie në kundërshtim me parimin e barazisë së partive politike përballë shtetit dhe as me parimin e shanseve të barabarta në konkurrimin politik. Pakica ndan një mendim të ndryshëm nga shumica për arsyet që shtjellohen në vijim.

Parimi i konkurrimit të lirë të partive politike, siç ka theksuar dhe shumica, përfshin detyrimin e shtetit për të respektuar shanset e barabarta të të gjitha partive dhe ndalon ligjvënësin të trajtojë palët në mënyrë të dallueshme nga njëra-tjetra, përveçse kur ekzistojnë arsye të forta përjashtimore për ta bërë këtë. Konkurrimi i lirë ndërmjet partive është një shfaqje e drejtpërdrejtë e natyrës pluraliste të shoqërisë demokratike dhe çdo kufizim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë mbi barazinë e partive në konkurrimin zgjedhor nuk duhet të ketë një pasojë diferencuese ose të përbëjë një trajtim preferencial për disa parti, ose të ndalojë pjesëmarrjen e partive politike në konkurrimin zgjedhor (*shih vendimin nr. 32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në vendimin e sipërcituar, Gjykata është shprehur se parimi i barazisë së të drejtës për t'u votuar/zgjedhur ndalon shtetin të diskriminojë ose të privilegjojë kandidatë të caktuar, parti politike ose grupe të tjera politike në përballjen konkurruese për të tërhequr votën e zgjedhësit. Midis partive duhet të krijohen shanse të barabarta dhe shteti duhet të jetë i paanshëm ndaj tyre. Në veçanti kërkesa për asnjësi zbatohet për fushatën zgjedhore, mbulimin nga media, si dhe për financimin publik të partive dhe fushatave. Në varësi të objektit, barazia mund të jetë strikte ose proporcionale. Në rast se është strikte, partitë politike trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga fuqia e tyre parlamentare aktuale ose mbështetja nga elektorati. Në rast se është proporcionale, partitë politike duhet të trajtohen në bazë të rezultateve të arritura në zgjedhjet Pakica çmon se nëse konkurrimi i lirë, në kushte të barabarta, i partive politike që marrin pjesë në garën elektorale nuk sigurohet, nëse krijohet një situatë ligjore që lejon partitë e mëdha ose më të mëdha, në mënyrë

të drejtpërdrejtë ose jo, të trajtohen në mënyrë të diferencuar, dispozitat që parashikojnë një gjë të tillë nuk mund të konsiderohen si kushtetuese. Parimi i konkurrimit të lirë të partive politike kërkon që ligjvënësi të marrë masa për të siguruar barazinë maksimale mes partive politike, duke siguruar konkurrimin e tyre të lirë dhe të ndershëm, hapjen e sistemit politik, si dhe mundësinë për të hyrë në skenën politike të entiteteve të reja. Duke iu referuar parimit të barazisë proporcionale, fondet publike duhet të akordohen sipas niveleve të mbështetjes popullore ndaj partive politike, zakonisht e matur në proporcion me numrin e votave për parti apo kandidat në zgjedhjet e përgjithshme legjislativë, dhe/ose me numrin e vendeve që përfitohen në parlament. Ndërsa barazia strikte kërkon që çdo parti ose kandidat të marrë një shumë të barabartë parash, ose një shumë të përgjithshme, pavarësisht nga mbështetja elektorale apo numri i vendeve/mandateve në parlament.

Sipas nenit 87 të KZ-së, që i referohet shpërndarjes së fondeve për financimin e fushatës zgjedhore të parashikuara në buxhetin e vitit kur do të zhvillohen zgjedhje, sasia e fondeve publike që i shpërndahet secilit prej subjekteve zgjedhore caktohet me vendim të KQZ-së, sipas rregullave të mëposhtme:

a) 50 për qind e shumës ndahet ndërmjet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore dhe që kanë mandate në Kuvend,(...) Shuma shpërndahet mbi bazën e numrit të mandateve të fituara në zgjedhjet për Kuvendin;

b) 50 për qind e shumës së përgjithshme ndahet midis partive politike të regjistruara si subjekt zgjedhor dhe që në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin kanë marrë jo më pak se 2 vende në Kuvend,(....)

Bazuar në përmbajtjen e nenit 87 të KZ-së, konstatohet se ligjvënësi shqiptar, në lidhje me shpërndarjen e fondeve publike për mbështetjen e fushatës zgjedhore, ka zbatuar parimin e proporcionalitetit, pra shpërndarjen e tyre në përputhje me mbështetjen popullore, të reflektuar në mandate, që gëzojnë partitë politike.

Nga interpretimi literal dhe sistematik i paragrafëve “a” dhe “b” të kësaj dispozite, kriteri që duhet të përmbushin partitë politike, të regjistruara si subjekte zgjedhore, për të përfituar nga fondet publike është të kenë mandate në Kuvend. Kjo nënkupton se vetëm partitë politike që janë pjesë e Kuvendit, pra janë parti parlamentare, mund të përfitojnë financim nga fondet publike.

Sipas paragrafit “a” mjafton pasja qoftë dhe vetëm e një mandati në Kuvend për të gëzuar të drejtën e përfitimit të fondeve publike. Numri i mandateve shërben thjesht dhe vetëm si bazë për shpërndarjen proporcionale të 50% të shumës totale të fondeve ndërmjet partive parlamentare. Paragrafi “b” e lidh marrjen e fondeve publike me një tjetër kriter, atë të arritjes së pragut prej të paktën dy mandatesh në Kuvend. Partitë politike, të regjistruara si subjekte zgjedhore, të cilat kanë të paktën 2 mandate në Kuvend përfitojnë 50% të shumës së përgjithshme të fondeve publike. Pavarësisht se mënyra e shpërndarjes së fondeve publike është parashikuar e ndarë në dy paragrafë, rregullimet që përmbajnë këta paragrafë të çojnë në thelb në të njëjtin rezultat; vetëm partitë parlamentare përfitojnë nga fondet publike gjatë fushatës zgjedhore. Rrjedhimisht, partitë politike, të cilat nuk kanë arritur pragun minimal të pasjes së një mandati në Kuvend në zgjedhjet paraardhëse si dhe partitë e reja të krijuara pas këtyre zgjedhjeve, janë të përjashtuara a priori nga skema e financimit me fonde publike të përcaktuar nga neni 87 i KZ-së. Për këto dy kategori partish politike nuk parashikohet asnjë kriter për akordimin e fondeve publike gjatë fushatës zgjedhore. Pakica vlerëson se kriteri që lidh përfitimin e fondeve publike gjatë fushatës zgjedhore me pasjen e një mandati në Kuvend, duke përjashtuar nga skema e këtij financimi partitë që nuk kanë fituar asnjë mandat në zgjedhjet pararendëse dhe partitë e reja të krijuara pas zgjedhjeve, nuk është proporcional dhe si i tillë cenon barazinë gjatë zgjedhjeve parlamentare në lidhje me financimin publik. Ky qëndrim mbështetet në argumentet që vijnë.

Pakica është dakord me mendimin e shumicës, sipas të cilit është e drejtë e ligjvënësit të përcaktojë me ligj jo vetëm sasinë e buxhetit të destinuar për financimin e partive politike, por edhe kriteret e diferencuara mbi bazën e të cilave ai do të shpërndahet. Megjithatë, duke pasur parasysh qëllimin për të cilin ky buxhet caktohet dhe shpërndahet (financimi i fushatës zgjedhore) pakica vlerëson se është thelbësore që këto kritere të jenë objektive, proporcionale, të drejta e të arsyeshme, si dhe të sigurojnë shanse të barabarta për të gjitha partitë politike, në mënyrë që ato të konkurrojnë në kushte të barabarta. Sistemet e financimit të përzgjedhura nga ligjvënësi duhet të synojnë të parashikojnë, për të gjitha partitë, mundësi për të konkurruar në zgjedhje, në përputhje me parimin e mundësive të barabarta.

Hapja e sistemit politik është e lidhur, mes të tjerash, edhe me formimin e një sistemi të përshtatshëm për financimin e partive

politike. Koncepti i përfaqësimit proporcional kuptohet përgjithësisht që zgjedhjet do të transferojnë në mënyrë proporcionale në Parlament një shpërndarje politike, e cila korrespondon me sa votues kanë votuar dhe rezultati i të cilit është zakonisht një parlament me parti politike të ndryshme dhe një qeveri koalicioni. Avantazhet e sistemit proporcional përfshijnë, mes të tjerash, lejimin e përfaqësimit maksimal të të gjitha opinioneve dhe interesave në parlament dhe mbështet formimin e një shumice mbi bazën e negociatave dhe kompromiseve. Një ndërhyrje e ligjvënësit, nëpërmjet stimujve integruarë, do të konsiderohet kushtetuese nëse ajo zbatohet vetëm për qëllimin e formimit të vullnetit politik të popullit, pra formimin e një shumice vendimmarrëse. Pakica vlerëson se, financimi i fushatës zgjedhore duhet të ketë si qëllim financimin e të gjitha partive politike që marrin pjesë në garën elektorale dhe një kusht për kushtetutshmërinë e tij është siguri i hapjes së sistemit politik, prandaj pragu për të përfituar financimin duhet të jetë në mënyrë domethënëse më i ulët se pragu i sistemit zgjedhor proporcional.

Për sa më sipër, pakica vlerëson se në rast të zbatimit të barazisë proporcionale, për shpërndarjen e fondeve publike, gjithashtu niveli i mbështetjes politike duhet të llogaritet në bazë të kriterëve objektive. Ligjvënësi duhet të parashikojë një prag minimal mbështetjeje për përfitimin e financimeve, i cili duhet të jetë më i ulët se ai i nevojshëm për caktimin e një mandati në parlament, pasi një prag i lartë i paarsyeshëm devijon pluralizmin politik dhe dëmton partitë e vogla politike. Në këtë aspekt mund të parashikohet për shembull një kriter i llojit politik, sipas numrit të mbështetësve të partisë politike përkatëse. Kërkesa për përfitimin e financimeve në bazë të numrit të mandateve, shpërfill kriterin e mbështetjes elektorale të partive pjesëmarrëse në garë dhe bën që fondet publike të përqendrohen vetëm në duart e partive parlamentare, duke mbartur rrezikun e krijimit të një monopolizimi të këtyre fondeve. Përqendrimi i mbështetjes financiare të shtetit për vetëm disa parti, ato parlamentare, është *de facto* një penalizim financiar për partitë e tjera më të vogla apo dhe partitë e reja. Për këtë arsye është e nevojshme të shqyrtohet me kujdes nëse qëllimi i masave të tilla është tejkaluar nga ligjvënësi. Ky qëllim, ashtu siç shprehet edhe shumica, duhet të jetë vetëm serioziteti i përpjekjes të partive konkurruese, i cili nuk synon të arrijë asgjë tjetër veç pjesëmarrjes në përfaqësimin politik të vendit dhe promovimin e programeve të tyre.

Kuadri ligjor që penalizon ato parti politike që duan të integrohen, kufizon konkurrimin e lirë të tyre. Kriteri bazë i kushtetutshmërisë, kur përcaktohet një prag minimal për pagesat për veprimtarinë e partive politike, qëndron në sigurimin e hapjes së sistemit politik, prandaj pragu duhet të jetë më i ulët se sa pragu mbyllës në sistemin proporcional për të përfituar një mandat. Gjykata Kushtetuese çeke i ka analizuar këta kufij në termat e dy parimeve: atë të integritimit (*'integration'*) dhe atë të përfaqësimit (*'representativeness'*). Parimi i përfaqësimit do të thotë, mbi të gjitha, që përbërja e një organi përfaqësues rrjedh nga struktura politike e një shoqërie civile, megjithatë ai, gjithashtu, përfshin kërkesën për një përfaqësim minimal të entiteteve (parti dhe lëvizje politike) që marrin pjesë në një garë elektorale. Në vendimin e saj nr.PI. US 30/98 Gjykata Kushtetuese çeke shfuqizoi kushtin e marrjes së të paktën 3% të numrit total të votave të vlefshme, me qëllim të përfitimit të financimit për mbulimin e shpenzimeve zgjedhore. Ajo ka vlerësuar se lidhja e përfitimit të financimit me marrjen e 3% të numrit total të votave të vlefshme në zgjedhje, tejkalon kufirin e nevojshëm për të përcaktuar seriozitetin e qëllimeve elektorale të partive dhe ndërhyr në barazinë e mundësive të partive politike në konkurrimin zgjedhor. Në vendimin nr. 2005/01/19 - PI. ÚS 10/03, Gjykata Kushtetuese çeke ka pohuar se në kuadrin e parimit të demokracisë përfaqësuese, është e lejueshme të ndërtohen në vetë mekanizmin elektoral disa stimuj integruar atje ku ka arsye serioze për këtë, veçanërisht bazuar në supozimin se një sistem proporcional i pakufizuar do të çonte në fragmentimin e votave ndërmjet një numri të madh partish politike, në një "mbipopullim" të partive politike dhe, si pasojë, në një rrezik në funksionimin e sistemit parlamentar. Kur vlerësohen kufijtë e pranueshmërisë së stimujve integruar, fillohet me parimin e proporcionalitetit në mënyrë që të sigurohet formimi i një shumice parlamentare, e nevojshme për marrjen e vendimeve dhe krijimin e qeverisë. Rritja e pragut hyrës nuk mund të rrezikojë substancën demokratike të zgjedhjeve.

Siç shihet qartë, Gjykata Kushtetuese çeke, në çështjet e financimit publik të partive politike, në konfliktin mes parimit të integritimit dhe atij të pluralizmit në një shoqëri demokratike, i ka dhënë prioritet këtij të fundit, duke konsideruar dispozitën që kushtëzonte financimin me arritjen e një pragu mbyllës në zgjedhjet elektorale si jokushtetuese. Ajo e ka lidhur hapjen e sistemit politik me një kufi më të ulët për të përfituar kontributin se sa ai për të marrë një vend në parlament.

Po kështu, në këtë drejtim mund të përmendim vendimin nr. 89-271 DC/1990 të Këshilli Kushtetues Francez, i cili ka deklaruar se lidhja e kontributit elektoral me përfitimin e më shumë se 5% të votave në distrikte individuale ishte jokushtetuese dhe në kundërshtim me parimin e barazisë. Në Gjermani marrja e 0.5% të votave në zgjedhjet elektorale është e mjaftueshme për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit, për të mundësuar ushtrimin nga partitë të funksioneve të tyre kushtetuese, njëra prej të cilave është dhe pjesëmarrja në zgjedhje.

Sipas opinionit të përbashkët të Komisionit të Venecias dhe OSBE/ODHIR për Kodin tonë Zgjedhor (Opinion nr.513/2009 CDL-AD(2009)005, Venice 13-14 mars 2009), përmbajtja e nenit 87 të Kodit nënkupton që vetëm partitë parlamentare përfitojnë fonde publike për zgjedhjet dhe se është e diskutueshme nëse partitë politike në Kuvend ia japin të gjitha fondet publike për fushatën elektorale vetes së tyre. Komisioni i Venecias dhe OSBE/ODIHR rekomandojnë që këto dispozita të amendohen për të parashikuar mekanizma edhe për financimin publik të partive jo-parlamentare. Nisur nga sa më lart, pakica çmon se, neni 87 i Kodit Zgjedhor, në thelb, duke parashikuar dhënien e financimit vetëm në bazë të mandateve të fituara, mbështet partitë e mëdha të stabilizuara tashmë, në kurriz të partive të reja apo dhe atyre të vogla që nuk kanë fituar mjaftueshëm vota për të siguruar një mandat në parlament. Në vlerësimin tonë ky parashikim cenon parimin e pjesëmarrjes së barabartë të partive politike në konkurrimin zgjedhor dhe parimin e proporcionalitetit. Nëse rregullimet ligjore nuk respektojnë konkurrimin e lirë të partive politike në kushte të njëjta dhe nuk përcaktojnë kritere proporcionale për financimin publik të partive politike gjatë fushatës zgjedhore, duke krijuar situata të favorshme për disa parti dhe jo të favorshme për disa të tjera, këto rregullime nuk mund të konsiderohen kushtetuese.

Si përfundim, në kuptim të arsytimit të mësipërm, pakica vlerëson se përmbajtja e nenit 87, pika 2, e Kodit Zgjedhor paraqet probleme kushtetutshmie dhe për këto arsye duhej të ishte pranuar kërkesa edhe për këtë pjesë dhe duhej të ishte vendosur shfuqizimi i kësaj dispozite.

Anëtarë: Sokol Berberi, Petrit Piloçi.

* * *

Vendim nr. 11, datë 13.03.2015

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Bashkim Dedja, Kryetar, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, anëtarë, me sekretare Edmira Babaj, në datën 07.10.2014 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 41/10 Akti, që i përket:

KËRKUES: **PARTIA ALEANCA KUQ E ZI,**
përfaqësuar në gjykim nga kryetari i saj
Kreshnik Spahiu dhe avokat Aldo Shala.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,**
përfaqësuar në gjykim nga z. Alban Brati,
me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE,
përfaqësuar në gjykim nga z. Koli Bele,
me autorizim.

OBJEKTI: Shpallja si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e neneve 67, pikat 1, 5 dhe 6; 68; 71; 72, shkronja “d” e pikës 2; 73, pika 4; 98, pikat 3 dhe 4; 106, pika 1; 117, pikat 2 dhe 3; 118, shkronja “c” e pikës 1; 163, pikat 5 dhe 6; 164; 165, pika 2 dhe 166, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).

BAZA LIGJORE: Nenet 131/a dhe 134/1/f të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenet 28, 29, 49, 50 dhe 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatos Lulo; përfaqësuesit e kërkuarit, që kërkuar pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, që kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr. 74, datë 19.07.2012, ka miratuar disa ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i cili është ligji bazë që ka për qëllim caktimin e rregullave për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendimet.

2. Këto ndryshime, ndër të tjera, lidhen me ushtrimin e të drejtës për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur, listat e mbyllura në një sistem zgjedhor proporcional, nënshkrimin e mbështetësve për partitë politike që nuk kanë mandate në Kuvend, si dhe parashikimin e zgjedhjes së kryetarëve të njësisve vendore me një raund të vetëm.

II

3. Kërkuari Partia Aleanca Kuq e Zi (AK) i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*këtu e në vijim: Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin si antikushtetuese të dispozitave ligjore objekt kërkesë, për faktin se kanë cenuar parimet themelore të sanksionuara në Kushtetutë, nenet 2/1, 9, 45/1, 70/1 dhe 109 të saj, si dhe nenin 3 të Protokollit Shtesë të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në thelb, kërkuari ka paraqitur këto argumente për të mbështetur kërkesën e tij:

3.1 Sistemi proporcional me lista të mbyllura, përveç papajtueshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nuk përputhet as me realitetin shoqëror dhe politik të vendit. Nenet 67/1/5/6, 73/4, 98/3/4, 106/1, 117/2/3, 118/1/c, 163/5/6, 164, 165/2 dhe 166 të Kodit Zgjedhor (*i ndryshuar me ligjin nr. 74, datë 19.07.2012*) nuk e lejojnë votuesin të shprehë preferencë për kandidatët, për të qenë përcaktues në zgjedhjet e përgjithshme apo

vendore, duke e shndërruar votimin në një proces indirekt. Këto parashikime shkelin dispozitat kushtetuese të cilat njohin të drejtën e popullit për zgjedhjen e legjislaturës, si dhe cenojnë aspektin e lirë dhe vetjak të votës, për sa kohë përcaktimi i përfaqësuesve u është lënë tërësisht partive politike dhe kryetarëve të tyre. Nenet 68, 71 dhe 72/2/d të Kodit Zgjedhor (*i ndryshuar*) janë në kundërshtim me nenin 45/4 të Kushtetutës, për shkak se nënshkrimi i një zgjedhësi në mbështetje të një partie politike për të qenë në listën e partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e përgjithshme apo ato vendore cenon aspektin e fshehtësisë së votës.

3.2 Neni 166/1 i Kodit Zgjedhor është në kundërshtim me nenin 45/4 të Kushtetutës, për shkak se parashikimi në këtë dispozitë i një kandidati fitues vetëm me një raund zgjedhjesh në rastin kur ai merr më pak se 50% +1 të votave, cenon parimin e barazisë së votës.

4. Subjekti i interesuar Kuvendi i Republikës së Shqipërisë parashtrori se kërkesa duhet rrëzuar si e pabazuar, duke pretenduar se:

4.1 Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* për të iniciuar këtë shqyrtim kushtetues, pasi nuk arrin të justifikojë interesin e tij, në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës. Kjo sepse shkaqet në kërkesë i referohen të drejtës themelore të lirisë së votës që Kushtetuta i njeht individit (*e drejta aktive e votës*) dhe jo të drejtës për t'u zgjedhur, si një e drejtë pasive e subjekteve zgjedhore, ku përfshihet edhe kërkuesi.

4.2 Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* për pretendimet që lidhen me dispozitën objekt shqyrtimi, e cila parashikon se kryetarët e bashkive ose komunave zgjidhen me një raund të vetëm, pavarësisht se në zgjedhjet e tyre kanë marrë pjesë më pak se 50% +1 e votuesve. Ky parashikim është përfshirë në nenin 166 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ligj i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe nuk ka pësuar asnjë ndryshim me ligjin nr. 74, 19.07.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008". Për rrjedhojë, pretendimet janë paraqitur në tejkalim të afatit 3-vjeçar të parashikuar nga neni 50 i ligjit nr. 8577 datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

4.3 Dispozitat e Kodit Zgjedhor që përcaktojnë sistemin

proporcional me lista të mbyllura janë në pajtim të plotë me Kushtetutën, pasi ky sistem është sanksionuar dhe gjen pasqyrim në nenin 68/1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

4.4 Dispozitat e kundërshtuara nga kërkuesi e që lidhen me detyrimin e partive politike që nuk zotërojnë asnjë mandat përfaqësimi, që për të paraqitur listat e kandidatëve për zgjedhjet e organeve përfaqësuese ato duhet të mbështeten nga një numër i caktuar zgjedhësish, janë në pajtim të plotë me Kushtetutën, pasi ky detyrim jo vetëm i është nënshtruar edhe më parë testit kushtetues (*shih vendimin nr. 32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*), por është sanksionuar dhe del edhe nga vet fryma e Udhëzimeve dhe Raportit Shpjegues të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias.

4.5 Dispozitat e Kodit Zgjedhor që përcaktojnë se organet përfaqësuese monokratike të njësive të qeverisjes vendore zgjidhen në bazë të një sistemi mazhoritar me një raund, pavarësisht se në zgjedhjet e tyre kanë marrë pjesë më pak se 50% +1 e votuesve, nuk e cenojnë aspektin e barazisë së votës, pasi në thelb ato pasqyrojnë standardet e vendosura në jurisprudencën kushtetuese lidhur me barazinë e votës.

5. Subjekti i interesuar Këshilli i Ministrave kërkoi rrëzimin e kërkesës, duke u ndalur veçanërisht në këto pretendime:

5.1 Kërkuesi nuk legjitimohet në kërkesat e tij. Jurisprudenca italiane e referuar në kërkesë nuk mund të shërbejë si argument për rastin në fjalë, pasi janë dy çështje cilësisht të ndryshme. Ajo që e bën të ndryshme çështjen e shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese Italiane, me vendimin nr. 1 të vitit 2014, është çështja e legjitimitit, pasi në këtë çështje në cilësinë e kërkuesit rezulton një shtetas italian, i cili ka kaluar shkallët e gjykimit të zakonshëm dhe vetëm pasi Gjykata e Lartë ka gjykuar se ndodhej përpara një çështjeje kushtetuese, çështja është referuar në Gjykatën Kushtetuese. Ndërsa në rastin në shqyrtim, kërkuesi, si subjekt politik, legjitimohet për të paraqitur kërkesë vetëm kur një rregullim i tillë hyn direkt në interesat e ligjshme apo pozitën e tij si person juridik.

5.2 Neni 68/1, i cili edhe pse flet në mënyrë të drejtpërdrejtë për zgjedhjet e përgjithshme, është qartësisht në frymën e Kushtetutës. I njëjti rregullim vlen edhe për zgjedhjen e këshillave vendorë, për aq sa ata janë të ngjashëm me zgjedhjet parlamentare.

5.3 Ligji zgjedhor është në vetvete si çdo ligj tjetër që ka

avantazhet dhe disavantazhet e tij. Në këtë kuptim, edhe sistemi mazhoritar mund të sjellë deformime në zgjedhjen e një kryetari bashkie (*pra të zgjedhurit vendor*) apo në kalimin e pragut minimal për marrjen e një mandati përfaqësues në Kuvend.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuessit

6. Gjykata vlerëson se kërkuessi legjitimohet *ratione personae*. Ai është person juridik i regjistruar si parti politike në bazë të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, me vendimin nr. 2747, datë 21.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës. Në kuptim të nenit 134/f të Kushtetutës, “*partitë politike*” janë subjekte që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për çështje që lidhen me interesat e tyre. Sipas kërkesës së paraqitur në Gjykatën Kushtetuese, ky subjekt politik ka deklaruar se dispozitat e kundërshtuara si të papajtueshme me Kushtetutën kanë cenuar mundësinë për përfaqësimin e tij në Kuvend në zgjedhjet e 23 qershorit 2013, si dhe po cenojnë mundësinë e saj për përfaqësim në zgjedhjet vendore të vitit 2014, si për sa u përket organeve kolegjiale të qeverisjes vendore, ashtu edhe kryetarëve të njësive vendore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Pra në këtë rast bëhet fjalë për pjesëmarrjen e kërkuessit në zgjedhjet e përgjithshme, çka është plotësisht në misionin, qëllimin dhe interesin kryesor të një partie politike.

7. Kërkuessi legjitimohet *ratione temporis* vetëm për pretendimet që lidhen me dispozitat e ligjit ndryshues nr. 74, datë 19.07.2012, për të cilat rezulton se kërkesa është paraqitur brenda afatit 3-vjeçar të parashikuar nga neni 50 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Si rrjedhim, pretendimet e kërkuessit lidhur me nenet 106/1, 117/2/3, 118/1/c, 163, 165 dhe 166 të Kodit Zgjedhor, të cilat rezultojnë të pandryshuara nga ligji nr. 74, datë 19.07.2012, nuk mund t'i nënshtrohen shqyrtimit në themel.

8. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vlerëson se është rasti të ritheksojë qëndrimin e saj se në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet që parashikohen

në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet funksionit e veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Partitë politike janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës si një ndër subjektet që e ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Ato kanë legjitimitet kushtetues vetëm për ato çështje që lidhen me interesat e tyre. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, partitë politike paraqiten si bashkime vullnetare mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit. Partitë politike në sistemin e zgjedhjeve e veçanërisht në procesin zgjedhor, që nga fushata parazgjedhore, paraqitja e kandidatëve, formimi i trupave zgjedhore, ndjekja e zgjedhjeve e deri te ndarja e mandateve, paraqiten si një faktorë përcaktues shumë të rëndësishëm. Prandaj, si demokracia përfaqësuese, edhe sistemi i zgjedhjeve nuk mund të paramendohen pa ekzistencën dhe funksionimin e partive politike. Ky pozicion i veçantë që partitë politike kanë në raport me zgjedhjet, përcakton njëkohësisht edhe interesin e tyre për të pasur një legjislacion dhe rregulla sa më të qarta e të drejta (*shih vendimin nr. 1, datë 07.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi bazën e këtij arsytimi, Gjykata vlerëson legjitimitimin e kërkuesit në rastin në shqyrtim.

B. Për pretendimin e cenimit të lirisë së votës

9. Kërkuesi pretendon se nenet 67/1/5/6, 73/4, 98/3/4 dhe 164 të Kodit Zgjedhor, të cilat rregullojnë aspekte të sistemit proporcional me lista të mbyllura, si për zgjedhjet e përgjithshme në Kuvend, ashtu edhe për ato të organeve kolegjiale në zgjedhjet vendore, janë në kundërshtim me nenet 2 dhe 45 të Kushtetutës. Sipas kërkuesit, këto dispozita cenojnë shprehjen e sovranitetit popullor duke deformuar marrëdhënien mes votuesve dhe deputetëve, si dhe mes votuesve dhe përfaqësuesve në organet e tyre kolegjiale të qeverisjes vendore. Sipas kërkuesit kjo lidhet me faktin se sistemi zgjedhor shqiptar i mundëson votuesit vetëm emrat e partive politike dhe jo listat nominale të kandidatëve, duke kufizuar në këtë mënyrë edhe lirinë e votuesve për zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre, që është një nga shprehjet kryesore të sovranitetit popullor.

10. Neni 2 i Kushtetutës, duke sanksionuar sovranitetin e popullit si një parim të rëndësishëm kushtetues, në pikën 2 përcakton edhe mënyrën e ushtrimit të tij nëpërmjet përfaqësuesve ose drejtpërsëdrejti. Gjykata ka theksuar se në një shtet kushtetues, ideja e një pushteti i cili nuk përballet me detyrime dhe kufizime që burojnë nga Kushtetuta, nuk mund të pranohet. Sovraniteti i popullit, i vendosur në kuadrin e një sistemi kushtetues e ligjor, nuk mund të ngatërrohet me pushtetin themelor dhe kërkesa për të ndjekur disa procedura të veçanta gjatë ushtrimit të tij është tërësisht në përputhje me sovranitetin popullor. Kushtetuta e Shqipërisë në mënyrë të qartë e ka lidhur ushtrimin e sovranitetit popullor me rregulla të veçanta. Është e vërtetë se në përputhje me nenin 2, pika 1, të Kushtetutës “sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i takon popullit”. Por, ky deklaram nuk nënkupton ushtrimin e sovranitetit nga populli në mënyrë të pakushtëzuar. Një nen i Kushtetutës duhet të interpretohet në kontekstin e Kushtetutës si një e tërë dhe jo i izoluar. Paragrafi në vijim i të njëjtit nen deklaron se “*populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërdrejt*”. Nga interpretimi literal dhe historik i këtij paragrafi Gjykata ka çmuar, se kushtetutëbërësi ka shprehur një preferencë të qartë në favor të demokracisë përfaqësuese (*shih vendimet nr. 25 datë 24.07.2009 dhe nr. 31, datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Përfaqësimi i popullit në Kuvend bëhet sipas nenit 64 të Kushtetutës nëpërmjet zgjedhjes së deputetëve me sistem proporcional me zona zgjedhore shumëmemërore. Konkretisht, në nenin 68 të Kushtetutës parashikohet: “Kandidatët për deputetë paraqiten në nivel zone zgjedhore nga partitë politike, koalicionet zgjedhore të partive politike, si dhe nga zgjedhësit. Një kandidat mund të paraqitet vetëm për një nga subjektet propozuese, sipas kësaj pike. Renditja e kandidatëve për deputetë në listat shumëmemërore nuk mund të ndryshohet pas paraqitjes së listës në komisionin zgjedhor përkatës”. Kjo frymë e hartuesit për të sanksionuar sistemin zgjedhor në Kushtetutë është paraprirë edhe nga debati kushtetues, ku është mbajtur qëndrimi se sistemi i zgjedhjeve është menduar të ngrihet në Kushtetutë, pasi është parë tendenca për ndryshimin e ligjit zgjedhor (...).”

12. Ngritja e një sistemi zgjedhor që garanton fshehtësinë, lirinë dhe barazinë e votës, u siguron shtetasve qenien e tyre

politikisht aktivë, duke formuar në këtë mënyrë thelbin e rolit që ata duhet të kenë në një sistem demokratik nëpërmjet ushtrimit të votës. E drejta e votës është një nga të drejtat themelore politike që gëzon individi. Kontributi kryesor i saj është garantimi i mundësisë për të gjithë zgjedhësit, pa bërë dallime mbi baza shtresash apo përkatësie në grupe të caktuara shoqërore ose mbi baza të tjera, që të ndikojnë në formimin e vullnetit politik në një shoqëri demokratike. Nga ushtrimi i të drejtës së votës nuk duhet përjashtuar asnjë pjesë sado e vogël e popullsisë, përveç rasteve të përcaktuara në ligjin themeltar të shtetit (*shih vendimin nr. 40, datë 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Si barazia e votës, ashtu dhe barazia e konkurruesve në zgjedhje, që është konkretizimi i shanseve politike të barabarta, janë të domosdoshme për realizimin e një procesi zgjedhor të drejtë. Subjekte përfituese të këtij parimi janë zgjedhësit, nga njëra anë, si dhe konkurruesit në zgjedhje, nga ana tjetër, ku përfshihen partitë politike, koalicionet e partive, kandidatët e tyre, si dhe kandidatët e pavarur (*shih vendimin nr. 1, datë 7.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit lidhen në thelb me depozitimin e listës së kandidatëve dhe koalicioneve të partive në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga njëra anë, dhe përmbajtjen e fletës së votimit, nga ana tjetër. Çështja e depozitimit të listave dhe renditja e kandidatëve për deputetë, gjen pasqyrim kryesisht në nenin 67 të Kodit Zgjedhor ku parashikohet: “1. *Partia politike, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve (...).*”

5. *Emrat në listën e partisë paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Numri i kandidatëve në listën shumemërore të një partie të regjistruar si subjekt zgjedhor më vete apo numri i përgjithshëm i kandidatëve të një koalicioni nuk duhet të jetë më i vogël sesa numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse. Për një parti pjesëtare të koalicionit, numri i kandidatëve nuk mund të jetë më i vogël sesa gjysma e mandateve që zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse. Për listat shumemërore për këshillat e bashkisë dhe të komunës zbatohet i njëjti rregull (...).*” Ky rregull përforcohet më tej në nenin 73/1 të Kodit Zgjedhor ku parashikohet: “1. *Emrat në listat shumemërore dhe renditja e*

tyre nuk mund të ndryshohen pas miratimit përfundimtar nga ana e KQZ-së ose, sipas rastit, KZAZ-së, sipas pikës 2 të këtij neni”. Ndërsa momenti i dytë lidhet me përmbajtjen e fletës së votimit, e cila parashikohet në nenin 98 të ligjit me këtë përmbajtje: *“3. Emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronjat nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Çdo subjekti që renditet në fletën e votimit i korrespondon hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi. 4. Partitë pjesëtare në një koalicion zgjedhor shënohen të renditura njëra pas tjetrës në pjesën e fletës së votimit që i përket koalicionit zgjedhor. Për secilën nga partitë politike të koalicionit shënohen emri i partisë, sigla, shkronjat nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Çdo partie politike anëtare të koalicionit i korrespondon hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi. Radha e renditjes së tyre përcaktohet në mënyrë të rastësishme nëpërmjet shortit.*

14. Gjykata, bazuar në përmbajtjen e këtyre dispozitave, vëren se ato pasqyrojnë rregullime kushtetuese për sistemin zgjedhor, siç është neni 73/1 i Kodit Zgjedhor, apo janë norma të autorizuara nga Kushtetuta, që në nenin 68/2 të saj parashikon: *“Në ligjin për zgjedhjet përcaktohen edhe kriteret, edhe rregulla të tjera të nevojshme për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, duke përfshirë ato për regjistrimin e zgjedhësve, zhvillimin e fushatës zgjedhore, administrimin, vlefshmërinë e zgjedhjeve dhe shpalljen e rezultateve të tyre”.* Në këtë kuptim, detyrë e Gjykatës nuk është të vihet në rolin e ligjvënësit pozitiv dhe të përcaktojë rregullimet ligjore, por të kontrollojë nëse zgjidhja që jep ligjvënësi nëpërmjet përcaktimeve të kriterëve ligjore [...] është ose jo në përputhje me dispozitat e Kushtetutës (*shih më gjerë vendimin nr. 1, datë 07.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Nisur nga fakti se argumenti kryesor i kërkuesit në mbështetje të këtij pretendimi lidhet me cenimin e lirisë së votës, Gjykata përpara se të vlerësojë respektimin e këtij aspekti kushtetues nga ligjvënësi, çmon të ndalet paraprakisht në sqarimin e konceptit “votim i lirë”. Duke iu referuar Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, kuptimi i votimit të lirë përfshin dy aspekte të ndryshme, formimi i lirë i vullnetit të zgjedhësit dhe liria e shprehjes së këtij vullneti, domethënë liria e procedurës së votimit dhe vlerësimi i

saktë i rezultatit. Liria e zgjedhësve për të formuar vullnetin e tyre është e ndërthurur pjesërisht me parimin e shanseve të barabarta. Ky aspekt, kërkon që shteti dhe autoritetet publike, në përgjithësi, të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të paanshme, veçanërisht për sa i përket përdorimit të mediave, vendosjes së afisheve zgjedhore, të drejtës për të demonstruar në sheshe publike dhe financimit të partive dhe kandidatëve. Liria e zgjedhësve për të shprehur vullnetin e tyre kërkon, para së gjithash, zbatimin rigoroz të procedurës së votimit. Në praktikë, zgjedhësit duhet të kenë mundësi të votojnë për listat e regjistruara ose për kandidatët, gjë që do të thotë se atyre duhet t'u vihen në dispozicion fletët e votimit me emrat e kandidatëve dhe t'u krijohet mundësia të hedhin fletët e votimit në kutitë e votimit. Shteti duhet të sigurojë mjediset e duhura për kryerjen e veprimeve zgjedhore.

16. Gjykata vëren se lidhur me aspektin e parë të “votimit të lirë”, e që lidhet me formimin e lirë të vullnetit të zgjedhësve, kërkuesi nuk ka argumentuar në nivel kushtetues se në ç'mënyrë është cenuar ky aspekt nga hartimi i listave të mbyllura apo përmbajtja e fletës së votimit. Për më tepër, ky aspekt i ushtrimit të lirë të votës konsiston më së shumti në përgjegjësi tekniko - organizative që u atashohen autoriteteve shtetërore, se sa në elementet substanciale të procesit të depozitimit të kandidaturave. Ndërsa, lidhur me aspektin e dytë që lidhet me lirinë e shprehjes së këtij vullneti (*liria e procedurës së votimit*), duke analizuar në tërësi përmbajtjen e Kodit Zgjedhor, Gjykata vëren se ligji parashikon një sistem bazë të publikimit të listave zgjedhore me emrat e kandidatëve dhe për rrjedhojë votuesit paraprakisht mund të njihen me to. Sipas nenit 73/3 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja e publikon listën e plotë të kandidatëve në media dhe në faqen zyrtare të saj në internet. Një kopje e listës për çdo zonë zgjedhore i dërgohet prefektit, këshillit të qarkut dhe KZAZ-ve, të cilat e publikojnë atë në mediat vendore dhe e shpallin në vende publike në zonën e tyre, sipas udhëzimeve të marra nga KQZ-ja.

17. Duke konsideruar sa më sipër, Gjykata arrin në konkluzionin se argumentet e paraqitura nga kërkuesi për të mbështetur cenimin e lirisë së votës janë të pabazuara, si rrjedhim ky pretendim i kërkuetit nuk qëndron.

C. Për pretendimin e cenimit të fshehtësisë së votës

18. Kërkuesi pretendon se detyrimi që vendos Kodi Zgjedhor në lidhje me mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse nga ana e partive politike që nuk kanë deputetë në Kuvend, është një cenim i hapur i fshehtësisë së votës dhe identifikimit të vullnetit politik e paraprak të votuesve. Në nenin 68 të këtij kodi parashikohet se partitë politike dhe koalicionet që nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend apo në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore duhet të mbështeten nga një numër i caktuar zgjedhësish. Mënyra se si do të provohet mbështetja rregullohet nga neni 71 i Kodit Zgjedhor, sidomos nga pika 2 e tij, që parashikon një mënyrë të detajuar, e cila e individualizon çdo mbështetës. Sipas kërkuesit, përcaktimi i këtyre kriterëve ligjore mbështetëse e vendos atë si subjekt politik në pozitë jo të barabartë në raport me subjektet e tjera zgjedhore.

19. Gjykata rithekson se parashikimi i kriterëve ligjore mbështetëse për partitë politike pa përfaqësim në Kuvend lidhet drejtpërdrejt me parimin e konkurrimit të lirë të partive politike në një proces zgjedhor. Në koncept, ky parim përfshin detyrimin e shtetit për të respektuar shanset e barabarta të të gjitha partive dhe zbatohet në legjislacionin që rregullon kushtet e këtij konkurrimi, si dhe në konfliktet ndërmjet pjesëmarrësve në të. Duke qenë se një efekt i tillë ndikon në respektimin e parimit të barazisë, Gjykata vlerëson se çfarëdolloj ndërhyrjeje nga ligjvënësi mbi këto kushte duhet të udhëhiqet nga interesi publik. Ligjvënësi e ka të ndaluar t'i trajtojë palët në mënyrë të dallueshme nga njëra-tjetra, përveçse kur ekzistojnë arsye të forta përjashtimore për ta bërë këtë (*shih vendimin nr. 32 datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata ka vlerësuar se zgjedhjet kanë si objektiv të mundësojnë zgjedhësit të zgjedhin përfaqësuesit e tyre, por edhe të sjellin një Kuvend me shumicë të qëndrueshme, që në vijim të mund të prodhojë legjislacion dhe të mundësojë një qeverisje efektive. Një sistem proporcional, tërësisht i pakufizuar përballë partive të vogla, mund të ketë potencialisht pasoja destabilizuese¹. Trajtimi i pabarabartë i partive, duke dalluar ndërmjet tyre partitë brenda dhe jashtë Kuvendit, bëhet për mbrojtjen e votuesit nga

1. *Entscheidungen des Bundesverfassungsgerichts. Volume 1, pp.247-248.*

shpërdorimi i votës. Gjykata ka vlerësuar se është një vullnet i ligjshëm i legjislatorit të kërkojë mbrojtjen e votuesit, në mënyrë që ai të mos ia japë votën një kandidati ose oferte të pashpresë. Një sistem zgjedhor që mundëson oferta zgjedhore, mund të funksionojë vetëm nëse paraqitja e një oferte nuk është thjesht e drejta e gjithkujt, pa asnjë përgjegjësi të mëtejshme. Vetëm një ofertë që merret seriozisht është një ofertë me kuptim. Numri i nënshkrimeve që duhet të mbliidhen sigurisht që mbetet një atribut i ligjvënësit për ta përcaktuar, por ky përcaktim duhet të jetë i drejtë. Gjykata ka vlerësuar se ky numër nënshkruesish nuk duhet të jetë aq i ulët sa të lejojë gjithkënd të marrë pjesë në konkurrim(...), por edhe të mos jetë aq i lartë sa ta bëjë praktikisht të pamundur apo të vështirë për një parti të re pjesëmarrjen në zgjedhje (shih më gjerë vendimin e shkurtit të vitit 1956 për ligjin zgjedhor të Baden-Württemberg të Gjykatës Kushtetuese Gjermane; *Entscheidungen des Bundesverfassungsgerichts*. Volume 4, pp.381-384.), (shih vendimin nr. 32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

21. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut edhe pse evidenton rëndësinë e padiskutueshme të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore”, ku parashikohet se palët e larta kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës, në qëndrimet e mbajtura në jurisprudencë shprehet se sado të rëndësishme të jenë të drejtat e përmendura në këtë nen, ato nuk janë absolute, për më tepër, kur një dispozitë e tillë i njeh këto të drejta pa i listuar shprehimisht dhe pa i përkufizuar, ka vend për disa “kufizime të nënkuptuara” (shih vendimin e GJEDNJ-së *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt v. Belgium*).

22. Kuptimi i “kufizime të nënkuptuara” sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1 paraqet një nevojë për të përcaktuar rëndësinë e qëllimeve të ndjekura nëpërmjet kufizimit të të drejtave të garantuara nga kjo dispozitë. Duke pasur parasysh se neni 3 i Protokollit nr. 1 nuk paraqet një listë të përcaktuar të “qëllimeve të ligjshme”, siç janë ato të përcaktuara në nenet 8 deri në 11 të Konventës, shtetet kontraktuese janë të lira që për të justifikuar një kufizim të mbështeten në një qëllim që nuk figuron në këtë listë, me kusht që pajtueshmëria e këtij qëllimi me parimin e shtetit të së drejtës

dhe objektivat e përgjithshme të Konventës të provohet sipas rrethanave të veçanta të një çështjeje specifike. Sipas GJEDNJ-së koncepti i “kufizimeve të nënkuptuara”, sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1, nënkupton, gjithashtu, se Gjykata nuk zbaton testin tradicional të “domosdoshmërisë” ose të “nevojës urgjente sociale”, të cilat janë përdorur në kontekstin e neneve 8 deri në 11 të Konventës. Në vlerësimin e pajtueshmërisë me nenin 3 të Protokollit nr. 1, Gjykata mbështetet, kryesisht, në dy kritere: nëse ka pasur një abuzim apo mungesë proporcionaliteti dhe nëse kufizimi ka cenuar shprehjen e lirë të mendimit të popullsisë (*shih vendimin e GJEDNJ-së Ždanoka v. Latvia* § 115). Në lidhje me këtë, Gjykata gjithmonë ka theksuar hapësirën e gjerë të vlerësimit që gëzojnë shtetet kontraktuese. Për më tepër, Gjykata ka theksuar nevojën e vlerësimit të çdo legjislacioni zgjedhor nën dritën e evoluimit politik të vendit në fjalë, me pasojën se disa karakteristika që janë të papranueshme në një sistem mund të justifikohen në një tjetër (*shih vendimet e GJEDNJ-së Mathieu-Mohin dhe Clerfayt v. Belgium, si dhe Podkolzina v. Polonia*).

23. Vendosja e detyrimit për nënshkrimet mbështetëse për partitë pa përfaqësim në parlament nuk është një instrument i panjohur kufizues, ai është sanksionuar edhe në Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore. Sipas këtij kodi detyrimi për të mbledhur një numër të caktuar firmash për të paraqitur kandidaturën është teorikisht në përputhje me parimin e votimit universal.

24. Parimi i votimit universal nuk e ndalon ligjvënësin që të vendosë kushte specifike për kandidaturat. Ligjvënësi ka të drejtë që duke përcaktuar përkrahjen e nevojshme për një kandidaturë në zgjedhjet për Asamblenë Kombëtare të garantojë se në garën zgjedhore mund të marrin pjesë vetëm kandidatët dhe pjesëmarrësit në lista, për të cilët është evidentuar se kanë të paktën një mundësi reale minimale të marrjes së një mandati (...). Kjo siguron mbikëqyrjen e zgjedhjeve dhe e bën më të lehtë fushatën zgjedhore, si dhe parandalon rrjedhjen e votave (*shih vendimin nr. 36/96, datë 4.03.1999 të Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë*).

25. Duke iu rikthyer analizës konkrete të çështjes, Gjykata konstaton se kushti ligjor i mbështetjes së kandidaturave në zgjedhje me anë të nënshkrimeve i është nënshtruar edhe më

parë kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 32, datë 21.06.2010 dhe nr. 28, datë 09.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se kjo vendimmarrje është reflektuar në punën e ligjvënësit, i cili miratoi ndryshime në Kodin Zgjedhor edhe për sa u përket nënshkrimeve mbështetëse, duke ulur numrin e kërkuar, si dhe duke thjeshtuar procedurat e mbledhjes së tyre. Në këtë kuptim, kërkuesi jo vetëm nuk ka paraqitur argumente të reja në kërkimet e tij para Gjykatës, por edhe qëndrimi i tij i shprehur në seancë plenare për të hequr nga ligji zgjedhor kriterin e nënshkrimeve mbështetëse, nuk ndjek frymën e standardeve dhe praktikave ndërkombëtare të shtjelluara më sipër.

26. Për më tepër kërkuesi nuk arriti të bazojë në argumente cenimin e fshehtësisë së votës gjatë procesit të votimit. Fshehtësia e votës është një aspekt i lirisë së zgjedhjes, qëllimi i së cilës është të mbrojë zgjedhësit nga presioni me të cilin ata mund të ballafaqohen në rast se të tjerët mësojnë se për kë kanë votuar. Fshehtësia duhet të aplikohet për të gjithë procedurën dhe veçanërisht ne hedhjen e fletëve të votimit e numërimin e votave. Zgjedhësit kanë të drejtë për ta pasur atë, por duhet ta respektojnë edhe vetë. Për zgjedhësin, fshehtësia e votimit nuk është vetëm një e drejtë, por edhe detyrë, mospërmbushja e së cilës duhet të ndëshkohet me shkualifikimin e çdo flete votimi kur zbulohet përmbajtja e saj. a) Votimi duhet të jetë mbi baza individuale. b) Votimi me familje dhe çdo lloj forme kontrolli i një zgjedhësi ndaj votës së tjetrit duhet të ndalohet. c) Lista e personave që faktikisht kanë votuar nuk duhet të botohet. d) Shkelja e fshehtësisë së votës duhet të ndëshkohet (*shih për më gjerë Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore dhe Raportin Shpjegues të Komisionit të Venecias*). Në këtë kuptim, Gjykata vëren se procedura e votimit është e parashikuar në nenet 104 e vijues të Kodit Zgjedhor në mënyrë tërësore dhe të mëvetësishme nga procedura e mbledhjes së nënshkrimeve. Procedura e parashikuar në nenin 106 të këtij kodi garanton fshehtësinë e votës.

27. Si përfundim, duke iu referuar konkluzioneve të arritura më lart, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk arriti të provojë antikushtetutshmërinë e dispozitave të Kodit Zgjedhor objekt kërkesë, për rrjedhojë kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “a”; 134, paragrafi 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës².

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIM PARALEL

1. Gjykata ka rrëzuar kërkesën e Partisë Aleanca Kuq e Zi (AK) me objekt shfuqizimin e disa dispozitave të Kodit Zgjedhor si të papajtueshme me Kushtetutën. Pavarësisht se në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës, kemi mendim të ndryshëm për sa u takon shkaqeve për këtë qëndrim, sepse mendojmë se kërkesa duhej rrëzuar për moslegjitimit të kërkuarit për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

2. Gjykata e ka vlerësuar çështjen e legjitimitetit të kërkuarit (*locus standi*) si një nga aspektet kryesore që lidhen me inicimin e gjykimit kushtetues të normës (kontrolli abstrakt). Kushtetuta, në nenin 134/1, shkronja “f”, parashikon si subjekte që mund ta vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese edhe “partitë politike”. Pra, partitë politike legjitimohen *ratione personae* në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës.

3. Megjithatë, kjo e drejtë është e kushtëzuar, ajo mund të ushtrohet vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre. Pra vetëm nëse e përmbushin kushtin e kërkuar nga paragrafi 2 i nenit 134 të Kushtetutës për të argumentuar “interesin e tyre” në një “çështje të veçantë”, subjektet e listuara në shkronjat “dh”, “e”, “ë” dhe “f” të

2. Gjyqtarët F. Lulo dhe S. Berberi janë shprehur me mendim paralel

nenit 134/1 legjitimohen *ratione materiae* për t'iu drejtuar Gjykatës në lidhje me kompetencën e saj për të vendosur, në këtë rast, mbi pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 17, datë 25.07.2008*).

4. Gjykata ka theksuar se interesi duhet provuar. Për këtë qëllim kërkuesi duhet, së pari, të saktësojë se në çfarë cilësie vepron kundër dispozitës së kundërshtuar dhe, më pas, të vërtetojë se në çfarë mënyre mund të preket në një aspekt të çfarëdoshëm të situatës së tij, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës së tij dhe normës që kundërshton (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 16, datë 25.07.2008*). Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.02.2007; nr. 11, datë 04.04.2007; nr. 35, datë 10.10.2007; nr. 41, datë 16.11.2007; nr. 9, datë 19.03.2008; nr. 16, datë 25.07.2008 dhe nr. 2, datë 28.04.2009*).

5. Me anë të këtij detyrimi, për të provuar interesin konkret për çështjen kushtetuese të ngritur, synohet identifikimi i të drejtës së shkelur të subjektit, si rrjedhojë e antikushtetutshmërisë në përmbajtje të normës juridike të kundërshtuar. Pra, interesi konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Për të vlerësuar legjitimitimin e subjektit, Gjykata përcakton fillimisht të drejtën kushtetuese të subjektit që pretendohet se i është cenuar nga norma konkrete e kundërshtuar para saj. Subjektet e parashikuara në nenin 134, pika 1, të Kushtetutës legjitimohen të kërkojnë antikushtetutshmërinë e normës juridike në qoftë se vetë norma ka cenuar ndonjë të drejtë ose liri kushtetuese nga ato që subjekti legjitimohet t'i mbrojë para Gjykatës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 09.07.2009*).

6. Në lidhje me legjitimitimin e partive politike, Gjykata ka vlerësuar se ato mund ta vënë këtë Gjykatë në lëvizje atëherë kur kundërshtojnë dispozitat e akteve normative, të cilat cenojnë statusin e tyre kushtetues dhe bashkë me të edhe pjesëmarrjen në ushtrimin e vullnetit shtetëror. Për këtë arsye, Gjykatës i takon të shqyrtojë nëse një organ kushtetues ka cenuar të drejtat e partive politike nëpërmjet aktit normativ të nxjerrë prej tij. Në këtë rast,

partia politike legjitimohet në kërkimet e saj nëse bëhet fjalë për respektimin nga ana e një organi kushtetues të statusit të saj që rrjedh nga Kushtetuta, gjatë procesit zgjedhor, si p.sh. financimi i partive politike nga shteti, dhënia e shansit të barabartë të gjitha partive për të marrë pushtetin, etj. Për partinë politike, si subjekt i cilësuar nga dispozita e nenit 134/1/f, lidhen me interesat e saj të gjitha ato akte përmbajtja e të cilave sjell pasoja negative për veprimtarinë e saj kushtetuese në kuadër të formimit të vullnetit politik (*shih vendimin nr. 15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, konstatojmë se Gjykata është vënë në lëvizje nga subjekti Partia Aleanca Kuq e Zi (AK), i cili është person juridik i regjistruar si parti politike në bazë të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike". Pretendimet e paraqitura prej tij para Gjykatës adresohen kryesisht në drejtim të cenimit të dy parimeve kushtetuese të së drejtës zgjedhore, përkatësisht: votimi *i lirë* dhe votimi *i fshehtë*. Konkretisht, kërkuesi pretendon se nenet 67/1/5/6, 73/4, 98/3/4 dhe 164 të Kodit Zgjedhor, të cilat rregullojnë aspekte të sistemit proporcional me lista të mbyllura, si për zgjedhjet e përgjithshme në Kuvend, ashtu edhe për ato të organeve kolegjiale në zgjedhjet vendore, cenojnë shprehjen e sovranitetit popullor duke deformuar marrëdhënien mes votuesve dhe deputetëve, si dhe mes votuesve dhe përfaqësuesve në organet e tyre kolegjiale të qeverisjes vendore. Sipas kërkuesit kjo lidhet me faktin se sistemi zgjedhor shqiptar i mundëson votuesit vetëm emrat e partive politike dhe jo listat nominale të kandidatëve, duke kufizuar në këtë mënyrë edhe lirinë e zgjedhjes së votuesve në zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre, që është një nga shprehjet kryesore të sovranitetit popullor. Gjithashtu, detyrimi që vendos Kodi Zgjedhor në lidhje me mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse nga ana e partive politike që nuk kanë deputetë në Kuvend, është një cenim i hapur i fshehtësisë së votës dhe identifikimit të vullnetit politik e paraprak të votuesve.

8. Në kuptim të standardeve të përmendura më lart, Partia Aleanca Kuq e Zi duhet të provojë se dispozitat ligjore të kundërshtuara kanë sjellë pasoja të pafavorshme (ose ekziston një rrezik real për ardhjen e pasojave të tilla), të drejtpërdrejta mbi të, mbi veprimtarinë që kjo parti ushtron sipas statutit, si p.sh financimi

i partive politike nga shteti dhe dhënia e shansit të barabartë të gjitha partive për të marrë pushtetin, çështje për të cilat kërkuesi legjitimohet t'i mbrojë para Gjykatës.

9. Nisur nga natyra e çështjeve të pretenduara para Gjykatës, rezulton se nëpërmjet tyre kërkuesi pretendon mbrojtjen e parimeve kushtetuese të së drejtës së votës. Kushtetuta në nenin 45 parashikon të drejtën e votës si një nga të drejtat themelore politike që gëzon individ. Kjo e drejtë ushtrohet nëpërmjet ngritjes së një sistemi zgjedhor që garanton fshehtësinë, lirinë dhe barazinë e votës, duke u siguruar shtetasve qenien e tyre politikisht aktive e duke formuar në këtë mënyrë thelbin e rolit që duhet të kenë ata në një sistem demokratik. E drejta e votës është një element qendror i demokracisë dhe i shtetit të së drejtës. *(shih vendimet nr. 1, datë 07.01.2005 dhe nr. 40, datë 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese)* Në këtë kuptim, mbrojtja e saj si pjesë e të drejtave të zgjedhësve nuk hyn në fushën e interesit të ngushtë të kërkuetit. Për rrjedhojë, në rastin konkret nuk ndodhemi përpara një cenimi të drejtpërdrejtë dhe konkret të veprimtarisë së kërkuetit, por përpara një interesi ligjor të përgjithshëm dhe abstrakt. Kushtetuta parashikon subjekte të posaçme që mund ta realizojnë një qëllim të tillë, sipas nenit 134/1, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të Kushtetutës, pa qenë nevoja e justifikimit të interesit.

10. Vetëm fakti që kërkuesi kundërshton dispozitat e Kodit Zgjedhor, pra të ligjit që rregullon zgjedhjet, nuk nënkupton detyrimisht se ai legjitimohet a priori t'i drejtohet kësaj Gjykate. Qenia e tij subjekt zgjedhor nuk do të thotë se ka legjitimet të pakufizuar. Partia politike që kërkon shfuqizimin e një akti normativ duhet të provojë interesin e drejtpërdrejt në çështje dhe të argumentojë pasojat negative të ardhura ose të pritshme (me sigurinë dhe jo me probabilitetin se do të ndodhin) që asaj i vijnë nga zbatimi i normave që kundërshton në Gjykatë.

11. Në këtë kuptim, për sa më lart u parashtrua, mendojmë se kërkuesi nuk arriti të justifikojë interesin e tij për çështjen, si rrjedhim kërkesa duhej rrëzuar për shkak të moslegjitimitit të tij.

Anëtarë: Fatos Lulo, Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka rrëzuar kërkesën e Partisë Aleanca Kuq e Zi për antikushtetutshmërinë e neneve 67, pikat 1, 5 dhe 6; 68; 71; 72, shkronja “d” e pikës 2; 73, pika 4; 98, pikat 3 dhe 4; 106, pika 1; 117, pikat 2 dhe 3; 118 shkronja “c” e pikës 1; 163 pikat 5 dhe 6; 164; 165, pika 2 dhe 166, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Kërkuesi pretendon se nenet e lartpërmendura, të cilat rregullojnë aspekte të sistemit proporcional me lista të mbyllura, si për zgjedhjet e përgjithshme në Kuvend, ashtu edhe për ato të organeve kolegjiale në zgjedhjet vendore, bien ndesh me nenet 2 dhe 45 të Kushtetutës, sepse cenojnë shprehjen e sovranitetit popullor duke deformuar marrëdhënien mes votuesve dhe deputetëve, si dhe mes votuesve dhe përfaqësuesve në organet e tyre kolegjiale të qeverisjes vendore.

3. Sikurse pranon edhe shumica, mendoj se ky pretendim i kërkuesit ka të bëjë me depozitimin e listës së kandidatëve dhe koalicioneve të partive në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga njëra anë, dhe përmbajtjen e fletës së votimit, nga ana tjetër (*shih paragrafin 13 të vendimit*). Shumica, duke iu shmangur pretendimit të mësipërm, e ka mbështetur analizën e dispozitave të Kodit Zgjedhor të kundërshtuara si antikushtetuese, vetëm në raport me rregullimet e parashikuar në nenet 64 dhe 68 të Kushtetutës, duke arritur në përfundimin se dispozitat në fjalë janë norma të autorizuara nga Kushtetuta (...), prandaj pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë së votës nuk është i bazuar (*shih paragrafët 14 dhe 17*).

4. Argumentet e shumicës për ta rrëzuar pretendimin në fjalë me arsyet e mësipërme më duken formale dhe si të tilla nuk janë në koherencë me vlerat themelore që Kushtetuta përcakton dhe mbron në një shtet të së drejtës. Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se në rastin konkret, pretendimi i kërkuesit është i drejtë, dhe, për rrjedhojë, duhej vendosur pranimi pjesërisht i kërkesës.

5. Parimi i sovranitetit të popullit është pjesë e vlerave themelore të mbrojtura nga Kushtetuta, i cili, për rëndësinë që ka në

sistemin tonë kushtetues, garantohet që në nenin 2 të saj. Parimi i ushtrimit të sovranitetit nga populli nënkupton që asnjë individ apo organ i qeverisjes nuk mund të pretendojë një legjitimitet të pavarur në ushtrimin e funksioneve shtetërore, për shkak se legjitimiteti këtyre organeve u është deleguar nga populli si titullar i sovranitetit.

6. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti (neni 2, paragrafi 2 i Kushtetutës). Në bazë të këtij parashikimi kushtetues, neni 70, paragrafi 1 i Kushtetutës sanksionon se *“deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues”* dhe neni 109, paragrafi 1 se *“organet përfaqësuese të njësive bazë të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilët zgjidhen çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë”*. Pra, të drejtën për të ushtruar funksionin ligjvënës, populli, normalisht, nuk e ushtron vetë në mënyrë të drejtpërdrejtë, por nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur prej tij. Në një demokraci përfaqësuese, qytetarët përfshihen në procesin përzgjedhës si të deputetëve të Kuvendit, ashtu edhe të organeve përfaqësuese të qeverisjes vendore.

7. Në këtë aspekt, zgjedhjet parlamentare dhe ato vendore janë ndër përbërësit më thelbësorë dhe ndërkohë një moment tepër delikat dhe i rëndësishëm për demokracinë si formë e qeverisjes. Vetëm përmes tyre mund të bëhet realitet parimi i rëndësishëm i sovranitetit të popullit, si dhe konstituimi demokratik i pushtetit qendror dhe vendor. Prandaj është e domosdoshme që ato të jenë të lira dhe në përputhje të plotë me kërkesat kushtetuese dhe standardet ndërkombëtare bashkëkohore. Në këtë këndvështrim mendoj se të gjitha organet dhe mekanizmat kushtetues dhe shtetërorë kanë për detyrë të garantojnë me prioritet dhe realisht këto kërkesa, duke qëndruar njëkohësisht sa më të paanshëm dhe objektivë gjatë gjithë këtij procesi.

8. Neni 45, paragrafët 1 dhe 4, i Kushtetutës përcakton se *“çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet”* dhe se *“vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë”*. Ngritja e një sistemi zgjedhor që garanton fshehtësinë, lirinë dhe barazinë e votës, u siguron shtetasve qenien e tyre politikisht aktive duke formuar në këtë mënyrë thelbin e rolit që duhet të kenë ata në një sistem

demokratik nëpërmjet ushtrimit të votës. E drejta e votës është një nga të drejtat themelore politike që gëzon individi. Kontributi kryesor i saj është garantimi i mundësisë për të gjithë zgjedhësit që të ndikojnë në formimin e vullnetit politik në një shoqëri demokratike (*shih vendimin nr. 40, datë 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Sipas doktrinës, liria e votës, ngushtësisht e lidhur me fshehtësinë e saj, nënkupton detyrimin për legjislatorin që të përcaktojë modalitete të ushtrimit të së drejtës së votës që garantojnë, në mënyrën më të plotë, mundësinë për të shprehur, pa asnjë kusht apo ndikim, vullnetin elektorale të subjektit³. Sigurisht që gjatë fushatës elektorale subjektet zgjedhore kanë të drejtë që me mjete e mënyra të ligjshme, me programin dhe alternativat që ofrojnë, të përpiqen të ndikojnë sa më shumë te zgjedhësit për të siguruar votën e tyre. Por, ky proces duhet të jetë i lirë dhe i hapur, sepse në përfundim të këtij procesi, çdo zgjedhës krijon vullnetin e tij politik dhe merr vendimin përkatës për të votuar.

10. Ky parim është sanksionuar edhe në nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sipas të cilit *“Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë, në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e trupit ligjvënës”*.

11. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në çështjen Özgürlük Ve Dayanışma Partisi (ÖDP) kundër Turqisë, aplikimi nr. 7819/03 (shih § 27-31) është shprehur se neni 3 i Protokollit nr. 1 mishëron një parim karakteristik të një demokracie politike efektive dhe për rrjedhojë është i një rëndësie primare në sistemin e Konventës (*shih Mathieu-Mohin dhe Clerfayt kundër Belgjikë, 2 mars 1987, § 47, Seria A nr. 113*). Roli i Shtetit, si garant i fundit i pluralizmit, përfshin marrjen e masave pozitive për të “organizuar” zgjedhje demokratike *“në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të njerëzve në zgjedhjen e trupit ligjvënës” (ibid., § 54)*.

3. Paolo Caretti, Ugo de Siervo, *“Istituzioni di diritto pubblico”*, G. Giappichelli Editore, faqe 100.

12. Në këtë kontekst, “shprehje e lirë e mendimit të popullit”, sikurse ka theksuar Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut në disa raste, do të thotë se zgjedhjet nuk mund të zhvillohen nën çfarëdo formë presioni në zgjedhjen e një ose më shumë kandidatëve, dhe se në këtë zgjedhje votuesi nuk duhet të jetë i detyruar padrejtësisht për të votuar për një parti ose një tjetër (*shih X. kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 7140/75, vendim i Komisionit, datë 6 tetor 1976, Vendimet dhe Raportet (DR) 7, fq. 95*).

13. Gjithsesi, të drejtat e sanksionuara në nenin 3 të Protokollit nr. 1 nuk janë absolute. Ka vend për “kufizime të nënkuptuara” dhe Shteteve Kontraktuese duhet t’u jepet një hapësirë e gjerë vlerësimi në këtë fushë (*shih Matthews kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], nr. 24833/94, § 63, ECHR 1999-I dhe Labita kundër Italisë [GC], nr. 26772/95, § 201, ECHR 2000-IV*). Nga ana tjetër, është detyrë e Gjykatës të përcaktojë, si mjet i fundit, nëse kërkesat e nenit 3 të Protokollit nr. 1 janë respektuar. Në këtë kontroll ajo duhet të shqyrtojë që kufizimet e caktuara mbi të drejtën për të votuar dhe për t’u kandiduar në zgjedhje nuk i kufizojnë të drejtat në fjalë në një masë të tillë që të cenojnë thelbin e tyre, si dhe të pengojnë efektivitetin e tyre (*shih Mathieu-Mohin dhe Clerfayt, cituar më lart*).

14. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, mendoj se nën dritën e parimeve të sanksionuara nga GJEDNJ-ja, të mishëruara në jurisprudencën e kësaj Gjykate, si dhe në nenet 2 dhe 45 të Kushtetutës, edhe Gjykata duhej të analizonte nëse dispozitat e kundërshtuara të Kodit Zgjedhor kanë cenuar thelbin apo efektivitetin e tyre, pra nëse është cenuar parimi i lirisë së votës, i lidhur ngushtë me parimin e sovranitetit të popullit. Gjithashtu, Gjykata, për shkak të lidhjes midis objektivit të kërkesës dhe neneve të tjera të Kodit Zgjedhor, bazuar në nenin 48/2 të ligjit organik të saj (ligj nr. 8577, datë 10.02.2000), këtë kontroll duhej ta shrinte edhe në ato nene të Kodit Zgjedhor të cilat lidhen me çështjen e depozitimit të listave dhe të renditjes së kandidatëve për deputetë apo për anëtarë të organeve kolegjiale të qeverisjes vendore, pra të shqyrtonte në tërësi sistemin zgjedhor.

15. Nga sa më lart, jam i mendimit se çështjet që duhet t’i nënshtroheshin debatit kushtetues gjejnë pasqyrim në nenet e mëposhtme të Kodit Zgjedhor:

neni 67, pika 1 dhe 5: *“1. Partia politike, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve..... 5. Emrat në listën e partisë paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. (...) Për listat shumemërore për këshillat e bashkisë dhe komunës zbatohet i njëjti rregull”;*

neni 106, pika 1: *“Pasi merr fletën e votimit, zgjedhësi hyn i vetëm në dhomën e fshehtë dhe në fletën votimit shënon në krah të emrit të subjektit zgjedhor apo partisë pjesëtare të një koalicioni shenjën “x” ose “+” apo një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij”;*

neni 117, pika 2: *“Vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore apo partinë politike pjesëtare të koalicionit në fletën përkatëse të votimit”;*

neni 163 lidhur me vlerësimin që bën KQZ-ja, si dhe përcaktimin e mandateve nominale për çdo parti politike sipas renditjes në listë;

neni 164 lidhur me zëvendësimin e vakancës pas ndërprerjes së mandatit, i cili i kalon kandidatit vijues;

neni 165, pika 2: *“Anëtarët e këshillave të bashkisë dhe të komunave zgjidhen në bazë të listave shumemërore të paraqitura nga partitë politike, koalicionet, ose të kandidaturave të propozuara nga zgjedhësit”;*

neni 166, pika 3: *“Mandatet e këshillave vendorë ndahen nga KQZ-ja në bazë të sistemit proporcional, sipas të njëjtave procedurave të parashikuara në nenet 162 dhe 163 të këtij Kodi”*

16. Nisur nga këto parashikime, më rezulton se dispozitat e kundërshtuara, që përcaktojnë mënyrën e shprehjes së votës për zgjedhjen e kandidatëve për deputetë apo për anëtarë të organeve kolegjiale të qeverisjes vendore, përfshihen në një kontekst normativ në bazë të të cilit vota shkon për zgjedhjen e listës, të përzgjedhur dhe të prezantuar sipas një renditjeje të caktuar nga partitë politike apo nga kryetari i saj. Në këtë kuadër, dispozitat e kundërshtuara përjashtojnë çfarëdo mundësie për votuesit që të ndikojnë në zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre në Parlament apo në organet e qeverisjes vendore duke deformuar në këtë mënyrë thelbin e sistemit politik.

17. Në vijim të këtij arsytimi, jam i mendimit se shumica nuk mund ti anashkalonte këto aspekte dhe ta bazonte vendimin e saj vetëm në përcaktimet e neneve 64 dhe 68 të Kushtetutës, të cilat parashikojnë sistemin zgjedhor proporcional me zona zgjedhore shumemërore, me lista të mbyllura. Në një situatë të tillë para Gjykatës qëndronte detyrimi për t'i dhënë përgjigje një “përplasjeje” të dukshme, që vihet re në çështjen në shqyrtim, midis parimeve themelore kushtetuese, në rastin konkret parimit të sovranitetit të popullit dhe ushtrimit të lirë të së drejtës së votës, nga njëra anë, dhe rregullimeve të tjera kushtetuese, pra sistemit zgjedhor të parashikuar nga nenet 64 dhe 68 të Kushtetutës, nga ana tjetër. Për rrjedhojë, fakti se sistemi proporcional me lista shumemërore të mbyllura është i parashikuar në Kushtetutë, nuk duhej të ishte pengesë për shqyrtimin e antikushtetutshmërisë së dispozitave të kundërshtuara të Kodit Zgjedhor në raport me parimet themelore të Kushtetutës, pra me parimin e sovranitetit të popullit dhe shprehjes së lirë të vullnetit të zgjedhësve.

18. Në ndryshim nga shumica, në gjykimin tim parashikimet e neneve 64 dhe 68 të Kushtetutës nuk mund të prevalojnë mbi parimet themelore të sanksionuara nga Kushtetuta. Sikurse Gjykata ka theksuar, rendi juridik nuk përbëhet nga norma juridike të barasvlershme apo me të njëjtën fuqi juridike, përkundrazi ai është një sistem i shkallëzuar, ku normat e të drejtës renditen në bazë të fuqisë juridike që kanë (*shih vendimet nr.19, datë 03.05.2007 dhe nr. 10, datë 06.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Pra, e njëjta gjë mund të thuhet edhe për parimet e sanksionuara në Kushtetutë. Ato nuk mund të kenë asnjëherë të njëjtën vlerë kushtetuese, por i nënshtrohen një sistemi vlerash të ndryshme.

19. Lidhur me vlerën e parimeve kushtetuese, Gjykata Kushtetuese Italiane në vendimin nr. 1146/1988 është shprehur se Kushtetuta italiane përmban disa parime supreme që nuk mund të përmbysen apo modifikohen në përmbajtjen e tyre thelbësore edhe nga ligjet për amendamentet kushtetuese ose nga ligjet e tjera kushtetuese. Këto janë jo vetëm parimet që vetë Kushtetuta në mënyrë eksplicite parashikon si kufizime absolute ndaj rishikimit

kushtetues, të tilla si forma e republikës (neni 139 i Kushtetutës), por edhe parimet të cilat, edhe pse nuk janë të përmendura shprehimisht ndërmjet atyre që nuk i nënshtrohen procesit të rishikimit kushtetues, i përkasin thelbit të vlerave të larta ku mbështetet Kushtetuta italiane, ndër të cilat edhe ai i sovranitetit të popullit (*shih vendimin nr. 18/1982*). Gjykata Kushtetuese Italiane tashmë në shumë vendime të saj ka theksuar se parimet supreme të rendit kushtetues kanë një vlerë më të lartë se standardet ose normat e tjera të rangut kushtetues. Për rrjedhojë, nuk mund të mohohet se kjo Gjykatë është kompetente të kontrollojë pajtueshmërinë e ligjeve të rishikimit të kushtetutës, si dhe të ligjeve të tjera kushtetuese me parimet e larta të rendit kushtetues. Përndryshe, e kundërta do të çonte në rezultatin absurd që sistemi i garancive të Kushtetutës të konsiderohej jo efektiv në lidhje me standardet e tij me vlerë të lartë.

20. Edhe Gjykata Kushtetuese Gjermane në jurisprudencën e saj është shprehur se Ligji Themelor është një sistem vlerash, në të cilin ka evidentuar disa parime si parime supreme. Parimet më të larta të këtij sistemi vlerash janë të mbrojtura ndaj ndryshimeve kushtetuese, dhe si të tilla Ligji Themelor ka parashikuar nenet 1⁴, 20⁵, 79, paragrafi 3⁶ të tij (*shih vendimin BVerfGE 6, 32*)⁷. Në këtë aspekt, Gjykata ka theksuar se mbrojtjen e lirisë dhe të dinjitetit njerëzor e njeh si qëllimin më të lartë të të gjithë sistemit të së drejtës (*shih vendimet BVerfGE 12, 45 [51]; 28, 175 [189] dhe BVerfGE 33, 1*)⁸. Ky qëndrim është përforcuar më tej nga Gjykata kur është shprehur se në sistemin e vlerave të Ligjit Themelor dinjiteti i njeriut është vlera më e lartë (*BVerfGE 6, 32 [41] dhe BVerfGE 27, 1*). Shteti në asnjë masë, madje as edhe me një ligj, nuk lejohet të shkelë dinjitetin e njeriut ose të prekë lirinë e personit në thelbin e saj⁹.

4. Mbrojta e dinjitetit human.

5. *Strukturat politike dhe sociale, mbrojta e rendit kushtetues. Ky nen garanton edhe sovranitetin e popullit, sepse përcakton se Republika Federale e Gjermanisë është një shtet federal demokratik dhe social (paragrafi i parë) dhe se çdo pushtet publik buron nga populli (paragrafi 2).*

6. *Rishikimi i Ligjit Themelor.*

7. *Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, faqe 70, paragrafi 2/c.*

8. *Po aty, faqe 57, paragrafi 2.*

9. *Po aty, faqe 104, paragrafi 2/1.*

21. Nga sa më lart, përfundimi që nxirret është se në një gjykim kushtetues, në rast të një “përplasjeje” midis parimeve themelore të sanksionuara nga pjesa e parë e Kushtetutës, në rastin konkret, parimi i sovranitetit të popullit dhe çështjeve të tjera të trajtuara në pjesët vijuese të saj, kanë përparësi të parat, si vlerat më të larta ku mbështetet Kushtetuta dhe rendi ynë demokratik. Respektimi i tyre lidhet me themelet dhe qëndrueshmërinë e sistemit politik, i cili në rastin në shqyrtim për shkak të rregullimeve të kundërshtuara si antikushtetuese, paraqitet i deformuar.

22. Çështja e kushtetutshmërisë së normave për zgjedhjen e deputetëve (të parashikuara nga dekreti i të Presidentit të Republikës nr. 361/1957), është trajtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese Italiane në vendimin nr. 1/2014, e cila është shprehur se dispozitat e kundërshtuara, duke përcaktuar se vota e shprehur nga zgjedhësit, e destinuar për të zgjedhur të gjithë anëtarët e Parlamentit, është një votë që zgjedh listën, përjashtojnë çfarëdolloj të drejte të zgjedhësit në zgjedhjen e përfaqësuesve të tij. Një formulim i tillë ligjor privon votuesit nga çdo lloj hapësire zgjedhjeje të përfaqësuesve të tyre, zgjedhje që i është lënë tërësisht partive politike. Kritere të tilla të votimit, që u imponojnë zgjedhësve, duke zgjedhur një listë, të zgjedhin “në bllok” të gjithë kandidatët e renditur në të, të cilët nuk kanë pasur mundësi që t’i njohin dhe t’i vlerësojnë dhe që automatikisht, për shkak të pozicionit të tyre në listë, bëhen deputetë (apo senatorë), bëjnë që ky sanksionim nuk mund të krahasohet me sisteme të tjera të karakterizuara nga lista të bllokuara vetëm për një pjesë të vendeve në Kuvend dhe as me të tjera që karakterizohen nga zona zgjedhore me dimensione administrative – territoriale të vogla, në të cilat numri i kandidatëve për të zgjedhur është i tillë që garanton njohjen efektive të tyre nga ana e zgjedhësve dhe bashkë me të efektivitetin e zgjedhjes dhe lirinë e votimit (sikurse ndodh edhe për rastet e kolegjeve njemërore).

23. Si përfundim, mendoj se nenet 67, pika 1 dhe 5; 106, pika 1; 117, pika 2; 163; 164; 165, pika 2 dhe 166, pika 3, të Kodit Zgjedhor duke parashikuar një kuadër rregullator sipas të cilit votimi zhvillohet mbi lista kandidatësh sipas një renditjeje të caktuar dhe të pandryshueshme, bëjnë që partitë të zëvendësojnë vullnetin e zgjedhësve, çka bie ndesh me parimin e sovranitetit të popullit dhe

të lirisë së votës, të sanksionuara respektivisht në nenet 2 dhe 45 të Kushtetutës. Po ashtu ato bien ndesh edhe me nenet 70/1 dhe 109 të Kushtetutës, që përcaktojnë se deputetët dhe organet e qeverisjes vendore janë funksionarë politikë që zgjidhen nëpërmjet votës së popullit dhe përfaqësojnë zgjedhësit.

24. Në këtë këndvështrim mendoj se kërkesa e Partisë Aleanca Kuq e Zi duhej pranuar.

Anëtar: Vladimir Kristo

* * *

INDEKS

A

- afat ligjor (V.11/1996, fq. 27; V.20/1996, fq. 42; V.23/1996, fq. 49)
- afat për paraqitjen/shqyrtimin e ankimeve (V.6/1994, fq. 13)
- Akti Final i Helsinkit (V.3/2003, fq. 162)
- anëtar i komisionit të zgjedhjeve (V.38/1996, fq. 62)
- antikushtetueshmëri e dispozitës (V.40/2007, fq. 193; V.11/2015, fq. 242)
- anulim:
 - i mandatit (V.40/1997, fq. 92)
 - i vendimit (V.24/1996, fq. 52)
- Avokati i Popullit (V.40/2007, fq. 193)

B

- balotazh (V.27/1997, fq. 72; V.33/1997, fq. 82; V.35/1997, fq. 86; V.42/1997, fq. 95; V.59/1997, fq. 97)
- barazi:
 - e votës (V.11/2015, fq. 242)
 - në fuqi zgjedhore (V.32/2010, fq. 202)
 - në konkurim (V.16/1997, fq. 67)
 - në votën numerike (V.32/2010, fq. 202)
 - në votime (V.16/1997, fq. 67)
 - në zgjedhje (V.32/2010, fq. 202)
 - para ligjit (V.16/1997, fq. 67; V.32/2010, fq. 202)
 - proporcionale (V.32/2010, fq. 202; V.28/2012, fq. 216)
 - strikte (V.32/2010, fq. 202 ; V.28/2012, fq. 216)
- blerje e votës (V.3/2003, fq. 162)
- bojkotim i detyrës (V.38/1996, fq. 62)
- (i) burgosur (V.40/2007, fq. 193)

C

- cenim:
 - aktual/potencial i të drejtës së votës (V.40/2007, fq. 193)
 - i rëndë (V.32/1997, fq. 80)

D

- deklarata të nënshkruara (V.29/1997, fq. 76)
- deklarim i votimit si të pavlefshëm (V.6/1994, fq. 13)
- demokraci:
 - përfaqësuese (V.32/2010, fq.202; V.28/2012, fq. 216; V.11/2015, fq. 242)
 - politike (V.11/2015, fq. 242)
- depozitim individualisht i nënshkrimit (V.32/2010, fq. 202)
- diferenca e votave/ndërmjet kandidatëve (V.35/1997, fq. 86; V.42/1997, fq. 95; V.3/2003, fq. 162)
- dokument:
 - identifikimi (V.30/1996, fq. 55; V.28/1997, fq. 74)
 - i regjistrimit të kandidatit (V.20/1996, fq. 42)
- (e) drejta:
 - e kandidimit (V.14/1996, fq. 36; V.117/2002, fq. 155)
 - e votës (V.40/2007, fq. 193)
 - e zgjedhjes (V.6/1994, fq. 13; V.32/1997, fq. 80)
 - për të zgjedhur (V.11/2015, fq. 242)
 - për t'u votuar/zgjedhur (V.6/1994, fq. 13; V.32/2010, fq. 202; V.28/2012, fq. 216; V.11/2015, fq. 242)
 - për të votuar (V.32/2010, fq. 202; V.28/2012, fq. 216)

DH

- (të) dhënat e plota të zgjedhësit (V.32/2010, fq. 202)
- dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve (V.3/2003, fq. 162)
- dhomë e fshehtë (V.11/2015, fq. 242)

E

- emërimi i komisioneve të zgjedhjeve të zonave (V.21/1996, fq. 43)

F

- financimi i partive politike (V.28/2012, fq. 216)
- firma:
 - mbështetëse (V.28/2012, fq. 216)
 - të falsifikuara (V.22/1996, fq. 46; V.30/1997, fq. 78)
- fletë:
 - votimi (V.34/1997, fq. 85)
 - votimi falso (V.30/1996, fq. 55)

- fonde publike (V.28/2012, fq. 216)
- fondi i shtetit për fushatë elektorale (V.39/1996, fq. 64)
- fragmentarizim i partive politike (V.32/2010, fq. 202; V.28/2012, fq. 216)
- fshehtësia e votës (V.11/2015, fq. 242)
- fuqi prapavepruese (V.4/1996, fq. 22)

GJ

- gjë e gjykuar (V.28/2012, fq. 216)

H

- heqja:
 - dorë nga kandidimi (V.117/2002, fq. 155)
 - e mandatit të deputetit (V.3/2003, fq. 162)

I

- imunitet (V.38/1996, fq. 62)
- instituti i ankimit (V.10/1996, fq. 25)
- interes:
 - publik (V.28/2012, fq. 216)
 - i subjektit (V.40/2007, fq. 193)
- interpretim *a contrario* (V.28/2012, fq. 216)

J

- juridiksion fillestar/përfundimtar (V.6/1994, fq. 13)

K

- kandidat:
 - fitues (V.28/1997, fq. 74)
 - i pavarur (V.17/1996, fq. 40; V.28/2012, fq. 216)
 - pasues (V.117/2002, fq. 155)
- kandidat/ura zëvendësues/e (V.12/1996, fq. 30; V.1/2004, fq. 173)
- Karta e Parisit për një Evropë të Re (V.3/2003, fq. 162)
- kërcënim (V.29/1997, fq. 76)
- koalicion parazgjedhor (V.32/2010, fq. 202)
- Kodi i Praktikës së Mirë në Fushën e Partive Politike i Komisionit të Venecias (V.28/2012, fq. 216)
- Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i

Komisionit të Venecias (V.28/2012, fq. 216; V.11/2015, fq. 242)

- komision:
 - i qendrës së votimit (V.35/1997, fq. 86)
 - i verifikimit (V.22/1996, fq. 46)
 - i zgjedhjeve të zonës (V.10/1996, fq. 25; V.11/1996, fq. 27; V.30/1996, fq. 55)
- Komisioni Shtetëror për Kontrollin e Figurës së Zyrtarëve dhe Personave të Tjerë (V.14/1996, fq. 36; V.15/1996, fq. 38)
- komitet nismëtar (V.28/2012, fq. 216)
- kompetencat e Gjykatës Kushtetuese (V.34/1996, fq. 58)
- konkurim i lirë (V.28/2012, fq. 216)
- kryetar i njësisë së qeverisjes vendore (V.11/2015, fq. 242)
- kufiri i zonës zgjedhore (V.1/2005, fq. 179)
- kufizime të nënkuptuara (V.11/2015, fq. 242)

L

- legjitimimi:
 - i kërkuesit (V.1/2005, fq. 179)
 - i pakufizuar (V.11/2015, fq. 242)
- ligj:
 - i zakonshëm (V.34/1996, fq. 58)
 - kushtetues (V.34/1996, fq. 58)
- ligjshmëria:
 - e listave (V.32/2010, fq. 202)
 - e zgjedhjeve (V.30/1996, fq. 55)
- liria:
 - e procedurës së votimit (V.11/2015, fq. 242)
 - e votës (V.11/2015, fq. 242)
- lista:
 - e kandidatëve (V.32/2010, fq. 202)
 - e zgjedhësve (V.14/1996, fq. 36; V.22/1996, fq. 46; V.30/1996, fq. 55; V.28/1997, fq. 74; V.34/1997, fq. 85; V.59/1997, fq. 97; V.169/2002, fq. 159; V.28/2012, fq. 216)
 - njëemërore (V.12/1996, fq. 30)
 - proporcionale (V.1/2004, fq. 173)
 - shumëemërore (V.117/2002, fq. 155; V.1/2004, fq. 173)
 - të mbyllura (V.11/2015, fq. 242)

- lokal privat (V.30/1997, fq. 78; V.34/1997, fq. 85)

M

- mandat: (V.28/2012, fq. 216)
 - përfaqësimi (V.11/2015, fq. 242)
 - shtesë (V.40/1997, fq. 92)
- manipulim (V.34/1997, fq. 85)
- mbarim:
 - i mandatit të deputetit (V.3/2003, fq. 162)
 - i parakohshëm i mandatit (V.1/2004, fq. 173)
- monopolizim (V.28/2012, fq. 216)
- moskryerja vullnetarisht e betimit (V.3/2003, fq. 162)
- mospranim për shqyrtim të dokumenteve të kandidimit (V.20/1996, fq. 42)
- mosregjistrim i kandidatëve (V.23/1996, fq. 49)
- mosshpërndarja e materialeve të votimit (V.32/1997, fq. 80)
- moszhvillimi i zgjedhjeve (V.32/1997, fq. 80)
- mungesë juridiksioni (V.35/1996, fq. 60)

N

- ndarja:
 - e mandateve shtesë (V.16/1997, fq. 67; V.117/2002, fq. 155)
 - e zonave zgjedhore (V.40/2001, fq. 100; V.1/2005, fq. 179)
- ndihmë financiare (V.39/1996, fq. 64)
- ndreqje e parregullsive (V.13/1996, fq. 33)
- nënshkrim mbështetës (V.32/2010, fq. 202; V.11/2015, fq. 242)
- noter (V.22/1996, fq. 46; V.32/2010, fq. 202)
- notë e shkruar rekomandë (V.14/1996, fq. 36)
- numri i zgjedhësve:
 - i barabartë (V.40/2001, fq. 100)
 - mesatar (V.40/2001, fq. 100)
 - i përafërt (V.40/2001, fq. 100; V.1/2005, fq. 179)
- numri i votave të vlefshme (V.16/1997, fq. 67)

O

- ofertë e pashpresë (V.32/2010, fq. 202; V.28/2012, fq. 216)

- organet kompetente (V.6/1994, fq. 13)
- organizëm monitorues (V.42/1997, fq. 95)

P

- parimi:
 - i barazisë në zgjedhje (V.28/2012, fq. 216)
 - i barazisë së shanseve për kandidatët (V.1/2005, fq. 179)
 - i barazisë së votës (V.1/2005, fq. 179; V.32/2010, fq. 202; V.28/2012, fq. 216)
 - i integritit (V.28/2012, fq. 216)
 - i konkurrencës së ndershme (V.1/2005, fq. 179)
 - i konkurimit në kushte barazie (V.16/1997, fq. 67)
 - i konkurimit të lirë (V.32/2010, fq. 202)
 - i mosdiskriminimit (V.32/2010, fq. 202; V.28/2012, fq. 216)
 - i përfaqësimit (V.28/2012, fq. 216)
 - i pluralizmit (V.32/2010, fq. 202; V.28/2012, fq. 216)
 - i sovranitetit popullor (V.32/2010, fq. 202)
 - i votës së lirë (V.3/2003, fq. 162)
 - i votimit të përgjithshëm (V.32/2010, fq. 202)
 - i votimit universal (V.32/2010, fq. 202; V.11/2015, fq. 242)
 - i zgjedhjeve të përgjithshme (V.32/2010, fq. 202)
- parregullsi:
 - e dokumentacionit (V.12/1996, fq. 30)
 - në dokumentet e regjistrimit të kandidatit (V.13/1996, fq. 33)
- pavlefshmëri:
 - e rezultatit të zgjedhjeve (V.29/1997, fq. 76)
 - e zgjedhjeve (V.169/2002, fq. 159; V.3/2003, fq. 162)
- përcaktimi i zonave zgjedhore (V.40/2001, fq. 100)
- përfaqësim: (V.32/2010, fq. 202)
 - i barabartë (V.28/2012, fq. 216)
 - i sovranitetit të popullit (V.1/2004, fq. 173)
 - real (V.1/2004, fq. 173)
- përfaqësues në komisionin e zonës së zgjedhjeve (V.17/1996, fq. 40)
- përgjegjësi penale (V.38/1996, fq. 62)

- përmbajtja e fletës së votimit (V.11/2015, fq. 242)
- përsëritja e zgjedhjeve (V.24/1996, fq. 52; V.28/1997, fq. 74; V.29/1997, fq. 76)
- pluralizëm politik (V.32/2010, fq. 202)
- prag:
 - minimal (V.11/2015, fq. 242)
 - mbështetjeje (V.28/2012, fq. 216)
- prishje e vendimit të komisionit të zonës (V.33/1997, fq. 82)
- procesverbal:
 - fiktiv (V.27/1997, fq. 72; V.29/1997, fq. 76)
 - i komisionit të zgjedhjeve të zonës (V.27/1997, fq. 72; V.33/1997, fq. 82; V.36/1997, fq. 89)
 - i qendrës së votimit (V.30/1996, fq. 55; V.33/1997, fq. 82; V.36/1997, fq.89)
 - i votimit (V.34/1997, fq. 85; V.35/1997, fq. 86)
 - i zonave të zgjedhjeve (V.24/1996, fq. 52; V.30/1996, fq. 55)
 - regjistrimi (V.22/1996, fq. 46)
- programi i punimeve të Kuvendit (V.4/1996, fq. 22)
- Protokolli 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (V.3/2003, fq. 162)
- provë shkresore (V.11/1996, fq. 27)
- publikim i listave zgjedhore (V.11/2015, fq. 242)
- punë e detyruar (V.38/1996, fq. 62)

Q

- qëllim legjitim (V.40/2007, fq. 193)

R

- raundi i dytë i zgjedhjeve (V.32/1997, fq. 80; V.59/1997, fq. 97; V.169/2002, fq. 159; V.3/2003, fq. 162)
- regjistrimi:
 - i kandidatëve (V.21/1996, fq. 43; V.22/1996, fq. 46)
 - i subjekteve zgjedhore (V.28/2012, fq. 216)
- rezultat përfundimtar (V.30/1996, fq. 55; V.32/1997, fq. 80; V.42/1997, fq. 95; V.59/1997, fq. 97)

RR

- rregullat e administrimit të zgjedhjeve (V.117/2002, fq. 155)
- rregullorja e Kuvendit (V.4/1996, fq. 22)
- rrjedhja e votave (V.11/2015, fq. 242)

S

- sistem:
 - i përzier (V.1/2004, fq. 173)
 - mazhoritar (V.6/1994, fq. 13; V.1/2004, fq. 173)
 - proporcional (V.16/1997, fq. 67; V.1/2004, fq. 173; V.32/2010, fq. 202; V.28/2012, fq. 216; V.11/2015, fq. 242)
 - zgjedhor (V.1/2004, fq. 173)
- sovraniteti popullor (V.11/2015, fq. 242)
- staf elektoral (V.3/2003, fq. 162)
- subjekt:
 - i legjitimuar (V.1/2005, fq. 179)
 - zgjedhor (V.6/1994, fq. 13; V.10/1996, fq. 25; V.12/1996, fq. 30; V.17/1996, fq. 40; V.117/2002, fq. 155)

SH

- shanse të barabarta (V.32/2010, fq. 202; V.28/2012, fq. 216; V.11/2015, fq. 242)
- shfuqizim i rezultatit të votimit (V.24/1996, fq. 52)
- shkelja e lirisë së votës (V.3/2003, fq. 162)
- shpallja:
 - e pavlefshme e mandatit të deputetit (V.3/2003, fq. 162)
 - e rezultatit të zgjedhjeve (V.11/2015, fq. 242)
 - e zgjedhjeve si të paligjshme (V.34/1997, fq. 85)
- shpenzimet e fushatës zgjedhore (V.28/2012, fq. 216)
- shpërdorim i votës (V.11/2015, fq. 242)
- shprehje direkte e vullnetit të zgjedhësit (V.40/2007, fq. 193)
- shtesa në listën e zgjedhësve (V.3/2003, fq. 162)
- shumë paradhënie (V.39/1996, fq. 64)
- shumicë e qëndrueshme (V.28/2012, fq. 216)

T

- tagër (V.4/1996, fq. 22)
- tejkalim i afatit (V.11/2015, fq. 242)

- tërheqja nga kandidimi (V.117/2002, fq. 155)
- transmetim i aktiviteteve të partive (V.39/1996, fq. 64)

U

- ushtrim i së drejtës së votës (V.40/2007, fq. 193)

V

- vend i vuajtjes së dënimit (V.40/2007, fq. 193)
- vend vakant (V.117/2002, fq. 155)
- vendbanim (V.13/1996, fq. 33; V.40/2007, fq. 193; V.32/2010, fq. 202)
- vendqëndrim (V.40/2007, fq. 193)
- vepër penale (V.3/2003, fq. 162)
- veprime të parregullta (V.6/1994, fq. 13; V.23/1996, fq. 49)
- vërtetim i mandatit (V.6/1994, fq. 13; V.40/1997, fq. 92)
- vëzhgues të huaj (V.35/1996, fq. 60)
- videokasetë (V.3/2003, fq. 162)
- vlefshmëria e mandatit (V.6/1994, fq. 13)
- vota të vlefshme (V.33/1997, fq. 82)
- votë e lirë (V.3/2003, fq. 162)
- votim:
 - i fshehtë (V.11/2015, fq. 242)
 - i lirë (V.11/2015, fq. 242)
 - për anëtarë të familjes (V.169/2002, fq. 159)

Z

- zgjedhës:
 - që kanë marrë pjesë në votime (V.1/2005, fq. 179)
 - të regjistruar (V.59/1997, fq. 97; V.1/2005, fq. 179)
- zgjedhje:
 - e raundit të dytë (V.6/1994, fq. 13)
 - shumëpartiake (V.32/2010, fq. 202)
 - të barabarta (V.32/2010, fq. 202)
 - të lira (V.3/2003, fq. 162; V.32/2010, fq. 202)
 - të ndershme (V.32/2010, fq. 202)
 - të pjesshme (V.169/2002, fq. 159)
- zona:
 - e zgjedhjeve (V.4/1996, fq. 22)

- njëemërore (V.1/2004, fq. 173)
- shumëemërore (V.11/2015, fq. 242)
- zyra e gjendjes civile (V.3/2003, fq. 162)

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

RSH. Gjykata Kushtetuese

Vendime të Gjykatës Kushtetuese me objekt fushën

e zgjedhjeve 1992-2015 / OSBE, RSH.
Gjykata Kushtetuese. –

Tiranë : **Graphic line-01**, 2016

280 f. ; 26X17 cm.

ISBN 978-9928-4311-2-7

1. E drejta kushtetuese 2. Gjykata kushtetuese
3.Vendime gjyqësore 4.Zgjedhje

342.565.2(496.5) "1992/2015"

VENDIME TË KOLEGJIT ZGJEDHOR

**Zgjedhjet për Kuvendin 2013,
Zgjedhjet e pjesshme 2013 dhe
Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2015**

Tiranë, 2016

© Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

ISBN: 978-9928-4311-3-4

Ky botim u realizua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve



Shënim:

Ky botim nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Versioni elektronik i këtij botimi gjendet në faqen e internetit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri
www.osce.org/albania

Dizenjimi grafik dhe shtypi: **Graphic Line-01**
info@graphicline01.com, www.graphicline01.com

Përmbajtja e lëndës

Hyrje

Faqja

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.....	5
Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.....	9

I. Zgjedhjet për Kuvend të datës 23 qershor 2013

1. Vendim nr. 1, datë 03.01.2013	13
2. Vendim nr. 12, datë 03.06.2013	25
3. Vendim nr. 13, datë 10.06.2013	36
4. Vendim nr. 16, datë 22.06.2013	47
5. Vendim nr. 17, datë 22.07.2013	59
6. Vendim nr. 18, datë 25.07.2013	75
7. Vendim nr. 19, datë 26.07.2013	86
8. Vendim nr. 21, datë 27.07.2013	102
9. Vendim nr. 24, datë 31.07.2013	130
10. Vendim nr. 25, datë 01.08.2013	146
11. Vendim nr. 26, datë 02.08.2013	150
12. Vendim nr. 39, datë 22.08.2013	170

II. Zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e Bashkisë Korçë të datës 3 nëntor 2013

13. Vendim nr. 45, datë 18.11.2013.....	178
---	-----

III. Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015

14. Vendim nr. 2, datë 31.03.2015.....	198
15. Vendim nr. 3, datë 14.04.2015.....	207
16. Vendim nr. 5, datë 24.04.2015	211
17. Vendim nr. 7, datë 15.05.2015	240
18. Vendim nr. 8, datë 15.05.2015	260
19. Vendim nr. 9, datë 22.05.2015.....	268
20. Vendim nr. 10, datë 22.05.2015	273
21. Vendim nr. 13, datë 28.05.2015	284

22.	Vendim nr. 14, datë 29.05.2015	303
23.	Vendim nr. 15, datë 29.05.2015	314
24.	Vendim nr. 16, datë 29.05.2015	323
25.	Vendim nr. 17, datë 29.05.2015	331
26.	Vendim nr. 18, datë 05.06.2015	356
27.	Vendim nr. 19, datë 08.06.2015	383
28.	Vendim nr. 20, datë 15.06.2015	409
29.	Vendim nr. 21, datë 19.06.2015	422
30.	Vendim nr. 22, datë 20.06.2015	430
31.	Vendim nr. 23, datë 20.06.2015	439
32.	Vendim nr. 26, datë 09.07.2015	464
33.	Vendim nr. 29, datë 10.07.2015	471
34.	Vendim nr. 33, datë 20.07.2015	502
35.	Vendim nr. 39, datë 27.07.2015	509
INDEKS		531

HYRJE

Të drejtat dhe liritë politike të individit për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur janë tipari kryesor i një sistemi demokratik për të siguruar pjesëmarrjen e individit në jetën politike dhe sociale të vendit. Në Shqipëri zgjedhjet e para pluraliste u zhvilluan në 31 mars 1991 me një kuadër ligjor të paplotë dhe me një botëkuptim ende të paformuar. Që prej asaj kohe, në vendin tonë janë zhvilluar zgjedhje të përgjithshme dhe vendore në mënyrë periodike, shoqëruar këto me ndryshime të shpeshta në legjislacion për të përmirësuar sistemin e përfaqësimit dhe shprehjen e vullnetit të votuesve.

Jemi dëshmitarë se si përgjatë këtyre viteve, pavarësisht reformave të shpeshta dhe ndërhyrjeve jo të pakta në legjislacionin zgjedhor, këto procese zgjedhore janë shoqëruar me ankesa ligjore, retorikë të skajshme politike dhe debate publike. Kam vënë re se në tërësinë e këtyre debateve flitet më së shumti për procedura, dhe shumë pak për parime, duke ndikuar cilësinë e tyre dhe argumenteve të shtjelluara nga organet e drejtësisë.

Nisur nga fakti që ndër vite vendimmarrjet e shqyrtimit të ankesave zgjedhore janë trajtuar nga institucione të ndryshme si: Gjykata Kushtetuese, Kolegji Zgjedhor dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vërehet se interpretimi i ligjeve dhe Kushtetutës nga ekspertë të çështjeve zgjedhore, juristë, studiues të shkencave politike, përfaqësues të partive politike, shoqërisë civile, etj. janë të ndryshme.

Me ndryshimet e dispozitave të Kodit Zgjedhor në vitin 2003, u krijua Kolegji Zgjedhor në Gjykatën e Apelit Tiranë që trajtonte ankesat zgjedhore. Kjo strukturë u ruajt edhe me miratimin e Ligjit të ri Nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" ndërsa ndryshimet e mëvonshme të tij të vitit 2012 formuan një strukturë zgjedhore apolitike, duke u garantuar partive politike influencën në procesin e përzgjedhjes së komisionerëve. Në këtë moment, vihet re se edhe cilësia e debateve juridike si në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ashtu edhe në Kolegjin Zgjedhor njohin cilësi ankesash dhe vendimesh gjithnjë e në rritje bazuar në parime.

Përmbledhja me vendimet e Kolegjit Zgjedhor ka qenë prej kohësh një kërkesë e të gjitha palëve në proces dhe, ndonëse të aksesueshme për publikun e gjerë, komplikohet për personat që nuk janë përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë me zgjedhjet, për të gjetur ekstraktet e vendimeve më të rëndësishme përsa i përket interpretimit specifik të neneve të caktuara të Kushtetutës dhe ligjit. Kjo ka krijuar një boshllëk të vlerësuar nga të gjitha grupet e interesit.

Vendimet e Kolegjit Zgjedhor tashmë kanë krijuar një bazë jurisprudence që shërben për ligjvënësit, partitë politike dhe të gjithë aktorët e interesuar në çështjet zgjedhore për të adresuar sa më mirë problematikat, në koherencë edhe me rekomandimet e strukturave të specializuara monitoruese vendase dhe të huaja. Janë pikërisht këto arsye që kanë përshpejtuar idenë për të botuar në format përmbledhës vendimet e Kolegjit Zgjedhor për zgjedhjet parlamentare dhe vendore të viteve zgjedhore 2013 dhe 2015, të cilat përkojnë me një vendimmarrje koherente me bazën ligjore në fuqi.

Duke qenë se në Kuvendin e Shqipërisë është ngritur Komisioni i Posaçëm i Reformës Zgjedhore, shpresojmë se kjo përmbledhje e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor për mënyrën e trajtimit të zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve zgjedhore, t'i shërbejë këtij Komisioni në punën e tij për reformën zgjedhore.

Botimi “Vendime të Kolegjit Zgjedhor - zgjedhjet për Kuvendin 2013, zgjedhjet e pjesshme 2013 dhe zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2015”, i përgatitur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, përmbledh dhe sistemon gjërësisht të gjithë informacionin e nevojshëm për aktorët dhe faktorët e përfshirë në procese zgjedhore, për çdo studiues, organizatë jofitimprurëse, individ, parti politike, dhe komisioner aktual apo potencial në fushën e zgjedhjeve.

Së fundmi, duke shpresuar se ky koleksion vendimesh të përzgjedhura të Kolegjit Zgjedhor të jetë i dobishëm, orientues dhe i vlefshëm për të gjithë institucionet dhe të interesuarit e përfshirë në çështjet zgjedhore, të shërbejë edhe si një gur kilometrik në funksion

të përmirësimeve të kuadrit ligjor ekzistues zgjedhor për çështjet që mbeten të patrajtuara nga ligji zgjedhor, me synim zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Lefterije Luzi

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

I dashur lexues,

Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë baza e demokracisë. Të gjitha Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, përfshirë Shqipërinë, janë shprehur për vlera dhe angazhime të përbashkëta në fushën e zgjedhjeve dhe të shtetit të së drejtës. Përgjatë viteve, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka ndihmuar institucionet shqiptare që të përmirësojnë proceset zgjedhore dhe i ka fuqizuar ato për t'i organizuar zgjedhjet në mënyrë të pavarur, transparente dhe profesionale, siç i kërkojnë qytetarët.

Në këtë kontekst, Prezenca e OSBE-së në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë përgatitën këtë përmbledhje me vendime të Kolegjit Zgjedhor për çështjet më të rëndësishme që u evidentuan gjatë zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2013 dhe zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015 me qëllim që të shërbejë si mjet praktik referimi për gjyqtarët, ekspertët dhe profesionistët e kësaj fushe.

Ky botim është pjesë e një serie me tre vëllime me vendime për zgjedhjet dhe referendumet. **Vëllimi i parë** përmban vendime të Gjykatës Kushtetuese për zgjedhjet që nga krijimi i saj në vitin 1992. **Vëllimi i dytë** përmban jurisprudencën e Kolegjit Zgjedhor për zgjedhjet e 2013-ës dhe 2015-ës. **Vëllimi i tretë** përmban vendime të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe vendime të gjykatave për referendumet që nga viti 1992.

Kjo seri, e para e këtij lloji në Shqipëri, synon t'i bëjë vendimet e këtyre institucioneve lehtësisht të arritshme për një sërë aktorësh. Ajo jo vetëm informon publikun për vendimet e institucioneve përkatëse lidhur me zgjedhjet dhe referendumet, por edhe ndihmon aktorët kryesorë të zgjedhjeve - përfshirë Kuvendin, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, shoqërinë civile dhe studiuesit - në punën e tyre. Të interesuarit mund të gjejnë kopje të kësaj serie, ndër të tjera, në Kuvend, në Bibliotekën Kombëtare, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës. Atë mund ta gjeni edhe në faqen e internetit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri (www.osce.org/albania).

U jam mirënjohës, si gjithmonë, Kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë si dhe administratës së këtyre institucioneve për partneritetin dhe bashkëpunimin në finalizimin e procesit të përgatitjes së këtij botimi. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri vazhdon të jetë partnere dhe mbështetëse e institucioneve shqiptare në realizimin e aspiratave të vendit.

Robert Wilton

***Kryetar në detyrë
i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri***

**I. Vendime të Kolegjit Zgjedhor
për zgjedhjet për Kuvendin
të datës 23 qershor 2013**



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOLEGJI ZGJEDHOR PRANE GJYKATES SE APELIT
TIRANE

Nr. 1 i Regjistrimit Themeltar

Nr. 1 i Vendimit

VENDIM

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit i përbërë nga:

KRYESUES :	ANDI CIVICI
ANETAR :	GJENOVEFA GABA
ANETAR :	PETRIT CENO
ANETAR :	FUAT VJERDHA
ANETAR :	KLITON SPAHIU

Me sekretare **Zana DISHA**, në Tiranë, sot më datë **03.01.2013**, në seancë gjyqëore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative-zgjedhore me nr.1 Akti, që u përket palëve :

PADITES: **Partia Demokratike e Shqipërisë**, përfaqësuar me autorizim nga Z. Njazi KOSOVRASTI, Ivi KASO, dhe Oerd BYLYKBASHI

I PADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar me autorizim nga Znj. Dëshira PASKO

PERSONI i TRETË: **Partia Socialiste e Shqipërisë**, përfaqësuar me autorizim nga Z.Koli BELE dhe Eridian SALIANJI
Levizja Socialiste për Integrim, (në mungesë)
Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, përfaqësuar me autorizim nga Z.Bledar SKENDERI

OBJEKTI : 1. Kundërshtimi i Vendimit të KQZ-së ne 20 datë 21.12.2012

2. Miratimin e ndarjes së re të zonave të administrimit zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin 2013, sipas propozimit të paraqitur nga Partia Demokratike e Shqipërisë në KQZ (100 zona të administrimit zgjedhor)

BAZA LIGJORE: Nenet 24, 27, 145 e vijues, 180 të ligjit nr.10019 dt.29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i RSH”

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATES SE APELIT TIRANE

Pasi dëgjoji palët prezent në pretendimet e tyre, paditësin nëpërmjet përfaqësuesve që në përfundim kërkuan pranimin e padisë sipas objektit, përfaqësuesen e palës së paditur, që kërkoi pranimin pjesërisht të padisë dhe miratimin e ndarjes së territorit në 89 ZAZ sipas propozimit të KQZ, përfaqësuesit e personit të tretë Partia Socialiste që kërkuan mospranimin e padisë dhe pushimin e gjykimit, përfaqësuesin e personit të tretë Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut që kërkoi rrëzimin e padisë, e si administroi provat e bisedoi çështjen në terësi:

VEREN

Në datën 21.12.2012 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet vendimit Nr.20 ka vendosur: “Të mos miratojë ndarjen e re të Zonave të Administrimit Zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvendin 2013, për mungese të shumicës së cilësuar në vendimmarrje”. Sipas nenit 24 pika 1/f e Kodit Zgjedhor, caktimi i Zonave të Administrimit Zgjedhor (ZAZ), që të konsiderohet i miratuar kërkon që në KQZ të votojnë “pro” jo më pak se 5 anëtarë të tij. Në rastin konkret kanë votuar pro vetëm 4 anëtarë të KQZ.

Paditësi, Partia Demokratike e Shqipërisë, (PD) pretendoi në gjykim se vendimi i mësipërm i KQZ për mosmiratimin e ndarjes së re të ZAZ është marrë në kundërshtim me ligjin, pasi ky i fundit përcakton si detyrë absolute të vet KQZ, ndarjen e re të zonave zgjedhore dhe jo mos ndarjen.

Sipas paditësit në mbledhjen e KQZ, PD propozoi ndarjen e re të ZAZ në 100 zona, duke garantuar kështu respektimin rigoroz

të frymës së Kodit Zgjedhor, rritjen e shpejtësisë së numërimit të votave, transparencës, besueshmërisë së procesit dhe nxjerrjes së rezultatit zgjedhor. Ky numër ZAZ-sh, maksimizon potencialin që japin kriteret e reja ligjore në funksion të mirëadministrimit të zgjedhjeve dhe respekton parashikimet ligjore në pikat 2, 3 dhe 4 të Kodit Zgjedhor. Në kushtet kur KQZ, nuk ka marrë shumicën e cilësuar të kërkuar nga ligji dhe mundësia e mosarritjes së konsensusit mbetet e pandryshuar, paditësi kërkoi gjykimin në themel të çështjes dhe ndarjen e re të zonave të administrimit zgjedhor sipas propozimit të PD në 100 ZAZ, duke i bashkangjitur propozimit edhe skemën e ndarjes së ZAZ.

Pala e paditur KQZ, prapësoi pretendimet e paditësit duke parashtruar se, nëpërmjet aplikimit saktësisht të kriterëve për ngritjen e ZAZ-ve, sipas pikave 2, 3 dhe 4 të nenit 27 të Kodit Zgjedhor dhe duke u mbështetur në të dhënat e dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile për numrin e zgjedhësve, del se nga 66 ZAZ që ishin në zgjedhjet për Kuvend në 2009, në zgjedhjet për Kuvend në vitin 2013 administrata e KQZ-së propozon që numri i ZAZ-ve të bëhet 89 ZAZ.

Kjo ndarje siguron një administrim shumë më efikas të procesit zgjedhor nga niveli i dytë i administratës zgjedhore dhe mbi të gjitha, një numërim shumë më të shpejtë e transparent, në përputhje me standartet ndërkombëtare. KQZ depozitoi propozimin me 89 ZAZ duke i bashkangjitur edhe skemën e ndarjes së ZAZ.

Sipas KQZ, propozimi i paraqitur nga Partia Demokratike, e cila kërkon ndarjen e territorit të Republikës së Shqipërisë në 100 ZAZ është i pambështetur në ligj dhe pikërisht në nenin 27 të Kodit Zgjedhor. Sipas propozimit të Partisë Demokratike kërkohet të ndahen në më shumë se një ZAZ edhe rrethe të cilat janë më pak se 60 mijë zgjedhës, si p.sh ndarja e rrethit Dibër, Kurbin e Krujë me 56.059 zgjedhës, të ndahen në më shumë se një ZAZ, bashki, të cilat janë me më pak se 80 mijë zgjedhës, si psh. Bashkia Fier, Korçë etj, të ndahen në më shumë se një ZAZ, njësitë bashkiake nr. 5 dhe 7, të cilat sipas nenit 27, pika 4 të Kodit Zgjedhor përbëjnë ZAZ më vete, kërkohen të ndahen në 2 ZAZ. Këto propozime janë në kundërshtim me pikën 2, 3 dhe 4 të nenit 27 të Kodit Zgjedhor dhe si të tilla duhet të rrezohen.

Sipas KQZ, propozimi i paraqitur nga Partia Socialiste, i cili kërkon ndarjen e territorit të Republikës së Shqipërisë në 75 ZAZ, jo vetëm që nuk ndihmon në mirëadministrimin e procesit zgjedhor nga komisionet e nivelit të dytë të KZAZ-të, por në të njëjtën kohë bën trajtim të pabarabartë të kritereve të nenit 27 të Kodit Zgjedhor. Sipas propozimit të Partisë Socialiste dhe pse disa rrethe janë me më shumë se 60 mijë zgjedhës p.sh rrethi i Beratit, sipas propozimit kërkohet të rishikohet, ndërsa rrethe si Lushnja, Durrësi, Elbasani, Korca, Shkodra, Kavaja, Vlora, edhe pse kanë më shumë se 60 mijë zgjedhës kërkohet të mos rishikohen. Një rreth sipas propozimit të PS duhet të rishikohet dhe të ndahet në më shumë se një ZAZ dhe rrethe të tjera të mos rishikohen nga KQZ dhe të mos ndahen.

Në seancë gjyqësore përfaqësuesit e personit të tretë Partia Socialiste e Shqipërisë (PS), prapësuan pretendimet e të dy palëve duke parashtruar se padia nuk ka objekt të ligjshëm pasi nuk ka vendim të KQZ që mund të ankimohet. Përfaqësuesit e PS shpjeguan rrethanat e përgatitjes së Projekt-vendimit duke pretenduar se paraprakisht është diskutuar në datën 05.12.2012 projekti me 76 ZAZ dhe PS ka kërkuar më shumë kohë për projektin për të përgatitur propozimet finale, ndërkohë që në datën 07.12.2012 përfaqësuesi i PD në KQZ ka kërkuar kohë për konsultim politik. Pas shtyrjes PD ka kërkuar në rrugë politike konsensus me PS për të shtuar akoma numrin e ZAZ dhe në mbledhjen e datës 21.12.2012 administrata e KQZ paraqiti një projekt të ri për ndarjen në 89 ZAZ.

Sipas PS, propozimi i KQZ në rrethin e Kavajës është në kundërshtim me ligjin pasi atje ka 57.462 zgjedhës, ndërkohë që propozohen 2 ZAZ. Përkundrajt edhe rretheve të tjera të mëdha ku propozohet ndarja me 3 apo 4 ZAZ, në rrethin e Tiranës me 280.959 zgjedhës propozohen vetëm 3 ZAZ. Sipas PS, duhet të vazhdojë negociimi politik midis palëve në respektim të frymës së ligjit.

PS prapësoi pretendimet e palëve duke parashtruar se Kolegji Zgjedhor nuk ka tagër për të gjykuar këtë çështje dhe në kuptim të nenit 145 pika 1 dhe 2 e Kodit Zgjedhor e drejta që pretendohet e shkelur nuk është një e drejtë subjektive e PD e shkelur nga KQZ, por një parashikim ligjor detyrues për KQZ si administrator i zgjedhjeve. Projekti me 89 ZAZ krijon disproporcion dhe asimetri numerike. Vetë ligji detyron KQZ të nxjerrë një akt juridik dhe kriteret e nenit 27 nuk janë *detyruese* por *elastike*.

Sipas PS, Kolegji Zgjedhor nëpërmjet vendimit de facto do të kthehej në administrator të zgjedhjeve. Për këtë arsye edhe në rast të mosmarrjes së një vendimi, ka një ndarje të ZAZ-ve e cila është në fuqi me 66 të tilla.

Në përfundim u prapësua se kërkesë padia e PD është haptazi në kundërshtim me Kodin Zgjedhor ku me flagrante u konstatua ndarja e 4 njësive bashkiake të Bashkisë së Tiranës, të cilat ligji i parashikon si ZAZ unike. U kërkua pushimi i gjyqimit për shkak se ai zhvillohet në mungesë të një shkakut të ligjshëm dhe kërkesa është në kundërshtim të hapur me ligjin material.

Të njëjtat parashtrime në mënyre verbale u paraqitën para Kolegjit edhe nga përfaqësuesi i PBDNJ, i cili sikundër përfaqësuesit e PS kërkoi rrëzimin e padisë dhe pushimin e gjyqimit.

Kolegji Zgjedhor pasi i'a nënshtroi çështjen debatit gjyqësor, dëgjoi palët, administroi provat shkresore dhe pretendimet përfundimtare, në përfundim cmoi të pranoje pjesërisht padinë, duke shfuqizuar vendimin nr.20 datë 21.12.2012 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe të miratojë ndarjen e re të ZAZ në 89 të tilla, sipas propozimit të KQZ.

Kolegji Zgjedhor cmon se ngritja e ZAZ-ve ka një rëndësi të madhe për gjithë procesin zgjedhor. Ngritja e ZAZ ndikon drejtëpërdrejt, në ngritjen dhe funksionimin e KZAZ-ve, të cilat në bazë të kompetencave të dhëna nga Kodi Zgjedhor janë themeli i procesit. Në këto kushte, miratimi i ZAZ-ve do të garantonte zhvillimin normal të procesit zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor cmon se në përputhje me nenin 145 e vijues të Kodit Zgjedhor gëzon tagrin për të marrë në shqyrtim kërkesë padinë e paraqitur nga PD, pasi në rastin konkret ndodhemi përpara një subjekti zgjedhor i cili paraqet ankim kundër vendimit nr.20 datë 21.12.2012 të KQZ.

Neni 145/1/2 i Kodit Zgjedhor parashikon se: *“Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe*

individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.

2. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim. Përrjashtim nga ky rregull bëjnë vendimet e KQZ-së për rrëzimin e kërkesës ankimore në lidhje me vendimet të marra në përputhje me shkronjat “a”, “b” “c” dhe “ç” të nenit 24 të këtij Kodi.”

Prapësimi i paraqitur nga PS se Kolegji Zgjedhor, nuk ka tagër për të gjykuar këtë çështje dhe në kuptim të nenit 145 pika 1 dhe 2 e Kodit Zgjedhor e drejta që pretendohet e shkelur nuk është një e drejte subjektive e PD e shkelur nga KQZ, por një parashikim ligjor detyrues për KQZ si administrator i zgjedhjeve, nuk është i mbështetur në ligj.

Është e qartë se në zbatim të ligjit është detyrë e KQZ caktimi i numrit të ZAZ, por në mungesë të formalizimit të vullnetit të KQZ për shkak të mosarritjes së kuorumit të kërkuar prej 5 votash, me të drejtë propozimi që nuk është miratuar, ka marrë trajtën e vendimit, sikundër rezulton jo vetëm nga akti i zbardhur, por edhe nga procesverbali i mbajtur në KQZ, në faqen 118 të të cilit pasqyrohet se *nuk miratohet akti!* Vendimi nr 20.

Pra ndryshe nga sa prapëson personi i tretë, KQZ e ka formalizuar propozimin nëpërmjet një vendimi, i cili nuk prodhon pasoja vetëm për mos arritjen e kuorumit të kërkuar prej 5 votash “pro”.

Sa më sipër, cilido prej subjekteve zgjedhore ka të drejtën të kontestojë një vendim të tillë, sipas nenit 145 të Kodit Zgjedhor, përsa kohë ligji nuk e ka lidhur këtë mosmiratim, me një procedurë tjetër administrative të parashikuar në Kodin Zgjedhor, për të rimundësuar marrjen e një vendimi sipas ndonjë formule tjetër. Në rastin konkret nuk jemi përpara mosmarrjes së një vendimi brenda afatit ligjor nga KQZ, sikundër parashikohet në nenin 145/2 të Kodit Zgjedhor.

Përcaktimi shterues që i ka bërë vetë ligji, nëpërmjet nenit 24 pika 1 gërma “f” caktimit të zonave të administrimit zgjedhor determinon në mënyrë absolute, një vendimarrje nëpërmjet ankimit nga një instrument ligjor nëpërmjet rekursit administrativ.

Është pikërisht pamundësia shteruese (fakti se në cdo moment KQZ mund të mos garantojë vendimarrje me 5 vota) që ligji ka parashikuar në rastin konkret, ajo që i jep Kolegjit Zgjedhor, diskrecionin e plotë për të shqyrtuar ankimin kundër këtij vendimi, i cili nuk ka prodhuar pasoja vetëm, për shkak të mosmarrjes së 5 votave pro. Ky diskrecion buron nga parashikimi i nenit 145 i Kodit Zgjedhor.

Kolegji vëren gjithashtu se Partia Demokratike gëzon legjitimitimin aktiv për të kontestuar një vendimarrje të tillë, pasi është subjekt zgjedhor i cili ashtu sic përcaktohet në nenin 145 të sipërcituar ka të drejtën e ankimit.

Neni 158 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

1. Në varësi nga çështjet në shqyrtim, Kolegji Zgjedhor vendos:

a) pushimin e gjykimit;

b) gjykimin e çështjes në themel; ose

c) detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim.

2. Pushimi i gjykimit vendoset kur Kolegji Zgjedhor konstaton se ankimi është paraqitur jashtë afateve të përcaktuara në këtë Kod ose për mungesë kompetence. Kur Kolegji Zgjedhor vendos mungesën e kompetencës, ia dërgon çështjen organit kompetent.

3. Me gjykimin e çështjes në themel, Kolegji Zgjedhor vendos pranimin e plotë apo të pjesshëm të padisë ose rrëzimin e plotë apo të pjesshëm të saj.

4. Kolegji Zgjedhor vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim, në zbatim të pikës 2 të nenit 145 të këtij Kodi. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor cakton afat të prerë për marrjen e vendimit jo më të gjatë se 10 ditë.

5. Vendimi i Kolegjit Zgjedhor është i formës së prerë. Ndaj tij nuk bëhet ankim.

6. Kolegji Zgjedhor është i detyruar të zbardhë vendimin jo më vonë se tre ditë nga data e dhënies së tij.

Pretendimi i PS se Kolegji Zgjedhor nuk ka tagër për të shqyrtuar vendimin sepse në thelb akti është inekzistent, nuk mbështetet në asnjë dispozitë të Kodit Zgjedhor, ndërkohë që rasti i pushimit të gjykimit të parashikuar në nenin 158/a të Kodit Zgjedhor, sikundër pretendon PS, parashikohet kur ankimi është jashtë afatit, ose për mungesë kompetence dhe në këtë rast neni parashikon, dërgimin e çështjes organit kompetent.

Ligji në mënyrë të posacme e ka rregulluar rastin kur vendimi i dërgohet KQZ-së, duke e parashikuar atë në pikën 4 të nenit 158 dhe pikës 2 të nenit 145. Nga përmbajtja e ketyre neneve i vetmi rast kur Kolegji i'a kthen cështjen për shqyrtim KQZ, **është atëherë kur KQZ nuk ka marrë vendim brenda afatit ligjor**, ndërkohë që në rastin konkret KQZ ka marrë vendimin nr.20, por ai nuk ka prodhuar pasoja, për shkak të mungesës së numrit të votave pro.

Nga sa më sipër Kolegji Zgjedhor cmon se është në kushtet e parashikuara nga pika 1 gërma "b" e nenit 158 të Kodit Zgjedhor, për gjykimin e cështjes në themel. Është pikërisht karakteri shterues që parashikon ligji në rastin konkret si dhe detyrimi që ka KQZ, për të miratuar numrin e ZAZ sipas gërmës "f", të nenit 24, ajo që e bën të kundërshtueshëm vendimin Nr. 20 datë 21.12.2012. Vendimi i mësipërm duhet të shfuqizohet, pasi ai është marrë në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të ligjit, i cili përcakton detyrimin e KQZ të marrë vendim sipas nenit 24 gërma "f" të Kodit Zgjedhor.

Në bazë të Kodit Zgjedhor, neni 27, pika 5, parashikon se: "Zonat e Administrimit Zgjedhor miratohen nga KQZ-ja jo më vonë se 9 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit, mbi bazën e numrit të shtetasve me të drejtë vote në datën e fundit të periudhës zgjedhore për caktimin e zgjedhjeve, sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Jo më vonë se 10 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon të dhënat KQZ-së, të ndara sipas njësive të qeverisjes vendore". Keto të dhëna KQZ i ka marrë me shkresën e Ministrisë së Brendshme Nr.7375/1, datë 07.11.2012.

Për zgjedhjet e Kuvendit të vitit 2009, në bazë të Kodit Zgjedhor, neni 180, ZAZ-të u miratuan nga Kuvendi si aneksi i Kodit Zgjedhor. Sipas këtij aneksi, territorri i Republikës së Shqipërisë ndahet në 66 ZAZ. Nisur nga eksperiencia e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2009 dhe atyre vendore të vitit 2011, rezultoi se kjo ndarje në 66 ZAZ është e pamjaftueshme për të siguruar një administrim efikas dhe në kohë të të gjithë proceseve zgjedhore në kompetencë të KZAZ-ve dhe në mënyrë të vecantë, nuk siguron një numerim efikas dhe të shpejtë dhe nxjerrje të rezultateve brenda afatit të përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Kjo mungesë efikasiteti, vonesa dhe mbingarkesa në numërim dhe vonesa në nxjerrjen e tabelave të rezultateve për

cdo ZAZ u konstatua edhe nga raportet e vëzhgimit të zgjedhjeve të viteve 2009 dhe 2011 të OSBE/ODIHR-it i cili bëri rekomandimet përkatëse për përmirësimin dhe rritjen e shpejtësisë së procesit të numërimit, raporte të cilat u administruan në gjykim prej Kolegjit Zgjedhor.

Neni 27 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

“1. Zonat e Administrimit Zgjedhor ngrihen dhe funksionojnë për çdo lloj zgjedhjeje dhe referendumi, sipas këtij Kodi.

2. Juridiksioni territorial i ZAZ-ve, si rregull, është i njëjtë me territorin administrativ të bashkisë, sipas ligjit që rregullon organizimin administrativ-territorial të Republikës së Shqipërisë. Bashkitë që kanë më shumë se 80 mijë shtetas me të drejtë vote ndahen nga KQZ-ja në më shumë se sa një Zonë të Administrimit Zgjedhor, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

a) pandashmëria e territorit të njësisë administrative, përjashtuar ato me më shumë se 80 mijë zgjedhës;

b) vazhdimësia dhe kompaktësia e territorit, duke shmangur barrierat gjeografike;

c) mundësi të mira komunikimi brenda territorit;

ç) numër i përafërt zgjedhësish.

3. Asnjë Zonë Administrimi Zgjedhor nuk mund të shtrihet gjeografikisht në dy ose më shumë qarqe.

4. Për Bashkinë e Tiranës, secila nga njësitë bashkiake përbën Zonë Administrimi Zgjedhor më vete.

5. Zonat e Administrimit Zgjedhor miratohen nga KQZ-ja jo më vonë se 9 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit, mbi bazën e numrit të shtetasve me të drejtë vote në datën e fundit të periudhës zgjedhore për caktimin e zgjedhjeve, sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Jo më vonë se 10 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon të dhënat KQZ-së, të ndara sipas njësive të qeverisjes vendore dhe njësive administrative të përfshira në to.

6. KQZ-ja, jo më vonë se 5 muaj para datës së zgjedhjeve, mund të ndryshojë kufijtë e ZAZ-së, sipas kërkesave të këtij neni, vetëm nëse ka ndryshim të kriterëve për caktimin e tyre sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni.”

Në lidhje me themelin e cështjes, Kolegji Zgjedhor nuk e gjen tërësisht të bazuar pretendimin e paditësit në lidhje me ndarjen e territorit në 100 ZAZ, pasi cmon se pavarësisht pretendimit se një

numër i tillë do të shërbejë në rritjen e shpejtësisë së numërimit të votave, transparencës, besueshmërisë së procesit dhe nxjerrjes së rezultatit zgjedhor, në variantin e propozuar nga PD rezultojnë të provuara se sipas këtij propozimi duhet të ndahen në më shumë se një ZAZ, edhe rrethe të cilat janë me më pak se 60 mijë zgjedhës, si psh.: ndarja e rrethit Dibër, Kurbin dhe Krujë me 56.059 zgjedhës. Bashki, të cilat janë me më pak se 80 mijë zgjedhës, si psh.: Bashkia Fier, Korçë etj, të ndahen në më shumë se një ZAZ. Njësitë bashkiake nr. 5 dhe 7, të cilat sipas nenit 27, pika 4 të Kodit Zgjedhor përbëjnë ZAZ më vete, ndahen në më shumë se një ZAZ. Këto propozime janë në kundërshtim me pikën 2, 3 dhe 4 të nenit 27 të Kodit Zgjedhor dhe si të tilla duhet të rrezohen.

Kolegji Zgjedhor cmon se projekt-akti i paraqitur për miratim nga administrata e KQZ-së, i cili parashikon ngritjen e 89 zonave të administrimit zgjedhor, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur, konsiderohet në përputhje me nenin 27 të Kodit Zgjedhor.

Sipas nenit 27, pika 2 të Kodit Zgjedhor, juridiksioni territorial i ZAZ-ve si rregull është i njëjtë me rrethin administrativ. Rrethet që kanë më shumë se 60 mijë zgjedhës ndahen nga KQZ-ja në më shumë se sa një ZAZ duke respektuar kriterin e pandashmërisë së territorit të komunës apo bashkisë, vazhdimësinë dhe kompaktësinë e territorit, barrierat gjeografike, mundësitë e mira të komunikimit dhe numër të përafërt zgjedhësish.

Në bazë të informacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile rezulton se nga 36 rrethe që ka në të gjithë vendin, 22 prej tyre kanë më pak se 60 mijë zgjedhës dhe përbëjnë secili nga një ZAZ, 14 rrethe kanë mbi 60 mijë zgjedhës dhe KQZ me të drejtë i ka ndarë ato në më shumë se një ZAZ.

Gjithashtu në pikën 4 të nenit 27 të Kodit Zgjedhor, në bashkitë që kanë më shumë se 80 mijë shtetas me të drejtë vote, KQZ mund të krijojë dy apo më shumë zona administrimi më vete me numër të barabartë votash, por në cdo rast duke ruajtur vazhdimësinë dhe kompaktësinë e territorit të zonave të Qendrave të Votimit. Nga informacioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile rezulton se bashkitë Durrës, Elbasan, Shkodër dhe Vlorë kanë më shumë se 80 mijë zgjedhës, përkatësisht 159.000 zgjedhës, 97.450 zgjedhës, 88.814 zgjedhës dhe 106.915 zgjedhës, në këto kushte

në përputhje me nenin 27, pika 4 KQZ me të drejtë ka vendosur se në secilën nga këto bashki duhet të ngrihen tre ZAZ më vete.

Në lidhje me rrethet të cilat kanë më shumë se 60 mijë shtetas me të drejtë vote rezulton si më poshtë:

Rrethet Sarandë (76 935 zgjedhës), Gjirokastër (67 167 zgjedhës), Lezhë (74 940 zgjedhës), dhe Pogradec (68 458 zgjedhës) ndahen në dy ZAZ secili. Rrethet që përvec bashkive qendër rrethi në të cilat krijohen ZAZ më vete kanë zgjedhës si më poshtë: Berat (68 175 zgjedhës), Durrës (97 644 zgjedhës), Elbasan (115 082 zgjedhës), Fier (137 239 zgjedhës), Lushnjë (94 832 zgjedhës), Korçë (85 688 zgjedhës), Shkodër (100 918 zgjedhës), Kavajë (57 462 zgjedhës), Tiranë (280 959 zgjedhës), Vlorë (83 290 zgjedhës) në përputhje me nenin 27, pika 2 të ndahen në më shumë se një ZAZ. Rrethi Berat ndahet në 2 ZAZ, Rrethi Durrës ndahet në 3 ZAZ, Rrethi Elbasan ndahet në 4 ZAZ, Rrethi Fier ndahet në 4 ZAZ, Rrethi Lushnjë ndahet në 3 ZAZ, rrethi Korçë ndahet në 3 ZAZ, rrethi Shkodër ndahet në 3 ZAZ, rrethi Kavajë ndahet në 2 ZAZ, rrethi Tiranë ndahet në 3 ZAZ, rrethi Vlorë ndahet në 3 ZAZ.

Nuk rezultoi në gjykim i provuar pretendimi i PS në lidhje me Kavajën, sipas të cilit propozimi i KQZ në rrethin e Kavajës është në kundërshtim me ligjin pasi atje ka 57.462 zgjedhës, ndërkohë që propozohen 2 ZAZ. Nga tabela e propozuar nga KQZ rezulton se janë zbatuar kriteret e nenit 27 të Kodit Zgjedhor pasi Bashkia Kavajë ka 30.230 zgjedhës dhe ajo është ZAZ më vehte dhe Rrethi Kavajë është ndarë në 2 ZAZ.

Po sipas nenit 27, pika 4 të Kodit Zgjedhor 11 njësitë bashkiake të Bashkisë së Tiranës, përbëjnë zona administrimi më vete.

Në krijimin e ZAZ-ve sipas propozimit të KQZ, Kolegji Zgjedhor cmon se janë respektuar plotësisht kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor pandashmëria e territorit të komunës dhe bashkisë; vazhdimësia dhe kompaktësia e territorit, duke shmangur barrierat gjeografike; mundësi të mira komunikimi brenda territorit dhe numër i përfaqësuesish.

PER KETO ARSYE

Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, bazuar në nenin
158 pika 3 të Kodit Zgjedhor

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të padisë.
2. Shfuqizimin e Vendimit nr.20 datë 21.12.2012 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Miratimin e ndarjes së re të zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet për kuvendin 2013, në 89 zona të administrimit zgjedhor (ZAZ), sipas propozimit të paraqitur nga KQZ.
4. Ky vendim është i formës së prerë.

Tiranë, më 03.01.2013

**ANETAR
FUAT VJERDHA**

**ANETAR
PETRIT ÇENO**

**KRYESUES
ANDI CIVICI**

**ANETAR
KLITON SPAHIU**

**ANETAR
VEFI GABA**

* * *



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANE
KOLEGJI ZGJEDHOR

Nr.11 Regj. Themeltar
Date 28.05.2013

Nr.12 Vendimi
Date 03.06.2013

VENDIM
“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegji Zgjedhor Gjyketes se Apelit Tirane i perbere prej:

KRYESUES:	Valbon ÇEKREZI
ANETAR:	Andi CIVICI
ANETAR:	Gjinovefa GABA
ANETAR:	Ilir TOSKA
ANETAR:	Kliton SPAHIU

Asistuar nga sekretare *Rexhina Baci*, sot me date 03.06.2013, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore çeshtjen civile qe i perket:

PADITese: Partia Socialiste e Shqiperise, perfaqesuar nga av.Eno Bushi dhe av.Arjan Salati te pajisur me autorizimin date 03.06.2013.

I PADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, perfaqesuar nga Ana Tenolli dhe Dashmir Alsula te pajisur me autorizimin Nr.5093 Prot, date 03.06.2013.

PALE E INTERESUAR: Partia Demokratike e Shqiperise, perfaqesuar nga lvi KASO, pajisur me autorizimin date 03.06.2013.

ME OBJEKT: Ndryshimi i vendimit te KQZ Nr.458, date 21.05.2013 “Per miratimin e disa qendrave te votimit ne ndertesa private, per zgjedhjet per Kuvend te dates 23 qershor 2013” per vendodhjen e QV Nr.1795, 17951, 17952 (pikat 92, 93, 94 te Lidhjes 1 te

vendimit), duke u caktuar vendndodhja e ketyre QV ne ambjentet e meparshme dhe /ose ne ambjente publike ne territorin e QV 1793 ne shkollen "Pal Engjelli".

BAZA LIGJORE: Nenet 62, 93, 145, 152, 153, 157, 158 te Kodit Zgjedhor, Udhezimi Nr.1 date 12.12.2012 i KQZ "Per menyren e ngritjes dhe caktimit te vendodhjes se qendrave te votimit dhe pergatitjen e hartes se njesise se qeverisjes vendore per zgjedhjet".

Ne perfundim te gjykimit te zhvilluar ne prani te paleve keto kerkuan; perfaqesuesit e pales paditese pranimin e padise, perfaqesuesit e pales se paditur rrezimin e padise, perfaqesuesi i pales se

Kolegji Zgjedhor Gjykates se Apelit Tirane

pasi administroi provat dhe degjoi pretendimet e paleve ne gjykim:

V E R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin Nr.458, date 21.05.2013 "Per miratimin e disa qendrave te votimit ne ndertesa private, per zgjedhjet per Kuvend te dates 23 qershor 2013" ka vendosur:" 1.Miratimin e ngritjes se qendrave te votimit ne ndertesa private, sipas lidhjes Nr.1, bashkangjitur ketij vendimi. 2.Ky vendim hyn ne fuqi menjehere."

Me kete vendim, nder te tjera eshte miratuar ngritja e QV(qender votimi) Nr.1795, 17951, 17952 qe i perkasin njesise se qeverisjes vendore, Njesise Bashkiake nr.4 Tirane ne ndertesa private perkatesisht;-QV Nr.1795-ne ndertesen A. Sherbimi Shoqat "Kuka", Rr."Shefqet Kuka";-QV Nr.17051-ne ndertesen Lokal Ylmi Kuka, Rr."Shefqet Kuka";- QV Nr.17052-ne ndertesen Bilardo Ylmi Kuka, Rr."Shefqet Kuka".

Ky vendim, eshte marre mbi bazen e propozimit te Kryetarit te Njesise se Qeverisjes Vendore, Njesise Bashkiake nr.4 Tirane, te paraqitur prane KQZ-se me shkresen nr.1313 prot, date 31.12.2012 per caktimin e disa qendrave te votimit ne ndertesa private, per zgjedhjet per Kuvend te dates 23.06.2013, nder to edhe per QV Nr.1795, 17951, 17952. Kryetari i Njesise Bashkiake nr.4 Tirane ka propozuar caktimin e ketyre qendrave te

votimit perkatesisht QV Nr.1795-ne ndertesën A. Sherbimi Shoqat “Kuka”, Rr.”Shefqet Kuka”;-QV Nr.17051-ne ndertesën Lokal Ylmi Kuka, Rr.”Shefqet Kuka”;- QV Nr.17052-ne ndertesën Bilardo Ylmi Kuka, Rr.”Shefqet Kuka”, me argumentin se Njesia Bashkiake nr.4 Tirane ka percaktuar qendrat e votimi ne ndertesat publike atje ku mund te perdoren dhe, ne 16 zona votimi te tjera (perfshire dhe QV Nr.1795, 17951, 17952) nuk ka mundesi objektive per te perdorur nje ndertese publike ne zonen e qendres se votimit ose ne nje zone qendre votimi fqinje, prandaj eshte pare e mundeshme qe keto qendra votimi te caktohen ne ndertesa private.

Ne relacionin me shkrim qe i eshte bashkangjitur propozimit, duke parashtruar arsyetimet per caktimin e qendrave te votimit ne ndertesa private, ne lidhje me QV Nr.1795, 17951, 17952 eshte parashtruar identifikimi i nderteses publike shkollës “Pal Engjelli” ne zonen e qendres se votimit fqinje (Nr.1794 te se njejtës zone zgjedhore) por kjo, nuk eshte marre ne konsiderate me argumentimin se ka nje largesi te konsiderueshme me qendrat e votimit.

Rezulton se, gjate shqyrtimit administrativ per kete vendim-marrje nga ana e KQZ-se eshte urdheruar kryerja e verifikimit nga ana e administrates dhe ne perfundim duke pranuar faktet ashtu sic edhe ishin parashtruar ne propozimin e kryetarit te njesise se qeverisjes vendore, eshte vendosur caktimi i QV Nr.1795, 17951, 17952 ne ndertesa private, me vendimin Nr.458, date 21.05.2013.

Vendimi i Komisionit Qendror te Zgjedhjeve eshte kundërshtuar nga pala paditese Partia Socialiste e Shqiperise, me padine objekt gjykimi duke kerkuar;- ndryshimin e vendimit te KQZ Nr.458, date 21.05.2013 “Per miratimin e disa qendrave te votimit ne ndertesa private, per zgjedhjet per Kuvend te dates 23 qershor 2013” per vendndodhjen e QV Nr.1795, 17951, 17952 (pikat 92, 93, 94 te Lidhjes 1 te vendimit), duke u caktuar vendndodhja e ketyre QV ne ambjentet e meparshme dhe /ose ne ambjente publike ne territorin e QV 1793 ne shkollën “Pal Engjelli”.

Ne fillim te seances gjyqesore, u paraqit kerkese nga Partia Demokratike e Shqiperise per te marre pjese si pale e interesuar ne kete gjykim. Kerkesa u pranua nga gjykata ne referim te neneve 133/1-b, 153/1-c te Kodit Zgjedhor pasi rezultoi se, Partia Demokratike e Shqiperise si subjekt zgjedhor ka qene pjesemarrëse ne shqyrtimin administrativ te zhvilluar prane KQZ, ne marrjen e ketij vendimi.

Pala paditese, Partia Socialiste e Shqiperise, ne padi dhe gjate gjykimit ka parashtruar se;

-KQZ me vendimin e marre per caktimin e vendndodhjes se QV Nr.1795, 17951, 17952 ne ndertesen private ne pronesi te shtetasit Ilmi Kuka, ka shkelur parashikimet e neneve 62, 93 te K.Zgjedhor dhe udhezimit Nr.1 date 12.12.2012 i KQZ "Per menyren e ngritjes dhe caktimit te vendndodhjes se qendrave te votimit dhe pergatitjen e hartes se njesise se qeverisjes vendore per zgjedhjet";

-nga relacioni i mbledhjes se KQZ rezulton se eshte miratuar ndryshimi i vendndodhjes se QV Nr.1795 nga ajo e meparshme, pa u marre ne konsiderate asnje shkak i ligjshem per kete ndryshim dhe as kriteret ligjore qe duhet te kete ambjenti privat ku vendoset QV;

-QV 1795, ne zgjedhjet e meparshme ka qene e vendosur ne nje ndertese private, ne lokaline ne pronesi te shtetasit Bedri Lici, i cili nuk ka qene i kontestuar nga askush, ploteson kriteret e kerkuara nga ligji dhe ndodhet brenda zones se qendres se votimit;

-ndryshimi ne kete rast rezulton te jete i pajustificuar ligjerisht, duke ekzistuar edhe nje rrethane tjeter e paligjshme qe konsiston ne faktin e paraqitjes ne propozimin e qeverisjes vendore me vendndodhje te meparshme ne ambientet publike te shkolles "Pal Engjelli", ç'ka nuk eshte e vertete;

-QV 17951, 17952 jane QV te krijuara rishtazi nga ndarja e QV 1795 dhe vendndodhja e tyre percaktohet per here te pare. Edhe keto QV jane caktuar ne te njejtin ambjent privat ne pronesi te shtetasit Ilmi Kuka, pa u verifikuar nga KQZ kriteret e kerkuara nga ligji ne lidhje me plotesimin ose jo te tyre;-ambienti i propozuar ne te cilin jane vendosur keto QV eshte ne pronesi te shtetasit Ilmi Kuka i cili eshte i aferm (vellai) i shtetasve Hysni Kuka e Ruzhdi Kuka. Hysni Kuka rezulton te jete kryetar i seksionit te PD ne kete zone, ndersa Ruzhdi Kuka eshte keshilltar i PD ne Keshillin Bashkiak te Njesise nr.4 i zgjedhur nga listat e PD ne zgjedhjet lokale te vitit 2011, nderkohe qe Ilmi Kuka eshte kryeplak i kesaj zone i zgjedhur nga Kryetari i Njesise Bashkiake nr.4 qe eshte subjekti politik PD;

-nga vete harta e zones dhe e zones se administrimit zgjedhor, rezulton se QV 1795 e ka ambjentin altertnativ po brenda zones se sa, ne te njejten vendndodhje ku ka qene me pare, ndersa ne zonen ngjitur te kesaj QV, ne ate te QV 1793 qe ndodhet ne ambjentet e shkolles "Pal Engjelli", ambjent publik i cili ploteson kriteret e kerkuar nga ligji dhe udhezimi i KQZ e ku mund te vendosen te treja keto

QV Nr.1795, 17951, 17952 duke qene se eshte zona ngjitur me te dhe ka ambjentin publik te lire ku mund te vendosen.

Pala e paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kerkuar rrezimin e padise duke parashtruar se;

-propozimi i bere nga Kryetari Njesise nr.4, ashtu dhe vendimmarrja e KQZ-se, per percaktimin e vendodhjeve te QV Nr.1795, 17951, 17952 ne ambjente private ka respektuar rigorozisht normat ligjore;

-eshte vertetuar dhe provuar nga inspektimi ne terren se, nuk ka patur mundesi objektive per te caktuar keto qendra votimi ne ndertesa publike ne zonen e qendres se votimit ose ne zone votimi fqinje;

-Kryetari i Njesise Bashkiake nr.4, ka referuar ne propozimin e tij edhe mundesite e caktimit te vendodhjes se ketyre QV edhe shkollen "Pal Engjelli", duke u shprehur se kjo shkolle ka nje largesi te konsiderueshme dhe ne keto kushte eshte vleresuar e domosdoshme te gjenden ambjente brenda territorit gjeografik te zones se Qendres se Votimit 1975;

-nuk ka patur mundesi alternative tjeter per konsiderim te caktimit te kesaj QV, rast i parashikuar ne piken 3 te nenit 93 ku percaktohet se "...bejne perjashtim rastet kur nuk eshte e mundur gjetja e nje objekti alternativ.";

-pala paditese ngre pretendime per njerin nga pronaret te jete kryetar i seksionit te PD ne zone, tjetrin te jete keshilltar i Njesise Bashkiake nr.4, kandiduar e zgjedhur nga listat e PD dhe per te tretin kryeplak i zones qe, nuk kane aspak lidhje me sa percakton dispozita si kusht ndalues, neni 93 ne piken 2;

-pala paditese, nuk ka ne vemendje se vendodhja e QV nuk mund te ndryshohet tani kur kane mbetur vetem 20 dite nga data e zgjedhjeve.

Pala e interesuar, Partia Demokratike e Shqiperise, ka kerkuar rrezimin e padise duke parashtruar se;

-ndertesa private ku jane percaktuar qendrat e votimit Nr.1795, 17951, 17952 nga ana e Njesise Bashkiake Nr.4, pozicionohet ne zonen e qendres se votimit, duke krijuar lehtesi ne arritjen e saj nga te gjitha zgjedhesit e kesaj zone;

-ne lidhje me pretendimet e ngritura nga subjekti zgjedhor i Partise Socialiste per perkatesine partiake te pronarit te nderteses private, shtetasit Ilmi Kuka, sipas percaktimeve te nenit 93/2-germa

c Kodit Zgjedhor kjo ndertese nuk perdoret dhe nuk eshte ne pronesi te ndonje partie politike, kandidati, te afermeve te tij dhe nuk ka sherbyer si zyre elektorale gjate fushates zgjedhore;

-ne zgjedhjet e fundit, per sa i perket qendrave te votimit te sipercituara nga Njesia Minibashkiake Nr.4, jane caktuar ambientet "Bilardo", ne pronesi te familjes Bomi dhe reparti i zdruktharise, ne pronesi te shtetasit Bedri Lici. Sipas percaktimeve te nenit 62, 93 te K.Zgjedhor nga ana e Njesise Minibashkiake nr.4, u verifikuan keto ambiente, por rezultoi se subjekti "Bilardo", ne pronesi te familjes Bomi nuk ekziston aktualisht, per shkak se eshte prishur nga vete pronari, dhe shtetasi Bedri Lici ka refuzuar dhenien e ambienteve te repartit te zdruktharise, per qendra votimi, per shkak se brenda ketij ambienti administrohen makinerite e punes;

-ne kete shtate, ne perputhje me percaktimet e nenit 93 te Kodit Zgjedhor dhe udhezimit nr.1, date 12.12.2012 te KQZ, Njesia Minibashkiake nr.4 percaktoi dhe ndertesat ne pronesi private te subjekteve per te mundesuar zhvillimin e procesit zgjedhor.

Kolegji zgjedhor pasi shqyrtoi e analizoi ceshtjen arriti ne perfundimin se padia eshte e pabazuar dhe si e tille duhet pranuar.

Referenca ligjore:

Neni 62 i Kodit Zgjedhor

"Caktimi i zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit

1. Zona e qendrës së votimit duhet të jetë brenda një territori kompakt dhe të pashkëputur gjeografik dhe numri i zgjedhësve për çdo qendër votimi nuk duhet të jetë më i vogël se 200 dhe më i madh se 1000 zgjedhës.

2. Institucionet e posaçme përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi. Qendra e votimit në këto institucione ngrihet kur në to ndodhen mbi 15 zgjedhës.

3.Kufijtë ekzistues të zonës së qendrës së votimit nuk ndryshojnë, me përjashtim të rastit kur bëhet i domosdoshëm ndryshimi për shkak të mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. KQZ-ja, me udhëzim të veçantë, numëron zonat e qendrave të votimit në mënyrë unike në shkallë vendi.

4. Vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsye objektive apo të parashikuara në nenin 93, kjo nuk është e mundur.

Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja.

5. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, jo më vonë se afati i përcaktuar në pikën 4 të nenit 51 të këtij Kodi, cakton dhe shpall vendndodhjen e qendrës së votimit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.

6. Kur një zonë qendre votimi ka më shumë se 1 000 zgjedhës dhe lista është ndarë sipas nenit 51 të këtij Kodi, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore vendos krijimin e qendrës shtesë të votimit brenda së njëjtës zonë. Në këtë rast qendra e re e votimit ngrihet, për sa është e mundur, në të njëjtën godinë me qendrën ekzistuese të votimit dhe numërohet sipas sistemit unik kombëtar të numërtimit të qendrave të votimit.

7. Kur një zonë qendre votimi ka më pak se 200 zgjedhës, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore vendos që ajo t'i bashkohet zonës së qendrës së votimit me numër më të madh zgjedhësish, më të afërt dhe me mundësi komunikimi rrugor. Si rregull, qendra e re e votimit nuk është më larg se 5 km nga qendra e votimit që shkrihet për zonat rurale. Në rast se nuk është e mundur të zbatohen të dy kriteret e mësipërme, kriteri i numrit minimal të zgjedhësve ka përparësi. Numri i qendrës së votimit të shkrire pezullohet dhe ky pezullim nuk ndikon në numërtimin ekzistues të qendrave të tjera të votimit. KQZ-ja përcakton me akt normativ kriteret dhe procedurat për bashkimin e qendrave të votimit, në përputhje me këtë pikë.

8. Përgjegjësitë e përcaktuara në këtë nen për Bashkinë e Tiranës ushtrohen nga kryetarët e njësive bashkiake të Tiranës.

9. Jo më vonë se 10 ditë nga përcaktimi i qendrës së votimit, sipas këtij neni, kryetari i njësisë vendore është i detyruar të njoftojë KQZ-në. Njoftimi për vendndodhjen shoqërohet edhe me planimetrinë, llojin e objektit dhe informacione të tjera të përcaktuara në aktin normativ të KQZ-së.

10. Mbi bazën e informacionit të marrë nga kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, në zbatim të këtij neni, KQZ-ja krijon dhe përditëson hartën e zonave të qendrave të votimit, si dhe krijon bazën e të dhënave mbi vendndodhjet e qendrave të votimit. Përfaqësuesit e partive politike të akredituara në KQZ kanë të drejtë të njihen në çdo kohë me to.

11. KQZ-ja, brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, ndërhyr kryesisht ose me ankesë të përfaqësuesve të partive në KQZ, për

të zbatuar kërkesat dhe kriteret për qendrën e votimit, numrin e zgjedhësve dhe vendndodhjen e tyre. Pas vendimit të KQZ-së qendra e votimit nuk ndryshon.

12. Në rast të refuzimit të zbatimit të urdhërimeve të KQZ-së në lidhje me qendrat e votimit, KQZ-ja ndëshkon kryetarin e njësisë vendore me 50 000 deri në 100 000 lekë gjobë, si dhe njofton prefektin për zbatimin e vendimit për caktimin e qendrave të votimit. Gjoha përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet sipas Kodit të Procedurës Civile.”.

Neni 93 i Kodit Zgjedhor

“Vendndodhja e qendrave të votimit, selive të KZAZ-ve dhe Vendeve të Numërimit të Votave.

1. Qendrat e votimit, selitë e KZAZ-ve dhe Vendi i Numërimit të Votave, për aq sa është e mundur, krijohen në ndërtesa publike me hyrje të lirë.

2. Qendrat e votimit, selitë e KZAZ-ve dhe Vendi i Numërimit të Votave nuk mund të krijohen:a) në ndërtesa private, pa vendim të KQZ-së. Në çdo rast qendra e votimit nuk mund të caktohet në banesa private;b) në ndërtesa që përdoren nga administrata publike, me përjashtim të institucioneve arsimore, kulturore dhe shëndetësore;c) në ndërtesa që përdoren apo janë në pronësi, pjesërisht ose tërësisht, të një partie politike, kandidati, të afërmeve të tij, ose kanë shërbyer si zyra elektorale gjatë fushatës zgjedhore.

3. KQZ-ja mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private kur nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike në zonën e qendrës së votimit ose në një zonë qendre votimi fqinje. Propozimi për caktimin e tyre paraqitet me dy objekte alternative, planimetrinë përkatëse ose fotografi të ambientit, një përshkrim për lehtësitë që ofron objekti për zhvillimin normal të zgjedhjeve dhe që plotëson kriteret e përcaktuara në këtë nen. Bëjnë përjashtim rastet kur nuk është e mundur gjetja e një objekti alternativ.

4. Me kërkesë të një anëtarit të saj, KQZ-ja urdhëron administratën për të kryer verifikimin përkatës në terren, e cila paraqet një raport për plotësimin e kushteve të parashikuara në këtë Kod apo në akte të tjera. Vendimi merret në konsultim me përfaqësuesit e akredituar të subjekteve në KQZ. Një kopje e vendimit të KQZ-së afishohet qartë në hyrjen e qendrave të votimit ose vendeve të numërimit të votave përkatëse në ditën e votimit.”.

Udhezimi Nr.1 date 12.12.2012 i KQZ-se “Per menyren e ngritjes dhe caktimit te vendndodhjes se qendrave te votimit dhe pergatitjen e hartes se njesise se qeverisjes vendore per zgjedhjet”.

Ne piken 1 te nenit 93 te Kodit Zgjedhor, eshte parashikuar rregulli i pergjithshem se qendrat e votimit krijohen ne ndertesa publike me hyrje te lire.

Sipas parashikimeve te nenit 62 te Kodit Zgjedhor, te drejten e caktimit te qendres se votimit ne ambiente publike e ka kryetari i njesise se qeverisjes vendore ne territorin e se ciles pershihet ajo qender votimi.

Ne perjashtim nga ky rregull i pergjithshem, po ne nenin 93 te Kodit Zgjedhor parashikohet se qendrat e votimit mund te ngrihen edhe ne ndertesa private.

Ndersa, vendndodhja e qendres se votimit ne ambiente publike caktohet nga kryetari i njesise se qeverisjes vendore, ne rastin e caktimit te qendres se votimit ne ndertese private ligjvenesi ka parashikuar nje rregullim te ndryshem. Ne kete rast, te caktimit te qendres se votimit ne ndertese private, kryetari i njesise se qeverisjes vendore nuk ka te drejten e “caktimit” por te “propozimit” prane KQZ dhe, eshte kjo e fundit qe merr vendim per caktimin e qendres se votimit ne ndertese private.

Ne nenin 93/3 te Kodit zgjedhor jane parashikuar ne menyre detyruese kushtet se, kur mund te behet caktimi i qendres se votimit ne nje ndertese private privat, madje keto kushte jane parashikuar ne menyre shteruese. Nje qender votimi mund te caktohet ne nje ndertese private vetem ne kushtet kur (i) nuk ka mundesi objektive per te perdorur nje ndertese publike ne zonen e qendres se votimit, (ii) nuk ka mundesi objektive per te perdorur nje ndertese publike ne nje zone qendre votimi fqinje. Ne te kundert, ne rast se ka mundesi objektive per te perdorur nje ndertese publike qofte ne zonen e qendres se votimit, qofte ne nje zone qendre votimi fqinje, atehere qendra e votimit nuk mund te caktohet ne nje ndertese private.

QV (qendrat e votimit) Nr.1795, 17951, 17952 i perkasin zones zgjedhore nr. 48/1 te Njesise Bashkiake nr.4 Tirane. QV 17951, 17952 jane QV te krijuara rishtazi nga ndarja e QV 1795 e, vendndodhja e tyre percaktohet per here te pare.

Ne zgjedhjet e fundit, per qendren e votimit Nr.1795 te sipercituar, vendndodhja ishte caktuar ndertimi privat-reparti i zdruktharise, ne pronesi te shtetasit Bedri Lici. Nga verifikimet ka

rezultuar se, shtetasi Bedri Lici ka refuzuar dhenien e ambienteve te repartit te zdurktharise, per qendra votimi, per shkak se brenda ketij ambienti administrohen makinerite e punes.

Ne nje shtate te tille do te duhej te caktoheshin vendndodhje te reja per QV Nr.1795, 17951, 17952, sic dhe eshte vepruar ne fakt.

Ka rezultuar se, per QV Nr.1795, 17951, 17952 nuk eshte identifikuar ndonje ndertese publike per te bere te mundur krijimin ne te qendres se votimit, ne zonen e tyre.

Por rezulton se, si nga kryetari i njesise se qeverisjes vendore ne propozimin e tij ashtu edhe nga KQZ ne shqyrtimin administrativ per miratimin e propozimit dhe marrjen e vendimit ndonese eshte konstatuar fakti qe, ne zonen e qendres se votimit 1794 qe i perket po zones zgjedhore 48/1 te Njesise se Qeverisjes Vendore nr.4 Tirane, ekziston mundesia objektive e perdorimit te nderteses publike shkolles "Pal Engjelli" si qender votimi, eshte caktuar nje ambient privat duke marre si kriter largesine e kesaj ndertese publike nga qendra e votimit.

Largesia e nderteses publike nga qendra e votimit, edhe ne rast se ekziston, nuk perben justifikim te pranueshem ligjerisht per caktimin e nje qendre votimi ne ndertese private.

Eshte i vertete fakti qe, afersia e qendres se votimit fasilton votimin (sic u pretenduar nga pala e paditur dhe pala e interesuar ne gjykim) por, ligjevenesi ato kriteret qe i ka perceptuar si me te rendesishem ne caktimin e qendres se votimit i ka parashikuar ne ligj (konkretisht nenin 93 te Kodit Zgjedhor), kriteret qe jane te detyrueshme te respektohen nga aktoret pjesmarres ne procesin vendim-marres te percaktimit te vendndodhjes se qendrave te votimit. Nuk mund te kene perparesi "fasilitetet", ndaj kritereteve ligjore e, as ne Kodin Zgjedhor dhe as ne Udhezim te KQZ nuk eshte percaktuar si kriter largesia por, i jepet prioritet kriterit qe qendra e votimit te percaktohet ne "ndertese publike".

Per sa kohe qe eshte konstatuar mundesia objektive per te perdorur nje ndertese publike ne zonen e qendres se votimit fqinj, KQZ-ja nuk mund te caktonte qendren e votimit ne nje ndertese private.

Duke vepruar ne kete menyre, si nga ana e kryetarit te qeverisjes vendore ne propozimin e tij, edhe nga ana e KQZ-se ne

vendim-marrjen e saj eshte refuzuar caktimi i qendres se votimit ne nje ndertese publike ne perputhje me parashikimet e nenit 93/3 te Kodit Zgjedhor, duke u percaktuar qendra e votimit ne nje ndertese private ne mosrespektim/kundershtim te parashikimeve te kesaj dispozite.

Sa me siper rezulton se si propozimi i kryetarit te njesise se qeverisjes vendore si pjese e vendim-marrjes se Komisionit Qendror te Zgjedhjeve ashtu edhe vendimi i KQZ-se qe ka caktuar QV Nr.1795, 17951, 17952 ne ndertese private, jane ne mosrespektim/kundershtim me parashikimet e nenit 93/3 te Kodit Zgjedhor, per pasoje vendimi i KQZ-se per caktimin e nderteses private per QV Nr.1795, 17951, 17952, duhet shfuqizuar.

Ne rastin ne gjykim jemi ne kushtet kur kolegji zgjedhor vendos gjykimin e ceshtjes ne themel, ne referim te nenit 158/1-c te Kodit Zgjedhor pasi nuk jemi ne kushtet e (i)pushimit te gjykimit qe vendoset kur konstatohet se ankimi eshte paraqitur jashte afatit ose mungesa e kompetences ne referim te nenit 158/1-a/2 te Kodit Zgjedhor, (ii) detyrimit te KQZ-se per te marre vendim ne referim te nenit 158/1-c/2 te Kodit Zgjedhor.

Ne keto kushte kur ekziston mundesia objektive per te perdorur nje ndertese publike shkollen "Pal Engjelli" si qender votim per QV Nr.1795, 17951, 17952, ndertese publike qe ndodhet ne zonen e qendres se votimit fqinj (te se njejtës zone zgjedhore nr.48/1) ne perputhje me parashikimet e nenit 93/3 te Kodit Zgjedhor, kolegji konkludon se kjo ndertese publike duhet caktuar si vendndodhje e qendrave te votimit Nr.1795, 17951, 17952.

PER KETO ARSYE:

Kolegji Zgjedhor Gjykates se Apelit Tirane ne baze te nenit 158/1-c te Kodit Zgjedhor

V E N D O S I:

Pranimin e kerkese padise.

Shfuqizimin e vendimit nr.458, date 21.05.2013, te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve per " Miratimin e disa qendrave te votimit ne ndertesa private per zgjedhjet per Kuvend te dates 23 qershor 2013" ne pikat 92, 93, 94 te Lidhjes nr.1, qe ka percaktuar qendrat e

votimit ne ndertesa private per vendodhjen e QV-ve nr.1795, 17951, 17952, ne Njesine Bashkiake nr.4 Tirane.

Caktimin e vendodhjes se Qendrave te Votimit nr.1795, 17951, 17952, te Njesise Bashkiake nr.4, Tirane, ne ndertesën publike arsimore Shkolla 9- vjecare “ Pal Engjelli” Tirane.

Tirane me dt.03.06.2013

**ANETAR
ILIR TOSKA**

**ANETAR
ANDI CIVICI**

**KRYESUES
VALBON ÇEKREZI**

**ANETAR
KLITON SPAHIU**

**ANETAR
GJINOVEFA GABA**

* * *



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANE
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**Nr.12 Regj. Themeltar
Date 05.06.2013**

**Nr.13 Vendimi
Date 10.06.2013**

VENDIM

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegji Zgjedhor Gjykates se Apelit Tirane i perbere prej:

KRYESUES :	PETRIT ÇENO
ANETAR :	GJINOVEFA GABA
ANETAR :	ILIR TOSKA
ANETAR :	EDLIRA PETRI
ANETAR :	KLITON SPAHIU

asistuar prej sekretares Rexhina Baci, në Tiranë, sot më datë 10.06.2013, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore, që u përket palëve:

PADITËSE : Partia Socialiste e Shqipërisë, përfaqësuar nga Avokatet Koli Bele dhe Eridian Salianji, me autorizimet e datave 16.05.2013 dhe 09.06.2013.

I PADITUR : Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Ana Tenolli, Endri Toporja dhe Elton Saliaga, me autorizimin e datës 10.06.2013

PALË E INTERESUAR : Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Avokati Ivi Kaso, me autorizimin e datës 10.06.2013.

OBJEKTI : Ndryshimin e vendimit të KQZ-së nr. 500, dt. 03.06.2013 “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 59, Qarku Fier, në Shkollën e Mesme Bujqësore “Rakip Kryeziu”, Komuna Qendër Fier, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23.06.2013.

BAZA LIGJORE: Neni 2, 93, 94, 145, 152, 153, 55, 156, 158 e vijues të Kodit Zgjedhor.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS APELIT TIRANË

Pasi dëgjoji palët prezent në pretendimet e tyre, përfaqësuesit e palës paditëse Partia Socialiste e Shqipërisë, që kërkuan pranimin e kërkesëpadisë, përfaqësuesit e palës së paditur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që kërkuan rrëzimin e kërkesëpadisë, përfaqësuesin e personit të interesuar Partia Demokratike e Shqipërisë, që kërkoi rrëzimin e kërkesëpadisë, si dhe administroi provat e bisedoi çështjen në tërësi :

VEREN

Se në kuadër të procesit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23.06.2013, Prefekti i Qarkut Fier, me Shkresën Nr. 305/3 prot., datë 07.05.2013, bazuar në nenin 94/1 të Kodit Zgjedhor, i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) një listë me 12 objekte brenda territorit të Qarkut Fier, që përmbushin kushtet e parashikuara nga pikat 1 dhe 2 të nenit 93 të këtij Kodi, me qëllim që KQZ-ja të caktonte vendet e numërimit të votave (VNV) për secilën nga Zonat e Administrimit Zgjedhor (ZAZ) të ngritura në këtë qark. Në këtë rast, Prefekti i Qarkut Fier, si vend për numërimin e votave për secilën ZAZ të Qarkut Fier, ka evidentuar nga 2 objekte, përfshirë këtu edhe për ZAZ-në nr. 59, zonë kjo që shtrihet gjeografikisht në Rrethin e Fierit dhe përfshin në juridiksionin territorial të saj 5 komuna.

Cështja e caktimit të VNV-së për ZAZ-në nr. 59, Qarku Fier është shqyrtuar nga KQZ-ja në mbledhjet e datave 21.05.2013 dhe 03.06.2013, ku në përfundim, me Vendimin Nr. 500, datë 03.06.2013, ka vendosur :

“Të caktojë vendin e numërimit të votave të ZAZ-së nr. 59, Qarku Fier, në Shkollën e Mesme Bujqësore “Rakip Kryeziu”, Komuna Qendër Fier”.

Në vendimin e saj, KQZ-ja ka arsyetuar se vendimi për caktimin e VNV-së për ZAZ-në nr. 59, Qarku Fier ishte marrë duke u mbështetur në Shkresën nr. 305/3 prot., datë 07.05.2013, të Prefektit të Qarkut Fier, me anë të të cilës KQZ-së i janë vënë në dispozicion ambientet e mundshme, të cilat mund të shërbenin si VNV për ZAZ-të e Qarkut Fier, ku për ZAZ-në nr. 59, ambienti i vënë në dispozicion nga Prefekti i Qarkut Fier ishte dhe Shkolla e Mesme Bujqësore “Rakip Kryeziu”, ndodhur në territor të Komunës Qendër Fier, ambient ky qe ndodhej brenda territorit të ZAZ-së nr. 59 dhe që plotësonte kriteret e parashikuara në nenet 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, si dhe të Udhëzimit Nr. 12, të KQZ-së “Për caktimin dhe përgatitjen e vendit të numërimit të votave, mënyrën e ngritjes së grupeve të numërimit dhe caktimin e tavolinave të numërimit të votave”.

Duke mos qenë dakord me këtë vendim, subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, më datë 05.06.2013, ka paraqitur një kërkesëpadi, me të cilën, duke paditur KQZ-në, ka kërkuar ndryshimin e Vendimit Nr. 500, datë 03.06.2013, të KQZ-së, duke caktuar Vendin e Numërimit të Votave për ZAZ-në nr. 59, Qarku Fier, në Shkollën e Mesme të Profilizuar "Perikli Ikonomi", Bashkia Fier.

Gjatë gjykimit të çështjes, përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar të saj, me anë të një kërkesë me shkrim, kërkoi të marrë pjesë në këtë gjykim si person i interesuar, në bazë të nenit 145 e vijues të Kodit Zgjedhor, duke pretenduar se ka interes të ligjshëm.

Kolegji Zgjedhor pranoi këtë kërkesë, me vendim të ndërmjetëm, duke lejuar subjektin zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë të marrë pjesë në këtë proces gjyqësor si palë e interesuar.

Pala paditëse Partia Socialiste e Shqipërisë, nëpërmjet përfaqësuesve të saj, pretendoi se Vendimi Nr. 500, datë 03.06.2013, i KQZ-së është marrë në kundërshtim me kriteret e parashikuara në nenet 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, ashtu sikundër edhe me praktikën më të mira të zgjedhjeve të mëparshme, në lidhje me caktimin e VNV-së për ZAZ-në nr. 59, Qarku Fier.

Partia Socialiste e Shqipërisë pretendoi se Kodi Zgjedhor dhe praktika, duke filluar nga zgjedhjet e vitit 2005, kanë vendosur standardin e numërimit të përqendruar të votave, duke e larguar këtë proces nga qendrat e votimit, drejt qendrave të bashkive me infrastrukturë të zhvilluar dhe lehtësisht të monitorueshme nga subjektet zgjedhore.

Konkretisht, Partia Socialiste e Shqipërisë pretendoi se sipas nenit 94/1 të Kodit Zgjedhor, në përcaktimin e VNV-ve, si opion të parë, KQZ-ja duhet të përzgjedhë një objekt që plotëson kushtet e kërkuara nga pikat 1 dhe 2 të nenit 93 të Kodit Zgjedhor dhe që ndodhet në territorin e bashkisë qendër rrethi dhe, në mungesë të kushteve të bashkisë qendër rrethi, apo në rastin kur organizimi në

territor i ZAZ-së apo kriteret e tjera, avantazhojnë bashkinë brenda territorit të ZAZ-së, KQZ-ja përzgjedh këtë të dytën, si vend numërimi të votave, ndërkohë që vetëm në rastin ekstrem (praktikisht i pa verifikuar në rastin konkret), kur mungojnë ambientet publike që plotësojnë këto kritere në territorin e bashkisë qendër rrethit apo të bashkisë brenda territorit të ZAZ-së, përjashtimisht KQZ-ja mund të përzgjedhë si vend numërimi të votave, një objekt në territor të njësisë më të madhe administrative. Në rastin konkret, sipas Partisë Socialiste të Shqipërisë, KQZ-ja ka vendosur të caktojë VNV-në për ZAZ-në nr. 59, Qarku Fier, duke zbatuar rastin përjashtimor, megjithëse në territorin e bashkisë qendër rrethi (Bashkisë Fier) ekziston një ndërtesë publike (Shkolla e Mesme e Profilizuar “Perikli Ikonomi”), që gjendet edhe në listën e paraqitur nga Prefekti i Qarkut Fier, ndërtesë publike kjo që plotëson kushtet e kërkuara nga nenet 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor.

Në vijim, Partia Socialiste e Shqipërisë pretendoi edhe se KQZ-ja ka vepruar në kundërshtim me nenin 94/1 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit, si rregull, VNV-ja nuk ndryshon nga njëra zgjedhje në tjetrën. Në rastin konkret, sipas Partisë Socialiste të Shqipërisë, në dy zgjedhjet e mëparshme (zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2009 dhe zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2011), ndërtesa publike e Shkollës së Mesme të Profilizuar “Perikli Ikonomi”, Bashkia Fier, ka qenë përzgjedhur nga KQZ-ja (me Vendimet Nr. 128, datë 30.04.2009 dhe Nr. 402, datë 14.04.2011), si VNV për ZAZ-në e mëparshme (nr. 20), zonë nën juridiksionin territorial të të cilës përfshihej edhe territori nën juridiksionin e ZAZ-së aktuale (nr. 59). Në vijim të kësaj, sipas palës paditëse, KQZ-ja ka ndryshuar vendin e numërimit të votave për këtë zonë të administrimit zgjedhor, megjithëse nuk kishte ndryshuar as kuadri ligjor në lidhje me caktimin e vendeve të numërimit të votave, ashtu sikundër as situata faktike në lidhje me plotësimin në rastin konkret, të kushteve të kërkuara nga nenet 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, në raport me ndërtesën publike Shkolla e Mesme e Profilizuar “Perikli Ikonomi”, Bashkia Fier, që ofronte hapësirë të mjaftueshme, energji, internet, lehtësi logjistike të transportit rrugor, distancës nga qendrat e votimit.

Në përfundim, Partia Socialiste e Shqipërisë pretendoi se KQZ-ja nuk duhet të kishte caktuar VNV-në për ZAZ-në nr. 59, Qarku

Fier, në Shkollën e Mesme Bujqësore “Rakip Kryeziu”, Komuna Qendër Fier, në rrethanat kur gjatë zgjedhjeve të mëparshme, në këtë zonë përplasjet politike kanë qenë konstante dhe mjaft të ashpra, deri në konfrontime të rënda fizike, gjë e cila do të vinte në pikëpyetje procesin zgjedhor.

Pala e paditur KQZ-ja, nëpërmjet përfaqësuesve të saj, kundërshtoi palën paditëse, duke pretenduar se Vendimi nr. 500, datë 03.06.2013, është në përputhje me ligjin, ndërkohë që kërkesëpadia e Partisë Socialiste të Shqipërisë ishte e pabazuar në ligj e prova.

Konkretisht, në prapësimet e saj, pala e paditur KQZ rikonfirmoi qëndrimin e saj të parashtruar edhe në vendimin objekt gjykimi, qëndrim ky sipas të cilit Vendimi Nr. 500, datë 03.06.2013, ishte marrë duke u mbështetur në Shkresën nr. 305/3 prot., datë 07.05.2013, të Prefektit të Qarkut Fier, ku ambienti i vënë në dispozicion si VNV për ZAZ-në nr. 59, Qarku Fier, pikërisht Shkolla e Mesme Bujqësore “Rakip Kryeziu”, ndodhur në territor të Komunës Qendër Fier, gjendej brenda territorit të kësaj zone të administrimit zgjedhor dhe plotësonte kriteret e parashikuara në nenet 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, si dhe të Udhëzimit Nr. 12, të KQZ-së “Për caktimin dhe përgatitjen e vendit të numërimit të votave, mënyrën e ngritjes së grupeve të numërimit dhe caktimin e tavolinave të numërimit të votave”.

Kështu, sipas palës së paditur, referuar nenit 94/1 të Kodit Zgjedhor, ishte i pabazuar në ligj pretendimi i palës paditëse se vendosja e VNV-së në një ndërtesë, jo në territor bashkie, përbënte rast përjashtimor, kur, sipas kësaj dispozite ligjore, KQZ-ja ka tagrin e plotë ligjor të përzgjedhjes dhe vendosjes ndërmjet tre alternativave të ambienteve publike, paraqitur nga Prefekti i Qarkut, pra ndërmjet bashkisë qendër rrethi, bashkisë brenda territorit të ZAZ-së dhe njësisë më të madhe administrative. Në rastin konkret, KQZ-ja ka përzgjedhur një ndërtesë publike, që ndodhet në njësinë më të madhe administrative brenda territorit të ZAZ-së nr. 59, pikërisht në Fshatin Çlirim, të Komunës Qendër Fier, duke marrë në konsideratë për këtë përparësitë që kërkon ligji, pikërisht lehtësitë logjistike të transportit rrugor, distancën nga qendrat e votimit, hapësirën që ofron salla dhe mundësinë e aplikimit të teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave, në kushtet kur, nga verifikimi i bërë në

terren nga inspektorët e KQZ-së, ka rezultuar se Shkolla e Mesme Bujqësore “Rakip Kryeziu” ndodhet në qendër të ZAZ-së nr. 59, ku me këtë vendndodhje gjeografike, ky ambient është më optimali, për të siguruar distancën më të shkurtër nga qendrat e votimit, duke i ardhur kështu në ndihmë përshpejtimit të procesit zgjedhor.

Të pabazuar konsideroi pala e paditur edhe pretendimin tjetër të palës paditëse për ndryshimin në rastin konkret të VNV-së, nga zgjedhjet e mëparshme, duke pretenduar se ligji, neni 94/1 i Kodit Zgjedhor, parashikon se, si rregull, VNV-ja nuk ndryshon nga njëra zgjedhje në tjetrën, por jo se ndalohej ndryshimi i VNV-së, për më tepër kur në rastin konkret jemi para një ndarje të re, të ndryshme, të zonave të administrimit zgjedhor, në raport me zgjedhjet e mëparshme, ku territori nën juridiksionin e ZAZ-së së mëparshme (nr. 20), ku përfshiheshin 8 komuna, nuk përputhet me atë të ZAZ-së aktuale (nr. 59), ku përfshihen vetëm 5 komuna.

Në vijim, sipas KQZ-së, ishte i pabazuar në ligj pretendimi i palës paditëse lidhur me përplasjet e ashpra politike të ndodhura në këtë zonë në zgjedhjet e mëparshme.

Pretendimet e palës paditëse u kontestuan edhe nga personi i interesuar Partia Demokratike e Shqipërisë, duke u bashkuar me qëndrimin e palës së paditur dhe pretenduar se vendimi objekt gjykimi i KQZ-së ishte marrë në përputhje me ligjin, ndërkohë që kërkesëpadia e Partisë Socialiste të Shqipërisë ishte e pabazuar në ligj e prova.

Gjatë shqyrtimit të çështjes, Kolegji Zgjedhor administroi praktikën dokumentare në lidhje me Vendimin Nr. 500, datë 03.06.2013, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në konsideratë të fakteve të rezultuara gjatë gjykimit të çështjes, si dhe të kuadrit ligjor në fuqi, në lidhje me caktimin e vendeve të numërimit të votave, Kolegji Zgjedhor çmon se kërkesëpadia e paraqitur nga pala paditëse, subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, është e bazuar në ligj e prova, duke vlerësuar se Vendimi i KQZ-së Nr. 500, datë 03.06.2013 është një akt administrativ që vjen në kundërshtim me ligjin, duke qenë kështu, një akt administrativ relativisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 118 të Kodit të Procedurave Administrative, që si i tillë duhet

të shfuqizohet. Nga ana tjetër, referuar përcaktimeve të nenit 158 të Kodit Zgjedhor, në kushtet kur në rastin konkret nuk ndodhemi para asnjë prej rasteve të parashikuara në pikat 1/a, 1/c, 2 dhe 4 të kësaj dispozite, pra para rasteve të pushimit të gjykimit të çështjes apo të detyrimit të KQZ-së për të marrë vendim, Kolegji Zgjedhor vlerëson se mosmarrëveshja objekt gjykimi përfshihet nën juridiksionin e plote të tij, prandaj është rasti për gjykimin në themel të çështjes dhe zgjidhjen përfundimtare të saj.

Për arritjen e këtij përfundimi, Kolegji Zgjedhor ka parasysh Kodin Zgjedhor dhe pikërisht këto dispozita:

nenin 93 (“Vendndodhja e qendrave të votimit, selive të KZAZ-ve dhe Vendeve të Numërimit të Votave”), sipas të cilit “1. Qendrat e votimit, selitë e KZAZ-ve dhe Vendi i Numërimit të Votave, për aq sa është e mundur, krijohen në ndërtesa publike me hyrje të lirë. 2. Qendrat e votimit, selitë e KZAZ-ve dhe Vendi i Numërimit të Votave nuk mund të krijohen : a) në ndërtesa private, pa vendim të KQZ-së. Në çdo rast qendra e votimit nuk mund caktohet në banesa private; b) në ndërtesa që përdoren nga administrata publike, me përjashtim të institucioneve arsimore, kulturore dhe shëndetësore; c) në ndërtesa që përdoren apo janë në pronësi, pjesërisht ose tërësisht, të një partie politike, kandidati, të afërmeve të tij, ose kanë shërbyer si zyra elektorale gjatë fushatës zgjedhore. 3. ...”;

nenin 94 (“Vendndodhja dhe përgatitja e Vendeve të Numërimit të Votave”), sipas të cilit “1. Jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, prefekti i qarkut i paraqet KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, që përmbushin kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 93 dhe të këtij neni. Jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve, KQZ-ja me vendim cakton Vendingun e Numërimit të Votave. Në përcaktimin e Vendingut të Numërimit të Votave KQZ-ja mund të përzgjedhë bashkinë qendër rrethi, pavarësisht nëse ndodhet jashtë juridiksionit territorial të ZAZ-së, ose bashkinë brenda territorit të ZAZ-së apo edhe njësinë më të madhe administrative, nëse bashkitë nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 93 dhe në këtë nen. Në përzgjedhjen e vendingut të VNV-së, KQZ-ja i jep përparësi lehtësive logjistike të transportit rrugor, distancës nga qendrat e votimit dhe

hapësirave të objekteve të mundshme. Si rregull, Vendi i Numërimit të Votave nuk ndryshon nga njëra zgjedhje në tjetrën. / VNV-ja caktohet në salla me përmasa të mëdha ose palestra sportive. Vendet e Numërimit të Votave vihen në dispozicion të KZAZ-ve jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve. KZAZ-ja, jo më vonë se 5 ditë para datës së zgjedhjeve, fton për njohje të Vendit të Numërimit të Votave subjektet zgjedhore dhe anëtarët e KQV-ve. Në përzgjedhjen e vendit, KQZ-ja duhet të marrë parasysh edhe mundësinë për aplikimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave, sipas pikës 4 të këtij neni. 2. ...”;

nenin 158 (“Llojet e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor”), sipas të cilit “1. Në varësi nga çështjet në shqyrtim, Kolegji Zgjedhor vendos : a) pushimin e gjykimit; b) gjykimin e çështjes në themel; ose c) detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim. 2. Pushimi i gjykimit vendoset kur Kolegji Zgjedhor konstaton se ankimi është paraqitur jashtë afateve të përcaktuara në këtë Kod ose për mungesë kompetence. Kur Kolegji Zgjedhor vendos mungesën e kompetencës, ia dërgon çështjen organit kompetent. 3. Me gjykimin e çështjes në themel, Kolegji Zgjedhor vendos pranimin e plotë apo të pjesshëm të padisë ose rrëzimin e plotë apo të pjesshëm të saj. 4. Kolegji Zgjedhor vendos detyrimin e KQZ-se për të marrë vendim, në zbatim të pikës 2 të nenit 145 të këtij Kodi. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor cakton afat të prerë për marrjen e vendimit jo më të gjatë se 10 ditë. 5. ...”.

Në konsideratë të kuadrit ligjor në fuqi, pikërisht të rregullimit të parashikuar në nenin 94/1 të Kodit Zgjedhor, në veçanti të rregullimit sipas të cilit “Në përcaktimin e Vendit të Numërimit të Votave KQZ-ja mund të përzgjedhë bashkinë qendër rrethi, pavarësisht nëse ndodhet jashtë juridiksionit territorial të ZAZ-së, ose bashkinë brenda territorit të ZAZ-së apo edhe njësinë më të madhe administrative, nëse bashkitë nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 93 dhe në këtë nen”, Kolegji Zgjedhor vlerëson se KQZ-ja, në marrjen e Vendimit Nr. 500, datë 03.06.2013, ka vepruar në kundërshtim me këtë rregullim ligjor, pasi ka përzgjedhur si VNV për ZAZ-në nr. 59, Qarku Fier një ndërtesë publike të ndodhur në territorin e njësisë më të madhe administrative (Komunës Qendër Fier), megjithëse

në rastin konkret “bashkitë” (pikërisht bashkia qendër rrethi/Bashkia Fier) plotësonin kushtet e parashikuara në nenet 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor.

Kështu, siç me të drejtë pretendohet nga pala paditëse Partia Socialiste e Shqipërisë, ndryshe nga sa pala e paditur KQZ-ja ka konsideruar, në interpretimin literal (sipas kuptimit të vetë fjalëve dhe lidhjes së tyre) dhe logjik (sipas qëllimit të ligjvënësit dhe logjikës juridike të normës), Kolegji Zgjedhor vlerëson se nëpërmjet rregullimit ligjor të mësipërm është përcaktuar se, si rregull, Vendi i Numërimit të Votave përzgjidhet në bashkinë qendër rrethi ose bashkinë brenda territorit të ZAZ-së dhe, përjashtimisht, vetëm nëse bashkitë nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, Vendi i Numërimit të Votave përzgjidhet në njësinë më të madhe administrative. Në rastin konkret, KQZ-ja ka vendosur të zbatojë rastin përjashtimor për përzgjedhjen e vendit të numërimit të votave, megjithëse rezultojnë që nuk kanë qenë kushtet e kërkuara nga ligji për zbatimin e tij, në rrethanat kur në bashkinë qendër rrethi, Bashkinë Fier, ekzistojnë ndërtesa publike që plotësojnë kushtet e kërkuara nga nenet 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, të evidentuara këto edhe në listën e objekteve që përmbushin këto kushte të paraqitur nga Prefekti i Qarkut Fier, ndërkohë që nuk ka vend për diskutim për sa i përket mundësisë alternative të përzgjedhjes së bashkisë brenda territorit të ZAZ-së në rastin konkret, për sa kohë rezultojnë dhe pranohet se brenda territorit të ZAZ-së nr. 59, Qarku Fier, nuk ka bashki.

Në lidhje me këtë, Kolegji Zgjedhor ka parasysh edhe qëndrimin e mbajtur nga vetë KQZ-ja në rastin e caktimit të VNV-së për ZAZ-në nr. 62, Qarku Fier (zonë e administrimit zgjedhor që edhe kjo përfshin në juridiksionin territorial të saj disa komuna të Rrethit Fier), për të cilën, siç u pranua, VNV-ja është caktuar në ndërtesën publike të Shkollës së Mesme Industriale “Petro Sota”, që gjendet në territorin e bashkisë qendër rrethi, pra të Bashkisë Fier.

Nga ana tjetër, Kolegji Zgjedhor vlerëson se, siç me të drejtë pretendohet nga pala paditëse Partia Socialiste e Shqipërisë, në rastin konkret është vendi që VNV-ja për ZAZ-në nr. 59, Qarku Fier, të caktohet në ndërtesën publike Shkolla e Mesme Profesionale

“Perikli Ikonomi”, Bashkia Fier, duke patur në konsideratë për këtë se kjo ndërtesë publike plotëson kushtet e kërkuara nga nenet 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, evidentuar kjo në listën e paraqitur nga Prefekti i Qarkut Fier, pranuar dhe nga pala e paditur, si dhe faktin se kjo ndërtesë publike ka shërbyer si VNV në zgjedhjet e mëparshme për një ZAZ (nr. 20), e cila në juridiksionin territorial të saj ka përfshirë të gjithë territorin aktual nën juridiksionin e ZAZ-së nr. 59, Qarku Fier. Po kështu, Kolegji Zgjedhor ka në konsideratë edhe faktin se Shkolla e Mesme Profesionale “Perikli Ikonomi”, Bashkia Fier nuk është përzgjedhur si VNV, për asnjë nga ZAZ-të e tjera të Qarkut Fier.

Sa më sipër, Kolegji Zgjedhor çmon se padia e paraqitur nga pala paditëse Partia Socialiste e Shqipërisë duhet të pranohet plotësisht.

PER KETO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, bazuar në nenin 158, pikat 1/b dhe 3, të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar),

V E N D O S I

Pranimin e kërkesëpadisë.

Shfuqizimin e vendimit nr. 500, datë 03.06.2013, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Caktimin e vendit të numërimit të votave të ZAZ-së nr. 59, Qarku Fier në Shkollën e Mesme të Profilizuar “Perikli Ikonomi”, Bashkia Fier.

U shpall në Tiranë, më datë 10.06.2013.

ANËTAR
ILIR TOSKA

ANËTAR
GJINOVEFA GABA

KRYESUES
PETRIT ÇENO

ANËTAR
EDLIRA PETRI

ANËTAR
KLITON SPAHIU

* * *



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANE
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**Nr.15 Regj. Themeltar
Date 22.06.2013**

**Nr.16 Vendimi
Date 22.06.2013**

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

**KRYESUES : FUAT VJERDHA
ANETAR : EDLIRA PETRI
ANETAR : PETRIT ÇENO
ANETAR : ILIR TOSKA
ANETAR : VALBON ÇEKREZI**

asistuar nga sekretarja Rexhina Baçi, në seancën gjyqësore të datës 22.06.2013, mori në shqyrtim çështjen civile, që u përket palëve :

PADITESE: PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE,
me Seli në Tiranë, Sheshi “Austria”, Nr. 91,
përfaqësuar në gjykim me autorizim nga Koli Bele.

I PADITUR: KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE,
me Seli në Tiranë, Bulevardi “Dëshmoret e Kombit”,
Pallati i Kongreseve, përfaqësuar në gjykim me
autorizim nga Dëshira Pasko dhe Ana Tenolli.

PALE E INTERESUAR : PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE,
me Seli në Tiranë, përfaqësuar në gjykim me autorizim
nga Ivi Kaso.

OBJEKTI: Konstatimin e pavlefshmërisë së Vendimit të KQZ-së Nr. 621, datë 21.06.2013, “Për materialet të cilat lejohen të përdoren gjatë ditës së votimit nga personat e pranishëm në qendrën e votimit”.

BAZA LIGJORE: Nenet 21, 23, 24, 145,152,153,155,156 dhe 158 të Kodit Zgjedhor; nenet 116 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATES SE APELIT TIRANE

Pasi dëgjoi përfaqësuesit e palës paditëse, që kërkuan pranimin e padisë; dëgjoi përfaqësuesit e palës së paditur, që kërkuan rrëzimin e padisë; dëgjoi përfaqësuesin e palës së interesuar, që kërkoi rrëzimin e padisë; si dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V E R E N

Në datë 22.06.2012, subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë ka paraqitur para Kolegjit Zgjedhor një kërkesëpadi, me të cilën, duke paditur Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (më poshtë referuar si KQZ), si dhe thirrur si palë të interesuar Partinë Demokratike të Shqipërisë, ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë së Vendimit të KQZ-së nr. 621, datë 21.06.2013 “Për materialet të cilat lejohen të përdoren gjatë ditës së votimit nga personat e pranishëm në qendrën e votimit” (më poshtë referuar si Vendimi nr. 621).

Nisur nga përmbajtja e Vendimit nr. 621, në veçanti shtrirjes së efekteve të tij në procesin e votimit për zgjedhjet e Kuvendit të datës 23.06.2013, Kolegji Zgjedhor, pasi u njoh me kërkesëpadinë e paraqitur, bazuar në nenin 154 të Kodit Zgjedhor, realizoi menjëherë hedhjen e çështjes në short për përbërjen e trupit gjykues, duke njoftuar paraprakisht dhe ftuar palët për të marrë pjesë në këtë procedurë. Më tej, trupi gjykues i caktuar me short për gjykimin e çështjes vendosi që gjykimi i saj të zhvillohej po këtë ditë, disa orë më vonë, pra në datë 22.06.2013, në orën 19.00, duke njoftuar menjëherë palët dhe duke i'u dërguar atyre edhe kopje të kërkesëpadisë.

Përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, në kuadër të kërkesave paraprake, përfaqësuesit e palës së paditur kërkuan që seanca gjyqësore të shtyhet, të paktën deri në orët e para të mëngjesit të datës 23.06.2013, duke e argumentuar këtë, me kohën e pamjaftueshme që kishte patur në dispozicion për përgatitjen e prapësimeve të saj rreth kërkesëpadisë së paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Gjithashtu, po në kuadër të kërkesave paraprake, përfaqësuesi i palës së interesuar kërkoi shtyrjen e seancës gjyqësore pas datës 26.06.2013, me argumentin se palëve në procesin administrativ, subjekte zgjedhore, duhej t'iu garantohej e drejta e ankimit, sipas nenit 145/1 të Kodit Zgjedhor, për sa kohë, që sipas nenit 152 të këtij Kodi, afati për të kundërshtuar Vendimin nr. 621 të KQZ-së, ishte 5 ditë nga shpallja e tij, afat ky që në rastin konkret përfundonte në datë 26.06.2013. Ky kërkim i palës së interesuar nuk i'u referua gjithsesi ndonjë ankimi eventual, që ky subjekt zgjedhor do të paraqiste ndaj Vendimit nr. 621 të KQZ-së

Kërkesat si më lart të palës së paditur dhe palës së interesuar, u kundërshtuan nga pala paditëse, e cila pretendoi se Kolegji Zgjedhor duhet të garantonte të drejtën e saj për të patur një ankim efektiv ndaj Vendimit nr. 621 të KQZ-së, i cili ishte marrë vetëm një ditë më parë, pra në datë 21.06.2013, në orën 16:00, ndërkohë që efektet e tij do të shtriheshin ditën e nesërme, pra në datë 23.06.2013, duke filluar nga ora 07.00, që fillonte dhe procesi i votimit për zgjedhjet e Kuvendit, sipas nenit 11 të Kodit Zgjedhor.

Kërkesat paraprake të paraqitura u morën menjëherë në shqyrtim nga Kolegji Zgjedhor, duke konkluduar për pabazueshmërinë e tyre dhe vendosur rrëzimin e kërkesave në lidhje me shtyrjen e seancës gjyqësore përtej datës 22.06.2013.

Nga ana tjetër, Kolegji Zgjedhor ndërpreu shqyrtimin gjyqësor, duke vendosur vazhdimin e tij disa orë më pas, në orën 21.30, me qëllim për t'i dhënë palës së paditur një kohë të arsyeshme dhe në përputhje me rrethanat e rastit për të përgatitur prapësimet e saj rreth kërkesëpadisë së paraqitur.

Në lidhje me shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor përtej datës 22.06.2013, Kolegji Zgjedhor vlerësoi se argumentet e paraqitura nga pala e paditur dhe pala e interesuar ishin të pabazuara dhe nuk mund të pranoheshin, duke patur parasysh se :

së pari, pavarësisht veprimit në afate të shpejta, shqyrtimi i kërkesëpadisë së paraqitur në rastin konkret, po realizohej brenda afatit 10-ditor të përcaktuar në nenin 157/1 të Kodit Zgjedhor, afat ky që sipas kësaj dispozite fillon nga momenti i depozitimit të kërkesëpadisë, duke mos u kondicionuar ky afat (fillimi i tij) nga ana tjetër me afatin e ankimit të subjekteve të përcaktuara nga ligji (Kodi Zgjedhor), ndërkohë që, në përputhje me nenin 154 të këtij Kodi, Kolegji Zgjedhor kishte ezauruar veprimet paraprake lidhur me kërkesëpadinë;

së dyti, palëve në procesin administrativ, subjekte zgjedhore, ndryshe nga sa pretendohet, nuk iu cenohej e drejta potenciale e ankimit sipas nenit 145/1 të Kodit Zgjedhor, duke vlerësuar se, në pikëpamje formale, shqyrtimi i një ankimi/kërkesëpadie të paraqitur nga një subjekt zgjedhor kundër një vendimi të KQZ-së, nuk i'u mohon subjekteve të tjera zgjedhore të drejtën e ankimit kundër këtij vendimi, përveç se mënyra e përfundimit/zgjidhjes së çështjes në rastin konkret nuk mund dhe nuk duhet të paragjykohej;

së treti, zhvillimi i shqyrtimit gjyqësor në orët e para të mëngjesit të datës 23.06.2013, pra përpara orës 07.00 të fillimit të procesit të votimit, ishte i papranueshëm në pikëpamje praktike dhe seriozitetit të vendimmarrjes së Kolegjit Zgjedhor, përveç se do të krijonte konfuzion në lidhje me zbatimin e vendimit objekt gjykimi të KQZ-së.

Nga ana tjetër, Kolegji Zgjedhor vlerësoi se shqyrtimi i kërkesëpadisë përtej datës 22.06.2013 do të passillte cenimin e të drejtës së palës paditëse për të patur një ankim efektiv, si dhe të drejtën e saj për akses në gjykatë.

Në lidhje me këtë çështje, Kolegji Zgjedhor ka parasysh standardin e vendosur nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ashtu sikundër edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. Kështu, detyrimi për respektimin e këtij parimi konventor,

konsiderohet i përmbushur, kur ankimi i subjektit që pretendon shkeljen, të jetë efektiv, si në aspektin ligjor, ashtu edhe në praktikë¹. Kolegji Zgjedhor vlerëson se dispozitat e Kodit Zgjedhor, lidhur me të drejtën e subjekteve për të paraqitur ankim ndaj vendimeve të KQZ-së, duhet të zbatohen në përputhje me garantimin e standardit të efektivitetit të ankimit. Në këtë aspekt, vendimi i kësaj gjykate, që eventualisht do të pranonte si të bazuar padinë në shqyrtim, do të rezultonte i karakterit thjesht, deklarativ, duke e prezantuar Kolegjin Zgjedhor si një institucion jo efektiv në parandalimin e shkeljes së pretenduar. Për sa më sipër, Kolegji Zgjedhor ka detyrimin ligjor që të garantojë subjektet zgjedhore, në rastin konkret palën paditëse, se ankimi i paraqitur jo vetëm do të zgjidhë çështjen në shqyrtim, por do të garantojë edhe parandalimin e shkeljes së pretenduar, nëse konkludon se ankimi është i bazuar.

Për sa i përket bazueshmërisë ligjore të kërkesëpadisë së paraqitur në rastin konkret, Kolegji Zgjedhor konstaton se :

Pala paditëse, Partia Socialiste e Shqipërisë i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor me kërkesë padi, me anë të së cilës ka kërkuar të konstatohet pavlefshmëria e Vendimit nr. 621 të KQZ-së, për shkak se ky vendim është marrë me një shumicë të votave “pro” prej vetëm katër anëtarëve të këtij Komisioni.

Duke e cilësuar këtë vendim si një akt me karakter normativ, në mbështetje të nenit 24/1/d dhe 22/4 të Kodit Zgjedhor, pala paditëse parashtron pretendimin se aktet me karakter normativ dhe që kanë për qëllim rregullimin e çështjeve, që lidhen me zgjedhjet duhet të miratohen me votën “pro” të jo më pak se pesë anëtarëve të KQZ-së.

Kolegji Zgjedhor arrin në përfundimin se Vendimi i KQZ-së, nr. 621, datë 21.06.2013, *“Për materialet të cilat lejohen të përdoren gjatë ditës së votimit nga personat e pranishëm në qendrën e votimit”* është një akt absolutisht i pavlefshëm, për shkak të mosrespektimit të dy kushteve bazë që kërkon vlefshmëria e aktit: procedura dhe kompetenca.

1. Shih për këtë edhe vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Gjyli kundër Shqipërisë.

Konkretisht, KQZ-ja me vendimin objekt shqyrtimi, ka normuar juridikisht, nëpërmjet rregullave të detyrueshme të sjelljes, veprimtarinë që duhet të kryejnë, në kuptim të procedurave të përcaktuara në nenet 101-109 të Kodit Zgjedhor, anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit dhe vëzhguesit e akredituar të subjekteve zgjedhore pranë qendrave të votimit. Ky vendim i KQZ-së është miratuar me votat e katër anëtarëve, ndërkohë që urdhërimi ligjor që parashikohet në nenin 24 të Kodit Zgjedhor, parashikon miratimin e këtij vendimi me shumicën e cilësuar të 5 votave.

Duke i'u referuar kuptimit që Kodi i Procedurave Administrative dhe Kodi Zgjedhor i jep akteve me natyrë administrative, përmbajtjes dhe formës që ato duhet të kenë, vendimi i KQZ-së nr. 621, datë 21.06.2013, *“Për materialet të cilat lejohen të përdoren gjatë ditës së votimit nga personat e pranishëm në qendrën e votimit”* është i pavlefshëm dhe, për rrjedhojë, nuk mund të prodhojë asnjë pasojë.

Pavlefshmëria e vendimit objekt shqyrtimi rezulton evidente qoftë në mosrespektimin e procedurës, ashtu dhe të inkompetencës së organit. Shkelja e rëndë procedurale, që lidhet me quorumin e vendimmarrjes së KQZ-së, e sjell ndikimin e drejtpërdrejtë edhe në drejtim të inkompetencës në vendimmarrje nga ky autoritet shtetëror.

Vendimi i KQZ-së nr. 621, datë 21.06.2013, *“Për materialet të cilat lejohen të përdoren gjatë ditës së votimit nga personat e pranishëm në qendrën e votimit”*, nga përmbajtja e tij është një **akt normativ**, që sipas nenit 24, pika 1, shkronja "d" të Kodit Zgjedhor, kërkon respektimin e *quorumit* të votave për t'u konsideruar i vlefshëm. Për rrjedhojë, vendimi është një akt absolutisht i pavlefshëm, për arsye të shkeljes së rëndë të procedurës së miratimit të tij.

Argumentet ligjore që përcaktojnë natyrën normative të vendimit nr. 621, datë 21.06.2013, *“Për materialet të cilat lejohen të përdoren gjatë ditës së votimit nga personat e pranishëm në qendrën e votimit”*, si dhe shkaqet që ndikojnë në konstatimin e pavlefshmërisë absolute të tij, konsistojnë në disa drejtime kryesore:

1. Nga analiza që i bëhet përmbajtjes së vendimit të sipërcituar, rezulton se KQZ-ja duke vendosur *rregulla të*

përgjithshme sjellje me karakter normativ për mënyrën se si anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit dhe vëzhguesit e akredituar të subjekteve zgjedhore pranë qendrave të votimit, në përmbushje të detyrës së tyre, duhet të përdorin vetëm materialet zgjedhore të përcaktuara në nenin 100 të Kodit Zgjedhor, dhe se nuk mund të zhvillojnë procedura të pa parashikuara në ligj etj, ka synuar të përmbushë detyrimin ligjor që rrjedh nga neni 21 i Kodit Zgjedhor. Këto dispozita ligjore njohin kompetencën e KQZ-së për të nxjerrë “në bazë dhe për zbatim të ligjit dhe brenda sferës së juridiksionit të saj, vendime dhe udhëzime me fuqi juridike të përgjithshme në të gjithë territorin e Republikës” (pika 1 e nenit 21); të marrë “vendime për njehsimin e praktikave zgjedhore” (pika 2 e nenit 21); si dhe të drejtojë dhe kontrollojë “procesin parazgjedhor dhe atë zgjedhor” (pika 3 e nenit 21 të Kodit Zgjedhor).

2. Pavarësisht se KQZ-ja nuk rezulton t'i jetë referuar, në vendimin objekt shqyrtimi, dispozitave të sipërcituara (*neni 21, pika 1, 2, 3 dhe neni 23, pika 2, 3 të Kodit Zgjedhor*), janë të njohura tashmë si nga doktrina e së drejtës administrative, ashtu dhe nga jurisprudenca gjyqësore vendase apo e huaj, kriteret që përcaktojnë natyrën e një akti normativ, të cilat gjenden të materializuara në këtë vendim. Konkretisht një akt normativ :

a. përcakton rregullime me fuqi juridike të përgjithshme;

b. parashikon hipoteza abstrakte, të cilat nuk është e sigurt nëse do të mund të zbatohen në të ardhmen;

c. nuk shteron me një akt të vetëm zbatimi.

3. Për nga vetë përmbajtja, vendimi i KQZ-së vendimit nr. 621, datë 21.06.2013, “*Për materialet të cilat lejohen të përdoren gjatë ditës së votimit nga personat e pranishëm në qendrën e votimit*”, është një akt normativ, që në mënyrë konkrete i përmban të tri këto cilësi:

a) Efektet juridike të përgjithshme të vendimit të KQZ-së duken qartë në rregullimin normativ të veprimtarisë që do të duhet të kryejnë, në kuptim të procedurave të përcaktuara në nenet 100-109 të Kodit Zgjedhor, anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit dhe vëzhguesit e akredituar të subjekteve zgjedhore pranë qendrave të votimit, në të gjithë territorin e Republikës. Në këtë vendim gjenden shumë rregulla të përgjithshme sjellje që orientojnë anëtarët e KQV-ve dhe vëzhguesit e akredituar të subjekteve zgjedhor, se çfarë duhet të bëjnë, në respektim të dispozitave të Kodit Zgjedhor, që lidhen me materialet të cilat lejohen të përdoren gjatë ditës së votimit në qendrën e votimit. Konkretisht po citojmë:

- i. Në pikën 1 të vendimit: “Gjatë procesit të votimit, anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit, në përmbushje të detyrës së tyre, **duhet të përdorin** vetëm materialet zgjedhore të përcaktuara në nenin 100 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.”
- ii. Në pikën 2 të vendimit: “Gjatë procesit të votimit, anëtarët e QV, **nuk mund të zhvillojnë procedura** të pa parashikuara në ligj, dhe që nuk përkojnë me përmbushjen e detyrës së tyre funksionale.”
- iii. Në pikën 3 të vendimit: “Gjatë procesit të votimit, anëtarët e QV në përmbushje të detyrës së tyre, në asnjë rast dhe për asnjë shkak **nuk mund të përdorin** mjete apo materiale, të cilat nuk përfshihen në grupin e materialeve zgjedhore të përcaktuara në nenin 100 të Kodit Zgjedhor, ...”
- iv. Në pikën 4 të vendimit: “Gjatë procesit të votimit, vëzhguesit e akredituar të subjekteve zgjedhore pranë qendrës së votimit, **nuk duhet të përdorin/mbajnë/shfaqin** materiale propagandistike të subjekteve zgjedhore, si dhe nuk mund të përdorin dokumentacion/mjete/materiale, të cilat dublojnë materialet zgjedhore të parashikuara nga neni 100 të Kodit Zgjedhor...”
- v. Në pikën 5 të vendimit: “Gjatë procesit të votimit, anëtarët e QV, apo vëzhguesit e pranishëm, **nuk lejohen të përdorin** pajisje si regjistruer audiovideo, pajisje që kontrollojnë apo regjistrojnë zgjedhësit që paraqiten për të votuar...”

vi. Në pikën 6 të vendimit: **“Në rast se** ndonjë nga anëtarët apo sekretari i KQV-së, apo vëzhguesit e pranishëm në qendrën e votimit, përdorin mjete të tjera të cilat nuk janë të përcaktuara në ligj, dhe janë të ndaluara për përdorim sipas pikave 4 dhe 5 të këtij vendimi, Kryetari, apo çdo anëtar tjetër i KQV-së që konstaton këtë fakt, mban një procesverbal dhe njofton menjëherë KZAZ-në përkatëse dhe KQZ-në.

Natyra e këtyre rregullave të sjelljes nuk mund të përjashtohet nga efekti i tyre juridik i përgjithshëm.

b) Vendosja, nëpërmjet një akti juridik, **të rregullave të mundshme dhe në abstrakt, që nuk është e sigurt se do të ndodhin** (pra që parashikojnë në mënyrë hipotetike mundësinë e lindjes së një marrëdhënie juridike), e bëjnë atë një akt normativ. Nga analiza që i bëhet vendimit të sipërpërmendur të KQZ-së, rezulton se rregulla të tilla sjellje janë të kushtëzuara pikërisht me mundësinë e lindjes së një mosmarrëveshje juridike, në të ardhmen. Pra, për çdo situatë që mund të paraqitet pas përdorimit të materialeve zgjedhore tej atyre që parashikohen në nenin 100 të Kodit Zgjedhor, apo të zhvillimit të procedurave të pa parashikuara në ligj, dhe që nuk përkojnë me përmbushjen e detyrës së tyre funksionale, do të bëhet i zbatueshëm ky akt normativ i KQZ-së. Në qoftë se nuk do të rezultojë në asnjë qendër votimi evidentimi i rasteve të sipërpërmendura në këtë akt normues juridik, atëherë do të jetë i panevojshëm zbatimi i tij. Kjo e bën hipotetike zbatimin e aktit normativ.

Është pika 6 e vendimit, objekt shqyrtimi, në të cilin thuhet se **“Në rast se** ndonjë nga anëtarët apo sekretari i KQV-së, apo vëzhguesit e pranishëm në qendrën e votimit, përdorin mjete të tjera të cilat nuk janë të përcaktuara në ligj, dhe janë të ndaluara për përdorim sipas pikave 4 dhe 5 të këtij vendimi, Kryetari, apo çdo anëtar tjetër i KQV-së që konstaton këtë fakt, mban një procesverbal dhe njofton menjëherë KZAZ-në përkatëse dhe KQZ-në.”

Pikërisht fakti se vendimi parashikon në mënyrë hipotetike (me frazën **“në rast se”**) mundësinë e konstatimit të

shkeljes dhe për rrjedhojë mundësinë e marrjes së vendimeve ndaj shkelësve të ligjit, i heq vendimit nr. 621, datë 21.06.2013, karakterin individual, duke e bërë atë një akt të qartë me natyrë normative.

c) Elementi i tretë, po aq i rëndësishëm dhe që përcakton natyrën normative të vendimit të KQZ-së është **mos shterimi i tij në rast zbatimi.**

Që në titullin e tij, vendimi i KQZ-së që lidhet me *“materialet të cilat lejohen të përdoren gjatë ditës së votimit nga personat e pranishëm në qendrën e votimit”*, rezulton qartazi se nuk arrin të shterojë me zbatimin e tij. Pikërisht këtij akti normativ, që ka normuar juridikisht, nëpërmjet rregullave të detyrueshme të sjelljes, veprimtarinë që duhet të kryejnë, në kuptim të procedurave të përcaktuara në nenet 101-109 të Kodit Zgjedhor anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit dhe vëzhguesit e akredituar të subjekteve zgjedhore pranë qendrave të votimit, do të duhet t'i referohen në çdo rast konkret organet e administrimit të zgjedhjeve:

- çdo KQV, nëpërmjet Kryetarit, apo çdo anëtar tjetër të tij, kur të konstatojë shkelje të rregullave të përcaktuara në këtë akt normativ, duke mbajtur një procesverbal dhe duke njoftuar menjëherë KZAZ-në përkatëse dhe KQZ-në;
- KQZ-ja në çdo ankim administrativ të paraqitur pranë saj, që do të ketë për objekt vlerësimin e shkeljeve në kuptim të rregullave të përcaktuara në këtë akt normativ;
- do t'i referohet Kolegji Zgjedhor, por dhe çdo organ tjetër, kur të vlerësojë procedurën e kryer nga KQZ-ja etj.

Pra, e gjithë *procedura që do të kryejnë në të ardhmen, të gjitha KQV-të dhe KZAZ-të, në të gjithë territorin e Republikës, KQZ-ja si organi më i lartë në rrugën e ankimit administrativ, por edhe vetë Kolegji Zgjedhor, do të bazohet në këtë vendim.* Për këtë arsye, **ky vendim i KQZ-së konsiderohet jo shterues, përderisa do të zbatohet për çdo rast, në të ardhmen, deri sa akti të ketë fuqi juridike.**

4. Për rrjedhojë, një vendim,

- a. që përcakton rregullime me fuqi juridike të përgjithshme për të gjitha KQV-të, KZAZ-të dhe KQZ-në;
- b. që parashikon hipoteza abstrakte, të cilat nuk është e sigurt se do të mund të zbatohen domosdoshmërisht në praktikë;
- c. që nuk shteron me një akt të vetëm zbatimi dhe,
- d. që prek mënyrën e rregullimit të çështjeve zgjedhore e të procesit të votimit, në të gjitha rastet që do të paraqiten nga i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë, në zbatim të parashikimeve të Kodit Zgjedhor,

duhet të ndjekë procedurën e përcaktuar në nenin 24 të Kodit Zgjedhor, që kërkon miratimin e akteve normative me votën “pro” të të paktën pesë anëtarëve të KQZ-së.

5. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk rezulton t'i ketë pasur parasysh cilësitë ligjore të sipërpërmendura të aktit normativ. Nëpërmjet votimit të këtij vendimi, me votën e katër anëtarëve, KQZ-ja ka shkëlur në mënyrë flagrante procedurën, duke e shndërruar veten në një organ inkompetent.

6. Kryerja e veprimeve të tilla, në kapërcim të dukshëm të *quourumit* të nevojshëm, që kërkohet për vendimmarrjen e KQZ-së, në vështrim të nenit 24 të Kodit Zgjedhor dhe të neneve 116 e 117 të Kodit të Procedurave Administrative, e bëjnë vendimin e KQZ-së nr. 621, datë 21.06.2013, *“Për materialet të cilat lejohen të përdoren gjatë ditës së votimit nga personat e pranishëm në qendrën e votimit”*, absolutisht të pavlefshëm.

Janë pikërisht:

- mosarritja e *quourumit* të nevojshëm të votave për miratimin e vendimit, objekt shqyrtimi, dhe për rrjedhojë,
- kompetenca jo e ligjshme që KQZ-ja i ka dhënë vetes për të nxjerrë një vendim të tillë,

që e evidentojnë vendimin nr. 621, datë 21.06.2013, “Për materialet të cilat lejohen të përdoren gjatë ditës së votimit nga personat e pranishëm në qendrën e votimit”, si në kundërshtim flagrant me ligjin, për shkak të cenimit të hapur të normave të përcaktuara të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës Apelit Tiranë bazuar në nenin 158 të Kodit Zgjedhor.

V E N D O S I :

1. Pranimin e kërkesëpadisë.
2. Konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit Nr. 621, datë 21.06.2013 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për materialet të cilat lejohen të përdoren gjatë ditës së votimit nga personat e pranishëm në qendrën e votimit”.

Tiranë, më 22.06.2013

Anëtare
Edlira PETRI

Anëtar
Valbon ÇEKREZI

Kryesues
Fuat VJERDHA

Anëtar
Ilir TOSKA

Anëtar
Petrit ÇENO

* * *



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANE
KOLEGJI ZGJEDHOR

Nr.19 Regj. Themeltar
Date 20.07.2013

Nr.17 Vendimi
Date 22.07.2013

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegji Zgjedhor i Gjykes se Apelit Tirane i perbere nga gjyqtaret:

KRYESUES : ANDI CIVICI
ANETAR : GJINOVEFA GABA
ANETAR : VALBON ÇEKREZI
ANETAR : ILIR TOSKA
ANETAR : KLITON SPAHIU

Me sekretare **Rexhina Baçi**, në Tiranë, sot në **date 22.07.2013**, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore me nr.19 Akti, që u përket palëve:

PADITESE: Partia Socialiste Shqipërisë,
përfaqësuar me autorizim nga Z.Koli BELE dhe
Eridian SALIANJI.

I PADITUR: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve,
përfaqësuar me autorizim nga Znj. Dëshira PASKO.

PALE E INTERESUAR: Partia Demokratike e Shqipërisë,
përfaqësuar me autorizim nga Z. Ivi KASO dhe Oerd
BYLYKBASHI.
Lëvizja Socialiste për Integrim, (në mungesë).

- OBJEKTI:**
1. Konstatim i pavlefshmerise absolute te Vendimit të K.Q.Z-së Nr. 744 datë 15.07.2013 “Per pranimin per shqyrtim te kerkeses ankimore nr. 41 date 15.07.2013 te subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqiperise”.
 2. Konstatim i pavlefshmerise absolute te Vendimit të K.Q.Z-së Nr. 739 datë 15.07.2013 “Per pranimin per shqyrtim te kerkeses ankimore nr. 40 date 15.07.2013 te subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqiperise”.
 3. Konstatimin si absolutisht te pavlefshme te procesit te hetimit administrativ qe lidhet me shqyrtimin ne thelb te kerkesave ankimore te mesiperme, me pasoje nderprerjen e te gjitha veprimeve qe po kryen KQZ.

BAZA LIGJORE: Nenet 24, 27, 145, 152, 153, 155, 156, 158 e vijues, të ligjit nr. 10019, date 29.12.2008
“Kodi Zgjedhor i RSH me ndryshimet perkatese”.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoi palët prezent në pretendimet e tyre, paditësin nëpërmjet përfaqësuesve që në perfundim kërkuan pranimin e padisë sipas objektit, përfaqësuesen e pales së paditur, që kërkoi rrezimin e padise, përfaqësuesit e personit të trete që kërkuan rrezimin e padisë, pasi administroi provat e bisedoi çështjen në tërësi;

V Ë R E N

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ) ne daten 15.07.2013 nëpërmjet vendimit Nr. 739 ka vendosur: “Pranimin per shqyrtim te kerkeses ankimore nr. 40 date 15.07.2013, të paraqitur nga Partia Demokratike e Shqiperise”.

Ne te njejten date nepermjet vendimit Nr. 744 KQZ ka vendosur: “Pranimin per shqyrtim te kerkeses ankimore nr. 41 date 15.07.2013, të paraqitur nga Partia Socialiste e Shqiperise”.

Objekti i kerkeses ankimore te Partise Demokratike ka qene:

1. Kundershtimi i Vendimit te KQZ Nr. 701 date 10.07.2013 qe ka shpallur rezultatin e votimit per Zonen Zgjedhore Qarku Lezhe, per Zgjedhjet per Kuvendin 2013.
2. Rinumerim dhe rivleresimi i votave te QV nr. 07051, QV nr. 0708, QV nr. 07081, QV nr. 0725, QV nr. 0762, QV nr. 0763, QV nr. 0764, QV nr. 0765, QV nr. 0769, QV nr. 0707 te KZAZ nr. 13 te Zones Zgjedhore Qarku Lezhe.
3. Rinumerim dhe rivleresimi i votave te QV nr. 0754, QV nr. 0759, QV nr. 0760, QV nr. 0761, QV nr. 0764, QV nr. 0765, QV nr. 0769, QV nr. 0707 te KZAZ nr. 13 te Zones Zgjedhore Qarku Lezhe.
4. Ndryshimi i vendimit Nr. 701 date 10.07.2013 te KQZ qe ka shpallur rezultatin e votimit per Zonen Zgjedhore Qarku Lezhe duke perfshire ne te rezultatin e dale nga rinumerimi dhe rivleresimi i votave.

Objekti i kerkeses ankimore te Partise Socialiste ka qene:

1. Kundershtimi i Vendimit te KQZ Nr. 701 date 10.07.2013 qe ka shpallur rezultatin e votimit per Zonen Zgjedhore Qarku Lezhe, per Zgjedhjet per Kuvendin 2013.
2. Kundershtimi i Vendimit te KZAZ Nr. 15 per miratimin e tabelës permblëdhese.
3. Shpalljen e pavlefshme te zgjedhjeve ne Qendren e Votimit (QV) nr. 0907, QV nr. 0910/1, QV nr. 0856, QV nr. 0856/1, QV nr. 0857 dhe QV nr. 0857/1 te ZAZ nr. 15 ne zonen zgjedhore Qarku Lezhe.

Nderkohe, me Vendimin Nr. 701 date 10.07.2013, KQZ ka vendosur: "Te miratoje Tabelen Permblëdhese te Rezultatit per zonen zgjedhore Qarku Lezhe, bashkëngjitur këtij vendimi".

Mbi bazen e vendimeve si me lart (Nr. 739 dhe Nr. 744 date 15.07.2013), me date 16.07.2013, KQZ ka filluar shqyrtimin ne themel te kërkesave ankimore, duke i bashkuar ato ne nje shqyrtim te vetem, gjate te cilit ka vendosur te kryeje këqyrjen e materialeve zgjedhore, rinumërimin dhe rivlerësimin e votave te ndodhura ne kutite e qendrave te votimit, fillimisht ato sipas ankimit te Partise Demokratike dhe, me pas, per te gjitha qendrat e votimit te zones zgjedhore Qarku Lezhe.

Ndersa KQZ vijonte shqyrtimin si me lart, me date 20.07.2013, Partia Socialiste ka depozituar përpara Kolegjit Zgjedhor nje ankim/kerkesepadi, me te cilen, duke paditur KQZ, si dhe thirrur si pale te interesuara Partine Demokratike dhe Levizjen Socialiste per Integrim, ka kërkuar sipas objektit te përshkruar ne pjesen hyrëse te këtij vendimi.

Paditësi, Partia Socialiste e Shqipërisë (PS), ne kerkesepadi dhe gjate gjykimit pretendoi se:

- Vendimet nr. 739 dhe nr. 744 te KQZ duhet te konstatohen si absolutisht te pavlefshme sepse kerkesat ankimore te paraqitura perpara KQZ konsistonin ne marrjen e nje vendimi qe, bazuar ne nenin 24/1, pikat “b” dhe “c”, te Kodit Zgjedhor, kerkon shumice te cilesuar. Per kete arsye, mbledhja e KQZ, referuar pikes 5 te nenit 22 te Kodit Zgjedhor, per trajtimin e ketyre kerkesave ankimore, eshte e vlefshme kur jane prezent te pakten 5 anetare te KQZ, nderkohe qe ne mbledhjen e KQZ ku jane marre vendimet objekt padie kane marre pjese vetem 4 anetare.
- Perderisa mbledhja e KQZ vetem me 4 (kater) anetare per trajtimin e ketyre kerkesave ankimore eshte ne kundërshtim me nje norme detyruese ligjore me pasoje “pavlefshmerine”, atehere edhe produkti i kesaj mbledhje, vendimet objekt ankimi, qe kane pranuar per shqyrtim kerkesat ankimore nr. 40 dhe nr. 41, si dhe cdo veprim tjetër procedural (hapja e kutive te votimit, rinumërimi dhe rivlerësimi i fleteve te votimit, si dhe marrja dhe administrimi i provave) eshte i pavlefshem dhe pasojat e tij jane nul.

- Shqyrtimi i kerkesave ankimore nga KQZ behet ne mbledhjet e saj, te cilat jane te thirrura dhe mbahen ne perputhje me dispozitat e nenit 22 te Kodit Zgjedhor. Kodi ne dy nene te vecanta, nenin 22 dhe 24 te tij, trajton te vecuar konceptin e “mbledhjeve te vlefshme” dhe ate te “vendimeve te vlefshme”, te cilat duhet te merren me 5 anetare.
- Pjesemarrja e 5 anetareve eshte domosdoshmeri gjate gjithë mbledhjeve qe zhvillohen ne procesin e shqyrtimit te ankeses/kerkeses/vendimit.
- KQZ gjate shqyrtimit te ankeses, duke zhvilluar mbledhje nen kuorumin e kerkuar nga ligji, eshte ne kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe me nenet 115/a dhe 116/c te Kodit te Procedurave Administrative.
- Mbledhjet e KQZ qe ne fillim te shqyrtimit administrativ kane paragjykuar vendimin, duke qene se pranimi i kerkesave ankimore kerkon nje vendim me 5 anetare. KQZ eshte pothuajse (quasi) gjykate kur shqyrton ankimet administrative dhe, si ne nje proces gjyqesor, nuk mund te kete hetim pa qene te pranishem te pakten anetaret e domosdoshem per kuorumin e kerkuar nga ligji.
- Koncepti i ndarjes se “mbledhjes se vlefshme” dhe “vendimit te vlefshem” parashikohet edhe ne ligjin nr. 8480/27.05.1999, “Per funksionimin e organeve kolegjinale te administrates shtetërore dhe enteve publike”, ne Rregulloren e Kuvendit te Republikës se Shqiperise dhe ne Rregulloren e Komisionit te Sherbimit Civil.

Pala e paditur KQZ, prapësoi pretendimet e paditësit duke parashtruar se:

- Pas regjistrimit te ankeses ne mbeshtetje te nenit 129 te Kodit Zgjedhor, KQZ ben verifikimin paraprak te kerkeses ankimore. Ne rastin konkret, pas verifikimit paraprak u konstatua se kerkesat ankimore nr. 40 dhe nr. 41 plotesonin elementet e percaktuar ne nenin 126 dhe 130 te Kodit Zgjedhor. Per kete arsye, ne perfundim te verifikimit sipas nenit 130 te

Kodit Zgjedhor, KQZ mori vendimet nr. 739 dhe nr. 744 date 15.07.2013, duke pranuar per shqyrtim kerkesat ankimore.

- Vendimet e KQZ per rezultatin e verifikimit paraprak nuk kerkojne vendimarrje me shumice te cilesuar, sikunder parashikohet ne nenin 24 te Kodit Zgjedhor. KQZ ne te gjitha proceset e zhvilluara ka marre vendime per rezultatin e verifikimit paraprak me 4 vota, ne mbeshtetje te nenit 129 te Kodit Zgjedhor dhe asnje prej subjekteve nuk ka pretenduar se kjo vendimarrje kerkon shumice te cilesuar.
- Vendimet objekt ankimi jane ne perputhje te plote me ligjin dhe konkretisht me nenet 126, 129, 130 te Kodit Zgjedhor dhe nuk jemi ne asnje prej kushteve te nenit 116 te Kodit te Procedurave Administrative.
- Kerkesa per pavlefshmeri absolute te procesit te hetimit administrativ eshte e pambeshtetur ne nenin 145/1 te Kodit Zgjedhor dhe vendimet e pretenduara ne ankim jane vendime te ndermjetme te marra gjate shqyrtimit administrativ, proces i cili rregullohet nga nenet 132 e ne vijues te Kodit Zgjedhor. Cdo vendim i KQZ i marre gjate procesit te shqyrtimit administrativ eshte vendim i ndermjetem dhe ankimohet se bashku me vendimin perfundimtar, i cili ne rastin konkret nuk eshte marre akoma nga KQZ.

Pala e interesuar Partia Demokratike e Shqipërisë (PD) prapësoi pretendimet e paditesit, duke parashtruar se:

- Kodi Zgjedhor ka parashikuar fazat e shqyrtimit administrativ te cilat jane:
 - 1-Regjistrimi i kerkeses ankimore;
 - 2-Shqyrtimi paraprak i kerkeses, qe mbyllet me vendim per kalim ose moskalim per shqyrtim te kerkeses ankimore;
 - 3-Çeljen e hetimit administrativ, hetimin dhe mbylljen e hetimit, gjate te cilit merren nje sere vendimesh te ndermjetme;

4-Vendimin përfundimtar.

- Nepermjet ankimit/padise se paraqitur pretendohet qe sistemi i mesiperm i zgjidhjes se ankesave te dermmohet dhe te behet i pavlefshem mbi pretendimin e mungeses se kourumit, ne nje kohe kur eshte vet PS qe ka urdheruar terheqjen e anetareve te saj nga KQZ me qellim per te bllokuar kete institucion. Paditesit nuk i intereson vlefshmeria e vendimmarrjes, por zhvleftesimi i hetimit publik te KQZ.
- Ne fazen e shqyrtimit paraprak KQZ kufizohet vetem ne nje shqyrtim formal te rregulluar nga nenet 129-131 te Kodit dhe KQZ ne kete faze sheh vetem 3 elemente te formes qe parashikohen ne nenin 130 te Kodit.
- Vendimi i marre sipas nenit 129 nuk hyn ne asnje rast tek vendimet e parashikuara ne nenin 24 te Kodit, si vendime qe merren me 5 vota, ku vetem vendimi përfundimtar per “pranimin” e kerkeses eshte i tille.
- Nje vendim pozitiv per kalimin per shqyrtim nuk paragjykon ne asnje rast vendimarrjet e mepasme te KQZ. Me kete vendim kjo faze mbyllet plotesisht dhe nuk kerkon 5 vota, por vetem 4 vota.
- Vendimet ne lidhje me veprimet hetimore jane te ndërmjetme, te cilat merren me 4 vota per te siguruar nje hetim efikas, te plote dhe te drejte.

Nga ana e saj, pala e interesuar Levizja Socialiste per Integrim, megjithëse e njoftuar rregullisht, nuk u paraqit ne gjykim, i cili u zhvillua ne mungese te saj.

Kolegji Zgjedhor, pasi ia nënshtroi çështjen debatit gjyqësor, dëgjoi palët, administroi provat shkresore dhe pretendimet përfundimtare, në përfundim cmon te pranoje padinë, si te mbeshtetur ne ligj dhe ne prova.

Referuar nenit 145/1 te Kodit Zgjedhor, Kolegji Zgjedhor cmon se Partia Socialiste, duke qene nje nga subjektet zgjedhor qe ka marre

pjesë në zgjedhjet për Kuvendin 2013, gëzon të drejtën për të ankimuar vendimet e KQZ kur çmon se ato cenojnë interesat e saj të ligjshëm, sipas afatëve të përcaktuara në nenin 152 të këtij Kodi.

Në rastin konkret, Partia Socialiste ka paraqitur ankim kundër vendimeve Nr. 739 dhe Nr. 744 datë 15.07.2013 të KQZ, nëpërmjet të cilëve, siç u parashtrua, janë pranuar për shqyrtim ankimet administrative të paraqitura kundër vendimit për miratimin e Tabeles Përmbledhëse të Rezultatit për zonën zgjedhore Qarku Lezhe, si dhe kërkesa e Partisë Socialiste për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në disa qendra votimi të kësaj zone zgjedhore, që sipas palës paditese cenojnë interesat e saj të ligjshëm.

Gjithashtu, Partia Socialiste, duke ankimuar vendimet si më lart të KQZ, konteston njëherazi dhe të gjithë procesin që KQZ është duke zhvilluar mbi bazën e ankimeve/kërkesës së paraqitur nga dy subjektet zgjedhore të lartpërmendura, pas pranimi të tyre për shqyrtim me vendimet objekt padie, duke kërkuar ndërprerjen e këtij procesi.

Rezulton që objekti i mosmarrëveshjes të paraqitur për shqyrtim të lidhet me interpretimin dhe zbatimin e neneve 22/5 dhe 24/1 të Kodit Zgjedhor përmbajtja e të cilave është si më poshtë:

Neni 22/5 i Kodit Zgjedhor parashikon: *“Mbledhjet e KQZ-së janë të vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 4 anëtarë të saj, me përjashtim të rasteve kur kërkohet shumicë e cilësuar për marrjen e vendimit, sipas nenit 24 të këtij Kodi”.*

Neni 24 pika 1 e Kodit Zgjedhor parashikon: *“Konsiderohen të miratuara, kur votojnë “pro” jo më pak se 5 anëtarë të KQZ-së, vendimet lidhur me:*

- a) shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, sipas neneve 162, 163 dhe 166 të këtij Kodi;*
- b) pranimin e ankimit kundër vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e zgjedhjeve të zonës zgjedhore, sipas nenit 123 të këtij Kodi dhe vendimet*

lidhur me ankimet kundër vendimeve të KZAZ-ve për rezultatin e zgjedhjeve për qeverisjen vendore;

- c) kërkesat për deklarimin e pavlefshëm të zgjedhjeve në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi;*
- ç) shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në zonën zgjedhore apo në të gjithë vendin dhe përsëritjen e tyre;*
- d) aktet me karakter normativ dhe që kanë për qëllim rregullimin e çështjeve që lidhen me zgjedhjet;*
- dh) propozimin për shkarkimin e anëtarit të KQZ-së, sipas pikës 2 të nenit 18 të këtij Kodi;*
- e) miratimin e strukturës organike të KQZ-së, si dhe rregulloren e funksionimit të KQZ-së;*
- ë) caktimin e mandateve për çdo zonë zgjedhore, sipas nenit 76 të Kodit;*
- f) caktimin e zonave të administrimit zgjedhor, sipas nenit 27 të Kodit. Vendimet e tjera miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KQZ-së.*

Vendimet e tjera miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KQZ”.

Ne konsiderate të pretendimeve të paraqitura Kolegji Zgjedhor vlerëson se:

Vendimet objekt ankimi Nr.739 dhe 744 datë 15.07.2013 të KQZ, që kanë pranuar kërkesat ankimore respektive të Partisë Demokratike dhe të Partisë Socialiste, janë vendime që merren në procesin e shqyrtimit administrativ të kërkesave ankimore mbas përmbylljes së procesit të numërimit dhe miratimit të tabelave përmbledhese për rezultatin e zgjedhjeve të zones/ave zgjedhore nga ana e KQZ. Procesi i shqyrtimit administrativ të kërkesave ankimore gjen rregullim të veçantë në pjesën X, nenet 124-144 të Kodit Zgjedhor.

Kërkesat ankimore te paraqitura ne rastin konkret, sipas objektit te kerkimit te tyre, kane synuar ndryshimin e vendimit te KQZ per miratimin e tabelës permbledhese per rezultatin e zgjedhjeve te zones zgjedhore Qarku Lezhe, nderkohe qe nga Partia Socialiste eshte kerkuar edhe deklarimi i pavlefshmerise se zgjedhjeve ne disa qendra votimi dhe, si te tilla, keto kerkime imponojne nje vendimarrje perfundimtare sipas nenit 24/1, germat “b” dhe “c”, te Kodit Zgjedhor.

Momenti i fillimit te shqyrtimit administrativ te kërkesave ankimore nga ana e KQZ parashikohet ne nenin 132/1 te Kodit Zgjedhor, sipas te cilit: ***“Shqyrtimi i kërkesave ankimore ndaj rezultatit të një zone zgjedhore, sipas nenit 124, fillon vetëm pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 124 të këtij Kodi. KQZ-ja, përpara ose gjatë shqyrtimit të një kërkesë ankimore, vendos shqyrtimin bashkërisht të saj me një ose më shumë kërkesa të tjera ankimore, të paraqitura nga subjekte të ndryshme kundër të njëjtit vendim të KZAZ-së, sipas nenit 122 apo, sipas rastit, të KQZ-së, sipas nenit 123 për rezultatin dhe/ose pavlefshmërinë e votimit.”***

Rezulton se momenti i fillimit te shqyrtimit te kërkeses ankimore eshte percaktuar si i tille me ndryshimet e Kodit Zgjedhor nepermjet ligjit nr. 74/2012, date 19.07.2012 dhe nje rregullim i tille nuk ka qene me pare. Keshtu, kjo dispozite përpara ndryshimit te bere ne vitin 2012, parashikonte se: *“KQZ-ja, përpara ose gjatë shqyrtimit të një kërkesë ankimore, ka të drejtë të vendosë shqyrtimin bashkërisht të saj me një ose më shumë kërkesa të tjera ankimore, të paraqitura nga subjekte të ndryshme kundër të njëjtit vendim të KZAZ-së apo sipas rastit të KQZ-së sipas nenit 123. Bashkimi i kërkesave ankimore bëhet edhe në rastet kur dy ose më shumë subjekte kërkojnë pavlefshmërinë e zgjedhjeve në të njëjtën zonë zgjedhore. KQZ-ja vendos bashkimin e kërkesave ankimore kur çmon se shqyrtimi i përbashkët i tyre lehtëson zhvillimin e gjyqimit, ose kur shqyrtimi i veçantë i secilës prej kërkesave ankimore mund të paragjykonte objektin e ankimeve të tjera”*

Nga sa me siper, rezulton se vet ligjvenesit ka synuar te percaktoje momentin e fillimit te shqyrtimit administrativ duke mos e lene kete moment evaziv dhe te erret ne ligj, pasi prej ketij momenti

percaktohet dhe kuorumi i nevojshem qe duhet te kete mbledhja e KQZ per shqyrtimin e kërkesave ankimore.

Shqyrtimi administrativ i kërkesave ankimore realizohet ne nje proces te vetem, i cili eshte i limituar ne kohe, qe fillon pas kalimit te afatit te percaktuar ne pikat 2 dhe 3 te nenit 124 te Kodit Zgjedhor, pra me paraqitjen e ankimit jo me vone se 5 dite nga shpallja e vendimit, si dhe qe përfundon brenda nje afati 10 ditor nga momenti i regjistrimit te kerkeses ankimore, referuar 143/3 te Kodit Zgjedhor. Vete procesi kalon neper disa faza. Fillimisht ne fazen e shqyrtimit paraprak te kerkeses ankimore, me tej ne fazen e shqyrtimit ne temel te saj dhe, me tej akoma, ne fazen e marrjes se vendimit, por qe gjithesesi, te gjitha keto faza jane pjese te nje procesi/shqyrtimi te vetem administrativ, duke mos perbere ne vetvete asnjera prej ketyre fazave nje proces te mevetesishem dhe te pavarur.

Ne nenin 22/5 te Kodit Zgjedhor, përcaktohet “vlefshmëria e mbledhjes” se KQZ, e cila, si rregull, eshte e vlefshme kur marrin pjese jo me pak se 4 anetare, me përjashtim te rasteve kur kërkohet “shumice e cilësuar” per marrjen e vendimit sipas nenit 24 te këtij Kodi, dispozite kjo pika 1, gjerat “a”-“f”, te te ciles, nga ana tjeter, përcakton shumicen e nevojshme qe duhet per nje vendimmarrje pozitive, votimin “pro” te jo me pak se 5 anetareve te KQZ. Pra, referuar nenit 22/5 te Kodit Zgjedhor, si rregull, mbledhja e KQZ eshte e vlefshme kur ne te marrin pjese jo me pak se 4 anetare, ndersa, si përjashtim, kemi dhe mbledhje, qe per te qene te vlefshme, duhet te marrin pjese jo me pak se 5 anetare. Eshte e qarte se kuorumi i nevojshem per vlefshmerine e mbledhjes se KQZ përcaktohet nga lloji i vendimmarrjes perfundimtare te KQZ, pra ne vendime qe merren me “shumice te cilësuar” (sipas nenit 24, pika 1, gjerat “a”-“f”, te Kodit Zgjedhor, qe kërkon votimin “pro” te jo me pak se 5 anetareve) apo ne vendime te tjera te ndryshme qe merren me “shumice te thjeshte” (sipas paragrafit te fundit te nenit 24/1 te Kodit Zgjedhor, qe kërkon shumicen e votave te te gjithë anetareve te KQZ, pra votimin “pro” te jo me pak se 4 anetareve). Nderkohe, referuar nenit 24/1 te Kodit Zgjedhor, vendimmarrjet e KQZ, nder te tjera, përcaktohen nga lloji i kërkesave ankimore apo kërkesave te paraqitura nga subjektet zgjedhore. Keshtu, kërkesat ankimore sipas gërmes “b” apo kërkesat sipas gërmes “c”, te nenit 24/1 te

Kodit Zgjedhor, kondicionojne nje vendimmarrje te KQZ vetem me “shumice te cilësuar”, pra te jo me pak se te 5 anetareve.

Ne rastin konkret, ajo c’ka eshte kërkuar nepermjet kërkesave ankimore te paraqitura para KQZ nga Partia Demokratike dhe Partia Socialiste referon ne germat “b” dhe “c” te nenit 24/1 te Kodit Zgjedhor, dispozite kjo qe, sic u parashtrua, përcakton marrjen e vendimit nga KQZ me “shumice te cilësuar”, pra votimin “pro” nga jo me pak se 5 anetareve, nderkohe qe eshte pikërisht kjo “shumice e cilësuar” e vendimmarrjes se KQZ qe imponon nga ana tjetër dhe kuorumin e nevojshem per vlefshmerine e mbledhjes se KQZ sipas nenit 22/5 te Kodit Zgjedhor, pra qenien e pranishem ne mbledhje te jo me pak se 5 anetareve te saj.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se KQZ, si organ kolegjal, si rregull i pergjithshem, ushtron veprimtarine e saj ne pranine e te gjithë anetareve (7), por, ne nenin 22/5 te Kodit Zgjedhor, ligjvenesit ka parashikuar mundesine qe ky organ te ushtroje veprimtarine e tij edhe me nje anetaresi me te pakët ne numer, duke parashikuar per kete vetem dy alternativa, ku sipas njerës me pranine e jo me pak se 4 anetareve, ndersa alternativa tjetër me pranine e jo me pak se 5 anetareve, kondicionuar kjo nga lloji i vendimmarrjes se KQZ, qe ne rastin e ushtrimit nga KQZ te funksionit te saj verifikues (neni 153 i Kushtetutes se RSH) ne thelb kushtezohet nga kërkesa apo kërkesa ankimore qe mund te paraqesin subjektet zgjedhore. Eshte e qarte se Kodi Zgjedhor ka percaktuar shprehimisht dhe ne menyre te qarte numrin minimal te anetareve qe duhet te jene te pranishem dhe qe autorizohen per te vepruar ne emer te KQZ, pra per te marre vendim ne emer te te gjithë anetareve te saj.

Nga sa me lart, ne kushtet kur mbledhja e KQZ e dates 15.07.2013 ka patur per objekt shqyrtimi kërkesa ankimore qe kerkojne vendimmarrje sipas nenit 24/1, germat “b” dhe “c”, te Kodit Zgjedhor, ne perputhje me nenin 22/5 te Kodit Zgjedhor, ajo duhet te zhvillohej ne prani te jo me pak se 5 anetareve, qe perben dhe kuorumin e nevojshem per vlefshmerine e mbledhjes. Mungesa e këtij kuorumi per vlefshmerine e mbledhjes se KQZ passjell pavlefshmerine e saj dhe, per rrjedhoje, pavlefshmerine absolute te vendimeve te marra nga KQZ ne kete mbledhje, pikërisht te vendimeve objekt gjykimi Nr. 739 dhe Nr. 744 datë 15.07.2013.

Çmohet i pabazuar nga Kolegji Zgjedhor prapësimi se, duke qene se objekti i verifikimit paraprak te KQZ-se ka per synim verifikimin e ekzistences se elementeve te formes, sipas nenit 126 te Kodit Zgjedhor, si dhe te elementeve te përcaktuara ne nenin 130 te këtij Kodi, atehere, per vlefshmerine e mbledhjes se KQZ, per marrjen e vendimit per pranimin per shqyrtim te kerkeses sipas nenit 129/3, germa “a”, te Kodit Zgjedhor, eshte e nevojshme prania e jo me pak se 4 anetareve, persa kohe nje vendimmarrje e tille nuk eshte nga ato sipas nenit 24/1, germa “a”-“f”, te Kodit Zgjedhor, qe kërkon “shumice te cilësuar”, por nje vendimmarrje qe kërkon vetem nje “shumice te thjeshte”.

Vendimi sipas nenit 129/3 te Kodit Zgjedhor, ndryshe nga sa pretendohet, eshte nje vendim qe merret gjate procesit te shqyrtimit administrativ te ankimit nga KQZ, pikërisht ne fazen fillestare te tij, qe sipas Kodit Zgjedhor përcaktohet si “verifikimi paraprak”, qe nënkupton shqyrtimin paraprak te ankeses me qellim verifikimin e disa elementeve, ekzistenca ose jo e te cileve passjell shqyrtimin ose jo ne temel te saj, pra qe kushtezon vazhdimin ose jo te shqyrtimit administrativ. Eshte e qarte se ligjvenesia, per te lehtësuar procesin e shqyrtimit administrativ te kërkesave ankimore, per ta bere ate efikas dhe efektiv, ka parashikuar te drejten, por dhe detyrimin e KQZ, per te verifikuar paraprakisht ekzistencen e disa elementeve formal, mosekzistenca e te cileve passjell mosshqyrtimin ne temel te kerkeses ankimore, pra disponimin per mospranimin e saj, ç’ka i jep fund procesit te shqyrtimit administrativ pa e shqyrtuar ne temel kerkesen ankimore. Nderkohe qe, vetem ekzistenca e ketyre elementeve formal kushtezon vijimin me tej te shqyrtimit, pra shqyrtimin ne temel te kerkeses ankimore. Ne keto kushte, persa kohe jemi para nje procesi te vetem ligjor, si dhe persa kohe ligji (Kodi Zgjedhor), ne varesi te llojit te vendimmarrjes dhe ne kete aspekt te natyres se kerkeses ankimore, ka percaktuar numrin e nevojshem te anetareve te KQZ qe duhet te jene te pranishem gjate shqyrtimit (mbledhjes) te kerkeses ankimore, atehere shqyrtimi i kërkesave ankimore te paraqitura ne rastin konkret nga Partia Demokratike dhe Partia Socialiste, perfshire dhe verifikimi paraprak i tyre, mund te behej vetem ne pranine e jo me pak se 5 anetareve te KQZ.

Referuar prapësimeve te paraqitura, Kolegji Zgjedhor vlerëson se ka nje konfondim ndermjet koncepteve “mbledhje te vlefshme” dhe

“vendim te vlefshem”. Dallimi i ketyre dy koncepteve rezulton edhe ne ligjin nr. 8480 date 27.05.1999 *“Per funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shtetore dhe enteve publike”*.

Kolegji Zgjedhor cmon se ne rastin konkret pavlefshmeria e vendimeve objekt padie nuk lidhet me numrin e nevojshem te votave per marrjen e tyre (shumicen e votave), por me mungesen e numrit te nevojshem te anetareve te pranishem (kuorumin) per zhvillimin e mbledhjes, mungese kuorumi kjo qe ben te pavlefshme mbledhjen ne kushtet kur 4 anetareve te pranishem ne rastin konkret ligji nuk iu ka dhene autorizim per te vepruar ne emer te organit, pra per te marre vendime ne emer te te gjithë anetareve.

Ky dallim evidentohet edhe ne Vendimin nr. 29 date 21.10.2009 te Gjykates Kushtetuese te Republikës se Shqipërisë, ku është kërkuar interpretimi i pikes 1 te nenit 78 te Kushtetutes se Republikës se Shqipërisë. Sipas nenit 78/1 percaktohet se : *“Kuvendi vendos me shumicen e votave, ne prani te me shume se gjysmes se te gjithë anetareve te tij, pervec rasteve kur Kushtetuta parashikon nje shumice te cilësuar”*.

Gjykata Kushtetuese ka interpretuar se: *“Prania e me shume se gjysmes se te gjithë anetareve te Kuvendit ne cdo seance vendimmarrje eshte absolutisht e nevojshme per vlefshmerine e vendimeve qe merr ky organ sipas përcaktimeve te nenit 78/1 te Kushtetutes”*. Gjykata Kushtetuese ka arritur ne përfundimin se pika 1 e nenit 78 te Kushtetutes duhet interpretuar si vijon: *“Numri i deputeteve te pranishem per celjen e seances se votimit parlamentar eshte minimalisht 71 deputete.”* Interpretimi i mesiperme e ben me te dallueshem konceptin e vlefshmerise se vendimit ne raport me numrin e anetareve te organit kolegjial te nevojshem per marrjen e këtij vendimi.

Vendimi nr. 739 date 15.07.2013 *“Per pranimin per shqyrtim te kerkeses ankimore nr. 40 date 15.07.2013 te subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë”* si dhe Vendimi nr. 744 date 15.07.2013 *“Per pranimin per shqyrtim te kerkeses ankimore nr. 41 date 15.07.2013 te subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë”* konstatohen si vendime absolutisht te pavlefshme sepse mbledhja e KQZ vetem me 4 (kater) anetare per trajtimin e ketyre kerkesave/

ankesave eshte ne kundershtim me nje norme detyruese ligjore me pasoje “pavlefshmerine” e mbledhjes se KQZ.

Prapesimi se vendimet e KQZ per rezultatin e verifikimit paraprak, nuk kerkojne vendimarrje me shumice te cilesuar, sikunder parashikohet ne nenin 24 te Kodit Zgjedhor, dhe se KQZ ne te gjitha proceset e zhvilluara ka marre vendime per rezultatin e verifikimit paraprak me 4 vota, ne mbeshtetje te nenit 129 te Kodit Zgjedhor, nuk perben argument per te legjitimuar parregullsine e vendimarrjes se KQZ. Vendimi per pranimin per shqyrtim te kerkeses ankimore sipas nenit 130 te Kodit, eshte pjese perberese e shqyrtimit administrativ te ankimit dhe si i tille, ne kushtet kur miratimi i tabelës permblidhese per zonen zgjedhore mund te behet ne nje mbledhje te vlefshme me pranine edhe te vetem 4 anetareve, ankimi kunder vendimit qe ka miratuar tabelen duhet te perfshije ne momentin e shqyrtimit nje garanci me te larte juridike, qe nga ana e ligjvenesit eshte reflektuar ne përcaktimin e kuorumit te nevojshem te mbledhjes, sipas nenit 22/5 te Kodit Zgjedhor, pra pranine e jo me pak se 5 anetareve. Kjo garanci ndan qartesisht procesin baze te numërimit dhe nxjerrjes se rezultatit te votimit nepermjet vendimit per miratimin e tabelës permblidhese te rezultateve te votimit, me procesin e rishikimit administrativ te këtij vendimi, procese keto qe ligji ia ka ngarkuar te njëjtë organ, KQZ. Persa i takon arsyeve te mungeses se anetarit te peste te KQZ, ato nuk jane dhe nuk mund te jene pjese e objektit te këtij gjykimi.

Pavlefshmeria absolute e akteve administrative objekt gjykimi, vendimeve Nr. 739 date 15.07.2013 dhe Nr. 744 date 15.07.2013, rrjedh edhe nga neni 116/b/c i Kodit te Procedurave Administrative, sipas te cilit: “Aktet administrative do te quhen absolutisht te pavlefshme, ne kuptim te ketij Kodi, ne rastet e meposhtme: “...; *b) kur akti eshte nxjerre nga nje organ administrativ ne kapercim te kompetencave te tij ligjore; c) kur akti eshte nxjerre ne kundershtim me formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji.*” Ne momentin e verifikimit paraprak te kërkesave ankimore te paraqitura nga Partia Demokratike dhe Partia Socialiste, KQZ ka pasur per detyre qe, konform nenit 130, germa “a”, te Kodit Zgjedhor, te verifikojë kompetencen e saj per shqyrtimin e ankimit. Ne kete moment KQZ, 4 anetaret e pranishem te saj, nuk kane patur nga ligji autorizimin/kompetencen per te shqyrtuar ankimet dhe per te marre vendim

ne emer te organit. Rrjedhimisht, vendimet e marra per pranimin per shqyrtim te kerkesave ankimore jane absolutisht te pavlefshme. Keto vendime, ne rastin eventual te pranimit per shqyrtim apo mospranimit te ankimit, prodhojne pasoja juridike te drejtperdrejta per palet ne procesin e shqyrtimit ankimor dhe ndaj tyre mund behet ankim sipas nenit 145/1 te Kodit Zgjedhor. Kete te drejte e ka njohur edhe vet pala e paditur KQZ, pasi ne fund te dispozitivit te vendimeve objekt gjykimi ka evidentuar te drejten e paleve per te bere ankimit ne Kolegjin Zgjedhor brenda 5 diteve nga shpallja e tyre.

Ne referim te nenit 117/1 te Kodit te Procedures Administrative, sipas te cilit: *“Aktet administrative absolutisht te pavlefshme nuk prodhojne pasoja ligjore pavaresisht nga fakti nese jane deklaruar apo jo si te tille”*, Kolegji Zgjedhor cmon se pasojat e prodhuara nga vendimet e mesiperme, pikërisht shqyrtimi ne themel i kërkesave ankimore (këqyrja, rinumërimi dhe rivlerësimi i votave, etj) do te konsiderohen nul, pasi, pervec kësaj, edhe shqyrtimi administrativ ne themel te kërkesave ankimore ka vijuar te kryhet ne mungese te kuorumit te nevojshem ligjor per vlefshmerine e mbledhjes se KQZ, referuar nenit 22/5 te Kodit Zgjedhor.

Per sa me lart, Kolegji Zgjedhor cmon se kerkesepadia e paraqitur nga Partia Socialiste eshte e bazuar ne prova dhe ligj dhe si e tille ajo duhet te pranohet teresisht sipas objektit te saj.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykates se Apelit Tirane,
bazuar ne nenin 158/3 te Kodit Zgjedhor,

V E N D O S I

1. Pranimin e padisë.
2. Konstatimin e pavlefshmerise absolute te Vendimit të K.Q.Z-së Nr. 744 datë 15.07.2013 “Per pranimin per shqyrtim te kerkeses ankimore Nr. 41 date 15.07.2013 te subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqiperise”.

3. Konstatimin e pavlefshmerise absolute te Vendimit të K.Q.Z-së Nr. 739 datë 15.07.2013 te subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqiperise.
4. Konstatimin absolutisht te pavlefshme te procesit te hetimit administrativ qe lidhet me shqyrtimin ne thelb te kerkesave ankimore te mesiperme.

Tiranë, më 22.07.2013

ANËTAR **ANËTAR** **KRYESUES**
VALBON ÇEKREZI **GJINOVEFA GABA** **ANDI CIVICI**
pjeserisht kunder

ANËTAR **ANËTAR**
KLITON SPAHIU **ILIR TOSKA**
pjeserisht kunder

* * *



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOLEGJI ZGJEDHOR I
GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Nr. 18, i Rregjistrimit Themeltar.
Nr. 18, i Vendimit.

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga:

KRYESUES : **Kliton SPAHIU,**
ANETARE : **Gjinovefa GABA,**

ANETAR : Fuat VJERDHA,
ANETARE : Edlira PETRI,
ANETAR : Andi CIVICI,

me sekretare Rexhina Baci, në Tiranë, sot më **dt.25.07.2013**, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative–zgjedhore me nr.18 Akti, që u përket palëve :

PADITES: **Dritan Prifti**, përfaqshues nga av. Eno Bushi.
Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqshues nga av. Eno Bushi.

I PADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqshues nga znj.Deshira Pasko.

Palë e Interesuar: **Partia Socialiste e Shqipërisë**, përfaqshues nga av. Koli Bele.
Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqshues nga av. Ivi Kaso dhe av. Oerd Bylykbashi.
Lëvizja Socialiste për Integrim, në mungesë.

OBJEKTI: -Shfuqizimin e vendimit nr 749, datë 16.07.2013 të KQZ.
-Anullimin e vendimit të ndërmjetëm të KQZ datë 15/07/2013 për mospranimin e kërkesës për rinumërim e rivlerësim të votave të të gjitha QV-ve të KZAZ Nr.54, KZAZ Nr.55, KZAZ Nr.56, KZAZ Nr.57, KZAZ Nr.58, KZAZ Nr.59, KZAZ Nr.60, KZAZ Nr.61, KZAZ Nr.62, KZAZ Nr.63 të Zonës Zgjedhore Qarku Fier.
-Rinumërimin e rivlerësimit të votave të të gjitha QV-ve të KZAZ nr.54, KZAZ nr.55, KZAZ nr.56, KZAZ nr.57, KZAZ nr.58, KZAZ nr.59, KZAZ nr.60, KZAZ nr.61, KZAZ nr.62, KZAZ nr.63 të Zonës Zgjedhore Qarku Fier.
-Ndryshimin e Vendimeve të KZAZ për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të KZAZ Nr.54, KZAZ Nr.55, KZAZ Nr.56, KZAZ Nr.57, KZAZ Nr.58, KZAZ Nr.59, KZAZ Nr.60, KZAZ Nr.61, KZAZ Nr.62, KZAZ Nr.63 të Zonës Zgjedhore Qarku Fier e të Vendimit të KZAZ

Nr.673 datë 04.07.2013 "Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për Zonën Zgjedhore Qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin, 23 qershor 2013" sipas rezultatit të dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave të të gjitha QV të KZAZ Nr.54, KZAZ Nr.55, KZAZ Nr.56, KZAZ Nr.57, KZAZ Nr.58, KZAZ Nr.59, KZAZ Nr.60, KZAZ Nr.61, KZAZ Nr.62, KZAZ Nr. 63 të Zonës Zgjedhore Qarku Fier.

Baza ligjore: Nenet 116, 117, 118, 119, 120, 122, 123, 138, 144, 145, 152, 153, 155, 156, 158 të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i RSH" i ndryshuar.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, shqyrtoi dhe administroi provat shkresore, dëgjoi palët prezent në pretendimet e tyre përfundimtare të cilët kërkuan; përfaqësuesi i palës paditëse i cili kërkoi pranimin e padisë; pasi dëgjoi përfaqësuesen e palës së paditur e cila kërkoi rrëzimin e padisë, e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Veprimet procedurale paraprake të kryera nga Kolegji Zgjedhor:

Paditësi Dritan Prifti është subjekt zgjedhor, si Kandidat i Mbështetur nga Zgjedhësit për Zonën Zgjedhore Qarku Fier, i cili ka paraqitur me datë 20.07.2013 në Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, kërkesë -padinë me objekt gjykimi: "*Shfuqizimin e vendimit nr 749, datë 16.07.2013 të KQZ. -Anullimin e të vendimit të ndërmjetëm të KQZ datë 15/07/2013 për mos pranimin e kërkesës për rinumrim e rivlerësim të votave të të gjitha QV të KZAZ Nr 54, KZAZ Nr 55, KZAZ Nr 56, KZAZ Nr 57, KZAZ Nr 58, KZAZ Nr 59, KZAZ Nr 60, KZAZ Nr 61, KZAZ Nr 62, KZAZ Nr 63, të Zonës Zgjedhore Qarku Fier. -Ndryshimin e Vendimeve të KZAZ për miratimin e Tabelës Përmbledhese të KZAZ Nr.54, KZAZ Nr.55, KZAZ Nr.56, KZAZ Nr.57, KZAZ Nr.58, KZAZ Nr.59, KZAZ Nr.60, KZAZ Nr.61, KZAZ Nr.62, KZAZ Nr.63 të Zonës Zgjedhore Qarku Fier e të Vendimit të KZAZ Nr.673 datë 04.07.2013 "Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për Zonën Zgjedhore Qarku Fier, për zgjedhjet për*

Kuvendin, 23 qershor 2013" sipas rezultatit të dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave të të gjitha QV të KZAZ Nr.54, KZAZ Nr.55, KZAZ Nr.56, KZAZ Nr.57, KZAZ Nr.58, KZAZ Nr.59, KZAZ Nr.60, KZAZ Nr.61, KZAZ Nr.62, KZAZ Nr. 63 të Zonës zgjedhore Qarku Fier".

Paditësi Partia Demokristiane e Shqipërisë është subjekt zgjedhor, i cili ka paraqitur me datë 20.07.2013 në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë kërkesë padinë me objekt gjykimi: *"-Shfuqizimin e vendimit nr 749, datë 16.07.2013 të KQZ. -Anullimin e të vendimit të ndërmjetëm të KQZ datë 15/07/2013 për mos pranimin e kërkesës për rinumrim e rivlerësim të votave të të gjitha QV të KZAZ Nr 54, KZAZ Nr 55, KZAZ Nr 56, KZAZ Nr 57, KZAZ Nr 58, KZAZ Nr 59, KZAZ Nr 60, KZAZ Nr 61, KZAZ Nr 62, KZAZ Nr 63, të Zonës Zgjedhore Qarku Fier. –Rinumrimin e rivlerësimit të votave të të gjitha QV të KZAZ Nr 54, KZAZ Nr 55, KZAZ Nr 56, KZAZ Nr 57, KZAZ Nr 58, KZAZ Nr 59, KZAZ Nr 60, KZAZ Nr 61, KZAZ Nr 62, KZAZ Nr 63 të Zonës Zgjedhore Qarku Fier. - Ndryshimin e Vendimeve të KZAZ për miratimin e Tabelës Përmbledhese të ZAZ (model 40-13 V) të KZAZ Nr.54, KZAZ Nr.55, KZAZ Nr.56, KZAZ Nr.57, KZAZ Nr.58, KZAZ Nr.59, KZAZ Nr.60, KZAZ Nr.61, KZAZ Nr.62, KZAZ Nr.63 të Zonës Zgjedhore Qarku Fier e të Vendimit të KZAZ Nr.673 datë 04.07.2013 "Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për Zonën Zgjedhore Qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin, 23 qershor 2013" duke përfshirë në to rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave të këtyre QV".*

Në kërkesat paraprake përfaqësuesi i palës paditëse av.Eno Bushi, kërkoi që paditë e ngritura nga dy subjektet zgjedhore të përfaqësuar prej tij, të cilat kanë të njëjtin objekt padie dhe me të njëjtët palë ndërgjyqëse të bashkohen në të njëjtën çështje.

Kolegji Zgjedhor konstatoi se paditësit Dritan Prifti dhe Partia Demokristiane e Shqipërisë kanë të njëjtin objekt, bazë ligjore, palë ndërgjyqëse si dhe shqyrtimi i ankimit administrativ pranë KQZ është kryer së bashku në të njëjtin procedim administrativ. Për sa më sipër bazuar në nenin 132 të K.Zgjedhor dhe nenin 57 të K.Pr. Civile, Kolegji Zgjedhor vendosi: Bashkimin e padisë së paraqitur nga Partia Demokristiane e Shqipërisë me nr.17 regj. them., datë 20.07.2013, me padinë e paraqitur nga paditësi Dritan Prifti me nr.18 rregj. them., datë 20.07.2013, në një çështje të vetme me palë dhe objekt të përshkruar në hyrje të këtij vendimi përfundimtar.

Ankimet në rrugë administrative të Komisioneve Zgjedhore, shqyrtimi administrativ dhe vendimi i dhënë nga KQZ:

KQZ-ja rezulton të ketë kryer shqyrtimin administrativ të kërkesave ankimore të subjeteve zgjedhore: -1) Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, -2) Partia Kristiandemokrate e Shqipërisë, -3) Partia Popullore e Pensionistëve Shqiptarë, -4) Kandidati i Pavarur z.Dritan Prifti, si dhe -5) Partia Demokristiane e Shqipërisë.

Pas shqyrtimit dhe administrimit në tërësi të kërkesave ankimore, KQZ-ja me vendimin përfundimtar nr.749, datë 16.07.2013, bazuar në nenin 143/1, d të Ligjit Nr 10019 datë 29.12.2008 ka vendosur:

- Rrëzimin e kërkesës ankimore Nr.10 të Partisë Aleanca për Barazi, Drejtësi Europiane.
- Rrëzimin e kërkesës ankimore Nr.17 të Partisë Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë.
- Rrëzimin e kërkesës ankimore Nr.26 të Partisë së Pensionistëve Shqiptarë.
- Rrëzimin e kërkesës ankimore Nr.30 të kandidatit të Mbështetur nga zgjedhësit, z.Dritan Prifti.
- Rrëzimin e kërkesës ankimore Nr.31 të Partisë Demokristiane e Shqipërisë.

Procedura e shqyrtimit gjyqësor të kërkesëpadisë:

Brenda afatit ligjor pesë ditor rezulton të kenë paraqitur ankim pranë këtij Kolegji Zgjedhor, me kërkesë-padi subjektet zgjedhore: Partia Demokristiane e Shqipërisë dhe kandidati i pavarur Dritan Prifti.

Në gjykimin e çështjes në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë u shqyrtuan dhe u administruan këto prova shkresore:

-Dosja që i përket KZAZ nr.60, vendimi nr.13, datë 26.06.2013, bashkëngjitur tabelat e rezultateve të votimit dhe procesverbal konstatimi, libri i protokollit të mbledhjes së KZAZ Qarku Fier.

-Dosja që i përket KZAZ nr.57, vendimi nr.71, datë 26.06.2013, bashkëngjitur tabelat e rezultateve të votimit dhe procesverbal konstatimi, libri i protokollit të mbledhjes së KZAZ Qarku Fier.

-Dosja që i përket KZAZ nr.55, vendimi nr.147, datë 25.06.2013, bashkëngjitur tabelat e rezultateve të votimit dhe procesverbal konstatimi, libri i protokollit të mbledhjes së KZAZ Qarku Fier.

-Dosja që i përket KZAZ nr 58, vendimi nr.45, datë 25.06.2013, bashkëngjitur tabelat e rezultateve të votimit dhe procesverbal konstatimi, libri i protokollit të mbledhjes së KZAZ Qarku Fier.

-Dosja që i përket KZAZ nr.56, vendimi nr.11, datë 24.06.2013, bashkëngjitur tabelat e rezultateve të votimit dhe procesverbal konstatimi, libri i protokollit të mbledhjes së KZAZ Qarku Fier.

-Dosja që i përket KZAZ nr.54, vendimi nr.41, datë 26.06.2013, bashkëngjitur tabelat e rezultateve të votimit dhe procesverbal konstatimi, libri i protokollit të mbledhjes së KZAZ Qarku Fier.

-Dosja që i përket KZAZ nr.63, vendimi nr.24, datë 25.06.2013, bashkëngjitur tabelat e rezultateve të votimit dhe procesverbal konstatimi, libri i protokollit të mbledhjes së KZAZ Qarku Fier.

-Dosja që i përket KZAZ nr.59, vendimi nr.09, datë 26.06.2013, bashkëngjitur tabelat e rezultateve të votimit dhe procesverbal konstatimi, libri i protokollit të mbledhjes së KZAZ Qarku Fier.

-Dosja që i përket KZAZ nr.62, vendimi nr.140, datë 26.06.2013, bashkëngjitur tabelat e rezultateve të votimit dhe procesverbal konstatimi, libri i protokollit të mbledhjes së KZAZ Qarku Fier.

-Dosja që i përket KZAZ nr.61, vendimi nr.117, datë 25.06.2013, bashkëngjitur tabelat e rezultateve të votimit dhe procesverbal konstatimi, libri i protokollit të mbledhjes së KZAZ Qarku Fier.

-Dosja që i përket vendimit nr.749, datë 16.07.2013 të KQZ, bashkëngjitur procesverbal i mbledhjes dhe gjithë dokumentat e shqyrtimit administrativ të çështjes.

Në gjykim u kërkua nga përfaqësuesi i palës paditëse av.Eno Bushi që të shqyrtohej dhe administrohej kopja e regjistrimeve filmike të kamerave të vendosura në tavolinat e numërimit të votave në KZAZ Nr.54, KZAZ Nr.55, KZAZ Nr.56, KZAZ Nr.57, KZAZ Nr.58, KZAZ Nr.59, KZAZ Nr.60, KZAZ Nr.61, KZAZ Nr.62 dhe KZAZ Nr.63 të Zonës Zgjedhore Qarku Fier.

Kolegji Zgjedhor vendosi të mos lejojë marrjen dhe shqyrtimin si provë të kopjes së regjistrimeve filmike të kamerave të vendosura në tavolinat e numërimit të votave në KZAZ-të. Kolegji vlerësoi se regjistrimet filmike të procesit të numërimit të votave, nuk i shërbenin gjykimin të çështjes, sepse pala paditëse, në kërkimin e saj, nuk përcaktoi faktin që kërkonte të vërtetonte me këtë provë. Si në kërkesë-padi, ashtu edhe në parashtrimet e palës paditëse në seancë gjyqësore, nuk u pretenduan fakte konkrete se

në cilën KZAZ dhe QV janë kryer numërime dhe vlerësuar vota, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, (nenet 116-119). Gjithashtu nuk u pretendua se nga cili GNV janë lejuar këto shkelje dhe për pasojë të jetë deformuar rezultati i zgjedhjeve në vendimet e komisioneve zgjedhore.

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, shqyrtoi dhe administroi provat shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse në dobi të gjyqimit konkludoi se:

Vendimi nr. 749, datë 16.07.2013 i KQZ objekt shqyrtimi në këtë Kolegj Zgjedhor është dhënë në zbatim të gabuar të nenit 22/5, 24 dhe 143/1, d të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008. Gjithashtu në shkelje është realizuar dhe shqyrtimi administrativ nga KQZ.

Në nenin 22/5 të Kodit Zgjedhor, përcaktohet vlefshmëria e mbledhjes së KQZ, e cila si rregull është e vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 4 anëtarë, me përjashtim të rasteve kur kërkohet shumicë e cilësuar për marrjen e vendimit sipas nenit 24 të këtij Kodi, dispozitë kjo sipas pikës 1, gërmat “a”-“f”, të së cilës përcaktojnë shumicën e nevojshme, që duhet për një vendimmarrje pozitive, votimin “pro” të jo më pak se 5 anëtarëve të KQZ. Pra, referuar nenit 22/5 të Kodit Zgjedhor, si rregull mbledhja e KQZ është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 4 anëtarë, ndërsa si përjashtim kemi dhe mbledhje që për të qenë të vlefshme, duhet të marrin pjesë jo më pak se 5 anëtarë. Është e qartë se kuorumi i nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes së KQZ përcaktohet nga lloji i vendimmarrjes përfundimtare të KQZ, pra në vendime që merren me “shumicë të cilësuar” (*sipas nenit 24, pika 1, gërmat “a”-“f”, të Kodit Zgjedhor, që kërkon votimin “pro” të jo më pak se 5 anëtarëve*) apo në vendime të tjera të ndryshme që merren me “shumicë të thjeshtë” (*sipas paragrafit të fundit të nenit 24/1 të Kodit Zgjedhor, që kërkon votimin “pro” të jo më pak se 4 anëtarëve*). Ndërkohe, referuar nenit 24/1 të Kodit Zgjedhor, quorumi i domosdoshëm për të patur vlefshmëri mbledhja e KQZ-së, dhe për më tej, për të pasur vlefshmëri i gjithë procesi hetimor i shqyrtimit administrativ që kryen ky organ, ndër të tjera përcaktohen nga lloji i kërkesave të paraqitura nga subjektet zgjedhore, si dhe natyra e vendimeve. Kështu, kërkesat ankimore sipas germës “b” apo kërkesat sipas germës “c”, kondicionojnë një vendimmarrje të KQZ vetëm me “shumicë të cilësuar”, pra të jo më pak se të 5 anëtarëve.

Në rastin konkret, ajo c'ka është kërkuar nëpërmjet kërkesave ankimore të paraqitura para KQZ nga Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, Partia Kristiandemokrate e Shqipërisë, Partia Popullore e Pensionistëve Shqiptarë, Kandidati i Pavarur z.Dritan Prifti, si dhe Partia Demokristiane e Shqipërisë referojnë në gërmat "b" dhe "c" të nenit 24/1 të Kodit Zgjedhor, dispozitë kjo që sic u parashtrua përcakton marrjen e vendimit nga KQZ me "shumice të cilësuar", pra votimin "pro" nga jo më pak se 5 anëtarëve; ndërkohë që është pikërisht kjo "shumicë e cilësuar" e vendimmarrjes së KQZ që determinon nga ana tjetër dhe kuorumin e nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes së KQZ sipas nenit 22/5 të Kodit Zgjedhor; pra qënien të pranishëm për fillimin dhe për vlefshmërinë e mbledhjes të jo më pak se 5 anëtarëve.

Nisur nga sa më sipër në kushtet kur mbledhja e KQZ e datës 15.07.2013 dhe 16.07.2013 ka patur për objekt kërkesa ankimore, që kërkojnë vendimmarrje sipas nenit 24/1, gërmat "b" dhe "c", të Kodit Zgjedhor, në përputhje me nenin 22/5 të Kodit Zgjedhor ajo nuk duhej të zhvillohej në prani të jo më pak se 5 anëtarëve, që përbën dhe kuorumin e nevojshëm për t'u konsideruar e mbledhja e vlefshme. Mungesa e këtij quorumi për vlefshmërinë e mbledhjes së KQZ passjell pavlefshmërinë e saj dhe për rrjedhojë pavlefshmërinë absolute të vendimeve të marra nga KQZ në këtë mbledhje; pikërisht të vendimeve objekt gjykimi Nr.749 datë 16.07.2013, si dhe të vendimit të ndërmjetëm datë 15.07.2013. Gjithashtu absolutisht i pavlefshëm është edhe procesi hetimor i shqyrtimit administrativ i kryer nga KQZ.

Pavarësisht nga kërkimi i parashtruar në objektin e padisë në lidhje me shfuqizimin, por edhe anulimin e vendimit nr. 749 datë 16.07.2013 të KQZ-së dhe vendimit të ndërmjetëm të datës 15.07.2013 të KQZ-së, Kolegji Zgjedhor konkludoi në përfundim të shqyrtimit gjyqësor se këto vendime janë akte administrative absolutisht të pavlefshme dhe si të tilla duhet të konstatohen të pavlefshme.

Pala paditëse në kërkesë padi ka kërkuar dhe rinumërim dhe rivlerësim të votave të gjitha QV të KZAZ-ve me nr. 54-63 të Zonës Zgjedhore Qarku Fier, ndryshimin e vendimeve të KZAZ-ve për miratimin e tabelës përmbledhëse të KZAZ-ve me nr. 54-63 të Zonës Zgjedhore Qarku Fier.

Ky Kolegj Zgjedhor pasi kreu shqyrtimin gjyqësor duke administruar provat shkresore të paraqitura nga pjesëmarrësit në proces konkludoi se; nga dokumentacioni zgjedhor i administruar,

(libri i protokollit të mbledhjes, procesverbali konstatimi tabelave të rezultateve të KZAZ-së dhe GN) asnjë nga prej anëtarëve të KZAZ-ve, anëtarë të Grupeve të Numërimit apo vëzhguesve të subjekteve zgjedhore nuk kanë pasqyruar vërejtje.

Paditësit në këtë proces gjyqësor rezultojnë të mos kenë patur anëtarë të KZAZ-ve dhe të GN, por sipas ligjit ata kanë të drejtë të kenë vëzhgues. Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore kanë të drejta sikurse dhe anëtarët e Grupit të Numërimit në procesin e numërimit të votave, në hapjen e kutive të materialit të votimit, në vlerësimin e votave si dhe në nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve nga Grupi i Numërimit, të përcaktuar në nenet 116, 166/1, 118 dhe 119 të K.Zgjedhor.

-Sipas nenit 7 të K. Zgjedhor vëzhguesit kanë këto të drejta:
*“a) të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor;
b) të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë;
c) të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor;
ç) të drejta të tjera të përcaktuara në këtë Kod apo në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij”.*

-Sipas nenit 116 paragrafi 7, të K. Zgjedhor cilido nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore që bënë konstatimin e mospërputhjeve njofton KZAZ-në dhe e pasqyron atë pasaktësi ose parregullsi në Procesverbalin e Konstatimit.

-Sipas nenit 116/1 të K. Zgjedhor cilido nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore që bënë konstatimin e mungesës së procesverbalit të mbylljes së votimit ose të të dhënave sipas nenit 113 të kodit, njofton KZAZ-në dhe e pasqyron atë pasaktësi ose parregullsi në Procesverbalin e Konstatimit

-Sipas nenit 118 të K. Zgjedhor cilido nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore që nuk është dakort me vlerësimin e numëruesit të parë, ky i fundit vendos fletën e votimit të kundërshtuar në një vend të vecantë. Në përfundim të numërimit të fletëve të votimit GN rivlerëson fletët e votimit të kontestuara dhe pas vlerësimit nga KZAZ, merret vendim për të.

-Sipas nenit 119 të K. Zgjedhor cilido nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore ka kundërshtime në lidhje me rezultatin e pasqyruar në tabelë ato shënohen menjëherë në librin e protokollit të KZAZ-së.

Referuar sa më sipër konkludohet se vëzhguesit, ashtu sikurse edhe anëtarët e KZAZ-ve dhe GN kanë të drejtë të bëjnë shënime në Procesverbalin e Konstatimit dhe në Librin e Protokollit. Nga materialet zgjedhore të administruara në këtë gjykim nuk rezultojnë të jenë bërë shënime në këto materiale zgjedhore nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, paditës në këtë gjykim, për pasojë nuk ka vend për rinumërim dhe rivlerësim të votave të të gjithë QV të KZAZ-ve me nr 54-63 të Zonës Zgjedhore Qarku Fier.

Në gjykim u pretendua se paditësve si subjekte zgjedhore i është mohuar e drejta për të patur vëzhgues.

Neni 6/1 K. Zgjedhor ka parashikuar se: *“Çdo parti politike apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit, i regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor, ka të drejtë të caktojë nga një vëzhgues në KZAZ, në KQV dhe për çdo tavolinë në Vendin e Numërimit të Votave pas regjistrimit të kandidatit/kandidatëve për zonën zgjedhore përkatëse ose pasi ka paraqitur listë shumëmemërore. Në rast se partitë politike paraqiten në zgjedhje si koalicion, të drejtën për të caktuar vëzhgues e ka vetëm koalicioni. Koalicioni mund të caktojë jo më shumë se tre përfaqësues për koalicion. Kandidatët e partive politike nuk kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues”*

Paditësi Partia Demokristiane e Shqipërisë rezultojnë të ketë qenë pjesëtare në koalicionin Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim, ndaj e drejta për caktimin e vëzhguesve i takon vetëm koalicionit dhe kjo çështje duhet të zgjidhet mes partive pjesëmarrëse në të. Megjithatë, paditësit, si subjekte zgjedhore, në bazë të nenit 6/5 të K.Zgjedhor kanë të drejtën e ankimit në rast se i është refuzuar kërkesa për caktimin e vëzhguesve. Subjektet zgjedhore, të cilat kërkimet e tyre nuk i kanë parashtruar dhe ankimuar sipas këtij kodi, e kanë humbur edhe atë drejtë të pretenduar duke mos sjellë pasojë për procesin zgjedhor të mëpasshëm, (kërkim i cili ka rënë në dekadencë).

Në përfundim të shqyrtimit gjyqsor ky kolegji konkludon se vendimet e KZAZ-ve me nr 54 deri 62, për miratimin e tabelës përmbledhëse të ZAZ-ve të tyre, si dhe të vendimit të KQZ me nr 673 datë 04.07.2013, *“Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për Zonën Zgjedhore, Qarkut Fier, për zgjedhjet e Kuvendit 2013”*, janë dhënë në zbatim korrekt të ligjit 10019 datë 29.12.2008.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë,
bazuar në nenin 158/3 të Kodit Zgjedhor.

V E N D O S I

-Konstatimin e pavleshmërisë absolute të vendimit nr. 749, datë 16.07.2013 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe të vendimit të ndërmjetëm datë 15.07.2013 për mospranimin e kërkesës për rinumërim e rivlerësim të votave të të gjitha QV-ve të KZAZ nr. 54, KZAZ nr. 55, KZAZ nr. 56, KZAZ nr. 57, KZAZ nr. 58, KZAZ nr. 59, KZAZ nr. 60, KZAZ nr. 61, KZAZ nr. 62, KZAZ nr. 63 të Zonës Zgjedhore të Qarkut Fier.

-Rrëzimin e padive lidhur me rinumërimin dhe rivlerësimin e votave të të gjitha QV-ve të KZAZ-ve të sipërcituara.

-Rrëzimin e padive për ndryshimin e vendimeve të KZAZ-ve për miratimin e tabelës përmbledhëse të ZAZ-ve të mësipërme.

-Rrëzimin e padive për ndryshimin e vendimit të KQZ nr.673, datë 04.07.2013 “Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zonën zgjedhore, Qarku Fier, për zgjedhjet e Kuvendit 2013”.

-U shpall në Tiranë sot më dt.**25.07.2013**.

ANËTARE **ANËTAR** **ANËTAR**
Gjinovefa GABA **Fuat VJERDHA** **Andi CIVICI**

ANËTARE **KRYESUES**
Edlira PETRI **Kliton SPAHIU**

* * *



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**NR. 21 REGJ. THEMELTAR
DATË 22.07.2013 REGJ.**

**Nr. 19 VENDIMI
DATË 26.07.2013 VENDIMI**

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

**Kryesuese : Edlira PETRI
Anëtar : Fuat VJERDHA
Anëtare : Gjinovefa GABA
Anëtar : Valbon ÇEKREZI
Anëtar : Andi CIVICI**

asistuar nga sekretarja gjyqësore Rexhina Baçi, në seancën gjyqësore me dyer të hapura, të datës 26.07.2013, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore, që u përket palëve :

PADITËSE: Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, e përfaqësuar nga av. Ferdinand Brahimaj, me autorizim të datës 04.07.2013.

I PADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga znj. Dëshira Pasko, me autorizim të datës 19.06.2013.

OBJEKTI: Shfuqizimi i Vendimit nr. 741, datë 15.07.2013 të KQZ-së për rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 5, datë 03.07.2013 të subjektit politik Lëvizja për Zhvillim Kombëtar; Kundërshtimin e vendimit nr. 670, datë 03.07.2013 “Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për Zonën Zgjedhore të Qarkut Vlorë”, duke rinumëruar dhe rivlerësuar votat e KZAZ-ve nr. 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88 dhe 89.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 145 e vijues i tij.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoji përfaqësuesin e palës paditëse Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, i cili kërkoi pranimin e padisë; përfaqësuesen e palës së paditur KQZ, që kërkoi rrëzimin e padisë; si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Në datë 04.07.2013, subjekti zgjedhor Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (më tej, KQZ), ankimin nr. 5, kundër vendimit nr. 670, datë 03.07.2013 “Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për Zonën Zgjedhore të Qarkut Vlorë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 23 Qershor 2013”. Nëpërmjet këtij ankimi, Lëvizja për Zhvillim Kombëtar ka kundërshtuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore të Qarkut Vlorë, si dhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendrat e votimit nr. 4511, nr. 4398 dhe nr. 4494. Më tej, rezulton se ankuesi ka hequr dorë nga kërkesa për pavlefshmëri të zgjedhjeve në QV-të e sipërcituara, duke kërkuar rinumërim dhe rivlerësim të votave të të gjitha QV-ve, të të gjitha KZAZ-ve të Zonës Zgjedhore të Qarkut Vlorë.

Në datë 15.07.2013, KQZ ka shqyrtuar në seancë plenare ankimin e Lëvizjes për Zhvillim Kombëtar dhe me vendimin nr. 741, ka vendosur : “Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 5 të paraqitur nga Lëvizja për Zhvillim Kombëtar. Lënien në fuqi të vendimit të KQZ-së nr. 670 datë 03.07.2012 “Për nxjerrjen e rezultatit të votimit të Qarkut Vlorë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 23 Qershor 2013.”

Në datë 22.07.2013 subjekti zgjedhor LZHK ka paraqitur pranë Kolegjit Zgjedhor, padinë me objekt “Shfuqizimin e Vendimit nr. 741, datë 15.07.2013 të KQZ-së, si dhe kundërshtimin e vendimit nr. 670, datë 03.07.2013 “Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për Zonën Zgjedhore të Qarkut Vlorë”, duke rinumëruar dhe rivlerësuar votat e KZAZ-ve nr. 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88 dhe 89”.

Pala paditëse parashtroi këto pretendime lidhur me vendimet e mësipërme të KQZ-së :

- procesi i numërimit të votave në Qarkun Vlorë është shoqëruar me parregullsi, shkelje dhe abuzime;
- subjektit politik LZHK i është mohuar e drejta për të pasur vëzhgues, nga subjekti politik i cili drejtonte koalicionin ku bënte pjesë, Aleanca për Punësim Mirëqenie dhe Integrim, çka ka bërë që numërimi i votave të mos jetë kryer në përputhje me ligjin;
- kandidati i LZHK-së është penguar të hyjë në ambientet e KZAZ-së për të ndjekur procesin e numërimit të votave;
- në tabelat e rezultateve nuk përputhen të dhënat me njëra – tjetrën, janë të korrigjuara, të fshira;
- KQZ-ja i ka konstatuar këto shkelje lidhur me mos rakordimin e të dhënave;
- Edhe nga pamjet filmime të procesit të numërimit të votave, të marra nga KQZ-ja vërehen këto të meta dhe se pamjet nuk janë të rregullta e të qarta, pra janë të palexueshme.

Përfaqësuesja e palës së paditur, KQZ, i kërkoi Kolegjit Zgjedhor rrëzimin e padisë duke prapësuar se :

- KQZ-ja ka vlerësuar se nuk ekzistojnë prova që të bazonin kërkesën e paditësit për rinumërim dhe rivlerësim të të gjitha QV-ve të Zonës Zgjedhore të Qarkut Vlorë;
- Vendimi i KQZ-së nr. 670, datë 03.07.2013 “Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për Zonën Zgjedhore të Qarkut Vlorë” është i drejtë, i bazuar në ligj dhe në prova.

Për të vërtetuar pretendimet e ngritura në padi e veçanërisht kërkesën për rinumërim dhe rivlerësim të votave të të gjitha QV-ve të Zonës Zgjedhore të Qarkut Vlorë, pala paditëse LZHK kërkoi që, veç akteve administrative të administruara në procesin zgjedhor nga komisionet zgjedhore, të merreshin në shqyrtim edhe pamjet filmime të procesit të numërimit të votave të të gjitha QV-ve të ZAZ-ve të Qarkut Vlorë, si dhe një CD, e cila sipas paditësit prezantonte transmetimet televizive të një televizioni lokal gjatë procesit të numërimit.

Kolegji Zgjedhor me vendim të ndërmjetëm vendosi të mos lejojë marrjen dhe shqyrtimin e provave të mësipërme, për këto arsye:

1. Faktet e transmetuara nëpërmjet mediave vizive, nuk mund të provojnë në gjykim, ecurinë e numërimit dhe vlerësimin të votave, proces ky që bazohet në një tërësi rregullash të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, të detyrueshme për t'u zbatuar nga numëruesit e votave (anëtarët e GNV-ve). Për këtë arsye procesi i numërimit dhe vlerësimin të votave nuk mund të kontrollohet nga mediat. Lidhur me rezultatet e procesit të numërimit të votave, Kodi Zgjedhor ka parashikuar dërgimin në rrugë elektronike të rezultatit të votimit të çdo qendre votimi pranë KQZ-së, menjëherë sapo GNV-ja plotëson tabelën e rezultatit, kopje të së cilës marrin edhe çdo anëtar i GNV-së si edhe vëzhguesit e subjekteve zgjedhorë (neni 119.2 i Kodit Zgjedhor). Për qëllim të transparencës së procesit, KQZ-ja publikon menjëherë në faqen e saj në internet, të dhënat e mësipërme të dërguara nga KZAZ-ja. Mediat, të cilat kanë transmetuar të dhëna lidhur me procesin e numërimit të votave, duhet të kenë pasur si burim informacioni pikërisht këto tabela të rezultateve të GNV-ve, origjinalin e së cilës e kanë subjektet e sipërcituara. Për rrjedhojë, Kolegji Zgjedhor vlerësoi se transmetimet televizive nuk i shërbejnë procesit të të provuarit të fakteve të pretenduara nga pala paditëse, për sa kohë burimi i tyre janë aktet e përpiluara nga GNV-të dhe më tej nga KZAZ-të, të administruara në procesin zgjedhor e të paraqitura në gjykim nga pala e paditur KQZ.

2. Pamjet filmime të procesit të votimit, të marra sipas parashikimit të nenit 94.4 dhe 118 të Kodit Zgjedhor, garantojnë transparencën e procesit të numërimit dhe vlerësimin të votave për personat e pranishëm në VNV. Kopje të regjistrimit filmik të këtij procesi, u jepet të gjitha subjekteve zgjedhore, siç ka ndodhur në rastin konkret për palën paditëse LZHK. Nëpërmjet këtij regjistrimi, pala paditëse ka synuar të vërtetojë parregullsitë dhe të metat e pretenduara të procesit të numërimit të votave, ndërkohë që pranon se pamjet që transmetohen në regjistrim, janë të paqarta e madje të palexueshme. Nga ana tjetër pala paditëse nuk përcaktoi faktet konkrete, për të cilat kërkoi nga Kolegji Zgjedhor marrjen si provë të regjistrimit filmik, duke u mjaftuar me pretendime të karakterit të përgjithshëm për parregullsi, të cilat përfshinin të gjitha QV-të e të gjitha KZAZ-ve të Zonës Zgjedhore të Qarkut Vlorë. Në këto kushte, Kolegji Zgjedhor vendosi të mos lejojë marrjen e kësaj prove, pasi

nuk u tregua se cilat ishin faktet konkrete dhe shkeljet e ligjit, që synohej të provoheshin.

Lidhur me objektin e padisë, Kolegji Zgjedhor diskutoi mbi ligjshmërinë e:

1. Vendimit nr. 741, datë 15.07.2013 të KQZ-së “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 5 të Partisë Lëvizja për Zhvillim Kombëtar me objekt “Kundërshtimin e vendimit të KQZ-së nr. 670, datë 03.07.2013 “Për nxjerrjen e rezultatit të Qarkut Vlorë për zgjedhjet për Kuvendin, 23 Qershor 2013.”” dhe
2. Vendimit të KQZ-së nr. 670, datë 03.07.2013 “Për nxjerrjen e rezultatit të Qarkut Vlorë për zgjedhjet për Kuvendin, 23 Qershor 2013.

1. Vendimi i KQZ-së nr. 741, datë 15.07.2013 “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 5 të Partisë Lëvizja për Zhvillim Kombëtar me objekt “Kundërshtimin e vendimit të KQZ-së nr. 670, datë 03.07.2013 “Për nxjerrjen e rezultatit të Qarkut Vlorë për zgjedhjet për Kuvendin, 23 Qershor 2013.”” (më tej, Vendimi nr. 741)

Pala paditëse LZHK ka parashtruar se vendimi i KQZ-së, me të cilin është rrëzuar ankimi i saj për kundërshtimin e vendimit nr. 670, datë 03.07.2013 “Për nxjerrjen e rezultatit të Qarkut Vlorë për zgjedhjet për Kuvendin, 23 Qershor 2013”, është i pabazuar në ligj, duke pretenduar se ky ankim duhej të pranohej. Referuar shkaqeve, për të cilat është bërë ankimi, rezulton se pala paditëse e cilëson vendimin e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit, si të marrë në kundërshtim me ligjin, pra relativisht të pavlefshëm.

Kolegji Zgjedhor pavarësisht pretendimit të palës paditëse, konkludon se Vendimi nr. 741 përbën një akt administrativ të marrë në tejkalim të kompetencave të organit (*në kundërshtim flagrant me ligjin*) dhe si i tillë ai është absolutisht i pavlefshëm. Ky përfundim nxirret nga Kolegji Zgjedhor, pas analizës dhe referimit në dispozitat ligjore të mëposhtme :

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë

Neni 22.5: Mbledhjet e KQZ-së

“5. Mbledhjet e KQZ-së janë të vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 4 anëtarë të saj, me përjashtim të rasteve kur kërkohet shumicë e cilësuar për marrjen e vendimit, sipas nenit 24 të këtij Kodi...”

Neni 24: Vendimmarrja në KQZ

“1. Konsiderohen të miratuara, kur votojnë “pro” jo më pak se 5 anëtarë të KQZ-së, vendimet lidhur me:

a) shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, sipas neneve 162, 163 dhe 166, pika 3 të këtij Kodi;

b) pranimin e ankimit kundër vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e zgjedhjeve të zonës zgjedhore, sipas nenit 123 të këtij Kodi dhe vendimet lidhur me ankimet kundër vendimeve të KZAZ-ve për rezultatin e zgjedhjeve për qeverisjen vendore;

c) kërkesat për deklarimin e pavlefshëm të zgjedhjeve në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi;

ç) shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në zonën zgjedhore apo në të gjithë vendin dhe përsëritjen e tyre;

Vendimet e tjera miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KQZ-së....”

Kodi i Procedurave Administrative

Neni 115: Akte te pavlefshme

“Pavlefshmëria e akteve administrative, në kuptimin e këtij Kodi, paraqitet në format e mëposhtme:

a) akte administrative absolutisht të pavlefshme (akte të nxjerra në kundërshtim flagrant me ligjin);

b) akte administrative relativisht të pavlefshme (akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin).

Neni 116: Aktet administrative absolutisht të pavlefshme

“Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme:

- a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar;
- b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;
- c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.”

Neni 117: Efektet e aktit administrativ absolutisht të pavlefshëm

“1. Aktet administrative absolutisht të pavlefshme nuk prodhojnë pasoja ligjore pavarësisht nga fakti nëse janë deklaruar apo jo si të tillë.... .“

Në kuadër të rregullimeve të mësipërme, por edhe të gjithë dispozitave të Kodit Zgjedhor, Kolegji vlerëson se, KQZ-ja është organi më i lartë shtetëror i përhershëm i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e caktuara në Kodin Zgjedhor. Kompetencat e KQZ-së të përcaktuara me ligj, duhet të ushtrohen kështu në, dhe për zbatimin e tij, në mënyrë që veprimtaria dhe produkti i vendimeve të saj, të konsiderohen të ligjshëm. Nisur nga mënyra e konstituimit të KQZ-së (anëtarët e saj propozohen nga partitë politike), ligjvënësi ka parashikuar se një sërë vendimesh të rëndësishme në procesin zgjedhor, duhet të miratohen me votën “pro” të një shumice të cilësuar prej pesë anëtarë të organit, në dallim nga rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit KQZ-ja i merr vendimet me shumicën e katër anëtarëve nga shtatë të tillë, që ka në përbërje (neni 24 i Kodit Zgjedhor). Vendimet që kërkojnë shumicë të cilësuar, për t’u konsideruar të miratuara, janë edhe ato që parashikohen nga shkronjat “b”, “c” dhe “d” të nenit 24. Ajo çka i bashkon vendimet e mësipërme, lidhet me fazën e procesit zgjedhor, në të cilën KQZ-ja i merr ato, e që është faza e ankimit administrativ ndaj tabelës përmbledhëse të rezultatit, të miratuar me vendim po të KQZ-së, në të cilën subjektet zgjedhorë mund të kërkojnë edhe pavlefshmërinë e votave dhe/apo zgjedhjeve. Siç shihet me këto vendime, KQZ-ja ushtron kontrollin administrativ mbi vendimet e ndërmjetme të komisioneve më të ulëta zgjedhore, por edhe të vetë vendimit të saj përfundimtar të miratimit të tabelës

përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për çdo zonë zgjedhore. Kjo është arsyeja, për të cilën Kodi Zgjedhor ka parashikuar një vendimmarrje të cilësuar të KQZ-së, duke garantuar kontrollin e ligjshmërisë nëpërmjet rritjes së pragut të kuorumit të organit.

Kodi Zgjedhor në dispozitat, që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së KQZ-së, ka përcaktuar rregulla të detyrueshme edhe për procedurën e zhvillimit të mbledhjeve të organit. Referuar nenit 22 të këtij Kodi, rezulton se në varësi të çështjes që shqyrtohet dhe vendimit që pritët të merret, në përfundim të këtij shqyrtimi, KQZ-ja duhet të mbledhet me quorum të detyrueshëm prej 4 ose 5 anëtarë. Nga përmbajtja e dispozitës së sipërcituar, rezulton se në rastin kur KQZ-ja shqyrton çështje, për të cilat ajo duhet të marrë një vendim përfundimtar me të paktën pesë vota “pro” të anëtarëve të saj, mbledhja do të quhet e vlefshme, kur zhvillohet në prani të të paktën pesë anëtarëve. Kjo do të thotë se nëse KQZ-ja zhvillon mbledhjen me katër anëtarë, ndërkohë që po shqyrton ankimet e subjekteve zgjedhore ndaj vendimit të saj për miratimin e tabelës përmbledhëse dhe/apo pavlefshmërinë e zgjedhjeve, procedimi administrativ dhe të gjitha veprimet e kryera gjatë tij, do të konsiderohen si të pavlefshme.

Rregullat e përcaktuara si më sipër nga nenet 22 e 24 të Kodit Zgjedhor lidhen kështu, si me procedurën e kryerjes së veprimtarisë së KQZ-së, ashtu edhe me kompetencën e saj për të marrë vendime të caktuara. Shkelja e rëndë procedurale, që lidhet me quorumin e zhvillimit të mbledhjes së KQZ-së, e sjell ndikimin e drejtpërdrejtë edhe në drejtim të inkompetencës në vendimmarrje nga ky autoritet shtetëror.

Në rastin në shqyrtim, pala paditëse Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar ka ankimuar vendimin e KQZ-së për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për Zonën Zgjedhore të Qarkut Vlorë. Ky ankim duhej të shqyrtohej nga KQZ-ja në seancë plenare, në prani të të paktën pesë anëtarëve, ndërkohë që rezulton se pala e paditur ka marrë në shqyrtim çështjen në prezencë të vetëm katër anëtarëve të KQZ-së. Po kështu edhe vendimi përfundimtar nr. 741, lidhur me këtë ankim, është miratuar me votën “pro” të katër anëtarëve. Këto fakte, për arsyet e lartpërmendura, e cilësojnë Vendimin nr. 741 të KQZ-së, si një akt administrativ të nxjerrë

në tejkalim të kompetencës dhe në kundërshtim me procedurën. KQZ-ja me përbërje prej katër anëtarësh, nuk mundet të shqyrtojë ankimet ndaj vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve, pasi kompetenca për këtë çështje i përket një quorumi prej të paktën pesë anëtarë të organit. Në këto rrethana, ky vendim është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, i paaftë për të sjellë pasoja juridike. Prandaj pretendimet e palës paditëse lidhur me Vendimin nr. 741, të cilat lidhen me shkaqe të natyrës së pavlefshmërisë relative, nuk u shqyrtuan në themelin e tyre, pasi i gjithë procedimi administrativ konsiderohet nul.

II. Vendimi i KQZ-së nr. 670, datë 03.07.2013 “Për nxjerrjen e rezultatit të Qarkut Vlorë për zgjedhjet për Kuvendin, 23 Qershor 2013” (më tej, Vendimi nr. 670).

Ankimi administrativ i palës paditëse ndaj Vendimit nr. 670 të KQZ-së, nuk ka marrë një vendim përfundimtar të vlefshëm nga pala e paditur. Me kalimin e afatit 10 ditor, brenda të cilit KQZ-ja duhej të kish marrë vendim, lidhur me ankimin e mësipërm (neni 143.3), bëhet e pamundur që ky organ të jetë i aftë për të ushtruar kompetencën e tij.

Në nenin 145.2 të Kodit Zgjedhor përcaktohet se: “2. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim. *Përjashtim nga ky rregull bëjnë vendimet e KQZ-së për rrëzimin e kërkesës ankimore në lidhje me vendimet të marra në përputhje me shkronjat “a”, “b” “c” dhe “ç” të nenit 24 të këtij Kodi.*”

Në këto rrethana, Kolegji Zgjedhor, bazuar në nenin 145.2 të Kodit Zgjedhor, e shqyrtoi në themel ligjshmërinë e vendimit nr. 670, pavarësisht mungesës së vendimit përfundimtar të KQZ-së lidhur me këtë çështje.

Nga shqyrtimi i pretendimeve të palës paditëse Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, në raport me provat e marra dhe të administruara, Kolegji Zgjedhor i gjeti ato, të pabazuara për arsyet e mëposhtme :

a) Pretendimi lidhur me mungesën e vëzhguesve të këtij subjekti zgjedhor, me pasojë numërimin e votave në kundërshtim me ligjin.

Referuar padisë në shqyrtim, është pretenduar se :

“... problemet më kryesore kanë ardhur në momentin kur ka filluar numërimi, këtu janë vërejtur parregullsi, shkelje dhe abuzime. Ne si subjekt bënim pjesë në koalicionin Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim, dhe si pjesëtar i këtij grupimi, paraqitëm dhe listën për t’u përfaqësuar dhe për të pasur vëzhguesit në KZAZ-të, si gjithë subjektet e tjera, që bënë pjesë në koalicionin e djathtë, por nga subjekti që drejtonte këtë koalicion, na është mohuar e drejta dhe ne si subjekt Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar nuk patëm mundësinë e përfaqësimit me vëzhgues në KZAZ.

Por dhe kur kandidati i këtij subjekti, në kohën që kishte filluar numërimi, ka kërkuar të futej në KZAZ për të parë ecurinë apo të vëzhgonte sa të mundte, është penguar nga policia me arsyetimin se kishin urdhër nga kryetarët e KZAZ-ve që të mos lejonin asnjë person, të futej, për arsye se nuk kishte më vende, në sallat e numërimit. Kjo pengesë është bërë e qëllimshme për arsyen se :

Gjatë zhvillimit të fushatës elektorale janë bërë sondazhe nga dy subjektet më të mëdha politike në Qarkun e Vlorës dhe Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar dilte me vota direkte dhe fitonte mandate. Mosmiratimi i listës së vëzhguesve për subjektin ankues ka sjellë që të mos jetë bërë numërimi i votave në përputhje me ligjin, pra vota të mos ketë shkuar, lexuar e numëruar për subjektin që është votuar, por ka shkuar e është numëruar për subjekt tjetër (pra është vjedhur nga subjektet që kishin përfaqësues në Grupet e Numërimit dhe komisioner në KZAZ). ...”

Kolegji Zgjedhor vlerëson se dispozitat e Kodit Zgjedhor përcaktojnë një sërë garancish për subjektet zgjedhore, lidhur me mbikëqyrjen e procesit të votimit, numërimit dhe vlerësimit të votave. Që në Kreun II të Pjesës I të këtij Kodi, parashikohet si e drejta e subjekteve zgjedhore për të pasur vëzhgues, ashtu edhe të drejtat dhe detyrat e këtyre të fundit. Neni 6 i Kodit, njeh të drejtën e çdo subjekti zgjedhor për të caktuar vëzhgues në KZAZ, në QV, si dhe në çdo tavolinë

të numërimit të votave në VNV. Po kjo dispozitë ka parashikuar edhe një kufizim të së drejtës së subjektit zgjedhor për të caktuar vëzhgues, në rastin kur ato janë pjesëmarrëse në një koalicion, duke përcaktuar për këtë të fundit të drejtën e caktimit të jo më shumë se tre vëzhguesve. Pala paditëse duke qenë pjesëmarrëse në koalicionin Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim, i'a ka kaluar atij, të drejtën e caktimit të vëzhguesve, ndaj kjo çështje duhej të zgjidhej mes subjekteve zgjedhore pjesëmarrës në koalicion. Fakti që partia politike, që drejtonte koalicionin Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim, nuk ka pranuar të caktojë asnjë vëzhgues të palës paditëse (siç pretendohet në gjykim), nuk përbën bazë për ngritjen e pretendimeve për parregullsi dhe shkelje gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave, pasi prezumohet se vëzhguesit e koalicionit i kanë përmbushur detyrimet dhe kanë realizuar të drejtat e tyre, në përputhje me parashikimet e nenit 7 të Kodit, por jo vetëm. Në nenet 116 e vijues të Kodit Zgjedhor, vëzhguesve të subjekteve zgjedhore u njihen mjaft të drejta, gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave, duke garantuar edhe pasqyrimin e vërejtjeve në librin e protokollit të KZAZ-së. Pala paditëse, e cila përfiton nga pjesëmarrja në një koalicion zgjedhor, ka pranuar edhe kufizimin ligjor lidhur me numrin e vëzhguesve të koalicionit dhe konkretisht, edhe refuzimin nga partia që drejton koalicionin, për të caktuar vëzhgues të zgjedhur nga Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar. Ky fakt ka qenë i ditur para fillimit të procesit të numërimit të votave, për të cilin ngrihen pretendimet, dhe prezantimi i tij pas përfundimit të procesit dhe nxjerrjes së rezultatit nga KZAZ-të, për të mbështetur pretendimin se janë shkelur dispozitat e Kodit Zgjedhor lidhur me numërimin e vlerësimin e votave, përbën veçse një dyshim të palës paditëse ndaj subjekteve të tjera zgjedhore, të cilat kanë pasur vëzhgues dhe anëtarë të KZAZ-ve, aspak të mbështetur në prova dhe fakte konkrete. Kolegji vlerëson se pala paditëse bazohet në të dhëna, të pakonfirmuara, të sondazheve që pretendon të jenë zhvilluar në periudhën parazgjedhore, por që gjithsesi nuk përbëjnë shkak të ligjshëm për të vënë në dyshim procesin zgjedhor dhe rezultatin e tij.

b) Pretendimi se kandidati i LZHK-së është penguar të hyjë në ambientet e KZAZ-së për të ndjekur procesin e numërimit të votave.

Pala paditëse, në vijim të pretendimit se është penguar të ndjekë me vëzhgues, procesin e numërimit dhe vlerësimit të votave, ka parashtruar se kandidati i saj ka dashur të hyjë në ambientet e KZAZ-së, por nuk është lejuar nga strukturat e policisë. Këtë pretendim, Kolegji Zgjedhor e gjeti të pabazuar. Nuk rezulton që përfaqësuesi i subjektit zgjedhor Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, pranë KQZ-së, të ketë paraqitur gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave, ndonjë kërkesë lidhur me pengesat e mundshme të KZAZ-ve, për pjesëmarrjen e kandidatëve në VNV. Megjithatë, sipas Kodit Zgjedhor, kandidatët e subjekteve zgjedhore nuk mund të ndërhyjnë në proces nëse konstatojnë mangësi, ndryshe nga vëzhguesit të cilët jo vetëm evidentojnë shkeljet e mundshme, por edhe i pasqyrojnë ato në librin e protokollit të KZAZ-së, shënime të cilat i shërbejnë më pas procedimit administrativ në fazat e mëvonshme. Në këto rrethana, pretendimi i palës paditëse për mos lejimin e kandidatit të saj në Zonën Zgjedhore të Qarkut Vlorë për të qëndruar në VNV, është i pabazuar në prova dhe në çdo rast, ky fakt nuk mund të hedhë dyshime mbi ligjshmërinë e procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave.

c) Pretendimi se procesi i numërimit të votave në Qarkun Vlorë është shoqëruar me parregullsi, shkelje dhe abuzime, referuar edhe tabelave të rezultateve të cilat nuk përputhen me njëra – tjetrën dhe janë të fshira, të korigjuara, çka është konstatuar edhe nga vetë KQZ-ja.

Pala paditëse ka parashtruar pretendime lidhur me marrjen e kopjeve të tabelave të rezultateve nga GNV-të dhe KZAZ-të, të cilat siç pohon në gjykim, i janë vënë në dispozicion nga pala e paditur KQZ. Këto tabela rezultatesh, sipas palës paditëse janë të cunguara, të korigjuara dhe të fshira, pra nuk plotësojnë kushtet e një dokumenti zyrtar. Konkretisht, pala paditëse u referohet tabelave përmbledhëse të KZAZ-ve nr. 83 dhe 85, në QV-të nr. 4456, 4510, 4460/1, 4461, 4493, 4481.

Nga shqyrtimi i akteve të procesit zgjedhor, të paraqitura në gjykim nga pala e paditur KQZ, por një pjesë të tyre edhe nga vetë pala paditëse, rezulton sa më poshtë:

Për KZAZ-në nr. 83 rezulton se me vendimin e ndërmjetëm nr. 7, datë 25.06.2013 është miratuar tabela përmbledhëse e rezultateve të kësaj Zone të Administrimit Zgjedhor. Në këtë Zonë bëjnë pjesë edhe QV-të nr. 4456 dhe 4510.

Nga tabela origjinale e rezultateve të votimit për *QV-në nr. 4456*, përpiluar nga GNV-ja nr. 2, rezulton se pala paditëse Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar ka marrë një votë. Në tabelën përmbledhëse të rezultateve të ZAZ-së nr. 83, ku pasqyrohet edhe rezultati i QV-së nr. 4456, në rubrikën që i përket numrit të votave të palës paditëse, është shënuar shifra "1", por e korrigjuar. Referuar këtij fakti, Kolegji Zgjedhor, duke mbajtur parasysh se tabela përmbledhëse e rezultateve të çdo ZAZ-je, përpilohet mbi bazën e tabelave origjinale të GNV-së, vlerëson se korrigjimi në tabelën përmbledhëse nuk përbën parregullsi të procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave në QV-në nr. 4456, pasi tabela origjinale e GNV-së, e cila pasqyron të njëjtin rezultat, nuk përmban korrigjime, fshirje apo ndonjë të metë tjetër, që do të vinte në dyshim rezultatin e votimit në këtë QV.

Për sa i përket *QV-së nr. 4510*, rezulton se në tabelën e rezultateve për këtë QV, përpiluar nga GNV nr. 3, pasqyrohet se subjekti zgjedhor Lëvizja për Zhvillim Kombëtar ka marrë katër vota. Ky është numri i votave të shënuara edhe në tabelën përmbledhëse të rezultateve të KZAZ-së nr. 83, por edhe në këtë rast, shifra pasqyrohet me korrigjim. Për të njëjtën arsye si edhe për QV-në nr. 4456, Kolegji Zgjedhor e gjen të pabazuar pretendimin e palës paditëse, pasi tabela përmbledhëse, ndonëse e korrigjuar, pasqyron të njëjtin rezultat si ai i tabelës origjinale, nga e cila janë marrë të dhënat dhe që nuk përmban asnjë korrigjim.

Nga shqyrtimi i të gjitha tabelave të rezultateve të qendrave të votimit të *KZAZ-së nr. 83*, rezulton se të dhënat e tyre janë pasqyruar korrekt në tabelën përmbledhëse të rezultateve të kësaj KZAZ-je.

Sa i përket *KZAZ-së nr. 85*, në përbërje të së cilës janë edhe qendrat e votimit nr. 4460/1, 4461, 4493, të përmendura në padi, rezulton sa vijon:

Për *QV nr. 4460/1*, sipas tabelës së rezultateve përpiluar nga GNV nr. 1, subjekti zgjedhor Lëvizja për Zhvillim Kombëtar ka marrë pesë

vota. Ky numër votash pasqyrohet edhe në tabelën përmbledhëse të rezultateve të KZAZ-së nr. 85, por shifra duket e korrigjuar. Kolegji Zgjedhor në vijim të qëndrimit të mësipërm, vlerëson se korrigjimi në tabelën e KZAZ-së, nuk përbën parregullsi të procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave, përderisa procesverbali origjinal i GNV-së, është i rregullt dhe pa korrigjime.

Për QV-të nr. 4461, 4493, vërehet e njëjta problematikë sepse sipas tabelës së rezultateve përpiluar nga GNV nr. 5, subjekti zgjedhor Lëvizja për Zhvillim Kombëtar nuk ka marrë asnjë votë (tabelat përkatëse nuk kanë asnjë korrigjim). Ky fakt pasqyrohet edhe në tabelën përmbledhëse të rezultateve të KZAZ-së nr. 85, por edhe këtu ka një korrigjim për të cilin paraqitet kundërshtimi nga pala paditëse.

Në total në këtë KZAZ Lëvizja për Zhvillim Kombëtar nuk ka marrë as 157 vota siç pretendon t'i jenë llogaritur, dhe as 179 vota sa pretendon, por 137 të tilla, sipas tabelës përmbledhëse edhe sipas tabelave të GNV-ve, por edhe sipas tabelës përmbledhëse të KZAZ-së nr. 85.

Në vendimin përfundimtar të KQZ-së nr. 670, datë 03.07.2013 "Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për Zonën Zgjedhore Qarku Vlorë, për zgjedhjet për Kuvendin, 23 Qershor 2013", janë evidentuar të gjitha mospërputhjet e konstatuara konform nenit 123 të Kodit Zgjedhor, duke plotësuar tabelën përmbledhëse sipas origjinaleve të tabelave të QV-ve. Kështu, referuar vendimit të sipërcituar lidhur me subjektin zgjedhor Lëvizja për Zhvillim Kombëtar me numër rendor 49, në fletën e votimit, rezulton se KQZ-ja ka konstatuar këto mospërputhje :

- Në KZAZ-në nr. 82, QV nr. 4407, konstatohet se rezultati sipas sistemit elektronik është 33 vota për palën paditëse, ndërkohë që sipas tabelës së GNV-së dhe KZAZ-së ky rezultat është katër vota. Konstatohet se subjekti vijues nr. 50, i cili sipas tabelave të mësipërme ka marrë 33 vota, sipas sistemit elektronik rezulton të mos ketë marrë asnjë votë. Në këto kushte, të dhënat e sistemit elektronik kanë rezultuar të pasakta, duke shënuar gabim rezultatin për këto dy subjekte;

- Në KZAZ-në nr. 84, QV nr. 4449/1, rezulton se sipas sistemit elektronik subjekti zgjedhor Lëvizja për Zhvillim Kombëtar ka marrë zero vota, ndërkohë që sipas tabelës së GNV-së, ka marrë po zero vota dhe sipas tabelës përmbledhëse të KZAZ-së ky rezultat është tetë vota. KQZ në vendimin e saj ka plotësuar tabelën përmbledhëse të rezultatit sipas të dhënave të tabelës origjinale të QV-së, pra me zero vota.

Mospërputhjet e mësipërme, të cilat konsiderohen nga vetë Kodi Zgjedhor si gabime materiale, që korrigojnë nga KQZ-ja në vendimin përfundimtar të plotësimit të tabelës përmbledhëse të rezultateve të çdo zone zgjedhore, rezultojnë të jenë konstatuar dhe ndrequr nga pala e paditur, me vendimin e saj nr. 670, datë 03.07.2013.

Në kushtet e mësipërme Kolegji Zgjedhor konkludon se pretendimet e palës paditëse lidhur me mospërputhjet e të dhënave të tabelave, janë zgjidhur me vendimin që kundërshtohet. Pala paditëse nuk paraqiti asnjë pretendim lidhur me këtë vendimmarrje të KQZ-së, por përkundrazi ajo pranoi se mospërputhja e të dhënave ishte konstatuar. Duke qenë se në vendimin nr. 670, datë 03.07.2013 “Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për Zonën Zgjedhore Qarku Vlorë, për zgjedhjet për Kuvendin, 23 Qershor 2013”, rezultati i votimit për subjektin zgjedhor Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, pasqyron të dhënat sipas tabelave origjinale të përpiluara nga GNV-të për çdo QV, Kolegji Zgjedhor e gjen të bazuar në ligj vendimin e mësipërm, me të cilin janë ndrequr edhe gabimet e kryera nga KZAZ-të e Zonës Zgjedhore Qarku Vlorë, në 14 vendimet e tyre të ndërmjetme për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për çdo ZAZ.

Në vijim të sa më sipër, Kolegji Zgjedhor arrin në përfundimin se pretendimet e paraqitura në padinë objekt gjykimi, lidhur me procesin e numërimit dhe vlerësimit të votave në QV-të e ZAZ-ve të Zonës Zgjedhore Qarku Vlorë, janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, bazuar në nenin 158 të Kodit Zgjedhor.

V E N D O S I :

- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 741, datë 15.07.2013 të KQZ-së “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 5 të Partisë Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, me objekt “Kundërshtimin e vendimit të KQZ-së nr. 670, datë 03.07.2013 “Për nxjerrjen e rezultatit të Qarkut Vlorë për zgjedhjet për Kuvendin, 23 qershor 2013”.
- Rrëzimin e padisë lidhur me kundërshtimin e vendimit nr. 670, datë 03.07.2013 të KQZ-së “Për nxjerrjen e rezultatit të Qarkut Vlorë për zgjedhjet për Kuvendin, 23 qershor 2013”.

Tiranë, 26.07.2013.

**Anëtare
Gjinovefa GABA**

**Anëtar
Fuat VJERDHA**

**Kryesuese
Edlira PETRI**

**Anëtar
Valbon ÇEKREZI**

**Anëtar
Andi CIVICI**

*** * ***



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR

NR. 16 REGJ. THEMELTAR
DATË 19.07.2013 REGJ.

Nr. 21 VENDIMI
DATË 27.07.2013 VENDIMI

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUES :	VALBON ÇEKREZI
ANETAR :	GJINOVEFA GABA
ANETAR :	EDLIRA PETRI
ANETAR :	ILIR TOSKA
ANETAR :	ANDI CIVICI

Me sekretare **Rexhina Baçi**, në Tiranë, sot në **datë 27.07.2013**, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore me nr. 19 Akti, që u përket palëve:

PADITËSE: **Lëvizja Socialiste për Integrim**,
përfaqësuar me autorizim nga Z. Ilirjan MUHO dhe
Z. Spartak BRAHO.

I PADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**,
përfaqësuar me autorizim nga Znj. Dëshira PASKO
dhe Z. Endri TOPORJA.

PALË E INTERESUAR: **Partia Demokratike e Shqipërisë**,
përfaqësuar me autorizim nga Z. Ivi KASO dhe
Z. Oerd BYLYKBASHI.
Partia Socialiste Shqipërisë,
përfaqësuar me autorizim nga Z. Koli BELE, i

pranishëm në seancën e datës 23.03.2013,
në seancat e tjera **në mungesë**.

OBJEKTI: Kundërshtimi i vendimit nr. 740, datë 15.07.2013 të KQZ “Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 21 të Lëvizjes Socialiste për Integrim për ndryshimin e vendimit nr. 666, datë 03.07.2013 të KQZ për nxjerrjen e rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Kukës”.

BAZA LIGJORE: Nenet 145, 152, 153, e vijues, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i RSH”, me ndryshimet përkatëse.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoi palët prezent në pretendimet e tyre, përfaqësuesin e palës paditëse, që në përfundim kërkoi pranimin e padisë, përfaqësuesin e palës së paditur, që në përfundim kërkoi pranimin pjesërisht të kërkesë padisë duke u pasqyruar rezultati i rinumërimit, përfaqësuesin e palës së interesuar, që në përfundim kërkoi pranimin pjesërisht të kërkesë padisë duke u pasqyruar rezultati i rinumërimit, pasi administroi provat e bisedoi çështjen në tërësi;

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 666, datë 03.07.2013 “Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për Zonën Zgjedhore Qarku Kukës, për zgjedhjet për Kuvendin, 23 qershor 2013”, ka vendosur të miratojë tabelën përmbledhëse të rezultatit për Zonën Zgjedhore, Qarku Kukës.

Subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim, më datë 08.07.2013, ka paraqitur kërkesën ankimore nr. 21 ndaj vendimit të KQZ-së nr. 666, datë 03.07.2013, që ka nxjerrë rezultatin e votimit për Zonën Zgjedhore Qarku Kukës.

Me anë të këtij ankimi, subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim ka kërkuar:

ndryshimin e rezultatit të votimit për Zonën Zgjedhore Qarku Kukës;

rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në kutitë e votimit të QV nr. 0524, QV nr. 0445, QV nr. 0465, QV nr. 0462, QV nr. 0454, QV nr. 0446, QV nr. 0441, QV nr. 0473, QV nr. 0504, QV nr. 0442, QV nr. 0455, QV nr. 0447, QV nr. 0443, QV nr. 0518, QV nr. 0444, të KZAZ nr. 9.

Në kërkesën ankimore të paraqitur, subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim ka pretenduar se:

koalicioni i djathtë, “Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim”, ka marrë më pak vota sa janë pasqyruar në tabelat e rezultatit për këto 15 qendra votimi;

gjatë këqyrjes së pamjeve filmike të numërimit të votave në KZAZ nr. 9, pjesë e së cilës janë edhe këto qendra votimi, del që rezultati i votimit të 15 qendrave të votimit të sipërpërmendura është i ndryshëm, nga rezultati i pasqyruar nga grupet e numërimit në tabelën e rezultatit të këtyre QV-ve.

Në fillim të shqyrtimit administrativ nga ana e KQZ-së, në kërkesat paraprake, subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim ka parashtruar pretendimin në lidhje me vlefshmërinë e mbledhjes së KQZ-së për shqyrtimin e kërkesës ankimore, duke parashtruar se vendimet, lidhur me kalimin për shqyrtim të ankimit kundër vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e zgjedhjeve të zonës zgjedhore, kërkojnë shumicë të cilësuar dhe, për pasojë, mbledhja duhet të hapej në praninë e të paktën 5 (pesë) anëtarëve të KQZ-së.

KQZ nuk e ka marrë në konsideratë këtë pretendim dhe ka vazhduar shqyrtimin e ankimit në një mbledhje, në të cilën kanë marrë pjesë katër anëtarë të saj (KQZ-së).

KQZ ka shqyrtuar në themel kërkesën ankimore dhe, me vendimin nr.740, datë 15.07.2013, ndër të tjera, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 21, të subjektit zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

Lënien në fuqi të vendimit të KQZ-së nr. 666, datë 03.07.2013 “Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për Zonën Zgjedhore Kukës.”

Subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim, më datë 18.07.2013, ka depozituar përpara Kolegjit Zgjedhor një ankim/kërkesëpadi, me të cilën, duke paditur KQZ, si dhe thirrur si palë të interesuara Partinë Demokratike dhe Partinë Socialiste, ka kërkuar sipas objektit të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Pala paditëse Lëvizja Socialiste për Integrim në padi dhe gjatë gjykimit ka pretenduar se:

vendimi i KQZ-së është i pambështetur në prova dhe në ligj;

është kërkuar nga KQZ-ja që, në referim të nenit 22, pika 5, të Kodit Zgjedhor, të konstatonte pamundësinë e zhvillimit të kësaj mbledhje për shkak të mungesës së quorumit, pasi që në fillim të mbledhjes u konstatua fakti se ishin të pranishëm vetëm katër anëtarë të KQZ-së;

në nenin 22, pika 5, të Kodit Zgjedhor thuhet që “... mbledhjet e KQZ-së janë të vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 4 anëtarë të saj, me përjashtim të rasteve kur kërkohet shumicë e cilësuar për marrjen e vendimit, sipas nenit 24 të këtij kodi”. Duke qenë se kjo mbledhje në përfundim të saj do të konkludonte me pranim ose mospranim të kërkesës për ndryshimin e tabelës që kishte miratuar rezultatit e votimit për zonën zgjedhore Qarku Kukës, siç parashikon neni 24, pika 1, shkronja “b”, i Kodit Zgjedhor, i cili përcakton se “Konsiderohen të miratuara, kur votojnë “pro” jo më pak se 5 anëtarë të KQZ-së, vendimet lidhur me: ... b) pranimin e ankimit kundër vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatit e zgjedhjeve të zonës zgjedhore, sipas nenit 123 të këtij Kodi ...”, kjo mbledhje e KQZ-së ishte e pavlefshme dhe vendimet e marra janë absolutisht të pavlefshme;

gjatë këqyrjes së regjistrimeve filmike të kamerave të vendosura në tavolinat e numërimit të votave në KZAZ nr. 9 Qarku Kukës, material filmik që është vënë në dispozicion nga KQZ-ja me shkresën nr. 5891/1, datë 08.07.2013, nga ana e vetë palës

paditëse, por edhe nga ekspertë të fushës përkatëse, u konstatua se në disa qendra votimi numri i votave për aleancën e djathtë ishte më i vogël se sa rezultati i pasqyruar në tabelat e grupeve të numërimit për këtë subjekt, konkretisht në qendrat e votimit nr. 0524, QV nr. 0445, QV nr. 0465, QV nr. 0462, QV nr. 0454, QV nr. 0446, QV nr. 0441, QV nr. 0473, QV nr. 0504, QV nr. 0442, QV nr. 0455, QV nr. 0447, QV nr. 0443, QV nr. 0518, QV nr. 0444;

materiali filmik i vënë në dispozicion nga KQZ-ja u këqyr dhe u verifikua me një grup specialistësh të fushës, ku u konstatua se një numër i caktuar fletësh votimi (187 fletë votimi) nuk kishin asnjë shenjë votimi për asnjë nga subjektet zgjedhore, ndërkohë që grupet e numërimit, në kundërshtim me nenin 117, pika 3, shkronja “dh”, të Kodit Zgjedhor, që parashikon se fletët e votimit janë të pavlefshme kur nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore, i kanë llogaritur gabimisht ato në favor të disa partive pjesëtare të koalicionit të djathtë;

nga krahasimi i rezultateve për këto qendra votimi sipas tabelave të grupeve të numërimit, rezulton se aleanca e djathtë ka marrë 4056 vota, ndërsa sipas numërimit të votave të shfaqura në materialin filmik të vënë në dispozicion nga KQZ-ja rezulton se kjo aleancë ka marrë 3901 vota, pra ekziston një diferencë prej 155 votash;

diferenca e votave në Qarkun e Kukësit midis dy koalicioneve për efekt të ndarjes së mandateve midis tyre, është vetëm 15 vota në favor të aleancës së djathtë, duke qenë kështu i qartë dhe i kuptueshëm efekti që sjellin këto 155 vota të përfituara padrejtësisht nga koalicioni i djathtë në ndarjen e mandateve midis dy koalicioneve;

kjo mospërputhje e rezultateve tregon se numërimi dhe vlerësimi i votave në KZAZ nr. 9 Qarku Kukës për këto qendra votimi është kryer në kundërshtim me nenet 118 dhe 119 të Kodit Zgjedhor;

argumentimi i KQZ, se nuk u paraqit asnjë provë, është në kundërshtim me ligjin, nenet 116, 116/1, 118 dhe 119 të Kodit Zgjedhor, pasi regjistrimi filmik i procesit është procedurë që parashikohet si e tillë në nenin 94/4 dhe nenin 118/2 të Kodit Zgjedhor;

KQZ-ja ka shkelur gjithashtu dhe nenin 136 të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon "... marrjen e provave të cilat nuk mund të siguroheshin nga ana jonë ...", pra fletët e votimit që ndodhen në këto kuti votimi. Paraqitja nga subjekti zgjedhor LSI e mospërputhjeve të rezultateve të tabelave të grupeve të numërimit me materialin filmik të vënë në dispozicion nga KQZ-ja, të vlerësuara si materiale zgjedhore, shërbente si një shkak i arsyeshëm, i mbështetur në prova, që ky organ, KQZ-ja, qoftë dhe kryesisht, të vendoste marrjen e provës, këqyrjen e fletëve të votimit në 15 kutitë e atyre qendrave të votimit, për të vlerësuar më tej kryerjen e rinumërimit dhe rivlerësimit të këtyre votave, për të vërtetuar kështu faktet e pretenduara;

Pala e paditur KQZ, prapësoi pretendimet e paditësit, duke parashtruar se:

shqyrtimi i ankimeve në lidhje me kundërshtimin e vendimeve të KQZ-së për nxjerrjen e rezultatit të zonës zgjedhore, nuk parashikohet nga neni 24 i Kodit Zgjedhor si rast i cili kërkon votimin "pro" të 5 anëtarëve të tij;

sipas nenit 143 të Kodit Zgjedhor rezulton se pranimi i ankimit për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të votimit për zonën zgjedhore, është një nga disa llojet e vendimit që merr KQZ-ja pas shqyrtimit të ankimeve zgjedhore. Fakti se, vetëm një prej llojeve të vendimeve që merr KQZ-ja, pas shqyrtimit të ankimeve zgjedhore, kërkon një shumicë të cilësuar prej 5 votash, nuk kushtëzon zhvillimin e mbledhjes së KQZ-së me pjesëmarrjen e 5 anëtarëve. Në këtë rast KQZ-ja ka të drejtën e parashikuar nga neni 22 i Kodit Zgjedhor për të zhvilluar mbledhjen për shqyrtimin e ankimeve dhe, më pas, të marrë vendimin përkatës;

në mbështetje të nenit 124 të Kodit Zgjedhor, kundër vendimit të KQZ-së për nxjerrjen e rezultatit në zonën zgjedhore, subjektet duhet të ushtrojnë të drejtën e ankimit administrativ, duke kundërshtuar vendimin për nxjerrjen e rezultatit të votimit në Zonën Zgjedhore Qarku Kukës, po përsëri përpara KQZ-së. Neni 137, pika 3, i Kodit të Procedurave Administrative parashikon se, në parim, palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë ezauruar rekursin administrativ. Në bazë të dispozitës së

sipërcituar, në rast se KQZ-ja nuk shqyrton kërkesat ankimore, u mohon të drejtën e ankimit administrativ subjekteve të interesuara;

KQZ-ja e gjeti të pambështetur në prova dhe ligj kërkesën e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për rinumërim dhe rivlerësim. Në mbështetje të nenit 138 të Kodit Zgjedhor, kërkesa duhet të mbështetet në prova të cilat pasqyrojnë se gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave sipas përcaktimeve të nenit 116, 116/1, 118, 119 të Kodit Zgjedhor ka pasur shkelje të konstatuara për numërim jo të saktë të votave për çdo subjekt zgjedhor, ose gjatë vlerësimit të votave ka pasur kundërshtim nga ndonjë prej anëtarëve të grupeve të numërimit apo vëzhguesve të subjekteve zgjedhore;

sipas procedurave të përcaktuara në nenin 116, pika 7 dhe 118 të Kodit Zgjedhor këto kontestime duhet të pasqyrohen në dokumentacionin zgjedhor si kundër është procesverbali i konstatimit dhe libri i protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së. Në këtë rast, votat e kontestuara, në mbështetje të nenit 118 të Kodit Zgjedhor, duhet të futen në zarfin e fletëve të votimit të kontestuara;

nga verifikimi i dokumentacionit zgjedhor, administruar si provë në hetimin administrativ, rezultoi se nuk ka prova të mjaftueshme, të cilat të shërbenin si shkak për thellimin e hetimit administrativ dhe rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në kutitë e votimit të pretenduara nga pala ankuese Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

Pala e interesuar Partia Demokratike prapësoi, duke parashtruar se:

vendimi për pranimin për shqyrtim të ankimit kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të votimit për zonën zgjedhore, është një nga disa llojet e vendimeve që merr KQZ-ja pas shqyrtimit të ankimeve zgjedhore. Fakti se vetëm një prej llojeve të vendimeve që merr KQZ-ja, pas shqyrtimit të ankimeve zgjedhore, kërkon një shumicë të cilësuar prej 5 votash, nuk kushtëzon zhvillimin e mbledhjes së KQZ-së me pjesëmarrjen e 5 anëtarëve. Në këtë rast KQZ-ja ka të drejtën e parashikuar nga

neni 22 i Kodit Zgjedhor për të zhvilluar mbledhjen për shqyrtimin e ankimeve dhe, më pas, të marrë vendimin përkatës;

nga hetimi administrativ i zhvilluar nga KQZ-ja në lidhje me ankimin e paraqitur nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim rezultoi se në dokumentacionin zgjedhor, të administruar në cilësinë e provës, përsa i përket pretendimit të palës ankuese për rinumërimin e votave në kutitë e votimit për qendrat e kontestuara dhe rinumërimin e votave me kampione, nuk gjendeshin prova dhe indicie të mjaftueshme që KQZ-ja të zhvillonte më tej hetimin administrativ. Nga këqyrja e dokumentacionit rezultoi se asnjë prej anëtarëve të KZAZ-së apo anëtarët e grupeve të numërimit nuk kanë pasqyruar asnjë vërejtje në dokumentacionin zgjedhor, si në librin e protokollit të mbledhjes, procesverbal konstatimi apo tabelat e rezultatit të KZAZ-së dhe Grupeve të Numërimit;

në mbështetje të nenit 138 të Kodit Zgjedhor, kërkesa duhet të mbështetet në prova, të cilat pasqyrojnë se gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave, sipas përcaktimeve të nenit 116, 116/1, 118, 119 të Kodit Zgjedhor, ka patur shkelje të konstatuara për numërim jo të saktë të votave për çdo subjekt zgjedhor, ose gjatë vlerësimit të votave ka patur kundërshtim nga ndonjë prej anëtarëve të grupeve të numërimit apo vëzhguesve të subjekteve zgjedhore;

Pala e interesuar Partia Socialiste, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, u bashkua me pretendimet e parashtruara nga pala paditëse në lidhje me pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 740, datë 15.07.2013, të KQZ-së.

Kolegji Zgjedhor, pasi ia nënshtroi çështjen debatit gjyqësor, dëgjoi palët, administroi provat, kreu procesin e rinumërimit dhe rivlerësimit të votave të qendrave të votimit të kontestuara, në përfundim konkludoi se padia duhet të pranohet pjesërisht.

Konkretisht, Kolegji vlerëson se, Lëvizja Socialiste për Integrim, duke qenë një nga subjektet zgjedhore, që ka marrë pjesë në zgjedhjet për Kuvendin 2013, gëzon legjitimitetin për të ankimuar vendimet e KQZ-së, sipas afateve të përcaktuara në nenin 152 të këtij Kodi.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 666, datë 03.07.2013 “Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për Zonën Zgjedhore Qarku Kukës, për zgjedhjet për Kuvendin, 23 qershor 2013”, ka vendosur të miratojë tabelën përmbledhëse të rezultatit për Zonën Zgjedhore Qarku Kukës.

Sipas parashikimeve të neneve 123/4, 124/3 të Kodit Zgjedhor, vendimi i KQZ-së për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore mund të ankimohet po në KQZ, jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi.

Subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim ka paraqitur ankim kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, Qarku Kukës, ankim i regjistruar pranë KQZ me nr. 21, datë 08.07.2013, pra brenda afatit ligjor të parashikuar në dispozitën e sipërcituar.

KQZ-ja, pasi e ka shqyrtuar në themel ankimin e paraqitur, në përfundim, me vendimin nr. 740, datë 15.07.2013, e ka rrëzuar atë.

Subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim ka paraqitur ankim pranë këtij Kolegji, duke kundërshtuar vendimin nr. 740, datë 15.07.2013, të KQZ “Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 21 të Lëvizjes Socialiste për Integrim për ndryshimin e vendimit nr. 666, datë 03.07.2013, të KQZ për nxjerrjen e rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Kukës”, si dhe duke kërkuar gjykimin në themel të çështjes.

Pala ankuese, subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim, në ankimin e paraqitur ka parashtuar se vendimi nr. 740, datë 15.07.2013, i KQZ, që ka vendosur rrëzimin e kërkesës së saj ankimore të paraqitur ndaj vendimit të KQZ-së nr. 666, datë 03.07.2013 “Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për Zonën Zgjedhore Qarku Kukës.”, është një vendim absolutisht i pavlefshëm për shkak të mungesës së quorumit të anëtarëve të KQZ, të domosdoshëm për të qenë të pranishëm në mbledhje.

Kolegji vlerësoi se ky pretendim i parashtuar nga pala ankuese, për pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 740, datë 15.07.2013, të KQZ, është i bazuar.

Në nenin 22/5 të Kodit Zgjedhor përcaktohet “vlefshmëria e mbledhjes” së KQZ, e cila, si rregull, është e vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 4 anëtarë, me përjashtim të rasteve kur kërkohet “shumicë e cilësuar” për marrjen e vendimit sipas nenit 24 të këtij Kodi, dispozitë kjo, pika 1, shkronjat “a”-“f”, të të cilës, nga ana tjetër, përcakton shumicën e nevojshme që duhet për një vendimmarrje pozitive, votimin “pro” të jo më pak se 5 anëtarëve të KQZ.

Subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim në ankimin e paraqitur para KQZ ka kundërshtuar vendimin nr. 666, datë 03.07.2013, të KQZ-së për nxjerrjen e rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Kukës”, ç’ka referon në një vendimmarrje sipas pikës “b”, të nenit 24 të Kodit Zgjedhor, që parashikon se *“Konsiderohen të miratuara, kur votojnë “pro” jo më pak se 5 anëtarë të KQZ-së, vendimet lidhur me: ...; b) pranimin e ankimit kundër vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e zgjedhjeve të zonës zgjedhore, sipas nenit 123 të këtij Kodi ...”*.

Quorumi i nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes së KQZ përcaktohet nga lloji i vendimmarrjes përfundimtare të KQZ, pra në vendime që merren me “shumicë të cilësuar”, sipas nenit 24, pika 1, shkronjat “a”-“f”, të Kodit Zgjedhor, që kërkon votimin “pro” të jo më pak se 5 anëtarëve.

Për sa kohë që mbledhja e KQZ-së në rastin objekt gjykimi ka patur për objekt shqyrtimin kërkesës ankimore që kërkon vendimmarrje sipas nenit 24/1, shkronja “b”, të Kodit Zgjedhor, në referim të përcaktimit të nenit 22/5 të Kodit Zgjedhor, mbledhja duhej të zhvillohej në prani të jo më pak se 5 anëtarëve, që përbën dhe quorumin e nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes. Mungesa e këtij quorumi për vlefshmërinë e mbledhjes së KQZ passjell pavlefshmërinë e saj dhe, për rrjedhojë, pavlefshmërinë absolute të vendimit të marrë nga KQZ në këtë mbledhje, pikërisht të vendimit objekt gjykimi me nr. 740, datë 15.07.2013, të KQZ-së.

Kolegji i referohet edhe qëndrimin të mbajtur prej tij në raste të tjera të ngjashme, që kanë qenë për shqyrtim gjatë këtij procesi zgjedhor.

Pavlefshmëria absolute e procesit administrativ të zhvilluar nga KQZ në shqyrtimin e ankimit të paraqitur nga subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim, për shkak të mungesës së quorumit të nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes, që passjell dhe pavlefshmërinë e vendimmarrjes në përfundim të atij procesi, siç u analizua më lart, kondicionon dhe shqyrtimin në themel të çështjes, kjo në referim edhe të nenit 158/1-c të Kodit Zgjedhor, pasi nuk jemi në kushtet e (i) pushimit të gjykimit, që vendoset kur konstatohet se ankimi është paraqitur jashtë afatit ose mungesa e kompetencës në referim të nenit 158/1-a/2 të Kodit Zgjedhor, apo në kushtet e (ii) detyrimit të KQZ-së për të marrë vendim në referim të nenit 158/1-c/2 të Kodit Zgjedhor.

Më tej, pala ankuese, subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim, me ankimin/padinë e paraqitur ka kërkuar dhe zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes, pikërisht ndryshimin e vendimit nr. 666, datë 03.07.2013 të KQZ-së për nxjerrjen e rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Kukës, mbi pretendimin se një vendim i tillë është i pabazuar në ligj e prova.

Kolegji vlerësoi se ky pretendim i parashtruar nga pala ankuese, për pabazueshmërinë ligjore dhe faktike të vendimit nr. 666, datë 03.07.2013 të KQZ-së, është pjesërisht i bazuar, referuar fakteve që rezultuan gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Konkretisht, në funksion të vërtetimit të fakteve në lidhje me këtë kërkim padie, pala ankuese, subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim, ka kërkuar marrjen si provë të materialit filmik të procesit të numërimit e vlerësimit të fletëve të votimit të ndodhura në kutitë e votimit të qendrave të votimit të KZAZ nr. 9, specifikisht në kutitë e votimit të QV nr. 0524, QV nr. 0445, QV nr. 0465, QV nr. 0462, QV nr. 0454, QV nr. 0446, QV nr. 0441, QV nr. 0473, QV nr. 0504, QV nr. 0442, QV nr. 0455, QV nr. 0447, QV nr. 0443, QV nr. 0518, QV nr. 0444, duke pretenduar se:

gjatë këqyrjes së regjistrimeve filmike të kamerave të vendosura në tavolinat e numërimit të votave në KZAZ nr. 9 Qarku Kukës, material filmik që u vu në dispozicion nga KQZ me shkresën nr. 5891/1, datë 08.07.2013, u konstatua se, në disa qendra votimi, numri i votave për aleancën e djathtë ishte më i vogël se sa rezultati

i pasqyruar në tabelat e grupeve të numërimit për këtë subjekt (në QV-të e kontestuara) dhe kjo mospërputhje e rezultateve tregon se numërimi dhe vlerësimi i votave në KZAZ nr. 9, për këto qendra votimi, është kryer në kundërshtim me nenet 118 dhe 119 të Kodit Zgjedhor;

materiali filmik i vënë në dispozicion nga KQZ u këqyr dhe u verifikua me një grup specialistësh të fushës, ku u konstatua se një numër i caktuar fletësh votimi (187 fletë votimi) nuk kishin asnjë shenjë votimi për asnjë nga subjektet zgjedhore dhe grupet e numërimit, në kundërshtim me nenin 117, pika 3, shkronja “dh”, të Kodit Zgjedhor, që parashikon se fletët e votimit janë të pavlefshme, kur nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore, i kanë llogaritur gabimisht ato, në favor të disa partive pjesëtare të koalicionit të djathtë.

Pala ankuese Lëvizja Socialiste për Integrim, rëndësinë e faktit të pretenduar prej saj, e lidh dhe me diferencën e ngushtë prej 15 votash për ndarjen e mandateve në Zonën Zgjedhore Qarku Kukës midis dy koalicioneve.

Pala ankuese paraqiti në Kolegj si provë, përveç materialeve filmike të gjendura në një Hard Disk, dhënë nga KQZ, edhe një akt-verifikimi (akt ekspertimi) të kryer në mënyrë private nga specialistë të fushës përkatëse, sipas të cilëve, gjatë procesit të verifikimit të pamjeve filmike të procesit të numërimit të votave në QV-të e kontestuara nga pala paditëse, ata (specialistët) kishin identifikuar 41 fletë votimi me më shumë se një shenje dalluese të vlefshme për votim, si dhe 187 fletë votimi “të bardha”, pa asnjë shenjë dalluese të vlefshme për votim.

Nga pala e paditur KQZ dhe personi i interesuar Partia Demokratike u pretendua se në rastin konkret, në kuptim të nenit 138 të Kodit Zgjedhor, nga dokumentacioni zgjedhor përkatës, nuk rezultonte asnjë provë e mjaftueshme referuar përcaktimeve të neneve 116, 116/1, 118 dhe 119 të këtij Kodi, për kryerjen e rinumërimit dhe rivlerësimin të votave në kutitë e votimit të pretenduara nga pala paditëse, ndërkohë që regjistrimi filmik, në kuptim të këtyre dispozitave, nuk mund të shërbejë si provë për klasifikimin e këtyre votave si “vota të caktuara”, pra si vota të identifikuara ose

të kontestuara, gjë e cila përbën shkak sipas ligjit, për kryerjen e rinumërimit dhe rivlerësimit të tyre. Nga ana tjetër, sipas palës së paditur dhe personit të interesuar, nga pamjet që ofronte regjistrimi filmik ishte e pamundur të vërtetohej që në procesin e numërimit të votave në kutitë e atyre qendrave të votimit të kundërshtuara nga pala paditëse, të ketë patur parregullsi dhe mosrespektim të ligjit.

Referuar pretendimeve të palëve, Kolegji vlerëson se dispozita ligjore, mbi të cilën palët referojnë pretendimet e tyre, është pikërisht neni 138 i Kodit Zgjedhor, e lidhur kjo me nenin 136, pika 1 dhe 4, të këtij Kodi.

Kështu, në nenin 138 të Kodit Zgjedhor, ku rregullohet “*Këqyrja e materialit zgjedhor*”, parashikohet se

“1. Për nevojat e hetimit administrativ, KQZ-ja, kur ka pranuar kërkesën e palëve apo sipas parashikimeve të nenit 136 pika 3 të këtij Kodi, këqyr dokumentacionin dhe materialin zgjedhor që ndodhet në kutinë e materialeve të votimit dhe/ose kutitë e votimit dhe fletët e votimit, si dhe çdo dokumentacion apo material tjetër zgjedhor. Kur materiali zgjedhor ndodhet brenda kutive me vula sigurie, hapja dhe rimbyllja e tyre bëhet sipas procedurave që parashikon ky Kod për hapjen dhe mbylljen e kutive, duke treguar dhe shënuar kodet me të cilat kutitë përkatëse janë mbyllur nga KZAZ-ja, si dhe numrat me të cilat ato mbyllen rishtazi.

2. Këqyrja e materialit zgjedhor bëhet në prani të palëve dhe publikut. Pas këqyrjes së materialit dhe/ose dokumentacionit zgjedhor, palët kanë të drejtë të paraqesin vlerësimet dhe pretendimet e tyre. Provat e gjetura paraqiten në procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së.

3. KQZ-ja, me kërkesë të palëve ose kryesisht, kur çmon se për dhënien e vendimit është i nevojshëm rinumërimi dhe/ose rivlerësimi i votave të caktuara, kryen, në praninë e palëve, rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave dhe pasqyron përfundimin në procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së dhe vendimin përkatës të saj. Vota të caktuara janë votat e identifikuara ose të kontestuara, sipas procedurave të neneve 116 dhe 118 të këtij Kodi, për të cilat është kontestuar vlerësimi ose numri i tyre gjatë procesit të numërimit, si dhe votat e tabelës së rezultatit të kundërshtuar, sipas pikës 2 të nenit 119 të këtij Kodi. Në rast se kërkesa për rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave të caktuara bëhet nga dy anëtarë të KQZ-së, ajo është e detyruar të bëjë rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave të kërkuara.

4. ...

5. *Vendimet e KQZ-së, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, mund të ankimohen së bashku me vendimin e KQZ-së”.*

Ndërsa, në nenin 136 të Kodit Zgjedhor, ku rregullohet “*Paraqitja e pretendimeve dhe kërkimi i provave*”, parashikohet se “*1. Në përfundim të veprimeve të përcaktuara në nenin 135 të këtij Kodi, KQZ-ja fton palët të paraqesin pretendimet e tyre dhe:*

a) të japin shpjegime rreth kërkesave të parashtruara në ankim;

b) të tregojnë faktet dhe provat, mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre. Llojet e provave përcaktohen në Kodin e Procedurës Civile; dhe

c) të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre, duke paraqitur njëkohësisht edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i tyre.

2. Pas paraqitjes së pretendimeve të palëve, KQZ-ja, me kërkesë të secilës prej tyre ose kryesisht, mund të vendosë marrjen e provave të tjera kur çmon se marrja e tyre është në dobi të gjyqimit.

3. ...

4. KQZ-ja mund të refuzojë kërkesën e ankuesit apo të palës së interesuar për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 dhe pikës 2 të këtij neni, vetëm nëse vlerëson se prova nuk shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara. Arsyetimi i KQZ-së për refuzimin e marrjes së provës jepet i detajuar në vendimin përfundimtar. KQZ-ja nuk mund të refuzojë kërkesën për prova, të bërë sipas pikës 3 të këtij neni.

5. ...

6. Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në këtë nen, kur KQZ-ja çmon se një fakt, rrethanë ose ngjarje ka ndodhur, ajo merret si provë, pavarësisht nëse nuk është pasqyruar në ndonjë dokument zgjedhor”.

Kolegji vlerëson se, pretendimi që pala ankuese LSI ka ngritur në kërkesën ankimore të paraqitur përpara KQZ-së në lidhje me bazueshmërinë faktike dhe, mbi këtë bazë, në atë ligjore, të Vendimit të KQZ-së nr. 666, datë 03.07.2013, pretendim i cili është përsëritur dhe në kërkesëpadinë objekt të këtij gjykimi, konsiston në fakte të rëndësishme për rezultatin e votimit, që kanë lidhje me votat, fletët e votimit të ndodhura në kutitë e 15 qendrave të votimit të përmendura më lart, fletë votimi këto të administruara nga

KQZ-ja dhe të cilat pala ankuese/pala paditëse nuk ka mundësi t'i sigurojë. Ndërkohë që, duke qenë e bindur për faktet e pretenduara, mbështetur kjo në mendimin/konstatimin e disa specialistëve me njohuri të posaçme në fushën e teknologjisë së informacionit, pala ankuese/pala paditëse pretendon se në rastin konkret ishte vendi për rinumërimin dhe rivlerësimin e votave të ndodhura në këto 15 kuti votimi, rezultat i cili, sipas palës ankuese/palës paditëse, do të vërtetonte pabazueshmërinë faktike dhe ligjore të vendimit objekt gjykimi të KQZ-së.

Referuar një pretendimi të tillë të palës ankuese/palës paditëse, Kolegji vlerëson se në thelb ai përfaqëson një kërkesë për marrje të provave nëpërmjet dy mjeteve të kërkimit të provës, pikërisht nëpërmjet këqyrjes së fletëve të votimit në kutitë e atyre qendrave të votimit, ashtu sikundër edhe nëpërmjet rinumërimin dhe rivlerësimit të këtyre fletëve të votimit, mjete kërkimi të provave këto që rregullohen në një dispozitë të vetme të Kodit Zgjedhor (neni 138), duke u paraqitur nga pala ankuese/pala paditëse në funksion të kësaj si provë, regjistrimi filmik i procesit të numërimit të votave në KZAZ nr. 9, ku përfshihen edhe qendrat e votimit objekt kundërshtimi.

Nisur nga sa më lart, në konsideratë të rregullimeve të bëra në nenet 94/4 dhe 118/2 të Kodit Zgjedhor, ashtu sikundër edhe në konsideratë të rregullimeve të përgjithshme të bëra në Kodin e Procedurës Civile në lidhje me provat në një proces gjyqësor civil, Kolegji vlerëson se, parimisht, regjistrimi filmik i procesit të numërimit të votave përbën provë, por duke dalluar vlerën e tij provuese në raport me faktet objekt të provuari në një gjykim konkret.

Konkretisht, regjistrimi filmik i procesit të numërimit të votave është pjesë e materialeve zgjedhore parashikuar si i tillë në nenin 94/4 të Kodit Zgjedhor, në të cilin parashikohet se *“ KQZ-ja vendos përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve) për shfaqjen e fletëve të votimit përpara vlerësimit të tyre. Kamerat me rezolucion të lartë instalohen mbi tavolinën e numërimit në mënyrë të tillë që bëjnë të mundur regjistrimin e vlerësimit të çdo flete votimi. Regjistrimi filmik transmetohet në kohë reale në monitorë të vendosur përballë vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Regjistrimi filmik i procesit ruhet në medie elektronike dhe dorëzohet në KQZ*

së bashku me materialet e tjera zgjedhore. KQZ-ja ose, kur është e mundur, edhe KZAZ-ja, duhet të riprodhojë kopje të tyre dhe t'i vërë në dispozicion të subjekteve zgjedhore kundrejt pagesës së një tarife që mbulon koston e riprodhimit.”

Madje, neni 118/2 i Kodit Zgjedhor, që rregullon procedurën e vlerësimit të votave nga grupet e numërimit, ka përcaktuar gjatë këtij procesi detyrimin e grupeve të numërimit dhe vlerësimit të votave për mundësinë e leximit të fletës së votimit nga ana e kamerës të vendosur sipas pikës 4, të nenit 94 të Kodit Zgjedhor.

Nga ana tjetër, çdo lloj regjistrimi, mund të përbëjë provë për ngjarjet e sendet që janë regjistruar, referuar nenit 278 të Kodit të Procedurës Civile.

Ndërkohë, sipas nenit 155/1 të Kodit Zgjedhor, Kolegji ka detyrimin të zbatojë dispozitat e Kodit të Procedurës Civile për gjykimin e çështjeve në lidhje me veprimet procedurale që nuk rregullohen nga Kodi Zgjedhor.

Por, pavarësisht se regjistrimi filmik i procesit të numërimit të votave përbën provë në kuptim të ligjit, një provë e tillë, në vlerësim të Kolegjit, është e qartë se nuk përbën provë, në funksion të vërtetimit të rezultatit të votimit në ato qendra votimi objekt padie dhe, më tej, në bazueshmërinë ligjore dhe faktike të vendimit objekt gjykimi të KQZ.

Por, ky regjistrim filmik, i shoqëruar me mendimin/konstatimet e disa specialistëve me njohuri të posaçme në fushën e teknologjisë së informacionit për fakte të caktuara dhe të rëndësishme në procesin e numërimit të votave, në vlerësim të Kolegjit, përbën shkak për marrjen e provës së ekspertimit, pikërisht ekzaminim gjyqësor të këtij regjistrimi filmik, konkretisht për verifikimin e fakteve që rezultojnë nga pamjet filmike të regjistruara, provë e cila nga ana tjetër, në potencë, mund të shërbejë ose jo si indicie për këqyrjen e fletëve të votimit në kutitë e qendrave të votimit objekt padie dhe, më tej, për kryerjen ose jo të rinumërimit dhe/ose të rivlerësimit të votave në këto kuti votimi.

Në kushtet kur pretendimet e palës ankuese/palës paditëse referonin në një pjesë të materialit zgjedhor, siç është regjistrimi filmik i procesit të numërimit e vlerësimit të votave në qendrat e votimit të kontestuara, duke qenë se për konstatimin dhe sqarimin e atyre fakteve të pretenduara kërkoheshin njohuri të posaçme në fushën e teknologjisë së informacionit dhe teknologjisë audiovizive, njohuri të cilat nuk i përkasin sferës juridike dhe njohurive të zakonshme dhe ekskluzive të një gjyqtari, Kolegji, në seancën e datës 23.07.2013, vendosi kryerjen e një ekspertimi, me ekspertë të fushës përkatëse, në referim të nenit 155 të Kodit Zgjedhor, si dhe dispozitave të Kodit të Procedures Civile, nenet 213, 224/a e vijues.

Tërheqja e mendimit të ekspertëve, kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve, që kanë lidhje me shqyrtimin e kërkesave ankimore, kërkohen njohuri të posaçme, parashikohet si në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile (neni 224/a e vijues), ashtu dhe në nenin 139 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji vendosi që për realizimin e këtij ekspertimi të caktojë një grup ekspertësh (ekspertë të propozuar nga palët në proces), sipas profileve përkatëse, të përbërë nga z. Ardian Pollo dhe z. Zamir Hoxha.

Me Vendimin “Për caktimin e detyrave të ekspertimit” datë 24.07.2013, Kolegji i caktoi ekspertëve këto detyra : A përmbajnë të njëjtat pamje regjistrimet filmike të paraqitura si provë nga pala paditëse LSI dhe KQZ. Çfarë pamjesh përmbajnë regjistrimet filmike? A janë të qarta pamjet që përmbajnë regjistrimet filmike? A mund të identifikohet procesi i numërimit të fletëve të votimit për qendrat e votimit objekt ekspertimi? Nëse po, në ç’mënyrë? Nëse mund të identifikohet procesi i numërimit të fletëve të votimit që i përkasin këtyre qendrave të votimit, a identifikohen fletët e votimit që përmbajnë të shënuara një shenjë, më shumë se një shenjë, asnjë shenjë të vendosur nga zgjedhësi në rubrikën në krah të emrave të subjekteve zgjedhore apo partive pjesëtare të një koalicioni dhe nëse po të përcaktohen këto fletë votimi.

Secili ekspertë paraqiti raportin e tij me shkrim në seancën gjyqësore të datës 25.07.2013, seancë e cila u shty për t’iu lënë kohë palëve të njiheshin me aktet e ekspertimeve, si dhe për t’iu

dhënë atyre mundësi për të parashtruar pretendimet në lidhje me këto akte ekspertimi.

Në seancën pasardhëse të datës 26.07.2013, ekspertët parashtruan mendimin e tyre, të shoqëruar dhe me demonstrimin video për faktet objekt ekspertimi, duke ia nënshtruar debatit gjyqësor.

Ekspertët kishin konkluduar se regjistrimet filmike të paraqitura nga pala ankuese LSI dhe pala e paditur KQZ përmbanin të njëjtat pamje filmike dhe se, këto pamje filmike përmbanin pamje të fokusuara mbi tavolina, proces numërim votash, dokumentacion të lënë mbi tavolinë etj.

Eksperti Zamir Hoxha parashtrroi se kishte mundur të identifikonte në materialin filmik procesin e numërimit për katër qendra votimi, pikërisht për Qendrat e Votimit nr. 0441, nr. 0455, nr. 0447 dhe nr. 0444, por se procesi i numërimit i paraqitur për këto qendra votimi nuk mund të përcaktohet nëse është apo jo i plotë dhe se, nga filmimet nuk mund të përcaktohet vlerësimi që bën grupi i numërimit për votat të cilat shfaqen në ekran. Gjithashtu, ai parashtrroi se përcaktimi i momentit kohor të fillimit dhe përfundimit të procesit të numërimit në mënyrë të saktë është i pamundur bazuar në materialet filmike që disponohen pasi kjo varet nga sinkronizimi i kohës në pajisjen e përdorur për regjistrim. Eksperti Zamir Hoxha parashtrroi edhe se për shkak të kohës së shkurtër të vënë në dispozicion nuk kishte mundur t'i përgjigjej të gjitha pyetjeve të caktuara nga Kolegji.

Nga ana tjetër, eksperti Ardian Pollo parashtrroi se nga pamjet filmike të vëna në dispozicion ishte i mundur identifikimi i procesit të numërimit dhe i leximit të fletëve të votimit për QV nr. 0524, QV nr. 0445, QV nr. 0465, QV nr. 0462, QV nr. 0454, QV nr. 0446, QV nr. 0441, QV nr. 0473, QV nr. 0504, QV nr. 0442, QV nr. 0455, QV nr. 0447, QV nr. 0443, QV nr. 0518, QV nr. 0444, duke u identifikuar edhe fletët e votimit që përmbajnë të shënuara një shenjë, më shumë se një shenjë, asnjë shenjë, të vendosur nga zgjedhësi në rubrikën në krahu të emrave të subjekteve zgjedhore apo partive pjesëtare të një koalicioni. Eksperti kishte identifikuar 41 fletë votimi që përmbanin të shënuara më shumë se një shenjë të vendosur nga zgjedhësi

në rubrikën në krah të emrave të subjekteve zgjedhore apo partive pjesëtare të një koalicioni, ashtu sikundër edhe 187 fletë votimi që, sipas ekspertit, nuk përmbanin asnjë shenjë në rubrikën në krah të emrave të subjekteve zgjedhore apo partive pjesëtare të një koalicioni.

Sipas parashikimit të nenit 117/3 të Kodit Zgjedhor janë vota të pavlefshme edhe kur *“d) është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit; dh) nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit”*.

Nga krahasimi i të dhënave të pasqyruara në tabelat e numërimit për qendrat e votimit QV nr. 0524, QV nr. 0445, QV nr. 0465, QV nr. 0462, QV nr. 0454, QV nr. 0446, QV nr. 0441, QV nr. 0473, QV nr. 0504, QV nr. 0442, QV nr. 0455, QV nr. 0447, QV nr. 0443, QV nr. 0518, QV nr. 0444, të hartuara nga grupet e numërimit të këtyre qendrave, si dhe të dhënave të pasqyruara në tabelën përmbledhëse të rezultateve të KZAZ nr. 9 Qarku Kukës (pjesë e së cilës janë qendrat e votimit të sipërcituara), me të dhënat e pasqyruara në aktin e ekspertimit (të ekspertit Ardian Pollo), rezultonin diferenca në lidhje me numrin e votat e pavlefshme, ato të pasqyruara si vota të pavlefshme në dokumentacionin zgjedhor në raport me ato që sipas ligjit konsiderohen të tilla, diferencë e cila kalon dukshëm diferencën e ngushtë prej 15 votash midis dy koalicioneve sipas tabelës së rezultateve të votimit për Zonën Zgjedhore Qarku Kukës.

Në konsideratë të fakteve të sjella nga ekspertimi teknik i regjistrimit filmik të procesit të numërimit të fletëve të votimit në QV nr. 0524, QV nr. 0445, QV nr. 0465, QV nr. 0462, QV nr. 0454, QV nr. 0446, QV nr. 0441, QV nr. 0473, QV nr. 0504, QV nr. 0442, QV nr. 0455, QV nr. 0447, QV nr. 0443, QV nr. 0518, QV nr. 0444, të KZAZ-se nr. 9, Qarku Kukës, duke pasur parasysh të dhënat e tabelave të rezultateve të votimit në veçanti lidhur me numrin e fletëve të vlerësuara si vota të pavlefshme, Kolegji vlerësoi se në rastin konkret ekzistonin dyshime për parregullsi në procesin e numërimit dhe vlerësimit të votave të ndodhura në kutitë e këtyre qendrave të votimit dhe që mund të kishin ndikuar në rezultatin e votimit të Zonës Zgjedhore, Qarku Kukës, ç’ka, edhe në funksion të dhënies së një vendimi të drejtë për themelin e çështjes, nëpërmjet realizimit të një

procesi të rregullt ligjor, të paanshëm dhe të besueshëm, përligjte këqyrjen dhe, me tej, rinumërimin e rivlerësimin të fletëve të votimit të ndodhura në kutitë e qendrave të votimit nr. 0441, nr. 0442, nr. 0443, nr. 0444, nr. 0445, nr. 0446, nr. 0545, nr. 454, nr. 0455, nr. 0462, nr. 0465, nr. 0504, nr. 0473, nr. 0518 dhe nr. 0524, të KZAZ nr. 9, Qarku Kukës.

Në këtë rast, Kolegji vlerësoi se përpara tij paraqitej si provë një ekspertim teknik, provë që justifikonte këqyrjen e fletëve të votimit të ndodhura në kutitë e qendrave të votimit si më lart, përveçse dhe rinumërimin e rivlerësimin e votave në këto kuti, për sa kohë vihej në dyshim respektimi i kriterëve ligjore (neni 117 i Kodit Zgjedhor) në procesin e vlerësimit të këtyre votave sipas nenit 118 të Kodit Zgjedhor. Në lidhje me këtë, Kolegji gjen të drejtë prapësimin e palës së paditur dhe palës së interesuar për qenien rast përjashtimor rinumërimi dhe rivlerësimi i votave të caktuara, por se, ndryshe nga sa u pretendua prej tyre, rinumërimi dhe rivlerësimi i votave të caktuara mund të kryhet në çdo rast kur ekzistojnë dyshime të qenësishme për parregullsi dhe mosrespektim të ligjit në procesin e numërimit e vlerësimit të votave, dyshime këto të bazuara, jo vetëm mbi prova, siç janë dokumentimi në dokumentacionin zgjedhor të kontestimeve për vota të caktuara nga ana e numëruesve apo vëzhguesve të subjekteve zgjedhore të caktuara, por edhe mbi çdo provë tjetër të ligjshme dhe të vlefshme, prova këto që sjellin fakte dhe të dhëna në lidhje me rregullsinë dhe ligjshmërinë e këtij procesi. Për këtë mjafton të përmendet fakti se, referuar Kodit Zgjedhor (neneve 6 dhe 96), jo çdo parti politike pjesëmarrëse në një proces zgjedhor, ka të drejtën e propozimit të numëruesve apo vëzhguesve, ku nisur nga kjo, nëse do të pranohej interpretimi që pala e paditur dhe pala e interesuar, i bëjnë nenit 138/3 të Kodit Zgjedhor në lidhje me nenet 116 e 118 të këtij Kodi, do të ndodheshim para situatës kur e drejta e kërimit të rinumërimit dhe rivlerësimit të votave të caktuara, si pjesë e të drejtës së ankimit kundër vendimit të KQZ për miratimin e rezultatit të votimit në një zonë zgjedhore të caktuar, do të ishte efektive vetëm për një numër të kufizuar partish politike pjesëmarrëse në zgjedhje (vetëm për ato që gëzojnë të drejtën e propozimit të numëruesve dhe vëzhguesve dhe, akoma më tej, vetëm për ato, numëruesit apo vëzhguesit e të cilave, në respektim të përgjegjësisë së ngarkuar nga Kodi, do të ngrinin dhe kërkonin të dokumentohej çdo kontestim në lidhje

me procesin). Ndërkohë, në Kodin Zgjedhor, nuk parashikohet një kufizim i tillë i të drejtës së ankimit, përfshirë dhe të të drejtës së kërkimit të provës në funksion të saj, për asnjë nga partitë politike pjesëmarrëse në një proces zgjedhor, përkundrazi, në nenin 124 të tij, parashikohet e drejta e ankimit për çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni zgjedhor, ashtu sikundër edhe e kandidatit të mbështetur nga zgjedhësit, përfshirë edhe ankimin ndaj vendimeve të KQZ për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të një zone zgjedhore të caktuar. Nga ana tjetër, fakti që pala ankuese/pala paditëse në rastin konkret ka pasur dhe ushtruar të drejtën e propozimit të numëruesve dhe vëzhguesve në zgjedhjet për Kuvendin të datës 23 qershor 2013, nuk kufizon të drejtën e saj për të kërkuar rinumërimin dhe rivlerësimin e votave të caktuara në kuadër të ankimit të paraqitur kundër vendimit të KQZ për miratimin e rezultatit të votimit për një zonë zgjedhore të caktuar, vetëm për rastin kur nga numëruesit apo vëzhguesit ka pasur kontestime në lidhje me procesin e numërimit e të vlerësimit të votave, kontestime këto të dokumentuara në dokumentacionin zgjedhor, sipas neneve 116 dhe 118 të Kodit Zgjedhor. Nëse do të pranohej një gjë e tillë, atëherë do të vihej në diskutim parimi i barazisë së mundësive të palëve në një proces, që është pjesë e procesit të rregullt ligjor.

Referuar sa më lart, Kolegji vlerëson se Kodi Zgjedhor iu siguron palëve në një proces zgjedhor, çdo partie politike, pjesëtare ose jo të një koalicioni zgjedhor, ashtu sikundër edhe kandidatit të mbështetur nga zgjedhësit, të drejtën e ankimit kundër vendimit të KQZ për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të një zone zgjedhore të caktuar, në kuadër të së cilës përfshihet edhe e drejta për kërkimin e provës nëpërmjet këqyrjes, rinumërimit dhe/ose rivlerësimit të votave të caktuara, e drejtë kjo e fundit që mund të realizohet nëse ato paraqesin prova të ligjshme dhe të vlefshme, që vënë në dyshim rregullsinë dhe ligjshmërinë e procesit të numërimit dhe vlerësimit të këtyre votave.

Në lidhje me modalitetet e realizimit të procesit të rinumërimit dhe rivlerësimit të votave në 15 kutitë e qendrave të votimit si më lart, Kolegji, pasi mori paraprakisht mendimin e palëve pjesëmarrëse në gjykim, vendosi që ky proces të realizohej në ambientet e Gjykatës së Apelit Tiranë ku Kolegji ushtron funksionet e tij, duke u ndjekur dhe zbatuar sa të ishte e mundur të njëjtat rregulla, që Kodi Zgjedhor

parashikon në lidhje me procesin e numërimit e të vlerësimit të votave. Kështu, Kolegji urdhëroi sjelljen në ambientet e gjykatës nga KQZ-ja, të kutive përkatëse të votimit, të cilat, në një seancë publike, në prani të palëve pjesëmarrëse në gjykim, do të hapeshin, duke u këqyrrur dhe nënshtruar rinumërimit dhe rivlerësimit çdo flete votimi, që ndodhej në to, proces ky gjatë të cilit Kolegji do të asistojë nga disa grupe (4), në përbërje të të cilëve u caktuan 2 specialistë të KQZ, që do të kryenin detyrën e numëruesit, si dhe 2 persona të tjerë, të propozuar nga secila prej palëve/partive politike pjesëmarrëse në gjykim (LSI dhe PD), që tërhiqnin interesa të kundërta, të cilët do të kryenin detyrën e vëzhguesit.

Procesi i rinumërimit dhe rivlerësimit të votave të ndodhura në 15 kutitë e votimit të lartpërmendura u realizua më datë 27.07.2013. Gjatë këtij procesi, nga ana e Kolegjit u bë rivlerësimi aty për aty i çdo vote të kontestuar nga palët nëpërmjet vëzhguesve të tyre pjesëtarë të grupeve të rinumërimit, pasi iu mori më parë mendimin, edhe përfaqësuesve të palëve, në përputhje me parashikimet e neneve 117 dhe 118 të Kodit Zgjedhor.

Gjate këtij procesi, personi i propozuar nga PD në cilësinë e vëzhguesit, përpara se të procedohej me hapjen e kutive të qendrave të votimit nr. 0441 dhe nr. 0446, evidentoi faktin e mospërputhjes së kodeve të mbylljes së këtyre kutive, me kodet e mbylljes referuar tabelës së rezultatit të votimit për këto qendra votimi, të plotësuara nga grupet e numërimit të votave. Konkretisht, për kutinë e qendrës së votimit nr. 0441, nuk përputheshin 2 kode të mbylljes, ndërsa për kutinë e qendrës së votimit nr. 0446, nuk përputheshin 4 kode të mbylljes. Për këtë shkak, hapja e këtyre kutive të votimit u realizua në fund të procesit, pasi më parë Kolegji dëgjoi dhe pretendimet e palëve. Në këtë rast, Kolegji vlerësoi të pabazuar pretendimin e palës paditëse LSI për mos hapjen e këtyre kutive dhe për mos rinumërimin e rivlerësimin e votave të ndodhura në to, duke gjetur të drejtë pretendimin e paraqitur në këtë rast nga pala e interesuar PD se në rastin konkret kishte ndodhur një gabim njerëzor në dokumentimin e kodeve të mbylljes së këtyre kutive të votimit nga ana e grupeve të numërimit. Kështu, Kolegji konstatoi se kodet e mbylljes së këtyre kutive përputheshin me kodet e mbylljes të pasqyruara në procesverbalin e dorëzimit të këtyre kutive të votimit në KQZ, nga ana e përfaqësuesve të KZAZ nr. 9. Po kështu,

Kolegji konstatoi se në rastin e kutisë me fletë votimi të qendrës së votimit nr. 0446, kodet e mbylljes në fakt të saj ishin të njëjta me kodet që në procesverbalin e dorëzimit të kutive ishin shënuar si kode të mbylljes së kutisë së materialeve zgjedhore të kësaj qendre votimi, çka linte të kuptohej se nga ana e grupit të numërimit duhet të ishte bërë gabim njerëzor në pasqyrimin në tabelën përkatëse të kodeve të mbylljes së kutive të kësaj qendre votimi. Nga ana tjetër, Kolegji vlerësoi se nga hapja e kutive të votimit për këto 2 qendra votimi mund të rezultonin të dhëna të vlefshme në lidhje me këtë mospërputhje të kodeve të mbylljes së këtyre kutive, referuar faktit se, sipas Kodit Zgjedhor, brenda këtyre kutive duhet të ishin dhe procesverbalet e mbylljes së kutive të hartuara nga grupet e numërimit. Mbas hapjes së kutisë me fletë votimi të qendrës së votimit nr. 0446, ne të u gjet procesverbali i mbylljes së kësaj kutie i hartuar nga grupi i numërimit, sipas të cilit kodet e mbylljes së kësaj kutie përputheshin me kodet e mbylljes në fakt. Ndërkohë, mbas hapjes së kutisë me fletë votimi të qendrës së votimit nr. 0441, në të nuk u gjet procesverbali i mbylljes së kësaj kutie hartuar nga grupi i numërimit. Por, megjithatë, Kolegji vendosi që në të dy rastet të vijonte procesi i rinumërimit dhe rivlerësimit të votave të ndodhura në këto dy kuti, për të vlerësuar më tej, në rastin e kutisë së qendrës së votimit nr. 0441, të dhënat që do të rezultonin nga ky proces me ato që kishin rezultuar dhe pasqyruar në tabelën përkatëse të rezultateve të votimit për këtë qendër, ku në përfundim u konstatua përputhje e numrit të fletëve të gjetura në kuti, e numrit të fletëve të përdorura, ashtu sikundër edhe e numrit të fletëve të papërdorura apo dhe atyre të dëmtuara.

Në përfundim të procesit të rinumërimit dhe rivlerësimit të votave rezultuan këto të dhëna për secilën qendër votimi :

1	QV-nr 0441	QV-nr 0442	QV-nr 0443	QV-nr 0444	QV-nr 0445	QV-nr 0446	QV-nr 0447	QV-nr 0454	QV-nr 0455	QV-nr 0462	QV-nr 0465	QV-nr 0473	QV-nr 0504	QV-nr 0518	QV-nr 0524	TOTALI
2	390	587	447	556	621	433	298	259	331	241	220	220	298	406	241	5548
3	234	314	303	404	335	397	274	151	277	155	139	133	207	200	218	3741
4	1	3	1	1	0	3	0	0	2	1	3	5	4	2	6	32
5	390	587	447	558	621	433	298	259	331	241	220	220	298	406	241	5550
6	4	4	2	5	8	4	3	2	4	4	3	3	5	2	4	57
7	386	583	445	553	613	429	295	257	327	237	217	217	293	404	237	5493
	SHPERNDARJA E VOTAVE TE VLEFSHME															
Nr.	QV-nr 0441	QV-nr 0442	QV-nr 0443	QV-nr 0444	QV-nr 0445	QV-nr 0446	QV-nr 0447	QV-nr 0454	QV-nr 0455	QV-nr 0462	QV-nr 0465	QV-nr 0473	QV-nr 0504	QV-nr 0518	QV-nr 0524	
1	3	2	0	0	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	20
2	1	0	0	0	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	3
3	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	2
5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	1
6	4	3	0	6	1	2	2	7	1	0	0	0	3	4	0	33
7	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
8	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
9	1	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	2
10	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
11	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
12	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
13	0	2	1	0	1	0	0	0	0	0	0	1	1	0	0	6
14	0	1	3	2	5	2	2	1	0	0	0	0	0	0	0	16
15	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
16	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
17	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1

44	Partia Demokratike	194	332	230	311	333	265	180	106	223	177	177	138	129	219	169	3183
45	Partia Republikane Shqiptare	21	63	53	49	57	16	22	52	13	17	17	4	101	97	14	585
46	Partia Minoriteti Ethnik Grek për të Ardhmen	0	1	0	0	1	1	1	1	0	0	0	0	0	0	0	5
47	Partia e të Drejtave të Mohuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
48	Partia Ora e Shqipërisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1
49	Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0	0	0	0	2	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
50	Partia Drejtësi, Integritim dhe Unitet	7	11	20	24	46	27	4	14	8	2	0	2	6	7	2	180
51	Balli Kombëtar Demokrat	0	0	0	0	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
52	Parti e të Drejtave të Mohuara e Re	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
53	Partia Lëvizja e Legalitetit	4	4	5	1	12	1	6	5	1	0	0	1	1	0	0	41
54	Partia Demokratiane e Shqipërisë	2	0	1	3	2	3	1	0	0	0	0	0	0	0	0	12
55	Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare	0	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
56	Partia Lëvizja Shqipëria e Re	1	3	0	2	1	2	0	0	1	0	0	0	0	0	3	13
57	Partia Balli Kombëtar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
58	Bashkimi Liberal Demokrat	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
59	Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
60	Partia Konservatore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
61	Partia Lidhja Demokratiane Shqiptare	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
62	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	0	0	0	5	1	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	8
63	Aleanca e Maqedonasve për Integritimin Europian	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
64	Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
65	Aleanca Kuq e Zi	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
66	Fryma e Re Demokratike	6	3	0	2	5	10	1	1	0	0	0	0	0	0	0	28
	Gjithsej vota te vlefshme	386	583	445	553	613	429	295	257	327	237	217	217	293	404	237	5493

Pas përfundimit të procesit të rinumërimit dhe rivlerësimit të votave në kutitë me fletë votimi objekt gjykimi, në parashtrimet përfundimtare, pala paditëse kërkoi pranimin tërësisht të padisë, ku në lidhje me kërkimin për ndryshimin e Vendimit të KQZ-së nr. 666, datë 03.07.2013, nga ana e saj u kërkua që ky vendim të ndryshohej në përputhje me rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave të ndodhura në 13 kutitë objekt gjykimi, duke mos u përfshirë në rezultatin përfundimtar të votimit të zonës zgjedhore, Qarku Kukës rezultati i dy qendrave të votimit (nr. 0441 dhe nr. 0446), për të cilat më parë, gjatë gjykimit, ishte kërkuar mos hapja e kutive me fletët e votimit të këtyre qendrave.

Nga ana tjetër, pala e paditur dhe pala e interesuar kërkuan që Kolegji të dispononte për ndryshimin e Vendimit të KQZ-se nr. 666, datë 03.07.2013, duke marrë në konsideratë të dhënat e rezultuara nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave të ndodhura në 15 kutitë objekt gjykimi, duke kundërshtuar në këtë rast si të pabazuar në ligj dhe në fakt pretendimin e palës paditëse për mospërfshirjen në rezultatin përfundimtar të votimit të zonës zgjedhore Qarku Kukës të rezultatit të dy qendrave të votimit nr. 0441 dhe nr. 0446, mbi argumentet se rezultati i votimit për një qendër votimi të caktuar nuk përfshihej në rezultatin përfundimtar të votimit të zonës përkatëse zgjedhore vetëm nëse zgjedhjet në atë qendër votimi deklaroheshin të pavlefshme sipas nenit 160 të Kodit Zgjedhor, çka nuk kishte ndodhur dhe as pretendohej në rastin konkret, sepse nuk ekzistonin indicje të mjaftueshme për cenimin e integritetit të këtyre kutive të votimit për sa kohë nuk rezultoi që këto dy kuti të ishin identifikuar si kuti të “pa rregullta”, që të mund të përjashtoheshin nga procesi i rinumërimit dhe rivlerësimit (sipas parashikimeve të nenit 115 të Kodit Zgjedhor), për më tepër kur të dhënat e përftuara gjatë procesit të rinumërimit dhe rivlerësimit ishin gati në përputhje të plotë me të dhënat e dala gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave të gjendura në kutitë e këtyre dy qendrave të votimit, me përjashtim të tre votave të vlerësuara si të pavlefshme dhe të rivlerësuara nga Kolegji si vota të vlefshme.

Në përfundim, Kolegji vlerëson se, në konsideratë të të dhënave të rezultuara nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave në kutitë me fletë votimi të 15 qendrave të votimit objekt gjykimi të KZAZ nr. 9, Qarku Kukës, ka vend për ndryshimin e Vendimit të KQZ-së nr. 666, datë 03.07.2013, “Për miratimin e tabelës

përmbledhëse të rezultatit të votimit për Zonën Zgjedhore, Qarku Kukës, për zgjedhjet për Kuvendin, 23 qershor 2013”, në përputhje me këto të dhëna të rezultuara gjatë gjykimi. Lidhur me këtë, Kolegji vlerëson të pabazuar në ligj dhe fakt pretendimin e palës paditëse për mospërfshirjen në rezultatit përfundimtar të votimit të kësaj zone zgjedhore të rezultatit të votimit në qendrat e votimit nr. 0441 dhe nr. 0446, duke gjetur të drejta pretendimet e parashtruara në këtë drejtim nga ana e palës së paditur dhe palës së interesuar.

Në lidhje me disponimin përfundimtar, Kolegji vlerëson se rezultatet e përfuara nga procesi i rinumërimit dhe i rivlerësimit të votave në këto qendra votimi do të referohen në tabelën përmbledhëse të rezultatit për Zonën Zgjedhore, Qarku Kukës, të miratuar nga KQZ me Vendimin nr. 666, datë 03.07.2013, tabelë e cila do të jetë pjesë përbërëse e vendimit të Kolegjit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë,
bazuar në nenin 158/3 të Kodit Zgjedhor,

VENDOSI

Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 740, datë 15.07.2013 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 21 të subjektit zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim”.

Ndryshimin e vendimit nr. 666, datë 03.07.2013 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ka miratuar tabelën përmbledhëse të rezultateve për zonën zgjedhore, Qarku Kukës, sipas tabelës pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Tiranë, më 27.07.2013.

ANËTAR
GJONOVEFA GABA

ANËTAR
EDLIRA PETRI

KRYESUES
VALBON ÇEKREZI

ANËTAR
ILIR TOSKA

ANËTAR
ANDI CIVICI

* * *



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR

NR. 24 REGJ. THEMELTAR
DATË 26.07.2013 REGJ.

Nr. 24 VENDIMI
DATË 31.07.2013 VENDIMI

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykeses se Apelit Tirane i perbere nga gjyqtaret :

KRYESUES :	PETRIT ÇENO
ANETAR :	FUAT VJERDHA
ANETAR :	GJINOVEFA GABA
ANETAR :	ILIR TOSKA
ANETAR :	ANDI CIVICI

asistuar nga sekretarja Rexhina Baçi, ne seancen gjyqesore te dates 31.07.2013, mori ne shqyrtim ceshtjen civile qe u perket paleve :

PADITESE : **Partia Demokratike e Shqiperise,**
me Seli ne Tirane, Rruga “Xhorxh W. Bush”, Nr.291,
perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Ivi Kaso dhe
Oerd Bylykbashi.

I PADITUR : **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,** me Seli ne Tirane,
Bulevardi “Deshmoret e Kombit”, Pallati i Kongreseve,
perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Deshira Pasko.

PALE E INTERESUAR : **Partia Socialiste e Shqiperise,**
me Seli ne Tirane, Sheshi “Austria”.

OBJEKTI : - Kostatimin e përfundimit te afatit ligjor per shqyrtimin
e ankimit te subjektit Partia Demokratike e Shqiperise

me objekt “Kundershtimi i vendimit te KQZ nr.701 date 10.07.2013 “Per nxjerrjen e rezultatit te votimit per zonen zgjedhore Qarku Lezhe, per zgjedhjet per Kuvendin 2013”.

- Rinumerim dhe rivlerësim i votave te QV nr.07051, nr.0708, nr.070801, nr.0725, nr.0762, nr.0763, nr.0764, nr.0765, nr.0769 dhe nr.0770, te KZAZ nr.13, te Zones Zgjedhore Qarku Lezhe.
- Ndryshimin e vendimit te KQZ nr.701 date 10.07.2013 “Per nxjerrjen e rezultatit te votimit per zonen zgjedhore Qarku Lezhe, per zgjedhjet per Kuvendin 2013”, duke perfshire ne te rezultatin e dale nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave si me siper. Gjykimin ne themel te ceshtjes, duke vendosur pranimin e kerkeses.
- Rinumerimi dhe rivlerësimi i votave per te gjitha QV e KZAZ nr.12, nr.13, nr.14 dhe nr.15, te zones zgjedhore Qarku Lezhe.
- Ndryshimin e vendimit te KQZ nr.701 date 10.07.2013 “Per nxjerrjen e rezultatit te votimit per zonen zgjedhore Qarku Lezhe, per zgjedhjet per Kuvendin 2013”, duke perfshire ne te :
- Rezultatin e sakte te secilës qender votimi te dale nga këqyrja e kutive te votimit ne KQZ.
- Rezultatin e dale nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave per QV nr.07051, nr.0708, nr.070801, nr.0725, nr.0762, nr.0763, nr.0764, nr.0765, nr.0769 dhe nr.0770, te KZAZ nr.13 dhe te 248 QV te tjera te zones zgjedhore Qarku Lezhe, nga ana e Kolegjit Zgjedhor.

BAZA LIGJORE: Nenet 24, 116, 117, 118, 119, 120, 122, 123, 136, 138, 143, 144, 145, 152, 153, 155, 156, 158 e vijues te Kodit Zgjedhor.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATES SE APELIT TIRANE

Pasi degjoi perfaqesuesit e pales paditese, qe kërkuan pranimin e plote te padise; degjoi perfaqesuesen e pales se paditur, qe u shpreh se e linte ceshtjen ne cmim te gjykates; ne mungese te pales se interesuar, njoftuar rregullisht me akt njoftimi; si dhe pasi shqyrtoi ceshtjen ne teresi,

VEREN

Pas përfundimit te procesit te votimit per zgjedhjet per Kuvendin, 23 qershor 2013, si dhe përfundimit te procesit te numërimit dhe vlerësimit te votave nga grupet e numërimit te KZAZ Nr.12, Nr.13, Nr.14 dhe Nr.15, te zones zgjedhore Qarku Lezhe dhe hartimin e dergimin e tabelave te rezultatit te votimit per keto zona te administrimit zgjedhor, pervec se edhe tabelat e qendrave perkatese te votimit te kësaj zone zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (me poshte referuar si KQZ), bazuar ne nenet 21/7, 23/1/a dhe 123 te Kodit Zgjedhor, ka miratuar Vendimin Nr.701, date 10.07.2013, "Per nxjerrjen e rezultatit te votimit per zonen zgjedhore Qarku Lezhe, per zgjedhjet per Kuvendin 2013".

Ne kete rast, gjatë hartimit të Tabelës Përmbledhëse të rezultatit për Zonën Zgjedhore Qarku Lezhe, ne kuadër te përmbushjes se detyrimit te percaktuar ne nenin 123/3 te Kodit Zgjedhor, per verifikimin e përputhjes së shifrave të votave për subjektet të tabelës së rezultatit të ZAZ-ve perkatese me tabelat e rezultateve të qendrave të votimit te kësaj zone zgjedhore, KQZ ka konstatuar se prane saj KZAZ Nr.13 nuk kishte dorëzuar kopjet origjinale te tabelave te rezultatit te votimit per qendrat e votimit nr.07051, nr.0708, nr.070801, nr.0725, nr.0762, nr.0763, nr.0764, nr.0765, nr.0769 dhe nr.0770, por fotokopje te tyre, qe kishin vulen e kësaj KZAZ.

Ne fotokopjen e tabelave te rezultatit te votimit per qendrat e votimit si me lart te KZAZ nr.13, zona zgjedhore Qarku Lezhe, KQZ ka konstatuar se fotokopjet e ketyre tabelave ishin realizuar pasi me pare ne tabelat origjinale ishin bere ndërhyrje, fshirje dhe korrigjim te shifrave, c'ka, sipas KQZ, dukeshin me sy te lire, nderkohe qe

rezultati sipas fotokopjeve te ketyre tabelave nuk përputhej me rezultatin e ketyre qendrave te votimit te hedhura nga operatori i KZAZ nr.13 ne bazen elektronike te te dhenave te KQZ, ne përmbushje te detyrimit te percaktuar ne nenin 119/2§2 te Kodit Zgjedhor dhe Udhezimit te KQZ Nr.17, date 22.05.2009, ku sipas ketyre rregullimeve ligjore rezultatet e hedhura ne forme elektronike per keto qendra votimi jane verifikuar dhe konfirmuar paraprakisht nga grupi perkates i numërimit dhe sekretari i kësaj KZAZ.

Ne nje situate te tille, KQZ ka kërkuar nga subjektet zgjedhore te paraqisnin kopjet e tyre kimike te tabelave origjinale te rezultatit te votimit per qendrat e votimit nr.07051, nr.0708, nr.070801, nr.0725, nr.0762, nr.0763, nr.0764, nr.0765, nr.0769 dhe nr.0770, te KZAZ nr.13, zona zgjedhore Qarku Lezhe, por, ne përgjigje te kësaj kerkese, vetem nga subjekti Partia Demokratike, eshte paraqitur nga nje kopje e tabelave origjinale vetem per 4 qendra votimi. Ne kushtet kur per keto 4 qendra votimi nuk jane paraqitur nga subjektet e tjera zgjedhore kopjet e tjera origjinale te tabelave te rezultatit te votimit, KQZ ka vendosur te mos administroje keto kopje tabelash duke konsideruar se ato nuk mund te kishin vleren e tabelave origjinale te rezultatit te votimit per keto qendra votimi.

Ne vijim, ne rrethanat kur nga KZAZ nr.13 nuk ishin depozituar ne KQZ tabelat origjinale te rezultatit te votimit per qendrat e votimit nr.07051, nr.0708, nr.070801, nr.0725, nr.0762, nr.0763, nr.0764, nr.0765, nr.0769 dhe nr.0770, por vetem fotokopje te tyre me parregullsitate e vërejtura me lart, KQZ, ne funksion te nxjerrjes se rezultatit te votimit per zonen zgjedhore Qarku Lezhe, lidhur me keto 10 qendra votimi, ka vendosur te konsideroje rezultatin e votimit te hedhur ne bazen e saj elektronike, duke konsideruar se, referuar procedurave te parashikuara nga neni 119/2§2 i Kodit Zgjedhor dhe Udhezimi i saj Nr.17, date 22.05.2009, ky rezultat ishte rezultati origjinal i votimit per keto qendra votimi.

Pas miratimit si me lart nga KQZ te Vendimit Nr.701, date 10.07.2013, bazuar ne nenin 124/3 te Kodit Zgjedhor, rezulton qe, me date 15.07.2013, përpara KQZ, te kete paraqitur ankim Partia Demokratike (me poshte referuar si PD), ankim me te cilin ka kundërshtuar kete vendim te KQZ, duke kërkuar :

rinumërimin dhe rivlerësimin e votave të qendrave të votimit nr.07051, nr.0708, nr.070801, nr.0725, nr.0762, nr.0763, nr.0764, nr.0765, nr.0769 dhe nr.0770, të KZAZ nr.13, të Zonës Zgjedhore Qarku Lezhe;

rinumërimin dhe rivlerësimin e votave të qendrave të votimit nr.0754, nr.0759, nr.0760, nr.0761, nr.0764, nr.0765 dhe nr.0769, të KZAZ nr.13, të Zonës Zgjedhore Qarku Lezhe;

ndryshimin e Vendimit Nr.701 datë 10.07.2013, të KQZ, "Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zonën zgjedhore Qarku Lezhe, për zgjedhjet për Kuvendin 2013", duke përfshirë në të, rezultatit të dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave.

Ne kërkesën e saj ankimore, PD ka pretenduar se përmbajtja e tabelave të rezultatit të votimit për 14 qendrat e votimit objekt ankese nuk pasqyrojnë në mënyrë të saktë numrin e votave të marra nga çdo subjekt zgjedhor në këto qendra votimi, ndërkohë që procesi i numërimit dhe vlerësimit të votave të këtyre qendrave të votimit ishte zhvilluar në shkallë të nënve 116-119 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë deformimin e rezultatit zgjedhor në këto qendra votimi dhe shtrembëruar në këto mënyra vullnetin e zgjedhësve.

Po kështu, në kërkesën e saj ankimore, PD ka parashtruar se, nisur nga konstatimet e arritura nga KQZ në rastin e miratimit të Vendimit Nr.701, datë 10.07.2013, në lidhje me tabelat e rezultateve për qendrat e votimit nr.07051, nr.0708, nr.070801, nr.0725, nr.0762, nr.0763, nr.0764, nr.0765, nr.0769 dhe nr.0770, të KZAZ nr.13, të zonës zgjedhore Qarku Lezhe, nga të cilat provohej manipulimi i tabelave të nxjerra nga grupet e numërimit për këto qendra votimi, me qëllim që rezultati i këtyre qendrave të votimit të pasqyrojë në mënyrë besnike vullnetin e zgjedhësve, kërkohet rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për këto qendra votimi, duke u përfshirë me pas rezultati i rinumërimit dhe rivlerësimit në rezultatit përfundimtar të zonës zgjedhore Qarku Lezhe.

Me tej, në kërkesën e saj ankimore, PD ka pretenduar se procesi i numërimit dhe pasqyrimin të votave për 3 qendrat e votimit si më lart (nr.0764, nr.0765 dhe nr.0769), por edhe për qendrat e votimit nr.0754, nr.0759, nr.0760 dhe nr.0761, të KZAZ nr.13, zona

zgjedhore Qarku Lezhe, eshte shoqeruar me tensione, konflikte midis numëruesve dhe parregullsi te llojeve te ndryshme, te cilat kane sjelle si pasoje pasqyrimin e nje numri shume me te vogel votash te subjektit PD ne tabelat e rezultatit te votimit te ketyre qendrave te votimit, ku ne keto kushte, me qellim qe rezultati i ketyre qendrave te votimit te pasqyronte ne menyre besnike vullnetin e zgjedhesve, kërkohej rinumërimi dhe rivlerësimi i votave per keto qendra votimi, duke u perfshire me pas rezultati i rinumërimit dhe rivlerësimit ne rezultatin përfundimtar te zones zgjedhore Qarku Lezhe.

Nderkohe, pas miratimit nga KQZ te Vendimit Nr.701, date 10.07.2013, del se, me date 15.07.2013, përpara KQZ, bazuar ne nenin 124/2 te Kodit Zgjedhor, te kete paraqitur ankim Partia Socialiste (me poshte referuar si PS), me te cilin ka kundërshtuar kete vendim te KQZ, ka kundërshtuar gjithashtu edhe Vendimin e KZAZ Nr.15, zona zgjedhore Qarku Lezhe "Per miratimin e tabelës permbledhese te rezultatit te votimit", duke kërkuar shpalljen e pavlefshme te zgjedhjeve ne qendrat e votimit nr.0907, nr.0910/1, nr.0856, nr.0856/1, nr.0857 dhe nr.0857/1, te KZAZ nr.15, si dhe ne te gjithe zonen zgjedhore Qarku Lezhe.

Me vendimet Nr.739, date 15.07.2013 dhe Nr.744, date 15.07.2013, KQZ (4 anetare te saj), bazuar ne nenin 129/3 te Kodit Zgjedhor, ka vendosur kalimin per shqyrtim te dy kërkesave ankimore si me lart te PD dhe te PS, duke i bashkuar ato ne nje shqyrtim te vetem, shqyrtim te cilin e ka filluar me date 16.07.2013.

Gjate shqyrtimit administrativ te kërkesave ankimore si me lart, KQZ (4 anetare te saj) ka vendosur te pranoje kerkesen e PD per rinumerimin dhe rivlerësimin e votave per 10 qendrat e votimit te KZAZ nr.13, per te cilat ne KQZ nuk ishte depozituar tabela origjinale e rezultatit te votimit dhe, pas kësaj, KQZ (4 anetare te saj) kane vendosur rinumërimin dhe rivlerësimin e votave edhe per 248 qendrat e tjera te votimit te zones zgjedhore Qarku Lezhe.

Ndersa zhvillohej ky proces, me date 20.07.2013, PS ka depozituar përpara Kolegjit Zgjedhor nje ankim/kerkesepadi, me te cilen, duke paditur KQZ, si dhe thirrur si pale te interesuara PD dhe LSI, ka kërkuar konstatimin e pavlefshmerise absolute te Vendimeve të KQZ Nr.739, date 15.07.2013 dhe Nr.744, date 15.07.2013, si

dhe konstatimin si absolutisht te pavlefshme te procesit te hetimit administrativ qe lidhet me shqyrtimin ne thelb te kerkesave ankimore te PD dhe PS, me pasoje nderprerjen e te gjitha veprimeve qe po kryen KQZ.

Mbi kete ankim/kerkesepadi, Kolegji Zgjedhor, me Vendimin Nr.17, date 22.07.2013, ka vendosur “1. Pranimin e padisë. 2. Konstatimin e pavlefshmerise absolute te Vendimit të KQZ-së Nr.744 datë 15.07.2013 “Per pranimin per shqyrtim te kerkeses ankimore Nr.41 date 15.07.2013 te subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqiperise”. 3. Konstatimin e pavlefshmerise absolute te Vendimit të KQZ-së Nr.739 datë 15.07.2013 te subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqiperise. 4. Konstatimin absolutisht te pavlefshme te procesit te hetimit administrativ qe lidhet me shqyrtimin ne thelb te kerkesave ankimore te mesiperme”.

Ne vendimin si me lart, Kolegji Zgjedhor, nder te tjera, ka konkluduar se :

“Nga sa me lart, ne kushtet kur mbledhja e KQZ e dates 15.07.2013 ka patur per objekt shqyrtimi kërkesa ankimore qe kerkojne vendimmarrje sipas nenit 24/1, germat “b” dhe “c”, te Kodit Zgjedhor, ne perputhje me nenin 22/5 te Kodit Zgjedhor, ajo duhet te zhvillohej ne prani te jo me pak se 5 anetareve, qe perben dhe kuorumin e nevojshem per vlefshmerine e mbledhjes. Mungesa e këtij kuorumi per vlefshmerine e mbledhjes se KQZ passjell pavlefshmerine e saj dhe, per rrjedhoje, pavlefshmerine absolute te vendimeve te marra nga KQZ ne kete mbledhje, pikërisht te vendimeve objekt gjykimi Nr. 739 dhe Nr. 744 datë 15.07.2013”;

“Kolegji Zgjedhor cmon se ne rastin konkret pavlefshmeria e vendimeve objekt padie nuk lidhet me numrin e nevojshem te votave per marrjen e tyre (shumicen e votave), por me mungesen e numrit te nevojshem te anetareve te pranishem (kuorumin) per zhvillimin e mbledhjes, mungese kuorumi kjo qe ben te pavlefshme mbledhjen ne kushtet kur 4 anetareve te pranishem ne rastin konkret ligji nuk iu ka dhene autorizim per te vepruar ne emer te organit, pra per te marre vendime ne emer te te gjithë anetareve”;

“Ne referim te nenit 117/1 te Kodit te Procedures Administrative, sipas te cilit: “Aktet administrative absolutisht te pavlefshme nuk prodhojne pasoja ligjore pavaresisht nga fakti nese jane deklaruar apo jo si te tille”, Kolegji Zgjedhor cmon se pasojat e prodhuara nga vendimet e mesiperme, pikërisht shqyrtimi ne themel i kërkesave ankimore (këqyrja, rinumërimi dhe rivlerësimi i votave, etj) do te konsiderohen nul, pasi, pervec kësaj, edhe shqyrtimi administrativ ne themel te kërkesave ankimore ka vijuar te kryhet ne mungese te kuorumit te nevojshem ligjor per vlefshmerine e mbledhjes se KQZ, referuar nenit 22/5 te Kodit Zgjedhor”.

Pas kësaj, me date 26.07.2013, përpara Kolegjit Zgjedhor eshte paraqitur nje ankim/kerkesepadi nga PS, me te cilen kërkonte shpalljen e pavlefshme te zgjedhjeve ne 6 qendrat e votimit si me lart, si dhe ne te gjithë zonen zgjedhore Qarku Lezhë.

Mbi kete ankimin/kerkesepadi, Kolegji Zgjedhor, me Vendimin Nr.23, date 31.07.2013, ka vendosur pushimin e gjykimit te ceshtjes, per shkak te heqjes dore nga ankimi/kerkesepadia prej pales paditese PS.

Nga ana tjeter, me date 26.07.2013, përpara Kolegjit Zgjedhor eshte paraqitur ankimi/kerkesepadia objekt i këtij shqyrtimi nga PD, me te cilen eshte kërkuar sic eshte përshkruar ne pjesen hyrëse te këtij vendimi.

Shqyrtimi nga Kolegji Zgjedhor i ankimit/kerkesepadise te paraqitur nga PD u zhvillua me date 31.07.2013, pasi njoftoi rregullisht dhe ftoi te marrin pjese ne gjykim te gjitha palet, ku pavarësisht kësaj, pala e interesuar PS nuk u paraqit, duke u zhvilluar gjykimi ne mungese te saj.

Ne kerkesepadine e paraqitur, pala paditese PD ka pretenduar se kunder Vendimit te KQZ Nr.701, date 10.07.2013 kishte paraqitur ankim përpara KQZ me date 15.07.2013, nderkohe qe afati per marrjen e nje vendimi përfundimtar nga KQZ ne lidhje me kete ankim, sipas nenit 143/3/4 te Kodit Zgjedhor, ka qene 10 dite nga regjistrimi i saj, ku ne keto kushte, Kolegji Zgjedhor duhet te

konstatoje përfundimin e këtij afati, si dhe, për shkak të mungesës së kuorumit prej 5 anetaresh të KQZ, c'ka do të mundësonte vlefshmerinë e mbledhjes së shqyrtimit administrativ nga KQZ të kësaj çeshtje, Kolegji Zgjedhor të gjykonte çeshtjen në themel.

Po kështu, në kërkesepadine e paraqitur, në lidhje me rezultatin e votimit të 14 qendrave të votimit, ato nr.07051, nr.0708, nr.070801, nr.0725, nr.0762, nr.0763, nr.0764, nr.0765, nr.0769 dhe nr.0770, ashtu si dhe të qendrave të votimit nr.0754, nr.0759, nr.0760 dhe nr.0761, të KZAZ nr.13, zona zgjedhore Qarku Lezhe, pala paditese PD ka parashtruar të njëjtat pretendime dhe kërkesa si dhe në kërkesën ankimore të paraqitur përpara KQZ me datë 15.07.2013, parashtruar me lart.

Me tej, në kërkesepadine e paraqitur, pala paditese PD ka parashtruar se mbi kërkesën e saj ankimore të datës 15.07.2013, KQZ, në një proces publik, në prani të përfaqësuesve të subjekteve politike, vëzhguesve të tyre, si dhe vëzhguesve vendas dhe nderkombetare, ka kryer këqyrjen dhe, me tej, rinumërimin dhe rivlerësimin e votave, fillimisht sipas kërkesës së saj të 10 qendrave të votimit dhe, më pas, edhe të të gjithë qendrave të tjera të votimit (248), të zonës zgjedhore Qarku Lezhe, proces, rezultati i të cilit është dokumentuar rregullisht në tabelat perkatese të rezultatit për çdo qendër votimi të kësaj zone, duke nxjerre në dritë parregullsi dhe manipulime përse i perket pasqyrimin të rezultatit të votimit në tabelat perkatese të plotësuar nga grupet e numërimit, pikërisht zhvendosje të votave gjatë procesit të tabulimit në disfavor të saj dhe në favor të subjektit politik PS.

Në vijim, në kërkesepadine e paraqitur, pala paditese PD ka kërkuar nga Kolegji Zgjedhor që:

tabelat e rezultateve të votimit të prodhuara nga KQZ në kuadër të rinumërimit dhe rivlerësimit të votave për të gjitha qendrat e votimit të zonës zgjedhore Qarku Lezhe, për vetë transparencën dhe moskontestimin e përmbajtjes së tyre, t'i konsideronte si prova të plota dhe, mbi bazën e tyre, të ndryshonte vendimin e KQZ Nr.701, datë 10.07.2013, duke i përfshirë ato drejtperdrejtë në rezultatin e zonës zgjedhore Qarku Lezhe;

ose

nese tabelat e prodhuara nga KQZ do te vlerësoheshin se nuk perbenin prove ne kuptimin e plote te ligjit, t'i vlerësonte ato si indicie, ose fillim prove, per te kryer rinumërimin dhe rivlerësimin e votave per 258 qendrat e votimit te zones zgjedhore Qarku Lezhe, rezultatin e te cilit me pas ta përfshinte ne rezultatin e votimit te kësaj zone zgjedhore, duke ndryshur keshtu vendimin e KQZ Nr.701, date 10.07.2013.

Ne lidhje me kerkesepadine e paraqitur, perfaqesuesja e pales se paditur KQZ beri nje prezantim te rastit dhe procesit te realizuar nga KQZ, duke depozituar dhe praktiken dokumentare perkatese, ku ne lidhje me zgjidhjen e ceshtjes ne themel u shpreh dakord per pranimin e kerkesepadise dhe ndryshimin e vendimit te KQZ Nr.701, date 10.07.2013.

Ne konsiderate te sa me lart, Kolegji Zgjedhor vlerëson se ne rastin konkret ka detyrimin ligjor qe, bazuar ne nenin 158, pika 1/b dhe 3, te Kodit Zgjedhor, te gjykoje ceshtjen ne themel, persa kohe nuk jemi përpara rastit te pushimit te gjykimit (referuar nenit 158, pika 1/a dhe 2, te Kodit Zgjedhor) dhe as përpara rastit te detyrimit te KQZ per te marre vendim (referuar nenit 158, pika 1/c dhe 4, te Kodit Zgjedhor) përderisa, per mungese te kuorumit (pranine e jo me pak se 5 anetareve) te kërkuar nga ligji (neni 22/5 ne lidhje me nenin 24/1/b, te Kodit Zgjedhor), KQZ eshte ne pamundësi te shqyrtimit dhe marrjes se nje vendimi ne lidhje me ankimin e paraqitur nga PD kunder vendimit per miratimin e tabelës permbledhese te rezultatit te votimit per zonen zgjedhore Qarku Lezhe.

Ne lidhje me themelin e ceshtjes, pra persa i perket bazueshmerise faktike dhe ligjore te vendimit te KQZ Nr.701, date 10.07.2013, Kolegji Zgjedhor vlerëson se kerkesepadia e paraqitur nga PD duhet te pranohet pjesërisht.

Konkretisht, Kolegji Zgjedhor vlerëson se vendimi i KQZ Nr.701, date 10.07.2013, duhet te ndryshohet, duke u perfshire ne tabelen permbledhese te rezultatit te votimit te zones zgjedhore Qarku Lezhe rezultatet e dala nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave i realizuar

gjate gjykimit per 10 qendra votimi, pikërisht per ato nr.07051, nr.0708, nr.070801, nr.0725, nr.0762, nr.0763, nr.0764, nr.0765, nr.0769 dhe nr.0770, te KZAZ nr.13, te kësaj zone zgjedhore.

Ne lidhje me kete, Kolegji Zgjedhor mban ne konsiderate ankimin fillestar te paraqitur nga pala paditese PD përpara KQZ kunder vendimit Nr.701, date 10.03.2013, per miratimin e tabelës permbledhese te rezultatit te votimit te zones zgjedhore Qarku Lezhe, duke vlerësuar se obligimi ligjor, fillimisht i KQZ dhe, me tej, i Kolegjit Zgjedhor (ne rast te nje vendimi jo te favorshem te KQZ), lidhet pikërisht me trajtimin dhe zgjidhjen e kësaj ankese.

Po keshtu, Kolegji Zgjedhor mban ne konsiderate se, referuar vendimit te tij Nr.17, date 22.07.2013, procesi i shqyrtimit administrativ nga KQZ i kerkeses ankimore te paraqitur nga PD kunder vendimit te saj Nr.701, date 10.07.2013, eshte konstatuar absolutisht i pavlefshem, pra nje proces jo i rregullt ligjor, ku per pasoje cdo akt i prodhuar gjate nje procesi te tille nuk mund te kete asnjë efekt ligjor ne raport me objektin e këtij gjykimi, pra ne lidhje me bazueshmerine faktike dhe ligjore te vendimit te KQZ Nr.701, date 10.07.2013. Nisur nga kjo, tabelat e rezultateve te votimit te prodhuara nga KQZ, ndryshe nga sa pretendon pala paditese, nuk mund te perbejne prova ne kuptim te ligjit per te vërtetuar rezultatin e votimit ne zonen zgjedhore Qarku Lezhe, pra per te vene ne diskutim bazueshmerine faktike dhe ligjore te vendimit te KQZ Nr.701, date 10.07.2013 dhe disponuar per ndryshimin e tij mbi bazen e ketyre tabelave. Po keshtu, keto tabela te prodhuara nga KQZ nuk mund te sherbejne as si prova ne kuptim te ligjit, Kodit Zgjedhor, per te vërtetuar ekzistencen e indiceve per parregullsi ne procesin e numërimit e te vlerësimit te votave per qendrat e votimit te kësaj zone zgjedhore ne funksion te kerkeses per marrje te provave, këqyrjen, rinumërimin dhe rivlerësimin e votave te ketyre qendrave te votimit sipas nenit 138 te Kodit Zgjedhor. Eshte e qarte se Kodi Zgjedhor, neni 136 ne lidhje me nenin 138, ngarkojne subjektin ankues me barren e proves ne lidhje me ekzistencen e indiceve ne funksion te kerkeses per marrjen e provave, këqyrjen, rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave te caktuara, c'ka do te thote se provat, njoftimet per fakte dhe rrethana konkrete, ne lidhje me vërtetimin e ketyre indiceve, i paraprijne këtij procesi (këqyrjes, rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave te caktuara) dhe nuk

mund te përftohen prej tij, per me teper nga nje proces jo i rregullt ligjor, sic ka ndodhur ne rastin konkret.

Nga ana tjeter, Kolegji Zgjedhor vlerëson se, referuar provave te paraqitura gjate gjykimit, bazuar ne nenin 138 te Kodit Zgjedhor, ishte vendi per kryerjen e këqyrjes, rinumërimin e rivlerësimit te votave vetem persa i perket 10 qendrave te votimit, pikërisht ato me nr.07051, nr.0708, nr.070801, nr.0725, nr.0762, nr.0763, nr.0764, nr.0765, nr.0769 dhe nr.0770, te KZAZ nr.13, zona zgjedhore Qarku Lezhe, ne rrethanat kur provohej se procesi i numërimit dhe vlerësimit te votave per keto qendra votimi ishte realizuar, por se mungonte akti formal ligjor i dokumentimit te rezultatit te votimit per keto qendra votimi, tabelat origjinale sipas nenit 119 te Kodit Zgjedhor, c'ka nga ana tjeter kishte detyruar KQZ qe vendimin e saj Nr.701, date 10.07.2013, ne lidhje me keto qendra votimi, ta mbështeste mbi rezultatit e votimit te hedhur ne bazen e saj elektronike nga KZAZ perkatese ne zbatim te nenit 119/2§2 te Kodit Zgjedhor dhe Udhezimit te saj Nr.17, date 22.05.2009.

Rinumërimi dhe rivlerësimi i votave per 10 qendrat e votimit si me lart u realizuar nga Kolegji Zgjedhor me date 31.07.2013, ne ambientet e Gjykates se Apelit Tirane, ku Kolegji Zgjedhor ushtron funksionet e tij, ne nje seance publike, ne prani te paleve pjesemarrese ne gjykim, duke ndjekur dhe zbatuar per aq sa ishte e mundur te njëjtat rregulla qe Kodi Zgjedhor parashikon ne lidhje me procesin e numërimit e te vlerësimit te votave, gjate te ciles Kolegji Zgjedhur u asistua nga 8 specialiste te KQZ, qe kryen detyren e numëruesve, si dhe 4 persona te tjere, te propozuar nga pala/partia politike e pranishme ne gjykim (PD), te cilet kryen detyren e vëzhguesit.

Ne perfundim te procesit te rinumërimin dhe rivlerësimit te votave rezultuan keto te dhena per secilen nga 10 qendrat e votimit si me lart :

1	QV-te qe pasqyrohen ne kete tabele	QV nr 07051	QV nr 0708	QV nr 07081	QV nr 0725	QV nr 0762	QV nr 0763	QV nr 0764	QV nr 0765	QV nr 0769	QV nr 0770	Totali
2	Numri i zgjedhëse që kanë votuar	217	233	253	434	102	293	156	149	281	183	2301
3	Fletë votimi të papërdorura	306	304	279	386	101	272	91	158	337	181	2415
4	Fletë votimi të dëmtuara	1	0	2	0	1	6	1	1	2	1	15
5	Fletë votimi të gjetura në kuti	217	233	254	434	102	293	156	150	281	183	2303
6	Vota të pavlefshme	5	4	3	8	0	3	4	0	1	4	32
7	Vota të vlefshme	212	229	251	426	102	290	152	150	280	179	2271
	SHIPERDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME											
Nr.	Subjektet zgjedhore	QV nr 07051	QV nr 0708	QV nr 07081	QV nr 0725	QV nr 0762	QV nr 0763	QV nr 0764	QV nr 0765	QV nr 0769	QV nr 0770	
1	Lidhja për Drejtësi dhe Progres	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
3	Aleanca Popullore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4	Partia Mendimi i Djathtë Liberal	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	2
5	Partia e Punës së Shqipërisë	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1
6	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	0	2	2	2	9	1	1	1	22	6	46
7	Ligi dhe Drejtësi	1	6	0	0	0	0	0	0	0	0	7
8	Partia Unitetit Kombëtar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
9	Partia Socialiste e Vërtetë 91	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
10	Partia G 99	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
11	Partia Shqiptare Atdheu	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
12	Partia Pajtimit Kombëtar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
13	Partia Komuniste e Shqipërisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
14	Partia e Gjellbër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
15	Partia e Punës e Shqipërisë e Rirganimizuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
16	Partia Bashkimi Republikan Shqiptar	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	1
17	Partia Rruga e Urisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

18	Aleanca Arbore Kombëtare	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0	2
19	Partia Demokracia Sociale	0	5	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	7	
20	Partia Kristian Demokratike e Shqipërisë	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	
21	Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
22	Partia Ambientaliste	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
23	Partia e Çështjeve Shqiptare	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1	
24	Partia e Reformave Demokratike Shqiptare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	
25	Partia Komuniste e Shqipërisë 8 Nëntori	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	2	
26	Lëvizja Socialiste për Integrim	26	16	22	43	8	55	30	24	48	64	336			
27	Partia Socialpunte Shqiptare	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	
28	Partia Demokratike për Integrim e Prosperitet	1	0	1	2	0	1	1	0	0	1	7			
29	Partia Socialiste e Shqipërisë	69	89	89	139	37	63	31	39	84	22	662			
30	Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	
31	Lëvizja për Drejtësi e Shqipëtarëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
32	Partia Personat me Afësi të Kufizuar	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1	
33	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	2	0	2	
34	Partia Lëvizja Punëtorë Shqiptare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
35	Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	4	2	4	1	2	5	6	6	5	0	35			
36	Partia Ardhmerija Shqiptare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
37	Partia Toleranca e Re e Shqipërisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
38	Partia Socialiste e Moderuar	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	
39	Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim	0	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	2	
40	Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
41	Partia Demokracia e Re Europiane	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
42	Aleanca Demokratike	0	1	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0	3	
43	Partia Emigracioni Shqiptar	0	1	0	0	0	0	0	0	2	0	0	0	3	

44	Partia Demokratike	55	46	81	143	36	123	34	36	95	75	724
45	Partia Republikane Shqiptare	4	0	5	4	2	14	44	26	13	6	118
46	Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
47	Partia e të Drejtave të Mihuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
48	Partia Ora e Shqipërisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
49	Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	1
50	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1
51	Balli Kombëtar Demokrat	0	2	3	0	0	2	0	0	1	0	8
52	Parti e të Drejtave të Mihuara e Re	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
53	Partia Lëvizja e Legalitetit	0	2	0	1	0	0	2	5	0	1	11
54	Partia Demokratiane e Shqipërisë	0	0	2	73	1	1	0	4	2	0	83
55	Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1
56	Partia Lëvizja Shqiptëria e Re	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
57	Partia Balli Kombëtar	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	2
58	Bashkimi Liberal Demokrat	47	53	35	10	5	22	1	5	5	0	183
59	Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar	0	1	0	0	0	1	0	0	0	0	2
60	Partia Konservatore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
61	Partia Lidhja Demokratiane Shqiptare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	2
62	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
63	Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
64	Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
65	Aleanca Kuq e Zi	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	2
66	Fryma e Re Demokratike	1	0	1	0	1	1	0	0	0	0	4
	Gjithsej vota te vlefshme	212	229	251	426	102	290	152	150	280	179	2271

Sa me siper, Kolegji Zgjedhor cmon se kërkesapadia e paraqitur nga pala paditese Partia Demokratike e Shqiperise duhet te pranohet pjesërisht si me lart u parashtua.

PER KETO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykates se Apelit Tirane,
bazuar ne nenin 158, pikat 1/b dhe 3, te Kodit Zgjedhor te ndryshuar,

V E N D O S I

Pranimin pjesërisht te kerkesepadise.

Ndryshimin e vendimit Nr.701, date 10.07.2013, te KQZ-se "Per nxjerrjen e rezultatit te votimit per Zonen Zgjedhore Qarku Lezhe, per zgjedhjet per Kuvendin 2013", sipas tabelës permbledhese pjese perberese te këtij vendimi.

Tirane, me 31.07.2013.

ANETAR
GJINOVEFA GABA
(kunder)

ANETAR
FUAT VJERDHA

KRYESUES
PETRIT ÇENO

ANETAR
ILIR TOSKA

ANETAR
ANDI CIVICI

* * *



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR

NR. 25 REGJ. THEMELTAR
DATË 30.07.2013 REGJ.

Nr. 25 VENDIMI
DATË 01.08.2013 VENDIMI

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykeses se Apelit Tirane i perbere nga gjyqtaret :

KRYESUES :	VALBON ÇEKREZI
ANETAR :	KLITON SPAHIU
ANETAR :	EDLIRA PETRI
ANETAR :	FUAT VJERDHA
ANETAR :	ANDI CIVICI

Me sekretare **Rexhina Baçi**, në Tiranë, sot në **date 01.08.2013**, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore me nr.25 Akti, që u përket palëve:

PADITESE: **Partia Bashkimi Popullor Pensionistëve Shqiptar**, në mungesë.

I PADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar me autorizim nga Znj. Dëshira PASKO.

OBJEKTI: Vendim nga Kolegji Zgjedhor ndaj mos marrjes të vendimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ankimit të Partisë Bashkimi Popullor Pensionistëve Shqiptar brenda afatit ligjor të KQZ-së të paraqitur me anën e postës sipas (lajmërim marrje) bashkëngjitur me këtë ankim nga Partia Bashkimi Popullor Pensionistëve Shqiptar.

BAZA LIGJORE: Nenet 145/2, të ligjit nr. 10019, date 29.12.2008
“Kodi Zgjedhor i RSH me ndryshimet perkatese”.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoi përfaqësuesen e palës së paditur që në përfundim kërkoi pushimin e gjykimit, pasi administroi provat e bisedoi çështjen në tërësi;

V Ë R E N

Subjekti zgjedhor Partia Bashkimi Popullor Pensionistëve Shqiptar, ka paraqitur ankim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duke kërkuar, pavlefshmërinë e zgjedhjeve parlamentare të 23 qershorit.

Pala ankuese ka pretenduar se, në fletën e votimit për këto zgjedhje, mbiemri i kryetarit të partisë nuk është shënuar korrekt, është shënuar “JENISHERI” kur në fakt duhej të shënohej “JENISHEHRI”, ç’ka sipas palës ankuese ka sjellë konfuzionin e votuesve dhe pakësimin e votave të kësaj partie.

Ankimi i paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Bashkimi Popullor Pensionistëve Shqiptar, është protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me Nr.5867 Prot, datë 01.07.2013.

Rezultoi se në lidhje me këtë ankim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duke mos e marrë në shqyrtim nuk është shprehur me një vendimmarrje.

Nga përfaqësuesja e palës së paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u parashtrua se, pretendimet e palës së paditur për pavlefshmëri të zgjedhjeve janë shqyrtuar gjatë shqyrtimit të ankimeve për zona zgjedhore të veçanta, sipas ankimeve të paraqitura prej saj.

Subjekti zgjedhor Partia Bashkimi Popullor Pensionistëve Shqiptar duke ju referuar ankimit të protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me Nr.5867 Prot, datë 01.07.2013 ka depozituar përpara Kolegjit Zgjedhor një ankim/kërkesëpadi, me të cilën, duke paditur KQZ, ka kërkuar; Vendim nga Kolegji Zgjedhor ndaj mos marrjes të vendimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ankimit të Partisë Bashkimi Popullor Pensionistëve Shqiptar brenda afatit ligjor të KQZ-së të paraqitur me anën e postës sipas lajmërim-marrje bashkëngjitur me këtë ankim nga Partia Bashkimi Popullor Pensionistëve Shqiptar.

Në ankim/kërkesëpadi, subjekti zgjedhor Partia Bashkimi Popullor Pensionistëve Shqiptar ka parashtruar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk e ka marrë në shqyrtim ankimin e paraqitur prej saj për më tepër brenda afatit 10 ditor që parashikojnë dispozitat e Kodit Zgjedhor.

Ankimin/kërkesëpadinë, subjekti zgjedhor Partia Bashkimi Popullor Pensionistëve Shqiptar e ka paraqitur pranë kolegjit me datë 30.07.2013.

Kodi Zgjedhor, në një sërë dispozitash të tij ka përcaktuar afate të prera që duhet të respektohen nga subjektet zgjedhore për paraqitjen e ankimeve si para Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ashtu edhe para Kolegjit Zgjedhor. Gjithashtu, ky kod ka parashikuar afate brenda të cilave duhet të shqyrtohen ankimet e paraqitura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Kolegji Zgjedhor.

Në referim të nenit 143 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të kishte marrë një vendim në lidhje me ankimin e paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Bashkimi Popullor Pensionistëve Shqiptar brenda një afati 10 ditor, nga dita që ishte regjistruar kërkesa pranë tij.

Sipas parashikimit të nenit 152 të Kodit Zgjedhor, gjatë periudhës zgjedhore deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, ankimi bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në rastin kur, Komisionit Qendror i Zgjedhjeve nuk e ka marrë në shqyrtim ankimin brenda afatit për shqyrtim (në rastin konkret prej 10 ditësh), afati i ankimit (në rastin konkret prej 5 ditësh) që mund të paraqesë subjekti para Kolegjit Zgjedhor, fillon nga data e mbarimit të afatit për shqyrtimin e ankimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Në rastin konkret rezulton që, ankimi nga subjekti zgjedhor është paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me datë 01.07.2013 ndërsa, padia në lidhje me këtë ankim është paraqitur në Kolegjin Zgjedhor me datë 30.07.2013, pra është paraqitur jashtë afatit.

Subjekti zgjedhor Partia Bashkimi Popullor Pensionistëve Shqiptar, do të duhej ta parashtronte zgjidhjen e kësaj çështjeje para kolegjit, brenda 5 ditëve, nga data e mbarimit të afatit të shqyrtimit të çështjes (ankimit) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Paraqitja e ankim/kërkesëpadi jashtë afatit, passjell pushimin e gjykimit në respekt të parashikimeve të nenit 158/1-a/2 të Kodit Zgjedhor, që parashikon se” *Pushimi i gjykimit vendoset kur Kolegji Zgjedhor konstaton se ankimi është paraqitur jashtë afateve të përcaktuara në këtë Kod ose për mungesë kompetence.*”

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë,
bazuar në nenin 158/1-a/2 të Kodit Zgjedhor,

VENDOSI

Pushimin e gjykimit të çështjes nr.25 Rregj.Themeltar, datë 30.07.2013, që i përket palës paditëse Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar.

U shpall sot ne dt.01.08.2013, Tirane

ANETAR
Edlira Petri

ANETAR
Andi Civici

KRYESUES
Valbon Çekrezi

ANETAR
Fuat Vjerdha

ANATAR
Kliton Spahiu

* * *



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**NR. 26 REGJ. THEMELTAR
DATË 31.07.2013 REGJ.**

**Nr. 26 VENDIMI
DATË 02.08.2013 VENDIMI**

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykeses se Apelit Tirane i perbere nga gjyqtaret :

KRYESUES :	ILIR TOSKA
ANETAR :	FUAT VJERDHA
ANETAR :	PETRIT ÇENO
ANETAR :	VALBON ÇEKREZI
ANETAR :	ANDI CIVICI

asistuar nga sekretarja Rexhina Baçi, ne seancen gjyqesore te dates 02.08.2013, mori ne shqyrtim ceshtjen civile qe u perket paleve :

PADITese : **PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE,**
me Seli ne Tirane, Sheshi “Austria”, perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Koli Bele.

I PADITUR : **KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE,**
me Seli ne Tirane, Bulevardi “Deshmoret e Kombit”, Pallati i Kongreseve, perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Deshira Pasko.

PALE E INTERESUAR : **PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE,**
me Seli ne Tirane, perfaqesuar me autorizim nga Ivi Kaso.

OBJEKTI : Kerkohet shpërndarja e mandateve per zonen zgjedhore Qarku Gjirokastrë.

BAZA LIGJORE: Nenet 145, 152, 153, 155, 156, 158, 162 dhe 163 te Kodit Zgjedhor.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATES SE APELIT TIRANE

Pasi degjoi perfaqesuesin e pales paditese, qe kerkoi pranimin e padise; degjoi perfaqesuesen e pales se paditur, qe u shpreh se e linte ceshtjen ne cmim te gjykates; degjoi perfaqesuesin e pales se interesuar, qe kerkoi rrezimin e padise; si dhe pasi shqyrtoi ceshtjen ne teresi,

V E R E N

Me kerkesepadine e paraqitur me date 31.07.2013, Partia Socialiste e Shqiperise (me poshte referuar si PS), ne cilesine e nje partie politike qe ka marre pjese ne zgjedhjet per Kuvendin te dates 23.06.2013, ka kerkuar nga Kolegji Zgjedhor te disponoje per ndarjen e mandateve per Kuvendin, pikërisht shpërndarjen e mandateve per Zonen Zgjedhore Qarku Gjirokastër, per cdo koalicion zgjedhor dhe parti politike qe ka konkurruar me vete, si dhe per cdo parti politike brenda koalicioneve zgjedhore, ashtu sikundër dhe përcaktimin e mandateve nominale per cdo parti politike.

Gjate shqyrtimit gjyqësor, ne seancen e dates 02.08.2013, mbi kerkesen e Partise Demokratike te Shqiperise (me poshte referuar si PD), Kolegji Zgjedhor vendosi pranimin e saj, duke lejuar pjesëmarrjen ne gjykim te PD-se si pale e interesuar, ne kushtet kur ajo eshte nje nga partite politike qe ka marre pjese ne zgjedhjet per Kuvendin te dates 23.06.2013.

Rezulton qe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (me poshte referuar si KQZ), me vendimin Nr.677, datë 08.07.2013, "Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zonën zgjedhore, Qarku Gjirokastër", ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të rezultatit për këtë zonë zgjedhore.

Del se, kundër këtij vendimi të KQZ, brenda afateve ligjore, te kene paraqitur ankim Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane,

Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë, si dhe Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve.

Mbi keto kërkesa ankimore, me Vendimin Nr.747, datë 15.07.2013, KQZ ka vendosur rrezimin e tyre dhe lënien në fuqi të vendimit të saj Nr.677, datë 08.07.2013.

Ndaj këtij vendimi të KQZ, nga subjektet ankuese nuk është paraqitur ankim/kerkesepadi përpara Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, në afatin 5 ditor të percaktuar nga neni 124/3 i Kodit Zgjedhor. Tejtij afati ligjor, me date 30.07.2013, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve ka paraqitur përpara Kolegjit Zgjedhor një ankim/kerkesepadi, me të cilën ka kërkuar pavlefshmerinë e zgjedhjeve parlamentare të datës 23.06.2013, kerkesepadi mbi të cilën, Kolegji Zgjedhor, me Vendimin Nr. 25, date 01.08.2013, ka vendosur pushimin e gjykimit të ceshtjes, me arsyetimin se ankimi/kerkesepadia ishte paraqitur tejtij afatit ligjor.

Me date 02.08.2013, ora 12.00, KQZ ka realizuar një mbledhje, duke përfshirë në rendin e ditës edhe Projekt-vendimin “Për shpërndarjen e mandateve midis koalicioneve zgjedhore dhe partive politike që konkurojnë me vete, për 12 Zonat Zgjedhore, për zgjedhjet e Kuvendit, të datës 23 Qershor 2013”, që ka të bëjë me shpërndarjen e mandateve midis koalicioneve zgjedhore dhe partive politike që kanë konkurruar me vete, referuar nenit 162 të Kodit Zgjedhor, për të gjitha zonat zgjedhore, përfshirë edhe për zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë. Në këtë rast, KQZ-ja ka konstatuar se, në zbatim të Kodit Zgjedhor, nuk ka kuorumin e nevojshëm për vazhdimin e shqyrtimit të “projekt vendimit/vendimeve” të përgatitura nga administrata e KQZ-së, përfshirë këtu edhe për zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë.

Është i njohur botërisht fakti që, 3 nga anetaret e KQZ kanë dhënë dorëheqjen e parëvokueshme dhe KQZ, prej datës 21.04.2013, ka funksionuar dhe vazhdon të funksionojë vetëm me 4 anetare.

Ndërkohe, gjatë gjykimit të ceshtjes përpara Kolegjit Zgjedhor, në kërkesat paraprake, përfaqësuesi i palës së interesuar, kërkoi që Kolegji të vendoste pushimin e gjykimit të ceshtjes, mbi argumentin se kerkesepadia e PS ishte paraqitur jo në afatin e percaktuar nga ligji, por përpara tij.

Kolegji Zgjedhor, pasi vuri ne diskutim kete kerkese, çmoi ta refuzonte ate, duke vlerësuar se ne rastin konkret nuk ishim para rastit te pushimit te gjykimit referuar nenit 158, pikat /1/a dhe 2, te Kodit Zgjedhor, pasi nuk rezultonte qe kërkesa per ndarjen e mandateve per Kuvendin per zonen zgjedhore Qarku Gjirokastër te ishte jashte afatit ligjor apo qe Kolegjit Zgjedhor t'i mungonte kompetenca per shqyrtimin e kësaj kerkese.

Konkretisht, ne lidhje me afatin e paraqitjes se kerkesepadise, per te cilin nga pala e interesuar u pretendua se kerkesa ishte paraqitur përpara afatit, duke e lidhur kete me momentin e trajtimit te ceshtjes se ndarjes se mandateve nga KQZ apo trajtimin e saj ne vijim nga KQZ, Kolegji Zgjedhor vlerëson se ligji, Kodi Zgjedhor, ka rregulluar procesin e ndarjes se mandateve per Kuvendin, proces ky qe realizohet per cdo zone zgjedhore, pasi te kete përfunduar procesi i ankimit te vendimit te KQZ per miratimin e rezultatit per ate zone zgjedhore apo pavlefshmerise se zgjedhjeve per ate zone. Ne rastin konkret, nuk kontestohet as nga pala e interesuar se procesi ankimor per miratimin e rezultatit te zones zgjedhore Qarku Gjirokastër apo pavlefshmerine e zgjedhjeve per kete zone zgjedhore ka përfunduar, c'ka ligjërisht i hap rruge procesit te ndarjes se mandateve per kete zone zgjedhore. Po keshtu, Kolegji Zgjedhor vlereson se KQZ nuk ka përmbushur ne kohe (afat) detyrimin ligjor per trajtimin e ceshtjes se ndarjes se mandateve per Kuvendin per zonen zgjedhore Qarku Gjirokastër, nderkohe qe, pavarësisht kësaj, KQZ, me date 02.08.2013, duke konsideruar se ishin kushtet e kërkuara nga ligji per realizimin e procesit te ndarjes se mandateve per Kuvendin per zonen zgjedhore Qarku Gjirokastër, ka trajtuar kete ceshtje, por duke mos e zgjidhur ate, per shkak te pamundesise se saj per marrjen e nje vendimi per mungese te kuorumit te nevojshem te kërkuar nga ligji, Kodi Zgjedhor. Pra, ne rastin konkret, jemi para rastit kur jane vërtetuar kushtet e kërkuara nga ligji per zhvillimin e procesit te ndarjes se mandateve per Kuvendin per zonen zgjedhore Qarku Gjirokastër, si dhe kur ky proces nuk eshte kryer dhe nuk mund te kryhet nga KQZ per mungese te kuorumit te nevojshem ligjor, duke mos patur keshtu ne kete rast nje vendim nga ana e KQZ, i cili te mund te ankimohej nga ana tjetere ne Kolegjin Zgjedhor brenda afatit ligjor te percaktuar ne nenin 152/2 te Kodit Zgjedhor. Ne kete kuptim, Kolegji Zgjedhor vlerëson se nuk mund

te konsiderohet si e paraqitur jo ne afatin ligjor, ne kapërcim te tij, kërkesa e paraqitur përpara Kolegjit Zgjedhor nga pala paditese per ndarjen e mandateve per Kuvendin per zonen zgjedhore Qarku Gjirokastër, persa kohe ajo eshte paraqitur mbas përfundimit te procesit te ankimit te vendimit te KQZ per miratimin e rezultatit te kësaj zone zgjedhore apo pavlefshmerine e zgjedhjeve ne kete zone, si dhe mbas përfundimit te afatit ligjor per trajtimin kryesisht te kësaj ceshtje nga KQZ. Per me teper, ne momentin e shqyrtimit gjyqësor, ishte ezauruar formalisht edhe trajtimi i kësaj ceshtje nga ana e KQZ.

Kolegji zgjedhor vlerëson se ndarja e mandateve per Kuvendin, referuar nenit 21 te Kodit Zgjedhor, eshte nje nga ceshtjet qe përfshihet ne kompetencat e KQZ, ceshtje per te cilen KQZ, referuar nenit 162/1 ne lidhje me nenin 163/7 te këtij Kodi, ka detyrimin per ta trajtuar dhe per t'u shprehur/disponuar "jo me vone se 3 dite nga përfundimi i procesit te ankimit kunder vendimit per miratimin e rezultateve te zones zgjedhore apo pavlefshmerise se zgjedhjeve, sipas këtij Kodi", disponim/vendimarrje e cila, referuar nenit 22/5 ne lidhje me nenin 24/1/a te Kodit Zgjedhor, mund te realizohet vetem ne nje mbledhje ku te jene te pranishem jo me pak se 5 anetare te KQZ, si dhe me votimin "pro" te jo me pak se 5 anetareve te saj.

Referuar sa me lart, del qe brenda afatit ligjor ("jo me vone se 3 dite nga përfundimi i procesit te ankimit kunder vendimit per miratimin e rezultateve te zones zgjedhore apo pavlefshmerise se zgjedhjeve, sipas këtij Kodi"), pra deri me date 18.07.2013, KQZ nuk ka vene ne diskutim/trajtuar ceshtjen e ndarjes se mandateve per Kuvendin per zonen zgjedhore Qarku Gjirokastër. Kolegji Zgjedhor vlerëson te gabuar interpretimin e bere nga pala e paditur dhe pala e interesuar te nenit 162/1 te Kodit Zgjedhor, kur sipas kësaj dispozite afati ligjor i percaktuar per shqyrtimin dhe disponimin nga ana e KQZ nuk lidhet me përfundimin e procesit ankimor ne teresi, pra me te gjitha proceset ankimore per vendimet e KQZ per miratimin e rezultateve te zones zgjedhore apo pavlefshmerise se zgjedhjes, por, per cdo rast, per cdo zone zgjedhore, me procesin e ankimit kunder vendimit te KQZ per miratimin e rezultatit te kësaj zone zgjedhore apo pavlefshmerine e zgjedhjeve ne kete zone zgjedhore.

Ne lidhje me trajtimin e bere ne mbledhjen e dates 02.08.2013, Kolegji Zgjedhor vlerëson se KQZ ka gabuar kur ndarjen e mandateve per Kuvendin per secilen zone zgjedhore ka konsideruar ta realizoje ne disa procese dhe nepermjet disa vendimeve, ne nje kohe kur ndarja e mandateve per Kuvendin, per cdo zone zgjedhore, eshte nje proces i vetem, qe realizohet nepermjet ndjekjes se disa procedurave qe shoqerohen me vendime te ndërmjetme dhe qe finalizohet me nje vendim përfundimtar te vetem, proces ky qe duhet te kryhet brenda afatit ligjor te percaktuar, pra “jo me vone se 3 dite nga përfundimi i procesit te ankimit kunder vendimit per miratimin e rezultateve te zones zgjedhore apo pavlefshmerise se zgjedhjeve, sipas këtij Kodi”.

Keshtu, fillimisht, ne nenin 162/1 te Kodit Zgjedhor, përcaktohet detyrimi i KQZ qe, **“jo me vone se 3 dite nga përfundimi i procesit te ankimit** kunder vendimit per miratimin e rezultateve te zones zgjedhore apo pavlefshmerise se zgjedhjeve, sipas këtij Kodi”, te përllogarise shpërndarjen e mandateve per cdo zone zgjedhore midis koalicioneve zgjedhore dhe partive politike qe kane konkurruar me vete, c’ka eshte nje ceshtje per te cilen kjo dispozite nuk kërkon nje vendimmarrje te veçante/te ankimueshme. Ne vijim, ne nenin 163/1 te këtij Kodi, përcaktohet detyrimi i KQZ qe, **menjehere pas përfundimit te llogaritjes se rezultatit sipas nenit 162**, te perllogarise shpërndarjen e mandateve brenda koalicionit per cdo zone zgjedhore, pra per cdo parti politike te koalicionit, c’ka edhe kjo eshte nje ceshtje per te cilen ligji nuk kërkon nje vendimmarrje te veçante/te ankimueshme. Me tej, ne nenin 163/5 te Kodit Zgjedhor, përcaktohet detyrimi i KQZ qe, **pas përfundimit te procedurave per ndarjen e mandateve per cdo parti politike**, te percaktoje mandatet nominale per cdo parti politike sipas renditjes ne liste te kandidateve, c’ka edhe kjo eshte nje ceshtje per te cilen ligji nuk kërkon nje vendimmarrje te veçante/te ankimueshme. Ne përfundim te këtij procesi, ne nenin 163/7 te Kodit Zgjedhor, përcaktohet detyrimi i KQZ per te disponuar me vendim per shpërndarjen e mandateve sipas neneve 162 e 163 te këtij Kodi per cdo zone zgjedhore, pra per shpërndarjen e mandateve midis koalicioneve zgjedhore dhe partive politike qe kane konkurruar me vete, per shpërndarjen e mandateve brenda koalicionit, per cdo parti politike, si dhe per përcaktimin e mandateve nominale per cdo parti politike te koalicionit. Sipas kësaj dispozite, eshte pikërisht ky vendimi përfundimtar i KQZ, qe ankimohet ne Kolegjin Zgjedhor.

Në lidhje me juridiksionin e Kolegjit Zgjedhor për shqyrtimin e çështjes në themel, Kolegji vlerëson se është e domosdoshme të identifikohen kufijtë ligjorë për ushtrimin e diskrecionit nga organi administrativ (me cilësinë e të cilit paraqitet KQZ në rastin në shqyrtim), si dhe kontrolli gjyqësor që i bëhet pushtetit diskrecionar.

Kufijtë për ushtrimin e diskrecionit nga organi administrativ janë dhënë qartë në Kodin e Procedurave Administrative. Diskrecioni mund të ushtrohet vetëm për të arritur një qëllim të ligjshëm (neni 7) dhe në përputhje me Kushtetutën dhe frymën e legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë (neni 149). Administrata publike, në ushtrimin e funksioneve të saj, mbron në çdo rast interesin publik, si dhe të drejtat dhe interesat kushtetuese e ligjore të personave privatë (neni 10). Ajo duhet të respektojë sidomos parimet e barazisë, kufijtë e të drejtave themelore individuale të njohura nga Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare, ligjet dhe aktet nënligjore dhe në çdo rast, duhet të respektojë parimin e proporcionalitetit, bazuar në një vlerësim të qëllimeve dhe disponueshmërisë dhe efikasitetit të mjeteve për t'i arritur ato (neni 11). Me qëllim që gjykata të përcaktojë nëse organi administrativ, duke ushtruar diskrecionin e tij, ka kaluar këto kufizime, ligji kërkon që organi administrativ të japë një vendim të arsyetuar, duke identifikuar qëllimin (neni 107/1), faktet e rëndësishme që çuan në nxjerrjen e aktit (neni 107/2/c) dhe bazën ligjore të aktit (neni 107/2/ç). Ky është koncepti për diskrecionin, me të cilin Kodi Zgjedhor e ka pajisur KQZ për të ushtruar pushtetin e saj konform ligjit.

Në doktrinën administrative, por edhe në jurisprudencën gjyqësore vendase e të huaj, është i njohur koncepti se në rast se një akt administrativ diskrecionar shfuqizohet nga gjykata për paligjshmëri, gjykata nuk mund të zërë vendin e administratës, nuk mund të ushtrojë vetë diskrecion administrativ dhe as nuk mund të nxjerrë vetë aktin administrativ, sepse mund të ketë akoma disa mundësi që organi administrativ të ushtrojë diskrecionin në mënyrë të ligjshme. Pikërisht, një zgjedhje e tillë nuk mund të bëhet nga gjykata, por i rezervohet përsëri organit administrativ. Prandaj, gjykata në këto çështje vetëm e shfuqizon aktin administrativ diskrecionar, bazuar në paligjshmërinë e ushtrimit të diskrecionit, duke e kthyer çështjen tek organi administrativ dhe duke e urdhëruar të vendosë edhe një

herë ushtrimin e diskrecionit, por këtë herë pa përsëritur gabimin me natyrë diskrecionale që ka gjetur gjykata. Ky është një koncept tashmë i konsoliduar si në jurisprudencën gjyqësore të huaj, ashtu edhe në atë shqiptare, që njihet si parimi i “shqyrtimit kasacional” në gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Por, krahas këtij parimi, është i njohur dhe parimi i “reformimit/ndryshimit”, sipas të cilit gjykata administrative nuk mjaftohet vetëm me shfuqizimin e aktit, pasi ajo mund ta ndryshojë atë dhe, në raste përjashtimore, edhe të nxjerre vete një akt të ri. Rregulli i përzgjedhur nga ligjvënisi në Kodin Zgjedhor i referohet parimit të “shqyrtimit kasacional”, që mishëron parimin kushtetues të “ndarjes dhe balancimit të pushteteve”, ndërkohe që pranon si përjashtim edhe aplikimin e parimit të “shqyrtimit reformues” në rastet e mos ushtrimit të kompetencës nga KQZ për vendimmarrje që i referohen në mënyrë eksplicite nën 24, pikë 1, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të Kodit Zgjedhor, kjo sipas parashikimit të bërë në nenin 145/2 (fjalë e fundit) e këtij Kodi. Në këto raste përjashtimore, kur gjykata bindet se organi administrativ nuk e ka të mundur për të ushtruar pushtetin diskrecionar, për të vlerësuar ndërmjet më shumë se një zgjidhjeje njëloj të ligjshme, se organi administrativ nuk mund të urdhërohet për të kryer një vendimmarrje administrative, ndërkohë që janë mbledhur të gjitha faktet e nevojshme për nxjerrjen e aktit, dhe për më tepër se organi administrativ është në pamundësi objektive për të vepruar, për shkak të inkompetencës, që shkaktohet nga mungesa e kuorumit, atëherë është veçse gjykata që ka për detyrë të ushtrojë pushtetin e saj ligjor për të zgjidhur përfundimisht mosmarrëveshjen juridike të krijuar, qoftë edhe duke e nxjerrë vetë aktin administrativ. Pra, vetëm në raste të tilla dhe tepër përjashtimore, ligji mund të lejojë ushtrimin nga gjykata të një kompetence, që i përket një pushteti tjetër. Pikërisht ushtrimin e pushtetit administrativ të KQZ nga Kolegji Zgjedhor, ka përcaktuar ligjvënisi në nenin 145/2 të Kodit Zgjedhor.

Duke iu kthyer rastit në shqyrtim rezulton se Kolegjit Zgjedhor i është paraqitur një kërkesë për të ushtruar pushtetin, lidhur me ndarjen e mandateve për Kuvendin për zonën zgjedhore Qarku Gjirokastër. Arsyeja e paraqitjes së një kërkesë të tillë lidhet me pamundësinë e ushtrimit të pushtetit nga KQZ, për shkak të mungesës së kuorumit

prej 5 anëtarësh, si kusht për thirrjen e mbledhjes së KQZ (neni 22/5 i Kodit Zgjedhor) dhe për vendimmarrjen e këtij organi, në rastet e parashikuara nga neni 24, pika 1, shkronja “a”, të Kodit Zgjedhor.

Në kushtet kur afati tre ditor për shpërndarjen e mandateve per Kuvendin per Zonen Zgjedhore Qarku Gjirokastrë, ka përfunduar, dhe per me teper ne Mbledhjen e dates 02.08.2013 vetë KQZ ka konstatuar pamundësinë e mbledhjes dhe vendimmarrjes per shkak të mungesës së quorumit, Kolegji Zgjedhor vlerëson se ka, jo vetëm të drejtën, por edhe detyrimin ligjor e kushtetues që, në funksion të garantimit të shtetit të së drejtës, të përmbyllë, sipas nenit 145/2 të Kodit Zgjedhor, të gjithë procesin vendimmarrës për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë.

Per rrjedhoje, Kolegji Zgjedhor vlerësoi se ne rastin konkret nuk jemi ne kushtet kur KQZ duhet te detyrohet per te marre vendim, por, referuar nenit 145/2 (fjalise se fundit) ne lidhje me nenin 158/1/b, jemi para rastit kur Kolegji Zgjedhor ka detyrimin të shqyrtoje çështjen ne themel dhe te vendose ne lidhje me ndarjen e mandateve per Kuvendin per zonen zgjedhore Qarku Gjirokastrë.

Ne lidhje me themelin e ceshtjes :

Bazuar ne nenin 162 të Kodit Zgjedhor, ne konsiderate te rezultatit të votimit të miratuar me Vendimin Nr.677, datë 08.07.2013, “Për nxjerrjen e rezultatit të votimit per zonen zgjedhore të Qarkut Gjirokastrë”, **Kolegji Zgjedhor vlerëson te përllogarise fillimisht shpërndarjen e mandateve për kete zonë zgjedhore midis koalicioneve dhe partitë që kane konkurruar më vete.**

Keshtu, rezultati për Qarkun Gjirokastrë për koalicionet dhe partitë që kane konkurruar më vete është si më poshtë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Vota	Përqindje
1	Aleanca per Shqiperine Europiane	40649	68,48%
2	Aleanca per Punesim Mireqenie dhe Integrim	18125	30,53%
3	Fryma e Re Demokratike	349	0,59%

4	Aleanca Kuq e Zi	203	0,34%
5	Lidhja për Drejtësi dhe Progres	25	0,04%
6	Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë	10	0,02%
	Gjithsej	59361	100%

Referuar nenit 162/1 të Kodit Zgjedhor, përjashtohen nga shpërndarja e mandateve partitë që konkurojnë më vete e që kanë marrë më pak se 3 përqind dhe koalicionet që kanë marrë më pak se 5 për qind të votave të vlefshme në zonën zgjedhore përkatëse. Koalicionet që plotësojnë kushtin për t'u përfshirë në përlogaritjen e shpërndarjes së mandateve rezultojnë të jenë :

Nr.	Subjekti zgjedhor	Vota
1	Aleanca për Shqipërinë Europiane	40649
2	Aleanca për Punësim Mireqenie dhe Integrim	18125

Sipas nenit 162/2 të Kodit Zgjedhor, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, që në bazë të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë është 5 (pesë).

	1	2	3	4	5
Aleanca për Shqipërinë Europiane	40649	20325	13550	10162	8130
Aleanca për Punësim Mireqenie dhe Integrim	18125	9063	6042	4531	3625

Me tej, sipas nenit 162/4 të Kodit Zgjedhor, herësit e përfutur nga çdo pjesëtim, renditen nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, pra 5. Nga kjo renditje marrim rezultatin si më poshtë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Herësit
1	Aleanca per Shqiperine Europiane	40649
2	Aleanca per Shqiperine Europiane	20325
3	Aleanca per Punesim Mireqenie dhe Integrim	18125
4	Aleanca per Shqiperine Europiane	13550
5	Aleanca per Shqiperine Europiane	10162

Ne vijim, në bazë të nenit 162, pika 5, te Kodit Zgjedhor, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar më sipër.

Mbi kete baze, rezulton qe mandatet për koalicionet zgjedhore dhe partitë politike që konkurojnë më vete, në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, të shpërndahen 4 (kater) mandate për Aleancën për Shqipëri Europiane dhe 1 (nje) mandat për Aleancën për Punësim Mireqenie dhe Integrim.

Ne konsiderate të përlogaritjes se shpërndarjes si më lart të mandateve për Kuvendin midis koalicioneve dhe partive që kanë konkurruar më vete për zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, **Kolegji Zgjedhor vlerëson se, bazuar në nenin 163 të Kodit Zgjedhor, është vendi të përlogarise shpërndarjen e mandateve brenda koalicioneve që kanë fituar mandate për këtë zonë zgjedhore.**

Keshtu, rezultati për Qarkun Gjirokastrë për partitë politike të koalicionit Aleanca për Shqipëri Europiane është si më poshtë :

Nr	Partitë politike	Vota
1	Partia Socialiste e Shqipërisë	25148
2	Levizja Socialiste për Integrim	11534
3	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	1872
4	Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	367
5	Partia Demokracia Sociale	331
6	Aleanca Arbnore Kombëtare	317
7	Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet	139

8	Partia Socialiste e Moderuar	86
9	Partia Komuniste e Shqipërisë	83
10	Partia Socialpuntore Shqiptare	83
11	Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane	75
12	Partia Komuniste e Shqipërisë 8 Nëntori	68
13	Partia Socialiste e Vërtetë 91	64
14	Ligj dhe Drejtësi	60
15	Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve	53
16	Partia e Punës së Shqipërisë	50
17	Partia e Reformave Demokratike Shqiptare	38
18	Aleanca Popullore	37
19	Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë	31
20	Partia Personat me Aftësi të Kufizuar	31
21	Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim	29
22	Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare	22
23	Partia Ardhmëria Shqiptare	21
24	Partia e Çështjeve Shqiptare	15
25	Partia Unitetit Kombëtar	13
26	Partia Ambientaliste	11
27	Partia G 99	10
28	Partia Bashkimi Republikan Shqiptar	9
29	Lëvizja për Drejtësi e Shqipëtarëve	9
30	Partia Rruga e Lirisë	8
31	Partia Toleranca e Re e Shqipërisë	8
32	Partia Mendimi i Djathtë Liberal	7
33	Partia Shqiptare Atdheu	7
34	Partia e Punës e Shqipërisë e Riorganizuar	6
35	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	4
36	Partia e Gjelbër	2
37	Partia Pajtimit Kombëtar	1
	Gjithsej	40649

Sipas nenit 163/2 te Kodit Zgjedhor, numri i votave të vlefshme të secilës parti pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë tek të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror që i korrespondon dyfishit të numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse për koalicionin në fjalë.

		1	2	3	4
		1	3	5	7
1	Partia Socialiste e Shqipërisë	25148	8383	5030	3593
2	Levizja Socialiste për Integrim	11534	3845	2307	1648
3	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	1872	624	374	267
4	Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	367	122	73	52
5	Partia Demokracia Sociale	331	110	66	47
6	Aleanca Arbnore Kombëtare	317	106	63	45
7	Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet	139	46	28	20
8	Partia Socialiste e Moderuar	86	29	17	12
9	Partia Komuniste e Shqipërisë	83	28	17	12
10	Partia Socialpuntore Shqiptare	83	28	17	12
11	Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane	75	25	15	11
12	Partia Komuniste e Shqipërisë 8 Nëntori	68	23	14	10
13	Partia Socialiste e Vërtetë 91	64	21	13	9
14	Ligj dhe Drejtësi	60	20	12	9
15	Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve	53	18	11	8
16	Partia e Punës së Shqipërisë	50	17	10	7
17	Partia e Reformave Demokratike Shqiptare	38	13	8	5

18	Aleanca Popullore	37	12	7	5
19	Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë	31	10	6	4
20	Partia Personat me Aftësi të Kufizuar	31	10	6	4
21	Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim	29	10	6	4
22	Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare	22	7	4	3
23	Partia Ardhmërija Shqiptare	21	7	4	3
24	Partia e Çështjeve Shqiptare	15	5	3	2
25	Partia Unitetit Kombëtar	13	4	3	2
26	Partia Ambientaliste	11	4	2	2
27	Partia G 99	10	3	2	1
28	Partia Bashkimi Republikan Shqiptar	9	3	2	1
29	Lëvizja për Drejtësi e Shqipëtarëve	9	3	2	1
30	Partia Rruga e Lirisë	8	3	2	1
31	Partia Toleranca e Re e Shqipërisë	8	3	2	1
32	Partia Mendimi i Djathtë Liberal	7	2	1	1
33	Partia Shqiptare Atdheu	7	2	1	1
34	Partia e Punës e Shqipërisë e Riorganizuar	6	2	1	1
35	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	4	1	1	1
36	Partia e Gjelbër	2	1	0	0
37	Partia Pajtimit Kombëtar	1	0	0	0

Me tej, sipas nenit 163/3 të Kodit Zgjedhor, herësit e përftuar nga çdo pjesëtim, renditen nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i

mandateve që shpërndahen për koalicionin në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, pra 4. Nga kjo renditje marrim rezultatin si më poshtë :

Nr.	Subjekti Zgjedhor	Herësit
1	Partia Socialiste e Shqipërisë	25148
2	Lëvizja Socialiste për Integrim	11534
3	Partia Socialiste e Shqipërisë	8383
4	Partia Socialiste e Shqipërisë	5030

Ne vijim, në bazë të nenit 163/4 të Kodit Zgjedhor, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar më sipër.

Me tej akoma, në bazë të nenit 163/5 të Kodit Zgjedhor, **Kolegji Zgjedhor vlerëson se, pas përfundimit të përlogaritjes së ndarjes së mandateve për cdo parti politike, është vendi për t'u përcaktuar mandatet nominale për cdo parti politike, në bazë të renditjes së kandidatëve në listat shumemërore të miratuara nga KQZ.**

Keshtu, KQZ, me Vendimin Nr.337, datë 11.05.2013, "Për miratimin e listave shumemërore të "Partisë Socialiste të Shqipërisë", për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013", ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste për të 12 zonat zgjedhore.

Sipas vendimit të mësipërm Lista shumemërore e "Partisë Socialiste" për Qarkun Gjirokastrë e miratuar nga KQZ, ka këtë renditje :

me numër rendor 1 (një) **Arben Ahmetaj,**
me numër rendor 2 (dy) **Erion Veliaj,**
me numër rendor 3 (tre) **Anastas Angjeli.**

Në këto kushte kandidatët fitues, për zgjedhjet për Kuvendin nga Lista shumemërore e Partisë Socialiste në Qarkun Gjirokastrë do të jenë personat e sipërcituar.

Po kështu, KQZ, me vendimin Nr.341, datë 11.05.2013, “Për miratimin e listave shumëmemërore të “Lëvizjes Socialiste për Integrim”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumëmemërore të Lëvizjes Socialiste për Integrim për të 12 zonat zgjedhore.

Sipas vendimit të mësipërm Lista shumëmemërore e “Lëvizjes Socialiste për Integrim” për Qarkun Gjirokastrë e miratuar nga KQZ, ka këtë renditje :

me numër rendor 1 (një) **Vangjel Tavo**.

Në këto kushte kandidati fitues, për zgjedhjet për Kuvendin nga Lista shumëmemërore e Lëvizjes Socialiste për Integrim në Qarkun Gjirokastrë do të jetë personi i sipërcituar.

Nga ana tjetër, rezultati për Qarkun Gjirokastrë për partitë politike të koalicionit Aleanca për Punësim Mirëqenie dhe Integrim është si më poshtë :

Nr.	Partitë politike	Vota
1	Partia Demokratike	13509
2	Partia Republikane Shqiptare	2642
3	Balli Kombëtar Demokrat	313
4	Partia Demokristiane e Shqipërisë	263
5	Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	242
6	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	196
7	Partia Lëvizja e Legalitetit	95
8	Aleanca Demokratike	93
9	Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	92
10	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	79
11	Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	78
12	Partia Emigracioni Shqiptar	69
13	Bashkimi Liberal Demokrat	61
14	Partia Demokracia e Re Europiane	53
15	Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare	48
16	Partia Balli Kombëtar	45

17	Partia Konservatore	38
18	Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar	36
19	Partia Lëvizja Shqipëria e Re	31
20	Partia Ora e Shqipërisë	29
21	Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare	27
22	Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar	27
23	Parti e të Drejtave të Mohuara e Re	22
24	Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European	20
25	Partia e të Drejtave të Mohuara	17
	Gjithsej	18125

Sipas nenit 163/2 të Kodit Zgjedhor, numri i votave të vlefshme të secilës parti pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë tek të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror që i korrespondon dyfishit të numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse për koalicionin në fjalë.

		1
		1
1	Partia Demokratike	13509
2	Partia Republikane Shqiptare	2642
3	Balli Kombëtar Demokrat	313
4	Partia Demokristiane e Shqipërisë	263
5	Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	242
6	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	196
7	Partia Lëvizja e Legalitetit	95
8	Aleanca Demokratike	93
9	Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	92
10	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	79
11	Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	78
12	Partia Emigracioni Shqiptar	69
13	Bashkimi Liberal Demokrat	61
14	Partia Demokracia e Re Europiane	53
15	Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare	48

16	Partia Balli Kombëtar	45
17	Partia Konservatore	38
18	Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar	36
19	Partia Lëvizja Shqipëria e Re	31
20	Partia Ora e Shqipërisë	29
21	Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare	27
22	Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar	27
23	Parti e të Drejtave të Mohuara e Re	22
24	Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European	20
25	Partia e të Drejtave të Mohuara	17

Me tej, sipas nenit 163/3 të Kodit Zgjedhor, herësit e përfuar nga çdo pjesëtim, renditen nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen për koalicionin në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, pra 1. Nga kjo renditje marrim rezultatin si më poshtë :

Nr.	Subjekti zgjedhor	Herësit
1	Partia Demokratike	13509

Ne vijim, në bazë të nenit 163/4 të Kodit Zgjedhor, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar më sipër.

Me tej akoma, në bazë të nenit 163/5 të Kodit Zgjedhor, **Kolegji Zgjedhor vlerëson se, pas përfundimit të përlllogaritjes së ndarjes së mandateve për cdo parti politike, është vendi për t'u përcaktuar mandatet nominale për cdo parti politike, në bazë të renditjes së kandidatëve në listat shumemërore të miratuara nga KQZ.**

Keshtu, KQZ, me vendimin Nr.340, datë 11.05.2013, "Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Demokratike, pjesëtare e Koalicionit Aleanca për Punësim Mirëqenie dhe Integrim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013" ka miratuar listën shumemërore të Partisë Demokratike për të 12 zonat zgjedhore.

Sipas vendimit të mësipërm Lista shumëmemërore e Partisë Demokratike për Qarkun Gjirokastrë e miratuar nga KQZ, ka këtë renditje :

me numër rendor 1 (një) **Genc Ruli**.

Në këto kushte kandidati fitues, për zgjedhjet për Kuvendin nga Lista shumëmemërore e Partisë Demokratike, në Qarkun Gjirokastrë do të jetë personi i sipërcituar.

Sa mesiper, Kolegji Zgjedhor cmon se kërkesa e paraqitur nga pala paditese Partia Socialiste e Shqipërisë duhet të pranohet si me lart u parashtrua, duke u ndare mandatet për Kuvendin për zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë.

PER KETO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë,
bazuar në nenin 158, pikat 1/b dhe 3,
si dhe nenet 162 e 163, të Kodit Zgjedhor të ndryshuar,

V E N D O S I

1. Të shpërndajë mandatet për koalicionet zgjedhore dhe partitë politike që konkurojnë më vete, në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, si më poshtë:

Aleanca për Shqipërinë Europiane 4 mandate

Aleanca për Punësim Mirëqenie dhe Integrim 1 mandat

2. Të shpërndajë mandatet brenda koalicionit zgjedhor Aleanca për Shqipërinë Europiane në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, si më poshtë:

Partia Socialiste e Shqipërisë 3 mandate

Lëvizja Socialiste për Integrim 1 mandat

3. Të shpallë kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste, për Qarkun Gjirokastrë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, si më poshtë:

I. Arben Nevruz Ahmetaj

II. Erion Luan Veliaj

III. Anastas Mihal Angjeli

4. Të shpallë kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për Qarkun Gjirokastrë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, si më poshtë:

I. Vangjel Llambi Tavo

5. Të shpërndaj mandatet brenda koalicionit zgjedhor Aleanca për Punësim Mirëqenie dhe Integrim në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, si më poshtë:

Partia Demokratike 1 mandat

6. Të shpallë kandidat fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, për Qarkun Gjirokastrë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, si më poshtë:

I. Genc Pëllumb Ruli

U shpall, sot me date 02.08.2013, ne Tirane.

ANETAR ANETAR KRYESUES
PETRIT ÇENO FUAT VJERDHA ILIR TOSKA

ANETAR ANETAR
ANDI CIVICI VALBON ÇEKREZI

* * *



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**NR. 39 REGJ. THEMELTAR
DATË 20.08.2013 REGJ.**

**Nr. 39 VENDIMI
DATË 22.08.2013 VENDIMI**

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga:

KRYESUES :	Edlira PETRI
ANËTAR :	Petrit ÇENO
ANËTAR :	Gjinovefa GABA
ANËTAR :	Kliton SPAHIU
ANËTAR :	Valbona Çekrezi

Asistuar nga sekretarja Iva Beliu, në seancën gjyqësore të datës 22.08.2013, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore, që u përket palëve:

PADITËS: Sherif Fortuzi, Kryetari i Bashkisë Sukth, i përfaqësuar me autorizim nga Z.Bledar Zerba.

I PADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Tiranë i përfaqësuar me autorizim nga Znj. Ana Tenolli.

ME OBJEKT: Kundërshtimi i vendimit nr.52, date 22.02.2013 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE: Neni 51 i Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit nr.2, date 12.12.2012 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoji përfaqësuesen e palës së paditur Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, që në kërkesat paraprake kërkoi pushimin e gjyqimit dhe shpalljen e mos kompetencës së Kolegjit Zgjedhor; përfaqësuesin e paditësit i cili kërkoi rrëzimin e kësaj kërkesë dhe zhvillimin e gjyqimit si dhe diskutoi lidhur me çështjen e kompetencës lëndore

VËREN

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.52, date 22.02.2013”Për vendosjen e sanksionit administrative ndaj Kryetarit të Bashkisë Sukth Z.Sherif Fortuzi”, ka vendosur:

- Të vendos seksionin administrative në masën 50 mijë (pesëdhjetë mijë) lekë për Z.Sherif Fortuzi, Bashkia Sukth Qarku Durrës, i cili nuk ka sjellë fare informacion në KQZ për qendrat e votimit, të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

Ky vendim rezulton të jetë marrë në kuadër të fazës përgatitore parazgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin të datës 23 qershor 2013. Shkak për konstatimin e kundërvajtjes dhe dënimin me gjobë të Kryetarit të Bashkish Sukth, sipas KQZ-së, është mospërputhja e detyrimeve të parashikuara në nenin 51 të Kodit Zgjedhor, nga paditësi, në cilësinë e kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, lidhur me ndarjen apo bashkimin e listës paraprake të zgjedhësve.

Në kushtet e mësipërme, paditësi Sherif Fortuzi ka paraqitur pranë Kolegjit Zgjedhor, padinë objekt gjykimi, me të cilën kundërshton vendimin e KQZ-së për dënimin e tij me gjobë.

Para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, përfaqësuesja e KQZ-së, i kërkoi Kolegjit Zgjedhor të konstatonte mungesën e kompetencës së tij, për gjykimin e çështjes. Nga ana tjetër përfaqësuesi i paditësit i kërkoi që Kolegji Zgjedhor të vijonte gjykimin e çështjes.

Referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor, konkludohet se Kolegji Zgjedhor nuk është kompetent nga pikëpamja lëndore për të gjykuar çështjen objekt shqyrtimi.

Pjesa X e Kodit Zgjedhor parashikon ankimin në rrugë gjyqësore të vendimeve të KQZ-së dhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Dispozitat e kësaj pjese rregullojnë gjykimin e posaçëm të mosmarrëveshjeve zgjedhore nga Kolegji i Zgjedhor. Që në Kreun I, në dispozitën e nenit 145 të këtij Kodi, titulluar “ E drejta e ankimit në gjykatë”, përcaktohen subjektet që legjitimohen t’i drejtohen Kolegjit Zgjedhor, për kundërshtimin e vendimeve të KQZ-së, e konkretisht:

“1. *Subjektet zgjedhore* kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato çënojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe *individët ose partitë politike*, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.

2. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mos marrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim. Përrjashtim nga ky rregull bëjnë vendimet e KQZ-së për rrëzimin e kërkesës ankimore në lidhje me vendime të mara në përputhje me shkronjat :a:, “b”, “c” dhe “ç” të nenit 24 të këtij Kodi.

3. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni e kanë edhe *subjektet e përmendura në nenin 6* të këtij Kodi, të cilëve u është refuzuar kërkesa për akreditimin e vëzhguesve. Në rastet kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet KZAZ-ve, atëherë e drejta e ankimit, sipas kësaj pike, fillon me ankimin administrativ, në përputhje me nenin 124 të këtij Kodi”.

Sipas kësaj dispozite subjektet të cilat mund t’i drejtohen Kolegjit Zgjedhor për të kundërshtuar vendimet e KQZ-së janë: subjektet zgjedhore sipas përcaktimit të neneve 63 e 64 të Kodit Zgjedhor, individët ose partitë politike të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor sipas neneve të sipërcituara, si edhe organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin dhe përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe medias, të cilët kërkojnë të caktojnë vëzhgues në zgjedhje (neni 6 i Kodit Zgjedhor).

Duke përcaktuar subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi në Kolegjin Zgjedhor, Kodi përcakton rrjedhimisht edhe fushën e veprimit të këtij Kolegji, duke kufizuar kompetencën e tij lëndore, me shqyrtimin vetëm të vendimeve të KQZ-së që:

- cenojnë interesat e ligjshëm të subjekteve zgjedhore;
- refuzojnë kërkesat e individëve ose partive politike për regjistrim si subjekt zgjedhor;
- refuzojnë kërkesat për akreditimin e vëzhguesve.

Në rastin në shqyrtim, paditësi në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Sukth, pretendon shfuqizimin e një vendimi të KQZ-së me të cilin është konstatuar dhe dënuar një kundërvajtje administrative. Zhvillimi i procesit zgjedhor përfshin krahas KQZ-së, si institucioni qendror për përgatitjen dhe administrimin e tij, edhe shumë organe të tjera me detyra specifike, si komisionet e zonave të administrimit zgjedhor, komisionet e qendrave të votimit, por edhe institucione të tjera administrative siç janë edhe kryetarët e njësive të qeverisjes vendore. Të gjithë anëtarët e këtyre organeve (përfshirë e kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore), janë përgjegjës për kryerjen e detyrave të tyre, duke u ndëshkuar me sanksion administrative në rastet e parashikuara në nenet 168 e vijues të Pjesës XIII të Kodit Zgjedhor “Përgjegjësitë dhe sanksionet”. Ndërkohë këto subjekte nuk janë përcaktuar nga Kodi, sit ë tillë, që të legjitimohen edhe vendimet e këtij organi për dënimin me gjobë të tyre, nuk përfshihen në ato akte administrative, që i nënshtrohen kontrollit gjyqësor prej këtij Kolegji.

Mosmarrëveshjet lidhur me shkeljet e konstatuara nga KQZ-ja, si organi kompetent i ngarkuar me ligj, dhe dhënia e dënimeve administrative, ndaj personave të ngarkuar me përgjegjësi prej Kodit Zgjedhor, janë të natyrës administrative dhe nuk përfshihen në fushën e veprimit të Kolegjit Zgjedhor. Në këto kushte, shqyrtimi i këtyre mosmarrëveshjeve administrative do të kryhet sipas rregullave të gjyqimit të posaçëm të Kodit të Procedurës Civile. Në nenin 327 të këtij kodi parashikohet se kompetenca tokësore për shqyrtimin e padisë për kundërshtimin e një akti administrative i përket seksionit përkatës të gjykatës, në zonën e së cilës ka qendrën organi administrative ndaj të cilit ngrihet padia. Në rastin konkret,

padia duhej të ishte paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi padia është ngritur ndaj KQZ-së e cila e ka qendrën në këtë qytet.

Për sa u arsyetua më sipër, Kolegji Zgjedhor konkludon se gjykata kompetente për shqyrtimin e padisë së paditësit Sherif Fortuzi, kryetar i bashkisë Sukth, është gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas nenit 158 të Kodit Zgjedhor “Llojet e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor”, në rastin kur Kolegji konstaton mungesën e kompetencës së tij, vendos pushimin e gjykimit dhe i’a dërgon çështjen organit kompetent.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës Apelit Tiranë bazuar në nenin 158 të Kodit Zgjedhor.

VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes për shkak të mungesës së kompetencës së Kolegjit Zgjedhor.
- dërgimin e kësaj çështje për kompetencë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Tiranë, më 22.08.2013

ANETAR ANETAR KRYESUES
GJINOVEFA GABA PETRIT ÇENO EDLIRA PETRI

ANETAR ANETAR
VALBON ÇEKREZI KLITON SPAHIU

* *
* *

**II. Vendime të Kolegjit Zgjedhor për
zgjedhjet e pjesshme për kryetarin
e Bashkisë Korçë të datës 3 nëntor 2013**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**NR. 45 REGJ. THEMELTAR
DATË 12.11.2013 REGJ.**

**Nr. 45 VENDIMI
DATË 18.11.2013 VENDIMI**

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykeses se Apelit Tirane i perbere nga gjyqtaret :

KRYESUES : FUAT VJERDHA
ANETAR : GJINOVEFA GABA
ANETAR : EDLIRA PETRI
ANETAR : VALBON ÇEKREZI
ANETAR : ILIR TOSKA

asistuar nga sekretarja Rexhina Baçi, ne seancen gjyqesore te dates 18.11.2013, mori ne shqyrtim ceshtjen civile qe u perket paleve :

PADITESE : **PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE,**
me Seli ne Tirane, perfaqesuar me autorizim nga Ivi Kaso.

I PADITUR : **KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE,**
me Seli ne Tirane, Bulevardi “Deshmoret e Kombit”,
Pallati i Kongreseve, perfaqesuar ne gjykim me
autorizim nga Deshira Pasko.

PALE E INTERESUAR : **PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE,**

me Seli ne Tirane, Sheshi "Austria", perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Eridian Salianji.

OBJEKTI : - Konstatimin e përfundimit të afatit ligjor për shqyrtimin e ankimit të subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë, nga KQZ, me objekt : "- Shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve në të gjitha QV-të e zonës zgjedhore Bashkia Korçë, në zgjedhjet e pjeshme për kryetarin e Bashkisë. - Shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore Bashki Korçë. - Urdherimin e perseritjes së zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore".

- Gjykimin e çështjes në themel, duke vendosur pranimin e kërkesës.

BAZA LIGJORE : Nenet 22, 24, 124, 125, 129, 130, 131, 143, 145, 152, 153, 160, 161 e vijues të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATES SE APELIT TIRANE

Pasi degjoi perfaqesuesin e pales paditese, qe kërkoj pranimin e padise; degjoi perfaqesuesen e pales se paditur, qe u shpreh se e linte ceshtjen ne cmim te gjykates; degjoi perfaqesuesin e pales se interesuar, qe kërkoj rrezimin e padise; si dhe pasi shqyrtoi ceshtjen ne teresi,

V E R E N

Pranë Kolegjit Zgjedhor ka ardhur për shqyrtim kërkesëpadija e ngritur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, me anë të së cilës kërkohet që, mbasi të konstatohet përfundimi i afatit ligjor për shqyrtimin nga KQZ të ankimit të saj, të gjykohet çështja në themel duke u shpallur të pavlefshme zgjedhjet në të gjitha QV-të e zonës zgjedhore Bashkia Korçë, në zgjedhjet e pjeshme për kryetarin e Bashkisë, të datës 03.11.2013, duke u shpallur të pavlefshme zgjedhjet në të gjithë zonën zgjedhore Bashkia Korçë, si dhe duke u urdhëruar përsëritja e këtyre zgjedhjeve në këto zone zgjedhore.

Kjo kërkesëpadi është paraqitur pasi më parë ky subjekt zgjedhor i është drejtuar KQZ-së, me kërkesë ankimore ne të njëjtin objekt.

KQZ-ja është mbledhur në datën 07.11.2013 për të shqyrtuar kërkesën ankimore të Partisë Demokratike dhe për shkak të mosformimit të shumicës së cilësuar të KQZ-së, prej pesë anëtarësh, duke u mbështetur në Vendimin Nr.17, datë 22.07.2013 të Kolegjit Zgjedhor, e ka mbyllur mbledhjen pa vendim, pasi ka konstatuar mungesën e kuorumit të nevojshëm për vlefshmerinë e mbledhjes së saj.

Ne vendimin Nr.17, datë 22.07.2013, Kolegji Zgjedhor ka arritur në përfundimin se: "..., kuorumi i nevojshëm për vlefshmerinë e mbledhjes së KQZ përcaktohet nga lloji i vendimmarrjes përfundimtare të KQZ, pra në vendime që merren me "shumicë të cilësuar" (sipas nenit 24, pika 1, gjerat "a"- "f", të Kodit Zgjedhor, që kërkon votimin "pro" të jo më pak se 5 anëtarëve) apo në vendime të tjera të ndryshme që merren me "shumicë të thjeshtë" (sipas paragrafit të fundit të nenit 24/1 të Kodit Zgjedhor, që kërkon shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KQZ, pra votimin "pro" të jo më pak se 4 anëtarëve). Nderkohe, referuar nenit 24/1 të Kodit Zgjedhor, vendimmarrjet e KQZ, ndër të tjera, përcaktohen nga lloji i kërkesave ankimore apo kërkesave të paraqitura nga subjektet zgjedhore".

Në këto rrethana, duke pasur parasysh edhe qëndrimet e mëparshme (në vendimet Nr.26 - 37, të datës 02.08.2013), Kolegji Zgjedhor çmon se kërkesëpadija e paraqitur për gjykim është në juridiksionin e tij.

Kështu, në qëndrimet e tij të mëparshme Kolegji Zgjedhor ka arsyetuar se: "..., është i njohur dhe parimi i "reformimit/ndryshimit", sipas të cilit gjykata administrative nuk mjaftohet vetëm me shfuqizimin e aktit, pasi ajo mund ta ndryshojë atë dhe, në rastet përjashtimore, edhe të nxjerre vete një akt të ri. Rregulli i përzgjedhur nga ligjvënosi në Kodin Zgjedhor i referohet parimit të "shqyrtimit kasacional", që mishëron parimin kushtetues të "ndarjes dhe balancimit të pushteteve", ndërkohe që pranon si përjashtim edhe aplikimin e parimit të "shqyrtimit reformues" në rastet e mos ushtrimit të kompetencës nga KQZ për vendimmarrje që i referohen

ne menyre eksplicite nenit 24, pika 1, gjerat "a", "b", "c" dhe "ç", te Kodit Zgjedhor, kjo sipas parashikimit te bere ne nenin 145/2 (fjalja e fundit) e ketij Kodi. Në keto raste perjashtimore, kur gjykata bindet se organi administrativ nuk e ka të mundur për të ushtruar pushtetin diskrecionar, për të vlerësuar ndërmjet më shumë se një zgjidhjeje njëloj të ligjshme, se organi administrativ nuk mund të urdhërohet për të kryer një vendimmarrje administrative, ndërkohë që janë mbledhur të gjitha faktet e nevojshme për nxjerrjen e aktit, dhe për më tepër se organi administrativ është në pamundësi objektive për të vepruar, për shkak të inkompetencës, që shkaktohet nga mungesa e kuorumit, atëherë është veçse gjykata që ka për detyrë të ushtrojë pushtetin e saj ligjor për të zgjidhur përfundimisht mosmarrëveshjen juridike të krijuar, qoftë edhe duke e nxjerrë vetë aktin administrativ. Pra, vetëm në raste të tilla dhe tepër përjashtimore, ligji mund të lejojë ushtrimin nga gjykata të një kompetence, që i përket një pushteti tjetër. Pikërisht ushtrimin e pushtetit administrativ të KQZ nga Kolegji Zgjedhor, ka përcaktuar ligjvënësi në nenin 145/2 të Kodit Zgjedhor".

Ne rastin objekt shqyrtimi, rezulton qe Kolegjit Zgjedhor t'i jete paraqitur një ankese/kërkesë për të ushtruar pushtetin lidhur me deklarimin e pavlefshem të zgjedhjeve në të gjitha QV-të te zonës zgjedhore Bashkia Korçë, në zgjedhjet e pjeshme për kryetarin e Bashkisë, me shpalljen e pavlefshme te zgjedhjeve ne kete zone zgjedhore dhe per urdhërimin e perseritjes se tyre. Arsyeja e paraqitjes së një kërkesë të tillë lidhet me pamundësinë e ushtrimit të pushtetit nga KQZ, për shkak të mungesës së quorumit prej 5 anëtarësh, si kusht për vlefshmerine e mbledhjes së KQZ (neni 22/5 i Kodit Zgjedhor) dhe për vendimmarrjen e ketij organi, në rastet e parashikuara nga neni 24, pika 1, shkronja "c" dhe "ç", të Kodit Zgjedhor.

Në kushtet kur afati 10 ditor, për shqyrtimin nga KQZ te kërkeses se subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, ka përfunduar, dhe, per me teper ne Mbledhjen e dates 07.11.2013 vetë KQZ ka konstatuar pamundësinë e mbledhjes dhe vendimmarrjes per shkak të mungesës së quorumit, Kolegji Zgjedhor vlerëson se ka, jo vetëm të drejtën, por edhe detyrimin ligjor e kushtetues që, në funksion të garantimit të shtetit të së drejtës, të shqyrtoje ne themel kerkesen e paraqitur nga ky subjekt.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se ne rastin konkret nuk jemi ne kushtet kur KQZ duhet te detyrohet per te marre vendim, por, referuar nenit 145/2 (fjalise se fundit) ne lidhje me nenin 158/1/b, jemi para rastit kur Kolegji Zgjedhor ka detyrimin të shqyrtoje çështjen ne themel dhe te vendose ne lidhje me kerkesen e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, per deklarimin e pavlefshem te zgjedhjet në të gjitha QV-të e zonës zgjedhore Bashkia Korçë, në zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e Bashkisë, te dates 03.11.2013, per shpalljen e pavlefshme te zgjedhjeve ne te gjithë zonen zgjedhore Bashkia Korçë dhe per përsëritjen e zgjedhjeve ne kete zone zgjedhore.

Nga shqyrtimi i provave të paraqitura në gjykim rezultoi e provuar se në datën 03.11.2013 janë zhvilluar zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e Bashkisë Korçë, ku kanë garuar kandidatët Sotiraq Filo, i mbështetur nga Koalicioni “Aleanca për Shqipërinë Europiane” dhe Sotiraq Stratobërdha, i mbështetur nga Partia Demokratike e Shqipërisë.

Me Vendimin Nr.4, datë 04.11.2013, KZAZ Nr.71, që administroi procesin zgjedhor në fjalë, ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore Bashkia Korçë, duke shpallur fitues Z.Sotiraq Filo me 15.953 vota, përkundrejt kandidatit tjetër Z.Sotiraq Stratobërdha me 5.283 vota.

Në mbrëmjen e datës 04.11.2013, në stacionin televiziv “Top Channel”, në emisionin “Fiks Fare”, janë transmetuar filmime, që kanë të bëjnë me procesin e votimit të zhvilluar një ditë më parë në qytetin e Korçës.

Pikërisht, bazuar në pamjet filmike të shfaqura në emisionin “Fiks Fare”, subjekti zgjedhor Partia Demokratike ka paraqitur kerkesen si me lart, fillimisht para KQZ dhe tashme para Kolegjit Zgjedhor, mbi pretendimin se procesin e votimit ne te gjitha QV-te e zones zgjedhore Bashkia Korçë, per zgjedhjet e pjesshme per kryetar Bashkie, te zhvilluar me date 03.11.2013, por edhe procesin e numërimit dhe te vlerësimit te votave ne kete njesi zgjedhore, e kanë shoqëruar shkelje të rënda të ligjit, te cilat kane cenuar rende procesin zgjedhor ne teresi dhe mund te kene ndikuar drejtpërdrejt ne ndarjen e mandateve ne kete zone zgjedhore, ku per shkak

te ketyre shkeljeve keto zgjedhje, per te gjithë zonen zgjedhore Bashkia Korçe, duhet te shpallen te pavlefshme dhe te urdhërohet përsëritja e tyre.

Konkretisht, sipas pales paditese, nga pamjet filmike të shfaqura në emisionin “Fiks Fare” rezultonte:

se ishte verifikuar masivisht fenomeni i blerjes se votes se zgjedhesve ne favor te kandidatit Sotiraq Filo, ne nje proces te paligjshem, te mire strukturuar dhe mire drejtuar nga strukturat e Partise Socialiste;

se emisioni investigativ “Fiks Fare” ne “Top Channel” ka denoncuar zbulimin e abuzimeve flagrante te shtabit elektoral te kandidatit te Partise Socialiste ne zgjedhjet e dates 03.11.2013 ne Bashkine e Korçes;

se kamerate “Fiks Fare” kishin filmuar të gjithë procesin e pagesës prej 2.000 lekësh për person, që i’u është bërë zgjedhësve në këmbim të votës, ku nje shtab pune i ngritur posacerisht per fushaten nga Partia Socialiste ishte kujdesur deri ne detaje, duke patur per qellim kryesor qe ne keto zgjedhje te siguronin sa me shume vota ne mbështetje te kandidatit Sotiraq Filo ne shkembimi te nje shume te hollash, konkretisht 2.000 leke te reja per cdo vote pro Partise Socialiste;

se gazetarët e “Fiks Fare” kishin zbuluar e filmuar me detaje mënyrën se si shtabi i Partise Socialiste operonte me zgjedhësit, të cilët më përpara kontaktoheshin në telefon, ku u tregohej fillimisht që duhej të votonin dhe më pas të shpërbleheshin, nderkohe qe, qe të gjithë zgjedhësit që duhet të votonin kandidatin e Partise Socialiste, kane qene të regjistruar në një listë, qe mbahej nga disa të rinj, anëtarë të shtabit të Z.Filo, liste kjo ku studentët ishin të regjistruar me numra telefoni celular, të cilëve, pasi verifikohej qe kishin votuar, nëpërmjet bojës në gishtin e madh të dorës, iu bëhej dhe pagesa prej 2.000 lekësh;

se provohej qe nje numer i larte dhe i vazhdueshem zgjedhësish ishin paraqitur ne menyre sistematike per te marre shpërblimin tek zyra e ngritur posacerisht nga shtabi elektoral i Partise Socialiste.

Referuar fakteve, qe sipas pales paditese vërtetoheshin nga pamjet filmike të shfaqura në emisionin “Fiks Fare”, subjekti zgjedhor Partia Demokratike pretendon se :

si pasoje e veprimtarise masive te paligjshme te blerjes se votes, ne rastin konkret ka patur deformim te thelle te vullnetit te zgjedhesve te zones zgjedhore Bashkia Korçe, jo vetem duke orientuar voten ne nje drejtim te caktuar, por edhe duke demotivuar zgjedhesit e tjere, ata te cilet nuk shkuan te votojne te bindur se vota e tyre nuk do te kishte asnjë vlere, c’ka per rrjedhoje ka sjelle nje rezultat zgjedhor te deformuar ne kete zone, duke materializuar ate “shkelje te ligjit te cilat kane cenuar rende procesin zgjedhor”, te cilen kërkon si rekuizit neni 160, pika 1/a, e Kodit Zgjedhor, per shpalljen e pavlefshmerise se zgjedhjeve ne nje apo disa qendra votimi;

shpallja fitues e kandidatit te Partise Socialiste nuk ka ardhur si pasoje e votave te marra nga zgjedhesit, por si rrjedhoje e zgjedhesve, te cilet i besuan ofertes se tij ekonomike te bere ne shkelje te ligjit, rregullit dhe moralit, per me teper kur blerja e votes perben dhe veper penale parashikuar nga Kodi Penal i Republikes se Shqiperise; filmimet e paraqitura ne emisionin investigativ ne fjale, ishin vetem maja e ajsgbergut, vetem ajo c’ka u arrit t’i përcillej publikut shqiptar me ze dhe figure, duke qene ajo dhe dëshmia me e qarte e atij abuzimi masiv me voten e zgjedhesve korçare nga Partia Socialiste;

ne rastin konkret ka patur nje manipulim elektorral, cenim te votes se lire dhe mungese te zgjedhjeve te lira, manipulim ky, megjithëse i denueshem ne vetvete, nuk mund kurrsesi te cenoje thelbin e garancise kushtetuese per “nje sistem zgjedhjes te lira, te barabarta, te përgjithshme e periodike” mbi te cilin bazohet qeverisja e vendit, si dhe ate te “nje vote te lire, te barabarte dhe te fshehte”, sanksionuar nga nanet 1 dhe 45 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, prandaj shkelja e ligjit ne rastin konkret eshte materializuar ne formen me te rende dhe nuk mund te ndëshkohej ne asnjë menyre tjetër pervecse duke shpallur te pavlefshme zgjedhjet ne te gjitha qendrat e votimit te zones zgjedhore Bashkia Korçe.

Si përfundim, pala paditese ka parashtruar se, nisur nga përmasat e fenomenit, si dhe nga pamundësia për ta dokumentuar në mënyrë specifike incidencën e tij për secilin qender votimi nga njëra anë, por edhe me synimin për t'i vënë fre një here e mire praktikës së turpshme antiligjore të deformimit të vullnetit ose teleguidimit të votës, duke qenë ajo e bindur se përmasa reale e fenomenit ishte shumë here më e madhe nga sa ishte dokumentuar dhe denoncuar nga emisioni investigativ "Fiks Fare", kërkonte shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në të gjitha qendrat e votimit të zonës zgjedhore Bashkia Korçë dhe urdhërimi i perseritjes së zgjedhjeve për kryetar Bashkie në këto zone zgjedhore, në përputhje me nenin 161 të Kodit Zgjedhor, pasi pavlefshmëria e zgjedhjeve në të gjitha qendrat e votimit automatikisht ndikonte në ndarjen e mandateve të kësaj zone zgjedhore.

Në lidhje me sa pretendoi, pala paditese kërkoi që në gjykim të merrej si provë një CD që përmbante pamjet filmike të shfaqura, me datë 04.11.2013, në emisionin "Fiks Fare" në "Top Channel".

Në kohë, në lidhje me sa pala paditese pretendoi, pala e paditur KQZ evidentoi në gjykim faktin e pamundësisë së marrjes nga ajo të një vendimi në lidhje me kërkesën e paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike, duke u shprehur se tashmë e linte ceshtjen në vlerësim të Kolegjit Zgjedhor. Nga ana e saj, pala e paditur paraqiti në gjykim si prova Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore Bashkia Korçë dhe Procesverbalin e Mbledhjes së KQZ të datës 07.11.2013.

Nga ana tjetër, pala e interesuar Partia Socialiste, kundërshtoi pretendimet e palës paditese, duke konsideruar abuzive padinë e paraqitur dhe parashtruar se procesi zgjedhor për zgjedhjet e pjeshme për kryetar Bashkie, në zonën zgjedhore Bashkia Korçë, të zhvilluara me datë 03.11.2013, nuk ka patur parregullsi dhe shkelje të ligjit dhe, aq më pak, ato të jenë të dokumentuara në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor. Po kështu, pala e interesuar pretendoi se pamjet filmike, mbi të cilat pala paditese referon padinë e saj, nuk provonin shkeljen e pretenduar të ligjit, për më tepër kur, sipas palës së interesuar, pala paditese nuk evidenton faktet konkrete që

rezultojnë sipas ketyre filmimeve, duke konsideruar pretendimet e saj thjeshte si deklarata politike qe synonin te perbaltnin procesin zgjedhor te zhvilluar ne kete zone zgjedhore, ne përfundim te te cilit kandidati i mbështetur nga pala paditese kishte humbur me nje diference te theksuar votash, përmbi 10.500 vota.

Ne konsiderate te kërkesave per prova te paraqitura nga palet, Kolegji Zgjedhor vendosi të marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga ato, perfshire dhe CD e paraqitur nga pala paditëse.

Ne lidhje me kete prove, Kolegji Zgjedhor realizoi këqyrjen e materialit filmik të emisionit “Fiks Fare” të televizionit “Top Channel”, ku nga shqyrtimi i provës në seancë gjyqësore, u konstatua se CD-ja përmbante të gjithë filmimin e emisionit “Fiks Fare” transmetuar në datë 04.11.2013, përfshirë edhe hapësirat e reklamave. Në këto kushte, pas përcaktimit të palës paditëse, u këqyrën vetëm tri sekuenca të filmimit, që lidheshin me çështjen objekt shqyrtimi. Filmimet e paraqitura rezultuan ato të shfaqura publikisht nga kanali televiziv “Top Channel” dhe të aksesueshme për publikun, nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik siç janë faqet e ndryshme të internetit, që kanë shpërndarë këto filmime.

Keshtu, në sekuencën e parë dëgjohej një dialog mes një studenteje (sipas titrave të autorëve të programit) dhe gazetarit të emisionit, i zhvilluar në një lokal. Nga dialogu, merret informacioni nga studentja se asaj dhe studentëve të tjerë, me studime në Tiranë, Partia Socialiste u jepte një shumë parash prej 2.000 lekësh, në këmbim të ardhjes në Korçë për të votuar. Konkretisht, studentja ka thene se “Partia Socialiste jep një shumë lekësh që unë të votoj për ta”, ku interesimit te gazetares, per shumen e lekeve qe i jepnin, i eshte përgjigjur “20 mijë lekë (të vjetra)”, nderkohe qe vërejtjes se gazetares se kjo shume ishte e vogel, studentja i eshte përgjigjur se “Po vetëm rrugën që të vesh e të vish, sepse s’vinë të votojnë një herë. Është pershembull si në Selanik, e marrin ata që janë emigrantë dhe paguajnë vetëm rrugën, nuk është se japin lekë”. Me tej, studentja evidenton faktin se “Nuk ka shumë votues”. Gjithashtu, ne kete bisede, studentja i tregon gazetarit edhe vendin se ku kryhej pagesa e lekëve për votuesit, “Tek “Dolce Vita” rrugica këtu, ku ikën për te 3-shi, te Folia”.

Sekuena e dytë paraqet pamjet e gazetares së emisionit, e cila, ne rrugë, komunikon me një banor të qytetit të Korçës. Gazetarja pyet se ku është selia e Partisë Socialiste, duke i'u prezantuar atij si studente dhe se do të merrte ca lekë, nderkohe që banori i tregon asaj se rrugën që duhet të mbante për të shkuar atje ku kërkonte.

Së fundi, ne sekuencën e tretë, paraqiten pamjet e një ambienti të brendshëm ku gjendet tri shtetase, të sistemuara në tavolina dhe të pajisura me disa lista. Në sfondin e ambientit dallohen simbolet elektorale të Partisë Socialiste. Dialogu nis me përshëndetjen e studentes, e cila u thotë vajzave të mësipërme se ishte studente, se e kishin marrë në telefon dhe i kishin thënë që pasi të vinte te vinte te paraqitej aty. Pasi kanë marrë të dhënat e studentes dhe numrin e telefonit, vajzat kanë verifikuar listat dhe, me pas, ajo është paguar me shumën e 2.000 lekëve, duke e falënderuar për mbështetjen. Më tej paraqiten të tjera pamje të të njëjtit vend, ku studentja e mësipërme u thotë vajzave që mbanin listat, se kishte sjellë disa vajza që nuk e dinin se ku duhej të paraqiteshin. Rezulton se njëra prej tyre fillimisht paguhet me 2.000 lekë. Një tjetër votuese rezulton se nuk i është gjetur emri në listë dhe për këtë arsye është refuzuar të kryhet pagesa. Filmimet ndërpriten hera herës, si rrjedhojë e montimit të pamjeve. Në vijim rezulton se vajzat që kryenin pagesën prej 2.000 lekësh, verifikonin më parë emrat e votuesve apo numrat e tyre të telefonit në listat që administronin dhe, vetëm nëse emri i votuesit apo numri i tij i telefonit gjendej në listë, ato kryenin pagesën prej 2.000 lekësh. Kështu nga pamjet duket sërish një tjetër studente, që del me 2.000 lekë në dorë dhe regjistrimi mbyllet me refuzimin që i bëhet një studentit pasi nuk e kishte emrin në listë dhe as numrin e telefonit.

Bazuar në të dhënat e sjella nga kjo provë pala paditëse kërkoi që të shpallen të pavlefshme zgjedhjet në të gjitha qendrat e votimit të zones zgjedhore Bashkia Korçe, bazuar në nenin 160, pika 1, germa "a", të Kodit Zgjedhor, duke pretenduar se nga materiali filmik provohet se kanë ndodhur shkelje të rënda të ligjit në të gjitha qendrat e votimit, të cilat kanë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në fitimin e mandatit të kryetarit të Bashkisë Korçe nga kandidati Sotirajq Filo.

Nga kqyrja e materialeve filmike në seancë gjyqësore, rezulton e provuar se stafi i kandidatit për kryetar të Bashkisë Korçë, Z.Sotiraq Filo, i mbështetur nga Koalicioni “Aleanca për Shqipërinë Europiane”, kishte te parapërgatitura nje liste me emra studentësh dhe numrat e telefonit te tyre, të cilët ishin kontaktuar më parë me telefon dhe ftuar për të ardhur për të votuar. Po keshtu, rezulton e provuar se te pakten ne 3 raste, studentët që kishin emrin në këto lista, pasi kishin votuar, jane paguar me 2 mije lekë nga ana e stafit te kandidatit për kryetar të Bashkisë Korçë, Z.Sotiraq Filo, nderkohe qe te pakten ne 2 raste te tjera, studentet qe nuk kishin emrin ne keto lista, nuk e kane marre nje pagese te tille. Ne vijim, rezulton e provuar se kjo pagesë eshte bere në kompensim të shpenzimeve të transportit për studentët korçarë, që studionin në universitetet e Tiranës.

Pra, nga te dhenat e pamjeve filmike, provohet se nga ana e stafit te kandidatit për kryetar të Bashkisë Korçë, Z.Sotiraq Filo, i mbështetur nga Koalicioni “Aleanca për Shqipërinë Europiane”, jane identifikuar zgjedhes te kategorise studente, qe studionin ne Tirane, duke krijuar nje liste me emrat e tyre, ashtu si dhe numrat e telefonit, te cilet jane kontaktuar ne telefon përpara dates se zgjedhjeve (dates 03.11.2013), duke u ftuar per te votuar ne qytetin e Korçes kundrejt kompensimit te shpenzimeve të transportit, ne nje shume prej 2 mije lekesh, menyre te vepruari kjo qe ka funksionuar, ku te pakten ne 3 raste studente korçare qe studionin ne Tirane kane shkuar per te votuar me daten 03.11.2013, duke iu paguar atyre me pas shuma 2 mije leke nga ana e stafit te kandidatit për kryetar të Bashkisë Korçë, Z.Sotiraq Filo.

Kolegji Zgjedhor, pasi shqyrtoi pretendimin e palës paditëse për përsëritjen e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Korçë, por edhe duke e vlerësuar këtë pretendim në raport me pretendimet e palës së interesuar, si dhe në raport me proporcionalitetin e masës së ndërhyrjes, arrin në përfundimin se ne rastin konkret kane ndodhur shkelje te ligjit qe kane cenuar procesin zgjedhor, por nuk provohet qe keto shkelje te jene ne nje mase te tille sa te mund te kene ndikuar ne ndarjen e mandatit te kryetarit te Bashkise

Korçe, c'ka nga ana tjetër të coje në pavlefshmerinë e zgjedhjeve të pjesëshme për kryetar Bashkie në zonën zgjedhore Bashkia Korçe dhe urdhërimin e perseritjes së zgjedhjeve në këto zona zgjedhore.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, që në nenin 1 të saj, sanksionon një nga parimet e demokracisë, e cila lidhet me qeverisjen e bazuar në një sistem zgjedhesh të lira, të barabarta, të përgjithshme dhe periodike. Më tej, në kreun për të drejtat dhe liritë politike, në nenin 45 të Kushtetutës, përcaktohet si një ndër të drejtat e njeriut edhe ajo e votës vetjake, të barabartë, të lirë dhe të fshehtë. Këto parime përfaqësojnë standardin e vendosur edhe nga e drejta ndërkombëtare universale me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (përfshirë këtu edhe praktikën e Gjykatës së Strasburgut).

Parë në aspektin ligjor, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, në nenin 3 të tij, parashikon ndër parimet e së drejtës së zgjedhjeve, zhvillimin e zgjedhjeve periodike, të lira, të fshehta, të barabarta dhe të drejtpërdrejta. Kjo dispozitë thekson ushtrimin e lirë të së drejtës së votës nga zgjedhësit.

Me qëllim zhvillimin e zgjedhjeve në standardin kushtetues të ligjor, ligji ka parashikuar edhe përgjegjësinë penale apo administrative ndaj personave që me veprimet apo mosveprimet e tyre të paligjshme cenojnë procesin zgjedhor. Kodi Zgjedhor në pjesën XIII të tij "Përgjegjësitë dhe sanksionet" (nenet 168 e vijues), parashikon shkeljet konkrete për të cilat ligji përcakton dënimin administrativ, kurse veprat penale të kryera në dëm të procesit zgjedhor, përcaktohen në Kodin Penal.

Lidhur me kërkimin e palës paditëse për perseritjen e zgjedhjeve në nenin 160 të Kodit Zgjedhor titulluar "Pavlefshmëria e zgjedhjeve në qendrën e votimit" përcaktohet se:

"1. KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, në rast se:

a) kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;

...

3. Kërkesa për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të përmbajë shkaqet ligjore, përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre.

...”

Ndersa, në nenin 161 të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon përsëritjen e zgjedhjeve, përcaktohet se:

“1. Pas përfundimit të procesit të ankimit, jo më vonë se 3 ditë nga nxjerrja e rezultatit të zonës zgjedhore, KQZ-ja kryesisht ose me kërkesë të subjektit, shpall të pavlefshme dhe urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore, kur pavlefshmëria e shpallur në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi, ndikon në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore ose në shkallë vendi.

2. ... Për zgjedhjet për kryetar të qeverisjes vendore ndikim në rezultat do të konsiderohet kur numri i zgjedhësve në qendrat e shpallura të pavlefshme është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme. ...”.

Nga analiza e dispozitave të mësipërme rezulton se Kodi Zgjedhor obligon pavlefshmërinë me rrjedhojë përsëritjen e zgjedhjeve, në ato raste kur:

1. Vërtetohen *“shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor”*;

2. Tërësia e shkeljeve "mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar" në rezultatin e zgjedhjeve;

Sipas palës paditëse, nga filmimet e paraqitura si provë, vërtetohet se në procesin zgjedhor për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Korçë kanë ndodhur disa shkelje të renda të ligjit, të cilat kanë cenuar procesin në atë masë sa kanë ndikuar në rezultatin përfundimtar.

Kolegji Zgjedhor vuri në diskutim rastet, për të cilat ligji parashikon pavlefshmërinë e zgjedhjeve, për rrjedhojë dhe përsëritjen e tyre, që janë ekzistenca e shkeljes së ligjit, që e ka cenuar rëndë procesin zgjedhor dhe masa e ndikimit të kësaj shkelje në rezultatin përfundimtar.

Për të vlerësuar (pa)ligjshmërinë e një veprimi të kryer, pra për të vërtetuar atë që parashikon Kodi Zgjedhor, nëse shkelja e ligjit ka qenë e tillë sa ka cenuar rëndë procesin zgjedhor, apo nëse tërësia e shkeljeve të kryera ka qenë e atyre përmasave sa mund të ketë ndikuar" në rezultatin e zgjedhjeve, Kolegji Zgjedhor orientohet nga konceptet që ka përpunuar jurisprudenca gjyqësore mbi parimin e proporcionalitetit.

Terminologjia "rëndë" dhe ndikimi "në një masë të tillë", i përdorur në nenin 160, pika 1, shkronja "a" të Kodit Zgjedhor, imponon kryerjen nga gjykata të një vlerësimi të arsyeshëm, objektiv dhe të paanshëm, mbi natyrën e shkeljes së ligjit. Kolegji Zgjedhor vlerëson se kuptimi i saktë dhe i drejtë i terminologjisë së përdorur në këtë dispozitë ligjore, duhet të analizohet dhe vlerësohet në tërësi nga disa faktorë, që kanë të bëjnë me rëndësinë e shkeljes së ligjit, pasojat e ardhura apo që mund të vinin nga kjo shkelje, kohëvazhdimin e këtyre pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si dhe vetë qëndrimin subjektiv, që mban personi konkret ndaj shkeljes së kryer dhe pasojës së ardhur. (*Shih vendimin nr. 75, datë 19.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese*).

Termi "rëndë", i përdorur në ligj, për të dalluar intensitetin e cenimit që mund t'i bëhet procesit zgjedhor, nënkupton dhe interpretimin a *contrario* se, procesi zgjedhor do të pranohet si i vlefshëm dhe ligjor, përderisa shkeljet e kryera nuk janë të asaj shkalle, sa të vlerësohen

si të rënda. Pra, cilësimi “rëndë” i shërben gjykatës për të dalluar këto veprime, nga sjelljet e një kategorie më të lehtë, të cilat nuk mund të përdoren për të cenuar të gjithë procesin zgjedhor dhe për të shpallur të pavlefshme zgjedhjet. Ky është një koncept që pranohet tashmë, jo vetëm nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese apo e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, por dhe nga legjislati ynë. Këtë kuptim ka edhe neni 40, pika 4 i Ligjit Nr.49, datë 03.05.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, sipas të cilit “Gjykata vendos rrezimin e padisë dhe kur vlerëson se, *pavarësisht shkeljeve procedurale të konstatuara të veprimtarisë administrative, pasojat do të ishin të njëjta.*” Pikërisht, këtë vlerësim bën Kolegji Zgjedhor, nisur nga parimi i proporcionalitetit, parim i cili kërkon një baraspeshim të përshtatshëm e të arsyeshëm (pa shpërfilluar faktet apo rrethanat që kanë rëndësi për çështjen), midis cenimit që i bëhet një të drejte konkrete dhe interesit të ligjshëm publik.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se liria e votës apo votimi i lire është një ndër parimet kushtetuese dhe ligjore të zgjedhjeve demokratike. Referuar Kodit Zgjedhor, nenit 3, rezulton se ky parim u krijon subjekteve zgjedhore të drejten për të garuar në një proces zgjedhor të drejtë e të barabartë, nëpërmjet prezantimit gjatë fushatës zgjedhore të programeve të tyre zgjedhore në çdo formë dhe mënyrë të ligjshme. Nëpërmjet programit zgjedhor secili subjekt zgjedhor synon të fitojë besimin e zgjedhësve dhe, për rrjedhojë, edhe votën pozitive të tyre. Nderkohe, liria e zgjedhësit për të formuar opinionin e tij dhe për të vendosur të votojë ose jo, e nëse po, për kë nga subjektet, përbën aspektin e parë të së drejtës për një votim të lirë, krahas lirisë për ta shprehur këtë vullnet.

Kolegji Zgjedhor, duke iu referuar rastit në shqyrtim, konstaton se kontaktimi i zgjedhësve të caktuar (studentë) dhe kërkesa ndaj tyre për të shkuar për të votuar, në këmbim të pagesës së shpenzimeve të udhëtimit, përbën një cenim të vullnetit të zgjedhësit për të vlerësuar i pandikuar procesin e votimit, pikërisht cenon lirinë e tij për të formuar opinionin nëse do të votojë ose jo. Për standardin që kërkon një proces i ndershëm zgjedhor, nuk ka rëndësi fakti se për kë subjekt kanë votuar studentët e paguar, përderisa ata rezultojnë tashmë të ndikuar në vullnetin e tyre ndaj procesit.

Në këtë aspekt, referuar dhe Kodit të Praktikës së Mire në Çështjet Zgjedhore miratuar nga Komisioni i Venecias, sjellja e stafit të kandidatit fitues, ndikon rrjedhimisht dhe në parimin e barazisë së shanseve mes subjekteve zgjedhore, të cilët duhej të garonin nëpërmjet programeve të tyre zgjedhore. Pretendimi për ta paraqitur rastin në shqyrtim si krijim të lehtësive për një kategori të caktuar zgjedhësish, nuk e përlligj veprimin e stafit të kandidatit fitues, përse kohë që Kodi Zgjedhor nuk e parashikon një masë të tillë, për më tepër të ndërmarrë nga një prej subjekteve zgjedhore. Kodi Zgjedhor në dispozitat e tij, ka marrë në konsideratë disa elementë objektivë të procesit zgjedhor me qëllim garantimin e zgjedhësit për të votuar i lirë (për shembull mënyra se si caktohen qendrat e votimit), por ky Kod, në asnjë rast, nuk parashikon mundësinë e financimit nga subjekte zgjedhor, kandidatë apo individë të shpenzimeve, që zgjedhësi duhet të bëjë për të arritur deri në qendrën e tij të votimit.

Në rastin në shqyrtim, rezulton se te pakten 3 studentë janë paguar, për arsye se kishin votuar, sipas një premtimi të mëparshëm nga stafi i kandidatit fitues.

Lidhur me shkeljet e ligjit, që mund ta kenë cenuar rëndë procesin zgjedhor, Kolegji Zgjedhor analizoi faktet e vërtetuara në gjykim, e që lidhen me pagesën e te pakten 3 studentëve nga stafi i kandidatit Sotiraq Filo, të cilëve u rimburoheshin shpenzimet e udhëtimit nga Tirana, ku ata studionin, për në Korçë, me kushtin për të votuar. Pagesa e kryer në këto raste rezulton në kuadër të një parapërgatitje të stafit të kandidatit për të nxitur apo siguruar pjesëmarrjen në votim të votuesve. Nisur nga qëllimi final i subjekteve zgjedhore, ai i fitimit të zgjedhjeve, krijohet bindja se në listat e parapërgatitura janë përfshirë votues, që subjektivisht për kandidatin vlerësoheshin si votues në favor të tij. Kjo bindje krijohet edhe për shkak se në procesin gjyqësor nuk u paraqitën prova që të vërtetojnë se stafi i kandidatit fitues ka përpiluar lista ku të përfshiheshin të gjithë studentët korçarë që studiojnë në Tiranë. Në vijim të analizës së provës së shqyrtuar, Kolegji Zgjedhor nuk krijon bindjen se, siç pretendohet nga pala paditëse, kandidati fitues i zgjedhjeve ka blerë votat e votuesve, të cilëve u ka paguar më pas shumë prej 2.000 lekë, në kuptimin që zgjedhesve në këtë rast iu është cenuar liria për të shprehur vullnetin e tyre. Ky konkluzion bazohet në faktin se, personat e paguar pranonin të ishin kontaktuar më parë me telefon

dhe se u ishte premtuar pagesa prej 2.000 lekësh vetem nëse ata do të votonin. Kjo pagesë është kryer vetëm me vërtetimin e faktit se studenti në listë kishte votuar, por pa iu kërkuar qoftë edhe pohimi se për kë kishte votuar dhe, aq me pak, për të vërtetuar në ndonjë mënyrë një fakt i tillë.

Nisur nga përfundimi se në procesin zgjedhor për Kryetarin e Bashkisë Korçë, provohen të jenë kryer shkelje të ligjit, Kolegji Zgjedhor diskutoi edhe lidhur me çështjen, nëse këto shkelje kanë cenuar procesin zgjedhor në atë masë, sa kanë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, pra që numri i votave rrjedhë e shkeljes së kësaj natyre të jetë më i madh se diferenca e votave të vlefshme mes dy kandidatëve, pra 10.670 vota. Lidhur me këtë çështje, pala paditëse pretendoi se fakti i pasqyruar në filmimin e shqyrtuar në seancë gjyqësore, përbën një fenomen masiv të zgjedhjeve për Kryetarin e Bashkisë Korçë, ndaj edhe mund të ketë ndikuar në rezultatin e votimit. Kolegji e gjen të pabazuar në fakt këtë pretendim, pasi masiviteti i fenomenit pretenduar nga pala paditëse nuk u provua në gjykim, duke mbetur në kuadrin e një hipoteze. Megjithatë, edhe nëse do të ketë pasur raste të tjera të pagesës së shpenzimeve të udhëtimit për studentët, nuk vërtetohet se kanë qenë të paktën 10.670 studentë, që kanë votuar pasi më parë janë regjistruar në listat e kandidatit fitues. Kolegjit madje nuk i rezulton i provuar as fakti lidhur me numrin e studentëve korçarë që studiojnë në Tiranë, për të vlerësuar mundësinë e ndikimit të votave të tyre në rezultatin e zgjedhjeve.

Kodi Zgjedhor cilëson si kundërvajtje administrative shkeljen e parimeve të zgjedhjeve, të përcaktuara në nenin 3 të Kodit Zgjedhor, ku përfshihet edhe liria e votës (neni 172 i Kodit Zgjedhor). Megjithatë përsëritja e zgjedhjeve nuk mund të kryhet për çdo shkelje të evidentuar, qoftë kjo edhe lidhur me parimet e zgjedhjeve, përveçse kur provohet se shkeljet janë të tilla që kanë ndikuar në rezultatin final. Në rastin konkret, duke mbajtur në konsideratë numrin total të votuesve, 21.236 të tillë, si dhe diferencën mes dy kandidatëve prej 10.670 vota, vlerësohet e pamundur që studentët e ardhur për të votuar me nxitjen e kandidatit fitues, të jenë në masë të barabartë ose më të madhe me votat që përbëjnë diferencën mes fituesit dhe humbësit të zgjedhjeve.

Në kushte të tilla, Kolegji Zgjedhor konkludon se, nga vlerësimi që i bën shkeljeve të ligjit, të cilat nuk janë të asaj natyre dhe të asaj mase sa të kenë ndikuar në rezultatin zgjedhor, i cili dukshëm rezulton me diferencë ndërmjet kandidatëve, kërkesëpadia duhet të rrezohet.

PER KETO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykates se Apelit Tirane,

bazuar ne nenin 158, pikat 1/b dhe 3,
te Kodit Zgjedhor te ndryshuar,

V E N D O S I

Rrëzimin e kërkesëpadiisë.

U shpall, sot me date 18.11.2013, ne Tirane.

ANETAR
EDLIRA PETRI

ANETAR
GJINOVEFA GABA

KRYESUES
FUAT VJERDHA

ANETAR
VALBON ÇEKREZI

ANETAR
ILIR TOSKA

* * *

**III. Vendime të Kolegjit Zgjedhor për
zgjedhjet për organet e qeverisjes
vendore të datës 21 qershor 2015**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**NR. 2 REGJ. THEMELTAR
DATË 23.03.2015 REGJ.**

**Nr. 2 VENDIMI
DATË 31.03.2015 VENDIMI**

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykeses se Apelit Tirane i perbere nga gjyqtaret :

KRYESUES :	PETRIT ÇENO
ANETAR :	GJINOVEFA GABA
ANETAR :	EDLIRA PETRI
ANETAR :	ILIR TOSKA
ANETAR :	KLITON SPAHIU

asistuar prej sekretares Rexhina Baci, në Tiranë, sot me datë 06.10.2014, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore, që u përket paleve:

PADITËSE : **KOMUNA ISHËM,**
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Teuta Koçi.

I PADITUR : **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Olsi Peto.

OBJEKTI : Anullimin e Vendimit Nr.43, date 16.03.2015, te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE : Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS APELIT TIRANË

Pasi vuri ne diskutim ceshtjen e kompetences lendore te Kolegjit Zgjedhor te Gjykares se Apelit Tirane per shqyrtimin e ceshtjes; degjoi palët prezent, perfaqesuesen e pales paditese dhe perfaqesuesin e pales se paditur, qe u shprehen se kompetenca lendore per shqyrtimin e ceshtjes i perkiste Kolegjit Zgjedhor te Gjykares se Apelit Tirane,

VEREN

Me Dekretin Nr.8844, datë 15.12.2014, ne mbështetje të neneve 92/gj dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 9§1§2 dhe 10§1§2 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), Presidenti i Republikës së Shqipërisë ka caktuar datën 21 qershor 2015 per zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Nderkohe, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (me poshte referuar si KQZ-ja) është organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod, referuar nenit 2/7 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar. Por, ne lidhje me përgatitjen e zgjedhjeve, perfshire dhe zgjedhjet per qeverisjen vendore, Kodi Zgjedhor i ndryshuar ka percaktuar dhe nje sere subjektesh te tjere, perfshire dhe zyrtare te qeverisjes vendore, nder ta edhe kryetaret e njesive te qeverisjes vendore, per te cilit ligji percakton detyrime konkrete lidhur me përgatitjen e listave te zgjedhesve (neni 51) dhe përcaktimin e qendrave te votimit (neni 62), duke u percaktuar per ata dhe nje afat kohor 30 ditor, qe fillon jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve, qe ne lidhje me zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015 ky afat fillonte me date 14.01.2015.

Ne lidhje me caktimin e vendndodhjes se qendrave te votimit dhe pergatitjen e hartes se njesise se qeverisjes vendore per zgjedhjet, si dhe dhenien e informacionit te percaktuar nga ligji per KQZ-ne, ky i fundit, ne përputhje me kompetencen e tij ka miratuar dhe Udhezimin Nr.01, date 12.12.2012, "Per menyren e ngritjes dhe caktimit te vendndodhjes se qendrave te votimit dhe përgatitjen e hartes se njesise se qeverisjes vendore per zgjedhjet".

Dhe ndersa afati ligjor per dergimin KQZ-se te informacioneve ne lidhje me qendrat e votimit ka përfunduar ne kuadër te procesit te përgatitjes se zgjedhjeve per qeverisjen vendore te dates 21 qershor 2015, KQZ-ja ka konstatuar se per disa njesi te qeverisjes vendore nuk jane përmbushur detyrimet e tyre ligjore, duke vlerësuar se nje mospermbushje e tille e detyrimeve ligjore passillte pergjegjesi administrative per titullaret e tyre.

Mbi kete baze, KQZ-ja ka vendosur te filloje nje procedure administrative per vendosje te sanksioneve administrative ndaj kryetareve te njesive te qeverisjes vendore te cilet nuk kishin dorëzuar ne KQZ te dhenat mbi qendrat e votimit per zgjedhjet e organeve te qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015.

Rezulton qe nje procedim i tille administrativ te jete iniciuar edhe kunder Kryetarit te Komunes Ishëm, Qarku Durres, Z. Sulejman Ibrahim, i cili, me Shkresen e KQZ-se Nr.2043 prot., date 09.03.2015, eshte ftuar te marre pjese ne kete procedim, ne kuadër te te cilit eshte zhvilluar dhe nje seance degjimore me date 16.03.2015.

Del qe, me date 16.03.2015, KQZ te kete realizuar seancen degjimore, ku ka marre pjese dhe N/Kryetari i Komunes Ishëm, i cili ka dhene shpjegimet e tij ne lidhje me mosdergimin e informacionit perkates prane KQZ-se ne afatin e percaktuar nga ligji.

Ne përfundim te këtij procedimi administrativ, KQZ-ja, ne përputhje me kompetencen e percaktuar ne nenin 21/20 te Kodit Zgjedhor (te ndryshuar) dhe bazuar ne nenin 169 te këtij Kodi, me Vendimin Nr.43, date 16.03.2015, ka vendosur te ndeshkoje administrativisht me gjobe ne masen 50.000 leke Z. Sulejman Ibrahim, Kryetar i Komunes Ishëm, Qarku Durres, per mos dergim te informacionit per qendrat e votimit dhe hartes se njesise se qeverisjes vendore per zgjedhjet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015.

Dhe ndersa Kodi Zgjedhor (i ndryshuar) hesht, nuk rregullon te drejten e ankimit te zyrtareve te organeve te qeverisjes vendore ndaj vendimeve te KQZ-se per ndëshkimin e tyre administrativisht me gjobe sipas nenit 169 te këtij Kodi, KQZ-ja ne rastin konkret del qe ne vendimin si me lart te kete evidentuar se ndaj këtij vendimi mund te behej ankim ne Kolegjin Zgjedhor prane Gjykates se Apelit

Tirane brenda 5 diteve nga shpallja e tij. Duket qe ne kete rast KQZ-ja te kete patur ne konsiderate rregullimin e bere ne nenin 152 te Kodit Zgjedhor (te ndryshuar).

Nisur nga ky përcaktim i bere nga KQZ-ja, me date 20.03.2015, Komuna Ishëm ka paraqitur përpara Kolegjit Zgjedhor te Gjykates se Apelit Tirane ankim kunder Vendimit te KQZ-se Nr.43, date 16.03.2015, mbi pretendimin se ky vendim eshte i paligjshem ne rrethanat kur informacioni perkates i eshte derguar ne afat KQZ-se.

Ne përmbushje te detyrimit ligjor per shqyrtimin e cdo ceshtje te paraqitur përpara tij, pas realizimit te procedurave administrativo-procedurale, Kolegji Zgjedhor i Gjykates se Apelit Tirane, ne seancen gjyqesore te dates 31.03.2015, referuar fakteve si me lart, vuri paraprakisht per diskutim përpara paleve prezent ne gjykim kompetencen e tij lendore per shqyrtimin e ceshtjes.

Sipas perfaqesueses se pales paditese, ceshtja eshte ne kompetencen lendore te Kolegjit Zgjedhor pasi keshtu eshte percaktuar ajo ne vendimin objekt ankimi te KQZ-se.

Nderkohe, perfaqesuesi i KQZ-se u shpreh se kompetenca lendore ne rastin konkret i perkiste Kolegjit Zgjedhor pasi, sipas Kodit Zgjedhor (te ndryshuar), vendimet e KQZ-se te marra sipas ketij Kodi mund te ankimoheshin vetem ne Kolegjin Zgjedhor.

Nisur nga sa me lart u parashtrua, Kolegji Zgjedhor vlerëson se ceshtja objekt shqyrtimi, paraqitur përpara tij si me lart, nuk eshte pjese e juridiksionit te tij gjyqësor dhe ne kompetencen lendore te tij, shkak per te cilin, ne zbatim te nenit 158/2 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, cmon se duhet te vendose pushimin e gjykimit te ceshtjes në Kolegjin Zgjedhor.

Lidhur me kete, Kolegji Zgjedhor ka parasysh lenden per shqyrtim, qe eshte nje vendimmarrje e KQZ-se per denimin administrativ me gjobe te nje zyrtari te organit te qeverisjes vendore, nxjerrë ne ushtrim te funksioneve te saj publike, ne përmbushje te pergjegjesive dhe sipas kompetencave te dhena nga Kodi Zgjedhor (i ndryshuar) lidhur me pergatitjen e zgjedhjeve (ne rastin konkret te zgjedhjeve per qeverisjen vendore).

Po keshtu, Kolegji Zgjedhor ka parasysh se KQZ-ja eshte nje organ publik, i krijuar me ligj, Kodin Zgjedhor te miratuar me Ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar, qe sipas nenit 2/7 te tij, "është organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod", ku ne ushtrim te pergjegjesive sipas këtij funksioni publik, KQZ-ja vepron si dhe cdo organ tjetër i administrates publike ne fushen e te drejtes publike dhe administrative, vendimmarrjet apo veprimtaria administrative e te cileve, sipas ligjit, i nënshtrohet kontrollit gjyqësor.

Me tej, Kolegji Zgjedhor ka parasysh se Kodi Zgjedhor (i ndryshuar) ka percaktuar rregullat për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet, duke përcaktuar ne menyre te veçante, ne nenin 21, kompetencat e KQZ-se si institucioni publik i ngarkuar per përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve.

Ne vijim, Kolegji Zgjedhor ka parasysh se Kodi Zgjedhor (i ndryshuar) ka rregulluar edhe rishikimin/kontrollin gjyqësor te nje kategorie te caktuar te vendimeve te KQZ-se te nxjerra ne kuadër dhe lidhur me përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve, rishikim/kontroll gjyqësor ky qe i eshte ngarkuar nje gjykate te posaçme autonome te krijuar sipas këtij Kodi, pikërisht Kolegjit Zgjedhor, organ gjyqësor ky i vetmi i ngarkuar nga ligji (Kodi Zgjedhor) per shqyrtimin e nje kategorie ceshtjesh qe lidhen me zgjedhjet (për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet), vendimet e te cilit jane te formes se prere, te paankimueshme.

Pra, Kolegji Zgjedhor ka parasysh se ligji, Kodi Zgjedhor (i ndryshuar), ndersa ka rregulluar shprehimisht rishikimin/kontrollin gjyqësor te nje kategorie te caktuar ceshtjesh, vendimesh te KQZ-se, mosmarrëveshjes zgjedhore, ka percaktuar ne kete menyre dhe juridiksionin gjyqësor qe i perket Kolegji Zgjedhor, si dhe kompetencen lendore te tij per shqyrtimin e tyre.

Ne kete kuptim, Kolegji Zgjedhor vlerëson se jo cdo vendimmarrje e KQZ-se, e nxjerre ne kuadër te veprimtarise se saj administrative, sipas funksionit publik dhe kompetencave te dhena nga Kodi

Zgjedhor (i ndryshuar), mund të jete objekt rishikimi/kontrolli gjyqësor nga Kolegji Zgjedhor, përkundrazi, juridiksioni gjyqësor i Kolegjit Zgjedhor dhe kompetenca e tij lëndore është vetëm për një kategori të caktuar mosmarrëveshjesh zgjedhore, të përcaktuara shprehimisht nga ligji, Kodi Zgjedhor (i ndryshuar).

Konkretisht, në Pjesën IX, Kreu I, të Kodit Zgjedhor (i ndryshuar), rregullohet “ankimi në rrugë gjyqësore të vendimeve të KQZ”, institut ligjor ky nepermjet të cilit ligjvënisi ka përcaktuar juridiksionin gjyqësor që i përket Kolegjit Zgjedhor dhe kompetencën lëndore të tij, duke përcaktuar shprehimisht mosmarrëveshjet zgjedhore dhe subjektet që mund të paraqesin ankim në Kolegjin Zgjedhor.

Kështu, në **nenin 145** të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar), titulluar “E drejta e ankimit në gjykatë”, parashikohet se :

“1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.

2. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim. Përrjashtim nga ky rregull bëjnë vendimet e KQZ-së për rrëzimin e kërkesës ankimore në lidhje me vendimet të marra në përputhje me shkronjat “a”, “b” “c” dhe “ç” të nenit 24 të këtij Kodi.

3. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe subjektet e përmendura në nenin 6 të këtij Kodi, të cilëve u është refuzuar kërkesa për akreditimin e vëzhguesve. Në rastet kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet KZAZ-ve, atëherë e drejta e ankimit, sipas kësaj pike, fillon me ankimin administrativ, në përputhje me nenin 124 të këtij Kodi.

Ndersa, ne **nenin 152** te Kodit Zgjedhor (te ndryshuar), titulluar “Afati i ankimit në gjykatë”, parashikohet se :

1. **Ankimet, sipas këtij Kodi**, paraqiten në Gjykatën e Apelit, Tiranë, e cila ia kalon ato Kolegjit Zgjedhor.

2. Ankimi për të gjitha vendimet që KQZ-ja merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tyre. Për vendimet që KQZ-ja merr jashtë kësaj periudhe, afati i ankimit në Kolegjin Zgjedhor është 30 ditë”.

Se cilet jane “subjektet zgjedhore” përcaktohen ne nenin 2/20 te Kodit Zgjedhor (te ndryshuar), sipas te cilit “Subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod”.

Kurse subjekte sipas nenit 6 te Kodit Zgjedhor (te ndryshuar) del te jene perseri “subjektet zgjedhore”, por edhe organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe përfaqësues të medias.

Pra, nga sa me lart, rezulton se jo cdo vendimmarrje e KQZ-se sipas kompetencave te saj te percaktuara ne nenin 21 te Kodit Zgjedhor (te ndryshuar) mund te ankimohet perpara Kolegjit Zgjedhor, perkundrazi, mund te ankimohet perpara Kolegjit Zgjedhor vetem nje kategori e caktuar vendimesh te saj dhe vetem nga nje kategori e caktuar subjektesh, percaktuar shprehimisht ne nenin 145 te ketij Kodi.

Ne rastin konkret, vendimi i KQZ-se i ankimuar perpara Kolegjit Zgjedhor, ashtu sikunder dhe subjekti qe ka paraqitur ankimin, nuk perfshihen ne asnjë prej mosmarrëveshjeve zgjedhore qe ben fjale neni 145 i Kodit Zgjedhor (te ndryshuar), zgjidhja e te cilave t'i perkase juridiksionit gjyqësor dhe competences lendore te Kolegjit Zgjedhor.

Nga ana tjetër, vendimmarrja e KQZ-se për të cilën kërkohet rishikimi gjyqësor në rastin konkret, rezultoi të jetë një akt administrativ individual (akt administrativ denimi me gjobe), i nxjerr për kundër një subjekti konkret (jo “subjekt zgjedhor” dhe as subjekt sipas nenit 6 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar), që materializon vullnetin e këtij organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik sipas nenit 21/20 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar). Sipas kësaj dispozite, “KQZ-ja ka këto kompetenca : ... 20. Vendos sanksione administrative kundër personave, që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet, si dhe bën kallëzim penal për vepra penale në lidhje me zgjedhjet”. Pra, në rastin konkret jemi para një vendimi të një organi të administratës publike, që ka kompetencën të nxjerre akte administrative individuale, veprimtaria e të cilit rregullohet me ligj të posaçëm (Kodi Zgjedhor), ligj i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative dhe dënimin me gjobë, vendim ky që krijon pasoja juridike në një rast individual, domethënë jemi para një vendimi për kundërvajtje administrative.

Për rrjedhojë, në referim të neneve 21/20 dhe 169 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar), neneve 20 dhe 26 të Ligjit Nr.10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe të neneve 2/2/6, 7/a dhe 72/2 të Ligjit Nr.49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Kolegji Zgjedhor cmon se në rastin konkret jemi para një mosmarrëveshje administrative, zgjidhja e të cilit i përket juridiksionit gjyqësor të gjykatave administrative të shkallës së parë, që kanë dhe kompetencën lëndore për shqyrtimin e saj. Nderkohe, referuar neneve 2/7 dhe 11/1 të Ligjit Nr.49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, gjykata administrative e shkallës së parë, që ka dhe kompetencën tokësore për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative në rastin konkret, është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pikërisht gjykata që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ (ka nxjerr aktin administrativ) që kundërshtohet.

Sa me sipër, në zbatim të ligjit të posaçëm që rregullon veprimtarinë e tij (Kodi Zgjedhor), Kolegji Zgjedhor konkludon se gjykimi i çështjes përpara tij duhet të pushohet, ndërsa çështja duhet t'i

dergohet organit kompetent gjyqësor, qe sic u parashtrua me lart eshte Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane.

PER KETO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykates se Apelit Tirane,
bazuar ne nenin 158, pika 2, te Kodit Zgjedhor (te ndryshuar),

V E N D O S I

Pushimin e gjykimit te ceshtjes ne Kolegjin Zgjedhor te Gjykates se Apelit Tirane.

Dergimin e ceshtjes per shqyrtim Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane.

Ky vendim eshte i formes se prere dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë, me date 31.03.2015.

ANËTAR
GJINOVEFA GABA

ANËTAR
EDLIRA PETRI

KRYESUES
PETRIT ÇENO

ANËTAR
ILIR TOSKA

ANËTAR
KLITON SPAHIU

* * *



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**NR. 3 REGJ. THEMELTAR
DATË 07.04.2015 REGJ.**

**Nr. 3 VENDIMI
DATË 14.04.2015 VENDIMI**

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykeses se Apelit Tirane i perbere nga gjyqtaret:

KRYESUES :	GJINOVEFA GABA
ANETAR :	EDLIRA PETRI
ANETAR :	PETRIT CENO
ANETAR :	VALBON CEKREZI
ANETAR :	ILIR TOSKA

Asistuar nga sekretarja Rexhina Baci, ne seancen gjyqesore te dates 14.04.2015, mori ne shqyrtim ceshtjen civile qe u perket paleve:

PADITESE: PARTIA E TE DREJTAVE TE MOHUARA,
me seli ne Tirane, Rruga “Budi” Nr10, perfaqesuar ne gjykim nga kryetari Z. Ilir Vata.

I PADITUR: KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE,
me seli ne Tirane, Bulevardi “Deshmoret e Kombit”,
Pallati i Kongreseve, perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Olsi Peto.

OBJEKTI: Rrezimi i vendimit te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve Nr.79, date 04.04.2015, ne dem te Partise se te Drejtave te Mohuara (per mosmarrjen pjese ne

zgjedhjet e 21 Qershorit 2015) dhe regjistrimin e Partise "P.D.M-se" si subjekt zgjedhor ne zgjedhjet vendore te 21 Qershorit 2015.

BAZA LIGJORE: Neni 145, pika 1 i Kodit Zgjedhor, per ankimin ne rrugen administrative ivendimit te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATES SE APELIT TIRANE

Pasi degjoi perfaqesuesin e pales paditese, qe kerkoi pranimin e padise; degjoi perfaqesuesen e pales se paditur, qe u shpreh per lenien ne fuqi te vendimit te K.Q.Z, pasi shqyrtoi ceshtjen ne teresi,

VEREN

Me kerkesepadine e paraqitur me date 07.04.2015, nga Partia "Partia e te Drejtave te Mohuara", me shkronja nistore "P.D.M", ne cilesine e nje partie politike qe ka marre pjese ne zgjedhjet per Kuvendin te dates 23.06.2013, nepermjet Kryetarit te saj, z. Ilir Vata, me date 30.03.2015 me nr. 2312 prot, ka paraqitur kerkesen prane Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, per zgjedhjet per Organe te Qeverisjes Vendore qe do te zhvillohen ne date 21 qershor 2015.

Mbi kerkesen e kesaj Partie, ne baze te nenit 64 pika 1 dhe 2 per regjistrimin e partive politike, eshte depozitur prane KQZ-se gjithje dokumentacioni perkates per regjistrimin si subjekt zgjedhor ne zgjedhjet vendore.

Komisioni Qendrori Zgjedhjeve, me vendimin Nr.79 date 04.04.2015, ka marre ne shqyrtim kerkesen e Partise "Partia e te Drejtave te Mohuara" per regjistrimin si subjekt zgjedhor ne zgjedhjet vendore te 21 qershorit 2015 dhe ne perfundim ka vendosur qe te mos pranoje kerkesen e Partise "P.D.M-se" per t'u regjistruar si subjekt zgjedhor per zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015.

Ne kete perfundim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka arritur me arsyetimin se, ne rezultatet perfundimtare te zgjedhjeve per Kuvendin, te dates 23 Qershor 2013, si Parti "Partia e te Drejtave te Mohuara", nuk ka marre mbi 0,5% te votave te vlefshme ne rang vendi dhe nuk i eshte pergjigjur nenit 87, pika 8 te Kodit Zgjedhor per kthimin e fondit te marre paradhenie brenda afatit 90 ditore, ne

shumen 61.321 leke, kriteret keto te cilat perbejne pengese per regjistrimin si subjekt zgjedhor ne zgjedhjet e rradhes.

Partia e te Drejtave te Mohuara, ne ankimin drejtuar Kolegjit Zgjedhor, ka pretenduar se per detyrimin ligjor qe ka patur si subjekt zgjedhor ne zgjedhjet parlamentare te qershorit 2013, per kthimin e fondeve te perfituara nga buxheti i shtetit per fushaten zgjedhore te vitit 2013, prej 61.321 mije leke, sipas pikes 6 te Nenit 87/1 te ligjit Nr 10019, nuk eshte informuar ne rruge zyrtare nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, as ne adrese te kryetarit Z. Ilir Vata (Rruga "Budi", Nr10, Tirane) ku i referohet emrit, mbiemrit dhe adreses se kryetarit te Partise si dhe ne adresen zyrtare te Partise te te Drejtave te Mohuara qe perkon me Adrese: Bulevardi Zogu I, ndertesa 20, kodi postare 1016, kati shtate.

Nga aktet e administruara ne shqyrtimin e ceshtjes ne Kolegjin Zgjedhor, eshte provuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ne vendimin Nr.79 te dates 04.04.2014 ka vendosur qe te mos regjistroje Partine e te Drejtave te Mohuara, si subjekt zgjedhor ne zgjedhjet vendore 21 qershorit 2015, per shkak se ka kaluar afatin e kthimit te fondit qe ka perfituar kjo Parti, duke iu referuar nenit 87 pika 8 te ligjit Nr.10019 date 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar.

Nga teresia e akteve te administruara ne shqyrtimin e ceshtjes perpara Kolegjit Zgjedhor dhe rrethana te faktit te provuara, konstatohet se vendimi i Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, i ankimuar nga Partia "P.D.M" eshte i pa bazuar ne ligj e prova, rrjedhoje i mosrespektimit te normave procedurale, qe lidhet me njoftimin e akteve zyrtare.

Rezulton nga aktet, nga kerkesa per gjykim, nga pretendimet e ankuesit si dhe nga permbajtja e vendimit te ankimuar, se objekt i ketij gjykimi jane te drejta te pretenduara qe lidhen me regjistrimin e Partise "Partia e te Drejtave te Mohuara" si subjekt zgjedhor, ne zgjedhjet e 21 qershorit 2015, bazuar ne piken 1 te nenit 64 te Kodit Zgjedhor, te ndryshuar.

Sipas pikes 8 te nenit 87 te Kodit Zgjedhor, parashikohet qe partite politike qe nuk kalojne pragun e percaktuar ne piken 5 te ketij neni, brenda 90 diteve te kthejne fondet perkatese, ne te kundert humbasin te drejten e financimeve te tjera publike si dhe nuk regjistrohen si subjekt zgjedhor ne zgjedhjet e rradhes.

Ne gjykim prane Kolegjit Zgjedhor, eshte administruar si prove nga ana e K.Q.Z, "Njoftimi per kthimin e shumes te perfituar si

paradhenie nga buxheti i shtetit, per fushaten zgjedhore te zhvilluar per zgjedhjet per Kuvend te 2013, me Nr 6231 prot Dt 07.102013, drejtuar Partise, "Partia e te Drejtave te Mohuara".

Ne rastin ne shqyrtim, Kolegji Zgjedhor konstaton se, lidhur me kete njoftim nuk eshte paraqitur asnje prove nga K.Q.Z, ku te pasqyrohet personi qe ka marre njoftimin, neshkrimi origjinal ose kopja e saj, i cili te kete marre persiper detyrimin qe kopja e njoftimit t'i dorezohet Komisionit Qendror te Zgjedhjeve.

Referuar sa me lart, ne kushtet qe ne vendqendrimin e marresit ose ne zyren e kryetarit te Partise "P.D.M", apo vendin ku ushtron veprimtarine Partia "Partia e te Drejtave te Mohuara" nuk eshte bere i mundur njoftimi sipas rregullave te njoftimit te akteve, Kolegji Zgjedhor cmon se vendimi i ankimuar eshte i pa bazuar ne ligj e prova, rrjedhoje i zbatimit te gabuar normave procedurale "Mbi njoftimin e akteve".

Rezulton, se ne shqyrtimin e ceshtjes ne Kolegjin Zgjedhor, nuk u evidentua asnje e dhene ne lidhje me identifikimin e personit i cili ka marre njoftimin per kthimin e shumes, kohen e paraqitjes se njoftimit brenda afatit qe eshte percaktuar ne piken 8 te neni 87 te Kodit Zgjedhor. I bie barra e proves K.Q.Z. te provonte respektimin e ketij afati.

Ne kushtet qe nuk provohet nje gje e tille, kerkesa e ankuesit per regjistrimin e Partise "Partia e te Drejtave te Mohuara", si subjekt zgjedhor per zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dt 21.06.2015, eshte e drejte e per rrjedhoje legjitimohet ne kerkimin e tij.

Sa me siper, Kolegji Zgjedhor i Gjykates se Apelit Tirane cmon se kerkesa e paraqitur nga pala paditese Partia "P.D.M", duhet te pranohet si me lart u parashtua, duke u vendosur pranimi i padise, shfuqizimi i vendimit Nr.79 dt.04.04.2015 te K.Q.Z.

Regjistrimin e Partise, "Partia e te Drejtave te Mohuara", me kryetar Z. Ilir Vata dhe shkonja nistore "P.D.M" si subjekt zgjedhor per zgjedhjet per Organe te Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015.

PER KETO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykates se Apelit Tirane bazuar ne nenet 64, 145 pika1 te Kodit Zgjedhor,

VENDOSI

-Pranimin e padise.

-Shfuqizimin e vendimit Nr. 79 dt. 04.04.2015, te K.Q.Z.

-Regjistrimin e Partise "Partia e te Drejtave te Mohuara", me kryetar Z. Ilir Vata dhe shkronja nistore P.D.M si subjekt zgjedhor per zgjedhjet ne Organet e Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015.

U shpall sot, me date 14.04.2015.

**ANETAR
VALBON ÇEKREZI**

**ANETAR
ILIR TOSKA**

**KRYESUESE
GJINOVEFA GABA**

* * *



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**NR. 05 REGJ. THEMELTAR
DATË 18.04.2015**

**Nr. 05 VENDIMI
DATË 24.04.2015**

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykeses se Apelit Tirane i perbere nga gjyqtaret:

KRYESUES :	ANDI CIVICI
ANETAR :	EDLIRA PETRI
ANETAR :	VALBON ÇEKREZI
ANETAR :	ILIR TOSKA
ANETAR :	FUAT VJERDHA

Me sekretare **Zana Disha**, në Tiranë, sot në date **24.04.2015**, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore me nr.05 Akti, që u përket palëve:

PADITESE: Partia Socialdemokrate Shqipërisë,
përfaqësuar nga kryetari i saj Z. Skender Gjinushi dhe Av. Arben Hakani.

I PADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,
përfaqësuar me autorizim nga Znj. Dëshira PASKO dhe Olsi PETO.

OBJEKTI:

- Konstatimi i pavlefshmerise absolute i ndryshimeve te bera arbitrarisht nga i padituri ne permbajtjen e Vendimit Nr.88, datë 07.04.2015, "Per miratimin e modeleve te kandidimit qe do te perdoren ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore date 21.06.2015", pas zbardhjes dhe publikimit te ketij vendimi ne faqen zyrtare te KQZ, pasi jane kryer pa respektuar procedurat ligjore (mbledhje, votim, vendimmarrje) dhe ne kundërshtim me frymen dhe permbajtjen e ligjit.
- Lenien ne fuqi te vendimit të marre nga KQZ me permbajtjen e miratuar ne mbledhjen e dates 07.04.2015, ora 12.00, pa ndryshimet e kryera pas publikimit fillestar te tij ne faqen zyrtare te ketij institucioni.

BAZA LIGJORE: Nenet 1/3, 4 dhe 42 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise; nenet 22,23, 24, 68, 70, 144, 145-158, të Ligjit Nr.10019, date 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise" i ndryshuar; nenet 115/a, 116 dhe 117 te Kodit te Procedurave Administrative.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoi palët prezent në pretendimet e tyre, paditësin nëpërmjet përfaqësuesve që në perfundim kërkuan pranimin e padisë sipas objektit, përfaqësuesen e pales së paditur, që kërkoi pushimin e gjykimit ose rrezimin e padise, pasi administroi provat e bisedoi çështjen në tërësi;

V È R E N

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ), ne Mbledhjen e dates 07.04.2015, bazuar ne nenet 23/1/a, 71/1 dhe 72/1 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, me Vendimin Nr.88, ka miratuar modelet e kandidimit qe do te perdoren ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015, konkretisht duke disponuar si vijon :

“1. Per zgjedhjet e organeve te qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015 per Kryetar Bashkie dhe anetar Keshilli, te miratoje modelet e dokumentacionit te kandidimit si me poshte :

- a. Model 01 K, “Kerkese per regjistrimin e kandidatit te propozuar nga zgjedhesit per Kryetar/Anetar Keshilli i Bashkise, qe zotëron mandat ne Kuvend/Keshillin e Bashkise, apo si kryetar i njesise se qeverisjes vendore”.
 - b. Model 02 K, “Kerkese e partise per regjistrimin e kandidatit per kryetar bashkie”.
 - c. Model 03 K, “Kerkese e koalicionit per regjistrimin e kandidatit per Kryetar Bashkie”.
 - d. Model 04 K, “Per regjistrimin e Komitetit Nismetar”.
 - e. Model 05 K, “Deklarate e kandidatit per Kryetar/Anetar Keshilli te Bashkise”.
 - f. Model 06 K, “Deklarate e kandidatit per kryetar/anetar Keshilli Bashkie te propozuar nga zgjedhesit”.
 - g. Model 08 K, “Lista mbeshtetese per paraqitjen e kandidateve per Kryetar Bashkie/Anetar Keshilli, nga partia politike/koalicioni/apo kandidatet e propozuar nga zgjedhesit”.
 - h. Model 09 K, “Deklarim i subjektit paraqites te listes shumemerore per vendet sipas kuotes gjinore”.
 - i. Model 10 K, “Kerkese per regjistrimin e listes shumemerore te kandidateve”.
 - j. Model 11 K, “Kerkese per regjistrimin e kandidatit te propozuar nga zgjedhesit”.
 - k. Model 12 K, “Procesverbal i dorëzimit te dokumenteve te kandidimit”.
2. Te miratoje modelet e vendimeve te KZAZ-se si me poshte :
- a. Model - 13 V, Vendim “Per regjistrimin e kandidatit per Kryetar Bashkie”.
 - b. Model - 14 V, Vendim “Per mos regjistrimin e kandidatit per

Kryetar Bashkie”.

- c. Model - 15 V, Vendim “Per regjistrimin e listes shumemerore per Keshillin e Bashkise”.
- d. Model - 16 V, Vendim “Per mos regjistrimin e listes shumemerore per Keshillin e Bashkise”.

Me Vendimin Nr.103, date 09.04.2015, bazuar ne nenin 64 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, KQZ ka vendosur “Te regjistroje Partine “Partia Socialdemokrate e Shqipërisë”, me kryetar Z. Skender Gjinushi, dhe shkronjat nistore “PSD”, si subjekt zgjedhor per zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015”.

Me date 17.04.2015, subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë (PSD) ka paraqitur përpara KQZ-se nje kerkese per sqarim ne lidhje me Vendimin Nr.88, date 07.04.2015, “Per miratimin e modeleve te kandidimit, qe do te perdoren ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015”, duke parashtruar se vendimin e zbardhur te dates 07.04.2015, KQZ e kishte publikuar menjehere ne faqen zyrtare te saj, ndersa kishte shperndare dhe modelaret perkates, por se, nga nje verifikim i kryer ate dite ne faqen zyrtare te KQZ, ishte konstatuar se vendimi kishte pesuar ndryshime ne përmbajtje, ndryshime keto arbitrare qe preknin aspekte thelbesore te ligjit dhe nuk ishin produkt i nje vendimmarrje ne përputhje me procedurat qe parashikonte Kodi Zgjedhor dhe vene keshtu ne diskutim legjitimitetin e zgjedhjeve.

Me kerkesen e paraqitur ky subjekt zgjedhor i kërkonte KQZ-se te konfirmonte zyrtarisht se cili ishte vendimi i miratuar ne Mbledhjen e dates 07.04.2015, ora 12.00, ai i publikuar ditën e marrjes se vendimit apo ai qe rezultonte ate dite i publikuar ne faqen zyrtare te saj.

Po keshtu, me kerkesen e paraqitur, subjekti zgjedhor PSD i ka kërkuar KQZ t'i vinte ne dispozicion nje ekzemplar te vendimit te quajtur përfundimtar, me qellim ndjekjen e procedurave te mëtejshme ligjore te ankimit nese do te ishte e nevojshme.

Ne përgjigje te kësaj kerkese, me Shkresen Nr.2891/1 prot., date 18.04.2015, ndersa i ka derguar nje kopje te njesuar me origjinalin te Vendimit Nr.88, date 07.04.2015, Sekretari i Pergjithshem i KQZ-

se ka sqaruar subjektin zgjedhor PSD se cdo variant tjetër që mund të gjendej elektronikisht, i ndryshem nga vendimi i derguar, nuk ishte versioni zyrtar i vendimit të KQZ-se.

Po kështu, subjekti zgjedhor PSD është informuar se, sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e KQZ-se”, materialet e mbledhjes së thirrur për cdo ceshtje në shqyrtim (projekaktet) publikoheshin në faqen zyrtare të KQZ-se në internet, ndërsa ato qëndronin të publikuara nga momenti i daljes së rendit të ditës dhe deri në miratimin e tyre përfundimtar nga KQZ, ku pas miratimit përfundimtar të aktit nga KQZ, në faqen zyrtare të internetit publikohej sipas rastit vendimi ose udhëzimi i KQZ-se.

Pas kësaj, me datë 18.04.2015, PSD ka paraqitur në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë (me poshtë referuar si Kolegji Zgjedhor) një kërkesepadi, me të cilën, duke paditur KQZ-ne, ka kërkuar:

konstatimin e pavlefshmerisë absolute të ndryshimeve të bera arbitrarisht nga i padituri në përmbajtjen e Vendimit Nr.88, datë 07.04.2015, “Për miratimin e modeleve të kandidimit që do të perdoren në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore datë 21.06.2015”, pas zbardhjes dhe publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të KQZ, pasi janë kryer pa respektuar procedurat ligjore (mbledhje, votim, vendimmarrje) dhe në kundërshtim me frymen dhe përmbajtjen e ligjit;

lenien në fuqi të vendimit të marrë nga KQZ me përmbajtjen e miratuar në mbledhjen e datës 07.04.2015 ora 12.00, pa ndryshimet e kryera pas publikimit fillestar të tij në faqen zyrtare të këtij institucioni.

Paditësi PSD, në kërkesepadi dhe gjatë gjykimit pretendoi se:

- Vendimi i KQZ-se Nr.88, datë 07.04.2015, që gjendet aktualisht i publikuar në faqen zyrtare të KQZ-se dhe vëne në dispozicion të paditesit ka përmbajtje të ndryshme nga vendimi i publikuar menjëherë pas marrjes së këtij vendimi dhe konkretisht:

ne vendimin e publikuar fillimisht arsyetohej se:

“... Neni 68, pika 2 e Kodit Zgjedhor parashikon se kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3.000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit, ose kur zotërojnë bashkërisht në këshillin përkatës një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit.

... Neni 70 parashikon të drejtën e një grup zgjedhësish të propozojnë kandidat për kryetar bashkie, apo për këshillat vendor. Për paraqitjen e kandidatëve nga zgjedhësit krijohet një Komitet Nismëtar i përbërë nga 9 zgjedhës të zonës zgjedhore përkatëse. Komiteti nismëtar krijohet për organizimin e punën për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve që do të mbështesin kandidatin. Sipas nenit 71 të Kodit Zgjedhor për mbledhjen e nënshkrimeve KQZ duhet të miratojë dhe të pajisë subjektet zgjedhore të interesuara me formularin tip për mbledhjen e nënshkrimeve. Bashkëlidhur formularit për çdo zgjedhës, duhet të depozitohet fotokopja e letërnjoftimit të vlefshme e nënshkruar nga zgjedhësi. Përjashtohen nga detyrimi i mësipërm kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, nëse janë kryetar bashkie ose komune, anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse (sipas ligjit për ndarjen territoriale, do të përfshihen ish komunat dhe bashkitë që tashmë janë njësi administrative përbërëse të bashkisë për të cilën do të kandidohet) ose deputet.

ndersa, ne vendimin e publikuar aktualisht arsyetohet se :

“... Neni 68, pika 2 e Kodit Zgjedhor parashikon se kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose si kryetar bashkie apo si anëtar i këshillit të bashkisë

përkatëse, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3.000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit, ose kur zotërojnë bashkërisht në këshillin e bashkise përkatës një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit.

... Neni 70 parashikon të drejtën e një grup zgjedhësish të propozojnë kandidat për kryetar bashkie, apo për këshillat vendor. Për paraqitjen e kandidatëve nga zgjedhësit krijohet një Komitet Nismëtar i përbërë nga 9 zgjedhës të zonës zgjedhore përkatëse. Komiteti nismëtar krijohet për organizimin e punën për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve që do të mbështesin kandidatin. Sipas nenit 71 të Kodit Zgjedhor për mbledhjen e nënshkrimeve KQZ duhet të miratojë dhe të pajisë subjektet zgjedhore të interesuara me formularin tip për mbledhjen e nënshkrimeve. Bashkëlidhur formularit për çdo zgjedhës, duhet të depozitohet fotokopja e letërnjoftimit të vlefshme e nënshkruar nga zgjedhësi. Përjashtohen nga detyrimi i mësipërm kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, *nëse janë kryetar bashkie, anëtarë të këshillit të bashkisë përkatëse ose deputet.*

- Me ndryshimin e tekstit të vendimit, i padituri ndryshoi dhe udhëzuesit për plotësimin e modeleve të kandidimit duke e reflektuar në dokumentacionin që duhej t'i bashkangjitej kërkesave për regjistrim (Model 03 K dhe Model 10 K)
- Nga krahasimi i teksteve të mesiperme, nepermjet ndryshimeve të kundërligjshme, i padituri ka mbajtur qëndrim të kundërt duke aplikuar përjashtimin nga rregulli i mbledhjes së nënshkrimeve të zgjedhësve vetëm për candidate të paraqitur nga parti politike që këne mandate vetëm bashkite përkatëse dhe jo në komuna, ndryshime këto arbitrare që prekin aspekte thelbësore të ligjit dhe që nuk janë produkt i një vendimmarrjeje në përputhje me procedurat që parashikon Kodi Zgjedhor, por i veprimeve haptazi manipulative të të paditurit, që vëne në diskutim legjitimitetin e zgjedhjeve. Për rrjedhojë i padituri ndryshoi

edhe udhëzuesit për plotësimin e modeleve të kandidimit duke reflektuar në dokumentacionin që duhej t'i bashkangjitej kërkesave për regjistrim (Model 03 K dhe model 10 K)

- Duke ndryshuar përmbajtjen e vendimit të mëparshëm të votuar dhe miratuar në mbledhjen e datës 07.04.2015, zbardhur dhe publikuar menjëherë në faqen zyrtare, KQZ ka vepruar në kundërshtim flagrant me ligjin, duke qenë ndryshimet e bëra në përmbajtjen e këtij vendimi, ashtu sikundër dhe përcaktimet e bëra në udhëzuesit për plotësimin e modeleve të kandidimit, absolutisht të pavlefshme në vështrim të Kodit të Procedurave Administrative, për shkak të mosrespektimit të kushteve që kërkon ligji për të qenë të vlefshme, konkretisht për shkak të mosrespektimit të procedurës, votimit dhe vendimmarrjes që parashikon Kodi Zgjedhor në nenet 22, 23, 24 dhe 144.
- Edhe sikur për një moment të pranohej se është respektuar procedura, persëri ndryshimet e bëra në këtë vendim të KQZ-se janë të pavlefshme për shkak se vijne në kundërshtim të hapur me frymen dhe përmbajtjen e ligjit, si dhe cenojnë parimin kushtetues të “barazisë së votës” (neni 1/3 i Kushtetutës), parim ky që ndalon shtetin të diskriminojë apo privilegjojë kandidatë të caktuar, parti politike ose grupime të tjera politike në përballjen konkurruese për të tërhequr votën e zgjedhësit, ku çdo kufizim i drejtperdrejtë ose i tërthortë mbi barazinë e partive në konkurrimin zgjedhor nuk duhet të ketë një pasoje diferencuese ose të përbejë një trajtim preferencial për disa parti ose të ndalojë pjesëmarrjen e partive politike në konkurrimin zgjedhor.
- Duke iu referuar ndryshimeve të bëra nga i padituri në Vendimin Nr.88, datë 07.04.2015, shihet se përjashtimi nga rregulli i mbledhjes së nënshkrimeve të zgjedhësve bëhet vetëm për kandidatë të paraqitur nga parti politike që kanë mandate vetëm bashkë të perkatese dhe jo në komuna ku paditesi ka me dhjetra të mandatuar, çka bën që formulimi i bërë në këtë vendim të KQZ-se të vijë në kundërshtim me frymen dhe qëllimin e Kodit Zgjedhor, nenit 68/2, ndërsa pengon arbitrarisht paditesin të kandidojë pa qenë nevoja e mbledhjes së nënshkrimeve të zgjedhësve, pra duke injoruar i padituri votat e zgjedhësve

te dhena per nje mandat ne këshillin e komunes, ndersa i jep vlere dhe perparesi vetem atyre ne këshillat e bashkive, gje qe cenon rende parimin e “barazise se votave dhe perfaqesimit te barabarte”, te sanksionuara dhe ne Udhezimet e Raportit Shpjegues te Kodit te Praktikës se Mire ne Ceshtjet Zgjedhore te Komisionit te Venecias.

Pala e paditur KQZ, prapësoi pretendimet e paditësit duke parashtruar se:

- Padia, ankimi i paditesi, eshte paraqitur tej afatit 5 ditor te ankimit ne gjykate, Kolegjin Zgjedhor, te parashikuar ne nenin 145 ne lidhje me nenin 152 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, kur vendimi nga KQZ eshte shpallur me date 07.04.2015, ndersa padia eshte paraqitur me date 18.04.2015, prandaj, ne baze te nenit 158 te këtij Kodi, eshte rasti per pushimin e gjykimit nga Kolegji Zgjedhor.
- Vendimi i KQZ objekt ankimi eshte marre ne përputhje te plote me Kodin Zgjedhor, kur KQZ, ne mbledhje publike, ne prani te mediave, perfaqesuesve te partive politike dhe perfaqesuesve te organizmave nderkombetare, ne zbatim te Kodit Zgjedhor, te neneve 67, 68, 70 dhe 72, ka miratuar dokumentacionin e kandidimit, si dhe manualet e trajnimit, te cilat shpjegojne dhe qartesojne anetaret e komisioneve te nivelit te dyte dhe te trete, si dhe cdo subjekt zgjedhor, pjesemarrës ne zgjedhje per zbatimin e tyre.
- Ndryshimet ne Kodin Zgjedhor (nepermjet Ligjit Nr.31/2015, miratuar me date 02.04.2015), kane hequr ne te gjithë tekstin e ligjit fjalet “komune” dhe “keshill komune”, ku ne mungese te nje dispozite ligjore tranzitore, per te qartësuar nenin 68/2 dhe nenin 70/4 te Kodit Zgjedhor, KQZ, ne modelet perkatese te miratuara me vendimin objekt ankimi, persa i perket te drejtes se përjashtimit nga listat e zgjedhesve qe mbështesin kandidatet e propozuar nga zgjedhesit, partite politike dhe koalicionet ne rastet kur keta te fundit zoterojne mandate ne Kuvend ose ne bashkine apo këshillin e bashkise perkatese, ka cituar ne dokumentacionin e kandidimit, dispoziten ligjore konkrete, nderkohe qe ne manualet e trajnimit ka shpjeguar ne

menyre te detajuar, te qarte dhe lehtësisht te kuptueshme dhe te zbatueshme nga te gjithë subjektet zgjedhore dhe komisionet e nivelit te dyte dhe te trete keto dispozita, si dhe rastet ne te cilat subjektet perfitojne nga e drejta e perjashtimit te detyrimeve per mbledhjen e nenshkrimeve mbeshtetese nga zgjedhesit e zones zgjedhore perkatese.

- Sipas nenit 22 te Kodit Zgjedhor dhe Rregullores “Per organizimin dhe funksionimin e KQZ-se”, materialet e mbledhjes se thirrur per cdo ceshtje ne shqyrtim (projektaktet) publikohen ne faqen zyrtare te KQZ ne internet, ndersa ato qendronin te publikuara nga momenti i daljes se rendit te dites dhe deri ne miratimin e tyre përfundimtar nga KQZ, ku pas miratimit përfundimtar te aktit nga KQZ, ne faqen zyrtare te internetit publikohej sipas rastit vendimi ose udhëzimi i KQZ-se, ku cdo variant tjetër, qe mund te gjendet elektronikisht i ndryshem nga vendimi i miratuar nga KQZ, nuk perbente versionin zyrtar te vendimit te KQZ.
- Ajo c’ka pretendohet ne ankimin e paraqitur ne rastin konkret, ne lidhje me interpretimin e neneve 68/2 dhe 70/4 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, per mandatin e kryetarit te komunes apo anetarit te këshillit te komunes, ka qene pjese e draftit te projektaktit te paraqitur per shqyrtim nga administrata e KQZ, nderkohe qe kjo e fundit, ne mbledhjen e saj publike, ka patur diskutime dhe kundërshtime perkatese te anetareve te saj dhe perfaqesuesve te partive politike pjesemarres ne mbledhje, c’ka me pas u materializuan ne vendimin e KQZ-se, vendim ky qe garanton te drejten per t’u zgjedhur, ndersa eshte ne përputhje me Kodin Zgjedhor dhe ligjet e tjera, qofte ne aspektin material, ashtu dhe ne ate formal, kur per kete vendimmarrje anetaret e KQZ-se kane shprehur vullnetin e tyre si nga ana materiale, ashtu dhe formale.
- Vendimi i KQZ-se, si ne pjesen arsyetuese dhe ne modelet e miratuara te kandidimit ne zbatim te neneve 68/2 dhe 70 te Kodit Zgjedhor, nuk ka bere gje tjetër vetem ka cituar ne menyre fanatike dispozitat ligjore perkatese, sipas te cilave perjashtohen nga detyrimi i mbledhjes se nenshkrimeve mbeshtetese, subjekte te cilat zoteroje mandate ne Kuvend, apo si kryetar bashkie apo si anetar te keshillit te bashkise perkatese.

- Ne asnje rast Kodi Zgjedhor dhe vendimet e KQZ-se nuk cenojne te drejten kushtetuese te zgjedhjes, e drejte kjo qe realizohet ne forma te ndryshme ose nepermjet mbledhjes se nënshkrimeve te zgjedhesve mbeshtetes, ose nepermjet zotërimit te mandatit ne organet e përcaktuara me ligj, ku ne rast se ankuesi nuk zotëron mandat ne organet e përcaktuara me ligj, mund te kandidoje duke marre mbeshtetjen e zgjedhesve, ne zonen zgjedhore perkatese.

Kolegji Zgjedhor, pasi ia nënshtroi çështjen debatit gjyqësor, dëgjoi palët, administroi provat shkresore dhe pretendimet përfundimtare, në përfundim cmon te rrezoje padinë, si te pabazur ne ligj dhe prova.

Referuar nenit 145/1 te Kodit Zgjedhor, Kolegji Zgjedhor cmon se Partia Socialdemokrate e Shqiperise duke qene nje nga subjektet zgjedhore, gezon te drejten per te ankimuar vendimet e KQZ kur cmon se ato cenojne interesat e saj te ligjshem, sipas afateve te përcaktuara ne nenin 152 te këtij Kodi.

Ne rastin konkret, Partia Socialdemokrate ka paraqitur ankim kunder Vendimit te KQZ-se Nr.88, datë 07.04.2015, qe sipas pales paditese cenon interesat e saj te ligjshem, persa kohe vendimi lidhet edhe me dokumentacionin e nevojshem qe duhet te paraqitet nga subjekti zgjedhor ne funksion te ushtrimit te te drejtave te tij per te garuar me kandidatet e tij ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015.

Fillimisht, Kolegji Zgjedhor vuri ne diskutim prapësimin e pales se paditur per paraqitjen tej afatit ligjor te ankimit ne rastin konkret nga subjekti zgjedhor PSD, duke e gjetur te pabazuar kete pretendim.

Konkretisht, rezulton se, sikundër u pranua nga pala e paditur, se vendimi objekt ankimi i KQZ, i marre ne mbledhjen e dates 07.04.2015, pikërisht vendimi i shkruar dhe i nënshkruar nga te gjithë anetaret e KQZ-se qe kane marre pjese ne votim, sipas përcaktimeve te nenit 24/2 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, nuk eshte zbardhur as menjehere dhe as brenda 24 oreve, ashtu sikundër as nuk eshte publikuar menjehere pas zbardhjes ne faqen zyrtare te KQZ-se, sikundër përcakton pika 3 e kësaj dispozite, por disa dite

me pas. Po keshtu, nuk rezulton, persa kohe pala e paditur nuk vërteton kohen, momentin kohor kur vendimi është zbardhur dhe publikuar ne faqen zyrtare te KQZ-se. Gjithashtu, rezulton se pala paditese, ndersa ende nuk ka qene e regjistruar si subjekt zgjedhor (regjistruar me date 09.04.2015), nuk ka qene pjesemarrese ne mbledhjen e KQZ-se te dates 07.04.2015, kur është marre vendimi objekt ankimi.

Sipas nenit 152/2 te Kodit Zgjedhor, “Ankimi për të gjitha vendimet që KQZ-ja merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tyre. ...”.

Nisur nga sa rezulton, referuar rrethanave faktike qe rezultojne ne rastin konkret, si dhe rregullimeve perkatese ligjore ne lidhje me zbardhjen dhe publikimin e vendimit nga KQZ (shpalljen publike te vendimeve), Kolegji Zgjedhor cmon se pala e paditur nuk verteton pretendimin e saj per paraqitjen nga pala paditese te ankimit/padise tej afatit 5 ditor nga dita e shpalljes se vendimit te ankimuar, persa kohe pala e paditur nuk vertetoi ne gjykim qe vendimi i zbardhur i saj te jete publikuar/shpallur me se paku me date 13.04.2015.

Lidhur me thelbin e pretendimeve te ngritura ne padi, duke patur parasysh se vendimi objekt ankimi prek, ka disponuar per te gjitha kategorite e subjekteve zgjedhore (percaktuar ne nenin 2/20 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar), Kolegji Zgjedhor vlerëson pretendimet e ngritura nga pala paditese duhet te shqyrtohet persa vendimi objekt ankimi prek, ka disponuar per kategorine e subjektit zgjedhor “parti politike”, sikundër rezulton te jete dhe pala paditese ne kete gjykim, duke konstatuar mungese interesi te ligjshem te pales paditese ne kete gjykim persa KQZ-ja ka disponuar me vendimin objekt ankimi per subjektet zgjedhore te kategorive te tjera (“koalicionet” apo “kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore”).

Nga sa me lart, rezulton qe pretendimet e ngritura ne ankim lidhen me pjese te caktuara te arsytimit te vendimit objekt ankimi te KQZ-se, si dhe me dy modele te kandidimit qe do te perdoren ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015, te

miratuara prej saj, konkretisht Modelin 02 K, “Kerkese e partise per regjistrimin e kandidatit per kryetar bashkie”, si dhe Modelin 10 K, “Kerkese per regjistrimin e listes shumemerore te kandidateve”.

Sipas Modelit 02 K, “Kerkese e partise per regjistrimin e kandidatit per kryetar bashkie”, variantit te zbardhur, te shkruar dhe nënshkruar nga anetaret e KQZ-se, ne dokumentacionin qe duhet t’i bashkelidhet kerkeses, nder te tjera, ne piken 3, eshte percaktuar **“Vertetim per zotërimin e mandatit sipas nenit 68, pika 2 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar/Listen e zgjedhesve qe mbështesin partine”**.

Ndersa, sipas Modelin 10 K, “Kerkese per regjistrimin e listes shumemerore te kandidateve”, variantit te zbardhur, te shkruar dhe nënshkruar nga anetaret e KQZ-se, ne dokumentacionin qe duhet t’i bashkelidhet kerkeses, nder te tjera, ne piken 3, eshte percaktuar **“Vertetim per zotërimin e mandatit sipas nenit 68, pika 2 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar/Listen e zgjedhesve qe mbështesin partine/koalicionin”**.

Nderkohe, sipas pales paditese, ne dy modelet e kandidimit te miratuara nga KQZ ne mbledhjen e dates 07.04.2015, si dhe te publikuara menjehere ne faqen e saj zyrtare, përcaktimet si me lart ne lidhje me dokumentacionin qe duhet t’i bashkelidhet atyre kërkesave ka qene i ndryshem.

Keshtu, sipas pales paditese, ne Modelin 02 K, ne dokumentacionin qe duhet t’i bashkelidhet kerkeses, nder te tjera, ne piken 3, përcaktohej **“Vertetim per zotërimin e mandatit ne Kuvend apo si kryetar/këshillin e njesise se qeverisjes vendore perkatese (nje nga njesite administrative perberese te bashkise perkatese)// Listen e zgjedhesve qe mbështesin partine. Neni 68, pika 2”**.

Po keshtu, sipas pales paditese, ne Modelin 10 K, ne dokumentacionin qe duhet t’i bashkelidhet kerkeses, nder te tjera, ne piken 3, përcaktohej **“Vertetim per zotërimin e mandatit ne Kuvend apo si kryetar/këshillin e njesise se qeverisjes vendore perkatese (nje nga njesite administrative perberese te bashkise perkatese)/ Listen e zgjedhesve qe mbështesin partine/koalicionin”**.

Nga sa me lart u parashtrua, pala paditese, ndersa pretendon per qenien absolutisht te pavlefshem te vendimit objekt ankimi te KQZ-se, nulitetin e ketij akti administrativ e pretendon per dy shkaqe:

1. Vendimi i zbardhur, i shkruar dhe nënshkruar nga anetaret e KQZ-se, nuk eshte marre sipas procedures se percaktuar nga ligji, pra ne nje mbledhje te KQZ-se, te votuar nga shumica e anetareve te tij.

2. Interpretimi i nenit 68/2 te Kodit Zgjedhor nga KQZ ne pjesen arsyetuese te vendimit te zbardhur, te shkruar dhe nënshkruar nga anetaret e saj, eshte ne kundërshtim flagrant me ligjin, Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Zgjedhor.

Nga provat e marra gjate shqyrtimit gjyqësor, Kolegji Zgjedhor konstaton se persa i perket modeleve te kandidimit, pikërisht Modelit 02 K dhe Modelit 10 K, keto modele sipas vendimit te zbardhur te KQZ-se, te shkruara dhe nënshkruara nga anetaret e saj, rezultojne te jene te njëjta me modelet e paraqitura per shqyrtim nga administrata e KQZ-se, te shqyrtuara dhe miratuara nga kjo e fundit ne Mbledhjen e dates 07.04.2015. Ne kete kuptim, referuar neneve 22, 23 dhe 24 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, si dhe Rregullores "Per organizimin dhe funksionimin e KQZ-se", rezulton i pabazuar pretendimi i pales paditese qe keto vendimmarrje te KQZ-se (miratimin e dy modeleve te kandidimit si me lart) te jene prekur nga vese qe cojne ne pavlefshmëri absolute te tyre. Pretendimi i pales paditese, se kane ekzistuar variante te tjera te ketyre modeleve te kandidimit te miratuar nga KQZ-ja ne Mbledhjen e dates 07.04.2015 (parashtruar si me lart), nuk rezulton i provuar ne kete gjykim.

Lidhur me aktin, pjesen arsyetuese te vendimit objekt ankimi, rezulton qe ai te kete qene pjese e shqyrtimit te KQZ-se ne Mbledhjen e dates 07.04.2015, kur eshte paraqitur ne formen e nje projektakti nga administrata e KQZ-se, ndersa eshte votuar per kete nga anetaret e saj pasi me pare ata kane votuar nje per nje te te gjithë modelet e kandidimit.

Ne projektaktin e paraqitur, referuar mosmarrëveshjes objekt gjykimi, ne paragrafin e fundit te faqes 2, qe vijon dhe ne faqen 3, ka qene kjo fjali "... Neni 68, pika 2 e Kodit Zgjedhor parashikon se kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur

nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend **ose në organet e njësive përkatëse të qeverisjes vendore**, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3.000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit, **ose kur zotërojnë bashkërisht në këshillin përkatës** një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit”.

E njëjta përmbajtje me tekstin si me lart del te jete paraqitur dhe ne Relacionin mbi Projektaktin.

Nderkohe, gjate mbledhjes se KQZ-se, anetaret e saj, ashtu sikundër dhe perfaqesues te partive parlamentare pjesemarres ne mbledhje, ndersa per diskutim dhe miratim kane qene modelet e kandidimit dhe konkretisht Modeli 01 K, kane diskutuar gjerësisht ne lidhje me dokumentacionin qe duhet t'i bashkëngjitej kerkeses ne rastet e kandidateve te propozuar nga zgjedhesit kur ata aktualisht ishin kryetar komune apo anetar këshilli komune, duke patur ne konsiderate per kete ndryshimet qe kishte pesuar legjislacioni ne lidhje me ndarjen administrativo-teritoriale te njesive te qeverisjes vendore (Ligji Nr.115/2014, miratuar me date 31.07.2014), per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore (Ligji Nr.30/2015, miratuar me date 02.04.2015), ashtu sikundër dhe Kodi Zgjedhor (Ligji Nr.31/2015, miratuar me date 02.04.2015), referuar te cileve eshte zvogëluar numri i njesive te qeverisjes vendore, jane përcaktuar rishtazi njesite e qeverisjes vendore, eshte përcaktuar se zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te vitit 2015 do te organizoheshin dhe zhvilloheshin mbi bazen e ndarjes se re administrativo-teritoriale, eshte përcaktuar si njesi baze e qeverisjes vendore vetem “bashkia”, ndersa jane hequr nga tekset e ketyre ligjeve fjalet “komune”, “kryetar komune” dhe “këshill komune”, si dhe eshte përcaktuar se organet e njësive të qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2011 dhe me juridiksion territorial, sipas ndarjes se vjeter administrativo-teritoriale (sipas Ligjit Nr.8653, datë 31.7.2000, të ndryshuar dhe Ligjit Nr.8654, datë 31.7.2000) do te vazhdonin funksionimin e tyre deri në konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive të qeverisjes vendore në zgjedhjet e vitit

2015. Diskutimi ne kete rast ka ardhur per shkak te mungeses se nje dispozite tranzitore/kalimtare ne Kodin Zgjedhor ne lidhje me aplikimin e përjashtimit nga rregulli i pergjithshem i parashikuar ne nenin 70/2 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, persa i perket mbështetjes se kandidatit te propozuar nga zgjedhesit (1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por, në çdo rast, jo më pak se 50 zgjedhës) ne rastin kur kandidati i propozuar nga zgjedhesit do te ishte aktualisht kryetar komune apo anetar këshilli komune, nderkohe qe legjislacioni si me lart nuk kishte me ne përmbajtjen e tij keto nocione. Per kete jane mbajtur qëndrime dhe propozime te ndryshme.

Nga ana tjeter, nuk rezulton qe ne mbledhje te jete bere objekt diskutimi i veçante ne lidhje me aplikimin e nenit 68 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, titulluar “Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve”, ne vecanti pikes 2 te tij, sipas te ciles “Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3 000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit, ose kur zotërojnë bashkërisht në këshillin përkatës një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit”.

Nderkohe, rezulton qe KQZ-ja te kete votuar per kete akt dhe ta kete miratuar, por se, ndryshe nga përmbajtja e asaj pjese te projektaktit te parashtruar me lart, ne vendimin e zbardhur, te shkruar dhe nënshkruar nga anetaret e KQZ-se, si dhe te publikuar ne faqen e saj zyrtare, kjo pjese e arsyetimit te aktit paraqitet si vijon :

“... Neni 68, pika 2 e Kodit Zgjedhor parashikon se kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend **ose si kryetar bashkie apo si anëtar i këshillit të bashkisë përkatëse**, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3.000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës. Bën përjashtim nga ky

rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit, **ose kur zotërojnë bashkërisht në këshillin e bashkise përkatës** një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit”.

Nga sa me lart, rezulton që në aspektin formal vendimmarrja e KQZ-se, në lidhje me aktin, pjesën arsyetuese të vendimit të saj (Vendimit Nr.88, datë 07.04.2015), të jetë produkt i mbledhjes së saj, të thirrur dhe zhvilluar rregullisht sipas ligjit, ndërsa përmban vullnetin e shumicës së anëtarëve të tij, ndërkohë që ekziston vetëm një vendim që përmban të gjithë elementet formal të kërkuar nga ligji, Kodi Zgjedhor i ndryshuar. Kolegji Zgjedhor vlerëson se në gjykim nuk u paraqit ndonjë provë, që vërtetonte ekzistencën e një vendimi tjetër të KQZ-se, një vendimmarrje të ndryshme të saj në lidhje me këtë. Kopja në letër e dokumentit elektronik të paraqitur si provë nga pala paditese në lidhje me vendimin objekt ankimi të KQZ-se, nuk mund të përbejë provë në kuptim të ligjit. Lidhur me këtë, në konsideratë të Ligjit Nr.10273, datë 29.04.2010, “Për dokumentin elektronik”, Kolegji Zgjedhor vlerëson se çdo informacion i krijuar me “cilësi dokumentare” (informacionin detyruar që i bashkëlidhet ose shoqëron dokumentin elektronik, si nënshkrimi elektronik, koha e krijimit, emri i krijuesit dhe të dhëna të tjera që krijohen së bashku me dokumentin elektronik, me qëllim regjistrimin, ruajtjen e autenticitetit, tërësinë dhe vlefshmërinë e dokumentit elektronik përgjatë ciklit të dokumentimit), i dërguar, i marrë ose i ruajtur në formë elektronike nga një sistem kompjuterik apo nga një mekanizëm i ngjashëm dhe që plotëson kushtet për vlefshmërinë sipas neneve 5 deri në 9 të këtij ligji, konsiderohet “dokument elektronik”, duke patur vlefshmëri ligjore dhe përben provë në kuptim të nenit 12 të këtij ligji. Nga ana tjetër, në Kodin e Procedurës Civile nuk rregullohet si provë “dokumenti elektronik”, kjo nisur dhe nga koha e hartimit dhe miratimit të këtij Kodi (mars 1996), por se në nenin 12 të Kodit përcaktohet se “provat janë të dhëna”, ç’ka është në përputhje me përcaktimin e bërë në ligjin e sipërpermendur lidhur me “dokumentin elektronik” si provë, sipas të cilit “dokument elektronik është çdo informacion”. Nderkohe, përse i përket formës së marrjes si provë në një proces gjyqësor të “dokumentit elektronik”, formë e marrjes së provave që konsiderohet si substanciale nga kjo dispozitë e ligjit procedural civil, mund të

thuhet se referuar formes se paraqitjes se jashtme te “dokumentit elektronik”, pra paraqitjes vizuale dhe te kuptueshme te permbajtjes se tij, qe mund te materializohet ne ekranin e kompjuterit apo ne pajisje te tjera te ngjashme ose ne letër apo ne mjete te tjera te materializuara, ne Kodin e Procedures Civile, ne varesi te formes se paraqitjes se jashtme te “dokumentit elektronik”, gjenden dhe rregulla te vecanta. Lidhur me rastin konkret, pala paditese ka pretenduar per ekzistencen e nje “dokumenti elektronik”, pikerisht te vendimit objekt ankimi te KQZ-se te publikuar menjehere pas marrjes se tij, sipas nje permbajtje te caktuar, dokument elektronik ekzistencen e te cilit pala paditese ka pretenduar ta proveje me paraqitjen e kopjes se tij ne leter. Por, ndryshe nga sa pala paditese pretendon, letra e paraqitur prej saj nuk mund te konsiderohet si kopje ne leter e nje dokumenti elektronik ne kuptim te nenit 8 te Ligjit “Per dokumentin elektronik”, persa kohe nje paraqitje e tille ne leter e dokumentit elektronik te pretenduar nuk eshte ne perputhje me formen e kerkuar nga neni 10 i ketij ligji, sipas te cilit “1. Vërtetimi i kopjes në letër të dokumentit elektronik nga institucionet publike kryhet nga personat e autorizuar nga titullari i institucionit. 2. Në të gjitha rastet e tjera, vërtetimi i kopjes në letër të dokumentit elektronik kryhet nga noteri publik. Rregullat dhe procedurat për vërtetimin nga noteri publik përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë. 3. Kopja në letër, e vërtetuar si kopje e dokumentit elektronik, duhet të mbajë bashkëlidhur shënimin “Kopje e njëjtë me dokumentin elektronik”. Ne keto kushte, pala paditese, ndryshe nga sa pretendon, nuk ka paraqitur ne gjykim ne formen e kerkuar nga ligji proven “dokument elektronik” te pretenduar prej saj, per rrjedhoje ajo pa te drejte konsideron se fakti i pretenduar prej saj eshte provuar pikerisht mbi bazen e nje dokumenti te tille. Kolegji Zgjedhor vlereson se eshte ne detyrimin ligjor te pales qe pretendon ekzistencen e nje prove, qofte kjo dhe “dokument elektronik”, per ta paraqitur ate ne gjykim ne formen e kerkuar nga ligji dhe per te mundesuar keshtu marrjen e saj ne formen e parashikuar nga Kodi i Procedures Civile, detyrim te cilin pala paditese ne rastin konkret nuk e ka permbushur.

Mbi arsyetimin si me lart, Kolegji Zgjedhor gjen te pabazuar shkakun e pretenduar ne padi per pavlefshmeri absolute te vendimit objekt gjykimi te KQZ-se, pra per nxjerrjen e tij ne kundërshtim me proceduren e kerkuar nga ligji.

Lidhur me shkakun tjetër të ngritur në padi për pavlefshmëri absolute të vendimit objekt gjykimi të KQZ-se, pra për qenien në kundërshtim flagrant me ligjin, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Zgjedhor, të interpretimit të bërë nga KQZ-ja të nenit 68/2 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar në pjesën arsyetuese të vendimit të zbardhur, të shkruar dhe nënshkruar nga anëtarët e saj, Kolegji Zgjedhor vlerëson se interpretimi i gabuar i ligji nga organi i administratës publike në pjesën arsyetuese të aktit nuk mund të përbejë shkak pavlefshmërie absolute të aktit administrativ të nxjerrë prej tij, ndërkohë që ajo çka kërkohet në këtë gjykim është pikërisht konstatimi i një pavlefshmërie të tillë të vendimit objekt gjykimi të KQZ-se. Sikundër përcaktohet në nenin 155/1 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar në lidhje me nenin 6 dhe 28 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Zgjedhor ka detyrimin të shprehët për gjithçka i kërkohet dhe vetëm për atë që i kërkohet, sikundër dhe brenda kufijve të padisë.

Gjithsesi, Kolegji Zgjedhor vlerëson se kerkimi i pales paditese në lidhje me nulitetin e arsyetimit të vendimit objekt gjykimi të KQZ-se është një kerkim pa pasoje juridike, për sa kohë rezulton se disponimi i vendimit të datës 07.04.2015 (pjesa urdheruese) nuk rezulton me pasoja, efekte negative për paditesin në modelet e kandidimit që prekin dhe kanë interes për të (Modeli 02 K dhe Modeli 10 K). Pretendimet në lidhje me interpretimin e ligjit në raport me zbatimin e tij në të ardhmen, sikundër paditesi kërkon, nuk mund të jenë objekt i këtij gjykimi për sa kohë ato lidhen me një situatë juridike të pazezauruar ende, në rrethanat kur nuk rezulton dhe as pretendohet që paditesit t'i jetë refuzuar kërkesa për regjistrim të kandidatëve të tij për kryetar bashkie apo anëtarë të keshillit bashkiak në zgjedhjet për qeverisjen vendore të datës 21 qershor 2015.

Sa më sipër, Kolegji Zgjedhor cmon se kërkesepadia e paraqitur nga Partia Socialdemokrate është e pabazuar në prova dhe ligj dhe si e tillë ajo duhet të rrezohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tirane,
bazuar në nenin 158/3 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar,

V E N D O S I

- Rrezimin e padisë.

Tiranë, më 24.04.2015

**ANËTAR
VALBON ÇEKREZI**

**ANËTAR
EDLIRA PETRI
(kundër)**

**KRYESUES
ANDI CIVICI**

**ANËTAR
FUAT VJERDHA
(kundër)**

**ANËTAR
ILIR TOSKA**

MENDIM PAKICE

Ne anëtarët e Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, parashtrajmë mendimin, të kundërt me atë të shumicës, lidhur me vendimin nr. 5, datë 24.04.2015, me të cilin është vendosur rrezimi i padisë së Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë.

Paraprakisht vlerësojmë të vëmë në pah qëndrimin unanimit, lidhur me prapësimin e palës së paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (më tej, KQZ) mbi paraqitjen e padisë objekt gjykimi tej afatit ligjor 5 ditor, çështje e arsyetuar në vendimin e këtij Kolegji Zgjedhor.

Lidhur me faktet e parashtruara nga palët dhe të evidentuara në vendimin e Kolegjit, ne gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë të paraqesim edhe faktet që kanë ndodhur në Mbledhjen e KQZ-së së datës 07.04.2015, në të cilën është diskutuar dhe vendosur për modelet e kandidimit që do të përdoren në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015.

Nga procesverbali i mbledhjes, i paraqitur në gjykim nga KQZ-ja, rezulton veç sa pasqyrohet në vendimin e Kolegjit Zgjedhor, se mes anëtarëve të KQZ-së, përfaqësueses së administratës që kish përpiluar projektvendimin, si dhe përfaqësuesve të partive politike pjesëmarrëse, është zhvilluar një debat i gjatë, lidhur me

interpretimin e neneve 68/2 dhe 70/4 të Kodit Zgjedhor, në rrethanat kur nga teksti i këtij ligji janë hequr fjalët “komunë”, “kryetar komune” dhe “këshill komune” (sipas ndryshimeve të bëra me ligjin 31/2015), ndërkohë që në dispozitat e sipërcituara përjashtoj nga detyrimi i mbledhjes së nënshkrimeve, kandidati i propozuar përkatësisht nga partia politike apo nga zgjedhësit, kur zotëronin një mandat si kryetar bashkie a komune apo si anëtarë të këshillave përkatës të njësisë së qeverisjes vendore. Të dy dispozitat përmbajnë të njëjtin formulim, lidhur me përjashtimin nga detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse.

Referuar kronologjikisht diskutimit në mbledhjen e KQZ-së, rezulton se fillimisht është prezantuar projektakti në të cilin, ashtu siç pasqyrohet në vendimin e Kolegjit Zgjedhor, rezulton të jetë interpretuar edhe neni 68.2 i Kodit Zgjedhor si vijon : “... Neni 68, pika 2 e Kodit Zgjedhor parashikon se kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend **ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore**, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3.000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit, **ose kur zotërojnë bashkërisht në këshillin përkatës** një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit”.

Sipas procesverbalit të mbledhjes, diskutimi ka filluar mbi dokumentet e kandidimit sipas nenit 70 të Kodit Zgjedhor, titulluar “Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për organet e qeverisjes vendore”. Duke pasqyruar dokumentet e nevojshme sipas kësaj dispozite, përfaqësuesja e administratës së KQZ-së që prezantonte projektaktin, ka parashtruar se e njëjta situatë është edhe për propozimet e partive politike (neni 68 i Kodit Zgjedhor).

Nisur nga fakti se modeli i parë që miratohej (modeli 01K), ishte ai që përcaktonte formën e paraqitjes së kërkesës për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit, referuar nenit 70.4 të Kodit Zgjedhor, debati në mbledhje është zhvilluar lidhur me çështjen nëse do të konsiderohej mandati i kryetarit të njësisë së qeverisjes

vendore aktuale (bashki apo komunë), si dhe mandati i anëtarit të këshillit përkatës të njësisë së qeverisjes vendore, i vlefshëm, në kuptim të përjashtimit nga detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve, në kuadër të reformës territoriale e cila tashmë përfshin në një bashki, disa njësi të qeverisjes vendore.

Përfaqësuesja e administratës së KQZ-së ka sqaruar se sipas projektaktit, konsiderohej për efekt të përjashtimit nga detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve, çdo mandat aktual si kryetar i njësisë të qeverisjes vendore (bashki dhe komunë), si dhe mandati i anëtarëve të këshillave përkatës, pra të gjitha njësitë përbërëse të Bashkisë së ardhshme.

Lidhur me këtë interpretim të bërë në projektaktin e paraqitur për votim, rezultojnë këto qëndrime:

- përfaqësuesi i Partisë Demokratike të Shqipërisë, nuk ka qenë dakord fillimisht me projektaktin, por gjatë diskutimit ka pranuar që përjashtimi nga mbledhja e nënshkrimeve tu njihet vetëm kryetarëve të bashkive dhe anëtarëve të këshillave të bashkisë, meqenëse tashmë komuna nuk njihet më si njësi e qeverisjes vendore;
- anëtari i KQZ-së Z. H. Osmanaj ka shprehur qëndrimin se të zgjedhurit aktualë (në bashki dhe komunë) gëzojnë të drejtën e kandidimit duke u përjashtuar nga detyrimi i mbledhjes së nënshkrimeve (faqe 6 e procesverbalit të mbledhjes);
- me qëndrimin e mësipërm është bashkuar edhe përfaqësuesi i Partisë Socialiste të Shqipërisë (faqe 12 dhe 13 e procesverbalit), i cili pavarësisht ometimit të ligjvënësit lidhur me parashikimin e një dispozite tranzitore, ka vlerësuar se e drejta e përjashtimit nga mbledhja e nënshkrimeve, është fituar nga të zgjedhurit aktualë, duke qenë dakord me variantin e vendimit të paraqitur nga administrata;
- anëtarja e KQZ, Znj. V. Shtjefni ka mbajtur qëndrimin sipas të cilit as kryetarët e bashkive aktuale dhe as ata

të komunave (si dhe anëtarët e këshillave përkatës), nuk duhet të përjashtohen nga detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve, sepse mungon një dispozitë kalimtare në ligjin me të cilin është ndryshuar Kodi Zgjedhor dhe me “njësi të qeverisjes vendore” tashmë duhet të kuptohen vetëm 61 bashkitë;

- Anëtari i KQZ-së, Z. D. Biba ka parashtruar se të zgjedhurit aktualë janë votuar nga një numër i caktuar zgjedhësish dhe se për këtë ata e kanë mbështetjen e këtyre zonave, që tashmë do të jenë pjesë e njësisë së madhe të pushtetit vendor, ndaj nuk duhet miratuar asnjë variant që do të shkaktonte shkelje, apo cenim në këtë përjashtim (nga mbledhja e nënshkrimeve) që vetë ligjvënësi e ka parashikuar;
- Në këtë pikë të debatit, nga procesverbali i mbledhjes rezulton se anëtari H. Osmanaj, vë në dyshim qëndrimin e tij të parashtruar në hyrje të mbledhjes, nisur nga fakti se tashmë është suprimuar komuna si njësi i qeverisjes vendore;
- Në vijim anëtari i KQZ-së Z. G. Veleshnja shprehet dakord me variantin e propozuar nga administrata, duke konsideruar se të gjithë kryetarët e komunave kanë fituar privilegjin e përjashtimit nga detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve, privilegj i cili sipas tij nuk mund tu hiqej (faqe 15 e procesverbalit);
- Me qëndrimin e anëtarëve Biba dhe Veleshnja, është bashkuar edhe anëtarja e KQZ-së Znj. E. Jorgaqi (faqe 18-19 e procesverbalit)
- Z. K. Zguri, anëtar i KQZ-së është shprehur kundër projektaktit të paraqitur nga administrata, për arsye se tashmë njësitë e qeverisjes vendore nuk janë të njëjta;
- Së fundi, kryetarja e KQZ-së, Znj. L. Luzi ka shprehur mendimin e saj pro projektaktit, duke u bashkuar edhe me tre kolegët e tjerë lidhur me të drejtën e të zgjedhurve

aktualë për tu përjashtuar nga detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve.

Rezulton se pas diskutimeve, paraprakisht është votuar një propozim i përfaqësuesit të Partisë Demokratike të Shqipërisë për të kufizuar aplikimin e përjashtimit nga mbledhja e nënshkrimeve vetëm për kryetarët e bashkive apo anëtarët e këshillave të bashkive, propozim i cili nuk është miratuar (faqe 22 e procesverbalit).

Menjëherë pas këtij votimi është kaluar në votimin e projektaktit të paraqitur nga administrata, i cili në tërësi është miratuar me rezultatin pesë vota “pro” dhe dy “kundër”. Në fakt referuar këtij procesverbalit, rezulton se për njërin nga modelet atë 01K, rezultati është katër vota “pro” dhe tre “kundër”, kurse për modelet e tjera rezulton që votimi të ketë qenë unanim, të gjitha votat “pro”.

Nisur nga konstatimi i asaj çfarë është diskutuar dhe miratuar në mbledhjen e KQZ-së, ne gjyqtarët në pakicë, gjejmë të bazuar pretendimin e palës paditëse Partia Socialdemokrate e Shqipërisë lidhur me faktin se akti i miratuar nga KQZ-ja në mbledhjen e datës 7 Prill 2015, nuk është ai i publikuar aktualisht në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së, i cili është paraqitur në gjykim.

Referuar përmbajtjes së vendimit, të paraqitur në gjykim nga KQZ-ja, rezulton mospërputhje me atë që është debatuar e votuar në seancë plenare nga anëtarët e saj, identifikuar qartësisht si nga fjala dhe qëndrimi i çdo pjesëmarrësi, ashtu edhe nga vetë teksti i projektvendimit të hartuar nga administrata i miratuar pa asnjë ndryshim.

Në rastin në shqyrtim, duke marrë në konsideratë natyrën normative të vendimit të miratuar, vlerësojmë se akti në tërësinë e tij, përcakton rregullat mbi bazën e të cilave do të operojnë aktorët në zgjedhjet vendore, rregulla këto të detyrueshme për zbatim. Për këtë, pavarësisht formës së përpilimit të aktit me një pjesë arsyetuese dhe më tej me pjesën urdhëruese që përbëhet nga modelet e miratuara, ndryshe nga shumica, jemi të mendimit se pala paditëse legjitimohet të kundërshtojë vendimin nr. 88, datë 07.04.2015 të KQZ-së, me të cilin është bërë një interpretim i dispozitave të neneve 68 dhe 70, i ndryshëm nga ai i votuar në seancë plenare.

Për ne gjyqtarët në pakicë, ka pak rëndësi fakti nëse vendimi i publikuar në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së, është ndryshuar nga publikimi i parë i tij. Ajo që vërtetohet dhe që nuk u kundërshtua as në gjykim, është fakti se projektvendimi i paraqitur nga administrata e KQZ-së (i paraqitur edhe në seancë para Kolegjit Zgjedhor), është miratuar pa asnjë ndryshim dhe çështja e vetme e debatuar lidhur me përjashtimin nga detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve nga të zgjedhurit aktualë, është vendosur në favor të tyre pavarësisht nëse janë të zgjedhur në bashki apo në komunë.

Nga sa më sipër, vlerësojmë se publikimi nga KQZ-ja i një vendimi, i cili nuk rezulton të jetë votuar dhe miratuar prej saj në mbledhjen e datës 07.04.2015, dhe që nuk pasqyron vullnetin e shprehur të anëtarëve, passjell pavlefshmërinë e tij. Në këtë konkluzion arrijmë duke i'u referuar normave ligjore që rregullojnë procedurën e vendimmarrjes së një organi kolegjal dhe posaçërisht rregullave të posaçme të funksionimit të KQZ-së, të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Situata e referuar nga pala paditëse, që përbën dhe shkakun ligjor të padisë, krijon ometim në vendimmarrjen e KQZ-së, pasi në të njëjtën kohë rezulton të ketë dy vullnete (vendime) të këtij organi për të njëjtën çështje.

Në kushtet e mësipërme, vlerësojmë se Kolegji Zgjedhor nuk duhej të kish zgjidhur çështjen në themel, por të detyronte palën e paditur, KQZ-në, të ushtronte pushtetin e saj për të marrë një vendim, në një afat të caktuar, sipas përcaktimit të nenit 158.1, shkronja "c" të Kodit Zgjedhor. Ky konkluzion është rrjedhojë e mendimit të ndryshëm nga shumica, e cila nuk vlerësoi rëndësinë e mbledhjes së KQZ-së, mënyrën e funksionimit të saj, si dhe natyrën normative të vendimit nr. 88, datë 04.07.2015, në tërësinë e përmbajtjes së tij.

Analiza e fakteve të konstatuara si më sipër, bazohet në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjinale të administratës shtetërore dhe enteve publike" (më tej, Ligji nr. 8480), si dhe Kodit Zgjedhor.

Sipas nenit 2.1 të Kodit të Procedurave Administrative, veprimtaria e organeve të administratës shtetërore, përcaktohet si "tërësia e

akteve dhe veprimeve nëpërmjet të cilave formohet dhe manifestohet vullneti i administratës publike”.

Ligji nr. 8480 përcakton rregulla të përgjithshme për funksionimin e organeve kolegjinale. Në dallim nga një organ monokraktik, i cili shpreh vullnetin shtetëror, nëpërmjet një personi, në rastin e organit kolegjal lind nevoja e përcaktimit të rregullave, mbi bazën e të cilave synohet të identifikohet vullneti i tij, i cili përbëhet nga një tërësi vullnetesh të individëve, anëtarë të organit. Për të formuar e më pas shprehur, vullnetin, duhet që anëtarët e organit të mblidhen në mbledhjet e kryesura nga Kryetari i tij, ku edhe shqyrtohen çështjet sipas rendit të ditës, për të cilat merren edhe vendimet përkatëse.

Në nenin 12 të këtij ligji, përcaktohet si rregull, se anëtarët e organit kolegjal, të pranishëm në mbledhje, nuk mund të abstenojnë, përveç se kur parashikohet ndryshe në ligj. Ky urdhërim obligon anëtarët e organit kolegjal për të shprehur në mënyrë pozitive, vullnetin personal, lidhur me vendimin që duhet të merret, rregull i cili, në harmoni edhe me nenin 21 të Kodit të Procedurave Administrative, që përcakton ushtrimin e detyrueshëm të kompetencave, garanton edhe në rastin e organeve kolegjinale, kryerjen e funksionit publik.

Ligji nr. 8480 përcakton gjithashtu se për sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji, vendimet e organeve kolegjinale merren me votim të hapur (neni 13).

Çdo mbledhje e organit pasqyrohet në procesverbal, ku pasqyrohen ndër të tjera edhe ajo çfarë është thënë, vendimet e marra, forma dhe rezultati i votimeve, duke shënuar në raste të caktuara edhe votat “kundër” (nenet 16 dhe 17).

Duke përcaktuar rregulla të hollësishme, lidhur me mënyrën e mbledhjes dhe zhvillimit të mbledhjeve të organit kolegjal, ligji nuk lejon një vendimmarrje të organit, nëpërmjet një procedure tjetër të formimit të vullnetit të tij.

Lidhur me formën e aktit të organit kolegjal, sipas nenit 106.2 të Kodit të Procedurave Administrative, ai bëhet detyrimisht në formë shkresore, vetëm në rastet kur kjo kërkohet shprehimisht nga ligji. Sipas kësaj dispozite, në rastet e tjera (pra kur ligji nuk

kërkon shprehimisht formë shkresore) aktet regjistrohen në një procesverbal, pa të cilin ato nuk shkaktojnë pasoja. Nga ky përcaktim ligjor, në lidhje edhe me sa parashikon ligji nr. 8480, arrihet në përfundimin se momenti kur miratohet një akt administrativ i organit kolegjal, është ai kur shumica e anëtarëve (sipas rastit, të pranishëm, apo shumica e cilësuar) votojnë “pro” miratimit, fakt ky që domosdoshmërisht pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes, sipas vullnetit të shprehur në votim. Më pas, nëse ligji e kërkon, vendimi tashmë i marrë, duhet të shkruhet/zbardhet, me qëllim plotësimin e elementit formal të aktit.

Kodi Zgjedhor përgjithësisht nuk përcakton rregulla të ndryshme për funksionimin e KQZ-së si organ kolegjal. Kështu :

- KQZ-ja kryen funksionin e saj mbi bazën e parimit të transparencës (neni 3.6 dhe 22.7);
- KQZ-ja ushtron kompetencat ligjore nëpërmjet vendimmarrjes në mbledhjet e saj (neni 22).

Ky Kod parashikon në mënyrë të posaçme se :

- Vendimet e KQZ-së, konsiderohen të miratuara kur votojnë “pro” jo më pak se 5 anëtarë vendimet lidhur edhe me aktet me karakter normativ që kanë për qëllim rregullimin e çështjeve që lidhen me zgjedhjet (neni 24.1, shkronja “d”);
- Vendimi zbardhet brenda 24 orëve nga marrja e tij dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe që kanë marrë pjesë në votim. Anëtarët e pakicës detyrohen të paraqesin mendimin e tyre me shkrim, që i bashkëngjitet vendimit përkatës.

Referuar rastit në shqyrtim dhe vendimit të publikuar, rezulton se KQZ-ja nuk ka përmbushur detyrimin për ushtrimin e autoritetit të saj publik, në respektim të dispozitave ligjore të sipërcituara. Në mbledhjen e datës 07.04.2015, KQZ-ja, pas votimit të projektvendimit të paraqitur, rezulton ta ketë miratuar atë pa asnjë ndryshim, duke u identifikuar në këtë mënyrë vullneti i organit. Ky fakt provohet me procesverbalin e kësaj mbledhjeje, ku pasqyrohet pjesëmarrja e

anëtarëve të KQZ-së, të pranishëm në mbledhje, mënyra e votimit (e hapur), vota dhe mendimi i secilit prej anëtarëve. Nga ana tjetër, ky vullnet i shprehur nuk gjen pasqyrim në aktin e zbardhur e të publikuar të KQZ-së, sipas detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 24, pika 3 të Kodit Zgjedhor, pasi në vendimin e zbardhur nuk pasqyrohet ajo çfarë është votuar dhe miratuar (projektvendimi i paraqitur nga administrata).

Ndryshe nga çfarë ka ndodhur në mbledhjen e datës 07.04.2015, KQZ-ja, ka nxjerrë një akt, "Vendimin" objekt padie, që mban të njëjtin numër e datë dhe referon në të njëjtën procedurë, të zhvilluar sipas procesverbalit të mbledhjes, cituar më sipër. Sipas këtij akti, KQZ-ja rezulton të ketë shfaqur një vullnet të ndryshëm me atë të shprehur në seancë, i cili ka shkaktuar konfuzion dhe pasiguri tek pala paditëse, e cila në thelb ka qenë dakord me atë që është shpallur në përfundim të votimit. Në përmbajtjen e këtij vendimi, nuk gjen pasqyrim asnjë fakt, apo rrethanë, që të shpjegonte mënyrën, se si KQZ-ja ka arritur në këtë vendimarrje, të ndryshme nga ajo e votuar dhe që rezulton të jetë arritur në shqyrtimin e çështjes prej saj.

Duke mbajtur në vëmendje se me përmbushjen e detyrimit ligjor për zbardhjen e vendimit, KQZ-ja formalizon me shkrim, atë çka ka vendosur në mbledhjen e saj, vendimi në formë të shkruar duhet të jetë i njëjtë, me atë që ky organ ka vendosur pas votimit të tij. Çdo "vendim", i cili nuk është rezultat i shqyrtimit dhe votimit nga anëtarët e KQZ-së, përbën një fakt të pavërtetë, për sa ai përmban. Në këtë kuptim, edhe vendimi objekt padie konstatohet të mos jetë rrjedhojë e votimit të mbledhjes së KQZ-së së datës 07.04.2013, vendim i marrë e i shpallur në seancë publike, në prezencë të përfaqësuesve të partive politike dhe organizatave ndërkombëtare e Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë.

Për sa më sipër, vlerësojmë se "Vendimi" nr. 88, datë 07.04.2015, përbën një akt që nuk pasqyron të vërtetën, ashtu si ajo ka ndodhur në mbledhjen e KQZ-së. Për më tepër, një vendimarrje e tillë nuk gjen pasqyrim në asnjë nga procesverbalet e mbledhjes së KQZ-së. Prandaj edhe nënshkrimi i këtij akti, nga katër anëtarë të KQZ-së, është rezultat i procedurave ekstra ligjore, që si të tilla nuk mund të prodhojnë efektet e një vendimi të ligjshëm, të marrë në mbledhjen e këtij organi, sipas quorum-it të përcaktuar në ligj. Përderisa KQZ-ja nuk rezulton të ketë shprehur vullnetin e ligjshëm konform rregullave

të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, si dhe duke pasur në vëmendje faktin se dy vendime kontradiktore sjellin ometim në vendimmarrje, duhej domosdoshmërisht të shprehet po ky organ, me një vendim përfundimtar.

KQZ-ja ka pasur detyrimin ligjor të përcaktojë formën e dokumenteve të kandidimit (neni 72.1) dhe duke pasur parasysh afatin e parashikuar në nenin 67 të Kodit Zgjedhor lidhur me regjistrimin e kandidatit për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe listat e kandidatëve për këshilltarë (50 ditë para zgjedhjeve), ky vendim duhej të merrej në një kohë të përshtatshme me qëllim që subjektet zgjedhore të mund të paraqisnin dokumentet deri në afatin e fundit që është data 02.05.2015.

Në nenin 145.2 të Kodit Zgjedhor parashikohet se : “2. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim. Përrjashtim nga ky rregull bëjnë vendimet e KQZ-së për rrëzimin e kërkesës ankimore në lidhje me vendimet të marra në përputhje me shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të nenit 24 të këtij Kodi.”

Në rrethanat kur, gjatë shqyrtimit të çështjes afati ishte drejt përfundimit dhe duke vlerësuar se KQZ-ja nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor për të ushtruar kompetencën e saj, nëpërmjet dhënies së një vendimi, Kolegji Zgjedhor nuk mund ta zgjidhte çështjen në themel, detyrim ky i përcaktuar në dispozitën e mësipërme. Në këtë rast, ashtu si parashikon neni 158.1, shkronja “c” dhe 158.4 i Kodit Zgjedhor, KQZ-ja duhej të detyrohej të merrte vendim, duke i caktuar për këtë një afat minimal (qoftë edhe një ditë).

Tiranë, 24.04.2015

**Gjyqtar
Fuat VJERDHA**

**Gjyqtare
Edlira PETRI**

* * *



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR

NR. 07 REGJ. THEMELTAR
DATË 08.05.2015 REGJ.

Nr. 07 VENDIMI
DATË 15.05.2015 VENDIMI

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykeses se Apelit Tirane i perbere nga gjyqtaret:

KRYESUES : EDLIRA PETRI
ANETAR : ILIR TOSKA
ANETAR : GJINOVAFA GABA
ANETAR : KLITON SPAHIU
ANETAR : PETRIT ÇENO

asistuar nga sekretarja gjyqësore Rexhina Baçi, mori në shqyrtim, në seancën gjyqësore me dyer të hapura të datës 15.05.2015, çështjen zgjedhore, që u përket palëve :

PADITËSE: **Partia Socialdemokrate e Shqipërisë,**
e përfaqësuar nga Kryetari Z. Skënder Gjinushi dhe
nga av. Irena Reso.

I PADITUR : **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,** i përfaqësuar me
autorizim nga Znj. Dëshira Pasko dhe Z. Olsi Peto.

OBJEKTI : Deklarimi i pavlefshmërisë së pikës 1 të vendimit
nr. 214, datë 06.05.2015 të Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve; Detyrimin e Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve të regjistrojë listën e kandidatëve për
anëtarë në Këshillin e Bashkisë Durrës, të
depozituar sipas Model-10.

BAZA LIGJORE : Nenet 1/3, 4 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Nenet 68.2, 145 e vijues të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); Nenet 118 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative.

Në përfundim të gjykimit, palët pjesëmarrëse i kërkuan Kolegjit Zgjedhor:

Pala paditëse Partia Socialdemokrate, nëpërmjet përfaqësuesve të saj Z. Skënder Gjinishi dhe av. Irena Reso: pranimin e padisë;

Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesve së tij, Znj. Dëshira Pasko e Z. Olsi Peto : Rrëzimin e padisë;

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoi pjesëmarrësit, shqyrtoi aktet dhe diskutoi çështjen në tërësi

V Ë R E N

Pala paditëse, Partia Socialdemokrate është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen në datë 21.06.2015, me vendimin nr. 103, datë 09.04.2005 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Partia Socialdemokrate, bazuar në nenin 67 të Kodit Zgjedhor titulluar “Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, listën shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Durrës.

Bazuar në nenin 72 të Kodit Zgjedhor, Partia Socialdemokrate ka depozituar dokumentet e kandidimit, ndër to edhe dy vërtetime sipas të cilave kjo parti ka një anëtar në këshillin e Bashkisë Sukth dhe një të tillë në Këshillin e Bashkisë Manëz.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi ka verifikuar dokumentet e kandidimit, sipas nenit 73, paragrafi i parë i Kodit Zgjedhor, ka konstatuar parregullsi, të evidentuara si vijon:

1. Kandidati me numër rendor 26, rezulton banor i Bashkisë Tiranë;
2. Partia Socialdemokrate, e cila kandidon e vetme në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, nuk plotëson kushtin e përcaktuar në nenin 68, pika 2 të Kodit Zgjedhor, në rrethanat kur kjo parti nuk ka asnjë mandat në Këshillin e Bashkisë Durrës, e cila konsiderohet si “bashkia përkatëse” në kuptim të kësaj dispozite, ndaj mandatet në këshillat e bashkive Sukth dhe Manëz, nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar nga kjo normë.

Për sa më sipër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1 të Kodit Zgjedhor, me vendimin nr. 214, datë 06.05.2015 (më tej, referuar si vendimi 214/2015) ka vendosur:

“Kthimin për korrigjim të dokumentacionit të kandidimit për listën shumemërore të kandidatëve për këshillin e bashkisë Durrës, të Partisë Socialdemokrate si më poshtë:

1. Të depozitohet lista e 1% të zgjedhësve të Bashkisë Durrës që mbështesin listën e kandidatëve për këshillin e bashkisë Durrës të propozuar nga Partia Socialdemokrate së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit, të nënshkruar prej tyre.
2. Zëvendësimin e kandidatit me numër rendor 26 në listën shumemërore për Këshillin e Bashkisë Durrës me kandidat nga zona zgjedhore Bashkia Durrës. ...”

Ky vendim, në lidhje me pikën e parë të dispozitivit të tij, është kundërshtuar nga **pala paditëse, subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate**, duke ngritur para Kolegjit Zgjedhor këto pretendime:

Parashikimi i nenit 68, pika 2 i Kodit Zgjedhor e përjashton Partinë Socialdemokrate nga detyrimi për të mbledhur nënshkrime

mbështetëse, për shkak të zotërimit të mandateve të anëtarëve në këshillat e bashkive Sukth e Manëz, të cilat përfshihen në Bashkinë Durrës. Dispozita e nenit 68, pika 2 e Kodit Zgjedhor është hartuar para Reformës Administrativo Territoriale, në kuadër të së cilës njësitë ekzistuese të qeverisjes vendore do të shkrihen dhe nuk do të ekzistojnë si të tilla, kurse njësitë e reja do të formohen për herë të parë pas këtyre zgjedhjeve. Në këto rrethana, “njësi përkatëse” sipas nenit 68 të Kodit Zgjedhor nuk mund të konsiderohet vetëm Bashkia aktuale e Durrësit, siç ka interpretuar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ky interpretim përbën diskriminim të mandateve të njësisive të caktuara, në raport me njësitë e tjera, të gjitha përbërëse të bashkisë së re, për të cilën kandidohet në zgjedhjet për njësitë e qeverisjes vendore. Kështu, nuk ka asnjë arsye që të konsiderohet “mandat në këshillin e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse”, ai i Këshillit të Bashkisë Durrës, ndërkohë që edhe vetë kjo bashki nuk do të ekzistojë si e tillë pas zgjedhjeve të qershorit 2015. Bashkia e re do të jetë e përbërë nga disa njësi të qeverisjes vendore aktuale, ndaj pjesët e së tërës gëzojnë të drejta dhe detyrime të barabarta.

Pala paditëse, evidenton gjithashtu edhe afatet e vendimmarrjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pasi sipas tij, interpretimi i gabuar i ligjit, është marrë vetëm dy javë para përfundimit të afatit të regjistrimit, referuar për këtë manualit për KZAZ-të, të cilave u kërkohet të aplikojnë të njëjtat kritere, si në rastin në shqyrtim. Vënia përballë një situatë, kur subjektit zgjedhor i kërkohet mbledhja e nënshkrimeve brenda 16 ditëve, cenon rëndë rregullat e lojës dhe shkakton pasiguri juridike.

Kërkesat e nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor, sipas palës paditëse, nuk kanë dhe nuk duhet të kenë rol shtrëngues a pengues, por disiplinues. Kandidimi sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është i lirë dhe pa kushte. Përmbajtja e nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor vendos kritere për të disiplinuar dhe jo për të penguar këtë të drejtë, kritere që duhet të jenë në proporcion me arsyet, për të cilat janë vendosur dhe, nëse do të mbahet parasysh se nëpërmjet tyre synohet të evitohet degradimi i garës zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk duhej të bënte një interpretim kufizues për partitë politike e veçanërisht ta bënte atë gjatë lojës.

Partia Socialdemokrate ka dy këshilltarë të bashkive që do të jenë pjesë e Bashkisë Durrës dhe megjithatë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin që kundërshtohet, kërkon mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse, që sipas palës paditëse vjen si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit.

Për arsyet e lartpërmendura, pala paditëse subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate ka kërkuar shfuqizimin e pikës “1” të vendimit 214/2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe detyrimin e tij të regjistrojë listën e kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Durrës.

Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkoj rrëzimin e padisë, duke prapësuar se “njësia përkatëse”, në zbatim të nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor, në rastin në shqyrtim, është bashkia aktuale Durrës dhe Këshilli i Bashkisë Durrës dhe jo bashkitë e tjera, që do të jenë pjesë përbërëse e Bashkisë Durrës, për të cilën zhvillohen zgjedhjet për qeverisjen vendore të qershorit 2015. Po ashtu, pala e paditur parashtroi para Kolegjit Zgjedhor se, në të kundërt me sa pretendohet në rastin në shqyrtim, pala paditëse Partia Socialdemokrate në raste analoge, ka depozituar nënshkrimet mbështetëse, duke qenë kështu kontradiktore në kuptimin dhe zbatimin e së njëjtës dispozitë ligjore.

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë para të cilit është paraqitur kjo mosmarrëveshje zgjedhore, vuri në diskutim çështjet e mëposhtme :

1. A përfshihet mosmarrëveshja në juridiksionin gjyqësor dhe a legjitimohet pala paditëse për të kundërshtuar vendimin 214/2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve?

Për të zgjidhur çështjen e mësipërme Kolegji u referohet dispozitave të Kodit Zgjedhor në tërësi, si dhe posaçërisht nenit 145 të tij, ku përcaktohet rrethi i subjekteve që legjitimohen ti drejtohen Kolegjit. Kjo dispozitë, në paragrafin e parë të saj parashikon se:

“Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi.”

Nisur nga fakti se me vendimin e kundërshtuar nuk është refuzuar kërkesa e palës paditëse për regjistrimin e listës së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Bashkisë Durrës, por i është kërkuar asaj të korrigjojë të metat e dokumentacionit të kandidimit, u shtrua për diskutim nga Kolegji, çështja nëse ky vendim, i cili nuk ka natyrën e një vendimi përfundimtar lidhur me shqyrtimin e kërkesës së palës paditëse për regjistrimin e listës së kandidatëve, mund të jetë objekt ankimi pranë Kolegjit Zgjedhor?

Kodi Zgjedhor ka përcaktuar rregullat për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet. Në këtë kuptim një proces zgjedhor i caktuar (për Kuvendin a organet e qeverisjes vendore), kalon në disa faza që fillojnë me dekretimin dhe vijojnë me përgatitjen, zhvillimin dhe përfundimin e procesit, me vendimin final të shpalljes së rezultateve. Për vetë natyrën e këtij procesi, Kodi Zgjedhor ka rregulluar veprimtarinë e organeve që administrojnë zgjedhjet (KQZ, KZAZ dhe KQV), në mënyrë të tillë që përgatitja dhe zhvillimi i zgjedhjeve të bëhen në afatet e përcaktuara rigorozisht në këtë Kod. Lidhur me vendimet e marra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për çështje të ndryshme që ai shqyrton në kuadër të një procesi zgjedhor, Kodi Zgjedhor nuk ka bërë një kualifikim të vendimeve, për të cilat kufizohet e drejta për ankim gjyqësor për shkak të natyrës “jo përfundimtare të tyre”. Në fakt, në kuptimin e ngushtë të fjalës “vendim përfundimtar i procesit zgjedhor” do të ishte ai i shpalljes së rezultatit përfundimtar, por për shkak të natyrës së veçantë të këtij procesi administrativ, përgjatë tij, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si organi më i lartë administrativ, shqyrton dhe merr vendime të natyrave të ndryshme për të gjitha çështjet, që lidhen me zgjedhjet përkatëse.

Në këto rrethana, duke mos vendosur asnjë kufizim për ankimin gjyqësor, e vetmja dispozitë që disiplinon paraqitjen në Kolegjin Zgjedhor të një mosmarrëveshje, është neni 145, i cili legjitimon çdo subjekt zgjedhor të kundërshtojë vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kur ato cenojnë të drejtat e tyre të ligjshme.

Në rastin konkret, pala paditëse ka pretenduar se interpretimi i nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor me vendimin 214/2015, cenon të drejtën

e saj për të kandiduar me një listë për kandidatë për këshillin e Bashkisë Durrës, pa pasur nevojë për nënshkrime mbështetëse. Rezulton se me këtë vendim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka konsideruar mospërmbushje të kërkesave të Kodit Zgjedhor, mungesën e nënshkrimeve mbështetëse, duke i kërkuar Partisë Socialdemokrate, korrigjimin e parregullsisë dhe depozitimin e listës me nënshkrimet e 1% të zgjedhësve të Bashkisë Durrës.

Sipas nenit 73.2 të Kodit Zgjedhor, me rastin e konstatimit të parregullsive në dokumentet e kandidimit, subjektit zgjedhor i lind detyrimi për korrigjimin e tyre, ndaj Kolegji, nisur nga fakti se me vendimin 214/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë një interpretim shterues të nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor lidhur me detyrimin e subjektit zgjedhor Partia Socialdemokrate, vlerëson se vendimi përfundimtar në rastin e moskorrigjimit të parregullsisë, prezumohet të jetë ai i refuzimit të kërkesës për regjistrimin e listës së kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Durrës. Në këto rrethana, duke marrë në konsideratë pretendimin thelbësor të palës paditëse për interpretimin dhe zbatimin e nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili sipas tij cenon të drejtën për të kandiduar për Këshillin e Bashkisë Durrës, Kolegji Zgjedhor vlerëson se subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate legjitimohet të bëjë ankim ndaj vendimit 214/2015. Kolegji Zgjedhor vlerëson natyrën e posaçme të procesit zgjedhor, në të cilin shqyrtimi i mosmarrëveshjeve duhet të synojë në zgjidhjen e shpejtë dhe efektive të tyre. Në rastin në shqyrtim, vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me të cilin nuk është regjistruar lista e kandidatëve e paraqitur nga Partia Socialdemokrate, duke e konsideruar atë të parregullt, konsiderohet si një vendim përfundimtar që e legjitimon këtë të fundit të ankohet pranë Kolegjit Zgjedhor për pikën e parë të vendimit, ndërkohë që për pikën e dytë të tij nuk ka pasur asnjë kundërshtim.

II. Pretendimi mbi paligjshmërinë e pikës "1" të vendimit 214/2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Partia Socialdemokrate ka pretenduar se mosregjistrimi i listës së paraqitur për anëtarë të Këshillit të Bashkisë Durrës, si rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, cenon të drejtat e

saj si subjekt zgjedhor për zgjedhjet vendore të qershorit 2015 e konkretisht ato për Këshillin e Bashkisë Durrës.

Neni 68 i Kodit Zgjedhor titullohet “Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve” dhe parashikon se :

“1. Listat e kandidatëve për Kuvendin, të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, duhet të mbështeten nga jo më pak se 5,000 zgjedhës në shkallë kombëtare. Në rastin e koalicionit zgjedhor listat në tërësi duhet të kenë marrë mbështetjen e jo më pak se 7,000 zgjedhësve në shkallë kombëtare. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit.

2. Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose ***në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore***, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast jo më shumë se 3,000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit, ose kur zotërojnë bashkërisht ***në këshillin përkatës*** një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit.

3. Për qëllim të këtij neni, partia politike ose koalicioni paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit.”

Me qëllim interpretimin e dispozitës së nenit 68, Kolegji Zgjedhor mbajti në vëmendje se mosmarrëveshja mes palës paditëse dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka lindur edhe për shkak të situatës së re të krijuar në procesin zgjedhor aktual, në kuadër të Reformës Administrative Territoriale, miratuar me ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, nëpërmjet të cilit u miratua një ndarje e re administrative territoriale e njësive të qeverisjes vendore, duke u zvogëluar numri i tyre (61 bashki)

e për rrjedhojë duke u ndryshuar kufijtë përkatës. Sipas nenit 3 të këtij ligji, “Organet e njësive të qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2011 dhe me juridiksion territorial sipas ndarjes administrativo-territoriale, të përcaktuar me ligjin nr. 8653, datë 31.7.2000, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me ligjin nr. 8654, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”, vazhdojnë funksionimin e tyre deri në konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive të qeverisjes vendore në zgjedhjet e vitit 2015”. Më tej, kjo dispozitë përcakton se “Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015 do të organizohen dhe zhvillohen mbi bazën e ndarjes administrativo-territoriale të përcaktuar në këtë ligj.”

Nisur edhe nga fakti se me ndarjen e re administrative, u përcaktua si njësi bazë e qeverisjes vendore vetëm “bashkia”, ndërkohë që aktualisht si e tillë është edhe “komuna”, ligjvënësi ndryshoi Kodin Zgjedhor me ligjin 31/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”. Nga përmbajtja e këtij ligji konstatohet se janë bërë ndryshimet përkatëse në funksion të zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, tashmë për kryetar bashkie dhe për këshillin e bashkisë.

Ndërkohë rezulton se pavarësisht se në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, u përcaktua se organet aktuale të qeverisjes vendore do të vijonin funksionimin deri në konstituimin e organeve që do të zgjidhen pas zgjedhjeve të qershorit 2015, nuk është hartuar asnjë dispozitë kalimtare për zbatimin e nenit 68 të Kodit Zgjedhor, lidhur me të drejtën e kandidimit pa detyrimin për mbledhjen e nënshkrimeve përkatëse, të partive që kanë mandate në organet e qeverisjes vendore aktuale, kur ato kandidojnë për organet që do të zgjidhen në zgjedhjet e qershorit 2015, në rrethanat kur ato nuk përkrijnë më mes tyre. Kjo sepse, njësitë e qeverisjes vendore sipas ligjit 115/2014, përbëhen nga disa njësi aktuale (bashki dhe komuna), ndaj në këto kushte ka lindur debati për interpretimin dhe zbatimin e nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor, i cili obligon partitë të cilat nuk kanë mandat në Kuvend apo në organet

e qeverisjes vendore (kryetar bashkie apo anëtar të Këshillit të Bashkisë), të mbledhin nënshkrime mbështetëse nga zgjedhësit për të kandiduar në njësinë përkatëse, për një nga organet e saj.

Zbatimi i kësaj dispozite, para reformës administrative territoriale, ka qenë i qartë për subjektet e procesit zgjedhor, lidhur me rregullin e përcaktuar sipas të cilit, mbledhja e nënshkrimeve për të kandiduar në organet e një njësie vendore, ishte kusht, nëse partia politike nuk dispononte mandat në Kuvend apo mandat si kryetar i njësisë apo anëtar i këshillit të njësisë, ku paraqiste kandidaturën për një nga këto organe. Njësitë e qeverisjes vendore, për organet e të cilave zhvilloheshin zgjedhjet, ishin po ato, ndaj edhe zbatimi i dispozitës nuk paraqiste asnjë ekuivok.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se kur njësitë e qeverisjes vendore ekzistuese nuk përkrijnë me ato të caktuara sipas ligjit 115/2014, si dhe kur ligjvënësi nuk ka parashikuar një dispozitë për zbatimin e nenit 68.2 për zgjedhjet e qershorit 2015, mosmarrëveshja ka lindur, për shkak se sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përderisa mandatet në organet aktuale të qeverisjes vendore, nuk korrespondojnë me mandatet, për të cilat zhvillohen zgjedhjet vendore të vitit 2015, ato nuk mund të vlejnë për tu përjashtuar partia që kandidon, nga detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse të zgjedhësve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka konsideruar të vlefshme për efekt të kandidimit pa nënshkrime mbështetëse, mandatet që zotërohen në njësitë e qeverisjes vendore, që rezultojnë të jenë qendrat e bashkisë së re (referuar për këtë interpretimit në rastin në shqyrtim, ku KQZ konsideron të vlefshme vetëm mandatet e zotëruara në organet e qeverisjes vendore të bashkisë Durrës).

Kolegji Zgjedhor, në vlerësim të pretendimeve të palëve të përfshira në mosmarrëveshje, lidhur me interpretimin dhe zbatimin e nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor, vlerëson të nevojshme të parashtrojë fillimisht, qëllimin e ligjvënësit në përcaktimin e detyrimit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse nga zgjedhësit, për partitë që nuk kanë mandate në Kuvend apo organet e qeverisjes vendore. Në lidhje me një rregullim të tillë ligjor Gjykata Kushtetuese është shprehur në disa vendime të saj, kur ka analizuar pretendimet e kërkuesve për cenim të nenit 1, paragrafi i tretë (barazia e votës) si dhe nenit 3

(pluralizmi si një nga bazat e shtetit) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese, duke analizuar pretendimet lidhur me papajtueshmërinë me Kushtetutën të detyrimit ligjor për mbledhjen e nënshkrimeve nga partitë që nuk kanë mandate në Kuvend apo organet e qeverisjes vendore, i ka trajtuar ato në funksion të parimeve të sanksionuara nga Kushtetuta, si dhe standardet e gjithëpranuara të përmendura edhe nga Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venecias (*Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 32/2010; nr. 28/2012; nr. 11/2015*).

Gjykata Kushtetuese duke e cilësuar pluralizmin si një tërësi rrethanash ku pushteti politik është i shpërndarë në atë mënyrë që asnjë grup interesi ose klasë e caktuar shoqërore të mos mbizotërojë mbi të tjerët, parashtron si kusht bazë për ekzistencën e tij, zgjedhjet e lira, shumësinë e interesave, lejimin e hapësirave për organizimin e mekanizmave të presionit ndaj organeve të pushtetit dhe një shtet, që është i përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve. Në vijim Gjykata Kushtetuese arsyeton se:

“Problemet e përfaqësimit të drejtë janë çështje të shanseve të barabarta që zëri i gjithkujt të dëgjohet apo të jetë i përfaqësuar. Sidoqoftë, është e lejueshme që një shtet demokratik, nëse ekzistojnë arsye serioze, të vendosë në mekanizmat e procesit zgjedhor disa elemente nxitëse të integritit shoqëror. Nga ana tjetër, një sistem zgjedhor proporcional i pakufizuar mund të rezultojë në ndarjen e votave të qytetarëve ndërmjet një numri shumë të madh partish politike dhe, për pasojë, në një kërcënim për funksionimin dhe vazhdimësinë e sistemit parlamentar, në kuptim të kapaciteteve për të arritur në një vendimmarrje brenda tij”.

Referuar parimit të barazisë së votës, Gjykata Kushtetuese parashtron komponentin *aktiv* (e drejta për të votuar) dhe atë *pasiv* (e drejta për t’u votuar/zgjedhur). Gjykata Kushtetuese ka theksuar se “parimi i barazisë së të drejtës për t’u votuar/zgjedhur ndalon shtetin të diskriminojë ose të privilegjojë kandidatë të caktuar, parti politike ose grupe të tjera politike në përballje n konkurruese për të tërhequr votën e zgjedhësit. Sipas Udhëzimeve të Raportit Shpjegues të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, barazia në çështjet zgjedhore përfshin shumë aspekte (Shih më gjerë Dokumentin CDL-AD (2002) 23 rev. Miratuar nga Komisioni i Venecias në Mbledhjen e tij të 52-të Plenare (Venecia,

18-19 Tetor 2002). Parimet që duhen respektuar në të gjitha rastet janë barazia në votën numerike, *barazia për sa i përket fuqisë zgjedhore dhe mundësive të barabarta*. (Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 32/2010; nr. 28/2012; nr. 11/2015).

Në respekt të parimit të barazisë së votës, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se:

“...midis partive dhe kandidatëve duhet të krijohen shanse të barabarta dhe shteti duhet të jetë i paanshëm ndaj tyre, duke zbatuar ligjet në mënyrë të njëjtë për të gjithë. Në veçanti, kërkesa për asnjësi zbatohet për fushatën zgjedhore dhe mbulimin nga media, veçanërisht media publike, si dhe për financimin publik të partive dhe fushatave, e cila mund të realizohet si në formën e një barazie “strikte”, ashtu dhe të barazisë “proporcionale”. Sipas barazisë “strikte”, partitë politike trajtohen pa marrë në konsideratë forcën e tyre aktuale në Kuvend ose të zgjedhësve, ndërsa sipas barazisë “proporcionale”, trajtimi i partive bëhet në raport me numrin e votave. Parimi i shanseve të barabarta (strikte dhe/ose proporcionale) zbatohet në veçanti për mbulimin në radio dhe televizion, fondet publike dhe forma të tjera mbështetjeje. Disa forma mbështetjeje mund t’u nënshtrohen, nga një anë, barazisë strikte dhe, nga ana tjetër, barazisë proporcionale.

Në koncept, parimi i konkurrencimit të lirë të partive politike përfshin detyrimin e shtetit për të respektuar shanset e barabarta të të gjitha partive dhe zbatohet në legjislacionin që rregullon kushtet e këtij konkurrencimi, si dhe në konfliktet ndërmjet pjesëmarrësve në të. Duke qenë se një efekt i tillë ndikon në respektimin e parimit të barazisë, Gjykata vlerëson se çfarëdolloj ndërhyrjeje nga ligjvënësi mbi këto kushte duhet të udhëhiqet nga interesi publik. Ligjvënësi e ka të ndaluar të trajtojë palët në mënyrë të dallueshme nga njëra-tjetra, përveçse kur ekzistojnë arsye të forta përjashtimore për ta bërë këtë.”

Duke analizuar posaçërisht nenin 68 të Kodit Zgjedhor, Gjykata Kushtetuese, i referohet Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore (Udhëzime dhe Raporti Shpjegues) ku rezulton i parashikuar formulimi: “8. Detyrimi për të mbledhur një numër të caktuar *firmash* për të paraqitur kandidaturën është teorikisht në

përputhje me parimin e votimit universal. Në praktikë, vetëm partitë shumë të vogla duket se kanë vështirësi për të mbledhur numrin e caktuar të nënshkrimeve. Ky detyrim nuk duhet të pengojë kandidatët të vendosin kandidaturat e tyre. Me qëllim që të parandalohet një manipulim i tillë, është e preferueshme që ligji të caktojë një kërkesë maksimale firmash prej 1%. ...”

Gjykata Kushtetuese ka marrë në analizë interesin publik që e ka shtyrë ligjvënësin për të përcaktuar kriteret mbi të cilat ka parashikuar kushtet e kandidimit të partive që nuk zotërojnë mandate në Kuvend a organet e qeverisjes vendore. Gjykata Kushtetuese ndërsa ka vlerësuar se zgjedhjet kanë si objektiv të mundësojnë për zgjedhësit të zgjedhin përfaqësuesit e tyre, nga ana tjetër ka vënë në pah se ato (zgjedhjet) synojnë edhe të sjellin një Kuvend me shumicë të qëndrueshme, që në vijim të mund të prodhojnë legjislacion dhe të mundësojnë një qeverisje efektive. Gjykata Kushtetuese parashton se “Një sistem proporcional, tërësisht i pakufizuar përballë partive të vogla, mund të ketë potencialisht pasoja destabilizuese.¹ Trajtimi i pabarabartë i partive, duke dalluar ndërmjet tyre partitë brenda dhe jashtë Kuvendit, bëhet për mbrojtjen e votuesit nga shpërdorimi i votës. Gjykata vlerëson se është “një vullnet i ligjshëm i legjislatorit të kërkojë mbrojtjen e votuesit, në mënyrë që ai të mos ia japë votën një kandidati ose oferte të pashpresë. Një sistem zgjedhor që mundëson oferta zgjedhore mund të funksionojë vetëm nëse paraqitja e një oferte nuk është thjesht e drejta e gjithkujt, pa asnjë përgjegjësi të mëtejshme. Vetëm një ofertë që merret seriozisht është një ofertë me kuptim. Numri i nënshkrimeve që duhet të mbledhen sigurisht që mbetet një atribut i ligjvënësit për ta përcaktuar, por ky përcaktim duhet të jetë i drejtë. ...”

Konkurrimi i lirë ndërmjet partive, vijon Gjykata Kushtetuese, është një shfaqje e drejtpërdrejtë e natyrës pluraliste të shoqërisë demokratike dhe është pikërisht mbrojtja e pluralizmit në jetën politike që ka kuptim për vetë ekzistencën e kësaj shoqërie. Gjykata thekson se çdo kufizim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë mbi barazinë e partive në konkurrimin zgjedhor nuk duhet të ketë një pasojë diferencuese ose të përbëjë një trajtim preferencial për disa parti, ose të ndalojë pjesëmarrjen e partive politike në konkurrimin zgjedhor.

¹ Entscheidungen des Bundesverfassungsgerichts. Volume 1, pp.247-248.

Nisur nga analiza e hollësishme dhe konstante e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, lidhur me rregullimin ligjor mbi kufizimin e partive joparlamentare dhe atyre që nuk kanë të zgjedhur në organet e qeverisjes vendore, në raport me partitë që kanë mandate në këto organe, Kolegji Zgjedhor vlerëson se detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve parashikuar nga neni 68.2 i Kodit Zgjedhor, duhet interpretuar nën frymën e standardeve kushtetuese të elaboruara si më sipër.

Referuar teknikës legislative të hartimit të dispozitës së nenit 68 të Kodit Zgjedhor, në pamje të parë krijohet përshtypja se rregulli për kandidim është ai i paraqitjes së nënshkrimeve mbështetëse, kurse përjashtimi nga ky rregull, është kandidimi i lirë nga partitë që kanë mandate në Kuvend a në organet e qeverisjes vendore. Kolegji Zgjedhor, pavarësisht mënyrës së hartimit të kësaj dispozite, vlerëson se parimi i sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 45.1), por edhe në nenin 3, pikat 2 dhe 3 të Kodit Zgjedhor, është ai i barazisë në të drejtën për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur. Për këtë, përcaktimi i detyrimit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse, vlerësohet si kufizim i kësaj të drejte, ndonëse neni 68, për nga mënyra e hartimit, të krijon përshtypjen se ai përbën rregullin, kurse garimi i lirë pa nënshkrime mbështetëse, është përjashtimi nga rregulli, duke u konsideruar si privilegj për partitë që kanë pasur sukses në zgjedhjet pararendëse.

Në funksion të interpretimit që bën jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, duke e konsideruar detyrimin për mbledhjen e nënshkrimeve si një kufizim të së drejtës për tu zgjedhur, Kolegji Zgjedhor mori në shqyrtim pretendimin e palës paditëse lidhur me zbatimin e nenit 68.2 për zgjedhjet e qershorit 2015, për organet e qeverisjes vendore. Kolegji Zgjedhor duke mbajtur në vëmendje se çdo kufizim i të drejtave të parashikuara në Kushtetutë bëhet me ligj (neni 17 i Kushtetutës) dhe se ligji duhet të jetë i qartë në kufizimin që përcakton për të mos shkaktuar konfuzion, pasiguri dhe për rrjedhojë cenim të së drejtës, vlerëson se ometimi i ligjvënësit si rrjedhojë e mungesës së një dispozite tranzitore për zbatimin e nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor për zgjedhjet vendore të vitit 2015, nuk mund të përkeqësojë situatën dhe të shtojë detyrimet që kufizojnë të drejtën për tu zgjedhur, të partive politike që kandidojnë.

Kuvendi i Shqipërisë, duke mos shprehur një vullnet pozitiv lidhur me zbatimin e nenit 68.2 për këto zgjedhje, ka lejuar zbatimin e nenit 68.2 edhe për këtë proces, pa pohuar qartësisht si do të vlerësohen mandatet e organeve të qeverisjes vendore aktuale, në raport me organet, për të cilat kandidohet, ndërkohë që disa njësi aktuale formojnë një njësi të re të qeverisjes vendore. Në vlerësimin e Kolegjit Zgjedhor ligjvënësi ka shprehur vullnetin që partitë pa mandat në Kuvend apo në organet e qeverisjes vendore, detyrohen të mbledhin nënshkrime mbështetëse, në zbatim të nenit 68.2. Një situatë e tillë është shumë e qartë. Çështja shtrohet për diskutim, në rastin kur një parti joparlamentare, që kandidon për organet e qeverisjes vendore për zgjedhjet e qershorit 2015, gëzon një mandat në organet e qeverisjes aktuale vendore, siç është rasti në shqyrtim kur Partia Socialdemokrate gëzon mandatin e këshilltarit në Këshillin e Bashkisë Manëz dhe Këshillin e Bashkisë Sukth, që janë pjesë përbërëse e Bashkisë Durrës, për të cilën kandidohet.

Në kushtet e mësipërme, Kolegji Zgjedhor vlerëson se pavarësisht ndonjë paqartësie të dispozitës ligjore nuk është në pamundësi për të kryer interpretimin e dispozitës së mësipërme, në kuptim edhe të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese.

Çështja që shtron për diskutim Kolegji Zgjedhor në këtë rast është, nëse duhet të përjashtohen nga detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve partitë që kanë mandat në organet e qeverisjes vendore të njërive aktuale, që janë pjesë e njërive të reja?

Ashtu siç u parashtrua më sipër, njësitë ekzistuese të qeverisjes vendore nuk përkojnë me ato të përcaktuara nga reforma territoriale, duke qenë secila prej tyre, pjesë e njërive të reja që krijohen. Sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vetëm mandatet që u përkasin organeve të qeverisjes vendore të qendrës së Bashkisë së re (në rastin konkret bashkia Durrës), janë ato, posedimi i të cilave përjashton partinë politike si subjekt zgjedhor, nga detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse. Nga ana tjetër Partia Socialdemokrate kundërshton këtë interpretim, duke ngritur çështjen e diskriminimit mes njërive të qeverisjes vendore që përbëjnë bashkinë e re për të cilën kandidohet.

Kolegji Zgjedhor vlerëson të drejtë pretendimin e palës paditëse, lidhur me interpretimin që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i bën nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor, për zgjedhjet e qershorit 2015, për sa kohë që nuk ka asnjë argument të bazuar në ligj për diferencimin e vlerës së mandatit në organet ekzistuese të qeverisjes vendore, të cilat do të përbëjnë njësinë e re. Përcaktimi prej ligjvënësit të qendrës së bashkisë së re, nuk mund të çojë në interpretimin se njësia ekzistuese, që mban emrin e qendrës së njësisë së re, të prevalojë në rëndësinë e mandatit të qeverisjes, përkundërt mandateve të organeve të njësive të tjera ekzistuese të qeverisjes vendore. Për Kolegjin Zgjedhor, të zgjedhurit në organet e qeverisjes vendore, të votuar në zgjedhje të lira dhe që ushtrojnë aktualisht funksionet e tyre, janë të barabartë. Përcaktimi i rregullave të njëjta, të barabarta nga ligjvënësi, si dhe zbatimi i tyre në mënyrë të tillë që të mos krijojë diferencim mes partive politike konkurente dhe që konsiston në trajtimin e pabarabartë e preferencial mes disa kandidatëve në raport me të tjerët, është obligim edhe për Kolegjin Zgjedhor, në interpretimin dhe zbatimin e ligjit për rastin në shqyrtim. Në këtë kuptim, përmbajtja e nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor duhet zbatuar në mënyrë të njëjtë, për të gjitha partitë që kanë mandate në organet e qeverisjes vendore aktuale, pavarësisht nëse kjo njësi është apo jo, qendra e njësisë së re, për organet e së cilës garohet në zgjedhjet e qershorit 2015.

Për sa më sipër, Kolegji Zgjedhor vlerëson se, nëse mandatet aktuale në organet e qeverisjes vendore, do të cilësohen të vlefshme për të përjashtuar partinë që i posedon ato, nga detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse, atëherë ky rregull do të zbatohet për mandatet e organeve të të gjitha njësive vendore që përbëjnë bashkinë e re, për të cilën zhvillohen zgjedhjet, pa bërë diferencim mes tyre.

Duke marrë në shqyrtim, situatën e re të krijuar për shkak të reformës territoriale, ku organet ekzistuese të qeverisjes vendore, nuk përkojnë me ato për të cilat subjektet zgjedhore paraqesin kandidatët e tyre, Kolegji Zgjedhor vuri në diskutim çështjen objekt shqyrtimi. Kolegji Zgjedhor, në mungesë të rregullimit tranzitor të zbatimit të dispozitës së nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor nëpërmjet shprehjes së vullnetit pozitiv të ligjvënësit, vlerëson se ka qenë vullneti i këtij të fundit, për të lejuar zbatimin e kësaj norme edhe për zgjedhjet e qershorit të vitit 2015. Zbatimi i nenit 68.2 mund të bëhet

vetëm në tërësinë e tij, si për detyrimin (mbledhjen e nënshkrimeve) ashtu edhe për përjashtimin prej tij. Çdo interpretim sipas të cilit subjektet zgjedhore jo parlamentare, do të detyroheshin të mblidhnin në çdo rast nënshkrime mbështetëse, për shkak se organet për të cilat ato kandidojnë nuk ekzistojnë dhe si të tilla, ato nuk mund të kenë mandate, do të linte pa efekt juridik, përjashtimin nga detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve, pra do të linte pa zbatim shprehjet “ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore” dhe “në këshillin përkatës”. Norma juridike hartohet për tu zbatuar dhe për të sjellë efekte juridike, ndaj është detyrë e Kolegjit Zgjedhor që të interpretojë nenin 68.2, në mënyrë të tillë që të aplikohet detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve, ashtu si edhe përjashtimi nga ky detyrim, për partitë politike që kanë mandate në organet e qeverisjes vendore. Nisur nga fakti se mbledhja e nënshkrimeve përbën një kufizim ligjor të së drejtës për tu zgjedhur, për parti politike që nuk kanë një sukses të mëparshëm në zgjedhje, detyrim ky i parashikuar prej ligjvënësit për interes publik, Kolegji Zgjedhor, vlerëson se interpretimi dhe zbatimi në praktikë i nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor nuk mund të rezultojë në një përkeqësim të situatës së subjekteve zgjedhore, që kanë mandate në organet aktuale të qeverisjes vendore, për sa kohë që ligjvënësi nuk e ka bërë një kufizim të tillë, qoftë edhe për zgjedhjet e qershorit 2015. Kriteret kufizuese të nenit 68 të Kodit Zgjedhor janë analizuar hollësisht nga Gjykata Kushtetuese, çka ka sjellë ndryshimet përkatëse të kësaj dispozite, në përputhje me parimet kushtetuese dhe standardet e gjithëpranuara për zgjedhjet. Si rrjedhojë, Kolegji Zgjedhor vlerëson se çdo interpretim që rrit masën e kufizimit lidhur me barazinë e votës, nuk është në përputhje me ligjin dhe shkakton cenim të së drejtës së subjekteve zgjedhorë që nuk detyrohen të mblidhin nënshkrime mbështetëse, për sa kohë që ky detyrim duhet të rezultojë i qartë nga vetë ligji dhe jo nga vlerësimi i zbatuesve të tij.

Si konkluzion i sa më sipër, Kolegji Zgjedhor vlerëson të pabazuar në ligj pikën “1” të vendimit 214/2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me të cilin është ngarkuar pala paditëse me një detyrim të papërcaktuar në ligj, duke cenuar të drejtat e saj në procesin zgjedhor. Për këtë shkak, Kolegji Zgjedhor vlerëson se kjo pikë e vendimit, që përbën edhe objektin e padisë në shqyrtim, duhet të shfuqizohet, si një akt administrativ relativisht i pavlefshëm, referuar nenit 118 të Kodit të Procedurave Administrative.

III. Lidhur me kërkimin e palës paditëse për detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të regjistruar listën e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Bashkisë Durrës.

Për shkak të pretendimit mbi pavlefshmërinë e pikës “1”, të vendimit 214/2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pala paditëse, duke pranuar se nuk ka asnjë kundërshtim me pikën “2” të tij, lidhur me parregullsinë e një prej kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Bashkisë Durrës, i ka kërkuar Kolegjit Zgjedhor të detyrojë palën e paditur të regjistrojë listën e kandidatëve. Në seancë gjyqësore përfaqësuesi i subjektit zgjedhor Partia Socialdemokrate, parashtroi se parregullsia e konstatuar me vendimin e sipërcituar, në pikën 2 të tij, është ndrequr prej saj.

Kolegji Zgjedhor, i cili shqyrton çështjet brenda kompetencave të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor, pranoi për të shqyrtuar në themel pretendimin për interpretimin dhe zbatimin e nenit 68.2 të këtij Kodi, për sa kohë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dha një vendim shterues mbi këtë çështje dhe rezultati përfundimtar lidhur me kërkesën për regjistrimin e listës së kandidatëve, do të ishte pa asnjë dyshim, ai i refuzimit të regjistrimit, nëse nuk depozitohet lista mbështetëse e zgjedhësve.

Nga ana tjetër, ushtrimi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i kompetencës së parashikuar në nenin 73 të Kodit Zgjedhor për verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, rezultoi të mos jetë ezauruar, për sa kohë që nga ky organ është konstatuar edhe një tjetër parregullsi, për të cilën pala paditëse nuk ka pasur vërejtje. Në këto kushte, i përket Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kompetenca për të vlerësuar nëse subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate ka përmbushur detyrimet e saj lidhur me depozitim të dokumentacionit të kandidimit të korrigjuar, për të vendosur përfundimisht regjistrimin ose refuzimin e regjistrimit të listës së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Bashkisë Durrës.

Për sa më sipër, referuar edhe nenit 158, pika 2 të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet se Kolegji Zgjedhor pushon gjykimin e çështjes, kur konstaton se nuk është kompetent për shqyrtimin e saj, vlerësohet se për këtë kërkim, ky Kolegj nuk mund të japë një vendim përfundimtar (themeli) pasi kompetent për të, është Komisioni

Qendror i Zgjedhjeve, i cili pasi të verifikojë korrigjimin e parregullsisë së konstatuar në pikën “2” të vendimit 214/2015, duhet të vendosë sipas rastit, regjistrimin apo refuzimin e kërkesës së palës paditëse.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës Apelit Tiranë bazuar në nenin 158, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, pika 2 dhe pika 3 të Kodit Zgjedhor.

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të padisë.
- Shfuqizimin e pikës “1” të vendimit nr. 214, datë 06.05.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me detyrimin e Partisë Socialdemokrate për depozitimin e listës mbështetëse të 1 për qind të zgjedhësve për Këshillin e Bashkisë Durrës.
- Pushimin e gjykimit lidhur me kërkimin për detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të regjistruar listën e kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Durrës.

Tiranë, 15.05.2015

**Gjyqtar
Gjinovefa GABA**

**Gjyqtar
Ilir TOSKA
(kundër)**

**Gjyqtar
Edlira PETRI**

**Gjyqtar
Petrit ÇENO**

**Gjyqtar
Kliton SPAHIU**

MENDIM PAKICE

Si anëtar i Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, ndaj mendim të kundërt me atë të shumicës, lidhur me vendimin nr. 7, datë 15.05.2015, pasi vlerësoj se gjykimi i çështjes duhej të ishte pushuar.

Subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate ka bërë anim pranë Kolegjit Zgjedhor, kundër pikës 1 të vendimit nr. 214, datë 06.05.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me të cilin ka vendosur :

“Kthimin për korrigjim të dokumentacionit të kandidimit për listën shumëmemërore të kandidatëve për këshillin e bashkisë Durrës, të Partisë Socialdemokrate si më poshtë :

1. Të depozitohet lista e 1% të zgjedhësve të Bashkisë Durrës që mbështesin listën e kandidatëve për këshillin e bashkisë Durrës të propozuar nga Partia Socialdemokrate së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit, të nënshkruar prej tyre. ...”

Ky vendim është marrë në rrethanat kur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjatë shqyrtimit të kërkesës së palës paditëse për regjistrimin e listës së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Bashkisë Durrës, ka konstatuar parregullsi në dokumentacionin e kandidimit e për këtë shkak, bazuar në nenin 73.1 të Kodit Zgjedhor ka urdhëruar korrigjimin e tij.

Në rrethanat si më sipër, rezulton se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka marrë një vendim përfundimtar lidhur me kërkesën e subjektit zgjedhor Partia Socialdemokrate, që do të konsistonte në pranimin apo refuzimin e kërkesës për regjistrim, çka do të thotë se çështja është ende në juridiksionin administrativ dhe në kompetencën e KQZ-së për të marrë një vendim përfundimtar. Vetëm në rastin e një vendimi refuzimi, subjekti zgjedhor përkatës, do të mund të pretendonte cenimin e të drejtave të tij në procesin zgjedhor e për rrjedhojë do të legjitimohej, që të bënte ankim në Kolegjin Zgjedhor kundër vendimit të KQZ-së, sipas nenit 145 të Kodit Zgjedhor.

Duke vlerësuar se padia e paraqitur nga Partia Socialdemokrate, ka për objekt të saj një vendim, kundër të cilit nuk lejohet ankim për shkak të kompetencës së KQZ-së mbi çështjen objekt shqyrtimi

(kërkesa për regjistrimin e listës së kandidatëve), referuar nenit 158.1, shkronja “a” dhe 158.2 të Kodit Zgjedhor, jam i mendimit se duhej vendosur pushimi i gjykimit.

Tiranë, 15.05.2015

Gjyqtar në pakicë
Ilir TOSKA

* * *



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR

NR. 08 REGJ. THEMELTAR
DATË 12.05.2015 REGJ.

Nr. 08 VENDIMI
DATË 15.05.2015 VENDIMI

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUES :	VALBON ÇEKREZI
ANËTAR :	EDLIRA PETRI
ANËTAR :	KLITON SPAHIU
ANËTAR :	ANDI CIVICI
ANËTAR :	PETRIT ÇENO

me sekretare **Rexhina Baci**, në Tiranë, sot në date **15.05.2015**, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore me nr.8 Akti, që u përket palëve:

PADITËSE: **Partia Socialdemokrate Shqipërisë,**
përfaqësuar nga kryetari i saj Z. Skënder Gjinushi.

I PADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,**
përfaqësuar me autorizim Olsi PETO.

PALË E INTERESUAR: **Partia Demokratike e Shqipërisë,**
në mungesë.
Partia Socialiste Shqipërisë, në mungesë.

OBJEKTI: Ndryshimi i vendimit Nr.220, datë 07.05.2014 i KQZ, pranimit të kërkesës sonë ankimore Nr.04., datë 05.04.2015 drejtuar KQZ. Detyrimin e KZAZ-së Nr.11, Bashkia Kukës të pranojë e të regjistrojë listën shumë emërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Kukës, të Partisë Socialdemokrate.

BAZA LIGJORE: Nenet 1/3, 4 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 22,23, 24, 68, 70, 144, 145-158, të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; nenet 115/a, 118 dhe 119 të Kodit të Procedurave Administrative.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoji palët prezent në pretendimet e tyre, paditësin nëpërmjet përfaqësuesit të tij që në perfundim kërkoi pranimin e padisë sipas objektit, përfaqësuesin e pales së paditur, që kërkoi rrëzimin e padisë, pasi administroi provat e bisedoi çështjen në tërësi;

VËREN

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me Vendimin Nr.103, datë 09.04.2015, bazuar në nenin 64 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar), ka vendosur “Të regjistrojë Partinë “Partia Socialdemokrate e Shqipërisë”, me kryetar Z. Skënder Gjinushi, dhe shkronjat nistore “PSD”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015”.

Me Vendimin Nr.88 të datës 07.04.2015, bazuar në nenet 23/1/a, 71/1 dhe 72/1 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar), KQZ ka miratuar modelet e dokumentacionit të kandidimit që do të përdoren në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 Qershor 2015, ndër të cilat edhe Modelin 10 K, "Kërkesë për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve".

Afati i dorëzimit të dokumentacionit për regjistrimin e listave shumemërore të kandidatëve për këshillin dhe kandidatëve për kryetar të organeve të qeverisjes vendore, ka qenë data 4 maj 2015, ora 18.00, afat ky që është shtyrë deri në orën 24.00 të po asaj dite, fakt që është bërë i njohur nëpërmjet deklaratës publike të Kryetares së KQZ-së në mbledhjen e datës 04.05.2015.

Më datë 05.05.2014 nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, është paraqitur pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve ankimi me objekt; "Kundërshtim i vendimit ekstraprocedural të KZAZ-së NR.11,verbale".

Nëpërmjet ankimit të paraqitur është pretenduar se; përfaqësues të këtij subjekti zgjedhor më datë 04.05.2015, janë paraqitur pranë Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ-së) Nr.11, Kukës për dorëzimin e dokumentacionit për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve të këtij subjekti për anëtarë këshilli të Bashkisë Kukës, por se ky dokumentacion nuk është pranuar me pretendimin se afati kishte përfunduar në orën 18.00, ndërkohë që KQZ kishte shtyrë afatin deri në orën 24.00; pavarësisht ndërhyrjes verbale nga ana e KQZ-së, KZAZ Nr.11 nuk ka pranuar listën shumemërore.

Në procesin administrativ të shqyrtimit të kësaj kërkesë ankimore nga ana e KQZ-së, rezulton të jenë pyetur me cilësinë e dëshmitarëve dhe shtetasit A.Elezi dhe S.Doci, anëtarë të KZAZ Kukës të cilët kanë mohuar që më datë 04.05.2014 të ishin paraqitur pranë asaj KZAZ-je përfaqësues të subjektit zgjedhor PSD-së për depozitimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtarëve të këshillit të Bashkisë Kukës.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ KQZ me vendimin nr.220, datë 07.05.2015 KQZ ka vendosur rrëzimin e kërkesës ankimore nr.4, regj. të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate me argumentin që; nga pala ankuese nuk ishte paraqitur asnjë provë për të vërtetuar faktin e pretenduar prej saj, se ishte paraqitur pranë KZAZ Nr.11, Kukës për të depozituar listën shumemërore të anëtarëve të këshillit të Bashkisë Kukës, në datë 14.04.2015 e cila ka qenë dhe data e fundit për regjistrimin e listave shumemërore.

Subjekti zgjedhor, PSD nëpërmjet padisë së paraqitur më datë 12.05.2015 pranë Kolegjit Zgjedhor, ka kundërshtuar vendimin nr.220, datë 07.05.2015 të K.Q.Z. duke pretenduar ; vendimi i KQZ është hapatazi i padrejtë pasi, KZAZ Nr.11 ka qenë e detyruar të pranojë dokumentacionin deri në orën 24.00 që është qartazi e provuar, madje edhe nga vetë KQZ gjatë shqyrtimit administrativ të kërkesës ankimore të paditësit por sidomos nga shkresa, "Informacion-Kërkesë", depozituar prej nesh pranë KQZ në orën 22.44 të datës 04.05.2015 dhe se, KZAZ nuk ka respektuar afatin ligjor; i njëjti shqetësim ka qenë edhe me KZAZ-n Prrenjas, çështje e cila u zgjidh me urdhërim të KQZ dhe se ky qëndrim i dyfishtë i KQZ tregon pabazueshmërinë e padrejtësinë e vendimit të KQZ.

Përfaqësuesi i KQZ, kërkoi rrëzimin e padisë duke iu përmbajtur argumentimit në vendimin e ankimuar.

Kolegji Zgjedhor, pasi ia nënshtroi çështjen debatit gjyqësor, dëgjoi palët, administroi provat, në konsideratë të fakteve të rezultuara nga provat e marra në gjykim, arriti në përfundimin që padia e paraqitur nga PSD rezulton e bazuar në prova dhe në ligj dhe se, Vendimi i KQZ Nr.220, datë 07.05.2015 është marrë në kundërshtim me faktet dhe në zbatim jo të drejtë të ligjit, duke qenë një akt administrativ relativisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 118 të Kodit të Procedurave Administrative , dhe si i tillë duhet të shfuqizohet.

Kolegji konstatoi fillimisht që, subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, legjitimohet në paraqitjen e ankimit/padisë ndaj vendimit Nr.220, datë 07.05.2015 të K.Q.Z-së në kuptim

të nenit 145 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar) dhe se, ankimi/padia është paraqitur brenda afatit (pesë ditë nga shpallja e vendimit të KQZ-së) të parashikuar në nenin 152 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar).

Gjatë shqyrtimit të çështjes, Kolegji Zgjedhor administroi përveçse praktikën dokumentare në lidhje me Vendimin Nr.220, datë 07.05.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve edhe provat e paraqitura nga pala paditëse si; "INFORMACION KËRKESË", datë 04.05.2015, ora 22.14 drejtuar KQZ-së; dokumentacioni për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve të këtij subjekti për anëtarë këshilli të Bashkisë Kukës.

Në referim të përcaktimeve të nenit 67/1 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar), partia politike që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, brenda afatit të përcaktuar duhet të paraqesë kërkesën për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve pranë KZAZ që mbulon njësinë e qeverisjes vendore ose, sipas rastit pranë KQZ-së kur territori i njësisë së qeverisjes vendore/bashkisë nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme sipas parashikimit të nenit 67 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar).

KZAZ-ja përkatëse ose sipas rastit KQZ-ja, në zbatim të nenit 73 (të ndryshuar) të Kodit Zgjedhor, me paraqitjen e dokumentacionit kryen verifikimin e rregullshmërisë së dokumentacionit duke konkluduar në vendim-marrje për pranim ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar, brenda një afati prej 48 orësh nga paraqitja e dokumentacionit.

Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore kishin detyrimin që brenda datës 04.05.2015 ora 24.00, që ishte dhe afati i përcaktuar, të paraqisnin kërkesat për regjistrimin e listave shumëmemërore të kandidatëve të tyre për anëtarë të këshillave bashkiakë pranë KZAZ-ve që mbulonin njësinë e qeverisjes vendore përkatëse ose, sipas rastit pranë KQZ-së kur territori i njësisë së qeverisjes vendore/bashkisë nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme.

Referuar rrethanave të faktit të rezultuara në gjykim, rezulton që subjekti zgjedhor PSD të ketë përmbushur detyrimin për paraqitjen e kërkesës për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve të saj për anëtarë të këshillit të Bashkisë Kukës pranë

KZAZ-së Nr.11, që mbulon njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Kukës, brenda afatit, para përfundimit të afatit që ishte ora 24.00 e datës 04.05.2015.

Në kushtet e pamundësisë regjistrimit/dorëzimit të kërkesës pranë KZAZ-së Nr.11 Kukës, PSD i është drejtuar me "INFORMACION KËRKESË" datë 04.05.2015, ora 22.14 KQZ-së, që rezulton të jetë protokolluar pranë KQZ-së me nr.4005, datë 04.05.2015, nëpërmjet së cilës e njoftonte se; *"KZAZ-të në Kukës dhe Prrenjas nuk kanë zbatuar orarin e vendosur prej Jush, për të pranuar dokumentat e kandidatimit për zgjedhjet e 21 Qershorit të përfaqësuesve të Partisë Socialdemokrate."*

Ndërkohë sic ka rezultuar e provuar edhe gjatë hetimit administrativ të zhvilluar pranë KQZ-së nga pyetja e dëshmitarëve A.Elezi dhe S.Doci anëtarë të KZAZ-së Kukës, kjo KZAZ kishte ndërprerë/përfunduar procesin e pranimit të dokumentacionit nga subjektet zgjedhore rreth orës 20.30 të datës 04.05.2015, kur afati i fundit të paraqitjes dhe pranimit të dokumentacionit ishte ora 24.00.

Komisioni Zonës së Administrimit Zgjedhor, si organ i administratës zgjedhore që ngrihet dhe funksionon në përputhje me Kodin Zgjedhor, kishte detyrimin që të mos e ndërpriste/përfundonte procesin e pranimit të dokumentacionit nga subjektet zgjedhore para përfundimit të afatit të përcaktuar në përputhje me parashikimet e nenit 67/1 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar), që për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, ka qenë ora 24.00 e datës 04.05.2015.

Në një situatë të tillë, në kushtet e pamundësisë së realizimit të të drejtës për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve të saj për anëtarë të këshillit të Bashkisë Kukës pranë KZAZ-së Nr.11, e kushtëzuar kjo edhe nga fakti që afati për regjistrimin ishte në limitet e tij, mjeti i vetëm i kërkuesit për të përmbushur këtë detyrim të tij ishte vënia në dijeni e KQZ-së që është organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve.

Kjo sjellje e palës paditëse si subjekt zgjedhor është në përputhje edhe me përcaktimet e nenit 21 (të ndryshuar) të Kodit Zgjedhor që parashikon kompetencat e KQZ-së, ku posacërisht në pikën 3 shprehet se: *"Drejton dhe kontrollon kolegjisht, nëpërmjet cdo anëtari ose strukturave të saj, procesin parazgjedhor dhe atë zgjedhor."*

Konsideratat e mësipërme, janë të mjaftueshme për t'i dhënë mundësi kolegjit të konstatojë që, subjekti zgjedhor PSD ka shprehur qartësisht vullnetin në përmbushje të detyrimit, paraqitjes së kërkesës për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit të Bashkisë Kukës brenda afatit të përcaktuar dhe se, mosmarrja në në shqyrtim e kësaj kërkesë dhe dokumentacionit ka qenë si pasojë e mosmarrjes së masave të nevojshme/duhura të administratës zgjedhore në përmbushje të detyrimeve të saj që i ngarkohen nga Kodi Zgjedhor, edhe për respektimin e afatit të pranimit të dokumentacionit nga subjektet zgjedhore.

E drejta për të marrë pjesë në zgjedhje e një partie politike është një e drejtë kushtetuese, për sa kohë kjo e drejtë ushtrohet në përputhje me ligjin dhe si e tillë nuk mund të dështojë si pasojë e mosmarrjes së masave të nevojshme/duhura nga administrata zgjedhore.

KQZ nëpërmjet vendim-marrjes objekt shqyrtimi, i ka mohuar të drejtën subjektit zgjedhor PSD për të paraqitur kërkesën për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve të saj për anëtarë të këshillit të Bashkisë Kukës në ushtrim të së drejtës për të marrë pjesë në zgjedhjet për anëtarëve të këshillit bashkiak të kësaj njësie të qeverisjes vendore, duke e bërë kështu këtë vendim-marrje jo në përputhje me ligjin.

Në referim të rrethanave të mësipërme, kolegji vlerëson që jemi para situatës që vendim i KQZ-së është marrë në kundërshtim me faktet dhe në zbatim jo te drejte te ligjit, duke qenë një akt administrativ relativisht i pavlefshëm në kuptim te nenit 118 te Kodit të Procedurave Administrative dhe si i tillë duhet të shfuqizohet, duke u detyruar organi vendim-marrës KQZ të marrë në shqyrtim kërkesën e subjektit zgjedhor PSD, në zbatim të nenit 158/1-c/4 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar) .

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë,
bazuar në nenin 158/1-c/4 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar,

V E N D O S I

- Pranimin e kërkesë padisë.
- Shfuqizimin e vendimit nr.220, datë 07.104.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Detyrimin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve të marrë në shqyrtim kërkesën së bashku me dokumentacionin e kandidimit të subjektit zgjedhor Partia Socialdemokrate, për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve të këtij subjekti për anëtar të Këshillit Bashkiak Kukës.
- Bashkangjitur këtij vendimi, i dërgohen Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, dokumentacioni i kandidimit të paraqitur nga pala paditëse, Partia Socialdemokrate për Këshillin Bashkiak Kukës.

Tiranë, më 15.05.2015

ANËTAR **ANËTAR** **KRYESUES**
EDLIRA PETRI **KLITON SPAHIU** **VALBON CEKREZI**
(pjeserisht kunder)

ANËTAR **ANËTAR**
PETRIT CENO **ANDI CIVICI**

* * *



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOLEGJI ZGJEDHOR
I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

NR. 09 REGJ. THEMELTAR
Nr. 9 i Vendimit.

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga:

KRYESUES :	Kliton SPAHIU
ANETAR :	Petrit ÇENO
ANETAR :	Valbon ÇEKREZI
ANETARE :	Edlira PETRI
ANETAR :	Andi CIVICI

me sekretare Rexhina Baci, në Tiranë, sot më **dt.22.05.2015**, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative–zgjedhore me nr.9 Akti, që u përket palëve:

PADITES: Agim BREGU, përfaqësuar nga av.Fatjola Halilaj.

I PADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,
përfaqësuar nga z.Olsi Peto.

Palë e Interesuar: Partia Socialiste e Shqipërisë,
përfaqësuar nga Gledion Llatja dhe Elion Semanaj.
Partia Demokratike e Shqipërisë, në mungesë.
Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimin e vendimit nr 406, datë 14.05.2015 të KQZ.

Baza ligjore: Nenet 145 e 152 të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008,
“Kodi Zgjedhor i RSH” i ndryshuar.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, shqyrtoi dhe administroi provat shkresore, dëgjoi palët prezent në pretendimet e tyre përfundimtare të cilët kërkuar; -përfaqësuesi i palës paditëse pranimin e padisë; -përfaqësuesi i palës së paditur rrëzimin e padisë, -përfaqësuesin e palës së interesuar Partia Socialiste, rrëzimin e padisë, e si bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Pranë Kolegjit Zgjedhor është paraqitur për shqyrtim kërkesë-padia e paditësit Agim Bregu, i cili ka paditur KQZ-në, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit me nr. 406, datë 14.05.2015.

Shqyrtimi administrativ i kërkesës nga KZAZ dhe ankimi administrativ pranë KQZ:

Partia Fronti i Majtë me vendimin Nr 120, datë 13.04.2015, është regjistruar si subjekt zgjedhor pranë KQZ-së.

Partia Fronti i Majtë në datë 03.05.2015, ora 16.30, ka dorëzuar pranë KZAZ-së Nr 62, kërkesën dhe dokumentacionin e kandidimit për Kryetar Bashkie, Z. Agim Bregu, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015.

KZAZ Nr 62, “Ura Vajgurore” në datë 09.05.2015 pasi ka verifikuar dokumentacionin e kandidimit, ka vendosur; *“Mosregjistrimin e kandidatit për kryetar Bashkia Ura Vajgurore, Z.Agim Bregu”*.

Me kërkesën ankimore të depozituar pranë KQZ, të datës 11.05.2015, me nr. protokollit 4499, Z. Agim Bregu si ankimues ka kundërshtuar vendimin e KZAZ-së Nr 62, të datës 09.05.2015, duke pretenduar se refuzimi i regjistrimit të tij nga KZAZ, ishte në kundërshtim me ligjin.

Gjatë shqyrtimit të ankimit administrativ të ankimuesit Agim Bregu, përfaqësuesi i Partisë Socialiste e Shqipërisë, në kërkesat paraprake ka pretenduar se ankimuesi nuk ka legjitimim për të paraqitur këtë kërkesë-ankimore, për faktin se nuk është paraqitur

autorizim nga Partia Politike Fronti i Majtë, si dhe kërkesa-ankimore është nënshkruar nga shtetasi Agim Bregu dhe jo nga Kryetari i Partisë që e ka propozuar atë si kandidat (*Partia Fronti i Majtë*). Këtë kërkesë paraprake në procedurë e ka mbështetur edhe përfaqësuesi i Partisë Demokratike të Shqipërisë.

KQZ-ja me vendimin Nr. 406, datë 14.05.2015, ka vendosur; *“Pushimin e shqyrtimit administrativ të kërkesës ankimore Nr. 9 Regjistri të paraqitur nga Z.Agim Bregu”*. Arsyetimi i saj në marrjen e këtij vendimi është se; Z.Agim Bregu prezantohet si kandidat për Kryetar Bashkie, Ura Vajguore, i Partisë Fronti i Majtë, dhe jo si përfaqësues i autorizuar nga kjo parti politike, si subjekt zgjedhor, për të paraqitur kërkesën ankimore në KQZ. Edhe nënshkrimi i kërkesës ankimore është bërë nga vetë kandidati dhe jo si përfaqësues me autorizim i subjektit zgjedhor.

Me këtë vendim nuk ka qenë dakord Z. Agim Bregu i cili në datë 18.05.2015 ka paraqitur Kërkesë-Padi, në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, shqyrtoi dhe administroi provat shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse në dobi të gjykimit, konkludoi se:

Vendimi nr. 406, datë 14.05.2015 i KQZ-së, objekt shqyrtimi në këtë Kolegj Zgjedhor është marrë në zbatim korrekt të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, e për pasojë padia e paditësit Agim Bregu duhet rrëzuar.

Neni 124/1 Kodit Zgjedhor ka përcaktuar subjektet zgjedhore të cilët mund të paraqesin ankim në KQZ kundër vendimeve KZAZ-së, të cilët janë; *-partitë politike dhe -kandidati i propozuar nga zgjedhësit*.

Në rastin në shqyrtim rezulton se shtetasi Agim Bregu është paraqitur si kandidat për Kryetar Bashkie, Ura Vajguore, nga subjekti zgjedhor, Partia Fronti i Majtë, dhe jo si kandidat i propozuar nga zgjedhësit, për pasojë ankimi në KQZ kundër vendimit të KZAZ-së, për refuzimin e regjistrimit të kandidatit të paraqitur nga partia politike, duhej të paraqitej nga subjekti zgjedhor, Partia Fronti i Majtë.

Kërkesa ankimore rezulton të ketë si subjekt ankimues z. Agim Bregu, i cili edhe e ka nënshkruar ankimin e depozituar. Po

kështu, edhe Kërkesë–Padia rezulton të jetë ngritur nga paditësi Agim Bregu dhe nënshkruar nga ai si paditës, në një kohë që sipas nenit 145 të Kodit Zgjedhor e drejta e ankimit në Kolegjin Zgjedhor u njihet vetëm subjekteve zgjedhore dhe partive politike a individëve që u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor. Në rastin në shqyrtim, ashtu si edhe u parashtrua më sipër, kërkesën për paraqitjen e kandidatit për Kryetar të Bashkisë Ura Vajgurore e ka bërë subjekti zgjedhor Partia Fronti i Majtë, ndaj ky është edhe subjekti, i cili ka legjitimimin për të bërë ankimin administrativ ndaj vendimit të KZAZ e më tej edhe ankimin gjyqësor. Paditësi Agim Bregu rezulton kështu, të mos ketë legjitimim aktiv për të paraqitur ankimin administrativ në KQZ, sikurse edhe padinë në këtë Kolegj Zgjedhor, meqenëse nuk është subjekt zgjedhor sipas parashikimit të nenit 2/20 të Kodit Zgjedhor (ai do të cilësohej si subjekt zgjedhor, vetëm pas regjistrimit të tij si kandidat).

Paditësi Agim Bregu në seancën e shqyrtimit gjyqësor në Kolegjin Zgjedhor, paraqiti një autorizim me nr.155 prot, datë 10.05.2015, me të cilën kërkoi të provonte se ai ka qenë i autorizuar për të bërë ankim, që në datë 10.05.2015, nga subjekti zgjedhor Partia Fronti i Majtë e për pasojë ka legjitimim aktiv për të ndjekur ankimin administrativ dhe gjyqësor ndaj vendimit të KZAZ-së me Nr. 62, *“Për mosregjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie Ura Vajgurore, Agim Bregu”*.

Ky Kolegj Zgjedhor, vlerëson se, autorizimi i paditësit nga Kryetari i Partisë Fronti i Mjatë “për të mbrojtur interesat e këtij subjekti pranë KQZ”, sic edhe është formuluar në rastin konkret, nuk e legjitimon përfaqësuesin (paditësin) që të veprojë në emrin e tij dhe jo të të përfaqësuarit (subjektit zgjedhor), në ushtrimin e të drejtave që Kodi Zgjedhor ia ka njohur vetëm këtij të fundit. Në rastin konkret, mungesa e paraqitjes së aktit të përfaqësimit gjatë shqyrtimit të ankimit administrativ, do të mund të ndreqej, nëse vetë mjeti procedural i ankimit do të ishte paraqitur në afatin e përcaktuar në ligj, në emër të Partisë Fronti i Majtë dhe jo në emër të paditësit Agim Bregu. Paraqitja e ankimit nga ky i fundit, nuk rezulton vetëm në aspektin formal të shënimit të emrit të ankuesit, por edhe nga vetë përmbajtja e ankimit, në të cilin paditësi ankon personalisht vendimin e KZAZ, me të cilin ishte refuzuar regjistrimi i tij si kandidat për Kryetar të Bashkisë Ura Vajgurore.

Për sa më sipër ky Kolegj Zgjedhor konkludon se vendimi i KQZ me Nr.406, datë 14.05.2015, është i drejtë dhe i bazuar në ligj, për pasojë bazuar në nenet 124/1, 2/20 dhe 158/3 të Kodit Zgjedhor, duhet rrëzuar padia e paditësit Agim Bregu.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, bazuar në nenin 158/3 të Kodit Zgjedhor.

V E N D O S I

-Rrëzimin e padisë së paditësit Agim Bregu.

U shpall në Tiranë sot më dt.22.05.2015.

ANËTAR
Valbon ÇEKREZI

ANËTAR
Andi CIVICI

ANËTAR
Petrit ÇENO

ANËTARE
Edlira PETRI

KRYESUES
Kliton SPAHIU

* * *



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR

NR. 10 REGJ. THEMELTAR
Date 19.05.2015

Nr. 10 Vendimit
Date 22.05.2015

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga:

KRYESUES :	GJINOVEFA GABA
ANETAR :	PETRIT ÇENO
ANETAR :	FUAT VJERDHA
ANETAR :	ILIR TOSKA
ANETAR :	KLITON SPAHIU

me sekretare **Rexhina Baçi**, në Tiranë, sot në date **22.05.2015**, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore me nr.10 Akti, që u përket palëve:

PADITESE: **Partia Socialdemokrate Shqipërisë**, përfaqësuar nga kryetari i saj Z. Skender Gjinushi dhe Av. Irena Reso.

I PADITUR: **Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar me autorizim nga Z. Olsi Peto.

PALE TE INTERESUARA: **Partia Socialiste e Shqipërisë**, përfaqësuar me autorizim nga Z. Gledion Llatja dhe Z. Elion Semanaj.
Partia Levizja Socialiste per Integrim, përfaqësuar me autorizim nga Z. Dritan Fejzo.

OBJEKTI: - Shfuqizimin e vendimit te ndermjetem te KQZ-se marre me date 14.05.2015 gjate shqyrtimit te Kerkeses Ankimore Nr.06.
- Urdherimin e KQZ-se per te marre vendim brenda 24 oreve per Kerkesen Ankimore Nr.06.

BAZA LIGJORE: Nenet 1/3, 4 dhe 42 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise; nenet 71, 143/3, 145 e vijues te Ligjit Nr.10019, date 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise" i ndryshuar; nenet 118 e vijues te Kodit te Procedurave Administrative.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoi palët prezent në pretendimet e tyre, palën paditëse PSD, që nëpërmjet përfaqësuesve të saj kërkoi pranimin e padisë sipas objektit, palën e paditur KQZ, që nëpërmjet përfaqësuesit të saj kërkoi pushimin e gjykimit ose rrëzimin e padisë, palën e interesuar PS, që nëpërmjet përfaqësuesve të saj kërkoi mospranimin e kërkesëpadisë dhe pushimin e gjykimit të çështjes, palën e interesuar LSI, që nëpërmjet përfaqësuesit të saj kërkoi rrëzimin e padisë, si dhe pasi administroi provat e bisedoi çështjen në tërësi;

V Ë R E N

Pala paditëse Partia Socialdemokrate e Shqipërisë (më poshtë referuar si PSD), është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015 (sipas Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Nr.103, datë 09.04.2015).

Në datë 03.05.2015, subjekti zgjedhor PSD, bazuar në nenet 67/1/3 dhe 72 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, ka paraqitur përpara Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (më poshtë referuar si KZAZ) Nr.53, Qarku Elbasan, një kërkesë për regjistrimin si kandidat për Kryetar të Bashkisë Prrenjas, Qarku Elbasan, në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 21.06.2015, Z. Artur Rexhep Topi, e shoqëruar me dokumentet përkatëse të kandidimit.

Mbi këtë kërkesë të subjektit zgjedhor PSD, KZAZ Nr.53, Qarku Elbasan, me Vendimin Nr.49, datë 05.05.2015, bazuar në nenin 67 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, ka vendosur:

“Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, të regjistrojë si kandidat për kryetar në Bashkinë Prrenjas, Z. Artur Rexhep Topi, paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë”, vendim ky ndaj të cilit mund të bëhej ankim brenda 3 ditëve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (më poshtë referuar si KQZ).

Duke mos qenë dakord me këtë vendim të KZAZ Nr.53, Qarku Elbasan, në datë 08.05.2015, përpara KQZ-së ka paraqitur ankim subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë (më poshtë referuar si PS), ankim me anë të të cilit ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe ç’regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Prrenjas Z. Artur Topi, me pretendimin se dokumentacioni i kandidimit paraqitur nga subjekti zgjedhor PSD për regjistrimin e kandidatit të saj për kryetar të Bashkisë Prrenjas nuk ishte në përputhje me kërkesat e ligjit, Kodit Zgjedhor të ndryshuar, por përmbante të meta thelbësore që cenonin frymën e ligjit, pasi nënshkrimet e zgjedhësve mbështetës të kandidatit të regjistruar ishin marrë në mashtrim të hapur të zgjedhësve në lidhje me subjektin zgjedhor për të cilin ai do të kandidohej (zgjedhësve u ishte thene se Z. Artur Topi do te ishte kandidat i PS dhe jo i PSD), përveç se një pjesë e nënshkrimeve të zgjedhësve mbështetës ishin të falsifikuara, ndërkohë që KZAZ nuk kishte verifikuar në përputhje me procedurat ligjore, listën e nënshkrimeve mbështetëse të zgjedhësve të paraqitur nga subjekti zgjedhor PSD, ndërsa kishte marrë vendimin pa prezencën e anëtarëve të emëruar me propozimin e subjektit zgjedhor ankues PS dhe të subjektit tjetër zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (më poshtë referuar si LSI).

Ankimi si më lart (identifikuar si Kërkesa Ankimore Nr.6) është marrë në shqyrtim administrativ nga KQZ, në Mbledhjen e datës 14.05.2015, ku fillimisht, mbi kërkesat e paraqitura, është vendosur të lejohej pjesëmarrja si palë të interesuara, përveç subjektit zgjedhor ankues, edhe të subjekteve zgjedhore PSD, Partia Demokratike e Shqipërisë dhe LSI. Në vijim të shqyrtimit administrativ, pas debatit rreth kërkesës ankimore dhe provave që subjekti zgjedhor ankues

ka kërkuar të merren, rezulton që KQZ-ja (me shumicë votash) ka vendosur të lejojë marrjen e provave në funksion të vërtetimit ose jo të fakteve të pretenduara nga pala ankuese, duke marrë në shqyrtim provat e paraqitura prej tij dhe, më tej, ka vendosur verifikimin nëpërmjet një ekspertimi grafik të të gjithë nënshkrimeve të zgjedhësve mbështetëse të kandidatit për kryetar të Bashkisë Prrenjas Z. Artur Topi, ndërsa ka vendosur ndërprerjen e shqyrtimit administrativ të kërkesës ankimore deri në momentin e paraqitjes së aktit të ekspertimit grafik përkatës.

Duke mos qenë dakord me mënyrën e shqyrtimit administrativ nga KQZ-ja të kërkesës ankimore si më lart, duke konsideruar se vendimet e ndërmjetme të saj në Mbledhjen e datës 14.05.2015 binin në kundërshtim me ligjin, për objektin e shqyrtimit administrativ nga KQZ dhe mënyrën e kufijtë e shqyrtimit administrativ prej saj, të kërkesës ankimore në lidhje me ligjshmërinë e vendimit të KZAZ Nr. 53, Qarku Elbasan, në datë 19.05.2015, subjekti zgjedhor PSD ka paraqitur përpara Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë një kërkesëpadi, me të cilën, duke paditur KQZ-në, kërkon shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm të KQZ-së të marrë në Mbledhjen e datës 14.05.2015, gjatë shqyrtimit të Kërkesës Ankimore Nr.06.

Po kështu, duke mos qenë dakord me mosmarrjen e një vendimi përfundimtar nga KQZ-ja, në lidhje me Kërkesën Ankimore Nr.06, mbi pretendimin se KQZ-ja kishte shkelur afatin ligjor 2-ditor për marrjen e një vendimi nga momenti i paraqitjes së ankimit, subjekti zgjedhor PSD me kërkesëpadinë e paraqitur ka kërkuar edhe urdhërimin e KQZ-së për të marrë vendim brenda 24 orëve për Kërkesën Ankimore Nr.06.

Kërkesëpadia si më lart e subjektit zgjedhor PSD u morr në shqyrtim nga Kolegji Zgjedhor në datë 22.05.2015, ku përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, mbi kërkesat e paraqitura, lejoi pjesëmarrjen në gjykim në cilësinë e palës së interesuar të subjekteve zgjedhore PS dhe LSI, që rezultonin të ishin pjesëmarrëse me të njëjtën cilësi procedurale edhe në shqyrtimin administrativ përpara KQZ-së, shqyrtim administrativ ky objekt kontesti (për vendimmarrjet e ndërmjetme dhe mosmarrjen e një vendimi përfundimtar) në kërkesëpadinë e paraqitur për shqyrtim.

Në lidhje me kërkesëpadinë e paraqitur, pala e paditur KQZ, duke e konsideruar atë si të pabazuar në ligj, prapësoi se KQZ-ja në përputhje me kompetencat e njohura nga ligji ishte në shqyrtim e sipër administrativ të kërkesës ankimore të paraqitur nga një prej subjekteve zgjedhore kundër vendimit si më lart të KZAZ Nr.53, Qarku Elbasan, shqyrtim administrativ gjatë të cilit kishte vendosur dhe marrjen e provave në funksion të kontrollit administrativ të ligjshmërisë së vendimit të ankimuar, ndërsa ditën e sotme (pra, në datë 22.05.2015), mbas depozitimit të aktit të ekspertimit përkatës, kishte rifilluar shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore për të dalë me një vendim përfundimtar. Sipas palës së paditur, për sa kohë ajo nuk kishte marrë një vendim përfundimtar për rastin, vendimet e ndërmjetme të KQZ-së të marra gjatë shqyrtimit të saj administrativ të kërkesës ankimore të paraqitur, nuk mund të ankimoheshin përpara Kolegjit Zgjedhor, duke qenë kështu përpara rastit kur Kolegji Zgjedhor duhet të pushojë gjykimin e çështjes.

Pala e interesuar PS, pretendoi se KQZ-ja është në shqyrtim e sipër administrativ të kërkesës ankimore të paraqitur prej saj kundër vendimit si më lart të KZAZ Nr. 53, Qarku Elbasan, duke qenë në të drejtën e KQZ-së, mbi kërkesa të palëve, por edhe kryesisht, marrja e provave që çmon në dobi të shqyrtimit. Me tej, sipas kësaj pale te interesuar, shqyrtimi administrativ nga KQZ-ja nuk ka përfunduar ende, pasi shqyrtimi ndodhet ne fazen e marrjes se provave dhe jo sic pala paditese pretendon, sikur shqyrtimi i ankimit ka përfunduar dhe ai ndodhet ne fazen e vendimit. Sipas pales se interesuar rasti objekt padie eshte ende ne juridiksionin administrativ, duke qene KQZ-ja i vetmi organ kompetent per te marre nje vendim përfundimtar ne lidhje me ankimin e paraqitur, nderkohe qe, vetem pas dhënies se vendimit përfundimtar nga KQZ-ja, cdo subjekt zgjedhor qe pretendon per cenim te te drejtave te tij, legjitimohet per te paraqitur ankim ne Kolegjin Zgjedhor.

Pala e interesuar LSI, pretendoi se pala paditese PSD nuk legjitimohet per te kundërshtuar përpara Kolegjit Zgjedhor vendime te ndërmjetme te KQZ-se sikundër kishte kundërshtuar ne rastin konkret, përkundrazi, keto kundërshtime ajo mund t'i paraqiste ne rastin e ankimit ndaj nje vendimi përfundimtar te KQZ-se. Edhe duke bere analogji me rregullimet e bera ne Kodin e Procedures Civile, vendimet e ndërmjetme te gjykates se shkalles se pare

mund të ankimoheshin vetëm kur ligji parashikonte shprehimisht të drejtën e ankimit, në të kundërt ato ankimoheshin bashkë me vendimin përfundimtar. Nderkohe Kodi Zgjedhor nuk parashikon që ndaj vendime të ndërmjetme të KQZ-se të marra gjatë shqyrtimit administrativ nga ajo të një kërkesë ankimore mund të bëhet ankim përpara Kolegjit Zgjedhor. Për rrjedhojë, sipas kësaj pale të interesuar, Kolegji Zgjedhor është para rastit kur duhet të vendosë pushimin e gjykimit të ceshtjes së ngritur mbi ankimin/padine e subjektit zgjedhor PSD. Po kështu, kjo pale e interesuar pretendoi se shqyrtimi administrativ nga KQZ-ja në rastin konkret po kryhej në përputhje me ligjin, në respektim të nenëve 136 e vijues të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, ndërkohe që nepermjet padisë së paraqitur synohej të pengohej dalja e të vertetesë përsa kishte ndodhur në lidhje me procedurën e ndjekur për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhesve mbështetës dhe rregullsine të dokumenteve të kandidimit të paraqitur në rastin konkret nga pala paditese.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, Kolegji Zgjedhor administroi rregullisht aktet që lidheshin me shqyrtimin administrativ të ndjekur nga KQZ-ja në rastin konkret.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Kolegji Zgjedhor vlerëson se për kërkimin e pare të padisë duhet që gjykimi i ceshtjes të pushohet, ndërsa kërkimi i dytë i padisë të pranohet.

I. Kundërshtimi i vendimit të ndërmjetëm të KQZ-së për marrjen e provave gjatë shqyrtimit administrativ

Procesi zgjedhor në Republikën e Shqipërisë normohet nga Kodi Zgjedhor, i cili përcakton rregullat për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet. Objekt i këtij ligji janë edhe afatet, procedura dhe kompetenca për regjistrimin e subjekteve zgjedhore (neni 1.2, shkronja "b" i Kodit Zgjedhor të ndryshuar). Ashtu si fazat e tjera të procesit, edhe regjistrimi i subjekteve zgjedhore është në kompetencën e administratës zgjedhore, në krye të së cilës qëndron KQZ-ja, si organi më i lartë shtetëror i përhershëm. Kompetencat dhe ushtrimi i tyre nga KQZ dhe organet e tjera të administrimit zgjedhor (KZAZ, KQV), duhet të kryhen në përputhje me rregullat

e posaçme të Kodit Zgjedhor, si dhe me parimet dhe normat e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Referuar rastit në shqyrtim rezulton se pala paditëse PSD kërkon kontrollin gjyqësor të një vendimi të ndërmjetëm të pales se paditur KQZ të marrë gjatë shqyrtimit administrativ të një ankimi të paraqitur nga një subjekt zgjedhor (pala e interesuar PS) kundër vendimit si më lart të KZAZ Nr.53, Qarku Elbasan.

Kolegji Zgjedhor duke marrë në shqyrtim këtë kërkim padie, si dhe prapësimet e palëve të tjera pjesëmarrëse, lidhur me juridiksionin e çështjes, vlerëson se vendimi i ndërmjetëm i KQZ-së, i marrë gjatë shqyrtimit administrativ të ankimit të paraqitur përpara saj, për lejimin e marrjes së provave të caktuara (përfshirë dhe kryerjen e një ekspertimi grafik nënshkrimi) në funksion të verifikimit të fakteve të pretenduara nga subjekti ankues, mund të ankimohet gjyqësisht përpara Kolegjit Zgjedhor vetëm bashkë me vendimin që KQZ do të marrë në përfundim të shqyrtimit të saj administrativ, pra bashkë me vendimin përfundimtar të KQZ-së.

Një ndër parimet bazë të shtetit të së drejtës është ai i ndarjes së pushteteve, në funksion të të cilit, pranohet kontrolli gjyqësor mbi veprimtarinë ekzekutive, vetëm kur organet e ngarkuara me ligj e kanë ushtruar kompetencën e tyre administrative. Në këtë kuptim edhe procesi zgjedhor si proces administrativ, drejtohet nga KQZ dhe komisionet e tjera zgjedhore, veprimtari e cila kontrollohet nga gjykata (Kolegji Zgjedhor). Referuar tërësisë së rregullave zgjedhore dhe posaçërisht kompetencave të Kolegjit Zgjedhor (nenet 145 e vijues të Kodit Zgjedhor), rezulton se ky i fundit ka rolin kontrollues mbi ligjshmërinë e vendimeve të marra nga KQZ për çështjet zgjedhore, ashtu si edhe pushtetin për të urdhëruar këtë organ të ushtrojë kompetencat, në rastet kur brenda afateve që ligji përcakton, KQZ nuk ka vepruar, pra nuk ka marrë vendimin mbi një çështje të caktuar.

Nisur nga kompetencat që Kodi Zgjedhor i ka dhënë Kolegjit, një mosmarrëveshje zgjedhore hyn në juridiksionin gjyqësor vetëm në rastin kur KQZ i jep zgjidhje përfundimtare çështjes, nëpërmjet marrjes së një vendimi që pretendohet se cenon të drejtat e subjektit zgjedhor ankues. Duke rikthësuar se një çështje nuk mund të jetë

njëkohësisht si në juridiksionin administrativ, ashtu si edhe në atë gjyqësor, Kolegji Zgjedhor, vlerëson se nuk ka kompetencën të shqyrtojë ligjshmërinë e një vendimi të ndërmjetëm të marrë nga KQZ gjatë procesit administrativ, që në rastin konkret është shqyrtimi i një ankimi administrativ ndaj një vendimi të KZAZ-së. KQZ ka përgjegjesinë ligjore të ushtrojë kompetencat e saj në përputhje me ligjin, me qëllim garantimin e zhvillimit të një procesi zgjedhor të drejtë. Në rastin në shqyrtim, KQZ ka për shqyrtim një ankim të subjektit zgjedhor PS, ç'ka është një çështje në kompetencën e saj, për të cilën ajo ka detyrimin të japë edhe një vendim mbi sa është kërkuar prej subjektit ankues. Nëse procesi administrativ i ndjekur nga KQZ-ja nuk është i rregullt, si dhe nëse shkeljet e pretenduara gjatë këtij procesi pasjellin marrjen e një vendimi të paligjshëm që cenon të drejtat e subjekteve zgjedhore, kjo mund të përbejë shkak për paraqitjen e një ankimi gjyqësor, por se ligjshmëria e procesit (shqyrtimit administrativ) të deritanishem të KQZ-se nuk mund të përbejë objekt të mevetesishem ankimi gjyqësor dhe as t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor përpara se KQZ-ja të marrë një vendim përfundimtar për rastin, me daljen e të cilit përfundon juridiksioni administrativ dhe çështja, mosmarrëveshja zgjedhore, behet pjesë e juridiksionit gjyqësor. Për rrjedhojë, ankimi i paraqitur në rastin konkret, kërkimi i pare, lidhet me veprimtarinë e KQZ-se në kuadër të një çështjeje që është ende në juridiksionin administrativ. Referuar rregullave të procesit, sipas nenit 134 të Kodit Zgjedhor, deklaratimet e palëve, provat që merren dhe urdhrat e vendimet e ndërmjetme të KQZ-së, pasqyrohen në procesverbalin e seancës plenare, nga përmbajtja e të cilit ato mund të behen objekt shqyrtimi nga Kolegji Zgjedhor në rastin e një ankimi të mundshëm gjyqësor për vendimin përfundimtar, përfshirë dhe pretendimet eventuale për paligjshmërinë apo parregullsine të procesit, shqyrtimit administrativ, të ndjekur nga KQZ-ja. Prosesi i të provuarit të fakteve dhe pretendimeve gjatë shqyrtimit të një ankimi zgjedhor, si dhe vendimet e ndërmjetme të KQZ-së për lejimin apo refuzimin e marrjes së një prove, i përkasin juridiksionit administrativ. Kundërshtimet që palët pjesëmarrëse në procesin administrativ kanë lidhur me marrjen e provave, parashtrohen po para KQZ-së në formën e prapësimeve, sipas përcaktimit të nenit 140 të Kodit Zgjedhor dhe vetëm pasi çështja zgjidhet përfundimisht nga pushteti administrativ, subjektet që cenohen mund të bëjnë ankim gjyqësor. Në këto kushte Kolegji Zgjedhor vlerëson se gjykimi i kërkimit për shfuqizimin e vendimit

të ndërmjetëm të KQZ-së, që ka lejuar marrjen e provave gjate atij shqyrtimi administrativ te saj, duhet të pushohet për shkak të mungesës së juridikisonit gjyqësor mbi këtë mosmarrëveshje zgjedhore.

II. Kërkimi për detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për marrjen e një vendimi përfundimtar brenda 24 orëve.

Ashtu si edhe u parashtua më sipër, procesi zgjedhor për vetë rëndësinë që mbart zhvillohet mbi rregulla që garantojnë për subjektet zgjedhore pjesëmarrjen e lirë dhe të barabartë, duke përfshirë edhe regjistrimin e tyre. Pikërisht në kuadër të regjistrimit të subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të qershorit 2015, subjekti zgjedhor PSD ka kërkuar nga Kolegji Zgjedhor të detyrojë KQZ-në të marrë një vendim përfundimtar lidhur me shqyrtimin e ankimit të PS-së, ndaj vendimit të KZAZ Nr.53, Qarku Elbasan. Sipas palës paditëse, regjistrimi i subjekteve zgjedhore duhej të kish përfunduar tashmë si proces dhe në kushtet kur ka filluar edhe fushata zgjedhore, ky subjekt është vënë në pozita të disfavorshme në raport me subjektet e tjera zgjedhore tashmë të regjistruara.

Lidhur me këtë çështje, Kolegji Zgjedhor vë në dukje se rregullat e Kodit Zgjedhor në fazën parazgjedhore, garantojnë objektivisht procesin e regjistrimit të subjekteve zgjedhore para fillimit të fushatës, duke u dhënë mundësinë për të parashtuar para zgjedhësve programet e tyre përgjatë fushatës zgjedhore e cila fillon 30 ditë para datës së zhvillimit të zgjedhjeve (neni 77 i Kodit Zgjedhor).

Rasti në shqyrtim i përket marrjes së një vendimi për regjistrimin e një subjekti zgjedhor për zgjedhjet vendore, që sipas nenit 33, shkronja "f" të Kodit Zgjedhor është në kompetencën fillestare të KZAZ-së. Referuar nenit 35 të këtij Kodi, rezulton se ligji ka parashikuar edhe zgjidhjen e situatave, në të cilat rezulton për shkaqe të ndryshme, pamundësia e KZAZ-së për marrjen e një vendimi në kompetencë të tij, duke urdhëruar për këtë KQZ-në, si organi më i lartë administrativ, për të marrë vetë vendimin, brenda 24 orëve. Ky rregullim i vendosur në pjesën e përgjithshme të përcaktimit të kompetencave të organeve të administrimit zgjedhor, reflekton qëllimin e ligjvënësit për të mos bllokuar procesin. Në vijim,

Kodi Zgjedhor rregullon procesin në të gjitha etapat e tij, përfshirë edhe atë të regjistrimit të subjekteve zgjedhore (Pjesa IV). Lidhur me këtë, në funksion edhe të kërkimit të palës paditëse, rezulton që Kodi Zgjedhor synon përfundimin e regjistrimit të subjekteve zgjedhore, në afate të përcaktuara, si vijon :

- deri në 70 ditë para datës së zhvillimit të zgjedhjeve, duhet të paraqiten kërkesat e partive politike për tu regjistruar si subjekte zgjedhore (neni 64.1), si dhe komitetet nismëtare për paraqitjen e një kandidati të propozuar nga zgjedhësit (neni 69);

- jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, duhet të regjistrohen koalicionet e partive politike (neni 65.1);

- jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve, subjektet zgjedhore duhet të regjistrojnë listën e kanddatëve të tyre (neni 67) apo komitetet nismëtarë duhet të regjistrojnë kandidatin e propozuar nga zgjedhësit (neni 70), dhe në rastin e zgjedhjeve vendore, KZAZ-ja, brenda 48 orëve duhet ta dërgojë listën e kandidatëve në KQZ;

- jo më vonë se 45 ditë para zgjedhjeve, duhet të jenë verifikuar dokumentet e kandidimit dhe në rast parregullsish, t'i kthehen subjektit zgjedhor për korrigjim dhe më tej, brenda 42 ditëve nga data e zgjedhjeve, subjekti zgjedhor duhet të depozitojë dokumentacionin e korrigjuar, ndërkohë që brenda 48 orëve (pra 40 ditë para datës së zgjedhjeve), duhet të merret vendimi përfundimtar për regjistrimin ose jo të kandidatëve (neni 73).

Nisur nga sa më sipër, si dhe duke marrë në konsideratë edhe afatet për ankimin administrativ (3 ditë) dhe atë gjyqësor (5 ditë), procesi i regjistrimit të subjekteve zgjedhore duhet të përfundojë në një moment të përshtatshëm, me qëllim garantimin e publikimit të kandidaturave, njohjen e tyre nga zgjedhësit dhe realizimin e fushatës zgjedhore mes kandidatëve.

Duke i'u kthyer rastit në shqyrtim, KQZ-ja ka regjistruar një ankim zgjedhor të subjektit zgjedhor PS, kundër një vendimi të KZAZ Nr.53, Qarku Elbasan, shqyrtimi i të cilit kryhet sipas rregullave të caktuara në nenet 124 e vijues të Kodit Zgjedhor. Dispozitat e kësaj pjese rregullojnë procesin e shqyrtimit të të gjitha ankimeve për një proces zgjedhor, ç'ka rezulton nga tërësia e dispozitave dhe

posaçërisht nga neni 127.5, i cili parashikon hapjen nga KQZ-ja të regjistrit të ankimeve zgjedhore brenda 24 orëve nga përfundimi i procesit zgjedhor pararendës. Sipas rregullave në vijim mbi procedurën që ndjek KQZ-ja, kjo e fundit brenda 24 orëve shqyrton paraprakisht elementët e formës dhe ato të përcaktuar në nenin 130 (kompetenca, legjitimiteti dhe afati), me qëllim për të vlerësuar pranimin për shqyrtim të ankimit. Sipas nenit 131 ankimi shqyrtohet jo më vonë se 48 orë nga momenti i vendimit për pranimin për shqyrtim të tij, kurse sipas nenit 143, KQZ-ja merr vendim jo më vonë se dy ditë nga paraqitja e ankimit. Në rastin në shqyrtim, ankimi i subjektit zgjedhor është paraqitur në datë 08.05.2015 dhe rezulton se KQZ ka filluar shqyrtimin e tij në seancën e datës 14.05.2015. Në këto rrethana, Kolegji Zgjedhor vlerëson të drejtë kërkimin e palës paditëse Partia Socialdemokrate për të detyruar KQZ-në të marrë një vendim përfundimtar, kërkim i paraqitur sipas nenit 145, pika 2 të Kodit Zgjedhor, që u jep të drejtën subjekteve zgjedhore të paraqesin ankim edhe në rastin kur KQZ nuk ushtron kompetencat e saj në afatet e përcaktuara në Kod.

Sipas nenit 125 të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohet mënyra e llogaritjes së afateve, dita e shtunë dhe e dielë janë pushim, ndaj Kolegji Zgjedhor vlerëson se detyrimi i KQZ-së për marrjen e një vendimi lidhur me ankimin që po shqyrtohet prej saj, duhet të përmbushet brenda datës 25.05.2015 (ditë e hënë), në rrethanat kur dy ditët në vijim janë e shtunë dhe e dielë.

Sa me sipër, Kolegji Zgjedhor çmon se gjykimi i ceshtjes në lidhje me kërkimin e pare të padise së paraqitur nga Partia Socialdemokrate duhet të pushohet, ndërsa kërkimi i dytë i padise duhet të pranohet, si me lart u parashtua.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykates së Apelit Tirane,
bazuar në nenin 158, pika 2 dhe 3, të Kodit Zgjedhor të ndryshuar,

V E N D O S I

1. Pushimin e gjykimit në Kolegjin Zgjedhor lidhur me kërkimin mbi shfuqizimin e vendimit të ndermjetem të KQZ-së marre me datë 14.05.2015 gjate shqyrtimit të Kerkeses Ankimore Nr.06.

2. Pranimin e kërkimit të dyte të padise, duke urdhëruar KQZ-ne të marrë vendim jo me vone se data 25.05.2015 në lidhje me ankimin e paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë kundër Vendimit Nr.49, datë 05.05.2015, të KZAZ Nr.53, Zona Zgjedhore Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan.

Tiranë, më 22.05.2015

ANËTAR **ANËTAR** **KRYESUES**
FUAT VJERDHA **PETRIT ÇENO** **GJINOVEFA GABA**

ANËTAR **ANËTAR**
KLITON SPAHIU **ILIR TOSKA**

* * *



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR

NR. 13 REGJ. THEMELTAR
Date 22.05.2015

Nr. 13 Vendimit
Date 28.05.2015

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga:

KRYESUES : **ILIR TOSKA**
ANETAR : **PETRIT ÇENO**
ANETAR : **GJINOVEFA GABA**

ANETAR : VALBON ÇEKREZI
ANETAR : KLITON SPAHIU

asistuar prej sekretares Rexhina Baci, në Tiranë, sot me datë 28.05.2015, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore, që u përket paleve:

PADITËSE : **PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE,**
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Z.Aurel
Bylykbashi dhe Z.Ivi Kaso.

I PADITUR : **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga
Znj.Deshira Pasko dhe Z.Olsi Peto.

PALE E INTERESUAR : **PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE,**
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Z.Koli Bele
dhe Z.Gledian Llatja.

OBJEKTI : - Kundershtimin e Vendimit Nr.493, date 20.05.2015,
te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve.
- Gjykimin e ceshtjes ne themel, duke vendosur lenien
ne fuqi te Vendimit Nr.55, date 13.05.2015, te
Komisionit Zonal te Administrimit Zgjedhor Nr.15,
Qarku Lezhe.

BAZA LIGJORE : Nenet 72, 73, 145 e vijues, te Kodit Zgjedhor te
Republikes se Shqiperise.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS APELIT TIRANË

Pasi degjoi perfaqesuesit e pales paditese Patia Demokratike e Shqiperise, qe kerkuan pranimin e padise sipas objektit; degjoi perfaqesuesit e pales se paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, qe kerkuan rrezimin e padise; degjoi perfaqesuesit e pales se interesuar Partia Socialiste, qe kerkuan rrezimin e padise; si dhe pasi shqyrtoi ceshtjen ne teresi,

VEREN

Me Dekretin Nr.8844, datë 15.12.2014, ne mbështetje të neneve 92/gj dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 9§1§2 dhe 10§1§2 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (me poshte referuar si Kodi Zgjedhor i ndryshuar), Presidenti i Republikës së Shqipërisë ka caktuar datën 21 qershor 2015 për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Pranohet se pala paditese Partia Demokratike e Shqipërisë (me poshte referuar si PD), ne përputhje me nenin 64 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, eshte regjistruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (me poshte KQZ) si subjekt zgjedhor ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015. Po keshtu pranohet se pala paditese PD, bashke me disa parti politike te regjistruara rregullisht si subjekte zgjedhore, bazuar ne nenin 65 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, jane regjistruar nga KQZ-ja si koalicion zgjedhor ne shkalle vendi, nen emrin Aleanca Popullore per Pune dhe Dinjitet (me poshte referuar si APPD), per zgjedhjet e organeve te qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015.

Me tej, pranohet se Koalicioni Zgjedhor APPD, ne respektim te drejtes se percaktuar ne nenin 165/3 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar dhe ne përputhje me kërkesat e nenit 67 te këtij Kodi, brenda afatit te percaktuar nga kjo dispozite (qe ne rastin e zgjedhjeve per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015 eshte llogaritur deri me date 4 maj 2015), ka paraqitur përpara Komisionit te Zones se Administrimit Zgjedhor Nr.15, Qarku Lezhe (me poshte referuar si KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe) nje kerkese per regjistrimin e Z.Altin Biba si kandidat per kryetar te Bashkise Kurbin per zgjedhjet e organeve te qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015, duke i bashkëlidhur asaj dhe dokumentet e kandidimit sipas nenit 72 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar.

Rezulton se, KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe, bazuar ne nenet 33/f dhe 73 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, me Vendimin Nr.50, date 06.05.2015, ndersa ka gjetur te rregullt dhe ne përmbushje te kërkesave te ligjit dokumentet e kandidimit, ka vendosur "Ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015 te regjistroje si

kandidat per kryetar te Bashkise Kurbin, Z.Altin Gjon Biba, paraqitur nga Koalicioni Aleanca Popullore per Pune dhe Dinjitet”.

Nderkohe, pranohet se ditën e trete mbas shpalljes se këtij vendimi, pra me date 09.05.2015, prane KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe, kandidati i regjistruar si me lart, Z.Altin Biba, ka paraqitur nje kerkese per heqjen dore nga kandidimi.

Pranohet se, me date 10.05.2015, kërkesen per heqje dore nga kandidimi i kandidatit te regjistruar Z.Altin Biba, KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe ia ka përcjell KQZ-se, por edhe subjektit zgjedhor Koalicionit APPD (partise politike kryesuese te koalicionit PD).

Ne vijim, ndersa ka ardhur ne dijeni per heqjen dore nga kandidimi te Z.Altin Biba dhe ndersa nuk ka patur ndonje ndërmarrje/veprim nga organet e administrates zgjedhore, rezulton se, me date 13.05.2015, subjekti zgjedhor Koalicioni APPD ka paraqitur përpara KZAZ Nr.13, Qarku Lezhe nje kerkese per regjistrimin e Z.Illir Pjeter Pjetraj si kandidat per kryetar te Bashkise Kurbin per zgjedhjet e organeve te qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015, duke i bashkëlidhur asaj dhe dokumentet e kandidimit sipas nenit 72 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar.

Rezulton se, po me date 13.05.2015, KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe te kete shqyrtuar fillimisht kerkesen e Z.Altin Biba per heqjen dore nga kandidimi, ku ne përfundim, me Vendimin Nr.54, te kete vendosur “1. Shfuqizimin e vendimit nr.50, date 06.05.2015. 2. Ç’regjistrimin e kandidatit per Kryetar te Bashkise Kurbin te Partise Demokratike Z.Altin Gjon Biba”.

Me tej, po me date 13.05.2015, rezulton se KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe, te kete shqyrtuar dhe kerkesen per regjistrim kandidati te Koalicionit APPD, ku ne përfundim, me Vendimin Nr.55, ka vendosur “Ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015 te regjistroje si kandidat per kryetar te Bashkise Kurbin, Z.Illir Pjeter Pjetraj, paraqitur nga Koalicioni Aleanca Popullore per Pune dhe Dinjitet”.

Duke mos qene dakort me vendimin e fundit te KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe (Vendimin Nr.55, date 13.05.2015), brenda afatit ligjor

3-ditor (me date 16.05.2015), subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqiperise (me poshte referuar si PS), ka paraqitur përpara KQZ-se nje ankim zgjedhor (identifikuar si Kerkesa Ankimore Nr.21), me te cilin ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe shfuqizimin e tij, me pretendimin se ky vendim eshte absolutisht i pavlefshem per shkak se eshte marre jashte cdo procedure dhe afati ligjor te percaktuar ne nenin 73/4 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar per depozitimin e dokumenteve te kandidimit dhe per regjistrimin e kandidateve per kryetar te njesise se qeverisjes vendore.

Sipas subjektit zgjedhor ankues, Kodi Zgjedhor i ndryshuar nuk parashikon tërheqjen nga kandidimi te kandidatit te regjistruar rregullisht dhe as zevendesimin e tij nga subjekti zgjedhor qe e kishte propozuar, përkundrazi, neni 73/4 i Kodit Zgjedhor, pengonte nje gje te tille, c'ka do te thoshte se KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe, pas kalimit te afatit te dorëzimit te dokumenteve te kandidimit, ne menyre kategorike nuk mund te merrte asnjë vendim per ndryshim apo zevendesim te emrit te kandidatit te regjistruar rregullisht brenda afatit ligjor.

Sipas ankuesit, vendimmarrja e paligjshme e KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe, ka sjell si pasoje c' regjistrimin e kandidatit te regjistruar ne respektim te Kodit Zgjedhor dhe regjistrimin e nje kandidati tjeter, jashte cdo afati ligjor prekluziv dhe rregullave te përcaktuara nga Kodi Zgjedhor, duke ndikuar kjo vendimmarrje negativisht në proceset zgjedhore të mëvonshme ne kuadër te përgatitjes se zgjedhjeve per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015.

Ankesa e paraqitur nga subjekti zgjedhor PS eshte shqyrtuar nga KQZ-ja ne Mbledhjen e dates 20.05.2015.

Edhe gjate shqyrtimit administrativ përpara KQZ-se, subjekti zgjedhor ankues PS ka riparashtruar te njëjtat pretendime si dhe ne ankim ne lidhje me paligjshmerine e veprimtarise se KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe, pas regjistrimit fillimisht (me date 06.05.2015) nga ajo te kandidatit te propozuar nga subjekti zgjedhor APPD, duke kërkuar shfuqizimin e Vendimit Nr.55, date 13.05.2015.

Nga ana tjeter, KQZ-ja ka lejuar pjesëmarrjen ne shqyrtimin administrativ si pale e interesuar te subjektit zgjedhor PD, pjese e

koalicionit zgjedhor APPD, subjekt zgjedhor ky qe ka parashtruar kundërshtimet e tij perkunder ankimit te paraqitur ndaj vendimit si me lart te KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe, ndersa ka kërkuar mospranimin e ankimit dhe lenien ne fuqi te vendimit te ankimuar.

Sipas pales se interesuar PD ne shqyrtimin administrativ, veprimtaria e KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe, per c'regjistrimin si kandidat te Z.Altin Biba dhe regjistrimin si kandidat per kryetar te Bashkise Kurbin te Z.Illir Pjetraj te propozuar nga subjekti zgjedhor APPD, eshte ne përputhje me ligjin dhe e realizuar brenda afatit qe ligji përcaktonte per realizimin e këtij procesi (procesin e regjistrimit te kandidateve, referuar nenit 73/1/2 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, sipas te cilit veprimtaria e komisioneve te zonave te administrimit zgjedhor apo KQZ-se per regjistrimin e kandidateve duhet te permbyllej 40 dite përpara dates se zgjedhjeve, afat ligjor ky qe ne rastin e zgjedhjeve per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015 perfundonte me date 13.05.2015, pra pikerisht dhe ditën kur KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe ka disponuar per regjistrimin e Z.Illir Pjetraj si kandidat per kryetar te Bashkise Kurbin i propozuar nga subjekti zgjedhor APPD.

Sipas pales se interesuar PD, c'regjistrimi nga KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe si kandidat te Z.Altin Biba ka ardhur per shkak te heqjes dore nga ai prej kandidimit, nderkohe qe Kodi Zgjedhor i ndryshuar nuk pengonte nje gje te tille.

Po keshtu, sipas pales se interesuar, zevendesimi i kandidatit pas regjistrimit dhe heqjes dore prej tij nga kandidimi, ka qene nje veprim i detyruar per subjektin zgjedhor APPD ne funksion te realizimit nga ai te te drejtes per te marre pjese ne zgjedhje, nderkohe qe Kodi Zgjedhor i ndryshuar nuk pengonte nje gje te tille.

Neni 73/4 i Kodit Zgjedhor te ndryshuar, sipas pales se interesuar, përcaktonte rregullime per "listat shumememore", pra per listat e kandidateve per këshillat ne njesite perkatese te qeverisjes vendore, rregullime keto qe nuk jane te vlefshme dhe as te zbatueshme ne rastin e kandidateve per kryetar te njesive te qeverisjes vendore.

Ne vijim, sipas pales se interesuar, nepermjet vendimmarrjeve te saj, KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe ka garantuar te drejten e saj per te

marre pjese ne zgjedhje, sikundër dhe te drejten e zgjedhesve per te zgjedhur, pervec se dhe te drejten per t'u zgjedhur, nderkohe qe kjo vendimmarrje nuk cenonte vijueshmerine rregullisht te procesit zgjedhor per kete njesi te qeverisjes vendore, kur afati kohor i mbetur ne raport me veprimet e nevojshme pergatitore qe duhet te kryheshin eshte i mjaftueshem dhe mundëson kryerjen e tyre.

Nga ana tjetër, sipas pales se interesuar, pranimi i ankeses dhe shfuqizimi i Vendimit Nr.55, date 13.05.2015, te KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe, do te conte para nje procesi zgjedhor ku do te mungonte gara zgjedhore/konkurrimi i lire dhe zgjedhesve do t'iu mungonin alternativat per te zgjedhur, duke mos patur keshtu ne kete rast nje proces te rregullt zgjedhor per shkak te cenimit te nje sere te drejtash kushtetuese dhe ligjore te subjektit politik dhe zgjedhesve.

Ne përfundim te shqyrtimit administrativ, KQZ-ja, me Vendimin Nr.493, date 20.05.2015, bazuar ne nenet 68/2, 73, 124 dhe 143/1/c te Kodi Zgjedhor te ndryshuar, ka vendosur :

“Konstatimin e pavlefshërisë absolute të Vendimit nr.55, datë 13.05.2015 të KZAZ nr.15, “Për regjistrimin e z. Ilir Pjetraj, si kandidat për kryetar bashkia Kurbin, propozuar nga koalicioni APPD dhe pranimin e kërkesës ankimore nr.21, të Partisë Socialiste”.

Ne vendimin e saj KQZ-ja ka arsyetuar se:

neni 67/1 i Kodit Zgjedhor parashikon se “Partia politike, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve. / Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pike. ...”, ku nga llogaritja e afatit të përcaktuar në kete dispozite rezulton qe dita e fundit e afatit te jete data 2 maj 2015, por se, në zbatim të nenit 125 të Kodit Zgjedhor, duke qene se data 2 maj ishte ditë e shtunë, afati i fundit për regjistrimin e kandidatëve ishte data 4 maj 2015;

ne nenin 73 të Kodit Zgjedhor përcaktohen procedurat dhe afatet respektive të procesit të verifikimit të dokumentacionit zgjedhor, ku sipas kësaj dispozite, komisioni përkatës (KQZ apo sipas rastit KZAZ), nga verifikimi i dokumentacionit të kandidimit, nëse vëren parregullsi ia kthen ato subjektit zgjedhor për korrigjim jo më vonë se 45 ditë para datës së zgjedhjeve (qe e llogaritur në datë kalendarike ne rastin e ketyre zgjedhjeve ky afat është jo më vonë se data 7 maj 2015), nderkohe qe në vazhdim të procedurave të parashikuara nga kjo dispozite (pika 2), subjektet zgjedhore duhet të ridepozitojnë dokumentacionin e korrigjuar jo më vonë se 42 ditë para datës së zgjedhjeve (qe e llogaritur në datë kalendarike ne rastin e ketyre zgjedhjeve ky afat është jo më vonë se data 10 maj 2015, qe në zbatim të nenit 125 të Kodit zgjedhor, duke qene se data 10 maj 2015 ishte ditë e diel, afati i fundit për kthimin për plotësim të dokumentacionit të kandidimit ka qene data 11 maj 2015) dhe, ne vijim, po sipas kësaj dispozite (pika 2), komisioni përkatës ka detyrimin të marrë vendimin përfundimtar për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit të kandidimit brenda 48 orëve (qe e llogaritur në ditë kalendarike ne rastin e ketyre zgjedhjeve afati i fundit për miratimin ose refuzimin përfundimtar të dokumentacionit të kandidimit ka qene data 13 maj 2015);

ne rastin konkret, KZAZ Nr.15, me Vendimin Nr.50, datë 06.05.2015, ka regjistruar kandidatin për kryetar Bashkia Kurbin Z.Altin Biba, të propozuar nga Koalicioni APPD, në përputhje me afatet e përcaktuara në nenet 67 dhe 73 të Kodit Zgjedhor, nderkohe qe me datë 09.05.2015, pranë KZAZ Nr.15 është depozituar dorëheqja e Z.Altin Biba nga kandidimi, ndersa, më datë 13 maj 2015, krejtesisht jashtë afatit të përcaktuar në nenin 67 të Kodit Zgjedhor (data 4 maj 2015), prane KZAZ Nr.15 eshte depozituar një kërkesë për regjistrimin e kandidatit për kryetar Bashkia Kurbin, Z.Illir Pjetraj, i propozuar nga Koalicioni APPD;

KZAZ Nr.15, me Vendimin Nr.54, datë 13.05.2015, ka vendosur shfuqizimin e Vendimit Nr.50, datë 06.05.2015, ndersa me Vendimin Nr.55, datë 13.05.2015, ka vendosur regjistrimin e kandidatit Ilir Pjetraj;

Vendimi Nr.55, datë 13.05.2015, i KZAZ Nr.15, është një vendim në kundërshtim me afatet dhe procedurën e kërkuar nga nenet 67 dhe 73 të Kodit Zgjedhor dhe në këto kushte, referuar nenit 116/c të Kodit të Procedurave Administrative, ky vendim është absolutisht i pavlefshëm, pasi është haptazi në kundërshtim me parashikimet perkatëse ligjore që rregullojnë këto marrëdhënie, duke patur parasysh se vendimi në fjalë i KZAZ Nr.15 është marrë si një regjistrim krejtësisht nga e para dhe pa asnjë lidhje me rregullimet e parashikuara nga neni 73/1/2 i Kodit Zgjedhor, të cilat sidoqoftë, nuk mund të shërbejnë si baze ligjore për këto veprime e vendime të KZAZ Nr.15, pasi rregullimet sipas kësaj dispozite lidhen vetëm me riparimin e parregullsisve apo mospërbushjeve të kërkesave të Kodit Zgjedhor, parregullsi këto të evidentuara nga KZAZ tek dokumentacioni i dorëzuar tashmë paraprakisht dhe brenda afatit;

regjistrimi i një kandidati për kryetar bashkie apo listës së kandidatëve për këshillin e bashkisë në kundërshtim me procedurën dhe afatet ligjore çënon parimin e barazisë së palëve në procesin zgjedhor, duke pasur këtu parasysh subjekte apo individë të tjerë të cilët nuk regjistrohen pasi deshtojnë të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në afatin e përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, ndërkohë që zbatimi i normave ligjore për çdo aspekt të procesit zgjedhor, duke filluar me procesin e kandidimit, votimit, nxjerrjes së rezultateve, garanton në tërësinë e tij një proces të rregullt zgjedhor, në përputhje me standartet ndërkombëtare të gjithëpranuara;

Kodi Zgjedhor, për të garantuar qëndrueshmërinë e procesit të regjistrimit të kandidatëve dhe të gjitha proceseve të tjera të ndërvarura me të, në asnjë mënyrë të tij nuk parashikon të drejtën e zëvendësimit, të kandidatëve, por, edhe nëse i referohemi normave ligjore të cilat kanë rregulluar proceset zgjedhore të mëparshme të cilat kanë parashikuar institutin e zëvendësimit të kandidatëve, kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm brenda disa afateve të përcaktuara në ligj (neni 82 i Kodit Zgjedhor të vitit 2003, i shfuqizuar); e drejta pasive e votës është një ndër elementet e të drejtës së zgjedhjes të parashikuar nga neni 45 i Kushtetutës, dispozite kjo që parashikon kufizimet e para në lidhje me këto të drejta (mosha apo aftësia për të vepruar e subjektit të të drejtës,

etj), nderkohe qe neni 17 i Kushtetutes parashikon se kufizime te drejtave dhe lirive te parashikuara ne kete Kushtetute mund te vendosen edhe me ligj, per nje interes publik, ku duke ardhur ne rastin konkret, afati 50 ditor per regjistrimin, i parashikuar nga ligji (Kodi Zgjedhor), eshte jo vetem ne fuqi, por edhe i arsyeshem e ne mbrojtje te nje interesi te jashtezakonshem publik;

cenimi (ne dukje) i te drejtes se nje individi per t'u regjistruar si kandidat ne zgjedhjet lokale (por edhe kombetare), si dhe i interesave te forces politike qe e mbeshtet ate apo votuesve potenciale te saj, eshte parashikuar nga legjislatori per te siguruar stabilitetin dhe mbarevajtjen e zgjedhjeve si nje proces i tere dhe i demokracise ne thelb, ku lejimi i ndryshimeve te vazhdueshme te kandidaturave, per gjithefarllaj qellimesh, do te bente praktikisht te pamundur hartimin perfundimtar te listave te kandidateve dhe te fleteve te votimit, duke bere praktikisht te pamundur ushtrimin nga shumica absolute e qytetareve te se drejtes se tyre per te zgjedhur.

Kunder vendimit si me lart te KQZ-se, brenda afatit ligjor 5-ditor, me date 22.05.2015, ka paraqitur ankim/padi subjekti zgjedhor PD, me te cilen, duke paditur KQZ-ne, si dhe thirrur si pale te interesuara PS dhe Z.Illir Pjetraj, ka kundërshtuar Vendimin e KQZ-se Nr.493, date 20.05.2015, duke kërkuar shfuqizimin e tij dhe gjykimin ne themel te ceshtjes dhe lenien ne fuqi te Vendimit Nr.55, date 13.05.2015, te KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe.

Përpara fillimit te shqyrtimit gjyqësor, Kolegji Zgjedhor vuri ne diskutim legjitimin si pale e interesuar ne kete gjykim te Z.Illir Pjetraj, ku pasi degjoi dhe mendimin e paleve pjesemarrese, ne konsiderate te përcaktimeve te bera ne nenin 2/20 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, vendosi te mos e legjitimoje kete shtetas si pale e interesuar ne kete gjykim dhe nxjerrjen e tij jashte gjykimit.

Ne kerkesepadi, si dhe gjate shqyrtimit gjyqësor, pala paditese pretendoi se:

Vendimi i KQZ-se Nr.493, date 20.05.2015, eshte nje vendim i marre ne shkelje te ligjit dhe qe duhet te shfuqizohej si i tille, pasi:

vendimmarrja e KQZ-se vinte ne thyerje te parimit kushtetues per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur, ne rrethanat kur:

ne dispozita te veçanta te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise (nenet 1 dhe 45), por edhe ne parimet e sanksionuara ne nenin 3 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, garantohej e drejta e shtetasve per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur, ashtu sikundër dhe e drejta e subjekteve zgjedhore per te garuar lirisht ne zgjedhje, duke paraqitur alternativën e tyre qeverisese ne secilin nivel sipas rregullave mbi te cilat funksionon nje demokraci parlamentare, ku per përfitimin e ketyre te drejtave Kushtetuta vendos nje sere kriteresh dhe procedurash qe duhen respektuar me qellim qe parashikimet kushtetuese dhe ligjore te mos mbeten thjesht parashikime boshe, por te behen efektive, nderkohe qe thelbi i te drejtave kushtetuese nuk mund te zhbehet dhe as te denatyrohet;

e drejta e shtetasve per te zgjedhur nuk mund te kuptohet vetem me lirine e zgjedhesve per te votuar, por edhe me mundesine qe ata duhet te kene per te zgjedhur midis disa alternativave qe subjektet zgjedhore ne gare perfaqesojne dhe ofrojne, duke qene pikërisht kjo dallimi midis zgjedhjeve te lira dhe demokratike ne vendet me demokraci te zhvilluar dhe zgjedhjeve ne vendet diktatoriale apo me sistem njepartiak, ku “zgjedhjet” shnderrohen ne nje procedure “votëbesimi” ndaj klases politike ne fuqi;

KQZ, ne kushtet e nje boshllëku ligjor, ka aplikuar nje kriter diskriminues dhe duke c'regjistruar kandidatin e propozuar nga opozita ka lene garen zgjedhore vetem me nje alternative, c'ka cenonte parimin kushtetues dhe thelbin e zgjedhjeve te lira dhe demokratike, megjithëse, ne rastin konkret, Koalicioni APPD, jashte dhe pavarësisht vullnetit te tij, ka plotësuar ne kohe te gjithë detyrimet e tij ligjore per regjistrimin e kandidatit te tij per kryetar te Bashkise Kurbin ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015;

vendimmarrja e KQZ-se eshte marre ne kushtet e mungeses se plote te nje parashikimi ligjor te shprehur qe rregullon posacerisht situaten e krijuar nga dorëheqja e nje kandidati per kryetar bashkie dhe zevendesimin e tij, ndersa ka aplikuar me analogji nje dispozite tjetër qe nuk rregullon pikërisht kete situatë, ne rrethanat kur:

nenet 72 dhe 73 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar parashikojne dokumentacionin, afatet dhe proceduren qe duhet te plotësohen dhe ndiqen nga subjektet zgjedhor dhe kandidatet per organet e qeverisjes vendore me qellim regjistrimin e tyre per zgjedhje nga organi perkates i administrates zgjedhore, rregullime keto qe synojne shprehjen e vullnetit nga dy aktoret kryesore, subjekti dhe kandidati, si dhe afatin brenda te cilit dokumentacioni perkates duhet te paraqitet, ashtu sikundër dhe afatin brenda te cilit procesi i regjistrimit te kandidateve te perfundoje, ne menyre qe te sigurohet nje afat kohor i mjaftueshem per përgatitjen e fazave te tjera te procesit zgjedhor (shorti per renditjen e kandidateve, përgatitja e fletes se votimit, etj), nderkohe qe ne rastin konkret, afati i fundem sipas ketyre dispozitave ligjore, ka qene data 13 maj 2015, date, pikërisht ne te cilen, KZAZ Nr.15, ka marre dhe vendimin e saj per regjistrimin e kandidatit te opozites, duke qene i ligjshem dhe i drejte ky vendim persa kohe ka qene brenda afatit te pergjithshem, afat brenda te cilit komisionet perkatese zgjedhore mund te merrnin vendime perfundimtare per regjistrim ose mosregjistrim kandidatesh;

KQZ-ja ne menyre te gabuar dhe ne kundërshtim me ligjin, ka aplikuar keq nenin 73/4 te Kodit Zgjedhor, qe permban rregullime te posaçme ne lidhje me “listat shumemerore” te kandidateve per këshillat e bashkise, ndersa nuk parashikon asgje per rastin kur nje kandidat i listes shumemerore terhiqet nga kandidimi dhe, aq me pak, nuk parashikon asgje ne rastin kur terhiqet nga kandidimi nje kandidat per kryetar bashkie, nderkohe qe “lista shumemerore” dhe “kandidati per kryetar bashkie” nuk jane e njëjta gje ne menyre qe kjo dispozite te perdoret per analogji ne te dy rastet, pasi midis “kandidatit sipas listes shumemerore” dhe “kandidatit per kryetar bashkie” ka dallime thelbesore, kur ne rastin e pare kandidati nuk figuron ne listen e votimit dhe per anetar te këshillit bashkiak votohet per subjektin, ndersa ne rastin e kandidatit per kryetar bashkie votohet drejtperdrejte ai, duke figuruar vetem emri i tij ne fleten e votimit, nderkohe qe heqja dore nga mandati i nje anetari te këshillit bashkiak con ne zevendesimin e tij me personin pasardhës ne listen shumemerore, kurse heqja dore nga mandati prej kryetarit te bashkise con ne zgjedhje te

parakohshme ne ate njesi te qeverisjes vendore, prandaj, nese ndalimi i parashikuar nga ligji per mosndryshim te emrave dhe renditjes ne listen shumememore eshte i përligjur, i njëjti ndalim nuk mund te aplikohet ne rastin e kandidatit per kryetar bashkie;

vendimmarrja e KQZ-se eshte marre ne kundërshtim dhe me vete praktiken e saj persa i perket afatit te fundem te regjistrimit te kandidatit, kur eshte fakt qe vete KQZ, jo vetem me date 13.05.2015, por edhe mbas kësaj date, ka marre vendime per regjistrim kandidatësh, nderkohe qe procedura dhe afatet e përcaktuara ne Kodin Zgjedhor te ndryshuar nuk jane parashikuar si qellim ne vetvete, por si mjete per te garantuar vullnetet, ate te subjekteve per t'u zgjedhur dhe ate te zgjedhesve per te zgjedhur dhe jo per te mohuar keto vullnete, sikundër ka vepruar KQZ-ja nepermjet vendimit objekt padie;

vendimmarrja e KQZ-se eshte marre mbi bazen e nje ankimi alogjik dhe te pabazuar, kur subjekti ankues, ndersa pretendon se ne zbatim te nenit 74/3 te Kodit Zgjedhor, ne momentin qe nje kryetar bashkie eshte regjistruar per kryetar brenda afateve te kësaj dispozite, ky regjistrim s'mund te pesoje ndryshime, konsideron te paligjshem vetem Vendimin Nr.55, date 13.05.2015, te KZAZ Nr.15, nderkohe qe pranon, merr te mireqene dhe konsideron te ligjshem vendimin tjetër te asaj dite te KZAZ Nr.15, pikërisht Vendimin Nr.54, me te cilin eshte c'regjistruar kandidati Altin Biba, duke qene keshtu i dukshem dhe i qarte synimi i subjektit ankues qe, nepermjet vetem kundërshtimit te Vendimit Nr.55, te arrije qëllimin e tij politik per te garuar i vetem ne ate njesi te qeverisjes vendore;

vendimmarrja e KQZ-se eshte marre ne kundërshtim me ligjin pasi vendimi i KZAZ Nr.15 i ankimuar përpara saj nuk cenon dhe as sjell asnjë pasoje ne procesin e administrimit zgjedhor ne pergjithesi dhe as ne procesin e prodhimit te fleteve te votimit, ne vecanti per ate zone zgjedhore, ne rrethanat kur periudha kohore e percaktuar nga vete legjislatori, qe ne rastin konkret periudha 13 maj - 21 qershor, eshte konsideruar si nje periudhe kohore teresisht e mjaftueshme per te proceduar normalisht me te gjitha hapat e e tjera te procesit te administrimit zgjedhor;

vendimmarrja e KQZ-se eshte alogjike dhe kunderthenese ne dispozitiv, nderkohe qe disponimi i saj nuk eshte nje nga llojet e vendimmarrjeve qe ligji i lejon KQZ-se, ne rrethanat kur:

referuar nenit 143 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, qe parashikon shprehimisht llojin e vendimeve qe KQZ-ja mund te marre (pushimin e shqyrtimit, lenien ne fuqi te vendimit te KZAZ-se, ndryshimin e vendimit te KZAZ-se), rezulton qe vendimmarrja e KQZ-se per konstatimin e pavlefshmerise absolute te vendimit te KZAZ-se te mos perputhet me asnjë nga llojet e vendimeve qe ligji parashikon, ndersa nuk lejon si opsion ate menyre disponimi sikundër eshte shprehur KQZ-ja ne rastin konkret;

dispozitivi i vendimit eshte kunderthenes, pasi nga njera ane konstaton (pa zgjidhur pasojat) nje vendimmarrje te KZAZ-se si absolutisht te pavlefshme, pra sikur te mos kete ekzistuar kurre, ndersa, nga ana tjetër, duke pranuar ankimin e PS, po ne dispozitiv vendos ta shfuqizoje ate vendim, pra sikur kjo vendimmarrje te ekzistojë; rastet e pavlefshmerise absolute te aktit administrativ parashikohen shprehimisht ne Kodin e Procedurave Administrative, nderkohe qe KQZ-ja ne vendimin e saj nuk arsyeton kete moment;

Vendimi Nr.55, date 13.05.2015, i KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe, eshte nje vendim i marre ne përputhje me ligjin, mbasi:

eshte marre brenda afatit te pergjithshem kohor (dates 13.05.2015), afat brenda te cilit komisionet perkatese zgjedhore mund te merrnin vendime perfundimtare per regjistrim ose mosregjistrim kandidatësh;

eshte marre ndersa ka konstatuar mungesen e njerit prej elementeve te dosmosdoshem per regjistrim kandidati, pikërisht ate te shprehjes se vullnetit te kandidatit, ne kushtet kur kandidati ka hequr dore nga kandidimi, ndersa nga subjekti eshte zevendesuar menjehere kandidati me nje tjetër dhe plotësuar menjehere dokumentacioni i kërkuar nga ligji.

Perkunder pretendimeve te pales paditese, pala e paditur KQZ prapësoi se kerkesepadia eshte e pabazuar ne prova dhe ligj, duke parashtruar te njëjtin qëndrim si dhe ne vendimin objekt gjykimi.

Pala e interesuar PS, ndersa ndau te njëjtin qëndrim ne lidhje me bazueshmerine ligjore te vendimit objekt gjykimi te KQZ-se, pretendoi se kerkesepadia e paraqitur ne rastin konkret eshte e pabazuar ne prova dhe ligj.

Gjate gjykimit, Kolegji Zgjedhor administroi si prove praktiken dokumentare te paraqitur nga pala e paditur KQZ ne lidhje me vendimin objekt gjykimi.

Ne përfundim te shqyrtimit, Kolegji Zgjedhor vlerëson se Vendimi i KQZ-se Nr.493, date 20.05.2015 eshte marre ne kundërshtim me ligjin dhe si i tille duhet te shfuqizohet. Nderkohe, persa kërkohet dhe lidhet me regjistrimin e kandidatit per kryetar te Bashkise Kurbin ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore, te propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni APPD, ndersa konstatohet se KQZ-ja nuk ka marre nje vendim përfundimtar per kete ceshtje, Kolegji Zgjedhor vlerëson se eshte rasti per te detyruar KQZ-ne te marre vendim duke shqyrtuar ne themel ceshtjen.

Konkretisht, Kolegji Zgjedhor vlerëson se pavarësisht se me date 10.05.2015, eshte depozituar (derguar nga KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe) nje kerkese per heqjen dore nga kandidimi, paraqitur nga kandidati i regjistruar per kryetar te Bashkise Kurbin, Z.Altin Biba, KQZ-ja, nuk e ka shqyrtuar kete kerkese, megjithëse ajo lidhet drejtperdrejte me nje vendimmarrje te KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe (Vendimin Nr.50, date 06.05.2015) dhe që ka të bëjë thelbesisht me procesin e regjistrimit te kandidatit per kryetar te Bashkise Kurbin te propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni APPD. KQZ-ja nuk e ka ushtruar pushtetin e saj as gjate shqyrtimit administrativ, ne rastin e marrjes se vendimit objekt gjykimi, megjithëse e referon rregullisht si nje ngjarje te ndodhur.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se pavarësisht mënyrës së rregullimit të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, KQZ-ja nuk duhej të mos e ushtronte një pushtet të tillë. Referuar pergjegjesise që ka KQZ-ja, si organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, si edhe rregullimit te bere ne nenin 21/26 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, që i njeh të drejtën KQZ-së të kryejë edhe detyra të tjera, që burojnë nga ky Kod ose nga ligje të tjera, kur ato nuk kryhen nga komisionet e niveleve më të ulëta, Kolegji Zgjedhor

vlerëson se KQZ-ja nuk ka përmbushur një detyrim që, sipas parimeve dhe vlerave të ligjit duhej të ishte përmbushur. Duke mos e shqyrtuar në kohë kërkesën e paraqitur nga një subjekt zgjedhor (kandidati), trajtimi i të ciles do të mundësonte zgjidhjen e situates se krijuar në atë rast në lidhje me procesin e regjistrimit të kandidatit për kryetar të Bashkisë Kurbin të propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni APPD, pjesë e të ciles është dhe subjekti zgjedhor PD, KQZ-ja ka lejuar KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë, që përtej kompetencave të saj të dhëna nga ligji (Kodi Zgjedhor i ndryshuar), të marrë për sipër zgjidhjen e situates. KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë, duke mos parashtruar ndonjë argument dhe as vlerësim ligjor, për kërkesën për heqjen dorë nga kandidimi, në kundërshtim dhe në shkelje të parimeve të përgjithshme të së drejtës (dhe asaj administrative në veçanti), ka disponuar vetë për shfuqizimin e vendimit të mëparshëm (Vendimit Nr.50, datë 06.05.2015), në një kohë që çështja nuk ishte pjesë e juridiksionit të këtij organi, por e organit më të lartë (neni 124/1 i Kodit të Procedurave Administrative). Referuar nenit 123 të Kodit të Procedurave Administrative, KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë, nuk ka patur as të drejtën për revokimin e vendimit të vetë të mëparshëm, përse kohë është organ i nivelit baze, vendimet e të cilin janë të ankimeshem përpara organit të tij epror (KQZ-se). Për më tepër, edhe në eventualitetin e pasjes së kësaj të drejte, KZAZ Nr.15 ishte në pamundësi ligjore në momentin dhe kur e ka ushtruar në fakt, pikërisht 7 ditë më pas, ndërkohë që kishte kaluar edhe afati 3-ditor i ankimit të vendimit. Përderisa çështja i ishte dërguar KQZ-së, kishte dalë nga pushteti i KZAZ-së dhe çdo vendimarrje konsiderohet jashtë juridiksionit të këtij organi. Prandaj, edhe për këto arsye, Kolegji Zgjedhor vlerëson se ka qenë detyrimi ligjor i KQZ-se për të shqyrtuar pikësisht kërkesën për heqjen dorë të kandidatit të regjistruar për kryetar bashkie Z. Altin Biba dhe në vijimësi të zgjidhte edhe situatën e krijuar.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se është mosveprimi në kohë i KQZ-se nga njëra anë, por edhe veprimi individual i kandidatit të regjistruar për heqjen dorë nga kandidimi, ato që e kanë detyruar subjektin zgjedhor Koalicionin APPD, që në funksion të realizimit të të drejtës për të marrë pjesë në zgjedhje (vullnetin për realizimin e të ciles tashme e kishte shprehur rregullisht me parë), brenda një kohe të shkurtër nga njoftimi për heqjen dorë nga kandidimi dhe ndërsa afati kohor ligjor teresor i procesit të regjistrimit të kandidateve nuk kishte

përfunduar ende, pikërisht ditën e fundit të tij (date 13 maj 2015), të paraqese një kerkese për regjistrim (bashkë me dokumentet e nevojshëm) të një kandidati tjetër për kryetar bashkie në atë njesi të qeverisjes vendore. Në thelb kërkesa e paraqitur synon zëvendësimin e kandidatit të propozuar dhe regjistruar më herët, i cili fillimisht kishte shprehur vullnetin për të kandiduar, por që më pas, pas regjistrimit, ishte shprehur për heqjen dorë nga kandidimi.

Edhe në këto rast, mbi të njëjtat argumente si më lart, Kolegji Zgjedhor vlerëson se trajtimi i kërkesës për heqjen dorë, por edhe i zëvendësimit të kandidatit të regjistruar për kryetar bashkie është një çështje që nuk i përket pushtetit të KZAZ-së, por vetëm KQZ-se. Një detyrim të tillë KQZ-ja nuk e ka përmbushur, sepse nuk e ka trajtuar në themel kërkesën e paraqitur në rastin konkret. Kështu, e vënë në lëvizje mbi bazën e ankimit zgjedhor të subjektit tjetër garues në zgjedhje, KQZ-ja, fillimisht e ka konsideruar dhe trajtuar kërkesën e paraqitur si kerkese fillestare, ku mbi këto baze ka vënë në diskutim afatin kohor të paraqitjes së saj, ndërsa, në një moment tjetër, e ka konsideruar dhe trajtuar atë si një kerkese të dytë, pas asaj fillestare dhe ka pranuar tashmë, por në funksion të përfundimit të saj për mosrespektim të procedurës nga komisioni zonal, që sipas KQZ-se, padrejtësisht kishte vepruar si për rastin e regjistrimit fillestar të kandidatit (krejtësisht nga e para).

Në këto kushte, Kolegji Zgjedhor vlerëson se, duke disponuar vetëm për konstatimin e pavlefshmerisë absolute të Vendimit Nr.55, datë 13.05.2015 të KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe (vendim ky i ardhur si pasoje e një vendimmarrje të mëparshme të komisionit zonal, Vendimit Nr.54, datë 13.05.2015, i evidentuar dhe në shqyrtimin administrativ, por për të cilin heshtet), KQZ-ja, jo vetëm nuk ka zgjidhur përfundimisht dhe në themel çështjen e ligjshmërisë së heqjes dorë të kandidatit për kryetar të Bashkisë Kurbin, Z. Altin Biba të propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni APPD, sikundër Kodi Zgjedhor i ndryshuar kërkon (referuar dhe llojit të vendimmarrjeve që ai përcakton për KQZ-ne në nenin 143), por e ka futur këto çështje në ngrac. Me mënyrën se si ka vepruar KQZ-ja, është tërësisht e paqarte nëse subjekti zgjedhor në fjalë ka ose jo ligjërisht të regjistruar kandidat për kryetar të Bashkisë Kurbin në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, në një kohë kur një gjë e tillë duhet të jetë domosdoshmërisht e qarte sepse lidhet drejtpërdrejtë, jo vetëm me të drejtën e subjektit zgjedhor, por edhe të drejtën e zgjedhësve për të votuar, duke qenë ajo një çështje që mbart në vetvete jo vetëm interesin personal të

subjektit zgjedhor, por edhe interesin publik te zgjedhesve te asaj zone zgjedhore. Kolegji Zgjedhor thekson se, pavarësisht nga mjeti, të cilin KQZ-ja e ka konsideruar që e ka vënë ne lëvizje, në kuptim të ligjit (nenit 143/3 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar), KQZ-ja nuk ka qene e kufizuar nga cfare i eshte kërkuar nga ankuesi. Përkundrazi, KQZ-ja ka patur dhe ka detyrimin te zgjidh përfundimisht rastin, duke dale me nje vendim përfundimtar ne lidhje me ligjshmërinë e heqjes dorë të kandidatit per kryetar te Bashkise Kurbin, Z. Altin Biba, te propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni APPD, si dhe për procesin e regjistrimit te kandidatit per kryetar bashkie, te propozuar nga subjekti zgjedhor ne fjale. Nje konfirmim, vendimmarrje e tille, eshte nje ceshtje qe i perket me se pari juridiksionit te organit shtetëror te ngarkuar nga ligji per administrimin e zgjedhjeve, pra juridiksionit administrativ dhe, vetem pas shqyrtimit final te ceshtjes ne kete juridiksion, ceshtja potencialisht mund t'i përcillet dhe te behet pjese e juridiksionit gjyqësor te Kolegjit Zgjedhor.

Nga ana tjetër, duke marre shkas nga opinioni i paleve, parashtruar gjate gjykimit te ceshtjes, sipas te cilit subjekti zgjedhor Koalicioni APPD ka mbetur tashme pa kandidat te regjistruar per kryetar te Bashkise Kurbin ne zgjedhjet per organet qe qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015, Kolegji Zgjedhor vlerëson te theksoje se legjislacioni i brendshem (Kushtetuta e Republikes se Shqiperise dhe Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise), aktet nderkombetare te ratifikuara nga Republika e Shqiperise (Konventa e te Drejtave te Njeriut, Pakti Nderkombetar per te Drejtat Civile dhe Politike), por edhe udhëzuesit e pranuar nderkombetarisht (Kodi i Praktikes se Mire per Ceshtjet Zgjedhore i Komisionit te Venecias), konsiderojne zhvillimin e zgjedhjeve demokratike dhe pluraliste, c'ka behet e mundur nepermjet respektimit te parimeve bazë te te drejtes zgjedhore, zgjedhje universale, te barabarta, te lira, te fshehta, te drejtpërdrejta dhe periodike, qe jane me rëndësi thelbesore për demokracinë dhe ndihmojne ate të shprehet në mënyra të ndryshme, por brenda kufijve të caktuar. Prandaj, Kodi Zgjedhor duhet te interpretohet dhe zbatohet ne përputhje me keto parime baze, per te siguruar nje proces konkurrues, te rregullt dhe te besueshem zgjedhor, ne respektim te te drejtave dhe lirive te njeriut, qe garanton formimin dhe shfaqjen e lire te vullnetit te zgjedhesve dhe ne kete menyre pluralizmin dhe demokracine ne vend.

Dhe, ndersa ka parasysh momentin qe tashme ndodhet procesi parazgjedhor, kur kemi hyre ne periudhen e fushates zgjedhore, Kolegji

Zgjedhor vlerëson se afati brenda te cilit KQZ-ja duhet te marre vendim përfundimtar per rastin konkret te jete jo me vone se data 30.05.2015.

Sa mesiper, Kolegji Zgjedhor konkludon se Vendimi i KQZ-se Nr.493, date 20.05.2015 duhet te shfuqizohet, duke u detyruar ai qe, jo me vone se data 30.05.2015, te marre vendim per ceshtjen e regjistrimit te kandidatit per kryetar te Bashkise Kurbin ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015 te propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni Aleanca Popullore per Pune dhe Dinjitet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykates se Apelit Tirane, bazuar ne nenin 158, pika 3 dhe 4, te Kodit Zgjedhor te ndryshuar,

V E N D O S I

1. Shfuqizimin e Vendimit Nr.493, date 20.05.2015, te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve.

2. Detyrimin e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve qe, jo me vone se data 30.05.2015, te marre vendim per ceshtjen e regjistrimit te kandidatit te propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni Aleanca Popullore per Pune dhe Dinjitet, duke trajtuar ne themel edhe kerkesen per dorëheqje te kandidatit Altin Biba dhe kerkesen e subjektit zgjedhor Koalicioni Aleanca Popullore per Pune dhe Dinjitet, te dates 13.05.2015, per regjistrimin/zevendesimin e kandidatit per kryetar te Bashkise Kurbin, Qarku Lezhe, ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015.

Tiranë, më 28.05.2015

ANËTAR **ANËTAR** **KRYESUES**
GJINOVEFA GABA **PETRIT ÇENO** **ILIR TOSKA**

ANËTAR **ANËTAR**
KLITON SPAHIU **VALBON ÇEKREZI**

* *
* *



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR

NR. 14 REGJ. THEMELTAR
Nr. 14, i Vendimit

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga:

KRYESUES : Kliton SPAHIU,
ANETAR : Gjinovefa GABA,
ANETAR : Valbon ÇEKREZI,
ANETARE : Edlira PETRI,
ANETAR : Andi CIVICI,

me sekretare Rexhina Baci, në Tiranë, sot më **dt.29.05.2015**, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative–zgjedhore me nr.14 Akti, që u përket palëve:

PADITES: Partia Socialdemokrate e Shqipërisë,
përfaqësuar nga kryetari saj **z.Skënder Gjinushi** dhe
av.**Irena Reso**.

I PADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,
përfaqësuar nga **z.Olsi Peto**.

Palë e Interesuar: Partia Socialiste e Shqipërisë,
përfaqësuar nga **Koli Bele** dhe **Gledian Llatja**.
Partia Lëvizja Socialiste për Integrim,
përfaqësuar nga **z.Dritan Fejzo**.

OBJEKTI: - Shfuqizimin e vendimit, datës 22.05.2015 të KQZ, Për ndryshimin e vendimit të KZAZ Nr 53 dhe c´regjistrimin e kandidatit të paraqitur nga PSD.
- Lënia në fuqi të vendimit të KZAZ Nr 53, për regjistrimin e kandidatit të PSD.

Baza ligjore: Nenet 1/3, 4 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Nenet 68/2, 145 e vijues të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i RSH” i ndryshuar, Nenet 118 e vijues të K.Pr.Administrative.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, shqyrtoi dhe administroi provat shkresore, dëgjoi palët prezent në pretendimet e tyre përfundimtare të cilët kërkuan:

- përfaqësuesi i palës paditëse pranimin e padisë;
- përfaqësuesi i palës së paditur rrëzimin e padisë,
- përfaqësuesin e palës interesuar, Partia Lëvizja Socialiste për integrim, rrëzimin e padisë,
- përfaqësuesin e palës së interesuar Partia Socialiste, rrëzimin e padisë, e si bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Pranë Kolegjit Zgjedhor, është paraqitur për shqyrtim kërkesë-padia e subjektit zgjedhor, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, e cila ka paditur KQZ-në, duke kërkuar; “-*Shfuqizimin e vendimit, datës 22.05.2015 të KQZ-së, Për ndryshimin e vendimit të KZAZ Nr 53 dhe c´regjistrimin e kandidatit të paraqitur nga PSD. -Lënie në fuqi të vendimit të KZAZ Nr 53, për regjistrimin e kandidatit të PSD*”.

Shqyrtimi administrativ dhe vendimi i dhënë nga KQZ:

Partia Socialdemokrate e Shqipërisë me vendimin Nr 103, datë 19.04.2015, është regjistruar si subjekt zgjedhor pranë KQZ-së, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015.

Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, me datë 03.05.2015, ka dorëzuar dokumentacionin për kandidimin për Kryetar të Bashkisë

Prrenjas, të Z.Artur Topi, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015, pranë KZAZ-së Nr. 53. Rezulton që të jetë mbajtur procesverbal i dorëzimit të dokumenteve të kandidimit, me datë 03.05.2015 ora 11.00, në të cilin janë pasqyruar dokumentet e dorëzuara nga ky subjekt zgjedhor, të cilat janë:

- Deklarata e kandidatit për kryetar,
- Certifikatë lindje për kandidatin,
- Lista nënshkrimeve e 1% të zgjedhësve të zonës zgjedhore të cilët mbështesin kandidatin.

Theksojmë se në rubrikën “Vërtetim nga Kuvendi i Shqipërisë apo Këshilli i Bashkisë për zotërimin e mandatit” të procesverbalit, është bërë shënimi te kollona “jo”. Pra, rezulton se është kërkuar të regjistrohet si kandidat për Kryetar të Bashkisë Prrenjas, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015, si i propozuar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, z. Artur Topi, mbështetur nga më shumë se 1% e zgjedhësve të asaj zone zgjedhore, (dhe jo me zotërim mandati në njësinë e qeverisjes vendore).

KZAZ-ja Nr. 53, “Qarku Elbasan”, me datë 05.05.2015, pasi ka verifikuar dokumentacionin e paraqitur nga kandidati për Kryetar Bashkie, Z.Artur Topi, paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, me vendimin Nr. 49, ka vendosur: “Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, të regjistrojë si kandidat për kryetar në Bashkinë Prrenjas z.Artur Rexhep Topi paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë”.

Me kërkesën ankimore të depozituar pranë KQZ-së, me datë 08.05.2015, me nr. protokolli 4260, nga Partia Socialiste e Shqipërisë, është kërkuar; “Ndryshimin e vendimit Nr 49, datë 05.05.2015 të KZAZ Nr 53, Bashkia Prrenjas, dhe c’regjistrimin e kandidatit për kryetar Bashkisë Prrenjas, z.Artur Topi”.

Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, i është drejtuar Sektorit të Policisë Shkencore, për kryerjen e aktit të ekspertimit grafik nënshkrimesh të Listës në Formularin Tip Model 07K, për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve që mbështesin kandidaturën për Kryetar të Bashkisë Prrenjas. Eksperti kriminalist Qemal Demaj ka kryer aktin e ekspertimit grafik nënshkrimesh me nr. 192, të datës 13.05.2015.

KQZ-ja pasi ka marrë në shqyrtim këtë kërkesë ankimore me nr 6, të Partisë Socialiste të Shqipërisë, ka kryer hetimin administrativ në të cilën janë shqyrtuar dhe administruar një sërë provash ndër të cilat edhe akti i ekspertimit grafik nënshkrimesh me nr. 4771, datë 19.05.2015, kryer sipas vendimit të ndërmjetëm të KQZ, si dhe vërtetimin me nr. 283 prot, i datës 13.05.2015, të lëshuar nga Këshilli Bashkisë Prenjas.

-Akti ekspertimi Nr. 4771, datë 19.05.2015, është kërkuar nga KQZ-ja nëpërmjet shkresës Nr. 4888, datë 16.05.2015. Në këtë akt ekspertimi të kryer nga eksperti kriminalist Vladimir Ikonomi, është konkluduar se në dokumentin objekt ekspertimi "Lista në Formular tip Model 07K", në kollonën "Nënshkrime" rezulton se ka nënshkrime të njëjta (të plotësuar) nga i njëjti person, duke përshkruar konkretisht në 16 raste, në të cilat më shumë se një nënshkrim ishte shkruar nga e njëjta dorë. Gjithashtu në këtë akt ekspertimi grafik nënshkrimesh të listës në formular tip model 07k, objekt ekspertimi, është kostatuar se; -në disa raste paraqiten në formë siglash si ndërthurje vijash që nuk paraqesin karakteristika të mjaftueshme me vlera krahasuese, -në disa raste me ndërtim grafik tepër të thjeshtë, me elementë të pakët sasior dhe cilësorë grafik, pa evidentuar karakteristika të mjaftueshme me vlera krahasuese, -në disa raste në gjendje të ndërthurrura me elementë grafik shkronjash afër tyre.

-Vërtetimin me nr. 283 prot, i datës 13.05.2015, të lëshuar nga Këshilli Bashkisë Prenjas, e cila që në datë të përpilimit të saj është jashtë afatit ligjor për paraqitjen e kandidatëve.

KQZ-ja në vendimin e saj nr. 559, datë 22.05.2015 ka konkluduar se; *"Nënshkrimet e evidentuar si të fallsifikuara nga akti i ekspertimit nr. 3582/1 dt.20.05.2015 i Institutit të Policisë Shkencore, nuk mund të konsiderohen si nënshkrime të "parregullta", sipas kuptimit që i jep neni 71/3 i Kodit Zgjedhor. Nënshkrime të "parregullta" janë ato nënshkrime që mund të kenë një apo disa mangesi e për pasojë mund të perjashtohen nga lista mbështetese, por që kurrsesi nuk janë të fallsifikuara, pasi një veprim i tillë e bën të gjithë dokumentin të fallsifikuar e për pasojë ekzistojnë të gjitha rrethanat për ekzistencën e shkaqeve të dënueshmërisë.*

Nga verifikimi i provave të administruara rezultoi se Partia Socialdemokrate nuk ka depozituar në KZAZ vërtetim për zotërimin e mandatit për anetar të keshillit, brenda afateve të përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor. Nga ky subjekt zgjedhor u paraqit në

KQZ nje vërtetimi i këshillit të Bashkisë Prrenjas i datës 13.05.2015, qe provonte se ky subjekt zgjedhor ka mandat këshilltari e për pasojë nuk ishte e nevojshme mbledhja e nenshkrimeve mbeshtetese. Paraqitja e ketij vërtetimi me dt. 13.5.2015 e bënë atë objektivisht të pa përdoshëm për shkak të tejkalimit të të gjitha afateve te paraqitjes se dokumentave per regjistrimin e kandidateve per kryetar bashkie. Njekohesisht mos paraqitja e ketij dokumenti ne KZAZ nr.53 ne afatin e caktuar, nuk i ka dhënë asnjë mundesi KZAZ nr. 53 per te orjentuar subjektin per dokumentat qe duhet te paraqiste me qellim regjistrimin e kandidatit. Ne daten 05.05.2015, kur KZAZ nr. 53 mori vendimin për regjistrimin si kandidat per kryetar te Bashkise Prrenjas te z Artur Topi, dokumenti i cili provonte se subjekti kishte anetare të Këshillit Bashkiak nuk ju vu ne dispozicion”.

Në përfundim të shqyrtimit administrative nga KQZ-ja me vendimin nr. 559, datë 22.05.2015. ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës ankimore nr. 6, të subjektit zgjedhor Partisë Socialiste, ndryshimin e vendimit nr. 49, datë 22.05.2015 të KZAZ nr.53, “Për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie, Z. Artur Topi, Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan, propozuar nga PSD”. Mosregjistrimin e kandidatit Artur Topi si kandidat për kryetar, bashkia Prrenjas dhe dërgimin e çështjes në prokurori”.*

Me këtë vendim nuk ka qenë dakord subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë e cila me datë 25.05.2015 ka paraqitur Kërkesë–Padi në shqyrtim, në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, shqyrtoi dhe administroi provat shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse në dobi të gjykimit, konkludoi se:

Vendimi nr. 559, datë 22.05.2015 i KQZ-së, objekt shqyrtimi në këtë Kolegj Zgjedhor është dhënë në zbatim korrekt të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, e për pasojë padia e paditësit Partia Socialdemokrate e Shqipërisë duhet rrëzuar.

Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, pasi është regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin Nr 103, datë 19.04.2015, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015, brenda afatit ligjor, *(jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve)* ka paraqitur kërkesën për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie në Prrenjas, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

të datës 21.06.2015, duke depozituar pranë KZAZ-së Nr 53, dokumentacionin e kandidimit.

Në Procesverbalin e dorëzimit të dokumentave të kandidimit sipas modelit 12K rezulton që të mos jetë paraqitur vërtetim me shkrim të nënshkruar nga institucioni i njësisë së qeverisjes vendore për zotërimin e mandatit të paktën 6 muaj e fundit, por për regjistrimin e kandidatit të tij, ky subjekt zgjedhor ka vlerësuar të paraqesë listën mbështetëse me nënshkrimet e 510 zgjedhësve të asaj njësie vendore.

KZAZ-ja Nr 53, Qarku Elbasan, referuar kërkesës dhe dokumentacionit përkatës të paraqitur nga subjekti zgjedhor, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë ka vlerësuar se plotësohen kriteret e nenit 67 të K.Zgjedhor, për pasojë ka vendosur të regjistrojë si kandidat për kryetar në Bashkinë e Prrenjasit Z.Artur Topi, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit, *(dhe jo me si subjekt zgjedhor me zotërim të mandatit në organin e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore)*.

Ankimi administrativ i paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë është fokusuar te lista mbështetëse me nënshkrimin e 510 zgjedhësve të asaj njësie, ndaj ky përbën dhe shkakun ankimor të parashtruar për shqyrtim.

Organi më i lartë për zhvillimin, administrimin dhe mbikqyrjen e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, KQZ-ja ka shqyrtuar këtë kërkesë-ankimore lidhur me pretendimet e ankuesit, ashtu si edhe prapësimet e palës së interesuar Partia Socialdemokrate. Rezulton të jetë kryer hetimi administrativ lidhur me listën mbështetëse më nënshkrimet e 510 zgjedhësve të asaj njësie, si dhe lidhur me vërtetimin nr 283, datë 13.05.2015 të paraqitur gjatë hetimit administrativ pranë KQZ-së. Edhe hetimi gjyqsor në Kolegjin Zgjedhor u fokusua në dy pretendimet kryesore të palës paditëse të cilat dhe po i parashtrujmë më poshtë:

-1.Lidhur me vërtetimin me Nr 283, datë 13.05.2015, të Bashkisë Prenjas, rezulton të jetë paraqitur me datë 22.05.2015, kur dhe është kryer hetimi administrativ pranë KQZ. Me këtë vërtetim subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, ka parashtruar si prapësim në shqyrtimin e ankesës administrative, edhe ekzistencën e mandateve në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duke pretenduar se është në përmbushje edhe të një alternative tjetër për regjistrimin si kandidat për Kryetar të Bashkisë Prenjas për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015, të Z.Artur Topi.

Ligjvënësi, në Kodin Zgjedhor ka parashikuar mënyrat dhe kriteret e regjistrimit të një kandidati për organet e qeverisjes vendore, ka përcaktuar afate, organin në të cilën paraqitet dokumentacioni përkatës, e tjerë. Në rastin në shqyrtim subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë ka zgjedhur si mënyrë regjistrimi të kandidatit të tij për kryetar të Bashkisë Prenjas, atë me listën mbështetëse me nënshkrimet e 510 zgjedhësve të asaj njësie, dhe jo atë me zotërimin e mandateve në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore.

Ky subjekt zgjedhor nuk mund të parashtrojë si alternativë për regjistrimin e kandidatit të tij, për kryetar të Bashkisë Prenjas, duke paraqitur vetëm në KQZ, një vërtetim të datës 13.05.2015 për të provuar se zotëron mandatin në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore. Në nenin 67/2 të K.Zgjedhor është parashikuar se; **së pari**, dokumentacioni për regjistrimin e kandidatit paraqitet në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore (*dhe jo në KQZ*), dhe **së dyti**, është përcaktuar një afat jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve, (*në rastin konkret dokumenti rezulton të jetë paraqitur tej këtij afati*).

-2.Lidhur me regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë e Prenjasit, Z.Artur Topi, si kandidat i mbështetur nga nënshkrimet e zgjedhësve, 510 të tillë, me vendimin me nr. 49, datë 05.05.2015 nga KZAZ-ja nr 53, Qarku Elbasan, ky kolegji vlerëson si më poshtë:

Në nenin 71 të Kodit Zgjedhor titulluar “Procedura e mbledhjes së nënshkrimeve” përcaktohet se :

“1. KQZ-ja, jo më vonë se 100 ditë para datës së zgjedhjeve, miraton dhe pajis subjektet e përcaktuara në nenet 68 dhe 69 të këtij Kodi me formularin tip për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për kandidatët e propozuar nga një grup zgjedhësish apo për partitë dhe koalicionet.

2. Zgjedhësit depozitojnë personalisht nënshkrimet e tyre në formularin tip. Formulari duhet të përmbajë identitetin e plotë të zgjedhësit, datëlindjen e tij dhe numrin telefonik të kontaktit. Bashkë me nënshkrimin, çdo zgjedhës depoziton edhe kopjen e letërnjoftimit të vlefshëm, të nënshkruar prej tij, e cila i bashkëngjitet listës. Në zbatim të nenit 69 të këtij Kodi, zgjedhësi duhet të jetë i regjistruar në zonën zgjedhore përkatëse.

3. Verifikimi i nënshkrimeve për zgjedhjet për Kuvendin kryhet nga administrata e KQZ-së dhe për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore kryhet nga KZAZ-ja përkatëse, duke verifikuar 5 për qind të listës mbështetëse të kërkuar sipas ligjit, nëse janë zgjedhës me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit. Pas verifikimit administrata paraqet një raport të detajuar mbi mangësitë e konstatuara. Raporti shqyrtohet në seancë publike, në prani të palës së interesuar. KQZ-ja vendos për pranimin ose refuzimin e listës mbështetëse. Lista pranohet kur numri i nënshkrimeve mbështetëse, duke përfshirë numrin e nënshkrimeve të parregullta, është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas këtij Kodi”.

Nisur nga rregullimi ligjor i procedurës për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse, si dhe referuar kuadrit historik të këtij aspekti të procesit zgjedhor, rezulton se sipas një rregullimi të mëparshëm për mbledhjen e nënshkrimeve, përcaktohej detyrimi i depozitimit të tyre para noterit publik apo para KQZ-së. Kjo procedurë garantonte vërtetësinë e nënshkrimit dhe vullnetit të zgjedhësit për mbështetjen e një kandidature të caktuar. Nga ana tjetër, nisur nga kostot e larta financiare që duhej të përballonin subjektet zgjedhore, për mbledhjen e nënshkrimeve para noterit apo KQZ-së, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 32/2010 vlerësoi si joproporcionale këtë procedurë e mbi këtë bazë, pas shfuqizimit të dispozitës mbi procedurën e mbledhjes së nënshkrimeve, Kuvendi, me ligjin 74/2012 miratoi rregullimin aktual të kësaj çështjeje.

Aktualisht mbledhja e nënshkrimeve të listës mbështetëse të kandidatit, realizohet nga vetë subjekti zgjedhor, i cili pajiset me formularin e miratuar nga KQZ-ja. Në këtë mënyrë subjekti zgjedhor krahas realizimit të së drejtës së tij për të kandiduar, është ngarkuar edhe me përgjegjësinë publike dhe ligjore të mbledhjes së nënshkrimeve të zgjedhësve.

Në aspektin administrativ të procedurës së mbledhjes së nënshkrimeve, neni 71 përcakton kriteret që duhet të plotësojë lista e tyre me qëllim që të pranohet nga KQZ-ja, si një dokument i vlefshëm kandidimi. Kodi Zgjedhor pranon hipotezën se dokumentacioni i kandidimit paraqitur nga një subjekt zgjedhor, mund të ketë parregullsi, të cilat me tu konstatuar nga KQZ-ja, apo sipas rastit KZAZ-të, kërkojnë të korrigjohen (*neni 73.1 i Kodit Zgjedhor*). Në

këtë aspekt parregullsitë mund të konstatohen edhe në listën e nënshkrimeve mbështetëse, nëse këto të fundit nuk përmbushin kërkesat e nenit 71 të këtij Kodi.

Nisur nga pretendimi i ankuesit PS mbi falsitetin e nënshkrimeve, si dhe nga nocioni “parregullsi” i përmendur nga Kodi Zgjedhor, Kolegji vuri në diskutim çështjen nëse falsiteti i nënshkrimeve në listën mbështetëse, përbën “parregullsi” në kuptim të Kodit Zgjedhor dhe si i tillë a ka vend për korrigjim.

Kolegji Zgjedhor, referuar faktit të vërtetuar nëpërmjet ekspertimit grafik, se lista mbështetëse e nënshkrimeve karakterizohet nga fenomeni i hedhjes së nënshkrimeve nga e njëjta dorë, ndërkohë që shumë nënshkrime është e pamundur të verifikohen, vlerëson se konstatimi i KQZ-së për falsitetin e saj, është i bazuar. Falsifikimi i dokumenteve nëpërmjet pasqyrimin në të, të të dhënave të rreme, përbën një shkelje të rëndë të ligjit, e cila është e dënueshme sipas së drejtës penale pasi cilësohet si krim. Nisur nga debati mbi ndarjen e juridiksionit penal nga ai administrativ, Kolegji Zgjedhor vlerëson se autoriteti për të filluar dhe ushtruar ndjekjen penale në Republikën e Shqipërisë i përket Prokurorisë (neni 148 i Kushtetutës) e në këtë kuptim është ky organi, i cili vlerëson nëse një veprë penale është kryer, identifikon autorin e saj dhe konkludon mbi ekzistencën e përgjegjësisë penale, që lind kur vërtetohen elementët objektivë dhe subjektivë të një veprë të caktuar si të dënueshme penalisht. Nga ana tjetër, përtej ekzistencës së kësaj përgjegjësie, funksionimi i shtetit të së drejtës, si në lëmin publik, ashtu edhe në atë të së drejtës private, nuk mund të bëhet duke anashkaluar shkelje të tilla të ligjit, që objektivisht janë të dënueshme nga e drejta penale. Elementët objektivë të falsifikimit siç janë konstatuar në rastin konkret (nënshkrimi i hedhur jo nga vetë zgjedhësi), vërtetojnë faktin se subjekti i ngarkuar me ligj për mbledhjen e nënshkrimeve (*subjekti zgjedhor*) ka mashtruar në paraqitjen e dokumenteve të kandidimit, duke bazuar mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse në të dhëna të pavërteta.

Nisur nga vlerësimi i mësipërm, pretendimi i subjektit zgjedhor PSD se nënshkrimet e hedhura nga e njëjta dorë duhet të konsiderohen të parregullta dhe të zbriten nga totali i tyre, gjendet i pabazuar. Referuar kërkesave të nenit 71 të Kodit Zgjedhor, Kolegji vlerëson se parregullsi konsiderohen, mungesat e elementëve si identiteti i plotë i zgjedhësit, numri i kontaktit, vendbanimi në një zonë tjetër zgjedhore, të cilat ose mund të korrigojnë ose mund

të zbriten nga totali i nënshkrimeve. Parregullsia nuk mund të barazohet me falsitetin, për të cilin ngarkohet me përgjegjësi subjekti zgjedhor që ka mbledhur nënshkrimet. Në këtë kuptim verifikimi i 5% të nënshkrimeve sipas nenit 71 të Kodit Zgjedhor, konsiston vetëm në vendbanimin e zgjedhësve nënshkrues, ndërkohë që sipas rregullave të arsyes dhe të së drejtës objektive, falsifikimi i nënshkrimeve nuk barazohet me parregullsinë e nënshkrimit të listës nga një zgjedhës që nuk banon në zonën zgjedhore përkatëse.

Nëpërmjet ekspertimit grafik të nënshkrimeve rezulton se përfundimi mbi nënshkrimet e hedhura nga e njëjta dorë, është i kufizuar nga fakti se shumë prej nënshkrimeve nuk kanë elementë të mjaftueshëm identifikues, ndaj Kolegji Zgjedhor vlerëson dhe krijon bindjen se lista e nënshkrimeve mbështetëse është e manipuluar dhe nuk vërteton mbështetjen reale të kandidatit.

Fakti i evidentimit në listën e nënshkrimeve të paraqitura në KQZ, të 16 rasteve të nënshkrimit nga e njëjta dorë të më shumë se një nënshkrimi, e bën të papranueshme atë, dhe për më tepër të ndaluar ligjërisht dhënien e legjitimitetit për veprimet e kryera nga subjekti zgjedhor. Përderisa fakti i falsitetit të nënshkrimeve, në rastin konkret, është i pranishëm, do të ishte kompromentuese për qëllimin e vetë ligjit që nga numri i përgjithshëm i nënshkrimeve të zbritet numri i nënshkrimeve të vërtetuara si të falsifikuara, me synimin për të përligjur numrin e nënshkrimeve të mbetura, dhe, për rrjedhojë për të legjitimuar edhe veprimet e subjektit zgjedhor, i cili është përgjegjës për respektimin e standardeve demokratike të zgjedhjeve.

Rregullimi që i bën si Kodi Zgjedhor, ashtu edhe legjislacioni i çdo shteti demokratik procedurës së verifikimit të ligjshmërisë së nënshkrimeve të zgjedhësve konsiston në rritjen e përgjegjshmërisë së subjektit zgjedhor, i cili duhet të respektojë dhe garantojë në të gjitha aspektet rregullshmërinë e të gjithë këtij procesi. Është e vërtetë që neni 71 i Kodit Zgjedhor kërkon pikësëpari saktësinë e nënshkrimeve nga ana e vetë zgjedhësve, por përgjegjësia kryesore, në rastin konkret, është e subjektit zgjedhor, partisë politike, e cila duhet të marrë të gjitha masat e domosdoshme me synim garantimin e një procesi sa më ligjor, që nuk lejon kompromentimin e dokumentacionit nëpërmjet nënshkrimeve të falsifikuara. Një subjekt zgjedhor që lejon marrjen e nënshkrimeve të falsifikuara me qëllim regjistrimin e kandidatit, kryen dhunimin më të rëndë që mund t'i bëhet procesit zgjedhor, që në fillimin e tij. Ashtu siç arsyeton

Gjykata Kushtetuese në Vendimin nr. 32, datë 21.06.2010, kur i referohet mënyrës se si legjislacioni italian parashikon paraqitjen e listave të zgjedhësve, evidentohet qartësisht se verifikimi i ligjshmërisë së tyre bëhet vetëm për autenticitetin e nënshkrimit “të përfaqësuesit partiak (*qoftë ky presidenti, sekretari i partisë ose i grupit politik, ose një nga përfaqësuesit e tjerë sipas ligjit*) dhe jo ajo e zgjedhësve.”. Është partia politike, si një subjekt i përgjegjshëm zgjedhor që nuk duhet të lejojë paraqitjen nga përfaqësuesit e saj të dokumenteve të falsifikuara. Evidentimi i dokumenteve të tilla, që në asnjë rast nuk mund të njehsohet me parregullsinë e procesit, por vetëm me shkeljen e rëndë të tij, në të njëjtën kohë, nuk shmang as penalizimin e subjektit zgjedhor.

Për sa më sipër ky Kolegj Zgjedhor konkludon se vendimi i KQZ me Nr. 559, datë 22.05.2015, është i drejtë dhe i bazuar në ligj, për pasojë bazuar në nenet 67 e vijues si dhe 158/3 të Kodit Zgjedhor, padia e Partisë Socialdemokrate e Shqipërisë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, bazuar në nenin 158/3 të Kodit Zgjedhor.

V E N D O S I

-Rrëzimin e padisë së palës paditëse Partia Socialdemokrate e Shqipërisë.

U shpall në Tiranë sot më d.29.05.2015.

ANËTAR
Valbon ÇEKREZI

ANËTAR
Andi CIVICI

ANËTARE
Gjinovefa GABA

ANËTARE
Edlira PETRI

KRYESUES
Kliton SPAHIU

* * *



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR

NR. 15 REGJ. THEMELTAR
Date 26.05.2015

Nr. 15, i Vendimit
Date 29.05.2015

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUES :	VALBON ÇEKREZI
ANËTAR :	ILIR TOSKA
ANËTAR :	KLITON SPAHIU
ANËTAR :	ANDI CIVICI
ANËTAR :	PETRIT ÇENO

me sekretare **Rexhina Baci**, në Tiranë, sot në date **29.05.2015**, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore me nr.15 Akti, që u përket palëve:

PADITËSE: **Partia Socialiste e Shqipërisë**,
përfaqësuar me autorizimin datë 29.05.2015 nga
Koli Bele.

I PADITUR: **Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve**,
përfaqësuar me autorizim nga Dëshira Pasko dhe
Olsi PETO.

PALË E INTERESUAR:**Partia Socialdemokratike e Shqipërisë**,
përfaqësuar nga kryetari i saj z.Skënder Gjinushi.

OBJEKTI: Kundërshtim i vendimit nr.523, datë 21.05.2015 të
K.Q.Z.-së.

Gjykimin e cështjes në themel duke vendosur ndryshimin e vendimit të K. Q.Z.-së dhe lënien në fuqi të vendimit të KZAZ-së Nr.74, Qarku Gjirokastër.

BAZA LIGJORE: Nenet 68/2, 73, 145 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoji palët prezent në pretendimet e tyre, paditësin nëpërmjet përfaqësuesit të tij që në perfundim kërkoi pranimin e padisë sipas objektit, përfaqësuesin e pales së paditur, që kërkoi rrëzimin e padisë, pasi administroi provat e bisedoi çështjen në tërësi;

VËREN

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ) me Vendimin Nr.89, datë 08.04.2015, bazuar në nenin 64 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar), ka vendosur “ Të regjistrojë Partinë, “Partia Socialiste e Shqipërisë”, me kryetar z. Edi RAMA, dhe shkronja nistore “P.S”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015”.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ) me Vendimin Nr.103, datë 09.04.2015, bazuar në nenin 64 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar), ka vendosur “Të regjistrojë Partinë “Partia Socialdemokrate e Shqipërisë”, me kryetar Z. Skënder Gjinushi, dhe shkronjat nistore “PSD”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015”.

Me Vendimin Nr.88 të datës 07.04.2015, bazuar në nenet 23/1/a, 71/1 dhe 72/1 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar), KQZ ka miratuar modelet e dokumentacionit të kandidimit që do të përdoren në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 Qershor 2015, ndër të cilat edhe Modelin 02 K, “Kërkesë për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie”.

Partia Socialdemokrate (referuar më poshtë më shkronjat e saj nistore PSD), ka paraqitur më datë 30.04.2015 përpara Komisionit

të Zonës së Administrimit Zgjedhor Nr.74, Qarku Gjirokastrë (më poshtë referuar si KZAZ Nr.74, Qarku Gjirokastrë), bazuar në nenin 67 të këtij Kodi Zgjedhor të ndryshuar, kërkesën për regjistrimin e Z.Gëzim Ibrahimit si kandidat për kryetar të Bashkisë Përmet për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 21 Qershor 2015 (në rastin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015 afati i paraqitjes së kërkesave është llogaritur deri më datë 4 maj 2015).

Në referim të nenit 72 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar së bashku me kërkesën është paraqitur dhe dokumentacioni i kandidimit; Modeli 02K (Kërkesë e PSD për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie), Model 05K (Deklaratë e kandidatit për Kryetar Bashkia Përmet), vërtetim nr.410 Prot, datë 30.04.2015 nga Këshilli i Komunës Petran për zotërimin e një mandati për këshilltar të kësaj komune nga ana e subjektit zgjedhor PSD, çertifikatë personale dhe fotokopje të kartës së identitetit të kandidatit.

KZAZ nr.74 Qarku Gjirokastrë pasi ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur, bazuar në nenet 33/f dhe 73 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, duke e konsideruar të rregullt dhe në përmbushje të kërkesave të ligjit atë (kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur) ka marrë vendimin nr.03, datë 05.05.2015 “Për regjistrimin e z.Gëzim Ibrahimit si kandidat për kryetar bashkie, propozuar nga PSD”.

Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë (referuar më poshtë më shkronjat e saj nistore PS) duke mos qenë dakort me këtë vendimmarrje të KZAZ nr.74 Qarku Gjirokastrë, ka paraqitur më datë 08.05.2015, pranë KQZ-së, ankimin zgjedhor nëpërmjet të cilit ka kundërshtuar Vendimin nr.03, datë 05.05.2015 të KZAZ nr.74, si të marrë jo në zbatim të neneve 68, pika 2, 72, 73 të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimet nr.88, datë 07.04.2015 e nr.144, datë 14.04.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas të cilëve *“në rast se partia politike nuk zotëron mandat ... si kryetar bashkie në rast se kandidati kandidon për kryetar bashkie, ... sipas nenit 68/2 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, paraqet edhe listën e zgjedhësve që mbështesin kandidatin e propozuar nga partia politike”*, gjë që në rastin në fjalë nuk ka ndodhur.

KQZ pasi ka marrë në shqyrtim ankimin zgjedhor, në përfundim të procesit administrativ nëpërmjet vendimit nr.405, datë 14.05.2015 (vendim për të cilin nuk rezulton të jetë iniciuar ndonjë procedurë ankimimi) ka vendosur: “1. Konstatimin e pavlefshërisë absolute të Vendimit nr.03, datë 05.05.2015 të KZAZ nr.74, Qarku Gjirokastrë. 2. Kthimin e akteve për korrigjim në KZAZ nr.74, Qarku Gjirokastrë, e cila duhet të marrë vendim për miratimin e dokumentacionit përfundimtar brenda 48 orëve.”

Sipas KQZ-së, vendimi nr.03, datë 05.05.2015 i KZAZ-së nr.74, Qarku Gjirokastrë është marrë në kundërshtim flagrant me kërkesat e nenit 68, pika 2 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar duke qenë një vendim i nxjerrë në kundërshtim me procedurën e parashikuar nga Kodit Zgjedhor i ndryshuar pasi, në momentin e vendimmarrjes së KZAZ-së përkatëse nuk ishte dorëzuar lista e zgjedhësve që mbështetin kandidatin e propozuar nga partia politike duke qenë se, partia politike që mbështeste këtë kandidat, nuk zotëronte asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore. Më tej argumentohet në vendimin e KQZ-së, “Në kontekstin e rastit në shqyrtim, ky subjekt politik bie nën rregullimin e parashikuar nga neni 68 pika 2 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit “Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3 000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës”.

Gjatë hetimit administrativ të zhvilluar nga ana e KQZ-së në shqyrtimin e këtij ankimi zgjedhor, rezulton që të jetë paraqitur dhe administruar vërtetimi i datës 13.05.2015 lëshuar nga KZAZ Nr.74, sipas të cilit “Gëzim Ibrahim ka paraqitur listat e mbështetësve për zgjedhje pranë KZAZ Përmet në datën 06.05.2015.”.

Në vendimmarrjen e saj, KQZ duke e konsideruar si parregullsi të dokumentacionit referuar parashikimit të nenit 73 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, mungesën e listave me nënshkrimet e 1% të zgjedhësve të zonës zgjedhore, ka detyruar KZAZ nr.74 që duke konsideruar listën e nënshkrimeve të 1% të zgjedhësve të zonës zgjedhore mbështetëse për kandidatin e propozuar nga PSD

për kryetar të Bashkisë Përmet të paraqitur më datë 06.05.2015, të konkludonte në një vendimmarrje brenda 48 orëve për miratimin e dokumentacionit.

KZAZ nr.74, Qarku Gjirokastrë pasi ka marrë në shqyrtim çështjen e regjistrimit të kandidatit për kryetar të Bashkisë Përmet propozuar nga subjekti zgjedhor PSD, me vendimin nr.74, datë 19.05.2015 ka vendosur mosregjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Përmet të z.Gëzim Fadil Ibrahimimi duke u parashtruar si shkak; “Mungesa e listave të zgjedhësve brenda afateve kohore datë 04.05.2015, të cilat janë sjellë në datën 06.05.2015, pas vendimit të KZAZ për regjistrim”

Subjekti zgjedhor PSD, duke mos qenë dakort me këtë vendimmarrje të KZAZ nr.74 Qarku Gjirokastrë, ka paraqitur më datë 20.05.2015, pranë KQZ-së, ankimin zgjedhor nëpërmjet të cilit ka kundërshtuar Vendimin nr.74, datë 19.05.2015, duke e konsideruar një vendim në kundërshtim me ligjin dhe se, nga ana e subjektit zgjedhor ishin paraqitur si vërtetimi i pasjes së një mandati të këshilltarit në Këshillin e Komunës Petran, tashmë pjesë përbërëse e njësisë së re administrative Bashkia Përmet, dhe dokumentacionin e listës mbështetëse të 1% të zgjedhësve të zonës zgjedhore për kandidatin e propozuar, në përputhje me parashikimet e nenit 68/2 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar.

KQZ pasi ka marrë në shqyrtim ankimin zgjedhor, në përfundim të procesit administrativ nëpërmjet vendimit nr.523, datë 21.05.2015 ka vendosur:”1. Ndryshimin e vendimit të KZAZ-së Nr.74, “Për mosregjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie”, z. Gëzim Ibrahimimi. 2. Regjistrimin e kandidatit për kryetar, Bashkia Përmet, të propozuar nga Partia Social Demokrate, z. Gëzim Ibrahimimi, për Zgjedhjet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015.”

KQZ ka arritur në një vendim marrje të tillë me argumentin që “Referuar nenit 68,pika 2 të Kodit Zgjedhor, Vendimit të Kolegjit Zgjedhor nr.7, datë 15.05.2015, Partia Socialdemokrate, përjashtohet nga detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkia Përmet për sa kohë zotëron mandat në Këshillin e Komunës Petran, aktualisht njësi administrative përbërëse, e Bashkisë Përmet.”

Subjekti zgjedhor, PS nëpërmjet padisë së paraqitur më datë 26.05.2015 pranë Kolegjit Zgjedhor, ka kundërshtuar vendimin nr.523, datë 21.05.2015 duke pretenduar ; vendimi i KQZ është një vendim i marrë në kundërshtim me ligjin nenin 68, pika 2 e Kodit Zgjedhor të ndryshuar dhe në interpretim të gabuar të vendimit nr.7, datë 15.05.2015 të Kolegjit Zgjedhor; në të gjithë interpretimin e vendimit të Kolegjit Zgjedhor, bëhet fjalë për depozitim të listave të nënshkrimeve për mandate në këshillin e njësisë së qeverisjes vendore, ndërkohë që në rastin objekt shqyrtimi, nuk bëhet fjalë për kandidimin në këshillin e njësisë së qeverisjes vendore, por bëhet fjalë për kandidimin për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore; nuk duhet vlerësuar si i barabartë një mandat simbolik këshilltari komune apo bashkie, i cili të mundëson sigurisht të kandidosh për këshill bashkiak, me mandatin e kryetarit të bashkisë dhe të deputetit.

Përfaqësuesi i KQZ, kërkoi rrëzimin e padisë duke iu përmbajtur argumentimit në vendimin e ankimuar.

Përfaqësuesi i personit të interesuar PSD-së, konsideroi të drejtë vendimmarrjen e KQZ-së në referim të Vendimit të Kolegjit Zgjedhor nr.7, datë 15.05.2015. Mandej, përfaqësuesi i palës së interesuar u largua nga salla e gjyqimit dhe në një situatë të tillë kolegji vazhdoi shqyrtimin e çështjes në mungesë të palës së interesuar.

Kolegji Zgjedhor, pasi ia nënshtroi çështjen debatit gjyqësor, dëgjoi palët, administroi provat, në konsideratë të fakteve të rezultuara nga provat e marra në gjykim, arriti në përfundimin që padia e paraqitur nga PS rezulton e pabazuar në prova dhe në ligj dhe se, Vendimi i KQZ Nr.523, datë 21.05.2015 është marrë në vlerësim të drejtë të fakteve si dhe në zbatim të drejtë të ligjit, dhe për pasojë padia duhet rrëzuar.

Kolegji konstatoi fillimisht që, subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, legjitimohet në paraqitjen e ankimit/padisë ndaj vendimit Nr.405, datë 14.05.2015 të K.Q.Z-së në kuptim të nenit 145 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar) dhe se, ankimi/padia është paraqitur brenda afatit (pesë ditë) nga shpallja e vendimit të KQZ-

së) të parashikuar në nenin 152 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar).

Gjatë shqyrtimit të çështjes, Kolegji Zgjedhor administroi; praktikën dokumentare në lidhje me Vendimin Nr.405, date 07.05.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; praktikën dokumentare në lidhje me Vendimin Nr.523, date 21.05.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në nenin 68, pika 2 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar janë parashikuar rregulla për procesin e regjistrimit të kandidatëve për organet e qeverisjes vendore, duke u parashikuar shprehimisht që: *“2. Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast jo më shumë se 3,000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit, ose kur zotërojnë bashkërisht në këshillin përkatës një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit.”*

Pala paditëse pretendon që, në rastin objekt shqyrtimi, jemi në një situatë të ndryshme nga ajo që është shqyrtuar nga ky kolegji në vendimin e nr.7 datë 15.05.2015 dhe se, interpretimi i bërë në atë vendim për nenin 68/2 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar nuk ka vend të zbatohet për rastin objekt gjykimi pasi, rasti objekt shqyrtimi lidhet me kandidimin për kryetar të qeverisjes vendore, ndërkohë që rasti objekt shqyrtimi në atë vendim lidhet me kandidimin për anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

Në vendimin nr.7 datë 21.04.2015 Kolegji Zgjedhor është shprehur: *“...nëse mandatet aktuale në organet e qeverisjes vendore, do të cilësohen të vlefshme për të përjashtuar partinë që i posedon ato, nga detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse, ky rregull do të zbatohet për mandatet e organeve të të gjitha njësive vendore që përbëjnë bashkinë e re, për të cilën zhvillohen zgjedhjet, pa bërë diferencim mes tyre... interpretimi dhe zbatimi në praktikë i nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor nuk mund të rezultojë në një përkeqësim të situatës së subjekteve zgjedhore, që kanë mandate në organet*

aktuale të qeverisjes vendore, për sa kohë që ligjvënësi nuk e ka bërë një kufizim të tillë, qoftë edhe për zgjedhjet e qershorit 2015. Kriteret kufizuese të nenit 68 të Kodit Zgjedhor janë analizuar hollësisht nga Gjykata Kushtetuese, çka ka sjellë ndryshimet përkatëse të kësaj dispozite, në përputhje me parimet kushtetuese dhe standardet e gjithëpranuara për zgjedhjet. Si rrjedhojë, Kolegji Zgjedhor vlerëson se çdo interpretim që rrit masën e kufizimit lidhur me barazinë e votës, nuk është në përputhje me ligjin dhe shkakton cenim të së drejtës së subjekteve zgjedhorë që nuk detyrohen të mbledhin nënshkrime mbështetëse, për sa kohë që ky detyrim duhet të rezultojë i qartë nga vetë ligji dhe jo nga vlerësimi i zbatuesve të tij.”

Sic vërehet, Kolegji në interpretimin që i ka bërë nenit 68 pika 2 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, i është referuar duke analizuar rregullat “për organet e njësisë së qeverisjes vendore”, ashtu sic parashikon edhe dispozita e interpretuar dhe, sipas përcaktimit të nenit 109 të Kushtetutës, organe të qeverisjes vendore janë këshillat e njësisë së qeverisjes vendore (organi përfaqësues) dhe kryetari njësisë së qeverisjes vendore (organi ekzekutiv), ndërkohë nuk rezulton që Kodi Zgjedhor të bëjë një rregullim të vecantë/me vehte për secilin nga organet e qeverisjes vendore për cështjen e normuar në nenin 68, pika 2 të tij.

Referuar rrethanave të faktit të rezultuara në gjykim, ku mosmarrëveshja e shtruar për zgjidhje lidhet me kandidimin për njërin nga organet e qeverisjes vendore posacërisht për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore, interpretimi i bërë për efekt të zbatimit në praktikë të nenit 68/2 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar nga ky kolegji në vendimin nr.7 datë 15.05.2015 është i zbatueshëm edhe në rastin objekt gjykimi, sic me të drejtë ka referuar KQZ në vendimin e saj objekt ankimi.

Në analizë sa më sipër, subjekti zgjedhor PSD për shkak të posedimit të mandatit të një anëtari në Këshillin e Komunës Petran, aktualisht njësi administrative përbërëse, e Bashkisë Përmet, përjashtohet nga detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve në paraqitjen e kandidatëve për organet e njësisë së qeverisjes vendore (kryetar të njësisë së qeverisjes vendore ose anëtar të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore), dhe mbi këtë bazë, me të drejtë nga ana e KQZ duke i gjetur të rregullta dhe në përmbushje

të kërkesave të neneve 68/2, 72,73 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti zgjedhor PSD për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Përmet, me vendimin objekt ankimi ka vendosur; “Regjistrimin e kandidatit për kryetar, Bashkia Përmet, të propozuar nga Partia Social Demokrate, z. Gëzim Ibrahim, për Zgjedhjet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015.”

Nga ana tjetër, konstatohet sic dhe ka rezultuar gjatë hetimit administrativ të zhvilluar pranë KQZ-së nëpërmjet administrimit të vërtetimit datë 13.05.2015 të KZAZ-së Nr.74 Qarku Gjirokastrë që, subjekti zgjedhor PSD të ketë paraqitur edhe listën mbështetëse të 1% të zgjedhësve të zonës zgjedhore për kandidatin e propozuar për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore, Bashkia Përmet, dokumentacion për të cilin është kryer verifikimi nga ana e KZAZ-së Nr.74 sipas parashikimeve të nenit 71/3 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, duke i gjetur “konform Kodit Zgjedhor në fuqi”, cka do të thotë se nga ana e subjektit zgjedhor PSD rezulton të jetë përmbushur (ndonëse nuk ka qenë detyrues për këtë subjekt zgjedhor për shkak të posedimit të mandatit të anëtarit të këshillit në Komunës Petran) edhe rregulli i parashikuar në nenin 68/2 për paraqitjen e listës mbështetëse të jo më pak se 1% të zgjedhësve për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Përmet.

Në analizë sa më sipër, kolegji konstaton se vendimmarrja e KQZ-së për regjistrimin e kandidatit për kryetar, Bashkia Përmet, të propozuar nga Partia Social Demokrate, z. Gëzim Ibrahim, për Zgjedhjet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015 është në përputhje me parashikimet e neneve 68/2, 71/3,72, 73 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar.

Në përfundim, Kolegji Zgjedhor cmon se kërkesëpadia e paraqitur nga Partia Socialiste është e pabazuar në prova dhe ligj dhe si e tillë ajo duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykates se Apelit Tirane,
bazuar ne nenin 158/3 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar,

V E N D O S I

- Rrezimin e kërkesë padisë së palës paditëse Partia Socialiste e Shqipërisë

Tiranë, më 29.05.2015

ANËTAR ANËTAR KRYESUES
ANDI CIVICI PETRIT ÇENO VALBON ÇEKREZI

ANËTAR ANËTAR
ILIR TOSKA KLITON SPAHIU

* *
* *



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR

NR. 17 REGJ. THEMELTAR
Date 27.05.2015

Nr. 16, i Vendimit
Date 29.05.2015

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUES :	PETRIT ÇENO
ANETAR :	GJINOVEFA GABA
ANETAR :	EDLIRA PETRI
ANETAR :	ILIR TOSKA
ANETAR :	ANDI CIVICI

asistuar prej sekretares Zana Disha, në Tiranë, sot me datë 29.05.2015, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore, që u përket paleve:

PADITËSE : PARTIA DEMOKRISTIANE E SHQIPERISE,
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Altina Klathi
dhe Shaban Kaziu.

I PADITUR : KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Olsi Peto.

OBJEKTI : Kundershtimin e Vendimit Nr.511, date 21.05.2015, te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE : Nenet 73, 154 dhe 152 te Kodit Zgjedhor te Republikes se Shqiperise.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS APELIT TIRANË

Pasi degjoi perfaqesuesit e pales paditese, qe kerkuan pranimin e padise; degjoi perfaqesuesin e pales se paditur, qe kerkoi rrezimin e padise; si dhe pasi shqyrtoi ceshtjen ne teresi,

V E R E N

Me Dekretin Nr. 8844, datë 15.12.2014, ne mbështetje të neneve 92/gj dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 9§1§2 dhe 10§1§2 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (me poshte referuar si Kodi Zgjedhor i ndryshuar), Presidenti i Republikes se Shqiperise ka caktuar daten 21 qershor 2015 per zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Pranohet se pala paditese Partia Demokratike e Shqiperise (me poshte referuar si PDK), ne përputhje me nenin 64 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, eshte regjistruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (me poshte KQZ) si subjekt zgjedhor ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015. Po keshtu pranohet se pala paditese PDK, bashke me disa parti politike te regjistruara rregullisht si subjekte zgjedhore, bazuar ne nenin 65 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, jane regjistruar nga KQZ-ja si koalicion

zgjedhor ne shkalle vendi, nen emrin Aleanca per Shqiperine Europiane, per zgjedhjet e organeve te qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015.

Me tej, rezulton se, me date 01.05.2015, subjekti zgjedhor PDK, ne respektim te te drejtes se percaktuar ne nenin 165/2 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar dhe ne përputhje me kërkesat e nenit 67 te këtij Kodi, brenda afatit te percaktuar nga kjo dispozite (jo me vone se 50 dite para dates se zgjedhjeve), ka paraqitur përpara Komisionit te Zones se Administrimit Zgjedhor Nr. 20, Qarku Durres (me poshte referuar si KZAZ Nr. 20, Qarku Durres) nje kerkese per regjistrimin e listes shumemerore te kandidateve per anetar te Keshillit te Bashkise Kruje per zgjedhjet e organeve te qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015, duke i bashkëlidhur asaj dhe dokumentet e kandidimit sipas nenit 72 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar.

KZAZ Nr. 20, Qarku Durres, referuar afatit te percaktuar nga neni 73/1 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, jo me vone se 45 dite para dates se zgjedhjeve (qe ne zgjedhjet e organeve te qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015 korrespondon me daten 07.05.2015), ne kuader te verifikimit te rregullsise se dokumentacionit te kandidimit te depozituar nga subjekti zgjedhor PDK ne rastin konkret, nuk ia ka kthyer ate subjektit zgjedhor ne fjale per korrigjim, ashtu sikunder as nuk ka marre vendim per miratimin e tij, pra vendim per regjistrimin e listes shumemerore, sipas detyrimit te percaktuar ne nenin 33/f te Kodit Zgjedhor te ndryshuar. Nderkohe, ne datat 2, 3, 4 dhe 5 maj 2015, KZAZ Nr. 20, Qarku Durres, ka miratuar rregullisht listat shumemerore te paraqitura nga subjekte te tjera zgjedhore per kandidate per anetare te Keshillit Bashkise Kruje per zgjedhjet e organeve te qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015, te cilat, ne përputhje me nenin 73/5 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, i ka depozituar prane KQZ-se jo me vone se 24 ore nga miratimi i ketyre listave.

Me tej, megjithese afati si me lart ka kaluar, ashtu sikunder ka kaluar dhe afati teresor i procesit te regjistrimit te kandidateve (jo me vone se 40 dite para dates se zgjedhjeve, neni 73/1 i Kodit Zgjedhor te ndryshuar, qe ne zgjedhjet e organeve te qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015 korrespondon me daten 13.05.2015), nderkohe qe organi zgjedhor i ngarkuar nga ligji (KZAZ Nr. 20, Qarku Durres)

nuk ka permbushur detyren e tij (nuk ka shqyrtuar kerkesen dhe disponuar pozitivisht apo negativisht per te), subjekti zgjedhor PDK nuk rezulton te kete perdorur mjetet legale te njohura nga ligji (Kodi Zgjedhor i ndryshuar) per te realizuar te drejten e tij. Keshtu, subjekti zgjedhor PDK nuk ka kerkuar zgjidhjen e situates nga KQZ-ja, si organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, qe referuar nenit 21/26 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, ka dhe të drejtën për të kryer edhe detyra të tjera, që burojnë nga ky Kod ose nga ligje të tjera, kur ato nuk kryhen nga komisionet e niveleve më të ulëta. Konkretisht Kodi Zgjedhor, ne nenin 35/5 te tij ka parashikuar qe, edhe nepermjet ankimit nga subjekti zgjedhor, KQZ-ja merr vendim lidhur me kerkesen e subjektit per regjistrim, kur KZAZ-ja ka deshtuar te ushtroje kompetencen e saj lidhur me kete ceshtje. Ne rastin ne shqyrtim, KQZ-se nuk i eshte paraqitur asnje pretendim, lidhur me marrjen prej saj te vendimit per shqyrtimin dhe miratimin e kerkeses dhe dokumentacionit te kandidimit per listen e kandidateve per anetare te Keshillit te Bashkise Kruje, te paraqitur nga subjekti zgjedhor PDK.

Dhe ndersa procesi i regjistrimit te kandidateve ka përfunduar, KQZ-ja, bazuar ne nenin 98 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, si dhe Udhezimin e saj Nr. 3, date 04.03.2015, "Për procedurën e hedhjes së shortit për renditjen e subjekteve zgjedhore ne fletën e votimit", ka organizuar shortin dhe me Vendimin Nr. 483, date 16.05.2015, ka miratuar rezultatin e tij, duke përcaktuar numrin rendor që do të ketë cdo subjekt zgjedhor në fletën e votimit.

Ne vijim, ndersa situata e subjektit zgjedhor PDK ne lidhje me regjistrimin e listes shumemerore per kandidatet per anetare te Keshillit te Bashkise Kruje vijonte te ishte e njejte, KQZ-ja, bazuar ne nenet 97 dhe 98 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, me Vendimin Nr.511, date 21.05.2015, ka vendosur :

"Të miratojë përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Krujë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi".

Ne fleten e votimit për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Krujë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor

2015, te miratuar nepermjet ketij vendimi te KQZ-se, rezulton te jene pasqyruar rregullisht nje sere subjektesh zgjedhore, subjekte jashte koalicioneve zgjedhore, por dhe subjekte te koalicioneve zgjedhore, ndersa nuk eshte pasqyruar subjekti zgjedhor PDK.

Rezulton se KQZ-ja ne kete rast ka konsideruar se, brenda afatit te percaktuar ne nenin 67/1/2 te Kodit Zgjedhor, kanë depozituar kerkesat per regjistrim listash shumemërore per kandidatë per Këshillin e Bashkisë Krujë 12 parti të Koalicionit Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet dhe 26 parti të Koalicionit Aleanca Për Shqipërinë Europiane, si dhe parti që kandidojnë më vete, subjekte keto ne te cilat nuk përfshihej subjekti zgjedhor PDK, per kerkesen e te cilit, KZAZ Nr. 20, Qarku Durres nuk ishte shprehur ne afatin e percaktuar nga ligji, ashtu sikundër situata e ketij subjekti zgjedhor per regjistrimin e listes shumemërore te kandidatëve per këshill ne kete njesi te qeverisjes vendore nuk ishte kërkuar te zgjidhej dhe as ishte zgjidhur ne fakt, duke mos patur keshtu ligjërisht per kete subjekt nje vendim miratimi te listes shumemërore ne fjale.

Ndersa ka ardhur ne dijeni per Vendimin e KQZ-se Nr. 511, date 21.05.2015, subjekti zgjedhor PDK, me date 25.05.2015, nepermjet shërbimit postar, ka depozituar ne Kolegjin Zgjedhor nje ankim kunder ketij vendimi, me pretendimin se KQZ-ja padrejtësisht nuk kishte perfshire PDK ne fletën e votimit për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Krujë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, ne rrethanat kur ky subjekt zgjedhor, brenda afatit ligjor, kishte depozituar rregullisht listen shumemërore dhe dokumentet perkatese te kandidimit.

Pas kësaj, rezulton qe KZAZ Nr. 20, Qarku Durres, bazuar ne nenin 67 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, me Vendimin Nr.47, date 26.05.2015, ka vendosur ;

“Te regjistroje listen shumemërore per Keshillin e Bashkise Kruje, Qarku Durres, per zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015, te Partise Demokristiane, pjesetare e Koalicionit Aleanca per Shqiperine Europiane.

Mbi kete baze, pala paditese pretendoi se lista e saj shumemërore e kandidatëve per Keshillin e Bashkise Kruje, Qarku Durres, per

zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015, ishte tashme e regjistruar rregullisht, regjistrim ky i bere me vonese per faj te organit zgjedhor (KZAZ Nr. 20, Qarku Durres), por qe per te cilin nuk duhet te penalizohej ajo, prandaj Vendimi i KQZ-se Nr. 511, date 21.05.2015 duhet te anullohej dhe PDK te përfshihej ne fleten e votimit për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Krujë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015.

Perkunder pretendimeve te pales paditese, pala e paditur KQZ, prapësoi se vendimi i saj objekt gjykimi ishte marre ne përputhje me ligjin, ku mosperfshirja e subjektit zgjedhor PDK ne fleten e votimit për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Krujë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, kishte ardhur per shkak te mungeses se nje vendimi regjistrimi te listes shumemerore te kandidateve te këtij subjekti te marre ne afatin e percaktuar nga ligji. Ne vijim, sipas pales se paditur, procesi zgjedhor, faza e përgatitjes se zgjedhjeve, kishte vijuar me tej, ku mbi bazen e vendimit objekt gjykimi, ishin ne proces prodhimi fletet e votimit për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Krujë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015.

Kolegji Zgjedhor, mbasi administroi si prove praktiken dokumentare te vendimit objekt gjykimi, sikundër dhe aktet shkresore te paraqitura nga pala paditese (procesverbal i dorëzimi te dokumenteve te kandidimit date 01.05.2015 dhe Vendimin Nr.47, date 26.05.2015, te KZAZ Nr.20, Qarku Durres), vlerëson se padia e paraqitur ne rastin konkret nga subjekti zgjedhor PDK eshte e pabazuar ne ligj, prandaj duhet te rrezohet.

Konkretisht, nga sa rezulton dhe nuk kontestohet, eshte fakt se ne afatin e percaktuar nga ligji (Kodi Zgjedhor i ndryshuar), nuk ka patur nje vendim te organit zgjedhor te ngarkuar nga ligji (KZAZ Nr. 20, Qarku Durres) per regjistrimin e listes shumemerore te kandidateve për Këshillin e Bashkisë Krujë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, te subjektit zgjedhor PDK. Po keshtu, eshte fakt se nje vendim te tille nuk ka patur as ne momentin kur KQZ-ja ka marre vendimin objekt gjykimi, per miratimin e fletes se votimit për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Krujë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor

2015. Per rrjedhoje, vendimi objekt gjykimi i KQZ-se, per miratimin e fletes se votimit ne fjale, ku nuk përfshihet subjekti zgjedhor PDK, eshte nje vendim i marre ne respektim te ligjit, persa kohe KQZ-ja, ne përputhje me kërkesat e ligjit, ka perfshire ne fleten e votimit vetem ato subjekte zgjedhore qe ishin ligjërish ne gare per anetare te këshillit te kësaj njesie te qeverisjes vendore.

Fakti qe subjekti zgjedhor PDK ka paraqitur ne kohe kerkesen per regjistrim te listes shumemerore te kandidateve për Këshillin e Bashkisë Krujë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, nuk eshte i mjaftueshem per te konsideruar te paligjshem vendimin objekt gjykimi te KQZ-se, persa kohe ligji (Kodi Zgjedhor i ndryshuar), përfshirjen e nje subjekti zgjedhor ne fleten e votimit e lidh domosdoshmerisht me miratimin perkates te kësaj liste nga organi zgjedhor i ngarkuar prej tij.

Po keshtu, edhe fakti i mostrajtimit ne kohe nga organi zgjedhor i ngarkuar nga ligji te kerkeses se pales paditese per regjistrimin e listes shumemerore te kandidateve për Këshillin e Bashkisë Krujë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, nuk eshte i mjaftueshem per te konsideruar te paligjshem vendimin objekt gjykimi te KQZ-se, persa kohe, ndersa eshte evidente moskryerja ne kohe e detyres nga organi publik ne kete rast, e tille eshte edhe neglizhenca e subjektit zgjedhor PDK per përdorimin e mjeteve legale te njohura nga ligji per realizimin e te drejtave te saj, neglizhenca keto qe kane cuar ne mospasjen e nje vendimi miratimi te listes shumemerore te kandidateve te këtij subjekti zgjedhor per këshillin e kësaj njesie te qeverisjes vendore, vendim ky i domosdoshem per përfshirjen e këtij subjekti ne fleten perkatese te votimit te miratuar me vendimin objekt gjykimi.

Gjithashtu, edhe fakti se tashme, 5 dite pas marrjes se vendimit objekt gjykimi te KQZ-se, organi zgjedhor i ngarkuar nga ligji per regjistrim kandidatesh ka miratuar listen shumemerore te kandidateve për Këshillin e Bashkisë Krujë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, te subjektit zgjedhor PDK, nuk mund te sherbeje per te cilësuar te paligjshem vendimin e KQZ-se, përkundrazi tregon bazueshmerine e këtij vendimi te KQZ-se ne momentin e marrjes se tij. Nga ana tjetër, vendimi ne fjale i organit zgjedhor (Vendimi Nr.47, date 26.05.2015, i KZAZ Nr.20,

Qarku Durres), persa kohe eshte marre pertej afatit ligjor gjate te cilit ligji i ka dhene atij pushtetin te marre vendime per regjistrim te kandidateve, si dhe persa kohe faza parazgjedhore ka evoluar me tej ne kuadër te përgatitjes se zgjedhjeve, eshte nje vendim nul, qe nuk mund te prodhoje pasoja te ligjshme dhe, aq me pak, te zhbeje pasojat e ligjshme te krijuara nga akte te marra nga organi publik ne përputhje me ligjin dhe sipas afateve te përcaktuara nga ai.

Sa me siper, Kolegji Zgjedhor konkludon se kerkesepadia e pales paditese Partia Demokristiane e Shqiperise duhet te rrezohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykates se Apelit Tirane,
bazuar ne nenin 158, pika 3, te Kodit Zgjedhor te ndryshuar,

V E N D O S I

Rrezimin e kerkesepadise se pales paditese Partia Demokristiane e Shqiperise.

Tiranë, më 29.05.2015

ANËTAR
GJINOVEFA GABA

ANËTAR
EDLIRA PETRI

KRYESUES
PETRIT ÇENO

ANËTAR
ILIR TOSKA

ANËTAR
ANDI CIVICI

* * *



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR**

NR. 16 REGJ. THEMELTAR
Date 27.05.2015

Nr. 17, i Vendimit
Date 29.05.2015

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUES : Edlira PETRI
ANËTAR : Andi CIVICI
ANËTAR : Ilir TOSKA
ANËTAR : Kliton SPAHIU
ANËTAR : Petrit ÇENO

asistuar nga sekretarja gjyqësore Zana Disha, mori në shqyrtim, në seancën gjyqësore me dyer të hapura të datës 29.05.2015, çështjen zgjedhore, që u përket palëve :

PADITËSE : **Partia Socialiste e Shqipërisë**, e përfaqësuar nga Z. Koli Bele.

I PADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, i përfaqësuar me autorizim nga Z. Olsi Peto.

PALË E INETERESUAR : **Partia Socialdemokrate e Shqipërisë**, në mungesë.

OBJEKTI : Shfuqizimi i vendimit nr. 560, datë 22.05.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 12 “Për regjistrimin e z. Ardian Hysa si kandidat për Kryetar Bashkie Malësi e Madhe,

Qarku Shkodër, propozuar nga partia Socialdemokrate; Gjykimi i çështjes në themel duke vendosur ndryshimin e vendimit të KZAZ nr. 01 dhe çregjistrimin e z. Ardian Hysa si kandidat për kryetar Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër, propozuar nga partia Socialdemokrate.

BAZA LIGJORE : Nenet 67, 68.2, 72, 73, 145, 152, 153, 155, 156, 158, 160 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar.

Në përfundim të gjykimit, palët pjesëmarrëse i kërkuan Kolegjit Zgjedhor:

Pala paditëse Partia Socialiste e Shqipërisë, nëpërmjet përfaqësuesit të saj Z. Koli Bele: pranimin e padisë;

Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesit të tij Z. Olsi Peto: Rrëzimin e padisë;

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoi pjesëmarrësit, shqyrtoi aktet dhe diskutoi çështjen në tërësi

V Ë R E N

Pala paditëse, subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë (më tej, referuar si PS) ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ankimin administrativ nr. 12, ndaj vendimit nr. 6, datë 08.05.2015 të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (më tej, referuar si KZAZ) nr. 01.

Referuar objektit të ankimit, rezulton se mosmarrëveshja zgjedhore ka si shkak të saj faktet e mëposhtme:

Me vendimin nr. 6, datë 08.05.2015, KZAZ nr. 01, Qarku Shkodër ka vendosur:

- Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, të regjistrojë si kandidat për kryetar në

Bashkinë Malësi e Madhe, z. Ardian Qamil Hysa, paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate.

Subjekti zgjedhor PS, nëpërmjet ankimit administrativ kundër vendimit të mësipërm, ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe çregjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe, z. Ardian Hysa, duke pretenduar që kandidimi i paraqitur nga Partia Socialdemokrate (më tej, referuar si PSD) është mbështetur nga lista me nënshkrimet e 493 zgjedhësve, dokumentacion i cili përmban të meta thelbësore që cenojnë rëndë frymën e Kodit Zgjedhor dhe bien në kundërshtim të hapur me parashikimet e neneve 68.2, 71, 72.d të këtij Kodi dhe konkretisht:

- gjatë procedurës së mbledhjes së nënshkrimeve është falsifikuar nënshkrimi i një pjese të zgjedhësve në listën mbështetëse, çka rezulton edhe nga deklaratat personale noteriale të njëzet shtetasve, që deklarojnë se nuk kanë nënshkruar në formular;
- konstatohet me sy të lirë, fakt i evidentuar edhe nga relacioni i tre anëtarëve të KZAZ nr. 01, se në listën mbështetëse një pjesë e madhe e nënshkrimeve janë falsifikuar, për çka do kryhej edhe një ekspertim grafik;
- është deformuar vullneti i zgjedhësve, pasi mbështetja për z. Ardian Hysa është ofruar për kandidimin e tij për Këshillin e Bashkisë dhe jo për Kryetar të saj.

Referuar sa më sipër, subjekti zgjedhor ankues PS, ka parashtruar se procesi i mbledhjes së nënshkrimeve jo vetëm që nuk ka qenë i ligjshëm, por është mbështetur në falsifikimin e nënshkrimeve dhe deformimin e vullnetit të mbështetësve nëpërmjet mashtrimit, duke theksuar edhe se falsifikimi përbën jo vetëm një shkelje të rëndë sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor, por edhe vepër penale. Sipas ankimit të PS, një kandidat, i cili që në krye të herës e mbështet kandidimin e tij në falsifikim, nuk gëzon integritetin e duhur moral e personal, për të qenë pjesë e një gare, në fund të së cilës fituesi përfaqëson administratorin lokal të të gjithë zonës zgjedhore. Si përfundim, ankuesi ka pretenduar se lista mbështetëse e zgjedhësve për kandidatin z. Ardian Hysa, si një dokument unik kandidimi, duhet konsideruar dokument i falsifikuar dhe si i tillë duhet cilësuar si absolutisht i pavlefshëm.

Gjatë shqyrtimit administrativ të ankimit të subjektit zgjedhor PS, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (më tej, referuar si KQZ), është vendosur pjesëmarrja në proces si palë të interesuara, të subjekteve zgjedhore Partia Demokratike e Shqipërisë, Partia Socialdemokrate dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

Rezulton se në funksion të të provuarit të fakteve, mbi të cilat është bazuar pretendimi i ankuesit, janë marrë në shqyrtim nga KQZ-ja këto prova:

1. Deklaratat noteriale të njëzet shtetasve që rezultojnë si mbështetës në listën e paraqitur në dokumentacionin e kandidimit nga subjekti zgjedhor PSD, nga përmbajtja e të cilave, rezulton se gjashtë zgjedhës deklarojnë se nuk kanë nënshkruar për të mbështetur kandidatin Ardian Hysa për Kryetar Bashkie, kurse katërmbëdhjetë të tjerë deklarojnë se nuk kanë nënshkruar asnjë formular në mbështetje të këtij kandidati;
2. Relacioni i përpiluar nga katër anëtarët e KZAZ nr. 01, që janë në shumicë dhe mbi bazën e votës së tyre është marrë vendimi objekt ankimi. Sipas këtij akti, në mbrojtje të vendimit të marrë, sqarohet se pas verifikimit të 5% të nënshkrimeve, ka rezultuar se të gjithë ata, janë banorë të Bashkisë Malësi e Madhe. Kandidati ka mbledhur edhe 80 nënshkrime më shumë se numri i nevojshëm i tyre. Tre anëtarët e tjerë të KZAZ (dy përfaqësues të PS dhe një i LSI) kanë refuzuar të marrin pjesë në mbledhje, me qëllim që kandidati të mos regjistrohej dhe sipas informacioneve që ishin marrë, nënshkruesve u është bërë presion. Anëtarët e KZAZ-së të propozuar nga PS dhe LSI, kanë kërkuar tejkalimin e kompetencave të dhëna nga Kodi Zgjedhor, lidhur me përfundimin se lista mbështetëse ishte e falsifikuar, proces i cili mund të kryhet nga prokuroria;
3. Relacioni i anëtarëve në pakicë të KZAZ nr. 01, sipas të cilëve është konstatuar së pari se, në të gjithë listën mungon nënshkrimi (referuar për këtë ligjit “Për noterinë”, që konsideron “nënshkrim”, shkrimin me dorë të emrit dhe mbiemrit) dhe se në vend të nënshkrimit konstatohen disa shkarravina. Numri i emrave në listë, për të cilat mungon

nënshkrimi është më i madh se 5% e listës, ndaj sipas nenit 71 të Kodit Zgjedhor ajo është e pavlefshme. Më tej, anëtarët në pakicë parashtrajnë rastet kur konstatohet se nënshkrimet janë identike e të përsëritura, si dhe pothuaj në të gjitha rastet fotokopja e kartës së identitetit, është e shoqëruar me një shkarravinë, që është e ndryshme nga nënshkrimi që vetë personi ka, në mjetin e identifikimit. Po ashtu, evidentohet fakti se në një pjesë të emrave të listës (mbi 100 raste), mungon numri i kontaktit për çka është i pamundur verifikimi i vërtetësisë së të dhënave dhe në raste të tjera rezultojnë një numër kontakti për më shumë se një zgjedhës (49 numra kontakti për 152 zgjedhës);

4. Ekspertimi grafik i kryer mbi kërkesën e ankuesit, subjektit zgjedhor PS, me numër akti 193, datë 13.05.2015, nëpërmjet të cilit i është dhënë përgjigje pyetjes, nëse në listën mbështetëse të kandidatit për Kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe, ka nënshkrime/firma të hedhura nga e njëjta dorë. Konkluzioni i këtij ekspertimi pohon ekzistencën e nënshkrimeve/firmave të njëjta (të hedhura nga e njëjta dorë), duke evidentuar të gjitha rastet e nënshkrimeve të njëjta, që në total janë 73 të tilla.

Nisur nga paraqitja e ekspertimit grafik dhe konkluzioni i tij, gjatë shqyrtimit administrativ, KQZ ka vendosur kryerjen e një ekspertimi grafik të nënshkrimeve për të përcaktuar nëse kishte nënshkrime të hedhura nga e njëjta dorë, e mbi këtë bazë është kryer dhe administruar ekspertimi me numër akti 4772, datë 19.05.2015.

Nga ekspertimi i kryer si më sipër, rezultojnë gjetjet e mëposhtme :

“a) Në tërësinë e tyre, objekte të drejtpërdrejta të ekspertimit, janë 495 nënshkrime (emër, mbiemër, firmë apo/dhe vetëm firma), të ndodhura nën kolonat e emërtuara “Nënshkrimi”, ku në më të shumtën e rasteve, nënshkrimet paraqiten në formën e shkrimeve *firmës*;

b) Nga ekzaminimet e kryera tërësisë së nënshkrimeve (firmave) objekte të drejtpërdrejta ekspertimi, konstatohet se shumë prej tyre paraqiten :

- në disa raste si një kompleks vijash të ndërthurura që nuk paraqesin karakteristika të mjaftueshme me vlera krahasuese.
 - në disa raste me ndërtim grafik tepër të thjeshtë, me elementë të pakët grafikë, pa shprehur karakteristika të mjaftueshme me vlera krahasuese;
 - në disa raste të ndërthurura me elementë grafikë shkronjash, të plotësimeve kufitare më poshtë apo më sipër tyre.
- c) Tërësia e evidentimeve sa më sipër, në kushtet e paraqitjes së këtyre nënshkrimeve objekt ekspertimi pa karakteristika të mjaftueshme me vlera krahasuese, nuk mundëson krijimin e një pamje të qartë të stereotipit dinakim të dorëshkruesve respektivë.”

Në kushtet e mësipërme, ekzaminimi është kryer midis nënshkrimeve që paraqisnin karakteristika shkrimore me vlera të mjaftueshme krahasuese, duke u arritur në përfundimin se *59 nënshkrime (të grupuara sipas rasteve konkrete kur ato janë shkruar nga e njëjta dorë), janë të përsëritura, pra nuk u përkasin 59 zgjedhësve të ndryshëm.*

Gjatë shqyrtimit administrativ të ankimit të paraqitur nga PS, kundrejt pretendimeve të kësaj të fundit, pala e interesuar PSD, ka prapësuar se:

- Ankuesi (PS) nuk legjitimohet të kundërshtojë vendimin për regjistrimin e kandidatit për Kryetar të Bashkisë Malësia e Madhe, të paraqitur nga PSD, për shkak të mungesës së interesit të ligjshëm të tij, të cenuar. Ankimi në kuptimin material paraqitet si e drejta për të kërkuar me anë të KQZ-së, realizimin e një kërkimi që buron nga një e drejtë subjektive, që kërkohet të rivendoset apo mbrohet, kundrejt subjektit që e cenon atë. Kërkimi për kundërshtimin e një vendimi të KZAZ-së, pa treguar të drejtën dhe gjendjen e faktit që i është kundërvënë kësaj të drejte, është një padi (ankim) që në kuptimin material nuk ekziston.
- Për sa u përket pretendimeve për parregullsi në mbledhjen e nënshkrimeve të listës mbështetëse, ato janë alogjike dhe dukshëm të pabazuara në ligj. Nuk mund të çorientohet apo gënjehet një zgjedhës dhe të deformohet vullneti i tij për të nënshkruar, në mbështetjen e një kandidati të ndryshëm, nga ai që dëshiron, ashtu siç pretendon ankuesi. Mjafton ti

referohesh nenit 71 të Kodit Zgjedhor lidhur me procedurën e mbledhjes së nënshkrimeve, për të treguar se mashtrimi i zgjedhësve është i pamundur, pasi përveç nënshkrimit, kërkohet edhe paraqitja e një sërë të dhënash e dokumente identifikimi, që e bëjnë procesin relativisht të gjatë e plotësisht të mjaftueshëm për të kuptuar veprimet e kryera. Vendimi i KZAZ nr. 01, është marrë në përputhje të plotë me ligjin, i cili ka përcaktuar si subjekte për verifikimin e nënshkrimeve mbështetëse, KZAZ-të dhe KQZ-në, e jo subjektet zgjedhore. Në rastin konkret, KZAZ ka verifikuar nënshkrimet dhe nuk ka gjetur asnjë nga parregullsitë e pretenduara nga ankuesi, i cili ka shkelur ligjin në kryerjen e veprimeve të ndërrmarra prej tij, siç është edhe ekspertimi, një akt i pavlefshëm në kuptimin procedural. Ky ekspertim është kryer vetëm mbi bazën e këqyrjes së nënshkrimeve të listës mbështetëse, pa u krahasuar ato me modele të lira të nënshkrimit të zgjedhësve nënshkrues.

Bazuar në sa më sipër, subjekti zgjedhor PSD ka kërkuar të mos pranohet ankimi i paraqitur nga PS.

Rezulton se seanca e shqyrtimit administrativ të ankimit e datës 14.05.2015, është shtyrë, pasi KQZ, me vendim të ndërrmjetëm të saj ka vendosur kryerjen e ekspertimit grafik të nënshkrimeve mbështetëse të zgjedhësve (i përmendur më sipër) dhe në këto kushte, shqyrtimi i mosmarrëveshjes ka vijuar në mbledhjen e datës 22.05.2015. Nga procesverbali i kësaj seance, rezulton se pala e interesuar PSD, krahas prapësimeve të treguara më lart, ka kërkuar të paraqesë si provë edhe një vërtetim të Këshillit të Bashkisë Kopluk i cili mban datën 29.04.2015 dhe në përmbajtje pasqyron faktin se PSD përfaqësohet në Këshillin Bashkiak me një anëtar. Sipas përfaqësueses së PSD-së pjesëmarrëse në seancë, ky vërtetim është paraqitur edhe në KZAZ, por se kjo e fundit nuk ka pranuar ta administrojë në dokumentacionin e kandidimit. Po nga procesverbali i seancës, rezulton se ky vërtetim nuk ka qenë pjesë e dokumentacionit të paraqitur në KQZ, nga KZAZ nr. 01, fakt i cili nuk kundërshtohet as nga përfaqësuesja e PSD-së. Kjo e fundit ka pretenduar se vërtetimi është dorëzuar në KZAZ, por ky komision nuk e ka administruar pasi e konsideronte të panevojshëm, referuar edhe qëndrimit të mëparshëm të vetë KQZ-së lidhur me këtë çështje.

Rezulton se vërtetimi i Këshillit të Bashkisë Koplík është marrë si provë gjatë shqyrtimit administrativ të ankimit.

Referuar debatit për provat e marra e të shqyrtuara, përfaqësuesja e PSD-së, ka kërkuar që ekspertimi grafik i kryer, të mos vlerësohej dhe konkluzioni i tij të mos merrej parasysh, pasi ai nuk është kryer i plotë dhe se KQZ-ja kish detyrimin të verifikonte parregullsitë dhe jo falsifikimin që përbën vepër penale dhe ndiqet nga prokuroria.

Përfaqësuesi i ankuesit ka mbajtur të njëjtin qëndrim të parashtruar në ankimin objekt shqyrtimi.

Përfaqësuesi i subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë ka vënë në dukje mungesën e një akti të miratuar nga KQZ, që do të disiplinonte procedurën e verifikimit të nënshkrimeve, çka ka sjellë edhe mosmarrëveshjet si ajo në shqyrtim. Lidhur me mashtrimin zgjedhor të pretenduar, është parashtruar qëndrimi se çështjet që lidhen me falsifikimin gjatë procesit zgjedhor, duhet të dërgohen në prokurori, e cila është organi kompetent që konkludon mbi këtë aspekt, kurse në aspektin e administrimit zgjedhor, nuk mund të priset vendimi i KZAZ-së mbi konkluzionin se është kryer një krim, ndaj duhet të vendoset mbi bazën e nënshkrimeve që mbeten, pasi të zbriten ato që janë gjetur të parregullta.

Debati është zhvilluar edhe mbi faktin e prezantuar para KQZ-së, lidhur me mandatin e PSD-së në Këshillin e Bashkisë Koplík, duke u parashtruar mendimi, se në këto rrethana, të mos shqyrtohen pretendimet mbi listën mbështetëse, por të lihet në fuqi vendimi i KZAZ-së për regjistrimin e kandidatit për Kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe, për shkak të gëzimit prej subjektit të këtij mandati. Ky opinion është bazuar edhe në vendimin e Kolegjit Zgjedhor nr. 7, datë 15.05.2015, që ka zgjidhur mosmarrëveshjen zgjedhore lidhur me të drejtën e kandidimit të PSD-së, pa nënshkrime mbështetëse për Këshillin e Bashkisë Durrës.

Kundër këtij opinion, rezulton të jetë parashtruar mendimi i kundërt sipas të cilit, paraqitja e vërtetimit nga Këshilli i Bashkisë Koplík, është kryer tej çdo afati të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor për depozitimin e dokumenteve të kandidimit. Në vijim të këtij qëndrimi, është kërkuar që çështja të shqyrtohet për sa është kërkuar në ankim, lidhur me

ligjshmërinë e regjistrimit të kandidatit dhe jo mbi hipotezat e asaj që duhej të ish vendosur prej KZAZ-së, nëse vërtetimi do të ishte paraqitur për efekt të kandidimit.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, me vendimin nr. 560, datë 22.05.2015 të KQZ-së, është vendosur lënia në fuqi e vendimit të KZAZ nr. 01 “Për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie, z. Ardian Hysa, Bashkia Malësi e Madhe, propozuar nga PSD” dhe rrëzimi i kërkesës ankimore. Nga përmbajtja e këtij vendimi, rezulton se KQZ-ja me shumicë votash, ka vlerësuar se:

- Referuar nenit 73 të Kodit, vendimi i KZAZ-së është në përputhje me ligjin, pasi ka verifikuar dokumentacionin e kandidimit dhe listën mbështetëse;
- Sipas vendimit nr. 7, datë 15.05.2015 të Kolegjit Zgjedhor, i cili ka bërë interpretimin përfundimtar të nenit 68, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si dhe referuar vërtetimit datë 29.04.2015 të Këshillit të Bashkisë Koplík për gëzimin e një mandati këshilltari nga PSD, ky subjekt plotëson kushtin për ta përjashtuar atë nga detyrimi për të paraqitur lista mbështetëse, në rrethanat edhe kur ky vërtetim është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në nenin 67, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Mbi këto argumente, KQZ-ja ka arritur në përfundimin se ankimi i paraqitur është i pambështetur në ligj dhe në prova.

Siç u parashtrua më sipër, mosmarrëveshja është paraqitur në Kolegjin Zgjedhor me ankim të palës paditëse, Partia Socialiste e Shqipërisë, e cila ka kundërshtuar vendimin e KQZ-së, duke parashtruar krahas pretendimeve të ankimit administrativ edhe kundërshtimin lidhur me paraqitjen jashtë afateve ligjore të një vërtetimi për mandat në Këshillin e Bashkisë Koplík gjatë shqyrtimit administrativ të ankimit, ndërkohë që vetë subjekti zgjedhor kish kërkuar të kandidojë mbi bazën e listës mbështetëse (referuar dokumenteve të kandidimit dhe procesverbalit të marrjes në dorëzim). Në këto rrethana, pala paditëse ka kërkuar që dokumenti i paraqitur dhe i administruar nga KQZ-ja tej afateve ligjore, nuk duhej të merrej në konsideratë në lidhje me procesin e regjistrimit të kandidatit. Në gjykim, pasi u kërkuar dhe u administruar si provë

Vërtetimi nr. 268 prot., datë 29.04.2015 i Këshillit të Komunës Koplík, mbi bazën e të cilit KQZ ka njohur të drejtën e subjektit zgjedhor PSD, për të kandiduar për Kryetar të Bashkisë Malësia e Madhe, nga pala paditëse u paraqit edhe një pretendim mbi aspektin formal të dokumentit, që konsiston në mungesën e vulës së institucionit që e kish lëshuar atë (Këshilli i Bashkisë Koplík), duke e shtuar si argument për ta përjashtuar nga rrethi i provave, mbi bazën e të cilave duhej të zgjidhej mosmarrëveshja zgjedhore.

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, pasi dëgjoji palët pjesëmarrëse dhe administroi aktet që i përkasin shqyrtimit administrativ të mosmarrëveshjes, vuri në diskutim çështjet e mëposhtme:

- 1. Legjitimi i ankuesit Partia Socialiste e Shqipërisë për të paraqitur ankim administrativ dhe gjyqësor ndaj vendimit nr. 6, datë 08.05.2015 të KZAZ nr. 01 (lënë në fuqi me vendimin objekt kundërshtimit të KQZ-së).*

Subjekti i interesuar Partia Socialdemokrate ka parashtruar gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjes në KQZ, se pala paditëse nuk legjitimohet për të paraqitur ankim, pasi nuk ka treguar dhe as provuar interesin e saj të ligjshëm, për të kundërshtuar vendimin e KZAZ nr. 01 për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe, si dhe referuar rregullave të përgjithshme për ngritjen e padisë në procesin civil, ankuesit (PS) i mungon legjitimiteti për sa kohë ankimi nuk paraqitet për mbrojtjen e një të drejte subjektive që i është cenuar nga ndonjë fakt i paligjshëm.

Referuar neneve 124 dhe 145 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilave ankimi administrativ dhe ai gjyqësor në KQZ dhe në Kolegjin Zgjedhor, bëhet nga subjektet që kundërshtojnë vendimet, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, Kolegji shtroi për diskutim çështjen mbi legjitimitetin e Partisë Socialiste të Shqipërisë për të kundërshtuar vendimin e KZAZ nr. 01, si dhe atë të KQZ-së, lidhur me regjistrimin e kandidatit për Kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate.

Kolegji Zgjedhor, ashtu si edhe më herët në praktikën e tij, riktheson se partitë politike kanë në misionin e tyre, ndikimin në jetën e vendit,

nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimin e popullit, duke marrë pjesë në formimin e vullnetit të tij politik në të gjitha fushat e jetës publike dhe duke u konsideruar si pjesë e sistemit demokratik (Shih ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”). Në këtë kontekst, çdo parti politike e regjistruar si subjekt zgjedhor sipas rregullave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, mbart në vetvete interesin e saj për të gjitha çështjet, që lidhen me administrimin e zgjedhjeve ku ajo kandidon, qoftë në fazën parazgjedhore, ashtu edhe me votimin apo më tej, me fazën paszgjedhore. Kodi Zgjedhor që në nenin 1 ka sanksionuar se qëllimi dhe objekti i tij është caktimi i rregullave “për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet”. Nga referimi që i bëhet të gjithë dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe mënyrës se si administrohet procesi zgjedhor, rezulton se partia politike është një subjekt përcaktues në arritjen e qëllimit të përbashkët publik, atë të garantimit të zhvillimit të zgjedhjeve të përgjithshme, të lira, të barabarta e të ndershme. Të drejtat që kanë përfaqësuesit e partive politike (në kuadër të kompetencave që ushtron KQZ-ja), konsistojnë jo vetëm në prezencën e tyre gjatë zhvillimit të mbledhjeve, por edhe në shprehjen e opinioneve dhe diskutimin mbi çështjet që ajo shqyrton, në rastet kur partia politike subjekt zgjedhor vlerëson se ka interes për çështjen dhe kërkon të marrë pjesë në shqyrtimin e saj. Kodi Zgjedhor u jep gjithashtu përfaqësuesve të partive politike të drejtën për të parashtruar kërkesa dhe propozime pranë KQZ-së, duke i konsideruar, në këtë mënyrë, edhe si subjekte që marrin pjesë në mënyrë aktive në vendimarrjen e këtij organi.

Në referim edhe të qëndrimeve të mëparshme, Kolegji Zgjedhor e gjen të pabazuar pretendimin e Partisë Socialdemokrate në referencën e saj mbi legjitimitimin në Kodin e Procedurës Civile, duke dalluar mosmarrëveshjet civile që sipas këtij Kodi lindin mes subjekteve qartësisht të përcaktuara, mbi përkatësinë dhe mbrojtjen e një të drejte subjektive, nga mosmarrëveshjet zgjedhore që kanë impakt në gjithë jetën e vendit dhe përfshijnë të gjithë subjektet zgjedhore e në radhë të parë, partitë politike.

Duke pasur parasysh karakterin e përgjithshëm dhe publik të çështjeve që lidhen me zgjedhjet, ku e drejta për të vënë në lëvizje një procedurë të tillë kryhet për arsye të një interesi publik, qoftë dhe

pa pasur një interes konkret subjektiv, interesi i ligjshëm i partive politike përfshirë paditësin në rastin konkret, prezumohet, ndaj bazuar në nenet 124 dhe 145 të Kodit Zgjedhor, Kolegji vlerëson se pala paditëse legjitimohet të paraqesë ankim administrativ dhe gjyqësor ndaj vendimit të KZAZ nr. 01, si dhe vendimit të KQZ-së, objekt shqyrtimi.

2. *Kufijtë e shqyrtimit të çështjes lidhur me ankimin e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.*

Çështja me të cilën kërkohet zgjidhja e mosmarrëveshjes për rastin në shqyrtim është vënë në lëvizje me ankim të subjektit zgjedhor PS, me të cilin pretendohet paligjshmëria e vendimit nr. 6, datë 08.05.2015 të KZAZ nr. 1, që konsiston në regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie Malësi e Madhe, i mbështetur në një listë nënshkrimesh të zgjedhësve të marrë jo përputhje me procedurën e përcaktuar në ligj, por të falsifikuar.

Duke analizuar prapësimin e subjektit PSD gjatë shqyrtimit administrativ të çështjes, si dhe argumentin e KQZ-së në vendimin e saj, sipas të cilit regjistrimi i kandidatit për Kryetar të Bashkisë Koplík, me vendimin e ankimuar të KZAZ nr. 01, duhet të lihet në fuqi, pasi subjekti zgjedhor gëzon një mandat në Këshillin e Bashkisë Koplík, Kolegji Zgjedhor paraprakisht vlerëson të evidentojë efektet juridike që kanë vendimet e tij, që zgjidhin mosmarrëveshjet zgjedhore. Kjo sepse, KQZ në marrjen e vendimit të vet ka referuar në një vendim të mëparshëm të Kolegjit Zgjedhor, në të cilin ky i fundit interpreton nenin 68.2 të Kodit Zgjedhor, në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes objekt i atij shqyrtimi.

Rregullat që përcaktojnë kompetencat e gjykimit të Kolegjit Zgjedhor, në parim, nuk ndryshojnë nga ato të gjykatave që shqyrtojnë mosmarrëveshjet civile apo administrative. Në themel qëndron parimi se vendimi gjyqësor ka efekt vetëm mes palëve pjesëmarrëse në gjykim (*inter partes*) dhe vetëm për atë që ka qenë objekti konkret i mosmarrëveshjes. Nga ky rregullim bën përjashtim gjykimi kushtetues, në të cilin, çdo vendim i Gjykatës Kushtetuese, në kuptim të nenit 132 të Kushtetutës, ka efektin *erga omnes*, sepse është i detyrueshëm për të gjithë. Në veçanti, jo vetëm përmbajtja e dispozitivit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, por edhe arsyeimi i vendimit (*rationes decidentis*) formojnë pjesë të efekteve *erga omnes*.

Në këtë kuptim, vendimi nr. 7, datë 15.05.2015 i Kolegjit Zgjedhor, ndonëse ka arritur në përfundimin për pranimin e ankimit të subjektit zgjedhor Partia Socialdemokrate, përmes interpretimit konkret që i ka bërë dispozitës së nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor, ka zgjidhur mosmarrëveshjen, në funksion të pretendimit të paraqitur, dhe që konsiston në të drejtën e subjektit për të kandiduar në zgjedhjet për Këshillin e Bashkisë Durrës, pa qenë nevoja për të mbajtur qëndrim apo për të kryer interpretim mbi mënyrën e marrjes së nënshkrimeve nga zgjedhësit. Në atë rast, subjekti zgjedhor PSD ka orientuar mbrojtjen e vetë duke kërkuar të paraqesë listën e kandidateve për në Këshillin e Bashkisë, ndërkohë që nga KQZ i është kërkuar paraqitja e listës mbështetëse të zgjedhësve. Kolegji Zgjedhor, ka qenë i detyruar t'i japë përgjigje pretendimit të ngritur nga subjekti zgjedhor përpara KQZ-së për kryerjen e regjistrimit të listës së kandidatëve për në Këshillin e Bashkisë, pretendim i cili është rrëzuar nga KQZ-ja. Interpretimi që i ka bërë Kolegji Zgjedhor nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor, është kryer në funksion të qëndrimit refuzues të mbajtur nga KQZ-ja, si dhe të kërkesës së paraqitur nga subjekti zgjedhor për të regjistruar listën e kandidatëve për Këshillin Bashkiak, pa qenë nevoja për nënshkrimet mbështetëse. Në këtë mënyrë, Kolegji Zgjedhor, në kuptim të nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor, e ka vlerësuar të pabazuar vendimin e KQZ-së, i cili nga ana e tij e ka konsideruar të pamjaftueshëm, gëzimin e mandateve në Këshillat e Bashkive Sukth dhe Manëz, për të kandiduar. Ky ka qenë konkluzioni kryesor i vendimit nr. 7, datë 15.05.2015 të Kolegjit Zgjedhor, dhe që nuk lidhet me ndonjë interpretim të Kodit Zgjedhor mbi vlerësimin e procedurës së mbledhjes së nënshkrimeve mbështetëse, për efekt të regjistrimit të subjektit zgjedhor.

Në dallim nga rasti i sipërpërmendur, Kolegji Zgjedhor vlerëson se pretendimi kryesor dhe i vetëm i subjektit zgjedhor PSD, kur ka nisur procedura administrative pranë KZAZ-së nr 01. ka qenë i orientuar te paraqitja e kandidatit për Kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe, në procedurën e mbështetjes së kandidaturës, nëpërmjet depozitimit të nënshkrimeve nga zgjedhësit. Pra, PSD nuk ka kërkuar dhe as ka pretenduar përpara autoriteteve zgjedhore, të paraqesë kandidatin e saj për Kryetar të Bashkisë, duke paraqitur një dokument me të cilin të vërtetonte se gëzonte mandat në organet e qeverisjes vendore, siç kish bërë në rastin e kandidimit për Këshillin e Bashkisë Durrës. Rruga që ka zgjedhur ky subjekt zgjedhor për të realizuar mbrojtjen ligjore, ashtu si edhe pretendimi kryesor i parashtruar pranë KZAZ nr 01, me qëllim

regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie ka qenë i bazuar vetëm te mbështetja nga zgjedhësit nëpërmjet depozitimit të nënshkrimeve.

Nisur nga kërkesa e subjektit zgjedhor, materializuar në modularin e miratuar nga KQZ-ja, KZAZ nr. 01 ka marrë në shqyrtim kërkesën për regjistrimin e kandidatit të paraqitur nga subjekti zgjedhor PSD, së bashku me dokumentacionin e kandidimit i cili veç të tjerash përmbante edhe listën me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve. Ky fakt, i cili sanksionohet nga Kodi Zgjedhor, si për afatin e paraqitjes së kërkesës, ashtu edhe për përmbajtjen e saj, është thelbësor në procesin e regjistrimit të kandidatëve. Rezulton se në rastin në shqyrtim, KZAZ nr. 01 ka marrë në shqyrtim një kërkesë për regjistrimin e kandidatit për Kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe, i cili paraqitej nga një parti politike (PSD) dhe që legjitimitetin për regjistrim e ka bazuar te mbështetja nga zgjedhësit nëpërmjet depozitimit të nënshkrimeve, referuar nenit 68.2 të Kodit Zgjedhor. Vërtetohet nga aktet e administruara në këtë proces, se asnjë vërtetim për gëzimin e ndonjë mandati në organet e qeverisjes vendore, nuk është marrë dhe as nuk është shqyrtuar nga KZAZ nr. 01, lidhur me regjistrimin e kandidatit.

Në kushtet kur është konstatuar se, vetëm pas pretendimit për falsitet dhe administrimit të ekspertimit grafik të nënshkrimeve, gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjes në KQZ, nga ana e përfaqësuesit të subjektit zgjedhor PSD, është paraqitur një vërtetim, me qëllim për të provuar faktin se nuk ishte nevoja për të kandiduar me një listë mbështetëse, Kolegji Zgjedhor ka shtruar për diskutim, çështjen, nëse e kishte kompetencën KQZ-ja për ta vlerësuar faktin e paraqitur rishtaz nga subjekti zgjedhor PSD, në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të KZAZ nr. 01, ndërkohë që thelbi i ankimit të paraqitur nga subjekti zgjedhor PS lidhej me falsitetin e nënshkrimeve.

Kolegji Zgjedhor merr në konsideratë rregullat e vendosura në Kodin Zgjedhor për regjistrimin e kandidatëve, duke evidentuar se ky proces është i kufizuar në kohë, pasi jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve, subjektet zgjedhore duhet të regjistronë listën e kandidatëve të tyre (neni 67), ashtu si edhe përcakton detyrime për subjektet zgjedhore lidhur me kushtet që duhet të plotësojë kërkesa e tyre për regjistrimin e kandidatëve (neni 72). Nisur nga vullneti i

subjektit zgjedhor PSD për të paraqitur kandidaturën për Kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe, sipas përcaktimit të nenit 68.2 bazuar mbi një listë me nënshkrime të zgjedhësve, kjo kërkesë është marrë në shqyrtim nga KZAZ në vlerësimin e regjistrimit të kandidatit. Gjithashtu, duke marrë parasysh se çështja në KQZ është shqyrtuar vetëm mbi bazën e ankimit të paraqitur nga subjekti zgjedhor PS, prapësimet e PSD për të mbështetur ligjshmërinë e vendimit të KZAZ nr. 01, nuk mund të konsistojnë në një modifikim tërësor të kërkesës fillestare, me të cilën i është drejtuar administratës zgjedhore, në rrethanat kur kishte kaluar çdo afat për paraqitjen e kërkesave për regjistrim.

Për sa më sipër, ky Kolegj vlerëson se KQZ-ja ka tejkaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes, kur ka vlerësuar të ligjshëm vendimin e KZAZ nr.01, mbi bazën e një argumenti krejt të ri, se subjekti zgjedhor PSD ka një mandat në Këshillin e Bashkisë Koplík e për rrjedhojë ai nuk ka nevojë të mbështesë kandidaturën me nënshkrime të zgjedhësve. Duke vlerësuar se paraqitja e një vërtetimi për gëzimin e mandatit, në thelb ndryshon kërkesën fillestare për regjistrim dhe si e tillë përbën një kërkesë të re, Kolegji vlerëson se prapësimi i PSD-së, ndërkohë që shqyrtimi i çështjes ish iniciuar nga ankuesi PS, nuk mund të merrej në konsideratë nga KQZ për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të KZAZ nr. 01, i marrë në rrethana të tjera e mbi një kërkesë të ndryshme.

Nga ana tjetër, në funksion edhe të parimit të disponibilitetit të ankimit, KQZ-ja ka pasur detyrimin ligjor për të mos i'u shmangur shqyrtimit dhe dhënies së përgjigjes përfundimtare për pretendimin kryesor të ngritur në ankim nga përfaqësuesi i PS, mbi falsitetin e nënshkrimeve të zgjedhësve. Mos dhënia e përgjigjes ligjore mbi këtë pretendim, që është dhe pretendimi kryesor i inicuesit të procesit administrativ në KQZ, nëpërmjet shmangies tek një prapësim krejtësisht i ndryshëm nga ana e subjektit të interesuar e cenon procesin.

Në këto kushte, përderisa KQZ-ja ka devijuar nga parimi i disponibiliteti të akimit dhe ka zgjidhur çështjen mbi një tjetër prapësim, që nuk ka qenë pjesë e fillimit të procedimit administrativ nga KZAZ-ja, Kolegji Zgjedhor vlerëson se nuk duhet analizuar as pretendimi i palës paditëse PS, parashtruar në gjykim, se edhe

nga pikëpamja formale vërtetimi i paraqitur nuk plotëson kushtet për tu marrë si provë, pasi nuk përmbante vulën e insitucionit që e kish lëshuar, Këshilli i Bashkisë Koplík. Detyrimi ligjor që ka Kolegji Zgjedhor është shqyrtimi i vlefshmërisë së të gjithë procesit administrativ, që nga inicimi i procesit në KZAZ, vendimmarrjes së këtij organi, pretendimeve të parashtruara përpara KQZ-së në ankimin e subjektit zgjedhor PS, mënyrës së vlerësimit të këtyre pretendimeve, por edhe vetë vendimmarrjes së KQZ-së.

3. Ligjshmëria e vendimeve të KZAZ nr. 01 dhe KQZ-së për regjistrimin e kandidatit për Kryetar të Bashkisë Malësia e Madhe, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate.

Në vijim të analizës, Kolegji Zgjedhor mori në shqyrtim pretendimet e ankuesit subjektit zgjedhor PS, mbi paligjshmërinë e vendimit për regjistrimin e kandidatit për Kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe, për shkak të mungesës së një prej kushteve të kandidimit, nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve.

Në nenin 71 të Kodit Zgjedhor titulluar “Procedura e mbledhjes së nënshkrimeve” përcaktohet se:

“1. KQZ-ja, jo më vonë se 100 ditë para datës së zgjedhjeve, miraton dhe pajis subjektet e përcaktuara në nenet 68 dhe 69 të këtij Kodi me formularin tip për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për kandidatët e propozuar nga një grup zgjedhësish apo për partitë dhe koalicionet.

2. Zgjedhësit depozitojnë personalisht nënshkrimet e tyre në formularin tip. Formulari duhet të përmbajë identitetin e plotë të zgjedhësit, datëlindjen e tij dhe numrin telefonik të kontaktit. Bashkë me nënshkrimin, çdo zgjedhës depoziton edhe kopjen e letërnjoftimit të vlefshëm, të nënshkruar prej tij, e cila i bashkëngjitet listës. Në zbatim të nenit 69 të këtij Kodi, zgjedhësi duhet të jetë i regjistruar në zonën zgjedhore përkatëse.

3. Verifikimi i nënshkrimeve për zgjedhjet për Kuvendin kryhet nga administrata e KQZ-së dhe për zgjedhjet e organeve të qeverisjes

vendore kryhet nga KZAZ-ja përkatëse, duke verifikuar 5 për qind të listës mbështetëse të kërkuar sipas ligjit, nëse janë zgjedhës me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit. Pas verifikimit administrata paraqet një raport të detajuar mbi mangësitë e konstatuara. Raporti shqyrtohet në seancë publike, në prani të palës së interesuar. KQZ-ja vendos për pranimin ose refuzimin e listës mbështetëse. Lista pranohet kur numri i nënshkrimeve mbështetëse, duke përjashtuar numrin e nënshkrimeve të parregullta, është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas këtij Kodi.”.

Nisur nga rregullimi ligjor i procedurës për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse, si dhe referuar kuadrit historik të këtij aspekti të procesit zgjedhor, rezulton se sipas një rregullimi të mëparshëm për mbledhjen e nënshkrimeve, përcaktohej detyrimi i depozitimit të tyre para noterit publik apo para KQZ-së. Kjo procedurë garantonte vërtetësinë e nënshkrimit dhe vullnetit të zgjedhësit për mbështetjen e një kandidature të caktuar. Nga ana tjetër, nisur nga kostot e larta financiare që duhej të përballonin subjektet zgjedhore, për mbledhjen e nënshkrimeve para noterit apo KQZ-së, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 32/2010 vlerësoi si joproportionale këtë procedurë e mbi këtë bazë, pas shfuqizimit të dispozitës mbi procedurën e mbledhjes së nënshkrimeve, Kuvendi, me ligjin 74/2012 miratoi rregullimin aktual të kësaj çështjeje.

Aktualisht mbledhja e nënshkrimeve të listës mbështetëse të kandidatit, realizohet nga vetë subjekti zgjedhor, i cili pajiset me formularin e miratuar nga KQZ-ja. Në këtë mënyrë subjekti zgjedhor krahas realizimit të së drejtës së tij për të kandiduar, është ngarkuar edhe me përgjegjësinë publike dhe ligjore të mbledhjes së nënshkrimeve të zgjedhësve.

Në aspektin administrativ të procedurës së mbledhjes së nënshkrimeve, neni 71 përcakton kriteret që duhet të plotësojë lista e tyre me qëllim që të pranohet nga KQZ-ja, si një dokument i vlefshëm kandidimi. Kodi Zgjedhor pranon hipotezën se dokumentacioni i kandidimit paraqitur nga një subjekt zgjedhor, mund të ketë parregullsi, të cilat me tu konstatuar nga KQZ-ja, apo sipas rastit KZAZ-të, kërkohen të korrigojnë (neni 73.1 i Kodit Zgjedhor). Në këtë aspekt parregullsitë mund të konstatohen edhe

në listën e nënshkrimeve mbështetëse, nëse këto të fundit nuk përmbushin kërkesat e nenit 71 të këtij Kodi.

Nisur nga pretendimi i ankuesit mbi falsitetin e nënshkrimeve, si dhe nga nocioni “parregullsi” i përmendur nga Kodi Zgjedhor, Kolegji vuri në diskutim çështjen nëse falsiteti i nënshkrimeve në listën mbështetëse, përbën “parregullsi” në kuptim të Kodit Zgjedhor dhe si i tillë a ka vend për korrigjim.

Kolegji Zgjedhor, referuar faktit të vërtetuar nëpërmjet ekspertimit grafik, se lista mbështetëse e nënshkrimeve karakterizohet nga fenomeni i hedhjes së nënshkrimeve nga e njëjta dorë, ndërkohë që shumë nënshkrime është e pamundur të verifikohen, vlerëson se pretendimi për falsitetin e saj, është i bazuar. Falsifikimi i dokumenteve nëpërmjet pasqyrimin në të, të të dhënave të rreme, përbën një shkelje të rëndë të ligjit, e cila është e dënueshme sipas së drejtës penale pasi cilësohet si krim. Nisur nga debati mbi ndarjen e juridiksionit penal nga ai administrativ, Kolegji Zgjedhor vlerëson se autoriteti për të filluar dhe ushtruar ndjekjen penale në Republikën e Shqipërisë i përket Prokurorisë (neni 148 i Kushtetutës) e në këtë kuptim është ky organi, i cili vlerëson nëse një vepër penale është kryer, identifikon autorin e saj dhe konkludon mbi ekzistencën e përgjegjësisë penale, që lind kur vërtetohen elementët objektivë dhe subjektivë të një vepre të caktuar si të dënueshme penalisht. Nga ana tjetër, përtej ekzistencës së kësaj përgjegjësie, funksionimi i shtetit të së drejtës, si në lëmin publik, ashtu edhe në atë të së drejtës private, nuk mund të bëhet duke anashkaluar apo toleruar shkelje të tilla të ligjit, që objektivisht janë të dënueshme nga e drejta penale. Elementët objektivë të falsifikimit siç janë konstatuar në rastin konkret (nënshkrimi i hedhur jo nga vetë zgjedhësi), vërtetojnë faktin se subjekti i ngarkuar me ligj për mbledhjen e nënshkrimeve (subjekti zgjedhor) ka mashtruar në paraqitjen e dokumenteve të kandidimit, duke bazuar mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse në të dhëna të pavërteta.

Nisur nga vlerësimi i mësipërm, prapësimi i subjektit zgjedhor PSD se nënshkrimet e hedhura nga e njëjta dorë duhet të konsiderohen të parregullta dhe të zbriten nga totali i tyre, gjendet i pabazuar. Referuar kërkesave të nenit 71 të Kodit Zgjedhor, Kolegji vlerëson se parregullsi konsiderohen, mungesat e elementëve si identiteti i

plotë i zgjedhësit, numri i kontaktit, vendbanimi në një zonë tjetër zgjedhore, të cilat ose mund të korrigojen ose mund të zbriten nga totali i nënshkrimeve. Parregullsia nuk mund të barazohet me falsitetin, për të cilin ngarkohet me përgjegjësi subjekti zgjedhor që ka mbledhur nënshkrimet. Në këtë kuptim verifikimi i 5% të nënshkrimeve sipas nenit 71 të Kodit Zgjedhor, konsiston vetëm në vendbanimin e zgjedhësve nënshkrues, ndërkohë që sipas rregullave të arsyes dhe të së drejtës objektive, falsifikimi i nënshkrimeve nuk barazohet me parregullsinë e nënshkrimit të listës nga një zgjedhës që nuk banon në zonën zgjedhore përkatëse.

Nëpërmjet ekspertimit grafik të nënshkrimeve rezulton se përfundimi mbi nënshkrimet e hedhura nga e njëjta dorë, është i kufizuar nga fakti se shumë prej nënshkrimeve nuk kanë elementë të mjaftueshëm identifikues, ndaj Kolegji Zgjedhor vlerëson dhe krijon bindjen se lista e nënshkrimeve mbështetëse është e manipuluar dhe nuk vërteton mbështetjen reale të kandidatit.

Fakti i evidentimit në listën e nënshkrimeve të paraqitura në KQZ, të 59 nënshkrimeve të falsifikuara e bën të papranueshme atë, dhe për më tepër të ndaluar ligjërisht dhënien e legjitimitetit për veprimet e kryera nga subjekti zgjedhor. Përderisa fakti i falsitetit të nënshkrimeve, në rastin konkret, është i pranishëm, do të ishte kompromentuese për qëllimin e vetë ligjit që nga numri i përgjithshëm i nënshkrimeve të zbritet numri i nënshkrimeve të vërtetuara si të falsifikuara, me synimin për të përligjur numrin e nënshkrimeve të mbetura, dhe, për rrjedhojë për të legjitimuar edhe veprimet e subjektit zgjedhor, i cili është përgjegjës për respektimin e standardeve demokratike të zgjedhjeve.

Rregullimi që i bën si Kodi Zgjedhor, ashtu edhe legjislacioni i çdo shteti demokratik procedurës së verifikimit të ligjshmërisë së nënshkrimeve të zgjedhësve konsiston në rritjen e përgjegjshmërisë së subjektit zgjedhor, i cili duhet të respektojë dhe garantojë në të gjitha aspektet rregullshmërinë e të gjithë këtij procesi. Është e vërtetë që neni 71 i Kodit Zgjedhor kërkon pikësëpari saktësinë e nënshkrimeve nga ana e vetë zgjedhësve, por përgjegjësia kryesore, në rastin konkret, është e subjektit zgjedhor, partisë politike, e cila duhet të marrë të gjitha masat e domosdoshme me synim garantimin e një procesi sa më ligjor, që nuk lejon kompromentimin

e dokumentacionit nëpërmjet nënshkrimeve të falsifikuara. Një subjekt zgjedhor që lejon marrjen e nënshkrimeve të falsifikuara me qëllim regjistrimin e kandidatit, kryen dhunimin më të rëndë që mund t'i bëhet procesit zgjedhor, që në fillimin e tij. Ashtu siç arsyeton Gjykata Kushtetuese në Vendimin nr. 32, datë 21.06.2010, kur i referohet mënyrës se si legjislacioni italian parashikon paraqitjen e listave të zgjedhësve, evidentohet qartësisht se verifikimi i ligjshmërisë së tyre bëhet vetëm për autenticitetin e nënshkrimit “të përfaqësuesit partiak (qoftë ky presidenti, sekretari i partisë ose i grupit politik, ose një nga përfaqësuesit e tjerë sipas ligjit) dhe jo ajo e zgjedhësve.”. Është partia politike, si një subjekt i përgjegjshëm zgjedhor që nuk duhet të lejojë paraqitjen nga përfaqësuesit e saj të dokumenteve të falsifikuara. Evidentimi i dokumenteve të tilla, që në asnjë rast nuk mund të njehsohet me parregullsinë e procesit, por vetëm me shkeljen e rëndë të tij, në të njëjtën kohë, nuk shmang as penalizimin e subjektit zgjedhor.

Si konkluzion, Kolegji Zgjedhor vlerëson se pranimi i listës mbështetëse të nënshkrimeve të zgjedhësve nga KZAZ nr. 01 dhe më tej, nga KQZ, është kryer në kundërshtim me ligjin dhe për rrjedhojë vendimet e tyre duhet të shfuqizohen. Në funksion të zgjidhjes së çështjes në themel, sipas përcaktimit të nenit 158 të Kodit Zgjedhor, Kolegji arrin në përfundimin se kërkesa e subjektit zgjedhor PSD për regjistrimin e kandidatit për Kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe është e pabazuar në ligj për shkak të mbështetjes së tij me një listë të paligjshme nënshkrimesh, ndaj regjistrimi i kandidatit duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës Apelit Tiranë bazuar në nenin 158, pika 1, shkronja “b” dhe pika 3 të Kodit Zgjedhor.

VENDOSI:

- Pranimin e padisë.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 560, datë 22.05.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 12 të paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë”, si dhe të vendimit nr. 6, datë 08.05.2015 të KZAZ nr. 01.

- Refuzimin e kërkesës për regjistrim të kandidatit për Kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe, z. Ardian Hysa të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015.

Tiranë, 29.05.2015

GJYQTAR
Andi CIVICI

GJYQTAR
Ilir TOSKA
(kundër)

KRYESUES
Edlira PETRI

GJYQTAR
Petrit ÇENO

GJYQTAR
Kliton SPAHIU
(kundër)

MENDIMI KUNDËR.

Unë Gjyqtari, Kliton SPAHIU, anëtar i trupës gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor të çështjes me palë ndërgjyqëse:

PADITESE: Partia Socialiste e Shqipërisë.

I PADITUR: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Palë të interesuar: Partia Socialdemokrate e Shqipërisë.

OBJEKTI: - Shfuqizimi i vendimit nr. 560, datë 22.05.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 12 “Për regjistrimin e z. Ardian Hysa si kandidat për Kryetar Bashkie Malësi e Madhe, Qarku Shkodër, propozuar nga partia Socialdemokrate; Gjykimi i çështjes në themel duke vendosur ndryshimin e vendimit të KZAZ nr. 01 dhe çregjistrimin e z. Ardian Hysa si kandidat për kryetar Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër, propozuar nga partia Socialdemokrate.

BAZA LIGJORE : Nenet 67, 68.2, 72, 73, 145, 152, 153, 155, 156, 158, 160 të K. Zgjedhor.

Jam i mendimit kundra për sa i përket disponimit mbi pranimin e padisë nga shumica e kësaj trupe gjyqsore, të Kolegjit Zgjedhor, duke mbetur në mendimit se padia është e pabazuar në prova dhe ligj, e për pasojë duhet rrëzuar për sa më poshtë:

Partia Socialdemokrate e Shqipërisë me vendimin Nr 103, datë 19.04.2015, është regjistruar si subjekt zgjedhor pranë KQZ-së, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015.

Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, ka dorëzuar dokumentacionin për kandidimin për Kryetar Bashkisë Malësi e Madhe, të Z.Ardian Hysa, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015, pranë KZAZ-së Nr 1.

Me vendimin nr. 6, datë 08.05.2015, KZAZ nr. 01, Qarku Shkodër ka vendosur :

“Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, të regjistrojë si kandidat për kryetar në Bashkinë Malësi e Madhe, z. Ardian Qamil Hysa, paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate”.

Subjekti zgjedhor PS, nëpërmjet ankimit administrativ kundër vendimit të mësipërm, ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe çregjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe, z. Ardian Hysa, duke pretenduar që kandidimi i paraqitur nga Partia Socialdemokrate është mbështetur nga lista me nënshkrimet e 493 zgjedhësve, dokumentacion i cili përmban të meta thelbësore që cenojnë rëndë frymën e Kodit Zgjedhor dhe bien në kundërshtim të hapur me parashikimet e neneve 68.2, 71, 72.d të këtij Kodi.

Në hetimin administrativ në KQZ rezulton të jetë shqyrtuar pretendimi që lidhet me listën mbështetëse të nënshkruar nga zgjedhësit, si dhe në vërtetimin Nr 268 Prot, datë 29.04.2015 të lëshuar nga Këshilli i Bashkisë Koplík.

Neni 68/2,3 i K.Zgjedhor ka parashikuar se; *“Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj*

njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3 000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit, ose kur zotërojnë bashkërisht në këshillin përkatës një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit.

Për qëllim të këtij neni, partia politike ose koalicioni paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit”.

Pra, referuar kësaj dispozite kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore të paraqitur nga partitë politike të cilët zotërojnë mandat në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore nuk është e nevojshme të mbështeten nga lista e nënshkruar nga një grup zgjedhësish.

Në rastin në shqyrtim rezulton se subjekti zgjedhor ka zgjedhur si alternativ për regjistrimin e kandidatit për kryetar Bashkie Malësi e Madhe, atë me listë mbështetëse si dhe me zotërim mandati (*për të cilën ka paraqitur edhe vërtetimin përkatës të Këshillit të Bashkisë Koplík që mban datën 29.04.2015*).

Lidhur me paraqitjen e këtij vërtetimi pranë KZAZ Nr 1, është kryer edhe një hetim administrativ pranë KQZ-së. Nga ky hetim administrativ, rezulton se së bashku me dokumentacionin në kandidimin për Kryetar Bashkisë Malësi e Madhe, të Z.Ardian Hysa, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015, pranë KZAZ-së Nr 1, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, ka paraqitur brenda afateve ligjore edhe vërtetimin me shkrim të nënshkruar nga institucioni i njësisë së qeverisjes vendore ku vërtetohet zotërimi i mandatit të anëtarit të këshillit, për këtë subjekt zgjedhor. Referuar datës 29.04.2015, të vërtetimit për zotërimin e mandatit, konkludohet se subjekti zgjedhor PSD e ka marrë atë në zbatim të nenit 68/3 të K.Zgjedhor dhe në plotësim të dokumentacionit për kandidimin për Kryetar Bashkisë Malësi e Madhe. Mospasqyrimi nga KZAZ Nr 1, në dorëzimit të dokumentave të kandidimit, nuk është për faj të subjektit zgjedhor por për neglizhencë të KZAZ-se.

Organi administrativ (KQZ-ja) ka patur për detyrë të sjellë të gjithë të gjithë aktet dhe provat të shqyrtuara gjatë hetimit administrativ, ndërkohë që gjatë hetimit gjyqsor në Kolegjin Zgjedhor,

mungonte procesverbali i dorëzimit të dokumentave të kandidimit, i cili është akti i rëndësishëm për të provuar se cili është shënimi që është bërë në rubrikën “Vërtetim nga Kuvendi i Shqipërisë apo Këshilli i Bashkisë për zotërimin e mandatit”, në kollonën “Po” apo “Jo”, të saj.

Kolegji Zgjedhor edhe nëse ka dyshime për këtë vërtetim (që lidhet me vërtetësinë e saj, vulën, dhe kohën e paraqitjes në KZAZ), ose duhet të kryente hetime të metejshme ose duhet të vlerësonte këtë dyshim në favor të subjektit zgjedhor, duke i dhënë atij shanse për të garuar në zgjedhje për organet e qeverisjes vendore.

Për sa më sipër unë mbetem i mendimit se vërtetimi i datës 29.04.2015, i lëshuar nga Këshilli Bashkisë Kopluk, përmbush kriteret e nenit 68/3 të K.Zgjedhor për të regjistruar z.Ardian Hysa, si kandidatit për Kryetar Bashkisë Malësi e Madhe, paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, (pa listën mbështetëse të nënshkruar nga zgjedhësit të asaj njësie), për pasojë padia e Partisë Socialiste të Shqipërisë duhet rrëzuar.

Tiranë sot me datë 29.05.2015.

GJYQTARI

Kliton SPAHIU

MENDIM PAKICE

Une gjyqtari Ilir Toska, në cilësinë e anetarit të trupit gjykues, shpreh mendimin tim të ndryshëm nga qendrimi i mbajtur nga shumica, në Vendimin Nr.17, datë 29.05.2015, duke vlerësuar se Kolegji Zgjedhor duhet të kishte vendosur rrezimin e padisë së ngritur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, pasi Vendimi Nr.6, datë 08.05.2015, i KZAZ Nr.01, Qarku Shkoder, për regjistrimin si kandidat për kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe të Z. Ardian Hysa, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, lene në fuqi me Vendimin e KQZ-se Nr.560, datë 22.05.2015, është një vendim i drejte dhe në përputhje me ligjin.

Lidhur me kete, parashtroj se nga materialet dokumentare te administruara rregullisht ne gjykim mendoj se kërkesa e subjektit zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqiperise, per regjistrim kandidati per kryetar te Bashkise Malesi e Madhe te Z. Ardian Hysa, per zgjedhjet ne organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015, eshte nje kerkese qe plotëson kërkesat e ligjit dhe qe me te drejte eshte pranuar nga KZAZ Nr.01, Qarku Shkoder, vendimmarrja e te ciles me pas eshte lene ne fuqi me vendimin objekt padie te KQZ-se, persa kohe rezulton se, ne përputhje me nenet 68 dhe 72 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, kërkesa per regjistrim kandidati ne rastin konkret eshte perligjur me paraqitjen e dokumenteve te nevojshem te kandidimit. Lidhur me kete, ndryshe nga shumica ne vendimin e saj, mendoj se subjekti zgjedhor kërkuar Partia Socialdemokrate e Shqiperise ka paraqitur dokumentet e kërkuar nga ligji qe provojne mbështetjen nga jo me pak se 1% e zgjedhesve te kandidatit te paraqitur nga ky subjekt politik per kete njesi te qeverisjes vendore. Keshtu, fakti se disa nga nënshkrimet e zgjedhesve mbeshtetes, sipas ekspertimit grafik te nënshkrimeve te realizuar gjate shqyrtimit administrativ nga KQZ-ja, kane rezultuar te mos jene te vërteta per shkak se jane bere nga njëjta dore, nuk i ben te pavërteta te gjitha nënshkrimet e zgjedhesve mbeshtetes te siguruara ne kete rast nga ky subjekt politik dhe, per rrjedhoje, te parregullt dokumentacionin e kandidimit, listen mbeshtetese te paraqitur prej tij. Ne vlerësimin tim parregullsia e disa nënshkrimeve ne listen mbeshtetese nuk i ben te parregullta te gjitha nënshkrimet e zgjedhesve ne kete liste, duke patur ne konsiderate per kete dhe përcaktimin e bere ne nenin 71/3 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, sipas te cilit "... Lista pranohet kur numri i nënshkrimeve mbështetëse, duke përjashtuar numrin e nënshkrimeve të parregullta, është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas këtij Kodi". Ne rastin konkret nuk eshte vene per asnje moment ne dyshim se numri i nenshkrimeve te rezultuara te parregullta ne listen mbeshtetese prek numrin minimal te nënshkrimeve te kërkuara sipas Kodit Zgjedhor te ndryshuar per ate njesi te qeverisjes vendore (1% te zgjedhesve te Bashkise Malësia e Madhe).

GJYQTAR

ILIR TOSKA

* * *



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR**

NR. 18 REGJ. THEMELTAR
Date 03.06.2015

Nr. 18, i Vendimit
Date 05.06.2015

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUES :	VALBON ÇEKREZI
ANËTAR :	EDLIRA PETRI
ANËTAR :	GJINOVEFA GABA
ANËTAR :	ANDI CIVICI
ANËTAR :	KLITON SPAHIU

asistuar prej sekretares Rexhina Baci, në Tiranë, sot me datë 05.06.2015, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore, që u përket paleve:

PADITËSE : PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE,
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Z.Ivi Kaso.

I PADITUR : KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Znj.Deshira Pasko dhe Z.Olsi Peto.

PALE E INTERESUAR : PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE,
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Z.Koli Bele dhe Z.Gledian Llatja.

OBJEKTI : - Kundërshtimin e Vendimit Nr.593, datë 01.06.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Gjykimin e ceshtjes ne themel, duke vendosur pranimin e dorëheqjes së kandidatit z. Altin Biba dhe regjistrimin e kandidatit të Koalicionit Alenaca Popullore për Punë dhe Dinjitet, z. Ilir Pjetër Pjetraj.

BAZA LIGJORE : Nenet 72, 73, 145 e vijues, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS APELIT TIRANË

Pasi dëgjoi perfaqësuesit e palës paditëse Partia Demokratike e Shqipërisë, që kërkuan pranimin e padisë sipas objektit; dëgjoi perfaqësuesen e palës së paditur Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, që kërkoj rrezimin e padisë; dëgjoi perfaqësuesit e palës së interesuar Partia Socialiste, që kërkuan rrezimin e padisë; si dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Me Dekretin Nr. 8844, datë 15.12.2014, në mbështetje të neneve 92/gj dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 9/1/2 dhe 10/1/2 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Presidenti i Republikës së Shqipërisë ka caktuar datën 21 qershor 2015 për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partia Demokratike e Shqipërisë me shkronja nistore PD, në përputhje me nenin 64 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ) si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015. Pala paditëse PD, bashkë me disa parti politike të regjistruara rregullisht si subjekte zgjedhore, bazuar në nenin 65 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, janë regjistruar nga KQZ-ja si koalicion zgjedhor në shkallë vendi, nën emrin Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet (APPD), për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015.

Partia Socialiste e Shqipërisë me shkronja nistore "PS", në përputhje me nenin 64 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar nga KQZ-ja si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015.

Koalicioni zgjedhor APPD, në ushtrim të të drejtës së përcaktuar në nenin 165/3 të Kodit Zgjedhor dhe në përputhje me kërkesat e nenit 67 të këtij Kodi, brenda afatit të përcaktuar nga kjo dispozitë (që në rastin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015 është llogaritur deri më date 4 maj 2015), ka paraqitur përpara Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) Nr.15, Qarku Lezhë një kërkesë për regjistrimin e z.Altin Biba si kandidat për kryetar të Bashkisë Kurbin për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, duke i bashkëlidhur asaj dhe dokumentet e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor te ndryshuar.

KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë, bazuar në nenet 33/f dhe 73 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, me Vendimin Nr.50, datë 06.05.2015, ndërsa ka gjetur të rregullt dhe në përmbushje të kërkesave të ligjit dokumentet e kandidimit, ka vendosur “Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015 të regjistrojë si kandidat për kryetar të Bashkisë Kurbin, z.Altin Gjon Biba, paraqitur nga Koalicioni Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet”.

Me regjistrimin, z.Altin Gjon Biba ka marrë cilesinë e “subjektit zgjedhor”, sipas përcaktimit të nenit 2/20 te Kodit Zgjedhor, që parashikon se “Subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe *kandidadët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë kod.*

Më datë 09.05.2015, ditën e tretë pas shpalljes së këtij vendimi, pranë KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë, kandidati i regjistruar që tashmë kishte dhe cilësinë subjektit zgjedhor z.Altin Biba, ka paraqitur një kërkesë për heqjen dorë nga kandidimi, kërkesë të cilën më datë 10.05.2015 KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe i’a ka përcjelle KQZ-së, por edhe subjektit zgjedhor Koalicionit APPD (partisë politike kryesuese të koalicionit PD).

Më datë 13.05.2015, subjekti zgjedhor Koalicioni APPD ka paraqitur përpara KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë një kërkesë për regjistrimin e Z.Illir Pjeter Pjetraj si kandidat për kryetar të Bashkisë Kurbin për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, duke i bashkëlidhur asaj dhe dokumentet e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor.

Ndërkohë, po më datë 13.05.2015, KZAZ Nr.15, Qarku Lezhe ka shqyrtuar fillimisht kërkesen e z.Altin Biba për heqjen dorë nga kandidimi, ku në përfundim, me Vendimin

Nr.54, ka vendosur “1. Shfuqizimin e vendimit nr.50, datë 06.05.2015.
2. Ç’regjistrimin e kandidatit për Kryetar të Bashkisë Kurbin të Partisë Demokratike Z.Altin Gjon Biba”.

Po me datë 13.05.2015, KZAZ Nr. 15, Qarku Lezhë, pasi ka shqyrtuar dhe kërkesën për regjistrimin e kandidatit të Koalicionit APPD, me Vendimin Nr.55, ka vendosur “Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015 të regjistrojë si kandidat për kryetar të Bashkisë Kurbin, z.Illir Pjetër Pjetraj, paraqitur nga Koalicioni Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet”.

Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë (PS), duke mos qenë dakord me vendimin Nr.55, datë 13.05.2015 të KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë, brenda afatit ligjor 3-ditor (më datë 16.05.2015), ka paraqitur përpara KQZ-së një ankim zgjedhor nëpërmjet të cilit ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe shfuqizimin e tij, duke pretenduar se është një vendim absolutisht i pavlefshëm për shkak së është marrë jashtë cdo procedure dhe afati ligjor të përcaktuar në nenin 73/4 të Kodit Zgjedhor për depozitimin e dokumenteve të kandidimit dhe për regjistrimin e kandidatëve për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore.

KQZ-ja, në përfundim të shqyrtimit administrativ, me Vendimin Nr.493, datë 20.05.2015, bazuar në nenet 68/2, 73, 124 dhe 143/1/c të Kodit Zgjedhor, ka vendosur “Konstatimin e pavlefshërisë absolute të Vendimit nr.55, datë 13.05.2015 të KZAZ Nr.15, “Për regjistrimin e z. Ilir Pjetraj, si kandidat për kryetar bashkia Kurbin, propozuar nga koalicioni APPD dhe pranimin e kërkesës ankimore nr.21, të Partisë Socialiste”.

Kjo vendimmarrje e KQZ-së, u ankimua nga subjekti zgjedhor PD, pranë Kolegjit Zgjedhor, i cili pas shqyrtimit të çështjes, me Vendimin Nr.13, datë 28.05.2013, ka vendosur:

“1. Shfuqizimin e Vendimit Nr.493, datë 20.05.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

2. Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që, jo më vonë se data 30.05.2015, të marrë vendim për cështjen e regjistrimit të kandidatit të propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet, duke trajtuar në themel edhe kërkesën për dorëheqje të kandidatit Altin Biba dhe kërkesën e subjektit zgjedhor Koalicioni Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet, të datës 13.05.2015, për regjistrimin/zëvendësimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Kurbin, Qarku Lezhë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015”.

Ne vijim, me Vendimin Nr.593, datë 01.06.2015, “Per ekzekutimin e vendimit te Kolegjit Zgjedhor te Gjykates se Apelit Tirane nr.08, date 28.05.2015, per te marre ne shqyrtim ceshtjen e regjistrimit te kandidatit te propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Aleanca Popullore per Pune dhe Dinjitet”, duke trajtuar ne themel edhe kerkesen per dorëheqje te kandidatit Altin Biba dhe kerkesen e subjektit zgjedhor Koalicionit “Aleanca Popullore per Pune dhe Dinjitet”, per regjistrimin/zevendesimin e kandidatit per kryetar te Bashkise Kurbin ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te vitit 2015”, KQZ-ja ka vendosur :

“1. Mospranimin e dorëheqjes, të kandidatit për kryetar për Bashkinë Kurbin, propozuar nga Koalicioni “Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet”.

2. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.54 dhe 55 të KZAZ-së nr.15.

3.Lënia në fuqi e vendimit nr.50, të KZAZ-së nr.15”.

Për këtë vendim marrje të tij, KQZ-ja ka argumentuar:

nga pikëpamja formale dorëheqja nuk plotëson elementet e një akti i cili të bind për deklarimin e këtij vullneti, një letër, e cila në fund rezulton e nënshkruar nga kandidati, vullnet i pavërtetuar sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim. Kandidati shprehet se për arsye objektive shëndetësore, familjare jep dorëheqjen e parevokueshme ... Kjo deklaratë nuk shoqërohet me asnjë dokumentacion për të vërtetuar

shkaqet e përmendura në dorëheqje dhe pamundësinë reale të kandidatit për të vazhduar kandidimin;

Kodi Zgjedhor, kandidimin e parashikon si një të drejtë të çdo individit i cili propozohet më pas nga një parti politike apo koalicion zgjedhor, dhe që duhet të plotësojë disa kriteret kushtetuese dhe ligjore. Me përfitimin e statusit të kandidatit kjo e fundit nuk është më një e drejtë por një detyrim ligjor për të mundësuar zhvillimin e zgjedhjeve të lira, demokratike dhe pluraliste;

Kodi Zgjedhor nuk e parashikon të drejtën e heqjes dorë nga kandidimi, pasi, pas shprehjes së vullnetit të individit se gëzon të drejtën dhe ka vullnet për të kandiduar, dhe regjistrimit si kandidat nga komisioni përkatës, kandidati i nënshtrohet disa procedurave ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor deri në nxjerrjen e rezultatit zgjedhor;

pranimi i dorëheqjes së kandidatit Altin Biba në mënyrën se si është paraqitur, si nga përmbajtja, nga ana formale, në kushtet kur përpara KQZ-se janë paraqitur edhe shumë dorëheqje të tjera, do të krijonte një “precedent” jo pozitiv e do të cënonte rëndë procesin zgjedhor, aq më tepër vlerësuar edhe faktin se Kodi Zgjedhor nuk parashikon shprehimisht në asnjë dispozitë të tij në lidhje me dorëheqjen e kandidatëve;

regjistrimit të kandidatit, procedurat e mësipërme ligjore nuk i nënshtrohen më një vullneti të kandidatit, por janë detyrim ligjor i cili duhet detyrimisht që të zbatohet. Zbatimi i normave ligjore për çdo aspekt të procesit zgjedhor, duke filluar me procesin e kandidimit, votimit, nxjerrjes së rezultateve, garanton në tërësinë e tij një proces të rregullt zgjedhor, në përputhje me standartet ndërkombëtare të gjithëpranuara.

Subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë (PD), nëpërmjet padisë së paraqitur pranë Kolegjit Zgjedhor, më datë 03.06.2015, ka kundërshtuar Vendimin Nr.593, datë 01.06.2015, të KQZ-se, duke kërkuar gjykimin e ceshtjes në themel dhe vendosur për pranimin e dorëheqjes së kandidatit z.Altin Biba dhe regjistrimin e kandidatit të Koalicionit APPD, z.Illir Pjetër Pjetraj.

Në ankimin zgjedhor, si dhe në shqyrtimin gjyqësor, pala paditëse parashtroi:

KQZ-ja në kundërshtim me ligjin dhe vendimin nr.13, datë 28.05.2015 të Kolegjit Zgjedhor, ka marrë vendimin përtej afatit ligjor të përcaktuar Kolegji Zgjedhor, ndersa nuk ka marrë në analizë detyrat e lëna prej tij lidhur me regjistrimin e kandidatit të propozuar nga Koalicioni APPD;

KQZ-ja në mënyrë të gabuar dhe në kundërshtim me ligjin, në mungesë të një ndalimi të shprehur në Kod për dorëheqjen dhe më pas ndryshimin e një kandidati për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, aplikon keq dipozitën (nenin 73/4 të Kodit Zgjedhor) duke marrë një vendim të paligjshëm për c' regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie të propozuar nga opozita;

detyra e lënë nga Kolegji Zgjedhor për KQZ-ne është të shqyrtonte kërkesën për dorëheqje, që do të thotë të shqyrtojë a ka një kërkesë të kandidatit për kryetar bashkie të firmosur nga vetë kërkuesi, në këtë kërkesë a shprehet vullneti i tij për t'u dorëhequr nga e drejta për të kandiduar në zgjedhje, a ka të përcaktuara shkaqe që e bëjnë kandidatin të dorëhiqet, etj., por në asnjë mënyrë kjo detyrë e Kolegjit Zgjedhor për KQZ-ne, ku kjo e fundit të shqyrtojë kërkesën e dorëheqjes, nga pikëpamja e kompetencës në lëndë, nuk mund të interpretohet si një e drejtë e KQZ-se për të vlerësuar të drejtën e dorëheqjes si koncept;

Kolegji Zgjedhor të drejtën e subjektit që të paraqesë dorëheqjen e konsideron si një e drejtë e individit, të cilën nuk mund ta cënoje asnjë organ administrativ, pasi në rast të kundërt nuk do të kishte kuptim që Kolegji Zgjedhor t'i kërkonte KQZ-se të shprehej për kërkesën për regjistrim të kandidatit z.Illir Pjetraj;

vendimmarrja absurde e KQZ-se, e cila detyron dikë të kandidojë në zgjedhje përtej vullnetit të tij, jo vetëm që bie ndesh me nenin 45 të Kushtetutës, ku të drejtën për t'u zgjedhur e koncepton si një e drejtë e individit, dhe jo si detyrim, por bie

ndesh edhe me parimet për një proces konkurrues, të rregullt dhe të besueshëm zgjedhor, duke caktuar si alternativë për të zgjedhur një kandidat i cili e ka të pamundur të konkurojë, duke deformuar kështu KQZ-ja qysh në gjeneze procesin zgjedhor;

nëse koncepti i të drejtës për t'u zgjedhur është relativisht i thjeshtë, koncepti i të drejtës për të zgjedhur nuk mund të kufizohet vetëm në lirinë që ka një zgjedhës për të shkuar apo jo të votojë ditën e zgjedhjeve, por edhe në atë të mundësisë që duhet të ketë zgjedhësi për të zgjedhur, pra për të patur mundësinë që me votë të shprehë preferencën ose pëlqimin për njërin prej alternativave që subjektet zgjedhore në garë përfaqësojnë dhe ofrojnë;

pavarësisht se në vështrim të parë dhe formalisht duket sikur vendimarrja e KQZ-se ka respektuar këtë parim të rëndësishëm kushtetues, duke garantuar më shumë se një alternativë për zgjedhësit, *de facto* nuk është ashtu, pasi paraqitja në fletën e votimit e një kandidati i cili, publikisht dhe zyrtarisht nëpërmjet një dorëheqje të parevokueshme, *de facto* për zgjedhësit përkthehet në mundësinë për të votuar vetëm për një alternativë, e cila e kthen procesin "zgjedhor" të 21 qershorit në një proces votëbesimi vetëm për kandidatin e maxhorancës;

e vetmja çështje e cila u debatua në shqyrtimin administrativ për herë të parë në KQZ dhe më pas në Kolegjin Zgjedhor, lidhur me procesin e regjistrimit/zëvendësimit të kandidatit z. Ilir Pjetraj, nga koalicioni APPD, ishte çështja e afatit në të cilin ish-in kryer veprimet dhe, konkretisht, aplikimin e këtij afati në raport me dispozitat e Kodit Zgjedhor, në nenet 72 dhe 73 të tij, çështje që është zgjidhur përfundimisht nga Kolegji Zgjedhor, i cili në vendimmarrjen e tij nr.13, datë 28.05.2015, ka vërejtur se këto veprime janë kryer brenda afatit të përgjithshëm të regjistrimit, i cili për këto zgjedhje ishte data 13 maj;

e vetmja gjë që duhet të bënte KQZ-ja ishte të konsideronte edhe dorëheqjen e z. Altin Biba, ashtu edhe të regjistrimit të mëpasëm, si të kryer brenda afatit ligjor, dhe rrjedhimisht të kryente regjistrimin, duke qene vetem kjo detyra për të cilën e

ngarkonte vendimarrja e Kolegjit Zgjedhor, por dhe e vetmja detyrë të cilën KQZ nuk kreu, pasi në vend që të zgjidhte në themel cështjen e regjistrimit të një kandidati, interpretoi detyrimin e vet si detyrim për të vlerësuar ligjshmërinë dhe paligjshmërinë e një dorëheqje.

Përfaqësuesja e KQZ-se, kërkoi rrëzimin e padisë, duke iu përmbajtur argumentimit në vendimin e ankimuar.

Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë (PS), me cilësinë e palës së interesuar në këtë gjykim, duke e konsideruar të drejtë vendimarrjen e KQZ-se, parashtroi se:

Vendimi i KQZ-se është një vendim i marrë në përputhje me Kodin Zgjedhor, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Praktikës së Mirë në Cështjet Zgjedhore;

me plotesimin e deklaratës Model 05K, me anë të së cilës shprehet vullneti për të kandiduar, si dhe me shpalljen e kandidatit pas miratimit të dokumentacionit nga KZAZ-ja, kandidimi nuk është me vetëm një e drejtë nga e cila mund të heqësh dorë, por është një detyrim për zbatimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor për organizimin e zgjedhjeve dhe zhvillimin e një fushate zgjedhore konform rregullave të caktuara në Kodin Zgjedhor;

KQZ-ja ka një eksperiencë të gjatë në deklaratat e dorëheqjes së kandidatëve të listave shumëmemërore të këshillit, të cilët deklarojnë dorëheqjen e tyre nga kandidimi edhe pse mund të jetë i pari në listën shumëmemërore, me të vetmen arsye sepse kërkojnë të jenë pjesë e komisioneve të qendrave të votimit, grupeve të numërimit të votave apo KZAZ-ve. Në asnjë rast, një kandidat edhe pse jep dorëheqjen nga kandidimi për anëtar të këshillit të bashkisë, nuk lejohet të jetë anëtar i një komisioni zgjedhor dhe dorëheqja e tij pranohet vetëm pasi bëhet shpallja si anëtar i këshillit bashkiak para sekretarit të këshillit, dhe është ky i fundit i cili bën zëvendësimin e anëtarit të këshillit bashkiak, pasi dorëheqja nuk mund të konsiderohet e ligjshme para se të fitohet e drejta;

paraqitja e kërkesës për regjistrimin e kandidatit në datë 13 maj 2015 është në tejkalim të afatit të parashikuar nga neni 67 i Kodit Zgjedhor. Zgjatja dhe tejkalimi i afateve ligjore nga ana e KZAZ-se në procesin e pranimit të dokumentacionit të kandidimit dhe regjistrimit të kandidatëve për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore është shkelje e dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe bën vendimmarrjen e KZAZ-se absolutisht të pavlefshëm. Kjo vendimarrje ndikon negativisht në proceset zgjedhore të mëvonshme, duke mos i konsideruar afatet e vendosura nga Kodi Zgjedhor si afate prekluzive;

neni 73/4 i Kodit Zgjedhor parashikon se: “emrat në listat shumëmbërore dhe renditja e tyre nuk mund të ndryshohen pas miratimit përfundimtar nga ana e KQZ-së ose, sipas rastit, KZAZ-së “. Kodi Zgjedhor shprehet për lista kandidatësh në të gjitha përcaktimet e tij, pa bërë dallim për kandidatët për deputet, për kryetar bashkie apo për këshillat bashkiak. Në këto kushte, mbështetur në nenin 73/4 të Kodit Zgjedhor, emrat e kandidatëve për kryetar bashkie nuk mund të ndryshojnë pas miratimit përfundimtar të tyre nga KZAZ-ja apo KQZ-ja dhe, sidomos, pas shpalljes së tyre;

Vendimet nr.54 dhe nr.55, date 13.05.2015, të KZAZ Nr. 15, me të cilat është vendosur c’regjistrimi i kandidatit z . Altin Biba dhe regjistrimi i kandidatit z.Illir Pjetraj, janë vendime në kundërshtim me afatet dhe procedurën e kërkuar nga nenet 67 dhe 73 të Kodit Zgjedhor dhe, në këto kushte, referuar nenit 116, germa “c”, të Kodit të Procedurave Administrative, janë absolutisht të pavlefshëm, pasi janë haptazi në kundërshtim me parashikimet perkatëse ligjore që rregullojnë këto marrëdhënie;

Vendimi nr.55, datë 13.05.2013, i KZAZ-së nr.15, nuk është marrë sipas parashikimeve të nenit 73, pikat 1 e 2, të Kodit Zgjedhor. Ky vendim është marrë si një regjistrim krejtësisht fillestar dhe pa asnjë lidhje me rregullimet e parashikuara nga neni 73, pikat 1 e 2, të Kodit Zgjedhor, të cilat sidoqoftë, nuk mund të shërbejnë si bazë ligjore për këtë vendim, pasi lidhen vetëm me riparimin e parregullsisë apo mospërbushjes së kërkesave të Kodit Zgjedhor, parregullsi këto të evidentuara nga KZAZ-ja vetëm për dokumentacionin e kandidimit të dorëzuar brenda afatit ligjor;

Kodi Zgjedhor për të garantuar qëndrueshmërinë e procesit të regjistrimit të kandidatëve dhe të gjitha proceseve të tjera të ndërvarura me të, në asnjë nen të tij nuk parashikon të drejtën e zëvendësimit, të kandidatëve. Por, edhe nëse i referohemi normave ligjore të cilat kanë rregulluar proceset zgjedhore të mëparshme, të cilat kanë parashikuar institutin e zëvendësimit të kandidatëve, kjo e drejtë mund dhe duhet të ushtrohet vetëm brenda disa afateve të përcaktuara në ligj;

qëllimi i legjislatorit përse i takon procesit të kandidimit, ka qenë sigurimi i garancive procedurale për zhvillimin e një procesi zgjedhor vetëm brenda kornizave të parashikuara shprehimisht në Kodin Zgjedhor, dhe vetëm brenda afateve të parashikuar në te. Duhet theksuar që Kodi Zgjedhor kryesisht është një kod procedural me afate prekluzive dhe të qarta, afate të cilat nuk mund të shkelen e tejkalohen, dhe respektimi i të cilave prevalon ndaj vullnetit të lirë të individit për t'u tërhequr nga gara në cdo kohë;

në legjislacione të ndryshme, në mënyrë përjashtimore, e drejta e zëvendësimit të kandidatit është parashikuar, por gjithmonë në një afat të caktuar dhe zakonisht për rastet kur kandidati vdes apo ka shkaqe pazgjedhshmërie.

Kolegji Zgjedhor, pasi ia nënshtroi çështjen debatit gjyqësor, dëgjoi palët, administroi provat, në konsideratë të fakteve të rezultuara nga provat e marra në gjykim, arriti në përfundimin që padia e paraqitur nga PD rezultoi e pabazuar në prova dhe në ligj dhe se, Vendimi i KQZ Nr.593, datë 01.06.2015 është marrë në vlerësim të drejtë të fakteve si dhe në zbatim të drejtë të ligjit, dhe për pasojë padia duhet rrëzuar.

Kolegji konstatoi fillimisht që, subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, legjitimohet në paraqitjen e ankimit/padisë ndaj vendimit Nr.593, datë 01.06.2015 të K.Q.Z-së në kuptim të nenit 145 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar) dhe se, ankimi/padia është paraqitur brenda afatit 5-ditor nga shpallja e vendimit të KQZ-së, parashikuar në nenin 152 të Kodit Zgjedhor.

Gjatë shqyrtimit të çështjes, Kolegji Zgjedhor administroi praktikën dokumentare në lidhje me vendimin objekt ankimi, Vendimin e KQZ-se Nr.593, datë 01.06.2015.

Fillimisht, Kolegji Zgjedhor vlerëson se KQZ-ja, në përputhje me detyrimin e saj ligjor, si dhe në respektim të vendimit të mëparshëm të Kolegjit Zgjedhor (Vendimin Nr.13, datë 28.05.2015), ka trajtuar në themel dhe në tërësi çështjen e regjistrimit të kandidatit për kryetar të Bashkisë Kurbin të propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni APPD, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, duke disponuar, pervec se për të gjitha vendimmarrjet e komisionit zgjedhor zonal, ashtu sikundër edhe për kërkesën për dorëheqje nga kandidimi të kandidatit të regjistruar z.Altin Biba, duke dalë tashmë me një vendim përfundimtar për këtë çështje, e cila, për shkak të ankimit zgjedhor të paraqitur, është pjesë e juridiksionit gjyqësor të Kolegjit Zgjedhor.

Më tej, Kolegji Zgjedhor vlerëson se vendimmarrja finale e KQZ-së e ankimuar nga pala paditëse në rastin konkret (Vendimi Nr.593, datë 01.06.2015), është një vendimmarrje e ligjshme dhe në përputhje me Kodin Zgjedhor.

Lidhur me këtë, Kolegji Zgjedhor cmon të pabazuara të dy argumentet mbi të cilat pala paditëse ka themeluar ankimin e saj.

Konkretisht, Kolegji Zgjedhor konstaton se ankimi i paraqitur nga pala paditëse bazohet mbi konsideratën se më herët, nëpërmjet Vendimit Nr.13, datë 28.05.2015, Kolegji Zgjedhor ka pranuar mundësinë e paraqitjes së dorëheqjes nga kandidati i regjistruar për kryetar bashkie dhe, më tej, mundësinë e zëvendësimit të kandidatit për kryetar bashkie nga subjekti zgjedhor në një afat kohor të përcaktuar, që në rastin konkret, sipas palës paditëse, është respektuar prej saj.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se pala paditëse gabon në konsideratat e saj për atë çka Kolegji Zgjedhor ka konkluduar në vendimin e tij nr. 13, datë 28.05.2015. Është e qartë se në vendimmarrjen e tij, Kolegji Zgjedhor ka pasqyruar me përpikmëri të gjithë historikun dhe kronologjinë e ngjarjeve që lidhen me mosmarrëveshjen zgjedhore, duke i evidentuar ato në raport dhe me pretendimet konkrete të palëve, subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në gjykim.

Kolegji Zgjedhor ka konkluduar se KQZ-ja, si organi më i lartë shtetëror i ngarkuar nga ligji për administrimin e zgjedhjeve, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për të trajtuar rastin në tërësi dhe për të dalë me një vendim përfundimtar në lidhje me ligjshmërinë e heqjes dorë të kandidatit për kryetar të Bashkisë Kurbin, z. Altin Biba, të propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni APPD, si dhe për procesin në tërësi të regjistrimit të kandidatit për kryetar bashkie, të propozuar nga subjekti zgjedhor në fjalë.

Detyrimi që Kolegji Zgjedhor ka vendosur për KQZ-në për të marrë vendim për çështjen e regjistrimit të kandidatit për kryetar të Bashkisë Kurbin të propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni APPD, duke trajtuar në themel, në këtë kuadër, si kërkesën për dorëheqje të kandidatit z. Altin Biba, ashtu edhe kërkesën e subjektit zgjedhor Koalicioni APPD, të datës 13.05.2015, për regjistrimin/zëvendësimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Kurbin, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, nuk mund të interpretohet, ashtu siç pala paditëse pretendon, sipas së cilës, Kolegji Zgjedhor, nëpërmjet kësaj vendimmarrje ka marrë përsipër që, në interpretim dhe zbatim të Kodit Zgjedhor, të konsiderojë se Kodi lejon/njih të drejtën e dorëheqjes së kandidatit të regjistruar rregullisht dhe mbi këtë bazë, me tej, lejon/njih edhe të drejtën e subjektit zgjedhor (subjektit politik) për zëvendësimin e kandidatit të saj të regjistruar dhe të dorëhequr më pas, ashtu sikundër të ketë pranuar dhe afate kohore kur këto të drejta janë të lejueshme për t'u ushtruar.

Përkundrazi, ndërsa ka evidentuar si fakte dorëheqjen e kandidatit të regjistruar dhe kërkesën e subjektit zgjedhor për zëvendësimin e tij, kohën e ndodhjes së këtyre ngjarjeve, ashtu sikundër dhe ngjarjen/vendimmarrjen e fundit të komisionit zgjedhor zonal (Vendimin nr. 55, të KZAZ Nr. 15, Qarku Lezhë), ngjarje kjo e fundit që KQZ-ja ka marrë përsipër të trajtojë në vendimmarrjen e ankimuar në atë rast (Vendimin Nr.493, date 20.05.2015), Kolegji Zgjedhor ka konkluduar se KQZ-ja nuk ka shqyrtuar në tërësi çështjen që lidhet me regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Kurbin të propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni APPD, për sa kohë nuk ka trajtuar dy kërkesat si më lart, që në vlerësim të Kolegjit Zgjedhor i përkasin kompetencës së KQZ-së, si dhe për sa kohë nuk ka trajtuar vendimmarrjet e komisionit zgjedhor zonal të marrë në kuadër të procesit të regjistrimit të kandidatit të këtij subjekti

zgjedhor, për të konkluduar përfundimisht për kandidatin për kryetar të Bashkisë Kurbin, të subjektit zgjedhor Koalicioni APPD, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015.

Për asnjë moment Kolegji Zgjedhor nuk ka vënë në diskutim dhe, aq më pak konkluduar, për mundësinë e një kandidati për kryetar bashkie të regjistruar rregullisht për të hequr dorë nga kandidimi dhe, si rrjedhojë e kësaj, për mundësinë e subjektit zgjedhor përkatës për të zëvendësuar kandidatin e regjistruar dhe të dorëhequr apo dhe për afatin kohor kur këto mundësi mund të shfrytëzoheshin.

Përkundrazi, janë pikërisht këto çështje që Kolegji Zgjedhor ka vlerësuar se janë pjesë e një vendimmarrje që i përket së pari juridiksionit të organit shtetëror të ngarkuar nga ligji për administrimin e zgjedhjeve (KQZ-së), pra juridiksionit administrativ dhe, vetëm pas shqyrtimit final të çështjes në këtë juridiksion, ajo potencialisht mund t'i përcillej dhe të bëhej pjesë e juridiksionit gjyqësor të Kolegjit Zgjedhor.

Mbi sa më lart, Kolegji Zgjedhor vlerëson të papranueshem ankimin e paraqitur nga pala paditëse në rastin konkret të themeluar mbi argumentin e pabazuar se, e drejta e kandidatit të regjistruar për kryetar bashkie për të hequr dorë nga kandidimi dhe e drejta e subjektit zgjedhor për zëvendësimin e kandidatit të tij të regjistruar dhe më pas të dorëhequr, janë të drejta të njohura nga Kodi Zgjedhor dhe të pranuar nga Kolegji Zgjedhor në vendimin e mëparshëm të tij të marrë në kuadër të kësaj mosmarrëveshje zgjedhore.

Në vijim, Kolegji Zgjedhor vlerëson të papranueshëm ankimin e palës paditëse të themeluar mbi argumentin e zbatimit të gabuar të ligjit, Kodit Zgjedhor, nga KQZ-ja.

Lidhur me këtë, ndërsa nuk kontestohet, në konsideratë dhe të përfundimeve të mëparshme të tij (në rastin e Vendimit Nr.13, datë 28.05.2015), Kolegji Zgjedhor e vlerëson në përputhje me ligjin disponimin në piken 2 të vendimit objekt ankimi të KQZ-së, për sa i përket konstatimit të pavlefshmërisë absolute të Vendimeve nr. 54 dhe nr. 55, datë 13.05.2015, të KZAZ Nr. 15, Qarku Lezhë.

Më tej, Kolegji Zgjedhor e vlerëson në përputhje me ligjin edhe disponimin në pikën 1 të vendimit objekt ankimi të KQZ-së, për sa i përket mospranimit të kërkesës për heqjen dorë nga kandidimi të kandidatit të regjistruar për kryetar të Bashkisë Kurbin, propozuar nga Kolacioni APPD, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015. Mbi këtë bazë, Kolegji Zgjedhor e vlerëson në përputhje me ligjin edhe disponimin në pikën 3 të vendimit objekt ankimi të KQZ-së, nëpërmjet të cilit, ndërsa është gjetur i ligjshëm, është lënë në fuqi Vendimi nr.50, datë 06.05.2015, i KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë, me të cilin është miratuar kërkesa dhe regjistruar rregullisht si kandidat për kryetar të Bashkisë Kurbin, z.Altin Biba, propozuar nga Koalicioni APPD.

Konkretisht, Kolegji Zgjedhor konstaton se referuar rrethanave të faktit, në situatën kur kandidati i regjistruar/subjekt zgjedhor për kryetar të Bashkisë Kurbin, z.Altin Gjon Biba, paraqitur nga Koalicioni APPD, më datë 09.05.2015, kishte paraqitur një kërkesë për heqjen dorë nga kandidimi dhe, mandej, më datë 13.05.2015, nga subjekti zgjedhor Koalicioni APPD është paraqitur përpara KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë një kërkesë për regjistrimin e Z.Illir Pjeter Pjetraj si kandidat për kryetar të Bashkisë Kurbin, rasti në vetvete paraqitet jo thjesht si “dorëheqje e kandidatit të regjistruar/subjekt zgjedhor”, por mbart edhe problematikën e “zëvendësimit të kandidatit të regjistruar/subjekt zgjedhor”.

Ndërkohë, Kodi Zgjedhor, ndërsa parashikon kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen në paraqitjen e kandidaturës për kryetar të njësive të qeverisjes vendore, afatet dhe procedurën e regjistrimit të tyre, nuk parashikon pozitivisht (në mënyrë lejuese) dhe nuk njeh të drejtën për heqjen dorë nga kandidimi të kandidatit të regjistruar për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe as të drejtën e subjektit zgjedhor (subjektit politik) për zëvendësimin e kandidatit të regjistruar të saj dhe të dorëhequr pas regjistrimit të tij rregullisht.

Në vlerësim të Kolegjit Zgjedhor, mungesa e parashikimit në Kodin Zgjedhor të të drejtës së kandidatit të regjistruar për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore për të hequr dorë nga kandidimi dhe, më tej, të të drejtës së subjektit zgjedhor (subjektit politik) për zëvendësimin e kandidatit të regjistruar të saj dhe të dorëhequr pas regjistrimit të tij rregullisht, tregon se qëllimi i ligjvënësit ka qenë

pikërisht mosdhënia nëpërmjet mosnjohjes pozitivisht të këtyre të drejtave për këto subjekte zgjedhore.

Lidhur me këtë, Kolegji Zgjedhor vlerëson se mungesa e një rregullimi specifik ligjor në Kodin Zgjedhor në lidhje me të drejtën e kandidatit të regjistruar për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore për të hequr dorë nga kandidimi dhe, më tej, me të drejtën e subjektit zgjedhor (subjektit politik) për zëvendësimin e kandidatit të regjistruar të saj dhe të dorëhequr pas regjistrimit të tij rregullisht, nuk mund dhe nuk duhet të interpretohet, sikundër pala paditëse pretendon, sikur ligji (Kodi Zgjedhor) njeh dhe lejon ushtrimin e këtyre të drejtave për sa kohë nuk i kufizon apo ndalon shprehimisht ato.

Për këtë, në konsideratë të natyrës, qëllimit, rëndësisë dhe të asaj c'ka procesi zgjedhor mbart, si dhe të faktit që nëpërmjet Kodit Zgjedhor është synuar përcaktimi në një masë sa më të gjerë dhe të detajuar të mundshme, të rregullave që lidhen me procesin zgjedhor (përfshirë dhe ato për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore), mbi një interpretim logjik të kuadrit ligjor zgjedhor, si dhe referuar parimeve të përgjithshme të rendit juridik, të lidhura këto me parimet themelore të të drejtës zgjedhore, në vlerësim të Kolegjit Zgjedhor, mungesa e një rregullimi specifik në Kodin Zgjedhor për të drejtat si më lart të pretenduara, të çon në përfundimin se subjekteve zgjedhore nuk u janë njohur këto të drejta, duke vlerësuar se kjo mënyrë të kuptuari është më afër qëllimit të ligjvënësit, sikundër dhe në përputhje me interesin publik që mbart procesi zgjedhor, krahas rregullshmërisë së tij. Në të kundërt, nëse qëllimi i ligjvënësit do të kish synuar për njohjen e këtyre të drejtave, atëherë, për vetë rregullshmërinë dhe rëndësinë e procesit zgjedhor, të drejtat në fjalë do të ishin parashikuar shprehimisht në ligjin zgjedhor, përveç se do të ishin parashikuar dhe afate rigorozë, brenda të cilave këto të drejta mund të ushtroheshin, afate këto të tilla që të mos dëmtonin apo pamundësonin realizimin e një procesi zgjedhor në respektim të parimeve bazë të të drejtës zgjedhore, pra zgjedhje universale, të barabarta, të lira, të fshehta, të drejtpërdrejta dhe periodike.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se referuar parashikimeve të neneve 67, 70, 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor, procesi i regjistrimit të kandidatit për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore kalon nëpër disa faza të përcaktuara në afate kohore, deri në përmbylljen përfundimtare të tij dhe konkretisht, faza e paraqitjes së kërkesës, faza e verifikimit

të dokumentacionit dhe faza finale e miratimit të kërkesës dhe regjistrimit të kandidatit të propozuar. Kandidati i propozuar, me regjistrimin e tij zyrtarisht si i tillë, fiton statusin e subjektit zgjedhor, pra të një subjekti të veshur me cilësi të posaçme, duke qenë kështu një nga subjektet e procesit ligjor zgjedhor, që si i tillë, ligji (Kodi Zgjedhor) i jep atij të drejta individuale, por e ngarkon dhe me detyrime. Në këtë kuptim, realizimi/fitimi nga një shtetas, nëpërmjet regjistrimit, të të drejtës për t'u kandiduar si kryetar i një njësie të qeverisjes vendore passjell për kandidatin përgjegjësi (të drejta dhe detyrime) në raport me procesin zgjedhor, subjektet pjesëmarrëse dhe zgjedhësit. Parimi i votimit të lirë (neni 45/3 i Kushtetutës), element i të cilit është liria e zgjedhësve që nëpërmjet rrjedhës normale të procesit zgjedhor të mund të formojnë rregullisht opinionin e tyre për të patur mundësinë që me votë të shprehin preferencën ose pëlqimin për njërin prej alternativave që ofrojnë subjektet zgjedhore, mund dhe duhet të realizohet nëpërmjet paraqitjes dhe njohjes së zgjedhësve me kandidatët e regjistruar dhe programet e tyre, proces që mbart në vetvete përgjegjësinë e kandidatit të regjistruar/subjekt zgjedhor për një sjellje në funksion e pajtim të përmbushjes së këtij parimi. Prandaj, nëse për të drejtat thjesht dhe vetëm individuale mund të pranohet parimisht heqja dorë prej tyre, heqja dorë nga përgjegjësitë nuk është e pranueshme, përveç se kur ligji lejon shprehimisht një gjë të tillë. Është e qartë se përkundër interesit personal prevalon interesi i përgjithshëm, interesi publik, që në rastin konkret konsiston në realizimin e një procesi zgjedhor në respektim të parimeve themelore të të drejtës zgjedhore, për të siguruar kështu ushtrimin nga shtetasit të të drejtës themelore për të zgjedhur atë që do t'i qeverisë ata në nivel vendor. Është pikërisht kjo baza, arsyeja apo përligjia që, në vlerësim të Kolegjit Zgjedhor, ka çuar ligjvënësin të mos parashikojë të drejtën e kandidatit të regjistruar për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore për të hequr dorë nga kandidimi dhe, më tej, si rrjedhojë e kësaj, për të mos njohur të drejtën e subjektit zgjedhor (subjektit politik) për të zëvendësuar kandidatin e saj të regjistruar rregullisht dhe të dorëhequr më pas.

Veç sa më sipër, Kolegji Zgjedhor mban në vëmendje se dispozitat e Kodit Zgjedhor janë hartuar në mënyrë të tillë që mbajnë në fokusin e tyre sistemin zgjedhor proporcional, për shkak të të cilit edhe formulimi i normave, përgjithësisht, u referohet listave të kandidatëve. Këto përkojnë me listat e kandidatëve për zgjedhjet

për Kuvendin dhe listat e kandidatëve për këshillat e bashkive, por jo me kandidatët për kryetarë të bashkive, të cilët nuk zgjidhen sipas sistemit proporcional. Duke pasur në konsideratë sa më sipër, edhe përmbajtja e nenit 73 të Kodit Zgjedhor, lidhur me verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, e konkretisht ndalimi i ndryshimit të emrave të kandidatëve pas miratimit përfundimtar të tyre nga KQZ-ja, sipas pikës 4 të këtij neni, duhet të interpretohet në funksion të qëllimit të ligjvënësit, për të mos lejuar ndryshim të kandidatëve pas regjistrimit të tyre. Dhe, ndërsa ligji pengon ndryshimin e kandidatëve të regjistruar për anëtarë të këshillave bashkiakë, për të cilët zgjedhësit votojnë për subjektin zgjedhor që i ka propozuar, duke mos u pasqyruar ata as në fletën e votimit, është e qartë se për ligjin është e papranueshme ndryshimi i kandidatëve të regjistruar për kryetar të bashkive, për të cilët zgjedhësit votojnë drejtpërdrejtë, duke qenë pikërisht ata (kandidatët) që pasqyrohen dhe në fletën e votimit.

Po kështu, për arritjen e përfundimit si më lart, Kolegji Zgjedhor ka në konsideratë dhe rregullimet ligjore zgjedhore dhe evolimin e tyre ndër vite, ku nga një vlerësim krahasues i tyre, rezulton se vetëm në ligjin elektorale të vitit 1992, ligjvënësi ka njohur/lejuar te drejten e “zëvendësimit të kandidatit të regjistruar”, duke percaktuar njëkohësisht dhe afatin brenda të cilit kjo e drejte mund të ushtrohej. Ndërsa, në ligjet e mëvonshme elektorale, duke filluar nga viti 1996, përfshirë edhe Kodin Zgjedhor të vitit 2003, ligjvënësi ka njohur/lejuar mundësinë/te drejten e “kandidatit në proces verifikimi” për të “tërhequr kandidaturen” duke percaktuar dhe një afat të shkurtër kohor për këtë (24 ore nga verifikimi prej komisionit), nderkohe që, në mënyrë të nënkuptuar, ka pranuar edhe mundësinë e kandidatit për t’u “tërhequr nga kandidimi” edhe pas regjistrimit të tij, por se, për rastin e dytë, pra të “dorëheqjes së kandidatit të regjistruar”, ligjvënësi ka ndaluar zëvendësimin e kandidatit nga subjekti politik që ai përfaqëson. Pra, në ligjet elektorale pararendëse, krahasuar me ato aktualin, është pranuar në mënyrë të shprehur e drejta e “dorëheqjes së kandidatit”, qoftë atij në proces verifikimi, ashtu dhe atij të regjistruar, por se, nëse për rastin e “tërheqjes së kandidatures” nga “kandidati në proces verifikimi”, në mënyrë të nënkuptuar, është pranuar mundësia e “zëvendësimit të kandidatit” nga subjekti politik përkatës, për rastin e “tërheqjes së kandidatures” nga “kandidati i regjistruar”, në mënyrë të shprehur, ligji nuk pranonte, përkundrazi ndalonte, mundësinë e “zëvendësimit të kandidatit” nga subjekti

politik perkates. Nisur nga kjo, rezulton se ligjvenesit kur ka dashur, ka parashikuar shprehimisht te drejten e "dorëheqjes se kandidatit" dhe, ne rrjedhoje te kësaj, edhe mundesine apo pamundesine e subjektit politik per "zevendesimin e kandidatit" ne varesi te momentit te tërheqjes se kandidatures nga kandidati, para apo pas regjistrimit te tij. Po keshtu, rezulton se per ligjvenesin, ne vijimesi, ka qene i papranueshem "zevendesimi i kandidatit te regjistruar dhe te dorëhequr me pas" nga subjekti politik perkates.

Gjithashtu, për arritjen e përfundimit si më lart, Kolegji Zgjedhor ka në konsideratë dhe rregullimet ligjore për marrëdhënie analoge në fushën e të drejtës publike. Kështu, sipas këtyre normave të së drejtës objektive, për një kategori funksionarësh të lartë publik (për shembull Ministri, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese apo i Gjykatës së Lartë, etj), nisur nga rëndësia e funksionit, ligji pengon apo më saktë detyron ata të vijojnë ushtrimin e funksioneve publike, pra të përmbushin përgjegjësitë e tyre sipas funksionit edhe në ato raste kur ata japin dorëheqje dhe ligji lejon një gjë të tillë. Kjo do të thotë se imponimi nga ligji për të vijuar përmbushjen e përgjegjësive ligjore përkundër dëshirës së një individi që ushtron pushtet, merr në konsideratë interesin publik edhe atëherë kur vetë ligji pranon, njeh të drejtën e tij për të hequr dorë nga funksioni. Në këtë kuptim, imponimi nga Kodi Zgjedhor, për shkak të mosdhënies/mosnjohjes së të drejtës së dorëheqjes për subjektin e veshur me cilësi të posaçme, pra për kandidatin e regjistruar për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore, për të vijuar përmbushjen e përgjegjësive të rrjedhura nga qenia e tij subjekt zgjedhor në një proces zgjedhor konkret nuk përbën anomali/devijim, përkundrazi, është një koncept i pranuar edhe nga e drejta publike.

Në analizë të sa më sipër, kolegji konstaton se vendimmarrja e KQZ-së ankimuar nga pala paditëse në rastin konkret, është një vendimmarrje e ligjshme dhe në përputhje me Kodin Zgjedhor, ndaj kërkesëpadia e paraqitur nga Partia Demokratike vlerësohet si e pabazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë,
bazuar në nenin 158, pika 3 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar,

V E N D O S I

Rrëzimin e kërkesëpadisë.

Tiranë, më 05.06.2015

ANËTAR **ANËTAR** **KRYESUES**
GJINOVEFA GABA **ANDI CIVICI** **VALBON ÇEKREZI**

ANËTAR **ANËTAR**
KLITON SPAHIU **EDLIRA PETRI**
(kundër)

MENDIMI KUNDËR.

Unë Gjyqtari, Kliton SPAHIU, anëtar i trupës gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor të çështjes me palë ndërgjyqëse:

PADITESE: Partia Demokratike e Shqipërisë.

I PADITUR: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Palë të interesuar: Partia Socialiste e Shqipërisë.

OBJEKTI: - Kundërshtimi i vendimit nr. 593, datë 01.06.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Gjykimi i çështjes në themel duke vendosur pranimin e dorëheqjes së kandidatit z.Altin Biba dhe regjistrimin e kandidatit të koalicionit Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet z.Illir Pjetër Pjetraj.

BAZA LIGJORE : Nenet 72,73, 145 të K. Zgjedhor.

Jam i mendimit kundra për sa i përket disponimit mbi rrëzimin e padisë nga shumica e kësaj trupe gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor,

duke mbetur në mendimin se padia është e bazuar në prova dhe ligj, e për pasojë duhet pranuar për sa më poshtë:

Partia Demokratike e Shqipërisë (*më poshtë referuar si PD*), në përputhje me nenin 64 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, është regjistruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (*me poshtë KQZ*) si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015. Pala paditese PD, bashkë me disa parti politike të regjistruara rregullisht si subjekte zgjedhore, bazuar në nenin 65 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, janë regjistruar nga KQZ-ja si koalicion zgjedhor në shkallë vendi, nën emrin Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet (*referuar si APPD në vijim*), për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015.

Koalicioni Zgjedhor APPD, në respektim të së drejtës së përcaktuar në nenin 165/3 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar dhe në përputhje me kërkesat e nenit 67 të këtij Kodi, brenda afatit të përcaktuar nga kjo dispozitë (*që në rastin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015 është llogaritur deri me datë 4 maj 2015*), ka paraqitur përpara Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor Nr.15, Qarku Lezhë (*më poshtë referuar si KZAZ Nr. 15, Qarku Lezhë*) një kërkesë për regjistrimin e Z. Altin Biba si kandidat për kryetar të Bashkisë Kurbin për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, duke i bashkëlidhur asaj dhe dokumentet e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar.

Rezulton se, KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë, bazuar në nenet 33/f dhe 73 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, me Vendimin Nr.50, datë 06.05.2015, ndërsa ka gjetur të rregullt dhe në përmbushje të kërkesave të ligjit dokumentet e kandidimit, ka vendosur "*Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015 të regjistrojë si kandidat për kryetar të Bashkisë Kurbin, Z. Altin Gjon Biba, paraqitur nga Koalicioni Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet*".

Ndërkohe, pranohet se ditën e tretë mbas shpalljes së këtij vendimi, pra me datë 09.05.2015, pranë KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë, kandidati i regjistruar si me lart, Z. Altin Biba, ka paraqitur një kërkesë për heqjen dorë nga kandidimi.

Me datë 10.05.2015, kërkesën për heqje dorë nga kandidimi i kandidatit të regjistruar Z. Altin Biba, KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë ia ka përcjellë KQZ-së, por edhe subjektit zgjedhor Koalicionit APPD (*partise politike kryesuese të koalicionit PD*).

Ndërsa ka ardhur në dijeni për heqjen dorë nga kandidimi të Z. Altin Biba dhe ndërsa nuk ka patur ndonjë veprim nga organet e administratës zgjedhore, rezulton se, me datë 13.05.2015, subjekti zgjedhor Koalicioni APPD ka paraqitur përpara KZAZ Nr.13, Qarku Lezhë një kërkesë për regjistrimin e Z. Ilir Pjeter Pjetraj si kandidat për kryetar të Bashkisë Kurbin për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, duke i bashkëlidhur asaj dhe dokumentet e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar.

Rezulton se, po me datë 13.05.2015, KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë të ketë shqyrtuar fillimisht kërkesën e Z. Altin Biba për heqjen dorë nga kandidimi, ku në përfundim, me Vendimin Nr.54, të ketë vendosur *“1. Shfuqizimin e vendimit nr.50, date 06.05.2015. 2. Ç’regjistrimin e kandidatit për Kryetar të Bashkisë Kurbin të Partisë Demokratike Z. Altin Gjon Biba”*.

Në po atë datë, (me 13.05.2015), rezulton se KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë, të ketë shqyrtuar dhe kërkesën për regjistrim kandidati të Koalicionit APPD, ku në përfundim, me Vendimin Nr.55, ka vendosur *“Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015 të regjistrojë si kandidat për kryetar të Bashkisë Kurbin, Z. Ilir Pjeter Pjetraj, paraqitur nga Koalicioni Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet”*.

Me këtë vendim të KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë (*Vendimin Nr.55, date 13.05.2015*), nuk ka qenë dakort subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë (*me poshte referuar si PS*), e cila ka paraqitur përpara KQZ-se një ankim zgjedhor (*identifikuar si Kërkesa Ankimore Nr.21*), me të cilin ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe shfuqizimin e tij, me pretendimin se ky vendim është absolutisht i pavlefshëm për shkak se është marrë jashtë cdo procedure dhe afati ligjor të përcaktuar në nenin 73/4 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar për depozitimin e dokumenteve të kandidimit dhe për regjistrimin e kandidatëve për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore.

Sipas subjektit zgjedhor ankues, *Kodi Zgjedhor i ndryshuar nuk parashikon tërheqjen nga kandidimi të kandidatit të regjistruar rregullisht dhe as zëvendësimin e tij nga subjekti zgjedhor që e kishte propozuar, përkundrazi, neni 73/4 i Kodit Zgjedhor, pengonte një gjë të tillë, c’ka do të thoshte se KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë, pas kalimit të afatit të dorëzimit të dokumenteve të kandidimit, në mënyre kategorike nuk mund të merrte asnjë vendim për ndryshim apo zëvendësim të emrit të kandidatit të regjistruar rregullisht*

brenda afatit ligjor. Vendimmarrja e paligjshme e KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë, ka sjellë si pasojë c'regjistrimin e kandidatit të regjistruar në respektim të Kodit Zgjedhor, dhe regjistrimin e një kandidati tjetër, jashtë cdo afati ligjor prekluziv dhe rregullave të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor, duke ndikuar kjo vendimmarrje negativisht në proceset zgjedhore të mëvonshme në kuadër të përgatitjes së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015.

Ankesa e paraqitur nga subjekti zgjedhor PS është shqyrtuar nga KQZ-ja në Mbledhjen e datës 20.05.2015. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, KQZ-ja, me Vendimin Nr.493, datë 20.05.2015, bazuar në nenet 68/2, 73, 124 dhe 143/1/c të Kodi Zgjedhor të ndryshuar, ka vendosur: *“Konstatimin e pavlefshërisë absolute të Vendimit nr.55, datë 13.05.2015 të KZAZ nr.15, “Për regjistrimin e z. Ilir Pjetraj, si kandidat për kryetar bashkia Kurbin, propozuar nga koalicioni APPD dhe pranimin e kërkesës ankimore nr.21, të Partisë Socialiste”.*

Kundër vendimit si më lart të KQZ-së, brenda afatit ligjor 5-ditor, me datë 22.05.2015, ka paraqitur ankim/padi subjekti zgjedhor PD, me të cilën, duke paditur KQZ-në, si dhe duke thirrur si palë të interesuara PS dhe Z. Ilir Pjetraj, ka kundërshtuar Vendimin e KQZ-së Nr.493, datë 20.05.2015, duke kërkuar shfuqizimin e tij dhe gjykimin në themel të çështjes dhe lënien në fuqi të Vendimit Nr.55, date 13.05.2015, të KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë.

Kolegji Zgjedhor në shqyrtim të padisë të ngritur nga subjekti zgjedhor PD, ka vlerësuar se Vendimi i KQZ-së Nr.493, datë 20.05.2015 është marrë në kundërshtim me ligjin dhe si i tillë duhet të shfuqizohet. Ndërkohe, përse është kërkuar dhe lidhet me regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Kurbin në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni APPD, ndërsa konstatohet se KQZ-ja nuk ka marrë një vendim përfundimtar për këtë çështje, Kolegji Zgjedhor ka vlerësuar se ishte rasti për të detyruar KQZ-në të marrë vendim duke shqyrtuar në themel çështjen.

Vendimi Nr 13, datë 28.05.2015 i Kolegjit Zgjedhor ka vendosur: *“1. Shfuqizimin e Vendimit Nr.493, date 20.05.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. 2. Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që, jo më vonë se data 30.05.2015, të marrë vendim për çështjen e regjistrimit të kandidatit të propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni Aleanca Popullore për Pune dhe*

Dinjitet, duke trajtuar ne themel edhe kerkesen per dorëheqje te kandidatit Altin Biba dhe kerkesen e subjektit zgjedhor Koalicioni Aleanca Popullore per Pune dhe Dinjitet, te dates 13.05.2015, per regjistrimin/zevendesimin e kandidatit per kryetar te Bashkise Kurbin, Qarku Lezhe, ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015”.

Pas marrjes në shqyrtim të çështjes për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni APPD, me datë 01.06.2015, KQZ-ja ka vendosur; “-1. Mospranimine dorëheqjes të kandidatit për kryetar për bashkinë Kurbin, propozuar nga koalicioni APPD. -2. Konstatimin e pavleshmërisë absolute të vendimit Nr 54 dhe 55 të KZAZ-së, Nr 15. -3. Lënien në fuqi të vendimit Nr 50, të KZAZ-së Nr 15”.

Kundër këtij vendimi, Nr 593, datë 01.06.2015, të KQZ-së, është parashtruar ankim/padi nga subjekti zgjedhor PD. Në kërkesë-padi kërkohet që çështja të gjykohet në themel duke vendosur pranimin e dorëheqjes së kandidatit z. Altin Biba dhe regjistrimin e kandidatit të koalicionit “Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet”, z. Ilir Pjetër Pjetraj.

Pas shqyrtimit të padisë nga ky Kolegj, jam i mendimit se vendimarrja e shumicës së këtij kolegji është në shkelje të parimeve kushtetuese, në interpretim të gabuar të Kodit Zgjedhor, si dhe në kundërshtim me vendimarrjet e mëparshme të këtij Kolegji Zgjedhor, dhe më konkretisht me vendimin Nr 13, të datës 28.05.2015.

-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 1 dhe 45), por edhe në parimet e sanksionuara në nenin 3 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, garanton të drejtën e shtetasve për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur, ashtu sikundër dhe të drejtën e subjekteve zgjedhore për të garuar lirisht ne zgjedhje, duke paraqitur alternativën e tyre qeverisëse në secilin nivel sipas rregullave mbi të cilat funksionon një demokraci parlamentare, ku për përfitimin e këtyre të drejtave Kushtetuta vendos një sërë kriteresh dhe procedurash që duhen respektuar, me qëllim që parashikimet kushtetuese dhe ligjore të mos mbeten thjesht parashikime boshe, por të bëhen efektive, ndërkohë që thelbi i të drejtave kushtetuese nuk mund të zhbëhet dhe as të denatyrohet.

E drejta e shtetasve për të zgjedhur nuk mund të kuptohet vetëm me lirinë e zgjedhesve për të votuar, por edhe me mundësinë që ata duhet të kenë për të zgjedhur midis disa alternativave që

subjektet zgjedhore në garë përfaqësojnë dhe ofrojnë, duke qenë pikërisht ky dallimi midis zgjedhjeve të lira dhe demokratike në vendet me demokraci të zhvilluar dhe zgjedhjeve në vendet diktatoriale apo me sistem një partiak, ku “zgjedhjet” shndërrohen në një procedure “votëbesimi” ndaj klasës politike në fuqi.

-Kodi Zgjedhor nuk ka parashikuar për rastin në shqyrtim se si procedohet kur një kandidat dorëhiqet. Ky boshllëk ligjor nuk duhet të penalizojë subjektin zgjedhor dhe as kandidatin e tij, por normat e këtij kodi (*i cili hesht për këtë rast në shqyrtim*) duhen interpretuar në mënyrë më të favorshme për subjektin zgjedhor dhe për kandidatin, për t'i paraprirë një procesi zgjedhor demokratik dhe garues jo vetëm në dukje por edhe në thelb.

Referuar Kodit Zgjedhor (*sqaruar edhe në vendimin Nr 13, datë 28.05.2015*), janë përcaktuar dhe afatet dhe procedurat e verifikimit të dokumentacionit zgjedhor. Në nenin 73 të Kodit Zgjedhor përcaktohen procedurat dhe afatet respektive të procesit të verifikimit të dokumentacionit zgjedhor, ku sipas kësaj dispozite, komisioni përkatës (*KQZ apo sipas rastit KZAZ*), nga verifikimi i dokumentacionit të kandidimit, nëse vëren parregullsi ia kthen ato subjektit zgjedhor për korrigjim jo më vonë se 45 ditë para datës së zgjedhjeve (*e llogaritur në datë kalendarike në rastin e këtyre zgjedhjeve ky afat është jo më vonë se data 7 maj 2015*), ndërkohe që në vazhdim të procedurave të parashikuara nga kjo dispozite (pika 2), subjektet zgjedhore duhet të ridepozitojnë dokumentacionin e korrigjuar jo më vonë se 42 ditë para datës së zgjedhjeve (*e llogaritur në datë kalendarike në rastin e këtyre zgjedhjeve ky afat është jo më vonë se data 10 maj 2015; në zbatim të nenit 125 të Kodit Zgjedhor, duke qenë se data 10 maj 2015 ishte ditë e diel, afati i fundit për kthimin për plotësim të dokumentacionit të kandidimit ka qenë data 11 maj 2015*) dhe, në vijim, po sipas kësaj dispozite (pika 2), komisioni përkatës ka detyrimin të marrë vendimin përfundimtar për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit të kandidimit brenda 48 orëve (*që e llogaritur në ditë kalendarike në rastin e këtyre zgjedhjeve afati i fundit për miratimin ose refuzimin përfundimtar të dokumentacionit të kandidimit ka qenë data 13 maj 2015*);

Në rastin konkret, KZAZ Nr.15, me Vendimin Nr.50, datë 06.05.2015, ka regjistruar kandidatin për kryetar Bashkia Kurbin të propozuar nga Koalicioni APPD, në përputhje me afatet e përcaktuara në nenet 67 dhe 73 të Kodit Zgjedhor.

Rezulton që në datë 09.05.2015, pranë KZAZ Nr.15 është depozituar dorëheqja e Z.Altin Biba nga kandidimi, ndërsa, më datë 13 maj 2015, pranë KZAZ Nr.15 është depozituar një kërkesë për regjistrimin e kandidatit për kryetar Bashkia Kurbin, Z.Illir Pjetraj, i propozuar nga Koalicioni APPD. Pra ndodhemi përpara një situatë të paparashikuar në Kodin Zgjedhor, por brenda afateve limit të parashikuara nga Kodi, që është data 13.05.2015, *(për sa interpretuar në sipër)*.

Subjekti zgjedhor në konkurim ka të drejtë të përfaqësohet në zgjedhje për organet e qeverisjes vendore me një kandidat efektiv. Legjislati në Republikën e Shqipërisë udhëhiqet nga parimi çfarë nuk ndalohet, lejohet, për pasojë nuk duhet t'i mohohet e drejta për të zëvendësuar kandidatin e subjektit zgjedhor kur kjo kryhet brenda disa afateve limit të parashikuara nga kodi dhe kur nuk kanë ardhur pasoja për mbarëvatjen dhe organizimin e zgjedhjeve në kohë.

Gjithashtu është e rëndësishme që zgjedhësve të mos i mohohet e drejta për të zgjedhur. Nuk mund të jemi përpara një procesi zgjedhor konkurrues, të rregullt dhe të besueshëm, kur zgjedhësi është përpara një alternative të mbetur në tentativë dhe fiktive. Zgjedhësi në rastin konkret është pa alternativë edhe për faktin se vota për një kandidat të dorëhequr, s'ka prespektivë dhe destinacion.

Dorëheqja në vetvete është vullnet i kandidatit i shprehur me shkrim dhe nuk i lind detyrimi atij subjekti të provojë arsyet dhe motivet *(sic dhe arsyetoni KQZ në vendimin e saj)* e kësaj dorëheqjeje. Kodi Zgjedhor nuk e ka të parashikuar procedurën si paraqitet dorëheqja dhe nëse ajo duhet motivuar *(dhe provuar me prova shkresore)*, për pasojë nuk ka pse KQZ-ja të kryente një hetim administrativ.

Mosshqyrtimi në kohë nga KQZ-ja, e kërkesës për heqjen dorë nga kandidimi, të kandidatit të regjistruar, ka çënuar të drejtën e subjektit zgjedhor Koalicionin APPD, për të marrë pjesë në zgjedhje, vullnetin për realizimin e të cilës tashmë e kishte shprehur më parë. Në kohë nuk është shprehur KQZ-ja edhe për sa i përket kërkesës së kandidatit zëvendësues Ilir Pjetri, kërkesë e cila është paraqitur brenda afateve kohore tërësore të procesit të regjistrimit të kandidatëve *(e cila nuk kishte përfunduar ende për sa arsyetuar më sipër dhe që mbaronte pikërisht me datë 13 maj 2015, kur edhe është paraqitur kërkesa)*. Në thelb kërkesa e paraqitur synon zëvendësimin e kandidatit të propozuar dhe regjistruar me herët, i

cili fillimisht kishte shprehur vullnetin për të kandiduar, por që më vonë, pas regjistrimit, ishte shprehur për heqjen dorë nga kandidimi.

Kolegji Zgjedhor në këtë gjykim ka diskrecion të zgjidhë çështjen përfundimisht duke përcaktuar një kandidat real, me vullnet e tij të lirë (*të shprehur*) për të kandiduar, dhe me vullnetin e subjektit zgjedhor, të cilin ai përfaqëson.

Në respektim të parimeve kushtetuese mbi lirinë dhe të drejtat politike, në respektim të KEDNj dhe të Paktit për të Drejtat Civile dhe Politike, në intepretim të zgjeruar, tolerant, pluralist dhe demokratik të Kodit Zgjedhor, si dhe në praktikën e Kolegjit Zgjedhor, çështja konkrete duhet zgjidhur me zëvendësimin e kandidatit të propozuar nga subjekti zgjedhor APPD.

Mbetem në mendimin se padia duhej të ishte pranuar, duke shfuqizuar vendimin e KQZ-së Nr 593, datë 01.06.2015, dhe duke e gjykuar në themel, pranimin e dorëheqjes së kandidatit Altin Biba dhe regjistrimi i kandidatit të koalicionit APPD, z.Illir Pjetraj.

Tiranë sot me datë 05.06.2015.

GJYQTARI

Kliton SPAHIU

* * *



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR

NR. 19 REGJ. THEMELTAR
DATË 05.06.2015 REGJ.

NR. 19 VENDIMI
DATË 08.06.2015 VENDIMI

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUES : Edlira PETRI
ANËTAR : Andi CIVICI
ANËTAR : Valbon ÇEKREZI
ANËTAR : Kliton SPAHIU
ANËTAR : Petrit ÇENO

asistuar nga sekretarja gjyqësore Rexhina Baçi, mori në shqyrtim, në seancën gjyqësore me dyer të hapura të datës 08.06.2015, çështjen zgjedhore, që u përket palëve :

PADITËSE : **Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet**, e përfaqësuar nga Kryetari Z. Shpëtim Idrizi, si dhe av. Eno Bushi dhe z. Gazmend Osmani.

I PADITUR : **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, i përfaqësuar me autorizim nga Znj. Ana Tenolli.

PALË TË INETERESUARA : 1. **Partia Socialiste e Shqipërisë**, e përfaqësuar nga z. Gledian Llatja dhe Elion Semanaj;
2. **Partia Demokratike e Shqipërisë**, e përfaqësuar nga z. Ivi Kaso;
3. **Partia Lëvizja Socialiste për Integrim**, e përfaqësuar nga z. Dritan Fejzo;

4. **Partia Republikane**, e përfaqësuar nga z. Arjan Madhi.

OBJEKTI : Kundërshtimi i vendimit nr. 611, datë 02.06.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me objekt “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 Qershor 2015”; Gjykimin e çështjes në themel duke vendosur ndryshimin e vendimit të sipërcituar, caktimin e partisë politike parlamentare Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet të marrë pjesë në shortin për anëtarin e tretë ose të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave.

BAZA LIGJORE : Nenet 95 pika 2, 96 pika 1, 145 e vijues të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim të gjyimit, palët pjesëmarrëse i kërkuan Kolegjit Zgjedhor :

Pala paditëse Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, nëpërmjet përfaqësuesve të saj Z. Shpëtim Idrizi dhe av. Eno Bushi: pranimin e padisë;

Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe palët e interesuara Partia Demokratike e Shqipërisë, Partia Republikane, Partia Socialiste e Shqipërisë, Lëvizja Socialiste për Integrim, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre: Rrëzimin e padisë;

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoi pjesëmarrësit, shqyrtoi aktet dhe diskutoi çështjen në tërësi

V Ë R E N

Pala paditëse, subjekti zgjedhor Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (më tej, referuar si PDIU) ka paraqitur në Kolegjin Zgjedhor ankimin kundër vendimit nr. 611, datë 02.06.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (më tej referuar si KQZ) “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

të datës 21 Qershor 2015”.

Mosmarrëveshja zgjedhore objekt i këtij ankimit, rezulton se ka si shkak të saj faktet e mëposhtme :

Në mbledhjen e datës 02.06.2015 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (më tej, KQZ) ka pasur në rendin e ditës edhe shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e partive politike të cilave ju lind e drejta të marrin pjesë në shortin për anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015”.

Në përfundim të mbledhjes, me vendimin nr. 611, datë 02.06.2015 KQZ-ja ka vendosur:

1. Partia politike e shumicës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të Grupeve të Numërimit të Votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015, është Lëvizja Socialiste për Integrim.
2. Partia politike e opozitës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015, është Partia Republikane.

Vendimi i mësipërm është bazuar në nenet 95 dhe 96 të Kodit Zgjedhor që rregullojnë mënyrën e ngritjes së Grupeve të Numërimit të Votave dhe konkretisht :

Neni 95 “Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV)”

“1. Për numërimin e votave në rang ZAZ-je, me vendim të KZAZ-së, 10 ditë para ditës së votimit, caktohen Grupe Numërimi të Votave. Numri i grupeve numërimit është dy për çdo tavolinë numërimi, sipas pikës 2 të nenit 94 të këtij Kodi. Anëtarët e grupeve të numërimit të votave duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e neneve 30 dhe 31 të këtij Kodi. Propozimet për emërimin e anëtarëve duhet të dorëzohen në KZAZ të paktën 12 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

2. Grupet e numërimit të votave përbëhen nga katër anëtarë, ku në çdo rast një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike, së cilës i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar pas propozimit të partisë që i përket nënkryetari, ndërsa anëtarin e tretë propozohet

nga partitë e shumicës qeverisëse dhe anëtari i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të këtij Kodi....”

Neni 96 “Procedura për përcaktimin e partive që propozojnë anëtarë të GNV-ve”

1. Partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin e KZAZ-së, përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ ndërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive të opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë. Në çdo rast, pas hedhjes së shortit për çdo ZAZ, të drejtën e propozimit për dy anëtarë të Grupit të Numërimit të Votave e ka një parti e shumicës parlamentare dhe një parti e opozitës parlamentare.... .”

Në kushtet kur PDIU është parti parlamentare dhe si e tillë ajo ka katër mandate të fituara në zgjedhjet për Kuvendin të datës 23.06.2013, ajo ka bërë ankim në Kolegjin Zgjedhor ndaj vendimit të KQZ-së, duke parashtruar këto pretendime:

Praninë në Grupet e Numërimit të Votave, PDIU-së ia garanton Kodi Zgjedhor, si dhe numri i deputetëve që kjo forcë politike ka fituar në zgjedhjet për Kuvendin të datës 23.06.2013. PDIU ka fituar katër mandate deputeti, ndaj referuar nenit 96 të Kodit Zgjedhor, ajo ka të drejtën të marrë pjesë në shortin për përcaktimin e partive që do të propozojnë anëtarin e tretë ose të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave.

Gjatë parashtrimit të pretendimeve në seancën e shqyrtimit të çështjes në Kolegjin Zgjedhor, përfaqësuesit e palës paditëse PDIU paraqitën edhe këto pretendime

- KQZ, në mënyrë të paligjshme dhe të pabazë, i ka mohuar PDIU-së të drejtën për të marrë pjesë në shortin e partive që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve;

- Në vetë përmbajtjen e shkresave të Kuvendit, drejtuar KQZ-së, rezulton e provuar se është përcaktuar qartë pozicioni i PDIU-së, si parti parlamentare e dalë nga zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013;
- Në lidhje me përcaktimin e partisë politike, si parti e shumicës a pakicës parlamentare, referuar neneve 95 dhe 96 të Kodit Zgjedhor, rezulton se faktor përcaktues për këtë ndarje është rreshtimi politik i partive në zgjedhjet pararendëse parlamentare. Në rastin konkret, PDIU rezulton të ketë qenë pjesë e opozitës parlamentare;
- Edhe procedura e vendimmarrjes së KQZ-së është kryer në shkelle të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të KQZ-së dhe të nenit 24 e vijues të Kodit Zgjedhor, pasi për këtë vendim është votuar gjashtë herë, referuar procesverbalit të mbledhjes;
- Në lidhje me vendimin e zbardhur, KQZ-ja ka lëshuar dy ekzemplarë të vendimit objekt ankimi me përmbajtje të ndryshme të tyre.

Pala e paditur KQZ, ashtu si edhe subjektet e interesuara kanë kërkuar rrëzimin e padisë, duke parashtruar përkatësisht këto argumente:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve :

- KQZ ka detyrimin ligjor që, jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve të përcaktojë partitë politike që kanë të drejtën të propozojnë anëtarët e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, kompetencë e cila ushtrohet në zbatim të neneve 95, pika 2 dhe 96, pika 1 të Kodit Zgjedhor;
- Për të përmbushur këtë detyrim, KQZ-ja i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, të cilit i ka kërkuar listën e partive politike të shumicës parlamentare dhe listën e partive politike të shumicës parlamentare, si dhe numrin e mandateve të fituara nga secila prej tyre në zgjedhjet për

Kuvendin të datës 23.06.2013. Nga informacioni i marrë ka rezultuar veç të tjerash se PDIU rezulton të jetë në listën e partive politike të pakicës parlamentare (me 4 mandate), krahas Partisë Demokratike (me 50 mandate) dhe asaj Republikane (me 3 mandate), ndërkohë që si parti të shumicës parlamentare janë renditur Partia Socialiste e Shqipërisë (me 65 mandate) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (me 16 mandate);

- KQZ, duke marrë në konsideratë faktin që PDIU është regjistruar në këto zgjedhje në koalicionin “Aleanca për Shqipërinë Europiane”; vendimet e mëparshme të KQZ-së për çështje analoge; praktikën gjyqësore lidhur me këto çështje; udhëzimet e Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore; është gjendur në vështirësi për të përcaktuar nëse PDIU është një parti e shumicës apo e pakicës parlamentare, në kuptim të nenit 95, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Sa më sipër ka si shkak jo vetëm të dhënat e mbledhura, por edhe vetë qëndrimin e përfaqësuesit të PDIU gjatë mbledhjes së KQZ-së, sipas të cilit kjo parti nuk kishte përkatësi në koalicione, apo në qëndrimet e dyshimta të ndonjë deputeti të kësaj force politike, për qëndrimin e saj në opozitë me qeverisjen aktuale, ndonëse marrëveshja e lidhur mes kësaj partie me koalicionin qeverisës e pozicionon atë në krahun e kundërt me opozitën;
- Veç sa më sipër, referuar përcaktimit ligjor të nenit 95, pika 2, kur shprehet për “parti të shumicës qeverisëse”, rezulton se ky kriter plotësohet vetëm nga Lëvizja Socialiste për Integrim, e cila përfaqësohet në qeveri me katër anëtarë, ndërkohë që PDIU nuk e plotëson këtë kriter.
- Si konkluzion vendimi i marrë nga KQZ garanton parimin e baraspeshimit politik, parashikuar në nenin 29 të Kodit Zgjedhor, ndërkohë që edhe vetë ankuesi në padinë e tij, nuk është i qartë nëse duhet të marrë pjesë në propozimin e anëtarit të tretë apo të katërt të GNV-ve.

Subjektet e interesuara kërkuan rrëzimin e padisë, pasi nga njëra anë, PD dhe PR e cilësuan PDIU-në si parti e shumicës parlamentare për sa kohë që edhe në këto zgjedhje ato konkurrojnë me PS dhe LSI, së bashku në koalicion dhe sepse ky përcaktim duhet bërë referuar pozicionimit faktit dhe aktual të një partie politike, ndërkohë që PS dhe LSI e cilësuan PDIU-në si parti të opozitës parlamentare duke i'u referuar për këtë rezultatit të zgjedhjeve të fundit për Kuvendin të 23 qershorit 2013, në të cilat kjo parti nuk ka qenë në koalicionin që formoi qeverisjen. Përfaqësuesit e PD dhe PR, referuan edhe në praktikën e mëparshme zgjedhore të KQZ-së dhe Kolegjit Zgjedhor, të cilat në përcaktimin e numëruesve, janë udhëhequr nga parimi i garantimit të balancës politike. Përfaqësuesi i LSI-së parashtroi nga ana tjetër, se pala paditëse, gjatë shqyrtimit të çështjes pranë KQZ-së nuk arriti të qartësojë pozicionimin e saj politik, në shumicën apo pakicën parlamentare, ndërkohë që përkatësia në shumicën parlamentare përcaktohet nga fakti nëse partia është apo jo pjesë e qeverisjes, siç është LSI, por jo PDIU. Në vijim të këtij pretendimi, parashtrohet se edhe në referencë të nenit 96 të Kodit Zgjedhor, përkatësia politike përcaktohet nga zgjedhjet pararendëse parlamentare, duke i'u referuar bashkimeve politike në këto zgjedhje.

Kolegji Zgjedhor, duke mbajtur në vëmendje:

- faktin që pala paditëse PDIU aktualisht është regjistruar në këto zgjedhje në koalicionin "Aleanca për Shqipërinë Europiane";
- pala paditëse duke qenë në aleancë me partitë qeverisëse në zgjedhjet e qeverisjes vendore të 21 qershorit 2015, nuk mund të jetë parti opozitare për këto zgjedhje lokale, në respektim dhe të balancave politike dhe transparencën e leximit të votës;
- vendimet e mëparshme të KQZ-së për çështje analoge;

konkludon se Pala paditëse PDIU, duhet të konsiderohet si parti e shumicës qeverisëse e cila duhet të propozoj për anëtarin e tretë të GNV-ve.

Subjekti Zgjedhor PDIU, në kërkes-padinë drejtuar Kolegjit Zgjedhor ka kërkuar ndryshimin e vendimit Nr 611, datë 02.06.2015 të KQZ-së, dhe caktimin e saj në shortin për anëtarin e tretë ose të katër të Grupit të Numërimit të Votave.

Në gjykim pala paditëse PDIU, e kufizoi kërkimin e saj duke kërkuar që të marrin pjesë në shortin për anëtarin e katër të Grupit të Numërimit të Votave, që do të emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtar të GNV-ve, për ZAZ respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të Kodit Zgjedhor.

Me këtë qëndrim të mbajtur në gjykim, pala paditëse Partia PDIU, prezumohet të ketë hequr dorë nga kundërshtimi i vendimit Nr 611, datë 02.06.2015 të KQZ-së, për pikën e parë të saj, në të cilën është vendosur që *“Partia politike e shumicës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të Grupeve të Numërimit të Votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015, është Lëvizja Socialiste për Integrim”*.

Është fakt se paditësi PDIU, aktualisht është Parti e shumicës qeverisëse, dhe si e tillë asaj i lind e drejta të propozoj për anëtarin e tretë të GNV-së, në hedhjen e shortit, nga kërkitimi i cili është hequr dorë gjatë gjykimit.

Pala paditëse PDIU, duke qenë një Parti e shumicës qeverisëse, ajo nuk legjitimohet të kërkoj të bëj propozimin e anëtarit të katër që i përket partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-së, për ZAZ-në, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të K.Zgjedhor.

Në këto kushte kërkitimi i palës paditëse PDIU është i pabazuar në Kodin Zgjedhor dhe për pasojë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës Apelit Tiranë bazuar në nenin 158, pika 1, shkronja “b” dhe pika 3 të Kodit Zgjedhor.

VENDOSI:

- Rrëzimin e padisë së palës paditëse Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet.

Tiranë, 08.06.2015

GJYQTAR
Andi CIVICI

GJYQTAR
Valbon ÇEKREZI

KRYESUES
Edlira PETRI
(kundër)

GJYQTAR
Petrit ÇENO

GJYQTAR
Kliton SPAHIU
(pjesërisht kundër)

MENDIM PAKICE

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, me vendimin nr. 19, datë 08.06.2015 vendosi të rrëzojë padinë e subjektit zgjedhor Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, duke zgjidhur në themel mosmarrëveshjen zgjedhore të referuar prej kësaj të fundit, lidhur me vendimin nr. 611, datë 02.06.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Si anëtare e këtij Kolegji, ndaj mendim të kundërt me atë të shumicës, për arsye se sipas vlerësimit tim vendimi nr. 611/2015 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhej të konstatohet si i pavlefshëm dhe çështja të shqyrtohet sërish nga ky organ.

Nga gjykimi i çështjes kanë rezultuar faktet e mëposhtme:

Në mbledhjen e datës 02.06.2015 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (më tej, KQZ) ka pasur në rendin e ditës edhe shqyrtimin e projektvendimit *“Për caktimin e partive politike të cilave ju lind e drejta të marrin pjesë në shortin për anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015”*.

Sipas procesverbalit të zbardhur të mbledhjes së KQZ-së, datë 02.06.2015, (ora 13:20 e fillimit), rezulton se kanë marrë pjesë në të, anëtarët e këtij organi, stafi administrativ i tij, subjektet zgjedhore PD, PS, LSI, PR, PSD, FRD, PKSH, organizata ndërkombëtare, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë, OSBE, ODIHR.

Referuar fakteve që lidhen me zhvillimin e mbledhjes, debatit mbi rendin e ditës dhe konkluzionit/vendimmarrjes lidhur me të, konstatohet se KQZ-ja i ka lejuar vetes shkelje të tilla të procesit, që cenojnë thelbin e tij, për shkak të të cilave vlerësoj se “vendimi” i shpallur dhe publikuar, duhej të cilësohej si absolutisht i pavlefshëm, situatë e cila detyron KQZ-në të rimarrë në shqyrtim çështjen, duke ushtruar kompetencën e saj në përputhje me ligjin.

Duke renditur kronologjikisht faktet procedurale të evidentuara nga procesverbali i mbledhjes së KQZ-së, rezulton sa vijon:

- Propozimi për vendimin që duhej të merrej nga KQZ-ja, konsistonte në përcaktimin e rregullave, mbi të cilat do të organizohej më pas, shorti për çdo ZAZ, lidhur me përcaktimin e anëtarit të tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, referuar për këtë neneve 95 dhe 96 të Kodit Zgjedhor. Lidhur me këtë çështje nga administrata e KQZ-së është parashtruar se paraprakisht ishin kërkuar të dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë lidhur me listën e partive të shumicës parlamentare dhe atyre të opozitës parlamentare. Nga informacioni i marrë ka rezultuar se Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, si parti e mazhorancës kishte 16 mandate, kurse partia Republikane dhe ajo Drejtësi, Integrim dhe Unitet si parti të opozitës parlamentare kishin respektivisht 3 dhe 4 mandate. Ndërsa ka qenë e qartë situata lidhur me Partinë LSI dhe PR, për Partinë PDIU është parashtruar se zotërimi i katër mandateve i jep asaj të drejtën për të marrë pjesë në shortin për përcaktimin e anëtarit të tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave;
- Pas parashtrimit të situatës si më sipër, ka filluar debati, nga i cili në mënyrë të përmbledhur rezultojnë dy opinione. Së pari, tre nga anëtarët e KQZ-së së bashku

me përfaqësuesit e Partisë Demokratike dhe Partisë Republikane, kanë dhënë argumentet sipas të cilave, PDIU duhej të klasifikohej si parti e shumicës parlamentare dhe si e tillë ajo duhej të merrte pjesë në shortin për përcaktimin e partive që do të propozojnë anëtarin e tretë të grupeve të numërimit të votave, short që duhej të hidhej mes saj dhe LSI. Nga ana tjetër, tre anëtarë të tjerë të KQZ-së, së bashku me përfaqësuesit e Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, kanë parashtruar se PDIU nuk është parti e shumicës qeverisëse, referuar për këtë rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2013 dhe faktit se kjo parti nuk i ka dhënë votën mbështetëse qeverisë. Mbi këtë bazë, këta të fundit mbajnë qëndrimin se PDIU duhet të marrë pjesë në shortin për përcaktimin e partisë politike, që do të propozojë anëtarin e katërt të grupeve të numërimit të votave, short që duhej të kryhej mes saj dhe Partisë Republikane. Rezulton se për këtë çështje (përcaktimin e partive të shumicës dhe pakicës parlamentare), përfaqësuesi i PDIU-së, ka insistuar në të drejtën e këtij subjekti zgjedhor për të propozuar anëtar në grupin e numërimit të votave, duke mos parashtruar asnjë qëndrim të qartë mbi qenien e tij, pjesë e shumicës apo pakicës parlamentare, por duke kërkuar që përtej këtij vlerësimi që do të kryhej nga KQZ-ja, këtij subjekti zgjedhor ti jepej e drejta që, nëpërmjet shortit, të propozonte anëtarin e tretë ose të katërt të grupeve të numërimit të votave;

- Pas gjithë debateve si më sipër, ka qenë Kryetarja e KQZ-së, që ka parashtruar një tjetër vlerësim, të ndryshëm nga ato të paraardhësve, i cili konsistonte në mos zhvillimin e shortit për përcaktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, duke njohur të drejtën e LSI-së për propozimin e anëtarit të tretë të grupeve të numërimit të votave për të gjitha ZAZ-të, si dhe të drejtën e PR-së për të propozuar anëtarin e katërt të këtyre grupeve. Sa më sipër, është propozuar edhe në kuadër të vështirësisë për të vlerësuar pozicionimin e PDIU-së, si parti e shumicës a pakicës parlamentare.

- Nga procesverbali i mbledhjes rezulton të jenë hedhur në votim të gjitha propozimet, duke filluar së pari me propozimin që anëtari i tretë i grupeve të numërimit të propozohet pas hedhjes së shortit mes LSI dhe PDIU. Ky propozim ka marrë tre vota “pro” dhe katër “kundër”.
- Votimi ka vijuar me propozimin që anëtari i katërt i grupeve të numërimit të propozohet pas hedhjes së shortit mes PR dhe PDIU. Edhe ky propozim nuk është pranuar nga shumica për shkak të rezultatit të votimit tre “pro” dhe katër “kundër”.
- Rezulton më tej se propozimi i Kryetares së KQZ-së, thellësisht i ndryshëm nga qëndrimet e tjera, që gjithsesi pranonin në parim se PDIU kishte të drejtën e pjesëmarrjes në short për të përcaktuar një prej anëtarëve (të tretë dhe të katërt) të grupeve të numërimit të votave, por ndaheshin në cilësimin e kësaj partie si pjesë e shumicës apo pakicës parlamentare, nuk është bërë pjesë e diskutimit mes pjesëmarrësve në mbledhje.
- Ky propozim është hedhur menjëherë në votim, nga i cili rezulton që gjashtë anëtarë të KQZ-së të kenë votuar “kundër” dhe Kryetarja “pro”. Menjëherë pas këtij votimi, i njëjti propozim është rihedhur në një votim të dytë, i cili ka rezultuar me dy vota “pro” dhe pesë vota “kundër”. Për këtë votim, rezulton të ketë shpjeguar votën “kundër” anëtarja e KQZ-së, znj. Vera Shtjefni.
- Rezulton në vijim se po i njëjti propozim është votuar për të tretën herë, duke marrë katër vota “pro” dhe tre “kundër”, çka është konsideruar edhe vendimi përfundimtar lidhur me caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave në çdo ZAZ për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015.

Faktet e parashtruara më sipër janë evidentuar edhe në parashtrimin e pretendimeve të ankuesit PDIU në Kolegjin Zgjedhor, ashtu si

edhe fakti tjetër që KQZ-ja kish lëshuar dy vendime për këtë çështje, me përmbajtje të ndryshme të pjesës arsyetuese.

- Në vlerësim të fakteve të verifikuara në seancë gjyqësore dhe mbi bazën e provave të paraqitura nga pala e paditur, KQZ-ja,
- duke i'u referuar normave ligjore që rregullojnë procedurën e vendimmarrjes së një organi kolegjal, parimeve të funksionimit të organeve administrative, si dhe normave të posaçme të Kodit Zgjedhor,
- duke qenë në dijeni të ekzistencës, për të njëjtin fakt, të tre vendimeve kontradiktore të KQZ-së, ku në dy të tilla nuk miratohet propozimi dhe në të tretin ai pranohet,
- dhe përderisa tre vendime që kundërshtojnë njëri tjetrin kanë krijuar një ometim në vendimmarrje,

arrij në përfundimin se Kolegji Zgjedhor nuk duhej të kish zgjidhur çështjen në themel, por të detyronte palën e paditur, KQZ-në, të ushtronte pushtetin e saj në mënyrë të ligjshme, për të marrë një vendim, në një afat të caktuar, sipas përcaktimit të nenit 158.1, shkronja “c” të Kodit Zgjedhor. Ky konkluzion është rrjedhojë e faktit se ndaj mendim të ndryshëm nga shumica, e cila nuk vlerësoi rëndësinë e mbledhjes së KQZ-së dhe mënyrën e funksionimit të saj.

Dispozitat ligjore, në të cilat bazoj sa më sipërm, janë ato të Kodit të Procedurave Administrative, Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjinale të administratës shtetërore dhe enteve publike” (më tej, Ligji nr. 8480), si dhe normat e posaçme të Kodit Zgjedhor.

Sipas nenit 2.1 të Kodit të Procedurave Administrative, veprimtaria e organeve të administratës shtetërore, përcaktohet si “tërësia e akteve dhe veprimeve nëpërmjet të cilave formohet dhe manifestohet vullneti i administratës publike”.

Ligji nr. 8480/1999 përcakton rregulla të përgjithshme për funksionimin e organeve kolegjinale. Në dallim nga një organ

monokrattik, i cili shpreh vullnetin shtetëror, nëpërmjet një personi, në rastin e organit kolegjal lind nevoja e përcaktimit të rregullave, mbi bazën e të cilave synohet të identifikohet vullneti i tij e që përbëhet nga një tërësi vullnetesh të individëve, anëtarë të organit. Për të formuar e më pas shprehur, vullnetin, duhet që anëtarët e organit të mblidhen në mbledhjet e kryesura nga Kryetari i tij, ku edhe shqyrtohen çështjet sipas rendit të ditës, për të cilat merren edhe vendimet përkatëse.

Në nenin 12 të tij, përcaktohet si rregull, se anëtarët e organit kolegjal, të pranishëm në mbledhje, nuk mund të abstenojnë, përveç se kur parashikohet ndryshe në ligj. Ky urdhërim obligon anëtarët e organit kolegjal për të shprehur në mënyrë pozitive, vullnetin personal, lidhur me vendimin që duhet të merret, rregull i cili, në harmoni edhe me nenin 21 të Kodit të Procedurave Administrative, që përcakton ushtrimin e detyrueshëm të kompetencave, garanton edhe në rastin e organeve kolegjinale, kryerjen e funksionit publik.

Ligji nr. 8480 përcakton gjithashtu se për sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji, vendimet e organeve kolegjinale merren me votim të hapur (neni 13).

Veç sa më sipër, ky Ligj përcakton edhe quorum-in e nevojshëm, pa të cilin organi kolegjal nuk mund të formojë vullnetin e tij të ligjshëm dhe të aftë, për të konkluduar në një vendimmarrje. Sipas nenit 14 të Ligjit nr. 8480, vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje, përveç rasteve kur me ligj kërkohet një shumicë e cilësuar. Për të arritur në marrjen e vendimit, ligji parashikon edhe rastin kur pas votimit nuk arrihet shumica e cilësuar, situatë kjo që sipas pikës 2 të nenit 14, zgjidhet nëpërmjet një votimi të dytë, në të njëjtën mbledhje. Nëse edhe pas këtij vendimi, nuk arrihet shumica e cilësuar e kërkuar nga ligji, çështja shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Çdo mbledhje e organit pasqyrohet në procesverbal, ku pasqyrohen ndër të tjera edhe ajo çfarë është thënë, vendimet e marra, forma dhe rezultati i votimeve, duke shënuar në raste të caktuara edhe votat “kundër” (nenet 16 dhe 17).

Duke përcaktuar rregulla të hollësishme, lidhur me mënyrën dhe zhvillimin e mbledhjeve të organit kolegjal, ligjvënësi ka garantuar respektimin e parimeve të rëndësishme si ai i ligjshmërisë, i mbrojtjes së interesit publik, i drejtësisë dhe paanësisë, i përgjegjshmërisë, të gjitha të përcaktuara edhe në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

Lidhur me formën e aktit të organit kolegjal e në rastin në shqyrtim të KQZ-së, sipas nenit 106.2 të Kodit të Procedurave Administrative, në lidhje edhe me nenin 24, pikat 2 dhe 3 të Kodit Zgjedhor, ai bëhet detyrimisht në formë shkresore. Nga ky përcaktim ligjor, në lidhje edhe me sa parashikon ligji nr. 8480, arrihet në përfundimin se momenti kur miratohet një akt administrativ i organit kolegjal, është ai kur shumica e anëtarëve (sipas rastit, të pranishëm, apo shumica e cilësuar) votojnë “pro” miratimit, fakt ky që domosdoshmërisht pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes, sipas vullnetit të shprehur në votim. Më pas, meqenëse ligji e kërkon, vendimi tashmë i marrë, duhet të shkruhet/zbardhet, me qëllim plotësimin e elementit formal të aktit.

Kodi Zgjedhor lidhur me funksionimin e KQZ-së si organ kolegjal, përcakton rregulla të posaçme, në harmoni me parimet e përgjithshme të së drejtës administrative. Kështu:

- KQZ-ja kryen funksionin e saj mbi bazën e parimit të transparencës (neni 3.6 dhe 22.7);
- KQZ-ja ushtron kompetencat ligjore nëpërmjet vendimmarrjes në mbledhjet e saj (neni 22).

Ky Kod parashikon në mënyrë të posaçme se:

- Vendimet e KQZ-së, veç atyre të përcaktuara në nenin 24.1, miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij (të paktën katër vota “pro” marrjes së vendimit konkret);
- Vendimi zbardhet brenda 24 orëve nga marrja e tij dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe që kanë marrë pjesë në votim. Anëtarët

e pakicës detyrohen të paraqesin mendimin e tyre me shkrim, që i bashkëngjitet vendimit përkatës.

Referuar rastit në shqyrtim, rezulton se KQZ-ja nuk ka përmbushur detyrimin për ushtrimin e autoritetit të saj publik, në respektim të dispozitave ligjore të sipërcituara. Në mbledhjen e datës 02.06.2015, KQZ-ja, pas votimit të propozimit të Kryetares së saj, nuk ka arritur të marrë vendim për shkak të një vote “pro” dhe gjashtë “kundër”.

Ky fakt provohet me procesverbalin e kësaj mbledhjeje, ku pasqyrohet pjesëmarrja e anëtarëve të KQZ-së, të pranishëm në mbledhje, mënyra e votimit (e hapur), si edhe rezultati i tij.

Ashtu si edhe është parashtruar më sipër, rezulton se i njëjti propozim është votuar edhe dy herë të tjera, derisa sa katër anëtarë të KQZ-së kanë votuar “pro” tij, duke u vendosur në këtë moment edhe përfundimi i mbledhjes.

Duke vlerësuar pikërisht parimet e garantuara në Kodin Zgjedhor, lidhur me paanësinë e KQZ-së në ushtrimin e kompetencave ligjore, si dhe të drejtën e subjekteve zgjedhore të interesuara për të shfaqur mendimin e tyre mbi çështjet e rendit të ditës, vlerësoj se marrja e një vendimi mbi një çështje për të cilën ishte votuar dhe vendosur më parë, pa revokuar këtë vendim, si dhe pa respektuar rregullat që garantojnë procesin ligjor të vendimmarrjes, kryesisht ato që u përkasin subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në proces, jam e mendimit se vendimi i shpallur i KQZ-së duhej të cilësohej i pavlefshëm, duke krijuar mundësinë e një shqyrtimi të ri administrativ.

Po në vlerësim të procedurës së ndjekur nga KQZ-ja, referuar konceptit të revokimit të aktit administrativ, pushtet që i përket organit që e ka nxjerrë atë (aktin), vlerësoj se në momentin kur KQZ-ja nuk ka arritur të marrë një vendim, pasi të tre propozimet janë refuzuar, duhej të kish shtyrë mbledhjen ose të rihapte diskutimet për tu dhënë mundësi pjesëmarrësve të diktatonin mbi zgjidhjet e mundshme. Në fakt, ajo çka është materializuar si vendim i KQZ-së rezulton të mos jetë produkt i këtyre diskutimeve e madje edhe vetë anëtarët e KQZ-së kanë pasur vështirësi për të kuptuar propozimin për të cilin kanë votuar tri herë. Si rezultat, ndonëse më herët ishte pranuar e drejta e PDIU-së për të marrë pjesë në short për propozimin e një anëtari

të GNV-ve, pavarësisht qëndrimeve të ndryshme mbi përkatësinë parlamentare të këtij subjekti, përfundimi rezultoi befasues për këtë subjekt zgjedhor dhe jo vetëm. PDIU nuk pati asnjë mundësi për tu shprehur mbi këtë qëndrim, ndaj vlerësoj të drejtë pretendimin për pavlefshmëri të vendimit, për shkak të shkëljes së procedurës së zhvillimit të mbledhjes dhe marrjes së vendimit.

Veç sa më sipër, konstatoj se as KQZ-ja dhe asnjë nga pjesëmarrësit nuk ka vënë në diskutim çështjen mbi natyrën e vendimit që ishte propozuar për tu marrë. Nisur nga objekti që synonte të rregullonte vendimi i propozuar, rezulton që rregullat që ai do të vendoste kishin karakter normativ, për sa kohë që synonin të rregullonin procedurën konkrete, që pritej të zhvillohej për hedhjen e shortit sipas nenit 96 të Kodit Zgjedhor. Duke vlerësuar pikërisht karakterin e përgjithshëm normativ, si dhe efektin jo shterues të këtij vendimi, vlerësoj gjithashtu se për këtë vendimmarrje duhej një shumicë e cilësuar e anëtarësisë së KQZ-së,

Për sa më sipër, personalisht jam e mendimit se duke vlerësuar të drejta pretendimet e ankuesit PDIU, mbi paligjshmërinë e procesit të zhvilluar nga KQZ, kjo e fundit duhej të ish detyruar të rishqyronte çështjen, duke e rivënë në diskutim atë dhe duke ushtruar kompetencat e saj konform ligjit. Në rrethanat kur afati për hedhjen e shortit ka përfunduar dhe KQZ-ja nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor për të ushtruar kompetencën e saj, nëpërmjet hedhjes së shortit për çdo ZAZ, si dhe Kolegji Zgjedhor nuk mund ta zgjidhte çështjen në themel, ashtu si parashikon neni 158.1, shkronja “c” dhe 158.4 i Kodit Zgjedhor, KQZ-ja duhej të detyrohej të merrte vendim, duke i caktuar për këtë një afat minimal (qoftë edhe një ditë).

Tiranë, 08.06.2015

**Gjyqtare në pakicë
Edlira PETRI**

MENDIMI PJESËRISHT KUNDËR.

Unë Gjyqtari, Kliton SPAHIU, anëtar i trupës gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor të çështjes me palë ndërgjyqëse:

PADITESE: Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet.

I PADITUR: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

**Palë të interesuar: Partia Socialiste e Shqipërisë.
Partia Demokratike e Shqipërisë.
Partia Republikane e Shqipërisë.
Partia Lëvizja Socialiste Për Integrim.**

OBJEKTI: - Kundërshtimi i vendimit nr. 611, datë 02.06.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Gjykimin e çështjes në themel duke vendosur ndryshimin e vendimit të sipërcituar, caktimin e partikës politike parlamentare PDIU të marrë pjesë në shortin për anëtarin e tretë ose të katër të GNV.

BAZA LIGJORE : Nenet 95, 96, dhe 145 vijues të K. Zgjedhor.

Unë Gjyqtari Kliton Spahiu, anëtar i trupës gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor në çështjen me nr 19, jam i mendimit kundra me tre anëtarët e trupës gjyqësore, për sa i përket kopetencës lëndore të kësaj çështje, duke u bashkuar me relatorin e kësaj trupe gjyqësore, gjyqtaren Edlira Petri.

Qëndrimi im lidhur me kopetencën është ai i mbajtur edhe nga relatorja Edlira Petri, për sa më poshtë:

Në mbledhjen e datës 02.06.2015 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (më tej, KQZ) ka pasur në rendin e ditës edhe shqyrtimin e projektvendimit *“Për caktimin e partive politike të cilave ju lind e drejta të marrin pjesë në shortin për anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015”*.

Sipas procesverbalit të zbardhur të mbledhjes së KQZ-së, datë 02.06.2015, (ora 13:20 e fillimit), rezulton se kanë marrë pjesë në të, anëtarët e këtij organi, stafi administrativ i tij, subjektet zgjedhore

PD, PS, LSI, PR, PSD, FRD, PKSH, organizata ndërkombëtare, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë, OSBE, ODIHR.

Referuar fakteve që lidhen me zhvillimin e mbledhjes, debatit mbi rendin e ditës dhe konkluzionit/vendimmarrjes lidhur me të, konstatohet se KQZ-ja i ka lejuar vetes shkelje të tilla të procesit, që cenojnë thelbin e tij, për shkak të të cilave vlerësoj se “vendimi” i shpallur dhe publikuar, duhej të cilësohej si absolutisht i pavlefshëm, situatë e cila detyron KQZ-në të rimarrë në shqyrtim çështjen, duke ushtruar kompetencën e saj në përputhje me ligjin.

Duke renditur kronologjikisht faktet procedurale të evidentuara nga procesverbali i mbledhjes së KQZ-së, rezulton sa vijon :

- Propozimi për vendimin që duhej të merrej nga KQZ-ja, konsistente në përcaktimin e rregullave, mbi të cilat do të organizohej më pas, shorti për çdo ZAZ, lidhur me përcaktimin e anëtarit të tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, referuar për këtë neneve 95 dhe 96 të Kodit Zgjedhor. Lidhur me këtë çështje nga administrata e KQZ-së është parashtruar se paraprakisht ishin kërkuar të dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë lidhur me listën e partive të shumicës parlamentare dhe atyre të opozitës parlamentare. Nga informacioni i marrë ka rezultuar se Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, si parti e mazhorancës kishte 16 mandate, kurse partia Republikane dhe ajo Drejtësi, Integrim dhe Unitet si parti të opozitës parlamentare kishin respektivisht 3 dhe 4 mandate. Ndërsa ka qenë e qartë situata lidhur me Partinë LSI dhe PR, për Partinë PDIU është parashtruar se zotërimi i katër mandateve i jep asaj të drejtën për të marrë pjesë në shortin për përcaktimin e anëtarit të tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave;
- Pas parashtrimit të situatës si më sipër, ka filluar debati, nga i cili në mënyrë të përmbledhur rezultojnë dy opinione. Së pari, tre nga anëtarët e KQZ-së së bashku me përfaqësuesit e Partisë Demokratike dhe Partisë Republikane, kanë dhënë argumentet sipas të cilave, PDIU duhej të klasifikohej si parti e shumicës parlamentare dhe

si e tillë ajo duhej të merrte pjesë në shortin për përcaktimin e partive që do të propozojnë anëtarin e tretë të grupeve të numërimit të votave, short që duhej të hidhej mes saj dhe LSI. Nga ana tjetër, tre anëtarë të tjerë të KQZ-së, së bashku me përfaqësuesit e Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, kanë parashtruar se PDIU nuk është parti e shumicës qeverisëse, referuar për këtë rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2013 dhe faktit se kjo parti nuk i ka dhënë votën mbështetëse qeverisë. Mbi këtë bazë, këta të fundit mbajnë qëndrimin se PDIU duhet të marrë pjesë në shortin për përcaktimin e partisë politike, që do të propozojë anëtarin e katërt të grupeve të numërimit të votave, short që duhej të kryhej mes saj dhe Partisë Republikane. Rezulton se për këtë çështje (përcaktimin e partive të shumicës dhe pakicës parlamentare), përfaqësuesi i PDIU-së, ka insistuar në të drejtën e këtij subjekti zgjedhor për të propozuar anëtar në grupin e numërimit të votave, duke mos parashtruar asnjë qëndrim të qartë mbi qenien e tij, pjesë e shumicës apo pakicës parlamentare, por duke kërkuar që përtej këtij vlerësimi që do të kryhej nga KQZ-ja, këtij subjekti zgjedhor ti jepej e drejta që, nëpërmjet shortit, të propozonte anëtarin e tretë ose të katërt të grupeve të numërimit të votave;

- Pas gjithë debateve si më sipër, ka qenë Kryetarja e KQZ-së, që ka parashtruar një tjetër vlerësim, të ndryshëm nga ato të paraardhësve, i cili konsistonte në mos zhvillimin e shortit për përcaktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, duke njohur të drejtën e LSI-së për propozimin e anëtarit të tretë të grupeve të numërimit të votave për të gjitha ZAZ-të, si dhe të drejtën e PR-së për të propozuar anëtarin e katërt të këtyre grupeve. Sa më sipër, është propozuar edhe në kuadër të vështirësisë për të vlerësuar pozicionimin e PDIU-së, si parti e shumicës a pakicës parlamentare.
- Nga procesverbali i mbledhjes rezulton të jenë hedhur në votim të gjitha propozimet, duke filluar së pari me

propozimin që anëtari i tretë i grupeve të numërimit të propozohet pas hedhjes së shortit mes LSI dhe PDIU. Ky propozim ka marrë tre vota “pro” dhe katër “kundër”.

- Votimi ka vijuar me propozimin që anëtari i katërt i grupeve të numërimit të propozohet pas hedhjes së shortit mes PR dhe PDIU. Edhe ky propozim nuk është pranuar nga shumica për shkak të rezultatit të votimit tre “pro” dhe katër “kundër”.
- Rezulton më tej se propozimi i Kryetares së KQZ-së, thellësisht i ndryshëm nga qëndrimet e tjera, që gjithsesi pranonin në parim se PDIU kishte të drejtën e pjesëmarrjes në short për të përcaktuar një prej anëtarëve (të tretë dhe të katërt) të grupeve të numërimit të votave, por ndaheshin në cilësimin e kësaj partie si pjesë e shumicës apo pakicës parlamentare, nuk është bërë pjesë e diskutimit mes pjesëmarrësve në mbledhje.
- Ky propozim është hedhur menjëherë në votim, nga i cili rezulton që gjashtë anëtarë të KQZ-së të kenë votuar “kundër” dhe Kryetarja “pro”. Menjëherë pas këtij votimi, i njëjti propozim është rihedhur në një votim të dytë, i cili ka rezultuar me dy vota “pro” dhe pesë vota “kundër”. Për këtë votim, rezulton të ketë shpjeguar votën “kundër” anëtarja e KQZ-së, znj. Vera Shtjefni.
- Rezulton në vijim se po i njëjti propozim është votuar për të tretën herë, duke marrë katër vota “pro” dhe tre “kundër”, çka është konsideruar edhe vendimi përfundimtar lidhur me caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave në çdo ZAZ për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015.

Faktet e parashtuara më sipër janë evidentuar edhe në parashtrimin e pretendimeve të ankuesit PDIU në Kolegjin Zgjedhor, ashtu si edhe fakti tjetër që KQZ-ja kish lëshuar dy vendime për këtë çështje, me përmbajtje të ndryshme të pjesës arsyetuese.

- Në vlerësim të fakteve të verifikuara në seancë gjyqësore dhe mbi bazën e provave të paraqitura nga pala e paditur, KQZ-ja,
- duke i'u referuar normave ligjore që rregullojnë procedurën e vendimmarrjes së një organi kolegjal, parimeve të funksionimit të organeve administrative, si dhe normave të posaçme të Kodit Zgjedhor,
- duke qenë në dijeni të ekzistencës, për të njëjtin fakt, të tre vendimeve kontradiktore të KQZ-së, ku në dy të tilla nuk miratohet propozimi dhe në të tretin ai pranohet,
- dhe përderisa tre vendime që kundërshtojnë njëri tjetrin kanë krijuar një ometim në vendimmarrje,

arrij në përfundimin se Kolegji Zgjedhor nuk duhej të kish zgjidhur çështjen në themel, por të detyronte palën e paditur, KQZ-në, të ushtronte pushtetin e saj në mënyrë të ligjshme, për të marrë një vendim, në një afat të caktuar, sipas përcaktimit të nenit 158.1, shkronja "c" të Kodit Zgjedhor. Ky konkluzion është rrjedhojë e faktit se ndaj mendim të ndryshëm nga shumica, e cila nuk vlerësoi rëndësinë e mbledhjes së KQZ-së dhe mënyrën e funksionimit të saj.

Dispozitat ligjore, në të cilat bazoj sa më sipërm, janë ato të Kodit të Procedurave Administrative, Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" (më tej, Ligji nr. 8480), si dhe normat e posaçme të Kodit Zgjedhor.

Duke përcaktuar rregulla të hollësishme, lidhur me mënyrën dhe zhvillimin e mbledhjeve të organit kolegjal, ligjvënësi ka garantuar respektimin e parimeve të rëndësishme si ai i ligjshmërisë, i mbrojtjes së interesit publik, i drejtësisë dhe paanësisë, i përgjegjshmërisë, të gjitha të përcaktuara edhe në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

Lidhur me formën e aktit të organit kolegjal e në rastin në shqyrtim të KQZ-së, sipas nenit 106.2 të Kodit të Procedurave Administrative, në lidhje edhe me nenin 24, pikat 2 dhe 3 të Kodit Zgjedhor, ai bëhet

detyrimisht në formë shkresore. Nga ky përcaktim ligjor, në lidhje edhe me sa parashikon ligji nr. 8480, arrihet në përfundimin se momenti kur miratohet një akt administrativ i organit kolegjal, është ai kur shumica e anëtarëve (sipas rastit, të pranishëm, apo shumica e cilësuar) votojnë “pro” miratimit, fakt ky që domosdoshmërisht pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes, sipas vullnetit të shprehur në votim. Më pas, meqenëse ligji e kërkon, vendimi tashmë i marrë, duhet të shkruhet/zbardhet, me qëllim plotësimin e elementit formal të aktit.

Kodi Zgjedhor lidhur me funksionimin e KQZ-së si organ kolegjal, përcakton rregulla të posaçme, në harmoni me parimet e përgjithshme të së drejtës administrative. Kështu:

- KQZ-ja kryen funksionin e saj mbi bazën e parimit të transparencës (neni 3.6 dhe 22.7);
- KQZ-ja ushtron kompetencat ligjore nëpërmjet vendimmarrjes në mbledhjet e saj (neni 22).

Ky Kod parashikon në mënyrë të posaçme se:

- Vendimet e KQZ-së, veç atyre të përcaktuara në nenin 24.1, miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij (të paktën katër vota “pro” marrjes së vendimit konkret);
- Vendimi zbardhet brenda 24 orëve nga marrja e tij dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe që kanë marrë pjesë në votim. Anëtarët e pakicës detyrohen të paraqesin mendimin e tyre me shkrim, që i bashkëngjitet vendimit përkatës.

Referuar rastit në shqyrtim, rezulton se KQZ-ja nuk ka përmbushur detyrimin për ushtrimin e autoritetit të saj publik, në respektim të dispozitave ligjore të sipërcituara. Në mbledhjen e datës 02.06.2015, KQZ-ja, pas votimit të propozimit të Kryetares së saj, nuk ka arritur të marrë vendim për shkak të një vote “pro” dhe gjashtë “kundër”. Ky fakt provohet me procesverbalin e kësaj mbledhjeje, ku pasqyrohet

pjesëmarrja e anëtarëve të KQZ-së, të pranishëm në mbledhje, mënyra e votimit (e hapur), si edhe rezultati i tij.

Ashtu si edhe është parashtruar më sipër, rezulton se i njëjti propozim është votuar edhe dy herë të tjera, derisa sa katër anëtarë të KQZ-së kanë votuar “pro” tij, duke u vendosur në këtë moment edhe përfundimi i mbledhjes.

Duke vlerësuar pikërisht parimet e garantuara në Kodin Zgjedhor, lidhur me paanësinë e KQZ-së në ushtrimin e kompetencave ligjore, si dhe të drejtën e subjekteve zgjedhore të interesuara për të shfaqur mendimin e tyre mbi çështjet e rendit të ditës, vlerësoj se marrja e një vendimi mbi një çështje për të cilën ishte votuar dhe vendosur më parë, pa revokuar këtë vendim, si dhe pa respektuar rregullat që garantojnë procesin ligjor të vendimmarrjes, kryesisht ato që u përkasin subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në proces, jam e mendimit se vendimi i shpallur i KQZ-së duhej të cilësohej i pavlefshëm, duke krijuar mundësinë e një shqyrtimi të ri administrativ.

Po në vlerësim të procedurës së ndjekur nga KQZ-ja, referuar konceptit të revokimit të aktit administrativ, pushtet që i përket organit që e ka nxjerrë atë (aktin), vlerësoj se në momentin kur KQZ-ja nuk ka arritur të marrë një vendim, pasi të tre propozimet janë refuzuar, duhej të kish shtyrë mbledhjen ose të rihapte diskutimet për tu dhënë mundësi pjesëmarrësve të diskutonin mbi zgjidhjet e mundshme. Në fakt, ajo çka është materializuar si vendim i KQZ-së rezulton të mos jetë produkt i këtyre diskutimeve e madje edhe vetë anëtarët e KQZ-së kanë pasur vështirësi për të kuptuar propozimin për të cilin kanë votuar tri herë. Si rezultat, ndonëse më herët ishte pranuar e drejta e PDIU-së për të marrë pjesë në short për propozimin e një anëtari të GNV-ve, pavarësisht qëndrimeve të ndryshme mbi përkatësinë parlamentare të këtij subjekti, përfundimi rezultoi befasues për këtë subjekt zgjedhor dhe jo vetëm. PDIU nuk pati asnjë mundësi për tu shprehur mbi këtë qëndrim, ndaj vlerësoj të drejtë pretendimin për pavlefshmëri të vendimit, për shkak të shkeljes së procedurës së zhvillimit të mbledhjes dhe marrjes së vendimit.

Veç sa më sipër, konstatoj se as KQZ-ja dhe asnjë nga pjesëmarrësit nuk ka vënë në diskutim çështjen mbi natyrën e vendimit që ishte propozuar për tu marrë.

Nisur nga objekti që synonte të rregullonte vendimi i propozuar, rezulton që rregullat që ai do të vendoste kishin karakter normativ, për sa kohë që synonin të rregullonin procedurën konkrete, që pritej të zhvillohej për hedhjen e shortit sipas nenit 96 të Kodit Zgjedhor. Duke vlerësuar pikërisht karakterin e përgjithshëm normativ, si dhe efektin jo shterues të këtij vendimi, vlerësoj gjithashtu se për këtë vendimmarrje duhej një shumicë e cilësuar e anëtarësisë së KQZ-së,

Për sa më sipër, jam e mendimit se duke vlerësuar të drejta pretendimet e ankuesit PDIU, mbi paligjshmërinë e procesit të zhvilluar nga KQZ, kjo e fundit duhej të ish detyruar të rishqyrtonte çështjen, duke e rivënë në diskutim atë dhe duke ushtruar kompetencat e saj konform ligjit. Në rrethanat kur afati për hedhjen e shortit ka përfunduar dhe KQZ-ja nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor për të ushtruar kompetencën e saj, nëpërmjet hedhjes së shortit për çdo ZAZ, si dhe Kolegji Zgjedhor nuk mund ta zgjidhte çështjen në themel, ashtu si parashikon neni 158.1, shkronja “c” dhe 158.4 i Kodit Zgjedhor, KQZ-ja duhej të detyrohej të merrte vendim, duke i caktuar për këtë një afat minimal (qoftë edhe një ditë).

Ky vendim moszgjidhjen e çështjes në themel nuk mundi të kalonte me shumicë votësh, detyroj kolegjin zgjedhor të shqyrtoj çështjen në themel të saj.

Pas bisedimit në dhomën e këshillimit për themelin e çështjes bashkohen me mendimit e shumicës së kësaj trupe gjyqsore. Mendimi im për themelin e çështjes është si më poshtë:

Subjekti Zgjedhor PDIU, në kërkes-padinë drejtuar Kolegjit Zgjedhor ka kërkuar ndryshimin e vendimit Nr 611, datë 02.06.2015 të KQZ-së, dhe caktimin e saj në shortin për anëtarin e tretë ose të katër të Grupit të Numërimit të Votave.

Në gjykim pala paditëse PDIU, e kufizoi kërkimin e saj duke kërkuar që të marrin pjesë në shortin për anëtarin e katër të Grupit të Numërimit të Votave, që do të emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtar të GNV-ve, për ZAZ

respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të Kodit Zgjedhor.

Me këtë qëndrim të mbajtur në gjykim, pala paditëse Partia PDIU, prezumohet të ketë hequr dorë nga kundërshtimi i vendimit Nr 611, datë 02.06.2015 të KQZ-së, për pikën e pare të saj, në të cilën është vendosur që *“Partia politike e shumicës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të Grupeve të Numërimit të Votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015, është Lëvizja Socialiste për Integrim”*.

Është fakt se paditësi PDIU, aktualisht është Parti e shumicës qeverisëse, dhe si e tillë asaj i lind e drejta të propozoj për anëtarin e tretë të GNV-së, në hedhjen e shortit, nga kërkimi i cili është hequr dorë gjatë gjyqimit.

Pala paditëse PDIU, duke qenë një Parti e shumicës qeverisëse, ajo nuk legjitimohet të kërkoj të bëj propozimin e anëtarit të katër që i përket partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-së, për ZAZ-në, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të K.Zgjedhor.

Në këto kushte kërkimi i palës paditëse PDIU është i pabazuar në Kodin Zgjedhor dhe për pasojë duhet rrëzuar.

Tiranë sot me datë 08.06.2015.

GJYQTARI

Kliton SPAHIU

* * *



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR

NR. 20 REGJ. THEMELTAR
DATË 12.06.2015 REGJ.

NR. 20 VENDIMI
DATË 15.06.2015 VENDIMI

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUES :	ANDI CIVICI
ANETAR :	PETRIT CENO
ANETAR :	VALBON ÇEKREZI
ANETAR :	KLITON SPAHIU
ANETAR :	FUAT VJERDHA

Me sekretare **Rexhina Baci**, në Tiranë, sot në date 15.06.2015, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore me nr.20 Akti, që u përket palëve:

PADITES: **Gentian Muhameti**,
përfaqësuar nga av. Tauland Asllanaj.

I PADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**,
përfaqësuar me autorizim nga Znj. Dëshira PASKO
dhe Olsi PETO.

PALE E INTERESUAR: **Aleanca Popullore per Punesim
dhe Dinjitet** (ne mungese).

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshem me aktet
nderkombetare, Kushtetuten e Republikes se
Shqiperise dhe me Kodin Zgjedhor te Vendimit nr

625 date 09.06.2015 te KQZ ne lidhje me pranimin e kerkeses se Koalicionit APPD, per terheqjen nga kandidimi te kandidatit per Bashkine Kelcyre Gentian Muhameti.

BAZA LIGJORE: Deklarata Universale e te Drejtave te Njeriut, 1948, neni 21, 25 i Konventes Nderkombetare per te Drejtat Civile e Politike e vitit 1966, Kodi i Praktikes se Mire ne Ceshtjet Zgjedhore pika 1.1, nenet 45, 69 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise; nenet 3, 45, 63, 67/1/2, 71, 72, 73 145-158, të Ligjit Nr.10019, date 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise” i ndryshuar.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoji palët prezent në pretendimet e tyre, paditësin nëpërmjet përfaqësuesit që në perfundim kërkoi pranimin e padisë sipas objektit, përfaqësuesen e pales së paditur, që kërkoi rrezimin e padise, pasi administroi provat e bisedoi çështjen në tërësi;

V Ë R E N

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ), me vendimin Nr. 548, datë 22.05.2015 ka miratuar përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për kryetar Bashkia Këlcyrë, Qarku Gjirokaster, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015.

Sipas vendimit të sipërcituar renditja në fletën e votimit për kandidatët për kryetar Bashkia Këlcyrë është:

kandidati Klement Ndoni renditet i pari në fletën e votimit, (Aleanca per Shqiperine Europiane);

kandidati Gentian Muhameti renditet i dyti, (Aleanca Popullore per Punesim dhe Dinjitet);

kandidati Hazbi Kasaj renditet i treti, (Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise);

dhe kandidati Bujar Fezga, renditet i katërti, (kandidat i propozuar nga zgjedhes).

Koalicioni Aleanca Popullore për Punësim dhe Dinjitet (APPD), në datën 30.05.2015, me nr. 5483 prot, ka depozituar një kërkesë në KQZ, për tërheqjen nga kandidimi të kandidatit z. Gentian Muhameti për kryetar të Bashkisë Këlcyrë, Qarku Gjirokastrë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2005.

KQZ, në seancën e datës 03.06.2015, mori në shqyrtim kërkesën e koalicionit Aleanca Popullore për punësim dhe Dinjitet.

Sipas subjektit zgjedhor Koalicioni Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet, kandidati refuzoi kërkesën e subjektit propozues për të verifikuar në lidhje me të kaluarën e kandidatit për pasjen ose jo të rekordeve kriminale. Edhe pse subjekti propozues nuk ka asnjë provë që të vërtetoj pasjen ose jo të kandidatit të rekordeve kriminale, refuzimi prej tij për ta bërë një gjë të tillë është indicie e mjaftueshme për të dyshuar.

Sipas APPD, referuar nenit 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor që një kandidat të kandidoj si i propozuar nga një parti politike apo koalicion zgjedhor duhet të përputhen vullnetet si të kandidatit dhe të subjektit që e përfaqëson. Në këto kushte duke qenë se subjekti propozues i kandidatit, APPD nuk ka më vullnet për të kandiduar si përfaqësues i tij z. Gentian Muhameti, KQZ i është kërkuar të vendos ç'është regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie Këlcyrë, z. Gentian Muhameti, propozuar nga APPD.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës në KQZ, është paraqitur përfaqësuesi i kandidatit për kryetar të Bashkisë Këlcyrë z. Gentian Muhameti, i cili kerkoi rrëzimin e kërkesës së koalicionit Aleanca Popullore për Punësim dhe Dinjitet për tërheqjen e kandidatit për Kryetar Bashkie Këlcyrë z. Gentian Muhameti pasi pretendimi i koalicionit APPD ishte i pambështetur në ligj. Kodi Zgjedhor nuk parashikon në asnjë dispozitë të tij të drejtën e një partie politike apo koalicioni zgjedhor që në përfundim të të gjitha procedurave për regjistrimin e kandidatëve, të kërkojë çregjistrimin e tij. Gjithashtu, sipas tij, subjekti propozues i kandidatit Gentian Muhameti nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar pretendimet e aluduara në lidhje me të kaluarën e kandidatit.

Përfaqësuesi i kandidatit gjate shqyrtimit te kerkeses ne KQZ, ka depozituar një kopje të çertifikatës së të dhënave të përgjithshme penale, të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë Italiane. Sipas kësaj çertifikatë rezulton se kandidati është i padënuar nga shteti italian.

Për të arritur në një vendimarrje sa më të saktë, KQZ, me shkresën nr. 5559, datë 03.06.2015, vendosi të kërkojë të dhëna për Z. Gentian Muhameti pranë Prokurorit te Përgjithshëm, Ministrit te Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Shërbimit Informativ Shtetëror.

Duke qenë se brenda datës 09.06.2015 nga këto institucione nuk u paraqit asnjë informacion dhe duke qenë se koha për prodhimin e fletës së votimit ishte në limitet e fundit të saj, KQZ vendosi të vazhdojë shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga APPD, për c'regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie Këlcyre, z. Gentian Muhameti.

KQZ, ne perfundim te shqyrtimit, me vendimin nr. 625 date 09.06.2015 ka vendosur:

1. Pranimin e kërkesës së Koalicionit APPD.
2. Ç'regjistrimin e kandidati për kryetar Bashkie Këlcyre, propozuar nga Koalicioni APPD, z. Gentian Hysen Muhameti.
3. Ndryshimin e vendimit nr. 548, datë 22.05.2015, "Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkia Këlcyre për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21 qershor 2015", duke hequr nga fleta e votimit kandidatin me numër rendor 2 (dy) Gentian Hysen Muhameti, propozuar nga Koalicioni APPD.

Pas kësaj, me date 12.06.2015, paditesi Gentian Muhameti ka paraqitur ne Kolegjin Zgjedhor prane Gjykates se Apelit Tirane (me poshte referuar si Kolegji Zgjedhor) nje kerkesepadi, me te cilen, duke paditur KQZ-ne, ka kërkuar "Shfuqizimi si i papajtueshem me aktet nderkombetare, Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe me Kodin Zgjedhor te Vendimit nr 625 date 09.06.2015 te KQZ ne lidhje me pranimin e kerkeses se Koalicionit APPD, per terheqjen nga kandidimi te kandidatit per Bashkine Kelcyre, Gentian Muhameti".

Paditësi Gentian Muhameti, nepermjet perfaqesuesit, ne kerkesepadi dhe gjate gjykimit pretendoi se:

- Z. Muhameti qe prej vitit 2011 e ne vijim eshte Kryetar i Komunes Suke, Permet si perfaqesues i Partise Demokratike, c'ka rrezon pretendimin se ai nuk eshte verifikuar. Ai ka paraqitur krahas deshmise se penalitetit te Republikes se Shqiperise edhe një kopje të çertifikatës së të dhënave të përgjithshme penale, të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë Italiane. Sipas kësaj çertifikatë rezulton se kandidati është i padënuar nga shteti italian.

- Nese Z Muhameti nuk do te kishte pranuar verifikimin, per cfare arsye APPD do te vendoste ta kandidonte dhe perse ajo nuk vendosi ta refuzoje ate ta kandidoje qysh ne fillim ne KZAZ nr. 75?

- Arsyetimi i perdorur nga KQZ cenon rende te drejttat dhe lirite themelore te paditesit te garantuara nga nenet 45 dhe 69 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, si dhe nga nenet 3, 63 dhe 72 te Kodit Zgjedhor. Kjo per arsye se KQZ, per kete situatë, nuk kishte asnje rregullim ligjor dhe kerkesa nuk mund te merrej fare ne shqyrtim.

- Vendimi i KQZ eshte marre ne nje kohe qe kandidati kishte depozituar te gjithe dokumentacionin e nevojshme ligjor, pasi ai ishte verifikuar, pasi ishte regjistruar nga KZAZ dhe pasi ishin marre vendime edhe nga vete KQZ, duke i mohuar ne kete menyre te drejten kushtetuese per t'u zgjedhur dhe kjo e bere pa asnje baze ligjore, por me argumentin qe anetaret e KQZ "te kene ndergjegjen e qete". Mjafton vetem ky fakt per ta bere vendimin e KQZ te paligjshem dhe te cenueshem ne veshtrim te ligjit.

- Kodi Zgjedhor kandidimin e parashikon si nje te drejte te cdo individi, i cili propozohet nga nje parti politike apo Koalicioni Zgjedhor dhe qe duhet te plotesoje disa kriterë Kushtetuese dhe ligjore. Me perfitimin e statusit te kandidatit kjo e fundit nuk eshte me nje e drejte, por nje detyrim ligjor per te mundesuar zhvillimin e zgjedhjeve te lira.

- Pas rregjistrimit te kandidatit, procedurat nuk i nenshtrohen me vullnetit te kandidatit, por jane detyrim ligjor qe duhet te zbatohen. Ne rastin e kandidatit te dorehequr te Bashkise Kurbin, edhe pse

jo identik, por te ngjashem, KQZ ka mbajtur nje qendrim teresisht te kundert me rastin ne fjale.

- KQZ ka mbajtur nje praktike ne kundershkrim me piken 1.1 paragrafi "d" te Kodit te Praktikës se Mire ne Ceshtjet Zgjedhore, ne te cilen parashikohet mundesia e perjashtimit nga e drejta per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur. Rasti ne fjale nuk perfshihet ne asnje prej rrethanave te percaktuara ne kete dispozite, aq me teper qe paditesi prej 4 vjetesh ka ushtruar mandatin e Kryetarit te Komunes.

Pala e paditur KQZ, prapësoi pretendimet e paditësit duke parashtruar se:

- Se pari, ne baze te nenit 145 te Kodit Zgjedhor te drejten e ankimit ne Kolegjin Zgjedhor e kane vetem subjektet zgjedhore, partite politike dhe individet qe u eshte refuzuar kerkesa per regjistrim si subjekt zgjedhor. Sipas nenit 67 te Kodit Zgjedhor kerkesa per regjistrimin e kandidatëve per kryetar bashkie, behet nga Partia politike/koalicioni zgjedhor ose nga zgjedhesit. Ne rastin e paditesit kerkesa per regjistrim dhe c' regjistrim eshte bere nga koalicioni APPD. Ne kete rast eshte ky subjekti qe ka te drejten te beje ankimin administrativ apo ate gjyqesor. Persa me siper paditesi Gentian Muhameti nuk legjitimohet per te kundershtruar vendimet e KQZ ne Kolegjin Zgjedhor.

- Se dyti, Kodi Zgjedhor nuk parashikon asnjë dispozitë e drejta e partive politike apo koalicioneve zgjedhore për të kërkuar tërheqjen, zëvendësimin, ç' regjistrimin e kandidatëve pas regjistrimit përfundimtar të tyre nga komisionet përkatëse KQZ/KZAZ. Për më tepër, KQZ ka miratur dhe përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për kryetar Bashkie Këlcyrë, duke e renditur kandidatin Gentian Muhameti të dytin, por referuar rëndësisë së madhe që përmban objekti i kërkesës së paraqitur nga Koalicioni APPD, për standartet e zgjedhjeve në përgjithësi siç është dekriminalizimi i kandidatëve, referuar faktit se pastërtia e figurave të cilat u paraqitën zgjedhësve shqiptar për t'i zgjedhur si drejtuesit e tyre vendor është përtej faktit nëse parashikohet apo jo një gjë tillë në një norme ligjore, si dhe referuar faktit se dyshimet për kriminalizim e kandidatëve, do të cënonin rëndë procesin zgjedhor dhe imazhin e vendit, KQZ ka vlerësuar se kërkesa koalicionit APPD duhet të pranohet dhe kandidati për kryetar i Bashkisë Këlcyrë, propozuar nga Koalicioni APPD, duhet të ç' regjistrohet.

Kolegji Zgjedhor, pasi ia nënshtroi çështjen debatit gjyqësor, dëgjoi palët, administroi provat shkresore dhe pretendimet përfundimtare, në përfundim cmon te rrezoje padinë, për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv të paditesit.

Referuar nenit 145/1 të Kodit Zgjedhor, Kolegji Zgjedhor cmon se paditesi Gentian Muhameti nuk gezon të drejtën për të ankimuar vendimin nr. 625 datë 09.06.2015 të KQZ, sipas afatëve të përcaktuara në nenin 152 të këtij Kodi.

Në rastin konkret, paditesi ka paraqitur ankim kundër vendimin nr. 625 datë 09.06.2015 të KQZ, që sipas paditesit cenon interesin e tij të ligjshëm, për arsye vendimi ka urdheruar c'regjistrimin e kandidati për kryetar Bashkie Këlcyrë, propozuar nga Koalicioni APPD, z. Gentian Hysen Muhameti.

Kolegji Zgjedhor e gjen të drejtë prapësimin e palës së paditur KQZ për moslegjitimin e paditesit. Sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor kërkesa për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie, bëhet nga partia politike/koalicioni zgjedhor ose nga një grup zgjedhësish. Në rastin e paditesit kërkesa për regjistrim kandidati dhe c'regjistrim të tij është bërë nga Koalicioni APPD. Në këtë rast, është ky i fundit (Koalicioni APPD) subjekti zgjedhor që ka të drejtën të bëjë ankimin administrativ apo atë gjyqësor, në bazë të nenëve 124/1 dhe 145 të Kodit Zgjedhor, pasi është ai subjekti zgjedhor kërkues, pra subjekti iniciues i procedurës së regjistrimit të kandidati për kryetar bashkie. Në kushtet kur kërkesa për c'regjistrim kandidati në KQZ është bërë nga Koalicioni APPD, që është dhe koalicioni që ka mbështetur kandidaturën e paditesit për kryetar të Bashkisë Këlcyre, ku mbi këtë kërkesë paditesi rezultoi të jetë c'regjistruar si i tillë, ky i fundit (paditesi) nuk legjitimohet në ngritjen e padisë objekt gjykimi, por është partia/koalicioni zgjedhor ai që gezon të drejtën e ankimit.

Për arsye të siper paditesi Gentian Muhameti nuk legjitimohet për të kundërshtuar vendimin objekt gjykimi të KQZ në Kolegjin Zgjedhor.

Përfundimisht, Kolegji Zgjedhor cmon se kërkesepadia e paraqitur nga paditesi Gentian Muhameti duhet të rrezohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë,
bazuar në nenin 158/3 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar,

V E N D O S I

- Rrezimin e padisë së paditesit Gentian Muhameti.

Tiranë, më 15.06.2015

ANËTAR
VALBON ÇEKREZI

ANËTAR
KLITON SPAHIU
Kunder

KRYESUES
ANDI CIVICI

ANËTAR
FUAT VJERDHA

ANËTAR
PETRIT CENO

MENDIMI KUNDËR.

Unë Gjyqtari, Kliton SPAHIU, anëtar i trupës gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor të çështjes me palë ndërgjyqëse:

PADITES: **Gentian Muhameti.**

I PADITUR: **Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.**

Palë e interesuar: **Aleanca Popullore për Punësim dhe Dinjitet.**

OBJEKTI: - Shfuqizimi si i papajtueshëm me aktet ndërkombetare, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me Kodin Zgjedhor të Vendimit nr .625 datë 09.06.2015 të KQZ në lidhje me pranimin e kërkesës së Koalicionit APPD, për tërheqjen nga kandidimi të kandidatit për Bashkinë Këlcyrë Z.Gentian Muhameti.

BAZA LIGJORE : Deklarata Universale e te Drejtave te Njeriut, 1948, neni 21, 25 i Konventes Nderkombetare per te Drejtat Civile e Politike e vitit 1966, Kodi i Praktikes se Mire ne Ceshtjet Zgjedhore pika 1.1, nenet 45, 69 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise; nenet 3, 45, 63, 67/1/2, 71, 72, 73 145-158, të Ligjit Nr.10019, date 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise” i ndryshuar..

jam i mendimit kundra për sa i përket disponimit mbi rrezimin e padisë nga shumica e kësaj trupe gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor, duke mbetur në mendimin se padia është e bazuar në prova dhe ligj, e për pasojë duhet pranuar për sa më poshtë:

Partia Demokratike e Shqiperise (*më poshtë referuar si PD*), në përputhje me nenin 64 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, është regjistruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (*me poshtë KQZ*) si subjekt zgjedhor, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015. PD bashkë me disa parti politike të regjistruara rregullisht si subjekte zgjedhore, bazuar në nenin 65 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, janë regjistruar nga KQZ- ja si koalicion zgjedhor në shkallë vendi, nën emrin Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet (*referuar si APPD në vijim*), për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015.

Koalicioni Zgjedhor APPD, në respektim të së drejtës së përcaktuar në nenin 165/3 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar dhe në përputhje me kërkesat e nenit 67 të këtij Kodi, brenda afatit të përcaktuar nga kjo dispozitë (*që në rastin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015 është llogaritur deri me datë 4 maj 2015*), ka paraqitur përpara Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (*referuar si KZAZ më poshtë*) Nr.75, Qarku Gjirokastrë, një kërkesë për regjistrimin e Z.Gentian Muhameti si kandidat për kryetar të Bashkisë Këlcyre për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, duke i bashkëlidhur asaj dhe dokumentet e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar.

Rezulton se, KZAZ Nr.75, bazuar në nenet 33/f dhe 73 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, ka gjetur të rregullt dhe në përmbushje

të kërkesave të ligjit dokumentet e kandidimit, ka vendosur “*Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015 të regjistrojë si kandidat për kryetar të Bashkisë Këlcyrë, Z.Gentian Muhameti, paraqitur nga Koalicioni Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet*”.

Koalicioni APPD, në datën 30.05.2015, nr. 5483 prot, ka depozituar një kërkesë në KQZ, për tërheqjen nga kandidimi të kandidatit z.Gentian Muhameti, për kryetar të Bashkisë Këlcyrë, Qarku Gjirokastrë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2005.

KQZ-ja në seancën e datës 03.06.2015 mori në shqyrtim kërkesën e Koalicionit Aleanca Popullore për punësim dhe Dinjitet. Sipas këtij Subjekti Zgjedhor, (*Koalicioni APPD*), kandidati refuzoi kërkesën e subjektit propozues për të verifikuar në lidhje me të kaluarën e kandidatit për pasjen ose jo të rekordeve kriminale. Edhe pse subjekti propozues nuk ka asnjë provë që të vërtetojë pasjen ose jo të kandidatit, të rekordeve kriminale, refuzimi prej tij për ta bërë një gjë të tillë është indicie e mjaftueshme për të dyshuar.

Sipas Koalicionit APPD, referuar nenit 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor që një kandidat të kandidojë si i propozuar nga një parti politike apo koalicion zgjedhor duhet të përputhen vullnetet si të kandidatit dhe të subjektit që e përfaqëson. Në këto kushte duke qenë se subjekti propozues i kandidatit, APPD nuk ka më vullnet për të kandiduar si përfaqësues të tij Z.Gentian Muhameti, KQZ-së i është kërkuar të vendosë çregjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie Këlcyrë, z. Gentian Muhameti, propozuar nga APPD.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, në KQZ, u paraqit përfaqësuesi i kandidatit për kryetar të Bashkisë Këlcyrë, z.Gentian Muhameti, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës së koalicionit Aleanca Popullore për Punësim dhe Dinjitet për tërheqjen e kandidatit për Kryetar Bashkie Këlcyrë z. Gentian Muhameti, pasi pretendimi i koalicionit APPD ishte i pa mbështetur në ligj. Kodi Zgjedhor nuk parashikon në asnjë dispozitë të tij të drejtën e një partie politike apo koalicioni zgjedhor që në përfundim të të gjitha procedurave për regjistrimin e kandidatëve, të kërkojë çregjistrimin e tij. Gjithashtu subjekti propozues i kandidatit Gentian Muhameti nuk paraqiti asnjë provë

qoftë për të vërtetuar pretendimet e aluduara në lidhje me të kaluarën e kandidatit.

Përfaqësuesi i kandidatit gjatë shqyrtimit të ankimit në KQZ, depozitoi një kopje të çertifikatës së të dhënave të përgjithshme penale, të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë Italiane. Sipas kësaj çertifikatë rezulton se kandidati është i padënuar nga shteti Italian.

Për të arritur në një vendimarrje sa më të saktë, KQZ me shkresën nr. 5559, datë 03.06.2015, vendosi të kërkojë të dhëna për Z. Gentian Muhameti, pranë Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Shërbimit Informativ Shtetëror.

Duke qenë se brenda datës 09.06.2015 nga këto institucione nuk u paraqit asnjë informacion dhe duke qenë se koha për prodhimin e fletës së votimit ishte në limitet e fundit të saj, KQZ vendosi të vazhdojë shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga APPD, për çregjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie Këlcyre, z. Gentian Muhameti.

KQZ në përfundim, me vendimin nr. 625 datë 09.06.2015 ka vendosur:

- 1. Pranimin e kërkesës së Koalicionit APPD.*
- 2. Ç'regjistrimin e kandidati për kryetar Bashkie Këlcyre, propozuar nga Koalicioni APPD, z. Gentian Hysen Muhameti.*
- 3. Ndryshimin e vendimit nr. 548, datë 22.05.2015, "Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkia Këlcyre për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21 qershor 2015", duke hequr nga fleta e votimit kandidatin me numër rendor 2 (dy) Gentian Hysen Muhameti, propozuar nga Koalicioni APPD.*

Me datë 12.06.2015, paditësi Gentian Muhameti ka paraqitur në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tirane një kërkesë-padi, me të cilën, duke paditur KQZ-në, ka kërkuar: *"Shfuqizimi si i papajtueshëm me aktet ndërkombëtare, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me Kodin Zgjedhor, të Vendimit nr 625 datë*

09.06.2015 të KQZ në lidhje me pranimin e kërkesës së Koalicionit APPD, për tërheqjen nga kandidimi të kandidatit për Bashkinë Këlcyre, Gentian Muhameti”.

Ky vendimi i KQZ-së është ankimuar (ngritur padi) brenda afatit ligjor në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, nga kandidati për Kryetar të Bashkisë Këlcyre z.Gentian Muhameti.

Kolegji Zgjedhor pasi shqyrtoi çështjen në tërësi me shumicë votash ka vendosur: *“- Rrëzimin e padisë së paditësit Gentian Muhameti”.*

Kolegji Zgjedhor arsyeton se:

“Kolegji Zgjedhor e gjen të drejtë prapësimin e pales së paditur KQZ për moslegjitimin e paditësit. Sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor kërkesa për regjistrimin e kandidateve për kryetar bashkie, bëhet nga partia politike/koalicioni zgjedhor ose nga një grup zgjedhësish. Në rastin e paditësit kërkesa për regjistrim kandidati dhe c’regjistrim të tij është bërë nga Koalicioni APPD. Në këtë rast, është ky i fundit (Koalicioni APPD) subjekti zgjedhor që ka të drejtën të bëjë ankimin administrativ apo atë gjyqësor, në bazë të nenëve 124/1 dhe 145 të Kodit Zgjedhor, pasi është ai subjekti zgjedhor kërkues, pra subjekti iniciues i procedurës së regjistrimit të kandidatit për kryetar bashkie. Në kushtet kur kërkesa për c’regjistrim kandidati në KQZ është bërë nga Koalicioni APPD, që është dhe koalicioni që ka mbështetur kandidaturen e paditësit për kryetar të Bashkisë Këlcyre, ku mbi këtë kërkesë paditësi rezultoi të jetë c’regjistruar si i tillë, ky i fundit (paditësi) nuk legjitimohet në ngritjen e padisë objekt gjykimi, por është partia/ koalicioni zgjedhor ai që gëzon të drejtën e ankimit.

Përsa me sipër paditësi Gentian Muhameti nuk legjitimohet për të kundërshtuar vendimin objekt gjykimi të KQZ në Kolegjin Zgjedhor”.

Unë Gjyqtari i kësaj trupe gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor, jam i mendimit se paditësi legjitimohet të kundërshtojë vendimin e KQZ-së në këtë Kolegji Zgjedhor, për pasojë dhe duhet shqyrtuar padia e tij në themelin e saj.

Neni 2/20 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

“Subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod.

Referuar sa më sipër konkludohet se; paditësi Gentian Muhameti duke u regjistruar rregullisht nga KZAZ Nr.75, në përputhje me Kodin Zgjedhor, është subjekt zgjedhor për pasojë ka legjitimim aktiv për të paraqitur ankim administrativ si dhe kërkesë-padi në Kolegjin Zgjedhor.

Edhe për sa i përket themelit të kësaj çështje në shqyrtim, jam i mendimit se padia është e bazuar në ligj dhe prova.

Kodi Zgjedhor në nenin 73/4 ka përcaktuar kufizimin e subjekteve zgjedhore për të ndryshuar emrat në listat shumëemërore dhe renditjen e tyre, dhe aq më pak kanë të drejtë subjektet zgjedhore të paraqesin kërkesa për të tërhequr kandidatin e tyre për kryetar të organeve të qeverisjes vendore të regjistruar sipas Kodit Zgjedhor.

Kodi Zgjedhor nuk ka parashikuar të drejtën e Subjektit Zgjedhor për t’u tërhequr nga kandidati për kryetar të organeve të qeverisjes vendore, (kjo është pranuar edhe nga KQZ) pasi është realizuar regjistrimi i tij rregullisht. Ligji i njeh subjekteve zgjedhore vetëm të drejtën për të propozuar kandidatët për kryetar të organeve të qeverisjes vendore, por jo edhe atë të tërheqjes në cdo kohë të këtij kandidati të regjistruar.

KQZ-ja megjithëse ka konstatuar se kandidati për kryetar Bashkisë Këlcyrë, propozuar nga Koalicioni APPD, Z.Gentian Hysen Muhameti, nuk ka asnjë rekord kriminal; nuk u administrua asnjë vendim penal i formës së prerë që të jetë i dënuar ky kandidat; përkundrazi u paraqitën vërtetime të gjendjes gjyqsore të tij, që figuron i padënuar në Republikën e Shqipërisë si dhe në Republikën e Italisë, (ku dhe dyshohej se është i dënuar nga Gjykatat e atij shteti), përsëri ka vendosur të çregjistrojë kandidatin për kryetar të Bashkisë Këlcyrë, propozuar nga Koalicioni APPD, Z.Gentian Hysen Muhameti.

Për sa më sipër mbetem në mendimin kundra me trupën gjyqësore të këtij Kolegji Zgjedhor, se paditësi Gentian Muhameti duhej të ishte legjitimuar në ngritjen e padisë pranë këtij Kolegji Zgjedhor, dhe për sa i përket themelit të çështjes jam i mendimit se padia është e bazuar në ligj dhe prova dhe si e tillë duhej të ishte pranuar.

Tiranë sot me datë 15.06.2015.

GJYQTARI

Kliton SPAHIU

* * *



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**NR. 21 REGJ. THEMELTAR
DATË 19.06.2015 REGJ.**

**NR. 21 VENDIMI
DATË 19.06.2015 VENDIMI**

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUES :	ILIR TOSKA
ANETAR :	PETRIT ÇENO
ANETAR :	GJINOVEFA GABA
ANETAR :	FUAT VJERDHA
ANETAR :	KLITON SPAHIU

asistuar prej sekretares Rexhina Baci, në Tiranë, sot me datë 19.06.2015, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore, që u përket paleve:

PADITËSE : **PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE,**
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Z.Aurel
Bylykbashi dhe Z.Ivi Kaso.

I PADITUR : **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,**
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Znj.Deshira
Pasko, Z.Olsi Peto dhe Znj. Anila Ruço.

OBJEKTI : - Kundershtim ndaj mosmarrjes vendim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve lidhur me Kerkesen Nr.6133, date 16.06.2015, te Partise Demokratike te Shqiperise.
- Detyrimin e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve te marre vendim lidhur me Kerkesen Nr.6133, date 16.06.2015, te Partise Demokratike te Shqiperise.

BAZA LIGJORE : Nenet 21, 22, 23, 24, 50, 145/2 e vijues, 158 e vijues, te Kodit Zgjedhor te Republikes se Shqiperise.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS APELIT TIRANË

Pasi degjoi perfaqesuesit e pales paditese Patia Demokratike e Shqiperise, qe kerkuan pranimin e padise sipas objektit; degjoi perfaqesuesit e pales se paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, qe kerkuan rrezimin e padise; si dhe pasi shqyrtoi ceshtjen ne teresi,

V E R E N

Me Dekretin Nr.8844, datë 15.12.2014, ne mbështetje të neneve 92/gj dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 9§1§2 dhe 10§1§2 të Ligjit

Nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (me poshte referuar si Kodi Zgjedhor i ndryshuar), Presidenti i Republikes se Shqiperise ka caktuar daten 21 qershor 2015 per zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Pranohet se pala paditese Partia Demokratike e Shqiperise (me poshte referuar si PD), ne përputhje me nenin 64 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, eshte regjistruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (me poshte KQZ) si subjekt zgjedhor ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015. Po keshtu pranohet se pala paditese PD, bashke me disa parti politike te regjistruara rregullisht si subjekte zgjedhore, bazuar ne nenin 65 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, jane regjistruar nga KQZ-ja si koalicion zgjedhor ne shkalle vendi, nen emrin Aleanca Popullore per Pune dhe Dinjitet (me poshte referuar si APPD), per zgjedhjet e organeve te qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015, subjekt zgjedhor (Koalicioni APPD) mbi kerkesen e te cilit jane regjistruar rregullisht dhe kandidatet per kryetar te Bashkise Durres dhe te Bashkise Kavaje, sikundër mbi kerkese te subjektit zgjedhor PD jane regjistruar dhe listat shumemerore per kandidatet per anetare te Keshillit Bashkiak Durres dhe te Keshillit Bashkiak Kavaje.

Me tej, pranohet hartimi, miratimi dhe publikimi i listes se zgjedhesve per cdo zone qendre votimi te njesive te qeverisjes vendore Bashkia Durres dhe Bashkia Kavaje.

Ne vijim, pranohet se mbi kallëzim te Partise Demokratike, por dhe te nje materiali te auditit teknikien te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, ne lidhje me rregullsine e regjistrimit te nje numri shtetasish ne njesite e qeverisjes vendore si me lart dhe, me tej, per përfshirjen e tyre ne listen e zgjedhesve te ketyre zona zgjedhore ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015, Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres dhe Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kavaje kane regjistruar procedimet penale te falsifikimit te dokumenteve, falsifikimit kompjuterik dhe shpërdorimit te detyres, ku ne kuadër te ketyre procedimeve penale, ne funksion te realizimit te hetimeve paraprake, mbi kerkese te organit te prokurorise, gjykatat respektive kane vendosur sekuestrimin e te dhenave kompjuterike ne lidhje me perberesit e gjendjes civile per disa shtetas te caktuar, ne funksion te vërtetimit te fakteve objekt hetimi.

Ne kete situatë, me date 16.06.2015, subjekti zgjedhor PD i ka drejtuar KQZ-se nje kerkese me shkrim, protokolluar me nr.6133, date 16.06.2015.

Me kete kerkese, referuar dhe veprimeve hetimore te Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres dhe Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kavaje, ndersa sipas vlerësimit te saj ekzistojne jo vetem dyshime te bazuara ne prova per manipulim te listave te zgjedhesve ne keto zona zgjedhore, por tashme keto dyshime ishin hetuar dhe konfirmuar edhe nga prokuroria, por edhe gjykata (Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres) nepermjet urdhrit te sekuestros, duke konsideruar se KQZ-ja, bazuar ne nenin 21/26 te Kodit Zgjedhor, kishte autoritetin dhe pergjegjesine per te marre masa per zgjidhjen e situatave "siu generis", si dhe se momenti kohor ishte ende i pershtatshem per marrjen e masave per te parandaluar prodhimin e efekteve te paligjshme te nje krimi elektoral, subjekti zgjedhor PD i ka kërkuar KQZ-se :

"Te marre te gjitha masat e nevojshme, duke urdhëruar Drejtorine e Gjendjes Civile, te prodhoje dhe shperndaje ne KZAZ-te perkatese, lista zgjedhore ne te cilat te mos figurojne te dhenat e shtetasve, rekordet e te cileve Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kavaje i ka sekuestruar".

Referuar procesverbalit te zbardhur te mbledhjes, rezulton qe kjo kerkese te jete perfshire ne diskutimet jashte rendit te dites, ne Mbledhjen e KQZ-se te dates 16.06.2015, ku ne kete rast, KQZ-ja ka vendosur qe ne mbledhjen e dites se nesërme te therrase Drejtorin e Pergjithshem te Gjendjes Civile, per te informuar KQZ-ne ne lidhje me Shkresen Nr.8699/1 prot., date 16.06.2015, te Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres, me te cilen ajo informonte ne lidhje me procedimin penal te filluar mbi kallezmin e Partise Demokratike dhe materialin kallëzues te auditit teknicien te KQZ-se, ku ne funksion te këtij hetimi, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres, me Vendimin Nr.337, date 09.06.2015, kishte vendosur dhe sekuestrimin ne lidhje me perberesit e gjendjes civile qe i përkasin shtetasve bashkëlidhur vendimit, pjese integrale e vendimit, si dhe urdhëruar ndalimin e kryerjes se veprimeve te mëtejshme ne keto te dhena nga zyra e gjendjes civile, vendim gjyqësor ky qe i ishte percjell per ekzekutim Drejtorise se Pergjithshme te Gjendjes Civile, te ciles KQZ-ja mund t'i drejtohej per informacion me te detajuar ne lidhje me listen dhe ekzekutimin e vendimit te gjykates.

Ne vijim, ne Mbledhjen e dates 17.06.2015, referuar procesverbalit te zbardhur te mbledhjes, KQZ-ja ka perfshire si ceshtje ne rendin e

dites marrjen e informacionit nga Drejtori i Pergjithshem i Gjendjes Civile persa i perket marrjes dhe ekzekutimit nga ky institucion te Vendimit Nr.337, date 09.06.2015, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres.

Ne Mbledhjen e KQZ-se te dates 17.06.2015, del te jete paraqitur Drejtori i Pergjithshem i Gjendjes Civile, i cili ka informuar KQZ-ne ne lidhje me marrjes dhe ekzekutimit nga ky institucion te Vendimit Nr.337, date 09.06.2015, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres, sikundër ka informuar edhe per ceshtje teknike referuar pyetjeve nga anetaret e KQZ-se apo perfaqesuesit e subjekteve zgjedhore te pranishem ne kete mbledhje.

Ne kete mbledhje, pas perfundimit te seances degjimore me Drejtorin e Pergjithshem te Gjendjes Civile, ne kuadër te kësaj pike te rendit te dites, perfaqesuesi i subjektit zgjedhor PD ka kërkuar shqyrtimin e kerkeses se paraqitur nga ky subjekt zgjedhor me date 16.06.2015, ku anetaret e KQZ-se kane shfaqur mendime te ndryshme rreth pranueshmerise ose jo per shqyrtim te kerkeses, juridiksionit dhe kompetences se KQZ-se per trajtimin e saj, bazen ligjore etj.

Ne përfundim te shqyrtimit te kësaj pike te rendit te dites, ndersa perseri perfaqesuesi i subjektit zgjedhor PD ka kërkuar dhënien e nje vendimi per kerkesen e paraqitur me date 16.06.2015, KQZ-ja nuk ka dale me ndonje vendim.

Me date 19.06.2015, ne Kolegjin Zgjedhor eshte paraqitur nje kerkesepadi nga subjekti zgjedhor PD, me te cilen, duke paditur KQZ-ne, ndersa ka kundërshtuar mosmarrjen e nje vendimi nga KQZ-ja ne lidhje me Kerkesen Nr.6133 prot., date 16.06.2015, ka kërkuar detyrimin e KQZ-se te marre vendim ne lidhje me kete kerkesë.

Ne kerkesepadi, si dhe gjate shqyrtimit gjyqësor, pala paditese pretendoi se KQZ-ja, ne kundërshtim me ligjin dhe kompetencat qe ai i jep ne lidhje me zgjidhjen e ankesave te subjekteve zgjedhore, si organi me i larte i administrimit zgjedhor, pavarësisht se eshte vene ne dijeni shkreserisht nga nje subjekt zgjedhor per nje problematike te rendesishme zgjedhore, sic jane listat e zgjedhesve, problematike

e cila kërkonte shqyrtimin dhe vendimmarrjen e saj, pavarësisht se zhvilloi te gjithë debatin lidhur me kete ceshtje, si dhe administroi te gjitha materialet ne funksion te saj, nuk u shpreh me vendim per kerkesen e paraqitur.

Sipas pales paditese, pika 17 e nenit 21 te Kodit Zgjedhor, te ndryshuar, përcakton se KQZ-ja ka kompetence te shqyrtoje dhe zgjidh ankesat e subjekteve zgjedhore per zhvillimin e procesit zgjedhor, ne përputhje me rregullat e këtij Kodi, ndersa pika 26 e këtij neni, lejon KQZ-ne te kryeje edhe detyra te tjera, perfshire edhe marrjen e masave per zgjidhjen e situatave “siu generis” dhe vecanerisht te zgjidhe shqetësimet qe adresohen nga subjektet zgjedhor, nderkohe qe sipas nenit 50/3 te Kodit, KQZ-ja ka pergjegjesine te mbikëqyr procesin e hartimit te listave te zgjedhesve, administrimin e zonave te qendrave te votimit dhe numrit te zgjedhesve per cdo qender votimi. Me tej, sipas pales paditese, Kodi Zgjedhor, i ndryshuar, ne nenin 23 përcakton aktet qe KQZ-ja mund te nxjerr ne baze dhe per zbatim te ligjit, vendime ose udhëzime, ndersa ne nenin 24 te tij, rregullohet vendimmarrja e KQZ-se.

Ne rastin konkret, sipas pales paditese, nuk ka vepruar ne respektim te ligjit, kur nuk dhene vendim per kerkesen e paraqitur prej saj. Perkunder pretendime te pales paditese, pala e paditur KQZ ka prapësuar, duke pretenduar se kërkesa e paraqitur nga subjekti zgjedhor padites eshte trajtuar, ku ne baze te nenit 50/3 te Kodit Zgjedhor, te ndryshuar, KQZ-ja kishte kërkuar dhe marre informacion te detajuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile, nderkohe qe me heret, per shkeljet e konstatuara nga auditi teknikien, KQZ-ja ia ka referuar ato organit te prokurorise.

Gjate gjykimit, Kolegji Zgjedhor administroi si prove aktet dokumentare te përmendura me lart dhe te paraqitura nga pala e paditur KQZ.

Ne përfundim te shqyrtimit, Kolegji Zgjedhor vlerëson se KQZ-ja, ne realizim te rregullt te veprimtarise se saj, nuk eshte shprehur me vendim per kerkesen e subjektit zgjedhor PD paraqitur asaj me date 16.06.2015.

Lidhur me kete, Kolegji Zgjedhor ka ne konsiderate se ligji, Kodi Zgjedhor, i ndryshuar, ka percaktuar shprehimisht menyren se si

KQZ-ja, si organi me i larte shtetëror i perhershëm, i ngarkuar per administrimin e zgjedhjeve, manifeston vullnetin e tij. Keshtu, ne baze te nenit 23/1 te Kodit Zgjedhor, te ndryshuar, ne kuadër te veprimtarise se saj, vullneti i KQZ-se manifestohet duke disponuar ajo me vendim per ceshtje te veçanta apo udhëzim per ceshtje te përgjithshme. Me tej, neni 24 i Kodit Zgjedhor, te ndryshuar, rregullon edhe menyren e formësimit te vullnetit te KQZ-se, ashtu sikundër dhe formen e vendimit te saj.

Ne rastin konkret, KQZ-se i eshte paraqitur nga subjekti zgjedhor padites nje kerkese me shkrim, nepermjet te ciles, ndersa konsideron si nje ceshtje te rendesishme per procesin zgjedhor ate te listave te zgjedhesve ne dy zona zgjedhore, ka kërkuar marrjen e masave te nevojshme dhe pikërisht urdhërimin e Drejtorise se Gjendjes Civile te prodhoje dhe shperndaje ne KZAZ-te perkatese lista zgjedhore ne te cilat te mos figurojne te dhenat e shtetasve, rekordet e te cileve Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kavaje i ka sekuestruar.

Me tej, del qe KQZ-ja ta kete trajtuar kete kerkese, duke marre informacion nga Drejtoria i Pergjithshem i Gjendjes Civile, por se, ne finale, duke konsideruar si te ezauruar trajtimin e kerkeses se subjektit zgjedhor padites me marrjen e këtij informacioni, pavarësisht opsioneve konkrete te shprehuara nga anetare te saj rreth pranueshmerise ose jo per shqyrtim te kerkeses, juridiksionit dhe kompetences se KQZ-se per trajtimin e saj, bazen ligjore etj, KQZ-ja nuk ka marre nje vendim per ate c'ka subjekti zgjedhor padites i kishte kërkuar posacerisht, pra marrjen e nje vendimi me te cilin te urdhërohej Drejtoria e Gjendjes Civile per te kryer nje veprimtari konkrete ne lidhje me prodhimin dhe shperndajen ne KZAZ-te perkatese te listave zgjedhore me nje përmbajtje te caktuar.

Ne vlerësim te Kolegjit Zgjedhor, ne cdo rast qe nje subjekt zgjedhor paraqet nje kerkese konkrete qe adresohet per procesin zgjedhor dhe nepermjet te ciles synohet nje vendimmarrje e caktuar, KQZ-ja, ne përputhje me kompetencat dhe detyrat e ngarkuara nga Kodi Zgjedhor, si dhe rregullimet e veçanta te tij, ka detyrimin ta marre ne shqyrtim dhe te shprehet me nje vendim konkret per nje kerkese te tille.

Dhe, ndersa ka parasysh ceshtjen objekt kerkese, si dhe momentin qe tashme ndodhet procesi parazgjedhor, dy dite përpara dates se zgjedhjeve, Kolegji Zgjedhor vlerëson se afati brenda te cilit KQZ-ja duhet te marre nje vendim per kerkesen e paraqitur nga subjekti zgjedhor padites te jete jo me vone se dita e nesërme, data 20.06.2015.

Sa mesiper, Kolegji Zgjedhor konkludon se padia e paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike duhet te pranohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykates se Apelit Tirane,
bazuar ne nenin 158, pika 4, te Kodit Zgjedhor te ndryshuar,

V E N D O S I

Pranimin e padise.

Detyrimin e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve te shprehet me vendim brenda dites se nesërme, date 20 qershor 2015, ne lidhje me kerkesen nr.6133 prot., date 16.06.2015, te Partise Demokratike te Shqiperise.

Tiranë, më 19.06.2015

ANËTAR
GJINOVEFA GABA

ANËTAR
PETRIT ÇENO

KRYESUES
ILIR TOSKA

ANËTAR
KLITON SPAHIU

ANËTAR
FUAT VJERDHA

* * *



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**NR. 22 REGJ. THEMELTAR
DATË 19.06.2015 REGJ.**

**NR. 22 VENDIMI
DATË 20.06.2015**

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUES :	GJINOVEFA GABA
ANËTAR :	KLITON SPAHIU
ANËTAR :	FUAT VJERDHA
ANËTAR :	PETRIT CENO
ANËTAR :	VALBON ÇEKREZI

asistuar prej sekretares Rexhina Baci, në Tirane, sot më datë 20.06.2015, në seancë gjyqësore me dyer te hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore, që u përket palëve:

PADITËSE: PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË,
përfaqësuar në gjykim me autorizim nga Z.Ivi Kaso.

I PADITUR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar në gjykim me autorizim nga Znj. Deshira Pasko dhe Z.Olsi Peto.

PALË E INTERESUAR: PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË,
përfaqësuar në gjykim me autorizim nga Z.Koli Bele dhe Z.Gledian Llatja.

OBJEKTI: Tërheqjen nga kandidimi të Z. Altin Gjon Biba si kandidat për kryetar të Bashkisë Kurbin, Qarku Lezhë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të Dt 21.06.2015, për shkak se ka dhënë dorëheqjen e parevokueshme nga kandidimi për kryetar Bashkie.

BAZA LIGJORE: Nenet 67,72, 73, 165 e vijues, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoi përfaqësuesin e palës paditëse, Partia Demokratike e Shqipërisë, që kërkoi pranimin e padisë sipas objektit; dëgjoi përfaqësuesin e palës së paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, që kërkoi rrëzimin e padisë; dëgjoi përfaqësuesit e palës së interesuar Partia Socialiste e Shqipërisë, që kërkuan rrëzimin e padisë; pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN

Koalicioni Aleanca Popullore per Pune dhe Dinjitet (APPD), në ushtrim të së drejtës së parashikuar në nenin 165/3 të Kodit Zgjedhor dhe në përputhje me kërkesat e nenit 67 të këtij Kodi, brenda përfundimit të afatit ligjor, datë 4 maj 2015, ka paraqitur përpara Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) Nr.15, Qarku Lezhë, kërkesën për regjistrimin e Z. Altin Biba si kandidat për kryetar të Bashkisë Kurbin për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, duke i bashkëlidhur kësaj kërkesë edhe dokumentet e kandidimit, sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor.

KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë, bazuar në nenet 33/f dhe 73 të Kodit Zgjedhor, me Vendimin Nr.50, datë 06.05.2015, në përmbushje të kërkesave të ligjit dhe mbi bazën e dokumenteve të kandidimit, ka vendosur *“të regjistrojë si kandidat per kryetar te Bashkise Kurbin, z.Altin Gjon Biba, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, paraqitur nga Koalicioni Aleanca Popullore per Pune dhe Dinjitet”*.

Me regjistrimin e tij, Z.Altin Gjon Biba ka marrë cilësinë e “subjektit zgjedhor”, sipas përcaktimit të nenit 2/20 të Kodit Zgjedhor, që parashikon se *“Subjekte zgjedhore janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë kod”*.

Më datë 09.05.2015, pra, tre ditë pas shpalljes së këtij vendimi, pranë KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë, kandidati i regjistruar, që tashmë kishte dhe cilësinë e subjektit zgjedhor, Z.Altin Biba, ka paraqitur një kërkesë për heqjen dorë nga kandidimi, kërkesë të cilën, më datë 10.05.2015, KZAZ Nr.15 i Qarkut Lezhe ia ka përcjellë KQZ-së, si edhe subjektit zgjedhor Koalicionit APPD (partisë politike kryesuese të koalicionit, Partisë Demokratike).

Më datë 13.05.2015, subjekti zgjedhor, Koalicioni zgjedhor APPD, ka paraqitur përpara KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë, një kërkesë për regjistrimin e Z.Illir Pjeter Pjetraj si kandidat për kryetar të Bashkisë Kurbin për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, duke i bashkëlidhur asaj dhe dokumentet e kandidimit, sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor.

Po më datë 13.05.2015, KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë ka shqyrtuar fillimisht kërkesën e z.Altin Biba për heqjen dorë nga kandidimi, në përfundim të së cilit, me Vendimin Nr. 54, ka vendosur “1. Shfuqizimin e vendimit Nr. 50, datë 06.05.2015 për regjistrimin e kandidatit për Kryetar të Bashkisë Kurbin të Partisë Demokratike Z.Altin Gjon Biba” dhe, më pas, me Vendimin Nr. 55, ka shqyrtuar kërkesën për regjistrimin e kandidatit të Koalicionit APPD dhe ka vendosur të regjistrojë si kandidat për kryetar të Bashkisë Kurbin, paraqitur nga Koalicioni Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet, z.Illir Pjeter Pjetraj.

Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë (PS), duke mos qenë dakord me vendimin Nr. 55, datë 13.05.2015, të KZAZ Nr.15, Qarku Lezhë, brenda afatit ligjor 3 ditor (më datë 16.05.2015), ka paraqitur përpara KQZ-së një ankim zgjedhor nëpërmjet të cilit ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe shfuqizimin e tij, duke pretenduar se është një vendim absolutisht i pavlefshëm për shkak se është marrë jashtë çdo procedure dhe afati ligjor, të përcaktuar

në nenin 73/4 të Kodit Zgjedhor për depozitimin e dokumenteve të kandidimit dhe për regjistrimin e kandidatëve për kryetar të njesisë së qeverisjes vendore.

KQZ-ja, në përfundim të shqyrtimit administrativ, me Vendimin Nr. 493, datë 20.05.2015, bazuar në nenet 68/2, 73, 124 dhe 143/1/c të Kodit Zgjedhor, ka vendosur “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit Nr.55, datë 13.05.2015, të KZAZ Nr.15, “Për regjistrimin e z. Ilir Pjetraj, si kandidat për kryetar bashkie Kurbin, propozuar nga koalicioni APPD dhe pranimin e kërkesës ankimore të Partise Socialiste”.

Kjo vendimmarrje e KQZ-së është ankimuar nga subjekti zgjedhor PD, pranë Kolegjit Zgjedhor, i cili pas shqyrtimit të çështjes, me Vendimin Nr.13, datë 28.05.2013, ka vendosur :

1. Shfuqizimin e Vendimit Nr. 493, datë 20.05.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

2. Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që, jo më vonë se data 30.05.2015, të marrë vendim për çështjen e regjistrimit të kandidatit të propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni Aleanca Popullore për Pune dhe Dinjitet, duke trajtuar në themel edhe kërkesën për dorëheqje të kandidatit Altin Biba dhe kërkesën e subjektit zgjedhor Koalicioni Aleanca Popullore për Pune dhe Dinjitet, të datës 13.05.2015, për regjistrimin/zevendësimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Kurbin, Qarku Lezhe, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015”.

Në vijim, me Vendimin Nr. 593, datë 01.06.2015, “Për ekzekutimin e vendimit të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë Nr 08, datë 28.05.2015, për të marrë në shqyrtim çështjen e regjistrimit të kandidatit të propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Aleanca Popullore për Pune dhe Dinjitet”, duke trajtuar në themel edhe kërkesën për dorëheqje të kandidatit Altin Biba dhe kërkesën e subjektit zgjedhor Koalicionit “Aleanca Popullore për Pune dhe Dinjitet”, për regjistrimin/zëvendësimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Kurbin në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015”, KQZ-ja ka vendosur:

1. Mospranimin e dorëheqjes të kandidatit për kryetar për Bashkinë Kurbin, propozuar nga Koalicioni “Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet”.
2. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit Nr. 54 dhe 55 të KZAZ-së Nr 15.
3. Lënien në fuqi të vendimit Nr. 50, të KZAZ-së Nr. 15.

Në vendimin e saj, KQZ-ja ka argumentuar si vijon:

nga pikëpamja formale doreheqja nuk ploteson elementet e nje akti i cili te bind per deklarimin e ketij vullneti, nje leter, e cila ne fund rezulton e nenshkruar nga kandidati, vullnet i pavertetuar sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim. Kandidati shprehet se per arsye objektive shendetesore, familjare jep doreheqjen e parevokueshme ... Kjo deklarate nuk shoqerohet me asnje dokumentacion per te vertetuar shkaqet e permendura ne doreheqje dhe pamundesine reale te kandidatit per te vazhduar kandidimin;

Kodi Zgjedhor, kandidimin e parashikon si nje te drejte te cdo individi i cili propozohet me pas nga nje parti politike apo koalicion zgjedhor, dhe qe duhet te plotesoje disa kriteret kushtetuese dhe ligjore. Me perfitimin e statusit te kandidatit kjo e fundit nuk eshte me nje e drejte por nje detyrim ligjor per te mundesuar zhvillimin e zgjedhjeve te lira, demokratike dhe pluraliste;

Kodi Zgjedhor nuk e parashikon te drejten e heqjes dore nga kandidimi, pasi, pas shprehjes se vullnetit te individit se gezon te drejten dhe ka vullnet per te kandiduar, dhe regjistrimit si kandidat nga komisioni perkates, kandidati i nenshtrohet disa procedurave ligjore te parashikuara ne Kodin Zgjedhor deri ne nxjerrjen e rezultatit zgjedhor;

Më datë 03.06.2015, Subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë (PD), nëpërmjet padisë së paraqitur pranë Kolegjit Zgjedhor, ka kundërshtuar Vendimin Nr. 593, datë 01.06.2015, të KQZ-së, duke kërkuar gjykimin e çështjes në themel, pranimin e dorëheqjes së kandidatit z.Altin Biba dhe regjistrimin e kandidatit të Koalicionit APPD, z.Illir Pjeter Pjetraj.

Kolegji Zgjedhor, pasi ka shqyrtuar pretendimet e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë (PD), në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë së paraqitur nga Partia Demokratike, si të pabazuar në ligj. Në arsyetimin e Kolegjit, Kodi Zgjedhor, ndërsa parashikon kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen në paraqitjen e kandidaturës për kryetar të njësive të qeverisjes vendore, afatet dhe procedurën e regjistrimit të tyre, nuk parashikon pozitivisht (në mënyrë lejuese) dhe nuk njeh të drejtën për heqjen dorë nga kandidimi të kandidatit të regjistruar për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe as të drejtën e subjektit zgjedhor (subjektit politik) për zëvendësimin e kandidatit të regjistruar të saj dhe të dorëhequr pas regjistrimit të tij rregullisht. Në vlerësim të Kolegjit Zgjedhor, mungesa e parashikimit në Kodin Zgjedhor të të drejtës së kandidatit të regjistruar për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore për të hequr dorë nga kandidimi dhe, më tej, të të drejtës së subjektit zgjedhor (subjektit politik) për zëvendësimin e kandidatit të regjistruar të saj dhe të dorëhequr pas regjistrimit të tij rregullisht, tregon se qëllimi i ligjvënësit ka qenë pikërisht mosdhënia nëpërmjet mosnjohjes pozitivisht të këtyre të drejtave për këto subjekte zgjedhore.

Më datë 10.06.2015, Subjekti Zgjedhor Koalicioni Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet (PD), i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me padi, me të cilën ka kërkuar çregjistrimin e kandidatit z. Altin Biba si kandidat për kryetar të Bashkisë Kurbin, me argumentin se ka dhënë dorëheqjen e parevokueshme nga kandidimi për kryetar Bashkie dhe në këto kushte ky kandidat nuk ka më vullnet për të përfaqësuar subjektin APPD, për të prezantuar alternativat dhe programin e këtij subjekti përpara zgjedhësve të bashkisë Kurbin. Sipas paditësit, emri i z. Altin Biba, në fletën e votimit, i prezantuar nën emrin dhe siglën e Koalicionit Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet, është fiktive pasi realisht Koalicioni APPD nuk përfaqësohet në këtë zonë me kandidat për Kryetar.

KQZ pas shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga përfaqësuesi Koalicionit APPD, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Koalicionit Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet “Për çregjistrimin e kandidatit për kryetar Bashkie Kurbin, Z Altin Biba”. Në arritjen e këtij përfundimi, KQZ ka argumentuar se Kodi Zgjedhor nuk parashikon asnjë dispozitë në të cilën të parashikohet e drejta e partive politike apo koalicioneve zgjedhore për të kërkuar tërheqjen / zëvendësimin

apo cregjistrimin e kandidatëve pas regjistrimit përfundimtar të tyre nga komisionet përkatëse KQZ/KZAZ.

Gjithashtu, KQZ përse i përket shqyrtimit të kërkesës, ka konkluduar se, nisur nga objekti i saj (cregjistrimi i kandidatit për kryetar Bashkie Kurbin z. Altin Biba), jemi para parimit të gjese se gjykuar (*res judicata*), pasi KQZ dhe më pas Kolegji Zgjedhor e kanë marrë në shqyrtim dhe kanë vendosur, cka e pengon dhënien e cdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar më parë në KQZ.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se konkluzioni i KQZ, sipas të cilit kërkesa e paraqitur nga koalicioni Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet për tërheqjen nga kandidimi të kandidatit për kryetar të bashkisë Kurbin, Z. Altin Biba përbën gjë të gjykuar, është i gabuar.

Nga analiza e akteve të administruara, rezulton se kërkesa objekt gjykimi është paraqitur nga koalicioni APPD dhe ka objekt tërheqjen/cregjistrimin nga kandidimi të z. Altin Biba, ndërkohë që me vendimin Nr. 593, datë 01.06.2015 të KQZ, të shqyrtuar më tej me vendimin Nr 18, datë 05.06.2015 të Kolegjit Zgjedhor, objekt i shqyrtimit gjyqësor ka qenë kërkesa për dorëheqje e kandidatit Altin Biba.

Lidhur me këtë fakt, kërkesa objekt gjykimi e koalicionit APPD, është shqyrtimi dhe vendimmarrja për cregjistrimin e kandidatit Z. Altin Biba, i cili ka dhënë dorëheqjen e parevokueshme, me qëllim që përfaqësimi i këtij subjekti në fletën e votimit të mos jetë thjesht formal dhe të mos figurojë në fletën e votimit.

Rezulton se KQZ dhe, më pas, Kolegji Zgjedhor kanë shqyrtuar kërkesën lidhur me dorëheqjen e kandidatit Z. Altin Biba, si shprehje e vullnetit të kandidatit pas regjistrimit të tij, dhe të zëvendësimit të kandidatit të regjistruar dhe të dorëhequr, por në asnjë moment si KQZ dhe më pas Kolegji Zgjedhor nuk janë shprehur dhe nuk e kanë marrë në shqyrtim kërkesën e Koalicionit Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet për tërheqje dhe rrjedhimisht cregjistruar nga kandidimi për Kryetar të Bashkisë Kurbin, Qarku Lezhe, zotën Altin Biba.

Pavarësisht se vendimi i Kolegjit Zgjedhor Nr. 18, datë 05.06.2015, që ka marrë formë të prerë, është midis të njëjtave palë dhe ngrihet

mbi të njëjtën bazë ligjore, konflikti nuk është për të njëjtin shkak. Rezulton se thelbi i konfliktit në çështjen objekt gjykimi të Kolegjit Zgjedhor, ka të bëjë me kërkesën e Partisë Demokratike për çregjistrimin e kandidatit të propozuar nga subjekti zgjedhor APPD, ndërkohë që Kolegji Zgjedhor ka marrë në shqyrtim dhe ka trajtuar gjerësisht në vendimin Nr. 18, datë 05.06.2015, i cili ka marrë formë të prerë, dorëheqjen e kandidatit Z.Altin Biba në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015.

Ndërsa, përse i përket shqyrtimit në themel të kërkesës së koalicionit APPD për tërheqjen dhe çregjistrimin e kandidatit, Kolegji Zgjedhor cmon se KQZ, me të drejtë, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Koalicionit Aleanca Popullore për Pune dhe Dinjitet, bazuar në nenin 73/4 të Kodit Zgjedhor.

Kodi Zgjedhor, në Nenin 73/4 të tij, përcakton shprehimisht se, *“emrat në listat shumëmemërore dhe renditja e tyre nuk mund të ndryshohen pas miratimit përfundimtar nga ana e KQZ-së ose, sipas rastit, KZAZ-së”*.

Nga ana tjetër, Kodi Zgjedhor nuk ka parashikuar në asnjë dispozitë të drejtën e subjekteve zgjedhore për t’u tërhequr nga kandidatët për kryetare të organeve të qeverisjes vendore, pas regjistrimit përfundimtar të tyre në komisionet përkatëse KQZ / KZAZ. Ligji i njuh subjektit zgjedhor, koalicionit APPD, vetëm të drejtën për të propozuar kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, por jo atë të tërheqjes të kandidatëve, pas regjistrimit të tyre.

Kodi Zgjedhor ka përcaktuar procedura dhe afate të qarta dhe urdhëruese lidhur me propozimin, verifikimin dhe regjistrimin e kandidatëve për zgjedhje. Këto rregullime ligjore kanë qëllim të garantojnë stabilitetin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor nga vonesa apo veprime që e vënë në rrezik atë. Në mënyrë të vecantë, urdhërimi ligjor i parashikuar në nenin 74, pika 4, të Kodit Zgjedhor, që ndalon shprehimisht ndryshimin e emrave në listat shumëmemërore pas miratimit përfundimtar të tyre nga ana e KQZ-së, synon, në vlerësimin e këtij Kolegji, të garantojë realizimin e një procesi zgjedhor transparent, në respektim të parimeve themelore të së drejtës zgjedhore, duke siguruar ushtrimin nga zgjedhësit të së drejtës themelore të tyre për të zgjedhur personat që do t’i qeverisin ata në nivel vendor.

Sikurse është shprehur ky Kolegj, parimi i votimit të lirë (neni 45/3 i Kushtetutës), element i të cilit është liria e zgjedhësve që, nëpërmjet rrjedhës normale të procesit zgjedhor, të mund të formojnë rregullisht opinionin e tyre për të patur mundësinë që me votë të shprehin preferencën ose pëlqimin për një të tjerë prej alternativave që ofrojnë subjektet zgjedhore, mund dhe duhet të realizohet nëpërmjet paraqitjes dhe njohjes së zgjedhësve me kandidatët e regjistruar dhe programet e tyre, proces që mbart në vetvete përgjegjësinë e kandidatit të regjistruar dhe koalicionit zgjedhor për një sjellje në funksion e pajtim të përmbushjes së këtij parimi.

Tërheqja/cregjistrimi apo zëvendësimi i kandidatëve nga subjektet zgjedhore, pas miratimit dhe shpalljes së listave dhe regjistrimit të kandidatëve apo, më tej, edhe pas përgatitjes së materialit zgjedhor përkatës, do të përbënte një rrezik për stabilitetin dhe transparencën e procesit zgjedhor dhe ushtrimin e së drejtës themelore të votës nga ana e zgjedhësve. Është pikërisht kjo arsyeja që, në vlerësim të Kolegjit Zgjedhor, ka çuar ligjvënësin të mos parashikojë të drejtën e subjektit / koalicionit zgjedhor për të tërhequr kandidatin e regjistruar për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore.

Sa më sipër, Kolegji Zgjedhor cmon se padia e paraqitur nga Partia Demokratike është e pabazuar në ligj dhe si e tillë duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, bazuar në nenin 158, pika 3, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

VENDOSI

Rrëzimin e kërkesë padisë.

ANËTAR **ANËTAR** **KRYESUESE**
VALBON CEKREZI **KLITON SPAHIU** **GJINOVEFA GABA**

ANËTAR **ANËTAR**
PETRIT CENO **FUAT VJERDHA**

* * *



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**NR. 23 REGJ. THEMELTAR
DATË 20.06.2015 REGJ.**

**NR. 23 VENDIMI
DATË 20.06.2015 VENDIMI**

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUES :	PETRIT ÇENO
ANETAR :	VALBON ÇEKREZI
ANETAR :	EDLIRA PETRI
ANETAR :	ILIR TOSKA
ANETAR :	KLITON SPAHIU

asistuar prej sekretares Rexhina Baci, në Tiranë, sot me datë 20.06.2015, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore, që u përket paleve:

PADITËSE : PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE,
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Z.Ivi Kaso.

I PADITUR : KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Znj.Deshira Pasko, Z.Olsi Peto dhe Znj. Anila Ruço.

PERSON I INTERESUAR : PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE,
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Z.Koli Bele.

OBJEKTI : - Kundershtim i Vendimit Nr.710, date 20.06.2015, te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve.
- Gjykimin e ceshtjes ne themel, duke vendosur

pranimin e Kerkeses Nr.6133 prot., date 16.06.2015,
te Partise Demokratike te Shqiperise.

BAZA LIGJORE : Nenet 21, 22, 23, 24, 50, 145 e vijues, te Kodit
Zgjedhor te Republikes se Shqiperise.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS APELIT TIRANË

Pasi degjoi perfaqesuesin e pales paditese Patia Demokratike e Shqiperise, qe kërkoj pranimin e padise sipas objektit; degjoi perfaqesuesit e pales se paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, qe kerkuan rrezimin e padise; degjoi perfaqesuesin e personit te interesuar, qe kërkoj rrezimin e padise; si dhe pasi shqyrtoi ceshtjen ne teresi,

V E R E N

Me Dekretin Nr.8844, datë 15.12.2014, ne mbështetje të neneve 92/gj dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 9§1§2 dhe 10§1§2 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (me poshte referuar si Kodi Zgjedhor apo Kodi), Presidenti i Republikes se Shqiperise ka caktuar daten 21 qershor 2015 per zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Pranohet se pala paditese Partia Demokratike e Shqiperise (me poshte referuar si PD), ne përputhje me nenin 64 te Kodit Zgjedhor, eshte regjistruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (me poshte referuar si KQZ) si subjekt zgjedhor ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015. Po keshtu, per keto zgjedhje, pranohet se pala paditese PD, bashke me disa parti politike te regjistruara rregullisht si subjekte zgjedhore, bazuar ne nenin 65 te Kodit Zgjedhor, jane regjistruar nga KQZ-ja si koalicion zgjedhor ne shkalle vendi, nen emrin Aleanca Popullore per Pune dhe Dinjitet, subjekt zgjedhor mbi kerkesen e te cilit jane regjistruar rregullisht dhe kandidatate per kryetar te Bashkise Durres dhe te Bashkise Kavaje, sikundër mbi kerkese te subjektit zgjedhor PD jane regjistruar dhe listat shumememore per kandidatate per anetare te Keshillit Bashkiak Durres dhe te Keshillit Bashkiak Kavaje.

Pranohet gjithashtu se pala paditese Partia Demokratike, si parti politike parlamentare qe ka marre pjese ne zgjedhje, ka status te perhershem prane KQZ-se.

Rezulton se mosmarrëveshja objekt i këtij shqyrtimi lidhet me listen e zgjedhesve te zonave zgjedhore te Bashkise Durres dhe te Bashkise Kavaje.

Sipas nenit 2/9 te Kodit Zgjedhor, “Listat e zgjedhësve” janë dokumente zyrtare të zgjedhësve, që burojnë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile për çdo zonë të qendrës së votimit, të hartuara në përputhje me këtë Kod”.

Per vete rendesine qe ka lista e zgjedhesve per procesin zgjedhor, duke qene pikërisht ajo dokumenti zyrtar qe përcakton zgjedhesit e nje qendre votimi, zgjedhesit ne nivel zone zgjedhore dhe zgjedhesit ne nivel vendi, ndersa mundëson ushtrimin nga shtetasit te te drejtes per te zgjedhur, ligjvenesit, Pjesen e Trete te Kodi Zgjedhor ia ka kushtuar posacerisht “zgjedhesve” dhe “listes se zgjedhesve”, duke percaktuar kushtet per te qene zgjedhes, si dhe rregullat ne lidhje me afatet, procedurat dhe kompetencat per përgatitjen, miratimin dhe publikimin e listes se zgjedhesve.

Keshtu, ne nenin 44 te Kodit, jane percaktuar kriteret për përfshirjen e një personi në listën e zgjedhësve, nder te tjera, edhe qenien e tij te regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (në vijim RKGJC), pasjen e vendbanimit te regjistruar në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit, si dhe regjistrimin e tij si zgjedhës në listën e vetëm një zone qendre votimi.

Ndersa, ne nenin 45 te Kodit, jane percaktuar perberesit zgjedhore nepermjet te cileve zgjedhesit identifikohen ne RKGJC, perberes zgjedhor keto qe jane disa prej perberesve te gjendjes civile, dhe konkretisht emri, atësia, amësia, mbiemri, datëlindja, numri personal i identifikimit, shtetësia dhe kodi i vendbanimit.

Me tej, Kodi, ne nenin 46/1, ka percaktuar se “lista e zgjedhësve” hartohet për çdo zonë qendre votimi, ndersa ajo përmban të gjithë zgjedhësit që kanë vendbanimin e regjistruar në RKGJC në atë zonë qendre votimi, ku përfshirja e zgjedhësit në listë bëhet mbi bazën e kodit të vendbanimit.

Ndersa ne nenin 47 te Kodit, percaktohet se "lista e zgjedhesve" nxirret nga RKGJC, regjister ky qe mundeson administrimin, përpunimin dhe përditësimin e përbërësve zgjedhorë, si dhe nxjerrjen e tyre në çdo moment dhe në përputhje me dispozitat e këtij Kodi. Nderkohe, sipas kesaj dispozite, ndryshimi i përbërësve të gjendjes civile që janë përbërës zgjedhorë, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për gjendjen civile, kryhet automatikisht në RKGJC.

Ne vijim, Kodi, ne nenin 48, ka percaktuar edhe përmbajtjen dhe formatin e listes se zgjedhesve, duke percaktuar se lista e zgjedhesve hartohet ne disa formate, në formë të printuar për publikim per cdo zone qendre votimi, në formë të printuar për përdorim nga KQV-ja në procesin e votimit per cdo zone qendre votimi, në forme elektronike me përmbledhjen e të gjithë zgjedhesve në nivel zone zgjedhore, qe printohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe përdoret nga KZAZ-ja për informim të zgjedhesve, si dhe ne forme elektronike me përmbledhjen e të gjitha listave në nivel vendi që publikohet në faqet zyrtare të internetit të KQZ-së dhe ministrisë që mbulon shërbimin e gjendjes civile, ndersa ka percaktuar se zgjedhesit në listë renditen sipas rendit alfabetik të mbiemrit.

Kodi, me tej, ne nenin 49/1, ka percaktuar dhe organin e ngarkuar per hartimin e listes se zgjedhesve, pikërisht zyrat e gjendjes civile, te cilat jane percaktuar si përgjegjëse për përgatitjen e listave të zgjedhesve të zonave të qendrave të votimit nën juridiksionin e tyre, duke qene ato organet qe kane përgjegjësi të plotë për saktësinë e administrimit dhe ndryshimit të përbërësve zgjedhorë të shtetasve të njësisë vendore, individualisht dhe në tërësi. Nderkohe, ne piken 3 te kësaj dispozite, eshte percaktuar edhe organi i ngarkuar per shpalljen e listave te zgjedhesve, pikërisht kryetari i njësisë së qeverisjes vendore që ka në juridiksion zyrën përkatëse të gjendjes civile, ku ne rast te mospermbushjes brenda afatit ligjor të këtij detyrimi nga ana e kryetarit, per shpalljen e listes se zgjedhesve ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Drejtimi metodologjik i procesit te përgatitjes se listave te zgjedhesve, sipas nenit 50 te Kodit, i eshte ngarkuar Ministrit qe ka ne varesi shërbimin e gjendjes civile, drejtim i cili realizohet nepermjet nxjerrjes se urdhrave dhe udhëzimeve per ceshtje te caktuara.

Nderkohe, sipas pikes 2 te kësaj dispozite te Kodit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile eshte ngarkuar me mbikëqyrjen dhe kontrollin e të gjitha veprimeve që kryhen në RKGJC, pervec se edhe me udhëzimin dhe drejtimin metodologjik të punës së zyrave të gjendjes civile, duke patur ajo te drejten per t'iu kërkuar atyre të verifikojnë dhe të ndryshojnë problemet e konstatuara në RKGJC, ashtu sikundër per te marre masa disiplinore për nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile që shkelin procedurat e administrimit të përbërësve zgjedhorë, ndersa i propozon KQZ-së marrjen e masave disiplinore për kryetarët e njësive të qeverisjes vendore që shkelin rregullat e përcaktuara në këtë Kod.

Me tej, sipas pikes 3 te kësaj dispozite te Kodit Zgjedhor, te ndryshuar (nenit 50), KQZ-ja eshte ngarkuar me mbikëqyrjen e procesit te hartimit të listave të zgjedhësve, administrimin e zonave të qendrave të votimit dhe numrit të zgjedhësve për çdo qendër votimi, ku per kete KQZ-ja i kërkon informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe njësive të qeverisjes vendore, nderkohe qe për shkeljet e konstatuara dhe për mosdhënie të informacionit, KQZ-ja, në përputhje me Kodin, vendos sanksione ndaj drejtuesve të institucioneve përgjegjëse.

Kodi Zgjedhor ne vijim ka rregulluar ne menyre te detajuar procesin e përgatitjes se listes se zgjedhesve.

Keshtu, ne nenin 51, Kodi, rregullon fillimisht hartimin dhe publikimin (pas miratimit te kryetarit te njësisë vendore) nga zyrat e gjendjeve civile, jo me vone se 30 dite nga dekretimi i datës së zgjedhjeve, te “ekstraktit te perberesve zgjedhore” të të gjithë shtetasve që kanë vendbanim në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e çdo zyre, ndersa Ministria që mbulon shërbimin e gjendjes civile dhe KQZ-ja publikojnë në faqet përkatëse zyrtare të internetit ekstraktin e zgjedhësve në shkallë vendi, publikime keto qe përsëritet në mënyrë periodike çdo 30 ditë deri në shpalljen e listës së zgjedhësve, duke u pasqyruar ne keto publikime çdo ndryshim i përbërësve zgjedhorë të RKGJC-së që është bërë nga publikimi paraardhës deri në momentin e publikimit të ri.

Nga ana tjetër, sipas nenit 52 te Kodit, zgjedhesit e perfshire ne ekstraktin e perberesve zgjedhore te publikuar rishtazi (jo me vone

se 30 dite nga dekretimi i datës së zgjedhjeve) lajmërohen me shkrim (kundrejt nënshkrimit, të atij vete apo një anetari madhor të familjes që gjendet në banesë), nga kryetari i njësisë vendore (nëpërmjet administratoreve të lagjeve, kryetaret e fshatrave apo persona të tjerë të administratës së njësisë vendore), për qëndren e votimit, vendndodhjen dhe adresën e saj, si dhe numrin rendor të zgjedhësve në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit.

Dhe, ndërsa ende nuk ka një listë finale zyrtare të zgjedhësve, Kodi, në nenin 53, parashikon, për rastet e përcaktuara shprehimisht, mundësinë e rishikimit të ekstraktit të perberësve zgjedhor, shtimin, ndryshimin ose fshirjen, ndërsa përcaktohen dhe subjekti/subjektet që mund të iniciojnë procedurën e ndryshimit të ekstraktit të perberësve zgjedhor, kryesisht vete shtetasit ose një anetar madhor i familjes së tyre, por, për disa nga rastet, edhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, përveç së dhe organi që mund të bëjë këto ndryshime, pikërisht zyrtarët e gjendjes civile. Në dispozitën pasardhëse të Kodit, nenin 54, përcaktohen rregullat e detyrueshme për t'u ndjekur në procedurën administrative të rishikimit dhe ndryshimit të ekstraktit të perberësve zgjedhorë, përfshirë dhe afatet e cdo veprimi pjesë të saj, sikundër dhe drejta e ankimit gjyqësor të shtetasit ndaj mos zgjidhjes së favorshme apo refuzimit nga zyra e gjendjes civile të kërkesës për ndryshime në ekstraktin e perberësve zgjedhorë.

Nderkohe, neni 56 (pika 1) i Kodit përcakton se, jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve, zyra e gjendjes civile ka detyrimin të hartojë "listën e zgjedhësve për çdo zonë qendrore votimi" (lista finale), duke nxjerrë nga të dhënat elektronike të RKGJC-së të gjithë shtetasit që do të mbushin moshën 18 vjeç deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve dhe që kanë vendbanimin në zonat e qendrës së votimit nën juridiksionin e saj. Lista e hartuar në këto raste miratohet (zyrtarizohet) nga kryetari i njësisë përkatëse të qeverisjes vendore dhe, jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, i dërgohet KZAZ-së në tri formate (në formë të printuar për publikim për cdo zonë qendrore votimi, në formë të printuar për përdorim nga KQV-ja në procesin e votimit për cdo zonë qendrore votimi, në formë të printuar me përmbledhjen e të gjithë zgjedhësve në nivel zone zgjedhore për informim të zgjedhësve), nderkohe që KZAZ-ja, sipas rastit, publikon listën pranë qendrës përkatëse të votimit, në një ambient

me akses të lirë për zgjedhësit, si dhe i dërgon KQV-së kopjen e saj të listës për përdorim gjatë votimit. Ne kete dispozite, përcaktohet se në rast te mos ushtrimit te kompetencave te parashikuara në këtë nen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, detyrimet, sipas këtij neni, përmbushen menjëherë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Dhe, ndersa lista e zgjedhësve eshte hartuar, miratuar dhe publikuar si me lart, ne pikën 5 te nenit 56 te Kodit, përcaktohet se *“Lista e zgjedhësve nuk ndryshon në asnjë rrethanë dhe për asnjë shkak pas afatit të parashikuar në pikën 1. Programi kompjuterik ndërtohet në një mënyrë të tillë që nuk lejon asnjë ndryshim në listën e zgjedhësve, pavarësisht nga ndryshimet në përbërësit e gjendjes civile në RKGJC”.*

Me tej, Kodi Zgjedhor ka parashikuar disa rregulla ne funksion te verifikimit te listes se zgjedhesve, jo vetem nga zgjedhesit, por edhe nga subjektet zgjedhore te regjistruara ne KQZ apo partite politike.

Keshtu, ne nenin 60, Kodi ka percaktuar detyrimin e kryetareve te njësisë së qeverisjes vendore dhe/ose Drejtorise se Përgjithshme te Gjendjes Civile per te vene ne dispozicion, pa pagese, mbi kerkese te tyre (subjekteve zgjedhore apo partive politike), brenda 3 diteve, “listat e zgjedhësve” dhe “ekstraktet e përbërësve zgjedhorë”, ashtu sikundër, per Drejtorine e Përgjithshme te Gjendjes Civile, edhe detyrimin per te vene ne dispozicion te tyre dhe një “kopje elektronike” të “listave të zgjedhësve” ose “ekstraktit të përbërësve zgjedhorë në shkallë vendi”, si dhe sa herë që ato përditësohen dhe publikohen, sipas nenit 51 të Kodit, kopje elektronike keto qe hartohen në mënyrë të tillë që të lejojnë kërkime dhe krahasime të kryqëzuara të të dhënave. Përveç kësaj, listat e zgjedhësve me përmbledhjen e të gjitha listave në shkallë vendi, shpallen edhe në formë elektronike në faqen zyrtare të internetit të KQZ-se dhe Ministrisë që mbulon pushtetin vendor, format elektronik ky qe duhet të mundësojë kërkime të shumëfishta të përbërësve të listës së zgjedhësve nga çdo i interesuar nëpërmjet internetit.

Nderkohe, ne nenin 61 te Kodit Zgjedhor, eshte rregulluar roli mbikqyres i KQZ-se ne procesin e hartimit te listave te zgjedhesve.

Keshtu, ne kuadër te procesit te caktimit të zonave të qendrave të votimit dhe numrit të zgjedhësve për çdo qendër votimi, mbikëqyrjen e procesit te hartimit te listave te zgjedhesve KQZ-ja e realizon permes kërkimit dhe marrjes se informacioneve nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe nga njësitë e qeverisjes vendore.

Po keshtu, sipas kësaj dispozite te Kodit, rolin mbikëqyres te procesit te hartimit te listave te zgjedhesve, KQZ-ja e realizon edhe permes informacioneve te marra nga dy auditet tekniciene, te emeruar prej saj, jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i zgjedhjeve, për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të RKGJC.

Sipas kësaj dispozite te Kodit Zgjedhor, te ndryshuar, “Auditët teknicienë”, qe duhet të kenë arsimim universitar dhe ekspertizë në fushën e teknologjisë së informacionit apo statistikës, si dhe të kenë njohuri për procesin e hartimit të listave të zgjedhësve dhe/ose gjendjes civile, *“kontrollojnë përputhshmërinë e veprimeve të kryera nga zyrat e gjendjes civile dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, me rregullat e përcaktura nga ky Kod, ligji për gjendjen civile dhe aktet e nxjerra në zbatim të tyre nga KQZ-ja dhe ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile”*.

Auditëve teknicienë te KQZ-se, sipas Kodit, iu eshte dhene e drejta per te patur akses në sistemin elektronik dhe bazën e të dhënave të RKGJC-së, për të bërë të mundur leximin dhe krahasimin e përbërësve të gjendjes civile, ndryshimeve të tyre, kohën kur janë kryer këto veprime nga përdoruesit apo administratorët e sistemit, si dhe të raporteve të auditit apo çdo lloj raporti të sistemit elektronik, të cilat gjurmojnë të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur mbi përbërësit zgjedhorë në RKGJC për periudhën që kontrollohet, duke përfshirë dhe metodologjinë si gjenerohet ky raport. Me tej, ky akses i auditëve teknicienë në çdo rast është jo më i vogël sesa akses i Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Gjendjes Civile, nderkohe qe, cdo audit, ka të drejtë të vizitojë Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile sa herë që e gjykon të arsyeshme, por të paktën një herë në muaj, por se ata (auditët teknicienë te KQZ-se) “nuk mund kryejnë dhe as të urdhërojnë veprime në bazën e të dhënave të RKGJC-së”.

Ne vijim, sipas kësaj dispozite të Kodit, *“Auditët teknicienë i paraqesin një raport auditimi çdo muaj KQZ-së për gjetjet e auditimit, sipas detyrave të përcaktuara nga KQZ-ja ose për vërejte apo çështje që lidhen me zbatimin e legjislacionit në lidhje me regjistrin e gjendjes civile”*, ku secili nga auditët teknicienë mund të paraqesë raport individual nëse ka opinion apo koment të ndryshëm nga auditi tjetër.

Nderkohe, sipas kësaj dispozite të Kodit, *“me kërkesën e dy anëtarëve të saj”*, KQZ-ja, *“përcjell gjetjet dhe rekomandimet e auditëve teknicienë për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile brenda 48 orëve, duke i kërkuar njëkohësisht shpjegime në lidhje me to”*, nderkohe që *“Detyra e auditëve teknicienë, në lidhje me mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve, përmbushet me raportin përfundimtar për listën e zgjedhësve të hartuar sipas nenit 56 të këtij Kodi”*.

Duke ardhur në rastin konkret, rezultoi se me Vendimin Nr.25, datë 18.02.2015, bazuar në nenin 61/2 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja ka emëruar dy audite tekniciene për mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015, z.Armand Teliti (propozuar nga Kryetarja e KQZ-së) dhe z.Ened Kërçini (propozuar nga Zevendeskrjetari i KQZ-së).

Pranohet se zyrat e gjendjeve civile të Bashkisë Durrës (zyrat e gjendjes civile të 5 rajoneve) dhe Zyra e Gjendjes Civile e Bashkisë Kavaje kanë hartuar, printuar dhe publikuar ekstraktin e perberesve zgjedhore të të gjithë shtetasve që kanë vendbanim në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e tyre, ndërsa ministria që mbulon shërbimin e gjendjes civile dhe KQZ-ja kanë publikuar në faqet përkatëse zyrtare të internetit ekstraktin e zgjedhësve në shkallë vendi, publikime këto që janë përsëritur në mënyrë periodike çdo 30 ditë deri në shpalljen e listës së zgjedhësve, duke u pasqyruar në këto publikime çdo ndryshim i përbërësve zgjedhorë të RKGJC-së që është bërë nga publikimi paraardhës deri në momentin e publikimit të ri.

Me tej, pranohet se zyrat e gjendjeve civile të Bashkisë Durrës (zyrat e gjendjes civile të 5 rajoneve) dhe Zyra e Gjendjes Civile e Bashkisë Kavaje, në një datë të papërcaktuar në këto gjykime, por brenda afatit të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor (neni 56/1), kanë

hartuar listën e zgjedhësve për çdo zonë qendre votimi, duke nxjerrë nga të dhënat elektronike të RKGJC-së të gjithë shtetasit që do të mbushin moshën 18 vjeç deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve dhe që kanë vendbanimin në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e tyre, lista te zgjedhesve keto qe, pas miratimit te tyre, iu jane derguar komisioneve perkatese te zonave te administrimit zgjedhor, sikunder keto lista u jane derguar dhe komisioneve perkatese te qendrave te votimit per përdorim gjate votimit.

Nderkohe, ndersa vijonte procesi i pergatitjes se listave te zgjedhesve per cdo zone qendre votimi ne territorin e Bashkise Durrës, del se, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor (neni 61), si dhe Udhëzimi i KQZ-së Nr.2, datë 28.12.2012, “Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknikien për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të RKGJC dhe në sistemin elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV)”, auditit teknikien i KQZ-se z.Armand Teliti, me date 04.05.2015, i ka paraqitur KQZ-se një Raport “Mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të RKGJC për Bashkinë Durrës”.

Po keshtu, ndersa vijonte procesi i pergatitjes se listave te zgjedhesve per cdo zone qendre votimi ne territorin e Bashkise Kavaje, del se auditit teknikien i KQZ-se z.Armand Teliti, ne nje date te papërcaktuar ne kete gjykim, ka përgatitur edhe një Raport “Mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të RKGJC për Bashkinë Kavaje”, raport ky qe ne nje date te papërcaktuar ne kete gjykim (gjithsesi mbas dates se paraqitjes se nje kallezimi penal nga kandidati per kryetar te Bashkise Kavaje, z.Engjell Cara), i eshte derguar Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Kavaje.

Rezulton qe Raporti i auditit teknikien “Mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të RKGJC për Bashkinë Durrës” del te jete shqyrtuar nga KQZ-ja ne Mbledhjen e dates 04.05.2015, ku ne perfundim te saj, mbështetur në nenet 21/1 dhe 61/8 të Kodit Zgjedhor, me Vendimin Nr.195, KQZ-ja ka vendosur :

“Përcjelljen Prokurorisë së Përgjithshme, të raportit të auditit teknikien, z.Armand Teliti “Mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të regjistrimit kombëtar të gjendjes civile

për Bashkinë Durrës”, si organi kompetent për vlerësimin e këtyre rekomandimeve, si dhe për hetimin e mëtejshëm të kësaj çështje”.

Referuar arsytimit të këtij vendimi të KQZ-se (Vendimit Nr.195, date 04.05.2015), rezulton se auditi teknik i KQZ-se, z.Armand Teliti, nga kontrolli dhe krahasimi i ekstrakteve të listave të zgjedhësve të Bashkisë së Durrësit, ka konstatuar një situatë jashtëzakonisht shqetësuese dhe konkretisht një rritje jo natyrale të numrit të zgjedhësve duke filluar nga Marsi 2015 dhe duke u rritur akoma më shumë në Prill 2015, veçanërisht në periudhën 12 - 27 prill 2015 (gjatë periudhës para dates së daljes së dekretit të Presidentit për caktimin e dates së zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore (Qershor 2013 - Dhjetor 2014), mesatarja mujore e hyrjeve të votuesve ka qene 183, ndersa në periudhën Janar -Shkurt 2015 ka patur 260 votues të shtuar, Shkurt - Mars 2015 ka patur 256 votues të shtuar, Mars - Prillit 2015 ka patur një shtesë prej 774 votuesish, kurse vetem për periudhën 12 prill - 27 prill 2015 ka patur nje rritje me 1.412 votues, ku në më pak se dy muaj numri i zgjedhësve të ardhur në Durrës ka qene 2.186, shifër kjo rreth 7 herë më e madhe se mesatarja mujore e hyrjeve në Bashkinë e Durrësit).

Me tej, sipas arsytimit të vendimit të KQZ-se, nga auditi teknik është referuar se ka kryer verifikimin e dokumentacionit shoqëruar në praktikat e ndryshimit të vendbanimit të zgjedhësve të ardhur në 4 muajt e fundit për 3 rajone të Bashkisë Durrës (ka verifikuar 113 praktika për secilin nga rajonet 1, 4 dhe 5) në funksion të kontrollit të përputhshmërisë së veprimeve të kryera nga zyrtarët e gjendjes civile, duke konstatuar përdorimin në këtë proces të kontratave qiraje të dyshimta të privatëve mes njëri-tjetrit në një periudhë shumë të ngjeshur, në ditë të përqëndruara, me të njëjtin noter apo me vetëm 2 kompani ndërtimi për kontratat e sipërmarrjes dhe, veçanërisht, përdorimin e aseteve në pronësi të Bashkisë së Durrësit dhe përfshirjen e ndërmarrjes së kësaj Bashkie në këtë operacion, ndersa njëri nga kandidatët në garë është kryetari aktual i Bashkisë Durrës, c’ka, sipas auditit teknik, shtonte dyshimet, duke i bere ato edhe më të arsyeshme, se ndodhemi përpara një krimi elektoral me synim ndryshimin e rezultatit të zgjedhjeve në Bashkinë Durrës.

Gjithashtu, sipas arsytimit te vendimit te KQZ-se, nga auditi teknikien i eshte rekomanduar KQZ-se qe, në zbatim të nenit 21/20 të Kodit Zgjedhor, të bënte kallëzim penal për përgjegjësit e këtij procesi, duke kërkuar si masë preventive nga prokuroria bllokimin e rekordeve të dyshuara në RKGJC dhe moslejimin e shfaqjes së tyre në listën përfundimtare të zgjedhësve.

Pas debatit rreth raportit si me lart te auditit teknikien, referuar arsytimit te vendimit te KQZ-se, kjo e fundit ka konstatuar se pretendimet/supozimet e ngritura në raport kërkonin një hetim të specializuar nga organi kompetent, organi i prokurorisë, qe kishte aftësinë, kapacitetet dhe kompetencën, për të vlerësuar nëse këto pretendime janë vepra penale dhe personat përgjegjës për kryerjen e tyre. Nga ana tjetër, KQZ ka konstatuar se vete ajo ishte ne pamundësi për të vlerësuar në lidhje me sa pretendohet, pra nëse kishte elemente të një vepre penale dhe, nëse do të konstatoheshin si të tilla, cilët ishin personat përgjegjës për këto vepra.

Mbi kete baze, KQZ-ja ka vlerësuar qe raportin e auditit teknikien t'ia dërgojë organit të prokurorisë, si organi kompetent për vlerësimin e rekomandimeve konkrete te auditit, si dhe për hetimin e mëtejshëm të kësaj çështjeje me dyshime të arsyeshme të paraqitura nga auditi teknikien.

Nderkohe, ndersa procesi i përgatitjes se listave te zgjedhesve per cdo zone qendre votimi ne territorin e Bashkise Durres dhe te Bashkise Kavaje kishte perfunduar dhe nga ana e saj, KQZ-ja, kishte percjell raportet e auditit teknikien Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Durres dhe Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Kavaje, me Shkresen Nr.5815 prot., date 11.06.2015, KQZ-ja ka kerkuar nga keto dy organe informacion rreth veporimtarise se realizuar nga ato mbi raportet e auditit teknikien percjellur atyre.

Me Shkresen Nr.8699/1 prot., date 16.06.2015, Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres ka informuar KQZ-ne se, me date 22.05.2015, mbi kallezimin e Partise Demokratike dhe materialin kallëzues te auditit teknikien te KQZ-se, ka filluar nje procedim penal per veprat penale te falsifikimit te dokumenteve nga personi qe ka per detyre ne bashkëpunim, falsifikimit kompjuterik

dhe shpërdorimit të detyres, parashikuar nga nenet 186/2/3, 186/a dhe 248 të Kodit Penal, ku në funksion të këtij hetimi, mbi kërkesën e prokurorit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me Vendimin Nr.337, datë 09.06.2015, kishte vendosur sekuestrimin e të dhënave kompjuterike në lidhje me perberësit e gjendjes civile që i përkasin shtetasve bashkëlidhur vendimit, pjesë integrale e vendimit, duke urdhëruar ndalimin e kryerjes së veprimeve të mëtejshme në këto të dhëna nga zyra e gjendjes civile. Me tej, sipas kësaj shkrese, ky vendim gjyqësor i ishte percjelle për ekzekutim Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, të ciles KQZ-ja mund t'i drejtohej për informacion me të detajuar në lidhje me listen dhe ekzekutimin e vendimit të gjykates.

Ndërsa, me Shkresën Nr.2064 prot., datë 15.06.2015, Prokuroria pranë Gjykates së Rrethit Gjyqësor Kavaje ka informuar KQZ-në se, mbi kallezimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Kavaje, z.Engjell Cara, për zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, ka filluar një procedim penal për veprat penale të falsifikimit të dokumenteve, falsifikimit të akteve të gjendjes civile dhe shpërdorimit të detyres, parashikuar nga nenet 186, 191 dhe 248 të Kodit Penal, ndërsa kallëzohej në lidhje me transferimin e gjendjes civile të 250 familjeve nga njësi vendore të tjera, në qytetin e Kavajës për periudhën parazgjedhore 20.04.2015 - 30.04.2015. Sipas kësaj shkrese, organi i prokurorisë, në funksion të hetimit të këtij procedimi penal, kishte këqyruar dhe marrë praktikën dokumentare pranë Zyres së Gjendjes Civile të Bashkisë Kavaje, ndërsa kishte regjistruar dhe emrin e personit që i atribuohet vepra penale e shpërdorimit të detyres për një shtetase punonjëse e kësaj zyre. Me tej, sipas kësaj shkrese, për këtë çështje ishte paraqitur dhe një material kallëzues nga auditi teknik i KQZ-së, z.Armand Teliti, që bente fjale për dyshime për një numër të konsiderueshëm regjistrimesh në Zyrën e Gjendjes Civile të Bashkisë Kavaje për një periudhë tjetër kohore, rreth një vit e gjysmë përpara.

Me heret, me një kerkese të datës 11.06.2015, pala paditese PD ka marrë të njëjtin informacion si më lart nga Prokuroria pranë Gjykates së Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas Shkresës Nr.276/1 prot., datë 12.06.2015.

Ne kete situate, rezulton se, me date 16.06.2015, subjekti zgjedhor PD i ka drejtuar KQZ-se nje kerkese me shkrim, protokolluar me nr.6133, date 16.06.2015.

Me kete kerkese, referuar dhe veprimeve hetimore te Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres dhe Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kavaje, ndersa sipas vlerësimit te saj ekzistojne jo vetem dyshime te bazuara ne prova per manipulim te listave te zgjedhesve ne keto zona zgjedhore, por tashme keto dyshime ishin hetuar dhe konfirmuar edhe nga prokuroria, por edhe gjykata (Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres) nepermjet urdhrit te sekuestros, duke konsideruar se KQZ-ja, bazuar ne nenin 21/26 te Kodit Zgjedhor, kishte autoritetin dhe pergjegjesine per te marre masa per zgjidhjen e situatave "sui generis", si dhe se momenti kohor ishte ende i pershtatshem per marrjen e masave per te parandaluar prodhimin e efekteve te paligjshme te nje krimi elektoral, subjekti zgjedhor PD i ka kërkuar KQZ-se:

“Te marre te gjithë masat e nevojshme, duke urdhëruar Drejtorine e Gjendjes Civile, te prodhoje dhe shperndaje ne KZAZ-te perkatese, lista zgjedhore ne te cilat te mos figurojne te dhenat e shtetasve, rekordet e te cileve Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kavaje i ka sekuestruar”.

Kjo kerkese e subjektit zgjedhor PD eshte perfshire ne diskutimet jashte rendit te dites, ne Mbledhjen e KQZ-se te dates 16.06.2015, ku ne kete rast, KQZ-ja, ka vendosur qe ne mbledhjen e dites se nesërme te therrase Drejtorin e Pergjithshem te Gjendjes Civile, per te informuar KQZ-ne ne lidhje me Shkresen Nr.8699/1 prot., date 16.06.2015, te Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres.

Ne vijim, ne Mbledhjen e dates 17.06.2015, KQZ-ja ka perfshire si ceshtje ne rendin e dites marrjen e informacionit nga Drejtori i Pergjithshem i Gjendjes Civile persa i perket marrjes dhe ekzekutimit nga ky institucion te Vendimit Nr.337, date 09.06.2015, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres. Ne mbledhjen e kësaj date eshte paraqitur Drejtori i Pergjithshem i Gjendjes Civile, i cili ka informuar KQZ-ne ne lidhje me marrjen dhe ekzekutimit nga ky institucion te

Vendimit Nr.337, date 09.06.2015, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres, sikundër ka informuar edhe per ceshtje teknike referuar pyetjeve nga anetaret e KQZ-se apo perfaqesuesit e subjekteve zgjedhore te pranishem ne kete mbledhje. Po keshtu, ne kete mbledhje, pas perfundimit te seances degjimore me Drejtorin e Pergjithshem te Gjendjes Civile, ne kuadër te kësaj pike te rendit te dites, perfaqesuesi i subjektit zgjedhor PD ka kërkuar shqyrtimin e kerkeses se paraqitur nga ky subjekt zgjedhor me date 16.06.2015, ku anetaret e KQZ-se kane shfaqur mendime te ndryshme rreth pranueshmerise ose jo per shqyrtim te kerkeses, juridiksionit dhe kompetences se KQZ-se per trajtimin e saj, bazen ligjore etj. Ne përfundim te shqyrtimit te kësaj pike te rendit te dites, ndersa perseri perfaqesuesi i subjektit zgjedhor PD ka kërkuar dhënien e nje vendimi per kerkesen e paraqitur me date 16.06.2015, KQZ-ja nuk ka dale me ndonje vendim.

Pas kësaj, me date 19.06.2015, subjekti zgjedhor PD ka paraqitur përpara Kolegjit Zgjedhor nje kerkesepadi, me te cilen, duke paditur KQZ-ne, ndersa ka kundërshtuar mosmarrjen e nje vendimi nga KQZ-ja ne lidhje me Kerkesen Nr.6133 prot., date 16.06.2015, ka kërkuar detyrimin e KQZ-se te marre vendim ne lidhje me kete kerkesë.

Ne ate rast, pala paditese ka pretenduar se KQZ-ja, ne kundërshtim me ligjin dhe kompetencat qe ai i jep ne lidhje me zgjidhjen e ankesave te subjekteve zgjedhore, si organi me i larte i administrimit zgjedhor, pavarësisht se eshte vene ne dijeni shkreserisht nga nje subjekt zgjedhor per nje problematike te rendesishme zgjedhore, sic jane listat e zgjedhesve, problematike e cila kërkonte shqyrtimin dhe vendimmarrjen e saj, pavarësisht se zhvilloi te gjithë debatin lidhur me kete ceshtje, si dhe administroi te gjithë materialet ne funksion te saj, nuk u shpreh me vendim per kerkesen e paraqitur.

Nga ana tjetër, pala e paditur KQZ ka prapësuar, duke pretenduar se kërkesa e paraqitur nga subjekti zgjedhor padites eshte trajtuar, ku ne baze te nenit 50/3 te Kodit Zgjedhor, te ndryshuar, KQZ-ja kishte kërkuar dhe marre informacion te detajuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile, nderkohe qe me heret, per shkeljet e konstatuara nga auditi teknikien, KQZ-ja ia ka referuar ato organit te prokurorise.

Nderkohe, Kolegji Zgjedhor, ne përfundim te shqyrtimit te këtij rasti, ka vlerësuar se KQZ-ja, ne realizim te rregullt te veprimtarise se saj, duhet te ishte shprehur me vendim per kerkesen e subjektit zgjedhor PD paraqitur asaj me date 16.06.2015, duke patur ne konsiderate per kete se ligji, Kodi Zgjedhor, ka percaktuar shprehimisht menyren se si KQZ-ja, si organi me i larte shtetëror i perhershëm, i ngarkuar per administrimin e zgjedhjeve, manifeston vullnetin e tij. Keshtu, ne baze te nenit 23/1 te Kodit Zgjedhor, te ndryshuar, ne kuadër te veprimtarise se saj, vullneti i KQZ-se manifestohet duke disponuar me vendim per ceshtje te veçanta apo udhëzim per ceshtje te përgjithshme. Me tej, neni 24 i Kodit Zgjedhor, te ndryshuar, rregullon edhe menyren e formësimit te vullnetit te KQZ-se, ashtu sikundër dhe formen e vendimit te saj. Po keshtu, Kolegji Zgjedhor ka vlerësuar se ne cdo rast qe nje subjekt zgjedhor paraqet nje kerkesë konkrete qe adresohet per procesin zgjedhor dhe nepermjet te ciles synohet nje vendimmarrje e caktuar, KQZ-ja, ne përputhje me kompetencat dhe detyrat e ngarkuara nga Kodi Zgjedhor, si dhe rregullimet e veçanta te tij, ka detyrimin ta marre ne shqyrtim dhe te shprehet me nje vendim konkret per nje kerkesë te tille.

Mbi nje vlerësim te tille, duke patur parasysh ceshtjen objekt kerkesë, si dhe momentin qe procesi parazgjedhor ndodhej, dy dite përpara dates se zgjedhjeve, Kolegji Zgjedhor, me Vendimin Nr.21, date 19.06.2015, ka vendosur:

“Pranimin e padise.

Detyrimin e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve te shprehet me vendim brenda dites se nesërme, date 20 qershor 2015, ne lidhje me kerkesen nr.6133 prot., date 16.06.2015, te Partise Demokratike te Shqiperise”.

Ne respektim te vendimit si me lart te Kolegjit Zgjedhor, ne Mbledhjen e dates 20.06.2015, KQZ-ja ka shqyrtuar kerkesen nr.6133 prot., date 16.06.2015, te Partise Demokratike te Shqiperise dhe ne përfundim, me Vendimin Nr.710, date 20.06.2015, ka vendosur :

“Rrëzimin e kërkesës nr.6133 prot., datë 16.06.2015 të Partisë Demokratike të Shqipërisë në lidhje mbi procedimin penal

nr.916 datë 22.05.2015 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe vendimin nr.337 datë 09.06.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, dhe veprimet e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Ne vendimin e saj si me lart, KQZ-ja ka konkluduar se kërkesa e Partisë Demokratike është e pambështur ne ligj dhe duhet të rrëzohet, duke arsyetuar se:

KQZ, në zbatim të nenit 50 të Kodit Zgjedhor, ka mbikqyrur rregullisht procesin e hartimit të listave të zgjedhësve nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

me procedurat e ndjekura ne rastin konkret, KQZ ka zbatuar në mënyrë ligjore të gjitha kompetencat e caktuar nga Kodi Zgjedhor në lidhje me mbikqyrjen e hartimit të listave të zgjedhësve, ne rrethanat kur:

referuar nenit 61 te Kodit Zgjedhor, qe ben fjale per mbikëqyrjen nga KQZ-ja te procesit te hartimit të listave nëpërmjet auditëve teknikien, ne baze te rekomandimit te auditit teknikien bere ne Raportin e dates 4 maj 2015, KQZ-ja, me vendimin nr.195, datë 04.05.2015, në zbatim të nenit 21/20 të Kodit Zgjedhor, bëri kallëzim penal për përgjegjësit e këtij procesi duke kërkuar si masë preventive nga Prokuroria bllokimin e rekordeve të dyshuara në RKGJC dhe moslejimin e shfaqjes së tyre në listën përfundimtare të zgjedhësve;

referuar shkresës nr.8699/1 prot., të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me te cilen jepet informacion per fillimin e procedimi penal nr.916, datë 22.05.2015, për veprat penale “falsifikim i dokumentave”, “shpërdorim i detyrës” dhe “falsifikim kompjuterik”, si dhe se, në funksion të hetimit, me vendimin nr.337, datë 09.06.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është vendosur “Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike në lidhje me përbërësit e gjendjes civile që i përkasin shtetasve sipas listës bashkëlidhur vendimit, pjesë integrale tij, duke urdhëruar ndalimin e kryerjes së veprimeve të mëtejshme në këto të dhëna nga Zyra e Gjendjes Civile”, për të dhenë sqarime ne lidhje me kete vendim, u thirr në

mbledhjen publike të KQZ-së, të datës 17 qershor 2015, Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, ku sipas deklarimeve të tij, kjo Drejtori ka ekzekutuar menjëherë kete vendim te organeve kompetente të drejtësisë, gjykatës dhe prokurorisë;

përsa kërkohet në shkresën e Partisë Demokratike Nr.6133, “Mbi procedimin penal nr.916, datë 22.05.2015 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe vendimin nr.337, datë 09.06.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe veprimet e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë”, KQZ vlerëson se:

organet kompetente janë duke shqyrtuar të gjitha pretendimet e paraqitura në kete kërkesë te Partisë Demokratike dhe kanë marrë masat e duhura sipas ligjeve në fuqi;

KQZ nuk mund të marr kompetencat të cilat me ligj i kanë organe të tjera apo të dale dhe mbi to;

nuk ka asnjë dispozitë në Kodin Zgjedhor apo në ligje të tjera që t'i caktojnë KQZ-se kompetencën të urdhëroje Drejtorine e Pergjithshme te Gjendjes Civile të bëjë ndryshime duke përjashtuar nga listat e zgjedhësve, zgjedhës të caktuar, nderkohe qe një shtetasi shqiptar, i cili ka mbushur moshën 18 vjec, mund t'i hiqet e drejta e votimit vetëm me vendim gjykate.

Kunder këtij vendimi te KQZ-se (Vendimit Nr.710, date 20.06.2015), po me date 20.06.2015, ora 16.30, subjekti zgjedhor PD ka paraqitur përpara Kolegjit Zgjedhor nje kerkesepadi, me te cilen, duke paditur KQZ-ne, ndersa ka kundërshtuar kete vendim duke kërkuar shfuqizimin e tij, ka kërkuar edhe gjykimin e ceshtjes ne themel duke vendosur pranimin e Kerkeses Nr.6133 prot., date 16.06.2015, te Partise Demokratike.

Nisur nga problematika e ceshtjes dhe ate cfare kërkohet nepermjet padise se paraqitur, qe lidhet me listat e zgjedhesve per zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 qershor, Kolegji Zgjedhor, mbasi u njoh menjehere me kerkesepadine e paraqitur, bazuar ne nenin 154 te Kodit Zgjedhor, realizoi brenda nje kohe te shkurter hedhjen e ceshtjes ne short per perberjen e trupit gjykues,

duke njoftuar paraprakisht dhe ftuar palet per te marre pjese ne kete procedure. Me tej, trupi gjykues i ngarkuar per gjykimin e ceshtjes, per te garantuar te drejten e pales paditese per te patur nje ankim efektiv, vendosi që gjykimi i saj te zhvillohej po kete dite, pak ore me vone (ne oren 20.30), nje kohe e arsyeshme kjo ne raport me rrethanat e rastiit per te përgatitur palet mbrojtjen e tyre, nderkohe qe ato jane njoftuar menjehere per kete.

Ne kete gjykim, përpara fillimit te shqyrtimit gjyqësor, mbi kerkesen e paraqitur, Kolegji Zgjedhor lejoi pjesëmarrje si person te interesuar te subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqiperise (me poshte referuar si PS).

Ne kerkesepadi, si dhe gjate gjykimit te ceshtjes, pala paditese PD pretendoi se :

ne vijim te shqetësimeve te auditit teknikien te KQZ-se, nga hetimi me i thelluar i organit te prokurorise, jane konstatuar nje sere shkeljesh te natyrave te ndryshme ne lidhje me përfshirjen ne kundërshtim me ligjin ne listat e zgjedhesve te nje numri te konsiderueshem zgjedhësish ne njesite zgjedhore Bashkia Durres dhe Bashkia Kavaje, shkelje keto te vlerësuar si te tilla nga gjykatat, ndersa ishin te shumëfishta, te renda dhe flagrante dhe kane te bejne me : transferimin e nje numri te madh shtetasish nga njesia e tyre tek nje njesi tjeter vendore, transferime keto qe : per nje pjese jane bere pa dijeni te shtetasve perkates, kur nje pjese e tyre nuk kane qene fare ne territorin e Shqiperise, ndersa per nje pjese tjeter eshte falsifikuar nënshkrimi i tyre; per nje pjese tjeter jane bere pa patur keta shtetas banese, kur si te tilla per nje pjese te tyre jane konsideruar ambiente te braktisura prej vitesh dhe te papershtatshme per banim, per nje pjese tjeter banesa ne pallate te pa ndertuar akoma; per nje pjese tjeter jane bere duke konsideruar si banese te shtetasve ambiente qe nuk kane qene ne pronesi te institucioneve qe kane lidhur kontratat; per nje pjese tjeter jane bere përpara se shtetasit perkates te paraqisnin kerkese, etj;

referuar gjetjeve te organit te prokurorise, ndersa ka autoritetin, por edhe pergjegjesine, qe si autoriteti me i larte shtetëror, i perhershëm, i ngarkuar me administrimin e procesit zgjedhor,

autoritet i cili ne baze edhe te parashikimit te nenit 21/26 te Kodit Zgjedhor, e lejonte te kryente edhe detyra te tjera, pra edhe marrjen e masave per zgjidhjen e situatave "sui generies" dhe vecanerisht te zgjidhe shqetesimet qe i adresohen nga subjektet zgjedhore, pervec se kur asaj, nepermjet nenit 50/3 te ketij Kodi, i jepet nje kompetence e gjere, ndersa ngarkohet me pergjegjesine e mbikqyrjes se procesit te pergatitjes se listave te zgjedhesve, KQZ-ja, mbi kerkese e paraqitur nga PD me date 16.06.2015, duhet te merrte te gjitha masat e nevojshme, duke urdhëruar Drejtorine e Gjendjes Civile, te prodhonte dhe shpërndante ne KZAZ-te perkatese, lista zgjedhore ne te cilat te mos figuronin te dhenat e shtetasve, rekordet e te cileve Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kavaje i ka sekuestruar;

KQZ-ja refuzoi kerkesen e PD megjithëse krijoi bindjen se ne zonat zgjedhore Bashkia Durres dhe Bashkia Kavaje po konsumohej nje krim i paralajmëruar elektoral, si dhe pavarësisht se ajo kishte te gjitha instrumentet ligjore dhe mundesine per te nderhyre per te patur ne keto zona zgjedhore lista zgjedhësish te hartuara ne menyre te ligjshme, c'ka perben nje prerogative per nje proces zgjedhor te besueshem, transparent, por mbi te gjitha nje proces ligjor, ku mosveprimi ne kete rast i KQZ ne lidhje me ligjshmerine e listave te zgjedhesve ne keto zona zgjedhore sjell pasoja te renda per te gjithë procesin zgjedhor.

Perkunder pretendimeve te pales paditese, pala e paditur KQZ prapësoi, duke konsideruar padine te pabazuar ne ligj dhe mbajtur te njëjtin qëndrim si dhe ne vendimin e saj objekt ankimi.

Po keshtu, edhe personi i interesuar PS konsideroi padine te pabazuar ne ligj, duke parashtruar se ishte e pavend shqyrtimi nje dite përpara dites se zgjedhjeve kërkesa te natyres si ajo e kerkeses se pales paditese PD, per fshirjen nga listat e zgjedhesve te gati 1.000 zgjedhesve te pidentifikuar nga pala paditese, pervec se nje kerkese e tille nuk mbështetej ne ndonje referim ligjor, përkundrazi, ligji, neni 56/5 i Kodit Zgjedhor, ndalonte cdo ndryshim te listes se zgjedhesve, per cdo lloj rrethane apo shkaku, pas afatit 40-ditor para dates se zgjedhjeve, percaktuar ne piken 1 te kësaj dispozite, nderkohe qe ne rastin konkret ishim vetem disa ore përpara dites

se votimit. Sipas personit te interesuar, ndërhyrja qe kërkohet nga pala paditese ne listat e zgjedhesve do te passillte nje pasiguri te madhe per realizimin e procesit zgjedhor. Po keshtu, sipas personit te interesuar, urdhërimi per te nderhyre ne listat e zgjedhesve nuk eshte nje ceshtje qe i përket kompetences se KQZ-se, ashtu sikundër dhe Kolegjit Zgjedhor.

Mbi sa me lart u parashtrua, referuar ceshtjeve objekt debati mes paleve, Kolegji Zgjedhor vlerëson se referuar Kodit Zgjedhor :

1. Lista e zgjedhesve nxirret nga Regjistri Kombetar i Gjendjes Civile, regjistër ky qe, sipas ligjit per gjendjen civile (Ligji Nr.10129, date 11.05.2009, i ndryshuar), eshte dokumenti i vetem shtetëror (dokument unik) ku pasqyrohen perberesit e gjendjes civile per cdo shtetas me banim ne Republikën e Shqipërisë, ndersa ai, ne përputhje me kete ligj, administrohet dhe perditesohet nga organet e shërbimit te gjendjes civile, respektivisht nga Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile dhe nga zyrat e gjendjes civile ne njesite e qeverisjes vendore.

2. Lista e zgjedhesve (perfshire dhe ekstraktet e perberesve zgjedhore) hartohet per cdo zone qendre votimi dhe hartimi i tyre eshte kompetence e organeve te shërbimit te gjendjes civile, pikërisht zyres se gjendjes civile të njesise se qeverisjes vendore ne territorin e te ciles ndodhet zona e qendres se votimit.

3. Lista e zgjedhesve per cdo zone qendre votimi shpallet zyrtarisht, jo me vone se 40 dite para dates se zgjedhjeve, ku per vete karakterin zyrtar te veprimit, shpallja është një akt institucional ne kompetence te institucionit te qeverisjes vendore (kryetarit) qe ka ne juridiksion zyren perkatese te gjendjes civile, ku ne rast mosveprimit ne afat, kjo kompetence ushtrohet nga Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile, ndërkohë qe publiciteti i saj realizohet permes afishimit dhe nëpërmjet mjeteve të komunikimit.

4. Lista zyrtare e zgjedhesve (sikundër dhe ekstraktet e perberesve zgjedhor) mund te jete objekt rishikimi, por ajo (lista zyrtare e zgjedhesve) nuk mund te ndryshohet per asnjë rrethane dhe per asnjë shkak ne periudhen 40 dite para dates se zgjedhjeve.

5. Ndersa ka kompetencen e përgjithshme te drejtimit dhe kontrollit te procesit parazgjedhor dhe atij zgjedhor, si organi me i larte shtetëror i perhershëm, i ngarkuar per administrimin e zgjedhjeve ne përputhje me rregullat e përcaktuara ne Kodin Zgjedhor, KQZ-ja, ne procesin e përgatitjes se listave te zgjedhesve (pjesë e procesit parazgjedhor, por edhe i procesit zgjedhor ne teresi) ka dhe kompetencen e veçante te mbikëqyrjes se këtij procesi, por, gjithësesi, ne kete proces, KQZ-ja nuk vepron si organ epror i organeve te ngarkuara nga ligji per përgatitjen e listave te zgjedhesve (organet e shërbimit te gjendjes civile dhe organet e qeverisjes vendore), pavarësisht se ato kane detyrimin ligjor te bashkepunojne me KQZ-ne, te informojne dhe t'i japin shpjegime asaj.

6. Ne procesin e përgatitjes se listave te zgjedhesve KQZ-ja ka:

kompetenca te karakterit mbikqyres, qe konsistojnë:

ne vëzhgimin e veprimeve te organeve te administrates publike (te shërbimit te gjendjes civile dhe te njesive te qeverisjes vendore) ne lidhje me përmbushjen nga ato te detyrave sipas kompetences se tyre dhe ne afatin e percaktuar nga ligji (Kodi Zgjedhor), gje te cilen e realizon nepermjet marrjes se informacionit apo shpjegimeve nga ana e tyre;

ne kontrollin e përputhshmërisë se veprimeve të kryera nga zyrat e gjendjes civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me rregullat e përcaktuara nga Kodi Zgjedhor, ligji për gjendjen civile dhe aktet e nxjerra në zbatim të tyre, gje te cilen e realizon nepermjet verifikimeve te veprimeve ne bazen e te dhenave te Regjistrit Kombetar te Gjendjes Civile nga auditet e saj teknikien;

kompetenca te karakterit informues dhe sensibilizues, qe konsistojnë:

ne përcjelljen, me kerkese te dy anetareve, brenda 48 orëve, te gjetjeve dhe rekomandimeve te auditëve teknikienë për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile;

kompetenca te karakterit ndeshkimor/denimi administrativ, qe konsistojne:

ne vendosjen e sanksioneve administrative me gjobe ndaj zyrtarëve të organeve të qeverisjes vendore ose qendrore qe refuzojne te bashkepunojne me KQZ-ne;

ne vendosjen e sanksioneve administrative me gjobe ndaj personave të ngarkuar me detyra nga Kodi Zgjedhor, te cilet shkelin dispozitat e këtij Kodi, kur keto shkelje nuk perbejne veper penale;

kompetence per te bere kallëzim penal per vepra penale qe lidhen me zgjedhjet.

Mbi konsideratat si me lart, referuar dhe fakteve ne lidhje me kete ceshtje ne shqyrtim, Kolegji Zgjedhor vlerëson se padia e paraqitur ne rastin konkret duhet te rrezohet, duke vlerësuar te drejte dhe ne perputhje me ligjin vendimin objekt gjykimi te KQZ-se per rrezimin e kerkeses se pales paditese te dates 16. qershor 2015.

Lidhur me kete, Kolegji Zgjedhor cmon se:

Kërkesa formale e subjekti zgjedhor PD, pra ajo cfare konkretisht i eshte kërkuar KQZ-se me kerkesen e dates 16 qershor 2015, rezulton te jete ne kapërcim te kompetencave te saj. KQZ-ja nuk mund te detyroje Drejtorine e Pergjithshme te Gjendjes Civile, organ ky i ngarkuar nga ligji per përgatitjen e listes se zgjedhesve, per te bere veprime te percaktuara konkretisht ne bazen e te dhenave te RKGJC dhe, me tej, per te prodhuar dhe shperndare lista te zgjedhesve me nje përmbajtje te caktuar (ku te mos figurojne te dhenat e shtetasve, rekordet e te cileve Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kavaje i ka sekuestruar). Ne procesin e përgatitjes se listave te zgjedhesve, KQZ-ja nuk ka kompetenca vendimmarrëse, pra te vendose per nje përmbajtje te caktuar te listave te zgjedhesve. Ajo, KQZ-ja, ndersa mund t'iu percjelle gjetjet dhe rekomandimet e auditeve te saj teknikien, nuk mund te urdheroje Drejtorine e Pergjithshme te Gjendjes Civile te beje veprime konkrete ne bazen e te dhenave te RKGJC. Ne nje rast hipotetik, gjetjet e auditeve teknikien te KQZ-se mund te sherbejne

si baze per organin e shërbimit te gjendjes civile per te verifikuar ligjshmerine, ne raport me ligjin per gjendjen civile, te regjistrimit/ eve ne RKGJC te perberesve te gjendjes civile te shtetasve konkret dhe per te marre masa, po ne përputhje me ligjin per gjendjen civile, per rivendosjen e nje situate te ligjshme, gje e cila, nga ana tjetër, implikon me tej veprimin ne ekstraktet e perberesve zgjedhor apo ne listen zyrtare te zgjedhesve. Gjithesesi, ne rastin konkret, nuk jemi para nje rasti te tille, pra para gjetjeve te auditeve teknicien te KQZ-se, ndersa pala paditese, subjekti zgjedhor PD, ne kerkesen e saj, ne menyre te përgjithshme, i referohet gjetjeve, ne nje proces tjetër ligjor, te organit publik te ngarkuar me ushtrimin e ndjekjes penale.

Ne aspektin substancial, ajo c'ka ne thelb subjekti zgjedhor PD ka synuar nepermjet kerkeses drejtuar KQZ-se me date 16 qershor 2015, pra rishikimi i listes se zgjedhesve te atyre zonave zgjedhore, nuk mund te pranohet.

Referuar momentit kohor aktual, por dhe atij te paraqitjes se kerkeses nga pala paditese, rishikimi i listave te zgjedhesve vjen ne kundërshtim me ligjin, nenin 56/5 te Kodit Zgjedhor, qe ndalon ndryshimin e listes zyrtare te zgjedhesve per cdo lloj rrethane dhe shkaku përtej nje afati te percaktuar shprehimisht. Kodi Zgjedhor lejon rishikimin e ekstrakteve te perberesve zgjedhore, ashtu sikundër edhe te listes zyrtare te zgjedhesve, por, per nje stabilitet dhe siguri te procesit zgjedhor, Kodi ka percaktuar nje afat limit përtej te cilit ky rishikim nuk mund te ndodhe per asnjë rrethane dhe per asnjë shkak. Ky afat limit i percaktuar nga Kodi perfshin periudhen 40 ditore para dates se zgjedhjeve, qe ne rastin konkret, per zgjedhjet e organeve te qeverisjes vendore te dates 21 qershor 2015, eshte periudha nga dhe pas dates 12 maj 2015.

Përtej kësaj, referuar faktit te interferimit tashme te procesit penal per ceshtjen e listave te zgjedhesve te ketyre zonave zgjedhore, eshte i pamundur rishikimi i ketyre listave duke fshire emra te caktuar zgjedhësish, persa kohe ne kuadër te procesit penal, me vendim te autoriteteve proceduese, eshte vendosur sekuestrimi i te dhenave kompjuterike ne lidhje me perberesit e gjendjes civile te shtetasve te caktuar dhe ndalimi i kryerjes se veprimeve te mëtejshme ne keto te dhena nga zyra e gjendjes civile.

Nga ana tjetër, referuar kohës së mbetur nga hapja e votimit dhe aspektëve teknike të procesit të përgatitjes së listave të zgjedhësve, rishikimi i këtyre listave është i pamundur të realizohet, jo vetëm për shkak të kohës së kufizuar, por edhe nën faktin se, referuar ligjit (neni 56/5 të Kodit Zgjedhor), programi kompjuterik që mundëson nxjerrjen e listës së zgjedhësve është i ndërtuar në një mënyrë të tillë që nuk lejon asnjë ndryshim në listë.

Nga sa më lart u parashtrua, rrjedhur ngjarjet si më lart, pretendimet e palës paditese në lidhje me pasaktësinë e listave të zgjedhësve të zonave zgjedhore të Bashkisë Durrës dhe të Bashkisë Kavaje (shkeljet e pretenduara të ligjit në përgatitjen e tyre) nuk mund të marrin një përgjigje e zaturueshme në funksion të rishikimit të këtyre listave brenda procesit parazgjedhor, tashmë në orët e tij të fundit, nderkohe që ligjërisht, përveç se është prioritare, procesi zgjedhor duhet të vijojë, mbi ato lista të shpallura zgjedhësish, duke qenë i papranueshëm, referuar sa më lart, rishikimi i këtyre listave.

Sa më sipër, Kolegji Zgjedhor konkludon se padia e paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike duhet të rrezohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë,
bazuar në nenin 158, pikë 1, germa “b”, të Kodit Zgjedhor të
ndryshuar,

V E N D O S I

Rrezimin e kërkesepadise.

Tiranë, më 20.06.2015

ANËTAR
VALBON ÇEKREZI

ANËTAR
EDLIRA PETRI

KRYESUES
PETRIT ÇENO

ANËTAR
KLITON SPAHIU

ANËTAR
ILIR TOSKA

* *
* *



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**NR. 27 REGJ. THEMELTAR
DATË 06.07.2015 REGJ.**

**NR. 26 VENDIMI
DATË 09.07.2015 VENDIMI**

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUES : Edlira PETRI
ANËTAR : Andi CIVICI
ANËTAR : Valbon ÇEKREZI
ANËTAR : Kliton SPAHIU
ANËTAR : Ilir TOSKA

asistuar nga sekretarja gjyqësore Rexhina Baçi, mori në shqyrtim, në seancën gjyqësore me dyer të hapura të datës 09.07.2015, çështjen zgjedhore, që u përket palëve :

PADITËSE : Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim, e përfaqësuar me autorizim nga av. Viola Goda.

I PADITUR : Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i përfaqësuar me autorizim nga Z. Olsi Peto.

PALË E INTERESUAR : Partia Socialiste e Shqipërisë, e përfaqësuar nga z. Gledian Llatja.

OBJEKTI : Kundërshtimi i vendimit nr. 820, datë 01.07.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE : Nenet 124 e vijues, 145 e vijues, 39.2 të Kodit Zgjedhor.

Në përfundim të gjykimit, palët pjesëmarrëse i kërkuan Kolegjit Zgjedhor :

Pala paditëse Lëvizja Demokratike për Ndryshim, nëpërmjet përfaqësueses të saj av. Vjola Goda : pranimin e padisë;

Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe pala e interesuar Partia Socialiste e Shqipërisë, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre : rrëzimin e padisë;

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoji pjesëmarrësit, shqyrtoi aktet dhe diskutoi çështjen në tërësi

V Ë R E N

Në datë 21 Qershor 2015 u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, në të cilat ka marrë pjesë si subjekt zgjedhor edhe Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim (më tej, referuar si PLDN).

Pranohet se ky subjekt zgjedhor ka paraqitur listën e kandidatëve të saj edhe për Këshillin e Bashkisë Lezhë dhe në datë 30.06.2015 ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (më tej referuar si KQZ), Kërkesën Ankimore regjistruar me nr. 90, me objekt të saj kundërshtimin e vendimit nr. 114, datë 26.06.2015 të KZAZ nr. 13, Rrethi Lezhë “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjet në Këshillin e Bashkisë Lezhë”.

Në Kërkesën Ankimore nr. 90, në mënyrë të përmbledhur, janë ngritur pretendime lidhur me procesin e numërimit të votave për këtë organ të qeverisjes vendore, që konsistojnë në ekzistencën e konfliktit të interesit të numëruesve pranë kësaj KZAZ-je dhe si rrjedhojë e shkeljeve, ky subjekt zgjedhor ka humbur anëtarin e Këshillit të Bashkisë Lezhë, që realisht e ka fituar.

KQZ-ja, në mbledhjen e datës 01.07.2015 ka kryer verifikimin paraprak të kushteve të pranueshmërisë së ankimit dhe me vendimin nr. 820 të kësaj date, ka vendosur:

- Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 90, datë 30.06.2015, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia “Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim”.

Referuar pjesës arsyetuese të këtij vendimi lidhur me shkakun konkret, për të cilin KQZ-ja nuk pranoi të shqyrtojë në thelb ankimin, rezulton se vendimi është marrë në referencë të neneve 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor, pa specifikuar arsyen për të cilën e ka gjetur të papranueshëm ankimin.

Kundër vendimit të mësipërm të KQZ-së, është paraqitur ankim në Kolegjin Zgjedhor nga subjekti zgjedhor PLDN, duke pretenduar se:

- Ankimi administrativ kundër vendimit nr. 114, datë 26.06.2015 të KZAZ nr. 13, është kryer bazuar në nenin 124 të Kodit Zgjedhor;
- Ankimi është bërë brenda afatit 5 ditor;
- Ankimi përmban të gjithë elementët e përcaktuar në nenin 126 të Kodit Zgjedhor, duke u paraqitur në formatin e miratuar nga KQZ-ja;
- Në kushtet kur KQZ-ja është organi kompetent për shqyrtimin e ankimit, ajo duhej ta kish shqyrtuar atë.

Për shkaqet e mësipërme, pala paditëse PLDN i ka kërkuar Kolegjit Zgjedhor të shfuqizojë vendimin e KQZ-së dhe ta shqyrtojë çështjen në themel.

Pala e paditur KQZ prapësoi kërkimin e ngritur në padi, duke kërkuar rrezimin e saj për këto arsye:

- Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të Zonës Zgjedhore Bashkia Lezhë, administrohen nga më shumë se një KZAZ, ndaj sipas nenit 123.1 të Kodit Zgjedhor, rezultati i votimit për këtë zonë zgjedhore nxirret nga KQZ-ja;
- Vendimi nr. 114, datë 26.06.2015, objekt i ankimit administrativ, është një vendim i ndërmjetëm (neni 123.5 i Kodit Zgjedhor) dhe si i tillë ankimohet në KQZ, së bashku me vendimin e kësaj të fundit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore;

- Në datë 06.07.2015 KQZ-ja ka marrë vendimin për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore Bashkia Lezhë, ndaj të cilit subjektet zgjedhore mund të bëjnë ankimin administrativ.

Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, palë e interesuar në këtë proces, ka mbajtur të njëjtin qëndrim si edhe KQZ-ja, duke kërkuar rrëzimin e padisë.

Kolegji Zgjedhor paraprakisht konstaton se KQZ-ja me vendimin objekt ankimi nuk ka arsyetuar shkakun konkret, për të cilin ajo ka vendosur të mos pranojë të shqyrtojë ankimin e subjektit zgjedhor PLDN, pavarësisht se ky shkak rezultoi gjatë gjyqimit, të jetë ai i ndarjes së territorit të Zonës Zgjedhore Bashkia Lezhë në më shumë se një ZAZ (kjo rezultoi nga procesverbali i mbledhjes së KQZ-së).

Sa i përket ankimit administrativ dhe kushteve të pranueshmërisë për shqyrtim të tij, Kolegji Zgjedhor analizoi çështjen, duke marrë në konsideratë këto rregullime të Kodit Zgjedhor:

Neni 122

Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve nga KZAZ-ja

“1. Tabela përmbledhëse e rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor nxirret nga KZAZ-ja jo më vonë se ora 2200 e ditës së nesërme të votimit.

2. Menjëherë pas përfundimit të numërimit, sipas procedurave të përcaktuara në nenet 116 deri në 119 të këtij Kodi, KZAZ-ja plotëson Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve për zonën që administron, në të cilën pasqyrohen rezultatet e çdo subjekti për çdo qendër votimi, sipas origjinaleve të tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi të plotësuar nga grupet e numërimit.

3. ...

4. ...

5. Në rast të zgjedhjeve vendore, KZAZ-ja miraton me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të bashkisë. ***Në rastet kur territori i bashkisë nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme, çdo KZAZ miraton me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për atë pjesë të territorit të bashkisë.*** Në çdo rast KZAZ-ja zbaton të njëjtat kritere dhe procedura të përshkruara në këtë nen.

Vendimi ankimohet sipas procedurave të përcaktuara në pjesën X të këtij Kodi.

6. Kopja origjinale e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të KZAZ-së dhe Tabelat e Rezultateve për çdo qendër votimi i dërgohen KQZ-së për të nxjerrë rezultatin, sipas nenit 123 të këtij Kodi.

Neni 123

Nxjerrja e rezultateve nga KQZ-ja

1. KQZ-ja verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për zonën zgjedhore për Kuvendin apo për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse. Për këtë, KQZ-ja plotëson Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore dhe e miraton atë me vendim jo më vonë se 48 orë nga mbërritja e të gjitha tabelave të zonës zgjedhore.

2. ...

3. ...

4. Vendimi i KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, sipas këtij neni, mund të ankimohet po në KQZ, sipas proceduarve të parashikuara në pjesën X të këtij Kodi.

5. Vendimi i KZAZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zgjedhjeve të ZAZ-së, çdo vendim i KZAZ-së, i marrë gjatë procedurës së marrjes në dorëzim të materialeve dhe dokumentacionit zgjedhor nga KQV-të, si dhe gjatë numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit të votimit, janë vendime të ndërmjetme dhe ankimohen në KQZ së bashku me ankimin kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas pikës 1 të këtij neni.

Pjesa X

Ankimi në rrugë administrative i vendimeve të komisioneve zgjedhore.

Neni 124

E drejta e ankimit

“1. Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër

vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

2. Kundër vendimit të KZAZ-së për shpalljen e rezultatit për zgjedhjet e organeve të njëjësive të qeverisjes vendore nën juridiksionin e saj, të marrë sipas nenit 122 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankimi në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi.

3. ***Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas nenit 123 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankimi po në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi.***

4.”

Siç rezulton nga dispozitat e mësipërme, Kodi Zgjedhor ka dy rregullime të ndryshme për nxjerrjen e rezultatit për një zonë zgjedhore, në varësi të faktit nëse territori i zonës zgjedhore administrohet nga një apo më shumë KZAZ. Kështu, referuar nenit 122 të Kodit Zgjedhor, është KZAZ-ja, organi që harton Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zonën zgjedhore që administron, kurse kur territori i zonës zgjedhore është i ndarë në dy a më shumë ZAZ, hartimi i Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit, bëhet nga KQZ-ja sipas nenit 123 të këtij Kodi. Në të dyja rastet, Kodi Zgjedhor parashikon ankimin administrativ në KQZ, kundër vendimit për nxjerrjen e rezultatit të zonës përkatëse zgjedhore. Ndërkohë vendimi i marrë nga KZAZ-ja sipas paragrafit 5 të nenit 122 (përpilimi i tabelës për pjesën e territorit të zonës zgjedhore që administrohet nga kjo KZAZ), cilësohet si vendim i ndërmjetëm, i cili mund të ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar të KQZ-së për nxjerrjen e rezultatit për zonën zgjedhore, gjë që përcaktohet në paragrafin 5 të nenit 123.

Në rastin në shqyrtim, referuar zonës zgjedhore Bashkia Lezhë, rezulton se territori i saj nuk administrohet nga një KZAZ e vetme. Për rrjedhojë Tabela Përmbledhëse e Rezultatit për Këshillin e kësaj

Bashkie, përpilohet nga KQZ-ja sipas kompetencës së nenit 123 të Kodit Zgjedhor, ndërkohë që vendimi nr. 114, datë 26.06.2015 i KZAZ nr. 13, është një vendim i ndërmjetëm, ndaj të cilit nuk mund të bëhet ankim, për shkak se ai mund të ankimohet së bashku me vendimin e KQZ-së për nxjerrjen e rezultatit për zonën zgjedhore Bashkia Lezhë.

Sipas nenit 130 të Kodit Zgjedhor, gjatë verifikimit paraprak të ankimit zgjedhor administrativ, KQZ-ja vendos mospranimin e tij kur: a) ajo nuk është kompetente për shqyrtimin e ankimit; b) ankuesi nuk legjitimohet si dhe c) ankimi është paraqitur jashtë afatit. Në rastin në shqyrtim, ashtu si edhe është parashtruar gjatë seancës së shqyrtimit të ankimit në KQZ, Bashkia Lezhë si zonë zgjedhore administrohet nga më shumë se një KZAZ, ndaj duke qenë se vendimi i KZAZ nr. 13, është një vendim i ndërmjetëm ndaj të cilit nuk mund të bëhet ankim, me të drejtë KQZ ka vendosur të mos e pranojë atë për ta shqyrtuar. Në këtë rast, ankuesi/pala paditëse ka të drejtën që pretendimet për vendimin nr. 114, datë 26.06.2015 të KZAZ nr. 13, t'i parashtrojë në rastin eventual të ankimit ndaj vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës zgjedhore Bashkia Lezhë (sipas përfaqësuesit të KQZ-së, ky vendim është marrë në datë 06.07.2015).

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës Apelit Tiranë bazuar në nenin 158, pika 1, shkronja "b" dhe pika 3 të Kodit Zgjedhor.

VENDOSI:

- Rrëzimin e padisë.

Tiranë, 09.07.2015

GJYQTAR
Andi CIVICI

GJYQTAR
Valbon ÇEKREZI

KRYESUES
Edlira PETRI

GJYQTAR
Ilir TOSKA

GJYQTAR
Kliton SPAHIU

* *
* * *



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**NR. 29 REGJ. THEMELTAR
DATË 07.07.2015 REGJ.**

**NR. 29 VENDIMI
DATË 10.07.2015 VENDIMI**

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUES :	VALBON ÇEKREZI
ANËTAR :	PETRIT ÇENO
ANËTAR :	GJINOVEFA GABA
ANËTAR :	ANDI CIVICI
ANËTAR :	KLITON SPAHIU

asistuar prej sekretares Rexhina Baci, në Tiranë, sot me datë 10.07.2015, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore, që u përket paleve:

PADITËSE : PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË,
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Z.Ivi Kaso.

I PADITUR : KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE,
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Znj.Deshira Pasko, Znj. Ana Tenolli dhe Z.Olsi Peto.

PALË E INTERESUAR :PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË,
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Z.Koli Bele dhe Z.Gledian Llatja.

OBJEKTI : - Kundërshtimin e Vendimit të KQZ-së Nr.863, datë 03.07.2015.

- Gjykimi i cështjes në themel duke shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve në të gjithë qendrat e votimit, Zona Zgjedhore Nr.15, Bashkia Kurbin. Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore, dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Bashkia Kurbin.

BAZA LIGJORE : Neni 145 e vijues, 160, 161 e vijues, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS APELIT TIRANË

Pasi degjoi perfaqesuesin e pales paditese Partia Demokratike e Shqiperise, qe kerkoi pranimin e padise sipas objektit; degjoi perfaqesuesit e pales se paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, qe kerkuan rrezimin e padise; degjoi perfaqesuesit e pales se interesuar Partia Socialiste, qe kerkuan rrezimin e padise; si dhe pasi shqyrtoi ceshtjen ne teresi,

V Ë R E N

Më datë 21 qershor 2015, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë zhvilluar zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, ndër to edhe në Zonën Zgjedhore Nr.15, Qarku Lezhë për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të Bashkisë Kurbin, Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak.

Subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, më datë 27.06.2015, në respektim të afatit të parashikuar në nenin 161/1 të Kodit Zgjedhor, ka paraqitur kërkesën ankimore pranë KQZ-së nëpërmjet së cilës ka kërkuar : shpalljen e pavlefshmërinë së zgjedhjeve në të gjithë qendrat e votimit, Zona Zgjedhore nr.15, Bashkia Kurbin; shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore; urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Bashkia Kurbin.

Pala ankuese ka pretenduar që, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, në Bashkinë Kurbin, kanë ndodhur shkelje të ligjit të cilat kanë cënuar procesin zgjedhor, në masë të tillë që kanë ndikuar në ndarjen e mandateve, shkelje

që kanë filluar më datë 20.06.2015, si pasojë e ndërhyrjes së paligjshme të KQZ-së në veprimtarinë e KZAZ-së (Komisioni Zonës Administrimit Zgjedhor) nr.15 dhe që kanë vijuar më tej edhe në procesin e votimit, numërimit dhe nxjerrjen e rezultatit final për këtë zonë zgjedhore.

Referuar situatës kohore ku pretendohen se kanë ndodhur shkeljet nga pala ankuese rezultojnë këto rrethana :

KQZ, duke konstatuar faktin që KZAZ nr.15, Qarku Lezhë ende deri më datën 20.06.2015, ora 16, nuk kishte emëruar anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit për pasojë as nuk kishte filluar procesin e shpërndarjes së materialeve zgjedhore për qendrat e votimit në juridiksionin e kësaj zone të administrimit zgjedhor, fakte që i ishin referuar KQZ-së nga antarë të asaj KZAZ-je nëpërmjet komunikimeve elektronike dhe që sipas tyre ndodhnin për shkak qëndrimeve të anëtarëve të kësaj KZAZ-je të emëruar nga Partia Demokratike, me vendimin nr.712, datë 20.06.2015, bazuar në nenet 23/1-a, 35/5 dhe 99/1 të Kodit Zgjedhor ka vendosur (në unanimitet) : - Të urdhërojë KZAZ-në nr.15, të emërojë anëtarët e KQV-ve në juridiksionin e saj brenda orës 18.30 të datës 2015. - KZAZ-ja nr.15 të fillojë shpërndarjen e bazës materiale për QV-të në juridiksionin e saj brenda orës 19.00 të datës 20.06.2015.

KQZ, tashmë mbi bazën e informacionit zyrtar të referuar nga inspektori rajonal i Qarkut Lezhë (i caktuar prej saj) sipas te cilit ende në orën 19.00 të datës 20.06.2015, nga KZAZ-ja nr.15 nuk ishin emëruar komisionerët e qendrave të votimit dhe se, shkak për këtë situatë të krijuar ishin bërë anëtarët e KZAZ-së të emëruar më propozim të subjekteve zgjedhore Partia Demokratike dhe Partia Republikane, se mosemërimi i komisionerëve jo vetëm që përbënte shkelje të përcaktimeve të nenit 33/a,b të Kodit Zgjedhor, por pamundësonte dhe respektimin e afatit ligjor të përcaktuar në nenin 99/1 të Kodit Zgjedhor për shpërndadjen e bazës materiale zgjedhore, me vendimin nr.716, datë 20.06.2015 (ora 20.30) bazuar në nenet 23/1-a, 29/1, 32/1-a të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit të saj (KQZ) nr.4, datë 21.01.2015 “Për caktimin e partive politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të KZAZ-së, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015” ka vendosur : - Të shkarkojë nga detyra kryetarin dhe anëtarët e KZAZ-së nr.15

Qarku Lezhë, Islam Ismaili dhe anëtarët Edona Velia e Hajredin Ismaili propozuar nga Partia Demokratike dhe Eduard Kurti të propozuar nga Partia Republikane. - Partia Demokratike dhe Partia Republikane të dorëzojnë propozimet për plotësim të vakancave brenda orës 21.30 të datës 20.06.2015.

Më tej, mbi bazën e propozimeve të subjekteve zgjedhore Partia Demokratike dhe Partia Republikane, me vendimin nr.720, datë 20.06.2015 bazuar në nenet 23/1-a, 29/1, 32/1-a të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit të saj (KQZ) nr.4, datë 21.01.2015 "Për caktimin e partive politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të KZAZ-së, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015", KQZ-ja ka vendosur : - Të emërojë kryetar të KZAZ-së Nr.15 Gjovalin Laskaj dhe anëtarë Gentian Mehmeti e Ornela Bibaj sipas propozimeve të PD dhe Esat Cakoni sipas propozimit të PR. Gjithashtu në këtë vendim, KQZ ka urdhëruar KZAZ nr.15 që të fillonte brenda orës 24.00 shpërndarjen e bazës materiale zgjedhore.

Ndërkohë në afatin limit të ditës parazgjedhore, rreth orës 24.00 të datës 20.06.2015, KQZ ka marrë në shqyrtim përsëri situatën në Zonën e Administrimit Zgjedhor Nr.15 edhe mbi bazën e informacionit zyrtar të sjellë nga inspektori rajonal i Qarkut Lezhë, i cili ka referuar faktin që ende nga KZAZ nuk ishin emëruar anëtarët e qendrave të votimit të kësaj zone zgjedhore, për pasojë, as nuk kishte filluar procesi i shpërndarjes së materialeve zgjedhore në qendrat e votimit, situatë që është konstatuar se vijonte përgjatë gjithë kësaj dite, dhe se shkak për këtë ishin bërë anëtarët e emëruar se fundi, KQZ-ja, me vendimin Nr.726, i marrë pas hyrjes në ditën zgjedhore datë 21.06.2015 (sic rezulton nga proces verbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së), bazuar në nenet 23/1-a, 29/1-8, 32/1-a të Kodit Zgjedhor, ka vendosur (me unanimitet) t'i shkarkojë anëtarët e KZAZ të emëruar se fundi prej saj, duke emëruar në detyrën e anëtarit të KZAZ-së nr.15, z. Fran Nezha (jo më mbi bazën e propozimeve të forcave politike), duke u identifikuar ky i fundit prej administratës së KQZ-së si një nga personat që plotësonte kërkesat ligjore për të ushtruar detyrën e anëtarit të KZAZ-së dhe që kishte depozituar kërkesën dhe dokumentacioni përkatës pranë saj sipas shpalljes publike të KQZ datë 14 mars 2015.

Në vijim, rezulton sipas librit të mbledhjeve të KZAZ nr.15, që kjo KZAZ të jetë mbledhur (tashmë kishte hyrë dita e zgjedhjeve) dhe të ketë emëruar si kryetar të saj z. Fran Nezha dhe, mandej, ka vijuar veprimtarinë me emërimin e anëtarëve të KQV-ve (Komisioneve të Qendrave Votimit) në territorin e kësaj zone zgjedhore, shpërndarjen e materialit zgjedhor, si dhe me emërimin e anëtarëve të GNV-ve (Grupit Numërimit Votave).

Më datë 21.06.2015, nga ora 07.00, është zhvilluar procesi i votimit, me mbylljen e të cilit është vijuar me procesin e numërimit të votave dhe, më tej, në përfundim të këtij procesi, është miratuar nga KZAZ Nr.15, me vendimin nr.415, datë 25.06.2015, tabela përmbledhëse e rezultatit për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Kurbin dhe të Këshillit Bashiak Kurbin, duke u pasqyruar në të rezultatet e cdo subjekti për cdo qendër votimi të plotësuar nga grupet e numërimit, bazuar në origjinalet e tabelave të rezultateve për cdo qendër votimi të plotësuar nga grupet e numërimit.

Ndaj vendimit si me lart, më datë 27.06.2015, si dhe u parashtua, ka paraqitur ankim subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë.

Po kështu, ndaj këtij vendimi, më datë 29.06.2015, ka paraqitur ankim edhe Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë.

Duke qenë në kushtet e nenit 132/1 të Kodit Zgjedhor, për shkak se kërkesat ankimore si me sipër referonin kundërshtimin e të njëjtit vendim KZAZ-je (te KZAZ nr.15), KQZ-ja, përpara fillimit të shqyrtimit administrativ të tyre, ka vendosur shqyrtimin bashkërisht të të dy kërkesave ankimore.

KQZ-ja, në përfundim të shqyrtimit administrativ, me vendimin nr. 863, datë 03.07.2015, ka vendosur: - Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.39 të Partisë Demokratike. - Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.65, të Partisë Popullore Kristian Demokrate. - Lënien në fuqi të vendimit të KZAZ nr.15, "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e Kruetarit dhe Këshillit Bashiak në Bashkinë Kurbin."

Për këtë vendimmarrje të tij, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka argumentuar:

për dhënien e një vendimi sa më të saktë dhe të drejtë duhej analizuar dhe veprimtaria dhe vendimet e KQZ-së, nr.716 datë 20.06.2015 dhe nr.726 datë 20.06.2015. Kodi Zgjedhor është një ligj specifik dhe si i tillë përcakton saktë dhe qartë afatet në nenin 152/pika 2, që parashikon afatin 5 ditor për ankimet ndaj vendimeve të KQZ-së në periudhën zgjedhore. Këto vendime, janë legjitime dhe të vlefshme, pasi për to nuk është bërë ankimim dhe, si pasojë, edhe veprimtaria e KZAZ nr.15 është e tillë, e cila është ngritur dhe ka funksionuar mbi bazën e vendimmarrjes së KQZ-së e është në përputhje me Kodin Zgjedhor. Sikurse rezulton nga proces i mbledhjeve të KQZ-së, por dihet dhe botërisht, këto vendime janë marrë në mbledhjen e datës 20 qershor, madje mbledhja ka përfunduar në orët e para të datës 21 qershor, nderkohe që ankimi i PD-së është në tejkalim të afatit 5 ditor të parashikuar nga nenet 124, 125, por edhe 152 të Kodit Zgjedhor;

është parim i njohur dhe i gjithëpranuar në një shtet të së drejtës se ndërmjet dy normave/ligjeve me të njëjtën fuqi juridike, ligji i veçantë ka përparësi ndaj atij të përgjithshëm, “lex specialis, generalis derogat”. Në rastin tonë, Kodi Zgjedhor, i cili zotëron edhe karakteristikën e “*lex specialis*” për fushën në fjalë, parashikon një afat ankimi shumë më të shkurtër (5 ditor) se sa Kodi i Procedurave Administrative, sikundër parashikon edhe një gjykatë të posacme, me juridiksion të përcaktuar e të pa konfondueshme, sikurse është Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Duke mos paraqitur ankimin në afatin e caktuar nga ligji, e drejta e Partisë Demokratike për kundërshtimin e vendimeve të KQZ, nr.716 datë 20.06.2015 dhe nr.726 datë 20.06.2015, ka rënë në dekadencë dhe nuk mund të merret parasysh;

në lidhje me pretendimin e palës ankuese, se në respekt të neneve 116 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative këto vendime janë absolutisht të pavlefshme dhe mund të goditen në cdo kohë, pasi janë marrë në kundërshtim me parashikimet e nenit 29/1,8 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja thekson se vendimet e mësipërme për shkarkimin e komisionerëve të propozuar nga PD në KZAZ nr.15 Kurbin erdhën pas konstatimit faktik se ata thjesht nuk e kishin kryer detyrën e tyre për emërimin e anëtarëve

KQV-ve në juridiksionin e KZAZ nr.15 dhe të shpërndarjes së materialeve zgjedhore, megjithëse kishte kaluar cdo lloj afati i parashikuar nga Kodi Zgjedhor. Pasi kjo situatë u bë e qartë për KQZ-ne nga inspektori rajonal, punonjës i KQZ-se në zonën e Kurbin, dhe pas tejkalimit edhe të një afati të dytë (ndonëse afati ligjor ishte shkëlur tashmë), KQZ-ja, sikundër edhe del qartë nga vendimet e saj nr.716 datë 20.06.2015 dhe nr.726 datë 20.06.2015, e ka referuar këtë vendimmarrje, ndër të tjera, te nenet 32, pika 1, gërma “a” dhe 33, gërma “a” e “b”, të Kodit Zgjedhor, që legjitimojnë shkarkimin e anëtarit të KZAZ-se kur ai shkel dispozitat e Kodit Zgjedhor që e ngarkojnë me përgjegjësi në lidhje me administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në ZAZ;

KZAZ nr.15 ka funksionuar me katër anëtare, të emëruar në bazë të nenit 29 të Kodit Zgjedhor, në kuorimin e nevojshëm për të marrë vendime dhe për të funksionuar në përputhje me nenin 33 dhe 34 të Kodit Zgjedhor. Anëtari i katërt i KZAZ-se është emëruar kryesisht nga KQZ-ja, në përputhje të plotë me nenin 29, pika 4, të Kodit Zgjedhor. Ndaj, pretendimet se KZAZ nr.15 ka vepruar në mënyrë të paligjshme dhe të padrejtë ndaj përfaqesuesve të subjekteve ankues nuk qëndrojnë, pasi dhe provat e paraqitura prej tyre nuk janë bindëse. KQZ-ja arsyeshëm pranon se, megjithëse përzgjedhja e tij është formalisht/ligjërisht korrekte, do të kishte qenë më mirë që kandidati i emëruar kryesisht prej KQZ-se të mos kishte asnjë hije dyshimi për anësi politike, por edhe i kujton palës se interesuar se në ato momente të vështira, të natës duke u gdhirë dita e zgjedhjeve, z.F.Nezha rezultoi, sipas administratës së KQZ-se, si i vetmi individ i trajnuar (e nevojshme sipas ligjit) nga KQZ-ja dhe me banim në zonën zgjedhore Kurbin (e domosdoshme sipas ligjit);

në lidhje me pretendimin e palës ankuese se jemi përpara një rasti të konfliktit të interesit me pasojë pavlefshmërinë e vendimmarrjes KZAZ nr.15 Kurbin, referuar nenit 32, pika 2, të Kodit Zgjedhor, pasi nënkryetarja e kësaj KZAZ, Znj.M.Cara, ka patur bashkëshortin (V.Cara) kandidat në listën shumëemërore të PS për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Kurbin, në gjykimin e shumicës së anëtarëve të KQZ, ndërsa ndahet mendimi unanim se marrëdhënia e znj.M.Cara me z.V.Cara është ajo që parashikohet nga gërma “a” e nenit 32, vërehet edhe dallimi që

ka dashur të bëjë legjislatori ndërmjet kandidatit për deputet/ për kryetar bashkie, të cilit i referohet rregullimi i pikës “a” dhe kandidatëve të listës shumëemërore të një partie a koalicioni, të cilëve iu referohet gërma “b”. Është e qartë se pika “a” parashikon një konflikt interesi të një anëtari (apo sekretarit) të KZAZ-se kur gjendet në marrëdhënie krushqie a gjinie me një prej kandidatëve që konkurrojnë në zonë, duke sjellë për operatorin e së drejtes thelbin e sistemit zgjedhor maxhoritar, pra konkurrimin e kandidatëve, ndërkohë që në pikën “b” parashikohet konflikti i interesit me detyrën e anëtarit/sekretarit të KZAZ kur ky i fundit është në marrëdhënie pune me ndonjë prej anëtarëve të listës shumëemërore. Në pikën “b”, ndryshe nga pika “a”, ato që konkurrojnë janë partitë politike, pra sistemi proporcional. Nëse do të ishte ndryshe, do të ndodheshim përpara një numri shumë lartë të rasteve potenciale të konfliktit të interesit, me pasojë vështirësimin e formësimit të KZAZ-ve apo edhe pavlefshmëri të vendimmarrjes së tyre, nëse konflikti i interesit evidentohet pas përfundimit të zgjedhjeve. Në këte kontekst logjik, KQZ-ja vëren edhe mospërcaktimin fare nga ana e legjislatorit të konfliktit të interesit në lidhje me komisionerët e Qendrave të Votimit. Duke qenë se bashkëshorti i znj.M.Cara, në rastin në analizë, është thjesht një nga kandidatët e listës shumëemërore dhe jo kandidat për kryetarin e Bashkisë Kurbin, KQZ-ja gjykon se nuk ndodhet përpara ndalesave të parashikuara nga neni 32, pika 2 me efektet e parashikuara nga neni 35, pika 4, të Kodit Zgjedhor;

KQZ vëren se neni 160 i Kodit Zgjedhor në kërkesat e tij shprehet qartë se, për të shpallur një Qendër Votimi të pavlefshme, faktet dhe provat duhet të vërtetojnë se ka patur një a më shumë shkelje të ligjit të cilat të kenë çenuar rëndë procesin zgjedhor dhe në një masë të tillë që të kenë ndikuar në ndarjen e *mandeteve*. Referuar provave të administruara nuk u provuan shkelje të ligjit dhe, për më tepër, të atij karakteri që të kenë ndikuar mbi rezultatin zgjedhor. Është detyrim i ankuesve të provojnë se ka shkelje të tillë të ligjit që të ndikojë në ndarjen e mandateve, detyrim i cili në shqyrtimin në fjalë nuk u arrit të provohej.

Subjekti zgjedhor, Partia Demokratike e Shqipërisë (PD), më datë 07.0.72015, ka paraqitur padinë në shqyrtim pranë Kolegjit

Zgjedhor, me objekt: - Kundërshtimin e Vendimit të KQZ-së Nr.863, datë 03.07.2015. - Gjykimi i çështjes në themel duke shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve në të gjithë qendrat e votimit, Zona Zgjedhore nr.15, Bashkia Kurbin. Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore, dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Bashkia Kurbin.

Në ankimin zgjedhor, sikunder dhe në shqyrtimin gjyqësor pala paditëse PD parashtroi:

Vendimi i KQZ nr. 863 datë 03.07.2015 është një vendim i marrë në kundërshtim me 1igjin, pasi nuk ka analizuar asnjë nga faktet dhe provat të cilat i janë paraqitur në shqyrtimin administrativ dhe, mbi të gjitha, nuk i ka analizuar këto prova dhe fakte në raport me 1igjin zgjedhor. Në zgjedhjet për organet e Qeverisjes Vendore të datës 21 qershor 2015, konkretisht për Bashkinë Kurbin, kanë ndodhur shkelje të ligjit të cilat kanë cënuar procesin zgjedhor, në masë të tillë që kanë ndikuar në ndarjen e mandateve;

shkeljet në këtë njësi zgjedhore kanë filluar në datën 20.06.2015, ku si pasojë e ndërhyrjes së paligjshme të KQZ-se në veprimtarinë e KZAZ nr.15, në kushtet kur kjo e fundit ishte në detyrë dhe në ushtrim të funksioneve të veta, është penguar veprimtaria normale e saj, janë shkarkuar padrejtësisht, brenda 2 orësh, tetë nga anëtarët e saj të propozuar nga opozita dhe, si pasojë, është deformuar rëndë procesi i administrimit zgjedhor, deformim që ka sjellë pasoja të rënda dhe ka ndikuar haptazi në një sërë hallkash të tjera të procesit të administrimit zgjedhor në nivelet e tjera, duke i shtuar paligjshmëri çdo hapi të procesit të administrimit zgjedhor ditën e zgjedhjeve, si dhe të numërimit dhe tabulimit të rezultatit zgjedhor më vonë;

me anë të vendimeve nr.716 date 20.06.2015 dhe nr.726 date 20.06.2015, KQZ ka ndërhyrë në mënyrë të dhunshme, të kundraligjshme dhe të papërligjur për shkarkimin e anëtarëve të KZAZ nr.15 të propozuar nga opozita parlamentare (e cila gezonte shumicën në këtë komision), duke prishur balancat e perfaqësimit dhe në kundërshtim me parashikimet e nenit 29, paragrafi 1 dhe 8, të Kodit Zgjedhor. Në vijim të shkeljes së

mësipërme, KQZ ka emëruar kryesisht një anëtar të “pavarur” në KZAZ nr.15, i cili është emëruar dhe kryetar, pavarësisht se ishte eksponent i njohur dhe funksionar i lartë i forcës politike që kishte të 3 anëtarët e mbetur në detyrë në këtë KZAZ, duke pasjellë në këtë mënyrë kontrollin total të KZAZ nr.15 nga e njëjta forcë politike;

KZAZ nr.15, megjithëse e konstituuar kështu në mënyrë të paligjshme, ka vijuar me menaxhimin e paligjshëm të procesit zgjedhor duke shkarkuar anëtarët e propozuar nga subjekti ynë për anëtare të KQV-ve në ZAZ nr.15, ndërsa nuk ka emëruar ata sipas propozimeve të ardhura po nga ky subjekt, por ka emëruar anëtare kryesisht nëpër KQV, persona identiteti i të cilëve, kriteret dhe modalitetet e emërimit të tyre, nuk dihen edhe sot, në kundërshtim me parashikimet e nenit 36 të Kodit Zgjedhor. KZAZ nr.15 ka vijuar me shpërndarjen e materialit zgjedhor për KQV-të përkatëse duke mos plotësuar asnjë dokumentacion, procesverbal, për shpërndarjen e materialit zgjedhor, madje duke mos shënuar as kodet e sigurisë me të cilat pajisej çdo QV, çka është në kundërshtim me parashikimet e nenit 100 të Kodit Zgjedhor. Një pjesë e këtij dokumentacioni është plotësuar në mënyrë fiktive në përfundim të procesit zgjedhor;

KQV-të e ZAZ nr.15, të krijuara në mënyrë të paligjshme, kanë administruar një proces votimi fiktiv në datën 21.0.2015, duke lejuar çdo parregullsi që do të favorizonte kandidatin e subjektit zgjedhor të cilit i përkisnin të gjithë anëtarët e KZAZ-se. Kështu është lejuar votimi familjar, votimi i hapur, votimi në emër të personave të tjerë, votimi i personave jo pjesë e listës së zgjedhësve etj;

KZAZ nr.15, në përfundim të procesit të votimit ka lejuar administrimin e një procesi numerimi tërësisht të parregullt, proces ky që, ndërsa nuk janë lejuar të marrin pjesë numëruesit tanë, është administruar nga numërues të panjohur dhe të emëruar në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu, në këtë proces, nuk janë lejuar të marrin pjesë vëzhguesit e subjektit tonë pavarësisht se një kërkesë të tillë ia kemi drejtuar me shkrim KZAZ nr.15, çka është në kundërshtim me nenet 116 e vijues të Kodit Zgjedhor;

në përfundim të procesit të numërimit nuk jemi lejuar të marrim pjesë në procesin e tabulimit, si dhe, pas disa kërkesave të përsëritura me shkrim nga ana jonë, vetëm me datë 25.06.2015 na është vënë në dispozicion një tabelë përmbledhëse e rezultatit për kandidatin për kryetar bashkie;

të njëjtat shkelje të sipërpërmendura kanë shoqëruar edhe procesin e votimit dhe numërimit edhe për këshillin bashkiak në këtë zonë zgjedhore;

legjislatori, procesit të administrimit dypalësh të balancuar të procesit zgjedhor, i ka dhënë një rëndësi të padiskutueshme për një proces zgjedhor të besueshëm, transparent dhe mbi të gjitha ligjor. Pamundësimi i administrimit të balancuar dhe jo të njëanshem, është një shkelje e rëndë e Kodit Zgjedhor sa që është e pamundur që nga ky proces të dalë një rezultat zgjedhor i ligjshëm dhe legjitim, c'ka ndikon drejtpërsëdrejti në ndarjen e mandateve;

është fakt se, përvec gjithë shkeljeve të tjera të ligjit të cilat janë provuar në këtë njësi zgjedhore, ne rastin konkret ka patur dhe një mosfunksionim të ligjshëm të KZAZ nr.15, pasi kjo e fundit ka patur ne perberjen e saj të paktën njërin nga anëtarët (nënkryetaren) në konflikt interesi, ne kushtet kur ajo është bashkeshortja e një prej kandidateve për këshilltar në listën shumëmerore të Partisë Socialiste;

në kushtet kur në këtë zonë zgjedhore nuk ka patur një KZAZ të konstituar sipas ligjit, atëherë të gjitha vendimet e marra nga KZAZ nr.15 janë nul dhe të pavlefshme.

Përfaqësuesit e KQZ, kërkuan rrëzimin e padisë duke iu përmbajtur argumentimit në vendimin e ankimuar.

Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, kishte paraqitur kërkesë për të marrë pjesë në gjykim me cilësinë e personit të interesuar, kërkesë që u pranua nga Kolegji Zgjedhor, duke cmuar se ishte e bazuar në nenin 133 të Kodit Zgjedhor, marrë në konsideratë dhe faktin që ky subjekt zgjedhor kishte marrë pjesë gjatë shqyrtimit administrativ.

Pala e interesuar duke e konsideruar të drejtë vendim marrjen e KQZ parashtroi se:

referuar parashikimeve të Kodit Zgjedhor, neneve 125 e 152, vendimmarrja e KQZ-së, e pretenduar si shkelje ligji nga Partia Demokratike, nuk mund të jetë objekt kundërshtimi në këtë shqyrtim gjyqësor, pasi vendimet e kundërshtuara të KQZ-së janë marrë më date 20.06.2015 dhe nuk janë kundërshtuar brenda afatit ligjor 5 ditor në Kolegjin Zgjedhor;

përsa i takon themelit të pretendimit të PD-së, ne lidhje me paligjshmërinë e vendimmarrjes së KQZ-së ditën e zgjedhjeve për ZAZ nr.15, theksojmë se vendimet e sipërcituara të KQZ janë të ligjshme pasi duke përmbledhur në mënyrë kronologjike procesin zgjedhor zhvilluar në ZAZ nr.15, vendimmarrjen e dates 19.06.2015 dhe 20.06.2015 të KZAZ-së, rezulton i provuar qëllimi i përfaqësuesve të PD në KZAZ nr.15 dhe i përfaqësuesve të PD-se të Kurbinut për dështimin e fillimit në afat të procesit zgjedhor;

sipas rendit të ditës të dates 20.06.2015, miratuar me unanimitet në datë 19.06.2015 nga KZAZ nr.15, është marrë vendim për shpërndarjen e materialeve zgjedhore në date 20.06.2015, nga ora 10.00 deri në ora 17.00 (sipas librit protokollit të mbledhjeve të KZAZ-se), nderkohe që, në kundërshtim me këtë vendimmarrje, ky rend dite, në mbledhjen e dates 20.06.2015, është ndryshuar në mënyrë të njëanshme e të paligjshme nga kryetari dhe anëtarët e opozitës në KZAZ nr.15, duke filluar me emërime dhe shkarkime anëtarësh GNV, si dhe duke u përfshirë në diskutime të tejzgjatura me qëllimin e vetëm zvarritjen e shpërndarjes së materialeve zgjedhore;

pavarësisht tejkalimit të afatit ligjor të emërimit të anëtarëve të GNV-ve dhe KQV-ve, subjekti PD ka ndryshuar, me shkresa të veçanta, pothuajse të gjithë anëtarët e KQV-ve (88 shkresa të depozituara nga PD në KZAZ nr.15 në date 20.06.2015), duke përfshirë në listën e të propozuarve për anëtar QV-je dhe GNV-je, në masën 70% të listës së saj, njerëz të cilët prej shumë vitesh banojnë jashtë Shqipërisë ose vuajnë denime me burgim. Kjo listë fiktive e propozuar nga PD, që në përbërje të saj ka edhe deri anëtarë të PS, nuk ka në asnjë rast të bashkëlidhur

fotokopjen e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike apo ndonjë dokument i cili të vërtetonte gjendjen gjyqësore ose arsimimin. Personat e propozuar nga PD as nuk kanë patuar dijëni për emërimin e tyre anëtarë QV-je dhe e vetmja pikë që lidh të gjithë këta persona me këtë proces zgjedhor është fakti që janë përzgjedhur fiktivisht. Ky fakt u provua katërcipërisht gjatë fazës së shpërndarjes së materialeve zgjedhore, proces në të cilin nuk u paraqit asnjë anëtar QV-je, i propozuar nga subjektet politike PD dhe PR;

është i pavërtetë pretendimi që vëzhguesit e PD-së nuk janë lejuar të vëzhgojnë në QV dhe në GNV-të KZAZ-se nr.15, mjaft të shikohet Libri i Protokollit të Mbledhjeve nr.2, faqet 41, 42 dhe 43, për emërimin e vëzhguesve të PD neper QV, si dhe faqet 49 dhe 50, për emërimin e vëzhguesve të PR neper GNV); janë të pabaza dhe të pavërteta plotësisht pretendimet e subjektit PD, se komisionerët e QV-ve dhe të GNV-ve përfaqësues të ASHE, janë emëruar në kundërshtim me ligjin dhe se ato janë të panjohur, pasi ata përvetë kanë pasur dokumentacionin të plotë sipas ligjit, sikundër mund të provohet edhe nga libri protokollit të mbledhjeve të KZAZ-se, janë emëruar me unanimitetin e shtatë anëtarëve të KZAZ nr.15, përpara fillimit të procesit të shpërndarjes së materialeve zgjedhore. Ndersa, përse i takon emërimin kryesisht të anëtarëve të QV-ve, ata janë përzgjedhur sipas ligjit vetëm nga lista e komisionereve kryesisht të trajnuar nga KQZ-ja, pjesë e shoqërisë civile;

absolutisht i pavërtetë është edhe pretendimi që nuk është plotësuar dokumentacioni i shpërndarjes së materialit zgjedhor, pasi, pavarësisht vështirësive të krijuara si pasojë e zvarritjeve nga përfaqësuesit e APPD deri në ora 01.45 e mëngjesit të datës 21.06.2015, materiali zgjedhor është shpërndarë duke u respektuar në mënyrë rigoroz procedurë e parashikuar në nenin 100 të Kodit Zgjedhor;

gjatë shqyrtimit të kërkesës ankimore në KQZ, pala ankuese pretendoi se një nga anëtarët e KZAZ nr.15 është në konflikt interesi, duke aluduar se zëvendëskryetarja e KZAZ është bashkëshortja e njërit prej kandidatëve të regjistruar për anëtar të këshillit bashkiak, ku në rast se një gjë të tillë, nëse është e

vërtete për sa është pretenduar, atëherë duhet të ishte kërkuar shkarkimi i këtij anëtar sipas nenit 32 të Kodit Zgjedhor dhe, më pas, mund të shqyrtohej vendimmarrja e këtij anëtar.

Kolegji Zgjedhor, pasi ia nënshtroi çështjen debatit gjyqësor, dëgjoi palët, administroi provat, në konsideratë të fakteve të rezultuara nga provat e marra në gjykim, arriti në përfundimin që padia e paraqitur nga PD rezulton e pabazuar në prova dhe në ligj dhe se, Vendimi i KQZ Nr.863, datë 03.07.2015 është marrë në vlerësim të drejtë të fakteve dhe në përputhje me ligjin, ku për pasojë padia duhet rrëzuar.

Kolegji Zgjedhor konstatoi fillimisht që subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë legjitimohet në paraqitjen e ankimit/padisë ndaj Vendimit Nr.863, datë 03.07.2015 të KQZ në kuptim të nenit 145 të Kodit Zgjedhor dhe se, ankimi/padia është paraqitur brenda afatit (pesë ditë nga shpallja e vendimit të KQZ) të parashikuar në nenin 152 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar).

Gjatë shqyrtimit të çështjes, Kolegji Zgjedhor administroi praktikën dokumentare në lidhje me Vendimin Nr.863, datë 03.07.2015 të KQZ; praktikën dokumentare në lidhje me Vendimet e KQZ Nr.712, Nr.716, Nr.720 dhe Nr.726, si dhe procesverbalet e mbledhjeve të zbardhuara të KQZ në lidhje me këto vendimmarrje; provat e paraqitura nga personi i interesuar, kërkesa të bëra me datë 20.06.2015 nga Partia Demokratike, Dega Kurbin, paraqitur pranë KZAZ-së nr.15, për zëvendësim komisionerësh të qendrave të votimit në administrim të kesaj KZAZ (88 kërkesa).

Me ankimin zgjedhor të paraqitur, nga pala pala paditëse nëpërmjet kundërshtimit të Vendimit Nr.863, datë 03.07.2015, të KQZ është kërkuar pavlefshmëria dhe përsëritja e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të Bashkisë Kurbin.

Lidhur me kërkimin e palës paditëse për përsëritjen e zgjedhjeve, në nenin 160 të Kodit Zgjedhor, titulluar "Pavlefshmëria e zgjedhjeve në qendrën e votimit" përcaktohet se:

"1. KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra

votimi, në rast se: a) kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;...3. Kërkesa për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të përmbajë shkaqet ligjore, përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre...”

Ndërsa, në nenin 161 të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon përsëritjen e zgjedhjeve, përcaktohet se:

“1. Pas përfundimit të procesit të ankimit, jo më vonë se 3 ditë nga nxjerrja e rezultatit të zonës zgjedhore, KQZ-ja kryesisht ose me kërkesë të subjektit, shpall të pavlefshme dhe urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore, kur pavlefshmëria e shpallur në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi, ndikon në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore ose në shkallë vendi.

2. Për zgjedhjet për kryetar të qeverisjes vendore ndikim në rezultat do të konsiderohet kur numri i zgjedhësve në qendrat e shpallura të pavlefshme është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme.

...

5. Përsëritja e zgjedhjeve urdhërohet në të njëjtin vendim të KQZ-së, që i shpall ato të pavlefshme. Zgjedhjet për këshillat e qeverisjes vendore nuk përsëriten.”

Nga analiza e dispozitave të mësipërme rezulton se Kodi Zgjedhor obligon pavlefshmërinë me rrjedhojë përsëritjen e zgjedhjeve, në ato raste kur: (i) Vërtetohen *“shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor.* (ii) Tërësia e shkeljeve *“mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar”* në rezultatin e zgjedhjeve.(Vendimi Kolegjit Zgjedhor Nr.45, date 18.11.2013).

Pala ankuese ka pretenduar që, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, në Bashkinë Kurbin, kanë ndodhur shkelje të ligjit të cilat kanë cenuar procesin zgjedhor,

në masë të tillë që kanë ndikuar në ndarjen e mandateve, shkelje që kanë filluar më datë 20.06.2015 si pasojë e ndërhyrjes së paligjshme të KQZ-së në veprimtarinë e KZAZ nr.15 dhe që kanë vijuar më tej edhe në procesin e votimit, numërimit dhe nxjerrjen e rezultatit final për këtë zonë zgjedhore.

Kolegji Zgjedhor vuri në diskutim rastet, për të cilat ligji parashikon pavlefshmërinë e zgjedhjeve, për rrjedhojë dhe përsëritjen e tyre, që janë ekzistenca e shkeljes së ligjit, që e ka cenuar rëndë procesin zgjedhor dhe masa e ndikimit të kësaj shkelje në rezultatin përfundimtar.

Për të vlerësuar (pa) ligjshmërinë e një veprimi të kryer, pra për të vërtetuar atë që parashikon Kodi Zgjedhor, nëse shkelja e ligjit ka qenë e tillë sa ka cenuar rëndë procesin zgjedhor, apo nëse tërësia e shkeljeve të kryera ka qenë e atyre përmasave sa mund të ketë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, Kolegji Zgjedhor orientohet nga konceptet që ka përpunuar jurisprudenca gjyqësore mbi parimin e proporcionalitetit.

Terminologjia “rëndë” dhe ndikimi “në një masë të tillë”, i përdorur në nenin 160, pika 1, shkronja “a” të Kodit Zgjedhor, imponon kryerjen nga gjykata të një vlerësimi të arsyeshëm, objektiv dhe të paanshëm, mbi natyrën e shkeljes së ligjit. Kolegji Zgjedhor vlerëson se kuptimi i saktë dhe i drejtë i terminologjisë së përdorur në këtë dispozitë ligjore, duhet të analizohet dhe vlerësohet në tërësi nga disa faktorë, që kanë të bëjnë me rëndësinë e shkeljes së ligjit, pasojat e ardhura apo që mund të vinin nga kjo shkelje, kohëvazhdimin e këtyre pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si dhe vetë qëndrimin subjektiv, që mban personi konkret ndaj shkeljes së kryer dhe pasojës së ardhur. (*Shih vendimin nr. 75, datë 19.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese*).

Termi “rëndë”, i përdorur në ligj, për të dalluar intensitetin e cenimit që mund t’i bëhet procesit zgjedhor, nënkupton dhe interpretimin a contrario, se procesi zgjedhor do të pranohet si i vlefshëm dhe ligjor, përderisa shkeljet e kryera nuk janë të asaj shkalle, sa të vlerësohen si të rënda. Pra, cilësimi “rëndë” i shërben gjykatës për të dalluar këto veprime, nga sjelljet e një kategorie më të lehtë, të cilat nuk mund të përdoren për të cenuar të gjithë procesin

zgjedhor dhe për të shpallur të pavlefshme zgjedhjet. Ky është një koncept që pranohet tashmë, jo vetëm nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese apo e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, por dhe nga legjislacioni ynë. Këtë kuptim ka edhe neni 40/4 i Ligjit Nr.49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, sipas të cilit “Gjykata vendos rrëzimin e padisë dhe kur vlerëson se, *pavarësisht shkeljeve procedurale të konstatuara të veprimtarisë administrative, pasojat do të ishin të njëjta.*” Pikërisht, këtë vlerësim bën Kolegji Zgjedhor, nisur nga parimi i proporcionalitetit, parim i cili kërkon një barazpeshim të përshtatshëm e të arsyeshëm (pa shpërfilluar faktet apo rrethanat që kanë rëndësi për çështjen), midis cenimit që i bëhet një të drejte konkrete dhe interesit të ligjshëm publik.

Referuar rastit në shqyrtim marrë në konsideratë dhe pretendimet e palës paditëse, Kolegji Zgjedhor vuri në diskutim ceshtjen nëse, sjellja/“ndërhyrja” e KQZ-së, si organi më i lartë i administrimit zgjedhor, në datat 20.06.2015 dhe 21.06.2015 në mbikqyrjen dhe administrimin e procesit zgjedhor në Zonën Zgjedhore nr.15, Qarku Lezhë, Bashkia Kurbin, formalizuar në vendimet e saj, ka qenë në përputhje dhe në përmbushje të kompetencave që i ngarkohen prej Kodit Zgjedhor si dhe e justifikueshme e arsyeshme në raport me situatën e krijuar në atë KZAZ.

KQZ është organi më i lartë i administratës zgjedhore, kompetencat e të cilit janë përcaktuar në nenin 21 të Kodit Zgjedhor, “... 3. Drejton dhe kontrollon kolegjisht, nëpërmjet cdo anëtari ose strukturave të saj, procesin parazgjedhor dhe atë zgjedhor. ...

11. Emëron dhe shkarkon, në përputhje me këtë Kod, anëtarët e KZAZ-së dhe i mbikëqyr në përmbushjen e detyrave të tyre.”.

Ndërkohë, emërimi i anëtareve të Komisionit të Qendrave të Votimit (KQV), emërimi i anëtarëve të Grupeve të Numërimit Votave (GNV) si dhe shpërndarja e materialit zgjedhor janë faza të rëndësishme për realizimin dhe mbarëvajtjen e një procesi zgjedhor dhe që gjejnë rregullim të hollësishëm në një sërë dispozitash të Kodit Zgjedhor, duke përcaktuar dhe afate brenda të cilave organet e administrimit zgjedhor do të duhet të përmbyllin këto faza.

Sipas parashikimit të nenit 33 të Kodit Zgjedhor, ndër detyrat që i ngarkohen KZAZ-së, përcaktohen *“a) përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në ZAZ, sipas dispozitave të këtij Kodi dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja; b) emëron kryetarin, zëvendëskryetarin, anëtarët, sekretarët e KQV-ve, dhe anëtarët e grupeve të numërimit, të përfshira në juridiksionin e ZAZ-së, sipas këtij Kodi.”*

Në cdo rast, emërimi i anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së, duhet të bëhet nga KZAZ-ja, jo më vonë se 20 ditë para datës së zgjedhjes (neni 36/2 i Kodit Zgjedhor), kurse grupet e numërimit të votave duhet caktohen nga KZAZ-ja 10 ditë para datës së votimit (neni 95/1 i Kodit Zgjedhor).

Ndërsa në nenet 99 dhe 100 të Kodit Zgjedhor gjejnë rregullim procedura dhe afatet kohore për shpërndarjen e materialeve zgjedhore. Posacërisht, në këtë dispozitë parashikohet se KQZ, jo më vonë se tre ditë para datës së zgjedhjeve, dërgon në selitë e KZAZ-ve materialet zgjedhore të ndara në kuti të vecanta për cdo qendër votimi. Ndërsa KZAZ-ja është e detyruar që jo më vonë se 15 orë para hapjes së votimit t’u shpërndajë materialet zgjedhore KQV-ve nën juridiksionin e saj.

Në normalitetin e procesit zgjedhor sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor do të duhej që më datë 20.06.2015, KZAZ nr.15 të kishte përfunduar rregullisht emërimin e anëtarëve të KQV-ve dhe GNV-ve, dhe se të paktën 15 orë para hapjes së votimit që, ne referim të parashikimit të nenit 11 të Kodit Zgjedhor, për këto zgjedhje ka qenë ora 07.00 e datës 21.06.2015, duhet të kishte përfunduar procesi i shpërndarjes së materialit zgjedhor pranë KQV-ve.

Referuar situatës konkrete në Zonën Zgjedhore nr.15, ka rezultuar që deri në orën 16.00 të datës 20.06.2015, nga KZAZ nr.15 nuk kishte përfunduar ende emërimi i anëtarëve të KQV-ve në juridiksionin e asaj KZAZ-je, si dhe ende nuk kishte filluar shpërndarja e materialit zgjedhor në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 100 të Kodit Zgjedhor, ndërkohë që KZAZ, sic rezulton edhe nga libri i protokollit të mbledhjeve, vijonte veprimtarinë e tij me shqyrtimin e kërkesave të paraqitur nga subjekti zgjedhor PD për zëvendësimin e komisionerëve të qendrave të votimit përkundër

edhe vendimmarrjes së saj (vendimit unanimit të datës 19.06.2015) për shpërndarjen e materialeve zgjedhore ne date 20.06.2015, nga ora 10.00 deri në ora 17.00, c'ka e ka detyruar KQZ-në që, fillimisht, të përcaktojë një afat limit për emërimin e anëtarëve të KQV-ve (brenda orës 18.30) dhe fillimin e procesit të shpërndarjes së materialit zgjedhor (brenda orës 19.00), nëpërmjet Vendimit Nr.712, datë 20.06.2015.

Mbi bazën e informacioneve zyrtar të referuara nga inspektori rajonal i Qarkut Lezhë (i caktuar prej saj) se ende, në mospërbushje jo vetëm të detyrimeve ligjore por edhe të afatit të përcaktuar nga KQZ me vendimin e sipërcituar, nga KZAZ-ja nr.15 nuk ishin emëruar komisionerët e qendrave të votimit dhe se, shkak për këtë situatë të krijuar ishin bërë anëtarët e KZAZ të emëruar më propozimin e subjekteve zgjedhore, Partia Demokratike dhe Partia Republikane, se mos emërimi i komisionerëve jo vetëm që përbënte shkelje të përcaktimeve të nenit 33/a,b të Kodit Zgjedhor, por pamundësonte dhe respektimin e afatit ligjor të përcaktuar në nenin 99/1 të Kodit Zgjedhor, për shpërndarjen e bazës materiale zgjedhore, KQZ, në ushtrim të kompetencave të saj *për drejtimin dhe kontrollin e procesit zgjedhor, emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të KZAZ-së duke i mbikëqyrur në përmbushjen e detyrave të tyre, (shkarkimi i anëtarëve të KZAZ-së në rastet kur shkelin dispozitat ligjore në lidhje me detyrat që u ngarkohen, mund të shkarkohen kryesisht nga KQZ sipas parashikimit të nenit 32/3 të Kodit Zgjedhor)*, me vendimin nr.716, datë 20.06.2015, ka vendosur të shkarkojë nga detyra kryetarin dhe anëtarët e KZAZ nr.15, Qarku Lezhë, Islam Ismaili dhe anëtarët Edona Velia e Hajredin Ismaili propozuar nga Partia Demokratike dhe Eduard Kurti të propozuar nga Partia Republikane, nderkohe që iu ka kerkuar Partise Demokratike dhe Partise Republikane të dorëzojnë propozimet për plotësim të vakancave brenda orës 21.30, të datës 20.06.2015. Me tej, me vendimin nr.720, datë 20.06.2015, KQZ ka vendosur të emërojë kryetar të KZAZ nr.15 Gjovalin Laskaj dhe anëtarë Gentian Mehmeti e Ornela Bibaj sipas propozimeve të PD dhe Esat Cakoni sipas propozimit të PR. Gjithashtu, në këtë vendim, KQZ ka urdhëruar KZAZ nr.15 të fillonte, brenda orës 24.00, shpërndarjen e bazës materiale zgjedhore.

Ndërkohë në afatin limit të ditës parazgjedhore, rreth orës 24.00 të datës 20.06.2015, KQZ ka marrë në shqyrtim përsëri situatën në ZAZ nr.15, bazuar në informacionin zyrtar të sjellë nga inspektori rajonal i Qarkut Lezhë, i cili ka referuar faktin që ende nga KZAZ nr.15 nuk ishin emëruar anëtarët e qendrave të votimit të kësaj zone zgjedhore dhe, për pasojë, as nuk kishte filluar procesi i shpërndarjes së materialeve zgjedhore në qendrat e votimit, ku shkak për këtë ishin bërë perseri anëtarët e emëruar se fundi. Ne kete rast, KQZ, me vendimin Nr.726, marrë pas hyrjes në ditën zgjedhore datë 21.06.2015 (sic rezulton nga procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ), bazuar në nenet 23/1-a, 29/1-8, 32/1-a të Kodit Zgjedhor, ka vendosur (me unanimitet) t'i shkarkojë anëtarët e KZAZ të emëruar se fundi prej saj, duke emëruar në detyrën e anëtarit të KZAZ-së nr.15 z.Fran Nezha (jo më mbi bazën e propozimeve të forcave politike), duke u identifikuar ky prej administratës së KQZ si një nga personat që plotësonte kërkesat ligjore për të ushtruar detyrën e anëtarit të KZAZ dhe që kishte depozituar kërkesën dhe dokumentacioni përkatës pranë saj sipas shpalljes publike të KQZ te datës 14 mars 2015.

Pala paditëse pretendon në paligjshmërinë e ndërhyrjes së KQZ-së në veprimtarinë e KZAZ nr.15, në kushtet kur kjo e fundit ishte në detyrë dhe në ushtrim të funksioneve të veta, duke u penguar veprimtaria norma1e e saj (KZAZ-së), e shkarkuar padrejtësisht, brenda 2 orësh, anëtarët e saj nëpërmjet vendimeve nr.716 date 20.06.2015 dhe nr.726 date 20.06.2015 të KQZ, me të cilët sipas saj është ndërhyrë në mënyrë të dhunshme, të kundraligjshme dhe të papër1igjur për shkarkimin e anëtarëve të KZAZ të propozuar nga opozita par1amentare (e ci1a gëzonte shumicën në këtë komision), duke prishur ba1ancat e përfaqësimit dhe në kundërshtim me parashikimet e nenit 29, paragrafi 1 dhe 8, të Kodit Zgjedhor, deformim ky që sipas saj ka sjellë pasoja të rënda, duke i shtuar paligjshmëri cdo hapi të procesit të administrimit zgjedhor ditën e zgjedhjeve si dhe të numërimit e tabulimit të rezultatit zgjedhor më vonë.

Në nenin 29 të Kodit Zgjedhor, "Përbërja e KZAZ-së", parashikohet formula/jepen modalitetet për emërimin e anetareve dhe formimin e KZAZ-ve që, si rregull, realizohet nëpërmjet propozimeve të

subjekteve zgjedhore (që gëzojnë cilësitë e shumicës e pakicës parlamentare), duke u krijuar baraspeshim pozitë-opozitë.

Ndërkohë, si përjashtim nga ky rregull, në këtë dispozitë parashikohet e drejta e KQZ që të emërojë kryesisht anëtarin/anëtarët e KZAZ-zë deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve të KZAZ-së për vendimmarrje, të cilët mund të qëndrojnë në detyrë deri në emërimin sipas propozimit të subjektit zgjedhor/partisë politike që i përket e drejta e propozimit.

Referuar rastit konkret, rezulton që KQZ, në situatën kur anëtarët e KZAZ nr.15 nuk po përmbushnin detyrimet e tyre të rrjedhura nga Kodi Zgjedhor për formimin e KQV (emërimin e anëtarëve të tyre), si dhe shpërndarjen e materialit zgjedhore në kuadër të administrimit e zhvillimit të zgjedhjeve në atë ZAZ (detyra të KZAZ të parashikuara në nenin 33 të Kodit Zgjedhor), pasi më parë nëpërmjet vendimmarrjeve të saj kishte bërë të mundur respektimin e rregullit të parashikuar nga neni 29/1 i Kodit Zgjedhor, KQZ, me vendimin Nr.726, marrë pas hyrjes në ditën zgjedhore datë 21.06.2015, bazuar në nenet 23/1-a, 29/1-8, 32/1-a të Kodit Zgjedhor, ka vendosur (me unanimitet) t'i shkarkojë anëtarët e KZAZ të emëruar se fundi prej saj që nuk përmbushnin detyren, duke emëruar kryesisht në detyrën e anëtarit të KZAZ-së nr.15, z.Fran Nezha dhe bere te mundur keshtu plotësimin e numrit te nevojshem te anëtarëve te kesaj KZAZ per vendimmarrje.

Kolegji Zgjedhor vlerëson që, në situatën e krijuar në ZAZ nr.15 si pasojë e mosfunksionimit rregullisht të KZAZ së kesaj zone, referuar sa mësipër, "ndërrhyrja"/veprimtaria e KQZ-së ka qenë jo vetëm e arsyeshme, e përligjur dhe imponuar nga rrethanat konkrete, por edhe në ushtrim të kompetencave të saj të ngarkuara/dhënë nga Kodi Zgjedhor, për drejtimin dhe kontrollin e procesit zgjedhor.

Pala paditëse ka konsideruar se shkeljet e rënda janë si pasojë e vendimmarrjeve nr.716 dhe nr.726 të KQZ që, sipas saj, janë marrë në mosrespektim të parashikimeve të nenit 29/1-8 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor vlerëson të theksojë se, përsa i përket kundërshtimit të vendimeve nr.720 dhe nr.726 të KQZ, që sipas pales paditese

kanë qenë edhe premiset e paligjshmerisë në procesin zgjedhor në këtë ZAZ, këto vendime nuk rezultojn të jenë ankimuar në afatin e parashikuar nga neni 152 i Kodit Zgjedhor dhe, për më tepër, nuk konstatohet ndonjë shkak pavlefshmërie absolute në këtë vendimmarrje të KQZ, ndonje prej rasteve të parashikuara nga neni 116 i Kodit Procedurave Administrative, që do të bënte marrjen në konsideratë të pavlefshmërisë absolute në cdo kohë, edhe përtej afatit të përcaktuar në nenin 152 të Kodit Zgjedhor.

Referuar parashikimeve të nenit 116 të Kodit Procedurave Administrative, aktet administrative quhen absolutisht të pavlefshme në rastet “a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar; b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencës së tij ligjore; c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.”.

Vendimet nr.720 dhe nr.726 të KQZ nuk janë akte absolutisht të pavlefshme pasi : janë nxjerrë nga organi i identifikuar administrativ (KQZ), organ ky i njohur nga ligji si organi kompetent për nxjerrjen e akteve në veprimtarinë e administratimit të procesit zgjedhor; janë nxjerrë nga organi administrativ (KQZ) brenda kufijve të kompetencave të tij që i janë dhënë nga Kodi Zgjedhor, në referim të nenit 21; aktet janë marrë në mbledhje publike të organit administrativ (KQZ) pas dëgjimit të palëve, duke respektuar kuorumin e nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes dhe për marrjen e vendimit, në referim të neneve 22, 23, 24 të Kodit Zgjedhor.

Nëse plotesimi nga KQZ, ditën e zgjedhjeve, të numrit të nevojshëm të anetareve të kësaj KZAZ për vendimmarrje është realizuar nepërmjet emerimit kryesisht të një anetari të saj, duke mos ruajtur atë balance në përzierje të KZAZ që përcaktohet në paragrafin e parë të nenit 29 të Kodit Zgjedhor për administrimin e procesit zgjedhor, ky mosbalancim, ndryshe nga sa pretendohet, është rrjedhojë e zbatimit korrekt të ligjit nga KQZ, përse kohe ligji, duke konsideruar prioritar realizimin e procesit zgjedhor, pra vëne në themel interesin publik për të patur zgjedhje, i ka dhënë KQZ kompetencë që, në kushtet e urgjencës, të emerojë kryesisht, përkohejisht, numrin e nevojshëm të anetareve të KZAZ për vendimmarrje, ndërkohe që, pas këtij momenti të emerimit kryesisht të anetarit të KZAZ në rastin

konkret, pavaresisht kontestimeve verbale, nuk ka asnjë ndërmarrje/veprim nga subjekti politik që i takon e drejta për propozim të anëtarit/ anëtareve respektiv të kësaj KZAZ, c'ka, në mungesë të një veprimi ndryshe, nënkupton pajtim me ato përberje të KZAZ. Për Kolegjin Zgjedhor është e papranueshme që në mungesë të ushtrimit të të drejtave që Kodi Zgjedhor përcakton për subjektet politike në lidhje me formimin e KZAZ/emerimin e anëtareve të saj, këto të fundit të kontestojnë përberjen e KZAZ pas perfundimit të procesit zgjedhor, nxjerrjes dhe tabulimit të rezultatit, tashmë jo mbi baze pretendimesh për paligjshmëri të vendimeve apo mosmarrjes së vendimeve nga KQZ, por mbi pretendime për pavlefshmëri absolute të vendimeve të KQZ. Është e qartë se nepermjet ankimeve zgjedhore në lidhje me formimin e KZAZ Kodi Zgjedhor synon të rikuperojë mangësitë apo paligjshmeritë e manifestuara për të rivendosur në ligjshmëri procesin, por jo të zhbërë procesin zgjedhor.

Si shkelje të rëndë, nga pala paditëse në formimin e KZAZ-së nr.15, është referuar edhe emerimi nga KQZ të anëtarit z.Fran Nezha që, sipas palës paditëse, është një eksponent i njohur i Partisë Socialiste në zonën përkatëse zgjedhore, i cili ka dalë dhe në fushatë sëbashku me kandidatin për kryetar bashkie të asaj zone zgjedhore.

Referuar akteve, rezulton që ky anëtar është emëruar nga KQZ kryesisht, jo më mbi bazën e propozimeve të forcave politike, por duke u identifikuar prej administratës së KQZ-së si një nga personat që plotësonin kërkesat ligjore për të ushtruar detyrën e anëtarit të KZAZ dhe që kishte depozituar kërkesën dhe dokumentacionin përkatës pranë saj sipas shpalljes publike të KQZ të datës 14 mars 2015.

Kushtet e papajtueshmërisë me detyrën e anëtarit të KZAZ përcaktohen në nenin 30 të Kodit Zgjedhor, që parashikon se *“Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së nuk mund të jenë : a) deputetë ose kandidatë për deputetë në Kuvend; b) kryetarë të bashkive; c) ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror; ose ç) anëtarë apo sekretarë të një komisioni tjetër zgjedhor”*, nderkohe që në rastin konkret anëtari i emëruar kryesisht nga KQZ nuk rezulton të ketë qene në kushte të tilla papajtueshmërie me funksionin që ai është caktuar.

Përvec kesaj, rezulton që anëtari i KZAZ nr.15 i emeruar kryesisht nga KQZ të plotësojë kushtet e parashikuara në nenin 31 të Kodit Zgjedhor për emërimin e tij si anëtar i asaj KZAZ, përfshirë dhe atë të qenit banor i kësaj zone zgjedhore, sikundër dhe i trajnuar, sipas konstatimit të administratës së KQZ e që kishte paraqitur kërkesë që në muajin mars 2015, pas shpalljes publike të bërë nga KQZ për rekrutimin e trajnuesve për zgjedhjet e 21 Qershorit 2015.

Pala paditëse, edhe pse ka kontestuar verbalisht emërimin kryesisht nga KQZ të këtij anëtari të KZAZ nr.15, nuk rezulton të ketë ushtruar të drejtën e saj të propozimit sic parashikon neni 29/5 i Kodit Zgjedhor, ndërkohë që anëtarët e emeruar kryesisht qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e anëtarëve përkatës sipas propozimit nga partia politike që i perket kjo e drejte.

Si shkelje e rëndë gjatë këtij procesi zgjedhor në këto zone zgjedhore me pasojë pavlefshmërinë e vendimmarrjes së KZAZ-së nr.15, pala paditëse ka parashtruar edhe faktin që, anëtarja e KZAZ znj.Majlinda Cara, e zgjedhur rregullisht edhe në detyrën e nënkryetares së kesaj KZAZ, është gjendur në konflikt interesi sipas parashikimit të nenit 32/2-a të Kodit Zgjedhor, në rrethanat kur ka patur bashkëshortin Vladimir Cara kandidat në listën shumëmemërore të subjektit zgjedhor PS për anëtar të Këshillit Bashkiak Kurbin.

Referuar rrethanave konkrete, marrë në konsideratë faktin (që nuk është kontestuar nga palët) që vendimmarrja e KZAZ-së nr.15 është realizuar me votat e katër anëtarëve përfshirë këtu edhe votën e anëtares Majlinda Cara, Kolegji Zgjedhor, ndryshe nga sa pretendon pala paditëse, vlerëson se shkak i pretenduar nuk prodhon pavlefshmëri të zgjedhjeve në të gjitha qendrat e votimit të kesaj zone zgjedhore me pasojë përsëritjen e tyre sikurse kërkon pala paditëse në referim të nenit 161 të Kodit Zgjedhor.

Në këto rast vlen të evidentohet fakti se znj.Majlinda Cara është emëruar si anëtare e KZAZ nr.15 që me ngritjen e kësaj KZAZ, nepërmjet emerimit të anëtareve të saj me Vendimin e KQZ Nr.133, datë 13.04.2015, ndërkohë që ajo është emeruar si nënkryetare e kesaj KZAZ me Vendimin e KQZ Nr.154, datë 15.04.2015. Mbas emerimit në detyrën e anëtares së KZAZ nr.15 dhe, me pas, edhe atë në nënkryetares së kesaj KZAZ, znj.Majlinda Cara ka ushtruar

rregullisht kete detyre perfshire dhe ne mbledhjen e kesaj KZAZ te dates 06.05.2015, kur, nepermjet vendimeve respektive, KZAZ nr.15 ka regjistruar kandidatet per kryetar te Bashkise Kurbin, ashtu sikunder dhe listat shumemërore te subjekteve zgjedhor per kandidatet per anetare te Keshillit Bashkiak Kurbin, nder to, edhe te subjektit zgjedhor PS (sipas Vendimit nr.29, date 06.05.2015), liste shumemërore e ketij subjekti zgjedhor ku ne numrin rendor "6" te kësaj liste si kandidat pasqyrohet emri i shtetasit Vladimir Cara, i cili, sipas pales paditese, eshte dhe bashkëshorti i anetares se KZAZ nr.15 znj.Majlinda Cara. Nderkohe, ndersa nuk kontestohet, pranohet se, referuar nenit 73/3 te Kodit Zgjedhor, lista shumemërore e subjektit zgjedhor PS per kandidatet per anetare te Keshillit Bashkiak Kurbin, sikunder dhe listat shumemërore te subjekteve te tjere zgjedhor, jane publikuar rregullisht. Me tej, rezulton se qenia anetare e KZAZ nr.15 e znj.Majlinda Cara nuk eshte kontestuar asnjehere nga ndonje prej subjekteve zgjedhore, aq me pak nga ana e tyre te jete iniciuar ndonje procedure per lirimin e saj mbi shkakun e qenies se saj ne konflikt interesi per faktin e ekzistences se nje marrredhenie te afert familjare midis saj si anetare e KZAZ nr.15 me nje nga kandidatet e listes shumemërore per kandidatet per anetare te Keshillit Bashkiak Kurbin te nje prej subjekteve zgjedhore garues ne kete zone zgjedhore. Vetem pas perfundimit te procesit te votimit, nxjerrjes dhe tabulimit te rezultatit per kete zone zgjedhore, subjekti zgjedhor PD, ne ankimin zgjedhor te paraqitur kunder Vendimit nr.415, date 25.06.2015, te KZAZ nr.15, per miratimin e tabelës permbledhese te rezultatit per zgjedhjen e Keshillit Bashkiak Kurbin.

Sipas nenit 32/2 të Kodit Zgjedhor, "*Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së lirohen nga detyra me vendim të KQZ-së kur: a) kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë; b) janë në marrëdhënie pune me ndonjërin prej kandidatëve të përfshirë në listën shumemërore të një partie apo koalicioni që konkurron në zonë; c) nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës; ç) nuk kanë më vendbanimin e tyre në zonën zgjedhore; d) subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre*".

Ndersa, sipas nenit 2/11 te Kodit Zgjedhor, "*Marrëdhënie krushqie e afërt*" është lidhja e krushqisë midis anëtarit të komisionit dhe

kandidatit, ku njëri prej tyre është prind i bashkëshortit ose bashkëshortes së tjetrit apo motër ose vëlla i bashkëshortit ose bashkëshortes, apo bashkëshort i motrës së bashkëshortes ose të bashkëshortit apo bashkëshorte e vëllait të bashkëshortes ose të bashkëshortit”.

Kurse, sipas nenit 32/3 te Kodit Zgjedhor, “Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së lirohen/shkarkohen nga detyra nga KQZ-ja, kryesisht ose me propozim të subjekteve zgjedhore, vetëm për shkaqet e parashikuara në këtë nen. Në çdo rast, kërkesa për lirim ose shkarkim duhet të përmbajë edhe argumente dhe fakte për shkeljen e pretenduar. Në rastin e parashikuar në shkronjën “d” të pikës 2 të këtij neni ky rregull nuk zbatohet dhe kërkesa pranohet në çdo rast”.

Nga sa rezulton, duket qe ligjvenesit te jete kujdesur per te shmangur konfliktin e interesit midis nje anetari te KZAZ me ndonjeren prej kandidateve qe konkurrojne ne nje zone zgjedhore, duke percaktuar si shkak lirim nga detyra ekzistencen e “marredhenies se afert te krushqise” apo “marredhenies se gjinise deri ne shkalle te katert”. Me tej, ndersa ka percaktuar definicionin e “marredhenies se afert te krushqise”, Kodi Zgjedhor ka heshtur persa i perket definicionit te “marredhenies se gjinise deri ne shkalle te katert”. Nga ana tjetere, ne legjislacionin shqiptar nuk gjendet nje perkufizim i lidhjes gjinore, por se, referuar dispozitave te Kodit Civil dhe Kodit te Familjes, gjinia percaktohet si lidhja prej gjaku qe krijohet midis dy apo me shume personave qe rrjedhin ose njeri pas tjetrit, ne vijet e drejte (gjyshi, ati, femija, nipi, femija i nipit, etj.), ose prej nje te paralinduri te perbashket, ne vijet e terthortet (vëllezërit e motrat ndërmjet tyre, ungi/emta dhe femijet e vëllezërve e të motrave, këta të fundit ndërmjet tyre, etj), nderkohe qe shkalla perfaqeson distancen ndermjet dy apo me shume personave qe kanë bazë lidhje gjinore, ku numri i shkallës tregon afërsinë ndërmjet dy apo me shume personave qe janë në gjini.

Pra, nga sa rezulton, ndersa ligjvenesit eshte kujdesur posacerisht per te shmangur konfliktin e interesit midis nje anetari te KZAZ me ndonjeren prej kandidateve qe konkurrojne ne nje zone zgjedhore, duke percaktuar si shkak lirim nga detyra te anetarit te KZAZ ekzistencen mes tyre te “marredhenies se afert te krushqise” apo te “marredhenies se gjinise deri ne shkalle te katert”, nuk ka bere

nje gje te tille persa i perket “marredhenies familjare te lindur nga martesesa mes bashkeshorteve”.

Ne interpretim literal te nenit 32/2-a te Kodit Zgjedhor, duket sikur ligjvenesit te mos kete konsideruar si shkak lirimi nga detyra ekzistencen e konfliktit te interesit per arsye te marredhenieve familjare si bashkeshort midis nje anetari te KZAZ me ndonjër in prej kandidatëve qe konkurrojnë ne nje zone zgjedhore. Ne kete kuptim, pretendimi i pales paditese nuk gjen mbështetje formale ne kete dispozite.

Por, nen frymen e ligjit, mbi nje interpretim logjik dhe te zgjeruar te normes, duke patur ne konsiderate qe ligjvenesit ka konsideruar si shkak lirimi nga detyra ekzistencen e konfliktit te interesit te nje anetari te KZAZ referuar marredhenieve te tilla ligjore (marredhenieve te krushqise) me ndonjër in prej kandidatët qe konkurrojnë ne nje zone zgjedhore qe jane me te largeta apo jo aq te forta (qofte shpirtore ashtu dhe materiale) se sa marredheniet familjare mes bashkeshortëve, Kolegji Zgjedhor cmon se nje marredhenie e tille, ajo familjare mes bashkeshortëve, duhet te klasifikohet si shkak per lirimin nga detyra te nje anetari te KZAZ.

Por, megjithatë, mbi nje interpretim te tille te normes (nenit 32/2-a te Kodit Zgjedhor), ndersa duket qe pala paditese te kete te drejte ne pretendimin e ngritur, Kolegji Zgjedhor cmon se nje pretendim i tille calon pasi nuk merr ne konsiderate faktin qe ligji, Kodi Zgjedhor, ne dispoziten ne fjale përcakton si shkak lirimi nga detyra te nje anetari te KZAZ kur ai ka lidhje (“marredhenie te aferta krushqie”, “marredhenie gjinie deri ne shkalle te katert” apo me interpretim dhe “marredhenie familjare te lindur nga martesesa mes bashkeshortëve”) me ndonjër in prej “kandidateve qe konkurrojnë ne nje zone zgjedhore”.

Referuar sistemit zgjedhor te adoptuar ne Kodin Zgjedhor, zgjedhja e organit te qeverisjes vendore te kryetarit te bashkise realizohet sipas sistemit mazhoritar, sipas te cilit kandidati per kryetar bashkie konkurron dhe votohet drejtpërdrejt nga zgjedhesit duke u klasifikuar dhe si subjekt zgjedhor (me te drejta dhe detyrime te përcaktuara nga ligji). Nga ana tjetër, zgjedhja e organit te qeverisjes vendore te këshillit te bashkise realizohet sipas sistemit proporcional,

sipas te cilit kandidatet per anetare këshilli bashkie ne nje zone zgjedhore nuk jane ata qe konkurrojne, përkundrazi, per kete organ te qeverisjes vendore konkurrojne subjektet politike/partite politike te regjistruara si subjekte zgjedhore, ku zgjedhesit votojne partite politike dhe ne baze te numrit te votave te fituara prej tyre ato marrin/ fitojne nje numer te caktuar mandatesh, te cilat me pas iu përkasin/ shpërndahen kandidateve te tyre sipas listave shumemërore.

Pra, per zgjedhjen e organit te qeverisjes vendore te këshillit te bashkise nuk kemi kandidate qe konkurrojne ne nje zone zgjedhore. Per rrjedhoje, edhe mbi nje interpretim logjik dhe te zgjeruar te nenit 32/2-a te Kodit Zgjedhor, pretendimi i pales paditese gjendet i pabazuar ne ligj.

Ne vijim, edhe duke pranuar per nje moment se ne rastin konkret ka ekzistuar nje shkak ligjor per lirimin nga detyra te anetares se KZAZ nr.15 znj.Majlinda Cara apo skualifikimin e saj nga vendimmarrjet e kësaj KZAZ pas dates 06.05.2015, ajo rrethane faktike nuk eshte bere prezent ne mbledhjet e kësaj KZAZ te mbas kësaj date, por dhe as ka shërbyer per subjektet zgjedhore te interesuara, per te iniciuar nje procedure per lirimin e saj nga detyra. Duket qe, pavarësisht qenies publike dhe te njohura te atyre rrethanave faktike, subjektet zgjedhore, ndersa nuk kane kontestuar sipas ligjit, jane pajtuar me qenien ne perberjen e KZAZ nr.15 edhe te znj.Majlinda Cara. Ne kete kuptim, sikundër dhe me lart u parashtua, per Kolegjin Zgjedhor eshte e papranueshme qe ne mungese te ushtrimit te te drejtave qe Kodi Zgjedhor përcakton per subjektet politike ne lidhje me perberjen e KZAZ, keto te fundit te kontestojne ate pas perfundimit te procesit zgjedhor, nxjerrjes dhe tabulimit te rezultatit, tashme jo mbi baze pretendimesh per paligjshmëri te vendimeve apo mosmarrjes se vendimeve nga KZAZ, por mbi pretendime per pavlefshmëri absolute te vendimeve te KZAZ.

Me tej akoma, duke vijuar me pranimin per nje moment se ne rastin konkret ka ekzistuar nje shkak ligjor per lirimin nga detyra te anetares se KZAZ nr.15 znj.Majlinda Cara apo skualifikimin e saj nga vendimmarrjet e kësaj KZAZ pas dates 06.05.2015, pra ka ekzistuar per te nje pengese ligjore per te marre pjese ne proceset e vendimmarrëse te kësaj KZAZ ne ditën e zgjedhjeve, te dates 21 qershor 2015, pra ne mbledhjet e jashtëzakonshme te kësaj date,

ndersa ajo nuk ishte skualifikuar/përrjashtuar nga vendimmarrja (qofte mbi kerkese te saj apo te cdo subjekti te interesuar), si dhe kur sipas ligjit (kodit Zgjedhor) i ndalohej te abstenonte, anetarja ne fjale e kësaj KZAZ ka qene ne kushtet e detyrimit ligjor, sipas nenit 39 te Kodit te Procedurave Administrative, per te ushtruar kompetencat e saj referuar situates emergjente qe kërkonte domosdoshmerisht ndërhyrjen e KZAZ per te mundësuar realizimin e procesit te votimit te asaj dite ne ate zone zgjedhore (ngritjen e komisioneve te votimit, krijimin e grupeve te numërimit dhe shpërndarjen e materialeve zgjedhore), nderkohe qe veprimet e saj me pas jane ratifikuar nga organi me i larte i administrimit te zgjedhjeve. Vlen te theksohet se vendimmarrjet e kësaj date te KZAZ nr.15, nuk jane kontestuar sipas ligjit (Kodit Zgjedhor) nga asnjë prej subjekteve zgjedhore.

Duke vijuar akoma me pranimin per nje moment se ne rastin konkret ka ekzistuar nje shkak ligjor per lirim nga detyra te anetares se KZAZ nr.15 znj.Majlinda Cara apo skualifikimin e saj nga vendimmarrjet e kësaj KZAZ pas dates 06.05.2015, referuar shkeljes se pretenduar te ligjit nga pala paditese, pra qenies pjese e vendimmarrjes se kësaj KZAZ edhe te anetares ne fjale, si dhe referuar natyres se vendimeve te kësaj KZAZ per rastin ne fjale, qe ka konsistuar ne shpërndarjen e materialeve zgjedhore, si dhe formimin e organit te administrimit te zgjedhjeve per cdo qender votimi brenda territorit te kësaj zone zgjedhore, sikundër dhe ngritjen e strukturave, grupeve te numërimit te votave, pra ne asnjë rast me ndonje vendimmarrje qe lidhet drejtperdrejte me bashkëshortin e saj, Kolegji Zgjedhor cmon se ne rastin konkret nuk vërtetohet se ne ZAZ nr.15 te kene ndodhur shkelje të tilla te ligjit të cilat te kenë cënuar rende procesin zgjedhor ne kete zone zgjedhore apo qe te kene ndodhur disa shkelje te ligjit, teresia e te cilave te kete cënuar procesin zgjedhor në masë të tillë që kanë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve ne kete zone zgjedhore.

Vlen te permendet se në nenin 161/5 të Kodit Zgjedhor parashikohet se “Perseritja e zgjedhjeve urdhërohet ne te njëjtin vendim te KQZ-se, qe i shpall ato te pavlefshme. Zgjedhjet për këshillat e qeverisjes vendore nuk përsëriten”, parashikim ky që është bërë në Kodin Zgjedhor aktual (një parashikim i tillë nuk gjendet në Kodin Zgjedhor të shfuqizuar) dhe ligjvënësi nëpërmjet këtij përcaktimi ka përrjashtuar përsëritjen e zgjedhjeve për këshillat e qeverisjes

vendore, përfshirë edhe pavlefshmërinë e vendimmarrjeve të KZAZ që mund të prodhohet për shkak të konfliktit të interesit në referim të neneve 32/2-a dhe 35/2 të Kodit Zgjedhor. Në rrethanat që : konflikti i interesit i anëtarës në fjale të KZAZ nr.15 rrjedh dhe lidhet me procesin zgjedhor për këshillin e bashkisë, proces ky që edhe në eventualitet të pasojës në vendimmarrjet perkatese të KZAZ nuk mund të passjellë përsëritjen e zgjedhjeve për këte këshill të qeverisjes vendore; procesi zgjedhor për këshillat e qeverisjes vendore e procesi zgjedhor për zgjedhjen e kryetarëve të bashkisë nuk paraqesin një marrëdhënie të pandashme në aspektin zgjedhor; Kolegji Zgjedhor vlerëson që, konflikti i interesit në rastin konkret nuk mund të sjellë pavlefshmërinë e zgjedhjeve për kryetar të bashkisë me pasojë përsëritjen e tyre, përse kohë që ky konflikt i interesit nuk e sjell një pasojë të tillë për procesin zgjedhor prej nga rrjedh e lidhet, pasi në të kundërt ai (konflikti i interesit) do të mund të sillte pasojë tej kufijve të konfliktit për të cilin është parashikuar nga ligjvënësi.

Në vijim të arsyetimit të mësipërm, nuk gjendet i bazuar kërkim i palës paditëse që edhe vetëm për këtë shkak, pavlefshmëria e zgjedhjeve në atë zonë zgjedhore më pasojë përsëritjen e tyre.

Për pasojë edhe pretendimet për shkelje të rënda, referuar pavlefshmërisë absolute të vendimmarrjes së KZAZ-së në vijim të procesit të administrimit dhe zhvillimit të procesit zgjedhor në atë zonë zgjedhore, nuk mund të merren parasysh.

Është referuar si shkelje nga pala paditëse që, procesi i shpërndarjes së materialeve zgjedhore është realizuar duke mos u plotësuar asnjë dokumentacion, në kundërshtim me parashikimet e nenit 100 të Kodit Zgjedhor, një pjesë e këtij dokumentacioni është plotësuar në mënyrë fiktive pas përfundimit të procesit zgjedhor dhe se janë emëruar anëtarë kryesisht të KQV-ve, identiteti i të cilëve, kriteret dhe modalitete të emërimit të tyre nuk janë të njohura.

Nga provat e administruara në këtë gjykim nuk mund të tërhiqet konkluzioni në të provuarit e faktit që dokumentacioni për shpërndarjen e materialit zgjedhor është plotësuar në mënyrë fiktive, ndërkohë që anëtarët e KQV-ve të emëruar kryesisht rezultojnë të jenë identifikuar nga një listë e komisionereve të të trajnuar nga KQZ-ja, sic rezultojnë edhe nga procesverbali i mbledhjes ku gjen

pasqyrim kjo vendimmarrje e KZAZ (faqe 38 e librit prokollit të mbledhjeve të KZAZ nr.15).

Ndërkohë është parashtruar nga pala paditëse që në votimin e kryer në atë zonë zgjedhore janë lejuar shkelje që referojnë në votim familjar, votim të hapur, votim në emër të personave të tjerë, votim i personave jo pjesë e listës shumëemërore të zgjedhësve, por se nuk identifikohen raste se në cilat qendra të votimit c'ka është e rëndësishme në vlerësimin për ekzistencën e shkeljes së rëndë apo të ndikimit të këtyre shkeljeve në ndarjen e mandateve në atë zonë zgjedhore, që kërkon dhe përcaktimi i nenit 160/1-a i Kodit Zgjedhor.

Pretendimet e palës paditëse për shkelje gjatë procesit të numërimit të votave e tabulimit të rezultateve në zonën zgjedhore, proces ky që tashmë nuk realizohet më në qendrën e votimit, janë pretendime që mund të themelohen në kuadrin e një ankimi zgjedhor për rinumërim apo rivlerësim të votave, sipas parashikimeve të neneve 116, 177 e vijues të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor konstaton që procesi i votimit në atë zonë zgjedhore nuk është zhvilluar në rrjedhën normale të një procesi zgjedhor sipas parashikimeve të të Kodit Zgjedhor, duke u shoqëruar ai me parregulli/shkelje, që lidhen me vijueshmërinë e fazave të procesit zgjedhor në afatet e parashikuara, por se këto nuk rezultoi të ngriheshin në nivelin e shkeljeve të rënda apo të shkeljeve më pasojë në ndarjen e mandateve në zonë zgjedhore, që do të kondiciononte pavlefshmëri me pasojë përsëritjen e zgjedhjeve për kryetar të bashkisë, ndërkohë që në nuk mund të passillte pavlefshmëri me pasojë përsëritjen e zgjedhjeve për këshillin e qeverisjes vendore/ këshillin bashkiak, për shkak të ndalimit të parashikuar në nenin 161/5 të Kodit Zgjedhor.

Në analizë sa më sipër, Kolegji Zgjedhor konkludon që kërkesëpadia nëpërmjet së cilës është kërkuar shpallja e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Bashkia Kurbin, duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë,
bazuar në nenin 158, pika 3 dhe 4, të Kodit Zgjedhor të ndryshuar,

V E N D O S I

1. Rrëzimin e kërkesës padisë.

Tiranë, më 10.07.2015

**ANËTAR
GJINOVEFA GABA**

**ANËTAR
ANDI CIVICI**

**KRYESUES
VALBON ÇEKREZI**

**ANËTAR
KLITON SPAHIU**

**ANËTAR
PETRIT ÇENO**

* *
* *



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**NR. 33 REGJ. THEMELTAR
DATË 15.07.2015 REGJ.**

**NR. 33 VENDIMI
DATË 20.07.2015 VENDIMI**

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

**KRYESUES : Fuat VJERDHA
ANËTAR : Petrit ÇENO**

ANËTAR : Valbon ÇEKREZI
ANËTAR : Kliton SPAHIU
ANËTAR : Gjinovefa GABA

Me sekretare seance Rexhina Baci, shqyrtoi sot në datë 20.07.2015 në seancë gjyqësore publike, mosmarëveshjen me palë ndërgjyqëse:

PADITËS: **Vlora Channel Televizion**, i përfaqësuar nga administratori Erven Hyseni, i asistuar nga av. Lorena Troka

I PADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, Tiranë, i përfaqësuar nga juristi Olsi Peto, i pajisur me autorizimin e datës 20.07.2015, me nr. prot. 7314.

ME OBJEKT: Kundërshtimi i vendimit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve nr. 650, datë 15.06.2015 “Për shqyrtimin e raportit të bordit të monitorimit të medias për datën 22.05.2015 deri në datën 13.06.2015”

BAZA LIGJORE: Neni 32/a, 154/a e vijues të K.Pr.Civile. Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, i azhornuar me ligjin nr. 74/2012, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS APELIT TIRANË

Pasi vuri në diskutim ceshtjen e kompetences lendore te Kolegjit Zgjedhor te Gjykeses se Apelit Tirane per shqyrtimin e ceshtjes; degjoi palët prezent, perfaqesuesen e pales paditese dhe perfaqesuesin e pales se paditur, qe u shprehen se kompetenca lendore per shqyrtimin e ceshtjes i perkiste Kolegjit Zgjedhor te Gjykeses se Apelit Tirane,

VËREN

Me Dekretin Nr.8844, datë 15.12.2014, në mbështetje të neneve 92/gj dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 9§1§2 dhe 10§1§2 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Presidenti i Republikës së Shqipërisë ka caktuar datën 21 qershor 2015

per zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Në përputhje me parashikimet e nenit 85 të Kodit Zgjedhor, nga KQZ-ja është ngritur Bordi i Monitorimit të Medias(në vijim BMM), i cili ka paraqitur raportin mbi monitorimin e medias për periudhën kohore 22.05.2015- 19.06.2015. KQZ-ja pasi ka shqyrtuar këtë raport, mbështetur në propozimet e BMM-së, me vendimin nr. 650, datë 15.06.2015 ka vendosur sanksionin administrativ me gjobë në vlerën 2(dy) milion lekë për operatorin televiziv Vlora Channel.

Ky vendim është marrë në mungesë të operatorit televiziv Vlora Channel, i cili ka marrë dijeni për këtë vendim kur Zyra e Përmbaramit Vlorë e ka lajmëruar për ekzekutimin vullnetar të gjobës në fjalë.

Duke mos u pajtuar me vendimin nr.650, datë 15.06.2015 të KQZ-së, operatori televiziv Vlora Channel ka paraqitur kërkesëpadi pranë Kolegjit Zgjedhor, me anë të së cilës kundërshton këtë vendim.

Ne përmbushje te detyrimit ligjor per shqyrtimin e cdo ceshtje te paraqitur përpara tij, pas realizimit te procedurave administrativo-procedurale, Kolegji Zgjedhor i Gjykates se Apelit Tirane, ne seancen gjyqesore te dates 20.07.2015, referuar fakteve si me lart, vuri paraprakisht per diskutim përpara paleve prezent ne gjykim kompetencen e tij lendore per shqyrtimin e ceshtjes.

Sipas perfaqesuesit të pales paditese, ceshtja eshte ne kompetencen lendore te Kolegjit Zgjedhor pasi keshtu eshte percaktuar ajo ne vendimin objekt ankimi te KQZ-se.

Nderkohe, perfaqesuesi i KQZ-se u shpreh se kompetenca lendore ne rastin konkret i perkiste Kolegjit Zgjedhor pasi, sipas Kodit Zgjedhor (te ndryshuar), vendimet e KQZ-se te marra sipas ketij Kodi mund te ankimoheshin vetem ne Kolegjin Zgjedhor.

Nisur nga sa me lart u parashtrua, Kolegji Zgjedhor vlerëson se ceshtja objekt shqyrtimi, paraqitur përpara tij si me lart, nuk eshte pjese e juridiksionit te tij gjyqësor dhe ne kompetencen lendore te tij, shkak per te cilin, ne zbatim te nenit 158/2 te Kodit Zgjedhor te ndryshuar, cmon se duhet te vendose pushimin e gjykimit te ceshtjes në Kolegjin Zgjedhor.

Lidhur me kete, Kolegji Zgjedhor ka parasysh lenden per shqyrtim, qe eshte nje vendimmarrje e KQZ-se per denimin administrativ me gjobe te nje operatori televiziv, nxjerrë ne ushtrim te funksioneve te saj publike, ne përmbushje te pergjegjesive dhe sipas kompetencave

te dhena nga Kodi Zgjedhor (i ndryshuar) lidhur me monitorimin e fushatës zgjedhore (ne rastin konkret te zgjedhjeve per qeverisjen vendore.

Po keshtu, Kolegji Zgjedhor ka parasysh se KQZ-ja eshte nje organ publik, i krijuar me ligj, Kodin Zgjedhor te miratuar me Ligjin Nr.10019, date 29.12.2008, i ndryshuar, qe sipas nenit 2/7 te tij, "eshte organi me i larte shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod", ku ne ustrim te pergjegjesive sipas këtij funksioni publik, KQZ-ja vepron si dhe cdo organ tjetër i administrates publike ne fushen e te drejtes publike dhe administrative, vendimmarrjet apo veprimtaria administrative e te cileve, sipas ligjit, i nënshtrohet kontrollit gjyqësor.

Me tej, Kolegji Zgjedhor ka parasysh se Kodi Zgjedhor (i ndryshuar) ka percaktuar rregullat për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet, duke përcaktuar ne menyre te veçante, ne nenin 21, kompetencat e KQZ-se si institucioni publik i ngarkuar per përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve.

Ne vijim, Kolegji Zgjedhor ka parasysh se Kodi Zgjedhor (i ndryshuar) ka rregulluar edhe rishikimin/kontrollin gjyqësor te nje kategorie te caktuar te vendimeve te KQZ-se te nxjerra ne kuadër dhe lidhur me përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve, rishikim/kontroll gjyqësor ky qe i eshte ngarkuar nje gjykate te posaçme autonome te krijuar sipas këtij Kodi, pikërisht Kolegjit Zgjedhor, organ gjyqësor ky i vetmi i ngarkuar nga ligji (Kodi Zgjedhor) per shqyrtimin e nje kategorie ceshtjesh qe lidhen me zgjedhjet (për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet), vendimet e te cilit jane te formes se prere, te paankimueshme.

Pra, Kolegji Zgjedhor ka parasysh se ligji, Kodi Zgjedhor (i ndryshuar), ndersa ka rregulluar shprehimisht rishikimin/kontrollin gjyqësor te nje kategorie te caktuar ceshtjesh, vendimesh te KQZ-se, mosmarrëveshjes zgjedhore, ka percaktuar ne kete menyre dhe juridiksionin gjyqësor qe i perket Kolegji Zgjedhor, si dhe kompetencen lendore te tij per shqyrtimin e tyre.

Ne kete kuptim, Kolegji Zgjedhor vlerëson se jo cdo vendimmarrje e KQZ-se, e nxjerre ne kuadër te veprimtarise se saj administrative,

sipas funksionit publik dhe kompetencave te dhena nga Kodi Zgjedhor (i ndryshuar), mund te jete objekt rishikimi/kontrolli gjyqësor nga Kolegji Zgjedhor, përkundrazi, juridiksioni gjyqësor i Kolegjit Zgjedhor dhe kompetenca e tij lendore eshte vetem per nje kategori te caktuar mosmarrëveshjesh zgjedhore, te përcaktuara shprehimisht nga ligji, Kodi Zgjedhor (i ndryshuar).

Konkretisht, ne Pjesen IX, Kreu I, te Kodit Zgjedhor (i ndryshuar), rregullohet “ankimi ne rruge gjyqesore i vendimeve te KQZ”, institut ligjor ky nepermjet te cilit ligjvenesit ka përcaktuar juridiksionin gjyqësor qe i perket Kolegjit Zgjedhor dhe kompetencen lendore te tij, duke përcaktuar shprehimisht mosmarrëveshjet zgjedhore dhe subjektet qe mund te paraqesin ankim ne Kolegjin Zgjedhor.

Keshtu, ne **nenin 145** te Kodit Zgjedhor (te ndryshuar), titulluar “E drejta e ankimit në gjykatë”, parashikohet se:

“1. **Subjektet zgjedhore** kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër **vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm** brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe **individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.**

2. **Subjektet zgjedhore** kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor **për mosmarrje të vendimit** brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim. Përrjashtim nga ky rregull bëjnë vendimet e KQZ-së për rrëzimin e kërkesës ankimore në lidhje me vendimet të marra në përputhje me shkronjat “a”, “b” “c” dhe “ç” të nenit 24 të këtij Kodi.

3. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe **subjektet e përmendura në nenin 6 të këtij Kodi, të cilëve u është refuzuar kërkesa për akreditimin e vëzhguesve.** Në rastet kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet KZAZ-ve, atëherë e drejta e ankimit, sipas kësaj pike, fillon me ankimin administrativ, në përputhje me nenin 124 të këtij Kodi.

Ndersa, ne **nenin 152** te Kodit Zgjedhor (te ndryshuar), titulluar “Afati i ankimit në gjykatë”, parashikohet se:

1. **Ankimet, sipas këtij Kodi**, paraqiten në Gjykatën e Apelit, Tiranë, e cila ia kalon ato Kolegjit Zgjedhor.

2. Ankimi për të gjitha vendimet që KQZ-ja merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tyre. Për vendimet që KQZ-ja merr jashtë kësaj periudhe, afati i ankimit në Kolegjin Zgjedhor është 30 ditë”.

Se cilet janë “subjektet zgjedhore” përcaktohen në nenin 2/20 të Kodit Zgjedhor (te ndryshuar), sipas të cilit “Subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod”.

Kurse subjekte sipas nenit 6 të Kodit Zgjedhor (te ndryshuar) del të jene perseri “subjektet zgjedhore”, por edhe organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe përfaqësues të medias.

Pra, nga sa me lart, rezulton se jo cdo vendimmarrje e KQZ-se sipas kompetencave të saj të përcaktuara në nenin 21 të Kodit Zgjedhor (te ndryshuar) mund të ankimohet përpara Kolegjit Zgjedhor, perkundrazi, mund të ankimohet përpara Kolegjit Zgjedhor vetëm një kategori e caktuar vendimesh të saj dhe vetëm nga një kategori e caktuar subjektësh, përcaktuar shprehimisht në nenin 145 të këtij Kodi.

Në rastin konkret, vendimi i KQZ-se i ankimuar përpara Kolegjit Zgjedhor, ashtu sikunder dhe subjekti që ka paraqitur ankimin, nuk përfshihen në asnjë prej mosmarrëveshjeve zgjedhore që bëjnë fjalë në nenin 145 të Kodit Zgjedhor (te ndryshuar), zgjidhja e të cilave t’i perkase juridiksionit gjyqësor dhe kompetencës lëndore të Kolegjit Zgjedhor.

Nga ana tjetër, vendimmarrja e KQZ-se për të cilën kërkohet rishikimi gjyqësor në rastin konkret, rezulton të jetë një akt administrativ

individual (akt administrativ denimi me gjobe), i nxjerr perkunder nje subjekti konkret (jo "subjekt zgjedhor" dhe as subjekt sipas nenit 6 te Kodit Zgjedhor, te ndryshuar), qe materializon vullnetin e ketij organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik sipas nenit 21/20 te Kodit Zgjedhor (te ndryshuar). Sipas kësaj dispozite, "KQZ-ja ka keto kompetenca: ... 20. Vendos sanksione administrative kundër personave, që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet, si dhe bën kallëzim penal për vepra penale në lidhje me zgjedhjet". Pra, ne rastin konkret jemi para nje vendimi te nje organi të administratës publike, që ka kompetencën të nxjerre akte administrative individuale, veprimtaria e të cilit rregullohet me ligj të posaçëm (Kodi Zgjedhor), ligj i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative dhe dënimin me gjobë, vendim ky qe krijon pasoja juridike në nje rast individual, domethene jemi para nje vendimi për kundërvajtje administrative.

Per rrjedhoje, ne referim te neneve 21/20 dhe 169 te Kodit Zgjedhor (te ndryshuar), neneve 20 dhe 26 te Ligjit Nr.10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative", si dhe te neneve 2/2/6, 7/a dhe 72/2 te Ligjit Nr.49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", Kolegji Zgjedhor cmon se ne rastin konkret jemi para nje mosmarrëveshje administrative, zgjidhja e te ciles i perket juridiksionit gjyqësor te gjykatave administrative te shkalles se pare, qe kane dhe kompetencen lendore per shqyrtimin e saj. Nderkohe, referuar neneve 2/7 dhe 11/1 te Ligjit Nr.49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", gjykata administrative e shkalles se pare, qe ka dhe kompetencen tokesore per shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative ne rastin konkret, eshte Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane, pikërisht gjykata që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ (ka nxjerre aktin administrativ) që kundërshtohet.

Sa me siper, ne zbatim te ligjit te posacem qe rregullon veprimtarine e tij (Kodit Zgjedhor), Kolegji Zgjedhor konkludon se gjykimi i ceshtjes perpara tij duhet te pushohet, ndersa ceshtja duhet t'i dergohet organit kompetent gjyqësor, qe sic u parashtua me lart eshte Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane.

PER KETO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, bazuar në nenin 158, pika 2, të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar),

V E N D O S I

Pushimin e gjykimit të çështjes në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë. Dërgimin e çështjes për shqyrtim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

U shpall në Tiranë, me datë 20.07.2015.

ANËTARE
GJINOVEFA GABA

ANËTAR
PETRIT ÇENO

KRYESUES
FUAT VJERDHA

ANËTAR
VALBON ÇEKREZI

ANËTAR
KLITON SPAHIU

* *
* *



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR

NR. 39 REGJ. THEMELTAR
DATË 20.07.2015 REGJ.

NR. 39 VENDIMI
DATË 27.07.2015 VENDIMI

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUES : Edlira PETRI
ANËTAR : Ilir TOSKA

ANËTAR : Andi CIVICI
ANËTAR : Kliton SPAHIU
ANËTAR : Valbon ÇEKREZI

asistuar nga sekretarja gjyqësore Rexhina Baçi, mori në shqyrtim, në seancën gjyqësore me dyer të hapura të datës 27.07.2015, çështjen zgjedhore, që u përket palëve :

PADITËSE: **Partia Demokratike e Shqipërisë**, e përfaqësuar me autorizim nga z. Besnik Kastrati.

I PADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, i përfaqësuar me autorizim nga Znj. Dëshira Pasko.

PALË E INTERESUAR: **Partia Socialiste e Shqipërisë**, e përfaqësuar me autorizim nga z. Gledian Llatja.

OBJEKTI : 1. Kundërshtimin e vendimit nr. 923, datë 14.07.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me anë të të cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës ankimore nr. 108, datë 08.07.2015, kundër vendimit nr. 868, datë 06.07.2015 të KQZ-së “Për miratimin e tabelës përmbledhëse për Kryetarin dhe Këshillin e Bashkisë, Zona Zgjedhore Bashkia Shkodër”;
2. Shqyrtimin e çështjes në themel, duke vendosur shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në qendrën e votimit nr. 092 të Zonës Zgjedhore Bashkia Shkodër; Mos përfshirjen e rezultatit të prodhuar nga kjo qendër votimi, në tabelën përmbledhëse të Këshillit të Bashkisë, Zona Zgjedhore Bashkia Shkodër, Qarku Shkodër.

BAZA LIGJORE : Nenet 3, pika 2, 4, 11, 33, 36, 105, 106 pika 3, 124, 126, 144, 145, 152, 153, 155, 156, 158, 160 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë; Nenet 115, 116, 117 të Kodit të Procedurave Administrative.

Në përfundim të gjykimit, palët pjesëmarrëse i kërkuan Kolegjit Zgjedhor:

Pala paditëse Partia Demokratike e Shqipërisë, nëpërmjet përfaqësuesit të saj Z. Besnik Kastrati : pranimin e padisë;

Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësueses së saj, Znj. Dëshira Pasko : rrëzimin e padisë;

Pala e interesuar Partia Socialiste e Shqipërisë, nëpërmjet përfaqësuesit të saj Z. Gledian Llatja : rrëzimin e padisë.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoji pjesëmarrësit, shqyrtoi aktet dhe diskutoi çështjen në tërësi

V Ë R E N

Në datën 21 qershor 2015 u zhvilluan zgjedhjet vendore në Republikën e Shqipërisë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (referuar më tej, si KQZ), me vendimin nr. 868, datë 06.07.2015 ka nxjerrë rezultatin e votimit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër, në zbatim të nenit 123 të Kodit Zgjedhor, për shkak se kjo Zonë Zgjedhore ndahet në katër Zona të Administrimit Zgjedhor (më tej referuar si ZAZ), përkatësisht ato me nr. 02, 04, 03 dhe 05. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se KQZ-ja, në nxjerrjen e rezultatit u është referuar Tabelave të Rezultatit për çdo Qendër Votimi (të plotësuara nga Grupet e Numërimit të Votave), si dhe Tabelave Përmbledhëse të Rezultatit, të miratuara nga Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (më tej, referuar si KZAZ). KQZ-ja, pasi ka evidentuar disa mospërputhje mes rezultateve të disa prej QV-ve, me ato të Tabelave Përmbledhëse të miratuara nga KZAZ-të, i ka korrigjuar ato, mbështetur në origjinalet e tabelave, duke miratuar edhe Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër.

Në datë 08.07.2015, pranë KQZ-së është paraqitur ankimi i subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, i regjistruar në Regjistrin e Ankimeve me nr. 108, me të cilin kundërshtohet vendimi nr. 868, datë 06.07.2015 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit ...”. Ankuesi i ka parashtruar KQZ-së pretendimet e tij lidhur me

votimin në Qendrën e Votimit nr. 092, ZAZ nr. 02, ku sipas ankuesit nuk është zhvilluar një proces i rregullt zgjedhor për këto arsye :

- Procesi i votimit në QV nr. 092 ka nisur përtej afatit të parashikuar në ligj (neni 11 i Kodit Zgjedhor), në rrethanat kur rezultoni të ketë filluar në orën 13.00 të datës 21.06.2015. Po ashtu, procesi i votimit është mbyllur para afatit të përcaktuar në ligj dhe konkretisht në orën 17.30 të datës 21.06.2015. Sa më sipër, sipas nenit 160, shkronja “c” të Kodit Zgjedhor, përbën shkak për pavlefshmëri të zgjedhjeve;
- Është shkelur Kodi Zgjedhor (nenet 33 e vijues të tij) lidhur me emërimin, zëvendësimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Komisioneve të Qendrës së Votimit (më tej, referuar si KQV). Pasi kanë detyruar me dhunë komisionerët e Partisë Demokratike, që të largohen nga QV nr. 092, komisionerët e majtë të kësaj QV-je, kanë vendosur të marrin atributet e KZAZ-së, duke bërë shkarkimin dhe zëvendësimin e komisionerëve të propozuar nga Partia Demokratike, me persona të panjohur. Ky veprim krijon bindjen se është bërë me qëllimin e manipulimit të zgjedhjeve, çka mbështetet edhe në pjesëmarrjen mbi 97% të zgjedhësve në këtë QV, që është e pamundur, për shkak se një pjesë e tyre janë në emigracion;
- Janë shkelur nenet 100 dhe 115 e vijues të Kodit Zgjedhor. Nuk përputhen numri i fletëve të votimit të marra në dorëzim nga KQV-ja, me numrin e fletëve të votimit të gjetura në kuti, si dhe ato të papërdorura (PV-KQV-05 dhe PV-KQV-08). Ky fakt është konstatuar dhe shënuar në rubrikën “Vërejtje” të Tabela e Rezultateve (model 57-15) për QV nr. 092, nga ana e numëruesve GNV 01/VNV 02. Pasojë e kësaj shkeljeje është deformimi i vullnetit të zgjedhësve, manipulimi i rezultatit zgjedhor në këtë QV, çka ndikon edhe në shpërndarjen e mandateve për Këshillin e Bashkisë Shkodër;
- Nga GNV 01, është konstatuar gjithashtu se në kutinë e votimit të QV nr. 092, janë gjetur fletë votimi të palosura 3 – 4 së bashku, çka tregon se është votuar nga i njëjti person më shumë se një herë. Ky fakt është shënuar në rubrikën e vërejtjeve nga ana e numëruesve të GNV 01;

- Që votimi në këtë QV ka qenë i parregullt, provohet edhe me pamjet filmike të shfaqura në rrjetet sociale, tashmë të njohura nga opinioni publik, nga ku rezulton se është votuar nga persona të panjohur dhe komisionerët e majtë, në emër të zgjedhësve të tjerë, pa qenë prezent, duke shkelur nenin 106, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

Në mbështetje të pretendimeve të mësipërme, ankuesi Partia Demokratike e Shqipërisë ka paraqitur këto prova:

1. Vendimi nr. 43, datë 20.06.2015 i KZAZ nr. 02 “Për emërimin e anëtarëve të KQV-së”, me të cilin janë emëruar si të tillë në QV nr. 092 : 1. Z. Gjergj Simon Kryqa, 2. Z. Rasim Shpen Kuçi, 3. Z. Mark Pjetër Ndreaj, 4. Z. Gjergj Lazër Çuku, 5. Z. Vat Fran Gurra, 6. Z. Rrok Tom Kryqa, 7. Z. Ylber Kadri Bregaj;
2. Vendimi nr. 44, datë 20.06.2015 i KZAZ nr. 02 “Për emërimin e kryetarit dhe sekretarit të KQV-së”, me të cilin janë zgjedhur si të tillë, përkatësisht Z. Mark Pjetër Ndreaj (i propozuar nga Partia Demokratike) dhe Z. Gjergj Simon Kryqa (i propozuar nga Partia Socialiste);
3. Procesverbali i vulosjes së kutive të votimit për QV nr. 092, përpara fillimit të votimit (PV-KQV-07), nga përmbajtja e të cilit rezulton se ky veprim është kryer në orën 08.30 të datës 21.06.2015, nga KQV-ja me përbërje : Kryetar z. Mark Ndreaj dhe anëtarë z. Rrok Kryqa, etj.
4. Një dokument i shkruar me dorë nga anëtarët e KQV nr. 092, i mbajtur në datë 21.06.2015, ora 12.00, nga përmbajtja e të cilit rezulton se është vendosur zëvendësimi i Z. Mark Ndreaj (kryetar i KQV-së) dhe Z. Gjergj Çuku (anëtar), me shtetasit Rrok Krygja dhe Agron Likaj. Po sipas këtij akti, është përshkruar se ky vendim është marrë “unanimisht” nga të gjithë anëtarët e tjerë, të cilët edhe kanë nënshkruar. Në vijim pasqyrohet se në orën “1.00 u hap sërish qendra e votimit 092 dhe u vazhdua normalisht”. Rezulton gjithashtu që në një pjesë të këtij akti, është vendosur edhe motivacioni i kësaj vendimmarrjeje, sipas shënimit “Për arsye se ishin nën ndikimin e alkoolit”;

5. Një tjetër akt i shkruar me dorë dhe i depozituar në KZAZ nr. 02, pasi përmban vulën e këtij komisioni, por nuk vërtetohet momenti kohor i paraqitjes së aktit në KZAZ. Kjo shkresë emërtuar “Deklaratë” është nënshkruar nga dy anëtarët e KQV 092 Mark Ndreaj dhe Gjergj Çuku, por teksti është shkruar vetëm nga Z. Mark Ndreaj, njëkohësisht edhe Kryetar i kësaj QV-je. Sipas kësaj shkrese, parashtrohet ndër të tjera edhe se : Ditën e diel, datë 21.06.2015, nuk është hapur procesi i votimit deri në orën 12.10, pasi mungonte Z. Ylber Kadri Bregaj (i propozuar nga PD), për shkak të largësisë dhe rrugës së keqe. Pas hapjes së votimit në orën 12.10, komisionerët e propozuar nga PS-ja, të cilësuar si militantë, kanë filluar të bëjnë presion, me fyerje dhe kërcënime, ndaj anëtarëve të propozuar nga PD-ja, përfshirë këtu edhe kryetarin Mark Ndreaj. Nën këtë presion komisionerët e PS-së kanë kërkuar dhe pastaj kanë lejuar me forcë, votimin familjar, ku një person votonte për të gjithë anëtarët e familjes, apo paraqitej me disa karta identiteti dhe votonte për zgjedhës që nuk ishin prezent në qendrën e votimit dhe për persona që ndodheshin jashtë shtetit. Kryetari të komisionit i është marrë vula, me forcë, duke e vijuar më pas votimin, sipas dëshirës. Megjithëse është kërkuar ndihma e policisë, forcat e rendit që ishin prezent nuk kanë ndërhyrë asnjëherë për të qetësuar situatën. Është kërkuar që nga Kryetari dhe anëtari Gjergj Çuku, të nënshkruhet procesverbali i mbylljes së votimit, gjë që nuk është pranuar të bëhet nga këta të fundit.
6. Procesverbali i mbylljes së votimit (PV-KQV-08), për QV nr. 092, i përpiluar në orën 17.30 të datës 21.06.2015, nga i cili rezulton se në përbërje të KQV-së janë edhe shtetasit Rrok Krygja (kryetar) dhe Agron Likaj (anëtar). Në këtë procesverbal janë pasqyruar edhe të dhënat e kërkuara në nenin 113 të Kodit Zgjedhor, si vijon : Numri i plotë i fletëve të votimit të QV nr. 092 është 394; Numri i zgjedhësve që kanë votuar është 377; Numri i fletëve të votimit të përdorura është po 377; Numri i fletëve të votimit të dëmtuara për kandidat për Këshillin e Bashkisë është 3;
7. Procesverbali i dorëzimit në KZAZ nr. 02, të materialeve zgjedhore nga KQV nr. 092 (PV-KZAZ-09), nga i cili rezulton se

është nënshkruar në cilësinë e kryetarit të KQV nr. 092, nga Z. Rrok Krygja, kurse në cilësinë e sekretarit nga Z. Gjergj Krygja (krahas anëtarëve të grupit të marrjes në dorëzim të KZAZ nr. 02). Po ashtu rezulton që dorëzimi i materialeve zgjedhore të jetë bërë në datë 22.06.2015, ora 01:45 dhe në momentin e dorëzimit, kutitë janë pranuar si të rregullta;

8. Tabela e Rezultateve për QV nr. 092, përpiluar nga GNV 01 pranë KZAZ nr. 02, në datë 24.06.2015. Nga ky dokument zgjedhor rezulton se në tabelën e rezultateve janë këto të dhëna : Numri i zgjedhësve që kanë votuar 388; Fletë votimi të papërdorura 0; Fletë votimi të dëmtuara 3; Fletë votimi të gjetura në kuti 388; Vota të pavlefshme 13; Vota të vlefshme 372; Fletë të hedhura gabim 3. Në rubrikën “kundërshtimet e anëtarëve të GN” rezulton se tre prej anëtarëve të GNV 01 kanë kundërshtuar tabelën e rezultateve duke shënuar se :
1. janë gjetur fletë votimi më tepër nga çfarë pasqyrohet në procesverbalin e mbylljes së votimit; 2. janë gjetur mbi 20 fletë votimi, nga 3 dhe 4 copë së bashku, të futura në grup;
9. Një CD, në të cilën sipas përfaqësuesit të ankuesit, gjenden pamje filmike të asaj çfarë ka ndodhur në QV 092, lidhur me votimin prej vetë anëtarëve të kësaj QV-je disa herë, në emër të zgjedhësve të tjerë;
10. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankimit, është marrë dhe administruar si provë edhe procesverbali i konstatimit të KZAZ nr. 02, nga përmbajtja e të cilit rezulton se në datë 21.06.2015 nga GNV 07, lidhur me kutinë e QV nr. 092, është konstatuar që “procesverbali i konsitutumit të kësaj QV-je, nuk është i njëjtë me atë që u gjend në dosjen e QV (Kryetari ishte ndryshuar nga komisioni dhe vula u dorëzua nga një komisioner tjetër). Më tej në këtë procesverbal është bërë edhe shënimi se komisionerët e djathtë e konsiderojnë këtë kuti me probleme serioze, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor.
11. Po ashtu është administruar edhe Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ nr. 02, në të cilin nuk gjen pasqyrim asnjë njoftim apo vendim lidhur me QV nr. 092, për çështje të caktuara ditën e zgjedhjeve 21 qershor 2015. Për sa i përket periudhës pas

zhvillimit të zgjedhjeve, rezulton se në datë 23.06.2015, ora 01.15, është bërë mbledhja e KZAZ-së lidhur me “pezullimin e kutisë QV 092 nga GNV 07”, në të cilën është vendosur që të hapet kutia me materiale zgjedhore. Pas kësaj procedure ka rezultuar se procesverbali PV-KQV-08 është i paplotësuar, ashtu si edhe procesverbali model PV-KQV-07. Në këto kushte, KZAZ ka vendosur përfundimisht që kutia me nr. 092 të quhet “E PARREGULLT”.

Lidhur me dy aktet e fundit, duhet sqaruar se i përkasin momentin kur po numëroheshin kutitë e votimit për Kryetar të Bashkisë Shkodër, pasi sipas Librit të Protokollit rezulton se numërimi i votave për Këshillin e Bashkisë ka filluar në datë 26.06.2015. Rezulton se ndërsa është diskutuar në mbledhje nga KZAZ nr. 02 rregullshmëria e kutisë së votimit për Kryetar, nuk është vënë në diskutim prej saj, kutia e votimit për Këshillin e Bashkisë Shkodër, pavarësisht gjetjeve të GNV 01, të pasqyruara në Tabelën e Rezultatit për QV 092.

Gjatë debatit në mbledhjen e KQZ-së, nga përfaqësuesi i subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, është kërkuar mospranimi i ankimit, për arsye se rezultati në Zonën Zgjedhore Bashkia Shkodër, është i tillë sa që numri i votave të QV 092, nuk ndikon në rezultatin zgjedhor, ndaj nuk ka vend që zgjedhjet të deklarohen të pavlefshme, pavarësisht pretendimeve për paligjshmëri të parashtruara nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike.

Rezulton se në kuadër të verifikimit të pretendimit lidhur me orën e fillimit të zgjedhjeve, KQZ-ja ka vendosur të hapë dhe të këqyrë kutinë e materialeve zgjedhore për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Shkodër me qëllim marrjen e të dhënave të kërkuara, nga Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KQV 092. Nga hapja e kësaj kutie dhe këqyrja e Librit të Protokollit, ka rezultuar se në këtë të fundit, nuk ka asnjë shënim lidhur me vendimet e marra nga KQV-ja.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimit nr. 108, KQZ-ja me vendimin nr. 923, datë 14.07.2015 “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 107 të paraqitur në KQZ nga Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë dhe kërkesës ankimore nr. 108 të paraqitur në KQZ nga Partia Demokratike e Shqipërisë”, ka vendosur (lidhur me kërkesën ankimore nr. 108):

1. ...

2. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 108 të Partisë Demokratike.

3. Lënien në fuqi të vendimit të KQZ nr. 686 datë 06.07.2015, "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e Këshillit Bashkiak në Bashkinë Shkodër".

Konkluzioni i mësipërm i KQZ-së është rezultat i arsytimit, sipas të cilit:

- Pretendimi për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në QV 092, për shkak të orarit të fillimit të votimit dhe pezullimit të tij për pesë orë, nuk është i bazuar në prova, në rrethanat kur nga procesverbali i hapjes PV-KQV-07 votimi rezulton të ketë filluar në orën 08.30, si dhe kur nga këqyrja e kutisë së materialeve nuk rezultoi një orar tjetër i fillimit të votimit;
- Referuar nenit 160, pika 1, shkronja "a" të Kodit Zgjedhor, ndonëse nga hetimi administrativ rezultojnë shkelje të këtij ligji, nuk plotësohen së bashku dy kushtet e kërkuara nga kjo dispozitë për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve : shkeljet e ligjit dhe ndikimi i tyre në ndarjen e mandateve. Sipas KQZ-së rezultati i votimit në QV 092 nuk ndikon në ndarjen e mandateve për Këshillin e Bashkisë Shkodër dhe se shkeljet nuk janë aq të rënda sa të ndikojnë në ndarjen e mandateve.

Kundër këtij vendimi, në datë 20.07.2015, ka bërë ankim në Kolegjin Zgjedhor, Partia Demokratike e Shqipërisë, duke ngritur të njëjtat shkaqe si në ankimin drejtuar KQZ-së dhe të përmendura më sipër në këtë vendim. Po kështu, sipas palës paditëse KQZ-ja ka marrë një vendim të pabazuar në ligj, kur e mbështet atë në arsytimin se "edhe sikur të pranojmë kërkesën për pavlefshmëri, rezultati i kësaj qendre nuk ndikon në ndarjen e mandateve", pasi në këtë mënyrë KQZ-ja legjitimon veprimet e paligjshme në një proces zgjedhor. Në kushtet kur KQZ-ja ende nuk është shprehur për ndarjen e mandateve, sipas palës paditëse, ajo nuk mund të shprehet paraprakisht nëse rezultati i QV 092 ndikon apo jo, në ndarjen e tyre. Pavarësisht ndikimit në rezultat, pala paditëse

pretendon se KQZ-ja nuk ka asnjë bazë ligjore që të pranojë si të rregullta veprimet e paligjshme të kryera në këtë QV.

Për arsyet e mësipërme, pala paditëse ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të KQZ-së për rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 108, shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në QV 092 dhe mos përfshirjen e rezultatit të saj në tabelën përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Shkodër.

KQZ-ja dhe pala e interesuar Partia Socialiste e Shqipërisë kërkuan rrëzimin e padisë, mbi të njëjtin arsyetim si ai i vendimit të KQZ-së, objekt ankimi në Kolegjin Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor diskutoi së pari, aspektin faktik të mosmarrëveshjes, lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve vendore të datës 21 qershor 2015 për Këshillin e Bashkisë Shkodër. Ky Kolegj, referuar akteve të paraqitura, në raport me pretendimet e palës paditëse, vlerëson si më poshtë:

1. Komisioni i Qendrës së Votimit nr. 092, i miratuar nga KZAZ nr. 02 me vendimet nr. 43 dhe 44 të datës 20.06.2015, ka ndryshuar përbërjen e tij, pas kryerjes së veprimit për vulosjen e kutive të votimit, duke zëvendësuar dy prej anëtarëve të tij (përfshirë kryetarin) me dy persona të tjerë. Ky ndryshim nuk është kryer me vendim të KZAZ-së, e cila rezulton gjithashtu të mos jetë njoftuar në kohë reale, lidhur me shkakun për të cilin dy prej anëtarëve të KQV-së, nuk e kanë ushtruar detyrën e tyre. Procesi i votimit është mbyllur me KQV-në e ndryshuar, në përbërje të të cilës, rezultojnë dy anëtarët e paemëruar nga KZAZ-ja.
2. Lidhur me fillimin e orarit të votimit, pretenduar nga pala paditëse të jetë ora 13.00, referuar procesverbalit të mbajtur nga anëtarët e KQV-së, për zëvendësimin e dy anëtarëve të saj, Kolegji Zgjedhor vlerëson se ky fakt nuk rezulton i qartë nga akti i mësipërm, në të cilin pasqyrohet se “votimi rifilloi”. Megjithatë, ky pretendim merret në konsideratë, për sa kohë që fillimi i votimit dhe vendimi i KQV-së lidhur me të, nuk gjejnë pasqyrim në asnjë dokument zgjedhor, siç është Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, në të cilin duhej të shënoheshin si ora

e fillimit të votimit, çdo ndërprerje, si dhe shkak i saj. Ajo çfarë është e sigurt nga aktet e administruara, është që votimi nuk ka filluar në orarin e përcaktuar nga ligji (07.00), por pas orës 08.30, orë kur janë vulosur kutitë e votimit, sipas procesverbalit përkatës;

3. Votimi është mbyllur në orën 17.30, pra para orës së përcaktuar nga ligji (19.00);
4. Vërtetohet të ketë mospërputhje të shifrave lidhur me votimin në këtë QV, referuar procesverbalit të mbylljes së votimit, pasi nuk rakordojnë fletët e plota të marra në dorëzim nga KQV-ja, me fletët e përdorura nga zgjedhësit dhe ato të papërdorura. Në vijim ka rezultuar se as numri i zgjedhësve i shënuar në këtë procesverbal, nuk përputhet me fletët e gjetura në kuti nga GNV 01, gjatë procesit të numërimit të votave;
5. Pas mbylljes së votimit, materialet zgjedhore të QV nr. 092, janë dërguar pranë vendit të numërimit të votave të KZAZ nr. 02, ku nuk janë dorëzuar nga kryetari i KQV-së miratuar nga KZAZ-ja. Ky fakt rezulton të jetë evidentuar nga KZAZ-ja në momentin kur nga GNV 07 ishte marrë për tu numëruar kutia për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, ashtu siç është evidentuar edhe mospërputhja e shifrave të fletëve të votimit. Rezulton se me vendim të KZAZ-së, është cilësuar “E PARREGULLT” kutia e votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë, por nuk është vënë në diskutim dhe nuk është marrë asnjë vendim lidhur me kutinë për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë;
6. Vërtetohet nga Tabela e Rezultatit për QV nr. 092, se shifrat nuk përputhen, as referuar fletëve të votimit të marra në dorëzim nga kjo QV, para procesit të votimit (mungojnë fletë nga totali prej 394 të tilla) dhe as të dhënave të shënuara në procesverbalin e mbylljes së votimit, lidhur me numrin e zgjedhësve 377, ndërkohë që në kuti janë gjetur 388 fletë votimi të përdorura nga zgjedhësit. Këto fakte pasqyrohen nga GNV 01, në rubrikën e vërejtjeve të Tabelës së Rezultatit;
7. Vërtetohet gjithashtu se në kutinë e votimit janë hedhur disa fletë votimi të palosura së bashku, çka do të thotë se një zgjedhës ka votuar më shumë se një herë;

8. Vërtetohet së fundi, se rezultati i kësaj QV-je, është përfshirë në Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për KZAZ nr. 02 e më tej në Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për Zonën Zgjedhore Bashkia Shkodër, sipas vendimit nr. 868, datë 08.07.2015 të KQZ-së, objekt i ankimit administrativ.

Faktet e vërtetuara si më sipër, u analizuan nga Kolegji Zgjedhor, referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor, të miratuara mbi bazën e parimeve të rëndësishme të së drejtës zgjedhore, nga e drejta ndërkombëtare dhe ajo e brendshme.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Protokolli Shtesë, neni 3 i tij) dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 1 saj), përcaktojnë si bazë për funksionimin e demokracisë, zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të përgjithshme, të barabarta dhe të fshehta. Këto parime, përfshirë edhe atë për zhvillimin periodik të zgjedhjeve, janë pasqyruar në Kodin e Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore (miratuar nga Komisioni i Venecias), duke i cilësuar si trashëgimi zgjedhore evropiane.

Mbi këtë bazë konventore dhe kushtetuese, Kodi Zgjedhor në nenin 3 të tij përcakton me besnikëri parimet e lartpërmendura, mbi të cilat janë hartuar rregullat e posaçme të së drejtës zgjedhore shqiptare. Nën këtë frymë, Kolegji Zgjedhor analizoi faktet e vërtetuara, për tu dhënë përgjigje çështjeve nëse ka pasur shkelje të dispozitave ligjore në procesin zgjedhor për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Shkodër në QV nr. 092 dhe nëse po, a përbëjnë ato shkak për t'i shpallur të pavlefshme zgjedhjet në këtë Qendër Votimi.

1. Lidhur me shkeljet ligjore në procesin zgjedhor në QV 092.

Paraprakisht duhet evidentuar se jo vetëm pala paditëse në cilësinë e subjektit ankues, por edhe vetë KQZ-ja, si dhe pala e interesuar pranojnë që të ketë pasur shkelje në këtë proces zgjedhor. Megjithatë, duke qenë se këto shkelje nuk janë përcaktuar në çdo rast të kryerjes së tyre, Kolegji Zgjedhor vlerëson se në procesin zgjedhor objekt kundërshtimi, janë kryer shkeljet e mëposhtme:

- a) Është shkelur parimi i nenit 3, pika 6 të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton se komisionet zgjedhore i përmbushin funksionet e tyre, në përputhje me ligjin, në mënyrë të paanshme dhe transparente. Në rastin në shqyrtim rezulton se KQV nr. 092 jo vetëm që nuk e ka administruar procesin e votimit në përputhje me këtë parim, por anëtarët e këtij komisioni kanë kryer veprime dhe mosveprime të tilla, që vijnë hapur në kundërshtim me detyrën që u ishte ngarkuar me ligj. Kështu, sipas neneve 33, shkronja “b” dhe 39 të Kodit Zgjedhor, kompetenca për emërimin, shkarkimin apo lirimin nga detyra të anëtarit dhe sekretarit të KQV-së, i përket KZAZ-së. Në ushtrimin e kësaj detyre, KZAZ-ja garanton si baraspeshën politike të KQV-së (neni 29 i Kodit Zgjedhor), ashtu edhe verifikon ekzistencën e shkaqeve të papajtueshmërisë (neni 37) apo plotësimin e kushteve të emërimit të anëtarit të KQV-së (neni 38). Rregullat zgjedhore, për ngritjen e komisioneve që administrojnë procesin zgjedhor, konsiderohen si garanci procedurale për zhvillimin e zgjedhjeve dhe krijimin e besimit në rezultatin e tyre. Në rastin konkret, rezulton që pesë anëtarë të KQV-së 092, të kenë “shkarkuar” dy anëtarë të tjerë, përfshirë edhe Kryetarin, që rezultojnë të jenë të propozuar nga pala paditëse Partia Demokratike e Shqipërisë. Ky komision, nuk ka vënë në dijeni KZAZ-në lidhur me ekzistencën e ndonjë mosmarrëveshje të mundshme, që shkaktonte moskryerjen e votimit, por ka marrë vetë vendimet për të cilat nuk ishte kompetente, duke ndryshuar përbërjen dhe lejuar pjesëmarrjen e dy personave të tretë, të pidentifikuar dhe të paverifikuar nga organi përgjegjës, KZAZ-ja. Kjo përbërje e re KQV-së rezulton të jetë e paligjshme dhe duke qenë se përbërja e QV-ve, është një nga garancitë që Kodi Zgjedhor ofron për subjektet zgjedhore, administrimi i procesit të votimit të datës 21.06.2015 në QV nr. 092, vlerësohet nga Kolegji Zgjedhor si i kryer në shkelje të rëndë të ligjit;
- b) Procesi i votimit në QV nr. 092, krahas përbërjes së paligjshme të KQV-së, është i pamundur të verifikohet edhe në saktësinë e rezultatit të tij, pasi në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të këtij komisioni, nuk ka asnjë shënim lidhur me vendimet e marra prej tij dhe të detyrueshme për tu pasqyruar në këtë dokument. Kështu, sipas nenit 42 të Kodit Zgjedhor KQV-ja është e

detyruar që të shënojë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve edhe vendimet lidhur me hapjen e votimit, pezullimin dhe mbylljen e tij. Nga këqyrja e këtij dokumenti gjatë shqyrtimit administrativ të ankimit, ka rezultuar se Libri i Protokollit të Mbledhjeve të QV nr. 092 nuk ka pasur asnjë shënim. Në këto kushte, Kolegji Zgjedhor e ka të pamundur të verifikojë nga ky dokument, nëse KQV-ja ka marrë apo jo vendime lidhur me çështjet e mësipërme, si dhe orën e marrjes së tyre. Për këtë shkak, Kolegji vlerëson se për sa kohë që i vetmi dokument zyrtar që pasqyron hapjen, pezullimin dhe mbylljen e votimit, nuk përmban asnjë të dhënë, nuk vërtetohet që KQV nr. 092 të ketë marrë vendime lidhur me këto çështje, gjë që përbën një tjetër shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor;

- c) Nga të vetmet dokumente të përpiluara nga KQV nr. 092, procesverbalet e vulosjes së kutive dhe mbylljes së votimit, vërtetohen vetëm momentet e kryerjes së këtyre veprimeve. Konkretisht vërtetohet se në orën 08.30 janë vulosur kutitë e votimit (pra votimi ende nuk kish filluar në këtë orë), dhe në orën 17.30 ishte mbyllur votimi (ora e saktë e mbylljes nuk vërtetohet) dhe ka përfunduar përpilimi i procesverbali të mbylljes. Referuar vetëm këtyre fakteve, rezulton se procesi i votimit nuk është kryer në gjithë intervalin kohor ora 07.00 – ora 19.00, të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, dhe në kushtet kur nuk tregohen shkaqet për të cilat ka ndodhur sa më sipër, administrimi i procesit të votimit konsiderohet i kryer në kundërshtim me këtë rregullim;
- d) Nga të dhënat e gjetura në dokumentet zgjedhore si procesverbali i mbylljes së votimit dhe tabela e rezultatit të votimit për këtë QV, përpiluar nga GNV 01, rezultojnë mospërputhje mes numrit të plotë të fletëve të votimit të marra në dorëzim nga KQV 092 para procesit të votimit, me numrin e fletëve të votimit të përdorura nga zgjedhësit dhe atyre të papërdorura apo të dëmtuara. Kodi Zgjedhor përcakton rregulla të detajuara mbi administrimin e fletëve të votimit nga KQV-ja (neni 113), por gjithmonë shifrat duhet të përputhen mes tyre (përrjashtimisht gabimeve materiale). Sipas Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, të paktën dy, janë kriteret për të vërtetuar saktësinë e rezultateve të votimit : numri i zgjedhësve

pjesëmarrës në votim dhe numri i fletëve të votimit të hedhura në kuti. Ndërkohë sipas këtij Kodi, duhet që fletët e votimit të përdorura të mos nxirren nga qendra e votimit. Këto aspekte të verifikimit të rezultatit, garantojnë nga rregulla të detajuara mbi mënyrën se si KQV-ja pasqyron të dhënat në përfundim të votimit, të dhëna të cilat në rastin konkret kanë rezultuar me mospërputhje e madje edhe të gabuara, siç është konstatuar edhe nga GNV 01. Masa dhe natyra e këtyre mospërputhjeve, shtuar edhe faktin e gjetjes nga GNV të disa fletëve të votimit të palosura së bashku, krijon bindjen edhe për Kolegjin Zgjedhor se në këtë rast, kanë ndodhur shkelje të tilla të ligjit, që kanë cenuar zhvillimin e një procesi zgjedhor të lirë, nëpërmjet veprimeve të kryera në mashtim të Kodit Zgjedhor, i cili garanton barazinë dhe fshehtësinë e votës, lirinë e zgjedhësve për të shprehur vullnetin, si dhe të drejtën e këtyre të fundit për të pasur një vlerësim të saktë të rezultatit të votimit.

2. Lidhur me kërkimin për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në QV nr. 092.

Kërkesa ankimore nr. 108, drejtuar KQZ-së, kishte për objekt të saj vendimin e kësaj të fundit për miratimin e Tabelës së Rezultatit të Votimit për Zonën Zgjedhore Bashkia Shkodër, ankim i ushtruar sipas nenit 124 të Kodit Zgjedhor. Kjo dispozitë përcakton se:

“1. Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

2. ...

3. Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas nenit 123 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankim po në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi. **Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi.**

4. Në çdo rast ankimi për pavlefshmëri, sipas nenit 160, dhe ankimi për ndryshimin e tabelës së rezultatit paraqitet në të njëjtën kërkesë ankimore, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni. Në kërkesë përcaktohen qendrat e votimit, për të cilat kërkohet ndryshimi i rezultatit apo pavlefshmëria.

5. ...

6. Në shqyrtimin e kërkesave ankimore të paraqitura, KQZ-ja shqyrton të gjithë problematikën e tyre, përfshirë edhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi, pa u kufizuar në objektin e kërkimit të kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti zgjedhor.”

Dispozita e mësipërme, në funksion të vlerësimit të saktë të rezultatit përmblendhës të Zonës Zgjedhore, u ka dhënë të drejtën subjekteve zgjedhore të kërkojnë nëpërmjet ankimit administrativ, edhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një ose disa qendra votimi. Nga ana tjetër, ankimi për pavlefshmërinë e votimit në një ose disa qendra votimi, kryhet sipas nenit 160 të Kodit Zgjedhor, në të cilin përcaktohet se:

“1. KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, në rast se:

a) kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhuara në ato qendra votimi mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;

b) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose

c) votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se pesë orë.

...”

Kolegji Zgjedhor, referuar debatit të zhvilluar lidhur me kërkimin për shpalljen e pavlefshëm të votimit në QV nr. 092, si dhe arsyetimit të KQZ-së sipas të cilit pavarësisht shkeljeve, ato nuk ndikojnë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjes së Këshillit të Bashkisë Shkodër, vlerëson se KQZ-ja ka gabuar në konkluzionin e saj, kur ka vlerësuar se pavlefshmëria e zgjedhjeve në qendrën e votimit, kushtëzohet përherë me ndikimin e saj në rezultatin, lidhur me ndarjen e mandateve për Zonën Zgjedhore, pjesë e së cilës është kjo QV.

Kolegji Zgjedhor paraprakisht vë në dukje se, nga pikëpamja procedurale, Kodi Zgjedhor nuk e kushtëzon kërkesën për pavlefshmëri të zgjedhjeve në qendrën e votimit, me ndikimin e saj në rezultatin përfundimtar të Zonës Zgjedhore. Sa më sipër, rezulton nga vetë përmbajtja e nenit 161 të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon përsëritjen e zgjedhjeve. Vendimi i KQZ-së për përsëritjen e zgjedhjeve në një Zonë Zgjedhore, merret jo më vonë se tre ditë pas përfundimit të procesit të ankimit, lidhur me rezultatin e kësaj Zone (kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore). Kushti për marrjen e këtij vendimi, është ndikimi në ndarjen e mandateve të Zonës Zgjedhore, i pavlefshmërisë së shpallur nga KQZ-ja për një ose disa qendra votimi. Më tej, kjo dispozitë përcakton edhe kuptimin e “ndikimit në rezultat” për çdo shkak të pavlefshmërisë, të parashikuar nga neni 160 i Kodit Zgjedhor.

Nga interpretimi sistematik i dispozitave të neneve 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor, rezulton e qartë se pavlefshmëria e zgjedhjeve në një apo disa qendra votimi, nuk lidhet domosdoshmërisht me ndikimin në rezultatin e Zonës Zgjedhore, dhe për rrjedhojë me përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë Zonën. Kodi Zgjedhor, me qëllim nxjerrjen e një rezultati të saktë të votimit, nuk lejon përfshirjen në rezultatin e votimit, atë të QV-ve, kutitë e të cilave janë cilësuar si “TE PARREGULLTA” (neni 138, pika 4 i Kodit Zgjedhor), si dhe atë të QV-ve ku zgjedhjet shpallen të pavlefshme (kryesisht ose mbi bazën e ankimit), në kushtet e përcaktuara nga neni 160 i Kodit Zgjedhor.

Duke i'u rikthyer dispozitës së nenit 160 të Kodit Zgjedhor, shkronja “a” e tij përcakton se kur në një ose disa QV, *“kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor”*,

KQZ-ja i shpall zgjedhjet të pavlefshme. Sipas Kolegjit Zgjedhor, shkronja “a” e nenit 160, përmban dy shkaqe për të cilat zgjedhjet shpallen të pavlefshme, të ndara me lidhëzën veçuese “ose”. Nëse në pjesën e parë të saj, të sipërcituar, dispozita e nenit 160 ka vlerësuar se shkeljet e ligjit që cenojnë rëndë procesin janë shkak për pavlefshmëri, në pjesën e dytë përcaktohen si të tilla tërësia e shkeljeve të ligjit që mund të kenë ndikuar në ndarjen e mandateve të zonës zgjedhore.

Kolegji Zgjedhor në vijim të analizës së mësipërme, vlerëson se shkeljet e vërtetuara në procesin zgjedhor të zgjedhjes së Këshillit të Bashkisë Shkodër në QV nr. 092, janë të tilla që kanë cenuar rëndë integritetin e tyre, pasi Komisioni i Qendrës së Votimit ka dështuar të kryejë një proces zgjedhor legjitim, duke lejuar si administrimin e zgjedhjeve nga një komision i ngritur në mënyrë të paligjshme, ashtu edhe veprime a mosveprime të tjera të paligjshme, që bëjnë të pamundur për të vërtetuar saktësinë e rezultatit të votimit, mbi bazën e votave të zgjedhësve, që kanë votuar vetëm një herë, që kanë shprehur lirisht vullnetin e tyre, duke garantuar parimet bazë të votimit të lirë, të barabartë dhe të fshehtë.

Mbi bazën e këtij vlerësimi, Kolegji Zgjedhor gjen të pabazuar vendimin e KQZ-së, për mospranimin e kërkesës ankimore nr. 108, të paraqitur nga Partia Demokratike e Shqipërisë, duke arritur në përfundimin se kërkimi i ankuesit Partia Demokratike e Shqipërisë për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në QV nr. 092 është i drejtë, ndaj rezultati i saj nuk duhet të përfshihet në Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore Bashkia Shkodër për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës Apelit Tiranë bazuar në nenin 158, pika 1, shkronja “b” dhe pika 3 të Kodit Zgjedhor.

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesëpadisë.
- Shfuqizimin e pikës “2” të vendimit nr. 923, datë 14.07.2015

të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 108 të Partisë Demokratike”.

- Shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve të datës 21 qershor 2015 për Këshillin e Bashkisë Shkodër në Qendrën e Votimit nr. 092, Zona Zgjedhore Bashkia Shkodër, Qarku Shkodër dhe mos përfshirjen e rezultatit të votimit të kësaj qendre në tabelën përmbledhëse.
- Ndryshimin e vendimit nr. 868, datë 06.07.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër, në zgjedhjet vendore të datës 21 qershor 2015”, sipas tabelës përmbledhëse pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Tiranë, 27.07.2015

**Gjyqtar
Andi CIVICI**

**Gjyqtar
Ilir TOSKA**

**Gjyqtar
Edlira PETRI**

**Gjyqtar
Valbon ÇEKREZI**

**Gjyqtar
Kliton SPAHIU**

ZGJEDHJE VENDORE 2015

TABELA PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE

Për kandidatët për këshillin e bashkisë SHKODER

QARKU SHKODER¹

			Gjithsej
1.a	Numri i zgjedhësve që kanë votuar		70018
1.b	Numri i femrave që kanë votuar		26671
2	Fletë votimi të papërdorura		69033
3	Fletë votimi të dëmtuara		959
4	Fletë votimi të gjetura në kuti		70062
5	Vota të pavlefshme		2728
6	Vota të vlefshme		67300
7	Fletë të hedhura gabim		34
Nr.	Subjektet Zgjedhore		
1	Partia Kristian Demokrate e Shqiperise	PKD	750
3	Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	PSD	1677
6	Partia Bashkimi për të Drejtat e njeriut	PBDNJ	655
Aleanca Popullore Për Punë dhe Dinjitet			
7	Partia e të Drejtave të Mohuara e Re	PDM-E RE	300
8	Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	LZHK	593
9	Partia Mendimi Djathtë Liberal	MDL	1055
10	Partia Balli Kombëtar Demokrat	PBKD	771
11	Partia Popullore Kristian Demokrate e Shqipërisë	PPKDSH	194
12	Partia Lëvizja e Legalitetit	PLL	229
13	Partia Republikane	PR	2273
14	Partia Ora e Shqipërisë	POSH	641
15	Partia Demokratike	PD	25353

¹ Pjesë përbërëse e vendimit nr. 39, datë 27.07.2015 të Kolegjit Zgjedhor

16	Partia Balli Kombëtar	PBK	534
17	Partia Konservatore	KONS	46
18	Partia Bashkimi Liberal Demokrat	BLD	598
19	Partia Bashkimi Demokrat	PBD	546
20	Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare	LDK	294
21	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	PAA	989
Totali Aleanca Popullore Për Punë dhe Dinjitet			34416
Aleanca për Shqipërinë Europiane			
22	Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim	PLDN	576
23	Partia Socialiste e Shqipërisë	PS	10884
25	Partia e Pajtimit Kombëtar	PPK	145
26	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	ADK	105
27	Partia Personat me Aftësi të Kufizuar	PPAK	112
28	Partia Ardhmëria Shqiptare	PASH	155
29	Partia Rruga e Lirisë	PRRL	15
30	Partia Socialiste e Vërtetë 91	PSV91	234
31	Partia Socialpunëtore Shqiptare	PSP	298
32	Fryma e Re Demokratike	FRD	771
33	Partia e Reformave Demokratike Shqiptare	PRDSH	33
34	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	PDIU	280
35	Partia për Europeanizimin dhe Integrimin e Shqipërisë	PEISH	89
37	Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	ADS	19
38	Partia e Gjelbër	PGJ	25
39	Aleanca për Barazi e Drejtësi Europiane	ABDE	9
40	Partia Demokracia Sociale	PDS	365
41	Partia Forca Rinia	FRA	150
43	Partia Ligj dhe Drejtësi	PLIDR	612
44	Aleanca Arbnore Kombëtare	AAK	167

45	Partia Shqiptare Atdheu	PSHA	243
47	Lëvizja Socialiste për Integrim	LSI	11790
48	Partia Demokracia e Re Europiane	PDRE	96
49	Partia Komuniste e Shqipërisë	PKSH	42
50	Partia G99	G99	250
52	Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve	PMDE	39
53	Aleanca Demokratike	AD	377
54	Partia Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve	LDSH	99
55	Partia e të Drejtave të Mohuara	PDM	35
57	Partia Socialiste e Moderuar	PSM	625
58	Partia Demokristiane e Shqipërisë	PKD	823
	Totali Aleanca për Shqipërinë Europiane		29463
59	Levizja Demokratike per Vlera Mireqenie Progres	LDVMP	339
	Totali i subjekteve		67300

ANETAR **ANETAR** **KRYESUES**
KLITON SPAHIU **VALBON ÇEKREZI** **EDLIRA PETRI**

ANETAR **ANETAR**
ILIR TOSKA **ANDI CIVICI**

INDEKS

A

- administrata zgjedhore (V.8/2015, fq. 260)
- administrimi si provë: (V.19/2013, fq. 86)
 - i regjistrimeve filmike (V.18/2013, fq. 75)
- afati:
 - ligjor (V.8/2015, fq. 260)
 - prekluziv (rigoroz) (V.13/2015, fq. 284; V.18/2015, fq. 356)
 - i fundëm i regjistrimit të kandidatit (V.13/2015, fq. 284)
- akt:
 - absolutisht i pavlefshëm (V.16/2013, fq. 47)
 - administrativ diskrecional (V.26/2013, fq. 150)
 - relativisht i pavlefshëm (V.13/2013, fq.36; V.8/2015, fq. 260)
 - ekspertimi grafik (V.14/2015, fq. 303)
 - normativ (V.16/2013, fq. 47)
- ambiente publike (V.12/2013, fq. 25)
- anëtarë të KZAZ-së të emëruar kryesisht (V.29/2015, fq. 471)
- anëtar i këshillit bashkiak (V.8/2015, fq. 260)
- ankim në afatin e caktuar nga ligji (V.29/2015, fq. 471)
- ankimimi i vendimit të ndërmjetëm (V.26/2015, fq.464)

B

- barazi:
 - e palëve (V.13/2015, fq. 284)
 - e votës (V.5/2015, fq. 211; V.15/2015, fq. 314; V.39/2015, fq. 509)
- bashki qendër rrethi (V.13/2013, fq. 36)
- baza elektronike (V.24/2013, fq. 130)
- blerja e votave (V.45/2013, fq. 178)
- buxheti i shtetit (V.3/2015, fq. 207)

C

- caktimi:
 - i vendndodhjes së qendrave të votimit (V.2/2015, fq. 198)
 - i Vendeve të Numërimit të Votave (V.13/2013, fq. 36)
- cenim i rëndë i procesit zgjedhor (V.39/2015, fq. 509)

Ç

- çregjistrim i kandidatit (V.13/2015, fq. 284; V.20/2015, fq. 409; V.22/2015, fq. 430)

D

- deformim i vullnetit të zgjedhësve (V.45/2013, fq. 178)
- deklaram i zgjedhjeve si të pavlefshme (V.17/2013, fq. 59)
- detyrim për të marrë vendim (V.13/2015, fq. 284; V.21/2015, fq. 422)
- dënim administrativ (V.39/2013, fq. 170)
- dëshmi penaliteti (V.20/2015, fq. 409)
- dëshmitar (V.8/2015, fq. 260)
- diferencë votash (V.45/2013, fq. 178)
- dokumentacion i kandidimit (V.8/2015, fq. 260)
- dokumenti elektronik si provë (V.5/2015, fq. 211)
- dorëheqja:
 - e kandidatit (V.18/2015, fq. 356; V.22/2015, fq.430)
 - e subjektit zgjedhor (V.18/2015, fq. 356)
- (e) drejta:
 - për t'u zgjedhur (V.18/2015, fq. 356)
 - për të marrë pjesë në short (V.19/2015, fq. 383)
 - për të marrë pjesë në zgjedhje (V.8/2015, fq. 260)
- (të) drejtat e vëzhguesve (V.18/2013, fq. 75)

E

- efektet juridike të vendimeve të Kolegjit Zgjedhor (V.17/2015, fq. 331)
- ekspertim:
 - grafik i nënshkrimeve (V.10/2015, fq. 273; V.17/2015, fq. 331)
 - teknik (V.21/2013, fq. 102)
- emërim i anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit (V.29/2015, fq. 471)

F

- fakt:
 - i paraqitur rishtaz (V.17/2015, fq. 331)
 - i njohur botërisht (V.26/2013, fq. 150)
- fletë votimi të kontestuar (V.21/2013, fq. 102)
- forcë madhore (V.12/2013, fq. 25)
- fshehtësia e votës (V.39/2015, fq. 509)

GJ

- gjetjet e auditëve teknikienë (V.23/2015, fq. 439)

H

- harta:
 - e njësisë së qeverisjes vendore (V.2/2015, fq. 198)
 - e zonave të qendrave të votimit (V.12/2013, fq. 25)
- hartimi i listës së zgjedhësve (V.21/2015, fq. 422; V.23/2015, fq. 439)
- heqja dorë nga kandidimi (V.13/2015, fq. 284; V.18/2015, fq. 356)
- hetim administrativ (V.14/2015, fq. 303)

J

- juridiksion:
 - gjyqësor (V.2/2015, fq. 198)
 - territorial (V.13/2013, fq. 36)

K

- (e) kaluara e kandidatit (V.20/2015, fq. 409)
- kandidat:
 - i regjistruar (V.18/2015, fq. 356)
 - në proces verifikimi (V.18/2015, fq. 356)
- këqyrja:
 - e fletëve të votimit (V.21/2013, fq. 102)
 - e materialit zgjedhor (V.21/2013, fq. 102)
 - e pamjeve filmike (V.21/2013, fq. 102)
- Komision i Zonës së Administrimit Zgjedhor (V.8/2015, fq. 260)
- kompetencë lëndore (V.39/2013, fq. 170; V.2/2015, fq. 198)
- konflikt interesi i anëtarit të KZAZ-së (V.29/2015, fq. 471)

- korrigjim:
 - i shifrave në tabelat e rezultateve (V.24/2013, fq. 130)
 - në tabelën e ZAZ-së (V.19/2013, fq. 86)
- kriteret ligjore (V.12/2013, fq. 25)
- kthim:
 - për korrigjim të dokumentacionit (V.7/2015, fq. 240; V.16/2015, fq. 323)
 - i fondit paradhënie (V.3/2015, fq. 207)
- kufijtë ekzistues të qendrës së votimit (V.12/2013, fq. 25)
- kundërvajtje administrative (V.39/2013, fq. 170)
- kuorumi: (V.1/2013, fq. 13; V.18/2013, fq. 75)
 - për mbledhjen (V.19/2013, fq. 86; V.45/2013, fq. 178)
 - për shqyrtim të kërkesës (V.17/2013, fq.59)
 - për vendimmarrjen (V.19/2013, fq. 86)

L

- legjitimimi i paditësit (V.20/2015, fq. 409)
- liria e votës (V.45/2013, fq. 178)
- lista:
 - mbështetëse e zgjedhësve (V.15/2015, fq. 314)
 - shumëemërore e kandidatëve (V.7/2015, fq. 240; V.8/2015, fq. 260)

M

- mandat (V.15/2015, fq. 314)
- manipulim (V.45/2013, fq. 178; V.39/2015, fq. 509)
- materialet që lejohen të përdoren në qendrën e votimit (V.16/2013, fq. 47)
- mbledhja e nënshkrimeve (V.5/2015, fq. 211; V.14/2015, fq. 303)
- mbledhje e vlefshme (V.17/2013, fq. 59)
- miratim i tabelave përmbledhëse (V.17/2013, fq. 59)
- modelet e kandidimit (V.5/2015, fq. 211)
- mosarritja e kuorunit (V.1/2013, fq. 13)
- moslegjitimimi i paditësit (V.20/2015, fq. 409)
- mosmarrëveshje administrative (V.33/2015, fq. 502)
- mosushtrim kompetence (V.16/2015, fq. 323)
- mungesë:
 - kompetence (V.39/2013, fq. 170)
 - kuorumi (V.45/2013, fq. 178)

N

- natyra jopërfundimtare e vendimeve (V.7/2015, fq. 240)
- ndarja:
 - e mandateve (V.26/2013, fq. 150; V.45/2013, fq.178)
 - e Zonave të Administrimit Zgjedhor (V.1/2013, fq. 13)
- ndërtesa publike me hyrje të lirë (V.12/2013, fq. 25)
- neglizhencë e subjektit zgjedhor (V.16/2015, fq. 323)
- nënshkrime:
 - mbështetëse (V.7/2015, fq. 240; .15/2015, fq. 314)
 - të falsifikuara/të parregullta (V.10/2015, fq. 273; V.14/2015, fq. 303)
- ngritja:
 - e grupeve të numërimit (V.19/2015, fq. 383)
 - e qendrave të votimit në ambiente private (V.12/2013, fq. 25)
- numri i shtetasve me të drejtë vote (V.1/2013, fq. 13)

NJ

- njoftimi i akteve (V.3/2015, fq. 207)

O

- objekte alternative (V.12/2013, fq. 25)
- organ kolegjal (V.5/2015, fq. 211)

P

- pamje filmike (V.19/2013, fq. 86; V.45/2013, fq. 178)
- pandashmëria e territorit të bashkisë/komunës (V.1/2013, fq. 13)
- paraqitja jashtë afatit e kërkesë-padisë (V.25/2013, fq. 146)
- parimi:
 - i disponibilitetit të ankimit (V.17/2015, fq. 331)
 - i ndryshimit (V.26/2013, fq. 150)
 - i proporcionalitetit (V.29/2015, fq. 471)
 - i shqyrtimit reformues (V.26/2013, fq. 150)
- parregullsi që ndikojnë në rezultatin zgjedhor (V.39/2015, fq. 509)
- pasiguri juridike (V.7/2015, fq. 240)
- përbërësi e gjendjes civile (V.21/2015, fq. 422; V.23/2015, fq. 439)
- përfundimi i procesit të ankimit (V.26/2013, fq. 150)
- përsëritje e zgjedhjeve (V.45/2013, fq. 178)
- pragu i votave për përfitim të fondeve nga Buxheti i Shtetit (V.3/2015, fq. 207)

- pranim ankimi (V.17/2013, fq. 59)
- procedura e mbledhjes së nënshkrimeve (V.14/2015, fq. 303)
- proces zgjedhor/parazgjedhor (V.8/2015, fq. 260)
- procesverbali i mbledhjes (V.45/2013, fq. 178)
- propozim i anëtarit të grupeve të numërimit (V.19/2015, fq. 383)
- prova e ekspertimit (V.21/2013, fq. 102)
- pushim i gjyqimit të çështjes (V.25/2013, fq. 146)

R

- regjistrim:
 - i kandidatit (V.9/2015, fq. 268; V.13/2015, fq. 284; V.15/2015, fq. 314; V.18/2015, fq. 356)
 - i listave shumëemërore (V.21/2015, fq. 422)
 - si subjekt zgjedhor (V.21/2015, fq. 422)
 - filmik (V.19/2013, fq. 86)
 - i partive politike (V.3/2015, fq. 207)
- rezultat që ndikon në shpërndarjen e mandateve (V.39/2015, fq. 509)
- rinumërim i votave (V.21/2013, fq. 102; V.24/2013, fq. 130)
- rishikim i listës së zgjedhësve (V.23/2015, fq. 439)
- rivlerësim i votave (V.21/2013, fq. 102; V.24/2013, fq. 130)

S

- subjekt:
 - i legjitimuar (V.39/2013, fq. 170)
 - zgjedhor (V.2/2015, fq. 198; V.3/2015, fq. 207; V.8/2015, fq. 260; V.9/2015, fq. 268; V.33/2015, fq. 502)

SH

- shkarkim i anëtarëve të KZAZ-së (V.29/2015, fq. 471)
- shkelje:
 - që cenojnë procesin zgjedhor (V.45/2013, fq. 178; V.29/2015, fq. 471)
 - konkrete (V.19/2013, fq. 86)
- shpallja e pavlefshme e zgjedhjeve (V.45/2013, fq. 178; V.29/2015, fq. 471)
- shqyrtim i çështjes në themel (V.13/2015, fq. 284)
- shumicë e thjeshtë/e cilësuar (V.45/2013, fq. 178)

T

- tabela:
 - përmbledhëse e rezultatit të zonës zgjedhore (V.45/2013, fq. 178; V.26/2015, fq. 464)
 - origjinale të rezultatit të votimit (V.24/2013, fq. 130)
- tejkalim i afatit ligjor (V.29/2015, fq. 471)
- territor:
 - i pashkëputur gjeografik (V.12/2013, fq. 25)
 - i njësisë më të madhe administrative (V.13/2013, fq. 36)
- tërheqja nga kandidimi (V.20/2015, fq. 409)
- transferimi i shtetasve (V.23/2015, fq. 439)

TH

- thellim i hetimit administrativ (V.21/2013, fq. 102)

U

- ushtrim diskrecioni (V.26/2013, fq. 150)

V

- vendim:
 - absolutisht i pavlefshëm (V.21/2013, fq. 102)
 - i marrë brenda afatit ligjor (V.1/2013, fq. 13)
 - i ndërmjetëm (V.10/2015, fq. 273)
 - i vlefshëm (V.17/2013, fq. 59)
 - përfundimtar (V.10/2015, fq. 273)
 - i KQZ-së që mund të ankimohet në Kolegjin Zgjedhor (V.33/2015, fq. 502)
- verifikim i nënshkrimeve mbështetëse (V.10/2015, fq. 273)
- vërejtje:
 - në librin e protokollit të mbledhjeve (V.21/2013, fq.102)
 - në protokollet e grupeve të numërimit (V.18/2013, fq. 75)
- vërtetim i pasjes së mandatit (V.15/2015, fq. 314)
- vota:
 - të caktuara (V.21/2013, fq. 102)
 - të pavlefshme (V.21/2013, fq. 102)
 - të vlefshme (V.3/2015, fq. 207)
- votim familjar (V.39/2015, fq. 509)

Z

- zbardhja/publikimi i vendimit (V.5/2015, fq. 211)
- zëvendësim i kandidatit (V.13/2015, fq. 284; V.18/2015, fq. 356; V.22/2015, fq. 430)
- zgjedhje të pjeshme (V.45/2013, fq.178)
- zona e qendrës së votimit (V.12/2013, fq. 25)
- zyrë elektorale (V.12/2013, fq. 25)

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Vendime të Kolegjit Zgjedhor : zgjedhjet për Kuvendin 2013,
zgjedhjet e pjesshme 2013 dhe zgjedhjet për organet e qeverisjes
vendore 2015 / Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. –

Tiranë : **Graphic line-01**, 2016

540 f. ; 26X17 cm.

ISBN 978-9928-4311-3-4

1.Zgjedhje 2.Gjykata kushtetuese

3.Vendime gjyqësore

342.565.2(496.5) "2013/2015"

VENDIME PËR REFERENDUMET

***Vendime të Gjykatës Kushtetuese, Kolegjit Zgjedhor
dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
1992 - 2016***

Tiranë, 2016

© Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

ISBN 978-9928-4311-8-9

Ky botim u realizua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve



Shënim:

Ky botim nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Versioni elektronik i këtij botimi gjendet në faqen e internetit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri

www.osce.org/albania

Dizenjimi grafik dhe shtypi: **Graphic Line-01**

info@graphicline01.com, www.graphicline01.com

Përmbajtja e lëndës

<i>Hyrje</i>	<i>Faqja</i>
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.....	6
Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.....	9

I. Vendime të Gjykatës Kushtetuese

1. Vendim nr. 3, datë 23.02.1995.....	13
2. Vendim nr. 44, datë 27.08.1997.....	21
3. Vendim nr. 31, datë 19.11.2003	30
4. Vendim nr. 25, datë 24.07.2009	36
5. Vendim nr. 5, datë 21.01.2011	52
6. Vendim nr. 8, datë 8.03.2013	55
7. Vendim nr. 19, datë 15.04.2015	79

II. Vendime të Kolegjit Zgjedhor

8. Vendim nr. 1, datë 14.01.2015.....	125
9. Vendim nr. 2, datë 16.05.2016.....	183
10. Vendim nr. 3, datë 16.05.2016.....	201
11. Vendim nr. 4, datë 16.05.2016.....	216

III. Vendime të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

12. Vendim nr. 25, datë 25.01.2003.....	233
13. Vendim nr. 37, datë 21.03.2003.....	236
14. Vendim nr. 505, datë 26.08.2003.....	238
15. Vendim nr. 609, datë 29.08.2003.....	241
16. Vendim nr. 1688, datë 25.11.2005.....	245
17. Vendim nr. 1876, datë 26.10.2007	247
18. Vendim nr. 47, datë 5.06.2008	252
19. Vendim nr. 26, datë 28.09.2010	257
20. Vendim nr. 1236, datë 22.12.2011.....	262
21. Vendim nr. 10, datë 28.06.2012	265
22. Vendim nr. 24, datë 14.11.2014	271
23. Vendim nr. 156, datë 14.11.2014	276
24. Vendim nr. 6, datë 23.03.2016	279
25. Vendim nr. 7, datë 23.03.2016	301
26. Vendim nr. 8, datë 23.03.2016	320
27. INDEKS	340

HYRJE

E drejta e popullit për të ushtruar pushtetin nëpërmjet referendumit në raport me zhvillimin e tyre ka qenë një nga temat e debatit mes ekspertëve, partive politike dhe qytetarëve aktivë. Në periudhën post-komuniste janë zhvilluar vetëm tre referendume, dy për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në vitin 1994 dhe në vitin 1998, si dhe referendumi për sistemin e qeverisjes i vitit 1997. E drejta për të ushtruar këtë formë pushteti nga populli ka mbetur gjerësisht pjesë e trajtimit juridik.

Duke qenë se kuadri ligjor kushtetues i vitit 1998 dhe ai i parashikuar në Kodin Zgjedhor që nga viti 2000 nuk kanë ndryshuar, dispozitat ligjore për zhvillimin e referendumeve sipas llojit të tyre, të parashikuara në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor janë të cunguara, shpeshherë shprehin paqartësi të çështjeve që shtrohen për referendum dhe lënë vend për interpretime.

Nisur nga fakti që vendimmarrjet për zhvillimin e referendumeve sipas llojit të tyre janë marrë në vite nga institucione të ndryshme si: Gjykata Kushtetuese, Kolegji Zgjedhor dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (ky i fundit si organi i parë që kontrollon fillimin e procedurave dhe ligjshmërinë e kërkesës së paraqitur për zhvillimin e referendumit), është vënë re se ekziston një paqartësi në nivele të ndryshme të grupeve të interesit dhe në publikun e gjerë të roleve dhe detyrave të institucioneve të ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligji.

Vendimet e gjykatave tashmë kanë krijuar një bazë jurisprudence që mund të shërbejë për ligjvënësit për të adresuar sa më mirë problematikat e hasura, në funksion të respektimit të të drejtave të njeriut dhe respektit për shtetin ligjor dhe të së drejtës. Mirëpo mungesa e një koleksioni të tillë, kishte krijuar një boshllëk të vlerësuar nga të gjithë, duke përshpejtuar në këtë mënyrë idenë për të botuar në format përmbledhës vendime të Gjykatës Kushtetuese, Kolegjit Zgjedhor dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zhvillimin e referendumeve, në vite.

Në cilësinë e institucionit qendror për mbarëvajtjen e zgjedhjeve, kemi treguar vëmendje të veçantë që ky botim të përmbledhë dhe të sistemojë plotësisht të gjithë informacionin e nevojshëm për institucionet, aktorët dhe faktorët e përfshirë në proceset

referendare, për çdo studiues apo hulumtues dhe çdo individ të interesuar në fushën e referendumeve.

Në këtë botim të posaçëm janë përfshirë vendimet e marra nga Gjykata Kushtetuese, Kolegji Zgjedhor dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zhvillimin e referendumeve sipas llojit të tyre.

Së fundmi, ky botim do të jetë funksional, orientues dhe i vlefshëm për të gjithë institucionet dhe të interesuarit që merren dhe janë të përfshirë në proceset referendare, për të kuptuar më mirë qëllimin substancial të legjislacionit për referendumet. Njëherazi, jam e ndërgjegjshme se nuk më takon mua, por individëve, studiuesve, etj. të shprehin vlerësime për formatin e këtij koleksioni. Madje kuptimi i roleve dhe përgjegjësi të institucioneve të ndryshme do të shërbejë për rritjen e kontributit qytetar për zhvillimin e referendumeve demokratike dhe transparente në përputhje me standartet e kërkuara.

Lefterije LUZI

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

I dashur lexues,

Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë baza e demokracisë. Të gjitha Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, përfshirë Shqipërinë, janë shprehur për vlera dhe angazhime të përbashkëta në fushën e zgjedhjeve dhe të shtetit të së drejtës. Përgjatë viteve, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka ndihmuar institucionet shqiptare që të përmirësojnë proceset zgjedhore dhe i ka fuqizuar ato për t'i organizuar zgjedhjet në mënyrë të pavarur, transparente dhe profesionale, siç i kërkojnë qytetarët.

Në këtë kontekst, Prezenca e OSBE-së në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë përgatitën këtë përmbledhje me vendimet që ato kanë marrë lidhur me referendumet nga viti 1992 deri në vitin 2016, me qëllim që të shërbejë si mjet praktik referimi për gjyqtarët, ekspertët dhe profesionistët e kësaj fushe.

Ky botim është pjesë e një serie me tre vëllime me vendime për zgjedhjet dhe referendumet. **Vëllimi i parë** përmban vendime të Gjykatës Kushtetuese për zgjedhjet që nga krijimi i saj në vitin 1992. **Vëllimi i dytë** përmban jurisprudencën e Kolegjit Zgjedhor për zgjedhjet e 2013-ës dhe 2015-ës. **Vëllimi i tretë** përmban vendime të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe vendime të gjykatave për referendumet që nga viti 1992.

Kjo seri, e parë këtij lloji në Shqipëri, synon t'i bëjë vendimet e këtyre institucioneve lehtësisht të arritshme për një sërë aktorësh. Ajo jo vetëm informon publikun për vendimet e institucioneve përkatëse lidhur me zgjedhjet dhe referendumet, por edhe ndihmon aktorët kryesorë të zgjedhjeve - përfshirë Kuvendin, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, shoqërinë civile dhe studiuesit - në punën e tyre. Të interesuarit mund të gjejnë kopje të kësaj serie, ndër të tjera, në Kuvend, në Bibliotekën Kombëtare, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës. Atëmund ta gjeni edhe në faqen e internetit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri (www.osce.org/albania).

U jam mirënjohës, si gjithmonë, Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Kryetaresë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Kryetarit

të Gjykatës së Apelit Tiranë si dhe administratës së këtyre institucioneve për partneritetin dhe bashkëpunimin në finalizimin e procesit të përgatitjes së këtij botimi. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri vazhdon të jetë partnere dhe mbështetëse e institucioneve shqiptare në realizimin e aspiratave të vendit.

Robert Wilton

Kryetar në detyrë i

Prezencës së OSBE-së në Shqipëri

I. Vendime të Gjykatës Kushtetuese

Vendim nr. 3, datë 23.02.1995

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Feti Gjilani, Zv/kryetar, Manol Konomi, Veli Budo, Franc Jakova, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Metush Saraçi, Hilmi Dakli, anëtarë, me sekretare Drita Filto, në datat 28.12.1994 dhe 23.02.1995, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.15/4 Akti, që i përket:

KËRKUES: GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE, GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALDEMOKRATE, përfaqësuar nga Skënder Gjinushi kryetar dhe Paskal Milo anëtar.

OBJEKTI: Deklarimi antikushtetues i ligjit nr.7866, datë 6.10.1994 “Për Referendumet”, të nenit 2 të këtij ligji si dhe të vendimit nr.262, datë 10.10.1994 “Për miratimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë me referendum”

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relacionin përkatës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Më parë është e nevojshme të vihet në dukje se partitë politike, të përfaqësuara nga grupet parlamentare, që i janë drejtuar kësaj Gjykate për shpalljen antikushtetues të ligjit “Për Referendumet”, të nenit 2 të këtij ligji si dhe të vendimit të Kuvendit Popullor “Për miratimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë me referendum”, kanë marrë pjesë në referendumin e 6 nëntorit, me alternativë të vetme “pro” ose “kundra” projektit të Kushtetutës. Kjo pjesëmarrje përbën një legjitimim të këtij referendumi dhe të dispozitave, në virtut të të cilave ai është vendosur, është një legjitimim “a priori” i rezultateve të referendumit.

Gjykata çmon se është detyrë e saj që të hyjë, edhe në kushtet post-referendare, në meritë të çështjes dhe të shqyrtojë në themel pretendimet e palëve, pavarësisht nga mendimi që ka shfaqur Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste. Ligji nr.7866, datë 6.10.1994 është

gjithnjë në fuqi, sepse ky ligj ve disa parime, cakton rregullat për organizimin dhe zhvillimin e referendumeve në përgjithësi.

Përmbajtja e nenit 2 të ligjit “Për referendumet” nuk ka karakter antikushtetues, për arsye se nuk vjen në kundërshtim me nenin 3 paragrafi II të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe as me nenin 16 pika 2 të këtij ligji.

Paragrafi i dytë i nenit 3 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” thotë: “Populli e ushtron pushtetin nëpërmjet organeve përfaqësuese të tij si dhe me referendum”.

Nga një analizë kritike e përmbajtjes së kësaj dispozite, duke patur gjithnjë parasysh dhe nenin 15, del e qartë:

a) Populli është mbajtës i vetëm i sovranitetit, ndërsa organet përfaqësuese të tij e ushtrojnë këtë sovranitet në emër të popullit dhe, në asnjë rast, në mënyrë absolute;

b) Populli ka të drejtë të konkurrojë drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij në bërjen e ligjeve dhe në mënyrë të veçantë e para së gjithash të ligjit suprem: bazë dhe burim i së drejtës pozitive.

Një interpretim i kësaj norme të ligjit kushtetues në kuptim të kundërt ose të ndryshëm nuk ka bazë konstitucionale, cenon rëndë parimin dhe nocionin e sovranitetit të popullit, mohon një nga atributet kryesore të këtij sovraniteti.

Neni 2 i ligjit “Për referendumet” u përmbahet plotësisht kërkesave të kartës kushtetuese. Ky nen nuk ka karakter prescriptiv, detyrues, nuk parashikon se miratimi i kushtetutës bëhet vetëm me referendum të drejtpërdrejtë nga populli duke përjashtuar çdo rrugë tjetër; ai shtron mundësinë e miratimit të kushtetutës me referendum në përgjithësi.

Shqyrtimi i normës së nenit 2 të ligjit “Për referendumet” dhe qëndrimi ndaj saj nuk duhet të bëhet i shkëputur nga fakti se është në kompetencën e Kuvendit Popullor të vendosi ose jo miratimin e kushtetutës me referendum dhe formën e këtij referendumi. Në dritën e këtyre rrethanave, pikëpamja se, sipas nenit 2 të ligjit “Për referendumet” miratimi i kushtetutës “de juris et de jure” duhet të bëhet me referendum të drejtpërdrejtë nga populli, është iracionale, dhe nuk ka asnjë bazë ligjore.

Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate mbron tezën se pranimi i referendumit në paragrafin e dytë të nenit 3 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, nuk kupton “aplikimin e referendumit për çdo problem e në çdo rast”, duke lënë kështu të kuptohet se referendumi nuk aplikohet për miratimin e kushtetutës.

Një metodë teleologjike interpretimi, e mbështetur në parafytyrime subjektive dhe duke u larguar krejtësisht nga norma e tekstit, lejon të arrihet në një konkluzion të atillë.

Siç u theksua më lart, referendumi si atribut i sovranitetit dhe si rrugë e realizimit të tij, nuk mund të përjashtohet nga asnjë ligj kushtetutes, nuk përjashtohet dhe as nga përmbajtja e paragrafit të dytë të nenit 3 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, duke zbatuar të njëjtën metodë interpretimi, ve në kontraponim njëra me tjetrën dy dispozita të së njëjtës kartë kushtetuese dhe që janë në harmoni midis tyre ose, më saktë, ve në kontraponim një dispozitë me karakter të posaçëm me një dispozitë që shpreh një parim me vlerë të përgjithshme dhe konkretisht, nenin 3 paragrafi II me nenin 16/2. Veç kësaj, përmbajtjes të nenit 3 paragrafi II i vihen kufizime, ndërsa nenit 16/2 i jepet një karakter absolut, me përfundimin se neni 16/2 nuk le asnjë mundësi interpretimi për miratimin e kushtetutës me referendum.

Gjykata çmon se as “latissimo sensu” nuk mund t’i jepet interpretimi i sipërm përmbajtjes së nenit 16/2 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, sepse kjo vjen në kundërshtim flagrant me konceptin e sovranitetit të popullit. Neni 16/2 i njuh Kuvendit Popullor të drejtën, i jep atij kompetencën që të miratojë ose të ndryshojë kushtetutën, por kurrësi nuk i konferon një pushtet absolut.

Eshtë me vend të përmendet këtu doktrina e famshme sipas së cilës “në rast se kushtetuta detyron organet e themeluara, (constitues) ajo nuk mund t’i heqë popullit lirinë që të shprehë vullnetin e tij..., populli është i lirë që të shprehë vullnetin e tij në çdo formë dhe të gjitha format janë të mira dhe vullneti i tij është gjithnjë ligj suprem”. Në këtë doktrinë ka bazën parimi se ligjet referendare nuk u shtrohen rregullave procedurale konstitucionale, parim i cili ka gjetur zbatim edhe në jurisprudencën konstitucionale të shteteve evropiane.

Pretendimi, nga njëra anë, se dispozitat kushtetuese në fuqi (neni 3 paragrafi II e 16/2) “nuk lenë asnjë mundësi interpretimi për miratimin e Kushtetutës me referendum të drejtpërdrejtë” dhe mbrojtja, nga ana tjetër, e tezës se këto dispozita “e shumta lenë të hapur mundësinë e ratifikimit të kushtetutës nga populli pas miratimit të saj në parlament” janë të papajtueshme dhe nuk gjejnë asnjë mbështetje në përmbajtjen e këtyre dispozitave; ato janë të papranueshme nga pikëpamja juridike.

Interpretimi i një ligji në përgjithësi e sidomos interpretimi i normave kushtetuese duhet të qëndrojë brenda disa kufijve të caktuara, të cilat nuk mund dhe nuk duhet të kapërcehen, duke u dhënë këtyre normave një kuptim të huaj nga përmbajtja dhe fryma, duke i dhënë një teksti të qartë një sens polisemik, si në rastin konkret: përjashtohet, në mënyrë kategorike, mundësia e miratimit të Kushtetutës me referendum të drejtpërdrejtë nga populli dhe pranohet mundësia e pranimi të saj me referendum, me konditë që të jetë miratuar më parë në parlament.

Eshtë parim i njohur se miratimi i kushtetutës dhe i ndryshimeve në të nuk mund të bëhen veçse me ligj kushtetues. Eshtë, gjithashtu, parim i njohur se një ligj kushtetues miratohet me quorum e votave që parashikohet me ligj.

Neni 2 i ligjit “Për referendumet” nuk ka karakter kushtetues sepse nuk plotëson, as ndryshon një dispozitë kushtetuese, prandaj nuk i shtrohet kërkesës së nenit 43 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, quorumit të 2/3 të votave të të gjithë deputetëve. Neni 2 i ligjit “Për referendumet”, siç u argumentua më lart, është një normë e thjeshtë, e cila shtron mundësinë e miratimit të kushtetutës me referendum si dhe të disa çështjeve të tjera të përmendura në mënyrë indikative.

Sipas praktikave të shteteve europiane dhe kushtetutave të këtyre vendeve, miratimi i kushtetutës bëhet nga një organ i posaçëm (Asamble Konstituente) e zgjedhur me mandatin preçiz: miratimin e kushtetutës, nga dhoma e deputetëve; në sistemet bikamerale, nga kjo Dhomë së bashku me Dhomën e Lartë (Senatin), nga populli me referendum të drejtpërdrejtë ose mbasi ajo të jetë miratuar më parë në parlament. Sidoqoftë, gjykata e çmon të nevojshme të nënvizojë se kjo nuk ka lidhje direkte me çështjen, nuk ndihmon në zgjidhjen e problemit në një drejtim ose në drejtim të kundërt: të qenit ose jo antikushtetues të nenit 2 të ligjit “Për referendumet”.

Me shtesën 4/a që i është bërë nenit 28 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me ligjin nr.7558, datë 09.04.1992, parashikohet se: “Presidenti i Republikës i propozon Kuvendit Popullor për referendume popullore”. Kjo prerogativë e Presidentit të Republikës nuk është e kufizuar vetëm në disa çështje, por ajo ka një shtrirje të gjerë duke përfshirë edhe miratimin e kushtetutës. Njohja e kësaj të drejte Presidentit të Republikës, me kufizime, duhej të ish shprehur në ligj.

Botimi i një ligji në Fletoren Zyrtare dhe kalimi i një afati pas botimit, kërkohet si kusht i domosdoshëm për hyrjen në fuqi, për

ligjet me efekt ndaj personave fizikë ose juridikë, për ato që krijojnë të drejta dhe detyrime, që detyrojnë ose ndalojnë kryerjen e një veprimi, sepse ndryshe nuk mund të zbatohet prezumimi “nemo censetur ignorare legem” (askush nuk mund të quhet se nuk e njeh ligjin). Për ligjet organike dhe për ato që kanë cilësinë e një ligji organik nuk kërkohet respektimi i kushteve të përmendura në nenin 23 paragrafi II të ligjit kushtetues.

Hyrja në fuqi e ligjit “Për referendumet”, siç parashikohet në nenin 42, menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare, është në pajtim të plotë me përmbajtjen e paragrafit të dytë të nenit 23 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe për rrjedhojë ky ligj, për efekt të këtij neni 23 dhe vendimi i Kuvendit Popullor nr.262, datë 10.10.1994, nuk paraqesin ekstremet e një akti antikushtetues.

Ligji “Për referendumet” është shpallur nga Presidenti i Republikës më datë 07.10.1994 dhe në të njëjtën datë është botuar në Fletoren Zyrtare, ndërsa vendimi i Kuvendit Popullor për miratimin e Kushtetutës me referendum është marrë më 10.10.1994, dmth., pas hyrjes në fuqi të ligjit të sipërpërmendur.

Kontradiktat dhe të metat që përmban, sipas pretendimit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, neni 2 “Për referendumet” nuk formojnë objekt shqyrtimi nga kjo gjykatë, për shkak se nuk hyjnë në kompetencën e saj. Ato janë të meta që mund të përmirësohen, me kërkesën e palës së interesuar, nga vetë ligjvënësi.

Së fundi, Gjykata çmon se pretendimi i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste se ligji për referendumet është antikushtetues “sepse në votimin e tij kanë marrë pjesë gjithsej 63 deputetë, që janë më pak se numri i domosdoshëm që kërkohet”, pasi, sipas nenit 43 të Rregullores së Parlamentit, “ligji mund të miratohet kur në votimin marrin pjesë më tepër se gjysma e numrit të përgjithshëm të deputetëve” është i gabuar dhe i pabazuar në ligj.

Neni 43 i Rregullores së Kuvendit Popullor nuk kërkon për miratimin e një ligji që të kenë votuar pro më tepër se gjysma e numrit të përgjithshëm të deputetëve, por ai i referohet rregullit të pranuar nga neni 23 i ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, sipas të cilit një ligj quhet i pranuar kur kanë votuar për të shumica e deputetëve të pranishëm, por jo më pak se një e treta e të gjithë deputetëve.

Nga shqyrtimi i dokumentave del se në mbledhjen e Kuvendit Popullor për shqyrtimin dhe miratimin e ligjit për referendumet, kanë

qenë të pranishëm, gjer në përfundimin e diskutimeve shumica e deputetëve që kërkohet nga neni 43 i Rregullores (105 deputetë), kanë marrë pjesë dhe kanë votuar pro 63 deputetë, dmth, shumica e deputetëve të pranishëm e më shumë se një e treta e numrit të përgjithshëm të deputetëve, siç parashikohet nga neni 23 i ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Abstenimi ose largimi i një numri të caktuar deputetësh nga mbledhja në kohën e votimit nuk ndikon ndaj shumicës (quorum) që kërkohet nga neni 23 i ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe as ndaj shumicës që parashikohet nga neni 43 i Rregullores së Kuvendit Popullor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 24, pikat 2 e 3 dhe 26 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesave të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate dhe Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për deklarimin antikushtetues të ligjit nr.7866, datë 6.10.1994 “Për referendimet”, të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të vendimit nr.262, datë 10.10.1994 të Kuvendit Popullor “Për miratimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë me referendum”.
- Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

MENDIMI I PAKICËS

Jemi kundër këtij vendimi, sepse ai vjen në kundërshtim me dispozitat kryesore kushtetuese:

Para së gjithash, nënvizojmë se nuk gjen asnjë mbështetje në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe as në legjislacionin e në përvojën historiko-kushtetuese krahasimore të vendeve me demokraci të konsoliduar arsyetimi i shprehur që në paragrafin e parë të këtij vendimi se: “Pjesëmarrja e partive politike, të përfaqësuara nga grupet parlamentare, të cilat i janë drejtuar kësaj Gjykate për shpalljen antikushtetues të nenit 2 të ligjit “Për Referendimet”

dhe të vendimit të lartpërmendur të Kuvendit Popullor përbën një legjitimim të këtij referendumi dhe të dispozitave, në virtyt të të cilave, ai është vendosur ...”. Pathemelësia e tejskajshme e këtij arsyetimi rezulton pa asnjë mëdyshje nga vetë fakti se legjislatori ynë dhe as ai i cilido shteti demokratik nuk pengon kurrësi ndonjë parti politike që të marrë pjesë në një referendum, qoftë edhe vetëm për të argumentuar antikushtetutshmërinë e objektit të atij referendumit dhe për të kërkuar nga elektorati që të votojë kundër tij. Mospajtimi me dispozitat kryesore kushtetuese e këtij vendimi del shumë qartë në pah sidomos nga shqyrtimi i dispozitave të poshtëshënuara të paketës së ligjeve kushtetuese në fuqi të shtetit tonë të së drejtës.

Sikurse dihet në nenin 16, pika 2 të ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, është përcaktuar shprehimisht se Kuvendi Popullor ka, ndër të tjera, edhe këtë kompetencë kryesore: “Miraton e ndryshon Kushtetutën dhe ligjet”. Kjo dispozitë është ndërtuar në bazë, për konkretizimin dhe zbatimin e nenit 3 të po këtij ligji kushtetues ku është sanksionuar tekstualisht sa vijon: “Populli ushtron pushtetin nëpërmjet organeve përfaqësuese të tij si edhe me referendum”.

Nga interpretimi logjik e sistematik i përmbajtjes së këtyre dy dispozitave konkludohet, pa ndonjë mëdyshje, se miratimi tërësor i drejtpërdrejtë i projektkushtetutës, si përbërës shumë thelbësor i sovranitetit të popullit, është, sipas legjislacionit tonë kushtetues në fuqi de lege lata, një kompetencë ekskluzive (prerogativë) e Kuvendit Popullor, e cila, duke patur këtë natyrë juridike absolute, përjashton mundësinë alternative për një miratim të tillë të projektkushtetutës me referendum.

Për bazueshmërinë e këtij interpretimi është shumë domethënës dhe elokuent fakti se asnjë dispozitë e paketës së ligjeve tonë kushtetuese në fuqi nuk parashikon mundësinë e miratimit tërësor të projektkushtetutës me referendum të drejtpërdrejtë nga zgjedhësit. Në dritën e përmbajtjes tekstuale e krejt të kthjelltë të dispozitave kushtetuese, që u parashtruan më lart, nuk mund të mos arrihet në përfundimin se interpretimi i shprehur në këtë vendim të kësaj Gjykate se, me gjithë qënien në fuqi të nenit 16, pika 2 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, miratimi tërësor i Kushtetutës me referendum nga zgjedhësit gjen mbështetjen e vet në nenin 3 të po këtij ligji (nen i cili ritheksojmë se përfshihet në dispozitat e përgjithshme të tij dhe është konkretizuar qartë, përta i përket

miratimit të Kushtetutës, në nenin 16, pika 2), është një interpretim tejet i pathemeltë apo, më saktë “ad libitum”.

Natyrisht neni 3 lejon realizimin e llojeve të tjera të referendumeve siç janë, para së gjithash, referendumi ratifikues ose konfirmues, dmth., aprovimi përfundimtar me referendum i Kushtetutës pasi teksti i saj të jetë miratuar paraprakisht nga Parlamenti ose Asambleja Kushtetuese (që është praktikuar gjerësisht në gjysmën e dytë të shekullit tonë, si psh., në vitin 1978 në Spanjë, në vitin 1991 në Rumani, si edhe në disa vende të Kontinentit Afrikan e të Amerikës Latine), referendumi pezullues ose shfuqizues i një ligji, si edhe të gjitha çështjet e tjera që përfshihen në kuadrin e nocionit të referendumit në kundërdallim nga ai i plebishitit.

Si rrjedhojë, për miratimin tërësor të projektkushtetutës me referendum të drejtpërdrejtë nga zgjedhësit ishte i domosdoshëm shfuqizimi i pikës 2 të nenit 16 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe natyrisht ky shfuqizim duhej bërë me një shumicë prej jo më pak se dy të tretave të të gjithë deputetëve, siç kërkohet nga paragrafi 2 i nenit 43 të po këtij ligji.

Nga sa u parashtrua më lart rezulton shumë qartë se vjen në kundërshtim flagrant me dispozitat e lartpërmendura të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, fraza e parë e nenit 2 të ligjit nr.7866, datë 06.10.1994 “Për Referendumet”, e cila ka fjalë për fjalë këtë përmbajtje: “Referendumi mund të vendoset për të miratuar Kushtetutën dhe amendamentet e saj ...”.

Siç dihet, ky është një ligj i zakonshëm dhe si i tillë nuk mund të cenohet asnjë dispozitë të ligjeve kushtetuese. Si rrjedhojë është antikushtetues edhe vendimi i Kuvendit Popullor nr.262, datë 10.10.1994 “Për miratimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë me referendum”, i cili është nxjerrë në bazë e në zbatim të ligjit të zakonshëm “Për Referendumet”.

Zv. Kryetar: Feti Gjilani, Anëtar: Veli Budo

*
* *

Vendim nr. 44, datë 27.08.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar, Hilmi Dakli, Manol Konomi, Veli Budo, Franc Jakova, Halil Kopani, Zija Vuci, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, anëtarë, me sekretare Arbenka Lalica, në datë 31.07.1997 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.46 Akti që i përket:

KËRKUES: PARTIA LEVIZJA E LEGALITETIT,

përfaqësuar nga Guri Durollari, kryetar dhe avokat Kleanth Koçi.

PARTIA SOCIALDEMOKRATE,

përfaqësuar nga Isak Spahiu.

SUBJEKT I INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I

ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Kristaq Kume, kryetar dhe Fatos Klosi, zv/kryetar.

OBJEKTI:

Shfuqizimi i vendimeve nr.1355, datë 13.07.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të Referendumit”, në bazë të nenit 18/1 të ligjit nr.7866, datë 06.10.1994 “Për Referendumet” dhe datë 13.07.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për rezultatet e shpallura nga komisioni i zgjedhjeve të zonës nr.2.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi përfaqësuesit e kërkuësve, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në datë 29 qershor 1997 u zhvillua referendumi i përgjithshëm për formën e qeverisjes me alternativat: “Republikë” ose “Monarki Kushtetuese”. Shpallja e rezultateve përfundimtare të referendumit u bë me vendimin nr.1355, datë 13.07.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas të cilit ka fituar forma e qeverisjes “Republikë” me 904.359 vota ose 66,75 %.

Partia Lëvizja e Legalitetit ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke parashtruar këto shkelje:

Procesi i votimit u karakterizua nga të meta serioze si para ashtu edhe gjatë votimit dhe veçanërisht në numurimin e votave, pati demonstrim force e përdorim armësh, ditën e votimit në shumë qendra mungonin listat e zgjedhësve e fletët e votimit, në shumë qendra votimi nuk janë numëruar votat - tipike është zona nr.75 Lushnje ku mungon plotësisht rezultati i referendumit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pranon një sërë vërejtjesh esenciale dhe nuk i merr parasysh me arsyetimin se kanë ndikuar paanshmërisht si për Republikën edhe për Monarkinë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka shpallur rezultatin me 8 vota pro e 6 kundër, janë shkelur disa nene të ligjit nr.7866, datë 06.10.1994 “Për Referendumet” - të rënda janë shkeljet e neneve 23 e 27.

Në seancë gjyqësore, kërkuesi, veç sa sipër, parashtron edhe këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:

Zhvillimi i referendumit në të njëjtën ditë me zgjedhjet për deputetët e Kuvendit Popullor ishte një gjetje e gabuar e cila solli si rezultat shkelje ligjore të rënda, ka patur demonstrime me armë, mungesë të dokumentacionit, procesverbale pa firmë, me korrigjime etj., pranohet se janë shpërndarë fletë votimi aq sa ka qenë numuri i përgjithshëm i shtetasve të regjistruar për votim, kur në bazë të nenit 23 të ligjit duhet 2 % më shumë, ne kemi pretenduar e vërtetuar se nuk janë shpërndarë disa qindra - mijë fletë votimi, nuk mund të bëhen arsyetime me përafërsi për pasojat dhe të quhen të rënda kur dëmtohet njëra alternativë dhe të lehta kur dëmtohen të dy alternativat, ndryshimi i mënyrës së votimit për referendumin pa u ndryshuar ligji, është arbitrar. Po të zbatohet kërkesa e ligjit, rezultati përmbysset. Ne nuk pretendojmë për këtë përmbysje por kemi të drejtë të themi se jemi para një procesi zgjedhor të paligjshëm.

Gjykata Kushtetuese konstaton se në bazë të nenit 1/2 të dekretit nr.1808, datë 06.06.1997, Partia Lëvizja e Legalitetit, njihet si “nismëtare e referendumit”, prandaj me këtë cilësi ajo legjitimohet për të bërë kërkesë. Gjithashtu, kërkuesi është brenda afatit ligjor të ankimit për faktin se vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i është njoftuar në datë 14 korrik 1997 dhe kërkesën e ka paraqitur në 16 korrik 1997.

Para se t'i hyjë shqyrtimit të pretendimeve të kërkuetit, Gjykata thekson se procesi i referendumit për formën e qeverisjes

është paraprirë dhe bazuar në një sërë dispozitash ligjore, që përcaktojnë kushtet dhe procedurat e zhvillimit të referendumeve. Kështu, sipas nenit 3 të ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, “Populli e ushtron pushtetin nëpërmjet organeve përfaqësuese të tij si dhe me referendum”. Në nenin 16/7, ndër kompetencat kryesore të Kuvendit Popullor, përcaktohet se “vendos për referendumet popullore”. Ndërsa neni 28/4 përcakton se Presidenti i Republikës “Shpall ligjet dhe referendumet e vendosura nga Kuvendi Popullor”. Në mbështetje të këtyre neneve të ligjit kushtetues, Kuvendi Popullor ka miratuar ligjin nr.7866, datë 06.10.1994 “Për referendumet”, i cili parashikon procedurat për organizimin dhe zhvillimin e referendumeve. Për referendumin e datës 19 qershor 1997, Kuvendi Popullor në mbështetje të nenit 16 pika 7 të ligjit themelor, me vendimin nr.310, datë 13.05.1997 ka vendosur thirrjen e referendumit të përgjithshëm për formën e qeverisjes, republikë ose monarki kushtetuese, në të njëjtën ditë me zgjedhjet për deputetët e Kuvendit Popullor. Ndërsa Presidenti i Republikës me dekretin nr.1798, datë 21.05.1997 ka shpallur referendumin e vendosur nga Kuvendi Popullor.

Sa sipër Gjykata çmon se caktimi i referendumit për formën e qeverisjes në datë 29 qershor 1997 është bërë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi.

Kërkuesi e konsideron shkelje të rëndë dhe të patolerueshme ndryshimin e mënyrës së votimit për referendumin pa u ndryshuar ligji dhe pretendon se jemi para një procesi zgjedhor të paligjshëm. Duke shqyrtuar këtë pretendim Gjykata konstaton se mënyra e votimit nuk është bërë sipas nenit 27 të ligjit nr.7866, datë 06.10.1994 “Për referendumet”, por sipas mënyrës së caktuar në ligjin për zgjedhjen e deputetëve të Kuvendit Popullor. Në nenin 27 të ligjit për referendumet thuhet se: “Shtetasi që voton le pa prekur atë alternativë në favor të së cilës është, duke i vënë vizë alternativës tjetër”. Në fakt votimi dhe numërimi i votave është bërë në mënyrë tjetër duke u quajtur kundër alternativa e paprekur dhe pro ajo që është prekur. Por, duke analizuar në tërësi këtë fakt, Gjykata çmon se ndodhemi para një moszbatimi formal të kërkesës së ligjit që nuk ka sjellë ndonjë pasojë. Përkundrazi, pavarësisht nga ndryshimi i mënyrës së votimit, duke u njësuar kjo me atë të zgjedhjes së deputetëve, votuesit e kanë shprehur drejt vullnetin e tyre për alternativën që kanë dëshiruar. Kjo për faktin se përveç sqarimeve paraprake e të vazhdueshme në masmedia, procedura

e votimit ka qenë e tillë që çdo votuesi iu dhanë dy fletë votimi, një për deputetët dhe një për referendumin duke iu sqaruar edhe mënyrën e njëjtë të votimit. Është pikërisht kjo mënyrë e njëjtë votimi që garanton shprehjen e vullnetit të drejtë të shtetasve, gjë që nuk mund të thuhet në rast se mënyrat e votimit do të ishin të ndryshme.

Përsa i përket pretendimit tjetër se është shkelur neni 23 i ligjit sepse nuk janë shpërndarë fletë votimi në masën 2 % më shumë se numri i përgjithshëm i shtetasve të regjistruar për votim, që është 1.986.550, Gjykata çmon se ky nuk duhet të merret në konsideratë për faktin se numri i shtetasve që kanë marrë pjesë në votime është 1.423.209, pra fletë votimet e shpërndara e kalojnë ndjeshëm numrin e votuesve.

Për mënyrën e marrjes së vendimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të cilën kërkuesi e konsideron të parregullt, ligji “Për referendimet” nuk shprehet, por Gjykata çmon se vendimi është marrë në mënyrë të rregullt me shumicë të thjeshtë votash.

Pretendimet e tjera të ngritura nga kërkuesi kanë të bëjnë me shkelje e parregullsi gjatë procesit të votimit për referendumin, të cilat janë analizuar edhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ky i fundit ndonëse i pranon ato, shprehet në vendim se “natyra dhe madhësia e këtyre parregullsive ka një ndikim të vogël në normalitetin e referendumit, ndikim që influencon paanshmërisht si për Republikën ashtu edhe për Monarkinë”.

Lidhur me këtë përfundim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe pretendimet e kërkuesit, Gjykata çmon se rëndësi ka fakti se në ç’madhësi janë parregullsitë dhe sa ndikojnë ato në rezultatin përfundimtar. Në këtë kuptim, në rast se për shkeljet e pretenduara dhe të njohura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të merreshin në favor të Monarkisë të gjitha votat e mundshme, përsëri kjo nuk ndikon në rezultatin përfundimtar, sepse shumica e tyre nuk i kalon 6 %.

Në këto rrethana, kërkesa e paraqitur nga Partia Lëvizja e Legalitetit për shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe deklarin të pavlefshëm të procesit të referendumit, nuk është e bazuar.

Gjykata mori në shqyrtim edhe kërkesën e Partisë Socialdemokrate, e cila kërkon të shfuqizohet vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.1371, datë 16.07.1997, që ka lënë në fuqi vendimin e komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.2 në favor të Monarkisë si dhe të përsëritet votimi për referendumin në këtë zonë. Si shkak për këtë kërkuesi parashtron se rezultatet e votimit

në këtë zonë janë të manipuluara, procesi zgjedhor është bërë me parregullsi të mëdha dhe se procesverbali i zonës është bërë pa procesverbalet e qendrave të votimit duke i improvizuar ato. Gjatë gjykimit kërkuesi nuk paraqiti prova për të vërtetuar pretendimet që parashtron, prandaj kjo kërkesë duhet të rrëzohet si e pabazuar.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ka shpallur rezultatet e referendumit për formën e qeverisjes, është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 24 e 25 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, si dhe në nenin 18 të ligjit nr.7866, datë 06.10.1994 “Për referendumet”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesave.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Jemi në kundërshtim me vendimet e shumicës për këto arsye:

Në bazë të nenit 27 të ligjit nr.7866, datë 06.10.1994 “Për Referendumet”, shtetasi që merr pjesë në votim, le të paprekur në fletën e votimit, alternativën në favor të së cilës është, duke i vënë vizë alternativës tjetër.

Përmbajtja e kësaj dispozita ligjore është e qartë dhe, si çdo dispozitë ligjore ka fuqi dhe karakter detyrues. Mënyra e votimit e parashikuar nga neni 27 i ligjit për referendumet nuk mund të ndryshohet as të zëvendësohet veçse me ligj. Në këtë këndvështrim ligjor, largimi nga përmbajtja e kësaj norme të nenit 27, kurrësesi nuk mund të konsiderohet formale, por në të kundërt ndodhemi përpara një shkelje me rëndësi të ligjit dhe për pasojë dhe të procesit zgjedhor për referendumin e 29 qershorit 1997 për formën e qeverisjes në Republikën e Shqipërisë: Republikë ose Monarki Kushtetuese.

Zhvillimi i referendumit në një kohë me zgjedhjet e deputetëve në Kuvendin Popullor, për të cilat zgjedhje parashikohet një mënyrë votimi e kundërt nga ajo për referendimet, nuk është një shkak dhe nuk përbën bazë ligjore për të zbatuar njërën ose tjetrën nga mënyrat e parashikuara nga ligji për referendimet ose nga ajo për zgjedhjet legjislative.

Nga ana tjetër asnjë organ shtetëror, duke përfshirë dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve - pavarësisht se ky komision ka marrë ose jo të gjitha masat për të bërë të njohur vendimin e tij - nuk është kompetent dhe nuk ka të drejtë të veprojë në kundërshtim me urdhërimet e nenit 27 të ligjit për referendimet dhe të nenit 68 të ligjit nr.8218, datë 16.05.1992, duke i dhënë preferencë njëres ose tjetres mënyrë votimi të caktuar nga dispozitat e sipërme.

Zhvillimi i referendumit në të njëjtën kohë me zhvillimin e zgjedhjeve të deputetëve në Kuvendin Popullor dhe për të mënjeluar çdo konfuzion, e bënte të nevojshme që neni 27 i ligjit për referendimet të ndryshohej duke e harmonizuar me nenin 68 të ligjit për zgjedhjen e organit ligjvënës, ashtu siç i kaluan me ligj detyrat e komisioneve të komunave, bashkive dhe rretheve, komisioneve të zonave të zgjedhjeve të ngritura në bazë të ligjit nr.8218, datë 16.05.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor”.

Eshtë e vështirë të kuptohet arsyetimi se “moszbatimi formal i kërkesës së ligjit (ndryshimi i parashikuar nga neni 27 i ligjit për referendimet, në mënyrën e votimit) nuk ka sjellë pasoja”, por “përkundrazi, votuesit kanë shprehur drejt vullnetin e tyre”, siç është e vështirë të pranohen dhe argumentat që parashtrihen në mbrojtje të pikëpamjes së sipërme.

Pakica është e mendimit se çdo shkelje ose çrregullim gjatë procesit zgjedhor, si dhe pasojat që rrjedhin prej tyre duhet t'i shtrohen një vlerësimi ligjor dhe objektiv, larg çdo varësie nga pikëpamjet e shfaqura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Konfuzioni i krijuar nga zbatimi i mënyrës së votimit të parashikuar nga ligji për zgjedhjet e Kuvendit Popullor edhe në votimin për referendumin e 29 qershorit 1997, me pasojat e tij negative si për njërën ashtu edhe për tjetrën alternativë, nuk legjitimon ndryshimin e rezultateve të referendumit, gjë që me të drejtë, nuk është kërkuar dhe nga ana e interesuar.

Për këto arsye, pakica është e mendimit që referendumi i 29 qershorit 1997 për formën e qeverisjes të shpallet i pavlefshëm.

Shtojmë se Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nuk duhej të linte në heshtje pa prekur, por të përgjigjej për bazueshmërinë ose jo të pretendimit të palës kërkuese, se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë vendimin për shpalljen e rezultateve të referendumit me 8 vota “pro” dhe 6 vota “kundër” në ndryshim nga ajo që kërkon ligji mbi zgjedhjet e Kuvendit Popullor, i cili cakton se vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve merren me 2/3 e të gjithë anëtarëve të komisionit.

Kryetar: Rustem Gjata;

Anëtarë: Halil Kopani, Hilmi Dakli, Manol Konomi, Rustem Gjata

MENDIMI I PAKICËS SHITESË

Përveç shkakut të parashtruar në mendimin e pakicës ku bëj pjesë edhe unë për shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe shpalljen të pavlefshëm të referendumit, mendoj se ka dhe një shkak tjetër të rëndësishëm ligjor, që e bën të paligjshëm pranimin e referendumit dhe fitoren e njërës apo tjetrës alternativë për formën e qeverisjes (regjimit).

Në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 36 të ligjit nr.7866, datë 06.10.1994 “Për referendimet”, i cili thotë: “Kushtetuta, amendamenti apo çdo çështje tjetër për të cilën është zhvilluar referendumi, quhet e pranuar kur për të kanë votuar pro më shumë se 50 % e shtetasve që marrën pjesë në votime, me kusht që numri i këtyre të fundit të jenë më i madh se 50 % e numrit të shtetasve të regjistruar në listat elektorale”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka nxjerrë rezultatin përfundimtar të referendumit në shkallë vendi sipas të cilit është shpallur se ka fituar Republika, në një kohë që rezultatet e votimit provojnë se ky referendum nuk mund të quhet se është pranuar mbasi asnjëra nga alternativat për të cilat është votuar, Republikë apo Monarki Kushtetuese, nuk ka fituar numrin e nevojshëm të votave.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes është provuar se numri i përgjithshëm i shtetasve të regjistruar për votime ka qenë 1.986.209, prej të cilëve kanë marrë pjesë në votime 1.423.209 dhe kanë votuar për Republikën 904.359 (66 %) dhe për Monarkinë 450.478 (34 %) e votuesve.

Sipas këtyre të dhënave del se kanë votuar pro Republikës më shumë se 50 % e shtetasve që kanë marrë pjesë në votime, por, megjithatë, numri i këtyre të fundit nuk është më i madh por më i vogël se 50 % e numrit të shtetasve të regjistruar në listat elektorale i cili, sipas nenit 36 të ligjit “Për referendumet”, përbën njërin nga kushtet themelore që referendumi të quhet i ligjshëm, dhe si i tillë, i pranuar.

Kështu, përderisa për asnjërën alternativë, Republikë ose Monarki Kushtetuese, nuk kanë votuar pro më shumë se 50 % e shtetasve të regjistruar në listat elektorale, nuk mund të quhet se referendumi është pranuar dhe të ketë fituar republika.

Po të pranohet pikëpamja e kundërt del përfundimi se rezultati i një referendumi popullor duhet të quhet i pranuar edhe atëhere kur pro tij ka votuar vetëm 25 % plus një e votuesve, gjë që do të zhvleftësonte kuptimin e vetë referendumit, prandaj edhe për këtë shkak mendoj për shpalljen të pavlefshëm të referendumit të 29 qershorit 1997.

Anëtar: Halil Kopani

ARSYETIM PARALEL

Vendimi i Kuvendit Popullor nr.310, datë 13.05.1997 “Për thirrjen e referendumit të përgjithshëm për formën e qeverisjes në Republikën e Shqipërisë, Republikë ose Monarki Kushtetuese”, duhej të shpallej antikushtetues për këto arsye:

1. Me një akt të zakonshëm të Kuvendit Popullor është injoruar një ligj kushtetues e pikërisht vendimi nr.191, datë 11.01.1946 i Asamblesë Kushtetuese, i cili jo vetëm që vendoste formën e qeverisjes (Republikë) por që ndalonte shprehimisht instalimin e monarkisë në Shqipëri, duke ndaluar edhe hyrjen në vend të familjes mbretërore. Ky akt kushtetues nuk është shfuqizuar shprehimisht, përkundrazi Republika si formë qeverisje është rikonfirmuar edhe në kushtetutat e mëvonshme e deri në dispozitat kryesore kushtetuese (neni 1). Në këto kushte pa mënjanuar këto pengesa kushtetuese Kuvendi Popullor nuk mund të merrte vendimin e lartpërmendur.

2. Vendimi nr.310, datë 13.05.1997 i Kuvendit Popullor veç dispozitave kushtetuese i referohet edhe ligjit nr.7866, datë 06.10.1994 “Për referendumet”. Edhe ky referim nuk ka bazë kushtetuese. Ligji i lartpërmendur, i cili parashikon shprehimisht

rastet se kur mund të vendoset referendumi, nuk bën fjalë aspak se objekti i tij mund të jetë edhe forma e qeverisjes. Ta interpretosh këtë “boshllëk ligjor” në të kundërtën e vet (se çdo gjë që s’ndalohej lejohet) do të ishte një qëndrim që u bie ndesh parimeve kushtetuese dhe një shteg për mjaft arbitraretete.

3. Në përmbajtje të tij, vendimi nr.310, datë 13.05.1997 duke vendosur Referendumin në të njëjtën ditë me zgjedhjet për në Kuvendin Popullor krijoi një situatë kontradiktore, të patolerueshme në zbatimin e vullnetit politik të popullit. Në të njëjtën kohë populli thirrej të shprehte vullnetin e tij për Kuvendin Popullor të Republikës e njëkohësisht nga ana tjetër të shprehej nëse kjo Republikë do të ekzistonte apo jo (që të nesërmen e zgjedhjes). Në një situatë të tillë paradoksale vendimi si dhe dekretet pasuese të Presidentit të Republikës vunë edhe subjektet elektorale (e veçanërisht Partinë Lëvizja e Legalitetit), e cila nga njëra anë përfaqësohej në zgjedhje për deputetët e Kuvendit Popullor e nga ana tjetër në referendum përfaqësonte monarkinë.

4. Në kushtet e një forme qeverisje Republikane, të pranuar e të vendosur para më se gjysëm shekulli, të diskutosh si alternativë monarkinë kushtetuese, do të thotë të diskutosh (e për më tepër të vendosësh) për një sërë të drejtash themelore të fituara (krahaso dispozitat tona kushtetuese me statutin e mbretërisë që pasuesit e monarkisë propaganduan si bazën dhe programin e mbretërisë); do të thotë që popullit t’i ngushtohet në një masë të ndjeshme ushtrimi i sovranitetit të tij.

Prandaj, shtetet me demokraci të zhvilluar në kushtetutat e tyre e kanë përcaktuar qartë se forma e qeverisjes si republikë nuk rishikohet (cenohet) - (shih Kushtetutën Italian - neni 139; Franceze - neni 89; Greke - neni 110; Rumune - neni 148 etj., etj.).

Ky parim, karakteristikë e shteteve moderne gjeti shprehjen e vet edhe në “Statutin themeltar të Republikës” të vitit 1925 neni 141 i cili shprehej se forma republikane e shtetit nuk mund të ndërrohej në asnjë mënyrë, pavarësisht se ish-mbreti me rrugë antikonstitucionale e shkeli atë.

Anëtarë: Zija Vuci, Alfred Karamuço.

*
* * *

Vendimi nr. 31, datë 19.11.2003
(V – 31/03)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga Fehmi Abdiu Kryetar dhe gjyqtarët: Zija Vuci, Gjergj Sauli, Alfred Karamuço, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Xhezair Zaganjori, Sokol Sadushi, Petrit Plloçi – relator i çështjes,

(...)

në datën 23.10.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen me kërkesë: 53 mijë Zgjedhës, me nismëtarë: Gëzim Kalaja, Bujar Cani, Tomorr Shahini, Gani Lami, Agim Lamja, Hiqmet Mella, Sami Karriqi, Bashkim Hoxha, Osman Redhi, Dëfrim Spahiu, Ismail Lila, Bilbil Kashi, përfaqësuar nga avokat Dervish Dumi, me objekt: “Kushtetutshmëria e kërkesës për zhvillimin e referendumit për shfuqizimin e neneve 4 e 6 të Ligjit nr.8889, datë 25.04.2002 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, në bazë të nenit 152 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 129 paragrafi 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”.

(...)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, njëzëri, vendosi: “Deklarimin si të papajtueshme me Kushtetutën të kërkesës për zhvillimin e referendumit për shfuqizimin e neneve 4 e 6 të ligjit nr.8889, datë 25.04.2002 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

(...)

Duke arsyetuar:

Me ligjin nr.8889, datë 25.04.2002, janë bërë disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Konkretisht, ndërmjet të tjerash, me nenet 4 dhe 6 të ligjit të 2002, është rritur moshja për përfitimin e pensionit të pleqërisë, për burrat nga 60 në 65 vjeç dhe për gratë nga 55 në 60 vjeç, duke ndryshuar, nenin 31 të ligjit të 1993, që përcakton kushtet e përfitimit të këtij pensioni, si dhe nenin 34 të po këtij ligji, që përcakton kushtet e përfitimit të pensionit të pjesshëm të pleqërisë.

Kërkesit, në bazë të nenit 126, pika 2 të Kodit Zgjedhor i kanë paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një kërkesë për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm me objekt, shfuqizimin e neneve 4 e 6 të ligjit të mësipërm.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi ka verifikuar rregullsinë e kërkesës, në bazë të nenit 129 pika 1, të Kodit Zgjedhor, i ka përcjellë kërkesën për referendum të përgjithshëm Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar paraprakisht kushtetutshmërinë e saj.

Lidhur me kushtetutshmërinë e kërkesës për referendum, gjatë gjykimit kanë shfaqur opinionet e tyre pala kërkuese dhe subjektet e interesuara. Këto opinione janë shfaqur në aspektin e pranueshmërisë së kërkesës në vështrim të nenit 126 pika 3 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit: “Kërkesa për shfuqizimin e një pjese të ligjit pranohet vetëm kur pjesa tjetër e ligjit është e vetëmjaftueshme” si dhe në aspektin e kushtetutshmërisë së saj, në vështrim të nenit 151 pika 2 të Kushtetutës, në të cilin parashikohet se “Çështjet që lidhen me ... buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit ... nuk mund të shtrohen në asnjë referendum”.

Sipas opinionit të kërkuësve, kërkesa e paraqitur prej tyre është në pajtim me nenin 126 pika 3 të Kodit Zgjedhor, sepse në rast shfuqizimi të dispozitave - objekt referendumi - pjesa e mbetur e ligjit është e vetëmjaftueshme, mbasi në këtë rast hyjnë në fuqi dispozitat e shfuqizuara të ligjit të vitit 1993. Për sa i përket aspektit të dytë, pala kërkuese shprehu opinionin se ligji që kundërshtohet nuk përfshihet në kategorinë e atyre ligjeve për të cilët Kushtetuta nuk lejon të shtrohen në referendum, pasi ky ligj nuk implikon buxhetin e shtetit.

Subjektet e interesuara, në dy aspektet e mësipërme, u shprehën se kërkesa për referendum është e papranueshme.

Lidhur me aspektin e parë, subjektet e interesuara parashtruan se kërkesa për referendum për shfuqizimin e dispozitave të kundërshtuara, është e papranueshme, sepse me shfuqizimin e këtyre dispozitave, pjesa e mbetur e këtij ligji nuk është e vetëmjaftueshme. Ndërmjet të tjerash ata argumentuan se, pjesa e ligjit që mbetet, nuk do të funksionojë sipas qëllimit që ka patur ky ligj - përmirësimin e balancës së skemës së sigurimeve shoqërore. Kështu, sipas tyre, në kushtet e kontributeve të ulura me ligjin e kundërshtuar dhe të moshës për përfitimin e pensionit, të përcaktuar me ligjin e vitit 1993, skema e sigurimeve shoqërore nuk do të funksionojë, sepse nuk do të përballojë detyrimet për pagesat e pensioneve me fondet e mbledhura nga kontribuesit e përfshirë në këtë skemë.

Për sa i përket çështjes së kushtetutshmërisë së kërkesës për referendum, subjektet e interesuara shprehën opinionin se ligji i

kundërshtuar i vitit 2002, përfshihet në atë kategori ligjesh, të cilët, në vështrimin kushtetues, nuk mund të shtrohen në referendum. Në këtë drejtim, subjektet e interesuara, në mënyrë të përmbledhur, argumentojnë se ndryshimet në legjislacionin e sigurimeve shoqërore kanë ndikim mbi buxhetin e shtetit. Sipas tyre, shteti paraqitet si kontribues në fondin e sigurimeve shoqërore, ndërmjet të tjerëve, në rastin e parashikuar nga neni 66 shkronja “a” (me cilësinë e punëdhënësit), dhe në rastet e parashikuara nga shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të po këtij neni. Përveç kësaj, buxheti i shtetit mbulon diferencën e krijuar, në rastin, kur shpenzimet për sigurimet shoqërore nuk mbulohen me të ardhurat e fondit të mësipërm (neni 67) si dhe garanton fondin e sigurimeve shoqërore në rast falimentimi (neni 69 i po këtij ligji).

*
* * *

1. Gjakata Kushtetuese vlerëson se shqyrtimi i kushtetutshmërisë së kërkesës për referendum, dikton nevojën e sqarimit të kushteve të përgjithshme që lidhen me institutin e referendumit në përgjithësi dhe atij shfuqizues në veçanti, në vështrim të nenit 151 të Kushtetutës.

Në një vështrim të përgjithshëm, pozicioni i referendumit si mjet kushtetues është i lidhur me nocionin e sovranitetit të popullit (neni 2/1 i Kushtetutës), që ushtrohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur prej tij ose në mënyrë të drejtpërdrejtë (neni 2/2). Në këtë drejtim një rëndësi themelore merr çështja e përcaktimit të kushteve dhe rasteve, në të cilat, populli mund ta ushtrojë sovranitetin në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Sipas doktrinës, parimi i ushtrimit të sovranitetit nga populli, nënkupton një koncept demokratik sipas kriterëve të një demokracie përfaqësuese që përmban edhe elementë që mundësojnë ushtrimin direkt të demokracisë kushtetuese. Me këtë kuptohet që populli, të drejtën për të ushtruar funksion ligjvënës, normalisht, nuk e ushtron vetë në mënyrë të drejtpërdrejtë, por nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur prej tij. Demokracia përfaqësuese, historikisht, është konceptuar si formë e zakonshme e qeverisjes. Ajo është shprehje e demokracisë që mundëson shfaqjen e vullnetit të shumicës në formën e një akti që do t'i shërbejë interesit të përgjithshëm.

Instrumentet e demokracisë direkte zenë vend në këtë vështrim, jo si pushtet konkurrues i organeve përfaqësuese, por si instrumente që mundësojnë mënjanimin e mungesës së veprimit nga ana e përfaqësuesve ose balancimin e kësaj mungese. Dispozitat e Kushtetutës lejojnë ushtrimin e sovranitetit të popullit nëpërmjet referendumeve, përderisa kjo nuk bie në kundërshtim me sistemin e procesit ligjvënës.

Pra, edhe referendumi, si një nga instrumentet e demokracisë direkte, nuk përbën alternativë ndaj procesit ligjvënës të parlamentit. Ai nuk mundëson bërjen e ligjeve, funksion i cili u është ngarkuar ekskluzivisht ligjvënësve. Në këtë mënyrë, referendumi paraqitet si mjet për integrimin dhe stimulimin e procesit ligjvënës në parlament, në rastet kur nuk gjen zbatim parimi i përputhjes së vullnetit të shumicës parlamentare me shumicën e popullit në një çështje konkrete. Pra, bëhet fjalë për një instrument që mundëson transmetimin e mendimit të zgjedhësve në drejtim të instancave politike.

Gjykata Kushtetuese, në bazë nenit 152 të Kushtetutës, duhet të shqyrtojë kushtetutshmërinë e kësaj kërkesë në linjat që u parashtruan më sipër.

2. Lidhur me kushtetutshmërinë e referendumit, Gjykata duhet të verifikojë nëse, në rastin në shqyrtim, janë të pranishëm ndalime të atij lloji që parashikon neni 151 paragrafi 2 i Kushtetutës, gjë që bën të nevojshme interpretimin e kësaj dispozite. Më konkretisht, Gjykata duhet të verifikojë, nëse ligji i kërkuar për t'u hedhur në referendum me qëllim shfuqizimi, është nga ajo kategori ligjesh, për të cilat Kushtetuta nuk lejon ndërmarrjen e një procedure të tillë referendare.

Dispozita kushtetuese e mësipërme përmend “Çështjet që lidhen me ... buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit, ...”, por nuk specifikon ligjet konkrete, që rregullojnë këto çështje. Gjykata Kushtetuese vlerëson se kuadri ligjor i financave publike, është kompleks dhe përfshin ligjet e buxhetit, të taksave e të detyrimeve financiare të shtetit. Këto ligje, për karakterin e fushave që mbulojnë dhe efektet që prodhojnë kanë një lidhje të ngushtë midis tyre. Përveç këtyre ligjeve, për të cilët parashikohet ndalim i shprehur kushtetues për t'u paraqitur në referendum, jurisprudenca ka identifikuar edhe ligje të tjera të cilët, nisur nga natyra dhe efektet që prodhojnë, kanë një lidhje të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë me çështjet e buxhetit,

të taksave dhe të detyrimeve financiare të shtetit, për shkak të pasojave të ngjashme me ato që prodhojnë këto të fundit (ndalime të nënkuptuara)¹.

Gjykata Kushtetuese vlerëson, se këtij përjashtimi kushtetues i nënshtrohet edhe ligji për sigurimet shoqërore. Për natyrën e tij, sistemi i sigurimeve shoqërore është një sistem “i hapur”, gjë që nënkupton se ndryshimet në të janë jo vetëm të pranueshme por edhe të pashmangshme. Për pasojë, iniciativa e ligjvënësit në këtë fushë mbetet veçanërisht e gjërë. Faktorët që i nxisin këto ndryshime mund të jenë çështje me interes publik, si: përpjekja për ta bërë sa më të drejtë sistemin për të dy palët, përfitues dhe kontribues, situata financiare e buxhetit si dhe faktorë socialë. Pra, ndërhyrja në sistemin e sigurimeve shoqërore është kompetencë ekskluzive e ligjvënësit, por duke iu përmbajtur kufijve të Kushtetutës për respektimin e të drejtave themelore të shtetasve².

Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa për referendum, për shfuqizimin e rregullimeve të reja të sigurimeve shoqërore, duhet të vlerësohet jokushtetuese.

Duke shqyrtuar dispozitat e ligjit të 1993 “Për sigurimet shoqërore” si dhe të ligjit “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit”, Gjykata Kushtetuese konkludon se ligji “Për sigurimet shoqërore” ka lidhje të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë me ligjin “Për buxhetin e shtetit” sa që shfuqizimi i dispozitave të kundërshtuara do të prishte ekuilibret financiarë të sistemit të përgjithshëm të sigurimeve shoqërore dhe do të prekte drejtpërdrejt buxhetin e shtetit.

Një lidhje e tillë e ngushtë e ligjit të kundërshtuar më ligjet e buxhetit rezulton po të shqyrtojmë kuadrin ligjor përkatës, dhe konkretisht nenet 64, 66, 67 e 69 të ligjit “Për sigurimet shoqërore”.

3. Gjykata Kushtetuese duhet të shprehet edhe për pranueshmërinë e kërkesës për referendum, në vështrim të kufizimit që imponon neni 126 pika 3 i Kodit Zgjedhor, sipas të cilit: “Kërkesa për shfuqizimin e një pjese të ligji pranohet vetëm kur pjesa tjetër e ligjit është e vetëmjaftueshme”.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky ndalim i parashikuar në Kodin Zgjedhor është në harmoni me parimin kushtetues të demokracisë përfaqësuese. Në këtë aspekt, nëqoftëse pas shfuqizimit me referendum, pjesa e mbetur e ligjit nuk do të ishte

1 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Italisë nr.2, viti 1994

2 Vendime të Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, 11, 221, 22, 242, 26, 44 (61f)

e vetëmjaftueshme, atëherë do të krijohej vakum ligjor, situatë kjo që e detyron ligjvënësin që edhe kundër dëshirës së tij, të plotësojë këtë vakum. Kjo situatë, nëqoftëse do të përsëritej shpesh, do të cënonte parimin themelor të demokracisë parlamentare. Nga ana tjetër, ashtu siç konstatohet edhe në jurisprudencë, “në qoftë se ligjvënësi nuk reagon në përgjigje të vakumit legjislativ, atëherë sistemi kushtetues nuk ofron ndonjë mjet efektiv, dhe kjo situatë mund të çonte në një krizë në sistemin e demokracisë përfaqësuese.”³ Gjykata vlerëson gjithashtu se me ndalimin e mësipërm ligjvënësi, ka patur për qëllim shmangjen e vakumeve legjislative që është në mbrojtje të një parimi të rëndësishëm të shtetit të së drejtës, dhe pikërisht, të parimit të sigurisë juridike. Kushti që pjesa e mbetur e ligjit në rast të një referendumit shfuqizues të jetë e vetëmjaftueshme, i shërben qëndrueshmërisë së sistemit juridik.

Në vështrim të ndalimit të mësipërm që imponon Kodi Zgjedhor, Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkesa për referendum të përgjithshëm për shfuqizimin e dispozitave të atakuara është e papranueshme.

Kështu, nga shqyrtimi i dispozitave të ligjit të kundërshtuar të vitit 2002, rezulton se përveç ndryshimit të moshës së përfitimit të pensionit të pleqërisë, ky ligj ka sjellë ndryshime edhe në përlllogaritjen e moshës dhe viteve që duhet të plotësojnë përfituesit e këtij pensioni. Pra, pavarësisht se kërkuesit e kanë kufizuar kërkesën e tyre vetëm në shfuqizimin e dispozitave që kanë të bëjnë me rritjen e moshës, ky aspekt nuk mund të veçohet nga pasojat që sjell ai. Kjo do të thotë, se në rast se dispozitat që kanë sjellë rritjen e moshës për pension do të shfuqizohen me anë të referendumit, tabela përlllogaritëse mbi vitet e punës dhe moshën e daljes në pension të plotë apo të parakohshëm nuk do të funksiononte më, pasi baza mbi të cilën ata përlllogariteshin do të ndryshonte. Gjykata vlerëson se dispozitat që kundërshtohen janë elementë bazë të ligjit në shqyrtim, pasi edhe sipas shpjegimeve në seancë gjyqësore të subjekteve të interesuara, ky ishte edhe qëllimi kryesor i ligjvënësit që çoi në ndryshimin e ligjit ekzistues: pra, të përpunonte një skemë të re të sigurimeve shoqërore në themel të të cilës, kryesisht, është ulja e masës së kontributeve si dhe rritja e numrit të kontribuesve, nëpërmjet rritjes së moshës së pensionit. Prandaj, në rast shfuqizimi me referendum të dispozitave që kanë të bëjnë me rritjen e moshës, funksionimi i kësaj skeme do të bëhej i pamundur, gjë që do të thotë se pjesa e mbetur e ligjit nuk është e vetëmjaftueshme.

Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa për shfuqizimin nëpërmjet referendumit të rregullimeve të reja të sigurimeve shoqërore është antikushtetuese.
(...)

**Vendimi nr. 25, datë 24.07.2009
(V – 25/09)**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Vladimir Kristo, Kryetar Gjergji Sauli, Fehmi Abdiu, Kujtim Puto, Xhezair Zaganjori, Petrit Pllloçi, Vitore Tusha, Sokol Sadushi, Sokol Berberi, anëtarë, me sekretare Blerina Çinari, në datë 25.11.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.25/11 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: **GRUPI NISMËTAR PËR ZHVILLIMIN E REFERENDUMIT**, përfaqësuar nga Spartak Braho dhe av.Bledar Fejzo, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Çlirim Gjata dhe Dëshira Pasko, me autorizim.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj me autorizim.

O B J E K T I: (a) Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.47, datë 05.06.2008 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

(b) Interpretimi i nenit 150, pika 1 dhe nenit 177 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 124, 131, 134, 150 pika 1 e 3 dhe 177 të Kushtetutës; nenet 126, 127, 128 dhe 129 të ligjit nr.8609, datë 08.05.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi; përfaqësuesit e kërkuetit, që kërkuan pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Kuvendit, që kërkuan rrëzimin e saj; u këshillua me mendimin “Amicus Curiae” të Komisionit të Venecies, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

1. Më datë 29.05.2008, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) është paraqitur kërkesa e një grupi nismëtar prej 24 zgjedhësish për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e neneve 5, 7 dhe 8 të ligjit nr.9904, datë 21.04.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e RSH”, të ndryshuar”. Në kërkesën drejtuar KQZ-së kërkohet edhe pajisja me fletët tip për mbledhjen e nënshkrimeve të 50 mijë zgjedhësve.

2. KQZ-ja, me vendimin nr.47, datë 05.06.2008, vendosi mospranimin për shqyrtim të kërkesës së Grupit Nismëtar për Zhvillimin e Referendumit (Grupi Nismëtar). Në vendimin e KQZ-së arsyetohet, ndër të tjera, se kërkesa e paraqitur ka të bëjë me një “referendum kushtetues”, sipas nenit 122 të Kodit Zgjedhor dhe jo me “referendum të përgjithshëm”, parashikuar nga neni 126 i Kodit Zgjedhor. Si rrjedhojë, kërkesa u konsiderua se nuk është objekt shqyrtimi nga ky organ.

3. Grupi Nismëtar për Zhvillimin e Referendumit, më pas, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për “Shfuqizimin e vendimit të mësipërm të KQZ-së dhe interpretimin e nenit 150, pika 1 dhe nenit 177 të Kushtetutës”.

Kërkuesi pretendoi se:

- Ky vendim i KQZ-së është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor si rezultat i të cilit është cenuar e drejta kushtetuese për zhvillimin e një referendumit. Arsyetimi i KQZ-së se grupi nismëtar kërkon mbajtjen e një referendumit kushtetues dhe se KQZ nuk është organi kompetent për shqyrtimin e kësaj kërkesë, cenon rregullshmërinë e procesit ligjor.

- Kërkuesit i janë shteruar të gjitha mjetet juridike për realizimin e të drejtës për kryerjen e procedurave për referendum të përgjithshëm.

- Vendimi i kundërshtuar i KQZ-s është marrë në tejkalim të kompetencave të KQZ-së, të cilat i takojnë Gjykatës Kushtetuese.

- Grupi i individëve që paraqet këtë kërkesë, sipas kërkuarit, gëzon të drejta kushtetuese jo vetëm si subjekt i një procesi që rregullohet nga Kodi Zgjedhor, por potencialisht si mbrojtës i të drejtave thelbësore kushtetuese që rrjedhin nga neni 150 i Kushtetutës. Për këto arsye ai legjitimohet edhe për të kërkuar interpretimin e Kushtetutës sipas nenit 124 dhe 134/2 të Kushtetutës.

- Nenet 150 e 177 të Kushtetutës nuk bien ndesh me njëra-tjetrën, por rregullojnë procedura të ndryshme dhe garantojnë të drejta të ndryshme, nga njëra anë për Kuvendin e Shqipërisë (neni 2/2 i Kushtetutës) dhe nga ana tjetër, të popullit (neni 2/1 i Kushtetutës). Neni 177 i Kushtetutës rregullon procedurën për referendum kushtetues, që ka të bëjë me faktin se ky lloj referendumi kërkohet vetëm për miratimin apo ratifikimin e ndryshimeve kushtetuese të realizuara nëpërmjet procedurave parlamentare. Ky është një referendum konsultativ apo “konsultim popullor”. Ushtrimi i drejtpërdrejtë i sovranitetit bëhet sipas nenit 150/1 të Kushtetutës.

Subjektet e interesuara, KQZ-ja dhe Kuvendi parashtuan se kërkesa duhet rrëzuar pasi:

- Kërkuari nuk plotëson kushtet e kërkuara për legjitimitimin. Grupi Nismëtar për Referendumin, nuk mund të konsiderohet, sipas nenit 134, pika 1, shkronja “f”, “organizata të tjera”. Në këtë kuptim, nismëtarët mund të konsiderohen vetëm sipas shkronjës “g” të nenit 134, pika 1 të Kushtetutës për të shpallur antikushtetues një vendim të KQZ-së pasi nuk na rezulton se janë shteruar të gjitha mjetet e ankimit.

- Vendimi i KQZ-së është në vetvete një akt administrativ, i cili realisht mund të ankimohet në gjykatën e juridiksionit të zakonshëm.

- Në Kodin Zgjedhor, në kreun e dytë, janë parashikuar tri lloje referendumesh: *referendumi kushtetues*, *referendumi i përgjithshëm* dhe ai *vendor*. Kërkuarit konfondojnë këtë ndarje duke kërkuar që referendumi kushtetues të konsiderohet si referendum i përgjithshëm.

- Sipas nenit 177 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e mbajtjes së referendumit kushtetues kur një kërkesë e tillë ka ardhur në përputhje me nenin 177 të Kushtetutës nga të paktën 28 deputetë dhe në përputhje edhe me nenet 122, 123 dhe 124 të Kodit Zgjedhor dhe jo nga ndonjë subjekt tjetër.

- Sipas nenit 150 të Kushtetutës dhe nenit 129 të Kodit Zgjedhor, Gjykata Kushtetuese do të shqyrtonte kushtetutshmërinë e kërkesës për referendum të përgjithshëm vetëm në rastet kur, pas verifikimit të rregullshmërisë, kërkesa përcillet në Gjykatën Kushtetuese nga KQZ-ja.

- Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor kanë përkufizuar qartë referendumin kushtetues dhe subjektin që mund të kërkojë këtë referendum. Konfondimi që përpriqet të bëjë kërkesimes referendumit kushtetues dhe atij të përgjithshëm është në kundërshtim me nenet 150 dhe 177 të Kushtetutës si dhe nenet 122-131 të Kodit Zgjedhor. Nenet 150 dhe 177 të Kushtetutës parashikojnë dy lloje të ndryshme referendumesh, të cilat rregullohen në mënyrë më të detajuar nga Kodi Zgjedhor.

- Kërkesit nuk legjitimohen as për kërkesën e dytë për interpretimin e një ose disa neneve të Kushtetutës, pasi nuk përfshihen në subjektet e parashikuara nga neni 71 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

II

1. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ngriti pretendimin se kërkesi nuk plotëson kushtet e kërkuara për legjitimimin për arsye se, Grupi Nismëtar për Referendumin, sipas shkronjës “g” të nenit 134, pika 1 të Kushtetutës, nuk rezulton të ketë shteruar të gjitha mjetet e ankimit për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së vendimit të KQZ-së; dhe, për kërkesën e dytë, lidhur me interpretimin e neneve 150 dhe 177 të Kushtetutës, nuk përfshihet në subjektet e parashikuara nga neni 71 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

2. Kërkesi pretendon, se bazuar në nenet 131, shkronja “f” dhe 134, shkronja “g” të Kushtetutës, ai legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas objektit të kërkesës, për arsye se i është cenuar e drejta kushtetuese për realizmin e procedurave për një referendum të përgjithshëm, ka shteruar të gjitha mjetet për realizmin e kësaj të drejte dhe se ky grup është, potencialisht, mbrojtës i të drejtave thelbësore kushtetuese që rrjedhin nga neni 150 i Kushtetutës.

3. Gjykata Kushtetuese (Gjykata), në jurisprudencën e saj, ka interpretuar kriteret kushtetuese për legjitimimin e subjekteve që mund ta vënë atë në lëvizje sipas nenit 134, pika 2, të Kushtetutës.

Individët janë përcaktuar në nenin 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke patur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Ata kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet interesit të tyre ligjor dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak (*Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 26.02.2007; nr.11, datë 04.04.2007; nr.35, datë 10.10.2007; nr.41, datë 16.11.2007; nr.9, datë 19.03.2008*). Për të vlerësuar legjitimitimin e subjektit Gjykata, fillimisht, përcakton të drejtën kushtetuese të subjektit që pretendohet se është cenuar nga akti konkret i kundërshtuar para saj. Në çështjen në shqyrtim kërkuesi pretendon, se akti i kundërshtuar ka cenuar të drejtën kushtetuese për realizimin e procedurave për një referendum të përgjithshëm, bazuar në nenin 150 të Kushtetutës.

4. Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me një kërkesë objekti i së cilës është: “Për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm me objekt për shfuqizimin e neneve 5, 7, dhe 8 të ligjit nr.9904, datë 21.04.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”. Kërkesa është bazuar në nenet 131, 134, 124, 150/1, 3 dhe 177 të Kushtetutës dhe në nenet 126, 127, 128, 129 të Kodit Zgjedhor (KZ).

5. Në nenin 150, pika 1 të Kushtetutës parashikohet: “Populli, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, ka të drejtën e referendumit për shfuqizimin e një ligji, si dhe t’i kërkojë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë”. Kodi Zgjedhor (KZ) ka bërë dallimin e “referendumit kushtetues” nga “referendumi i përgjithshëm”. Sipas nenit 122 të KZ, “Referendumi kushtetues, sipas pikës 5 të nenit 177 të Kushtetutës, është referendumi që kërkohet nga një e pesta e deputetëve, për t’ia nënshtruar votimit popullor amendamentin kushtetues, të miratuar nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit”. Ndërsa referendumi i përgjithshëm është referendumi që mund të kërkohet nga pesëdhjetë mijë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve, për shfuqizimin e një ligji, në përputhje me pikën 1 të nenit 150 të Kushtetutës, si dhe me dispozitat e KZ (neni 126/1 i KZ). Kërkesa për fillimin e procedurave të referendumit të përgjithshëm paraqitet në KQZ nga një grup prej jo më pak se

12 nismëtarësh, të cilët janë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve (neni 126/2 i KZ).

6. Gjykata, për të vlerësuar interesin e kërkuarit në këtë kontroll kushtetues çmon se duhet t'i japë përgjigje pyetjes nëse neni 150 zbatohet ndaj ligjeve për rishikimin e Kushtetutës, me fjalë të tjera, nëse pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e popullit në rishikimin e Kushtetutës kufizohet në mundësitë e parashikuara nga dispozitat e veçanta të nenit 177 të Kushtetutës, apo kjo pjesëmarrje e drejtpërdrejtë mund të organizohet gjithashtu sipas parashikimeve të përgjithshme të nenit 150.

7. Gjykata çmon, se bazuar vetëm në interpretimin literal të togfjalëshit "shfuqizim i ligjit", nuk mund të nxirret kuptimi i qartë i normës kushtetuese të parashikuar në nenin 150 për shkak se termi "ligj" merr përmbajtje të ndryshme në dispozita të ndryshme të Kushtetutës. Kështu, në nenin 116, pika 1, bëhet një dallim i qartë midis Kushtetutës dhe "ligjeve". Ndërsa në nenin 4, pika 2, deklarohet se "Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë". Ky kuptim i ndryshëm i termit "ligj" konfirmohet dhe nga fakti se vetë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është miratuar me ligjin nr.8417, datë 28.10.1998. Gjithashtu, në rastin konkret, amendamentet kushtetuese, të cilat kërkuari kërkon t'ia nënshtrojë referendumit, janë miratuar me ligjin nr.9904, datë 21.04.2008 "Mbi disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar".

8. Gjykata rithekson se çdo dispozitë e Kushtetutës duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese. Kjo, për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik. Natyra e Kushtetutës, koncepti i kushtetutshmërisë, nënkupton që Kushtetuta nuk mund të ketë kontradikta të brendshme. Për pasojë, asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.2, datë 19.01.2005). Në këtë linjë duhet të interpretohen edhe dispozitat objekt shqyrtimi.

9. Lidhur me çështjen në shqyrtim, Kushtetuta ka rregulluar, në një pjesë të veçantë, procedurat për rishikimin e Kushtetutës (Pjesa e shtatëmbëdhjetë, neni 177). Për rrjedhojë, shqyrtimi i çështjes nëse neni 150 zbatohet gjithashtu ndaj ligjeve për rishikimin e kushtetutës nuk mund të vlerësohet pa marrë në konsideratë dhe nenin 177 të Kushtetutës. Sipas këtij neni, një amendament kushtetues i miratuar, mund t'i nënshtrohet referendumit në dy raste:

1) kur vendosin dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (neni 177/4); 2) kur kërkohet nga një e pesta e anëtarëve të Kuvendit (neni 177/5). Duke qenë se neni 177 i Kushtetutës së Shqipërisë është dispozitë e veçantë për ndryshimin e Kushtetutës duhet prezumuar se, ky nen, trajton në mënyrë të hollësishme mundësitë e organizimit të një referendumit kushtetues për një ndryshim të Kushtetutës. Nga kuptimi i nenit 177 del se, një amendament kushtetues nuk i nënshtrohet referendumit në mënyrë të detyrueshme, por vetëm në rastin kur e kërkojnë subjektet e përmendura më sipër. Neni 177 nuk parashikon të drejtën për të thirrur një referendum për shfuqizimin e një ndryshimi të Kushtetutës nga 50 mijë shtetas me të drejtë vote. Kjo do të thotë që, përfshirja e drejtpërdrejtë e popullit në procesin kushtetutëbërës mundësohet vetëm nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Kuvend.

10. Gjykata thekson se Kushtetuta, si ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë, duhet të jetë një akt i qëndrueshëm. Stabiliteti i Kushtetutës është një veçori, e cila, së bashku me veçori të tjera të saj e bën rregullimin normativ kushtetues të ndryshëm nga rregullimi normativ i bërë me akte ligjore të një fuqie më të ulët. Stabiliteti i Kushtetutës është një vlerë kushtetuese. Kjo garantohet nga një procedurë e vështirë dhe komplekse e amendimeve të Kushtetutës, e parashikuar nga neni 177 i Kushtetutës. Gjykata çmon se kjo qëndrueshmëri mund të dëmtohet nëse një amendament kushtetues, i miratuar me një shumicë prej dy të tretash dhe për të cilin nuk është kërkuar që t'i nënshtrohet referendumit nga subjektet e parashikuara në nenin 177 të Kushtetutës, mund të shfuqizohet nëpërmjet një referendumit të kërkuar nga 50 mijë zgjedhës. Kushtetuta ka krijuar hapësirë për pakicën e anëtarëve të Kuvendit, e përbërë prej një të pestës së anëtarëve të tij që në rastin kur nuk bie dakord me shumicën e anëtarëve prej dy të tretash për amendamentin kushtetues, të kërkojë që ky i fundit t'i nënshtrohet referendumit. Megjithatë Kushtetuta, në mënyrë të qartë nuk synon mbajtjen gjithmonë të një referendumit mbi ndryshimet e Kushtetutës, por e kushtëzon atë vetëm në ato raste kur konsensusi i gjerë politik mungon. Në këtë kuptim, neni 177 parashikon garanci të mjaftueshme për pakicat (një e pesta e anëtarëve) pa qenë nevoja t'i drejtohet parashkimeve të nenit 150 të Kushtetutës.

11. Sipas kërkuesit, ushtrimi i drejtpërdrejtë i sovranitetit të popullit nuk kushtëzohet nga vullneti i asnjë organi tjetër. Kur inicohet një referendum i përgjithshëm për shfuqizimin e një ligji, pas plotësimit të anës formale e procedurale, asnjë organ nuk ka

mundësinë për të “penguar” zhvillimin e këtij referendumi, sepse kjo bazohet në nenin 2 të Kushtetutës. Referendumi i përgjithshëm për shfuqizimin e një ligji kushtetues argumenton kërkuesi, nuk duhet të ngatërrohet me referendumin e organizuar sipas nenit 177, i cili është një referendum ratifikues, mbas një procesi amendimi. Neni 150 i Kushtetutës, po sipas kërkuesit, përcakton një garanci të përgjithshme të kontrollit të popullit mbi Kuvendin, të cilit i ka kaluar të drejtën e ushtrimit të sovranitetit. Të vetmet ligje, për të cilat populli i ka hequr të drejtën vetes për të ushtruar kontroll shfuqizues, janë ato të përmendura në nenin 151/2 të Kushtetutës.

12. Gjykata vëren se kërkuesi, për të mbështetur qëndrimin e tij, referohet në teorinë e sovranitetit popullor sipas të cilës populli nuk përballet me kufizime dhe as detyrohet nga parashikimet kushtetuese në ushtrimin e sovranitetit. Për rrjedhojë, populli i cili presupozohet të jetë pushteti themeltar, duhet të jetë i lirë në zgjedhjen e mënyrës së ndryshimit të Kushtetutës, veçanërisht nëse bëhet fjalë për mbajtjen e një referendumi nëpërmjet iniciativës popullore.

13. Gjykata thekson se në një shtet kushtetues, ideja e një pushteti, i cili nuk përballet me detyrime dhe kufizime që burojnë nga Kushtetuta, nuk mund të pranohet. Sovraniteti i popullit, i vendosur në kuadrin e një sistemi kushtetues e ligjor, nuk mund të ngatërrohet me pushtetin themelor dhe kërkesa për të ndjekur disa procedura të veçanta gjatë ushtrimit të tij është tërësisht në përputhje me sovranitetin popullor. Kushtetuta e Shqipërisë në mënyrë të qartë e ka lidhur ushtrimin e sovranitetit popullor me rregulla të veçanta. Është e vërtetë se në përputhje me nenin 2, pika 1 e Kushtetutës “*sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i takon popullit*”. Por, ky deklaram nuk nënkupton ushtrimin e sovranitetit nga populli në mënyrë të pakushtëzuar. Siç Gjykata theksoi më sipër, një nen i Kushtetutës duhet të interpretohet në kontekstin e Kushtetutës si një e tërë dhe jo i izoluar. Paragrafi në vijim i të njëjtit nen deklaron, se “*populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërdrejt*”. Nga interpretimi literal dhe historik i këtij paragrafi Gjykata çmon, se kushtetutëbërësi ka shprehur një preferencë të qartë në favor të demokracisë përfaqësuese. Instrumentet e demokracisë direkte zenë vend në këtë vështrim, jo si pushtet konkurrues i organeve përfaqësuese, por si instrumente që mundësojnë mënjanimin e mungesës së veprimit nga ana e përfaqësuesve ose balancimin e kësaj mungese. Referendumi, si një nga instrumentet e demokracisë direkte, nuk përbën alternativë

ndaj procesit ligjvënës të parlamentit. Ai nuk mundëson bërjen e ligjeve, funksion i cili u është ngarkuar ekskluzivisht ligjvënësve (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.31, datë 19.11.2003*).

14. Sovraniteti i popullit është një parim shumë i përgjithshëm, i cili bëhet i zbatueshëm nëpërmjet dispozitave të veçanta të Kushtetutës dhe nuk mund të përdoret për përjashtimin e këtyre dispozitave. Gjykata çmon, se nenet 150-152 dhe 177 të Kushtetutës janë në harmoni me parimin e sovranitetit popullor siç parashikohet nga neni 2. Këto nene nuk vijnë në kundërshtim me parimin, por e konkretizojnë atë duke treguar masën në të cilën sovraniteti ushtrohet nga përfaqësuesit, drejtpërdrejt nga populli apo në mënyrë të kombinuar.

15. Bazuar në analizën e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se Kushtetuta e Shqipërisë lejon thirrjen e një referendumi për amendamentet kushtetuese vetëm brenda kufijve të parashikuar nga neni 177. E drejta e 50 mijë shtetasve me të drejtë vote për të kërkuar shfuqizimin e një ligji, sipas nenit 150, nuk shtrihet në ligjet për rishikimin e Kushtetutës.

16. Për sa më sipër, Gjykata çmon se kërkuesi nuk legjitimohet për të kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.47, datë 05.06.2008, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Gjykatën Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 shkronja “ë”; 134, pika 1, shkronja “g”; 150; 152 dhe 177 të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.47, datë 05.06.2008 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIM PAKICE

Mendimi ynë është i kundërt me qëndrimin e mbajtur nga shumica në shqyrtimin e ankimit kushtetues me kërkuar “Grupi Nismëtar për Zhvillimin e Referendumit” dhe me objekt: “1) Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.47, datë 05.06.2008 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; 2) Interpretimi i nenit 150 pika 1 dhe nenit 177 të Kushtetutës”.

Shumica ka vendosur rrëzimin e kërkesës duke u bazuar në konkluzionin se kërkuar nuk legjitimohet për të kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.47, datë 05.06.2008, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve pasi ky vendim nuk cenon një interes legjitim të kërkuar. Këtë konkluzion shumica e mbështet në përfundimin që ka arritur pas interpretimit të neneve 2, 150 dhe 177 të Kushtetutës, se e drejta e 50 mijë shtetasve me të drejtë vote për të kërkuar shfuqizimin e një ligji, sipas nenit 150, nuk shtrihet në ligjet për rishikimin e Kushtetutës.

Gjyqtarët në pakicë kanë të njëjtin qëndrim me shumicën përse i përket kuptimit të neneve 2, 150 dhe 177 të Kushtetutës dhe përfundimit të arritur pas interpretimit të këtyre dispozitave, por ndahen për çështjen e legjitimitetit të kërkuar dhe kushtetutshmërisë së vendimit nr.47, datë 05.06.2008, të KQZ-së.

1. Lidhur me legjitimitetin e kërkuar

Kërkuar pretendon, se bazuar në nenet 131, shkronja “f” dhe 134, shkronja “g” të Kushtetutës, ai legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas objektit të kërkesës, për arsye se i është cenuar e drejta kushtetuese për realizmin e procedurave për një referendum të përgjithshëm, ka shteruar të gjitha mjetet për realizmin e kësaj të drejte dhe se ky grup është, potencialisht, mbrojtës i të drejtave thelbësore kushtetuese që rrjedhin nga neni 150 i Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese është shprehur se individët, sipas nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, e ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Ata kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet

interesit të tyre ligjor dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi pretendon se akti i kundërshtuar ka cenuar të drejtën kushtetuese për realizimin e procedurave për një referendum të përgjithshëm, bazuar në nenin 150 i Kushtetutës.

Pakica vëren se kërkuesi i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me kërkesën që ka për objekt: “Për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm me objekt për shfuqizimin e neneve 5, 7, dhe 8 të ligjit nr.9904, datë 21.04.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë””. Kërkesa është bazuar në nenet 131, 134, 124, 150 dhe 177 të Kushtetutës dhe në nenet 126, 127, 128, 129 të Kodit Zgjedhor. Sipas Kodit Zgjedhor (KZ) “referendum i përgjithshëm” është referendum i qendror që mund të kërkohet nga pesëdhjetë mijë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve, për shfuqizimin e një ligji, në përputhje me pikën 1 të nenit 150 të Kushtetutës, si dhe me dispozitat e KZ (neni 126/1 i KZ). Kërkesa për fillimin e procedurave të referendumit të përgjithshëm paraqitet në KQZ nga një grup prej jo më pak se 12 nismëtarësh, të cilët janë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve (neni 126/2 i KZ). Me vendimin nr. 47 datë 05.06.2008, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur mospranimin për shqyrtim të kërkesës së Grupit të 24 nismëtarëve. KQZ ka arsyetuar, ndër të tjera, se kërkesa e paraqitur ka të bëjë me një “referendum kushtetues” sipas nenit 122 të Kodit Zgjedhor dhe jo me “referendum të përgjithshëm”, parashikuar nga neni 126 i Kodit Zgjedhor. Si rrjedhojë, KQZ konstatoi se kërkesa nuk është objekt shqyrtimi nga ky organ.

Pakica çmon se KQZ-ja, me vendimin e sipërpërmendur, ka cenuar të drejtën legjitime të kërkuesit për të kërkuar fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumit të përgjithshëm. Kjo e drejtë e kërkuesit bazohet në pikën 1 të nenit 150 të Kushtetutës dhe nenit 126 të Kodit Zgjedhor. Grupi nismëtar, ka kërkuar të ushtrojë të drejtën e tij ligjore, duke kërkuar fillimin e procedurave për një referendum të përgjithshëm. Kodi Zgjedhor, në zbatim të nenit 150 të Kushtetutës, ka parashikuar rregulla të posaçme ligjore që nëpërmjet një grupi nismëtar prej 12 shtetasish, përmbush njëkohësisht edhe të drejtën kushtetuese të 50 mijë shtetasve për zhvillimin e referendumit. Interesi i grupit nismëtar, në këtë fazë në të cilën ndodhet çështja, është i përligjur. Nga ana tjetër, KQZ-ja, në këtë fazë të procesit, në kuptim të dispozitës përkatëse të Kodit

Zgjedhor, ka të drejtë të vendos për pranimin ose mospranimin e kërkesës, duke e bazuar vendimin mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur dhe plotësimin e kriterëve ligjore lidhur me kërkesat për fillimin e procedurave për referendum. Kushtetutshmëria e çështjes që do t'i nënshtrohet referendumit, sipas nenit 152 të Kushtetutës, nuk vlerësohet nga KQZ-ja, por nga Gjykata Kushtetuese në një fazë të mëvonshme. Për rrjedhojë, pakica vlerëson se kërkuesi, ka interes në kuptim të nenit 134, pika 2, e Kushtetutës për të kërkuar kontrollin e kushtetushmërisë së vendimit nr. 47, datë 05.06.2008, të KQZ-së, që sipas tij e ka penguar fillimin e procedurës ligjore për realizimin e referendumit.

Subjekti i interesuar, Kuvendi, pretendoi se kërkuesi nuk plotëson kushtet e kërkuara për legjitimitimin: Grupi nismëtar për referendumin, sipas shkronjës “g” të nenit 134, pika 1 të Kushtetutës, nuk ka shteruar të gjitha mjetet e ankimit për të shpallur antikushtetues vendimin e KQZ-së, objekt shqyrtimi, përpara se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese. Vendimi i KQZ-së është në vetvete një akt administrativ, i cili realisht mund të ankimohet në gjykatën e juridiksionit të zakonshëm.

Pakica çmon se kërkuesi ka plotësuar kushtin e kërkuar nga neni 131, shkronja “f”, e Kushtetutës për shterimin e të gjitha mjeteve juridike për mbrojtjen e të drejtës së tyre për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi të përgjithshëm. Kodi Zgjedhor nuk parashikon rregulla për ankimimin e vendimit të KQZ-së kur ajo vendos mospranimin e kërkesës, sipas nenit 128 të KZ. Në nenin 129 parashikohet kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e kërkesës, pas verifikimit nga ana e KQZ-së të rregullsisë së kësaj kërkesë, ndërkohë që sipas nenit 326, shkronja “c” të Kodit të Procedurës Civile, “nuk mund të ngrihet padi në gjykatë për...aktet administrative të cilat sipas Kushtetutës janë në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese.” Pavarësisht se vendimi, objekt shqyrtimi, i marrë nga KQZ, ka elementet e një akti administrativ, shqyrtimi i vlefshmërisë së tij nuk mund të jetë objekt i juridiksionit të zakonshëm gjyqësor edhe për shkak të natyrës së çështjes së zgjidhur nga KQZ-ja. Ky organ ka rrëzuar kërkesën e një grupi nismëtar prej 12 shtetasish, duke vlerësuar kushtetutshmërinë e referendumit të kërkuar prej tyre, ndërkohë që shqyrtimi i një çështje të tillë, sipas nenit 152 të Kushtetutës, përbën juridiksion kushtetues. Për rrjedhojë, pakica është e mendimit se nuk mund të shmangen nga juridiksioni i drejtpërdrejtë i Gjykatës

Kushtetuese çështjet që lidhen me procedurat dhe kompetencat e organeve përkatëse të parashikuara nga Kodi Zgjedhor, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga neni 150 i Kushtetutës.

2. Lidhur me pretendimin se vendim i KQZ-së është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor

Sipas nenit 42/1 të Kushtetutës dhe jurisprudencës tashmë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe p.sh. në procese disiplinore administrative (*Shih vendimin nr. 21, datë 01.10.2008 vendimin nr. 76/2002 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese kuptohet që, lista e proceseve ligjore ku gjen zbatim e drejta e procesit të rregullt ligjor, nuk është shteruar.

Në vendimet e saj, Gjykata Kushtetuese ka çmuar se çdo organ i pushtetit publik gjatë ushtrimit të funksioneve të tij kushtetues e ligjor është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike që lidhen me procesin e rregullt, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Në vendimin interpretues nr.75, datë 19.04.2002, Gjykata Kushtetuese është shprehur për disa elementë të procesit të rregullt administrativ si njohja paraprake e personit me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i të drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, si nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes. Gjithsesi Gjykata është shprehur se këto janë disa elemente bazë të procesit të rregullt ligjor, cenimi ose jo i të cilave vlerësohet rast pas rasti nga vetë Gjykata.

Kërkuesi pretendon se procesi i zhvilluar nga KQZ është i parregullt pasi ky organ ka vepruar në tejkalim të kompetencave që i jep ligji. Në përpjekje për të bërë një analogji ndërmjet elementëve të një procesi të rregullt ligjor me ato të një procesi të rregullt gjyqësor sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe 6 të KEDNJ, kuptimi i termit 'gjykatë e caktuar me ligj' si element i procesit të rregullt gjyqësor mund të hedhë dritë mbi kuptimin e organit administrativ, i cili detyrohet të respektojë standardet e procesit të rregullt ligjor.

Gjykata, në jurisprudencën e saj ka interpretuar termin "gjykatë e caktuar me ligj" në shumë raste. Sipas saj, e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë "e caktuar me ligj" është element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Por e drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një

gjykate kompetente, kërkon gjithashtu që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë prej ligjit. Gjykata Kushtetuese i referohet GJEDNJ kur citon se, "Një tribunal karakterizohet në kuptimin thelbësor të shprehjes nga funksioni i tij gjyqësor, me të cilin duhet kuptuar të vendosurit mbi çështjet brenda kompetencave të tij, bazuar në rregullimet ligjore dhe sipas procedurave të zhvilluara në mënyrë të përcaktuar (*Shih vendimin e GJK 31/2005 i cili referon te Vendimi i GJEDNJ "Belilos v. Zvicrës", dt.29.04.1988, Series A no. 132, § 64*). Termi "ligj", në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNJ, përfshin në veçanti legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e organeve gjyqësore (*Shih vendimin e GJEDNJ Lavents v. Latvia, nr. 58442/00, § 114, 28 nëntor 2002*). Rrjedhimisht, nëse një tribunal nuk ka juridiksion për të gjykuar një person në përputhje me dispozitat e të drejtës së brendshme, ai nuk është 'krijuar me ligj' sipas kuptimit të nenit 6 § 1 (*Shih çështjen JORGIC v. GERMANY, nr. 74613/01 vendim i 12 korrik 2007, § 64*). Gjykata më tej rithekson, se në parim, një shkelje e këtyre dispozitave ligjore për krijimin dhe kompetencën e organeve gjyqësore mund të lindë nje shkelje të nenit 6 § 1 (*Çështja JORGIC, § 65*).

Nga formulimet e mësipërme, koncepti i gjykatës së caktuar me ligj, lidhet qartazi me veprimin në përputhje me kompetencën e caktuar me ligj. Për analogji, çdo organ administrativ mund të konsiderohet se vepron në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe respekton të drejtën për një proces të rregullt ligjor nëse vepron në bazë, përputhje dhe brenda kompetencave që i jep ligji.

Mbi standarde të tilla niset pakica për të analizuar nëse, vendimi i KQZ-së objekt shqyrtimi, është një akt i kryer në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ato të Kodit Zgjedhor, apo është akt në tejkalim të kompetencave (*ultra vires*) dhe që mund të ketë cenuar standardet e një procesi të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës.

Neni 150, pika 1 e Kushtetutës parashikon se populli, nëpërmjet 50 mijë zgjedhësve, ka të drejtën e referendumit për shfuqizimin e një ligji, si dhe t'i kërkojë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë. Neni 150, pika 3 parashikon se parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit si dhe vlefshmëria e tij parashikohen me ligj. Lidhur me referendumet, në bazë të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese ka dy kompetenca : njëra në bazë të nenit 131 shkronja "ë" dhe tjetra në bazë të nenit 152. Sipas nenit 131, shkronja "ë", Gjykata

Kushtetuese vendos për kushtetueshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij pasi ky referendum është kryer. Në bazë të nenit 152, Gjykata Kushtetuese shqyrton *paraprakisht* kushtetueshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum sipas nenit 150, pika 1 e 2 (për referendumin e përgjithshëm), nenit 151, paragrafët 2 e 3 dhe sipas nenit 177 paragrafët 4 e 5 (për rishikimin e Kushtetutës) brenda 60 ditëve. Gjykata në këtë rast vihet në lëvizje nga subjektet që legjitimohen para Gjykatës sipas parashikimeve të nenit 134 të Kushtetutës dhe të Kodit Zgjedhor.

Çështja e referendumeve, përveç Kushtetutës, rregullohet nga dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor (KZ), Pjesa e pestë. Kreu i dytë i kësaj pjese bën dallimin ndërmjet referendumeve kushtetuese, të përgjithshme vendore dhe parashikon procedurat përkatëse (nenet 118-128 të KZ). Më konkretisht, neni 126 i KZ mbi nismën për referendum të përgjithshëm e përdor fjalën “kërkesë” për të kuptuar “kërkesën për referendum nga 50 mijë zgjedhës”; “kërkesën për fillimin e procedurave të referendumit”. Neni 128 përshkruan me hollësi verifikimin e kërkesës nga KQZ. Neni 128 paragrafi 2 i Kodit Zgjedhor qartëson se KQZ-ja vendos për pranimin ose mospranimin e kërkesës brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së saj, duke e bazuar vendimin *vetëm* mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur. Fjalja pasuese e nenit se “ky vendim duhet t’i njoftohet nismëtarëve” lë të kuptojë që fjala ‘kërkesë’ përfshin edhe “kërkesën për fillimin e procedurave të referendumit”. Normat e përcaktuara në nenet 126 dhe 128, nisur nga interpretimi literal, e kufizojnë hapësirën e vlerësimit të KQZ-së lidhur me kërkesën për të filluar një referendum të përgjithshëm vetëm në çështjen nëse janë plotësuar kriteret e nenit 126, pika 4 për fillimin e procedurave për referendum.

Ndonëse Kodi Zgjedhor i njeh KQZ-së autoritetin për të pranuar kërkesat për ushtrimin e të drejtës për referendum, si çdo dispozitë ligjore që kufizon të drejta edhe kjo duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtë. Gjykata Kushtetuese është shprehur më parë për rëndësinë dhe instrumentin e referendumit si mjet kushtetues i lidhur me nocionin e sovranitetit të popullit (neni 2/1 i Kushtetutës), që ushtrohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur prej tij ose në mënyrë të drejtpërdrejtë (neni 2/2). Çështja e përcaktimit të kushteve dhe rasteve, në të cilat populli mund ta ushtrojë sovranitetin në mënyrë të drejtpërdrejtë, merr një rëndësi themelore (*Shih vendimin e GJK nr. 31, datë 19.11.2003*). Nga ky këndvështrim, kompetenca

e KQZ-së për shqyrtimin e kërkesës për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit interpretohet se duhet ushtruar në mënyrë strikte dhe brenda kufijve që përcaktojnë nenet 126 dhe 128 të Kodit Zgjedhor.

Neni 129 i KZ parashikon se KQZ-ja pasi verifikon rregullsinë e kërkesave, ia përcjell kërkesat për referendum të Përgjithshëm Presidentit të Republikës dhe Gjykatës Kushtetuese. Këto kërkesa KQZ-ja duhet t'ia dërgojë për vlerësim Gjykatës Kushtetuese, dhe është kjo e fundit që vendos paraprakisht për kushtetueshmërinë e kërkesave për referendum të përgjithshëm nga pikëpamja e çështjeve që shtrohen në kërkesë. Gjykata Kushtetuese paraprakisht mund të shprehet nëse kërkesa e paraqitur kualifikohet sipas nenit 150 apo sipas nenit 177 të Kushtetutës. Më pas Gjykata Kushtetuese ushtron kompetencën ekskluzive dhe shprehet paraprakisht për kushtetueshmërinë e çështjeve që shtrohen për referendum në përputhje me parashikimet e nenit 152 të Kushtetutës.

Vendimi i KQZ-së, objekt shqyrtimi para Gjykatës Kushtetuese, në pjesën arsyetuese të tij përmban vlerësime rreth kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumit, të cilat për nga përmbajtja janë drejtpërdrejtë interpretime që lidhen me kushtetueshmërinë e çështjeve që shtrohen për referendum. Kështu p.sh. KQZ shprehet, se “Kushtetuta e RSH ..parashikon ushtrimin e drejtpërdrejtë të sovranitetit të popullit nëpërmjet referendumit...Kushtetuta parashikon disa lloje referendumesh..”, “në rastin konkret jemi para një kërkesë për referendum kushtetues” etj. Nga analiza e pjesës arsyetuese të vendimit të KQZ-së rezultojnë, se në disa paragrafë KQZ-ja del përtej vlerësimeve që ajo duhet të bënte sipas neneve 126 dhe 128 të Kodit Zgjedhor, i cili i kërkon të vendosë për pranimin ose mospranimin e kërkesës nga data e paraqitjes së saj duke e bazuar vendimin vetëm mbi rregullsinë e dokumentacionit.

Mbi bazën e kësaj analize kushtetuese pakica konkludon, se vendimi nr.47, datë 05.06.2008 i KQZ është rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor për shkak të tejkalimit të kompetencave që i ka caktuar ligji këtij organi.

Anëtarë: Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Fehmi Abdiu

*
* *

Vendim nr. 5, datë 21.01.2011

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga : Sokol Sadushi, Anëtar i Gjykatës Kushtetuese Vitore Tusha, Anëtare e Gjykatës Kushtetuese dhe Admir Thanza, Anëtar i Gjykatës Kushtetuese në datë 21.01.2011 mori në shqyrtim paraprak kërkesën me nr. 05 Akti, që i përket:

KËRKUES: GRUPI NISMËTAR PËR ZHVILLIMIN E NJË REFERENDUMI

SUBJEKTE TË INTERESUARA: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 26, datë 28.09.2010
2. Interpretimi përfundimtar i nenit 150, pika 1 të Kushtetutës.

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, pasi shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Një grup nismëtar për zhvillimin e një referendumi, në mbështetje të nenit 150 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 126, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, në datën 5.8.2010 ka paraqitur kërkesë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendum, për një çështje të rëndësishme së veçantë, duke ftuar zgjedhësit për të vendosur në lidhje me rinumërimin e fletëve të votimit të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009. Pas ndërhyrjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 398, datë 24.8.2010, kërkuesi ka paraqitur përsëri kërkesën, duke saktësuar tri pyetjet e shtruar në pyetjen e vetme se :*“A duhet të rinumërohen fletët e votimit të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009?”*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 26, datë 28.09.2010, ka vendosur mospranimin për shqyrtim të kërkesës së

grupit nismëtar, me arsyetimin e paqartësisë së saj, për çështjen e rëndësisë së veçantë, për të cilën duhet zhvilluar referendumi. Sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përderisa procesi i rinumërimit të votave parashikohet shprehimisht nga Kodi Zgjedhor, shtrimi i pyetjes për këtë proces e devijon çështjen e rëndësisë së veçantë në referendum për shfuqizimin e ligjit. Kërkesa e paraqitur rezulton, sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e ngritur ligjërisht gabim.

Në rrethana të tilla, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për shkak të një konfondimi që, sipas tij, i bën kërkuesi të dy llojeve të referendumit, ka argumentuar pamundësinë për të shqyrtuar në themel kërkesën, me qëllim vendosjen e përmbajtjes së fletës tip. Për rrjedhojë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur në bazë të nenit 128, pika 2 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, mospranimin për shqyrtim të kërkesës.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke parashtruar se vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i papajtueshëm me Kushtetutën dhe si i tillë duhet të shfuqizohet. Pasi ka arsyetuar për legjitimitimin e tij për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, si e vetmja instancë që shqyrton në rastin konkret vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, argumentet në drejtim të thelbit të kërkesës bazohen në parregullsinë e procesit të zhvilluar nga ky organ i ngarkuar nga ligji për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit. Argumenti kryesor në kërkesë bazohet në mohimin që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në kundërshtim me nenin 150 të Kushtetutës, i ka bërë kërkesës së grupit nismëtar për zhvillimin e referendumit për një çështje të rëndësisë së veçantë.

Kërkuesi pretendon se i ka përmbushur kriteret ligjore për përcaktimin e çështjes që do të shtrohet në referendum, rëndësinë e saj, duke evidentuar dhe pyetjen konkrete që do të shtrohet në referendum. Arsyetimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për paqartësinë e çështjes që përcakton dhe llojin e referendumit, kërkuesi e konsideron të pabazuar sepse, sipas tij, janë respektuar kërkesat e Kushtetutës dhe të Kodit Zgjedhor, në lidhje me referendumin për një çështje të rëndësisë së veçantë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më datën 29.12.2010 ka vendosur hapjen e kutive të votimit dhe të materialeve zgjedhore, të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 28 Qershor 2009. Ndaj këtij vendimi, kërkuesi ka paraqitur një shtesë të objektit të kërkesës, duke kërkuar shfuqizimin e tij si antikushtetues. Sipas kërkuesit, një vendim i tillë, mbi bazë të të cilit fillon djegia e fletëve të votimit dhe në kundërshtim me

Kodin Zgjedhor, e bën të pavlefshëm kërkesën për zhvillimin e referendumit.

Kolegji Gjykatës Kushtetuese (Kolegji) çmon se kërkesa e paraqitur nga një grup nismëtar është haptazi e pabazuar. Sipas dispozitave të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur nga jo më pak se 12 nismëtar për zhvillimin e referendumit për një çështje të rëndësishme të veçantë. Përderisa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, siç rezulton nga vendimi nr. 26, datë 28.09.2010, ka vlerësuar anën formale të rregullsisë së dokumentacionit, që lidhet me përcaktimin e qartë të llojit të referendumit e të llojit të objektit të kërkesës, Kolegji çmon se një shqyrtim i tillë nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese por të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ndaj qëndrimeve që mban Komisioni Qendror i Zgjedhjeve lidhur me parregullsinë e dokumentacionit të paraqitur është detyrimi i kërkuarit për të shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore që kërkon Kodi Zgjedhor për të riparaqitur kërkesën pas korrigjimit të parregullsive të vërejtura.

Përderisa, këto çështje përfshihen në juridiksionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nuk janë pjesë e ndonjë juridiksioni kushtetues, Kolegji vlerëson se kërkesa, si haptazi e pabazuar, nuk plotëson kushtet për t’u kaluar në seancë.

PËR KËTO ARSYE;

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare

*
* * *

Vendim nr. 8, datë 08.03.2013
(V-8/13)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Bashkim Dedja, Kryetar, Vladimir Kristo, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Admir Thanza, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, anëtarë, me sekretare Elta Milori, në datën 12.02.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 4 Akti, që i përket:

KËRKUES: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, përfaqësuar nga Dëshira Pasko, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: **MBI 50 MIJË ZGJEDHËS**, me nismëtarë Kozara Kati, Ermira Pirdeni, Andi Tepelena, Yllka Hida, Lavdosh Feruni, Leart Kola, Elton Kacidhja, Blendi Kajsui, Andi Kananaj, Geldona Metaj, Aldo Merkoçi, Rajmonda Stefa, të përfaqësuar nga avokatët Arben Hakani dhe Dorian Matlia, me prokurë të posaçme;

KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj dhe Arjeta Çefa, me autorizim;

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Ivi Kaso, me autorizim.

OBJEKTI: Kushtetutshmëria e kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e nenit 22, pika 3, dhe nenit 49 të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

BAZA LIGJORE: Nenet 150, paragrafi 1, 151, paragrafët 2 dhe 3, 152, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 129, paragrafi 2, i ligjit nr.9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha; mori në shqyrtim kërkesën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shqyrtimin, paraprakisht, të kushtetutshmërisë së çështjes së shtruar për referendum të përgjithshëm shfuqizues; pretendimet e përfaqësuesve të grupit nismëtar, që kërkuan deklarin e kërkesës në pajtim me Kushtetutën; prapësimet e përfaqësuesve të subjekteve të interesuara, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe, pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

1. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, qëllimi i të cilit është mbrojtja e mjedisit dhe e shëndetit të njeriut dhe sigurimi i menaxhimit të duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet: (a) parandalimit dhe minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i tyre, (b) përmirësimit të efikasitetit të përdorimit të tyre, (c) pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve (neni 1). Në kuptim të këtij ligji, “*menaxhim i integruar i mbetjeve*” është grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe asgjësimi i mbetjeve dhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtejshëm për vendet e asgjësimit si dhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e tregtarit ose agjentit” (neni 3, pika 32), kurse “*mbetja*” është çdo substancë ose objekt, të cilin mbajtësi e hedh, ka ndërmend ta hedhë ose i kërkohet ta hedhë (neni 3, pika 31). Ligji mban shënimin se përmbajtja është e përafër plotësisht me Direktivën 2008/98/KE “Për mbetjet” të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Bashkimit Evropian.

2. Në datën 30.11.2011, një grup prej 16 nismëtarësh i janë drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me kërkesë për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi të përgjithshëm, për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, konkretisht, të nenit 22, pika 3 “Rrjeti i integruar i impianteve të trajtimit të mbetjeve”, që parashikon se: “*Këshilli i Ministrave ndalon ose kufizon importin e mbetjeve, që destinohet për incinerim, kur ky operacion klasifikohet*

si rikuperim dhe vlerësohet se: a) një gjë e tillë është e nevojshme për të mbrojtur rrjetin e impianteve të trajtimit të mbetjeve; b) importe të tilla mundësojnë trajtimin ose asgjësimin e mbetjeve të vendit me mënyra që nuk përputhen me planet përkatëse të menaxhimit të integruar të mbetjeve.” dhe të nenit 49 “Importi i mbetjeve jo të rrezikshme” që parashikon se “1. Në Republikën e Shqipërisë importohen vetëm mbetjet jo të rrezikshme apo mbetjet inerte, përveç atyre të përcaktuara në pikën 3 të nenit 48 të këtij ligji. 2. Importimi i mbetjeve, sipas pikës 1 të këtij ligji, është i mundur vetëm me autorizim të Këshillit të Ministrave. 3. Kërkesa për autorizimin e importit paraqitet në ministri. 4. Autorizimi i importit të mbetjeve jo të rrezikshme lëshohet vetëm në përputhje të plotë me këtë ligj dhe akte të tjera në fuqi. 5. Këshilli i Ministrave, kur shqyrton kërkesën për importin e mbetjeve jo të rrezikshme, merr në konsideratë arsyet e importimit të këtyre mbetjeve. Kërkuesi i autorizimit të importit të mbetjeve jo të rrezikshme duhet të provojë se janë shfrytëzuar të gjitha mbetjet, sipas llojit dhe kodit, të kërkuar në vend. 6. Autorizimi për importin e mbetjeve jo të rrezikshme është i vlefshëm për një periudhë kohe deri një vit dhe i nënshtrohet kushteve të përgjithshme, të përcaktuara në rregulloret e miratuara në zbatim të këtij ligji, si dhe çdo kushti specifik që lidhet me rastin konkret. 7. Në autorizimin e importimit të mbetjeve përcaktohen: a) lloji i mbetjeve për importin e të cilave lëshohet; b) standardet që lidhen me ambalazhimin dhe etiketimin e mbetjeve dhe dokumentet shoqëruese gjatë transportit të tyre; c) kërkesat për monitorimin dhe raportimin e lëvizjeve të mbetjeve. 8. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton listën e mbetjeve që lejohen të importohen dhe rregullat për zbatimin e këtij neni”.

3. Brenda 90 ditëve nga depozitimi i kërkesës së grupit nismëtar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka verifikuar nënshkrimet e mbi 50 000 zgjedhësve, saktësinë e dokumenteve të identifikimit si dhe rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur. KQZ-ja, ndonëse ka konstatuar parregullsi në nënshkrimet e zgjedhësve, ka rritur në përfundimin se numri i zgjedhësve që kanë nënshkruar për zhvillimin e referendumit mbetet përsëri mbi 50 000 zgjedhës, në përmbushje të kërkesës kushtetuese dhe ligjore. Me vendimin nr.10, datë 28.06.2012 “Për shqyrtimin e kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 ‘Për menaxhimin e integruar të mbetjeve’” ka vendosur, midis të tjerash, pranimin e kërkesës së paraqitur nga

grupi nismëtar, si në përputhje me nenet 129, pika 2 dhe 119, pika 6, të ligjit nr.9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

II

4. **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, në datën 11.01.2013, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin, paraprakisht, të kushtetutshmërisë së kërkesës së grupit nismëtar për shfuqizimin e nenit 22, pika 3, dhe nenit 49 të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, bazuar në nenin 152, pika 1 e Kushtetutës dhe në nenin 129, pika 1 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar.

5. **Subjekti i interesuar, Grupi Nismëtar**, në kërkesën për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm shfuqizues, drejtuar KQZ-së, si dhe në parashtrimet e paraqitura në seancën plenare përpara Gjykatës Kushtetuese, ka parashtruar se:

5.1 Ligji, nenet e të cilit kërkohen të shfuqizohen me referendum, nuk përfshihet në çështjet që ndalohen t’i nënshtrohen referendumit sipas pikave 2 dhe 3 të nenit 151 të Kushtetutës dhe, gjithashtu, është në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 126, pika 3 dhe 5 dhe nenin 129, pika 2, të Kodit Zgjedhor. Çështja që do të shtrohet për referendum është formuluar qartë, në mënyrë të plotë dhe pa ekuivoqe dhe zgjedhësit mund të përgjigjen me “Po” ose “Jo”.

5.2 Nenet objekt shfuqizimi parashikojnë mundësinë e importit të mbetjeve me qëllim asgjësimi, duke vënë në rrezik qëllimin e ligjit që është kufizimi i importit të mbetjeve për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të individëve dhe cilësinë e mjedisit.

5.3 Ligji është i vetëmjaftueshëm, pasi në rast shfuqizimi të nenit 49, i cili parashikon llojet e mbetjeve që lejohen të importohen, autoritetin e dhënies së autorizimit të importit dhe procedurat, nuk shkaktohen probleme për pjesën tjetër të tij, sepse ekzistojnë nene të tjera me parashikime të qarta ligjore dhe detyrime negative të shtetit. Konkretisht, neni 48 rregullon ndalimin e importit dhe të kalimit transit të mbetjeve të rrezikshme dhe ndalimin e mbetjeve jo të rrezikshme, për arsye ruajtjeje ose asgjësimi.

5.4 Nenet 48 dhe 49 të ligjit duhen parë në raport me parashikimet e Konventës së Bazelit, neni 4, pika 1/c dhe pika 7, sipas të cilave importi nuk mund të kryhet nëse shtetet e tjera nuk marrin pëlqimin me

shkrim nga shteti shqiptar dhe nëse operatorët e importit nuk pajisen me autorizimin përkatës nga Këshilli i Ministrave. Këto rregullime konventore parashikohen edhe në pikat 1 deri në 7 të nenit 49.

5.5 Po ashtu, pika 1 e nenit 49 parashikon, përveç importit të mbetjeve jo të rrezikshme, edhe importin e mbetjeve inerte. Mungesa e lidhjes organike midis pikës 1 dhe neneve të tjera të ligjit, nuk krijon probleme në rast shfuqizimi. Kurse, pikat 2-8 të nenit, që parashikojnë modalitetet e administrimit të importit, mbeten pa asnjë funksion dhe, natyrshëm, duhet të hiqen nga ligji.

5.6 Edhe shfuqizimi i pikës 3 të nenit 22 nuk shkakton probleme për pjesën tjetër të ligjit, pasi, në rast të ndalimit të importit të mbetjeve, përmbajtja e saj mbetet pa funksion dhe pa zbatim. Po ashtu, përmbajtja e pikës 3 qëndron jashtë logjikës së problematikës së normës ku bën pjesë dhe, për më tepër, bie ndesh edhe me nenin 48, pika 3, pasi duke lejuar importin e mbetjeve jo të rrezikshme me qëllim asgjësimi, relativizon detyrimin negativ absolut të shtetit, duke i dhënë Këshillit të Ministrave diskrecion të pamërituar.

5.7 Procesi i incinerimit, që parashikon pika 3 e nenit 22, është asgjësim, për rrjedhojë, ky i fundit nuk mund të konsiderohet rikuperim. Mbetjet që i nënshtrohen operacionit të incinerimit me qëllim rikuperimi janë vetëm mbetjet bashkiake dhe jo ato të importuara, kurse impiantet e incinerimit duhet të kenë qëllim parësor prodhimin e energjisë dhe jo incinerimin e mbetjeve, pra asgjësimin e tyre. Edhe në rast rikuperimi, mbetjet do të ruhen përkohësisht në vende të caktuara, duke u shndërruar nga mbetje jo të rrezikshme në të rrezikshme, për shkak të kombinimeve fiziko-kimiko-biologjike për shkak të kushteve atmosferike dhe ndërveprimit me faktorë të tjerë.

6. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, prapësoi në mënyrë të përmbledhur si vijon:

6.1 KQZ-ja nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, pasi vendimi nr.10, datë 28.06.2012, që e konsideron të rregullt kërkesën për referendum, është një akt absolutisht i pavlefshëm, që bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe nenet 126-130 të Kodit Zgjedhor. KQZ-ja, pas konstatimit, me përzgjedhje rastësore, të firmave të falsifikuara, kishte detyrimin ligjor të verifikonte të gjitha nënshkrimet e depozituara nga grupi nismëtar për zhvillimin e referendumit.

6.2 Kërkesa për zhvillimin e referendumit shfuqizues bie ndesh me ndalimet e parashikuara në nenin 151, pika 2 të Kushtetutës, pasi nenet objekt referendumi kufizojnë të drejta dhe liri themelore dhe, po ashtu, lidhen me buxhetin, taksat dhe detyrimet financiare të shtetit. Konkretisht, në rast të shfuqizimit të neneve të kundërshtuara, cenohet, padrejtësisht, dinjiteti njerëzor, si një prej vlerave themelore të organizimit të shtetit, cenohet liria ekonomike dhe parimi i ligjshmërisë dhe, po ashtu, e drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, në referim të nenit 59/d të Kushtetutës. Gjithashtu, shfuqizimi i normave ligjore të kundërshtuara dhe, për rrjedhojë, ndalimi i importit të mbetjeve, pakëson të ardhurat që burojnë nga taksat dhe tatimet.

6.3 Shfuqizimi i neneve me referendum cenon kërkesën për vetëmjaftueshmëri të ligjit. Nenet 22, pika 3, dhe 49 të ligjit kanë lidhje logjike dhe në përmbajtje me njëra–tjetrën, për rrjedhojë, nuk duhet të lexohen dhe të interpretohen të shkëputura, pasi do të sillnin kuptim dhe zbatim të gabuar të ligjit. Kështu, nëse shfuqizohet neni 49, përmbajtja e ligjit cenohet, pasi nuk do të ekzistojë asnjë dispozitë ligjore për kufizimin e llojeve të mbetjeve që lejohen të importohen, për procedurat e importit dhe mbikëqyrjen e importeve të mbetjeve jo të rrezikshme për riciklim. Gjithashtu, përmbajtja e këtij neni është në përputhje me kërkesat që burojnë nga kuadri ligjor për mjedisin në Republikën e Shqipërisë dhe me objektivat specifike për zbatimin e nenit 108 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), pasi ka transpozuar plotësisht Direktivën 2008/98/KE për mbetjet dhe, pjesërisht, Direktiva të tjera të BE-së.

6.4 Kërkesa nuk plotëson elementet e saktësisë dhe qartësisë, si detyrime që burojnë nga neni 126, pikat 4 dhe 6 i Kodit Zgjedhor. Formulimi i kërkesës pasqyron një raport shpërpjestimor midis mjetit të përdorur dhe qëllimit që synohet të arrihet dhe, po ashtu, një kontradiktë të plotë midis arsyeve të kërkesës, “ndalimi i importit pa kriter të mbetjeve”, dhe rezultatit ligjor, “lejimi i importit pa asnjë kusht dhe pengesë”.

6.4 Kërkesa për referendum shfuqizues cenon parimin e sigurisë juridike, pasi, duke shfuqizuar nenet e kundërshtuara, cenohet liria ekonomike. Një kufizim i tillë mund të vendoset vetëm me ligj, duke miratuar një tekst pozitiv dhe jo përmes teknikës së shfuqizimit të ligjit.

7. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave prapësoi në mënyrë të përmbledhur si vijon:

7.1 Ligji përqas plotësisht Direktivën 2008/98/KE të Bashkimit Evropian, dhe pjesërisht Rregulloren 1013/2006 për transferimin e mbetjeve dhe, po ashtu, është hartuar në zbatim të nenit 108 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

7.2 Ligji nuk e përmbush kriterin që pjesa e mbetur e tij të jetë e vetëmjaftueshme, në rast se nenet 22, pika 3, dhe 49 shfuqizohen me referendum. Kuadri ligjor, i cili do të mbetet i cinguar, do të lejonte importin e mbetjeve, por pa ofruar garancitë administrative dhe procedurale të domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, që përbën edhe qëllimin e ligjit.

7.3 Po ashtu, kërkesa nuk plotëson kriterin e qartësisë, mungesës së ekuivokut dhe homogjenitetit, në kundërshtim me nenin 126, pika 5 të Kodit Zgjedhor. Nëse zgjedhësit do të shpreheshin pro shfuqizimit të neneve të propozuara, rezultati, pas referendumit, do të ishte i kundërt me synimin e grupit nismëtar për ndalimin tërësisht të importit, pasi importi jo vetëm do të liberalizohej, por mbetjet do të importoheshin në mungesë të garancive rregullatore.

7.4 Shfuqizimi i neneve objekt referendumi do të cenonte në mënyrë të tërthortë Kushtetutën, konkretisht nenin 59, pikat “d” dhe “dh”, si dhe detyrimet ndërkombëtare që burojnë nga neni 6 i MSA-së për përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Mbi legjitimitimin e kërkuarit¹

8. Gjykata Kushtetuese (Gjykata), vlerëson, paraprakisht, të marrë në shqyrtim pretendimin e përfaqësuesit të subjektit të interesuar, Kuvendit të Shqipërisë, mbi moslegjitimitimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vënien në lëvizje të gjykimin kushtetues. Sipas përfaqësuesit të Kuvendit të Shqipërisë, KQZ-ja, pas konstatimit nga Instituti i Policisë Shkencore se rreth 70% e firmave të përzgjedhura rastësisht ishin të falsifikuara, kishte detyrimin ligjor të verifikonte të gjitha nënshkrimet e depozituara nga grupi

¹ Gjyqtari V.Kristo votoi kundër legjitimitimit *ratione materiae* të kërkuarit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

nismëtar për zhvillimin e referendumit. Për rrjedhojë, për shkak të mospërbushjes së këtij detyrimi, vendimi nr.10, datë 28.06.2012 i KQZ-së, që e konsideron të rregullt kërkesën për referendum, është një akt absolutisht i pavlefshëm, që bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe nenet 126-130 të Kodit Zgjedhor.

9. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta), në Pjesën e XI dhe XVII (nenet 150-152,177) parashikon llojet e referendumeve, subjektet që legjitimohen të kërkojnë zhvillimin e tyre dhe ndalimet kushtetuese në lidhje me to. Për sa i përket parimeve dhe procedurave për zhvillimin e referendumit si dhe vlefshmërisë së tij, Kushtetuta parashikon shprehimisht se ato parashikohen me ligj (neni 150, pika 3).

10. Në përmbushje të këtij parashikimi kushtetues, parimet dhe procedurat mbi referendumet, janë parashikuar, fillimisht, nga ligji nr.9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, midis të tjerash, edhe me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008. Ky i fundit, në nenin 185 përcakton se "*dispozitat për referendumet (pjesa e IX e ligjit nr.9087/2003) si dhe çdo pjesë e dispozitave të tij që ka lidhje me të, mbetet në fuqi deri në miratimin e ligjit të ri për referendumet e përgjithshme dhe vendore. Administrimi i procesit të referendumeve dhe nxjerrja e rezultatit të tyre bëhen në përputhje me këtë Kod*".

11. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se në përputhje me kërkesat e nenit 126, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kërkesa për fillimin e procedurave të referendumit për shfuqizimin e neneve 22, pika 3, dhe 49 të ligjit është paraqitur në KQZ nga një grup prej jo më pak se 12 nismëtarësh, të cilët janë zgjedhës të regjistruar ne Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve. KQZ-ja, bazuar në detyrimet që parashikon neni 128 i Kodit Zgjedhor, ka verifikuar nënshkrimet në fletët-tip dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të zgjedhësve dhe, me vendim të arsyetuar nr.10, datë 28.06.2012, ka vendosur pranimin e kërkesës për zhvillimin e referendumit.

12. Gjykata, nisur nga prapësimet e subjektit të interesuar, Kuvendit të Shqipërisë, mbi moslegjitimimin e kërkuarit, çmon se vendimi i KQZ-së, për pranimin e kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm shfuqizues, nuk i nënshtrohet vlerësimit nga Gjykata, por përbën mjetin për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues për të shqyrtuar, paraprakisht, kushtetutshmërinë e kërkesës për referendum të përgjithshëm shfuqizues, të paraqitur nga grupi nismëtar në emër të mbi 50 mijë zgjedhësve.

13. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se plotësohen kërkesat për legjitimimin *ratione personae* të KQZ-së, pasi është subjekti të cilit Kodi Zgjedhor i njuh kompetencën për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues për shqyrtimin, paraprakisht, të kushtetutshmërisë së kërkesës për referendum të përgjithshëm shfuqizues. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, pretendimet e kërkuarit janë *prima facie* në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, pasi ato përfshihen në rregullimin kushtetues të neneve 131/ë dhe 152/1, që parashikojnë se Gjykata Kushtetuese vendos për “kushtetutshmërinë e referendumeve” dhe “shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum”. Për sa i përket legjitimitit *ratione temporis*, kërkesa është paraqitur brenda afateve të parashikuara nga Kodi Zgjedhor, i ndryshuar.

B. Lidhur me kushtetutshmërinë e kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm shfuqizues të neneve 22, pika 3, dhe 49 të ligjit

14. Kushtetuta, në nenin 150 parashikon të drejtën e popullit, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, për të kërkuar referendumin për shfuqizimin e një ligji. Në referim të nenit 152, pika 1, kushtetutshmëria e çështjeve të shtruara për referendum shqyrtohet, paraprakisht, nga Gjykata Kushtetuese, në një proces gjykimi kushtetues të posaçëm, i cili duhet të përfundojë brenda 60 ditëve nga paraqitja e kërkesës nga KQZ-ja.

15. Gjykata ka theksuar se referendumi është mjeti kushtetues që lidhet me nocionin e sovranitetit të popullit (neni 2/1 i Kushtetutës), që ushtrohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur prej tij ose në mënyrë të drejtpërdrejtë (neni 2/2). Çështja e përcaktimit të kushteve dhe rasteve në të cilat populli mund ta ushtrojë sovranitetin në mënyrë të drejtpërdrejtë, merr rëndësi themelore. Parimi i ushtrimit të sovranitetit nga populli nënkupton një koncept demokratik sipas kriterëve të një demokracie përfaqësuese, që përmban edhe elemente që mundësojnë ushtrimin direkt të demokracisë kushtetuese. Me këtë kuptohet që populli, të drejtën për të ushtruar funksion ligjvënës, normalisht, nuk e ushtron vetë në mënyrë të drejtpërdrejtë, por nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur prej tij (*shih vendimin nr.31, datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Sovraniteti i popullit, i vendosur në kuadrin e një sistemi kushtetues e ligjor, nuk mund të ngatërrohet me pushtetin themelor dhe kërkesa për të ndjekur disa procedura të veçanta, gjatë

ushtrimit të tij, është tërësisht në përputhje me sovranitetin popullor. Kushtetuta, në mënyrë të qartë, e ka lidhur ushtrimin e sovranitetit popullor me rregulla të veçanta. Është e vërtetë se në përputhje me nenin 2, pika 1, të Kushtetutës “*sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i takon popullit*”. Por, ky deklaram nuk nënkupton ushtrimin e sovranitetit nga populli në mënyrë të pakushtëzuar. Çdo nen i Kushtetutës duhet të interpretohet në kontekstin e Kushtetutës si një e tërë dhe jo i izoluar (*shih vendimin nr.25, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Instrumentet e demokracisë direkte konsiderohen jo si pushtet konkurrues i organeve përfaqësuese, por si instrumente që mundësojnë mënjanimin e mungesës së veprimit nga ana e përfaqësuesve, ose balancimin e kësaj mungese. Ato nuk mundësojnë bërjen e ligjeve, funksion i cili i është ngarkuar ekskluzivisht ligjvënësit. Në këtë mënyrë, referendumi paraqitet si mjet për *integrimin dhe stimulimin* e procesit ligjvënës në parlament, në rastet kur nuk gjen zbatim parimi i përputhjes së vullnetit të shumicës parlamentare me shumicën e popullit në një çështje konkrete. Pra, bëhet fjalë për një instrument që mundëson transmetimin e mendimit të zgjedhësve në drejtim të instancave politike (*shih vendimin nr.31, datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Kushtetuta, si ligji themelor i shtetit, i detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese, duke i dhënë, në këtë mënyrë, jetë parimit të rëndësishëm të kushtetutshmërisë funksionale. Normat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur vetë Kushtetuta parashikon ndryshe. Ky parim themelor sanksionohet në nenin 4, pika 3 të Kushtetutës, dhe nënkupton se kur rregulli kushtetues parashikohet shprehimisht, ai nuk mund të mënjanohet dhe as të tejkalohet, por duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti (*shih vendimin nr.29, datë 09.11.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Kushtetuta, në nenin 152, pika 1, evidenton elementët përcaktues të kufijve të shqyrtimit të kushtetutshmërisë së kontrollit të çështjes së shtruar për referendum. Shqyrtimi i kushtetutshmërisë kërkon domosdoshmërisht vlerësimin nëse, në rastin në shqyrtim, janë të pranishme ndalime të atij lloji që parashikon neni 151, paragrafi 2 i Kushtetutës, konkretisht, nëse ligji (ose nene të tij) i kërkuar për t’u hedhur në referendum me qëllim shfuqizimi, është nga

ajo kategori ligjesh, për të cilat Kushtetuta nuk lejon, shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar, ndërmarrjen e një procedure të tillë referendare. Gjykata, në referim të përmbajtjes së nenit 151, pika 2, konstaton se lista e çështjeve, të cilat nuk mund të shtrohen për referendum të përgjithshëm shfuqizues, kufizohet në ato që lidhen me tërësinë territoriale të RSH-së, me kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore, me buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit, me vendosjen dhe heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme, me deklarimin e luftës dhe të paqes dhe me amnistinë.

20. Gjykata rithekson se çdo dispozitë e Kushtetutës duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese. Kjo, për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik. Natyra e Kushtetutës, koncepti i kushtetutshmërisë, nënkupton që Kushtetuta nuk mund të ketë kontradikta të brendshme. Për pasojë, asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete (shih vendimin nr.25, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë kuptim, në referim të jurisprudencës kushtetuese, mund të identifikohen edhe ndalime të nënkuptuara, ose, e thënë ndryshe, ekzistenca e kërkesave të tjera kushtetuese të lidhura me ato të nenit 151 të Kushtetutës, të cilat preken nga ligji (nenet) objekt referendumi.

21. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se nga analiza e përmbajtjes së ligjit nenet e të cilit kërkohen të shfuqizohen me referendum, rezulton se nene të veçanta të tij bëjnë referencë të drejtpërdrejtë në norma me hierarki të ndryshme normative, si në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit”, “Për lejet e mjedisit”, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në RSH”, “Për koncesionet”, “Për kundërvajtjet administrative”; në Vendimet e Këshillit të Ministrave: nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”; nr.99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”; nr.798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”; nr.806, datë 4.12.2003 “Për miratimin e rregullave e procedurave për importimin e mbetjeve me qëllim përdorimi, përpunimi e riciklimi”; në Rregulloren nr.1, datë 30.3.2007, të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit “Për trajtimin e mbetjeve nga ndërtimi dhe shkatërrimet, që nga krijimi dhe transporti i tyre për asgjësim”; në

Udhëzimin nr.6, datë 27.11.2007 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave “Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta”; në Rregulloren nr.4, datë 15.10.2003 të Ministrit të Mjedisit “Për kërkimin, shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të eksportimit dhe të transitimit të mbetjeve”, apo në “Marrëveshjen Evropiane për Transportimin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme”.

22. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se ligji “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe nenet 22, pika 3, dhe 49 objekt referendumit, nuk i përkasin ndonjëres prej kategorive të ligjeve për të cilat ndalimi për t’iu nënshtruar referendumit është absolut dhe as ndalimeve të nënkuptuara, të cilat mund të shërbenin si arsye bindëse për të vlerësuar se ekziston lidhje e drejtpërdrejtë me to.

23. Në këtë kuptim, Gjykata i vlerëson si të pabazuara prapësimet e subjektit të interesuar, Kuvendit të Shqipërisë, se nenet objekt referendumit kufizojnë të drejta dhe liri themelore (dinjitetin njerëzor, lirinë ekonomike), lidhen me buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit dhe cenojnë parimin e i ligjshmërisë.

24. Subjektet e interesuara, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se, në rast shfuqizimi me referendum të neneve 22, pika 3, dhe 49, ligji nuk plotëson kriterin e vetëmjaftueshmërisë, në referim të nenit 126, pika 3 të Kodit Zgjedhor. Sipas tyre, kuadri ligjor, i cili do të mbetet i cunguar, do të lejonte importin e mbetjeve, por pa ofruar garancitë administrative dhe procedurale të domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, që përbën edhe qëllimin e ligjit.

25. Gjykata, duke i vlerësuar edhe këto pretendime nën dritën e parashikimeve kushtetuese që përcaktojnë kufijtë e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së çështjes së shtruar për referendum të përgjithshëm shfuqizues, parashikuar nga neni 151, pika 2 e Kushtetutës, arrin në përfundimin se argumentet e parashtruara nga përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, në mbështetje të prapësimeve lidhur me mungesën e vetëmjaftueshmërisë së ligjit pas shfuqizimit të neneve 22, pika 3, dhe 49, nuk janë bindëse për të provuar cenimin e ndalimeve kushtetuese.

26. Po ashtu, përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Këshilli të Ministrave, ka pretenduar se shfuqizimi i neneve 22, pika 3, dhe 49 të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, bie ndesh

me detyrimet ndërkombëtare që burojnë nga neni 6 i MSA-së për përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së, konkretisht me Direktivën 2008/98/KE të Bashkimit Evropian, Rregulloren 1013/2006 “Për transferimin e mbetjeve” dhe me kërkesat e nenit 108 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

27. Nisur nga natyra dhe karakteristikat e gjykimit kushtetues konkret, Gjykata vlerëson se objekt i tij është shqyrtimi, paraprakisht, i kushtetutshmërisë së kërkesës për referendum të përgjithshëm shfuqizues dhe jo pajtueshmëria e neneve, objekt i referendumit, me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.

28. Për sa i përket kërkesës së parashikuar nga neni 151, pika 3 e Kushtetutës, Gjykata konstaton se kërkesa për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së çështjes së shtruar për referendum nuk është paraqitur më parë në harkun kohor të tri viteve, për rrjedhojë, nuk ekziston ndonjë pengesë e karakterit kohor në këtë drejtim.

29. Në përfundim të analizës së mësipërme, Gjykata vlerëson se në përmbajtjen e kërkesës nuk konstatohen pengesa kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 150, paragrafi 1, 151, paragrafët 2 dhe 3 dhe 152, paragrafi 1 i Kushtetutës, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Pranimin e kërkesës.
- Deklarimin si të pajtueshme me Kushtetutën të kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e nenit 22, pika 3, dhe nenit 49 të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIM PAKICE

1. Jam dakord me arsyetimin e shumicës, lidhur me mungesën e ndalimeve kushtetuese të parashikuara nga neni 151, pika 2 e Kushtetutës, por ndaj mendim të ndryshëm në lidhje me elementet përcaktuese të kufijve të shqyrtimit, paraprakisht, të

kushtetutshmërisë së kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm, për shfuqizimin e neneve 22, pika 3, dhe 49 të ligjit “Mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

2. Llojet e referendumeve, subjektet që legjitimohen të kërkojnë zhvillimin e tyre, ndalimet kushtetuese në lidhje me to, parashikohen shprehimisht në Pjesën e XI dhe XVII të Kushtetutës (nenet 150-152, 177). Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit si dhe vlefshmëria e tij parashikohen me ligj (neni 150, pika 3), konkretisht ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor”, i cili në nenin 185, përcakton se “*dispozitat për referendumet (pjesa e IX e ligjit nr.9087/2003) si dhe çdo pjesë e dispozitave të tij që ka lidhje me të, mbetet në fuqi deri në miratimin e ligjit të ri për referendumet e përgjithshme dhe vendore. Administrimi i procesit të referendumeve dhe nxjerrja e rezultatit të tyre bëhen në përputhje me këtë Kod*”.

3. Në jurisprudencën kushtetuese referendumit është përkufizuar si një mjet kushtetues që lidhet me nocionin e sovranitetit të popullit (neni 2/1 i Kushtetutës), që ushtrohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur prej tij ose në mënyrë të drejtpërdrejtë (neni 2/2). Thelbi i këtij instituti të demokracisë konsiston në dy kritere kryesore: së pari në përkufizimin e pushtetit sovran të popullit, *suprema potestas*, dhe rëndësinë ligjore të akteve të miratuara në procesin e zbatimit të demokracisë së drejtpërdrejtë. Po ashtu, referendumit paraqitet si mjet për *integrimin dhe stimulimin* e procesit ligjvënës në parlament, në rastet kur nuk gjen zbatim parimi i përputhjes së vullnetit të shumicës parlamentare me shumicën e popullit në një çështje konkrete. Pra, bëhet fjalë për një instrument që mundëson transmetimin e mendimit të zgjedhësve në drejtim të instancave politike (*shih vendimin nr.31, datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Liria e nxitësve të kërkesave për zhvillimin e referendumit dhe liria e votuesve për vlerësimin e një kërkesë të tillë janë dy çështje të ndryshme dhe, për rrjedhojë, ato nuk duhet të ngatërrohen, pasi është e vërtetë se dorëzimi i kërkesave përbën burimin e nevojshëm për të filluar procesin referendar, por është po kaq i vërtetë edhe fakti se sovraniteti i popullit nuk ka të bëjë me sovranitetin e nxitësit dhe se populli duhet të jetë i garantuar në ushtrimin e pushtetit të tij sovran. Referendumi shfuqizues, si një mjet thelbësor i demokracisë së drejtpërdrejtë, nuk mund të shndërrohet në një instrument të shtrembëruar të demokracisë përfaqësuese (*shih vendimin nr.16/1978 të Gjykatës Kushtetuese Italiane*).

5. Në këtë kuptim, çështja e përcaktimit të kushteve dhe kritereve, të cilat duhet të respektohen nga populli për ta ushtruar sovranitetin në mënyrë të drejtpërdrejtë, merr rëndësi themelore kushtetuese. Kontrolli gjyqësor i objektit/kërkesës së referendumit, i cili i është ngarkuar, kryesisht, organeve kushtetuese të pavarura, si Gjykata Kushtetuese, tradicionalisht, është përqendruar në vlerësimin e dy elementeve: së pari, *vlefshmëria formale* e çështjes së shtruar për referendum, e cila vlerësohet nën dritën e qartësisë dhe njëtrajtshmërisë së pyetjes/objektit (p.sh. në SHBA, Zvicër ose Itali), që përbën edhe kërkesën minimale të referendumeve dhe, së dyti, *vlefshmëria materiale* e çështjes, e cila lidhet, para së gjithash, me vlerësimin e fushave të cilat janë objekt referendumi, por nuk përjashtohet edhe mundësia që të ketë lidhje edhe me pajtueshmërinë e propozimit për referendum me *status quo*-në, në disa fusha të caktuara, të legjisllacionit më të lartë në hierarki si Kushtetuta, ose katalogu i të drejtave, etj (shih “*The Oxford Book of Comparative Constitutional Law*”, 2012, fq. 522-523).

6. Edhe Kodi i Praktikave të Mira për Referendumet i Komisionit të Venecias, të Këshillit të Evropës, (shih CDL-AD(2007)008rev, datë 21.01.2009), për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore, veçanërisht të së drejtës për të votuar, përcakton tërësinë e rregullave dhe parimeve që duhen respektuar gjatë proceseve referendare nga të gjitha subjektet e interesuara dhe pjesëmarrëse në këtë proces. Në dritën e këtyre standardeve theksohet se, pavarësisht nga forma në të cilën paraqitet kërkesa për referendum, nga pikëpamja e *vlefshmërisë formale* ajo duhet të plotësojë parime që lidhen me: Unitetin e formës: kërkesa nuk mund të jetë kombinim i formave të ndryshme (p.sh.: formulim me terma konkrete, formulim me terma të përgjithshme, ose propozim në parim); Unitetin e përmbajtjes: me përjashtim të rasteve kur kërkesa ka të bëjë me rishikimin e të gjithë ligjit, në rastet e tjera duhet të ekzistojë një lidhje e natyrshme midis pjesëve të ndryshme të kërkesës/pyetjes të shtruar për votim, me qëllim garantimin e të drejtës së votës (nuk duhet të ekzistojë prishmëria që votuesi të pranojë ose rrëzojë, në tërësi, dispozita pa lidhje midis tyre). Ky parim është shprehje e lirisë së votës; Unitetin e nivelit hierarkik: e njëjta pyetje nuk mund të shtrohet, njëkohësisht, për ligje të niveleve të ndryshme hierarkike (p.sh. për Kushtetutën dhe legjisllacionin që del në bazë dhe zbatim të saj); Pyetje të qarta dhe jo orientuese: liria e votës nënkupton që “pyetja që i paraqitet elektoratit duhet të jetë e qartë

(jo e panjohur dhe as me disa kuptime); ajo nuk duhet të çojë në keqkuptime; nuk duhet të sugjerojë një përgjigje tjetër; zgjedhësit duhet të jenë të informuar për pasojat e referendumit; duhet të përgjigjen me “po” ose “jo”, ose me votë boshe. Këto parime, të cilat sanksionohen shprehimisht nga disa legjislacione kombëtare, duhet të konsiderohen universale. Për sa i përket *vlefshmërisë materiale* të tekstit që shtrohet për referendum, ai duhet të jetë në përputhje me të gjitha ligjet superiore (parimi i hierarkisë së normave) dhe jo në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare ose parimet statutore të Këshillit të Evropës si demokracia, të drejtat e njeriut dhe shteti i së drejtës.

7. Nisur nga sa më sipër, mendoj se shumica në vendim ka vlerësuar vetëm ndalimet kushtetuese të parashikuara në nenin 151, pika 2, të cilat përkojnë me vlerësimin e elementeve të vlefshmërisë materiale të kërkesës për referendum. Kriteret ndaluese si tërësia territoriale, të drejtat e njeriut, çështjet e buxhetit, etj, në përmbajtjen e tyre shprehin fusha për të cilat Kushtetuta ka përcaktuar shprehimisht ndalimin absolut për zhvillimin e referendumit shfuqizues. Janë pikërisht këto fusha që përcaktojnë kufijtë e kontrollit kushtetues, në kuptim të vlefshmërisë materiale të kërkesës.

8. Arsytimi i shumicës bie ndesh me vendimmarrjen e mëparshme të kësaj Gjykate, në të cilën ajo është shprehur se shqyrtimi i kushtetutshmërisë së kërkesës për referendum kërkon verifikimin dhe vlerësimin, paraprakisht, nga Gjykata të dy çështjeve: së *pari*, nëse, në rastin në shqyrtim, janë të pranishme ndalime të atij lloji që parashikon neni 152, paragrafi 2 i Kushtetutës. Konkretisht, Gjykata vlerëson nëse ligji i kërkuar për t'u hedhur në referendum me qëllim shfuqizimi, është nga ajo kategori ligjesh, për të cilat Kushtetuta nuk lejon, shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar, ndërmarrjen e një procedure të tillë referendare. Së *dyti*, nëse pjesa tjetër e ligjit është e vetëmjaftueshme në rast se shfuqizohen normat ligjore objekt i kërkesës për referendum shfuqizues, në vështrim të kufizimit që imponon neni 126, pika 3 e Kodit Zgjedhor. Madje, Gjykata ka vlerësuar se ky ndalim i parashikuar në Kodin Zgjedhor është në harmoni me parimin kushtetues të demokracisë përfaqësuese. Në këtë aspekt, nëqoftëse pas shfuqizimit me referendum, pjesa e mbetur e ligjit nuk do të ishte e vetëmjaftueshme, atëherë do të krijohej vakuum ligjor, situatë kjo që e detyron ligjvënësin që edhe kundër dëshirës së tij, të plotësojë këtë vakuum. Kjo situatë, nëqoftëse do të përsëritej shpesh, do të cenonte parimin themelor

të demokracisë parlamentare. Në qoftë se ligjvënësi nuk reagon në përgjigje të vakuimit legjislativ, atëherë sistemi kushtetues nuk ofron ndonjë mjet efektiv, dhe kjo situatë mund të çonte në një krizë në sistemin e demokracisë përfaqësuese. Gjykata ka vlerësuar, gjithashtu, se me ndalimin e mësipërm, ligjvënësi ka pasur për qëllim shmangien e vakuimeve legjislative, që është në mbrojtje të një parimi të rëndësishëm të shtetit të së drejtës, dhe pikërisht të parimit të sigurisë juridike. Kushti që pjesa e mbetur e ligjit, në rast të një referendumit shfuqizues, të jetë e vetëmjaftueshme, i shërben qëndrueshmërisë së sistemit juridik (*shih vendimin nr.31, datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në vlerësimin tim, shumica duhet të kishte vlerësuar, paraprakisht, edhe elementet e vlefshmërisë formale që imponon ky lloj gjykimi, konkretisht, kërkesat për vetëmjaftueshmërinë e ligjit, pas shfuqizimit të normave objekt referendumi, dhe qartësinë e kërkesës. Kufijtë e kontrollit të kërkesës imponohen jo vetëm nga kuadri kushtetues – ligjor, por dhe nga praktikat më të mira mbi çështjet referendare.

10. Në lidhje me vetëmjaftueshmërinë e pjesës së mbetur të ligjit, pas shfuqizimit të neneve 22, pika 3, dhe 49 të tij, shumica arsyeton se “*Gjykata, duke i vlerësuar edhe këto pretendime nën dritën e parashikimeve kushtetuese që përcaktojnë kufijtë e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së çështjes së shtruar për referendum të përgjithshëm shfuqizues, parashikuar nga neni 151, pika 2 e Kushtetutës, arrin në përfundimin se argumentet e parashtruara nga përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, në mbështetje të prapësimeve lidhur me mungesën e vetëmjaftueshmërisë së ligjit pas shfuqizimit të neneve 22, pika 3, dhe 49, nuk janë bindëse për të provuar cenimin e ndalimeve kushtetuese.*” (*shih prg. 25*).

11. Mendoj se vlerësimi i kërkesës për vetëmjaftueshmëri të ligjit (*element i vlefshmërisë formale*) nën dritën e ndalimeve kushtetuese (kërkesat e nenit 151, pika 2 të Kushtetutës - *element i vlefshmërisë materiale*) është sa i pamundur, aq dhe i gabuar. Elementet e vlefshmërisë formale nuk mund të kontrollohen përmes referimit në elemente të vlefshmërisë materiale, pasi të parat duhet të plotësojnë kërkesa që kanë të bëjnë me unitetin e formës, të përmbajtjes, qartësisë së kërkesës, etj, kurse të dytat kanë të bëjnë me fusha të caktuara, për të cilat ndalohej (shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar) zhvillimi i referendumit.

12. Kërkesa për referendum është një akt i privuar nga motivet, pasi objektivi i nënshkruesve nuk buron nga deklarimi i qëllimit të tyre, por vetëm nga qëllimi i përfshirë në pyetjen që i shtrohet referendumit, pra, nga qëllimi objektivist i arritshëm që rezulton nga lidhja midis normave të paraqitura për shfuqizimin përmes referendumit dhe atyre që do të rezultojnë pas shfuqizimit. Me fjalë të tjera, pyetja e shtruar për referendum kontrollohet mbi bazën e formulimit të saj dhe nga ndikimi i referendumit mbi kuadrin normativ në fjalë (*shih vendimin nr.25/2011 të Gjykatës Kushtetuese Italiane*). Prania e kërkesave në lidhje me formulimin e pyetjes së referendumit si njëtrajtshmëria, qartësia dhe thjeshtësia, karakteri unik, plotësia, qëndrueshmëria, përshtatshmëria, marrin rëndësi thelbësore. Vlerësimi i përshtatshmërisë, mjaftueshmërisë dhe qartësisë së pyetjes së shtruar për shfuqizim me referendum, është i nevojshëm për të identifikuar: a) qëllimin që synohet të arrihet; b) rregullimin që vjen më pas; c) për të krahasuar rezultatet që burojnë në plotësim të dy pikave të para (*shih vendimet nr.26/1981; nr.45/2005; nr.16/2008 të Gjykatës Kushtetuese Italiane*).

13. Në vështrim të sa më sipër, mendoj se për çështjet për të cilat nuk ka ndalesa kushtetuese, në kuptim të nenit 151, pika 2 e Kushtetutës, siç është dhe rasti në gjykim, është i domosdoshëm vlerësimi edhe i elementeve të vlefshmërisë formale, në funksion të garantimit të së drejtës së votës të zgjedhësve. Si në aspektin doktrinal ashtu dhe atë jurisprudencial, këto vlerësime, edhe pse përkufizohen si autonome, të pavarura dhe qartësisht të dallueshme nga njëra-tjetra, janë kërkesa kumulative për kontrollin, paraprakisht, të kushtetutshmërisë së kërkesës për referendum.

14. Shumica, me të drejtë, i referohet një parimi të rëndësishëm të elaboruar në jurisprudencën kushtetuese, atij të kushtetutshmërisë, sipas të cilit Kushtetuta nuk mund të ketë kontradikta të brendshme, se çdo dispozitë e saj duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese, për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik. Për pasojë, asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete (*shih prg.20*). Por, arsyetimi i shumicës jo vetëm nuk respekton natyrën harmonike të Kushtetutës, por devijon dukshëm nga kërkesat kushtetuese, ligjore dhe, akoma më shumë, standardet evropiane mbi shqyrtimin, *ex ante*, të kushtetutshmërisë së kërkesës për referendum të përgjithshëm shfuqizues si dhe nga jurisprudenca e mëparshme kushtetuese. Ndryshe nga rastet e mëparshme të

vendimmarrjes kushtetuese ku shkaqet dhe arsytet e ndryshimit të praktikës janë arsyetuar, në rastin konkret mungojnë tërësisht argumentet në këtë drejtim.

15. Duke iu kthyer çështjes konkrete, konstatohet se grupi nismëtar u ka shtruar zgjedhësve për votim pyetjen: “A duhet shfuqizuar neni 22, pika 3, dhe neni 49 i ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve ?””. Sipas argumenteve të parashtruara në kërkesë dhe gjatë gjykimit, grupi nismëtar synon që përmes iniciativës referendare të ndalojë plotësisht importin e mbetjeve jo të rrezikshme. Në rast se kuorumi i kërkuar i votuesve do të votonte pro shfuqizimit të neneve 22, pika 3, dhe 49 të ligjit, atëherë rezultati i pritshëm prej tyre duhet të ishte ndalimi i importit të çdo lloji mbetjeje. Mendoj se mënyra e formulimit të pyetjes, edhe në eventualitetin e shfuqizimit të normave ligjore objekt referendumi, nuk sjell rezultatin e pritshëm. *Së pari*, neni 48 i ligjit përcakton në mënyrë të shprehur se kategoritë e mbetjeve që ndalohen të importohen dhe të kalojnë tranzit janë ato të rrezikshme, kurse për mbetjet jo të rrezikshme importi ndalohet kur ato janë të destinuar për qëllime ruajtjeje ose asgjësimi. Formulimi i kësaj norme ligjore evidenton në mënyrë shteruese rastet e ndalimit të importit të mbetjeve, duke mos përcaktuar ndalimin e importit për mbetjet jo të rrezikshme kur destinacioni i tyre është i ndryshëm nga ruajtja ose asgjësimi. *Së dyti*, në referim të përmbajtjes së ligjit, konkretisht nenit 62 “Kundërvajtjet dhe sanksionet”, pikat 51-52 prezumojnë importin e mbetjeve jo të rrezikshme pa autorizim, dhe vetëm për mungesën e autorizimit e përkufizojnë këtë veprim si kundërvajtje penale, duke parashikuar gjobë. *Së treti*, ligji, në nenin 68 me titull “Vazhdimi i efekteve të disa akteve ligjore”, në pikën “d” parashikon, midis të tjerash, se VKM-ja nr.806, datë 4.12.2003 “Për miratimin e procedurave për importin e mbetjeve me qëllim përdorimin, përpunimin e riciklimin” mbetet në fuqi deri në shfuqizimin me akte të veçanta. Në pikën 3 të këtij vendimi parashikohet se miratimi për importin e mbetjeve jepet nga Këshilli i Ministrave (KM) duke përcaktuar llojin dhe sasinë dhe afatet e importimit. Kurse në pikën 7 vendimi parashikon se kur KM nuk e miraton kërkesën, atëherë kërkuesi, brenda 30 ditëve, mund të ankohet në gjykatë.

16. Në vështrim të sa më sipër, edhe pse votuesit do të votojnë për ndalimin tërësisht të importit të mbetjeve, pjesa e mbetur e

normave ligjore duket se do të lejojë sërish importin e tyre. Në përfundim, mendoj se mënyra e formulimit të pyetjes do të deformojë vullnetin e zgjedhësve të shprehur përmes votës, duke cenuar, në këtë mënyrë, një të drejtë themelore që duhet, para së gjithash, të garantohet nga iniciativat referendare shfuqizuese.

Anëtare: Vitore Tusha

MENDIM PAKICE

(Lidhur me legjitimimin *ratione materiae* të kërkuesit)

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, vetëm në lidhje me çështjen e legjitimitetit *ratione materiae* të kërkuesit, e çmoj me vend të shprehem me mendim pakice. Ndërkohë, i ndërgjegjshëm për rëndësinë e vendimmarrjes së Gjykatës, në respekt edhe të jurisprudencës së mëparshme të saj (*shih vendimin nr.15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*) si dhe për shkaqet që do të sqarohen më poshtë (shih paragrafin 16 të këtij mendimi), kam vlerësuar t'i bashkohem shumicës në votimin mbi themelin e kërkesës për referendum.

2. Shumica ka arritur në përfundimin se plotësohen kërkesat për legjitimimin *ratione personae* të KQZ-së, pasi është subjekti të cilit Kodi Zgjedhor i njej kompetencën për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues për shqyrtimin, paraprakisht, të kushtetutshmërisë së kërkesës për referendum të përgjithshëm shfuqizues. Gjithashtu, sipas shumicës, lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, pretendimet e kërkuesit janë *prima facie* në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, pasi ato përfshihen në rregullimin kushtetues të neneve 131/ë dhe 152/1, që parashikojnë se Gjykata Kushtetuese vendos për "*kushtetutshmërinë e referendumeve*" dhe "*shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum*".

3. Në vështrim të sa më sipër, çmoj se shumica ka vlerësuar vetëm *prima facie* legjitimimin *ratione materiae* të kërkuesit, pa u ndalur në analizën e mënyrës së formulimit të dispozitave kushtetuese që përcaktojnë të drejtën e popullit për referendum shfuqizues, edhe pse ajo (shumica) u është referuar pikërisht këtyre

parashikimeve kushtetuese në vlerësimin e kufijve të shqyrtimit të pranueshmërisë/kushtetutshmërisë së çështjes së shtruar për referendum. Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se në rastin konkret kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* për t'iu drejtuar kësaj Gjykate, për arsye të mëposhtme.

4. Nenet 150-152 të Kushtetutës parashikojnë, respektivisht, subjektet që legjitimohen të kërkojnë zhvillimin e referendumit të përgjithshëm, ndalimet kushtetuese në lidhje me të dhe kufijtë e shqyrtimit, nga ana e kësaj Gjykate, të kushtetutshmërisë së çështjeve të shtruara për referendum. Konkretisht, iniciativa popullore për zhvillimin e referendumit është e sanksionuar shprehimisht në nenin 150/1 të Kushtetutës, i cili parashikon të drejtën e popullit, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, për të kërkuar referendumin për “shfuqizimin e një ligji”. Ndalimet kushtetuese janë të parashikuara nga neni 151/2 i Kushtetutës, ndërsa në referim të nenit 152/1 të Kushtetutës, kushtetutshmëria e çështjeve të shtruara për referendum sipas neneve 150/1/2 dhe 151/2/3, shqyrtohet, paraprakisht, nga kjo Gjykatë, në një proces gjykimi kushtetues të posaçëm.

5. Përveç dispozitave të lartpërmendura, instituti i referendumit, në zbatim të nenit 150/3 të Kushtetutës, është i rregulluar edhe nga ligji nr.9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, neni 126/1 i të cilit, në përputhje me nenin 150/1 të Kushtetutës, përcakton të drejtën e 50 mijë zgjedhësve, të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve, për referendum të përgjithshëm për “shfuqizimin e një ligji”, ndërsa në paragrafët 3 dhe 4 të po këtij neni, flitet edhe për shfuqizimin e “një pjese të ligjit” dhe parashikohen kriteret përkatëse për pranimin e kërkesës për referendum.

6. Nga një krahasim i dispozitave të lartpërmendura mund të konstatohet lehtë një “përplasje” midis nenit 150/1 të Kushtetutës, i cili përcakton të drejtën e referendumit të përgjithshëm për “shfuqizimin e një ligji” dhe nenit 126/3/4 të Kodit Zgjedhor, që parashikon jo vetëm të drejtën e shfuqizimit, nëpërmjet referendumit, të një ligji, por edhe të “një pjese të tij (ligjit)”.¹

¹ Ky konstatim është bërë edhe në: “JOINT RECOMMENDATIONS ON THE ELECTORAL LAW AND THE ELECTORAL ADMINISTRATION IN ALBANIA” of the European Commission for Democracy through Law (Venice Commission, Council of Europe) and the Office for Democratic Institutions and Human Rights (ODIHR) of the OSCE, on the basis of comments by Mr. Jessie Pilgrim (OSCE/ODIHR, expert, USA) Mr. Adriaan Stoop (OSCE/ODIHR, expert, the Netherlands), <http://www.venice.coe.int/>

7. Kjo Gjykatë, në jurisprudencën e saj, është shprehur tashmë se respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shih vendimin nr.02, datë 03.02.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër (*lex superior derogat inferiori*). Po ashtu, Gjykata ka theksuar se Kushtetuta, si ligji themelor i shtetit, i detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese, duke i dhënë, në këtë mënyrë, jetë parimit të rëndësishëm të kushtetutshmërisë funksionale. Normat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur vetë Kushtetuta parashikon ndryshe. Ky parim themelor sanksionohet në nenin 4/3 të Kushtetutës, dhe nënkupton se kur rregulli kushtetues parashikohet shprehimisht, ai nuk mund të mënjanohet dhe as të tejkalohet, por duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti (*shih vendimin nr.29, datë 09.11.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në të njëjtën linjë arsyetimi, edhe sovraniteti i popullit, i vendosur në kuadrin e një sistemi kushtetues e ligjor, nuk mund të ngatërrohet me pushtetin themelor, dhe kërkesa për të ndjekur disa procedura të veçanta gjatë ushtrimit të tij është tërësisht në përputhje me sovranitetin popullor. Kushtetuta, në mënyrë të qartë, e ka lidhur ushtrimin e sovranitetit popullor me rregulla të veçanta (*shih vendimin nr.25, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Nisur nga sa më lart, në rastin konkret, vlerësoj se legjitimimi i kërkuarit duhet përcaktuar vetëm sipas parashikimit të nenit 150/1 të Kushtetutës, që i atribuon 50 mijë zgjedhësve të drejtën e referendumit për shfuqizimin e gjithë ligjit dhe jo të një pjese të tij.

9. Duke shkuar më tej, edhe nga interpretimi literal i nenit 150/1 të Kushtetutës, pra nga kuptimi leksikologjik i tij, arrijmë në të njëjtin rezultat: ushtrimi i drejtpërdrejtë i sovranitetit të popullit nëpërmjet votimit, pra e drejta e tij e referendumit ka të bëjë vetëm me shfuqizimin e një ligji. Kushtetuta nuk përmend edhe të drejtën e 50 mijë zgjedhësve për të kërkuar shfuqizimin e pjesëve të veçanta të tij (ligjit). Jam i mendimit se teksti i dispozitës kushtetuese, “*shfuqizimin e një ligji*”, është i qartë dhe shpreh saktësisht vullnetin e kushtetutëbërësit, i cili ka përdorur formulime plotësisht të përshtatshme për të shprehur mendimin e tij.

webforms/documents/CDL-EL%282004%29002rev-e.aspx”, paragrafi 62, në të cilin rekomandohet një ndryshim në nenin 126 të Kodit Zgjedhor në mënyrë që të përputhet me nenin 150/1 të Kushtetutës.

10. Në këtë këndvështrim, më rezulton se përcaktimet plotësuese të dispozitave kushtetuese të parashikuara nga nenet 126 dhe 129 të Kodit Zgjedhor, si në lidhje me subjektet që legjitimohen t'i drejtohen kësaj Gjykate me kërkesë për referendum, ashtu edhe me kufijtë e shqyrtimit të kushtetutshmërisë/kontrollit të çështjes së shtruar për referendum, janë bazuar në vendimet e jurisprudencës së konsoliduar kushtetuese italiane. Kjo e fundit, që në vendimin nr.16/1978, ka theksuar se i korrespondon funksionit natyral të institutit të referendumit, nevoja që pyetja (çështja) që shtrohet për referendum të formulohet në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë, të ketë karakter unik dhe homogjen si dhe ka përcaktuar kriterin e vetëmjaftueshmërisë së ligjit kur kërkesa për referendum ka të bëjë me shfuqizimin e një pjese të ligjit (*shih edhe vendimet nr. 47/1991; 32/1993; 5/1995 të Gjykatës Kushtetuese Italiane*).

11. Ndërkohë, ajo që tërheq vëmendjen është fakti se ka një ndryshim thelbësor ndërmjet formulimit të dispozitës kushtetuese shqiptare dhe asaj italiane. Neni 75 i Kushtetutës Italiane parashikon në mënyrë të shprehur vullnetin e kushtetutëbërësit për t'i atribuuar popullit (500 mijë zgjedhësve) të drejtën e referendumit për shfuqizimin edhe të një pjese të ligjit¹. Pikërisht kësaj norme i referohet jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese Italiane në përcaktimin e kriterëve për kontrollin e pranueshmërisë së kërkesës për referendum.

12. Për më tepër, në një vështrim krahasues dhe me Kushtetutat e vendeve të tjera, rezulton se disa prej tyre shprehimisht përcaktojnë të drejtën e referendumit shfuqizues edhe të një pjese të ligjit (shih p.sh. Kushtetutën e Zvicrës, Maltës), ndërsa disa të tjera sanksionojnë vetëm të drejtën e shfuqizimit të ligjit (shih p.sh. Kushtetutën e Danimarkës, Kroacisë etj.). Kjo do të thotë se kur kushtetutëbërësi ka pasur për qëllim t'i njihte popullit të drejtën, nëpërmjet votimit në referendum, për të shfuqizuar jo vetëm ligjin në tërësinë e tij, por edhe dispozita të veçanta të tij, vullnetin e ka shprehur në mënyrë eksplicite.

13. Gjithashtu, mendoj se ekziston edhe një arsye tjetër për këtë zgjedhje të vullnetshme të kushtetutëbërësit shqiptar: ushtrimi i drejtpërdrejtë i sovranitetit të popullit nëpërmjet votimit në referendum për shfuqizimin e një ligji në tërësinë e tij (si p.sh. të një

¹ Neni 75/1 i Kushtetutës Italiane parashikon se: "500.000 shtetas me të drejtë vote, ose 5 Këshilla Rajonale kanë të drejtën e referendumit për shfuqizimin, total ose të një pjese, të një ligji ose të një akti që ka fuqi ligji".

ligji për lejimin e eutanazisë, për ndalimin e abortit, për lejimin apo ndalimin e dënimit me vdekje, etj.) garanton shprehjen e një vote më të ndërgjegjshme nga pikëpamja e “lehtësisë” së vlerësimit të tematikës së ligjit nga ana e zgjedhësve, në krahasim me vlerësimin më “teknik” që ata do të duhej të bënin në rastin kur do të thirreshin të votonin vetëm për një pjesë të ligjit.

14. Nga sa më lart, mendoj se kushtetutëbërësi shqiptar, në mënyrë të vullnetshme, ka qenë i orientuar në drejtim të njohjes së të drejtës së popullit për referendum shfuqizues të të gjithë ligjit, në tërësinë e tij, dhe jo të dispozitave të veçanta të ligjit. Si përfundim, çmoj se kriteret e përcaktuara nga Kodi Zgjedhor në lidhje me të drejtën për referendum, edhe për një pjesë të ligjit, janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe përtej kufijve të autorizuar prej saj. Për rrjedhojë, si të tilla, në mbështetje dhe të nenit 124/2 të Kushtetutës, ato nuk duhet të merren në konsideratë nga kjo Gjykatë.

15. Për arsyet e lartpërmendura, në rastin konkret, përderisa kërkuesi ka kërkuar fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi të përgjithshëm për shfuqizimin e nenit 22, pika 3, dhe të nenit 49 të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, pra vetëm të disa dispozitave të tij, duke vënë në themel të argumenteve të tij dispozitat relevante të Kodit Zgjedhor, mendoj se ai nuk legjitimohet *ratione materiae* për t’iu drejtuar kësaj Gjykate.

16. Së fundmi, çmoj të përmend se edhe shumica, në vlerësimin e themelit të kushtetutshmërinë së kërkesës për zhvillimin e referendumi të përgjithshëm shfuqizues, ka shqyrtuar gjithë pretendimet e subjekteve në gjykim (kërkuesit dhe subjekteve të interesuara) vetëm nën dritën e parashikimeve kushtetuese që përcaktojnë kufijtë e këtij shqyrtimi. Pra, ajo (shumica) nuk është ndalur në analizën e kriterëve të caktuara nga Kodi Zgjedhor për pranueshmërinë e kërkesës objekt gjykimi, arsye për të cilën, sikurse u tha më lart, kam çmuar të marr pjesë në votimin lidhur me themelin e kësaj kërkesë.

Anëtar: Vladimir Kristo

* * *

Vendim nr. 19, datë 15.04.2015
(V-19/15)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Bashkim Dedja, Kryetar, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Fatmir Hoxha, anëtarë, me sekretare Edmira Babaj, në datën 09.12.2014 mori në shqyrtim, në seancë plenare, çështjen nr.59/27 Akti që i përket:

KËRKUES: NJË GRUP DEPUTETËSH, JO MË PAK SE 1/5 E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar në gjykim nga zoti Oerd Bylykbashi, zoti Gazment Bardhi dhe zoti Ivi Kaso.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (KUVENDI), përfaqësuar përfaqësuar në gjykim nga zoti Armando Subashi, zoti Alban Brati dhe zonja Mimoza Pano.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar në gjykim nga zoti Bledi Çuçi, zoti Artur Metani dhe zoti Enea Hoti.

OBJEKTI: Shpalljen si të papajtuëshëm me Kushtetutën të ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Pezullimin e ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, deri në shpalljen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 13, 75, 83/3, 108, 116, 131, shkronja “a” dhe 134/1 shkronja “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha; shqyrtoi pretendimet e kërkuarit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës; prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, të cilat kërkuan rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

1. Kuvendi, me ligjin nr.115/2014 “Për ndarjen administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, (në vijim “*ligji nr.115/2014*”), ka miratuar ndarjen e re administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore. Sipas ligjit, numri i njësive të qeverisjes vendore është 61 bashki dhe 12 qarqe. Emërtimi, shtrirja territoriale, kufijtë, qendra, njësitë administrative përbërëse për çdo njësi të qeverisjes vendore dhe nënndarjet e tyre janë të përcaktuara në hartat dhe tabelat bashkëlidhur ligjit (*nenet 1 dhe 2*).

2. Organet e njësive të qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2011 dhe me juridiksion territorial sipas ndarjes administrativo-territoriale, të përcaktuar me ligjin nr.8653, datë 31.7.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me ligjin nr.8654, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”, vazhdojnë funksionimin e tyre deri në konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive të qeverisjes vendore në zgjedhjet e vitit 2015. Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015 do të organizohen dhe zhvillohen mbi bazën e ndarjes administrativo-territoriale të përcaktuar në këtë ligj. Organet e qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015, do të organizohen dhe funksionojnë bazuar në ndarjen administrativo-territoriale të përcaktuar në këtë ligj (*neni 3 i ligjit*).

3. Po sipas këtij ligji, ligji nr. 8653, datë 31.7.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet. (*neni 4/2*). Ky ligj, i shfuqizuar tashmë, përcaktonte se ndarja administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë është 309 komuna, 65 bashki dhe 12 qarqe (*neni 1*).

4. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shpalljen si të papajtueshëm me Kushtetutën të ligjit nr.115/2014, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

4.1 Komisioni i Posaçëm i krijuar për reformën territoriale nuk ka qenë gjithëpërfshirës dhe konsensual.

4.2 Projektligji është shqyrtuar në kundërshtim me rregullat kushtetuese të procesit ligjvënës, të sanksionuara në nenin 81/2, shkronja”f”, 83/3 dhe 75/2 të Kushtetutës, si dhe në Rregulloren e Kuvendit.

4.3 Ligji nr.115/2014 ka bërë një ndryshim të kufijve ekzistues të komuniteteve vendore, duke i zgjeruar ato në kuptimin ekonomik, tradicional. Kushtetuta detyron ligjvënësin që në rastet e ndarjes ekzistuese territoriale të realizojë konsultimin paraprak me popullsinë, në mënyrë që të shprehet drejtpërdrejt lidhur me ndryshimin e kufijve nëpërmjet bashkimit të njësive territoriale dhe suprimimit të organeve vetëqeverisëse.

4.4 Ligji nr.115/2014 ka cenuar parimin e hierarkisë së akteve normative dhe të shtetit të së drejtës, pasi jo vetëm nuk ka plotësuar dhe rregulluar njësitë bazë të qeverisjes vendore, por në mënyrë antikushtetuese dhe abuzive ka suprimuar komunën si një prej njësive bazë të qeverisjes vendore, të përcaktuar në nenin 108/3 të Kushtetutës. Njësitë bazë të përcaktuara në këtë dispozitë dhe kompetencat e tyre mund të hiqen apo ndryshohen vetëm me amendament kushtetues.

4.5 Ligjit nr.115/2014 cenon parimin e barazisë së votës, pasi njësitë e ndryshme territoriale kanë madhësi të pakrahasueshme me njëra-tjetrën, edhe pse janë të gjitha bashki, duke ndikuar drejtpërdrejt në peshën e votës së zgjedhësve.

4.6 Ligji nr.115/2014 ka marr për bazë censusin e vitit 2011, duke iu referuar një numri popullsie jashtë parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

4.7 Ligji nr.115/2014 deformat votën e zgjedhësve, pasi paracaktohet rezultati zgjedhor për zgjedhjet vendore për anëtarë të këshillave bashkiakë dhe kryetarë bashkish nga ndarja e re territoriale, fenomene të njohura përkatësisht për sisteme proporcionale si “gjeometri aktive zgjedhore” dhe për sisteme mazhoritare si “garrymandering”.

5. Subjekti i interesuar, Kuvendi ka propësuar se:

5.1 Projektligji, si nismë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, nuk është shqyrtuar me procedurë të përsheptuar.

5.2 Komisioni i Posaçëm, duke pasur kompetenca shteruese mbi çështjen e rëndësishme që i është ngarkuar, në parim e bën të panevojshme shqyrtimin e nismës ligjvënëse të Komisionit të Posaçëm nga komisionet e përhershme të Kuvendit e për rrjedhojë të panevojshme përfshirjen në programin e punës dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit.

5.3 Në kuptimin e nenit 108 të Kushtetutës, marrja e mendimit të popullsisë, nuk është domosdoshmërisht marrja e pëlqimit të popullsisë.

5.4 Ligji nuk ka cenuar parimin e subsidiaritetit, sepse nuk ka pasur për qëllim organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, por vetëm ndarjen administrativo- territoriale.

5.5 Suprimimi i komunës nuk sjell probleme për kushtetutshmërinë e ligjit, pasi “bashkia” dhe “komuna”, sipas nenit 108 të Kushtetutës, janë të dyja njësi bazë të qeverisjes vendore, dhe si të tilla mund të ekzistojnë të dyja ose vetëm njëra.

5.6 Elementi i popullsisë është kriter variabël dhe dinamik dhe mbi të gjitha nuk është kriter kushtetues për ndarjen administrativo-territoriale, prandaj edhe pretendimi për mbështetjen e reformës territoriale në censusin e vitit 2011 si antikushtetues, është i pabazuar.

5.7 Pretendimet për cenimin e parimit të barazisë së votës janë të pambështetura në argumente kushtetuese, pasi për zhvillimin e zgjedhjeve vendore të ardhshme dhe numrin e zgjedhësve, organet e ngarkuara nga ligji zgjedhor do t’i referohen Regjistrin Themeltar të Gjendjes Civile dhe jo Censurit të vitit 2011.

6. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave ka propësuar se:

6.1. Procesi i ndarjes administrativo - territoriale dhe kufijtë e njërive të qeverisjes vendore që rezultojnë prej këtij procesi, edhe pse gëzojnë mbrojtje kushtetuese, nuk përfshihen në sferën e rezervës së të drejtave dhe kompetencave që Kushtetuta ia njihë ekskluzivisht pushtetit vendor, përkundrazi neni 81/2, shkronja “f” e Kushtetutës për ndarjen administrativo-territoriale ka parashikuar miratimin me ligj nga Kuvendi.

6.2. Në një interpretim literal, sistematik dhe teleologjik të nenit 108/2 të Kushtetutës, ndryshimi i kufijve të njërive të qeverisjes

vendore i nënshtrohet vetëm kushtit të marrjes paraprake të mendimit të popullsisë që banon në to, por jo edhe marrjes domosdoshmërisht paraprakisht të pëlqimit të kësaj popullsie.

6.3. Ndarja e kufijve administrativo- territoriale nuk është çështje thjesht me karakter vendor, por ajo ka një ndikim të rëndësishëm në interesin e përgjithshëm kombëtar.

6.4. Neni 108 i Kushtetutës nuk ka bërë asnjë dallim thelbësor për bashkitë apo komunat si njësi bazë të qeverisjes vendore sa i përket mënyrës së krijimit, organizimit dhe ushtrimit të kompetencave të tyre, prandaj edhe përdorimi i termit “bashki” apo “komuna” nuk paraqet asnjë dallim nga pikëpamja kushtetuese.

6.5. Argumentet e kërkuarit mbi deformimin dhe paracaktimin e rezultatit i referohen rezultatit të zgjedhjeve të mëparshme, prirjeve të elektoratit dhe historikut të rezultatit ndër vite, si dhe formulës së përcaktimit të mandateve vendore, këshilltar bashkiak/banorë, që pritet të ndryshohet, kështu që nuk mund të shërbejnë si shkak për shfuqizimin e ligjit nr.115/2014.

III

Vlerësimi i Gjykatës

A. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit nr.115/2014.

7. Kërkuarisi ka kërkuar pezullimin e ligjit nr.115/2014, duke parashtruar këto argumente: ligji mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërore, shoqërore ose të individëve; dëmi që mund t’u shkaktohet interesave shtetërore është i rëndë dhe i pamundur për t’u riparuar, pasi zhvillimi i zgjedhjeve jo të rregullta dhe jo në përputhje me standardet, si pasojë e mungesës së kohës së mjaftueshme për përgatitjen e tyre, sjell deformim të vullnetit të zgjedhësve dhe cenim të së drejtës së tyre kushtetuese; nga ana tjetër, ekziston urgjencë për pezullimin e ligjit, sepse dekretimi i zgjedhjeve dhe përgatitja e tyre fillon shumë kohë para përfundimit të mandatit të organeve ekzistuese; vendimi i Gjykatës Kushtetuese hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare dhe organet zgjedhore nuk kanë kohën e mjaftueshme për përgatitjen e zgjedhjeve.

8. Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit objekt shqyrtimi të paraqitur nga kërkuarisi dhe vlerësoi se kjo kërkesë nuk plotëson kriteret e përcaktuara

nga neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Për rrjedhojë, Gjykata në datën 13.11.2014 ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë si të pabazuar.

B. Për legjitimitimin e kërkuetit¹

9. Edhe pse subjektet e interesuara nuk kanë parashtruar pretendime që kanë lidhje me legjitimitimin e kërkuetit, Gjykata çmon të ndalet te ky kriter i vënies në lëvizje të Gjykatës për kontrollin kushtetues abstrakt të normës juridike.

10. Gjykata rithekson se në nenin 134/1 të Kushtetutës është përcaktuar në mënyrë shteruese rrethin e subjekteve kushtetuese, të cilat legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Kriteri kushtetues i “detyrimit për të justifikuar interesin”, i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit të mësipërm, është interpretuar nga jurisprudenca kushtetuese si përcaktues në ndarjen e rrethit të subjekteve kushtetuese në dy kategori: subjekte të kushtëzuara dhe subjekte të pakushtëzuara. Në këtë kuptim, subjektet e parashikuara në shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f” dhe “g” të paragrafit 1 të nenit 134, të cilat mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre, janë subjekte të kushtëzuara. Parashikimi i këtij kriteri kushtetues vetëm për një numër të kufizuar subjektësh kushtetuese, në një interpretim *a contrario*, do të thotë se ai nuk është i zbatueshëm për subjektet e tjera të parashikuara në pikat a, b, c, ç të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës, të cilat nuk kanë detyrimin për të justifikuar interesin në rast se i drejtohen me kërkesë Gjykatës Kushtetuese.

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) të një të pestës së deputetëve ka qenë objekt i shqyrtimit nga kjo Gjykatë në shumë raste të tjera, në të cilat ajo në mënyrë të vazhdueshme ka vlerësuar se një e pesta e deputetëve përfaqëson një nga subjektet e parashikuara në nenin 134/1, shkronja “c” të Kushtetutës, të cilat kanë të drejtë të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret (*shih vendimin nr.9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të

¹ Gjyqtari V. Kristo votoi kundër legjitimitimit të kërkuetit, sipas qëndrimit të shprehur në mendimin paralel të vendimit nr.25, datë 08.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese.

shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (*shih vendimet nr.18, datë 29.07.2008; nr.25, datë 28.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata në asnjë rast nuk e ka vënë në dyshim legjitimitimin e një të pestës së deputetëve, kur ata i janë drejtuar kësaj Gjykate për kontrollin abstrakt të normës juridike, prandaj ajo rithekson se në referim të nenit 134/1, shkronja "c", të Kushtetutës, 1/5 e deputetëve të Kuvendit përfaqëson një subjekt me legjitimitet të pakushtëzuar dhe si e tillë ka të drejtë të kërkojë kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së një akti normativ.

C. Për themelin

1. Për pretendimin se procedura e miratimit të ligjit është në kundërshtim me nenet 81/2, shkronja "f", 83/3 dhe 75/2 të Kushtetutës si dhe me Rregulloren e Kuvendit

13. Kërkuesi pretendon se projektligji është shqyrtuar në kundërshtim me kërkesat kushtetuese të procesit ligjvënës të sanksionuar në nenet 81/2, shkronja "f", 83/3 dhe 75/2 të Kushtetutës. Sipas tij, nisma ligjvënëse për këtë projektligj është depozituar në Kuvend në datën 23.07.2014, duke u futur për miratim në seancën e datës 31.07.2014, edhe pse nuk ishte përfshirë në kalendarin 3 - javor të punimeve të Kuvendit (për periudhën 4-25 Korrik), jashtë radhës së përcaktuar, veprime që e kthejnë procedurën e shqyrtimit të këtij ligji në procedurë të përshpejtuar. Gjithashtu, po në këtë drejtim, kërkuesi pretendon shkelje të nenit 75/2 të Kushtetutës, pasi projektligji nuk është shqyrtuar dhe miratuar paraprakisht nga Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut.

14. Subjekti i interesuar, Kuvendi, pretendon se projektligji si nismë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, nuk mund të shqyrtohej dhe nuk është shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar. Shqyrtimi dhe miratimi nga komisionet e përhershme, në kushtet e krijimit të një komisioni të posaçëm për një çështje të rëndësishme të veçantë, e bën të panevojshëm shqyrtimin nga komisionet e përhershme.

15. Gjykata çmon të sqarojë paraprakisht se pretendimet e kërkuesit të lidhura me Rregulloren e Kuvendit do të vlerësohen, me qëllim që t'i jepet përgjigje pretendimit për shkelje të nenit 83/2 të Kushtetutës mbi zbatimin e procedurës së përshpejtuar

për miratimin e ligjit edhe pse kjo Rregullore nuk përbën lëndë kontrolli kushtetues. Sipas Gjykatës, nisur nga natyra harmonike e normave kushtetuese, parashikimi i nenit 81, pika 2, shkronja "f" duhet analizuar në raport me rregullimet e nenit 83, pikat 2 dhe 3 të Kushtetutës, por edhe me nenet përkatëse të Rregullores së Kuvendit që parashikojnë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve, si dhe përjashtimet në lidhje me to, në këndvështrim të nenit 75/2 të Kushtetutës.

16. Kërkuesi bazohet vetëm në dy momente procedurale, të cilat sipas tij nuk janë bërë sipas parashikimeve të Rregullores së Kuvendit dhe që *de facto* e kanë bërë procedurën e miratimit të ligjit objekt shqyrtimi të përsheptuar: a) mosshqyrtimi i projektligjit nga Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut; b) futja në rendin e ditës pa u përfshirë më parë në kalendarin 3 javor të punimeve.

17. Neni 77/1 i Kushtetutës përcakton se Kuvendi zgjedh nga gjiri i tij komisione të përhershme, si dhe mund të caktojë komisione të posaçme. Komisionet parlamentare organizohen dhe funksionojnë sipas Rregullores së Kuvendit.

18. Në bazë të Rregullores së Kuvendit, komisionet e përhershme shqyrtojnë sipas përkatësisë projektligjet, projektvendimet dhe çështjet e tjera që paraqiten në Kuvend, kryejnë studime për efektivitetin e ligjeve në fuqi, ndjekin zbatimin e ligjeve dhe kontrollojnë veprimtarinë e ministrive dhe të organeve të tjera qendrore, duke i propozuar Kuvendit ose Këshillit të Ministrave marrjen e masave përkatëse, si dhe propozojnë për miratim në Kuvend projektligje, projektdeklarata ose projektrezoluta (*neni 18*). Përbërja e komisioneve të përhershme, për aq sa është e mundur, pasqyron grupet parlamentare, sipas përpjestimit që zënë në Kuvend (*neni 20*).

19. Komisionet e posaçme krijohen nga Kuvendi për shqyrtimin dhe përgatitjen e nismave ligjvënëse, si dhe për çështje të një rëndësie të veçantë (*neni 24*). Pra, këto komisione, në dallim nga komisionet e përhershme, përveç funksionit të shqyrtimit të projektakteve që i paraqiten Kuvendit, ngarkohen, ndër të tjera, edhe me detyrën për propozimin e nismave ligjvënëse, të cilat formalizohen si propozime të një grupi deputetësh. Rregullat për organizmin dhe zhvillimin e mbledhjeve të komisioneve të përhershme zbatohen edhe për komisionet e posaçme, me përjashtim të rastit kur Kuvendi vendos ndryshe. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe

të Drejtat e Njeriut ka në fushën e tij të përgjegjësishë kodet dhe organizimin e pushtetit gjyqësor, administratën publike, organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor, shërbimet e pavarura në sistemin e drejtësisë dhe të drejtat e njeriut (*neni 19*).

20. Konkretisht, Kuvendi me vendimin nr.1, datë 23.01.2014 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për reformën administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-territoriale. Komisioni i Posaçëm ka patur për objekt të veprimtarisë së tij: (i) Përcaktimin e kriterëve për ndarjen e re administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë; (ii) Hartimin dhe përcaktimin e kalendarit të zbatimit të reformës administrativo-territoriale; (iii) Përgatitjen e projektit për ndarjen e re administrativo-territoriale (*pika 2 e vendimit*). Në përbërje të tij parashikohej të kishte 16 anëtarë, nga të cilët 8 përfaqësues të pozitës (6 PS-ja, dhe 2 LSI-ja) dhe 8 përfaqësues të opozitës (6 PD-ja, 1 PR-ja, dhe 1 PDIU-ja). Emrat e anëtarëve të komisionit do të përcaktoheshin me vendim të Kuvendit (*pika 3 e vendimit*). Komisioni do të zhvillonte veprimtarinë e tij në një afat kohor 3- mujor, nga data 24.01.2014 deri në datën 24.04.2014 (*pika 5 e vendimit*).

21. Gjykata vëren se Komisioni i Posaçëm i krijuar me vendimin e sipërcituar nuk ka funksionuar, duke mosrealizuar asnjë mbledhje apo vendimmarrje deri në afatin e parashikuar për veprimtarinë e tij, që ishte data 24.04.2014. Me vendimin nr.24, datë 24.04.2014, Kuvendi ndryshoi pikën 3 të vendimit mbi përbërjen e Komisionit, duke përcaktuar se “Komisioni i Posaçëm ngrihet mbi bazën e përfaqësisë pozitë-opozitë. Në përbërje të tij do të ketë 17 anëtarë, nga të cilët 9 janë përfaqësues të pozitës (7 PS-ja dhe 2 LSI-ja) dhe 8 përfaqësues të opozitës (6 PD-ja, 1 PR-ja dhe 1 PDIU-ja); emrat e anëtarëve të komisionit përcaktohen me vendim të Kuvendit; opozita ruan të drejtën për të kërkuar ndryshimin e këtij përfaqësimi në çdo moment, mbi bazë të barazisë së anëtarësisë pozitë-opozitë, në këtë komision. Me pjesëmarrjen e opozitës në këtë komision, mbi bazën e parimit të barazisë së anëtarësisë pozitë-opozitë, pozita garanton respektimin e këtij parimi si në përbërje, ashtu dhe në vendimmarrje. Kuvendi miraton menjëherë raportin e ri të përfaqësimi, në përbërje të këtij komisioni.” (*pika 3 e ndryshuar*). Në lidhje me afatin e veprimtarisë së komisionit, ndryshohet, duke u përcaktuar si afat përfundimi data 24.06.2014 (*pika 5 e ndryshuar*). Ndërsa me vendimin nr.43, datë 24.06.2014 të Kuvendit, “Për një

ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 1, datë 23.1.2014 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për reformën administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me vendimin nr. 24/2014”, ky afat i veprimtarisë së komisionit shtyhet deri me datë 31.07.2014. Ky komision pas miratimit të programit, ka zhvilluar mbledhjet e tij, sipas kalendarit të dëgjësave publike, me rend dite: - Seancë dëgjimore me përfaqësues të njësive të qeverisjes vendore dhe shoqatave të të zgjedhurve vendorë (*referuar procesverbalit të datës 29.04.2014 dhe procesverbalit 02.05.2015*); - Seancë dëgjimore me organizatat jofitimprurëse (*referuar procesverbalit të datës 05.05.2014*); - Seancë dëgjimore paradite me përfaqësues të organizatave dhe agjencive ndërkombëtare, si dhe donatorët që mbështesin reformën territoriale (*referuar procesverbalit të datës 09.05.2014*); - Seancë dëgjimore pasdite me përfaqësues të institucioneve të pavarura: KLSH-në, Avokatin e Popullit dhe ILDKPKI-në (*referuar procesverbalit të datës 09.05.2014*); - Seancë dëgjimore me përfaqësues të organizatave jofitimprurëse që veprojnë në fushën e biznesit (*referuar procesverbalit të datës 12.05.2014*); - Seancë dëgjimore me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe me ekspertë ndërkombëtarë (*referuar procesverbalit të datës 13.05.2014*); - Prezantimi i ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, zotit Bledi Çuçi, lidhur me variantet e ndarjes së re administrative-territoriale të Shqipërisë (*referuar procesverbalit të datës 16.05.2014*); - Miratimi i variantit përfundimtar të ndarjes administrative-territoriale të Republikës së Shqipërisë (*referuar procesverbalit të datës 22.05.2014*); - Shqyrtimi i mendimeve të NJQV-ve dhe të këshillave të qarqeve në lidhje me propozimet për ndarjen e re administrative-territoriale (*referuar procesverbalit të datës 10.07.2014*); - Shqyrtimi i përgjigjeve zyrtare të kryetarëve të bashkive, komunave dhe këshillave të bashkive dhe komunave, sipas qarqeve për propozimin për ndarjen e re administrative – territoriale në Republikën e Shqipërisë (*referuar procesverbalit të datës 15.07.2014*); - Shqyrtimi i përgjigjeve zyrtare të kryetarëve të bashkive, komunave dhe këshillave të bashkive e komunave, sipas qarqeve për propozimin për ndarjen e re administrative-territoriale në Republikën e Shqipërisë (*referuar procesverbalit të datës 17.07.2014*). Me vendimin nr.5, datë 17.07.2014, Komisioni miratoi variantin përfundimtar të hartës për ndarjen e re administrative-territoriale në Republikën e Shqipërisë, që do të ishte pjesë

përbërëse e projektligjit “Për ndarjen administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë”. Me vendimin nr.6, datë 23.07.2014 “Për miratimin e nismës ligjore për depozitimin e projektligjit “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Posaçëm Parlamentar e miratoi nismën ligjore për depozitim në Kuvend të projektligjit.

22. Gjykata, bazuar në kuptimin dhe qëllimin e rregullave parlamentare për organizimin dhe funksionimin e komisioneve parlamentare dhe fakteve të paraqitura më lart, vlerëson se Komisioni i Posaçëm i krijuar për ndarjen e re administrativo - territoriale, përveç propozimit të nismës ligjvënëse, ka përmbushur edhe funksionin e shqyrtimit të projektaktit, i cili sipas rregullit të zakonshëm, përpara se të kalonte në seancë, duhej të shqyrtohej në komisionin e përhershëm përkatës. Grupet parlamentare kanë pasur mundësi për të marrë pjesë në debat dhe për të bërë propozime konkrete nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në komisionin e posaçëm. Qëllimi i krijimit të komisionit të posaçëm presupozon formimin e një trupe për të bërë vlerësime më të plota, të thelluara dhe teknike për fushën që lidhet me objektin e komisionit.

23. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se projektligji për ndarjen administrative nuk ka qenë i miratuar në kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhat 04-25 korrik 2014 dhe 25-31 korrik 2014.

24. Gjykata vëren se rregullorja përcakton rregullat mbi hartimin e programit dhe Kalendarit të punimeve të Kuvendit. Programi përmban listën e çështjeve që do të shqyrtojë Kuvendi. Në të shënohen institucioni që ka ndër marrë nismën, data e paraqitjes, si dhe komisioni përgjegjës që ngarkohet me shqyrtimin e tij. Si komision përgjegjës, Kryetari propozon një komision të përhershëm dhe në rastet kur e sheh të nevojshme, ai propozon mbledhje të përbashkët të dy komisioneve të përhershme ose ngritjen e një komisioni të posaçëm (*neni 26/3*). Po kështu, Rregullorja sanksionon se për zbatimin e programit të punës së Kuvendit, Kryetari i Kuvendit i propozon Konferencës së Kryetarëve kalendarin e punimeve të Kuvendit për një periudhë 3 – javore. Kalendarin e punimeve të Kuvendit përmban në mënyrë të detajuar kohën kur Kuvendi zhvillon punimet në seancë plenare dhe në komisione. Kalendarin publikohet dhe u shpërndahet deputetëve, si dhe u vihet në dispozicion përfaqësuesve të medias. Në çdo rast, rendi i ditës duhet të jetë bërë publik të paktën 2 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e komisionit ose seancës plenare (*neni 27/5*).

25. Në vështrim të Rregullores, rregullat procedurale, të lidhura me rendin e ditës, me zhvillimin e mbledhjeve, me organizimin e punës, me publicitetin e mbledhjeve, me seancat dëgjimore, me shqyrtimin, me kuorumin si dhe me vendimmarrjen në komisione, zbatohen edhe për komisionet e posaçme, me përjashtim të rastit kur në vendimin e krijimit të tyre përcaktohet ndryshe (*nenet 24/4 dhe 32-41*).

26. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se vendimi i Kuvendit nr.1, datë 23.01.2014 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për reformën administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë” nuk ka pasur asnjë parashikim të ndryshëm, prandaj dhe procedura në lidhje me rendin e ditës, zhvillimin e mbledhjeve, organizimin e punës, kuorumin, vendimmarrjen dhe programin e punës së Komisionit të Posaçëm mbi Reformën Territoriale duhet të jetë e njëjtë me rregullat procedurale që aplikohen dhe zbatohen edhe nga komisionet e përhershme.

27. Nisur nga kjo premisë, Gjykata vëren se Komisioni i Posaçëm e zhvilloi mbledhjen e parë të punës në datë 28.04.2014 me rend dite: (i) miratimi i *planit të punës* së Komisionit të Posaçëm dhe i listës së subjekteve për organizimin e seancave dëgjimore publike; (ii) miratimi i kriterëve teknike për ndarjen e re administrativo-territoriale. Me vendimin nr.2, datë 28.04.2014 Komisioni i Posaçëm miratoi *planin e detajuar të punës*, sipas aktiviteteve në vijim: (1) Propozimi i kriterëve teknike me institucion përgjegjës Ministrin për Çështjet Vendore; (2) Miratimi i kriterëve teknike me institucion përgjegjës komisionin; (3) Konsultime dhe dëgjesa publike me aktorët e interesit brenda periudhës 29 prill-16 maj me institucion përgjegjës komisionin; (4) Paraqitja e propozimeve për ndarjen e re administrativo-territoriale për periudhën 15 maj-19 maj me institucion përgjegjës Ministrin për Çështjet Vendore; (5) Shqyrtimi i propozimeve dhe miratimi i projekthartës për ndarjen e re administrativo-territoriale brenda periudhës 19 maj-22 maj me institucion përgjegjës komisionin; (6) Projektharta e miratuar nga komisioni dergohet për mendim në të gjitha bashkitë/komunat, brenda datës 23 maj-23 korrik me institucion përgjegjës Ministrin për Çështjet Vendore; (7) Procesi i konsultimit në të gjithë Shqipërinë për projekthartën e propozuar brenda periudhës 23 maj-23 korrik me institucion përgjegjës Ministrin për Çështjet Vendore; (8) Përgatitja e paketës ligjore me ndryshimet në ligjin nr.8652, datë 30.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” brenda datës 23 maj-23 korrik me institucion

përgjegjës Ministrin për Çështjet Vendore; (9) Miratimi i projektligjit për ndarjen e re administrativo-territoriale brenda datës 31 korrik 2014 me institucion përgjegjës Kuvendin.

28. Gjykata vëren se Komisioni i Posaçëm ka pasur një plan pune 3 mujor (28.04.2014 - 31.07.2014), ku përfshihej përgatitja dhe miratimi i projektligjit për ndarjen e re administrativo - territoriale nga ky komision brenda datës 23 korrik 2014, me afat funksionimi disa herë të ndryshuar dhe të shtyrë, duke e bërë edhe përfshirjen e projektligjit në kalendarin 3-javor të punimeve jo saktësisht të parashikueshëm.

29. Në parashikimet e nenit 31/2 të Rregullores përcaktohet si përjashtim se për çështje që janë jashtë kalendarit të punimeve, Kuvendi merr vendim me jo më pak se tre të pestat e deputetëve të pranishëm për të diskutuar ose vendosur në seancë plenare për çështje që nuk janë në rendin e ditës. Propozimet për vendosje të çështjeve të tjera në rend të ditës duhet të paraqiten me shkrim nga të paktën 10 deputetë, nga një kryetar grupi parlamentar ose nga Këshilli i Ministrave vetëm para fillimit të seancës, para fillimit të diskutimit të një pike të rendit të ditës ose kur është pezulluar diskutimi.

30. Ky rregullim është ndjekur dhe në rastin konkret, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i diskutimit në seancë plenare të çështjeve të parashikuara nga kalendarin 3-javor të punimeve. Gjykata konstaton se kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, me shkresën nr.2575/1, të datës 23.07.2014, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste ka parashtruar kërkesë për futjen në rendin e ditës të datës 31.07.2014 për shqyrtim të projektligjit për ndarjen administrativo-territoriale. Ky propozim është votuar me 3/5 e anëtarëve të Kuvendit, (megjithëse Rregullorja kërkon 3/5-at e anëtarëve të pranishëm të Kuvendit), duke u përfshirë në rendin e ditës të kësaj seance plenare.

31. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se vetë Rregullorja le hapësira që në rendin e ditës të përfshihen projektligje që kërkojnë shumicë të cilësuar, me kusht që të ndiqen rregullat e parashikuara mbi subjektet që bëjnë propozimet, fazën në të cilën bëhet ky propozim, si dhe kuorumin e nevojshëm për votimin dhe miratimin e propozimit.

32. Duke iu kthyer pretendimit se ligji është miratuar me procedurë të përshpejtuar, Gjykata vëren se rregullimi kushtetues

i përcaktuar në nenin 83/3 e ndalon zbatimin e procedurës së përshpejtuar për shqyrtimin e projektligjeve të renditura në nenin 81/2, me përjashtim të ligjit për gjendjen e jashtëzakonshme, të parashikuar nga shkronja “dh” e kësaj dispozite. Neni 83, pika 2 i Kushtetutës parashikon kushtet dhe kriteret për shqyrtimin dhe miratimin e një projektligji me procedurë të përshpejtuar. Po ashtu, norma evidenton edhe subjektet që legjitimohen t'i drejtohen me kërkesë Kuvendit, të cilat janë Këshilli i Ministrave ose një e pesta e të gjithë numrit të deputetëve. Për sa i përket aspektit kohor të zbatimit të kësaj procedure, norma kushtetuese vendos kufij kohorë, duke sanksionuar se *“Kuvendi... mund të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit”*.

33. Në rastin konkret, Komisioni i Posaçëm Parlamentar, me vendimin nr.6, datë 23.07.2014 “Për miratimin e nismës ligjore për depozitimin e projektligjit “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, e ka miratuar nismën ligjore, si nisëm e një grupi deputetësh, bazuar në nenin 81/1 të Kushtetutës, dhe e ka dorëzuar pranë Kryetarit të Kuvendit për të vijuar me procedurat parlamentare, sipas nenit 68 të Rregullores (*pika 2 e vendimit*). Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste me shkresën nr.2575/1 të datës 23.07.2014, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste parashtroi kërkesë për futjen në rendin e ditës të datës 31.07.2014 për shqyrtim të projektligjit për ndarjen administrativo-territoriale. Ky propozim është votuar me 3/5-at e anëtarëve të Kuvendit, duke u përfshirë në rendin e ditës të kësaj seance plenare. Projektligji është miratuar në seancën plenare të datës 31.07.2014 nga tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

34. Në këndvështrim të këtyre fakteve, Gjykata vlerëson se projektligji “Për ndarjen administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, me objekt ndryshimin e ndarjes administrativo-territoriale të njësive vendore në Republikën e Shqipërisë, është propozuar nga një grup deputetësh - pjesë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar. Ky projektligj nuk është shoqëruar me kërkesë drejtuar Kryetarit të Kuvendit, për shqyrtim me procedurë të përshpejtuar, sipas nenit 28 të Rregullores. Në seancë projektligji është miratuar me 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Afati brenda të cilit është shqyrtuar projektligji nga fillimi i procedurës së shqyrtimit nuk cenon kërkesën e nenit 83/2

të Kushtetutës. Prandaj, duke iu referuar kërkesave të nenit 81/2, shkronja “f” në lidhje me shumicën e cilësuar, dhe nenit 83, pg..2 dhe pg. 3 të Kushtetutës në lidhje me subjektet që iniciojnë procedurën e përshpejtuar dhe afatin që duhet respektuar, nuk konstatohen elemente të cenuar të procedurës së përshpejtuar në miratimin e ligjit objekt shqyrtimi.

35. Krahas vlerësimeve të mësipërme, Gjykata çmon të rëndësishme të evidentojë se kërkuesi nuk ka argumentuar se si dhe deri në çfarë mase është prekur në të drejtat e tij kushtetuese parlamentare, konkretisht gjatë procedurës së zhvilluar nga Kuvendi për futjen në rendin e ditës së shqyrtimit dhe miratimit të ligjit nr.115/2014, jashtë kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit si dhe duke mënjanuar nga shqyrtimi dhe miratimi paraprak Komisionin e Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut. Kërkuesi nuk ka marrë pjesë në komisionin e posaçëm dhe gjatë shqyrtimit të ligjit në komision dhe në seancat plenare përkatëse.

36. Për sa më lart, Gjykata konkludon se pretendimet e kërkuetit për cenim të nenit 81/2, shkronja “f”, dhe 83/3 të Kushtetutës gjatë procedurës së miratimit të ligjit nr.115/2014, si dhe të rregullores së Kuvendit, janë të pabazuara.

2. Për pretendimin se ligji bie ndesh me nenin 108/1 të Kushtetutës.

37. Kërkuesi pretendon se ligji objekt shqyrtimi bie ndesh me nenin 108/1 të Kushtetutës, pasi suprimon njësinë e qeverisjes vendore “komunë”. Gjithashtu, ky ligj bie ndesh edhe me nenin 116 të Kushtetutës, pasi me ligj ndryshohet një koncept i parashikuar nga Kushtetuta. Subjekti i interesuar, Kuvendi parashtron se neni 108/1 i Kushtetutës e parashikon “komunën” si njësi vendore alternative me “bashkinë”. Në këtë kuptim nuk kemi të bëjmë me cenim të nenit 116 të Kushtetutës. Të njëjtin argument ka paraqitur dhe Këshilli i Ministrave.

38. Gjykata fillimisht e çmon me vend të ndalet në ndryshimet që sjell ligji objekt shqyrtimi. Ndarja administrativo-territoriale, para hyrjes në fuqi të ligjit objekt shqyrtimi (me 12 qarqe, 65 bashki dhe 308 komuna), është miratuar me ligjin nr.8653, datë 31.7.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj, së bashku me ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes

vendore” dhe ligjin nr.8654, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Tiranë” ishte e pjesë e paketës ligjore të reformës së decentralizimit që u miratua në vitin 2000. Kjo reformë u bazua në konceptin e decentralizimit simetrik të funksioneve dhe kompetencave, pra duke mos bërë dallim në madhësinë e njësive të qeverisjes vendore apo kapacitetet e tyre për kryer këto funksione. Kalimi drejt modelit të qeverisjes nëpërmjet decentralizimit pas vitit 1992 dhe reformës administrative dhe fiskale që u miratua me ligjin organik të qeverisjes vendore në vitin 2000, u shoqërua me një ndryshim në strukturën e organizimit administrativo-territorial të vendit.

39. Gjatë seancës gjyqësore të zhvilluar para kësaj Gjykate, subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, parashtroi se arsyet kryesore që nxitën shumicën qeverisëse të ndërmarrë një reformë tërësore përsa i takon organizimit administrativ të territorit të vendit, ishin kryesisht këto: Ndryshimet demografike të dekadës së fundit sollën ndryshime drastike në madhësinë e njësive të qeverisjes vendore (më poshtë: NJQV-ja); Niveli i lartë i fragmentimit të NJQV-ve ka penguar thellimin e mëtejshëm të decentralizimit, si rezultat i mungesës së kapaciteteve dhe i pamundësisë për të ofruar shërbime me eficiencë të lartë. Kjo ka sjellë, gjithashtu, edhe mosrealizimin e decentralizimit duke krijuar një sërë pabarazish të ndjeshme mes NJQV-ve; Rritja e shpenzimeve administrative në nivel vendor dhe tendenca e një pjese të konsiderueshme të NJQV-ve për të patur buxhet të dominuar vetëm nga shpenzimet e personelit. Një numër i madh njësish vendore nuk arrinin të mblidhnin asnjë të ardhur të vetën, duke mos qenë në gjendje të ofronin shërbime për banorët e tyre.

40. Këto mangësi sollën si rrjedhojë mospasjen sukses të procesit të demokratizimit në thuajse të gjitha nivelet e qeverisjes vendore, i cili ishte objektivi kryesor i ndarjes territoriale të vitit 2000. Kjo solli, gjithashtu, si pasojë krijimin e pabarazive mes NJQV-ve në ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Për këtë arsye, mazhoranca qeverisëse caktoi si një nga prioritetet kryesore të programit të saj kryerjen dhe zbatimin e reformës administrativo-territoriale, me synim rritjen e eficiencës së shërbimeve publike vendore dhe fuqizimin e NJQV-ve me qëllim menaxhimin sa më të mirë të fondeve publike. Në zbatim të këtij prioriteti, qeveria caktoi Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore si institucionin përgjegjës për përgatitjen e projektligjit. Përveç kësaj, me qëllim garantimin e

gjithëpërfshirjes të faktorit politik, Kuvendi, me vendimin nr.1, datë 22.1.2014 miratoi ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale.

41. Në datën 31.07.2014 Kuvendi miratoi ligjin nr.115 “Për ndarjen administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë”, i cili përmban 6 nene, si dhe hartat e tabelat shoqëruese. *Neni 1* përcakton ndarjen administrativo-territoriale të vendit në 12 qarqe dhe 61 bashki. Ndarja administrativo-territoriale në nivelin e qarqeve mbetet e pandryshuar me 12 qarqe. Rrethi, si njësi territoriale dhe nënndarje e qarkut, është suprimuar. Niveli i parë i qeverisjes vendore është riorganizuar me 61 njësi të qeverisjes vendore, nga 373 (bashki dhe komuna) që kishte para miratimit të ligjit objekt shqyrtimi. Sipas relacionit shoqërues të ligjit, ndarja administrativo-territoriale me 61 bashki bazohet në metodologjinë e zonave funksionale, që do të thotë se janë bashkuar disa bashki dhe komunat ekzistuese, të cilat së bashku formojnë 1 zonë funksionale, nisur nga kriteret teknike të miratuara nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar. *Neni 2* u referohet qendrave të bashkive të reja, shtrirjes territoriale dhe nënndarjeve të bashkive, të cilat përcaktohen në tabelat dhe hartat që i bashkëlidhen projektligjit dhe janë pjesë përbërëse e tij. Fshatrat dhe qytetet në përbërje të bashkive dhe komunave ekzistuese mbeten edhe me ndarjen e re administrativo-territoriale. *Neni 3 dhe neni 4* parashikojnë se organet e zgjedhura të njësive të qeverisjes vendore ekzistuese vijojnë ushtrimin e mandatit 4-vjeçar pa ndërprerje deri në përfundimin e tij sipas legjislacionit në fuqi për zgjedhjet vendore. Në këtë aspekt, ndarja e re territoriale do t'i shtrijë efektet me zgjedhjet e reja vendore, duke mos cenuar mandatet aktuale të të zgjedhurve vendorë.

42. Pretendimi kryesor i kërkuesit është se ligji objekt shqyrtimi bie ndesh me nenet 108/1 dhe 116 të Kushtetutës, pasi ai suprimon njësinë vendore *komunë* të parashikuar në Kushtetutë. Sipas kërkuesit, ligji ka suprimuar një njësi vendore ekzistuese të parashikuar në nivel kushtetues, gjë e cila nuk mund të shmanget me ligj, qoftë ky i miratuar me shumicë të cilësuar.

43. Gjykata vëren se neni 108 i Kushtetutës parashikon: *“Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj... Komuna dhe bashkia janë njësi bazë të qeverisjes vendore. Ato kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisëse, me përjashtim të atyre që me ligj u jepen njësive të tjera të qeverisjes vendore.”* Neni 1 i

ligjit 115/2014 objekt shqyrtimi parashikon: “1. Njësitë e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë janë: Bashki – 61; Qarqe – 12”. Ligji i ri ka lënë jashtë parashikimit “komunën” si njësi qeverisjeje vendore. Ky ligj në ndarjen e re, sipas tabelave shoqëruese të tij, i referohet kriterit të zonave funksionale, i cili parashikon ndërthurjen e zonave urbane dhe rurale në njësi të vetme administrative, duke bashkuar bashkitë (si rregull zona urbane) dhe komunat (si rregull zona rurale). 61 bashkitë e reja përfshijnë mesatarisht 5-6 bashki dhe/ose komuna ekzistuese, që do të thotë se në përbërjen e tyre do të kenë si zona urbane, ashtu edhe zona rurale.

44. Gjykata fillimisht vlerëson të ndalet në detyrimin që rrjedh nga neni 108 i Kushtetutës lidhur me nivelet e qeverisjes vendore. Sipas nenit 108/1, fjalìa e parë, garantohet qeverisja vendore me dy nivele: niveli i parë është komuna ose bashkia dhe niveli i dytë është qarku. Ndërsa referuar fjalisë së dytë të nenit 108/1 të Kushtetutës, Gjykata çmon se mundësia e pasjes së njërive të tjera vendore, përveç atyre të parashikuar në Kushtetutë (komunat/bashkitë/qarqet), është e hapur. Ajo që paraqet rëndësi në aspektin kushtetues është fakti nëse organizimi i qeverisjes vendore me një, dy ose më shumë njësi vendore mbetet efikas apo dëmtohet. Ligjvënësi, para ndërmarrjes së çdo reforme për pakësimin apo shtimin e numrit të NJQV-ve, duhet t’i përgjigjet pyetjes nëse një gjë e tillë sjell pasoja negative për qeverisjen vendore dhe rrjedhimisht për komunitetin. Për t’i dhënë përgjigje kësaj pyetje, ligjvënësi duhet të vlerësojë të gjitha kriteret kushtetuese dhe ligjore të nevojshme për t’u respektuar kur ndërmerret një reformë territoriale tërësore. Nëse rezulton se komunitetit nuk i ka ardhur ndonjë pasojë negative konkrete nga reforma, atëherë nuk kemi të bëjmë me një pretendim të natyrës kushtetuese, por me çështje të oportunitetit të ligjvënësit, gjë e cila nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga kjo Gjykatë. Reformat ligjore janë pjesë e programeve qeveritare dhe si të tilla duhet të vlerësohen edhe në aspektin e oportunitetit të ligjvënësit, për aq kohë sa nuk bien ndesh me parime kushtetuese.

45. Meqë Kushtetuta nuk parashikon ndalim të shprehur ose të nënkuptuar lidhur me numrin e NJQV-ve që mund të ketë në vend, Gjykata e sheh me vend të ndalet më tej, tek çështja nëse *komuna* është koncept i mbrojtur nga Kushtetuta. Për këtë qëllim, Gjykata do t’u drejtohet metodave të interpretimit teleologjik dhe gramatikor. Referuar këtyre metodave, Gjykata thekson se qëllimi i kushtetutbërësit në hartimin e gjithë pjesës së gjashtë

të Kushtetutës, ka qenë organizimi i qeverisjes vendore sipas parimeve të caktuara. Një nga parimet e organizimit të pushtetit vendor është edhe krijimi i njësive bazë të qeverisjes vendore, të cilat janë thelbësore për realizimin e qeverisjes vendore. Këto njësi bazë janë mjaft të rëndësishme, pasi mbajnë peshën kryesore të realizimit të funksioneve të tyre brenda juridiksionit të tyre. Pa njësinë bazë nuk është i mundur realizimi i vetëqeverisjes lokale, si formë e qeverisjes demokratike. Është kjo arsyeja që ato parashikohen në Kushtetutë dhe kjo e fundit autorizon ligjvënësin që të krijojë me ligj, nëse e sheh të arsyeshme, edhe njësi të tjera (neni 108/1, fjalia e dytë). Pra, si komuna, ashtu edhe bashkia njihen si NJQV bazë.

46. Para Gjykatës shtrohet çështja a ka qenë qëllimi i kushtetutëbërësit që këto njësi bazë (komuna/bashki) të jenë njëkohësisht prezente. Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje, Gjykatës nuk i vjen në ndihmë metoda e interpretimit historik, pasi periodha së cilës mund t'i referohet nuk është aq e gjatë sa të justifikojë një qëndrim të konsoliduar. Për këtë arsye, i referohemi interpretimit gramatikor. Duke iu referuar shprehjes së përdorur në nenin 108/1, njësitë e qeverisjes vendore janë *komunat ose bashkitë* dhe më tej në nenin 108/3 *komunat dhe bashkitë janë njësitë bazë të qeverisjes vendore*, vihet re se ka në dukje një mospërputhje gramatikore në përdorimin e lidhëzës “ose” apo “dhe” midis fjalëve “komuna” e “bashki”. Më tej, në nenin 109 e gjejmë përsëri të shprehur lidhëzën “ose” midis organeve ekzekutive të *komunës ose bashkisë*, apo të *këshillave të komunës ose bashkisë*.

47. Gjykata çmon se qëllimi i ligjvënësit kushtetues ka qenë dhënia e konceptit të njësisë bazë të qeverisjes vendore, e cila mund të jetë *komunë ose bashki*. Secila prej këtyre njësive synon realizimin e funksioneve të veta bashkë me organet përkatëse ekzekutive ose përfaqësuese, *kryetar komune ose kryetar bashkie, këshill komune ose këshill bashkiak*. Pra, Kushtetuta ka parashikuar njësinë bazë dhe organet e saj, sipas rastit, nëse do të jetë komunë ose bashki. Gjykata konstaton se në asnjë prej dispozitave që i dedikohet qeverisjes vendore nuk bëhet dallimi midis dy njësive bazë, pra nuk rezulton që komuna ose bashkia të kenë kompetenca të veçanta. Përderisa Kushtetuta nuk ka bërë dallim midis komunave dhe bashkive përsa i takon mënyrës së krijimit të tyre, funksioneve që ato kanë apo mënyrës së mbarimit të këtyre organeve, atëherë kushtetutëbërësi nuk ka pasur si qëllim domosdoshmërisht ekzistencën e njëhershme të tyre. Në të

kundërt, ai do t'i kishte parashikuar ato me kompetenca të veçanta, madje edhe me procedura të veçanta emërimi/zgjedhje ose shkarkimi/mbarimi. Kështu, nenet 108/4 dhe 109 parashikojnë se organet përfaqësuese të komunave ose bashkive zgjidhen me anë të zgjedhjeve të drejtpërdrejta. Neni 115/1 parashikon se organet e qeverisjes vendore mund të shkarkohen ose shpërndahen me vendim të Këshillit të Ministrave. Neni 108/3 parashikon se komunat ose bashkitë kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisëse, pa bërë dallim mes tyre. Neni 111 parashikon se njësitë e qeverisjes vendore janë persona juridikë dhe kanë buxhet të pavarur, pa bërë dallime mes tyre.

48. Gjykata, duke u nisur nga parashikimi i dispozitave konkrete kushtetuese që parashikojnë NJQV-ve, çmon se midis komunës dhe bashkisë nuk rezulton të ketë dallim të nivelit kushtetues, në mënyrë që të justifikohet domosdoshmërisht ekzistenca e tyre e njëkohshme si njësi të qeverisjes vendore. Fakti që me ligjin 8652/2000 është bërë dallimi që zonat rurale të grupohen në komuna dhe ato urbane në bashki, nuk është argument kushtetues, pasi është çështje e vlerësimit të ligjvënësit të zakonshëm, i cili në kohë të ndryshme mund të formojë një vullnet të ndryshëm të shprehur në ligj. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se mosparashikimi në ligjin objekt shqyrtimi të komunave nuk cenon nenin 108/1 si dhe rrjedhimisht, as nenin 116 të Kushtetutës.

49. Gjithashtu, Gjykata konstaton se edhe argumenti i kërkuarit që mosparashikimi i komunave si njësi bazë vendore cenon parimin e sigurisë juridike, është i pabazuar, pasi ekzistenca e komunave/bashkive nuk është e garantuar për të ruajtur vetë njësitë si të tilla, por për të realizuar qeverisjen vendore në tërësi. Kërkuarisi nuk arriti të sjellë argumente të nivelit kushtetues se përse modeli i zgjedhur nga ligjvënësi nuk e realizon qëllimin për të cilin ai është parashikuar.

50. Përsa i takon pretendimit tjetër se suprimimi i komunave cenon procesin zgjedhor, pasi zonat zgjedhore janë të organizuara apo të ndara duke marrë si njësi bazë komunën, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk mund të jetë objekt shqyrtimi prej saj, pasi kjo çështje lidhet me Kodin Zgjedhor dhe jo me ligjin objekt kërkesë. Ky i fundit ka për qëllim organizimin e pushtetit vendor dhe jo organizimin e zgjedhjeve, i cili rregullohet me ligj të posaçëm.

3. Për pretendimin se ligji bie ndesh me nenin 108/2 të Kushtetutës.

51. Kërkuesi pretendon se projektligji për reformën administrativo-territoriale është hartuar duke mosrespektuar parimin kushtetues të marrjes së mendimit të komunitetit që preket prej saj. Në mbështetje të pretendimit të tij, kërkuesi i referohet nenit 108/2 të Kushtetutës, i cili parashikon se kufijtë e njësive të qeverisjes vendore nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që jeton në to. Sipas tij, konsultimi paraprak është i domosdoshëm, me qëllim ruajtjen e identitetit kulturor dhe historik të njësive vendore. Kërkuesi është i qëndrimit se mënyra e vetme e konsultimit për ndryshimin e kufijve administrativo-territorial është referendumi vendor, pasi, sipas tij, vetëm kjo formë konsultimi e realizon në thelb detyrimin kushtetues të sanksionuar në nenin 108/2. Ligjvënësi nuk e ka respektuar këtë kriter dhe si rrjedhojë ndarja e re territoriale është antikushtetuese.

52. Subjekti i interesuar Kuvendi argumenton se ndryshimi i kufijve të njësive të qeverisjes vendore i nënshtrohet vetëm kushtit të marrjes paraprake të mendimit të popullsisë që banon në to, por jo marrjes domosdoshmërisht të pëlqimit të saj nëpërmjet referendumit. Ky nuk është mjeti i vetëm me të cilin merret mendimi i popullsisë që preket nga reforma administrativo-territorial. Subjekti i interesuar Këshilli i Ministrave, argumenton se marrja e mendimit të popullsisë nuk mund të interpretohet ngushtë duke iu referuar vetëm referendumit, me qëllim ndryshimin e kufijve administrativo-territoriale. Kushtetuta, nëse do të kishte pasur këtë synim, do ta kishte parashikuar shprehimisht si të vetmen formë konsultimi. Format e marrjes së mendimit janë parashikuar në ligjin përkatës dhe ato rezultojnë të jenë respektuar para miratimit përfundimtar të ligjit.

53. Gjykata vëren se neni 108 i Kushtetutës parashikon:

“1. Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj.

2. Ndarjet administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike. Kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to...”

Neni 5 i Kartës Europiane të Autonomisë Vendore shprehet:

“Mbrotjtja e kufijve territorialë të bashkësive vendore

Për çdo ndryshim të kufijve territorialë vendorë, bashkësive vendore përkatëse duhet t’u merret mendimi paraprakisht, po qe nevoja, me anë referendumi, aty ku e lejon ligji.”

Neni 67 i ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore (më poshtë ligji 8652/2000) parashikon se:

“Argumentimi dhe dokumentimi i riorganizimit nga propozuesi”

Propozimi për riorganizimin e një ose më shumë njësive të qeverisjes vendore, për çdo rast të veçantë, i paraqitet Kuvendit së bashku me këto fakte dhe argumente:

...

Mënyrat e marrjes së mendimeve në mbledhje të hapura, seanca këshillimi me publikun, dëgjime publike, sondazhe opinioni të certifikuara nga organe kompetente ose qëndrim i shprehur nëpërmjet referendumit vendor ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme dhe të besueshme...”

54. Gjykata çmon me vend të ndalet fillimisht në konceptin kushtetues “*të marrjes së mendimit nga popullsia*”, sipas nenit 108 të Kushtetutës, si kriter për kryerjen e një reforme administrativo-territoriale. Gjykata konstaton se neni 108 i Kushtetutës, i cili është i pari midis 8 neneve që përbëjnë “Pjesën e Gjashtë” të Kushtetutës kushtuar organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor, mishëron disa parime. Kështu, në këtë dispozitë përcaktohen këto parime: *Njësité bazë të qeverisjes vendore janë përcaktuar të jenë bashki ose komuna, të cilat kryejnë detyrat vetëqeverisëse; NJQV të tjera mund të përcaktohen me ligj; Ndarja administrativo-territoriale përcaktohet me ligj; Ndarja administrativo-territoriale bazohet tek nevojat dhe interesat e përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike; Kufijtë e NJQV-ve nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to; Vetëqeverisja ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese dhe referendumeve vendore.*

55. Gjykata vlerëson se qëllimi i përfshirjes së këtyre parimeve në këtë dispozitë ka qenë përcaktimi i disa prej shtyllave kryesore ku duhet të mbështetet organizimi i qeverisjes vendore, të cilat në terma më të përmblendhura mund të shprehen në dy drejtime kryesore: a) *vetëqeverisja lokale nëpërmjet njësive të përcaktuara në ligj dhe b) organizimi i pushtetit lokal mbështetur në interesa dhe tradita të zonës, si dhe duke marrë parasysh mendimin e popullsisë që banon në to.*

56. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se koncepti i marrjes së mendimit nga popullsia që banon në NJQV, në rastet kur synohet ndryshimi i kufijve pjesorë ose tërësorë është detyrim kushtetues. Detajet mbi mënyrat e realizimit të këtij detyrimi, kushtetutbërësi ia ka deleguar ligjvënësit të zakonshëm. Për këtë qëllim është miratuar edhe ligji 8652/2000, i cili parashikon mënyrat me të cilat realizohet marrja e mendimit të popullsisë. Referuar nenit 67 të këtij ligji, marrja e mendimit realizohet nëpërmjet këtyre metoda alternative: mbledhjeve të hapura; seancave të këshillimit me publikun; dëgjimeve publike; sondazheve të opinionit të certifikuara nga organe kompetente; qëndrimit të shprehur nëpërmjet referendumit vendor ose ndonjë mënyre tjetër të përshtatshme dhe të besueshme.

57. Gjykata vëren se ligji 8652/2000 ka bërë një zbërthim të mënyrave me të cilat mund të merret mendimi i popullsisë që banon në njësitë vendore dhe që preken nga ndryshimi i kufijve midis NJQV-ve. Para se të ndalet te mënyrat e realizimit të marrjes së mendimit të popullsisë në çështjen në gjykim, Gjykata vlerëson të nevojshme të ndalet te rëndësia e këtij detyrimi kushtetues, duke qenë se nuk ka praktikë të mëparshme kushtetuese për këtë qëllim. Gjithashtu, duke qenë se mungon jurisprudenca e kësaj Gjykate në lidhje me konceptin e marrjes së mendimit para bërjes së një reforme territoriale administrative, Gjykata për këtë qëllim i është referuar praktikës së Gjykatës Federale Kushtetuese Gjermane, e cila ka elaboruar këtë koncept kushtetues si standard që duhet respektuar nga ligjvënësi.

58. Koncepti i vetëqeverisjes së pushtetit lokal është një ide relativisht moderne, i cili lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e qeverisjes në tërësi dhe me shërbimin sa më të mirë kundrejt shtetasve në veçanti. Ajo ka si kusht kryesor ekzistencën e njësisive administrative me qëllim realizimin e funksioneve të veta. Këto njësi nuk duhen parë vetëm si ndarje administrative vertikale të pushtetit apo si një mënyrë e organizimit të administratës publike. Më shumë ato duhen konceptuar si shprehje të shkallëzimit të demokracisë, si një pjesë përbërëse dhe formuese e shtetit demokratik (*Vendim i GJKF-së gjermane BverfGE 52, 95 (111)*). Ideja ku u mbështet si fillim koncepti i vetëqeverisjes lokale, ishte përfshirja më e madhe e qytetarëve në vendimmarrje që lidhen me interesat e tyre, duke realizuar kështu edhe demokracinë funksionale nga poshtë lart. Në funksion të këtij

koncepti, vetëqeverisja nuk është një e drejtë themelore, por një parim kushtetues që përmban një garanci institucionale (*Horst Dreier, Grundgesetzkommentar – Komentar i Ligjit Themelor Gjerman (1998) fq.523*). Kjo garanci lidhet me ekzistencën e NJQV-ve si të tilla dhe me ushtrimin e kompetencave të tyre brenda juridiksionit që u është dhënë. Elementet e vetëqeverisjes së NJQV-ve janë të lidhura jo vetëm me ekzistencën e tyre si institucione, por edhe me kompetencat që ushtrojnë. Kështu, koncepti i vetëqeverisjes lidhet me 3 garanci:

a) *Garancia institucionale* – NJQV-ve kanë të drejtë të ekzistojnë si subjekte të së drejtës publike, të cilat krijohen dhe organizohen me ligj. Ligjvënësi ka të drejtë në këtë aspekt të respektojë autonominë gjatë krijimit të tyre, do të thotë se ligjvënësi nuk ka të drejtë t'i suprimojë të gjitha njësitë vendore në atë shkallë sa të bëjë të pamundur realizimin e qeverisjes vendore në thelb, por as edhe t'i prekë kompetencat e tyre deri në atë pikë sa t'i bëjë ato të pamundura për t'u ushtruar. Mbrojtja institucionale e organeve të qeverisjes vendore nuk është individuale, por institucionale, gjë e cila do të thotë se nga kjo garanci nuk rrjedh detyrimisht ekzistenca dhe statusi i njësive vendore të veçanta, por i të gjitha njësive vendore, si bashkësi njësisish që realizojnë vetëqeverisjen në shkallë vendi. Rrjedhimisht, ndryshimi i kufijve të NJQV-ve është i mundur, por gjatë këtij ndryshimi duhen respektuar kriteret formale dhe materiale.

b) *Garancitë objektive* – NJQV kanë të drejtë të ushtrojnë kompetencat e tyre të dhëna me ligj pa u penguar nga pushteti qendror. Ushtrimi i tyre lidhet si me anën formale ashtu edhe me atë materiale, me qëllim realizimin e funksioneve të tyre brenda konceptit të vetëqeverisjes. Ligjvënësi në çdo rast ka detyrimin të respektojë autonominë e NJQV-ve me qëllim mospengimin e tyre në realizimin e funksionit për të cilin ato janë krijuar.

c) *Garancitë subjektive* – NJQV-të kanë të drejtë të përdorin mjete juridike të krijuara, me qëllim mbrojtjen e tyre nga ndërhyrjet e pajustificuara të ligjvënësit, kur ato kanë bindjen se autonomia e tyre është cenuar në thelb. Pretendimet e NJQV-ve mund të lidhen me: konsultimin e tyre nga qeveria/ligjvënësi për ndërmarrjen e reformave të çdo lloji që prekin edhe NJQV-të; bashkëpunimin gjatë proceseve të planifikimit urban, etj. Procesi i konsultimit, p.sh mund të realizohet nëpërmjet dëgjimit, këshillimit apo bashkëpunimit

nga ana e NJQV-ve deri në procesin vendimmarrës (*Horst Dreier, Grundgesetzkommentar (Komentari i Ligjit Themelor Gjerman) fq.530*).

59. Gjykata thekson se parimi i vetëqeverisjes, i përbërë nga këto tri elemente nuk e ndalon ndryshimin e kufijve të çdo njësie, pasi garancia kushtetuese që rrjedh nga neni 108/1 lidhet me ekzistencën e njësive (komunës/bashkisë) nga pikëpamja institucionale dhe jo nga pikëpamja individuale. Për këtë arsye, në parim, shkrirja e komunave, bashkimi i tyre, ngjitja e tyre në një njësi tjetër ose çdo formë tjetër e ndryshimit të kufijve lokalë nuk prek thelbin e vetëqeverisjes lokale si garanci kushtetuese. Megjithatë çdo ndryshim që prek kufijtë e njësive vendore duhet të ketë si pikënisje interesin publik dhe të jetë i bazuar edhe mbi mendimin e komunitetit të prekur nga ndryshimet (*Vendim i GJFK-së gjermane: BverfGE 86, 90, 12 maj 1992*).

60. Gjykata e sheh me vend të nënvizojë se detyrimi për të dëgjuar NJQV-ve që preken nga ndryshimi i kufijve të tyre (nëpërmjet ndarjes së re apo çdo lloj riorganizimi), nënkupton që njësitë të marrin dijeni/informacion për rregullimin e ri. Informacioni duhet të përfshijë përmbajtjen substanciale të riorganizimit, si dhe arsyet përkatëse që çuan në këtë rregullim të ri. Thelbi i parimit të vetëqeverisjes, sipas nenit 108/1 të Kushtetutës, është që NJQV, në realizimin konkret të kompetencave të tyre të dhëna nga Kushtetuta, t'u jepet mundësia që të mbajnë qëndrim lidhur me reformën territoriale apo çdo rregullim tjetër që do të sillte si pasojë, veç të tjerash, edhe ndryshimin e kufijve midis njësive. Qëllimi i mundësisë për t'u dëgjuar është që NJQV-të të mos kthehen në objekt të veprimtarisë së pushtetit qendror, por të jenë pjesëmarrëse në reformë.

61. Gjykata thekson se vendimmarrja e ligjvënësit në lidhje me një ndarje të re administrativo-territoriale të vendit është e nevojshme t'i nënshtrohet testit të proporcionalitetit, i cili duhet të peshojë interesa të ndryshëm të të gjithë subjekteve që preken nga reforma. Ky test nuk mund të japë rezultate të sakta pa pjesëmarrjen e të gjitha subjekteve. Nëpërmjet këtij testi, ligjvënësi mbledh informacion mbi të gjitha çështjet e ndjeshme që përfshihen në një reformë të mundshme. Për këtë arsye, e drejta e komunitetit për t'u dëgjuar para ndërhyrjes së ligjvënësit në kufijtë territoriale të hapësirës administrative ku ai jeton, është jo vetëm përmbajtja materiale e garancisë objektive të vetëqeverisjes lokale, por edhe element i shtetit të së drejtës, i cili ka për synim funksionimin siç

duhet të të gjithë pushtetit shtetëror. Procesi i dëgjimit të NJQV-ve që preken nga reforma nuk është i detyrueshëm të jetë i detajuar, mjafton marrja e mendimit për thelbin e reformës dhe argumentet ku ajo mbështetet (*Vendim i GJK-së gjermane: BverfGE 50, 195, 17 janar 1979*). Megjithatë, Gjykata çmon se pavarësisht detajeve, procesi i dëgjimit duhet të përfshijë si kusht minimal pjesëmarrjen formale të banorëve të NJQV-ve që preken nga reforma në një proces diskutimi, ku jo vetëm të paraqitet varianti përfundimtar që do të miratohet, por ai të jetë i hapur për ndryshime të mundshme, sipas sugjerimeve të komunitetit, aty ku ka (*Vendim i GJK-së të Landit të Brandeburgut: VfGBbg 95/03, 18 dhjetor 2003*).

62. Gjykata vlerëson se detyrimet e vendosura nga Kushtetuta dhe nga Karta Europiane për Vetëqeverisjen Vendore specifikohen në detaje nga ligji nr.8652/2000. Ky ligj, përveç mënyrave të marrjes së mendimit, parashikon edhe kategorinë e subjekteve, të cilat duhet të shprehen dhe konsultohen mbi ndarjen administrativo-territoriale, si dhe mënyrat dhe mjetet se si duhet t'u merret mendimi këtyre subjekteve. Konkretisht, neni 67 parashikon: *"Propozimi për riorganizimin e një ose më shumë njësisive të qeverisjes vendore, për çdo rast të veçantë, i paraqitet Kuvendit së bashku me këto fakte dhe argumente: ...Mënyrat dhe materialet ose dokumentet e përdorura për informimin e publikut mbi riorganizimin dhe çështjet që lidhen me të; Mendimin e popullatës që banon në njësitë e qeverisjes vendore që do të riorganizohen, si dhe mendimin "pro" dhe "kundër" këtij riorganizimi, sipas çdo rasti të veçantë nga subjekte ose grupe të interesuara drejtpërdrejt ose jo-drejtpërdrejt në këtë riorganizim.; Mënyrat e marrjes së mendimeve në mbledhje të hapura, seanca këshillimi me publikun, dëgjime publike, sondazhe opinioni të certifikuara nga organe kompetente ose qëndrim i shprehur nëpërmjet referendumit vendor ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme dhe të besueshme."*

63. Nisur nga standardet e shprehura më lart, Gjykata konstaton se referuar edhe ligjit nr.8652/2000, i cili parashikon si metoda alternative të marrjes së mendimit: mbledhjet e hapura, seancat e këshillimit me publikun, dëgjimet publike, sondazhet e opinionit të certifikuara nga organe kompetente ose qëndrimin e shprehur nëpërmjet referendumit vendor ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme dhe të besueshme, nuk është e domosdoshme për hartuesin e ligjit që këto metoda të konsultimit të plotësohen të

gjitha njëherësh, me qëllim që ky proces të quhet i kryer. Natyrisht sa më shumë prej këtyre metodave të përdoren aq më i besueshëm dhe i qendrueshëm është rezultati.

64. Gjithashtu, në nenin 68 sanksionohet detyrimi për të shprehur mendimin me shkrim nga organet e qeverisjes vendore brenda afatit prej 60 ditësh: *“Këshillat komunalë, bashkiakë dhe të qarqeve, që janë të përfshira drejtpërdrejt në riorganizim, si dhe kryetarët e tyre japin mendimin e tyre zyrtar dhe nëse ka, edhe mendimin “kundër” të një pjesë të këshilltarëve të këshillit përkatës.”*

65. Nisur nga baza ligjore, si dhe nga materialet e sjella në gjykim nga subjektet e interesuara në këtë gjykim, Gjykata konstaton se janë ndjekur këto metoda, me qëllim kryerjen e procesit të konsultimit publik lidhur me reformën e re territorialo-administrative:

- Informimi i publikut mbi ecurinë e reformës administrativo-territoriale është kryer duke përdorur disa instrumente, si p.sh: takimet dhe mbledhjet e hapura, seancat e këshillimit publik, dëgjesat publike, sondazhin kombëtar, si dhe mediat vizive dhe të shkruara. Konsultimi publik, ashtu siç përcaktohet nga ligji 8652/2000, është zhvilluar në disa faza të reformës me 3 grupe kryesore:

Grupi i parë përbëhej nga përfaqësues të qeverisjes vendore dhe të shoqatave të të zgjedhurve vendorë. Gjatë gjithë fazës së parë të reformës, informimi dhe konsultimet janë zhvilluar nëpërmjet takimeve të punës, seminareve, konferencave dhe dërgimit të informacioneve me shkrim. Në muajin mars-prill 2014 u zhvillua rauti i parë i konsultimit publik, ku ka pasur mbledhje publike me përfaqësues të qeverisjes vendore në të gjitha qarqet e vendit për të informuar mbi procesin e reformës dhe për konsultimin e kriterëve teknike. Në periudhën 28 prill 2014 deri në 16 maj 2014, Komisioni i Posaçëm Parlamentar zhvilloi disa seanca dëgjesash publike, ku u dëgjuan përfaqësues të qeverisjes vendore dhe shoqatave të tyre. Mendimet e organeve të qeverisjes vendore mbi variantin 39/47, të miratuar nga Komisioni në datën 22 maj 2014, u kërkuan në mënyrë zyrtare, bazuar në nenin 68 të ligjit organik 8652/2000, në datën 23 maj 2014. Sipas këtij neni, organet e njësive të qeverisjes vendore duhet të shprehen me shkrim brenda 60 ditëve. Ky afat skadoi në datën 22 korrik 2014.

Grupi i dytë përbëhej nga grupet e interesit, shoqëria civile dhe përfaqësues të biznesit lokal, për konsultimin e të cilëve, gjatë gjithë procesit të prezantimit të reformës administrativo-territoriale, gjatë periudhës maj-qershor 2014 janë zhvilluar 37 takime në

qendrat e rrethit me grupet e interesit dhe shoqërinë civile, si dhe 5 takime e një anketim kombëtar me biznesin.

Grupi i tretë përbëhej nga banorët e zonave që preken nga reforma, për konsultimin e të cilëve është përdorur instrumenti i sondazhit kombëtar të opinionit, bazuar në nenin 67 të ligjit organik të qeverisjes vendore 8652/2000. Në sondazhin e kryer nga një organizatë shqiptare e përzgjedhur nga PNUD-i me financimin e projektit STAR, kanë marrë pjesë 16000 të intervistuar. Rezultatet e sondazhit kombëtar raportojnë për një mbështetje të reformës administrativo-territoriale nga mbi 50% e të anketuarve. Pyetjeve për propozimin konkret të ndarjes së territorit në 39/47 NJQV, shumica e të anketuarve u përgjigj në favor të variantit të ndarjes së vendit në 39 zona funksionale.

66. Gjithashtu, në zbatim të nenit 68, pika 1 dhe 3 të ligjit 8652/2000, organet e njësive të qeverisjes vendore kanë të drejtë të japin mendimin e tyre zyrtar me shkrim mbi propozimin për riorganizimin administrativo-territorial brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës. Në funksion të këtij procesi, Komisioni i Posaçëm Parlamentar, pas miratimit më datë 22.05.2014 të variantit të ndarjes administrativo-territoriale me 39/47 njësi të qeverisjes vendore, ngarkoi Ministrin e Çështjeve Vendore për të kërkuar mendimin zyrtar mbi këtë variant nga të gjithë kryetarët e bashkive dhe komunave si dhe nga këshillat e bashkive dhe të komunave. Ministri për Çështjet Vendore, me shkresën përcjellëse nr.2068, datë 23.05.2014, i dërgoi propozimin konkret të riorganizimit për secilën njësi të qeverisjes vendore sipas variantit 39/47, të gjithë kryetarëve të bashkive dhe këshillave të bashkive, si dhe kryetarëve të komunave dhe këshillave të komunave, në total 746 organeve vendore të nivelit të parë bashki/komunë. Deri në datën 22.07.2014, nga totali prej 373 bashkish dhe komunash, kishin kthyer përgjigje 286 NJQV ose 76% e numrit të përgjithshëm të bashkive dhe komunave në vend, në emër të të cilave janë shprehur ose kryetari i njësisë vendore, ose këshilli, ose të dyja organet së bashku. Gjithsej janë 393 përgjigje zyrtare të sjella nga 263 kryetarë bashkish dhe komunash, si dhe nga 130 këshilla të bashkive dhe komunave. Pra, gjithsej kanë shprehur mendimin zyrtar 52,5% e totalit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të bashkive dhe komunave në vend. Nga shqyrtimi në detaje i përgjigjeve të ardhura dhe pas marrjes në konsideratë nga ana e komisionit të mendimeve të ardhura, rezulton se: 160 kryetarë të bashkive dhe komunave, si dhe këshilla të bashkive dhe

të komunave kanë kthyer përgjigje pozitive (PRO) ndaj variantit të propozuar 39/47; 56 kryetarë të bashkive dhe komunave, si dhe këshilla të bashkive dhe të komunave janë shprehur për një ndarje tjetër nga varianti i propozuar 39/47, duke dhënë propozime konkrete për riorganizimin e njësive të tyre vendore. Komisioni, pas vlerësimit të këtyre propozimeve dhe argumenteve, vendosi t'i pranohë këto propozime dhe mbi bazën e tyre të miratojë variantin me 61 bashki; 41 kryetarë të bashkive dhe komunave si dhe këshilla të bashkive dhe të komunave janë shprehur për një ndarje tjetër nga varianti i propozuar 39/47, duke mbështetur në parim reformën administrativo-territoriale në variantin me mbi 60 njësi vendore; 58 kryetarë të bashkive dhe komunave, si dhe këshilla të bashkive dhe të komunave janë shprehur kundër variantit të propozuar, duke dhënë argumentet përkatëse në mbështetje të kundërshtimit të tyre; 78 kryetarë të bashkive dhe komunave, si dhe këshilla të bashkive dhe të komunave janë shprehur kundër variantit të propozuar 39/47, duke mos dhënë asnjë lloj argumenti.

67. Nga sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se procesi i marrjes së mendimit është realizuar nëpërmjet përdorimit të pjesës më të madhe të metodave të parashikuara nga ligji 8652/2000. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kriteri kushtetues i marrjes së mendimit, sipas nenit 108/2 të Kushtetutës, nuk është cenuar.

4. Për cenim të parimit kushtetues të barazisë së votës.

68. Kërkuesi pretendon se ligji nr.115/2014 cenon parimin kushtetues të barazisë së votës, pasi Censusi 2011 përbën një bazë të paligjshme dhe të deformuar për përlogaritjen e popullsisë në vitin 2014, në funksion të kërkesave kushtetuese për rishikim të kufijve territorialë të njësive vetëqeverisëse dhe sigurimit të përfaqësimit të barabartë të popullsisë. Për shkak të deformimeve të rënda në kriterin demografik, njësitë e ndryshme kanë madhësi territoriale të pakrahueshme me njëra – tjetrën. Kjo lloj pabarazie si demografike edhe territoriale nuk respekton parimin e barazisë së përfaqësimit, pra të votës.

69. Subjekti i interesuar Kuvendi prapëson se pretendimet për cenimin e parimit të barazisë së votës janë të pambështetura, pasi për zhvillimin e zgjedhjeve vendore të ardhshme dhe numrin e zgjedhësve, organet e ngarkuara nga ligji zgjedhor do t'i referohen Regjistrin Themeltar të Gjendjes Civile dhe jo Censurit të vitit 2011.

Ndërsa subjekti tjetër i interesuar, Këshilli i Ministrave, argumenton se pretendimet e kërkuesit bazohen mbi rezultatin e zgjedhjeve të mëparshme, prirjet e elektoratit dhe historikun e rezultatit ndër vite, si dhe formulën e përcaktimit të mandateve vendore, këshilltar bashkiak/banorë, që pritet të ndryshohet.

70. Neni 45 i Kushtetutës parashikon se e drejta e zgjedhjes është një ndër të drejtat kushtetuese të shtetasve që luan një rol kryesor në procesin zgjedhor. Kjo e drejtë garanton barazinë dhe fshehtësinë e votës së shtetasve gjatë procesit zgjedhor. Koncepti i votës së barabartë u jep të drejtë zgjedhësve, sa të jetë e mundur, të ndikojnë në mënyrë të njëlojtë dhe me të njëjtën peshë në rezultatin e zgjedhjeve (*vendimi nr.1, datë 07.01.2005 i Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se nisur edhe nga lloji i sistemit zgjedhor, barazia e peshës së çdo vote nuk nënkupton barazinë e saktë matematike të kontributit të çdo vote në rezultatin final të zgjedhjeve. Pesha e çdo vote është e lidhur me mekanizmat e sistemit zgjedhor dhe është e pashmangshme ekzistenca e dallimeve në influencën që mund të ketë çdo votë në varësi nga mekanizmat e adoptuar (*vendimi nr.1, datë 07.01.2005 i Gjykatës Kushtetuese*). Sipas saj, “koncepti kushtetues ‘numër i përafërt zgjedhësish’ nuk është i njëlojtë dhe as nuk mund të konfundohet me numrin e barabartë të zgjedhësve, pasi një koncept i tillë do të ishte i pakuptimtë për t’u përdorur në ndarjen e zonave zgjedhore, por edhe i pamundur njëkohësisht. Koncepti ‘numër i përafërt zgjedhësish’ sigurisht që e përmban në vetvete kriterin numerik, por nuk mund të konkludohet se ai është i vetmi kriter që shërben për përcaktimin e zonave zgjedhore” (*vendimi nr.40, datë 17.05.2001 i Gjykatës Kushtetuese*).

71. Gjykata, gjithashtu i ka dhënë rëndësi edhe ndarjes territoriale në funksion të barazisë së votës, duke u shprehur se “... Ndarja e zonave zgjedhore nuk duhet konceptuar si një ndarje e thjeshtë e natyrës tekniko-administrative. Ajo përbën një proces me rëndësi kushtetuese dhe është pjesë integrale e parimit të barazisë së votës” (*vendimi nr.1, datë 07.01.2005 i Gjykatës Kushtetuese*).

72. Kodi i Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore, duke përmbledhur standardet europiane për zgjedhje demokratike, përcakton edhe aspektet e ndryshme të barazisë së votës, që duhet kuptuar si: (i) *E drejtë votimi e barabartë*: çdo votues ka në parim një votë; nëse sistemi zgjedhor i jep zgjedhësve më shumë se një votë, çdo zgjedhës ka të njëjtin numër votash (prg. 2.1); (ii) *Peshë*

votimi e barabartë: mandatet duhet të shpërndahen në mënyrë të barabartë nëpër zona zgjedhore (prg. 2.2) (iii) *Barazia e mundësive* (prg. 2.3). Ky kod thekson se fuqia e barabartë e votës konsiston në shpërndarjen e qartë dhe të balancuar të mandateve midis zonave zgjedhore mbi bazën e një prej kritereve të mëposhtme të ndarjes së mandateve: popullsia, numri i banorëve lokalë (duke përfshirë minorenët), numri i zgjedhësve të regjistruar dhe mundësisht numri i njerëzve që faktikisht votojnë. (*Kodi i Praktikës së Mirë në Cështjet Zgjedhore; Udhëzime dhe Raporti shpjegues - miratuar nga Komisioni i Venecias në mbledhjen e tij të 51-të dhe të 52-të*).

73. Gjykata konstaton se Kodi Zgjedhor (miratuar me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012), në lidhje me zgjedhjen e përfaqësuesve për Kuvendin, në nenin 74 përcakton: “1. Zona zgjedhore përputhet me territorin e qarkut dhe shërben si njësi zgjedhore për zgjedhjen e një numri të caktuar mandatesh, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod. 2. Kufijtë administrativë të qarqeve vendosen me ligjin për ndarjen administrative e territoriale të Republikës së Shqipërisë.” Ndërsa ligji nr.115/2014 për ndarjen territoriale të nivelit të dytë, parashikon ndarjen në 12 qarqe, ashtu siç ka qenë edhe me ligjin nr.8652/2000.

74. Gjykata vlerëson se për zgjedhjet e përgjithshme të Kuvendit “zona zgjedhore” përputhet me territorin e qarkut dhe në këtë kuptim ligji nr.115/2014 nuk sjell efekte në zgjedhjet e përgjithshme dhe rezultatin e tyre, bazuar mbi argumentin e ndarjes së re territoriale – administrative, pasi zona zgjedhore mbetet e njëjtë në kuptimin territorial. Duke qenë se kërkuesi pretendimet i ka të orientuara drejt zgjedhjeve vendore dhe pasojave që mund të sjellë kjo ndarje e re administrativo - territoriale në cenimin e barazisë së votës për këshillat bashkiakë dhe kryetarët e bashkive, Gjykata e sheh me vend të ndalet edhe në këtë pretendim.

75. Konkretisht, parashikimet ligjore të Kodit Zgjedhor në lidhje me përfaqësuesit vendorë sanksionojnë mënyrën e zgjedhjes së kryetarëve të komunave dhe bashkive për sa vijon: Kryetarët e bashkive ose të komunave, si dhe këshillat e bashkive ose komunave zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë nga zgjedhësit me vendbanim në territorin e bashkisë ose të komunës (*neni 165/1*). 1. Kryetar bashkie ose komune zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse. 2. Në rastin kur dy ose më shumë kandidatë marrin numër të barabartë votash, atëherë ndërmjet tyre

hidhet short. Shorti organizohet nga KQZ-ja në një seancë publike, me pjesëmarrjen edhe të kandidatëve. KQZ-ja përcakton rregullat e organizimit të shortit (*neni 166, prg.1 dhe prg.2*). Ndërsa për sa i përket anëtarëve të këshillave të bashkive dhe të komunave, sipas Kodit ata zgjidhen në bazë të listave shumëemërore të paraqitura nga partitë politike, koalicionet, ose kandidaturat e propozuara nga zgjedhësit (*neni 165/2*). Mandatet e këshillave vendorë ndahen nga KQZ-ja në bazë të sistemit proporcional, sipas të njëjtave procedurave të parashikuara në nenet 162 dhe 163 të këtij Kodi. (*neni 166/3*).

76. Ndërkohë që sipas ligjit nr.8652/2000, këshilli komunal dhe ai bashkiak përbëhet nga këshilltarë të zgjedhur sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë (*neni 23*). Ndërsa numri i anëtarëve të këshillit komunal dhe atij bashkiak përcaktohet sipas numrit të popullsisë: komunat dhe bashkitë deri në 5000 banorë, 13 anëtarë; 5000-10000 banorë, 15 anëtarë; komunat me 10000-20000 banorë, 17 anëtarë; komunat me 20000-50000 banorë, 25 anëtarë; komunat me 50000-100000 banorë, 35 anëtarë; komunat me 100000-200000 banorë, 45 anëtarë, ndërsa Bashkia e Tiranës ka 55 anëtarë. Në zbatim të këtij neni, prefekti përcakton numrin e anëtarëve të këshillit për çdo komunë e bashki nën juridiksionin e tij, mbi bazën e numrit të banorëve sipas evidencave të zyrave të gjendjes civile të datës 1 janar të vitit kur zhvillohen zgjedhjet (*neni 24*).

77. Për sa i takon këtij pretendimi, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk ka paraqitur argumente kushtetuese që të mbështesin pretendimin e tij se ndarja e re territoriale administrative sjell cenim të barazisë së votës së shtetasve.

78. Kërkuesi pretendon, gjithashtu, se ndarja e re territoriale paracakton rezultatin për zgjedhjen e kryetarëve të bashkive. Konkretisht, sipas tij, territori i Bashkisë së re të Tiranës është shtrirë duke përmbledhur sa më shumë njësi të favorshme për mazhorancën në pushtet, përfshirë ish-komunën e Shëngjergjit pas malit të Dajtit, me qëllim që të sigurohet një rezultat i qëndrueshëm zgjedhor në favor të mazhorancës parlamentare. Sipas tij, kësaj bashkie i është bashkuar edhe ish-komuna e Zall-Herit, që nuk ka lidhje tokësore të drejtpërdrejtë me bashkinë aktuale të Tiranës. Një gjë e tillë të çon në përfundimin se bashkimi i njësive vendorë është bërë në funksion të një rezultati më të favorshëm zgjedhor për shumicën qeverisëse.

79. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata çmon se kërkuesi bazohet në argumente hipotetike, duke u nisur nga premisa të karakterit politik, si rezultatet e zgjedhjeve të mëparshme dhe prirjet e elektoratit përkatës. Gjykata vlerëson se argumentet e parashtruara nga kërkuesi nuk ishin të nivelit kushtetues dhe për këtë arsye ajo nuk mund t'u japë atyre një përgjigje përfundimtare.

80. Në përfundim, bazuar në sa më lart, Gjykata çmon se kërkesa për shfuqizimin e ligjit nr.115/2014 "Për ndarjen administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", duhet rrëzuar si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/a, 132 dhe 134/1/c të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletore Zyrtare.

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen e kontrollit të pajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjit nr. 115, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", shumica ka vendosur rrëzimin e kërkesës së 1/5-ës të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë.

2. Kërkuesi pretendon se procedura e miratimit të ligjit është në kundërshtim me nenet 81/2, shkronja "f", 83/3 dhe 75/2 të Kushtetutës, si dhe me Rregulloren e Kuvendit; se reforma territoriale suprimon njësinë vendore *komunë*, çka bie ndesh me nenin 108/1 të Kushtetutës, i cili parashikon komunën dhe bashkinë si njësi të qeverisjes vendore, si dhe me nenin 116 të Kushtetutës, pasi me ligj ndryshohet një koncept i parashikuar nga Kushtetuta; se ligji është realizuar në cenim të parimit kushtetues të marrjes së mendimit të

popullsisë që banon në njësitë e qeverisjes vendore, të sanksionuar në nenin 108/2 të Kushtetutës; se cenohet parimi i barazisë së votës, pasi ligji nr.115/2014 deformat votën e zgjedhësve.

3. Parimet e funksionimit të qeverisjes vendore garantohen nga neni 13 i Kushtetutës dhe, për rëndësinë që ajo paraqet, është pjesë e vlerave themelore të mbrojtura nga Kushtetuta. Konkretisht, parimi i decentralizimit të pushtetit dhe i autonomisë vendore, si parime kushtetuese që qëndrojnë në themelin e dy shtyllave të qeverisjes vendore, përbëjnë thelbin e nenit 13. Ndërsa rregullat e detajuara të kësaj qeverisjeje përcaktohen në pjesën e gjashtë të Kushtetutës (nenet 108-115).

4. Sikurse konstaton edhe shumica, neni 108 i Kushtetutës, i cili është i pari midis 8 neneve që përbëjnë “Pjesën e Gjashtë” të Kushtetutës dedikuar organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor, mishëron disa parime. Kështu, në këtë dispozitë citohen këto parime: *Përcaktimi i njërive bazë të qeverisjes vendore, të cilat kryejnë detyrat vetëqeverisëse; NJQV të tjera mund të krijohen me ligj; Ndarja administrativo-territoriale përcaktohet me ligj; Ndarja administrativo-territoriale bazohet tek nevojat dhe interesat e përbashkët ekonomike dhe të traditës historike; Kufijtë e njërive të qeverisjes vendore nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to; Vetëqeverisja ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese dhe referendumëve vendore (shih paragrafin nr. 54 të vendimit).*

5. Gjithashtu, parime të tjera të qeverisjes vendore sanksionohen në Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore, e cila është bërë pjesë integrale e sistemit të brendshëm juridik shqiptar.

6. Pikërisht për rëndësinë që gëzojnë njësitë e qeverisjes vendore, Kushtetuta ka parashikuar miratimin, ndryshimin apo shfuqizimin e ligjit për ndarjen administrativo-territoriale të Republikës me shumicë të cilësuar, 3/5-at e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (neni 81/2/f i Kushtetutës).

7. Lidhur me nenin 81, pika 2, të Kushtetutës, Gjykata është shprehur se në thelb ajo mbetet një dispozitë që synon mbrojtjen e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta, për shkak të rëndësisë së fushave që rregullojnë ligjet e cilësuar, me qëllim për t’i bërë ato sa më të qëndrueshme, për të kërkuar një konsensus më të gjerë nga forcat politike të përfaqësuar në Kuvend dhe për të shmangur mundësinë që forca politike që ka shumicën, të mund të cenojë parime themelore për funksionimin

e një shoqërie demokratike (*shih vendimet nr.25, datë 05.12.2008 dhe nr.1, datë 12.01.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, respektimi i kriterit kushtetues “shumicë e cilësuar” është edhe në funksion të parimit të sigurisë juridike, parim që ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligjet në tërësi duhet të garantojnë qartësi, parashikueshmëri dhe kuptueshmëri për individin (*shih vendimet nr.23, datë 08.06.2011 dhe nr. 5, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Bazuar në këtë standard, ligji i kundërshtuar, edhe pse është miratuar me shumicën e cilësuar të kërkuar nga neni 82/2/f i Kushtetutës, mendojmë se respekton kriterin kushtetues vetëm nga pikëpamja formale, por nuk e respekton atë nga pikëpamja substanciale, pasi shpreh në mënyrë të njëanshme vetëm vullnetin e shumicës parlamentare dhe si i tillë nuk përfaqëson konsensusin e të gjitha forcave politike të Kuvendit. Në këtë këndvështrim, por edhe për sa do të trajtohet më poshtë, nuk jemi dakord me argumentet e shumicës për t’i rrëzuar pretendimet e kërkuesit që lidhen me cenimin e neneve 108/1, 108/2 dhe 116 të Kushtetutës, sepse ato nuk janë në koherencë me vlerat themelore që Kushtetuta mishëron dhe mbron në një shtet të së drejtës. Në këto kushte, ne gjyqtarët në pakicë po japim arsyet e këtij mendimi pakice.

Për pretendimin për cenimin e neneve 108/1 dhe 116 të Kushtetutës

9. Kushtetuta në nenin 108/1 parashikon: “Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj”. Në vijim të këtij parashikimi neni 108/3 i Kushtetutës citon: “Komuna dhe bashkia janë njësi bazë të qeverisjes vendore. Ato kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisëse, me përjashtim të atyre që me ligj u jepen njësive të tjera të qeverisjes vendore”. Ndërsa neni 116 i Kushtetutës sanksionon piramidën e akteve normative dhe marrëdhëniet midis tyre, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së këtyre normave. Pavarësisht këtyre parashikimeve kushtetuese, ligji i kundërshtuar si njësi të qeverisjes vendore përcakton bashkitë dhe qarqet (neni 1 i ligjit), duke suprimuar komunat¹.

10. Shumica, edhe pse shprehet se çështjet e oportunitetit të ligjvënësit nuk janë objekt i kontrollit kushtetues (*shih paragrafin*

¹ Neni 1 i ligjit 115/2014 objekt shqyrtimi parashikon: “1. Njësitë e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë janë: Bashki – 61; Qarqe – 12”.

nr. 44 të vendimit), pas një analize të detajuar të risive që sjell ligji objekt shqyrtimi (*shih paragrafët nr. 38-41 të vendimit*) ka vlerësuar si aspekt kushtetues të rëndësishëm, për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi, faktin nëse organizimi i qeverisjes vendore me një, dy ose më shumë njësi vendore mbetet efikas apo dëmtohet (*shih paragrafin nr. 44 të vendimit*). Ajo (shumica), pavarësisht se ka vlerësuar se komuna, ashtu sikurse edhe bashkia njihen si njësi bazë të qeverisjes vendore (*shih paragrafin nr. 45 të vendimit*), nëpërmjet interpretimit gramatikor të Kushtetutës, ka arritur në përfundimin se midis komunës dhe bashkisë nuk rezulton të ketë dallim të nivelit kushtetues dhe se kushtetutëbërësi nuk ka pasur si qëllim ekzistencën e njëhershme të tyre. Për këtë arsye, sipas shumicës, mosparashikimi në ligjin objekt shqyrtimi të komunave nuk cenon nenin 108/1, rrjedhimisht as nenin 116 të Kushtetutës (*shih paragrafin nr. 48 të vendimit*).

11. Gjykata në jurisprudencën e saj tashmë të konsoliduar është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese (*shih vendimet nr. 5, datë 05.02.2014 dhe nr. 1, datë 12.01.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material (*shih vendimet nr. 5, datë 05.02.2014 dhe nr. 23, datë 08.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shih vendimet nr. 5, datë 05.02.2014 dhe nr. 2, datë 03.02.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie, ku në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfutur kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shih vendimet nr. 5, datë 05.02.2014 dhe nr.3, datë 20.02.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Bazuar në këto parime, Gjykata ka theksuar se për çdo rast, kur rregullimi kushtetues parashikohet shprehimisht prej saj, ai detyrimisht do të zbatohet drejtpërdrejt. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke u

dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. Ky detyrim rrjedh nga përmbajtja e nenit 4/3 të Kushtetutës. Në rastet kur Kushtetuta lë hapësira me qëllim delegimin e kompetencës ligjvënësit të zakonshëm, atëherë, nuk është i nevojshëm referimi te kjo dispozitë, pra e zbatimit të drejtpërdrejt të saj. Nëse ndodhemi para kësaj situate, është e pritshme që aktet normative që do të dalin për këtë qëllim të respektojnë hierarkinë e akteve normative (*shih vendimin nr.3, datë 20.02.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Nga sa më lart, në ndryshim nga shumica, jemi të mendimit se çfarë shtrohet për diskutim nuk është çështja e efikasitetit apo dëmtimit të organizimit të qeverisjes vendore për shkak të suprimimit të komunës. Ajo që Gjykata duhet të vlerësojë është nëse ky suprimim, çka ka sjellë parashikimin nga ligji i kundërshtuar si njësi bazë të qeverisjes vendore vetëm të bashkisë, bie ndesh me rregullimet që burojnë nga nenet 13, 108/1 dhe 116 të Kushtetutës.

15. Neni 108 i Kushtetutës ka parashikuar si njësi bazë të qeverisjes vendore komunën dhe bashkinë së bashku. Në këndvështrim tonë, edhe po t'i referohemi kriterit të interpretimit gramatikor, të përdorur edhe nga shumica, arrihet pikërisht në këtë rezultat. Edhe pse në paragrafin e parë të këtij neni kushtetutëbërësi përdor lidhëzën “ose” ndërmjet fjalëve komunë dhe bashki², ky paragraf nuk është përcaktues në këtë drejtim, pasi ai identifikon të gjitha njësitë e qeverisjes vendore (komunë, bashki, qark) dhe jo vetëm njësitë vendore bazë. Po ashtu ai parashikon edhe mundësinë që njësi të tjera mund të krijohen me ligj. Ajo që ka rëndësi vlerësoj se është paragrafi i tretë i nenit 108, pasi është ky paragraf që parashikon në mënyrë specifike *vetëm* njësitë *bazë* të qeverisjes vendore, ku jo rastësisht kushtetutëbërësi përdor lidhëzën “dhe”³. Kjo lidhëz (“dhe”) përdoret edhe në nenin 110 të Kushtetutës, ku sanksionohet njësia e dytë e qeverisjes vendore, qarku.

16. Edhe nëse *ad absurdum* do të pranohet që interpretimi gramatikor i përdorur më lart nuk çon në këtë rezultat, vjen në ndihmë interpretimi logjik, pra nxjerrja në pah e qëllimit (*ratio*) të kushtetutëbërësit. Në këtë drejtim, sikurse thekson dhe doktrina, duhet të merren në konsideratë, para së gjithash, punimet përgatitore të normës juridike. Në diskutimet në komisionin parlamentar të

2 Neni 108/1 parashikon “Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj”.

3 Neni 108/3 parashikon “Komuna dhe bashkia janë njësi bazë të qeverisjes vendore”.

hartuesve të Kushtetutës, pavarësisht mënyrave të ndryshme të propozuara për formulimin e nenit 108 të Kushtetutës, rezulton qartë se qëllimi i tyre ka qenë në favor të njësive bazë. Pra, edhe nëse me ligj mund të krijohen njësi të tjera apo kompetencat që nuk ushtrohen nga njësitë bazë, u jepen njësive të tjera të qeverisjes vendore, në këto diskutime asnjëherë nuk është vënë në dyshim ekzistenca e komunës dhe bashkisë. Konkretisht është theksuar se e rëndësishme është që *“njësitë bazë mbeten gjithmonë bashkitë dhe komunat. ... Kjo përcakton prioritetin e nivelit të parë kundrejt nivelit të dytë”*⁴.

17. Kushtetutëbërësi në zgjedhjen e tij, si më lart, ka pasur në konsideratë edhe parimin themelor të funksionimit të organeve të qeverisjes vendore, parimin e decentralizimit të parashikuar nga neni 13 i Kushtetutës. Ky parim ka gjetur pasqyrim edhe në nenin 5 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*, në të cilin përcaktohet se *“komuna përfaqëson një unitet administrativo - territorial dhe bashkësi banorësh, si rregull në zona rurale”*, ndërsa *“bashkia përfaqëson një unitet administrativo - territorial dhe bashkësi banorësh kryesisht në zona urbane”*. Theksojmë se ky ligj nuk është shfuqizuar nga ligji i ri, çka do të thotë jo vetëm se njësitë bazë të qeverisjes vendore vazhdojnë të jenë komunat dhe bashkitë, secila me veçoritë përkatëse, por njëkohësisht se krijohen edhe përplasje midis tyre.

18. Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj shqyrtimi i përplasjeve dhe papajtueshmërive mes dy ligjeve të ndryshme apo ligjeve dhe kodeve. Në juridiksionin kushtetues hyjnë papajtueshmëria e ligjeve apo kodeve me Kushtetutën (*shih vendimet nr.35, datë 10.10.2007 dhe nr. 1, datë 06.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Por, Gjykata është shprehur, gjithashtu, se mungesa e harmonizimit të dispozitave të një ligji me ato të ligjeve të tjera mund të mos krijojë në vetvete antikushtetutshmëri, por kur paqartësia krijon probleme të tilla që çojnë në zbatim të gabuar të dispozitave ligjore dhe në cenim të parimit të shtetit të së drejtës e të sigurisë juridike, atëherë nuk mund të pranohet se këto norma nuk janë të papajtueshme edhe me frymën e Kushtetutës (*shih vendimin nr. 14, datë 22.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Nga ana tjetër, edhe nëse do të marrim të mirëqena arsyet (një numër i madh njësish vendore nuk arrinin të mbledhnin asnjë të ardhur të vetën, duke mos qenë në gjendje të ofronin shërbime për

banorët e tyre), që nxitën ndërmarrjen e një reformë tërësore për sa i takon organizimit administrativ të territorit të vendit, të sjella nga Këshilli i Ministrave (shih paragrafin nr. 39 të vendimit), ndonëse ato mund të kenë rëndësi, bazuar në parimet e mishëruara në jurisprudencën kushtetuese, ato mund të shërbejnë në ndërmarrjen e nismave për ndryshimin e Kushtetutës, por në asnjë rast ky ndryshim nuk mund të bëhet me një akt ligjor që kapërcen frymën dhe përmbajtjen e saj.

20. Duke konsideruar sa më sipër, mendojmë se suprimi i komunës nga njësitë bazë të qeverisjes vendore deformat vullnetin e kushtetutëbërësit dhe si i tillë bie ndesh me nenet 13, 108/1 dhe 116 të Kushtetutës.

Për pretendimin për cenimin e nenit 108/2 të Kushtetutës

21. Neni 108/2 i Kushtetutës parashikon: *“Ndarjet administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike. Kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to”*.

22. Shumica, edhe pse çmon se koncepti i marrjes së mendimit nga popullsia që banon në njësitë e qeverisjes vendore është detyrim kushtetues (*shih paragrafin nr. 56 të vendimit*), lidhur me mënyrat e realizimit të këtij detyrimi, i referohet ligjit 8652/2000. Bazuar në nenin 67 të këtij ligji, shumica ka konstatuar se metodat e ndjekura, me qëllim kryerjen e procesit të konsultimit publik lidhur me reformën e re administrativo-territoriale, janë takimet dhe mbledhjet e hapura, seancat e këshillimit publik, dëgjesat publike, sondazhi kombëtar, si dhe mediat vizive dhe të shkruara (*shih paragrafin nr. 65 të vendimit*). Për këto arsye ajo ka arritur në përfundimin se kriteri kushtetues i marrjes së mendimit është realizuar nëpërmjet përdorimit të pjesës më të madhe të metodave të parashikuara nga ligji i lartpërmendur, prandaj nuk është cenuar neni 108/2 i Kushtetutës (*shih paragrafin nr. 67 të vendimit*).

23. Një trajtim i tillë i ngushtë i problemit më thelbësor në këtë çështje, duke u kufizuar thjesht në respektimin e nenit 108/2 të Kushtetutës, le jashtë vëmendjes atë që është më e rëndësishme në një shtet të së drejtës, respektimin e parimit të sovranitetit të popullit, që buron nga neni 2 i Kushtetutës.

24. Interpretimi gramatikor, por edhe logjik i nenit 108/2 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të Kushtetutës, nxjerr në pah se

ajo (Kushtetuta) mbron njësitë e qeverisjes vendore duke përcaktuar disa kritere për procesin e ndryshimit të kufijve administrativo – territorialë të këtyre komuniteteve. Pra, që të jetë e mundur ndarja administrative duhet të përmbushen dy kushte: ajo të mbështetet në interesat e përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike, si dhe të bazohet në mendimin e popullsisë që banon në to.

25. Për më tepër, pjesa e parë e fjalisë së dytë të dispozitës është mohuese kategorike *“kufijtë e njësive të qeverisjes vendore nuk mund të ndryshohen”*, i vetmi përjashtim është përcaktuar në pjesën e dytë të fjalisë, pra marrja më parë e mendimit të popullsisë që banon në to.

26. Parimi i mbrojtjes së kufijve territorialë të bashkësive vendore sanksionohet edhe nga neni 5 i Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, i cili përcakton: *“Për çdo ndryshim të kufijve territorialë vendorë, bashkësive vendore përkatëse duhet t’u merret mendimi paraprakisht, po qe nevoja, me anë referendumi, aty ku e lejon ligji”*.

27. Në këtë kuptim, për shkak të rëndësisë që kanë kufijtë administrativo- territorialë të njësive vendore, vlerësojmë se marrja e mendimit duhet të kryhet nëpërmjet një instrumenti sa më të përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës, i cili i përgjigjet edhe kriterit të parë të përcaktuar nga neni 108/2 i Kushtetutës (interesat e përbashkët ekonomikë dhe tradita historike). Harmonizimi i kërkesave të parashikuara nga nenet 2/2, 13 dhe 108/2 të Kushtetutës, sipas pikëpamjes tonë, arrihet vetëm nëpërmjet referendumit, si mënyra më demokratike për të pasqyruar vullnetin e popullsisë së interesuar. Mendojmë se referendumi, në rastin në shqyrtim ai konsultativ, duke qenë se siguron një votim të përgjithshëm, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë, është i vetmi mjet që përmbush më mënyrën më adekuate të gjitha kriteret kushtetuese.

28. Veç sa më sipër, jemi të mendimit se ndryshimi i kufijve ndikon në mënyrën e vetëqeverisjes së njësive të qeverisjes vendore, prandaj mbrojtja e tyre është në funksion edhe të garantimit të parimit të autonomisë vendore. Në këtë drejtim, paragrafi i dytë i nenit 108 duhet interpretuar në unitet me paragrafin e katërt të tij, i cili citon se *“vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore”*. Pra, edhe në respekt të autonomisë vendore, mënyra më e përshtatshme e vetëqeverisjes ushtrohet nëpërmjet referendumit vendor.

29. Në ndryshim nga shumica, vlerësojmë se metodat e ndjekura në rastin në shqyrtim, të tilla si: takimet dhe mbledhjet e hapura, seancat e këshillimit publik, dëgjesat publike, sondazhi kombëtar, si dhe mediat vizive dhe të shkruara, mund të jenë të rëndësishme gjatë procesit të diskutimit të projektligjit për ndarjen administrative territoriale, por finalizimi i këtij procesi duhet domosdoshmërisht të bëhet nëpërmjet referendumit, si e vetmja metodë që siguron marrjen e mendimit të popullsisë në respekt të parashikimeve kushtetuese. Prandaj, mospërdorimi i këtij mjeti përbën cenim të neneve 2/2, 13 dhe 108/2 të Kushtetutës nga ligji nr. 115/2014.

30. Edhe gjykatat kushtetuese evropiane janë investuar për mënyrën e marrjes së mendimit të popullsisë në çështjet e referendumeve administrative. Kështu, Gjykata Kushtetuese Italiane, në mënyrë të përsëritur, është vënë në lëvizje për të interpretuar termin "*pasi ka dëgjuar popullsitë e veta*", të parashikuar nga neni 133/2⁵ i Kushtetutës. Ajo ka theksuar se formulimi i këtij neni bën të qartë që në asnjë rast nuk mund të procedohet në mungesë të njërit prej kritereve të përcaktuara nga neni 133/2 i Kushtetutës, të cilat janë: ligji rajonal dhe referendumi konsultativ. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata Kushtetuese Italiane ka theksuar se "*është parim i konsoliduar i jurisprudencës së kësaj Gjykate që neni 133/2 i Kushtetutës, duke i atribuuar rajonit kompetencën që me ligj rajonal të krijojë në territorin e tij komuna të reja dhe të ndryshojë kufijtë dhe emërtimet e tyre, parashikon që të dëgjohen popullsitë e interesuara, gjë që passjell për rajonet me statut të zakonshëm, detyrimin që të procedojnë për realizimin e këtij qëllimi nëpërmjet referendumit*" (shih vendimet nr. 214/2010, nr. 237/2004, 47/2003, 279/1994, nr. 107/1983 dhe nr. 204/1981). Gjithashtu, në vendimin nr. 36/2011 ajo gjykatë është shprehur se përmbushja e "*dëgjimit të popullsisë të interesuara*", me anë të referendumit konsultativ, përbën një fazë të detyrueshme⁶ që duhet të ketë, në çdo rast, një evidencë të pavarur

5 Neni 133 citon: "Ndryshimi i territorit të provincës dhe krijimi i provincave të reja brenda një rajoni vendosen me ligje të Republikës, me nismën e komunave, pasi dëgjohe vetë rajoni.

Rajoni, pasi ka dëgjuar popullsitë e interesuara, mundet, me ligje të tij, të krijojë në territorin e vet komuna të reja dhe të ndryshojë territorin dhe emërtimet e tyre".

6 Gjykata është shprehur se nuk pranohen përjashtime edhe për ndonjë situatë që mund të konsiderohet si më pak e rëndësishme. Me fjalë të tjera, procedurat duhet të ndiqen (ligj rajonal dhe referendum) edhe kur ekziston një vullnet i përbashkët i organeve të komunave që përfshihen në ndryshimet territoriale (si ka ndodhur në rastin në shqyrtim nga GJK-ja – vendimi nr. 214/2010), ashtu edhe kur bëhet fjalë thjesht për një integrim të emërtimit origjinal të komunës, të kërkuar nga këshilli komunal, sepse edhe kjo passjell një ndryshim (si ka ndodhur në rastin e vendimit nr. 237/2004).

në procedurën e ndjekur”. Instituti i referendumit, në fakt, garanton “*nevojën e pjesëmarrjes së popullsisive të interesuara*” (vendimi nr. 279/2004) edhe thjesht për ndryshimin e territorit të komunave (vendimi nr.433/1995). Për pasojë ligjvënësi rajonal disponon në këtë fushë vetëm kompetencën që të rregullojë procedurën që passjell ndryshimin dhe në mënyrë të veçantë të përcaktojë kriteret eventuale për të identifikuar “popullsitë e interesuara” për referendum.

31. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese Sllovene, në vendimin nr. UI – 85/94, datë 20.05.1994, është shprehur se Kushtetuta e detyron ligjvënësin për të mbajtur referendum para themelimit të komunave të reja. Ndërsa në vendimin nr. UI- 183/94 të datës 09.11.1994 thekson se “*referendumet, në kuptim të nenit 139⁷ të Kushtetutë, pasqyrojnë vullnetin e banorëve në një zonë të caktuar... dhe se referendumi konsultativ është parashikuar në Kushtetutë, ndërsa përcaktimi përfundimtar i zonave të një komune i është lënë ligjvënësit*”.

32. Në këtë drejtim mendojmë se jo rastësisht si në formulimin e nenit 108/4 të Kushtetutës, ashtu edhe në atë të nenit 5 të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, ndërmjet shumë kritereve të njohura për marrjen e mendimit të popullsisë, përmendet në mënyrë specifike vetëm referendumi, pasi përveç sa më lart, ai është i vetmi instrument që lejon identifikimin e saktë të personave që marrin pjesë në proces, si dhe transparencën e plotë të tij (procesit).

33. Një parashikim të tillë e gjejmë edhe në nenin 7 të ligjit të vitit 2000 për administrimin dhe vetëqeverisjen vendore të Republikës së Kroacisë⁸, i cili përcakton se mendimi i banorëve për ndryshimet në territorin e një njësie vendore përbëhet nga deklaratat e dhëna nga banorët e një njësie të caktuar. Këto deklarata duhet të jenë të nënshkruara individualisht nga banorët, si dhe të përmbajnë datën dhe një numër identifikimi personal. Për këtë ligj Gjykata Kushtetuese Kroate, në vendimin nr. U-I-3226/2006 të datës 09.07.2008, është shprehur se ai kërkon në mënyrë të qartë dhe

7 Neni 139 (Komunat) citon: “Komunat janë komunitete që vetëqeverisen. Territori i komunës përfshin një zonë apo disa zona së bashku të lidhura nga nevojat e përbashkëta dhe interesat e banorëve. Një komunë përcaktohet me ligj, si dhe nga referendumi me anë të të cilit merret vullneti i banorëve në një territor të caktuar. Edhe territori i komunës përcaktohet me ligj”.

8 Në Republikën e Kroacisë njësitë e qeverisjes vendore sanksionohen në nenin 129 të Kushtetutës.

pa mëdyshje shprehjen e vullnetit të qytetarëve për ndryshimin e kufijve.

34. Për arsyet e mësipërme, mendojmë se me këtë vendim të shumicës Gjykata humbi një shans për të vendosur një standard kushtetues bashkëkohor lidhur me të drejtën e popullit për referendum.

35. Si përfundim, për shkak të ndryshimeve thelbësore që reforma administrativo-territoriale ka sjellë si në sasi (kufizimi drastik i numrit të njësive bazë të qeverisjes vendore), por edhe në cilësi (duke suprimuar njësinë më të vogël bazë, komunën), pa marrë më parë mendimin e popullsisë së interesuar nëpërmjet instrumentit të referendumit, si dhe të mungesës së konsensusit ndërmjet forcave politike në miratimin e ligjit, mendojmë se ligji nr. 115/2014 bie ndesh me nenet 2/2, 13, 82/2/f, 108/1, 108/2 dhe 116 të Kushtetutës.

Anëtarë: Gani Dizdari, Vladimir Kristo

II. Vendime të Kolegjit Zgjedhor



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**NR. 2/1 REGJ. THEMELTAR
DATË 16.12.2013 REGJ.**

**Nr. 1 VENDIMI
DATË 14.01.2015 VENDIMI**

**V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUES :	Edlira PETRI
ANËTAR :	Ilir TOSKA
ANËTAR :	Fuat VJERDHA
ANËTAR :	Kliton SPAHIU
ANËTAR :	Andi CIVICI

asistuar nga sekretarja Drita Ndoka, në seancën gjyqësore të datës 14.01.2015, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen zgjedhore, që u përket palëve :

PADITËSE : Partia Socialiste e Shqipërisë, e përfaqësuar me autorizim nga Z. Koli Bele, Z. Eridjian Salihanji dhe Z. Gledian Llatja.

I PADITUR : Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i përfaqësuar me autorizim nga Znj. Dëshira Pasko, Znj. Ana Tenolli dhe Z. Olsi Peto.

PERSONA TË INTERESUAR :

1. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Bujan;
2. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Pirg;
3. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Lis;
4. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Macukull;
5. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Ndroq;
6. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Shtiqën;
7. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Vergo;
8. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Gorë;
9. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Luz i Vogël;
10. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Golaj;
11. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Bubullimë;
12. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Fier Shegan;
13. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Tomin;
14. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Bashkinë Rubik;
15. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Qendër Malësi e Madhe;
16. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Lazarat;
17. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Shkrel;
18. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Kelmend;
19. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Vaqarr;
20. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Proptisht;

21. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Kastrat;
22. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Lunxhëri;
23. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Muhurr;
24. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Arras;
25. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Markat;
26. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Xarrë;
27. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Hysgjokaj;
28. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Pezë;
29. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Prezë;
30. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Zavalinë;
31. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Hotolisht;
32. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Mollas;
33. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Gjinar;
34. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Tregan;
35. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Gracen;
36. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Labinot Mal;
37. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Levan;
38. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Xhafzotaj;
39. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Zall-Herr;
40. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Fajza;

41. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Shënkoll;
42. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Ungrej;
43. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Vreshtas;
44. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Bërxull;
45. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Shllak;
46. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Trebisht;
47. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Ostren;
48. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Gjinaj;
49. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Fierzë-Elbasan;
50. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Rrasë;
51. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Kajan;
52. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Grekan;
53. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Derjan;
54. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Bërzhitë;
55. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Tërbuf;
56. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Mollas – Kolonjë;
57. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Melan;
58. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Kastriot;
59. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Guri i Zi;
60. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Dajc;

61. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Pojan;
62. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Cudhi;
63. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Bytyc;
64. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Bradashesh;
65. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Fshat Tropojë;
66. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Fierzë;
67. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Gjocaj;
68. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Shezë;
69. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Krrabë;
70. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Funarë;
71. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Thumanë;
72. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Shupenzë;
73. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Bashkinë Mamurras;
74. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Milot;
75. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Brataj;
76. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Bashkinë Fushë Krujë;
77. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Fushë-Cidhen;
78. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Ruzhdie;
79. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Tërthore;
80. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Dishnicë;

81. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Petran;
82. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Suke;
83. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Golem;
84. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Nikel;
85. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Strum;
86. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Dardhas;
87. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Udenisht;
88. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Cerravë;
89. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Bubq;
90. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Velcan;
91. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Bucimas;
92. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Shishtavec;
93. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Maqellarë;
94. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Surroj;
95. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Kolonjë;
96. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Dajt;
97. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Shëngjergj;
98. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Baldushk;
99. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Ksamil;
100. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Bicaj;

101. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Cakran;
102. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Topojan;
103. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Velipojë;
104. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Gosë;
105. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Kryevidh;
106. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Kashar;
107. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Farkë;
108. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Lekaj;
109. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Synej;
110. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Helmes;
111. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Luzni;
112. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Fratar;
113. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Paskuqan;
114. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Zall-Bastar;
115. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Petrelë;
116. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Rrethina;
117. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Ana-Malit;
118. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Postrinë;
119. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Pult;
120. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Vig-Mnelë;

121. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Përparim;
122. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Pajovë;
123. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Qendër Leskovik;
124. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Bashkinë Leskovik;
125. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Orosh;
126. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Fanë;
127. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Thellë;
128. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Otlak;
129. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Lumas;
130. Grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Vërtop;

të gjithë në mungesë;

131. Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar me autorizim nga Z. Oerd Bylykbashi, Z. Spiro Dodbiba dhe Z. Njazi Kosovrasti.

OBJEKTI : Shfuqizimi i vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi nismëtar për fillimin e procedurave, për zhvillimin e një referendumi vendor” në njësitë e qeverisjes vendore të grupeve përkatëse nismëtare, si vijon :

- | | | |
|-----------------------------|------------------------------|------------------------------|
| 1. nr. 110, datë 14.11.2014 | 34. nr. 126, datë 14.11.2014 | 67. nr. 26, datë 14.11.2014 |
| 2. nr. 111, datë 14.11.2014 | 35. nr. 127, datë 14.11.2014 | 68. nr. 27, datë 14.11.2014 |
| 3. nr. 112, datë 14.11.2014 | 36. nr. 128, datë 14.11.2014 | 69. nr. 56, datë 14.11.2014 |
| 4. nr. 113, datë 14.11.2014 | 37. nr. 137, datë 14.11.2014 | 70. nr. 104, datë 14.11.2014 |
| 5. nr. 114, datë 14.11.2014 | 38. nr. 136, datë 14.11.2014 | 71. nr. 105, datë 14.11.2014 |
| 6. nr. 138, datë 14.11.2014 | 39. nr. 54, datë 14.11.2014 | 72. nr. 94, datë 14.11.2014 |
| 7. nr. 140, datë 14.11.2014 | 40. nr. 82, datë 14.11.2014 | 73. nr. 95, datë 14.11.2014 |
| 8. nr. 139, datë 14.11.2014 | 41. nr. 81, datë 14.11.2014 | 74. nr. 96, datë 14.11.2014 |
| 9. nr. 43, datë 14.11.2014 | 42. nr. 80, datë 14.11.2014 | 75. nr. 97, datë 14.11.2014 |

10. nr. 83, datë 14.11.2014 43. nr. 135, datë 14.11.2014 76. nr. 131, datë 14.11.2014
 11. nr. 77, datë 14.11.2014 44. nr. 134, datë 14.11.2014 77. nr. 98, datë 14.11.2014
 12. nr. 75, datë 14.11.2014 45. nr. 87, datë 14.11.2014 78. nr. 99, datë 14.11.2014
 13. nr. 78, datë 14.11.2014 46. nr. 86, datë 14.11.2014 79. nr. 100, datë 14.11.2014
 14. nr. 160, datë 01.12.2014 47. nr. 85, datë 14.11.2014 80. nr. 101, datë 14.11.2014
 15. nr. 142, datë 14.11.2014 48. nr. 84, datë 14.11.2014 81. nr. 102, datë 14.11.2014
 16. nr. 141, datë 14.11.2014 49. nr. 118, datë 14.11.2014 82. nr. 103, datë 14.11.2014
 17. nr. 143, datë 14.11.2014 50. nr. 115, datë 14.11.2014 83. nr. 42, datë 14.11.2014
 18. nr. 144, date 14.11.2014 51. nr. 116, datë 14.11.2014 84. nr. 133, datë 14.11.2014
 19. nr. 146, date 14.11.2014 52. nr. 117, datë 14.11.2014 85. nr. 88, datë 14.11.2014
 20. nr. 145, date 14.11.2014 53. nr. 129, datë 14.11.2014 86. nr. 89, datë 14.11.2014
 21. nr. 147, date 14.11.2014 54. nr. 57, datë 14.11.2014 87. nr. 90, datë 14.11.2014
 22. nr. 148, datë 14.11.2014 55. nr. 59, datë 14.11.2014 88. nr. 91, datë 14.11.2014
 23. nr. 149, datë 14.11.2014 56. nr. 60, date 14.11.2014 89. nr. 132, datë 14.11.2014
 24. nr. 150, datë 14.11.2014 57. nr. 61, date 14.11.2014 90. nr. 92, datë 14.11.2014
 25. nr. 152, datë 14.11.2014 58. nr. 62, date 14.11.2014 91. nr. 93, datë 14.11.2014
 26. nr. 151, datë 14.11.2014 59. nr. 63, datë 14.11.2014 92. nr. 47, datë 14.11.2014
 27. nr. 76, datë 14.11.2014 60. nr. 65, datë 14.11.2014 93. nr. 48, datë 14.11.2014
 28. nr. 119, datë 14.11.2014 61. nr. 58, datë 14.11.2014 94. nr. 49, datë 14.11.2014
 29. nr. 121, datë 14.11.2014 62. nr. 106, datë 14.11.2014 95. nr. 50, datë 14.11.2014
 30. nr. 122, datë 14.11.2014 63. nr. 107, datë 14.11.2014 96. nr. 52, datë 14.11.2014
 31. nr. 123, datë 14.11.2014 64. nr. 130, datë 14.11.2014 97. nr. 51, datë 14.11.2014
 32. nr. 124, datë 14.11.2014 65. nr. 108, datë 14.11.2014 98. nr. 53, datë 14.11.2014
 33. nr. 125, datë 14.11.2014 66. nr. 109, datë 14.11.2014 99. nr. 36, date 14.11.2014
 100. nr. 37, date 14.11.2014 111. nr. 20, date 14.11.2014 121. nr. 24, datë 14.11.2014
 101, nr. 38, date 14.11.2014 112. nr. 66, date 14.11.2014 122. nr. 25, datë 14.11.2014
 102. nr. 39, date 14.11.2014 113. nr. 67, date 14.11.2014 123. nr. 28, datë 14.11.2014
 103. nr. 79, date 14.11.2014 114. nr. 68, date 14.11.2014 124. nr. 29, datë 14.11.2014
 104. nr. 40, date 14.11.2014 115. nr. 69, datë 14.11.2014 125. nr. 30, datë 14.11.2014
 105. nr. 41, date 14.11.2014 116. nr. 70, datë 14.11.2014 126. nr. 31, datë 14.11.2014
 106. nr. 74, date 14.11.2014 117. nr. 71, datë 14.11.2014 127. nr. 32, datë 14.11.2014
 107. nr. 55, date 14.11.2014 118. nr. 72, datë 14.11.2014 128. nr. 33, datë 14.11.2014
 108. nr. 44, date 14.11.2014 119. nr. 73, datë 14.11.2014 129. nr. 34, datë 14.11.2014
 109. nr. 45, date 14.11.2014 120. nr. 64, datë 14.11.2014 130. nr. 35, datë 14.11.2014
 110. nr. 46, date 14.11.2014

BAZA LIGJORE : Neni 23, pika 1, shkronja “a” i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); Neni 126, pika 2 dhe 5, neni 127, pika 1, neni 132, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

***Në përfundim të gjykimit, palët pjesëmarrëse i kërkuar
Kolegjit Zgjedhor :***

Pala paditëse Partia Socialiste e Shqipërisë, nëpërmjet përfaqësuesit të saj Z. Koli Bele: Gjykimin e çështjes në themel, pranimin e padisë dhe shfuqizimin e vendimeve të KQZ-së, objekt shqyrtimi;

Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësueses së tij, Znj. Dëshira Pasko : Rrëzimin e padisë;

Pala e interesuar, Partia Demokratike e Shqipërisë, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, Z. Spiro Dodbiba : Rrëzimin e kërkesëpadisë dhe pushimin e gjykimit.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoji pjesëmarrësit, shqyrtoi aktet dhe diskutoi çështjen në tërësi

V Ë R E N

Partia Socialiste e Shqipërisë ka depozituar pranë Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, 130 padi me të cilat ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi nismëtar për fillimin e procedurave, për zhvillimin e një referendumi vendor” në njësitë e qeverisjes vendore të grupeve përkatëse nismëtare, persona të interesuar në këtë proces.

Në seancat gjyqësore të zhvilluara në datë 08.01.2015, Kolegji Zgjedhor me vendim të ndërmjetëm ka vendosur bashkimin e të gjitha padive, në një gjykim të vetëm.

Kolegji Zgjedhor ka vendosur të lejojë pjesëmarrjen në proces si palë e interesuar të Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Në këto rrethana, në datë 14.01.2015, Kolegji Zgjedhor ka zhvilluar gjykimin e çështjes nga ku ka rezultuar sa vijon :

Grupet nismëtare për fillimin e procedurave, për zhvillimin e një referendumi vendor në njësitë e qeverisjes vendore, të pasqyruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi, kanë paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në vijim, KQZ) kërkesat respektive duke arsyetuar se :

- Kuvendi ka miratuar ndarjen e re territoriale të vendit, sipas së cilës territori i Republikës së Shqipërisë do të ndahet në 61 bashki, duke abroguar 373 njësitë e qeverisjes vendore ekzistuese (64 bashki dhe 309 komuna);
- E ashtuquajtura reformë territoriale, gjykuar si një proces me rëndësi të jashtëzakonshme themelore për organizimin dhe funksionimin e shtetit, u krye brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore, gjatë së cilës Komisioni Parlamentar dhe asnjë institucion tjetër, nuk ka kryer konsultime të mirëfillta me komunitetin, në kundërshtim me nenin 108, pika 2 të Kushtetutës;
- Ndryshimi i kufijve të njësisë përkatëse, duke e shkrirë me njësitë përreth dhe të tjera më larg, do të ketë një ndikim të jashtëzakonshëm në mbarëvajtjen e komunitetit. Pavarësisht vështirësive të procesit të decentralizimit, koncepti i demokracisë vendore dhe parimi i legjitimitetit të organeve të pushtetit vendor, që administrojnë pushtetin dhe ofrojnë shërbime, nëpërmjet zgjedhjeve, është konsoliduar tashmë. Një ndryshim i tillë i kufijve, përbën një çështje të rëndësisë së veçantë për popullsinë e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse, që pas më shumë se 22 vjetësh vetëqeverisje është konsoliduar si entitet kulturor, ekonomik, social i formësuar qartë dhe me tradita të konsoliduara.

Grupet nismëtare kanë argumentuar rëndësinë e çështjes, për të cilën kërkojnë fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit vendor, duke referuar në parimin e demokracisë vendore dhe të decentralizimit të pushtetit, të sanksionuara në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe në legjislacionin e miratuar me shumicë të cilësuar. Mbi bazën e këtyre parimeve, grupet nismëtare parashtrojnë se, edhe

organizimi e funksionimi i qeverisjes vendore, kompetencat e veta, sikundër dhe kufijtë e saj, janë hartuar dhe përcaktuar në mënyrë që të garantojnë administrim efikas dhe sa më pranë qytetarëve. Nisur nga formulimi i parimit të vetëqeverisjes, si e drejta dhe aftësia e organeve të qeverisjes vendore për të rregulluar dhe administruar pjesë të qenësishme të çështjeve publike nën autoritetin e tyre dhe në interes të komunitetit vendor, grupet nismëtare parashtrajnë se me “komunitet” nuk nënkuptohet çdo lloj agregimi i qytetarëve apo komuniteteve të popullsisë lokale të ndryshme. Sipas tyre, komuniteti lokal i qytetarëve përcaktohet nga tradita historike dhe kulturore të njëjta, interesa ekonomike dhe sociale të përbashkëta, të përcaktuara nga zhvillimi historik, ekonomik, kulturor, dhe rrethanat e kushtet gjeografike dhe infrastrukturore, siç sanksionohet edhe në nenin 108, pika 2 të Kushtetutës.

Po kështu, sipas grupeve nismëtare, ndërkohë që Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore, Kushtetuta dhe Ligji, garantojnë ushtrimin e pushtetit vendor sa më pranë popullatës, shkrirja e njësisë së qeverisjes vendore në një njësi më të madhe, e shkëput lidhjen e drejtpërdrejtë, vështirëson aksesin tek organet dhe mbledhjet e tyre, gati në pamundësi, për shkak të distancave dhe kostove, duke cenuar demokracinë vetëqeverisëse të komunitetit përkatës. Kjo gjë i largon organet që duhet të përfaqësojnë komunitetin dhe, duke qenë se nuk është kryer fare konsultimi me të, bie ndesh me Kartën dhe Kushtetutën.

Në vijim, grupet nismëtare parashtrajnë se çështja e shtruar është e rëndësishme, parë edhe në aspektin e mbledhjes dhe shpenzimit të të ardhurave nga taksat vendore. Sipas tyre, shkrirja e njësisë së qeverisjes vendore në një bashki shumë të madhe me komunitete të ndryshme, jo vetëm që nuk do të sigurojë që të ardhurat e nxjerra nga burimet e komunitetit ekzistues, të përdoren për të, por edhe për shkak të dobësisë së lidhjes së drejtpërdrejtë me organet e zgjedhura, llogaridhënia për përdorimin e këtyre burimeve, do të jetë e dobët. Për këtë arsye, grupet nismëtare parashtrajnë se pretendimi i Qeverisë dhe shumicës parlamentare, se me nismën e tyre që çoi në ndryshimin e kufijve të njësisë përkatëse, do të kursehen para, është sa i pabazuar në fakte dhe argumente, aq edhe në kundërshtim me parimet e Kartës dhe Kushtetutës, në bazë të të cilave këshilli (i komunës ose

i bashkisë) ka autoritetin e duhur, të dhënë me votën e komunitetit, që të përcaktojë taksat dhe nivelin e tyte, në mënyrë që të ushtrojë sa më mirë kompetencat ligjore në interes të popullatës.

Arsyet e sipërcituara nënvizojnë, sipas grupeve nismëtare, rëndësinë që ka për komunitetin çështja e ndryshimit të kufijve të njësisë, për shkak të mos kryerjes së asnjë konsultimi të qenësishëm me popullsinë, siç përcakton neni 108, pika 2 i Kushtetutës.

Grupet nismëtare në secilin rast parashtrajnë se kjo është një çështje shumë e rëndësishme, që shkon përtej tagrave të organeve vendore të zgjedhura, të cilat janë edhe në vitin e fundit të mandatit.

Në kushtet kur referendumi është një nga instrumentet ligjorë të marrjes së mendimit të popullsisë, si dhe kur Kushtetuta e përcakton referendumin, jo vetëm si një nga format e qeverisjes në nivel të përgjithshëm qendror, por edhe në nivel vendor, si forma më masive, tërësore, e drejtpërdrejtë, e fshehtë dhe e lirë, asnjë formë tjetër, pretendon grupet nismëtare, nuk mund të ketë vlerën konsultative që kërkon neni 108 i Kushtetutës. Për këtë arsye, duke vlerësuar se mos konsultimi me komunitetin në kuptim të Kushtetutës parashikohet si një kusht ndalues për rishikimin e kufijve të njësisë së qeverisjes vendore dhe kur referendumi është mënyra me të cilën duhet të ishte konsultuar komuniteti, grupet nismëtare parashtrajnë si domosdoshmëri që banorët e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, të shprehen për shkrirjen apo mos shkrirjen e saj, në kuadër të bashkisë së re, sipas ndarjes territoriale.

Kërkesat e grupeve nismëtare për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumeve vendore, janë shqyrtuar nga KQZ-ja, që me vendimet objekt padie, ka vendosur të miratojë kërkesën për pajisjen me fletën tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për referendum vendor për çështjen e qeverisjes vendore përkatëse, në të cilën është shtruar pyetja se: “A jeni dakord që Komuna/ Bashkia ... të shkrihet?”

Referuar si përmbajtjes së vendimeve të mësipërme, ashtu edhe procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së, rezulton se kjo e fundit, duke u bazuar pikën 4 të nenit 132, pikën 2 të nenit 126 dhe pikën 1 të nenit 127 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor në

RSH" (në vijim Kodi Zgjedhor/Referendumet), ka vlerësuar se duhet të kryejë verifikimin e faktit nëse nismëtarët që kanë depozituar kërkesën, janë zgjedhës të njësisë së qeverisjes vendore ku kërkohet të zhvillohet referendumi, si dhe t'i pajisë ata, kundrejt pagesës, me fletën-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme.

Mbi këtë bazë, KQZ-ja, pasi ka konstatuar, rast pas rasti, se nismëtarët janë zgjedhës në njësitë e qeverisjes vendore ku kërkohet të zhvillohet referendumi, referuar në nenin 127 të ligjit të sipërcituar, ka vlerësuar se duhet të pajisë grupin nismëtar me fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme.

Nga procesverbali i mbledhjes së KQZ-së rezulton se përfaqësuesi, pranë saj, i Partisë Socialiste të Shqipërisë ka kërkuar të mos pranohen kërkesat e nismëtarëve, për këto arsye :

1. njësia e qeverisjes vendore ku kërkohet të zhvillohet referendumi nuk ekziston më si e tillë, referuar ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë";
2. të drejtën për shfuqizim të ligjit me referendum, sipas nenit 150 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e kanë 50 mijë shtetas, pra nëpërmjet referendumit të përgjithshëm dhe referendumet e kërkuara cenojnë kështu ligjin;
3. vetë KQZ-ja në praktikën e saj ka rrëzuar kërkesat për referendume vendore, në ato raste kur kërkohet shfuqizimi i ligjit, siç është edhe rasti konkret, kur kërkesa ndonëse nga pikëpamja formale bëhet për një referendum vendor, në thelb synon shfuqizimin e ligjit për Ndarjen Territoriale.

Kolegji Zgjedhor konstaton se pretendimet e parashtruara si më sipër, gjatë shqyrtimit të çështjes nga KQZ-ja, nuk rezulton të kenë gjetur pasqyrim dhe marrë një përgjigje në vendimet e saj objekt shqyrtimi.

Në kushtet e mësipërme, pala paditëse i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, me një kërkesë, me objekt shfuqizimin e vendimeve të

KQZ-së. Pala paditëse e ka konsideruar vendimin e KQZ-së të marrë në zbatim të gabuar të ligjit (*Kodit Zgjedhor/Referendumet*), duke parashtruar se :

1. KQZ-ja nuk ka bërë një vlerësim të thelbit të kërkesës së grupit nismëtar. KQZ-ja është mjaftuar me vlerësimin e faktit që ka të bëjë me qenien e nismëtarëve, zgjedhës dhe banorë të njësisë së qeverisjes vendore, ç'ka është konsideruar si e mjaftueshme për të vendosur pranimin e kërkesës dhe pajisjen e nismëtarëve me fletën-tip, që përmban pyetjen (çështjen) që do të shtrohet në referendum. Në lidhje me këtë çështje (verifikimin e nismëtarëve) pala paditëse parashtron në padi se nuk ka asnjë pretendim.
2. Referuar në nenin 132, pika 4 të ligjit nr. 9087/2003 (*Kodi Zgjedhor/Referendumet*) rezulton se për referendumin vendor nuk ka një rregullim të posaçëm, dhe se shqyrtimi i një kërkesë me objekt të tillë bëhet duke iu referuar neneve 126, 127 dhe 128 të këtij ligji. KQZ-ja ka pranuar kërkesën, duke u mjaftuar vetëm me përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në nenin 126, pika 2 të Kodit Zgjedhor/Referendumet.
3. Sipas pikës 5 të nenit 126 rezulton që KQZ-ja duhet të verifikojë edhe (i) nëse çështja është e përcaktuar qartë; (ii) nëse kërkesa ka treguar/përshkruar rëndësinë e çështjes. KQZ-ja duhet të verifikojë dhe të shprehet nëse çështja, apo pyetja, që duhet të shtrohet për referendum është e plotë dhe pa ekuivoke, si dhe të jetë e tillë që zgjedhësit ti përgjigjen lehtësisht me “PO” ose me “JO”. Në fakt rezulton se KQZ-ja nuk ka bërë asnjë vlerësim, qoftë edhe formal të këtyre aspekteve të kërkesës së nismëtarëve, duke mos përmbushur një detyrim ligjor që lidhet me verifikimin dhe kontrollin ligjor të kërkesës për zhvillimin e referendunit vendor.
4. Përmbushja e kërkesave të ligjit prej grupit nismëtar, bën të domosdoshëm ushtrimin e kontrollit ligjor nga një autoritet i caktuar, për më tepër në fazën në të cilën ndodhet procesi, që sapo ka filluar dhe nuk ka përfunduar. I vetmi organ që mund të kontrollojë përmbushjen e këtyre urdhërimeve ligjore,

është KQZ-ja. Qëllimi i ligjvënësit nuk është përfshirja e zgjedhësve në një procedurë të mbledhjes së nënshkrimeve, pa verifikuar më parë nëse kjo procedurë e nisur dhe kërkesa e paraqitur, është ose jo në përputhje me nenin 126, pika 5, siç do të ishin rastet kur pyetja e shtruar nuk do të ishte e qartë, ose nuk do të kishte lidhje me përcaktimet e Kushtetutës dhe Kodit Zgjedhor/Referendumet, lidhur me të drejtën e qytetarëve për të zhvilluar referendum vendor.

5. Vendimi i marrë nga KQZ-ja, në këtë rast, ashtu si çdo vendim i marrë prej saj në ushtrim të pushtetit të vet, nuk mund të mbetet jashtë kontrollit gjyqësor. Nëse nuk arrihet të realizohet kontrolli ligjor mbi vendimmarrjen e KQZ-së, e cila vlerësohet në kundërshtim me ligjin, atëherë gjithë veprimtaria e këtij organi, që ka për detyrë të parandalojë vijimin e mëtejshëm të procedurave që nuk respektojnë urdhërimet e ligjit, do të mbetet jashtë kontrollit gjyqësor. Kontrolli që ushtrohet nga Kolegji Zgjedhor ndaj vendimit të marrë nga KQZ-ja, sipas nenit 126 të Kodit Zgjedhor 2003, është kontrolli që vlerëson përmbushjen e të gjithë elementëve që parashikohen në nenin 126 pika 5. Në rast se ky kontroll nuk do të realizohej nga Kolegji Zgjedhor, atëherë një vendimmarrje e tillë do të mbetet jashtë kontrollit gjyqësor. Në këtë aspekt është e nevojshme të bëhet dallimi midis kontrollit ligjor që ushtrojnë KQZ dhe, më tej Kolegji Zgjedhor, nga kontrolli që ushtron Gjykata Kushtetuese, lidhur me verifikimin e kushtetutshmërisë së çështjes që shtrohet për referendum.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, përfaqësuesi i palës paditëse, në mbështetje të argumenteve të tij, paraqiti edhe dy vendime të KQZ-së e konkretisht :

1. Vendimi nr. 1876, datë 26.10.2007 “Për shqyrtimin e kërkesës të paraqitur nga Këshilli i Bashkisë Vlorë, për organizimin e referendumit vendor “Për lejimin ose jo të ndërtimit të kompleksit të depozitave të naftës dhe terminalit e anijeve naftëmbajtëse (projekti La Petrolifera), brenda territorit të Bashkisë Vlorë”.

2. Vendimi nr. 26, datë 28.09.2010 “Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi nismëtar, për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi për një çështje të rëndësisë së veçantë “A doni të rinumërohen fletët e votimit të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009?”.

Pala paditëse, në referim të vendimeve të mësipërme, parashtroi se KQZ-ja në këto raste, analoge me atë në shqyrtim, ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga vendimi objekt padie, në drejtim të kufijve të kompetencave të saj, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së kërkesës për referendum vendor.

Në vendimin nr. 1876, datë 26.10.2007, KQZ-ja, pasi ka verifikuar se kërkesa është në përputhje me nenin 132, pika 2 të Kodit Zgjedhor, lidhur me të drejtën për të kërkuar referendum vendor, arsyeton se : “Për sa i përket kërkesës që parashikon neni 132, pika 2 e Kodit Zgjedhor nëse çështja për të cilën Këshilli i Bashkisë Vlorë kërkon të merret mendimi i komunitetit të Qarkut Vlorë, duhet të jetë një çështje që i përket qeverisjes vendore në nivel Qarku u shqyrtuan të gjitha aktet e depozituara nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se miratimi për ndërtimin e kompleksit të depozitave të naftës dhe terminalin e anijeve naftëmbajtëse (projekti La Petrolifera), brenda territorit të Bashkisë Vlorë është bërë me Vendime të Këshillit të Ministrave, me Vendimet përkatëse të KRRTRSH dhe, për më tepër, Marrëveshja e Koncesionit ... është ratifikuar me ligjin nr. 9231, datë 13.05.2004 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Aktet ligjore dhe nënligjore të mësipërme shprehin qartë se çështja për të cilën kërkohet referendum në nivel Qarku nuk është çështje e qeverisjes vendore. Nuk ka asnjë vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë apo të organeve të tjera të qeverisjes vendore në nivel bashkie apo qarku. Vepra që është miratuar për ndërtim ka karakter kombëtar dhe jo vendor, sepse është miratuar me ligj dhe me akte të qeverisjes qendrore dhe jo me akte të qeverisjes vendore. Gjithsesi ligjet nuk shfuqizohen me referendume lokale. Vetëm në bazë të nenit 150 pika 2 të Kushtetutës një ligj mund t'i nënshtrohet një referendumi të përgjithshëm ... nuk mund të organizohet referendum lokal për kundërshtimin ose jo të ndërtimit të një objekti të miratuar me ligj.

Në këto kushte kërkesa duhet rrëzuar si e pabazuar në ligj dhe në kushtetutë dhe KQZ nuk mund të organizojë një referendum të tillë.”

Në vendimin nr. 26, datë 28.09.2010, në shqyrtimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi për një çështje të rëndësisë së veçantë, (ku është shtruar pyetja se “A duhet të rinumërohen fletët e votimit të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009?”), KQZ-ja ka vënë në diskutim llojin e referendumit që kërkohej nga grupi nismëtar (për shfuqizimin e një ligji apo për një çështje të rëndësisë së veçantë). KQZ arsyeton në këtë rast se : “... Rinumërimi i fletëve të votimit të zgjedhjeve dhe destinacioni i fletëve të votimit pas përfundimit të procesit zgjedhor, është një proces i cili është i trajtuar dhe rregulluar me ligj (Kodi Zgjedhor i RSH). Për këtë arsye pyetja që grupi nismëtar kërkon të shtrojë në referendum “A doni të rinumërohen fletët e votimit të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009? Po/Jo” është një pyetje e cila pa mëdyshje, të çon në përfundimin se jemi para një çështje që zgjidhet me referendum për shfuqizimin e një ligji dhe jo me referendum për një çështje të rëndësisë së veçantë. Duke menduar se pyetja që kërkohet të shtrohet është formalisht për një lloj referendumi, ndërsa në praktikë synohet një lloj tjetër referendumi, KQZ arrin në përfundimin se kërkesa nuk është korrekte ligjërisht dhe vendos në pamundësi KQZ për të hartuar fletën tip për mbledhjen e nënshkrimeve. ...”.

Në prapësim të pretendimeve të parashtruara nga pala paditëse, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar nga Kolegji Zgjedhor të rrëzojë padinë, për këto arsye :

- KQZ-ja, në mbështetje të neneve 132, pika 4; 126, pika 2 dhe 127, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003, verifikoi nëse nismëtarët e depozitimit të kërkesës, ishin zgjedhës të Komunës përkatëse, dhe e pajisi grupin nismëtar, kundrejt pagesës, me fletën-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme;
- në bazë të këtyre dispozitave (neni 132, pikat 1 dhe 4; neni 126, pika 2), KQZ-ja në shqyrtimin e kërkesës, ka kompetencë vetëm verifikimin e legjitimitetit të kërkuarit, pra verifikimin nëse nismëtarët janë 12 zgjedhës të njësisë vendore për të cilën kërkohet referendumi;

□ pretendimi se KQZ-ja duhet të verifikojë ligjshmërinë e kërkesës në përputhje me pikën 5 të nenit 126, është i pabazuar, pasi (ashtu si edhe vetë pala paditëse referon në rregullimin ligjor, sipas të cilit për referendumet vendore zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat që rregullojnë referendumin e përgjithshëm), në nenin 129, pika 2 parashikohet se është Gjykata Kushtetuese, e cila vendos për kushtetutshmërinë e kërkesave për referendum të përgjithshëm dhe nëse ato janë formuluar në përputhje me pikat 3 dhe 5 të nenit 126. KQZ-ja nuk mund të shqyrtojë dhe të vlerësojë objektin e kërkesës, shqyrtimi i të cilës është në kompetencë të një organi tjetër;

□ në çdo rast KQZ-ja, pas verifikimit të nismëtarëve si zgjedhës të njësisë së qeverisjes vendore, do t'i pajiste ata me fletën-tip, pasi kufizimet në të drejtën për referendum parashikohen në nenin 151, pika 2 të Kushtetutës dhe sipas nenit 152, pika 1, kompetencën për shqyrtimin e kërkesës në përputhje me nenin 152, pika 2 të Kushtetutës, e ka një organ tjetër që është Gjykata Kushtetuese;

□ paditësi pretendon kontrollin gjyqësor në lidhje me vendimmarrjen e KQZ, pasi duhet të parandalohet vijimi i mëtejshëm i procedurave që nuk respektojnë urdhërimet e ligjit, pa përmendur në ankim, se çfarë procedurash të mëtejshme do të parandaloheshin nga kundërshtimi i këtij vendimi të KQZ-së, ose cilat janë pasojat që do të sjellë shfuqizimi i këtij vendimi;

□ KQZ-ja, në zbatim të vendimeve objekt ankimi, ka pajisur grupet nismëtare me numrin e nevojshëm të fletëve-tip, të cilët kanë mbledhur nënshkrimet e nevojshme, duke depozituar në KQZ 125 kërkesa, së bashku me nënshkrimet e zgjedhësve për zhvillimin e referendumeve vendore. KQZ-ja është duke kryer verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit dhe brenda afateve ligjore po përgatitet për vendimmarrjen përkatëse, në lidhje me këto kërkesa.

Partia Demokratike e Shqipërisë, si palë e interesuar në proces, ka kërkuar së pari rrëzimin e kërkesës dhe pushimin e çështjes, për këto shkaqe procedurale :

□ padia objekt gjykimi, në aspektin formal, rezulton me të meta, pasi referuar nenit 153, pika 1, shkronja “c” të Kodit Zgjedhor, ndër-gjyqësia nuk është e saktë për shkak të mos thirrjes si palë e interesuar në proces, të Partisë Demokratike. Kjo e metë duhej të konstatohej nga gjykata dhe të kërkohej rregullimi i saj përpara shqyrtimit gjyqësor (neni 154, pika 3, shkronja “b” i Kodit Zgjedhor), gjë që nuk ka ndodhur;

□ padisë i mungon baza ligjore, lidhur me të drejtën e Partisë Socialiste për të ankimuar këtë vendim të KQZ-së. Prandaj kjo padi nuk mund të ngrihet për mungesë të legjitimitetit aktiv të palës paditëse. E drejta që diskutohet në rastin konkret është shprehja me referendum, të cilën ligji ua ka njohur vetëm zgjedhësve, ndërkohë që Partia Socialiste nuk ka arritur të argumentojë se cili është interesi i saj i ligjshëm dhe ku është cenuar ky interes nga vendimmarrja e KQZ-së. Lidhja e drejtpërdrejtë mes interesit të ligjshëm dhe objektit të ankimit, sanksionohet si në ligje me karakter të përgjithshëm, si Kodi i Procedurës Civile, Kodi i Procedurave Administrative, por edhe në ligjin specifik, nenin 145 i Kodit Zgjedhor. Interesi i ligjshëm lidhet me të drejtën që mbart ankuesi dhe që materializohet në ligjin material, e cila në rastin konkret u përket zgjedhësve.

Në lidhje me themelin, Partia Demokratike e Shqipërisë ka parashtruar se ankimi nuk duhet të pranohet për këto arsye :

□ e drejta për të kërkuar mbajtjen e një referendumi vendor është e drejtë ekskluzive e banorëve të njësisë vendore dhe ligji ka parashikuar kontrollin e ligjshmërisë së kërkesës nga ana e KQZ-së, vetëm nga pikëpamja formale, ashtu si Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë kushtetutshmërinë apo jo të çështjes për referendum. Në këtë kuptim, rezulton se vendimmarrja dhe procedura e ndjekur nga KQZ-ja duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e nenit 127, 128 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003, të cilat janë te vetmet dispozita që përcaktojnë në mënyrë taksative dhe urdhëruese veprimet që kryen KQZ-ja;

□ ndërkohë që KQZ-ja kryen kontrollin formal të kërkesave për referendum, kontrolli kushtetues i është lënë, si një e drejtë ekskluzive, vetëm Gjykatës Kushtetuese, e cila referuar edhe nenit

129 të Kodit Zgjedhor/Referendumet, kontrollon zbatueshmërinë e nenit 126, pika 5 të Kodit Zgjedhor/ Referendumet. Në këtë mënyrë, KQZ-ja nuk mund të marrë atributet e Gjykatës Kushtetuese dhe të kontrollojë kushtetutshmërinë ose jo të kërkesës, si dhe kontrollin ligjor substancial të saj;

□ KQZ-ja në vendimmarrjen e saj ka verifikuar se nismëtarët janë zgjedhës të njësive të qeverisjes vendore ku kërkohet të zhvillohen referendumet. Gjithashtu, në kërkesën drejtuar KQZ-së, nismëtarët përshkruajnë bazueshmërinë ligjore dhe rëndësinë e saj, qëndrimin e tyre, pyetjen që shtrohet dhe mënyrën e përgjigjes vetëm me “PO” ose “JO”. Pra, në kuptimin formal, kërkesat mbartin të gjithë elementët e kërkuar nga ligji dhe, për këtë arsye, KQZ-ja nuk ka konstatuar *prima facie* mungesë të elementëve dhe nuk ka urdhëruar korrigjimin e tyre, ndërsa kontrolli kushtetues substancial i këtyre elementëve nuk është në kompetencën e KQZ-së;

□ kërkesat për referendum nuk synojnë shfuqizimin e ndonjë ligji, por kërkojnë të marrin opinionin e komunitetit për një çështje të rëndësishme të veçantë, përfundim në të cilin ka arritur edhe KQZ-ja, duke mos u mohuar zgjedhësve të drejtën për të organizuar një referendum, që sanksionohet në ligj dhe Kushtetutë.

Kolegji Zgjedhor, për shqyrtimin e mosmarrëveshjes zgjedhore të paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë, i referohet kuadrit kushtetues dhe ligjor. Konkretisht :

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 2 (pikat 1 dhe 2)

“1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit.
2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti.”

Neni 13

“Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore.”

Neni 108

- “1. Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj.
2. Ndarjet administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike. Kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa u marrë me parë mendimi i popullsisë që banon në to.
3. Komuna dhe bashkia janë njësi bazë të qeverisjes vendore. Ato kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisese, me përjashtim të atyre që me ligj u jepen njësive të tjera të qeverisjes vendore.
4. Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore. Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit vendor parashikohen me ligj në përputhje edhe me nenin 151 paragrafi 2.”

Neni 124

- “1. Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj.
2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.”

Neni 131 (shkronja “ë”)

“Gjykata Kushtetuese vendos për:

...

ë) kushtetutshmerinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij;”

Neni 151 (pika2)

“2. Çështjet që lidhen me tërësinë territoriale të Republikës së Shqipërisë, me kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, me buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit, me vendosjen dhe heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme, me deklarin e luftës dhe të paqes dhe me amnistinë nuk mund të shtrohen në asnjë referendum.”

Neni 152 (pikat 1 dhe 2)

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum sipas nenit 150 paragrafët 1 e 2, nenit 151 paragrafët 2 e 3 edhe sipas nenit 177 paragrafët 4 e 5 brenda 60 ditëve.

2. Rëndësia e çështjeve të veçanta, të parashikuara në nenin 150 paragrafët 1 e 2 nuk është objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese.”

KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

I miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 74/2012

Neni 1 : Qëllimi dhe objekti

“1. Ky Kod ka për qëllim caktimin e rregullave për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe **referendumet**. ...”

Neni 2 : Përkufizime

“Në këtë Kod termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

...

18. “Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve” është rezultati i shpallur nga KQZ-ja, në përputhje me këtë Kod dhe që përfshin:

...

ç) rezultatin e votimit për çdo alternativë në **referendum**, sipas dispozitave të këtij Kodi.

...

23. “Zgjedhje” janë votimet për Kuvendin, për njësitë e qeverisjes vendore dhe **referendumet**.

Neni 145 : E drejta e ankimit në gjykatë

“1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. ...”

Neni 152 : Afati i ankimit në gjykatë

1. Ankimet, sipas këtij Kodi, paraqiten në Gjykatën e Apelit, Tiranë, e cila ia kalon ato Kolegjit Zgjedhor.

2. Ankimi për të gjitha vendimet që KQZ-ja merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tyre. Për vendimet që KQZ-ja merr jashtë kësaj periudhe, afati i ankimit në Kolegjin Zgjedhor është 30 ditë.”

Neni 185 : Shfuqizime

“1. Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, ligji nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe çdo akt tjetër ligjor ose nënligjor, që bie në kundërshtim me të, shfuqizohet.

2. Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në pikën 1 të këtij neni, pjesa e nëntë “Referendimet” e ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe çdo pjesë e dispozitave të tij që ka lidhje me të mbetet në fuqi deri në miratimin e ligjit të ri për referendimet e përgjithshme dhe vendore. Administrimi i procesit të referendumeve dhe nxjerrja e rezultatit të tyre bëhen në përputhje me këtë Kod.”

KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË **I miratuar me ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003**

Neni 1 : Qëllimi i këtij Kodi

“Ky Kod ka për qëllim përcaktimin e rregullave:

...

e) për zhvillimin dhe vlefshmërinë e referendumeve; ...”

Neni 2 : Përkufizime

“...

19. “Referendum kushtetues” është referendumi, që zhvillohet sipas pikës 4 ose 5 të nenit 177 të Kushtetutës.

20. “Referendum i përgjithshëm” është referendum, që zhvillohet sipas nenit 150, 151 dhe 152 të Kushtetutës.

21. “Referendum vendor” është referendum, që zhvillohet sipas pikës 4 të nenit 108 të Kushtetutës.

...

34. “Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve” është rezultati i shpallur nga KQZ-ja dhe që përfshin:

...

c) rezultatin e votimit në referendum, sipas dispozitave të pjesës së nëntë të këtij Kodi.”

PJESA E NENTE REFERENDUMET

Neni 118 : Kuptimi i referendumit

1. Referendumi është ushtrimi i drejtpërdrejtë i sovranitetit të popullit, nëpërmjet votimit, për një çështje ose një ligj të caktuar, sipas neneve 108 pika 4, 150, 151, 152 dhe 177 të Kushtetutës. ...”

Neni 126 : Nisma për referendum të përgjithshëm

“1. Pesëdhjetë mijë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve kanë të drejtën e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e një ligji, si dhe t’i kërkojnë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë, në përputhje me pikën 1 të nenit 150 të Kushtetutës, si dhe me dispozitat e këtij Kodi.

2. Kërkesa për fillimin e procedurave të referendumit paraqitet në KQZ nga një grup prej jo më pak se 12 nismëtarësh, të cilët janë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve.

3. Kërkesa për shfuqizimin e një pjese të ligjit pranohet vetëm kur pjesa tjetër e ligjit është e vetëmjaftueshme.

4. Kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për shfuqizimin e një ligji ose të një pjese të tij, përmban:

a) titullin, numrin dhe datën e miratimit të ligjit që kërkohet të shfuqizohet, si dhe në qoftë se kërkohet të shfuqizohet vetëm një pjesë e ligjit, dispozitat përkatëse;

b) arsyet përse ligji ose dispozita të veçanta të tij duhen shfuqizuar.

5. Kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për një çështje të një rëndësie të veçantë duhet të përshkruajë qartë çështjen që shtrohet, rëndësinë e saj si dhe qëndrimin e nismëtarëve në lidhje me atë çështje. Çështja duhet të formulohet në mënyrë të qartë, të plotë dhe pa ekuivoke dhe në mënyrë të tillë që zgjedhësit të mund të përgjigjen me “PO” ose “JO”.

Neni 127 : Fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve

“1. KQZ-ja, brenda 20 ditëve nga paraqitja e kërkesës për referendum të përgjithshëm, pajis grupin nismëtar kundrejt pagesës me fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të 50 mijë zgjedhësve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve në kohën e paraqitjes së kërkesës. Në krye të fletës-tip shtypet titulli i ligjit, dispozitat që kërkohen të shfuqizohen ose çështja që shtrohet në referendum.

2. Nënshkrimet në mbështetje të kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm depozitohen në KQZ në periudhën nga 1 janari deri më 30 nëntor të çdo viti.”

Neni 128 : Verifikimi i kërkeses nga KQZ-ja

“1. KQZ-ja verifikon nënshkrimet dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të zgjedhësve, në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra prej saj.

2. KQZ-ja vendos për pranimin ose mospranimin e kërkesës brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së saj, duke e bazuar vendimin vetëm mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur. Vendimi u njoftohet menjëherë nismëtarëve. Vendimi për mospranimin e kërkesës duhet të përcaktojë qartë shkaqet e mospranimit.

3. Brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit, grupi nismëtar mund t'i deklarojë KQZ-së se është i gatshëm të korrigjojë parregullsitë e vërejtura. Në këtë rast, KQZ-ja cakton një afat deri në 30 ditë për riparaqitjen e kërkesës. KQZ-ja vendos brenda 10 ditëve për pranimin ose jo të kërkesës së riparaqitur dhe i njofton menjëherë nismëtarët.”

“1. Dhjetë për qind e zgjedhësve të regjistruar në listat e zgjedhësve të komunës ose bashkisë ose 20 mijë prej tyre, cilado shifër të jetë më e vogël, kanë të drejtën e referendumit vendor për një çështje të qeverisjes vendore në bashkinë ose komunën përkatëse.

2. Një numër këshillash bashkiake ose komunale, që përfaqësojnë jo më pak se një të tretën e popullsisë së një qarku, kanë të drejtë të kërkojnë zhvillimin e një referendumi për një çështje të qeverisjes vendore në nivel qarku.

3. Referendumi për të njëjtën çështje nuk mund të përsëritet në të njëjtën njësi të qeverisjes vendore pa kaluar tre vjet nga zhvillimi i tij.

4. Për zhvillimin e referendumit vendor zbatohen, për aq sa është e mundur ose e nevojshme, dispozitat e parashikuara për referendumin e përgjithshëm në pikat 2 dhe 5 të nenit 126, nenin 127 dhe në pikën 2 të nenit 128 të këtij Kodi.”

Referuar fakteve të vërtetuara, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve në proces, si dhe bazës kushtetuese dhe ligjore të zbatueshme, Kolegji Zgjedhor vuri në diskutim çështjet e mëposhtme:

1. Në lidhje me pretendimin e parashtruar nga Partia Demokratike e Shqipërisë mbi të metat e padisë, objekt shqyrtimi, Kolegji Zgjedhor e gjen atë të pabazuar në ligj.

Sipas këtij pretendimi, duke referuar në nenin 153 të Kodit Zgjedhor titulluar “Forma dhe përmbajtja e ankimit”, në shkronjën “c” të pikës 1, të tij, parashikohet edhe detyrimi i ankuesit (paditësit) për të treguar palët e interesuara, të cilat sipas këtij parashikimi ligjor janë palët pjesëmarrëse në shqyrtimin administrativ pranë KQZ-së. Duke qenë se në rastin konkret, pala paditëse ka përcaktuar në padinë e saj, si palë të interesuara, grupet nismëtare për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumeve vendore dhe nuk ka treguar se palë e interesuar është edhe Partia Demokratike e Shqipërisë, kjo e fundit ka pretenduar se ankimi/padia rezulton me

të meta dhe se gjykata duhej që me paraqitjen e saj, të kërkonte plotësimin e padisë, konform nenit 154, pika 2, shkronja “b” të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, kompetenca e të cilit konsiston në ushtrimin e kontrollit gjyqësor të vendimeve të KQZ-së, mban parasysh se mbledhjet e KQZ-së janë kurdoherë publike (neni 22.7 i Kodit Zgjedhor) dhe se njoftimi për mbledhjen dhe rendin e saj, jo vetëm që njoftohen publikisht, por partitë parlamentare siç është Partia Demokratike e Shqipërisë, njoftohen posaçërisht nga KQZ-ja. Në këtë mënyrë Kodi Zgjedhor u garanton, si palëve që kanë iniciuar një shqyrtim administrativ pranë KQZ-së, ashtu edhe subjekteve të tjera të interesuara, të marrin pjesë në mbledhjet që zhvillohen, për të shfaqur opinionin e tyre mbi çështjen që shqyrtohet.

Në rastin konkret, rezulton se objekt shqyrtimi kanë qenë kërkesat e grupeve nismëtare për zhvillimin e referendumeve vendore.

Referuar elementëve të ankimit pranë Kolegjit Zgjedhor, përcaktuar në nenin 153 të Kodit Zgjedhor, pavarësisht interesit të Partisë Demokratike të Shqipërisë lidhur me çështjen, e për të cilin ky Kolegj e pranoi kërkesën për të marrë pjesë në gjykim si palë e interesuar, rezulton se në momentin e paraqitjes së padisë, referuar vendimeve respektive të KQZ-së bashkëlidhur kërkesëpadive, ky subjekt nuk është evidentuar si pjesëmarrës në shqyrtimin administrativ të KQZ-së, përfshirë dhe paraqitjen e qëndrimit të tij mbi këto kërkesa. Duke qenë se në momentin e paraqitjes së kërkesëpadive, bashkëlidhur të cilave kanë qenë vendimet e KQZ-së, nuk rezultonte që Partia Demokratike e Shqipërisë të kishte qenë pjesëmarrëse në këto shqyrtime administrative, Kolegji Zgjedhor nuk e kishte mundësinë objektive për të verifikuar edhe këtë aspekt të procesit. Në këto rrethana, Kolegji Zgjedhor vlerëson se e ka patur objektivisht të pamundur të konsideronte në momentin fillestar të paraqitjes së kërkesëpadive pasjen, edhe të palëve të tjera të interesuara, ndërkohë që me ardhjen në dijeni të këtij fakti, sipas kërkesës së paraqitur përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor nga përfaqësuesit e Partisë Demokratike të Shqipërisë, por dhe akteve dokumentare të paraqitura nga KQZ-ja përpara seancës gjyqësore, vendosi të lejojë pjesëmarrjen në gjykim të kësaj partie parlamentare si palë e interesuar në gjykim.

2. Legjitimiteti i palës paditëse, Partia Socialiste e Shqipërisë, për të kundërshtuar vendimet e KQZ-së.

Subjekti i interesuar Partia Demokratike e Shqipërisë ka parashtruar se pala paditëse nuk legjitimohet për të paraqitur ankim, pasi nuk ka treguar dhe as provuar interesin e saj të ligjshëm, për të kundërshtuar vendimet e KQZ-së për pranimin e kërkesave të grupeve nismëtare për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumeve vendore.

Referuar nenit 145 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit ankimi në Kolegjin Zgjedhor, bëhet nga subjektet që kundërshtojnë vendimin e KQZ-së, që cenon interesat e tyre të ligjshëm, Kolegji shtroi për diskutim çështjen mbi legjitimitimin e Partisë Socialiste të Shqipërisë për të kundërshtuar vendimin e KQZ-së, lidhur me kërkesat për referendum.

Partitë politike kanë në misionin e tyre, ndikimin në jetën e vendit, nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimin e popullit, duke marrë pjesë në formimin e vullnetit të tij politik në të gjitha fushat e jetës publike dhe duke u konsideruar si pjesë e sistemit demokratik (*Shih ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike"*). Në këtë kontekst, çdo parti politike mbarë në vetvete interesin e saj në çështjet politike të vendit, duke përfshirë këtu edhe çështjet që lidhen me ushtrimin nga populli të sovranitetit të drejtpërdrejtë, nëpërmjet zgjedhjeve për referendum. Procesi për iniciimin dhe zhvillimin e referendumit, nuk mundet për rrjedhojë të mbetet jashtë interesit të ligjshëm të partive politike, në kuptim të rolit dhe misionit të tyre në një demokraci kushtetuese. Vetë Kodi Zgjedhor që në nenin 1 ka sanksionuar se qëllimi dhe objekti i tij është caktimi i rregullave "për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet", si dhe në pikën 23 të nenit 2, "Zgjedhje" janë votimet për Kuvendin, për njësitë e qeverisjes vendore dhe referendumet.". Nga referimi që i bëhet të gjithë dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe mënyrës se si administrohet procesi për referendumin, rezulton se partia politike është një subjekt përcaktues. Për vetë rëndësinë që kanë dhe rolin që luajnë partitë politike, Kodi Zgjedhor kujdeset për të përkufizuar termat "*parti politike*" (pika 13 e nenit 2), "*parti parlamentare*" (pika 12 e këtij neni), "*përfaqësues i subjektit*

zgjedhor” (pika 14 e po këtij neni). Për më tepër, në nenet 22 e 26 (*dispozitat që rregullojnë mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e KQZ-së*), rezulton se përfaqësuesit e partive parlamentare (siç është pala paditëse) janë me status të përhershëm pranë KQZ-së dhe kanë të drejtë të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet që zhvillon ky organ. Të drejtat që kanë përfaqësuesit e partive politike (në kuadër të kompetencave që ushtron KQZ-ja), konsistojnë jo vetëm në prezencën e tyre gjatë zhvillimit të mbledhjeve, por edhe në shprehjen e opinioneve dhe diskutimin mbi çështjet që ajo shqyrton. Kodi Zgjedhor u jep gjithashtu përfaqësuesve të partive politike të drejtën për të parashtruar kërkesa dhe propozime pranë KQZ-së, duke i konsideruar, në këtë mënyrë, edhe si subjekte që marrin pjesë në mënyrë aktive në vendimmarjen e këtij organi.

Kolegji Zgjedhor e gjen të pabazuar pretendimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë në referencën e saj mbi legjitimitimin në Kodin e Procedurës Civile apo ligje të tjera, duke dalluar mosmarrëveshjet që sipas këtyre ligjeve lindin mes subjekteve qartësisht të përcaktuar, nga mosmarrëveshjet zgjedhore që kanë impakt në gjithë jetën e vendit dhe përfshijnë të gjithë subjektet zgjedhore e në radhë të parë, partitë politike. Duke pasur parasysh pikërisht karakterin e përgjithshëm dhe publik të çështjeve që lidhen me zgjedhjet (përfshirë ato për referendum), interesi i ligjshëm i partive politike, ne veçanti i partive parlamentare, përfshirë paditësin në rastin konkret, prezumohet, ndaj bazuar në nenin 145 të Kodit Zgjedhor, në interpretim edhe me nenin 152, pika 2 (fjalja e fundit) të këtij Kodi, Kolegji vlerëson se pala paditëse legjitimohet të paraqesë padi ndaj vendimeve të KQZ-së objekt shqyrtimi. Mbi të njëjtin vlerësim, Kolegji Zgjedhor legjitimoi si pale të interesuar në këtë gjykim dhe Partinë Demokratike të Shqipërisë.

3. Kompetencat e KQZ-së në shqyrtimin e kërkesës për referendum vendor.

Nga pjesëmarrësit në proces u parashtruan para Kolegjit Zgjedhor dy qëndrime të ndryshme në lidhje me kufijtë e shqyrtimit nga KQZ-ja, të kërkesës për zhvillimin e një referendumi.

Sipas KQZ-së dhe palës së interesuar, Partia Demokratike e Shqipërisë, kërkesa për fillimin e procedurave për zhvillimin e

referendumit vendor verifikohet nëse është paraqitur nga 12 nismëtarë dhe nëse këta të fundit janë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve, në njësinë e qeverisjes vendore ku kërkohet të zhvillohet referendumi. Sipas këtij qëndrimi, me përmbushjen e kërkesave të mësipërme (*neni 126, pika 2 të Kodit Zgjedhor/Referendumet*), KQZ-ja është e detyruar të pajisë nismëtarët me fletën-tip, pa marrë në shqyrtim elementët e tjerë, të cilësuar si thelbësorë. Si KQZ-ja ashtu edhe Partia Demokratike i qëndrojnë pikëpamjes se KQZ-ja nuk ka kompetencë për të shqyrtuar objektin e kërkesës.

Përkundrajt këtij qëndrimi, pala paditëse Partia Socialiste e Shqipërisë ka pretenduar se KQZ-ja ka detyrimin dhe kompetencën për të verifikuar kërkesën për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit vendor, lidhur me të gjithë elementët që ligji (*neni 126, pika 5 dhe neni 132 të Kodit Zgjedhor/Referendumet*) përcakton se duhet të përmbushen nga nismëtarët. Paditësi në këtë rast, i është referuar edhe praktikës së mëparshme të KQZ-së, kur pas kryerjes së hetimit administrativ lidhur me objektin e kërkesës për referendum vendor, në përfundim e ka rrëzuar atë, duke vlerësuar se çështja e shtruar nuk ishte një çështje vendore sepse vinte në kundërshtim me një rregullim ligjor. Paditësi i është referuar edhe një rasti tjetër, kur KQZ-ja ka refuzuar kërkesën për referendum të përgjithshëm për një çështje të rëndësisë së veçantë, për arsye se çështja e shtruar nga nismëtarët nuk ka qenë e qartë dhe se vinte në kundërshtim me një rregullim ligjor në fuqi.

Në lidhje me çështjen e shtruar për diskutim mbi kufijtë e shqyrtimit të kërkesës për referendum nga KQZ-ja, Kolegji Zgjedhor vlerëson paraprakisht të nevojshme që të evidentojë kuadrin historik në të cilin ligjvënësi ka hartuar dhe miratuar dispozitat e Kodit Zgjedhor mbi referendimet. Kështu, ligji nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (që për pjesën e referendumit është ende në fuqi si një ligj i zbatueshëm) i përket periudhës kur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve parashikohej si një organ kushtetues (*neni 153 i Kushtetutës*). Sipas atij rregullimi kushtetues, KQZ-ja konsiderohej një organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe me referendimet dhe shpall rezultatet e tyre. Funkcionet e KQZ-së, procedura që ndiqet, si dhe kontrolli i ligjshmërisë së akteve që ky organ nxirrte,

për të gjithë procesin zgjedhor, pa përjashtuar procesin referendar, kanë qenë të parashikuara si pushtete që nuk mund t'i shmangen kontrollit ligjor dhe atij kushtetues.

Duke mbajtur në vëmendje këtë pozicion të KQZ-së, Kolegji vlerëson se edhe kompetencat e KQZ-së, që lidhen me rregullimin ligjor që i është bërë ushtrimit nga populli të së drejtës për referendum, duhen kuptuar se buronin, jo thjesht nga Kodi Zgjedhor/Referendumet, por së pari nga vetë Kushtetuta.

Aktualisht, KQZ-ja nuk është një organ kushtetues, për shkak ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 9904, datë 21.04.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. KQZ-ja parashikohet me ligj si “organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod” (neni 2, pika 7). Veprimtaria e këtij organi rregullohet në mënyrë të posaçme nga Kodi Zgjedhor. Përderisa është një organ publik, i cili në ushtrim të kompetencave të tij nxjerr edhe akte administrative (neni 23 i Kodit Zgjedhor), normat e përgjithshme të vendosura nga Kodi i Procedurave Administrative, ose ligje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e organeve administrative, janë të detyrueshme për zbatim nga ky organ. Në këtë kuadër, KQZ-ja është e detyruar nga ligji (Kodi Zgjedhor) për të marrë vendime edhe për çështjet e referendumeve, sipas dispozitave të posaçme që rregullojnë këtë proces ligjor.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se, për shkak të ripozicionimit të KQZ-së, nga një organ kushtetues në një organ ligjor, por edhe të ndryshimeve të vazhdueshme që i janë bërë në vite Kodit Zgjedhor, është jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, që me kontributin e saj të vlefshëm ndihmon në shmangien e debatit mbi një konflikt juridiksional për shqyrtimin e çështjeve të kësaj natyre.

Kompetenca e KQZ-së për shqyrtimin e elementëve ligjorë që duhet të përmbushë kërkesa për kryerjen e një referendumi është analizuar në jo pak vendime të Gjykatës Kushtetuese.

Kështu, në vendimin nr. 5, datë 21.01.2011, Gjykata Kushtetuese ka rrëzuar kërkesën e grupit nismëtar për zhvillimin e referendumit

të përgjithshëm, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 26, datë 28.09.2010 të KQZ-së, me të cilin është refuzuar pajisja me fletën-tip për zhvillimin e referendumit për një çështje të veçantë, ku shtrohej pyetja se “A duhet të rinumërohen fletët e votimit të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009 ?”. Arsyetimi i përdorur nga KQZ-ja, në këtë vendim, ishte se *çështja e shtruar për referendum nuk ishte e qartë*. Gjykata Kushtetuese e ka gjetur kërkesën e paraqitur nga grupi nismëtar si haptazi të pabazuar, duke arsyetuar ndër të tjera se: “Sipas dispozitave të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur nga jo më pak se 12 nismëtarë për zhvillimin e referendumit për një çështje të rëndësishme të veçantë. Përderisa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, siç rezulton nga vendimi nr. 26, datë 28.09.2010, ka vlerësuar anën formale të rregullsisë së dokumentacionit, që lidhet me *përcaktimin e qartë të llojit të referendumit e të llojit të objektit të kërkesës*, Kolegji [i Gjykatës Kushtetuese] çmon se një shqyrtim i tillë nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, por të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ndaj qëndrimeve që mban Komisioni Qendror i Zgjedhjeve lidhur me parregullsinë e dokumentacionit të paraqitur, është detyrim i kërkuarit për të shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore që kërkon Kodi Zgjedhor për të riparaqitur kërkesën pas korigjimit të parregullsive të vërejtura.” Gjykata Kushtetuese ka konkluduar me këtë vendim se “Përderisa, këto çështje përfshihen në juridiksionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nuk janë pjesë e ndonjë juridiksioni kushtetues”, atëherë edhe kërkesa vlerësohet “si haptazi e pabazuar” dhe “nuk plotëson kushtet për të kaluar në seancë.” (*Shih më gjerë vendimi nr. 26, datë 28.09.2010 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese*). Jurisprudenca kushtetuese e ka evidentuar në këtë rast KQZ-në si organi kompetent, që shqyrton aspektin ligjor të kërkesës së nismëtarëve lidhur me detyrimin e tyre për të paraqitur qartësisht çështjen për të cilën kërkojnë të fillojnë procedurat për zhvillimin e referendumit.

Kompetenca e KQZ-së për të vlerësuar llojin e referendumit, për të cilin grupi nismëtar ka paraqitur kërkesë, është pranuar edhe në vendimin nr. 25, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin është rrëzuar kërkesa e grupit nismëtar për shfuqizimin e vendimit nr. 47, datë 05.06.2008 të KQZ-së. Me këtë vendim KQZ-ja ka rrëzuar kërkesën e një grupi nismëtar për fillimin e procedurave për

zhvillimin e një referendumi të përgjithshëm për shfuqizimin e neneve 5, 7 dhe 8 të ligjit nr. 9904, date 21.04.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, date 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. KQZ-ja argumenton vendimin e saj me faktin se kërkesa e grupit nismëtar ka të bëjë me një referendum kushtetues, sipas nenit 122 të Kodit Zgjedhor dhe jo me referendum të përgjithshëm, parashikuar nga neni 126 i këtij Kodi e për rrjedhojë kërkesa është konsideruar se nuk përbën objekt shqyrtimi nga ky organ. Me vendimin nr. 25/2009, Gjykata Kushtetuese nuk e ka legjitimuar kërkuesin, duke arsyetuar se thirrja e referendumit për amendamentet kushtetuese mund të bëhet vetëm brenda kufijve të parashikuar nga neni 177 i Kushtetutës dhe se e drejta e 50 mijë shtetasve me të drejtë vote për të kërkuar shfuqizimin e një ligji, sipas nenit 150, nuk shtrihet në ligjet për rishikimin e Kushtetutës. Me këtë qëndrim të mbajtur nga jurisprudenca kushtetuese, KQZ-ja vlerësohet si organi që ka kompetencën ligjore për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve edhe sa i përket llojit të referendumit që ata kërkojnë të zhvillojnë, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor.

Gjithashtu, nisur nga pretendimi që ka paraqitur Kuvendi i Shqipërisë për moslegjitimitimin e KQZ-së për të dërguar për kontroll të kushtetutshmërisë së referendumit, me arsyetimin se vendimi është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, për shkak të mos verifikimit të nënshkrimeve (nga verifikimi kanë rezultuar nënshkrime të falsifikuara), Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 8, datë 08.03.2013 është shprehur se : “... vendimi i KQZ-së, për pranimin e kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm shfuqizues, nuk i nënshtrohet vlerësimit nga Gjykata, por përbën mjetin për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues për të shqyrtuar, paraprakisht, kushtetutshmërinë e kërkesës për referendum të përgjithshëm shfuqizues, të paraqitur nga grupi nismëtar në emër të mbi 50 mijë zgjedhësve”. Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese i konsideron jashtë juridiksionit të saj çështjet që lidhen me aspektin ligjor e faktik të procesit të vendimmarrjes së KQZ-së, duke i konsideruar ato në kompetencë të këtij organi.

Nisur nga nevoja për të evidentuar kuadrin historik në të cilin ligjvënësi ka hartuar dhe miratuar dispozitat e Kodit Zgjedhor mbi referendumet, por edhe nga elaborimi që

jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka bërë, në këtë drejtim, Kolegji Zgjedhor vlerëson se, në interpretim të dispozitave mbi veprimtarinë administrative që KQZ-ja kryen, në kuadër të depozitimit, verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për referendum, ligjvënësi ka ngarkuar këtë organ për të kryer verifikimin e ligjshmërisë së kërkesave, në kuptim të përmbushjes së kushteve ligjore që duhet të plotësojnë nismëtarët për zhvillimin e referendumit në përgjithësi, dhe atë vendor, si në rastin konkret.

Duke iu referuar, për rastin në shqyrtim, dispozitave të Kodit Zgjedhor për referendumet, Kolegji Zgjedhor vlerëson se ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht dhe në mënyrë të detajuar etapat në të cilën kalon procedura për ushtrimin e së drejtës për referendum. Si një kusht parësor për fillimin e procedurës për zhvillimin e referendumit, është paraqitja fillimisht e kërkesës në KQZ nga 12 zgjedhës (nismëtarët), me anë të së cilës kërkojnë marrjen prej saj të fletës-tip, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme, që mbështesin referendumin. Fleta-tip përmban, në varësi të kërkesës së nismëtarëve, ligjin që kërkohet të shfuqizohet me referendum, ose çështjen që shtrohet për referendum. Në këtë moment procedural shtrohet pyetja, nëse është e mjaftueshme për KQZ-në të evidentojë vetëm 12 zgjedhës që kanë paraqitur kërkesën për shfuqizimin e një ligji ose që shtrojnë një çështje për referendum, me qëllim vijimin e mbledhjes së nënshkrimeve nga zgjedhësit që mbështesin referendumin (formalizimin juridik të kërkesës për referendum nga subjekti, që ligji i njeh të drejtën e referendumit, sipas nenit 126/1 apo nenit 132/1 të Kodit Zgjedhor/Referendumet), apo edhe shqyrtimi në thelb i kërkesës së paraqitur duke verifikuar përputhjen me kërkesat e nenit 126 dhe të dispozitave të tjera të Kodit Zgjedhor/Referendumet.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se, siç rezulton edhe në nenin 126 të Kodit Zgjedhor/Referendumet, procedura për zhvillimin e referendumit duhet të fillojnë me plotësimin e disa kushteve nga nismëtarët, të cilët janë të detyruar të paraqesin qartësisht në kërkesën e tyre, jo vetëm ligjin/dispozitën që kërkohet të shfuqizohet, por edhe arsyen se përse duhet shfuqizuar. Ndërkohë që në rastin e referendumit për një çështje të rëndësishme së veçantë, nismëtarët duhet të përshkruajnë qartë çështjen, rëndësinë e saj, qëndrimin e tyre si dhe të shtrojnë pyetjen pa ekuivoke, e mundshme për t'iu përgjigjur

me “Po” ose “Jo”. Nëse KQZ-ja nuk ka në kompetencën e saj verifikimin e këtyre elementëve ligjorë, të domosdoshëm për iniciimin e procedurës së mbledhjes së nënshkrimeve nga zgjedhësit, ky proces, potencialisht, rrezikon të jetë i paligjshëm dhe të përfshijë zgjedhësit e tjerë, në çështje të cilat mund të vijnë ndesh, së paku, me moralin shoqëror dhe, më së shumti, me rendin demokratik.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se KQZ-ja ka përgjegjësinë (të drejtën dhe detyrimin) për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve në drejtime si : lloji i referendumit për të cilin kërkohet fillimi i procedurave (i përgjithshëm apo vendor); ekzistencën dhe qartësinë e çështjes që shtrohet për referendum, si dhe rëndësia e saj, përveç se edhe aspekte të tjera ligjore që do të gjejnë pasqyrim në fletën-tip për mbledhjen e nënshkrimeve, që përpilohet nga vetë KQZ-ja. Për sa kohë që ligjvënësi ka paracaktuar në pikën 5 të nenit 126 rregulla strikte ligjore përpara mbledhjes së nënshkrimeve të nevojshme për të kërkuar fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit, rregulla të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur, në radhë të parë, nga nismëtarët, atëherë i vetmi organ që kontrollon ligjshmërinë e kërkesës, është dhe duhet të jetë veçse KQZ-ja, që në ushtrim të kompetencave ligjore, nuk lejon fillimin e procedurave që bien në kundërshtim me ligjin.

KQZ, në pozicionin e saj si palë e paditur në këtë proces gjyqësor, si dhe Partia Demokratike e Shqipërisë kanë pretenduar, ndërmjet të tjerave se, është Gjykata Kushtetuese, organi i cili pas mbledhjes së nënshkrimeve të nevojshme për kërkesën për referendum, shqyrton kushtetutshmërinë e çështjes që shtrohet në referendum dhe se KQZ-ja nuk mund të marrë kompetencat që i përkasin kësaj gjykate, duke u kufizuar vetëm në verifikimin e nënshkrimeve.

Në referim të Kushtetutës, Kolegji Zgjedhor thekson se sipas nenit 124, pika 2, Gjykata Kushtetuese, për vet pozicionin që ka si një autoritet i lartë, i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe në ushtrim të kompetencave të saj, ajo vendos për kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij (neni 131, shkronja “ë” e Kushtetutës), si dhe shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum, sipas nenit 150 paragrafët 1 e 2, nenit 151 paragrafët 2 e 3, nenit 177 paragrafët 4 e 5 (neni 152). Janë këtë kompetenca të cilat gjenden të parashikuara në

shumë dispozita të Kushtetutës, në lidhje me referendumet dhe që kanë qenë objekt interpretimi nga jurisprudenca kushtetuese, mbi të cilat orientohet vetë Gjykata Kushtetuese për të përcaktuar juridiksionin e saj.

Ajo që Kolegji Zgjedhor vlerëson, në rastin konkret, lidhet me detyrimin e KQZ-së për të shqyrtuar të gjithë aspektet ligjore të kërkesës së nismëtarëve, duke mos u kufizuar vetëm në verifikimin e cilësisë së tyre si zgjedhës, në pranimin e kërkesës për pajisjen me fletën tip. Një kërkesë e vlefshme ligjërisht, që paraqitet nga nismëtarët dhe që konsiderohet si e tillë nga KQZ-ja, është një kusht për vijimin e procedurës së mëtejshme për zhvillimin e referendunit. Për rrjedhojë, vendimi i KQZ-së që kontrollon ligjshmërinë e kërkesës, për nga natyra e çështjeve që shqyrton, në këtë moment procedural, është një vendim përfundimtar dhe i kontrollueshëm gjyqësisht. Vetëm pas certifikimit ligjor të këtij vendimi përfundimtar, KQZ-ja, në kuptim të nenit 128 të Kodit Zgjedhor, “verifikon nënshkrimet dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të zgjedhësve, në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra prej saj” si dhe “vendos për pranimin ose mospranimin e kërkesës brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së saj, duke e bazuar vendimin vetëm mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur.”.

4. E drejta për të kërkuar zhvillimin e një referendumi vendor, si e drejtë kushtetuese dhe e parashikuar me ligj.

Pretendimi bazë i grupit nismëtar, i cili është mbështetur edhe nga Partia Demokratike e Shqipërisë lidhet me realizimin e të drejtës për referendum, si një mjet i domosdoshëm për tu ushtruar nga banorët e njësive përkatëse të qeverisjes vendore, për të shprehur qëndrimin e tyre për shkrirjen apo mos shkrirjen e njësive, në kuadër të ndarjes së re territoriale.

Pikësëpari, Kolegji vlerëson se e drejta e popullit për referendum si ushtrim i drejtpërdrejtë i sovranitetit, parashikohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, fillimisht në parimet themelore, e më tej në nenet 108 (referendumi vendor), 150 e vijues (pjesa XI) si dhe 177 (referendumi kushtetues). Kjo e drejtë garanton ushtrimin e drejtpërdrejtë të demokracisë kushtetuese, krahas asaj

përfaqësuese, nëpërmjet të zgjedhurve. Dispozitat kushtetuese parashikojnë si llojet e referendumit, ashtu edhe subjektet që legjitimohen të iniciojnë zhvillimin e tyre, krahas edhe ndalimeve kushtetuese për ushtrimin e kësaj të drejte. Ndërkohë Kushtetuta, në nenet 108, pika 4 dhe 150, pika 3 parashikon se parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit, parashikohen me ligj. Sovraniteti i popullit dhe ushtrimi i tij i drejtpërdrejtë nëpërmjet referendumit, kushtëzohet kështu nga Kushtetuta me rregulla të veçanta procedurale, të cilat duhet të përmbushen në përputhje me përcaktimet ligjore.

Sipas doktrinës, pranuar edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, (*Shih vendimin nr. 31, datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*) "... parimi i ushtrimit të sovranitetit nga populli, nënkupton një koncept demokratik sipas kriterëve të një demokracie përfaqësuese që përmban edhe elementë që mundësojnë ushtrimin direkt të demokracisë kushtetuese. Me këtë kuptohet që populli, të drejtën për të ushtruar funksion ligjvënës, normalisht, nuk e ushtron vetë në mënyrë të drejtpërdrejtë, por nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur prej tij. Demokracia përfaqësuese, historikisht, është konceptuar si formë e zakonshme e qeverisjes. Ajo është shprehje e demokracisë që mundëson shfaqjen e vullnetit të shumicës në formën e një akti që do t'i shërbejë interesit të përgjithshëm. Instrumentet e demokracisë direkte zënë vend në këtë vështrim, jo si pushtet konkurrues i organeve përfaqësuese, por si instrumente që mundojnë mënjanimin e mungesës së veprimit nga ana e përfaqësuesve ose balancimin e kësaj mungese. Dispozitat e Kushtetutës lejojnë ushtrimin e sovranitetit të popullit nëpërmjet referendumeve, përderisa kjo nuk bie në kundërshtim me sistemin e procesit ligjvënës." (*Shih edhe vendimet nr. 8, datë 08.03.2013 dhe nr. 25, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese.*)

Ligji i cili, në përmbushje të detyrimit kushtetues, rregullon çështjet mbi parimet dhe procedurat e zhvillimit të referendumit, është ai nr. 9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (*referuar në këtë vendim si Kodi Zgjedhor/Referendumet*). Me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 është shfuqizuar Kodi Zgjedhor i vitit 2003, me përjashtim të dispozitave për referendume (pjesa IX e ligjit 9087/2003, si dhe çdo pjesë e dispozitave të tij që ka lidhje me të, të cilat sipas përcaktimit ligjor të nenit 185, do të mbeten në

fuqi deri në miratimin e ligjit të ri për referendumet e përgjithshme dhe vendore). Mbi këtë bazë, janë dispozitat e mësipërme ligjore, ato të cilat rregullojnë ligjshmërinë e procedurës dhe respektimin e parimeve, në rastin e kërkesave për zhvillimin e referendumeve (kushtetues, të përgjithshëm apo vendor).

Një prej llojeve të referendumeve, që Kushtetuta dhe ligji parashikojnë në ushtrim të sovranitetit të popullit në mënyrë të drejtpërdrejtë, është ai vendor. Kushtetuta e parashikon se vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore, duke e ndaluar ushtrimin e kësaj të drejte, për çështjet që parashikohen në nenin 151, pika 2 të Kushtetutës, kontrolli paraprak (*ex ante*) i të cilave i është ngarkuar Gjykatës Kushtetuese (neni 152 i Kushtetutës).

Në aspektin ligjor, konstatohet se dispozitat që rregullojnë referendumin kushtetues dhe atë të përgjithshëm, parashikojnë në mënyrë të detajuar rregullat mbi bazën e të cilave kryhet procedura për zhvillimin e tyre. Sa i përket referendumit vendor, ai gjen rregullim në nenin 132 të ligjit, i cili përcakton subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar referendum vendor dhe kufizimin në kohë për të kërkuar përsëritjen e referendumit për të njëjtën çështje. Në pikën 4 të nenit 132 parashikohet se : “Për zhvillimin e referendumit vendor zbatohen, për aq sa është e mundur ose e nevojshme, dispozitat e parashikuara për referendumin e përgjithshëm në pikat 2 dhe 5 të nenit 126, nenin 127 dhe në pikën 2 të nenit 128 të këtij Kodi.”

Dispozitat e sanksionuara nga ligjvënësi për rregullimin e referendumit vendor, të cilave duhet t’i referohet KQZ-ja fillimisht, por edhe vetë Kolegji Zgjedhor kur kontrollon ligjshmërinë e vendimeve të KQZ-së, trajtojnë këto çështje :

- *E drejta për të kërkuar fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor dhe organi të cilit i paraqitet kërkesa.* Sipas pikës 2 të nenit 126 të Kodit Zgjedhor/Referendumet “Kërkesa për fillimin e procedurave të referendumit paraqitet në KQZ nga një grup prej jo më pak se 12 nismëtarësh, të cilët janë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve.”

- *Përmbajtja e kërkesës për fillimin e procedurave për referendum.* Pika 5 e nenit 126 parashikon se “Kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për një çështje të një rëndësie të veçantë duhet të përshkruajë qartë çështjen që shtrohet, rëndësinë e saj, si dhe qëndrimin e nismëtarëve në lidhje me atë çështje. Çështja duhet të formulohet në mënyrë të qartë, të plotë dhe pa ekuivoke dhe në mënyrë të tillë që zgjedhësit të mund të përgjigjen me “PO” ose “JO”.”
- *Afati brenda të cilit KQZ-ja vendos te pajise nismëtarët me fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme, përmbajtja e fletës-tip, si dhe periudha gjatë së cilës ligji lejon depozitimin e nënshkrimeve në mbështetje të referendumit.* Sipas nenit 127 të ligjit “KQZ-ja, brenda 20 ditëve nga paraqitja e kërkesës për referendum të përgjithshëm, pajis grupin nismëtar kundrejt pagesës me fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të 50 mijë zgjedhësve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve në kohën e paraqitjes së kërkesës.”
- *Vendimi që merr KQZ-ja pas depozitimit të nënshkrimeve që mbështesin referendumin, afati i marrjes së këtij vendimi, si dhe detyrimi i këtij organi për të bazuar vendimin vetëm mbi rregullsinë e dokumentacionit.* Në pikën 2 të nenit 128 thuhet: “KQZ-ja vendos për pranimin ose mospranimin e kërkesës brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së saj, duke e bazuar vendimin vetëm mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur. Vendimi u njoftohet menjëherë nismëtarëve. Vendimi për mospranimin e kërkesës duhet të përcaktojë qartë shkaqet e mospranimit.”

Kolegji Zgjedhor konstaton se jo të gjitha dispozitat që rregullojnë referendumin e përgjithshëm janë referuar për tu zbatuar, qoftë edhe për atë sa është e mundur, në rastin e kërkesave për referendum vendor. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se procedura për zhvillimin e referendumin vendor do të rregullohet në aspektin kushtetues (nenet 108, pika 4; 151, paragrafi 2; 152) dhe në aspektin ligjor, vetëm nga neni 132 i Kodit Zgjedhor, i cili të referon në dispozitat përkatëse. Çdo rregull tjetër i parashikuar në ligj dhe që ligjvënësi

nuk e ka përfshirë krahas pikave 2 dhe 5 të nenit 126, nenit 127 dhe pikës 2 të nenit 128, vlerësohet se nuk aplikohet në rastin e kërkesës për referendum vendor, pasi referencat në dispozitat e sipërcituara janë shteruese.

Mbi këtë bazë kushtetuese dhe ligjore Kolegji Zgjedhor është i detyruar të shprehet përfundimisht mbi ligjshmërinë e vendimeve të KQZ-së.

5. Ligjshmëria e vendimeve të KQZ-së, objekt ankimi.

Miratimi i ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, nëpërmjet të cilit u miratua një ndarje e re administrative territoriale e njësive të qeverisjes vendore, duke u zvogëluar numri i tyre dhe për rrjedhojë edhe duke u ndryshuar kufijtë e njësive vendore, është shkaku për të cilin grupet nismëtare i janë drejtuar KQZ-së me kërkesat respektive për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumeve vendore. Për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore është shtruar pyetja e njëjtë se “A jeni dakord që Komuna/Bashkia ... të shkrihet?”.

Kërkesa për referendum vendor është bazuar në nenet 2, pika 2; 108, pikat 2 dhe 4 të Kushtetutës, si dhe në dispozitat e Kodit Zgjedhor/Referendumet. Nismëtarët, në çdo rast, kanë argumentuar rëndësinë e çështjes për komunitetin e tyre, duke pretenduar se në kryerjen e reformës territoriale dhe ndryshimin e kufijve të njësive të qeverisjes vendore, nuk janë kryer konsultime të mirëfillta me komunitetin, në kundërshtim me sa parashikon Kushtetuta dhe Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore dhe duke qenë se shkrirja e njësisë vendore përkatëse do të ketë ndikim të thellë për komunitetin vendor, është domosdoshmëri, që banorët e njësive vendore, të shprehin mendimin e tyre për shkrirjen ose jo të njësive përkatëse.

Referuar shkakut për të cilin grupet nismëtare i janë drejtuar KQZ-së, ashtu edhe referencës kushtetuese, nenin 108, pika 2 të Kushtetutës, çështja e kërkuar për tu shtruar në referendume vendore lidhet me përcaktimin e kufijve të njësive të qeverisjes vendore, të përcaktuara aktualisht me ligjin nr. 115/2014. Sipas këtij

ligji, për shkak të riorganizimit të ndarjes administrativo-territoriale, njësitë e qeverisjes vendore ku kërkohet të zhvillohet referendumi, nuk do të ekzistojnë më si të tilla, pasi ligjvënësi ka parashikuar një numër më të vogël të njësive vendore.

Në shqyrtimin e pretendimeve të palës paditëse, Kolegji Zgjedhor analizoi kërkesën e grupeve nismëtare, duke arritur në përfundimin se çështja e shtruar për referendum, nuk është çështje e qeverisjes vendore, por e asaj qendrore, qe si e tille nuk mund te perbeje ceshtje per referendum vendor, ndaj KQZ-ja nuk duhej të kishte miratuar fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit vendor ne rastin konkret.

Referendumi vendor duhet domosdoshmërisht të zhvillohet për çështje të qeverisjes vendore, organet e të cilave i kanë të përcaktuara me ligj kompetencat e tyre. Në kuadër të ushtrimit të këtyre kompetencave, populli mund të ushtrojë drejtpërdrejtë qeverisjen nëpërmjet referendumit. Është e njohur, shprehet Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 25, datë 24.07.2009, “teoria e sovranitetit popullor sipas të cilës populli nuk përballet me kufizime dhe as detyrohet nga parashikimet kushtetuese në ushtrimin e sovranitetit”. Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese thekson se “në një shtet kushtetues, ideja e një pushteti, i cili nuk përballet me detyrime dhe kufizime që burojnë nga Kushtetuta, nuk mund të pranohet. Sovraniteti i popullit, i vendosur në kuadrin e një sistemi kushtetues e ligjor, nuk mund të ngatërrohet me pushtetin themelor dhe kërkesa për të ndjekur disa procedura të veçanta gjatë ushtrimit të tij është tërësisht në përputhje me sovranitetin popullor.”.

Është e vërtetë se në përputhje me nenin 2, pika 1 e Kushtetutës “*sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i takon popullit*”, por ky deklaram thekson Gjykata Kushtetuese, “nuk nënkupton ushtrimin e sovranitetit nga populli në mënyrë të pakushtëzuar.” Sipas Gjykatës Kushtetuese “kushtetutëbërësi ka shprehur një preferencë të qartë në favor të demokracisë përfaqësuese. Instrumentet e demokracisë direkte zënë vend në këtë vështrim, jo si pushtet konkurrues i organeve përfaqësuese, por si instrumente që mundësojnë mënjanimin e mungesës së veprimit nga ana e përfaqësuesve ose balancimin e kësaj mungese. Referendumi, si një nga instrumentet e demokracisë direkte, nuk përbën alternativë ndaj procesit ligjvënës

të parlamentit. Ai nuk mundëson bërjen e ligjeve, funksion i cili u është ngarkuar ekskluzivisht ligjvënësve (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 31, datë 19.11.2003*).

Nisur nga kjo analizë kushtetuese, Kolegji Zgjedhor vlerëson se një çështje e tillë që mbart në vetvete mundësinë për shfuqizimin e një ligji që shtrin efektet e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, që synon të lërë pa fuqi juridike ndarjen territoriale, të cilën ligjvënësi e ka miratuar me një ligj me shumicë të cilësuar dhe që nuk përfshihet as në konceptin kushtetues të autonomisë vendore, nëpërmjet të cilës populli i çdo njësie vendore zgjidh dhe vendos vetëm çështjet “që Kushtetuta dhe ligjet ua kanë lënë atyre në kompetencë”, është një çështje me rëndësi kombëtare. (*Shih vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

Njëkohësisht, Kolegji vlerëson se asnjë çështje që nuk ka impakt vetëm në çështjet vendore të njësisë ku kërkohet të zhvillohet referendumi, por që përfshin interesin edhe të komuniteteve të tjera, ashtu sikundër pranohet edhe nga vete grupet nismëtare në rastin konkret, nuk mund të shtrohet në referendum vendor. Rezultati i këtij referendumi në çdo rast nuk do të kish fuqi në njësitë e tjera të qeverisjes vendore dhe aq më pak, në të gjithë vendin, përderisa ka një vullnet të shprehur nga një autoritet që qëndron tej atij vendor. Në rastin konkret, çështja që shtrohet dhe për të cilën kërkohet fillimi i procedurave për referendum vendor, është rregulluar me ligj, kushtetutshmëria e të cilit është e prezumuar.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se ky proces, përfshirë edhe përcaktimin e kufijve të njërive të qeverisjes vendore, kryhet me ligj (neni 108 i Kushtetutës). Në këto kushte rezulton që një çështje e tillë nuk është në kompetencë të pushtetit vendor, por të pushtetit qendror, Kuvendit të Shqipërisë. Çështja e respektimit të nenit 108, pika 2 të Kushtetutës lidhur me marrjen e mendimit të popullsisë për ndryshimin e kufijve të njërive të qeverisjes vendore, nuk lidhet me realizimin domosdoshmërisht të referendumit vendor, por me respektimin nga ligjvënësi të detyrimit kushtetues në procesin ligjvënës. Prandaj, kjo dispozitë nuk mund të shërbejë si shkak dhe të motivojë një çështje të kërkuar për tu shtruar domosdoshmërisht në referendum.

Nisur nga kjo analizë kushtetuese dhe ligjore, Kolegji Zgjedhor vlerëson se për shqyrtimin e kërkesave të grupeve nismëtare për zhvillimin e referendumeve vendore, KQZ-ja duhej, para së gjithash, të shqyrtonte çështjen, duke përcaktuar llojin e referendumit për të cilin nismëtarët kërkonin të fillonin procedurat dhe të pajiseshin me fletët-tip. Siç është parashtruar nga KQZ-ja, në seancë gjyqësore, ky organ nuk ka vlerësuar këtë aspekt të procesit, pasi është kufizuar vetëm me verifikimin e nismëtarëve dhe i ka pajisur ata me fletën-tip, duke shkruar në krye të saj, pyetjen e propozuar nga grupet nismëtare “Ajeni dakord që Komuna/Bashkia ... të shkrihet?” Pra, nisur nga llojet e ndryshme të referendumeve, që Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor/Referendumet parashikojnë, si dhe të rregullave të ndryshme që përcaktohen për secilin prej tyre, Kolegji vlerëson se KQZ-ja duhej të kishte marrë në shqyrtim çështjen e llojit të referendumit, si edhe legjitimitetin e nismëtarëve. Sipas Kodit Zgjedhor, KQZ-ja nuk ka kompetenca në fazën paraprake të inicimit të një referendumi kushtetues, ndërsa për referendumin e përgjithshëm dhe referendumin vendor, ky Kod nuk parashikon rregulla identike. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se KQZ-ja duhet paraprakisht të sqaronte çështjen nëse nismëtarët, pavarësisht kërkesës së tyre dhe emërimit të llojit të referendumit, kërkojnë të pajisen me fletët-tip për fillimin e procedurave për një referendum të përgjithshëm, vendor apo kushtetues, gjë që në rastin konkret nuk rezulton të jetë kryer, ndërkohë që KQZ-ja ka miratuar kërkesat për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit vendor.

Për këto arsye, Kolegji vlerëson se kërkesat e grupeve nismëtare për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit vendor, janë të pabazuara në ligj dhe si të tilla nuk duhej të pranoheshin nga KQZ-ja.

Përfundimisht, Kolegji Zgjedhor vlerëson se padia objekt gjykimi është ligjërisht e bazuar dhe se vendimet e dhëna nga KQZ-ja duhet të shfuqizohen, duke u rrezuar kërkesat e grupeve nismëtare. Përfundimi në të cilin arrin Kolegji Zgjedhor, në lidhje me paligjshmërinë e vendimmarrjes së KQZ-së, në këtë moment procedural të procesit, nuk lejon vijimin e mëtejshëm të procedurës së verifikim nga KQZ-ja të nënshkrimeve dhe saktësisë së dokumenteve identifikuese të zgjedhësve.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës Apelit Tiranë bazuar në nenin 158, pika 1, shkronja “b” dhe pika 3 të Kodit Zgjedhor.

VENDOSI:

- Pranimin e padisë.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 110, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Bujan.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 111, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Pirg.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 112, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Lis.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 113, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Macukull.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 114, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Ndroq;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 138, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Shtiqën;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 140, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Vergo;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 139, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Gorë;

- Shfuqizimin e vendimit nr. 43, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Luz i Vogël;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 83, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Golaj;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 77, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Bubullimë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 75, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Fier Shegan;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 78, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Tomin;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 160, datë 01.12.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Bashkinë Rubik;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 142, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Qendër Malësi e Madhe;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 141, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Lazarat;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 143, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Shkrel;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 144, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Kelmend;

- Shfuqizimin e vendimit nr. 146, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Vaqarr;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 145, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Proptisht;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 147, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Kastrat;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 148, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Lunxhëri;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 149, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Muhurr;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 150, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Arras;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 152, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Markat;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 151, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Xarrë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 76, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Hysgjokaj;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 119, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Pezë;

- Shfuqizimin e vendimit nr. 121, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Prezë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 122, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Zavalin;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 123, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Hotolisht;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 124, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Mollas;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 125, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Gjinar;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 126, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Tregan;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 127, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Gracen;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 128, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Labinot Mal;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 137, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Levan;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 136, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Xhafzotaj;

- Shfuqizimin e vendimit nr. 54, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Zall-Herr;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 82, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Fajza;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 81, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Shënkoll;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 80, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Ungrej;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 135, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Vreshtas;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 134, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Bërxull;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 87, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Shllak;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 86, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Trebisht;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 85, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Ostren;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 84, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Gjinaj;

- Shfuqizimin e vendimit nr. 118, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Fierzë Elbasan;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 115, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Rrasë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 116, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Kajan;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 117, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Grekan;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 129, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Derjan;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 57, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Bërzhitë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 59, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Tërbuf;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 60, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Mollas Kolonjë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 61, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Melan;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 62, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Kastriot;

- Shfuqizimin e vendimit nr. 63, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Gur i Zi;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 65, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Dajç;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 58, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Pojan;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 106, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Cudhi;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 107, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Bytyç;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 130, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Bradashesh;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 108, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Fshat Tropojë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 109, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Fierzë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 26, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Gjocaj;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 27, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Shezë;

- Shfuqizimin e vendimit nr. 56, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Krrabë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 104, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Funarë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 105, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Thumanë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 94, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Shupenzë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 95, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Bashkinë Mamurras;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 96, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Milot;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 97, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Brataj;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 131, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Bashkinë Fushë Krujë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 98, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Fushë-Cidhen;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 99, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Ruzhdie;

- Shfuqizimin e vendimit nr. 100, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Tërthore;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 101, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Dishnicë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 102, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Petran;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 103, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Suke;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 42, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Golem;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 133, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Nikël;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 88, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Strum;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 89, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Dardhas;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 90, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Udënisht;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 91, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Cërravë;

- Shfuqizimin e vendimit nr. 132, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Bubq;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 92, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Velçan;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 93, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Buçimas;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 47, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Shishtavec;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 48, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Maqellarë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 49, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Surroj;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 50, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Kolonjë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 52, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Dajt;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 51, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Shëngjergj;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 53, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Baldushk;

- Shfuqizimin e vendimit nr. 36, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Ksamil;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 37, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Bicaj;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 38, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Cakran;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 39, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Topojan;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 79, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Velipojë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 40, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Gosë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 41, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Kryevidh;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 74, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Kashar;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 55, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Farkë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 44, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Lekaj;

- Shfuqizimin e vendimit nr. 45, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Synej;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 46, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Helmes;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 20, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Luzni;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 66, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Fratar;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 67, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Paskuqan;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 68, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Zall-Bastar;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 69, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Petrelë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 70, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Rrethina;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 71, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Ana Malit;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 72, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Postribë;

- Shfuqizimin e vendimit nr. 73, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Pult;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 64, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Vig-Mnelë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 24, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Përparim;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 25, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Pajovë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 28, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Qendër Leskovik;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 29, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Bashkinë Leskovik;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 30, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Orosh;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 31, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Fanë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 32, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Thellë;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 33, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Otlak;

- Shfuqizimin e vendimit nr. 34, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Lumas;

- Shfuqizimin e vendimit nr. 35, datë 14.11.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Komunën Vërtop.

Tiranë, 14.01.2015

Gjyqtar

Fuat VJERDHA

Gjyqtar

Ilir TOSKA

Gjyqtar

Edlira PETRI

Gjyqtar

Andi CIVICI

Gjyqtar

Kliton SPAHIU

* * *



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANE
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**Nr.2 Regj. Themeltar
Date 21.04.2016**

**Nr.12 Vendimi
Date 16.05.2016**

Kolegji Zgjedhor i Gjykeses se Apelit Tirane i perbere nga gjyqtaret:

KRYESUES :	KLITON SPAHIU
ANETAR :	GJINOVEFA GABA
ANETAR :	PETRIT ÇENO
ANETAR :	FUAT VJERDHA
ANETAR :	ILIR TOSKA

asistuar prej sekretares Rexhina Baci, në Tiranë, sot me datë 16.05.2016, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore, që u përket paleve:

PADITËSE: PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE,
me Seli ne Tirane, Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr.11,
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Z.Ivi Kaso
dhe Z.Spiro Dodbiba.

I PADITUR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,
me Seli ne Tirane, Rruga “Ibrahim Rrugova”, Nr.4,
përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Znj.Deshira
Pasko, Z.Olsi Peto dhe Znj. Anila Ruço.

PALE E INTERESUAR: PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE,
me Seli ne Tirane, Sheshi “Austria”, Nr.91, përfaqësuar ne
gjykim me autorizim nga Znj.Klotilda Bushka dhe Z.Gledian
Llatja.

OBJEKTI: - Kundershtimi i Vendimit Nr.6, date 23.03.2016, te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, "Per shqyrtimin e kerkeses se nje grupi nismetaresh per fillimin e procedurave, per zhvillimin e nje referendumi vendor ne Bashkine Tirane, per ceshtjen "A jeni dakort qe ne territorin e Parkut Rinia te Bashkise Tirane, te ndertohet nje parkim nentokesor".

- Gjykimin e ceshtjes ne themel, miratimin e fletes-tip per mbledhjen e nenshkrimeve te nevojshme, te cilat duhet te depozitohen nga zgjedhes per paraqitjen e kerkeses ne Komisionin Qendror te Zgjedhjeve.

BAZALIGJORE: Nenet 145 e vijues, te Kodit Zgjedhor te Republikes se Shqiperise.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS APELIT TIRANË

Pasi degjoi perfaqesuesit e pales paditese Partia Demokratike e Shqiperise, qe kerkuan pranimin e padise sipas objektit; degjoi perfaqesuesit e pales se paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, qe kerkuan rrezimin e padise; degjoi perfaqesuesit e pales se interesuar Partia Socialiste e Shqiperise, qe kerkuan rrezimin e padise; si dhe pasi shqyrtoi ceshtjen ne teresi,

V E R E N

Ceshtja e paraqitur per gjykim lidhet me nje mosmarreveshje qe ka te beje me referendumet, proces ky qe, pervec se nga Kushtetuta e Republikes se Shqiperise, rregullohen ne menyre te posaçme me dispozitat e Kodit Zgjedhor te meparshem (miratuar me Ligjin Nr.9087, date 19.06.2003), nenet 118-132 te tij, dispozita vetem keto qe jane ne fuqi edhe sipas Kodit Zgjedhor aktual (miratuar me Ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008). Prandaj, per lehtësi, teresia e normave per referendumet ne Ligjin Nr.9087, date 19.06.2003, me poshte do te identifikohet si ligji per referendumet.

Rezulton se, me date 04.03.2016, mbështetur ne nenet 2/2 dhe 108/2/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe ne nenet 126 dhe 132 te ligjit per referendumet, një grup prej 12 nismëtarësh, i jane drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (me poshte referuar si KQZ) nepermjet nje kerkese për fillimin e procedurave

për zhvillimin e një referendumi vendor ne Bashkine Tirane, duke identifikuar si ceshtje qe duhet te shtrohej per referendum “A jeni dakord me vendimin nr.67, datë 30.12.2015, të Këshillit Bashkiak Tirane, për ndërtimin me koncesion të një parkimi nëntokësor tek Parku Rinia?”.

Ne kërkesën e tyre grupi nismëtar ka argumentuar se, nepermjet një procedurë të dyshimtë, duke injoruar shumë kërkesa ligjore, perfshire dhe dëgjesat publike, si dhe procesin e vlerësimit te ndikimit ne mjedis, sigurimin e ofertes nga kompania private etj, Këshilli Bashkiak Tirane ka marre Vendimin Nr.67, datë 30.12.2015, “Për miratimin e termave kryesorë të kontratës koncensionare mbi parkimin e nëntokësor në Parkun Rinia”, vendim nepermjet te cilit ndryshohej tipologjia e Parkut Rinia, pasi pjesa mbi toke nuk mund te kishte me peme, por vetem bar te ngjashem me barin e taracave, duke u prishur keshtu ky Park dhe shkatërruar ne kete menyre pjesa e fundit e mushkërive te qytetit Tirane per ndertimin e nje parkingu nentokesor, i cili mund te ndertohej ne zona te tjera te ndertuara qe nuk ishin parqe apo lulishte.

Sipas grupit nismëtar, në kushtet kur Këshilli Bashkiak Tirane, nepermjet Vendimit Nr.67, date 30.12.2015, në një proces të shkurtër, jo transparent dhe ne mungese te nje vlerësimi mjedisor sic kërkohet nga ligji, bente te domosdoshme që komuniteti i Bashkisë Tiranë të shprehej për këtë vendim nëpërmjet referendumit vendor.

Per kerkesen si me lart, KQZ-ja, ne përputhje me përcaktimet e neneve 126/2, 127/1 dhe 132/4 te ligjit per referendumet, paraprakisht ka verifikuar nëse nismëtarët e depozitimit të kërkesës ishin zgjedhës të Bashkisë Tiranë, ku pas verifikimit te bere ka rezultuar se ata ishin zgjedhës në kete njesi te veteqeverisjes vendore.

Me tej, ne Mbledhjen e dates 21.03.2016, KQZ-ja ka marre ne shqyrtim kerkesen si me lart, ku referuar përcaktimeve te neneve 126/5 dhe 132/4 te ligjit per referendumet, ka konstatuar se ishte i paqarte lloji i referendumit qe kërkohet te behej, pra nese kërkohet referendum për një çështje të rëndësisë së veçantë apo kërkohet një referendum shfuqizues (abrogues) i një akti administrativ, sikurse ishte Vendimi Nr.67, datë 30.12.2015, i Keshillit Bashkiak Tirane,

“Për miratimin e termave kryesorë të kontratës koncensionare mbi parkimin e nëntokësor në Parkun Rinia”, nderkohe qe nese do te ishim para rastit te dyte, pra para nje kerkese per referendum shfuqizues te një akti, atehere kërkesa formalisht nuk përmbushte kriteret e parashikuara në nenin 126/4 të ligjit per referendumet, pasi, as ne kerkese dhe as ne pyetjen e propozuar per t’u parashtruar per referendum nuk kërkohej shfuqizim i ndonje akti konkret, pervec se, ne thelb, kjo kerkese binte ndesh me nenin 150 te Kushtetutes, por edhe me ligjin per referendumet, te cilet parashikojne referendum te pergjithshem për shfuqizimin e një ligji, ndersa nuk parashikojne referendum lokal per shfuqizimin e një akti administrativ.

Mbas këtij konstatimi, po me date 21.03.2016, grupi nismëtar, nepermjet nje kerkese me shkrim, ka saktësuar se kërkohej fillimi i procedurave per zhvillimin e nje referendumi vendor ne Bashkine Tirane per nje ceshtje te rendesise se vecante, duke identifikuar tashme si ceshtje qe duhet te shtrohej per referendum pyetjen “A jeni dakord qe në territorin e Parkut Rinia të Bashkisë Tiranë, të ndërtohet një parkim nëntokësor?”.

Kjo kerkese e grupit te nismetareve, duke u konsideruar si kerkese per ndreqjen e te metave te kerkeses fillestare, bazuar ne nenin 68 te Kodit te Procedurave Administrative, eshte pranuar nga KQZ-ja, ne Mbledhjen e dates 23.03.2016, duke vijuar me shqyrtimin e metejshem te saj, tashme sipas saktësimit te bere nga grupi nismëtar.

Ne mbledhjen e KQZ-se per shqyrtimin e kerkeses kane marre pjese edhe perfaqesues te Partise Demokratike dhe te Partise Socialiste, parti politike parlamentare keto me status te perhershem prane KQZ-se.

Gjate shqyrtimit te kerkeses, KQZ-ja ka thirrur dhe marre sqarime nga perfaqesues te Keshillit Bashkiak Tirane.

Ne përfundim te shqyrtimit, KQZ-ja, me Vendimin Nr.6, date 23.03.2016, ka vendosur :

“Rrezimin e kërkesës së 12 nismëtarëve për pajisjen me fletë-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për referendum vendor për çështjen e qeverisjes vendore të Bashkisë Tiranë. “A jeni dakord në territorin e Parkut Rinia të Bashkisë Tiranë, të ndërtohet një parkim nëntokësor”.

Ne vendimin e saj, KQZ-ja, referuar dhe ceshtjeve objekt debati mes pjesemarrësve, ka arsyetuar se :

ne konsiderate te jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese (Vendimet 31/2003, 25/2009, 26/2010, 5/2011 dhe 8/2013), si dhe të praktikës së Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë (Vendimi 1/2015), lidhur me kufijtë e shqyrtimit nga KQZ-ja të kërkesës për zhvillimin e një referendumi, vlerëson se KQZ-ja ka të drejtën dhe detyrimin për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve në drejtim të llojit të referendumit për të cilin kërkohet fillimi i procedurave (i përgjithshëm apo vendor), në drejtim të ekzistencës dhe qartësisë së çështjes që shtrohet për referendum, në drejtim të rëndësise se saj, në drejtim të kufizimit në ushtrimin e të drejtës për referendum, përveç se edhe aspekte të tjera ligjore që do të gjejnë pasqyrim në fletën-tip për mbledhjen e nënshkrimeve, pra për të kontrolluar përputhshmërinë e kërkesës me legjislacionin e interesuar, duke qene ajo organi më i parë që kontrollon ligjshmërinë e kërkesës, që në ushtrim të kompetencave ligjore, nuk lejon fillimin e procedurave që bien në kundërshtim me ligjin;

kërkesa e grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Bashkinë Tiranë, duhet të rrezohet pasi :

ceshtja referendare që kërkohet lidhet me buxhetin e Bashkisë Tiranë, prandaj, në bazë të nenit 152/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo nuk mund të shtrohet për referendum, në rrethanat kur :

nga analiza e Vendimit Nr.67, datë 30.12.2015, të Këshillit Bashkiak Tiranë, “Për miratimin e termave kryesorë të kontratës koncesionare mbi parkimin e nëntokësor në Parkun Rinia”, si dhe shpjegimet e dhena nga përfaqësuesja e Këshillit Bashkiak Tiranë, rezulton se me këtë vendim Këshilli Bashkiak Tiranë ka përcaktuar termat kryesorë të kontratës koncesionare për një parkim nëntokësor, ku si bazë ligjore për marrjen e këtij vendimi, ndër të tjera, ka shërbyer dhe Ligji Nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, si dhe Ligji Nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndërkohe që pjesë e këtij vendimi është dhe Aneksi 1, “Tarifat referencë të parkimeve nëntokësore si dhe pajtimet periodike” për subjektin “Taiwan”, Parku Rinia, aneks në të cilin, në kriterin e dytë, është përcaktuar “tarifa koncesionare me oferte 15% të fitimit”;

koncepti i “tarifës së koncesionit” gjendet ne nenin 29 te Ligjit Nr.125/2013, “Per koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, sipas te cilit “1. ... 2. Tarifa koncesionare paguhet në përputhje me rregullat e caktuara nga ministri i Financave për arkëtimin e të ardhurave për llogari të buxhetit të shtetit. 3. ... 4. ... 5. Tarifat e koncesionit janë pjesë e të ardhurave të buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose të buxheteve të organeve të qeverisjes vendore”, c’ka, ne rastin konkret, do të thotë se tarifa koncesionare e parashikuar ne Aneksin 1 te vendimit si me lart te Keshillit Bashkiak Tirane është pjesë e buxhetit të Bashkisë Tiranë;

duke qenë se “tarifa koncesionare” e parashikuar ne Vendimin Nr.67, datë 30.12.2015, te Keshillit Bashkiak Tirane, sipas parashikimeve të nenit 29/5 të Ligjit Nr.125/2013 “Per koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, është pjesë e buxhetit të Bashkisë Tiranë, kërkesa fillestare për referendum qe adresohet drejtperdrejte tek ky vendim i Keshillit Bashkiak Tirane binte haptazi ndesh me kufizimet e përcaktuara ne nenin 152§2 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, sipas te cilit “Çështjet që lidhen me ..., me buxhetin, ... nuk mund të shtrohen në asnjë referendum”, nderkohe qe kjo situatë antikushtetueshmërie mbetet e tille edhe per kerkesen e modifikuar per referendum, ndryshimit nga grupi nismetar te pyetjes referendare duke mos e cituar drejtëpërsëdrejti vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë, pasi në hipotezën e miratimit të referendumit te kerkuar, pasoja e tij do t’i shtrinte realisht efektet mbi Vendimin Nr.67, datë 30.12.2015, të Këshillit Bashkiak Tiranë;

ceshtja referendare qe kërkohet, ne hipotezen e qenies se saj nje ceshtje e rendesise se veçante, ne baze te nenit 119/6 te ligjit per referendumet, nuk mund te shqyrtohet, ne rrethanat kur sipas kësaj dispozite kërkesat për referendum, qe nuk kane kaluar neper te gjitha procedurat e këtij kreu, brenda datës 15 mars te çdo viti, pavarësisht se kur janë paraqitur, shtyhen deri ne vitin pasardhës, nderkohe qe ne rastin konkret kërkesa e grupit nismëtar për fillimin e procedurave per referendum është depozituar në datë 04.03.2016, ku duke llogaritur afatet procedurale për veprimet e mëtejshme të parashikuara nga ligji për referendumet, kjo kërkesë nuk i ka kaluar të gjitha procedurat deri më datë 15 mars, prandaj në këto kushte ajo duhet te shtyhet për vitin tjetër;

ceshtja referendare qe kërkohet nuk perben nje ceshtje te rendesise se veçante ne kuptim te nenit 132/4 ne lidhje me nenin 126/5 te ligjit per referendumet, duke patur ne konsiderate per kete objektin e

saj, qe është ndërtimi i një parkimi nëntokësor, si dhe nga koha kur zgjedhësit do të duhet të shprehen për ndërtimin ose jo të tij, pervec se duke vlerësuar :

faktin qe ligji per referendumet nuk ka një parashikim konkret në lidhje me konceptin “çështje e veçantë”, ku nisur nga kjo, referuar per analogji jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese lidhur me interpretim përfundimtar të nenit 77/2 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë per nocionin “ceshtje te veçanta” (Vendimi Nr.18, datë 14.05.2003), një vendim i këshillit bashkiak, sic është dhe Vendimi Nr.67, datë 30.12.2015, i Keshillit Bashkiak Tirane, nuk mund të përbëjë çështje të veçantë persa kohe nuk përfshihet në asnjë nga elementët e përmendur nga Gjykata Kushtetuese;

se e drejta për referendum është një e drejtë kushtetuese që duhet zhvilluar në mënyrë të atillë, që të mos ndërhyjë pa kufizim në veprimtarinë e organeve të pushteteve të tjera, përfshirë edhe atyre te qeverisjes vendore, prandaj jo çdo vendim i këtyre organeve mund t'i nënshtrohet praktikave referendare pasi një mënyrë e tillë do të çonte në paralizë të veprimtarisë së këtyre organeve, nderkohe qe njihen edhe mjete të tjera të përshtatshme kushtetuese, për të kontrolluar veprimtarinë e organeve të qeverisjes vendore;

se referendumi, si nje instrument i rëndësishëm në një këndvështrim politiko-filozofik, është një mekanizëm i demokracisë së drejtëpërdrejtë, një procedurë që lejon qytetarët të marrin vendime politike drejtëpërdrejt nëpërmjet votës, por, nuk mund të përdoret në mënyrë abuzive dhe tej hapësirës dhe limiteve që Kushtetuta njej, prandaj ushtrimi i këtij mjete juridik kushtetues për ato çështje dhe në ato pushtete, dhe në mënyrën se si është parashtruar nga kërkuesit, do të dëmtonte këtë kompetencë kushtetuese.

Me date 21.04.2016, partia politike parlamentare me status te perhershem ne KQZ, Partia Demokratike e Shqiperise (me poshte referuar si PD), ka paraqitur para Kolegjit Zgjedhor nje kerkesepadi, me te cilen, duke paditur KQZ-ne, si dhe thirrur si pale te interesuar partine tjeter politike parlamentare me status te perhershem ne KQZ, Partine Socialiste te Shqiperise (me poshte referuar si PS), ka kundërshtuar Vendimin e KQZ-së Nr.6, date 23.03.2016, ndersa ka kërkuar gjithashtu edhe gjykimin e ceshtjes ne themel, miratimin e fletes-tip per mbledhjen e nënshkrimeve te nevojshme, te cilat duhet te depozitohen nga zgjedhes per paraqitjen e kerkeses ne KQZ.

Ne kërkesepadi, si dhe gjate shqyrtimit gjyqësor, pala paditese PD pretendoi se vendimi objekt padie i KQZ-se eshte marre ne kundërshtim me ligjin dhe kompetencat e dhena nga ai, pasi :

ligji per referendumet ka parashikuar kontroll te ligjshmerise se kërkeses per referendum nga KQZ-ja vetem ne pikëpamje formale, pra nese kërkesa ishte paraqitur ose jo nga 12 zgjedhes te asaj njesie te qeverisjes vendore, nese kërkeses i jane bashkëlidhur certifikatat perkatese etj, ndersa kontrollin e zbatueshmerise te nenit 126/5 ligji ia ka dhene Gjykates Kushtetuese, ku ne kete kuptim, ne rastin konkret, KQZ-ja kishte marre atributet e Gjykates Kushtetuese;

KQZ-ja ia dha kompetence vetes te shqyrtonte ne kete faze objektin e kërkeses se grupit te nismetareve, por edhe sikur te pranohej qe KQZ-ja ishte institucioni qe kishte kete kompetence, arsyetimi i përdorur nga ajo per rrezimin e kërkeses ishte ne kundërshtim me nenin 108/4 te Kushtetutes dhe nenet 126/5, 127 e 132/1/4 te ligjit per referendumet, duke i hequr ajo padrejtësisht grupit nismëtar te drejten per te thirrur zgjedhesit e njesise se qeverisjes vendore Bashkia Tirane per te vendosur per nje ceshtje te rendesishme sic ishte ndotja e mjedisit ku qytetaret dhe femijet e tyre zhvillonin jeten e përditshme;

ishte i pabazuar arsyetimi i KQZ se ceshtja qe kërkohej per t'u shtruar ne referendum ishte nje ceshtjes qe kishte lidhje me buxhetin e Bashkise Tirane sepse, referuar Ligjit Nr.8652, date 31.07.2000, "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ku përcaktohen dhe procedurat dhe aktet me te cilat njesite e qeverisjes vendore miratojne buxhetet e tyre, kërkesa e nismetareve ne rastin konkret, ceshtja qe ata kerkojne te shtrohet ne referendum, pra "A jeni dakort qe ne territorin e Parkut Rinia te Bashkise Tirane, te ndertohet nje parkim nentokesor?", nuk kishte asnjë lidhje me aktet te cilat miratojne buxhetin e Bashkise Tirane, sikundër nuk kishte asnjë lidhje as me Vendimin Nr.67, date 30.12.2015, te Keshillit Bashkiak Tirane, pasi ajo kishte te bente me ndertimet ne ambientet publike te kësaj bashkie, me mjedisin dhe ndotjen e tij;

ne vendimin e saj KQZ-ja nuk i referohet asnjë dispozite kushtetuese dhe ligjore qe kufizon te drejten e zgjedhesve per te kërkuar

referendum vendor per ceshtje qe i përkasin hapësirave te gjelberta te qytetit te tyre, parqeve dhe lulishteve;

duke qene se ceshtja e paraqitur per referendum eshte e qarte, se ajo eshte nje ceshtje vendore, ndersa plotësohen te gjitha kushtet ligjore, duhet te miratohej fleta-tip dhe te pajisej me to grupi nismëtar per mbledhjen e nënshkrimeve te nevojshme, qe duhet te depozitohen nga zgjedhes per paraqitjen e kerkeses ne KQZ. Perkunder pretendimeve te pales paditese, pala e paditur KQZ ka prapësuar, duke mbajtur te njëjtin qëndrim si dhe ne vendimin e saj objekt gjykimi.

Po keshtu, edhe pala e interesuar PS, kundërshtoi pretendimet e ngritura nga pala paditese, duke konsideruar te drejta përfundimet e arritura nga KQZ-ja ne vendimin e saj objekt gjykimi. Gjate gjykimit, Kolegji Zgjedhor administroi si prova shkesore praktiken dokumentare te vendimit objekt ankimi, paraqitur nga pala e paditur KQZ.

Ne përfundim te shqyrtimit, ne konsiderate te ceshtjeve objekt i debatit gjyqësor, si dhe fakteve te rezultuara nga provat e marra gjate gjykimit, Kolegji Zgjedhor cmon se padia e paraqitur nga pala paditese PD eshte e pabazuar ne ligj dhe prova.

Konkretisht, Kolegji Zgjedhor cmon te pabazuara pretendimet e ngritura nga pala paditese, per kompetencen e KQZ-se dhe kufijte e shqyrtimit prej saj te kerkeses per fillimin e procedurave per zhvillimin e referendumit, ne rastin konkret te nje referendumi vendor ne Bashkine Tirane.

Lidhur me kete moment, rezulton qe Kolegji Zgjedhor, me heret, me Vendimin Nr.1, date 14.01.2015, te kete trajtuar gjerësisht dhe me hollesi te njëjtat pretendime te paraqitura edhe ne rastin konkret, qëndrim ky i Kolegjit Zgjedhor qe eshte mbajtur parasysht dhe nga KQZ-ja ne vendimin objekt ankimi ne kete rast.

Duke rikonsideruar teresisht qëndrimin e tij te meparshem, pa patur vend per te riparashtruar analizen dhe vlerësimet e veta per keto ceshtje te ligjit, Kolegji Zgjedhor, cmon se KQZ-ja, ndryshe nga sa pala paditese ne kete gjykim pretendon, ka vepruar ne respektim te ligjit dhe brenda kompetencave te saj ne shqyrtimin ne rastin konkret

te kerkeses se nje grupi nismetaresh per fillimin e procedurave te referendumit, për pajisjen me fletë-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për referendum vendor për çështjen e qeverisjes vendore të Bashkisë Tiranë “A jeni dakort qe ne territorin e Parkut Rinia te Bashkise Tirane, te ndertohet nje parkim nentokesor?”.

Ne vijim, Kolegji Zgjedhor cmon se, ndryshe nga sa pala paditese pretendon, ne thelb vendimi objekt ankimi i KQZ-se gjendet i ligjshem.

Keshtu, rezulton qe si shkak per paraqitjen e kerkeses se grupit nismëtar per fillimin e procedurave te referendumit ne rastin konkret ka shërbyer marrja e Vendimit Nr.67, date 30.12.2015, te Këshillit Bashkiak Tirane, “Per miratimin e termave kryesore te kontrates koncensionare per parkimin nentokesor ne Parkun Rinia”.

Ky vendim i Keshillit Bashkiak Tirane rezulton te jete marre mbi propozim te Kryetarit te Bashkise Tirane, duke u mbështetur :

ne nenin 7/2, 10/3/l/d/ë, 32/e/f/k dhe 33/3/4 te Ligjit Nr.8652, date 31.07.2000, “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar;

nenin 48 te Ligjit Nr.125/2013, date 25.04.2013, “Per koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar;

Ligjin Nr.10296, date 08.07.2010, “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

VKM Nr.1181, date 23.07.2008, “Per përcaktimin e autoritetit kontraktues, per dhenien me koncesion vendor te parkimit nentokesor, ne Parkun “Rinia”, Tirane dhe miratimin e bonuesit, ne proceduren perzgjedhese konkurruese, qe i jepet shoqerise”;

VKM Nr.843, date 13.12.2006, “Per miratimin e listes se pjeshme te inventarit te pronave te paluajtshme shteterore, qe jane ne juridiksionin territorial dhe administrativ te Bashkise Tirane te Qarkut te Tiranës”;

VKM Nr.798, date 30.09.2015, “Per shfuqizimin e Vendimit Nr.1233, date 11.12.2009, te Keshillit te Ministrave, “Per kalimin ne

pergjegjesi administrimi Ministrise se Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit te siperfaqes se truallit te Parkut "Rinia", Tirane";

Udhezimin e Ministrit te Financave Nr.30, date 27.12.2011, "Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik", i ndryshuar;

Vendimin e Keshillit Bashkiak Nr.36, date 29.09.2008, "Per përcaktimin e formes se dhënies me koncesion te dy parkimeve nentokesore ne qytetin e Tiranës";

Raportin Permbledhes Nr.4663 prot., date 20.05.2009, "Mbi vlerësimin e ofertave per dhënien me koncesion vendor te parkimit nentokesor ne Parkun "Rinia", Tirane";

Shkresen e Kryetarit te Komisionit te Vleresimit te Ofertave Nr.4207 prot., date 06.05.2009, "Njoftim mbi vlerësimin dhe klasifikimin e shoqerise".

Nepermjet këtij vendimi, Keshilli Bashkiak Tirane ka vendosur :

"1. Te miratoje termat kryesore te kontrates koncesionare per parkimin nentokesore ne Parkun "Rinia", i cili do te realizohet nga koncesionari, Shoqeria "Taiwan" shpk, sipas ankesit nr.1 bashkelidhur këtij vendimi".

2. Koncesionari do te realizoje punimet mbi bazen e kontrates koncesionare dhe sipas procedurave ligjore ne fuqi per planifikimin e territorit, tek Parku "Rinia", me numer pasurie 7/187, ne zonen kadastrale nr.8380.

3. Koncesionari detyrohet qe, pas ndertimit te objektit dhe përpara fillimit te operimit te shërbimit, te realizoje punimet qe te ktheje mbitokene ne destinacionin aktual, perkatesisht ne park.

4. Koncesionari ndalohet te kolateralizojë per efekt financimi te investimit dhe shërbimit, truallin dhe objektin ndërtimor, pasuri te cilat mbeten te lira nga cdo barre dhe risk gjate periudhes koncesionare.

5. Te kryhet kontabilizimi i vlerave te investimeve perkatesisht per Parkun "Rinia", me numer pasurie 7/187, ne zonen kadastrale nr.8380. Te reflektohen ndryshimet kontabël duke zbritur vetem

vlerat perkatese te investimeve qe rezultojnë brenda siperfaqes, qe do te jepet me koncesion dhe do te ndjeke procedurat ligjore per dorezimin e saj ndaj koncesionarit. Me përfundimin e ndertimit te parkimit nentokesor dhe rikthimin ne destinacionin aktual te siperfaqes se mbitokes, koncesionari do te beje kalimin e vlerave perkatese kontabël Bashkise se Tiranes.

6. Koncesionari ne përfundim te Kontrates Koncesionare, i kalon Bashkise se Tiranes pronen sipas genplanit bashkëlidhur.

7. Autorizohet Kryetari i Bashkise Tirane te nenshkruaje kontraten koncesionare sipas përcaktimeve te këtij vendimi dhe procedurave ligjore.

8. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohen strukturat e Bashkise Tirane.

9. Ky vendim hyn ne fuqi sipas pikes 6 te nenit 33, te Ligjit Nr.8652, date 31.07.2000, "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" (i ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tirane".

Me tej, ne Aneksin 1 bashkelidhur këtij vendimi te Këshillit Bashkiak Tirane, jane percaktuar tarifat e parkimit, tarifa koncesionare (15% e fitimit), numri maksimal i vendparkimeve (1.342), numri maksimal i vendparkimeve per kategori te veçanta, tarifat e posaçme te parkimit per kategori te veçanta, koha e venies ne shfrytezim e vepres (15 muaj), kohëzgjatja e koncesionit (30 vjet) dhe vlera e investimit (1.937.932.800 leke).

Nga grupi nismëtar eshte argumentuar rëndësia e çështjes për banoret e qytetit Tirane, duke pretenduar se në marrjen e atij vendimi Këshilli Bashkiak Tirane, ne nje proces te shkurter, te nxituar, jotransparent ne lidhje me opsionin e miratuar, nuk ishte konsultuar me publikun dhe as nuk kishte realizuar nje proces vlerësimi per ndikimin ne mjedis.

Me tej, sipas grupit nismëtar, ky vendim i Këshilli Bashkiak Tirane (Vendimi Nr.67, date 30.12.2015), ndersa lejonte ndertimin e nje parkimi nentokesor ne Parkun "Rinia", do te ndryshonte përfundimisht tipologjine e këtij Parku pasi pjesa mbitoke nuk do te kishte me peme, por vetem bar te ngjashem me barin e taracave, c'ka do te

prishte kete Park dhe shkatërronte pjeset e fundit te mushkërive te qytetit te Tiranes dhe demtuar ne kete menyre cilesine e jetes se banoreve te saj, gje per te cilen ishte e domosdoshme qe banoret e Bashkise Tirane të shprehnin mendimin e tyre për ndertimin ose jo te nje parkimi nentokesor tek Parku “Rinia”.

Nderkohe, KQZ-ja, ceshtjen qe grupi nismëtar ka paraqitur per t’u shtruar ne referendum vendor ne Bashkine Tirane, e ka konsideruar si nje ceshtje qe lidhej me buxhetin e kësaj njesie te vetëqeverisjes vendore dhe qe si e tille, bazuar ne nenin 151/2 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, nuk mund te shtrohej per referendum.

Po keshtu, KQZ-ja, bazuar ne nenin 119/6 te ligjit per referendumet, ka konsideruar se kërkesa e grupit nismëtar per fillimin e procedurave per zhvillimin e referendumit, ndersa shqyrtimi i saj neper te gjitha procedurat nuk kishte përfunduar deri me daten 15 mars, duhet te shtyhej per vitin tjetër.

Gjithashtu, KQZ-ja, ceshtjen qe grupi nismëtar ka paraqitur per t’u shtruar ne referendum vendor ne Bashkine Tirane, nuk e ka konsideruar si ceshtje me rendesi te veçante qe meritonte te shtrohej per referendum vendor.

Argumentet si me lart te KQZ-se per rrezimin e kerkeses se grupit nismëtar, jane kundërshtuar nga pala paditese PD nepermjet ankimit/padise se paraqitur.

Nga sa me lart u parashtua, Kolegji Zgjedhor gjen te drejta pretendimet e ngritura ne ankim, duke vlerësuar te pabazuar argumentin e KQZ-se se ceshtja qe kërkohej nga grupi nismëtar nuk mund te shtrohej per referendum vendor per shkak te qenies se saj nje ceshtje qe lidhej me buxhetin e Bashkise Tirane.

Kolegji Zgjedhor cmon se ne rastin konkret, ceshtja qe kërkohej per t’u shtruar ne referendum vendor, pra “A jeni dakort qe ne territorin e Parkut Rinia te Bashkise Tirane, te ndertohet nje parkim nentokesor?”, ne pamje te pare nuk ka lidhje me aktin juridik qe KQZ-ja i referohet, pra me Vendimin Nr.67, date 30.12.2015, te Keshillit Bashkiak Tirane.

Keshtu, ceshtja qe kërkohej per t’u shtruar ne referendum ka te beje me ndertimin e nje objekti ne nje territor te caktuar te Bashkise Tirane, pra ne thelb ka te beje me planifikimin e këtij territori.

Ndersa, akti juridik qe KQZ-ja i referohet, vendimi i Keshillit Bashkiak Tirane, eshte nje prej akteve finale te nje procedure koncesioni te ndjekur sipas kërkesave te Ligjit Nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, i ndryshuar, dispozitat e te cilit kane gene te zbatueshme ne rastin konkret pavarësisht shfuqizimit te këtij ligji (referuar nenit 48 te ligjit shfuqizues, Ligjit Nr.125/2013, date 25.04.2013, “Per koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar), përderisa, nga sa rezulton, jemi para nje procedure koncesionare qe vijonte prej disa vitesh.

Eshte e qarte se procedura koncesionare ne kete rast synon realizimin/jetesimin e zhvillimit te atij territori sipas planifikimit te bere me heret te tij.

Pra, pavarësisht se ne dukje ceshtja e planifikimit te territorit te Parkut “Rinia” eshte e ndryshme nga ceshtja e koncesionit te parkimit nentokesor tek Parku “Rinia”, te dy ato lidhen pikërisht me ndertimin e parkimit nentokesor ne kete territor, persa kohe planifikimi i territorit dhe zhvillimi i tij jane te lidhura pazgjidhshmërisht me njeri-tjetrin.

Por, pavarësisht kësaj, pra pavarësisht se ceshtja objekt kerkese per referendum indirekt prek dhe procedurat e koncesionit te realizuara ne rastin konkret (ne nje suate hipotetike objekti i koncesionit mund te behej i pamundur), Kolegji Zgjedhor cmon se procedura e koncesionit ne kete rast, sikundër dhe akti juridik qe KQZ-ja i referohet (Vendimi Nr.67, date 30.12.2015, i Keshillit Bashkiak Tirane), nuk mund te perbejne ceshtje te buxhetit te Bashkise Tirane ne kuptim te nenit 151/2 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise. Qellimi i koncesioneve eshte përmbushja e funksioneve qeverisese, nepermjet realizimit te puneve dhe shërbimeve publike nga sektorit privat, ndersa rregullohen me ligj te veçante, ligj ky qe nuk përfshihet rrethin e atyre ligjeve qe rregullojne financat publike (ligjet per buxhetin, taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore). Fakti qe ne nje koncesion vendor njesia e vetëqeverisjes vendore realizon përfitime (si dhe ne rastin konkret) qe sipas ligjit shkojne ne favor te buxhetit te saj, nuk e bejne koncesionin ne vetvete, sikundër dhe ate akt te Keshillit Bashkiak Tirane qe ka miratuar termat kryesore te kontrates se koncesionit, nder te tjera, edhe tarifen koncesionare (percaktuar ne ate procedure konkurimi publik), nje ceshtje te buxhetit vendor te Bashkise Tirane.

Per rrjedhoje, ndryshe nga sa KQZ-ja ka pranuar, Kolegji Zgjedhor cmon se ceshtja objekt kerkese per referendum vendor nuk lidhet

me buxhetin vendor te Bashkise Tirane, duke mos ekzistuar ne kete rast ndalimi per referendum qe ben fjale neni 151/2 i Kushtetutes se Republikes se Shqiperise.

Ne vijim, Kolegji Zgjedhor konstaton se KQZ-ja, me tej, per rrezimin e kerkeses se grupit te nismetareve ka parashtruar dy argumente qe jane ne kontradite me njeri-tjetrin.

Keshtu, referuar nenit 119/6 te ligjit per referendumet, KQZ-ja arsyeton se kerkesa per fillimin e procedurave per zhvillimin e referendumit vendor duhet te shtyhet, përdërisa ka kaluar data 15 mars dhe procedurat e nevojshme nuk kishin përfunduar. Nderkohe, nga ana tjetër, nepermjet argumentit te parashtruar ne vijim, por edhe atij te parashtruar me pare (si me lart), KQZ-ja ne fakt ka shqyrtuar kerkesen e grupit nismëtar, duke dale me vendim përfundimtar per refuzimin e saj.

Kolegji Zgjedhor cmon te pabazuar, jo vetem ne thelb, por edhe ne funksion te rrezimit te kerkeses, argumentin e përdorur nga KQZ-ja ne referim te nenit 119/6 te ligjit per referendumet. Fakti qe procedurat e nevojshme te trajtimit te kerkeses per referendum vendor ne rastin konkret nuk kane përfunduar deri me date 15 mars 2016, nuk pengojne shqyrtimin e kerkeses ne kete rast. Neni 119/6 i ligjit per referendumet, qe parashikon se “kërkesat për referendum, qe nuk kane kaluar neper te gjitha procedurat e këtij kreu, brenda datës 15 mars te çdo viti, pavarësisht se kur janë paraqitur, shtyhen deri ne vitin pasardhës”, i referohet nenit 152/3 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, qe parashikon se “Gjatë vitit referendumet zhvillohen vetëm në një ditë”. Nisur nga ajo c’ka kushtetutberesi ka synuar nepermjet këtij rregullimi, vlerësuar ne harmoni me rregullimin e bere ne nenin 119/6 te ligjit per referendumet, pamundësohet zhvillimi i referendumit ne vitin kur procedurat e shqyrtimit te kerkeses per referendum kane përfunduar pertej dates 15 mars te atij viti. Nje rregullim i tille nuk vendos kufizime ne raport me shqyrtimin e kerkeses per referendum dhe, aq me pak, e ben te pabazuar kerkesen.

Nderkohe, Kolegji Zgjedhor, ndryshe nga sa pretendohet ne ankim, cmon te bazuar përfundimin e KQZ-se se ne rastin konkret ceshtja qe grupi nismëtar ka paraqitur per t’u shtruar ne referendum vendor ne Bashkine Tirane, nuk perben ceshtje me rendesi te veçante qe meritonte te shtrohej per referendum vendor.

Nga sa me lart u parashtrua, Kolegji Zgjedhor vlerëson se kërkesa per referendum e grupit nismëtar nuk plotëson elementet e saktësisë dhe qartësisë ne kuptim te nenit 126/5 te ligjit per referendumet. Konkretisht, Kolegji Zgjedhor cmon se ne rastin konkret mungon lidhja logjike mes arsyes se kërkeses per referendum me ceshtjen qe kërkohet te shtrohet per referendum. Keshtu, ndersa arsyeja e artikuluar nga nismetaret e kërkeses per referendum eshte “mos ndryshimi i tipologjise se mbitokes te Parkut “Rinia”, ajo c’ka synohet ne fakt nepermjet ceshtjes qe kërkohet te shtrohet per referendum eshte “ndalimi i ndertimit te parkingut nentokesor tek Parku “Rinia”. Duket qe ka nje mospërputhje mes arsyes per referendum (qe lidhet me planifikimin e mbitokes se territorit tek Parku “Rinia”) dhe qëllimit qe synohet te arrihet nepermjet tij (mos zhvillimin e territorit te nentokes tek Parku “Rinia” sipas planifikimit te tij).

Përcaktimi i destinacionit te përdorimit te mbitokes se nje territori te caktuar nuk nenkupton njëherazi edhe përcaktimin e destinacionit te përdorimit te nentokes se këtij territori. Mundet, kur edhe per nentoken e nje territori te jete percaktuar nje destinacion, qe destinacioni i mbitokes me ate te nentokes te jene te ndryshme dhe te mos cenojne njeri-tjetrin. Ne rastin konkret, nuk argumentohet se perse destinacioni i nentokes se territorit te Parkut “Rinia”, percaktuar per ndertim parkingu nentokesor, cenon destinacionin e mbitokes se këtij Parku, përjashtuar periudhen e përkohshme te kryerjes se punimeve te ndertimit nentokesor. Sipas termave te miratuara te kontrates se koncesionit (Vendimi Nr.67, date 30.12.2015, i Keshillit Bashkiak Tirane), koncesionari ka detyrimin qe, pas ndertimit te objektit (percaktuar 15 muaj) dhe përpara fillimit te operimit te shërbimit, te realizoje punimet qe te ktheje mbitoken e Parkut “Rinia” ne destinacionin aktual, perkatesisht ne park. Pra, pas periudhes se përkohshme te kryerjes se punimeve te ndertimit te parkingut nentokesor, mbitoka e territorit te Parkut “Rinia” do te ruaje te njëjtin destinacion me ate aktual, c’ka do te thote se destinacioni aktual i këtij Parku do te humbase perkohesisht vetem gjate periudhes se kryerjes se punimeve. Nisur nga kjo, e gjithë situata e konsideruar nga nismetaret ne kërkesen e tyre per referendum, praktikisht permblidhet ne nje periudhe kohore disa mujore. Atehere, pyetja qe shtrohet eshte se a mundet qe kjo situata e përkohshme disa mujore e humbjes se destinacionit te Parkut “Rinia” te beje me rendesi te veçante ceshtjen qe grupi nismëtar ka kërkuar per t’u shtruan per

referendum vendor. Ne vlerësim të Kolegjit Zgjedhor, sikundër dhe KQZ-ja ka konkluduar, një situatë e tillë nuk mund të shërbejë si shkak dhe të motivojë shtrimin domosdoshmerisht në referendum të çështjes së kërkuar në rastin konkret.

Nderkohe, lidhur me pretendimet e paraqitura dhe nga grupi nismëtar, për mungesën e konsultimeve me publikun apo për mosmarrjen e një vlerësimi të ndikimit në mjedis në rastin e marrjes së Vendimit Nr.67, datë 30.12.2015, të Keshillit Bashkiak Tiranë, “Për miratimin e termave kryesore të kontratës koncesionare për parkimin nentokesor në Parkun Rinia”, Kolegji Zgjedhor cmon se pretendime të kësaj natyre, jo vetëm nuk kanë të bëjnë me këtë vendim të Keshillit Bashkiak Tiranë, por ato nuk kanë të bëjnë as me rëndësinë e veçante të çështjes për referendum në funksion të të cilit parashtrihen. Këto pretendime kanë të bëjnë me ligjshmerinë e vendimit për planifikimin e territorit të Parkut “Rinia”, për të cilat legjislativi në fuqi ka parashikuar mjete të posaçme për adresimin e tyre në funksion të kontrollit të vendimmarrjeve për të cilat pretendohet se kanë impakt në mjedis.

Në përfundim, Kolegji Zgjedhor ka në konsideratë dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, ku në disa raste ajo ka evidentuar se “Sovraniteti i popullit, i vendosur në kuadrin e një sistemi kushtetues e ligjor, nuk mund të ngatërrohet me pushtetin themelor dhe kërkesa për të ndjekur disa procedura të veçanta, gjatë ushtrimit të tij, është tërësisht në përputhje me sovranitetin popullor. Kushtetuta, në mënyrë të qartë, e ka lidhur ushtrimin e sovranitetit popullor me rregulla të veçanta. Është e vërtetë se në përputhje me nenin 2, pika 1, të Kushtetutës “*sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i takon popullit*”. Por, ky deklaram nuk nënkupton ushtrimin e sovranitetit nga populli në mënyrë të pakushtëzuar. Çdo nen i Kushtetutës duhet të interpretohet në kontekstin e Kushtetutës si një e tërë dhe jo i izoluar”.

Nga sa më lart, Kolegji Zgjedhor vlerëson se kërkesa e grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit vendor me të drejtë nuk është pranuar nga KQZ-ja, duke qenë e pabazuar në prova e ligj ankimi/paditë e paraqitur nga pala paditëse PD, që si e tillë ajo duhet të rrezohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykeses se Apelit Tirane,
bazuar ne nenin 158, pika 1, shkronja "b" dhe pika 3,
te Kodit Zgjedhor te ndryshuar,

ANËTAR

GJINOVEFA GABA

(Kunder)

ANËTAR

PETRIT ÇENO

KRYESUES

KLITON SPAHIU

ANËTAR

FUAT VJERDHA

ANËTAR

ILIR TOSKA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANE
KOLEGJI ZGJEDHOR

Nr.3 Regj. Themeltar
Nr.3 Vendimi

Datë 21.04.2016
Datë 16.05.2016

V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegji Zgjedhor i Gjykeses se Apelit Tirane i perbere nga gjyqtaret:

KRYESUES: ILIR TOSKA
ANETAR: PETRIT ÇENO
ANETAR: FUAT VJERDHA
ANETAR: VALBON ÇEKREZI
ANETAR: KLITON SPAHIU

asistuar prej sekretares Rexhina Baci, në Tiranë, sot me datë 16.05.2016, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore, që u përket paleve:

PADITËSE : PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE,me Seli ne
Tirane, Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 11, përfaqësuar

ne gjykim me autorizim nga Z.Ivi Kaso dhe Z.Spiro Dodbiba.

I PADITUR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, me Seli ne Tirane, Rruga "Ibrahim Rugova", Nr.4, përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Znj.Deshira Pasko, Z.Olsi Peto dhe Znj. Anila Ruço.

PALE E INTERESUAR: PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE, me Seli ne Tirane, Sheshi "Austria", Nr.91, përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Znj.Klotilda Bushka dhe Z.Gledian Llatja.

OBJEKTI: - Kundershtimi i Vendimit Nr.7, date 23.03.2016, te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, "Per shqyrtimin e kerkeses se nje grupi nismetarësh per fillimin e procedurave, per zhvillimin e nje referendumi vendor ne Bashkine Tirane, per ceshtjen "A jeni dakort qe brenda Parkut te Liqenit ne Bashkine Tirane, ne te dy anet e Korpusit te Universitetit Politeknik te ndertohen objekte, qofshin keto edhe social-kulturore, universitare apo administrative".

- Gjykimin e ceshtjes ne themel, miratimin e fletes-tip per mbledhjen e nënshkrimeve te nevojshme, te cilat duhet te depozitohen nga zgjedhes per paraqitjen e kerkeses ne Komisionin Qendror te Zgjedhjeve.

BAZALIGJORE: Nenet 145 e vijues, te Kodit Zgjedhor te Republikes se Shqiperise.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS APELIT TIRANË

Pasi degjoi perfaqesuesit e pales paditese Partia Demokratike e Shqiperise, qe kerkuan pranimin e padise sipas objektit; degjoi perfaqesuesit e pales se paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, qe kerkuan rrezimin e padise; degjoi perfaqesuesit e pales se interesuar Partia Socialiste e Shqiperise, qe kerkuan rrezimin e padise; si dhe pasi shqyrtoi ceshtjen ne teresi,

VEREN

Ceshtja e paraqitur per gjykim lidhet me nje mosmarreveshje qe ka te beje me referendumet, proces ky qe, pervec se nga Kushtetuta e Republikes se Shqiperise, rregullohen ne menyre te posaçme me dispozitat e Kodit Zgjedhor te meparshem (miratuar me Ligjin Nr.9087, date 19.06.2003), nenet 118-132 te tij, dispozita vetem keto qe jane ne fuqi edhe sipas Kodit Zgjedhor aktual (miratuar me Ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008). Prandaj, per lehtësi, teresia e normave per referendumet ne Ligjin Nr.9087, date 19.06.2003, me poshte do te identifikohet si ligji per referendumet.

Rezulton se, me date 04.03.2016, mbështetur ne nenet 2/2 dhe 108/2/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe ne nenet 126 dhe 132 te ligjit per referendumet, një grup prej 12 nismëtarësh, i jane drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (me poshte referuar si KQZ) nepermjet nje kërkesë për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor ne Bashkine Tirane, duke identifikuar si ceshtje qe duhet te shtrohej per referendum “A jeni dakord me vendimin për të ndërtuar objekte social-kulturore, universitare dhe administrative në dy anët e korpusit të Universitetit Politeknik?”.

Ne kërkesën e tyre grupi nismëtar ka argumentuar se, nepermjet një procedurë të dyshimtë, duke injoruar shumë kërkesa ligjore, perfshire dhe dëgjesat publike, si dhe procesin e vlerësimit te ndikimit ne mjedis, Këshilli Kombëtar i Territorit ka marre Vendimin Nr.11, datë 16.02.2015, i Këshillit Kombëtar te Territorit, “Per miratimin e zonimit funksional të hyrjes së parkut të Liqenit të Tiranës pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, si dhe marrjen e nismës për hartimin e Planit të Detajuar dhe projekteve zhvillimore brenda këtij territori”, vendim nepermjet te cilit :

shumë lulishte kthehen në pallate shumëkatëshe, si dhe shumë zona kulturore dhe zona të gjelbra kthehen në zona ndërtimore, pasi ne kete vendim sipërfaqet e gjelbra në të dy anët e Korpusit të Universitetit Politeknik përcaktohen si “objekte social-kulturore, universitare dhe administrative”, duke hequr keshtu këto sipërfaqe nga zonat e gjelbra të Parkut te Liqenit;

do të shkatërrohej pjesa hyrëse e Parkut të Liqenit, që shërbente si mushkeria kryesore e qytetit, për të ndërtuar objekte shumëkatëshe qëllimisht të quajtura social-kulturore, universitare dhe administrative.

Sipas grupit nismëtar, në kushtet kur Këshilli Kombëtar i Territorit, nepermjet Vendimit Nr.11, date 16.02.2016, në një proces të shkurtër, jo transparent dhe në mungesë të një vlerësimi mjedisor sic kërkohet nga ligji, bente të domosdoshme që komuniteti i Bashkisë Tiranë të shprehej për këtë vendim nëpërmjet referendumit vendor.

Per kerkesen si me lart, KQZ-ja, në përputhje me përcaktimet e neneve 126/2, 127/1 dhe 132/4 të ligjit për referendumet, paraprakisht ka verifikuar nëse nismëtarët e depozitimit të kërkesës ishin zgjedhës të Bashkisë Tiranë, ku pas verifikimit të bere ka rezultuar se ata ishin zgjedhës në kete njesi të veteqeverisjes vendore.

Me tej, në Mbledhjen e dates 21.03.2016, KQZ-ja ka marrë në shqyrtim kerkesen si me lart, ku referuar përcaktimeve të neneve 126/5 dhe 132/4 të ligjit për referendumet, ka konstatuar se ishte e paqarte lloji i referendumit që kërkohet të bëhet, pra nëse kërkohet referendum për një çështje të rëndësishme së veçantë apo kërkohet një referendum shfuqizues (abrogues) të një akti administrativ, sikurse ishte Vendimi Nr.11, datë 16.02.2016, i Keshillit Kombëtar të Territorit, "Për miratimin e zonimit funksional të hyrjes së parkut të liqenit të Tiranës, pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, si dhe marrjen e nismës për hartimin e planit të detajuar dhe projekteve zhvillimore brenda këtij territori", nderkohe që nëse do të ishim para rastit të dytë, pra para një kerkese për referendum shfuqizues të një akti, atehere kërkesa formalisht nuk përmbushte kriteret e parashikuara në nenin 126/4 të ligjit për referendumet, pasi, as në kerkese dhe as në pyetjen e propozuar për t'u parashtruar për referendum nuk kërkohet shfuqizim i ndonjë akti konkret, përveç se, në thelb, kjo kerkese binte ndesh me nenin 150 të Kushtetutës, por edhe me ligjin për referendumet, të cilët parashikojnë referendum të përgjithshëm për shfuqizimin e një ligji, ndërsa nuk parashikojnë referendum lokal për shfuqizimin e një akti administrativ.

Mbas këtij konstatimi, po me date 21.03.2016, grupi nismëtar, nepermjet nje kerkese me shkrim, ka saktësuar se kërkohet fillimi i procedurave per zhvillimin e nje referendumi vendor ne Bashkine Tirane per nje ceshtje te rendesise se vecante, duke identifikuar tashme si ceshtje qe duhet te shtrohet per referendum pyetjen “A jeni dakord që brenda Parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë, në të dy anët e Korpusit të Universitetit Politeknik të ndërtohen objekte, qofshin këto edhe social-kulturore, universitare apo administrative?”.

Kjo kerkese e grupit te nismetareve, duke u konsideruar si kerkese per ndreqjen e te metave te kerkeses fillestare, bazuar ne nenin 68 te Kodit te Procedurave Administrative, eshte pranuar nga KQZ-ja, ne Mbledhjen e dates 23.03.2016, duke vijuar me shqyrtimin e metejshem te saj, tashme sipas saktësimit te bere nga grupi nismëtar.

Ne mbledhjen e KQZ-se per shqyrtimin e kerkeses kane marre pjese edhe perfaqesues te Partise Demokratike dhe te Partise Socialiste, parti politike parlamentare keto me status te perhershëm prane KQZ-se.

Gjate shqyrtimit te kerkeses, KQZ-ja ka thirrur dhe marre sqarime nga perfaqesues te Keshillit Bashkiak Tirane.

Ne përfundim te shqyrtimit, KQZ-ja, me Vendimin Nr.7, date 23.03.2016, ka vendosur :

“Rrezimin e kërkesës së 12 nismëtarëve për paisjen me fletë-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për referendum vendor për çështjen e qeverisjes vendore të Bashkisë Tiranë. “A jeni dakord që brenda Parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë, në të dy anët e Korpusit të Universitetit Politeknik të ndërtohen objekte, qofshin këto edhe social-kulturore, universitare apo administrative?”.

Ne vendimin e saj, KQZ-ja, referuar dhe ceshtjeve objekt debati mes pjesemarresve, ka arsyetuar se :

ne konsiderate te jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese (Vendimet 31/2003, 25/2009, 26/2010, 5/2011 dhe 8/2013), si dhe të praktikës së Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së

Apelit Tiranë (Vendimi 1/2015), lidhur me kufijtë e shqyrtimit nga KQZ-ja të kërkesës për zhvillimin e një referendum, vlerëson se KQZ-ja ka të drejtën dhe detyrimin për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve në drejtim të llojit të referendumit për të cilin kërkohet fillimi i procedurave (i përgjithshëm apo vendor), në drejtim të ekzistencës dhe qartësisë së çështjes që shtrohet për referendum, në drejtim të rëndësise se saj, në drejtim të kufizimit në ushtrimin e të drejtës për referendum, përveç se edhe aspekte të tjera ligjore që do të gjejnë pasqyrim në fletën-tip për mbledhjen e nënshkrimeve, pra për të kontrolluar përputhshmërinë e kërkesës me legjislacionin e interesuar, duke qene ajo organi më i parë që kontrollon ligjshmërinë e kërkesës, që në ushtrim të kompetencave ligjore, nuk lejon fillimin e procedurave që bien në kundërshtim me ligjin;

nga analiza e vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit, si dhe shpjegimeve të përfaqesueses së Këshillit Bashkiak Tirane, rezulton se çështja që shtrohet për referendum vendor në Bashkinë e Tiranës në kërkesën e grupit nismëtar, është një çështje që përfshin :

nje zonë me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, identifikuar si Kurora e Gjelbër e Tiranës, Parkun e Liqenit, përcaktuar me Vendimin Nr.4, datë 29.12.2014, të Këshillit Kombëtar të Territorit, “Për përcaktimin e çështjes dhe zonës me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, identifikuar si Kurora e Gjelbër e Tiranës”;

hartimin e planit të detajuar dhe projekteve zhvillimore të një territori të cilësuar si zonë me rëndësi kombëtare, miratuar me Vendimin Nr.11, datë 16.02.2015, të Këshillit Kombëtar të Territorit, “ Për miratimin e zonimit funksional të hyrjes së parkut të liqenit të Tiranës, pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, si dhe marrjen e nismës për hartimin e planit të detajuar dhe projekteve zhvillimore brenda këtij territori”;

miratimi për ndërtimin e kompleksit të objekteve rezulton të jete bërë me vendime të Këshillit Kombëtar të Territorit, akte nënligjore këto që shprehin qartë se çështja për të cilën kërkohet referendum në nivel bazë të njësisë së qeverisjes vendore nuk është çështje e qeverisjes vendore, pasi :

Vendimi Nr.4, datë datë 29.12.2014, i Këshillit Kombëtar të Territorit, Parkun e Liqenit Tiranë e përcakton si një çështje me rëndësi kombëtare;

nuk ka asnjë vendim të Këshillit të Bashkisë Tiranë që të ketë lidhje me çështjen që shtrohet për referendum vendor;

objektet të cilat janë miratuar për ndërtim kanë karakter kombëtar dhe jo vendor, sepse janë përcaktuar si të tilla dhe miratuar me akte të qeverisjes qendrore dhe jo me akte të qeverisjes vendore;

Kushtetuta dhe ligji për referendume kanë përcaktuar disa lloje referendumesh, duke përfshirë referendum të përgjithshëm për një çështje të rëndësishme së veçantë me karakter kombëtar (neni 150 i Kushtetutes, dhe neni 126/1 i ligjit për referendume) dhe referendum vendor për çështje të qeverisjes vendore (neni 108 i Kushtetutës dhe neni 132 i ligjit për referendume), ku karakteri i çështjes, kombëtare apo lokale, bën ndryshimin ndërmjet këtyre dy llojeve të referendumeve;

duke qene se KQZ-ja ka të drejtën dhe detyrimin për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve për të përkjet lloji të referendumit për të cilin kërkohet fillimi i procedurave, ajo vlerëson se çështja e referuar “A jeni dakord që brenda Parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë, në të dy anët e Korpusit të Universitetit Politeknik të ndërtohen objekte, qofshin këto edhe social-kulturore, universitare apo administrative?” është një çështje që mund të shtrohet vetëm për referendum të përgjithshëm.

Me datë 21.04.2016, partia politike parlamentare me status të perhershëm në KQZ, Partia Demokratike e Shqipërisë (me pasht referuar si PD), ka paraqitur para Kolegjit Zgjedhor një kërkesepadi, me të cilën, duke paditur KQZ-në, si dhe thirrur si pale të interesuar partine tjeter politike parlamentare me status të perhershëm në KQZ, Partine Socialiste të Shqipërisë (me pasht referuar si PS), ka kundërshtuar Vendimin e KQZ-së Nr.7, datë 23.03.2016, ndërsa ka kërkuar gjithashtu edhe gjykimin e çështjes në themel, miratimin e fletës-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme, të cilat duhet të depozitohen nga zgjedhes për paraqitjen e kërkesës në KQZ.

Në kërkesepadi, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, pala paditese PD pretendoi se vendimi objekt padie i KQZ-se është marrë në kundërshtim me ligjin dhe kompetencat e dhëna nga ai, pasi :

ligji per referendumet ka parashikuar kontroll te ligjshmerise se kerkeses per referendum nga KQZ-ja vetem ne pikëpamje formale, pra nese kërkesa ishte paraqitur ose jo nga 12 zgjedhes te asaj njesie te qeverisjes vendore, nese kerkeses i jane bashkëlidhur certifikatat perkatese etj, ndersa kontrollin e zbatueshmerise te nenit 126/5 ligji ia ka dhene Gjykates Kushtetuese, ku ne kete kuptim, ne rastin konkret, KQZ-ja kishte marre atributet e Gjykates Kushtetuese;

KQZ-ja ia dha kompetence vetes te shqyrtonte ne kete faze objektin e kerkeses se grupit te nismetareve, por edhe sikur te pranohej qe KQZ-ja ishte institucioni qe kishte kete kompetence, arsyetimi i përdorur nga ajo per rrezimin e kerkeses ishte ne kundërshtim me nenin 108/4 te Kushtetutes dhe nenet 126/5, 127 e 132/1/4 te ligjit per referendumet, duke i hequr ajo padrejtësisht grupit nismëtar te drejten per te thirrur zgjedhesit e njesise se qeverisjes vendore Bashkia Tirane per te vendosur per nje ceshtje te rendesishme sic ishte zhdukja e hapësirave te gjelberta me ndertime dhe betonizime pa kriter, ndotja e mjedisit ku qytetaret dhe femijet e tyre zhvillonin jeten e përditshme;

ne vendimin e saj KQZ-ja nuk i referohet asnjë dispozite kushtetuese dhe ligjore qe kufizon te drejten e zgjedhesve per te kërkuar referendum vendor per ceshtje qe i përkasin hapësirave te gjelberta te qytetit te tyre, parqeve dhe lulishteve, nderkohe qe ndërtimi i nje objekti ne territor te Bashkise Tirane ishte nje ceshtje qe kishte te bente me ndertimet ne ambientet publike te Bashkise Tirane, pra me mjedisin dhe ndotjen e tij, qe si e tille ishte eskuzivitet i banoreve te kësaj bashkie qe afektonte ne menyre te drejtperdrejte ata, duke mos qene keshtu ceshtja e paraqitur per referendum nje ceshtje per referendum kombëtar, por per referendum vendor;

duke qene se ceshtja e paraqitur per referendum eshte e qarte, se ajo eshte nje ceshtje vendore, ndersa plotësohen te gjitha kushtet ligjore, duhet te miratohej fleta-tip dhe te pajisej me to grupi nismëtar per mbledhjen e nënshkrimeve te nevojshme, qe duhet te depozitohen nga zgjedhes per paraqitjen e kerkeses ne KQZ.

Perkunder pretendimeve te pales paditese, pala e paditur KQZ ka prapësuar, duke mbajtur te njëjtin qëndrim si dhe ne vendimin e saj objekt gjykimi.

Po keshtu, edhe pala e interesuar PS, kundërshtoi pretendimet e ngritura nga pala paditese, duke konsideruar te drejta përfundimet e arritura nga KQZ-ja ne vendimin e saj objekt gjykimi.

Gjate gjykimit, Kolegji Zgjedhor administroi si prova shkresore praktiken dokumentare te vendimit objekt ankimi, paraqitur nga pala e paditur KQZ.

Ne përfundim te shqyrtimit, ne konsiderate te ceshtjeve objekt i debatit gjyqësor, si dhe fakteve te rezultuara nga provat e marra gjate gjykimit, Kolegji Zgjedhor cmon se padia e paraqitur nga pala paditese PD eshte e pabazuar ne ligj dhe prova.

Konkretisht, Kolegji Zgjedhor cmon te pabazuara pretendimet e ngritura nga pala paditese, per kompetencen e KQZ-se dhe kufijte e shqyrtimit prej saj te kerkeses per fillimin e procedurave per zhvillimin e referendumit, ne rastin konkret te nje referendumi vendor ne Bashkine Tirane.

Lidhur me kete moment, rezulton qe Kolegji Zgjedhor, me heret, me Vendimin Nr.1, date 14.01.2015, te kete trajtuar gjerësisht dhe me hollesi te njëjtat pretendime te paraqitura edhe ne rastin konkret, qëndrim ky i Kolegjit Zgjedhor qe eshte mbajtur parasysht dhe nga KQZ-ja ne vendimin objekt ankimi ne kete rast.

Duke rikonsideruar teresisht qëndrimin e tij te meparshem, pa patur vend per te riparashtruar analizen dhe vlerësimet e veta per keto ceshtje te ligjit, Kolegji Zgjedhor, cmon se KQZ-ja, ndryshe nga sa pala paditese ne kete gjykim pretendon, ka vepruar ne respektim te ligjit dhe brenda kompetencave te saj ne shqyrtimin ne rastin konkret te kerkeses se nje grupi nismetarësh per fillimin e procedurave te referendumit, për paisjen me fletë-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për referendum vendor për çështjen e qeverisjes vendore të Bashkisë Tiranë “A jeni dakord që brenda Parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë, në të dy anët e Korpusit të Universitetit Politeknik të ndërtohen objekte, qofshin këto edhe social-kulturore, universitare apo administrative?”.

Ne vijim, Kolegji Zgjedhor cmon te pabazuara edhe pretendimet e ngritura nga pala paditese ne lidhje me ligjshmerine e vendimi objekt ankimi te KQZ-se.

Keshtu, rezulton qe shkaku i kerkeses se grupit nismëtar per fillimin e procedurave te referendumit ne rastin konkret ka qene marrja e Vendimit Nr.11, datë 16.02.2015, i Këshillit Kombëtar te Territorit, "Per miratimin e zonimit funksional të hyrjes së parkut të Liqenit të Tiranës pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, si dhe marrjen e nismës për hartimin e Planit të Detajuar dhe projekteve zhvillimore brenda këtij territori".

Nepermjet këtij vendimi, qe eshte marre duke u mbështetur ne nenet 5, 7, 8 dhe 18 te Ligjit Nr.107/2014, "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit", mbi propozimin e Ministrise se Arsimit dhe Sportit, Ministrise se Puneve te Brendshme dhe Ministrise se Shtetit per Inovacionin dhe Administraten Publike, Keshilli Kombetar i Territorit ka vendosur :

"1. Miratimin e zonimit funksional të Hyrjes së Parkut të Liqenit të Tiranës, pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, shpallur me Vendimin Nr.4, date 29.12.2014.

2. Miratimin e nismes per hartimin e Planit te Detajuar per Hyrjen e e Parkut te Liqenit te Tiranës dhe projekteve zhvillimore brenda territorit te tij.

3. Fillimin e procedures per ngritjen e grupeve te punes me eksperte vendas dhe te huaj.

4. Pjese perbere te këtij vendimi jane :

- kufijte dhe përcaktimi ne harte i territorit qe do te studiohet;

- Zonimi funksional i tij.

5. Autoritetet e planifikimit propozuese te këtij vendimi te përgatisin programet e detajuara hapesineore per zhvillimin e këtij territori sipas fushes se interesit dhe zonimit funksional te miratuar.

6. Autoriteti Rrugor Shqiptar ne bashkërendim me Ministrine e Transportit dhe Infrastruktures te hartoje projektin e rruges lidhese te Sheshit "Frederik Shopen" me Rrugen "Sami Frasherit".

7. Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit te kordonoje punen per hartimin e Planit te Detajuar dhe te kryeje bashkërendimin,

këshillimin dhe organizimin e takimeve publike me të gjitha autoritetet e planifikimit dhe palet e interesuara.

8. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia Kombetare e Planifikimit të Territorit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e PUNEVE të Brendshme, Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturas dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar, për zbatimin e këtij vendimi”.

Nderkohe, me heret, me Vendimin Nr.4, date 29.12.2014, mbështetur në nenet 5, 7 dhe 9 të Ligjit Nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me propozim të Agjencisë Kombetare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit ka vendosur :

“1. Përcaktimin e ceshtjes dhe zones me rëndësi kombetare në planifikimin e territorit, identifikuar si Kurora e Gjelber e Tiranës, bazuar në vendimin e AK_T-se me nr.1159 Prot, date 18.08.2014 dhe në vendimin e KKT-se nr.3, date 22.08.2014, “Për miratimin e nismes për përcaktimin e disa ceshtjeve/zonave të rëndësise kombetare në planifikimin e territorit”.

2. Shpalljen “zone me rëndësi kombetare” të Kurores së Gjelber të Tiranës, sipas kufijve të territorit të paraqitur në hartën përkatëse bashkëlidhur këtij vendimi”.

3. Ngarkohet Agjencia Kombetare e Planifikimit të Territorit, në bashkëpunim me të gjitha Autoritetet e Planifikimit që preken nga ky vendim, të hartojnë planin e zhvillimit me qëllim rritjen e shkallës së ruajtjes së Kurores së Gjelber të Tiranës, sipas zonimit të territorit.

4. Ngarkohet Agjencia Kombetare e Planifikimit të Territorit të jetë autoriteti përgjegjës për kontrollin e përputhshmërisë me këtë Vendim, të dokumenteve të planifikimit të çdo niveli, që do të hartohen në të ardhmen për “Kuroren e Gjelber të Tiranës”, si edhe të dokumenteve të zhvillimit të ndërtimit brenda këtij territori.
...”

Nga grupi nismëtar është argumentuar rëndësia e çështjes për banorët e qytetit Tiranë, duke pretenduar se në marrjen e atij vendimi Këshilli Kombëtar i Territorit (Vendimi Nr.11, date 16.02.2015) nuk kishte informuar dhe përfshirë publikun dhe as kishte marrë një vlerësim për ndikimin në mjedis.

Me tej, sipas grupit nismëtar, ky vendim i Këshillit Kombëtar të Territorit (Vendimi Nr.11, date 16.02.2015), ndersa parashikonte heqjen/reduktimin e zonave të gjelberta brenda Parkut të Liqenit, në të dy anët e Korpusit të Universitetit Politeknik, lejonte zhvillimin në këte territor të ndertimeve, c'ka do të conte në shkatërrimin e Parkut të Liqenit, i cili shërbente si mushkeria kryesore e qytetit të Tiranës dhe demtuar në këte mënyrë çilesinë e jetes së banoreve të saj, gje për të cilën ishte e domosdoshme që banoret e Bashkisë Tiranë të shprehnin mendimin e tyre për ndertimin ose jo të çdo lloji objekti brenda Parkut të Liqenit, në të dy anët e Korpusit të Universitetit Politeknik

Nderkohe, KQZ-ja, ceshtjen që grupi nismëtar ka paraqitur për t'u shtruar në referendum vendor në Bashkinë Tiranë, nuk e ka konsideruar si ceshtje të qeverisjes vendore, por si ceshtje të qeverisjes qendrore, që si e tillë nuk mund të përbejë ceshtje për referendum vendor, përfundim të cilin pala paditese e kundërshton në ankimin/padine e saj.

Lidhur me përfundimin e saj, KQZ-ja del të këte marrë në konsideratë faktin se territori i Kurores së Gjelber të Tiranës është shpallur zone me rëndësi kombëtare, si dhe është përcaktuar si një ceshtje dhe zone me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, me vendim të një autoriteti përgjegjës për planifikimin e territorit të nivelit qendror, pikërisht të Këshillit Kombëtar të Territorit (Vendimi Nr.4, date 29.12.2014), dale në bazë të Ligjit Nr.107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Pra, KQZ-ja, del të këte konsideruar se ceshtja e planifikimit të territorit të zones së "Kurores së Gjelber të Tiranës", ku përfshihet dhe territori që lidhet ceshtjen që kërkohet për t'u shtruar në referendum, sipas legjisllacionit në fuqi në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, ishte përcaktuar si një ceshtje dhe zone me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, që si e tillë planifikimi i saj nuk ishte një ceshtje që i përkiste qeverisjes vendore, por qeverisjes qendrore.

Në ankimin/padine e saj pala paditese nuk parashton asnjë argument për pabazueshmërinë e përfundimit si më lart të KQZ-së, por mjaftohet vetëm me argumentin se përderisa territori që lidhet

me ceshtjen qe kërkohet per t'u shtruar ne referendum, eshte pjese e territorit administrativ te Bashkise Tirane, nderkohe qe planifikimi dhe zhvillimi i tij ka ndikim te drejtperdrejte tek banoret e qytetit Tirane, ceshtja e planifikimit te këtij territori i perket qeverisjes vendore, pra Bashkise Tirane.

Ndryshe nga sa pala paditese pretendon, ndersa ne rastin konkret kemi te bejme me nje ceshtje te planifikimit te nje territori te caktuar, Kolegji Zgjedhor cmon se kurrresi nuk mundet qe vlerësimet ne lidhje me rendesine dhe perkatesine e ceshtjeve te planifikimit te këtij territori te behen duke anashkaluar/moskonsideruar legjisllacionin ne fuqi te kësaj fushe dhe implementimin e tij. Ne fushen e planifikimit dhe zhvillimit te territorit eshte ligji i veçante (Ligji Nr.107/2014) ai qe rregullon ceshtjet e kësaj fushe, perfshire dhe definicionin e ceshtjeve dhe zonave me rendesi kombetare ne planifikimin e territorit (ato qe lidhen me interesa shtetërore ose kombetare), sikundër dhe autoritetet pergjegjese per planifikimin e territorit (ne nivel qendror/kombëtar dhe ne nivel vendor).

Nderkohe, eshte fakt qe pranohet se territori qe lidhet me ceshtjen qe kërkohet per t'u shtruar ne referendum, pra “Hyrja e Parkut te Liqenit te Tiranës”, eshte pjese e nje zone te shpallur nga autoriteti kombëtar pergjegjës i planifikimit te territorit si zone me rendesi kombetare, si dhe eshte percaktuar si nje ceshtje dhe zone me rendesi kombetare ne planifikimin e territorit, pra si nje ceshtje dhe zone qe lidhet me interesa shtetërore dhe/ose kombetare, referuar nenit 3/7 te Ligjit Nr.107/2014, “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Pra, pavarësisht se territori i percaktuar si “Hyrja e Parkut te Liqenit te Tiranës” gjeografikisht ndodhet brenda territorit vendor te Bashkise Tirane, ne zbatim te ligjit te veçante ne fushen e planifikimit dhe zhvillimit te territorit, ky territor, si pjese e “Kurores se Gjelber e Tiranës”, eshte shpallur zone me rendesi kombetare, planifikimi i te cilit, sipas ligjit, eshte nje ceshtje qe i perket autoriteteve pergjegjese qendrore/kombetare te planifikimit te territorit, duke mos qene keshtu planifikimi i këtij territori (“Hyrja e Parkut te Liqenit”) nje ceshtje qe i perket ndonje prej autoriteteve pergjegjese vendore te planifikimit te territorit.

Fakti që planifikimi dhe, me tej, edhe zhvillimi i territorit të “Hyrjes së Parkut të Liqenit të Tiranës”, për vetë vendndodhjen e tij gjeografike, afekton drejtperdrejtë banoret e qytetit të Tiranës, nuk do të thote se planifikimi i këtij territori është një çështje me rëndësi vendore, që ka të bëjë ekskluzivisht me interesa vendore dhe ngushtësisht të lidhur dhe me impakt vetëm tek banoret e kësaj njesie të qeverisjes vendore. Përkundrazi, ndërsa kjo zonë dhe planifikimi i saj, në përputhje me ligjin e veçantë, është përcaktuar si një çështje dhe zonë me rëndësi kombëtare, planifikimi i këtij territori impakt me të gjere, që prek dhe interesa kombëtare. Po kështu, fakti i referuar nuk do të thote as se planifikimi i këtij territori përfshihet në rrethin e çështjeve për të cilat, sipas kuartit ligjor në fuqi, është ngarkuar Bashkia e Tiranës.

Në rrethim, lidhur me pretendimet e paraqitura dhe nga grupi nismëtar, për mosinformim të publikut dhe mospërfshirjen e tij në rastin e marrjes së Vendimit Nr.11, datë 16.02.2015, të Këshillit Kombëtar të Territorit, “Për miratimin e zonimit funksional të hyrjes së parkut të Liqenit të Tiranës pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, si dhe marrjen e nismës për hartimin e Planit të Detajuar dhe projekteve zhvillimore brenda këtij territori” apo për mosmarrjen në këtë rast të një vlerësimi të ndikimit në mjedis, Kolegji Zgjedhor cmon se këto pretendime kanë të bëjnë me ligjshmerinë e atij vendimi të Këshillit Kombëtar të Territorit, për të cilat legjislativi në fuqi parashikon mjete të posaçme për adresimin e tyre në funksion të kontrollit të vendimmarrjeve për të cilat pretendohet se kanë impakt në mjedis. Këto pretendime, ndërsa nuk kanë të bëjnë me rëndësinë vendore dhe as me përfshirjen e çështjes së planifikimit të atij territori konkret në rrethin e çështjeve të njesisë së veteqeverisjes vendore Bashkia e Tiranës, Kolegji Zgjedhor cmon se ato nuk mund të shërbejnë si shkak dhe të motivojnë shtrimin domosdoshmërisht në referendum të çështjes së kërkuar.

Në vlerësim të Kolegjit Zgjedhor, në konsistencë me qëndrimet e mëhershme të tij, referendumi vendor duhet domosdoshmërisht të zhvillohet për çështje të qeverisjes vendore, organet e të cilave i kanë të përcaktuara me ligj kompetencat e tyre, në rrethim që në kuart të ushtrimit të këtyre kompetencave, populli mund të ushtrojë drejtpërdrejtë qeverisjen nëpërmjet referendumit. Në rastin konkret, “Kurora e Gjelber e Tiranës” është përcaktuar sipas legjislativitetit në fuqi si një zonë me rëndësi kombëtare, planifikimi i territorit të të cilit

eshte percaktuar i te njejtës rendesi (kombetare), duke mos qene planifikimi i saj nje ceshtje e organeve te njesise se veteqeverisjes vendore Bashkia Tirane.

Nga sa me lart, Kolegji Zgjedhor vlerëson se kërkesa e grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit vendor me te drejte nuk eshte pranuar nga KQZ-ja, duke qene i pabazuar ne prova e ligj ankimi/padia e paraqitur nga pala paditese PD, qe si e tille ajo duhet te rrezohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykeses se Apelit Tirane,
bazuar ne nenin 158, pika 1, shkronja “b” dhe pika 3,
te Kodit Zgjedhor te ndryshuar,

V E N D O S I

Rrezimin e padise.

U shpall në Tiranë, me date 16.05.2011.

ANËTAR	ANËTAR	KRYESUES
FUAT VJERDHA	PETRIT ÇENO	ILIR TOSKA

ANËTAR	ANËTAR
KLITON SPAHIU	VALBON ÇEKREZI

*
* *



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT TIRANE
KOLEGJI ZGJEDHOR**

**Nr.4 Regj. Themeltar
Datë 21.04.2016**

**Nr.4 Vendimi
Datë 16.05.2016**

**V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”**

Kolegji Zgjedhor i Gjykes se Apelit Tirane i perbere nga gjyqtaret:

**KRYESUES : FUAT VJERDHA
ANETAR : KLITON SPAHIU
ANETAR : ILIR TOSKA
ANETAR : VALBON ÇEKREZI
ANETAR : PETRIT ÇENO**

asistuar prej sekretares Rexhina Baci, në Tiranë, sot me datë 16.05.2016, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen administrative zgjedhore, që u përket paleve:

PADITËSE : PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE, me Seli ne Tirane, Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr.11, përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Z.Ivi Kaso dhe Z.Spiro Dodbiba.

I PADITUR : KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, me Seli ne Tirane, Rruga “Ibrahim Rugova”, Nr.4, përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Znj.Deshira Pasko, Z.Olsi Peto dhe Znj. Anila Ruço.

PALE E INTERESUAR : PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE,
me Seli ne Tirane, Sheshi "Austria", Nr.91, përfaqësuar
ne gjykim me autorizim nga Znj.Klotilda Bushka dhe
Z.Gledian Llatja.

OBJEKTI : - Kundershtimi i Vendimit Nr.8, date 23.03.2016, te
Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, "Per shqyrtimin
e kerkeses se nje grupi nismetarësh per fillimin e
procedurave, per zhvillimin e nje referendumi vendor
ne Bashkine Tirane, per ceshtjen "A jeni dakort qe
të ndërtohet kënd lojrash duke betonizuar zemrën e
parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë?".
- Gjykimin e ceshtjes ne themel, miratimin e fletes-tip
per mbledhjen e nënshkrimeve te nevojshme, te cilat
duhet te depozitohen nga zgjedhes per paraqitjen e
kerkeses ne Komisionin Qendror te Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE : Nenet 145 e vijues, te Kodit Zgjedhor te Repub
likes se Shqiperise.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS APELIT TIRANË

Pasi degjoi perfaqesuesit e pales paditese Partia Demokratike e
Shqiperise, qe kerkuan pranimin e kerkesepadisë, shfuqizimin e
vendimit të KQZ-së dhe shqyrtimin e çështjes në themel ; degjoi
perfaqesuesit e pales se paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, qe
kerkuan rrezimin e kerkesepadise dhe lënien në fuqi të vendimit të
KQZ-së ; degjoi perfaqesuesit e pales se interesuar Partia Socialiste
e Shqiperise, qe kerkuan rrezimin e kerkesepadise dhe lënien në
fuqi të vendimit të KQZ-së, si dhe pasi shqyrtoi ceshtjen ne tërësi,

V Ë R E N

Ceshtja e paraqitur per gjykim lidhet me nje mosmarreveshje qe ka
te beje me referendumet, proces ky qe, pervec se nga Kushtetuta
e Republikes se Shqiperise, rregullohet ne menyre te posaçme
me dispozitat e Kodit Zgjedhor te meparshem (miratuar me Ligjin
Nr.9087, date 19.06.2003), nenet 118-132 te tij, dispozita vetem
keto qe jane ne fuqi edhe sipas Kodit Zgjedhor aktual (miratuar me

Ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008). Prandaj, për lehtësi, teresia e normave për referendimet në Ligjin Nr.9087, datë 19.06.2003, me poshtë do të identifikohet si ligji për referendimet.

Me datë 04.03.2016, mbështetur në nenet 2/2 dhe 108/2/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 126 dhe 132 të ligjit për referendimet, një grup prej 12 nismëtarësh, i janë drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (me poshtë referuar si KQZ) nëpërmjet një kërkesë për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në Bashkinë Tiranë, duke identifikuar si çështje që duhet të shtrohet për referendum “A jeni dakort që të ndërtohet kënd lojrash duke betonizuar zemrën e parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë?”.

Në kërkesën e tyre grupi nismëtar ka argumentuar se, nëpërmjet një procedurë të dyshimtë, duke injoruar shumë kërkesa ligjore, përfshirë dhe dëgjuesat publike, si dhe procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, Këshilli Kombëtar i Territorit ka marrë Vendimin Nr.11, datë 16.02.2015 “Për miratimin e zonimit funksional të hyrjes së parkut të Liqenit të Tiranës pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, si dhe marrjen e nismës për hartimin e Planit të Detajuar dhe projekteve zhvillimore brenda këtij territori”.

Sipas pretendimeve të kërkuësve:

Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) miratoi me vendimin nr. 11, datë 16.02.2015 “Miratimin e zonimit funksional të hyrjes së parkut të Liqenit të Tiranës pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, si dhe marrjen e nismës për hartimin e Planit të Detajuar dhe projekteve zhvillimore brenda këtij territori” me një procedurë të dyshimtë, me shumë përcaktime ligjore duke injoruar dhe dëgjuesat publike dhe procesin e vlerësimit strategjik mjedisor.

Ndërkohë që u shpall marrja e nismës për hartimin e Planit të detajuar... ky plan ende nuk është përfunduar nuk ka asnjë dokument të Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe nuk ka hyrë në fuqi.

Në një mënyrë të fshehtë Bashkia Tiranë kreu zhvillimin e një tenderi pa patur leje ndërtimi dhe pa patur plan hapësinor të miratuar dhe filloi punimet në terren pa leje ndërtimi, pa supervisor, pa masterplan, të miratuar, pa vlerësim strategjik të miratuar etj.

Pas shume ditësh protestash të partisë demokratike, për prerjen e pemëve në park, KKT, nxorri vendimin nr. 1, datë 12.02.2016, “Për miratimin e lejes së Ndërtimit për objektin “Kënd i Lojrave për fëmijë, projekti 4, në kuadër të rehabilitimit të Parkut të Liqenit Bashkia Tiranë”

Ndërkohë që objekti titullohet kënd lojrash, 8 nga 10 zërat e punimeve janë për beton

Sipas grupit nismëtar, në kushtet kur Këshilli Kombëtar i Territorit, nepermjet Vendimit Nr.1, date 12.02.2016, në një proces të shkurtër, jo transparent dhe ne mungese te nje vlerësimi mjedisor sic kërkohet nga ligji, bente te domosdoshme që komuniteti i Bashkisë Tiranë të shprehet për këtë vendim nëpërmjet referendumit vendor.

Per kerkesen si me lart, KQZ-ja, ne përputhje me përcaktimet e neneve 126/2, 127/1 dhe 132/4 te ligjit per referendumet, paraprakisht ka verifikuar nëse nismëtarët e depozitimit të kërkesës ishin zgjedhës të Bashkisë Tiranë, ku pas verifikimit te bere ka rezultuar se ata ishin zgjedhës në kete njesi te veteqeverisjes vendore.

Me tej, ne Mbledhjen e dates 21.03.2016, KQZ-ja ka marre ne shqyrtim kerkesen si me lart, ku referuar përcaktimeve te neneve 126/5 dhe 132/4 te ligjit per referendumet, ka konstatuar se ishte e paqarte lloji i referendumit qe kërkohet te behej, pra nese kërkohet referendum për një çështje të rëndësisë së veçantë apo kërkohet një referendum shfuqizues (abrogues) të një akti administrativ, sikurse ishte Vendimi Nr.11, datë 16.02.2015, i Keshillit Kombetar te Territorit, “Për miratimin e zonimit funksional të hyrjes së parkut të liqenit të Tiranës, pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, si dhe marrjen e nismës për hartimin e planit të detajuar dhe projekteve zhvillimore brenda këtij territori”, nderkohe qe nese do te ishim para rastit te dyte, pra para nje kerkese per referendum shfuqizues te një akti, atehere kërkesa formalisht nuk përmbushte kriteret e parashikuara në nenin 126/4 të ligjit per referendumet, pasi, as ne kerkese dhe as ne pyetjen e propozuar per t’u parashtruar per referendum nuk kërkohet shfuqizim i ndonje akti konkret, pervec se, ne thelb, kjo kerkese binte ndesh me nenin 150 te Kushtetutes, por

edhe me ligjin per referendumet, te cilet parashikojne referendum te pergjithshem për shfuqizimin e një ligji, ndersa nuk parashikojne referendum lokal per shfuqizimin e një akti administrativ.

Mbas këtij konstatimi, po me date 21.03.2016, grupi nismëtar, nepermjet nje kerkese me shkrim, ka saktësuar se kërkohet fillimi i procedurave per zhvillimin e nje referendumi vendor ne Bashkine Tirane per nje ceshtje te rendesise se vecante, duke identifikuar tashme si ceshtje qe duhet te shtrohet per referendum pyetjen “A jeni dakort qe të ndërtohet kënd lojrash duke betonizuar zemrën e parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë?”

Kjo kerkese e grupit te nismetareve, duke u konsideruar si kerkese per ndreqjen e te metave te kerkeses fillestare, bazuar ne nenin 68 te Kodit te Procedurave Administrative, eshte pranuar nga KQZ-ja, ne Mbledhjen e dates 23.03.2016, duke vijuar me shqyrtimin e metejshem te saj, tashme sipas saktësimit te bere nga grupi nismëtar.

Ne mbledhjen e KQZ-se per shqyrtimin e kerkeses kane marre pjese edhe perfaqesues te Partise Demokratike dhe te Partise Socialiste, parti politike parlamentare keto me status te perhershem prane KQZ-se.

Gjate shqyrtimit te kerkeses, KQZ-ja ka thirrur dhe marre sqarime nga perfaqesues te Keshillit Bashkiak Tirane.

Ne përfundim te shqyrtimit, KQZ-ja, me Vendimin Nr.8, date 23.03.2016, ka vendosur :

“Rrezimin e kërkesës së 12 nismëtarëve për paisjen me fletë-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për referendum vendor për çështjen e qeverisjes vendore të Bashkisë Tiranë. “A jeni dakord që të ndërtohet kënd lojrash duke betonizuar zemrën e parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë?”

Ne vendimin e saj, KQZ-ja, referuar dhe ceshtjeve objekt debati mes pjesemarresve, ka arsyetuar se :

ne konsiderate te jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese (Vendimet 31/2003, 25/2009, 26/2010, 5/2011 dhe

8/2013), si dhe të praktikës së Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë (Vendimi 1/2015), lidhur me kufijtë e shqyrtimit nga KQZ-ja të kërkesës për zhvillimin e një referendumi, vlerëson se KQZ-ja ka të drejtën dhe detyrimin për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve në drejtim të llojit të referendumit për të cilin kërkohet fillimi i procedurave (i përgjithshëm apo vendor), në drejtim të ekzistencës dhe qartësisë së çështjes që shtrohet për referendum, në drejtim të rëndësise se saj, në drejtim të kufizimit në ushtrimin e të drejtës për referendum, përveç se edhe aspekte të tjera ligjore që do të gjejnë pasqyrim në fletën-tip për mbledhjen e nënshkrimeve, pra për të kontrolluar përputhshmërinë e kërkesës me legjislacionin e interesuar, duke qene ajo organi më i parë që kontrollon ligjshmërinë e kërkesës, që në ushtrim të kompetencave ligjore, nuk lejon fillimin e procedurave që bien në kundërshtim me ligjin;

nga analiza e vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit, si dhe shpjegimeve të përfaqesueses së Këshillit Bashkiak Tirane, rezulton se çështja që shtrohet për referendum vendor në Bashkinë e Tiranës në kërkesën e grupit nismëtar, është një çështje që përfshin :

nje zonë me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, identifikuar si Kurora e Gjelbër e Tiranës, Parkun e Liqenit, përcaktuar me Vendimin Nr.4, datë 29.12.2014, të Këshillit Kombëtar të Territorit, “Për përcaktimin e çështjes dhe zonës me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, identifikuar si Kurora e Gjelbër e Tiranës”;

hartimin e planit të detajuar dhe projekteve zhvillimore të një territori të cilësuar si zonë me rëndësi kombëtare, miratuar me Vendimin Nr.11, datë 16.02.2015, të Këshillit Kombëtar të Territorit, “ Për miratimin e zonimit funksional të hyrjes së parkut të liqenit të Tiranës, pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, si dhe marrjen e nismës për hartimin e planit të detajuar dhe projekteve zhvillimore brenda këtij territori”;

miratimi për ndërtimin e kompleksit të objekteve rezulton të jete bërë me vendime të Këshillit Kombëtar të Territorit, akte nënligjore këto që shprehin qartë se çështja për të cilën kërkohet referendum në nivel bazë të njësisë së qeverisjes vendore nuk është çështje e qeverisjes vendore, pasi :

Vendimi Nr.4, datë datë 29.12.2014, i Këshillit Kombëtar të Territorit, Parkun e Liqenit Tiranë e përcakton si një çështje më rëndësi kombëtare;

nuk ka asnjë vendim të Këshillit të Bashkisë Tiranë që të ketë lidhje me çështjen që shtrohet për referendum vendor;

objektet të cilat janë miratuar për ndertim kanë karakter kombëtar dhe jo vendor, sepse janë përcaktuar si të tilla dhe miratuar me akte të qeverisjes qendrore dhe jo me akte të qeverisjes vendore;

Kushtetuta dhe ligji për referendume kanë përcaktuar disa lloje referendumesh, duke përfshirë referendum të përgjithshëm për një çështje të rëndësishme së veçantë me karakter kombëtar (neni 150 i Kushtetutes, dhe neni 126/1 i ligjit për referendume) dhe referendum vendor për çështje të qeverisjes vendore (neni 108 i Kushtetutës dhe neni 132 i ligjit për referendume), ku karakteri i çështjes, kombëtare apo lokale, bën ndryshimin ndërmjet këtyre dy llojeve të referendumeve;

duke qene se KQZ-ja ka të drejtën dhe detyrimin për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve për të përkjet lloji të referendumit për të cilin kërkohet fillimi i procedurave, ajo vlerëson se çështja e referuar “A jeni dakord që të ndërtohet kënd lojrash duke betonizuar zemrën e parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë?” është një çështje që mund të shtrohet vetëm për referendum të përgjithshëm.

Me datë 21.04.2016, partia politike parlamentare me status të perhershëm në KQZ, Partia Demokratike e Shqipërisë (me pasht referuar si PD), ka paraqitur para Kolegjit Zgjedhor një kërkesepadi, me të cilën, duke paditur KQZ-në, si dhe thirrur si pale të interesuar partine tjeter politike parlamentare me status të perhershëm në KQZ, Partine Socialiste të Shqipërisë (me pasht referuar si PS), ka kundërshtuar Vendimin e KQZ-së Nr.8, datë 23.03.2016, ndërsa ka kërkuar gjithashtu edhe gjykimin e çështjes në themel, miratimin e fletës-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme, të cilat duhet të depozitohen nga zgjedhes për paraqitjen e kërkesës në KQZ.

Në kërkesepadi, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, pala paditese PD pretendoi se vendimi objekt padie i KQZ-se është marre në kundërshtim me ligjin dhe kompetencat e dhena nga ai, pasi :

ligji per referendumet ka parashikuar kontroll te ligjshmerise se kerkeses per referendum nga KQZ-ja vetem ne pikëpamje formale, pra nese kërkesa ishte paraqitur ose jo nga 12 zgjedhes te asaj njesie te qeverisjes vendore, nese kerkeses i jane bashkëlidhur certifikatat perkatese etj, ndersa kontrollin e zbatueshmerise te nenit 126/5 ligji ia ka dhene Gjykates Kushtetuese, ku ne kete kuptim, ne rastin konkret, KQZ-ja kishte marre atributet e Gjykates Kushtetuese;

KQZ-ja ia dha kompetence vetes te shqyrtonte ne kete faze objektin e kerkeses se grupit te nismetareve, por edhe sikur te pranohej qe KQZ-ja ishte institucioni qe kishte kete kompetence, arsyetimi i përdorur nga ajo per rrezimin e kerkeses ishte ne kundërshtim me nenin 108/4 te Kushtetutes dhe nenet 126/5, 127 e 132/1/4 te ligjit per referendumet, duke i hequr ajo padrejtësisht grupit nismëtar te drejten per te thirrur zgjedhesit e njesise se qeverisjes vendore Bashkia Tirane per te vendosur per nje ceshtje te rendesishme sic ishte zhdukja e hapësirave te gjelberta me ndertime dhe betonizime pa kriter, ndotja e mjedisit ku qytetaret dhe femijet e tyre zhvillonin jeten e përditshme;

ne vendimin e saj KQZ-ja nuk i referohet asnjë dispozite kushtetuese dhe ligjore qe kufizon te drejten e zgjedhesve per te kërkuar referendum vendor per ceshtje qe i përkasin hapësirave te gjelberta te qytetit te tyre, parqeve dhe lulishteve, nderkohe qe ndërtimi i nje objekti ne territor te Bashkise Tirane ishte nje ceshtje qe kishte te bente me ndertimet ne ambientet publike te Bashkise Tirane, pra me mjedisin dhe ndotjen e tij, qe si e tille ishte eskuzivitet i banoreve te kësaj bashkie qe afektonte ne menyre te drejtperdrejte ata, duke mos qene keshtu ceshtja e paraqitur per referendum nje ceshtje per referendum kombëtar, por per referendum vendor;

duke qene se ceshtja e paraqitur per referendum eshte e qarte, se ajo eshte nje ceshtje vendore, ndersa plotësohen te gjitha kushtet ligjore, duhet te miratohej fleta-tip dhe te pajisej me to grupi nismëtar per mbledhjen e nënshkrimeve te nevojshme, qe duhet te depozitohen nga zgjedhes per paraqitjen e kerkeses ne KQZ.

Perkunder pretendimeve te pales paditese, pala e paditur KQZ ka prapësuar, duke mbajtur te njëjtin qëndrim si dhe ne vendimin e saj objekt gjykimi.

Po keshtu, edhe pala e interesuar PS, kundërshtoi pretendimet e ngritura nga pala paditese, duke konsideruar te drejta përfundimet e arritura nga KQZ-ja ne vendimin e saj objekt gjykimi.

Gjate gjykimit, Kolegji Zgjedhor administroi si prova shkresore praktiken dokumentare te vendimit objekt ankimi, paraqitur nga pala e paditur KQZ.

Ne përfundim te shqyrtimit, ne konsiderate te ceshtjeve objekt i debatit gjyqësor, si dhe fakteve te rezultuara nga provat e marra gjate gjykimit, Kolegji Zgjedhor cmon se padia e paraqitur nga pala paditese PD eshte e pabazuar ne ligj dhe prova.

Konkretisht, Kolegji Zgjedhor cmon te pabazuara pretendimet e ngritura nga pala paditese, per kompetencen e KQZ-se dhe kufijte e shqyrtimit prej saj te kerkeses per fillimin e procedurave per zhvillimin e referendumit, ne rastin konkret te nje referendumi vendor ne Bashkine Tirane.

Lidhur me kete moment, rezulton qe Kolegji Zgjedhor, me heret, me Vendimin Nr.1, date 14.01.2015, te kete trajtuar gjerësisht dhe me hollesi te njëjtat pretendime te paraqitura edhe ne rastin konkret, qëndrim ky i Kolegjit Zgjedhor qe eshte mbajtur parasysht dhe nga KQZ-ja ne vendimin objekt ankimi ne kete rast.

Duke rikonfirmuar teresisht qëndrimin e tij te meparshem, pa patur vend per te riparashtruar analizen dhe vlerësimet e veta per keto ceshtje te ligjit, Kolegji Zgjedhor, cmon se KQZ-ja, ndryshe nga sa pala paditese ne kete gjykim pretendon, ka vepruar ne respektim te ligjit dhe brenda kompetencave te saj ne shqyrtimin ne rastin konkret te kerkeses se nje grupi nismetaresh per fillimin e procedurave te referendumit, për paisjen me fletë-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për referendum vendor për çështjen e qeverisjes vendore të Bashkisë Tiranë “A jeni dakort qe të ndërtohet kënd lojrash duke betonizuar zemrën e parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë?”.

Ne vijim, Kolegji Zgjedhor cmon te pabazuara edhe pretendimet e ngritura nga pala paditese ne lidhje me ligjshmerine e vendimi objekt ankimi te KQZ-se.

Keshtu, rezulton qe shkak i kerkeses se grupit nismëtar per fillimin e procedurave te referendumit ne rastin konkret ka qene marrja e

Vendimit Nr.11, datë 16.02.2015, i Këshillit Kombëtar të Territorit, “Per miratimin e zonimit funksional të hyrjes së parkut të Liqenit të Tiranës pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, si dhe marrjen e nismës për hartimin e Planit të Detajuar dhe projekteve zhvillimore brenda këtij territori”.

Nepermjet këtij vendimi, qe eshte marre duke u mbështetur ne nenet 5, 7, 8 dhe 18 te Ligjit Nr.107/2014, “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, mbi propozimin e Ministrise se Arsimit dhe Sportit, Ministrise se Puneve te Brendshme dhe Ministrise se Shtetit per Inovacionin dhe Administraten Publike, Keshilli Kombetar i Territorit ka vendosur :

“1. Miratimin e zonimit funksional të Hyrjes së Parkut të Liqenit të Tiranës, pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, shpallur me Vendimin Nr.4, date 29.12.2014.

2. Miratimin e nismes per hartimin e Planit te Detajuar per Hyrjen e e Parkut te Liqenit te Tiranës dhe projekteve zhvillimore brenda territorit te tij.

3. Fillimin e procedures per ngritjen e grupeve te punes me eksperte vendas dhe te huaj.

4. Pjese perbere te këtij vendimi jane :

- kufijte dhe përcaktimi ne harte i territorit qe do te studiohet;

- Zonimi funksional i tij.

5. Autoritetet e planifikimit propozuese te këtij vendimi te përgatisin programet e detajuara hapesine per zhvillimin e këtij territori sipas fushes se interesit dhe zonimit funksional te miratuar.

6. Autoriteti Rrugor Shqiptar ne bashkërendim me Ministrine e Transportit dhe Infrastruktures te hartoje projektin e rruges lidhese te Sheshit “Frederik Shopen” me Rrugen “Sami Frasheri”.

7. Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit te kordonoje punen per hartimin e Planit te Detajuar dhe te kryeje bashkërendimin, këshillimin dhe organizimin e takimeve publike me te gjitha autoritetet e planifikimit dhe palet e interesuara.

8. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Puneve te Brendshme, Ministri i Shtetit per Inovacionin dhe Administraten Publike, Ministria e Transportit dhe Infrastruktures dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar, per zbatimin e këtij vendimi”.

Nderkohe, me heret, me Vendimin Nr.4, date 29.12.2014, mbështetur ne nenet 5, 7 dhe 9 te Ligjit Nr.107/2014, “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me propozim te Agjencise Kombetare te Planifikimit te Territorit, Keshilli Kombetar i Territorit ka vendosur :

“1. Percaktimin e ceshtjes dhe zones me rendesi kombetare ne planifikimin e territorit, identifikuar si Kurora e Gjelber e Tiranës, bazuar ne vendimin e AK_T-se me nr.1159 Prot, date 18.08.2014 dhe ne vendimin e KKT-se nr.3, date 22.08.2014, “Per miratimin e nismes per përcaktimin e disa ceshtjeve/zonave te rendesise kombetare ne planifikimin e territorit”.

2. Shpalljen “zone me rendesi kombetare” te Kurores se Gjelber te Tiranës, sipas kufijve te territorit te paraqitur ne hartën perkatese bashkëlidhur këtij vendimi”.

3. Ngarkohet Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit, ne bashkëpunim me te gjitha Autoritetet e Planifikimit qe preken nga ky vendim, te hartojne planin e zhvillimit me qellim rritjen e shkalles se ruajtjes se Kurores se Gjelber te Tiranës, sipas zonimit te territorit.

4. Ngarkohet Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit te jete autoriteti pergjegjes per kontrollin e perputhshmerise me kete Vendim, te dokumenteve te planifikimit te cdo niveli, qe do te hartohen ne te ardhmen per “Kuroren e Gjelber te Tiranës”, si edhe te dokumenteve te zhvillimit te ndertimit brenda këtij territori.”

Nga grupi nismëtar eshte argumentuar rëndësia e çështjes për banoret e qytetit Tirane, duke pretenduar se në marrjen e atij vendimi Këshilli Kombëtar i Territorit (Vendimi Nr.11, date 16.02.2015) nuk kishte informuar dhe perfshire publikun dhe as kishte marre nje vlerësim per ndikimin ne mjedis.

Me tej, sipas grupit nismëtar, ky vendim i Këshillit Kombëtar te Territorit (Vendimi Nr.11, date 16.02.2015), ndersa parashikonte heqjen/reduktimin e zonave te gjelberta brenda Parkut të Liqenit, në të dy anët e Korpusit të Universitetit Politeknik, lejonte zhvillimin ne kete territor te ndertimeve, ç’ka do te çonte ne shkaterrimin e Parkut

te Liqenit, i cili shërbente si mushkeria kryesore e qytetit te Tiranës duke demtuar ne kete menyre cilesine e jetes se banoreve te saj, gje per te cilen ishte e domosdoshme qe banoret e Bashkise Tirane të shprehnin mendimin e tyre për ndertimin ose jo te cdo lloj objekti brenda Parkut të Liqenit, në të dy anët e Korpusit të Universitetit Politeknik.

Nderkohe, KQZ-ja, ceshtjen qe grupi nismëtar ka paraqitur per t'u shtruar ne referendum vendor ne Bashkine Tirane, nuk e ka konsideruar si ceshtje te qeverisjes vendore, por si ceshtje te qeverisjes qendrore, qe si e tille nuk mund te perbente ceshtje per referendum vendor, përfundim te cilin pala paditese e kundërshton ne ankimin/padine e saj.

Lidhur me përfundimin e saj, KQZ-ja del te kete marre ne konsiderate faktin se territori i Kurores se Gjelber te Tiranës eshte shpallur zone me rendesi kombetare, si dhe eshte percaktuar si nje ceshtje dhe zone me rendesi kombetare ne planifikimin e territorit, me vendim te nje autoriteti pergjegjes per planifikimin e territorit te nivelit qendror, pikërisht te Keshillit Kombetar te Territorit (Vendimi Nr.4, date 29.12.2014), dale ne baze te Ligjit Nr.107/2014, "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Pra, KQZ-ja, del te kete konsideruar se ceshtja e planifikimit te territorit te zones se "Kurores se Gjelber te Tiranës", ku përfshihet dhe territori qe lidhet ceshtjen qe kërkohet per t'u shtruar ne referendum, sipas legjislacionit ne fuqi ne fushen e planifikimit dhe zhvillimit te territorit, ishte percaktuar si nje ceshtje dhe zone me rendesi kombetare ne planifikimin e territorit, qe si e tille planifikimi i saj nuk ishte nje ceshtje qe i përkiste qeverisjes vendore, por qeverisjes qendrore.

Ne ankimin/padine e saj pala paditese nuk parashton asnjë argument per pabazueshmerine e përfundimit si me lart te KQZ-se, por mjaftohet vetem me argumentin se përderisa territori qe lidhet me ceshtjen qe kërkohet per t'u shtruar ne referendum, eshte pjese e territorit administrativ te Bashkise Tirane, nderkohe qe planifikimi dhe zhvillimi i tij ka ndikim te drejtperdrejte tek banoret e qytetit Tirane, ceshtja e planifikimit te këtij territori i perket qeverisjes vendore, pra Bashkise Tirane.

Ndryshe nga sa pala paditese pretendon, ndersa ne rastin konkret kemi te bejme me nje ceshtje te planifikimit te nje territori te caktuar, Kolegji Zgjedhor cmon se kurrsesi nuk mundet qe vlerësimet ne

lidhje me rendesine dhe perkatesine e ceshtjeve te planifikimit te ketij territori te behen duke anashkaluar/moskonsideruar legjislacionin ne fuqi te kesaj fushe dhe implementimin e tij. Ne fushen e planifikimit dhe zhvillimit te territorit eshte ligji i veçante (Ligji Nr.107/2014) ai qe rregullon ceshtjet e kesaj fushe, perfshire dhe definicionin e ceshtjeve dhe zonave me rendesi kombetare ne planifikimin e territorit (ato qe lidhen me interesa shtetërore ose kombetare), sikundër dhe autoritetet pergjegjese per planifikimin e territorit (ne nivel qendror/kombëtar dhe ne nivel vendor).

Nderkohe, eshte fakt qe pranohet se territori qe lidhet me ceshtjen qe kërkohet per t'u shtruar ne referendum, pra "Hyrja e Parkut te Liqenit te Tiranës", eshte pjese e nje zone te shpallur nga autoriteti kombëtar pergjegjës i planifikimit te territorit si zone me rendesi kombetare, si dhe eshte percaktuar si nje ceshtje dhe zone me rendesi kombetare ne planifikimin e territorit, pra si nje ceshtje dhe zone qe lidhet me interesa shtetërore dhe/ose kombetare, referuar nenit 3/7 te Ligjit Nr.107/2014, "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Pra, pavarësisht se territori i percaktuar si "Hyrja e Parkut te Liqenit te Tiranës" gjeografikisht ndodhet brenda territorit vendor te Bashkise Tirane, ne zbatim te ligjit te veçante ne fushen e planifikimit dhe zhvillimit te territorit, ky territor, si pjese e "Kurores se Gjelber e Tiranës", eshte shpallur zone me rendesi kombetare, planifikimi i te cilit, sipas ligjit, eshte nje ceshtje qe i perket autoriteteve pergjegjese qendrore/kombetare te planifikimit te territorit, duke mos qene keshtu planifikimi i ketij territori ("Hyrja e Parkut te Liqenit") nje ceshtje qe i perket ndonje prej autoriteteve pergjegjese vendore te planifikimit te territorit.

Fakti qe planifikimi dhe, me tej, edhe zhvillimi i territorit te "Hyrjes se Parkut te Liqenit te Tiranës", per vete vendndodhjen e tij gjeografike, afekton drejtperdrejte banoret e qytetit te Tiranës, nuk do te thote se planifikimi i ketij territori eshte nje ceshtje me rendesi vendore, qe ka te beje ekskluzivisht me interesa vendore dhe ngushtësisht te lidhur dhe me impakt vetem tek banoret e kesaj njesie te qeverisjes vendore. Përkundrazi, ndersa kjo zone dhe planifikimi i saj, ne përputhje me ligjin e veçante, eshte percaktuar si nje ceshtje dhe zone me rendesi kombetare, planifikimi i ketij territori ka impakt me te gjere, qe prek dhe interesa kombetare. Po keshtu, fakti i referuar

nuk do të thote as se planifikimi i këtij territori përfshihet në rrethin e ceshtjeve për të cilat, sipas kuadrit ligjor në fuqi, është ngarkuar Bashkia Tirane.

Nderkohe, lidhur me pretendimet e paraqitura dhe nga grupi nismëtar, për mosinformim të publikut dhe mospërfshirjen e tij në rastin e marrjes së Vendimit Nr.11, datë 16.02.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit, "Për miratimin e zonimit funksional të hyrjes së parkut të Liqenit të Tiranës pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, si dhe marrjen e nismës për hartimin e Planit të Detajuar dhe projekteve zhvillimore brenda këtij territori" apo për mosmarrjen në këto rast të një vlerësimi të ndikimit në mjedis, Kolegji Zgjedhor cmon se këto pretendime kanë të bëjnë me ligjshmerinë e atij vendimi të Këshillit Kombëtar të Territorit, për të cilat legjislativi në fuqi parashikon mjete të posaçme për adresimin e tyre në funksion të kontrollit të vendimmarrjeve për të cilat pretendohet se kanë impakt në mjedis. Këto pretendime, ndërsa nuk kanë të bëjnë me rëndësinë vendore dhe as me përfshirjen e ceshtjes së planifikimit të atij territori konkret në rrethin e ceshtjeve të njesise së vetëqeverisjes vendore Bashkia Tirane, Kolegji Zgjedhor cmon se ato nuk mund të shërbejnë si shkak dhe të motivojnë shtrimin domosdoshmërisht në referendum të ceshtjes së kërkuar.

Në vlerësim të Kolegjit Zgjedhor, në konsistencë me qëndrimet e mëhershme të tij, referendumi vendor duhet domosdoshmërisht të zhvillohet për ceshtje të qeverisjes vendore, organet e të cilave i kanë të përcaktuara me ligj kompetencat e tyre, ndërkohë që në kuadër të ushtrimit të këtyre kompetencave, populli mund të ushtrojë drejtpërdrejtë qeverisjen nëpërmjet referendumit. Në rastin konkret, "Kurora e Gjelber e Tiranës" është përcaktuar sipas legjislativorit në fuqi si një zonë me rëndësi kombëtare, planifikimi i territorit të të cilit është përcaktuar i të njëjtes rëndësi (kombëtare), duke mos qenë planifikimi i saj një ceshtje e organeve të njesise së vetëqeverisjes vendore Bashkia Tirane.

Nga sa më lart, Kolegji Zgjedhor vlerëson se kërkesa e grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit vendor me të drejtë nuk është pranuar nga KQZ-ja, duke qenë i pabazuar në prova të ligj ankimi/padisë e paraqitur nga pala paditese PD, që si e tillë ajo duhet të rrezohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykes se Apelit Tirane,
bazuar ne nenin 158, pika 1, shkronja "b" dhe pika 3,
te Kodit Zgjedhor te ndryshuar,

V E N D O S I

Rrezimin e kërkesëpadisë.
U shpall në Tiranë, me date 16.05.2016.

ANËTAR

PETRIT ÇENO

ANËTAR

ILIR TOSKA

KRYESUS

FUAT VJERDHA

ANËTAR

KLITON SPAHIU

ANËTAR

VALBON ÇEKREZI

III. Vendime të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Vendim nr. 25

Data 25.01.2003

**PËR MIRATIMIN E FLETËS-TIP PËR MBLEDHJEN E
NËNSHKRIMEVE PËR ORGANIZIMIN E REFERENDUMIT TË
PËRGJITHSHËM, PËR SHFUQIZIMIN E LIGJIT NR. 8889 DATË
25.04.2002 “PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN
7703 DATË 11.05.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË””.**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me pjesëmarrjen e:

Ilirjan	CELIBASHI -	Kryetar
Maksim	SHIMANI -	Anëtar
Tomor	MALAJ -	Anëtar
Pandeli	VARFI -	Anëtar
Klement	ZGURI -	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.01.2003, shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për miratimin e fletës-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të 50 mijë zgjedhësve për organizimin e një Referendumi të Përgjithshëm, për shfuqizimin e ligjit nr. 8889 datë 25.04.2002 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë””.

BAZË LIGJORE: Neni 18, pika 1, neni 122, pika 2 e 4, dhe neni 123, pika 1 të ligjit nr. 8609, datë 08.05.2000 “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur:

VËREN

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura në shkresën me nr. 36. Prot., datë 12.01.2003 drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkon fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi të përgjithshëm për shfuqizimin e ligjit nr. 8889 datë 25.04.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë””. Konkretisht 12 nismëtarët, anëtarë të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, kërkojnë shfuqizimin e nenit 4 të ligjit nr.8889 datë 25.04.2002, i cili ndryshon nenin 31 të ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 si dhe shfuqizimin e nenit 6 dhe nenit 8 të ligjit 8889 që lidhen drejtëpërsëdrejti me ngritjen e moshës së pensionit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bëri verifikimet përkatëse lidhur me përputhshmërinë e kërkesës me nenin 122, pika 2 e 4, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenet, 18 pika 1, nenin 122, pika 2, e 4, si dhe neni 123, pika 1 të ligjit nr. 8609 datë 08.05.2000 “ Për kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”;

V E N D O S I

1) Miratimin e fletes-tip për mbledhjen e nënshkrimeve për zhvillimin e referendumi të përgjithshëm, për shfuqizimin e ligjit nr 8889 datë 25.04.2002 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi.

2) Grupi nismëtar të pajiset me fletët-tip, kundrejt pagesës 4 lekë per një fletë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

FLETË PËR MBLEDHJEN E NËNSHKRIMEVE PËR ORGANIZIMIN E REFERENDUMIT TË PËRGJITHSHËM

*Për shfuqizimin e ligjit nr. 8889, datë 25.04.2002 "Për disa shtesa
e ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet
shoqërore në Republikën e Shqipërisë".*

Nr	Emri Atesia Mbiemri	Date lindja (Dita, muaji, viti)	Nr. I dokumentit te identifikimit (Pasaporte, leternjoftim, karte zgjedhese certifikate me fotografi)	Nenshkrimi i zgjedhesit



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Vendim nr. 37

Data 21.03.2003

**PËR MIRATIMIN E FLETËS-TIP PËR MBLEDHJEN E
NËNSHKRIMEVE PËR ORGANIZIMIN E REFERENDUMIT
VENDOR, PËR BASHKIMIN E FSHATRAVE BUDULL DHE
BUBQ, KOMUNA BUBQ, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE-
TERRITORIALE TË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA
PREZË.**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me pjesëmarrjen e:

Ilirjan	CELIBASHI-	Kryetar
Gasper	KOKAJ-	Anëtar
Maksim	SHIMANI-	Anëtar
Tomor	MALAJ-	Anëtar
Pandeli	VARFI-	Anëtar
Igli	TOSKAJ-	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.03.2003, shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për miratimin e fletës-tip për mbledhjen e nënshkrimeve për organizimin e referendumit vendor, për bashkimin e fshatrave Budull dhe Bubq, Komuna Bubq, në njësinë administrative-territoriale të qeverisjes vendore, Komuna Prezë.

BAZË LIGJORE: Neni 18, pika 1, neni 128, pika 4, të ligjit nr. 8609, datë 08.05.2000 "Për kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike:

VËREN

12 nismëtarë të Komunës Prezë në shkresën me nr. 1. Prot, datë 20.02.2003 drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkojnë fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor për bashkimin e dy fshatrave Budull dhe Bubq, Komuna Bubq në njësinë administrative-territoriale të qeverisjes vendore, Komuna Prezë. Kërkesën e tyre për zhvillimin e referendumit vendor për bashkimin e këtyre dy fshatrave në Komunën Prezë 12 nismëtarët e mbështesin mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomik dhe të traditës historike që këto fshatra kanë në Komunën Prezë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bëri verifikimet përkatëse lidhur me përputhshmërinë e kërkesës me nenin 122, pika 2 e 5 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenet, 18 pika 1, nenin 128, pika 4 të ligjit nr. 8609 datë 08.05.2000 “ Për kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”;

V E N D O S I

1) Miratimin e fletës-tip për mbledhjen e nënshkrimeve për zhvillimin e referendumit vendor për bashkimin e fshatrave Budull dhe Bubq, Komuna Bubq në njësinë administrative-territoriale të qeverisjes vendore, Komuna Prezë, sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi.

2) Grupi nismëtar të pajiset me fletët-tip, kundrejt pagesës 8 lekë per një fletë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

* * *



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Vendim nr. 505

Data 26.08.2003

**PËR PRANIMIN E KËRKESËS SË 12 NISMËTARËVE TË
BASHKIMIT TË SINDIKATAVE TË PAVARURA TË SHQIPËRISË
PËR ORGANIZIMIN E REFERENDUMIT TË PËRGJITHSHËM,
PËR SHFUQIZIMIN E LIGJIT NR. 8889 DATË 25.04.2002
“PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN 7703, DATË
11.05.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË””.**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me pjesëmarrjen e:

Ilirjan	CELIBASHI-	Kryetar
Dodë	PRENGA-	Anëtar
Maksim	SHIMANI-	Anëtar
Tomor	MALAJ-	Anëtar
Pandeli	VARFI-	Anëtar
Klement	ZGURI-	Anëtar
Igli	TOSKA-	Anëtar

në mbledhjen e tij të datës 26.08.2003, shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Pranimin e kërkesës së 12 nismëtarëve të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë për organizimin e referendumi të përgjithshëm, për shfuqizimin e ligjit nr. 8889 datë 25.04.2002 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë””.

BAZË LIGJORE: Neni 29, pika 1, neni 126, pika 1, 2, 4 dhe neni 128, pika 1, 2 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike:

VËREN

BSPSH në vijim të kërkesës nr. 36. prot, datë 12.01.2003 për organizimin e një Referendumi të përgjithshëm për shfuqizimin e ligjit nr. 8889, datë 25.04.2002 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” ka paraqitur pranë KQZ-së bashkangjitur shkresës nr 97. prot datë 25.04.2003, 2193 flete-tip me nënshkrimet e 52 632 votuesve shqiptarë.

Në vijim Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Vendimin e tij nr. 44, datë 13.05.2003, “Për miratimin e procedurave, për verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të paraqitur nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë për organizimin e Referendumit të Përgjithshëm, për shfuqizimin e Ligjit nr. 8889, datë 25.04.2002 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” miratoi ngritjen e Grupit Teknik të Punës i përbërë nga:

- a) Z. Kleonard PIPA, jurist pranë Drejtorisë Juridike
- b) Z. Angjeli THANASI, informaticien pranë Drejtorisë së Regjistrimit Kombëtar të Zgjedhësve
- c) Z. Muharrem ÇOBO, inspektor pranë Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore
- d) Znj. Fatbardha AJDARI, përgjegjëse e prot-Arkivit pranë Departamentit të Personelit

i krijuar me qëllim që të verifikojë:

1. Rregullsinë e Plotësimit të të gjithë elementëve të përcaktuar në fletën tip, të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr 25, datë 25.01.2003, “Për miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për organizimin

e Referendumit të Përgjithshëm për shfuqizimin e ligjit nr. 8889 datë 25.04.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;

2. Nëse emrat e jo më pak se 50 000 firmëtarëve, figurojnë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve, në kohën e paraqitjes së kërkesës.

Nga verifikimi i kryer dhe nga raporti i Grupit Teknik të Punës u konstatua që:

Nga 52 632 nënshkrime, 51 300 firmëtarë, kanë plotësuar elementet e përcaktuara në fletën tip konform kërkesës së KQZ-së të parashikuara në vendimin nr. 25, datë 25.01.2003, “Për miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për organizimin e Referendumit të Përgjithshëm, për shfuqizimin e ligjit nr. 8889 datë 25.04.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të cilët **figurojnë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve, në kohën e paraqitjes së kërkesës.**

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 29, pika 1, neni 126, pika 1, 2, 4 dhe nenin 128, pika 2, të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I

Pranimin e kërkesës së 12 nismëtarëve të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë për organizimin e Referendumi të Përgjithshëm, për shfuqizimin e ligjit nr. 8889 datë 25.04.2002 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë””.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Vendim nr. 609

Data 29.08.2003

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË NISMËTARËVE TË
KOMUNËS PREZË PËR ORGANIZIMIN E REFERENDUMIT
VENDOR, PËR BASHKIMIN E FSHATRAVE BUDULL DHE
BUBQ, KOMUNA BUBQ, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE-
TERRITORIALE TË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA PREZË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan	CELIBASHI-	Kryetar
Dodë	PRENGA-	Anëtar
Maksim	SHIMANI-	Anëtar
Tomor	MALAJ-	Anëtar
Pandeli	VARFI-	Anëtar
Klement	ZGURI-	Anëtar
Igli	TOSKA-	Anëtar

në mbledhjen e tij të datës 29.08.2003, shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Shqyrtimin e kërkesës së 12 nismëtarëve të Komunës Prezë për organizimin e Referendumit Vendor, për bashkimin e fshatrave Budull dhe Bubq, Komuna Bubq, në njësinë administrative-territoriale të Qeverisjes Vendore, Komuna Prezë

BAZË LIGJORE: Neni 29, pika 1, neni 132, pika 4 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike:

VËREN

Bazuar në vendimin nr 45, datë 13.05.2003 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për miratimin e procedurave, për verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të paraqitur nga 12 nismëtarët e Komunës Prezë për organizimin e Referendumit Vendor, për bashkimin e fshatrave Budull dhe Bubq, Komuna Bubq, në njësinë administrative-territoriale të Qeverisjes Vendore, Komuna Prezë” Grupit Teknik të Punës i përbërë nga:

- a) Z. Kleonard PIPA, jurist pranë Drejtorisë Juridike
- b) Z. Angjeli THANASI, informaticien pranë Drejtorisë së Regjistrimit Kombëtar të Zgjedhësve
- c) Z. Muharrem ÇOBO, inspektor pranë Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore
- d) Znj. Fatbardha AJDARI, përgjegjëse e prot-Arkivit pranë Departamentit të Personelit

i krijuar me qëllim që të verifikojë:

1. Rregullsinë e Plotësimit të të gjithë elementëve të përcaktuar në fletën tip, të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr 37, datë 21.03.2003, “Për miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për organizimin e Referendumit Vendor, për bashkimin e fshatrave Budull dhe Bubq, Komuna Bubq, në njësinë administrative-territoriale të Qeverisjes Vendore, Komuna Prezë
2. Nëse emrat e jo më pak se 10% të firmëtarëve, të secilës komunë figurojnë të regjistruar në listat e zgjedhësve të komunave përkatëse, në kohën e paraqitjes së kërkesës.

Ju raporton si vijon:

Nga verifikimi i kryer u konstatua që:

Me shkresën nr. 214/3 prot datë 03.05.2003 nismëtarët e Komunës Prezë kanë paraqitur 23 fletë-tip të plotësuar nga 552 firmëtarë gjithsej nga të dyja komuna Prezë e Bubq si më poshtë:

- a) **360 firmëtarë të Komunës Prezë**, kanë plotësuar elementet e përcaktuara në fletën tip konform kërkesës së KQZ-së të parashikuara në vendimin nr. 37, datë 21.03.2003, “ Për miratimin e fletes-tip për mbledhjen e nënshkrimeve për zhvillimin e Referendumit Vendor për bashkimin e fshatrave Budull dhe Bubq, Komuna Bubq në njësinë administrative-territoriale të qeverisjes vendore, Komuna Prezë”, të cilët **figurojnë të regjistruar në listat e Zgjedhësve të kësaj komune, në kohën e paraqitjes së kërkesës.**
- b) **120 firmëtarë të fshatit Budull dhe 72 të fshatit Bubq, pra gjithsej 192 firmëtarë të Komunës Bubq**, kanë plotësuar elementet e përcaktuara në fletën tip konform kërkesës së KQZ-së të parashikuara në vendimin nr. 37, datë 21.03.2003, “ Për miratimin e fletes-tip për mbledhjen e nënshkrimeve për zhvillimin e Referendumit Vendor për bashkimin e fshatrave Budull dhe Bubq, Komuna Bubq në njësinë administrative-territoriale të qeverisjes vendore, Komuna Prezë”, të cilët **figurojnë të regjistruar në listat e Zgjedhësve të kësaj komune, në kohën e paraqitjes së kërkesës.**

Nga të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Zgjedhësve na rezultoi se **Komuna Prezë** ka gjithsej **3875 zgjedhës**, të regjistruar në listat e zgjedhësve të kësaj komune, kurse **komuna Bubq** ka gjithsej **4851 zgjedhës**, të regjistruar në listat e zgjedhësve të kësaj komune.

Në bazë të nenit 128, pika 1, të ligjit nr. 8609, datë 08.05.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, dhe vendimit nr. 45, pika 2/b datë 13.05.2003 “Për miratimin e procedurave, për verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të paraqitur nga 12 nismëtarët e Komunës Prezë për organizimin e Referendumit Vendor, për bashkimin e fshatrave Budull dhe Bubq, Komuna Bubq, në njësinë administrative-territoriale të Qeverisjes Vendore, Komuna Prezë” **10% firmëtarë të komunës Prezë dhe 10% firmëtarë të komunës Bubq**, duhet të plotësonin elementët e përcaktuar në fletën tip.

Për të qënë më të saktë 387 firmëtarë **firmëtarë të komunës Prezë** dhe **485 firmëtarë të komunës Bubq**, duhet të plotësonin elementët e përcaktuar në fletën tip si dhe të figurojnë të regjistruar

në listat e zgjedhësve të komunave përkatëse, në kohën e paraqitjes së kërkesës.

Për komunën Prezë rezultoi që nga **387 firmëtarë** që duhet të ishin kemi **360 të tillë**.

Për komunën Bubq rezultoi që nga **485 firmëtarë** që duhet të ishin kemi **192 të tillë**.

Për sa më sipër ju bëjmë me dije se:

Dokumentacioni I paraqitur nga 12 nismëtarët e komunës Prezë në shkresën nr. 214 prot datë 3.5.2003 rezulton:

- a) Në kundërshtim me nenin nr. 128, pika 1, të ligjit nr. 8609, datë 08.05.2000 “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, i cili ka qënë në fuqi në kohën kur është në kohën kur është bërë kërkesa dhe verifikimi i dokumentacionit.
- b) Si dhe në kundërshtim me vendimin nr. 45, pika 2/b datë 13.05.2003 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për miratimin e procedurave, për verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të paraqitur nga 12 nismëtarët e Komunës Prezë për organizimin e Referendumit Vendor, për bashkimin e fshatrave Budull dhe Bubq, Komuna Bubq, në njësinë administrative-territoriale të Qeverisjes Vendore, Komuna Prezë”

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 29, pika 1, dhe nenin 132, pika 4 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I

Rrëzimin e kërkesës së 12 nismëtarëve të Komunës Prezë për organizimin e Referendumit Vendor, për bashkimin e fshatrave Budull dhe Bubq, Komuna Bubq, në njësinë administrative-territoriale të Qeverisjes Vendore, Komuna Prezë

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Vendim nr. 1688

Data 25.11.2005

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS TË PARAQITUR NGA
GRUPIMI “ALEANCA QYTETARE PËR MBROJTJEN E
GJIRIT TË VLORËS” PËR ORGANIZIMIN E REFERENDUMIT
VENDOR “PËR LEJIMIN OSE JO TË NDËRTIMIT TË
PARKUT INDUSTRIAL-ENERGJITIK (TEC-E, DEPOZITA
KARBURANTESH, TERMINAL NAFTE, RAFINERI, PORT
DETAR NAFTE) NË BREGDETIN E VLORËS”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 25.11.2005,
me pjesëmarrjen e:

Ilirjan	CELIBASHI -	Kryetar
Tomor	MALAJ -	Anëtar
Klement	ZGURI -	Anëtar
Dëshira	SUBASHI -	Anëtar
Çlirim	GJATA -	Anëtar
Dodë	PRENGA -	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Shqyrtimi i kërkesës të paraqitur nga Grupimi “Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës”, për organizimin e referendumit vendor “Për lejimin ose jo të ndërtimit të parkut energjitik (TEC-E, Depozitë karburantesh, Terminal nafte, Rafineri, Port detar) në bregdetin e Vlorës”

BAZË LIGJORE: Neni 108, pika 4, i Kushtetutës, neni 29, pika 1, neni 127 neni 128, dhe neni 132 pika 1, të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjo i diskutimet e të pranishmëve;

VËREN

Grupimi Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor për lejimin ose jo të ndërtimit të një Parku Industrial – Energjitik në bregdetin e Vlorës.

Me vendimin nr. 609, datë 04.06.2005 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi pranimin e kërkesës së grupimit “Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës” dhe paisjen me fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për referendum vendor.

Me datë 28.10.2005 grupimi “Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës” në bazë të nenit 127, pika 2 të Kodit Zgjedhor ka depozitur në KQZ fletët me nënshkrimet e 13 929 personave të cilët duhet të jenë zgjedhës të regjistruar në listat e zgjedhësve të Bashkisë Vlorë, Bashkisë Orikum, Komunës Novoselë dhe Komunës Qendër. Lista e zgjedhësve e dates 3 korrik 2005 e këtyre njësive të qeversijes vendore përmban 125 589 zgjedhës, pra grupimi “Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës” ka paraqitur, 1340 emra të personave që kanë nëshkruar në fletën-tip, më shumë se 10% të zgjedhësve që parashikon ligji.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bazë të nenit 127, pika 1 dhe 132, pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, verifikoi, emrat e 1714 ose 12.3% personave, të cilët kanë nëshkruar në fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve për referendum. Nga verifikimi rezultoi se 61 emra ose 3.5% e emrave të verifikuar nuk figurojnë të regjistruar në listat e zgjedhësve të komunave dhe bashkive përkatëse.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 108, pika 4 të Kushtetutës, nenin 29, pika 1, nenin 127, neni 128, dhe neni 132, pika 1, të ligjit Nr. 9087, datë 19.06. 2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

V E N D O S I

1. Rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga grupimi “Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës” për zhvillimin e referendumit vendor për lejimin ose jo të ndërtimit të një Parku Industrial – Energjistik në bregdetin e Vlorës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Vendim nr. 1876

Data 26.10.2007

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESES TË PARAQITUR NGA KËSHILLI I BASHKISË VLORË, PËR ORGANIZIMIN E REFERENDUMIT VENDOR “PËR LEJIMIN OSE JO TË NDËRTIMIT TË KOMPLEKSIT TË DEPOZITAVE TË NAFTËS DHE TERMINALIN E ANIJEVE NAFTËMBAJTËSE (PROJEKTI LA PETROLIFERA), BRENDA TERRITORIT TË BASHKISË VLORË”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 26.10.2007, me pjesëmarrjen e:

Çlirim
Flamur

GJATA -
ÇATO -

Kryetar
Zv/Kryetar

Arben	RISTANI -	Anëtar
Dëshira	SUBASHI -	Anëtar
Dodë	PRENGA -	Anëtar
Genti	SHALA -	Anëtar
Klement	ZGURI -	Anëtar
Shkëlqim	HYSI -	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës të paraqitur nga Këshilli i Bashkisë Vlorë, për organizimin e referendumit vendor “Për lejimin ose jo të ndërtimit të kompleksit të depozitave të naftës dhe terminalin e anijeve naftëmbajtëse (projekti la petrolifera), brenda territorit të Bashkisë Vlorë”

BAZË LIGJORE: Neni 108, pika 4, i Kushtetutës, neni 29, pika 1, neni 128, pika 1 dhe 2 dhe neni 132 pika 2 , të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve;

VËREN

Z. Arben Sinanaj, Kryetar i Këshillit të Bashkisë Vlorë, ne emer te ketij Keshilli i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vendimin e Keshillit te Bashkise Vlore me ane te se cilit i kerkohet K.Q.Z. organizimi i nje referendumit vendor. Kërkesa ben fjale për organizimin e referendumit vendor “Për lejimin ose jo të ndërtimit të kompleksit të depozitave të naftës dhe terminalin e anijeve naftëmbajtëse (projekti la petrolifera), brenda territorit të Bashkisë Vlorë”. Me anë të kësaj kërkesë, Këshilli i Bashkisë Vlorë në bazë të nenit 132, pika 2 të Kodit Zgjedhor kërkon kryerjen e një referendumit vendor, në nivel qarku, për tërheqjen e mendimit të popullit të kësaj njësie vendore lidhur me ndërtimin ose jo të depozitave të naftës nga kompania “La Petrolifera”, në zonën e ish Sodës. Në kërkesë është përshkruar çështja që shtrohet si dhe rëndësia e veçantë e saj.

Gjithashtu, çështja është formuluar në mënyrë të tillë që zgjedhësit të përgjigjen me “PO” ose “JO”.

Sipas nenit 132, pika 2 e Kodit Zgjedhor, një numër këshillash bashkiakë ose komunalë që përfaqësojnë jo më pak se një të tretën e popullsisë së një qarku, kanë të drejtë të kërkojnë zhvillimin e një referendumi për një çështje të qeverisjes vendore në nivel qarku.

Pas depozitimit të kërkesës në KQZ, me shkresën nr. 4807/2, datë 18.10.2007 dhe shkresën nr. 4807/3, datë 18.10.2007, për nevoja të shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga Këshilli i Bashkisë Vlorë, për të verifikuar plotësimin e kushteve të parashikuara në nenin 132, pika 2 dhe 3 të Kodit Zgjedhor për nismën e referendumit Vendor, u kërkuar informacion përkatësisht nga Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës dhe Ministria e Brendshme.

Në shkresën nr. 4807/6, datë 25.10.2007 të Ministrisë së Brendshme rezulton se numri i popullsisë së Bashkisë Vlorë është 128.639 dhe numri popullsisë së Qarkut Vlorë është 362.154..

Me shkresën nr. 4807, datë 24.10.2007 Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës sqaron se kërkesa e Këshillit të Bashkisë Vlorë datë 17.10.2007 dhe kërkesa e Grupimit Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës datë 30.05.2005 lidhen më dy çështje të ndryshme, që kanë trajtim dhe vendim-marrje të ndryshme dhe që nuk i referohen të njëjtit objekt. Bashkëlidhur shkresës së mësipërme, Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, i ka vënë në dispozicion KQZ edhe të gjitha aktet përkatëse, në bazë të të cilave do të ndërtohen këto objekte në bregdetin e Vlorës, si më poshtë:

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 251, datë 20.04.2001, “Për miratimin e Studimit “Përcaktimi i hapësirave të përshtatshme për ndërtimin e depozitave bregdetare të naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre”.
2. Vendimi i KRRTRSH-së nr. 4, datë 22.06.2007 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për terminalin bregdetar dhe infrastrukturës përkatëse portuale për depozitimin e naftës dhe nënprodukteve të saj në Gjirin e Vlorës, për shoqërinë “La Petrolifera italo Albaneze”

3. Vendimin e KRRTRSH-së nr. 2, datë 22.05.2007 “Për Miratimin e ndryshimit të destinacionit të Parkut Vlorë, nga “Parku Industrial dhe Energjitik”, në “Park Industrial”
4. Vendimi i KRRTRSH nr. 7, datë 11.09.2004 “Për miratimin e kufirit të Parkut Industrial dhe Energjitikë –Vlorë”
5. Vendimi i KRRTRSH nr.81, datë 19.02.2003 “Për miratimin e Parkut Industrial dhe Energjitikë –Vlorë”
6. Ligji nr.9231, datë 13.05.2004 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Koncesionit, të formës “BOO”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar...”

KQZ, në mbledhjen e datës 26.10.2007 mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Këshilli i Bashkisë Vlorë dhe pasi dëgjoi diskutimet anëtarëve të KQZ-së, përfaqësuesve të partive politike kryetarit të Këshillit të Bashkisë Vlorë z. Arbën Sinanaj dhe përfaqësuesit të grupimit Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës, vëren se: Kërkesa e paraqitur nga Këshilli i Bashkisë Vlorë është në përputhje me nenin 132, pika 2 të Kodit Zgjedhor të republikës së Shqipërisë, për sa i përket popullsisë që përfaqëson Këshilli i Bashkisë Vlorë. Në bazë të shifrave të ardhura nga Ministria e Brendëshme Këshilli i Bashkisë Vlorë përfaqëson me tepër se një të tretën e popullsisë së Qarkut Vlorë. Për sa i përket kërkesës që parashikon neni 132, pika 2 e Kodit Zgjedhor nëse çështja për të cilën Këshilli i Bashkisë Vlorë kërkon të shprehet mendimi i komunitetit të Qarkut Vlorë, duhet të jetë një çështje që i përket qeverisjes vendore në nivel Qarku u shqyrtuan të gjitha aktet e depozitura nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se miratimi për ndërtimin e kompleksit të depozitave të naftës dhe terminalin e anijeve naftëmbajtëse (projekti La Petrolifera), brenda territorit të Bashkisë Vlorë” është bërë me Vendime të Këshillit të Ministrave me Vendimet përkatëse të KRRTRSH dhe për më tepër Marrëveshja e Koncesionit, të formës “BOO”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar, për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj në Gjirin e Vlorës dhe marrëveshja e koncesionit, të formës “BOT”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar në Gjirin e Vlorës është ratifikuar me ligjin nr. 9231, datë 13.05.2004 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Aktet ligjore dhe nënligjore të mësipërme shprehin qartë se çështja për të cilën kërkohet referendum në nivel Qarku nuk është çështje e qeverisjes

vendore. Nuk ka asnjë vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë apo të organeve të tjera të qeverisjes vendore në nivel bashkie apo qarku. Vepra që është miratuar për ndertim ka karakter kombëtar dhe jo vendor, sepse është miratuar me ligj dhe me akte të qeverisjes qendrore dhe jo me akte të qeverisjes vendore. Gjithsesi ligjet nuk shfuqizohen me referendume lokale. Vetëm në bazë të nenit 150 pika 2 të Kushtetutës një ligj mund të nënshtrohet një referendumi të përgjithshëm dhe ky vetëm me propozim të Këshillit të Ministrave ose një të pestes së deputeteve dhe në shkallë kombëtare. Në asnjë rast me referendum vendor nuk mund të kundërshtohet një ligj, çfarëdo qoftë ai. Edhe në rast referendumi vendor ligji nuk mund të shfuqizohet. Do të kishim një rezultat referendumi dhe një ligj në fuqi kundër tjetrit. Si përfundim nga të gjithë këto arsye rezulton se nuk mund të organizohet referendum lokal për kundërshtimin ose jo të ndërtimit të një objekti të miratuar me ligj. Në këto kushte kërkesa duhet rrefuzuar si e pabazuar në ligj dhe në kushtetute dhe K.Q.Z. nuk mund të organizojë një referendum të tillë.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 108, pika 4 të Kushtetutës, nenin 29, pika 1, neni 128, pika 1 dhe 2 dhe neni 132, pika 2, të ligjit Nr. 9087, datë 19.06. 2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

V E N D O S I

Rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga Këshilli i Bashkisë Vlorë, për organizimin e referendumi vendor “Për lejimin ose jo të ndërtimit të kompleksit të depozitave të naftës dhe terminalin e anijeve naftëmbajtëse (projekti La Petrolifera), brenda territorit të Bashkisë Vlorë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Vendim nr. 47

Data 05.06.2008

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË 24 NISMËTARËVE, ME
OBJEKT: PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR ZHVILLIMIN
E REFERENDUMIT TË PËRGJITHSHËM PËR SHFUQIZIMIN E
NENIT 5, 7 DHE 8 TË LIGJIT NR.9904, DATË 21.04.2008”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 05.06.2008,
me pjesëmarrjen e:

Çlirim	GJATA-	Kryetar
Flamur	ÇATO-	Zv.Kryetar
Arben	RISTANI-	Anëtar
Dëshira	SUBASHI-	Anëtar
Dodë	PRENGA-	Anëtar
Fatmir	KUMBARO-	Anëtar
Genti	SHALA-	Anëtar
Klement	ZGURI-	Anëtar
Shkëlqim	HYSI-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës së 24 nismëtarëve,
me objekt: “Për fillimin e procedurave për
zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për
shfuqizimin e nenit 5, 7 dhe 8 të ligjit nr.9904,
datë 21.04.2008”

BAZË LIGJORE: Neni 29, pika 1, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve;

VËREN

Në datë 29.05.2008, z. Artur Zheji, Kryetar i Komitetit të Mbrojtjes së Kushtetutës, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, shkresën e datës 28.05.2008. Me anë të kësaj shkrese, një grup nismëtar prej 24 personash, të cilët janë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve, kërkojnë fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi të përgjithshëm për shfuqizimin e një pjese të ligjit, përkatësisht nenet 5, 7 dhe 8 të ligjit nr. 9904, datë 21.04.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

Në kërkesën e paraqitur grupi nismëtar kërkon shfuqizimin, e nenit 5 të ligjit të sipërcituar, i cili parashikon ndryshimin e nenit 87 të Kushtetutës, e nenit 7 i cili parashikon ndryshimin e nenit 104 të Kushtetutës dhe nenit 8 i cili parashikon ndryshimin e nenit 105 të Kushtetutës. Sipas grupit nismëtar, pjesa tjetër e ligjit është e vetëmjaftueshme, pasi nuk ka lidhje me dispozitat që kërkojnë të shfuqizojnë. Po sipas nismëtarëve këto dispozita (neni 5, 7 dhe 8 të ligjit 9904) çenojnë parimet bazë, frymën mbi të cilën është ndërtuar Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe denatyrojnë funksionet e organeve kushtetuese, duke çenuar funksionimin e shtetit të së drejtës. Më tej Grupi nismëtar parashtron arsyet përse dispozita të veçanta të ligjit nr. 9904, datë 21.04.2008 duhet të shfuqizohen.

Në përfundim të parashtrimit të arsyeve grupi nismëtar kërkon pajisjen me fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të 50 mijë zgjedhësve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve në kohën e paraqitjes së kërkesës.

KQZ, në mbledhjen e datës 05.06.2008, mori në shqyrtim kërkesën e 24 nismëtarëve dhe pranoi pjesëmarjen e nismëtarëve si persona të interesuar në këtë shqyrtim administrativ, përfaqësuar nga avokati Bledar Fejzo.

Sipas nismëtarëve, Kushtetuta, që kemi tani pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 9904, datë 21.04.2008 të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, është një Kushtetutë e re e ndryshme nga ajo e miratuar nga populli nepërmjet referendumit të vitit 1998. Për këtë arsye është populli ai që duhet të vendos nëse kushtetuta e miratuar prej Tij duhet të ndryshojë apo jo. Gjithashtu, nismëtarët të cilët kanë firmosur për të kërkuar fillimin e procedurave për referendum të përgjithshëm, sipas verifikimeve janë zgjedhës të regjistruar në regjistrin kombëtar të zgjedhësve, konform nenit 126 pika 2 të Kodit Zgjedhor.

Gjithashtu, nismëtarët mendojnë se kërkesa është në përputhje me nenin 150 të Kushtetutës dhe nenit 126, 127 të Kodit Zgjedhor dhe KQZ është institucioni që vetëm me paraqitjen e kërkesës investohet për të pajisur nismëtarët me Formularët-Tip për mbledhjen e të paktën 50 mijë firmave për iniciimin e një referendumi popullor. Pavarësisht arsyetimit për kompetencën e KQZ në lidhje me kërkesën, nismëtarët parashirojnë pretendimet e tyre për të bindur KQZ-së se kanë të drejtë për të kërkuar fillimin e procedurave për referendum të përgjithshëm, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 126, të Kodit Zgjedhor, pasi ligji, dispozita të vecanta të të cilit kërkohet të shfuqizohen, është një ligj i zakonshëm.

Pretendimet e nismëtarëve të paraqitura jo vetëm në kërkesën e depozituar, por edhe gjatë shqyrtimit administrativ në KQZ nuk qëndrojnë. Ligji nr. 9904, datë 21.04.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar është e qartë që, ka ndryshuar që në titullin e tij, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe përkatësisht nenin 87, nenin 104 dhe nenin 105 të saj.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e miratur me referendumin e vitit 1998, parashikon ushtrimin e drejtpërdrejtë të sovranitetit të popullit nepërmjet referendumit për një çështje ose një ligj të caktuar sipas neneve 108, pika 4, 150, 151, 152, dhe 177. Pra, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon disa lloj referendumesh. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 177 të saj parashikon edhe mënyrën e rishikimit të saj. Në nenin 177 të saj parashikohet se dy nga mënyrat e rishikimit të Kushtetutës janë rastet, pika 4, kur Kuvendi mund të vendosë, me dy të tretat

e të gjithë anëtarëve të tij që projektamendamenti kushtetues të votohet drejtpërsëdrejti me referendum, ose pika 5, amendamenti kushtetues i miratuar i nënshtrohet referendumit kur këtë e kërkon një e pesta e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Ligji nr. 9904, datë 21.04.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dispozita të të cilit kërkohet të shfuqizohen, është amendament kushtetues i miratuar dhe sipas nenit 177, pika 5 i nënshtrohet referendumit vetëm kur këtë e kërkon një e pesta e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parimet dhe proceduart për zhvillimin e referendumit si dhe vlefshmëria e tij parashikohen në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë përkatësisht në pjesën e nëntë të tij “Referendumet”. Kodi Zgjedhor në pjesën e nëntë të tij parashikon llojet e vecanta të referendumeve dhe pikërisht në nenin 122 të tij, referendumin kushtetues. Sipas nenit 122 të Kodit Zgjedhor mund të organizohen dy lloj referendumesh kushtetuese, referendum kushtetues sipas pikës 4 dhe referendum kushtetues sipas pikës 5, të nenit 177 të Kushtetutës.

Në rastin konkret jemi para një kërkesë për referendum kushtetues konform nenit 122 Kreut të Dytë, Pjesa e Nëntë, Seksionit të Parë “Referendumi Kushtetues” të Kodit Zgjedhor, dhe jo para kërkesës për referendum të përgjithshëm konform nenit 126 të Kodit Zgjedhor sic e kanë paraqitur kërkuesit. Gjithmonë, këtu flitet për procedurat fillestare që iniciojnë një referendum. Kjo rezulton nëse marrim si bazë thelbin e asaj që kërkohet të kundërshtohet me referendum, gjithmonë sipas kërkesës që është amendamenti për ndryshimet kushtetuese të miratuar me ligjin nr.9904 dt.21.04.2008. Ky ligj është pikërisht amendament kushtetues, ndryshimi i të cilit kërkon referendum kushtetues dhe jo ligj i thjeshtë ndryshimi apo shfuqizimi i të cilit kërkon referendum të përgjithshëm. Vetë ligjvënësi, si në kushtetutë ashtu edhe në Kodin Zgjedhor, i ka ndarë procedurat në: referendum kushtetues dhe në referendum të përgjithshëm. Nëse ndryshimet kushtetuese do të përfshiheshin në referendum të përgjithshëm, atëherë kapitulli për referendum kushtetues si procedurë me vete mbetet pa kuptim dhe pa vlerë. Është pikërisht një shprehje që i bashkon pikën 5 të nenit 177 të Kushtetutës me nenin 122 të Kodit Zgjedhor, “amendamentin kushtetues të

miratuar”. Kjo procedurë e veçantë për zhvillimin e referendumeve kushtetuese përjashton cdo procedurë tjetër pikërisht për shkak të rëndësisë që paraqet çështja, kur kemi të bëjmë me ndryshimin e ligjit themeltar të shtetit, kushtetutën.

Sipas Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë përkatësisht në Referendumin Kushtetues në nenin 123, ku përcaktohen procedurat fillestare, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk është organi, të cilit i drejtohet kërkesa për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit kushtetues. Neni 123 dhe 124 përcaktojnë qartë procedurën fillestare me dorëzimin e kërkesës, sekretarit të përgjithshëm të Kuvendit duke vazhduar më pas me shqyrtimin paraprak nga Gjykata Kushtetuese. Sic vihet re, KQZ nuk përmendet fare dhe vihet në lëvizje vetëm pas caktimit të datës së referendumit nga Presidenti dhe njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit konform nenit 125 pika 2 të Kodit Zgjedhor.

Për sa më sipër, KQZ konstaton së kërkesa e paraqitur nga 24 nismëtarët për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e nenit 5, 7 dhe 8 të ligjit nr.9904, datë 21.04.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar nuk është objekt i shqyrtimit nga KQZ.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 29, pika 1, të ligjit Nr. 9087, datë 19.06. 2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

V E N D O S I:

Mospranimin për shqyrtim të kërkesës së 24 nismëtarëve me objekt: “Për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e nenit 5, 7 dhe 8 të ligjit nr.9904, datë 21.04.2008”.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Vendim nr. 26

Data 28.09.2010

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË NJË GRUPI NISMËTAR,
PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR ZHVILLIMIN E
NJË REFERENDUMI PËR NJË ÇËSHTJE TË RËNDËSISË SË
VEÇANTË “A DONI TË RINUMËROHEN FLETËT E VOTIMIT TË
ZGJEDHJEVE TË 28 QERSHORIT 2009”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 28.09.2010,
me pjesëmarrjen e:

Arben	RISTANI -	Kryetar
Artan	LAZAJ -	Anetar
Hysen	OSMANAJ -	Anëtar
Klement	ZGURI -	Anëtar
Pandeli	VARFI -	Anëtar
Vera	SHTJEFNI -	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi nismëtar,
për fillimin e procedurave për zhvillimin e
një referendumi për çështjen e rëndësisë së
veçantë “A doni të rinumërohen fletët e votimit
të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009”

BAZË LIGJORE: Neni 150, pika 1, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 21, pika 1, neni 185, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, neni 126, pika 1, 2, dhe 4 dhe neni 127 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve;

VËREN

Me shkresën nr. 403 prot., datë 27.08.2010, një grup nismëtarësh i është drejtuar Presidentit të Republikës dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me një kërkesë për referendum.

Grupi nismëtar, i përbërë prej 14 personash, në mbështetje të nenit 150 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 126, pika 1, të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003, kërkon nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi me qëllim për t'i dhënë fund krizës politike si një çështje e një rëndësie të veçantë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 126, pika 2, të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003, përpara shqyrtimit të kërkesës së paraqitur, përmbushi detyrimin ligjor për verifikimin nëse anëtarët e grupit nismëtar për zhvillimin e referendumit, figurojnë zgjedhës të regjistruar në Listën e Zgjedhësve. Për këtë qëllim, KQZ iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, në cilësinë e autoritetit përgjegjës nëpërmjet shkresave nr. 415 prot., datë 02.09.2010, dhe 415/1 prot., datë 15.09.2010.

Përfundimisht, në përgjigje të kërkesave të përsëritura, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 5308/3 prot., datë 22.09.2010, konfirmon se 13 nga 14 shtetasit që figurojnë në listën e grupit nismëtar, janë të rregjistruar në listën e zgjedhësve. Bazuar në faktin se 13 nga 14 anëtarët e grupit nismëtar janë zgjedhës të rregjistruar në listën e zgjedhësve, fakt i cili përmbush kriterin e përcaktuar në nenin 126, pika 2, KQZ mund të procedojë më tej me shqyrtimin e kërkesës së paraqitur.

KQZ, në mbledhjen e datës 28.09.2010 mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga grupi nismëtar, dhe pranoi pjesëmarjen e nismëtarëve si persona të interesuar në këtë shqyrtim administrativ,

Nga analiza e përmbajtjes së kërkesës së paraqitur rezulton se ky grup nismëtar, vlerëson se në vend ka krizë politike, kjo falë pozicionimit të kundërt të forcave kryesore politike sa i përket hapjes apo jo të kutive të votimit të 28 qershorit 2009. Grupi nismëtar shprehet se në këto kushte Sovrani duhet të marrë përgjegjësinë e fateve të vendit nëpërmjet referendumit, pra të vendosë nëse kutitë do të hapen, nëse votat duhet të rinumërohen, dhe se nga kush do të rinumërohen. Ky propozim, dhe kjo iniciativë, shprehen kërkuessit, buron nga dështimet e njëpasnjëshme të lëvizjeve politike të të dy krahëve.

Bazuar në argumentat e parashtruara në kërkesë, konkretisht, nëse populli nuk ndërhyr do të ketë përkeqësime të situatës; për të mënjeluar destabilizimin e Shqipërisë; dhe mendimin se kjo çështje mund të marrë zgjidhje vetëm nëpërmjet referendumit të përgjithshëm mbarëpopullor, vlerësojnë çështjen të një rëndësie të veçantë. Mbi bazën e këtij vlerësimi, si dhe në referim të nenit 126, pika 1, të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003, kërkojnë zhvillimin e referendumit, duke theksuar se nëpërmjet tij shqiptarët kanë mundësi të shprehin vullnetin e tyre të lirë sa i përket rinumërimit të votave të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009.

Në vijim, grupi nismëtar duke ritheksuar se objekti i referendumit do të jetë zgjidhja e krizës politike që ka bllokuar jetën institucionale dhe ekonomike në vend, shton se në përputhje me nenin 126, pika 5, nenin 127, pika 1, të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003, pyetja që duhet vendosur në krye të fletëve-tip duhet të jetë “A duhet të rinumërohen fletët e votimit të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009”? Po/Jo”.

Nisur nga fakti se në kërkesën e paraqitur në KQZ grupi nismëtar ka paraqitur si objektiv të referendumit zgjidhjen e krizës politike dhe si pyetje që do të shtrohte në referendum “A duhet të rinumërohen fletët e votimit të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009”, nuk del e qartë se cila është çështja e rëndësisë së veçantë për të cilën duhet të zhvillohet referendumi. Për sa më sipër KQZ i kërkoi grupit nismëtar saktësimin dhe qartësimin se cila nga çështjet e shtruara do të jetë

çështje e rëndësisë së vecantë e cila do të shtrohet në referendum. Në diskutimin e tyre në seancë grupi nismëtar qartësoi se çështja e rëndësisë së vecantë e cila kërkohet të shtrohet në referendum është: A duhet të rinumërohen fletët e votimit të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009?”

KQZ, në përfundim, pasi dëgjoji diskutimet e grupit nismëtar konstaton se:

Në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit si dhe vlefshmëria e tij parashikohen në pjesën e nëntë të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003, pjesë e cila nuk është shfuqizuar nga ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Në kreun II të kësaj pjese parashikohen llojet e vecanta të referendumeve, dhe në seksionin 2, neni 126, përcaktohet se nisma për referendum të përgjithshëm mund të ndërmerret si për shfuqizimin e një ligji apo për një çështje të rëndësisë së veçantë. Në interpretim të këtij parashikimi ligjor dallohen qartë dy llojet e referendumeve që 50 mijë zgjedhës kanë të drejtë të kërkojnë.

Pikërisht për ti dhënë mundësi grupit nismëtar që kërkesën e tij ta bazonte korrektësisht në ligj, KQZ kërkoi nga ky grup, në mënyrë të përsëritur, që kërkesa të përcaktonte llojin e referendumit që kërkohet. Për ta theksuar, KQZ kërkoi që grupi të pozicionohej qartë nëse kërkonte referendum për shfuqizimin e një ligji apo referendum për një çështje të rëndësisë së vecantë e cila nuk të con në shfuqizime ligjore.

Përcaktimi i saktë i asaj që kërkohet nga kërkuesit është kusht themelor ligjor për KQZ për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm ligjor nga kërkuesi dhe për të ndërtuar fletën tip për mbledhjen e nënshkrimeve sipas përcaktimeve të nenit 127 të K.Z.

Përfundimisht grupi nismëtar, kërkuesit, u pozicionuan duke kërkuar “A doni të rinumërohen fletët e votimit të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009? Po/Jo, si referendum për një çështje të rëndësisë së vecantë.

Në funksion të kësaj kërkesë KQZ është e mendimit se:

Rinumërimi i fletëve të votimit të zgjedhjeve dhe destinacioni i fletëve të votimit pas përfundimit të procesit zgjedhor, është një

proces i cili është i trajtuar dhe rregulluar me ligj (Kodi Zgjedhor i R.SH.) Për këtë arsye pyetja që grupi nismëtar kërkon të shtrojë në referendum “A doni të rinumërohen fletët e votimit të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009? Po/Jo” është një pyetje e cila pa mëdyshje, të con në përfundimin se jemi përpara një çështje që zgjidhet me referendum për shfuqizimin e një ligji dhe jo me referendum për një çështje të një rëndësie të vecantë.

Duke menduar se pyetja që kërkohet të shtrohet është formalisht për një lloj referendumi, ndërsa në praktikë synohet një lloj tjetër referendumi, KQZ arin në përfundimin se kërkesa nuk është korrekte ligjerisht dhe vendos në pamundësi KQZ për të hartuar fletën tip për mbledhjen e nënshkrimeve.

Nenit 126 pika 4 i K.Z. përcakton se çfarë duhet të përmbajë kërkesa për fillimin e procedurave për shfuqizimin e një ligji ose të një pjese të tij, ndërsa pika 5 e të njëjtit nen përcakton se çfarë përmban kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për një çështje të një rëndësie të vecantë.

Kërkesa objekt shqyrtimi është një përzierje e qëllimshme e të dy llojeve të referendumeve duke sjellë si pasojë pamundësinë e KQZ për të shqyrtuar në themel kërkesën, pra për të vendosur përmbajtjen e fletës tip.

Duke qënë se legjitimiteti i kërkuesve për të bërë kërkesën e tyre dhe përcaktimi i qartë sipas ligjit i objektit të kërkesës janë dy nga çështjet kryesore që KQZ shqyrton për ta pranuar kërkesën në parim, KQZ vjen në konkluzionin se kërkesa nuk duhet pranuar për shqyrtim pasi parimisht është e gabuar ligjerisht. Parimisht kërkesa duhet të marri formën e duhur ligjore duke përcaktuar saktë objektin ligjor të referendumit dhe duke plotësuar sipas rastit dhe llojit të referendumit kërkesat e pikave 4 ose 5 të nenit 126 të K.Z.

Pranimi për shqyrtim i kërkesës për fillimin e procedurave të referendumit, sipas parashikimeve të K.Z., do të thotë diskutimi nga KQZ dhe më pas vendimmarrja për përcaktimin e përmbajtjes së fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve të 50 mijë zgjedhësve.

Në rastin konkret, kur përzihen dy llojet e mundshme të referendumeve, dhe nuk plotësohet përmbajtja ligjore e kërkesës

sipas përcaktimeve ligjore, as për njërin lloj referendumi dhe as për tjetrin, KQZ është e mendimit se nuk mund ta shqyrtojë në themel kërkesën pasi ajo parimisht është e ndërtuar në kundërshtim me ligjin.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2009 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, neni 128, pika 2, e ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003,

V E N D O S I:

Mospranimin për shqyrtim të kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit për një çështje të rëndësishme të veçantë “A doni të rinumërohen fletët e votimit të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Vendim nr. 1236

Data 22.12.2011

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË GJASHTËMBËDHJETË NISMËTARËVE PËR PAJISJEN ME FLETËT-TIP PËR MBLEDHJENE E NËNSHKRIMEVE PËR ZHVILLIMIN E REFERENDUMIT TË PËRGJITHSHËM PËR SHFUQIZIMIN E NJËPJESE TË LIGJIT NR. 10463, DATË 22.09.2011 “PËR MEXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.12.2011, me pjesëmarrjen e:

Arben	RISTAN -	Kryetar
Artan	LAZAJ -	Anëtar
Hysen	OSMANAJ -	Anëtar
Klement	ZGURI -	Anëtar
Vera	SHTJEFN I-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës së gjashtëmbëdhjetë nismëtarëve për paisjen me fletë-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për referendum të përgjithshëm për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”

BAZË LIGJORE: Neni 21, pika 1, neni 126 pika 2,3 e 4, neni 127, të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve;

VËREN

Në datë 30.11.2011, një grup prej 16 nismëtarësh ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën nr 6531 prot, datë 30.11.201. Me anë të kësaj kërkesë, një grup nismëtar prej 16 personash kërkojnë fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi të përgjithshëm, për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Neni 22, “Rrjeti i integruar i i mpianteve të trajtimit të mbetjeve, pika 3 dhe neni 49 “Importi i mbetjeve jo të rrezikshme”, janë dispozitat konkrete të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 të cilat kerkohen të shfuqizohen.

KQZ në mbështetje të nenit 126, pika 2 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 i ndryshuar, me, shkresën nr. 6545, datë 05.12.2011, i kërkoi Ministrisë së Brendëshme si organi kompetent të verifikojë nëse 16 personat me cilësinë e grupit nismëtar janë apo jo zgjedhës, Ministria e Brendëshme me shkresën nr.6545/1, datë 15.12.2011

konfirmon faktin se 16 personat janë zgjedhës. Gjithashtu nga verifikimi rezultoi se kërkesa e paraqitur, përmbush elementet e kërkuara nga neni 126, pika 4, i ligjit të sipërcituar, pasi përmban titullin, numrin dhe datën e miratimit të ligjit pjesë të të cilit kërkohet të shfuqizohet, dhe dispozitat konkrete të cilat kërkohet të shfuqizohet.

Në mbështetje të nenit 127 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 i ndryshuar, KQZ duhet të pajis kundrejtë pagesës grupin nismëtar me fletën tip, për mbledhjene e nënshkrimeve të 50 mijë zgjedhësve, të cilët duhet të jenë zgjedhës në kohën e paraqitjes së kërkesës. Po sipas nenit 127 të ligjit të sipërcituar, në krye të fletës tip duhet të shënohet titulli i ligjit si dhe dispozitat që kërkohen të shfuqizohen.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 21, pika 1, nenin 126 pika 2, dhe 4, nenin 127, pika 1 të ligjit Nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

V E N D O S I

1. Pranimin e kërkesës së 16 nismëtarëve për paisjen me fletë-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për referendum e përgjithshëm për shfuqizimin e nenit 22, “Rrjeti i integruar i impianteve të trajtimit të mbetjeve, pika 3 dhe nenit 49 “Importi i mbetjeve jo të rrezikshme” të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

2. Miratimin e modelit të fletës-tip sipas Modelit F-01 bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Vendim nr. 10

Date 28.06.2012

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR ZHVILLIMIN E
REFERENDUMIT TË PËRGJITHSHËM PËR SHFUQIZIMIN
E NJË PJESE TË LIGJIT NR. 10463, DATË 22.09.2011 “PËR
MENXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 28.06.2012,
me pjesëmarrjen e:

Arben	RISTANI -	Kryetar
Dëshira	SUBASHI -	Zëvendëskryetare
Artan	LAZAJ -	Anëtar
Hysen	OSMANAJ -	Anëtar
Klement	ZGURI -	Anëtar
Vera	SHTJEFNI -	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”

BAZË LIGJORE: Neni 21, pika 1, neni 119, pika 6, neni 127, pika 2, neni 128, pika 1 dhe 2, neni 129, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve, të Grupit Nismëtar për referendumin, përfaqësueseve të Partisë Demokratike, përfaqësuesve të Partisë Socialiste;

VËREN

Në datë 30.11.2011, një grup prej 16 nismëtarësh paraqiten në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi të përgjithshëm, për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Neni 22, “Rrjeti i integruar i i mpianteve të trajtimit të mbetjeve, pika 3 dhe neni 49 “Importi i mbetjeve jo të rrezikshme”, janë dispozitat konkrete të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, të cilat kërkohen të shfuqizohen.

Në mbështetje të nenit 127 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 i ndryshuar, KQZ me vendimin nr. 1236, datë 22.12.2011, vendosi miratimin e modelit të fletës-tip sipas Modelit F-01 dhe pajisi grupin nismëtar, kundrejt pagesës, me numrin e duhur të tyre për mbledhjen e nënshkrimeve të 50 mijë zgjedhësve.

Më datë 13.03.2012, trembëdhjet prej nismëtarëve, u paraqitën në KQZ për të depozituar kërkesën, së bashku me nënshkrimet e zgjedhësve për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Nisur nga fakti se dokumentacioni ishte voluminoz dhe nuk mund të merrej në dorëzim nga KQZ brenda datës 13.03.2012, nismëtarët depozituan në KQZ kërkesën tjetër nr. 309, datë 13.03.2012, me anë të së cilës kërkonin që dokumentacioni të rinte fizikisht në ambientet e KQZ-së i siguruar brenda kutive të votimit, të cilat do të mbylleshin me kode sigurie. Kodet e sigurisë do të mbaheshin shënim nga të dy palët (nismëtarët dhe punonjësit e KQZ-së) dhe, çdo ditë, në prani të të dy palëve do të hapeshin kutitë dhe do të behëj dorëzimi dhe protokollimi i dokumentacionit. Kërkesa e nismëtarëve nr. 309, datë 13.03.2012, u pranua nga KQZ dhe marrja në dorëzim e të gjithë formularëve Tip Model-01F (nënshkrimeve), sipas procesverbalit të dorëzimit nr. 341, dt. 30.03.2012, përfundoi më datë 30.03.2012.

Kërkesën për referendum të përgjithshëm, nismëtarët si depozitues të nënshkrimeve të zgjedhësve e bazojnë në nenin 150, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 9087, datë 19.06.2003, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, pjesa e nëntë, neni 126, pika 2, 3 dhe 4 dhe neni 127.

KQZ, në përputhje me nenin 128 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, brenda 90 ditëve, duke filluar nga data 30.03.2012, verifikoi nënshkrimet dhe saktësinë e dokumentave të identifikimit të zgjedhësve, duke u bazuar mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur. Pas marrjes në dorëzim të kërkesës për zhvillimin e referendumit dhe nënshkrimeve përkatëse, Sekretarja e Përgjithshme e KQZ-së me shkresat nr. 356, datë 03.04.2012 dhe nr.356/1, datë 13.04.2012, vendosi të ngrejë grupin e punës në funksion të verifikimit të nënshkrimeve dhe saktësisë së dokumentave identifikues. Grupi i punës filloi menjëher nga puna duke përcaktuar se objekt i verifikimit të dokumentacionit ishte:

Afati i dorëzimit të kërkesës në KQZ;

Verifikimi i dokumentacionit nëse nënshkrimet e zgjedhësve ishin mbledhur në Fletën-Tip të miratuar nga KQZ;

Verifikimi i plotësimin të dhënave që kërkohet në fletën tip

Numërimi i të gjithë zgjedhësve dhe nënshkrimeve

Numërimi i të gjitha kopjeve të dokumentave të identitetit

Verifikimi i përputhjes së të dhënave të zgjedhësve që kanë depozituar nënshkrimin në Fletën-Tip me të dhenat në dokumentin e identifikimit

Verifikimi i kushtit nëse nënshkruesit në fletën-tip, ishin zgjedhës në momentin e depozitimit të kërkesës mëpërmjet verifikimit në dokumentin e identitetit të moshës së nënshkruesve

Nga verifikimi i dokumentacionit të kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm, për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Neni 22, “Rrjeti i integruar i impianteve të trajtimit të mbetjeve, pika 3 dhe neni 49 “Importi i mbetjeve jo të rrezikshme”, rrezulton se: Grupi nismëtar rrezulton se ka depozituar gjithësej **3798** Flet-Tip në të cilat janë **65649** shtetas që kanë nënshkruar dhe **64655** kopje të kartave të identitetit.

Në **3798** Fletët-tip e depozituara rezulton se:
në **9** raste mungon nënshkrimi në rubriken nënshkrimi i zgjedhësit,;
në **1470** raste mungon atësia;
në **5** raste mungon ditëlindja;
në **3455** raste te dhenat në fletën tip nuk janë plotësuar me germa kapitale;
në **994** raste mungon karta e identitetit;
në **49** raste si dokument identifikimi është bashkelidhur kopje e pasaportes jo biometrike e vjetër, **2** persona fotokopje të Letër Njoftimit ët vjetër, **1** person fotokopje te vizes shengen;
në **93** raste gjeneralitet emri/mbiemri/datëlindja të shënuar në fletën-tip janë të ndryshëm nga të dhënat në kartën e identitetit;
në **246** raste nuk përputhet numri personal i identitetit me nr personal në dokumentin e identitetit;
në **4** raste mungon numri personal i identifikimit ne formular
në **3** raste ka dublime emri dhe nenshkrimi i zgjedhësit është ne dy formular
218 raste janë të datëlindjes më të vogel se 18 vjec në datë 30.03.2012
Në **1889** raste është shënuar gabim numri personal i edentifikimit

Në vijim të verifikimit të nënshkrimeve dhe dokumentacionit përkatës, me sy të lirë u krijua dyshimi se, shumë emra të zgjedhësve dhe nënshkrimet përkëtëse të tyre ishin të plotësuar nga e njëjta dorë. Në këto Kushte KQZ, me shkresen nr.520, datë 12.06.2012 dërgoi duke bërë një përzgjedhje rastësore, nga qarqe të ndryshme, një pjesë të Modeleve-Tip pranë Institutit të Policisë Shkencore, për të bërë verifikim të specializuar të emrave dhe nënshkrimeve të zgjedhësve, për të cilat ka lindur dyshimi i falsifikimit. Sipas shkresës nr. 2407, datë 22.06.2012 të Institutit të Policisë Shkencore rezulton se rreth 70% e nënshkrimeve, nga kampionët të cilat u dërguan për ekspertim, janë të falsifikuara, të bëra nga e njëjta dorë. Nga verifikimi i të gjithë dokumentacionit të dorëzuar, KQZ konstaton se, numri i zgjedhësve të cilët kanë nënshkruar në formularin-tip Model 01-F është **65649**. Duke hequr nga ky numër, numrin e nënshkrimeve me parregullsitë e përmendura më sipër, numëri i zgjedhësve, të cilët kanë nënshkruar për zhvillimin e referendumit të përgjithëshëm, ngelet përsëri më i madh së 50.000.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës për Referendum përfaqësuesi ligjor i Partisë Demokratike, ngriti pretendimin se verifikimi i kryer nga KQZ

në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nuk është i plotë. Sipas PD, KQZ në vendimin nr. 1236, datë 22.12.2011 “Për shqyrtimin e kërkesës së gjashtëmbëdhjetë nismëtarëve për paisjen me fletë-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për referendum të përgjithshëm për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, në pikën 4 të udhëzuesit ka përcaktuar detyrimin se zgjedhësit duhet të plotësojnë vetë më shkrimin të dhënat në rreshtin përkatës të fletes tip.

Nga sa rezulton, KQZ nuk e ka bërë një verifikim të tillë, nëse zgjedhësi ka plotësuar individualisht të dhënat (emër, atësi, mbiemër, ditëlindje), por KQZ është mjaftuar vetëm me verifikimin e nënshkrimeve. Gjithashtu, sipas përfaqësuesit ligjor të Partisë Demokratike, nga verifikimi i një kampioni të nënshkrime (rreth 147 nga 65649), nga organi i kompetent (Drejtori e Policisë Shkencore), rezultoi se ka rreth 70% të tyre të falsifikuara, të bëra nga një dorë. Nga sa më sipër lind dyshimi se, ky raport duhet të reflektohet edhe në pjesën tjetër të nënshkrimeve, të cilat për pamundësi kohore nuk mund të verifikohen të gjitha nga organi kompetent. Në rast se ky verifikim nuk e shtrin efektin edhe tek pjesa tjetër e nënshkrimeve, verifikimi nga KQZ është i paplotë. Në këto kushte Partia Demokratike kërkoi të vazhdojë verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, në mënyrë që t’i jepet përgjigje dy pyetjeve:

1. Në sa raste nuk është respektuar pika 4 e udhëzuesit, të miratuar me vendimin e KQZ nr. 1236, datë 22.12.2011?
2. Në sa nga 65649 nënshkrimet, ka firma te hedhura nga një dorë duke, nisur nga rezultati i dalë nga kampioni prej 147 firma?

KQZ, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit konstaton se, pavarësisht faktit se në një numër të madh nuk është respektuar pikërisht kërkesa e përcaktuar në pikën 4 të udhëzuesit të miratuar me Vendimin e KQZ nr. 1236, datë 22.12.2011, fakti që për çdo zgjedhës që ka nëshkruar është bashkëlidhur kopja e kartës së identitetit, na bind se vullneti i zgjedhësit është i pacënuar. Duke qenë se çdo zgjedhës ka dorëzuar kopjen e kartës së identitetit tregon se ka vullnet për të kërkuar zhvillimin e referendumit, për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Gjithashtu, për sa i përket fallsifikimit të firmave rezulton se, dyshimi me sy të lirë në lidhje

me firmat e hedhura nga një dorë nuk e kalon shifrën prej 50 000 zgjedhës, kusht i kërkuar nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor, për të kërkuar zhvillimin e një referendumi të përgjithshëm.

Në këto kushte KQZ me vendim të ndërmjetëm vendosi rrëzimin e kërkesës së Partisë Demokratike.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës për referendum, lidhur me përcaktimin e kohës se kur KQZ duhet t' ia përcjellë kërkesën për referendum të miratuar Gjykatës Kushtetuese, përfaqësuesi ligjor i Partisë Demokratike, në mbështetje të nenit 129, parashtrori kërkesën se, KQZ përcjell kërkesat për referendum të përgjithshëm, Presidentit të Republikës dhe Gjykatës Kushtetuese, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 119 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë". Neni 119 i ligjit të sipërcituar, në pikën 6 të tij, përcakton se: ...kërkesat për referendum, që nuk kanë kaluar nëpër të gjitha procedurat, brenda datës 15 mars të çdo viti, pavarësisht se kur janë paraqitur, shtyhen deri në vitin pasardhës.

Nisur nga kërkesa e paraqitur nga grupi nismëtar, për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqzimin e një pjese të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" rezultoi se, kjo kërkesë nuk i ka përfundur procedurat brenda datës 15 mars të vitit 2012.

Në këto kushte kërkesa për referendum e miratuar nga KQZ duhet t' i përcilllet Gjykatës Kushtetuese vitin tjetër.

KQZ shqyrtoi kërkesën e paraqitur dhe konstatoi se ajo është në përputhje me nenet 129, pika 2 dhe 119, pika 6 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në Neni 21, pika 1, nenit 119 pika 6, neni 127, pika 2, neni 128, pika 1 dhe 2, neni 129, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I

1. Pranimin e kërkesës, për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
2. Në zbatim të nenit 129, pika 1 dhe 119, pika 6 të të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, dërgimin e kërkesës për referendumin e përgjithshëm për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” Presidentit të Republikës dhe Gjykatës Kushtetuese më datë 03.01.2013.
3. Të njoftojë Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin për pranimin e kërkesës për referendum të përgjithshëm për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Vendim nr. 24

Data 14.11.2014

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË NJË GRUPI NISMËTARËSH PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE, PËR ZHVILLIMIN E REFERENDUMIT VENDOR NË KOMUNËN PËRPARIM

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 14.11.2014, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	LUZI-	Kryetare
Hysen	OSMANAJ-	Anëtar
Klement	ZGURI-	Anëtar
Vera	SHTJEFNI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi nismëtarësh për fillimin e procedurave, për zhvillimin e një referendumi në Komunën Përparim.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa a, i ligjit nr 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 126, pika 2 dhe 5, neni 127, pika 1, neni 132, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve;

VËREN:

Në datë 30.10.2014, një grup prej 15 nismëtarësh ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën nr.1435 prot, datë 30.10.2014. Me anë të kësaj kërkesë, grupi nismëtar i drejtohet KQZ-së për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor, në nivel të njësisë bazë të qeverisjes vendore.

Kërkesën e tyre Grupi nismëtar e bën në mbështetje të nenit 2, pika 2, nenit 108, pika 2 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe dispozitave konkrete të Kodit Zgjedhor, për zhvillimin e referendumeve.

KQZ, në mbështetje të nenit 132, pika 4, nenit 126, pika 2 dhe nenit 127, pika 1 të ligjit nr.9087, datë 19.06.2003, i ndryshuar, duhet të verifikojë nëse nismëtarët e depozitimit të kërkesës, janë zgjedhës të Komunës Përparim, dhe të pajisë grupin nismëtar, kundrejt pagesës, me fletën-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme.

Bashkëlidhur kërkesës, nismëtarët për secilin prej tyre kanë depozituar kopje të kartës së Identitetit dhe/ose certifikatë personale të lëshuar nga Komuna Përparim respektivisht në datat 27.08.2014.

Për plotësimin e kushtit, nëse nismëtarët janë zgjedhës të Komunës Përparim në mbështetje të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 45 dhe 46, pika 1, të Kodit Zgjedhor, dhe praktikës së vendosur në raste të ngjashme, KQZ verifikoi dokumentacionin e depozituar duke patur objekt verifikimi:

Nëse nismëtarët janë shtetas shqiptar që kanë mbushur moshën 18 vjeç në ditën e depozitimit të kërkesës.

Nëse nismëtarët kenë vendbanimin në Komunën Përparim.

Nga verifikimi i certifikatave të depozituara, rezulton se 15 nismëtarët janë zgjedhës me vendbanim në Komunën Përparim.

Në mbledhjen e datës 14.11.2014, Partia Socialiste paraqiti kërkesën paraprake bazuar në nenin 23 të Kodit të Procedurës Administrative për pezullimin e shqyrtimit nga KQZ, të kërkesës së nismëtarëve, pasi çështja për kushtetueshmërin e ligjit nr.115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen Administrativo-Territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” është duke u shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese.

KQZ e vlerësoi kërkesën të pambështetur në Kodin Zgjedhor.

Në mbështetje të nenit 127 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003, i ndryshuar, KQZ duhet të pajisë kundrejt pagesës grupin nismëtar me fletën tip, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme, të cilat duhet të depozitohen nga zgjedhës në kohën e paraqitjes së kërkesës në KQZ-së. Po sipas nenit 127 të ligjit të sipërcituar, në krye të fletës tip duhet të shënohet çështja që shtrohet në referendum“. Në pjesën e pasme të Fletës-Tip, janë përcaktuar udhëzimet për mënyrën e plotësimit të saj, si dhe dokumentacioni i nevojshëm, i cili duhet të depozitohet së bashku me nënshkrimet.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa a, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 126, pika 2 dhe 5, nenin 127, pika 1,

nenin 132, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së 15 nismëtarëve për pajisjen me fletë-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për referendum vendor për çështjen e qeverisjes vendore të Komunës Përparim. “A jeni dakord që komuna Përparim të shkrihet”?
2. Miratimin e modelit të fletës-tip sipas Modelit F-01 bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MIRATIMI I KËRKESËS PËR PAJISJEN ME FLETËN TIP

- | | | | |
|-----|------------------------|-----|-----------------------|
| 1- | Komuna Përparim | 22- | Komuna Synej |
| 2- | Komuna Pajovë | 23- | Komuna Helmes |
| 3- | Komuna Gjocaj | 24- | Komuna Shishtavec |
| 4- | Komuna Shezë | 25- | Komuna Maqellare |
| 5- | Komuna Qender Leskovik | 26- | Komuna Surroj |
| 6- | Bashkia Leskovik | 27- | Komuna Kolonjë |
| 7- | Komuna Orosh | 28- | Komuna Shëngjergj |
| 8- | Komuna Fane | 29- | Komuna Dajt |
| 9- | Komuna Kthellë | 30- | Komuna Baldushk |
| 10- | Komuna Otlak | 31- | Komuna Zall-herr |
| 11- | Komuna Lumas | 32- | Komuna Farkë |
| 12- | Komuna Vertop | 33- | Komuna Krrabë |
| 13- | Komuna Ksamil | 34- | Komuna Bëzrzhitë |
| 14- | Komuna Bicaj | 35- | Komuna Pojan |
| 15- | Komuna Cakran | 36- | Komuna Tërbuf |
| 16- | Komuna Topojan | 37- | Komuna Mollas-Kolonjë |
| 17- | Komuna Gose | 38- | Komuna Melan |
| 18- | Komuna Kryevill | 39- | Komuna Kastriot |
| 19- | Komuna Golem | 40- | Komuna Gur I Zi |
| 20- | Komuna Luz I vogel | 41- | Komuna Vig-Mnelë |
| 21- | Komuna Lekaj | 42- | Komuna Dajç |

43-	Komuna Fratar	81-	Komuna Funarë
44-	Komuna Paskuqan	82-	Komuna Thumanë
45-	Komuna Zall-bastar	83-	Komuna Cudhi
46-	Komuna Petrelë	84-	Komuna Bytyc
47-	Komuna Rrethina	85-	Komuna Fshat-Tropojë
48-	Komuna Ana-Malit	86-	Komuna Fierzë
49-	Komuna Postrib	87-	Komuna Bujan
50-	Komuna Pult	88-	Komuna Pirg
51-	Komuna Kashar	89-	Komuna Lis
52-	Komuna Fier-Shegan	90-	Komuna Macukull
53-	Komuna Hys-Gjokaj	91-	Komuna Ndroq
54-	Komuna Bubullimë	92-	Komuna Rrasë
55-	Komuna Tomin	93-	Komuna Kajan
56-	Komuna Velipojë	94-	Komuna Grekan
57-	Komuna Ungrej	95-	Komuna Fierzë-Elbasan
58-	Komuna Shënkoll	96-	Komuna Pezë
59-	Komuna Fajza	97-	Komuna Luzni
60-	Komuna Golaj	98-	Komuna Prezë
61-	Komuna Gjinaj	99-	Komuna Zavalinë
62-	Komuna Ostren	100-	Komuna Hotolisht
63-	Komuna Trebisht	101-	Komuna Mollas-Elbasan
64-	Komuna Shllak	102-	Komuna Gjinar
65-	Komuna Strum	103-	Komuna Gracen
66-	Komuna Dardhas	104-	Komuna Labinot Mal
67-	Komuna Udenisht	105-	Komuna Derjan
68-	Komuna Çerrave	106-	Komuna Bradashesh
69-	Komuna Velçan	107-	Komuna Fushë-Krujë
70-	Komuna Buçimas	108-	Komuna Bubq
71-	Komuna Shupenzë	109-	Komuna Nikël
72-	Bashkia Mamurras	110-	Komuna Bërxull
73-	Komuna Milot	111-	Komuna Vreshtas
74-	Komuna Brataj	112-	Komuna Xhafzotaj
75-	Komuna Fushë-Cidhen	113-	Komuna Levan
76-	Komuna Ruzhdie	114-	Komuna Shtiçen
77-	Komuna Tërthore	115-	Komuna Gore
78-	Komuna Dishnic	116-	Komuna Vergo
79-	Komuna Petran	117-	Komuna Lazarat
80-	Komuna Sukë	118-	Komuna Qender Malësi e Madhe

119- Komuna Shkrel
120- Komuna Kelmend
121- Komuna Proptisht
122- Komuna Vaqarr
123- Komuna Kastrat
124- Komuna Lunxheri

125- Komuna Muhur
126- Komuna Arras
127- Komuna Xarrë
128- Komuna Markat
129- Bashkia Rubik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Vendim nr. 156

Data 14.11.2014

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË NJË GRUPI
NISMËTARËSH PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE, PËR
ZHVILLIMIN E REFERENDUMIT VENDOR NË KOMUNËN
GRABIAN

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 14.11.2014,
me pjesëmarrjen e:

Lefterije	LUZI -	Kryetare
Hysen	OSMANAJ -	Anëtar
Klement	ZGURI -	Anëtar
Vera	SHTJEFNI -	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi
nismëtarësh për fillimin e procedurave, për
zhvillimin e një referendumi në Komunën
Grabian

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa a, i ligjit nr 10019, datë

29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 126, pika 2 dhe 5, neni 127, pika 1, neni 132, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve;

VËREN

Në datë 31.10.2014, një grup prej 20 nismëtarësh ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën nr 1486 prot, datë 31.10.2014. Me anë të kësaj kërkesë, grupi nismëtar i drejtohet KQZ-së për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor, në nivel të njësisë bazë të qeverisjes vendore.

Kërkesën e tyre Grupi nismëtar e bën në mbështetje të nenit 2, pika 2, nenit 108, pika 2 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe dispozitave konkrete të Kodit Zgjedhor, për zhvillimin e referendumeve.

KQZ, në mbështetje të nenit 132, pika 4, nenit 126, pika 2 dhe nenit 127, pika 1 të ligjit nr.9087, datë 19.06.2003, i ndryshuar, duhet të verifikojë nëse nismëtarët e depozitimit të kërkesës, janë zgjedhës të Komunës Grabian, dhe të pajisë grupin nismëtar, kundrejt pagesës, me fletën-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme.

Bashkëlidhur kërkesës, nismëtarët për secilin prej tyre kanë depozituar vetem kopje të kartës së Identitetit

Për plotësimin e kushtit, nëse nismëtarët janë zgjedhës të Komunës Grabian në mbështetje të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 45 dhe 46, pika 1, të Kodit Zgjedhor, dhe praktikës së vendosur në raste të ngjashme, KQZ verifikoi dokumentacionin e depozituar duke patur objekt verifikimi:

Nëse nismëtarët janë shtetas shqiptar që kanë mbushur moshën 18 vjeç në ditën e depozitimit të kërkesës.

Nëse nismëtarët kenë vendbanimin në Komunën Grabian

Nga verifikimi dokumentacionit të depozituara, rezulton se për 20 nismëtarët nuk mund te verifikohet nëse janë zgjedhës të komunës Grabian apo jo.

Në mbështetje të nenit 132, pika 1 referendum vendor për çështje të njësisë bazë të qeverisjes vendore, mund ta kërkojnë zgjedhësit e komunës osë bashkisë përkatëse. Duke qene se nismëtarët nuk mund të provojnë faktin së janë zgjedhës të kësaj komune, kërkesa e tyre duhet të rrëzohet

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa a, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 126, pika 2 dhe 5, nenin 127, pika 1, nenin 132, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

V E N D O S I

1. Të rrëzojë kërkesën e 20 nismëtarëve për pajisjen me fletë-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për referendum vendor për çështjen e qeverisjes vendore të Komunës Grabian

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

RRËZIMI I KËRKESËS PËR PAJISJEN ME FLETËN TIP

1. Komuna Dushk
2. Komuna Katund I Ri
3. Komuna Mollaj
4. Komuna Grabian
5. Komuna Hajmel
6. Komuna Blerim



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE**

Vendim nr. 6

Data 23.03.2016

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË NJË GRUPI
NISMËTARËSH PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE, PËR
ZHVILLIMIN E REFERENDUMIT VENDOR NË BASHKINË
TIRANË PËR ÇËSHTJEN “A JENI DAKORD QË NË
TERRITORIN E PARKUT RINIA TË BASHKISË TIRANË , TË
NDËRTOHET NJË PARKIM NËNTOKËSOR”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.03.2016,
me pjesëmarrjen e:

Lefterije	LUZI -	Kryetare
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Gëzim	VELESHNJA -	Anëtar
Hysen	OSMANAJ -	Anëtar
Klement	ZGURI -	Anëtar
Vera	SHTJEFNI -	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi nismëtarësh për fillimin e procedurave, për zhvillimin e një referendumi në Bashkinë Tiranë për çështjen “A jeni dakord në territorin e Parkut Rinia të Bashkisë Tiranë, të ndërtohet një parkim nëntokësor”?

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma a, i ligjit nr 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 126, pika 2 dhe 5, neni 127, pika 1, neni 132, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve;

VËREN:

Në datë 04.03.2016, një grup prej 12 nismëtarësh ka paraqitur në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, kërkesën nr.263 prot, datë 04.03.2016. Me anë të kësaj kërkesë, grupi nismëtar i drejtohet Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve me kërkesën për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor, në nivel të njësisë bazë të qeverisjes vendore duke ju drejtuar zgjedhësve për çështjen “A jeni dakord me vendimin nr. 67 datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak për ndërtimin me koncesion të një parkimi nëntokësor tek Parku Rinia?”

Kërkesën e tyre Grupi nismëtar e bën në mbështetje të nenit 2, pika 2, nenit 108, pika 2 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe dispozitave konkrete të Kodit Zgjedhor, për zhvillimin e referendumeve.

Sipas pretendimeve të kërkuësve:

Këshilli Bashkiak miratoi me vendimin nr. 67, datë 30.12.2015 “Për miratimin e termave kryesorë të kontratës koncensionare mbi parkimin e nëntokësor në Parkun Rinia” me një procedurë të dyshimtë, duke injoruar shumë kërkesa ligjore përfshirë dëgjesat publike, procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sigurimin e ofertës nga kompania private.

Prishja e Parkut Rinia për të ndërtuar një parkim nëntokësor shkatërron pjesët e fundit të mushkërive të qytetit, do ndryshojë përfundimisht tipologjinë e parkut, pasi pjesa mbetë nuk mund të

ketë pemë por vetëm bar të ngjashëm me barin e taracave. Pse duhet ndërtuar parkim në një zonë parku? Pse të mos ndërtohet parkim nëntokësor në zona të tjera të cilat nuk janë parqe apo lulishtë?

Në kushtet kur Bashkia dhe Këshilli Bashkiak, në një proces të shkurtër, jo transparent, në lidhje me opsionin që u miratua, pa konsultim me publikun pa proces vlerësimi mjedisor si kërkohet nga ligji, kërkuesit mendojnë se është domosdoshmëri që komuniteti i Bashkisë Tiranë të shprehet për këtë çështje nëpërmjet referendumit vendor.

Përfaqesuesi në KQZ i Partisë Socialiste, parashtroi se:

Kërkesa e paraqitur për sa i përket objektit të saj dhe pyetjes që kërkohet të shtrohet për referendum është e paqartë për sa i përket llojit të rreferendumit, sipas përcaktimeve të Kushtetutes së Shqipërisë dhe dispozitave për referendumin të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 i ndryshuar

Gjithashtu Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tiranë me vendimin nr. 67, datë 30.12.2015, ka përcaktuar termat kryesorë të kontratës koncesionare për një parkim nëntokësor. Parashikimi ligjor se *Tarifa e koncesionit është pjesë e të ardhurave të buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë ose të BUXHETEVE Të ORGANEVE TE QEVERISJES VENDORE* do të thotë se në rastin konkret, kjo tarifë koncesionare e parashikuar, me vendimin e këshillit bashkiak është pjesë e buxhetit të Bashkisë Tiranë.

Në keto kushte referuar nenit 108, pika 2 dhe nenit 151, pika 2 të Kushtetutës, çështjet që lidhen mebuxhetin, taksat dhe detyrimet financiare të shtetit nuk mund të shtrohen në asnjë referendum.

Përfaqësuesi i në KQZ i Partisë Demokratike parashtroi se:

KQZ në këtë fazë duhet vetëm të pajis Grupin Nismëtar me fletën tip dhe nuk ka kompetencën për të shqyrtuar objektin e kërkesës.

Gjithashtu, çështja që shtrohet për referendum nuk lidhet më taksat, buxhetin apo detyrimet financiare të shtetit. Cdo çështje që mund

të shtrohet për referendum apo cdo ligj që kërkohet të shfuqizohet me referendum ka dhe një kosto financiare. Çështja e paraqitur nga Grupi nismëtar, për tu shtruar në referendum ka lidhje vetëm me ndërtimin ose jo në Parkun Rinia të parkimit nëntokësor. Këshili i Bashkisë së Tiranës mund të vendos për ndërtimin me koncesion të një parkimi nëntokësor në një ambient tjetër të qytetit të Tiranës.

Në lidhje me këtë kërkesë, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 132, pika 4, nenit 126, pika 2 dhe nenit 127, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 i ndryshuar, paraprakisht duhet të verifikojë nëse nismëtarët e depozitimit të kërkesës, janë zgjedhës të Bashkisë Tiranë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 277, prot., datë 08.03.2016 i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile verifikimin nëse nismëtarët janë zgjedhës të Bashkisë Tiranë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr277/1, datë 18.03.2016, konfirmoi se të 12 nismëtarët janë zgjedhës në Bashkinë Tiranë.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, më datë 21.03.2016 mori në shqyrtim kërkesën nr.263 prot, datë 04.03.2016, me objektin cituar si më sipër, në përputhje me parashikimet e nenit 132, pika 4 dhe 126 të Kodit Zgjedhor

Referuar parashikimeve të nenit 126, pika 5 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE”, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve fillimisht çmon se, në mënyrën se si është formuluar pyetja që kërkuesit kanë kërkuar të shtrohet për referendum, është e paqartë. Në këtë mënyrë është i paqartë edhe lloji i referendumit që kërkohet të bëhet. Pra, është e paqartë nëse kemi të bëjmë me një kërkesë për një çështje të rëndësisë së veçantë apo kërkohet një referendum shfuqizues (abrogues) të një akti administrativ, sikurse është vendimi nr. 67, datë 30.12.2015 “Për miratimin e termave kryesorë të kontratës koncensionare mbi parkimin e nëntokësor në Parkun Rinia”, i Këshillit Bashkiak Tiranë.

Pyetja, “A jeni dakord me vendimin nr. 67 datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak për ndërtimin me koncesion të një parkimi nëntokësor tek Parku Rinia?” është e paqartë në kuptim të ligjit sepse:

Në rast se do të ishte referendum shfuqizues i një akti, kërkesa formalisht nuk përmbush kriteret e parashikuara në nenin 126, pika 4, të ligjit 9087/2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, ku parashikohet shprehimisht se: “Kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për shfuqizimin e një ligji ose të një pjese të tij përmban:

- titullin, numrin dhe datën e miratimit të aktit që kërkohet të shfuqizohet.

Pra, me fjalë të tjera duhet që kërkesa të citojë shprehimisht “SHFUQIZIMIN” e aktit që atakohet, që në rastin konkret nuk është formuluar si e tillë. Dhe kjo gjë vihet re lehtësisht si në objektin e kërkesës ashtu edhe në pyetjen e formuluar nga ana e kërkueseve.

Objekti i kërkesës citon shprehimisht: “kërkesë për zhvillimin e një referendumi vendor lidhur me vendimin për parkim nëntokësor në Parkun Rinia në njësinë e qeverisjes vendore Bashkia Tiranë.”

Pyetja e propozuar për t’u parashtruar për referendum citon shprehimisht:

“A jeni dakort me vendimin nr.67, datë 30.12.2016 të Këshillit Bashkiak për ndërtimin me koncesion të një parkimi nëntokësor tek Parku Rinia?”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se, në respekt të kërkesave ligjore, pyetja referendare duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që të shprehë realisht vullnetin e kërkuesit dhe të përcillet në të njëjtën mënyrë edhe tek zgjedhësit e thirrur për të votuar. Nëpërmjet *referendumit shfuqizues* pyetja duhet të jetë: A DONI QE VENDIMI Nr.67, datë 30.12.2015, të shfuqizohet?

Kjo është shumë e rëndësishme. Ndërtimi dhe parashtrimi i pyetjes referendare duhet të plotësojë kriterin e qartësisë që do të thotë që, pyetja referendare duhet të jetë një pyetje e tillë që të kuptohet lehtësisht nga ana e votuesit dhe të mos krijojë paqartësi, kritere të cilat nuk plotësohen në mënyrën se si është ndërtuar pyetja nga ana e kërkuesve.

Sa më sipër, mbahet në konsideratë fakti se natyra e referendumit shfuqizues në sistemin tonë kushtetues është akt-burim i së drejtës. Ashtu si legjislatori përfaqësues (KUVENDI) frymëzon dhe koordinon vullnetin e tij tek një objekt të përcaktuar edhe nëpërmjet shfuqizimit të një ligji, ashtu edhe vullneti popullor mund dhe duhet

të frymëzohet nga një “ratio” gjithashtu e përcaktuar. Kur Kuvendi shfuqizon një ligj sigurisht që i referohet formalisht attributeve të këtij ligji, pra do të thotë që i referohet konkretisht numrit, datës së miratimit të tij dhe titullit të tij. E njëjta gjë duhet të karakterizojë edhe këtë proces.

Kur flasim për referendum shfuqizues bëhet fjalë për një akt-burim i së drejtës, ku pyetja që shtrohet për zgjedhësit është nëse ata dëshirojnë apo jo të shfuqizojnë një normë të një akti apo të gjithë aktin. Dhe në këtë mënyrë, nëpërmjet ftesës për referendum, populli merr pjesë “aktive” në procesin “hartimit të së drejtës” edhe nëpërmjet shfuqizimit (hartimit të aktit në mënyrë negative) të një akti që natyrisht do të pasohet nga një normë tjetër që do të shkruhet për të plotësuar vullnetin e zgjedhësve (vullneti pozitiv).

Aq më tepër bëhet e domosdoshme në referendumin shfuqizues nevoja për qartësi, thjeshtësi të pyetjes, edhe për faktin tjetër se në referendum, shprehja e vullnetit të zgjedhësve nuk është konceptuar si një përgjigje e artikuluar, por kërkohet thjesht një zgjedhje PO ose JO.

Pra, thënë ndryshe, kërkuesit, në mënyrën se si e kanë formuluar pyetjen e referendunit, nuk kanë qenë të aftë të shprehin në mënyrë evidente qëllimin e shfuqizimit referendar.

Më tej, konstatimi i mangësive në pyetjen referendare, që përbën shkak për mospranimin e saj qëndron edhe në atë ç’ka mungon në të, pra në atë që kërkuesit e saj kanë lënë jashtë kërkesës, pra, kemi të bëjmë me atë që quhet “omisionin” e kërkesës referendare.

Edhe sikur pyetja referendare të ishte formuluar në mënyrën e duhur dhe pa mangësi, përsëri jemi në shkelje të parashikimeve të nenit 150 i Kushtetutës ku parashikohet shprehimisht se:

“1. Populli, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, ka të drejtën e referendunit për shfuqizimin e një ligji, si dhe t’i kërkojë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendunit për çështje të një rëndësie të veçantë”.

Pra, Kushtetuta dhe në tërësi baza ligjore për organizimin e referendumeve të përgjithshme dhe lokale në vendin tonë nuk e

parashikon refendumin shfuqizues lokal, pra nuk parashikohet referendumi shfuqizues për një akt të organeve të qeverisjes vendore!

Pasi dëgjoi vlerësimet paraprake si më sipër, referuar parashikimeve të nenit 126, pika 5 të të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 263, datë 21.03.2016 grupi nismëtar i kërkoi Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve saktësimin e kërkesës nr.263, datë 04.03,2016, lidhur më formulimin e çështjes së rëndësisë së veçantë që kërkohet të shtrohet për referendum, duke e saktësuar pyetjen si më poshtë:

“A jeni dakord në territorin e Parkut Rinia të Bashkisë Tiranë, të ndërtohet një parkim nëntokësor”.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, më datë 23.03.2016 mori në shqyrtim kërkesën e grupit nismëtar për saktësimin e çështjes që do të shtrohet për referendum dhe referuar nenit 68, “Te metat e kërkesës fillestare” të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 154/a të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar) me vendim të ndërmjetëm,

vendosi të pranojë kërkesën për saktësim të çështjes që do të shtrohet për referendum.

Në lidhje me kufijtë e shqyrtimit nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, të kërkesës për zhvillimin e një referendumi, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve referuar nenit 126, pika 5 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese¹ dhe të praktikës së Kolegjit Zgjedhor² të Gjykatës së Apelit Tiranë, vlerëson se:

“Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka të drejtën dhe detyrimin për të

1 Vendimi 31/2003 i Gjykatës Kushtetuese
vendimi nr. 25, datë 24.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese;
Vendimi nr. 26, date 25.9.2010 i Gjykatës Kushtetuese
Vendimi nr.5, datë 21.01.2011 i Gjykatës Kushtetuese
vendimi nr. 8, datë 8.03.2013 i Gjykatës Kushtetuese.

2 Vendimi nr.1, datë 14.01.2015 i Kolegjit Zgjedhor

shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve në drejtime si: lloji i referendunit për të cilin kërkohet fillimi i procedurave (i përgjithshëm apo vendor); ekzistencën dhe qartësinë e çështjes që shtrohet për referendum, rëndësia e saj, kufizimet në ushtrimin e të drejtës për referendum, përveç se edhe aspekte të tjera ligjore që do të gjejnë pasqyrim në fletën-tip për mbledhjen e nënshkrimeve, që përpilohet nga vetë Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. Për sa kohë që ligjvënësi ka paracaktuar në pikën 5 të nenit 126 rregulla strikte ligjore përpara mbledhjes së nënshkrimeve të nevojshme për të kërkuar fillimin e procedurave për zhvillimin e referendunit, rregulla të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur, në radhë të parë, nga nismëtarët, atëherë organi më i parë që kontrollon ligjshmërinë e kërkesës, është Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, që në ushtrim të kompetencave ligjore, nuk lejon fillimin e procedurave që bien në kundërshtim me ligjin.

Në këto kushte Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve përpara miratimit të modelit të fletës tip, dhe pajisjes së grupit nismëtar me to duhet të kontrollojë përputhshmërinë e kërkesës me legjislacionin e interesuar.

Kompetenca e Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve për shqyrtimin e elementëve ligjorë që duhet të përmbushë kërkesa për kryerjen e një referendumi është analizuar në jo pak vendime të Gjykatës Kushtetuese³.

Kështu, në vendimin nr. 5, datë 21.01.2011, Gjykata Kushtetuese ka rrëzuar kërkesën e grupit nismëtar për zhvillimin e referendunit të përgjithshëm, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 26, datë 28.09.2010 të KQZ-së, me të cilin është refuzuar pajisja me fletën-tip për zhvillimin e referendunit për një çështje të veçantë, ku shtrohej pyetja se “A duhet të rinumërohen fletët e votimit të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009?”. Arsyetimi i përdorur nga KQZ-ja, në këtë vendim, ishte se çështja e shtruar për referendum nuk ishte e qartë. Gjykata Kushtetuese e ka gjetur kërkesën e paraqitur nga grupi nismëtar si haptazi të pabazuar, duke arsyetuar ndër të tjera se: “Sipas dispozitave të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur nga

3 Per me gjere referohu ne vendimin nr. 1, date 14.01.2015 te kolegjit Zgjedhor, faqe 33 e ne vijim

jo më pak se 12 nismëtarë për zhvillimin e referendumit për një çështje të rëndësishë së veçantë. Përderisa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, siç rezulton nga vendimi nr.26, datë 28.09.2010, ka vlerësuar anën formale të rregullsisë së dokumentacionit, që lidhet me *përcaktimin e qartë të llojit të referendumit e të llojit të objektit të kërkesës*, Kolegji çmon se një shqyrtim i tillë nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, por të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ndaj qëndrimeve që mban Komisioni Qendror i Zgjedhjeve lidhur me parregullsinë e dokumentacionit të paraqitur, është detyrim i kërkuarit për të shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore që kërkon Kodi Zgjedhor për të riparaqitur kërkesën pas korrigjimit të parregullsive të vërejtura.” Gjykata Kushtetuese ka konkluduar me këtë vendim se “Përderisa, këto çështje përfshihen në juridiksionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nuk janë pjesë e ndonjë juridiksioni kushtetues”, atëherë edhe kërkesa vlerësohet “si haptazi e pabazuar” dhe “nuk plotëson kushtet për të kaluar në seancë.” (Shih më gjerë vendimi nr. 26, datë 28.09.2010 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese). Jurisprudenca kushtetuese e ka evidentuar në këtë rast KQZ-në si organi kompetent, që shqyrton aspektin ligjor të kërkesës së nismëtarëve lidhur me detyrimin e tyre për të paraqitur qartësisht çështjen për të cilën kërkojnë të fillojnë procedurat për zhvillimin e referendumit.

Kompetenca e Komisionit Qendror i Zgjedhjeve për të vlerësuar llojin e referendumit, për të cilin grupi nismëtar ka paraqitur kërkesë, është pranuar edhe në vendimin nr.25, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin është rrëzuar kërkesa e grupit nismëtar për shfuqizimin e vendimit nr.47, datë 05.06.2008 të KQZ-së. Me këtë vendim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka rrëzuar kërkesën e një grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e neneve 5, 7 dhe 8 të ligjit nr. 9904, datë 21.04.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve argumenton vendimin e tij me faktin se kërkesa e grupit nismëtar ka të bëjë me një referendum kushtetues, sipas nenit 122 të Kodit Zgjedhor dhe jo me referendum të përgjithshëm, parashikuar nga neni 126 i këtij Kodi e për rrjedhojë kërkesa është konsideruar se nuk përbën objekt shqyrtimi nga ky organ. Me vendimin nr. 25/2009, Gjykata Kushtetuese nuk e ka legjitimuar kërkuarin, duke arsyetuar se thirrja e referendumit për amendamentet kushtetuese mund

të bëhet vetëm brenda kufijve të parashikuar nga neni 177 i Kushtetutës dhe se e drejta e 50 mijë shtetasve me të drejtë vote për të kërkuar shfuqizimin e një ligji, sipas nenit 150, nuk shtrihet në ligjet për rishikimin e Kushtetutës. Me këtë qëndrim të mbajtur nga jurisprudenca kushtetuese, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerësohet si organi që ka kompetencën ligjore për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve edhe sa i përket llojit të referendumit që ata kërkojnë të zhvillojnë, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor.

Gjithashtu, nisur nga pretendimi që ka paraqitur Kuvendi i Shqipërisë për moslegjitimitimin e Komisionit Qendror i Zgjedhjeve për të dërguar për kontroll të kushtetutshmërisë së referendumit, me arsyetimin se vendimi është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, për shkak të mos verifikimit të nënshkrimeve (nga verifikimi kanë rezultuar nënshkrime të falsifikuara), Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 8, datë 08.03.2013 është shprehur se : "... vendimi i KQZ-së, për pranimin e kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm shfuqizues, nuk i nënshtrohet vlerësimit nga Gjykata, por përbën mjetin për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues për të shqyrtuar, paraprakisht, kushtetutshmërinë e kërkesës për referendum të përgjithshëm shfuqizues, të paraqitur nga grupi nismëtar në emër të mbi 50 mijë zgjedhësve".

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese i konsideron jashtë juridiksionit të saj çështjet që lidhen me aspektin ligjor e faktik të procesit të vendimmarrjes së KQZ-së, duke i konsideruar ato në kompetencë të këtij organi.

Nisur nga nevoja për të evidentuar kuadrin historik në të cilin ligjvënësi ka hartuar dhe miratuar dispozitat e Kodit Zgjedhor mbi referendumet, por edhe nga elaborimi që jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka bërë, në këtë drejtim, Kolegji Zgjedhor vlerëson se, në interpretim të dispozitave mbi veprimtarinë administrative që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kryen, në kuadër të depozitimit, verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për referendum, *ligjvënësi ka ngarkuar këtë organ për të kryer verifikimin e ligjshmërisë së kërkesave, në kuptim të përmbushjes së kushteve ligjore që duhet të plotësojnë nismëtarët për zhvillimin e referendumit në përgjithësi, dhe atë vendor, si në rastin konkret.*

Duke iu referuar, për rastin në shqyrtim, dispozitave të Kodit Zgjedhor për referendumet, Kolegji Zgjedhor vlerëson se ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht dhe në mënyrë të detajuar etapat në

të cilën kalon procedura për ushtrimin e së drejtës për referendum. Si një kusht parësor për fillimin e procedurës për zhvillimin e referendumit, është paraqitja fillimisht e kërkesës në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve nga 12 zgjedhës (nismëtarët), me anë të së cilës kërkojnë marrjen prej saj të fletës-tip, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme, që mbështesin referendumin. Fleta-tip përmban, në varësi të kërkesës së nismëtarëve, ligjin që kërkohet të shfuqizohet me referendum, ose çështjen që shtrohet për referendum. Në këtë moment procedural shtrohet pyetja, nëse është e mjaftueshme për KQZ-në të evidentojë vetëm 12 zgjedhës që kanë paraqitur kërkesën për shfuqizimin e një ligji ose që shtrojnë një çështje për referendum, me qëllim vijimin e mbledhjes së nënshkrimeve nga zgjedhësit që mbështesin referendumin (formalizimin juridik të kërkesës për referendum nga subjekti, që ligji i njej të drejtën e referendumit, sipas nenit 126/1 apo nenit 132/1 të Kodit Zgjedhor/Referendumet), apo edhe shqyrtimi në thelb i kërkesës së paraqitur duke verifikuar përputhjen me kërkesat e nenit 126 dhe të dispozitave të tjera të Kodit Zgjedhor/Referendumet.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se, siç rezulton edhe në nenin 126 të Kodit Zgjedhor/Referendumet, *procedura për zhvillimin e referendumit duhet të fillojë me plotësimin e disa kushteve nga nismëtarët*, të cilët janë të detyruar të paraqesin qartësisht në kërkesën e tyre, jo vetëm ligjin/dispozitën që kërkohet të shfuqizohet, por edhe arsyen se përse duhet shfuqizuar. Ndërkohë që në rastin e referendumit për një çështje të rëndësisë së veçantë, nismëtarët duhet të përshkruajnë qartë çështjen, rëndësinë e saj, qëndrimin e tyre si dhe të shtrojnë pyetjen pa ekuivoqe, e mundshme për t'iu përgjigjur me "Po" ose "Jo". Nëse KQZ-ja nuk ka në kompetencën e saj verifikimin e këtyre elementëve ligjorë, të domosdoshëm për iniciimin e procedurës së mbledhjes së nënshkrimeve nga zgjedhësit, ky proces, potencialisht, rrezikon të jetë i paligjshëm dhe të përfshijë zgjedhësit e tjerë, në çështje të cilat mund të vijnë ndesh, së paku, me moralin shoqëror dhe, më së shumti, me rendin demokratik.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se KQZ-ja ka përgjegjësinë (të drejtën dhe detyrimin) për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve në drejtime si:

- lloji i referendumit për të cilin kërkohet fillimi i procedurave (i përgjithshëm apo vendor);
- ekzistencën dhe qartësinë e çështjes që shtrohet për referendum,
- rëndësia e saj,

- përveç se edhe aspekte të tjera ligjore që do të gjejnë pasqyrim në fletën-tip për mbledhjen e nënshkrimeve, që përpilohet nga vetë KQZ-ja.

Për sa kohë që ligjvënësi ka paracaktuar në pikën 5 të nenit 126 rregulla strikte ligjore përpara mbledhjes së nënshkrimeve të nevojshme për të kërkuar fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit, rregulla të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur, në radhë të parë, nga nismëtarët, atëherë i vetmi organ që kontrollon ligjshmërinë e kërkesës, është dhe duhet të jetë veçse KQZ-ja, që në ushtrim të kompetencave ligjore, nuk lejon fillimin e procedurave që bien në kundërshtim me ligjin.

Partia Demokratike e Shqipërisë ka pretenduar, ndërmjet të tjerave se, është Gjykata Kushtetuese, organi i cili pas mbledhjes së nënshkrimeve të nevojshme për kërkesën për referendum, shqyrton kushtetutshmërinë e çështjes që shtrohet në referendum dhe se KQZ-ja nuk mund të marrë kompetencat që i përkasin kësaj gjykate, duke u kufizuar vetëm në verifikimin e nënshkrimeve.

Në referim të Kushtetutës, Kolegji Zgjedhor thekson se sipas nenit 124, pika 2, Gjykata Kushtetuese, për vet pozicionin që ka si një autoritet i lartë, i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe në ushtrim të kompetencave të saj, ajo vendos për kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij (neni 131, shkronja "ë" e Kushtetutës), si dhe shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum, sipas nenit 150 paragrafët 1 e 2, nenit 151 paragrafët 2 e 3, nenit 177 paragrafët 4 e 5 (neni 152). Janë këtë kompetenca të cilat gjenden të parashikuara në shumë dispozita të Kushtetutës, në lidhje me referendumet dhe që kanë qenë objekt interpretimi nga jurisprudenca kushtetuese, mbi të cilat orientohet vetë Gjykata Kushtetuese për të përcaktuar juridiksionin e saj.

Ajo që Kolegji Zgjedhor vlerëson, në rastin konkret, lidhet me detyrimin e KQZ-së për të shqyrtuar të gjithë aspektet ligjore të kërkesës së nismëtarëve, duke mos u kufizuar vetëm në verifikimin e cilësisë së tyre si zgjedhës, në pranimin e kërkesës për pajisjen me fletën tip. Një kërkesë e vlefshme ligjërisht, që paraqitet nga nismëtarët dhe që konsiderohet si e tillë nga KQZ-ja, është një kusht për vijimin e procedurës së mëtejshme për zhvillimin e referendumit. Për rrjedhojë, vendimi i KQZ-së që kontrollon ligjshmërinë e kërkesës,

për nga natyra e çështjeve që shqyrton, në këtë moment procedural, është një vendim përfundimtar dhe i kontrollueshëm gjyqësisht. Vetëm pas certifikimit ligjor të këtij vendimi përfundimtar, KQZ-ja, në kuptim të nenit 128 të Kodit Zgjedhor, “verifikon nënshkrimet dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të zgjedhësve, në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra prej saj” si dhe “vendos për pranimin ose mospranimin e kërkesës brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së saj, duke e bazuar vendimin vetëm mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur.”.

Të drejtën e shtetasve me të drejtë vote, për të kërkuar referendum e sanksionon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 9087, datë 19.06.2003, kështu për pshqyrimin e kësaj kërkesë për referendum Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve i referohet kuadrit kushtetues dhe ligjor në fuqi:

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 2 (pikat 1 dhe 2)

1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit.
2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti.”

Neni 13

“Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore.”

Neni 108

1. Njësitë e qeverisjes vendore janë komunitat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj.
2. Ndarjet administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike. Kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa u marrë me parë mendimi i popullsisë që banon në to.
3. Komuna dhe bashkia janë njësi bazë të qeverisjes vendore. Ato kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisese, me përjashtim të atyre që me ligj u jepen njërive të tjera të qeverisjes vendore.
4. Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve

të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore. Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendunit vendor parashikohen me ligj në përputhje edhe me nenin 151 paragrafi 2.”

Neni 124

“1. Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj.

2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.”

Neni 131 “Gjykata Kushtetuese vendos për: ... ë) kushtetutshmerinë e referendunit dhe verifikimin e rezultateve të tij;”

Neni 151

“2. Çështjet që lidhen me tërësinë territoriale të Republikës së Shqipërisë, me kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, me buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit, me vendosjen dhe heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme, me deklarimin e luftës dhe të paqes dhe me amnistinë nuk mund të shtrohen në asnjë referendum.”

Neni 152

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum sipas nenit 150 paragrafët 1 e 2, nenit 151 paragrafët 2 e 3 edhe sipas nenit 177 paragrafët 4 e 5 brenda 60 ditëve.

2. Rëndësia e çështjeve të veçanta, të parashikuara në nenin 150 paragrafët 1 e 2 nuk është objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese.”

KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË I miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 74/2012

Neni 1 : Qëllimi dhe objekti

“1. Ky Kod ka për qëllim caktimin e rregullave për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet. ...”

Neni 2 : Përkufizime

“Në këtë Kod termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: ... 18. “Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve” është rezultati i shpallur nga KQZ-ja, në përputhje më këtë Kod dhe që përfshin: ... ç) rezultatin

e votimit për çdo alternativë në referendum, sipas dispozitave të këtij Kodi. ... 23. “Zgjedhje” janë votimet për Kuvendin, për njësitë e qeverisjes vendore dhe referendumet.

Neni 145 : E drejta e ankimit në gjykatë

“1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. ...”

Neni 152 : Afati i ankimit në gjykatë

1. Ankimet, sipas këtij Kodi, paraqiten në Gjykatën e Apelit, Tiranë, e cila ia kalon ato Kolegjit Zgjedhor.

2. Ankimi për të gjitha vendimet që KQZ-ja merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tyre. Për vendimet që KQZ-ja merr jashtë kësaj periudhe, afati i ankimit në Kolegjin Zgjedhor është 30 ditë.”

Neni 185 : Shfuqizime

“1. Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, ligji nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe çdo akt tjetër ligjor ose nënligjor, që bie në kundërshtim me të, shfuqizohet.

2. Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në pikën 1 të këtij neni, pjesa e nëntë “Referendumet” e ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe çdo pjesë e dispozitave të tij që ka lidhje me të mbetet në fuqi deri në miratimin e ligjit të ri për referendumet e përgjithshme dhe vendore. Administrimi i procesit të referendumeve dhe nxjerrja e rezultatit të tyre bëhen në përputhje me këtë Kod.”

KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË I miratuar me ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003

Neni 1 : Qëllimi i këtij Kodi

“Ky Kod ka për qëllim përcaktimin e rregullave: ... e) për zhvillimin dhe vlefshmërinë e referendumeve; ...”

Neni 2 : Përkufizime

“... 19. “Referendum kushtetues” është referendum, që zhvillohet sipas pikës 4 ose 5 të nenit 177 të Kushtetutës.

20. “Referendum i përgjithshëm” është referendum, që zhvillohet sipas nenit 150, 151 dhe 152 të Kushtetutës.

21. “Referendum vendor” është referendum, që zhvillohet sipas pikës 4 të nenit 108 të Kushtetutës.

...

34. “Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve” është rezultati i shpallur nga KQZ-ja dhe që përfshin:

...

c) rezultatin e votimit në referendum, sipas dispozitave të pjesës së nëntë të këtij Kodi.”

PJESA E NENTE REFERENDUMET

Neni 118 : Kuptimi i referendumit

1. Referendumi është ushtrimi i drejtpërdrejtë i sovranitetit të popullit, nëpërmjet votimit, për një çështje ose një ligj të caktuar, sipas neneve 108 pika 4, 150, 151, 152 dhe 177 të Kushtetutës.”

Neni 126 : Nisma për referendum të përgjithshëm

“1. Pesëdhjetë mijë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve kanë të drejtën e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e një ligji, si dhe t’i kërkojnë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë, në përputhje me pikën 1 të nenit 150 të Kushtetutës, si dhe me dispozitat e këtij Kodi.

2. Kërkesa për fillimin e procedurave të referendumit paraqitet në KQZ nga një grup prej jo më pak se 12 nismëtarësh, të cilët janë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve.

3. Kërkesa për shfuqizimin e një pjese të ligjit pranohet vetëm kur pjesa tjetër e ligjit është e vetëmjaftueshme.

4. Kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për shfuqizimin e një ligji ose të një pjese të tij, përmban:

a) titullin, numrin dhe datën e miratimit të ligjit që kërkohet të shfuqizohet, si dhe në qoftë se kërkohet të shfuqizohet vetëm një pjesë e ligjit, dispozitat përkatëse;

b) arsyet përse ligji ose dispozita të veçanta të tij duhen shfuqizuar.

5. Kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për një çështje të një rëndësie të veçantë duhet të përshkruajë qartë çështjen që shtrohet, rëndësinë e saj si dhe qëndrimin e nismëtarëve në lidhje me atë çështje. Çështja duhet të formulohet në mënyrë të qartë, të plotë dhe pa ekuivoqe dhe në mënyrë të tillë që zgjedhësit të mund të përgjigjen me “PO” ose “JO”.

Neni 127 : Fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve

“1. KQZ-ja, brenda 20 ditëve nga paraqitja e kërkesës për referendum të përgjithshëm, pajis grupin nismëtar kundrejt pagesës me fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të 50 mijë zgjedhësve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve në kohën e paraqitjes së kërkesës. Në krye të fletës-tip shtypet titulli i ligjit, dispozitat që kërkohen të shfuqizohen ose çështja që shtrohet në referendum.

2. Nënshkrimet në mbështetje të kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm depozitohen në KQZ në periudhën nga 1 janari deri më 30 nëntor të çdo viti.”

Neni 128 : Verifikimi i kërkeses nga KQZ-ja

“1. KQZ-ja verifikon nënshkrimet dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të zgjedhësve, në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra prej saj.

2. KQZ-ja vendos për pranimin ose mospranimin e kërkesës brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së saj, duke e bazuar vendimin vetëm mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur. Vendimi u njoftohet menjëherë nismëtarëve. Vendimi për mospranimin e kërkesës duhet të përcaktojë qartë shkaqet e mospranimit.

3. Brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit, grupi nismëtar mund t'i deklarojë KQZ-së se është i gatshëm të korrigjojë parregullsitë e vërejtura. Në këtë rast, KQZ-ja cakton një afat deri në 30 ditë për riparaqitjen e kërkesës. KQZ-ja vendos brenda 10 ditëve për pranimin ose jo të kërkesës së riparaqitur dhe i njofton menjëherë nismëtarët.”

Neni 132 : Nisma për referendum vendor

“1. Dhjetë për qind e zgjedhësve të regjistruar në listat e zgjedhësve të komunës ose bashkisë ose 20 mijë prej tyre, cilado shifër të jetë më e vogël, kanë të drejtën e referendumit vendor për një çështje të qeverisjes vendore në bashkinë ose komunën përkatëse.

2. Një numër këshillash bashkiake ose komunale, që përfaqësojnë

jo më pak se një të tretën e popullsisë së një qarku, kanë të drejtë të kërkojnë zhvillimin e një referendumi për një çështje të qeverisjes vendore në nivel qarku.

3. Referendumi për të njëjtën çështje nuk mund të përsëritet në të njëjtën njësi të qeverisjes vendore pa kaluar tre vjet nga zhvillimi i tij.

4. Për zhvillimin e referendumit vendor zbatohen, për aq sa është e mundur ose e nevojshme, dispozitat e parashikuara për referendumin e përgjithshëm në pikat 2 dhe 5 të nenit 126, nenin 127 dhe në pikën 2 të nenit 128 të këtij Kodi.”

Kërkesa e grupit nismëtar për të thirrur zgjedhësit e Bashkisë Tiranë në një referendum vendor, shtrohet për çështjen “A jeni dakord në territorin e Parkut Rinia të Bashkisë Tiranë, të ndërtohet një parkim nëntokësor”? Gjithashtu, vet grupi nismëtar parashtroi se kjo kërkesë ka lindur pasi Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tiranë, miratoi me vendimin nr. 67, datë 30.12.2015 “Miratimin e termave kryesorë të kontratës koncesionare mbi parkimin e nëntokësor në Parkun Rinia” .

Nga analiza e vendimit të sipërpërmendur të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë si dhe shpjegimeve të përfaqësueses së Këshillit Bashkiak të thirrur nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve për këtë qëllim, rezultoi se Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tiranë me vendimin e sipërcituar ka përcaktuar termat kryesorë të kontratës koncesionare për një parkim nëntokësor.

Ndërkohë, bashkëlidhur kërkesës për zhvillimin e një referendumi vendor lidhur me vendimin për parkimin nëntokësor në Parkun “Rinia”, i është bashkëlidhur vendimi nr. 67, date 30.12.2015 i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë, “PER MIRATIMIN E TERMAVE KRYESORE TE KONTRATES KONCESIONARE MBI PARKIMIN NENTOKESOR NE PARKUN “RINIA”, vendim i cili në pjesën hyrëse ka të listuar edhe bazën ligjore të tij. Normalisht është referenca në ligjin organik të pushtetit vendor, Ligjit 8652/31.07.2000 “PER ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISJES VENDORE”, Ligjit Nr.125/2013 “PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”, ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 “PER MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN”, si dhe një sërë aktesh nenligjore.

Më tej, vendimi bashkëlidhur ka edhe nje aneks 1, njëlloj i vlefshëm sikurse edhe vendimi të titulluar “TARIFAT REFERENCË TË PARKIMEVE NËNTOKËSORE SI DHE PAJTIMET PERIODIKE PËR SUBJEKTIN “TALËAN” PARKU RINIA.

Ky aneks ka miratuar 8 kritere dhe ndërmjet tyre tërheq vëmendje edhe KRITERI I DYTE, është

“TARIFA KONCESIONARE” me një ofertë prej 15% të fitimit.

Në këtë pikë të vendimmarrjes KQZ vlerëson të sqarojë se konceptin e tarifës së koncesionit. Përgjigjen në lidhje me këtë e gjejmë në ligjin Nr.125/2013 “PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”, i ndryshuar.

Neni 29 “Tarifa e koncesionit” i ligjit Nr.125/2013 “PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT” (i ndryshuar), parashikon shprehimisht se:

1. ...
2. Tarifa koncesionare paguhet në përputhje me rregullat e caktuara nga ministri i Financave *për arkëtimin e të ardhurave për llogari të buxhetit të shtetit.*
3. ...
4. ...
5. *Tarifat e koncesionit janë pjesë e të ardhurave të buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose të buxheteve të organeve të qeverisjes vendore.*

Parashikimi ligjor se *tarifa e koncesionit është pjesë e të ardhurave të buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë ose të BUXHETEVE Të ORGANEVE TE QEVERISJES VENDORE* do të thotë se në rastin konkret, kjo tarifë koncesionare e parashikuar, me numër rendor 2, 15% e fitimit, është pjesë e buxhetit të Bashkisë Tiranë.

Në keto kushte i referohemi edhe njeherë legjisllacionit që rregullon në lidhje me referendumet dhe, konkretisht, nenit 108, pika 4 të Kushtetutës ku parashikohet shprehimisht se:

“4. Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore. *Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendunit vendor parashikohen me ligj në përputhje edhe me nenin 151 paragrafi 2.*

Neni 152, paragrafi 2 i Kushtetutes parashikon se:

“2. Çështjet që lidhen me ..., me buxhetin, ... nuk mund të shtrohen në asnjë referendum.

Pra me fjalë të tjera, listimi i çështjeve të cilat nuk i nënshtrohen asnjë referendumit të parashikuara në nenin 152, paragrafi i dytë i Kushtetutës, për referendumet e përgjithshme, vlejné si të tilla (pra si kufizime) edhe për referendumet e organeve të qeverisjes vendore, përse kohë që Kushtetuta nuk ka bërë asnjë dallim në lidhje me këtë.

Sa më sipër, duke qenë se tarifa konçesionare, sipas parashikimeve të nenit 29, pika 5 të ligjit Nr.125/2013 “PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT” (I ndryshuar) është pjesë e buxhetit të Bashkisë Tiranë, pranimi i kërkesës për referendum do të binte ndesh haptazi me parashikimet e nenit 152, paragrafi i dytë i Kushtetutës që parashikon si çështje që nuk mund të nënshtrohet në asnjë referendum, çështje që lidhen me buxhetin e pushtetit vendor, si organe legjitime të shtetit shqiptar.

Sa më sipër, pavarësisht faktit se kërkuesi e ndryshoi pyetjen referendare në formën:

“A jeni dakord në territorin e Parkut Rinia të Bashkisë Tiranë, të ndërtohet një parkim nëntokësor”, pra duke mos e cituar drejtëpërsëdrejti vendimin nr. 67 datë 30.12.2016 të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë, në hipotezën e miratimit të këtij referendumit, pasoja e tij do të ishte e tillë që do t'i shrinte realisht efektet mbi vendimin nr. 67 datë 30.12.2016 të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë, fakt i cili do të shkonte në antikushtetueshmëri.

Në shqyrtimin e kërkesës e Grupit Nismëtar, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, duhet të vlerësojë nëse çështja që shtrohet a është çështje e rëndësisë së vecantë sipas nenit 126, pika 5 të Kodit Zgjedhor.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Kodi Zgjedhor në nenin 126, pika 5 dhe neni 132 të tij parashikojné të drejtën e zgjedhësve për të kërkuar referendum për një çështje të rëndësisë së veçantë. 12 nismëtarë kanë të drejtë të fillojnë procedura për të thirrur zgjedhësit të nënshkruar për të kërkuar që një çështje e rëndësisë së vecantë që i përket njësisë së qeverisjes vendore, t'i nënshtrohet referendumit.

Referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor për zhvillimin e referendumeve nenit 119, pika 6 të tij si dhe praktikave të mëparëshme të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, kërkesat për referendum, që nuk kaluar nëpër të gjitha procedurat, brenda datës 15 mars të çdo viti, pavarësisht se kur janë paraqitur, shtyhen deri në vitin pasardhës. Kërkesa e Grupit Nismëtar për fillimin e procedurave është depozituar në datë 4.03.2015, duke llogaritur afatet procedurale për veprimet e mëtejshme të parashikuara nga ligji për referendumet, kjo kërkesë nuk i kalon të gjitha procedurat deri më datë 15 mars, në këto kushte do të shtyhet për vitin tjetër.

Nisur nga objekti i cili është ndërtimi i një parkimi nëntokësor, si dhe nisur nga koha kur zgjedhësit do të duhet të shprehen për ndërtimin ose jo të tij, KQZ vlerëson se kjo çështje nuk është një çështje e rëndësisë së veçantë.

Kodi Zgjedhor nuk ka një parashikim konkret në lidhje me konceptin “çështje e veçantë”, ndaj në lidhje me këtë. KQZ vlerëson ti referohet për analogji jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, e konkretisht vendimit nr. 18, datë 14.05.2003 (V – 18/03), Gjykata Kushtetuese, në interpretim përfundimtar të nenit 77, pika 2 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, citon shprehimisht se:

“4. Çështjet e veçanta që përbëjnë thelbin e objektit të veprimtarisë së komisioneve hetimore parlamentare, të cilat e përmbajnë në vetvete interesin publik, janë ato që hetohen në aspektin e kontrollit e të zbatimit të ligjeve, të njohjes e verifikimit në thellësi të një fenomeni, ngjarjeje, a veprimtarie dhe që nxisin iniciativat për propozime, amendime apo miratime ligjesh, me qëllim parandalimin e fenomeneve negative për shoqërinë e shtetin dhe nxjerrjen e përgjegjësive institucionale”.

Për këtë arsye një vendim i Këshillit Bashkiak, si është dhe vendimi nr. 67, datë 30.12.2015 nuk mund të përbëjë çështje të veçantë në kuptim të këtij vendimi

Pavarësisht kontekstit të interpretimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të këtij koncepti, rasti konkret në shqyrtim nuk përfshihet në asnjë nga elementët e përmendur shprehimisht nga ana e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. (V – 18/03).

Gjithashtu, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, çmon të nevojshme të theksojë se e drejta refendare, pra e drejta për referendum, është një e drejtë kushtetuese që duhet zhvilluar në mënyrë të atillë, që të mos ndërhyjë pa kufizim në veprimtarinë e organeve të pushteteve të tjera, përfshirë edhe organet e qeverisjes vendore. Jo çdo vendim i këtyre organeve mund t'i nënshtrohet praktikave referendare pasi një mënyrë e tillë do të çonte në paralizë të veprimtarisë së këtyre organeve.

Referendumi, ky instrument i rëndësishëm në një këndvështrim politik-filozofik është një mekanizëm i demokracisë së drejtëpërdrejtë, një procedurë që lejon qytetarët të marrin vendime politike drejtëpërdrejt nëpërmjet votës, por, nuk mund të përdoret në mënyrë abuzive dhe tej hapësirës dhe limiteve që Kushtetuta njeh. Prandaj, ushtrimi i këtij mjete juridik kushtetues për ato çështje dhe në ato pushtete, dhe në mënyrën se si është parashtruar nga kërkuesit, do të dëmtonte këtë kompetencë kushtetuese.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, çmon se jo çdo çështje që trajtohet nga qeverisja vendore mund të çohet në referendum, njihen edhe mjete të tjera të përshtatshme kushtetuese, për të kontrolluar veprimtarinë e organeve të qeverisjes vendore.

Sa më sipër, referuar dispozitave të sipërcituara, duke qenë se Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka të drejtën dhe detyrimin për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve për sa i përket lloji i referendumit për të cilin kërkohet fillimi i procedurave (i përgjithshëm apo vendor); ekzistencën dhe qartësinë e çështjes që shtrohet për referendum, rëndësia e saj, kufizimet në ushtrimin e të drejtës për referendum, përveç se edhe aspekte të tjera ligjore që do të gjejnë pasqyrim në fletën-tip, vlerëson se referuar në objektin e saj çështja “A jeni dakord në territorin e Parkut Rinia të Bashkisë Tiranë, të ndërtohet një parkim nëntokësor?” është një çështje e cila kufizohet nga parashikimet e nenit 151, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nuk mund të shtrohet në asnjë referendum.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 21, pika 1, nenin 126 pika 2, dhe 4, nenin 127, pika 1 të ligjit Nr. 9087, datë 19.06. 2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

V E N D O S I

1. Rrëzimin e kërkesës së 12 nismëtarëve për paisjen me fletë-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për referendum vendor për çështjen e qeverisjes vendore të Bashkisë Tiranë. “A jeni dakord në territorin e Parkut Rinia të Bashkisë Tiranë, të ndërtohet një parkim nëntokësor”?
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Vendim nr. 7

Data 23.03.2016

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË NJË GRUPI
NISMËTARËSH PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE, PËR
ZHVILLIMIN E REFERENDUMIT VENDOR NË BASHKINË
TIRANË, PËR ÇËSHTJEN “A JENI DAKORD QE BRENDA
PARKUT TË LIQENIT NË BASHKINË TIRANË, NË TË DY
ANËT E KORPUSIT TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË
NDËRTOHEN OBJEKTE, QOFSHIN KËTO EDHE SOCIAL-
KULTURORE, UNIVERSITARE APO ADMINISTRATIVE?”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.03.2016,
me pjesëmarrjen e:

Lefterije
Denar

LUZI
BIBA

Kryetare
Zv/Kryetar

Edlira
Gëzim

JORGAQI
VELESHNJA

Anëtare
Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi nismëtarësh për fillimin e procedurave, për zhvillimin e një referendumi në Bashkinë Tiranë për çështjen “A jeni dakord që brenda Parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë, në të dy anët e Korpusit të Universitetit Politeknik të ndërtohen objekte, qofshin këto edhe social-kulturore, universitare apo administrative?”

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa a, i ligjit nr 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 126, pika 2 dhe 5, neni 127, pika 1, neni 132, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve;

VËREN

Në datë 04.03.2016, një grup prej 12 nismëtarësh ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën nr.264 prot, datë 04.03.2016. Me anë të kësaj kërkesë, grupi nismëtar i drejtohet KQZ-së për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor, në nivel të njësisë bazë të qeverisjes vendore duke ju drejtuar zgjedhësve për çështjen “A jeni dakord me vendimin për të ndërtuar objekte social-kulturore, universitare dhe administrative në dy anët e korpusit të Universitetit Politeknik”?

Kërkesën e tyre Grupi nismëtar e bën në mbështetje të nenit 2, pika 2, nenit 108, pika 2 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe dispozitave konkrete të Kodit Zgjedhor, për zhvillimin e referendumeve.

Sipas pretendimeve të kërkuesve:

Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) miratoi me vendimin nr. 11, datë 16.02.2016 “Miratimin e zonimit funksional të hyrjes së parkut të Liqenit të Tiranës pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, si dhe marrjen e nismës për hartimin e Planit të Detajuar dhe projekteve zhvillimore brenda këtij territori” me një procedurë të dyshimtë, me shumë përcaktime ligjore duke injoruar dhe dëgjesat publike dhe procesin e vlerësimit strategjik mjedisor.

Shumë lulishte u kthyen në pallate shumëkatëshe, si dhe shumë zona kulturore dhe zona të gjelbra janë kthyer në zona ndërtimore. Me vendimin nr. 11, datë 16.02.2016, KKT ka shënuar sipërfaqet e gjelbra në të dy anët e korpusit të Universitetit Politeknik, si “Objekte Social-Kulturore, Universitare dhe Administrative”, duke hequr këto sipërfaqe nga zonat e gjelbra të Parkut.

Prishja e Parkut të Liqenit për të ndërtuar objekte shumëkatëshe qëllimisht të quajtura social-kulturore, universitare, dhe administrative shkatëron pjesën hyrëse të parkut që shërben si mushkria kryesore e qytetit.

Në kushtet kur Këshilli Kombëtar i Territorit, në një proces të shkurtër, jo transparent, në lidhje me opsionin që u miratua, pa proces vlerësimi mjedisor si kërkohet nga ligji kërkuesit mendojnë se është domosdoshmëri që komuniteti i Bashkisë Tiranë të shprehet për këtë çështje nëpërmjet referendumit vendor.

Në lidhje me këtë kërkesë, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 132, pika 4, nenit 126, pika 2 dhe nenit 127, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 i ndryshuar, paraprakisht duhet të verifikojë nëse nismëtarët e depozitimit të kërkesës, janë zgjedhës të Bashkisë Tiranë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr.277, prot., datë 08.03.2016 i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile verifikimin nëse nismëtarët janë zgjedhës të Bashkisë Tiranë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr.277/1, datë 18.03.2016, konfirmoi se të 12 nismëtarët janë zgjedhës në Bashkinë Tiranë.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, më datë 21.03.2016 mori në shqyrtim kërkesën nr.264 prot, datë 04.03.2016, me objektin cituar si më sipër, në përputhje me parashikimet e nenit 132, pika 4 dhe 126 të Kodit Zgjedhor

Referuar parashikimeve të nenit 126, pika 5 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE”, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve fillimisht çmon se, në mënyrën se si është formuluar pyetja që kërkuesit kanë kërkuar të shtrohet për referendum, është e paqartë. Në këtë mënyrë është i paqartë edhe lloji i referendumit që kërkohet të bëhet. Pra, është e paqartë nëse kemi të bëjmë me një kërkesë për një çështje të rëndësishë së veçantë apo kërkohet një referendum shfuqizues (abrogues) të një akti administrativ, sikurse është vendimi nr. 11, datë 16.02.2015 “ Për miratimin e zonimit funksional të hyrjes së parkut të liqenit të Tiranës, pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, si dhe marrjen e nismës për hartimin e planit të detajuar dhe projekteve zhvillimore brenda këtij territori”.

Pyetja, “Ajeni dakord me vendimin nr. 67 datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak për ndërtimin me koncesion të një parkimi nëntokësor tek Parku Rinia?” është e paqartë në kuptim të ligjit sepse:

Në rast se do të ishte referendum shfuqizues i një akti, kërkesa formalisht nuk përmbush kriteret e parashikuara në nenin 126, pika 4, të ligjit 9087/2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, ku parashikohet shprehimisht se: “Kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për shfuqizimin e një ligji ose të një pjese të tij përmban:

- titullin, numrin dhe datën e miratimit të aktit që kërkohet të shfuqizohet.

Pra, me fjalë të tjera duhet që kërkesa të citojë shprehimisht “SHFUQIZIMIN” e aktit që atakohet, që në rastin konkret nuk është formuluar si e tillë. Dhe kjo gjë vihet re lehtësisht si në objektin e kërkesës ashtu edhe në pyetjen e formuluar nga ana e kërkueseve.

Objekti i kërkesës citon shprehimisht: “kërkesë për zhvillimin e një referendumit vendor lidhur me vendimin për parkim nëntokësor në Parkun Rinia në njësinë e qeverisjes vendore Bashkia Tiranë.”

Pyetja e propozuar për t’u parashtruar për referendum citon shprehimisht:

“A jeni dakord me vendimin për të ndërtuar objekte social-kulturore, universitare dhe administrative në dy anët e korpusit të Universitetit Politeknik”?

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se, në respekt të kërkesave ligjore, pyetja referendare duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që të shprehë realisht vullnetin e kërkuarit dhe të përcillet në të njëjtën mënyrë edhe tek zgjedhësit e thirrur për të votuar. Nëpërmjet *referendumit shfuqizues* pyetja duhet të jetë: A DONI QE VENDIMI Nr.11, datë 16.02.2015, të shfuqizohet?

Kjo është shumë e rëndësishme. Ndërtimi dhe parashtrimi i pyetjes referendare duhet të plotësojë kriterin e qartësisë që do të thotë që, pyetja referendare duhet të jetë një pyetje e tillë që të kuptohet lehtësisht nga ana e votuesit dhe të mos krijojë paqartësi, kritere të cilat nuk plotësohen në mënyrën se si është ndërtuar pyetja nga ana e kërkuarësve.

Sa më sipër, mbahet në konsideratë fakti se natyra e referendumit shfuqizues në sistemin tonë kushtetues është akt-burim i së drejtës. Ashtu si legjislatori përfaqësues (KUVENDI) frymëzon dhe koordinon vullnetin e tij tek një objekt të përcaktuar edhe nëpërmjet shfuqizimit të një ligji, ashtu edhe vullneti popullor mund dhe duhet të frymëzohet nga një “ratio” gjithashtu e përcaktuar. Kur Kuvendi shfuqizon një ligj sigurisht që i referohet formalisht attributeve të këtij ligji, pra do të thotë që i referohet konkretisht numrit, datës së miratimit të tij dhe titullit të tij. E njëjta gjë duhet të karakterizojë edhe këtë proces.

Kur flasim për referendum shfuqizues bëhet fjalë për një akt-burim i së drejtës, ku pyetja që shtrohet për zgjedhësit është nëse ata dëshirojnë apo jo të shfuqizojnë një normë të një akti apo të gjithë aktin. Dhe në këtë mënyrë, nëpërmjet ftesës për referendum, populli merr pjesë “aktive” në procesin “hartimit të së drejtës” edhe nëpërmjet shfuqizimit (hartimit të aktit në mënyrë negative) të një akti që natyrisht do të pasohet nga një normë tjetër që do të shkruhet për të plotësuar vullnetin e zgjedhësve (vullneti pozitiv).

Aq më tepër bëhet e domosdoshme në referendumin shfuqizues nevoja për qartësi, thjeshtësi të pyetjes, edhe për faktin tjetër se në referendum, shprehja e vullnetit të zgjedhësve nuk është konceptuar si një përgjigje e artikuluar, por kërkohet thjesht një zgjedhje PO ose JO.

Pra, thënë ndryshe, kërkuesit, në mënyrën se si e kanë formuluar pyetjen e referendumit, nuk kanë qenë të aftë të shprehin në mënyrë evidente qëllimin e shfuqizimit refendar.

Më tej, konstatimi i mangësive në pyetjen refendare, që përbën shkak për mospranimin e saj qëndron edhe në atë ç'ka mungon në të, pra në atë që kërkuesit e saj kanë lënë jashtë kërkesës, pra, kemi të bëjmë me atë që quhet "omisionin" e kërkesës referendare.

Edhe sikur pyetja referendare të ishte formuluar në mënyrën e duhur dhe pa mangësi, përsëri jemi në shkelje të parashikimeve të nenit 150 i Kushtetutës ku parashikohet shprehimisht se:

"1. Populli, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, ka të drejtën e referendumit për shfuqizimin e një ligji, si dhe t'i kërkojë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë".

Pra, Kushtetuta dhe në tërësi baza ligjore për organizimin e referendumeve të përgjithshme dhe lokale në vendin tonë nuk e parashikon *refendumin shfuqizues lokal*, pra *nuk parashikohet referendumi shfuqizues për një akt të organeve të qeverisjes vendore!*

Pasi dëgjoi vlerësimet paraprake si më sipër, referuar parashikimeve të nenit 126, pika 5 të të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", me shkresën nr. 263, datë 21.03.2016 grupi nismëtar i kërkoi Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve saktësimin e kërkesës nr.265, datë 04.03,2016, lidhur më formulimin e çështjes së rëndësisë së veçantë që kërkohet të shtrohet për referendum, duke e saktësuar pyetjen si më poshtë:

"A jeni dakord që brenda Parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë, në të dy anët e Korpusit të Universitetit Politeknik të ndërtohen objekte, qofshin këto edhe social-kulturore, universitare apo administrative?"

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, më datë 23.03.2016 mori në shqyrtim kërkesën e grupit nismëtar për saktësimin e çështjes që do të shtrohet për referendum dhe referuar nenit 68, "Te metat e kërkesës fillestare" të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe të

nenit 154/a të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar) me vendim të ndërmjetëm vendosi të pranojë kërkesën për saktësim të çështjes që do të shtrohet për referendum.

Në lidhje me kufijtë e shqyrtimit nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, të kërkesës për zhvillimin e një referendumi, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve referuar nenit 126, pika 5 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese¹ dhe të praktikës së Kolegjit Zgjedhor² të Gjykatës së Apelit Tiranë, vlerëson se:

“Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka të drejtën dhe detyrimin për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve në drejtime si: lloji i referendumit për të cilin kërkohet fillimi i procedurave (i përgjithshëm apo vendor); ekzistencën dhe qartësinë e çështjes që shtrohet për referendum, rëndësia e saj, kufizimet në ushtrimin e të drejtës për referendum, përveç se edhe aspekte të tjera ligjore që do të gjejnë pasqyrim në fletën-tip për mbledhjen e nënshkrimeve, që përpilohet nga vetë Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. Për sa kohë që ligjvënësi ka paracaktuar në pikën 5 të nenit 126 rregulla strikte ligjore përpara mbledhjes së nënshkrimeve të nevojshme për të kërkuar fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit, rregulla të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur, në radhë të parë, nga nismëtarët, atëherë organi më i parë që kontrollon ligjshmërinë e kërkesës, është Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, që në ushtrim të kompetencave ligjore, nuk lejon fillimin e procedurave që bien në kundërshtim me ligjin.

Në këto kushte Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve përpara miratimit të modelit të fletës tip, dhe pajisjes së grupit nismëtar me to duhet të kontrollojë përputhshmërinë e kërkesës me legjislacionin e interesuar. Kompetenca e Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve për shqyrtimin e

1 Vendimi 31/2003 i Gjykatës Kushtetuese vendimi nr. 25, datë 24.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese; Vendimi nr. 26, datë 25.9.2010 i Gjykatës Kushtetuese Vendimi nr.5, datë 21.01.2011 i Gjykatës Kushtetuese vendimi nr. 8, datë 8.03.2013 i Gjykatës Kushtetuese.

2 Vendimi nr.1, datë 14.01.2015 i Kolegjit Zgjedhor

elementëve ligjorë që duhet të përmbushë kërkesa për kryerjen e një referendumit është analizuar në jo pak vendime të Gjykatës Kushtetuese³.

Kështu, në vendimin nr. 5, datë 21.01.2011, Gjykata Kushtetuese ka rrëzuar kërkesën e grupit nismëtar për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 26, datë 28.09.2010 të KQZ-së, me të cilin është refuzuar pajisja me fletën-tip për zhvillimin e referendumit për një çështje të veçantë, ku shtrohej pyetja se “A duhet të rinumërohen fletët e votimit të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009?”. Arsyetimi i përdorur nga KQZ-ja, në këtë vendim, ishte se çështja e shtruar për referendum nuk ishte e qartë. Gjykata Kushtetuese e ka gjetur kërkesën e paraqitur nga grupi nismëtar si haptazi të pabazuar, duke arsyetuar ndër të tjera se: “Sipas dispozitave të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur nga jo më pak se 12 nismëtarë për zhvillimin e referendumit për një çështje të rëndësishme të veçantë. Përderisa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, siç rezulton nga vendimi nr.26, datë 28.09.2010, ka vlerësuar anën formale të rregullsisë së dokumentacionit, që lidhet me *përcaktimin e qartë të llojit të referendumit e të llojit të objektit të kërkesës*, Kolegji çmon se një shqyrtim i tillë nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, por të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ndaj qëndrimeve që mban Komisioni Qendror i Zgjedhjeve lidhur me parregullsinë e dokumentacionit të paraqitur, është detyrim i kërkuarit për të shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore që kërkon Kodi Zgjedhor për të riparaqitur kërkesën pas korrigjimit të parregullsive të vërejtura.” Gjykata Kushtetuese ka konkluduar me këtë vendim se “Përderisa, këto çështje përfshihen në juridiksionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nuk janë pjesë e ndonjë juridiksioni kushtetues”, atëherë edhe kërkesa vlerësohet “si haptazi e pabazuar” dhe “nuk plotëson kushtet për të kaluar në seancë.” (Shih më gjerë vendimi nr. 26, datë 28.09.2010 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese). Jurisprudenca kushtetuese e ka evidentuar në këtë rast KQZ-në si organi kompetent, që shqyrton aspektin ligjor të

³ Per me gjere referohu ne vendimin nr. 1, date 14.01.2015 te kolegjit Zgjedhor, faqe 33 e ne vijim

kërkesës së nismëtarëve lidhur me detyrimin e tyre për të paraqitur qartësisht çështjen për të cilën kërkojnë të fillojnë procedurat për zhvillimin e referendumit.

Kompetenca e Komisionit Qendror i Zgjedhjeve për të vlerësuar llojin e referendumit, për të cilin grupi nismëtar ka paraqitur kërkesë, është pranuar edhe në vendimin nr.25, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin është rrëzuar kërkesa e grupit nismëtar për shfuqizimin e vendimit nr.47, datë 05.06.2008 të KQZ-së. Me këtë vendim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka rrëzuar kërkesën e një grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi të përgjithshëm për shfuqizimin e neneve 5, 7 dhe 8 të ligjit nr. 9904, datë 21.04.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve argumenton vendimin e tij me faktin se kërkesa e grupit nismëtar ka të bëjë me një referendum kushtetues, sipas nenit 122 të Kodit Zgjedhor dhe jo me referendum të përgjithshëm, parashikuar nga neni 126 i këtij Kodi e për rrjedhojë kërkesa është konsideruar se nuk përbën objekt shqyrtimi nga ky organ. Me vendimin nr. 25/2009, Gjykata Kushtetuese nuk e ka legjitimuar kërkuesin, duke arsyetuar se thirrja e referendumit për amendamentet kushtetuese mund të bëhet vetëm brenda kufijve të parashikuar nga neni 177 i Kushtetutës dhe se e drejta e 50 mijë shtetasve me të drejtë vote për të kërkuar shfuqizimin e një ligji, sipas nenit 150, nuk shtrihet në ligjet për rishikimin e Kushtetutës. Me këtë qëndrim të mbajtur nga jurisprudenca kushtetuese, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerësohet si organi që ka kompetencën ligjore për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve edhe sa i përket llojit të referendumit që ata kërkojnë të zhvillojnë, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor.

Gjithashtu, nisur nga pretendimi që ka paraqitur Kuvendi i Shqipërisë për moslegjitimitimin e Komisionit Qendror i Zgjedhjeve për të dërguar për kontroll të kushtetutshmërisë së referendumit, me arsyetimin se vendimi është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, për shkak të mos verifikimit të nënshkrimeve (nga verifikimi kanë rezultuar nënshkrime të falsifikuara), Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 8, datë 08.03.2013 është shprehur se : “... vendimi i KQZ-së, për pranimin e kërkesës për zhvillimin e referendumit të

përgjithshëm shfuqizues, nuk i nënshtrohet vlerësimit nga Gjykata, por përbën mjetin për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues për të shqyrtuar, paraprakisht, kushtetutshmërinë e kërkesës për referendum të përgjithshëm shfuqizues, të paraqitur nga grupi nismëtar në emër të mbi 50 mijë zgjedhësve”.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese i konsideron jashtë juridiksionit të saj çështjet që lidhen me aspektin ligjor e faktik të procesit të vendimmarrjes së KQZ-së, duke i konsideruar ato në kompetencë të këtij organi.

Nisur nga nevoja për të evidentuar kuadrin historik në të cilin ligjvënësi ka hartuar dhe miratuar dispozitat e Kodit Zgjedhor mbi referendumet, por edhe nga elaborimi që jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka bërë, në këtë drejtim, Kolegji Zgjedhor vlerëson se, në interpretim të dispozitave mbi veprimtarinë administrative që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kryen, në kuadër të depozitimit, verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për referendum, *ligjvënësi ka ngarkuar këtë organ për të kryer verifikimin e ligjshmërisë së kërkesave, në kuptim të përmbushjes së kushteve ligjore që duhet të plotësojnë nismëtarët për zhvillimin e referendumit në përgjithësi, dhe atë vendor, si në rastin konkret.*

Duke iu referuar, për rastin në shqyrtim, dispozitave të Kodit Zgjedhor për referendumet, Kolegji Zgjedhor vlerëson se ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht dhe në mënyrë të detajuar etapat në të cilën kalon procedura për ushtrimin e së drejtës për referendum. Si një kusht parësor për fillimin e procedurës për zhvillimin e referendumit, është paraqitja fillimisht e kërkesës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga 12 zgjedhës (nismëtarët), me anë të së cilës kërkojnë marrjen prej saj të fletës-tip, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme, që mbështesin referendumin. Fleta-tip përmban, në varësi të kërkesës së nismëtarëve, ligjin që kërkohet të shfuqizohet me referendum, ose çështjen që shtrohet për referendum. Në këtë moment procedural shtrohet pyetja, nëse është e mjaftueshme për KQZ-në të evidentojë vetëm 12 zgjedhës që kanë paraqitur kërkesën për shfuqizimin e një ligji ose që shtrojnë një çështje për referendum, me qëllim vijimin e mbledhjes së nënshkrimeve nga zgjedhësit që mbështesin referendumin (formalizimin juridik të kërkesës për referendum nga subjekti, që ligji i njeh të drejtën e referendumit, sipas nenit 126/1 apo nenit 132/1 të Kodit Zgjedhor/Referendumet), apo edhe shqyrtimi në thelb i

kërkesës së paraqitur duke verifikuar përputhjen me kërkesat e nenit 126 dhe të dispozitave të tjera të Kodit Zgjedhor/Referendumet.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se, siç rezulton edhe në nenin 126 të Kodit Zgjedhor/Referendumet, *procedura për zhvillimin e referendumit duhet të fillojnë me plotësimin e disa kushteve nga nismëtarët*, të cilët janë të detyruar të paraqesin qartësisht në kërkesën e tyre, jo vetëm ligjin/dispozitën që kërkohet të shfuqizohet, por edhe arsyen se përse duhet shfuqizuar. Ndërkohë që në rastin e referendumit për një çështje të rëndësisë së veçantë, nismëtarët duhet të përshkruajnë qartë çështjen, rëndësinë e saj, qëndrimin e tyre si dhe të shtrojnë pyetjen pa ekuivoqe, e mundshme për t'iu përgjigjur me "Po" ose "Jo". Nëse KQZ-ja nuk ka në kompetencën e saj verifikimin e këtyre elementëve ligjorë, të domosdoshëm për iniciimin e procedurës së mbledhjes së nënshkrimeve nga zgjedhësit, ky proces, potencialisht, rrezikon të jetë i paligjshëm dhe të përfshijë zgjedhësit e tjerë, në çështje të cilat mund të vijnë ndesh, së paku, me moralin shoqëror dhe, më së shumti, me rendin demokratik.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se KQZ-ja ka përgjegjësinë (të drejtën dhe detyrimin) për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve në drejtime si:

- lloji i referendumit për të cilin kërkohet fillimi i procedurave (i përgjithshëm apo vendor);
- ekzistencën dhe qartësinë e çështjes që shtrohet për referendum,
- rëndësia e saj,
- përveç se edhe aspekte të tjera ligjore që do të gjejnë pasqyrim në fletën-tip për mbledhjen e nënshkrimeve, që përpilohet nga vetë KQZ-ja.

Për sa kohë që ligjvënësi ka paracaktuar në pikën 5 të nenit 126 rregulla strikte ligjore përpara mbledhjes së nënshkrimeve të nevojshme për të kërkuar fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit, rregulla të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur, në radhë të parë, nga nismëtarët, atëherë i vetmi organ që kontrollon ligjshmërinë e kërkesës, është dhe duhet të jetë veçse KQZ-ja, që në ushtrim të kompetencave ligjore, nuk lejon fillimin e procedurave që bien në kundërshtim me ligjin.

Partia Demokratike e Shqipërisë ka pretenduar, ndërmjet të tjerave se, është Gjykata Kushtetuese, organi i cili pas mbledhjes së nënshkrimeve të nevojshme për kërkesën për referendum, shqyrton kushtetutshmërinë e çështjes që shtrohet në referendum

dhe se KQZ-ja nuk mund të marrë kompetencat që i përkasin kësaj gjykate, duke u kufizuar vetëm në verifikimin e nënshkrimeve.

Në referim të Kushtetutës, Kolegji Zgjedhor thekson se sipas nenit 124, pika 2, Gjykata Kushtetuese, për vet pozicionin që ka si një autoritet i lartë, i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe në ushtrim të kompetencave të saj, ajo vendos për kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij (neni 131, shkronja “ë” e Kushtetutës), si dhe shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum, sipas nenit 150 paragrafët 1 e 2, nenit 151 paragrafët 2 e 3, nenit 177 paragrafët 4 e 5 (neni 152). Janë këtë kompetenca të cilat gjenden të parashikuara në shumë dispozita të Kushtetutës, në lidhje me referendumet dhe që kanë qenë objekt interpretimi nga jurisprudenca kushtetuese, mbi të cilat orientohet vetë Gjykata Kushtetuese për të përcaktuar juridiksionin e saj.

Ajo që Kolegji Zgjedhor vlerëson, në rastin konkret, lidhet me detyrimin e KQZ-së për të shqyrtuar të gjithë aspektet ligjore të kërkesës së nismëtarëve, duke mos u kufizuar vetëm në verifikimin e cilësisë së tyre si zgjedhës, në pranimin e kërkesës për pajisjen me fletën tip. Një kërkesë e vlefshme ligjërisht, që paraqitet nga nismëtarët dhe që konsiderohet si e tillë nga KQZ-ja, është një kusht për vijimin e procedurës së mëtejshme për zhvillimin e referendumit. Për rrjedhojë, vendimi i KQZ-së që kontrollon ligjshmërinë e kërkesës, për nga natyra e çështjeve që shqyrton, në këtë moment procedural, është një vendim përfundimtar dhe i kontrollueshëm gjyqësisht. Vetëm pas certifikimit ligjor të këtij vendimi përfundimtar, KQZ-ja, në kuptim të nenit 128 të Kodit Zgjedhor, “verifikon nënshkrimet dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të zgjedhësve, në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra prej saj” si dhe “vendos për pranimin ose mospranimin e kërkesës brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së saj, duke e bazuar vendimin vetëm mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur.”.

Të drejtën e shtetasve me të drejtë vote, për të kërkuar referendum e sanksionon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 9087, datë 19.06.2003, kështu për pshqyrimin e kësaj kërkesë

për referendum Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve i referohet kuadrit kushtetues dhe ligjor në fuqi:

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 2 (pikat 1 dhe 2)

- “1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit.
2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti.”

Neni 13

“Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore.”

Neni 108

- “1. Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj.
2. Ndarjet administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike. Kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa u marrë me parë mendimi i popullsisë që banon në to.
3. Komuna dhe bashkia janë njësi bazë të qeverisjes vendore. Ato kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisese, me përjashtim të atyre që me ligj u jepen njërive të tjera të qeverisjes vendore.
4. Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore. Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit vendor parashikohen me ligj në përputhje edhe me nenin 151 paragrafi 2.”

Neni 124

- “1. Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj.
2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.”

Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos për: ... ë) kushtetutshmerinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij;”

Neni 151

“2. Çështjet që lidhen me tërësinë territoriale të Republikës së Shqipërisë, me kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, me buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit, me vendosjen dhe heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme, me deklarimin e luftës dhe të paqes dhe me amnistinë nuk mund të shtrohen në asnjë referendum.”

Neni 152

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum sipas nenit 150 paragrafët 1 e 2, nenit 151 paragrafët 2 e 3 edhe sipas nenit 177 paragrafët 4 e 5 brenda 60 ditëve.

2. Rëndësia e çështjeve të veçanta, të parashikuara në nenin 150 paragrafët 1 e 2 nuk është objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese.”

KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË I miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 74/2012

Neni 1 : Qëllimi dhe objekti

“1. Ky Kod ka për qëllim caktimin e rregullave për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet. ...”

Neni 2 : Përkufizime

“Në këtë Kod termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: ... 18. “Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve” është rezultati i shpallur nga KQZ-ja, në përputhje me këtë Kod dhe që përfshin: ... ç) rezultatit e votimit për çdo alternativë në referendum, sipas dispozitave të këtij Kodi. ... 23. “Zgjedhje” janë votimet për Kuvendin, për njësitë e qeverisjes vendore dhe referendumet.

Neni 145 : E drejta e ankimit në gjykatë

“1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. ...”

Neni 152 : Afati i ankimit në gjykatë

1. Ankimet, sipas këtij Kodi, paraqiten në Gjykatën e Apelit, Tiranë, e cila ia kalon ato Kolegjit Zgjedhor.

2. Ankimi për të gjitha vendimet që KQZ-ja merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjeshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tyre. Për vendimet që KQZ-ja merr jashtë kësaj periudhe, afati i ankimit në Kolegjin Zgjedhor është 30 ditë.”

Neni 185 : Shfuqizime

“1. Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, ligji nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe çdo akt tjetër ligjor ose nënligjor, që bie në kundërshtim me të, shfuqizohet.

2. Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në pikën 1 të këtij neni, pjesa e nëntë “Referendimet” e ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe çdo pjesë e dispozitave të tij që ka lidhje me të mbetet në fuqi deri në miratimin e ligjit të ri për referendimet e përgjithshme dhe vendore. Administrimi i procesit të referendumeve dhe nxjerrja e rezultatit të tyre bëhen në përputhje me këtë Kod.”

KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË I miratuar me ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003

Neni 1 : Qëllimi i këtij Kodi

“Ky Kod ka për qëllim përcaktimin e rregullave: ... e) për zhvillimin dhe vlefshmërinë e referendumeve; ...”

Neni 2 : Përkufizime

“... 19. “Referendum kushtetues” është referendumi, që zhvillohet sipas pikës 4 ose 5 të nenit 177 të Kushtetutës.

20. “Referendum i përgjithshëm” është referendumi, që zhvillohet sipas nenit 150, 151 dhe 152 të Kushtetutës.

21. “Referendum vendor” është referendumi, që zhvillohet sipas pikës 4 të nenit 108 të Kushtetutës.

...

34. “Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve” është rezultati i shpallur nga KQZ-ja dhe që përfshin:

...

c) rezultatin e votimit në referendum, sipas dispozitave të pjesës së nëntë të këtij Kodi.”

PJESA E NENTE REFERENDUMET

Neni 118 : Kuptimi i referendumit

1. Referendumi është ushtrimi i drejtpërdrejtë i sovranitetit të popullit, nëpërmjet votimit, për një çështje ose një ligj të caktuar, sipas neneve 108 pika 4, 150, 151, 152 dhe 177 të Kushtetutës. ... ”

Neni 126 : Nisma për referendum të përgjithshëm

“1. Pesëdhjetë mijë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve kanë të drejtën e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e një ligji, si dhe t’i kërkojnë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë, në përputhje me pikën 1 të nenit 150 të Kushtetutës, si dhe me dispozitat e këtij Kodi.

2. Kërkesa për fillimin e procedurave të referendumit paraqitet në KQZ nga një grup prej jo më pak se 12 nismëtarësh, të cilët janë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve.

3. Kërkesa për shfuqizimin e një pjese të ligjit pranohet vetëm kur pjesa tjetër e ligjit është e vetëmjaftueshme.

4. Kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për shfuqizimin e një ligji ose të një pjese të tij, përmban:

a) titullin, numrin dhe datën e miratimit të ligjit që kërkohet të shfuqizohet, si dhe në qoftë se kërkohet të shfuqizohet vetëm një pjesë e ligjit, dispozitat përkatëse;

b) arsyet përse ligji ose dispozita të veçanta të tij duhen shfuqizuar.

5. Kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për një çështje të një rëndësie të veçantë duhet të përshkruajë qartë çështjen që shtrohet, rëndësinë e saj si dhe qëndrimin e nismëtarëve në lidhje me atë çështje. Çështja duhet të formulohet në mënyrë të qartë, të plotë dhe pa ekuivoqe dhe në mënyrë të tillë që zgjedhësit të mund të përgjigjen me “PO” ose “JO”.

Neni 127 : Fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve

“1. KQZ-ja, brenda 20 ditëve nga paraqitja e kërkesës për referendum të përgjithshëm, pajis grupin nismëtar kundrejt pagesës me fletët-tip

për mbledhjen e nënshkrimeve të 50 mijë zgjedhësve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve në kohën e paraqitjes së kërkesës. Në krye të fletës-tip shtypet titulli i ligjit, dispozitat që kërkohen të shfuqizohen ose çështja që shtrohet në referendum.

2. Nënshkrimet në mbështetje të kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm depozitohen në KQZ në periudhën nga 1 janari deri më 30 nëntor të çdo viti.”

Neni 128 : Verifikimi i kërkeses nga KQZ-ja

“1. KQZ-ja verifikon nënshkrimet dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të zgjedhësve, në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra prej saj.

2. KQZ-ja vendos për pranimin ose mospranimin e kërkesës brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së saj, duke e bazuar vendimin vetëm mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur. Vendimi u njoftohet menjëherë nismëtarëve. Vendimi për mospranimin e kërkesës duhet të përcaktojë qartë shkaqet e mospranimit.

3. Brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit, grupi nismëtar mund t'i deklarojë KQZ-së se është i gatshëm të korrigjojë parregullsitë e vërejtura. Në këtë rast, KQZ-ja cakton një afat deri në 30 ditë për riparaqitjen e kërkesës. KQZ-ja vendos brenda 10 ditëve për pranimin ose jo të kërkesës së riparaqitur dhe i njofton menjëherë nismëtarët.”

Neni 132 : Nisma për referendum vendor

“1. Dhjetë për qind e zgjedhësve të regjistruar në listat e zgjedhësve të komunës ose bashkisë ose 20 mijë prej tyre, cilado shifër të jetë më e vogël, kanë të drejtën e referendumit vendor për një çështje të qeverisjes vendore në bashkinë ose komunën përkatëse.

2. Një numër këshillash bashkiake ose komunale, që përfaqësojnë jo më pak se një të tretën e popullsisë së një qarku, kanë të drejtë të kërkojnë zhvillimin e një referendumi për një çështje të qeverisjes vendore në nivel qarku.

3. Referendumi për të njëjtën çështje nuk mund të përsëritet në të njëjtën njësi të qeverisjes vendore pa kaluar tre vjet nga zhvillimi i tij.

4. Për zhvillimin e referendumit vendor zbatohen, për aq sa është e mundur ose e nevojshme, dispozitat e parashikuara për

referendumin e përgjithshëm në pikat 2 dhe 5 të nenit 126, nenin 127 dhe në pikën 2 të nenit 128 të këtij Kodi.”

Nga analiza e vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit si dhe shpjegimeve të përfaqesueses të këshillit bashkiak e thirur nga KQZ për këtë qëllim, rezulton se, çështja që shtrohet për referendum vendor, në Bashkinë e Tiranës në kërkesën e grupit nismëtar, është një çështje e cila përfshin:

1. Zonën e çështjes me rëndësi kombëtare, në planifikimin e territorit, identifikuar si Kurora e Gjelbër e Tiranës, Parkun e Liqenit, përcaktuar me vendimin nr. 4, datë 29.12.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për përcaktimin e çështjes dhe zonës me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, identifikuar si Kurora e Gjelbër e Tiranës”;
2. Hartimin e Planit të Detajuar dhe projekteve zhvillimore një territor të cilësuar si zonë me rëndësi kombëtare, të miratuar me vendin nr. 11, datë 16.02.2015, të Këshillit Kombëtar të Territorit “ Për miratimin e zonimit funksional të hyrjes së parkut të liqenit të Tiranës, pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, si dhe marrjen e nismës për hartimin e planit të detajuar dhe projekteve zhvillimore brenda këtij territori”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se miratimi për ndërtimin e kompleksit të objekteve është bërë me Vendime të Këshillit Kombëtar të Territorit. Aktet nënligjore të mësipërme shprehin qartë se çështja për të cilën kërkohet referendum në nivel bazë të njësisë së qeverisjes vendore nuk është çështje e qeverisjes vendore.

Vendimi nr.4, datë datë 29.12.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit Parkun e Liqenit Tiranë e përcakton si një çështje me rëndësi kombëtare. Nuk ka asnjë vendim të Këshillit të Bashkisë Tiranë të cilat të kenë lidhje me çështjen që shtrohet për referendum vendor. Objektet të cilat janë miratuar për ndërtim kanë karakter kombëtar dhe jo vendor, sepse janë përcaktuar si të tilla dhe miratuar me akte të qeverisjes qendrore dhe jo me akte të qeverisjes vendore.

Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor i miratuar me ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003 kanë përcaktuar disa lloje referendumesh, duke përfshirë referendum të përgjithshëm për një çështje të rëndësishme së veçantë me karakter kombëtar (neni 150, pika e kushtetutes, neni 126, pika 1 e ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003) dhe referendum vendosur për çështje të qeverisjes vendore (neni 108, i Kushtetutës dhe neni 132, pika i ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003. Karakteri i çështjes kombëtare apo lokale bën ndryshimin ndërmjet këtyre dy llojeve të referendumeve.

Referuar dispozitave të sipërcituara, duke qene se KQZ-ja ka të drejtën dhe detyrimin për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve për sa i përket lloji të referendumit për të cilin kërkohet fillimi i procedurave, vlerëson se referuar në objektin e saj çështja “A jeni dakord që brenda Parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë, në të dy anët e Korpusit të Universitetit Politeknik të ndërtohen objekte, qofshin këto edhe social-kulturore, universitare apo administrative?” është një çështje e cila mund të shtrohet vetëm për referendum të përgjithshëm.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Neni 23, pika 1, germa a, i ligjit nr 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 126, pika 2 dhe 5, neni 127, pika 1, neni 132, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

V E N D O S I

1. Rrezimin e kërkesës së 12 nismëtarëve për paisjen me fletë-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për referendum vendor për çështjen e qeverisjes vendore të Bashkisë Tiranë. “A jeni dakord që brenda Parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë, në të dy anët e Korpusit të Universitetit Politeknik të ndërtohen objekte, qofshin këto edhe social-kulturore, universitare apo administrative?”

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Vendim nr. 8

Data 23.03.2016

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË NJË GRUPI
NISMËTARËSH PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE, PËR
ZHVILLIMIN E REFERENDUMIT VENDOR NË BASHKINË
TIRANË, PËR ÇËSHTJEN “A JENI DAKORD QË TË
NDËRTOHET KËND LOJRASH DUKE BETONIZUAR ZEMRËN
E PARKUT TË LIQENIT NË BASHKINË TIRANË?”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.03.2016,
me pjesëmarrjen e:

Lefterije	LUZI	Kryetare
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Gëzim	VELESHNJA	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi nismëtarësh për fillimin e procedurave, për zhvillimin e një referendumi në Bashkinë Tiranë për çështjen “A jeni dakord që të ndërtohet kënd lojrash duke betonizuar zemrën e Parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë?”

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa a, i ligjit nr 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 126, pika 2 dhe 5, neni 127, pika 1, neni 132, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve;

VËREN

Në datë 04.03.2016, një grup prej 12 nismëtarësh ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën nr.265 prot, datë 04.03.2016. Me anë të kësaj kërkesë, grupi nismëtar i drejtohet KQZ-së për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor, në nivel të njësisë bazë të qeverisjes, vendore duke ju drejtuar zgjedhësve për çështjen “A jeni dakord me vendimin për të ndërtuar parkun e lojrave në zemër të Parkut të Liqenit sipas vendimit nr.1, datë 12.02.2016?”

Kërkesën e tyre Grupi nismëtar e bën në mbështetje të nenit 2, pika 2, nenit 108, pika 2 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe dispozitave konkrete të Kodit Zgjedhor, për zhvillimin e referendumeve.

Sipas pretendimeve të kërkuësve:

Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) miratoi me vendimin nr. 16, datë 16.02.2016 “Miratimin e zonimit funksional të hyrjes së parkut të Liqenit të Tiranës pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, si dhe

marrjen e nismës për hartimin e Planit të Detajuar dhe projekteve zhvillimore brenda këtij territori” me një procedurë të dyshimtë, me shumë përcaktime ligjore duke injoruar dhe dëgjesat publike dhe procesin e vlerësimit strategjik mjedisor.

Ndërkohë që u shpall marrja e nismës për hartimin e Planit të detajuar... ky plan ende nuk është përfunduar nuk ka asnjë dokument të Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe nuk ka hyrë në fuqi.

Në një mënyrë të fshehtë Bashkia Tiranë kreu zhvillimin e një tenderi pa patur leje ndërtimi dhe pa patur plan hapësinor të miratuar dhe filloi punimet në terren pa leje ndërtimi, pa supervisor, pa masterplan, të miratuar, pa vlerësim strategjik të miratuar etj.

Pas shume ditësh protestash të partisë demokratike, për prerjen e pemëve në park, KKT, nxorri vendimin nr. 1, datë 12.02.2016, “Për miratimin e lejes së Ndërtimit për objektin “Kënd i Lojrave për fëmij, projekti 4, në kuadër të rehabilitimit të Parkut të Liqenit Bashkia Tiranë”

Ndërkohë që objekti titullohet kënd lojrash, 8 nga 10 zërat e punimeve janë për beton

Në kushtet kur Këshilli Kombëtar i Territorit, në një proces të shkurtër, jo transparent, në lidhje me opsionin që u miratua, pa proces vlerësimi mjedisor si kërkohet nga ligji kërkuesit mendojnë se është domosdoshmëri që komuniteti i Bashkisë Tiranë të shprehet për këtë çështje nëpërmjet referendumit vendor.

Në lidhje me këtë kërkesë, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 132, pika 4, nenit 126, pika 2 dhe nenit 127, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 i ndryshuar, paraprakisht duhet të verifikojë nëse nismëtarët e depozitimit të kërkesës, janë zgjedhës të Bashkisë Tiranë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr.277, prot., datë 08.03.2016 i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjëndjes Civile verifikimin nëse nismëtarët janë zgjedhës të Bashkisë Tiranë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr. 277/1, datë 18.03.2016, konfirmoi se të 12 nismëtarët janë zgjedhës në Bashkinë Tiranë.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, më datë 21.03.2016 mori në shqyrtim kërkesën nr.265 prot, datë 04.03.2016, me objektin cituar si më sipër, në përputhje me parashikimet e nenit 132, pika 4 dhe 126 të Kodit Zgjedhor

Referuar parashikimeve të nenit 126, pika 5 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE”, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve fillimisht çmon se, në mënyrën se si është formuluar pyetja që kërkuesit kanë kërkuar të shtrohet për referendum, është e paqartë. Në këtë mënyrë është i paqartë edhe lloji i referendumit që kërkohet të bëhet. Pra, është e paqartë nëse kemi të bëjmë me një kërkesë për një çështje të rëndësishë së veçantë apo kërkohet një referendum shfuqizues (abrogues) të një akti administrativ, sikurse është vendimi I Këshillit Kombëtar të Territorit, nr. 1, datë 12.02.2016 “Për miratimin e lejes së Ndërtimit për objektin “Kënd i Lojrave për fëmij, projekti 4, në kuadër të rehabilitimit të Parkut të Liqenit Bashkia tiranë”

Pyetja, “A jeni dakord me vendimin për të ndërtuar parkun e lojrave në zemër të Parkut të Liqenit sipas vendimit nr.1, datë 12.02.2016? është e paqartë në kuptim të ligjit sepse:

Në rast se do të ishte referendum shfuqizues i një akti, kërkesa formalisht nuk përmbush kriteret e parashikuara në nenin 126, pika 4, të ligjit 9087/2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, ku parashikohet shprehimisht se: “Kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për shfuqizimin e një ligji ose të një pjese të tij përmban:

- titullin, numrin dhe datën e miratimit të aktit që kërkohet të shfuqizohet.

Pra, me fjalë të tjera duhet që kërkesa të citojë shprehimisht “SHFUQIZIMIN” e aktit që atakohet, që në rastin konkret nuk është formuluar si e tillë. Dhe kjo gjë vihet re lehtësisht si në objektin e kërkesës ashtu edhe në pyetjen e formuluar nga ana e kërkueseve.

Objekti i kërkesës citon shprehimisht: “kërkesë për zhvillimin e një referendumit vendor lidhur me vendimin për të ndërtuar parkun e lojrave në zemër të Parkut të

Pyetja e propozuar për t’u parashtruar për referendum citon shprehimisht:

“A jeni dakord me vendimin për të ndërtuar parkun e lojrave në zemër të Parkut të Liqenit sipas vendimit nr.1, datë 12.02.2016?”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se, në respekt të kërkesave ligjore, pyetja referendare duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që të shprehë realisht vullnetin e kërkuarit dhe të përcillet në të njëjtën mënyrë edhe tek zgjedhësit e thirrur për të votuar. Nëpërmjet referendumit shfuqizues pyetja duhet të jetë: A DONI QE VENDIMI Nr.1, datë 12.02.2016, të shfuqizohet?

Kjo është shumë e rëndësishme. Ndërtimi dhe parashtrimi i pyetjes referendare duhet të plotësojë kriterin e qartësisë që do të thotë që, pyetja referendare duhet të jetë një pyetje e tillë që të kuptohet lehtësisht nga ana e votuesit dhe të mos krijojë paqartësi, kriteret të cilat nuk plotësohen në mënyrën se si është ndërtuar pyetja nga ana e kërkuarësve.

Sa më sipër, mbahet në konsideratë fakti se natyra e referendumit shfuqizues në sistemin tonë kushtetues është akt-burim i së drejtës. Ashtu si legjislatori përfaqësues (KUVENDI) frymëzon dhe koordinon vullnetin e tij tek një objekt të përcaktuar edhe nëpërmjet shfuqizimit të një ligji, ashtu edhe vullneti popullor mund dhe duhet të frymëzohet nga një “ratio” gjithashtu e përcaktuar. Kur Kuvendi shfuqizon një ligj sigurisht që i referohet formalisht attributeve të këtij ligji, pra do të thotë që i referohet konkretisht numrit, datës së miratimit të tij dhe titullit të tij. E njëjta gjë duhet të karakterizojë edhe këtë proces.

Kur flasim për referendum shfuqizues bëhet fjalë për një akt-burim i së drejtës, ku pyetja që shtrohet për zgjedhësit është nëse ata dëshirojnë apo jo të shfuqizojnë një normë të një akti apo të gjithë aktin. Dhe në këtë mënyrë, nëpërmjet ftesës për referendum, populli merr pjesë “aktive” në procesin “hartimit të së drejtës” edhe nëpërmjet shfuqizimit (hartimit të aktit në mënyrë negative) të një akti që natyrisht do të pasohet nga një normë tjetër që do të shkruhet për të plotësuar vullnetin e zgjedhësve (vullneti pozitiv).

Aq më tepër bëhet e domosdoshme në referendumin shfuqizues nevoja për qartësi, thjeshtësi të pyetjes, edhe për faktin tjetër se në referendum, shprehja e vullnetit të zgjedhësve nuk është konceptuar si një përgjigje e artikulluar, por kërkohet thjesht një zgjedhje PO ose JO.

Pra, thënë ndryshe, kërkuesit, në mënyrën se si e kanë formuluar pyetjen e referendumit, nuk kanë qenë të aftë të shprehin në mënyrë evidente qëllimin e shfuqizimit refendar.

Më tej, konstatimi i mangësive në pyetjen refendare, që përbën shkak për mospranimin e saj qëndron edhe në atë ç'ka mungon në të, pra në atë që kërkuesit e saj kanë lënë jashtë kërkesës, pra, kemi të bëjmë me atë që quhet “omisionin” e kërkesës referendare.

Edhe sikur pyetja referendare të ishte formuluar në mënyrën e duhur dhe pa mangësi, përsëri jemi në shkelje të parashikimeve të nenit 150 i Kushtetutës ku parashikohet shprehimisht se:

“1. Populli, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, ka të drejtën e referendumit për shfuqizimin e një ligji, si dhe t'i kërkojë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë”.

Pra, Kushtetuta dhe në tërësi baza ligjore për organizimin e referendumeve të përgjithshme dhe lokale në vendin tonë nuk e parashikon *refendumin shfuqizues lokal, pra nuk parashikohet referendumi shfuqizues për një akt të organeve të qeverisjes vendore!*

Pasi dëgjoi vlerësimet paraprake si më sipër, referuar parashikimeve të nenit 126, pika 5 të të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 263, datë 21.03.2016 grupi nismëtar i kërkoi Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve saktësimin e kërkesës nr.263, datë 04.03,2016, lidhur më formulimin e çështjes së rëndësisë së veçantë që kërkohet të shtrohet për referendum, duke e saktësuar pyetjen si më poshtë:

“A jeni dakord që të ndërtohet kënd lojrash duke betonizuar zemrën e Parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë?”

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, më datë 23.03.2016 mori në shqyrtim kërkesën e grupit nismëtar për saktësimin e çështjes që do të shtrohet për referendum dhe referuar nenit 68, “Te metat e kërkesës fillestare” të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 154/a të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës

Civile i Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar) me vendim të ndërmjetëm vendosi të pranojë kërkesën për saktësim të çështjes që do të shtrohet për referendum.

Në lidhje me kufijtë e shqyrtimit nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, të kërkesës për zhvillimin e një referendumi, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve referuar nenit 126, pika 5 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese¹ dhe të praktikës së Kolegjit Zgjedhor² të Gjykatës së Apelit Tiranë, vlerëson se:

“Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtën dhe detyrimin për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve në drejtime si: lloji i referendumit për të cilin kërkohet fillimi i procedurave (i përgjithshëm apo vendor); ekzistencën dhe qartësinë e çështjes që shtrohet për referendum, rëndësia e saj, kufizimet në ushtrimin e të drejtës për referendum, përveç se edhe aspekte të tjera ligjore që do të gjejnë pasqyrim në fletën-tip për mbledhjen e nënshkrimeve, që përpilohet nga vetë Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. Për sa kohë që ligjvënësi ka paracaktuar në pikën 5 të nenit 126 rregulla strikte ligjore përpara mbledhjes së nënshkrimeve të nevojshme për të kërkuar fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit, rregulla të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur, në radhë të parë, nga nismëtarët, atëherë organi më i parë që kontrollon ligjshmërinë e kërkesës, është Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, që në ushtrim të kompetencave ligjore, nuk lejon fillimin e procedurave që bien në kundërshtim me ligjin.

Në këto kushte Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve përpara miratimit të modelit të fletës tip, dhe pajisjes së grupit nismëtar me to duhet të kontrollojë përputhshmërinë e kërkesës me legjisllacionin e interesuar.

1 Vendimi 31/2003 i Gjykatës Kushtetuese vendimi nr. 25, datë 24.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese; Vendimi nr. 26, datë 25.9.2010 i Gjykatës Kushtetuese Vendimi nr.5, datë 21.01.2011 i Gjykatës Kushtetuese vendimi nr. 8, datë 8.03.2013 i Gjykatës Kushtetuese.

2 Vendimi nr.1, datë 14.01.2015 i Kolegjit Zgjedhor

Kompetenca e Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve për shqyrtimin e elementëve ligjorë që duhet të përmbushë kërkesa për kryerjen e një referendumi është analizuar në jo pak vendime të Gjykatës Kushtetuese³.

Kështu, në vendimin nr. 5, datë 21.01.2011, Gjykata Kushtetuese ka rrëzuar kërkesën e grupit nismëtar për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 26, datë 28.09.2010 të KQZ-së, me të cilin është refuzuar pajisja me fletën-tip për zhvillimin e referendumit për një çështje të veçantë, ku shtrohej pyetja se “A duhet të rinumërohen fletët e votimit të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009?”. Arsyetimi i përdorur nga KQZ-ja, në këtë vendim, ishte se çështja e shtruar për referendum nuk ishte e qartë. Gjykata Kushtetuese e ka gjetur kërkesën e paraqitur nga grupi nismëtar si haptazi të pabazuar, duke arsyetuar ndër të tjera se: “Sipas dispozitave të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur nga jo më pak se 12 nismëtarë për zhvillimin e referendumit për një çështje të rëndësishme të veçantë. Përderisa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, siç rezulton nga vendimi nr.26, datë 28.09.2010, ka vlerësuar anën formale të rregullsisë së dokumentacionit, që lidhet me *përcaktimin e qartë të llojit të referendumit e të llojit të objektit të kërkesës*, Kolegji çmon se një shqyrtim i tillë nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, por të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ndaj qëndrimeve që mban Komisioni Qendror i Zgjedhjeve lidhur me parregullsinë e dokumentacionit të paraqitur, është detyrim i kërkuarit për të shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore që kërkon Kodi Zgjedhor për të riparaqitur kërkesën pas korrigjimit të parregullsisë të vërejtura.” Gjykata Kushtetuese ka konkluduar me këtë vendim se “Përderisa, këto çështje përfshihen në juridiksionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nuk janë pjesë e ndonjë juridiksioni kushtetues”, atëherë edhe kërkesa vlerësohet “si haptazi e pabazuar” dhe “nuk plotëson kushtet për të kaluar në seancë.”(Shih më gjerë vendimi nr. 26, datë 28.09.2010 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese). Jurisprudenca kushtetuese e ka evidentuar në këtë

3 Per me gjere referohu ne vendimin nr. 1, date 14.01.2015 te Kolegjit Zgjedhor, faqe 33 e ne vijim

rast KQZ-në si organi kompetent, që shqyrton aspektin ligjor të kërkesës së nismëtarëve lidhur me detyrimin e tyre për të paraqitur qartësisht çështjen për të cilën kërkojnë të fillojnë procedurat për zhvillimin e referendumit.

Kompetenca e Komisionit Qendror i Zgjedhjeve për të vlerësuar llojin e referendumit, për të cilin grupi nismëtar ka paraqitur kërkesë, është pranuar edhe në vendimin nr.25, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin është rrëzuar kërkesa e grupit nismëtar për shfuqizimin e vendimit nr.47, datë 05.06.2008 të KQZ-së. Me këtë vendim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka rrëzuar kërkesën e një grupi nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e neneve 5, 7 dhe 8 të ligjit nr. 9904, datë 21.04.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve argumenton vendimin e tij me faktin se kërkesa e grupit nismëtar ka të bëjë me një referendum kushtetues, sipas nenit 122 të Kodit Zgjedhor dhe jo me referendum të përgjithshëm, parashikuar nga neni 126 i këtij Kodi e për rrjedhojë kërkesa është konsideruar se nuk përbën objekt shqyrtimi nga ky organ. Me vendimin nr. 25/2009, Gjykata Kushtetuese nuk e ka legjitimuar kërkuuesin, duke arsyetuar se thirrja e referendumit për amendamentet kushtetuese mund të bëhet vetëm brenda kufijve të parashikuar nga neni 177 i Kushtetutës dhe se e drejta e 50 mijë shtetasve me të drejtë vote për të kërkuar shfuqizimin e një ligji, sipas nenit 150, nuk shtrihet në ligjet për rishikimin e Kushtetutës. Me këtë qëndrim të mbajtur nga jurisprudenca kushtetuese, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerësohet si organi që ka kompetencën ligjore për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve edhe sa i përket llojit të referendumit që ata kërkojnë të zhvillojnë, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor.

Gjithashtu, nisur nga pretendimi që ka paraqitur Kuvendi i Shqipërisë për moslegjitimitimin e Komisionit Qendror i Zgjedhjeve për të dërguar për kontroll të kushtetutshmërisë së referendumit, me arsyetimin se vendimi është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, për shkak të mos verifikimit të nënshkrimeve (nga verifikimi kanë rezultuar nënshkrime të falsifikuara), Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 8, datë 08.03.2013 është shprehur se : “... vendimi i KQZ-së, për pranimin e kërkesës për zhvillimin e referendumit të

përgjithshëm shfuqizues, nuk i nënshtrohet vlerësimit nga Gjykata, por përbën mjetin për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues për të shqyrtuar, paraprakisht, kushtetutshmërinë e kërkesës për referendum të përgjithshëm shfuqizues, të paraqitur nga grupi nismëtar në emër të mbi 50 mijë zgjedhësve”.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese i konsideron jashtë juridiksionit të saj çështjet që lidhen me aspektin ligjor e faktik të procesit të vendimmarrjes së KQZ-së, duke i konsideruar ato në kompetencë të këtij organi.

Nisur nga nevoja për të evidentuar kuadrin historik në të cilin ligjvënësi ka hartuar dhe miratuar dispozitat e Kodit Zgjedhor mbi referendumet, por edhe nga elaborimi që jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka bërë, në këtë drejtim, Kolegji Zgjedhor vlerëson se, në interpretim të dispozitave mbi veprimtarinë administrative që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kryen, në kuadër të depozitimit, verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për referendum, *ligjvënësi ka ngarkuar këtë organ për të kryer verifikimin e ligjshmërisë së kërkesave, në kuptim të përmbushjes së kushteve ligjore që duhet të plotësojnë nismëtarët për zhvillimin e referendumit në përgjithësi, dhe atë vendor, si në rastin konkret.*

Duke iu referuar, për rastin në shqyrtim, dispozitave të Kodit Zgjedhor për referendumet, Kolegji Zgjedhor vlerëson se ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht dhe në mënyrë të detajuar etapat në të cilën kalon procedura për ushtrimin e së drejtës për referendum. Si një kusht parësor për fillimin e procedurës për zhvillimin e referendumit, është paraqitja fillimisht e kërkesës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga 12 zgjedhës (nismëtarët), me anë të së cilës kërkojnë marrjen prej saj të fletës-tip, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme, që mbështesin referendumin. Fleta-tip përmban, në varësi të kërkesës së nismëtarëve, ligjin që kërkohet të shfuqizohet me referendum, ose çështjen që shtrohet për referendum. Në këtë moment procedural shtrohet pyetja, nëse është e mjaftueshme për KQZ-në të evidentojë vetëm 12 zgjedhës që kanë paraqitur kërkesën për shfuqizimin e një ligji ose që shtrojnë një çështje për referendum, me qëllim vijimin e mbledhjes së nënshkrimeve nga zgjedhësit që mbështesin referendumin (formalizimin juridik të kërkesës për referendum nga subjekti, që ligji

i njeh të drejtën e referendumit, sipas nenit 126/1 apo nenit 132/1 të Kodit Zgjedhor/Referendumet), apo edhe shqyrtimi në thelb i kërkesës së paraqitur duke verifikuar përputhjen me kërkesat e nenit 126 dhe të dispozitave të tjera të Kodit Zgjedhor/Referendumet.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se, siç rezulton edhe në nenin 126 të Kodit Zgjedhor/Referendumet, *procedura për zhvillimin e referendumit duhet të fillojnë me plotësimin e disa kushteve nga nismëtarët*, të cilët janë të detyruar të paraqesin qartësisht në kërkesën e tyre, jo vetëm ligjin/dispozitën që kërkohet të shfuqizohet, por edhe arsyen se përse duhet shfuqizuar. Ndërkohë që në rastin e referendumit për një çështje të rëndësisë së veçantë, nismëtarët duhet të përshkruajnë qartë çështjen, rëndësinë e saj, qëndrimin e tyre si dhe të shtrojnë pyetjen pa ekuivoqe, e mundshme për t'iu përgjigjur me "Po" ose "Jo". Nëse KQZ-ja nuk ka në kompetencën e saj verifikimin e këtyre elementëve ligjorë, të domosdoshëm për iniciimin e procedurës së mbledhjes së nënshkrimeve nga zgjedhësit, ky proces, potencialisht, rrezikon të jetë i paligjshëm dhe të përfshijë zgjedhësit e tjerë, në çështje të cilat mund të vijnë ndesh, së paku, me moralin shoqëror dhe, më së shumti, me rendin demokratik.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se KQZ-ja ka përgjegjësinë (të drejtën dhe detyrimin) për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve në drejtime si:

- lloji i referendumit për të cilin kërkohet fillimi i procedurave (i përgjithshëm apo vendor);
- ekzistencën dhe qartësinë e çështjes që shtrohet për referendum,
- rëndësia e saj,
- përveç se edhe aspekte të tjera ligjore që do të gjejnë pasqyrim në fletën-tip për mbledhjen e nënshkrimeve, që përpilohet nga vetë KQZ-ja.

Për sa kohë që ligjvënësi ka paracaktuar në pikën 5 të nenit 126 rregulla strikte ligjore përpara mbledhjes së nënshkrimeve të nevojshme për të kërkuar fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit, rregulla të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur, në radhë të parë, nga nismëtarët, atëherë i vetmi organ që kontrollon ligjshmërinë e kërkesës, është dhe duhet të jetë veçse KQZ-ja, që në ushtrim të kompetencave ligjore, nuk lejon fillimin e procedurave që bien në kundërshtim me ligjin.

Partia Demokratike e Shqipërisë ka pretenduar, ndërmjet të tjerave se, është Gjykata Kushtetuese, organi i cili pas mbledhjes së nënshkrimeve të nevojshme për kërkesën për referendum, shqyrton kushtetutshmërinë e çështjes që shtrohet në referendum dhe se KQZ-ja nuk mund të marrë kompetencat që i përkasin kësaj gjykate, duke u kufizuar vetëm në verifikimin e nënshkrimeve.

Në referim të Kushtetutës, Kolegji Zgjedhor thekson se sipas nenit 124, pika 2, Gjykata Kushtetuese, për vet pozicionin që ka si një autoritet i lartë, i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe në ushtrim të kompetencave të saj, ajo vendos për kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij (neni 131, shkronja “ë” e Kushtetutës), si dhe shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum, sipas nenit 150 paragrafët 1 e 2, nenit 151 paragrafët 2 e 3, nenit 177 paragrafët 4 e 5 (neni 152). Janë këtë kompetenca të cilat gjenden të parashikuara në shumë dispozita të Kushtetutës, në lidhje me referendumet dhe që kanë qenë objekt interpretimi nga jurisprudenca kushtetuese, mbi të cilat orientohet vetë Gjykata Kushtetuese për të përcaktuar juridiksionin e saj.

Ajo që Kolegji Zgjedhor vlerëson, në rastin konkret, lidhet me detyrimin e KQZ-së për të shqyrtuar të gjithë aspektet ligjore të kërkesës së nismëtarëve, duke mos u kufizuar vetëm në verifikimin e cilësisë së tyre si zgjedhës, në pranimin e kërkesës për pajisjen me fletën tip. Një kërkesë e vlefshme ligjërisht, që paraqitet nga nismëtarët dhe që konsiderohet si e tillë nga KQZ-ja, është një kusht për vijimin e procedurës së mëtejshme për zhvillimin e referendumit. Për rrjedhojë, vendimi i KQZ-së që kontrollon ligjshmërinë e kërkesës, për nga natyra e çështjeve që shqyrton, në këtë moment procedural, është një vendim përfundimtar dhe i kontrollueshëm gjyqësisht. Vetëm pas certifikimit ligjor të këtij vendimi përfundimtar, KQZ-ja, në kuptim të nenit 128 të Kodit Zgjedhor, “verifikon nënshkrimet dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të zgjedhësve, në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra prej saj” si dhe “vendos për pranimin ose mospranimin e kërkesës brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së saj, duke e bazuar vendimin vetëm mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur.”.

Të drejtën e shtetasve me të drejtë vote, për të kërkuar referendum e sanksionon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr.

9087, datë 19.06.2003, kështu për shqyrtimin e kësaj kërkesë për referendum Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve i referohet kuadrit kushtetues dhe ligjor në fuqi:

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 2 (pikat 1 dhe 2)

1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit.
2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti.”

Neni 13

“Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore.”

Neni 108

1. Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj.
2. Ndarjet administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike. Kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa u marrë me parë mendimi i popullsisë që banon në to.
3. Komuna dhe bashkia janë njësi bazë të qeverisjes vendore. Ato kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisese, me përjashtim të atyre që me ligj u jepen njërive të tjera të qeverisjes vendore.
4. Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore. Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit vendor parashikohen me ligj në përputhje edhe me nenin 151 paragrafi 2.”

Neni 124

“1. Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj.

2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.”

Neni 131 “Gjykata Kushtetuese vendos për: ... ë) kushtetutshmerinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij;”

Neni 151

“2. Çështjet që lidhen me tërësinë territoriale të Republikës së Shqipërisë, me kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, me buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit, me vendosjen dhe heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme, me deklarimin e luftës dhe të paqes dhe me amnistinë nuk mund të shtrohen në asnjë referendum.”

Neni 152

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum sipas nenit 150 paragrafët 1 e 2, nenit 151 paragrafët 2 e 3 edhe sipas nenit 177 paragrafët 4 e 5 brenda 60 ditëve.

2. Rëndësia e çështjeve të veçanta, të parashikuara në nenin 150 paragrafët 1 e 2 nuk është objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese.”

KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË I miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 74/2012

Neni 1 : Qëllimi dhe objekti

“1. Ky Kod ka për qëllim caktimin e rregullave për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet. ...”

Neni 2 : Përkufizime

“Në këtë Kod termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: ... 18. “Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve” është rezultati i shpallur nga KQZ-ja, në përputhje më këtë Kod dhe që përfshin: ... ç) rezultatin e votimit për çdo alternativë në referendum, sipas dispozitave të këtij Kodi. ... 23. “Zgjedhje” janë votimet për Kuvendin, për njësitë e qeverisjes vendore dhe referendumet.

Neni 145 : E drejta e ankimit në gjykatë

“1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. ...”

Neni 152 : Afati i ankimit në gjykatë

1. Ankimet, sipas këtij Kodi, paraqiten në Gjykatën e Apelit, Tiranë, e cila ia kalon ato Kolegjit Zgjedhor.

2. Ankimi për të gjitha vendimet që KQZ-ja merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tyre. Për vendimet që KQZ-ja merr jashtë kësaj periudhe, afati i ankimit në Kolegjin Zgjedhor është 30 ditë.”

Neni 185 : Shfuqizime

“1. Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, ligji nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe çdo akt tjetër ligjor ose nënligjor, që bie në kundërshtim me të, shfuqizohet.

2. Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në pikën 1 të këtij neni, pjesa e nëntë “Referendimet” e ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe çdo pjesë e dispozitave të tij që ka lidhje me të mbetet në fuqi deri në miratimin e ligjit të ri për referendimet e përgjithshme dhe vendore. Administrimi i procesit të referendumeve dhe nxjerrja e rezultatit të tyre bëhen në përputhje me këtë Kod.”

KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË I miratuar me ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003

Neni 1 : Qëllimi i këtij Kodi

“Ky Kod ka për qëllim përcaktimin e rregullave: ... e) për zhvillimin dhe vlefshmërinë e referendumeve; ...”

Neni 2 : Përkufizime

“... 19. “Referendum kushtetues” është referendumi, që zhvillohet sipas pikës 4 ose 5 të nenit 177 të Kushtetutës.

20. “Referendum i përgjithshëm” është referendumi, që zhvillohet sipas nenit 150, 151 dhe 152 të Kushtetutës.

21. “Referendum vendor” është referendumi, që zhvillohet sipas pikës 4 të nenit 108 të Kushtetutës.

...

34. “Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve” është rezultati i shpallur nga KQZ-ja dhe që përfshin:

...

c) rezultatin e votimit në referendum, sipas dispozitave të pjesës së nëntë të këtij Kodi.”

PJESA E NENTE REFERENDUMET

Neni 118 : Kuptimi i referendumit

1. Referendumi është ushtrimi i drejtpërdrejtë i sovranitetit të popullit, nëpërmjet votimit, për një çështje ose një ligj të caktuar, sipas neneve 108 pika 4, 150, 151, 152 dhe 177 të Kushtetutës.”

Neni 126 : Nisma për referendum të përgjithshëm

“1. Pesëdhjetë mijë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve kanë të drejtën e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e një ligji, si dhe t’i kërkojnë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë, në përputhje me pikën 1 të nenit 150 të Kushtetutës, si dhe me dispozitat e këtij Kodi.

2. Kërkesa për fillimin e procedurave të referendumit paraqitet në KQZ nga një grup prej jo më pak se 12 nismëtarësh, të cilët janë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve.

3. Kërkesa për shfuqizimin e një pjese të ligjit pranohet vetëm kur pjesa tjetër e ligjit është e vetëmjaftueshme.

4. Kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për shfuqizimin e një ligji ose të një pjese të tij, përmban:

a) titullin, numrin dhe datën e miratimit të ligjit që kërkohet të shfuqizohet, si dhe në qoftë se kërkohet të shfuqizohet vetëm një pjesë e ligjit, dispozitat përkatëse;

b) arsyet përse ligji ose dispozita të veçanta të tij duhen shfuqizuar.

5. Kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për një çështje të një rëndësie të veçantë duhet të përshkruajë qartë çështjen që shtrohet, rëndësinë e saj si dhe qëndrimin e nismëtarëve në lidhje me atë çështje. Çështja duhet të formulohet në mënyrë të qartë, të plotë dhe pa ekuivoqe dhe në mënyrë të tillë që zgjedhësit të mund të përgjigjen me “PO” ose “JO”.”

Neni 127 : Fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve

“1. KQZ-ja, brenda 20 ditëve nga paraqitja e kërkesës për referendum të përgjithshëm, pajis grupin nismëtar kundrejt pagesës me fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të 50 mijë zgjedhësve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve në kohën e paraqitjes së kërkesës. Në krye të fletës-tip shtypet titulli i ligjit, dispozitat që kërkojnë të shfuqizohen ose çështja që shtrohet në referendum.

2. Nënshkrimet në mbështetje të kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm depozitohen në KQZ në periudhën nga 1 janari deri më 30 nëntor të çdo viti.”

Neni 128 : Verifikimi i kërkesës nga KQZ-ja

“1. KQZ-ja verifikon nënshkrimet dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të zgjedhësve, në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra prej saj.

2. KQZ-ja vendos për pranimin ose mospranimin e kërkesës brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së saj, duke e bazuar vendimin vetëm mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur. Vendimi u njoftohet menjëherë nismëtarëve. Vendimi për mospranimin e kërkesës duhet të përcaktojë qartë shkaqet e mospranimit.

3. Brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit, grupi nismëtar mund t'i deklarojë KQZ-së se është i gatshëm të korrigjojë parregullsitë e vërejtura. Në këtë rast, KQZ-ja cakton një afat deri në 30 ditë për riparaqitjen e kërkesës. KQZ-ja vendos brenda 10 ditëve për pranimin ose jo të kërkesës së riparaqitur dhe i njofton menjëherë nismëtarët.”

Neni 132 : Nisma për referendum vendor

“1. Dhjetë për qind e zgjedhësve të regjistruar në listat e zgjedhësve të komunës ose bashkisë ose 20 mijë prej tyre, cilado shifër të jetë më e vogël, kanë të drejtën e referendumit vendor për një çështje të qeverisjes vendore në bashkinë ose komunën përkatëse.

2. Një numër këshillash bashkiake ose komunale, që përfaqësojnë jo më pak se një të tretën e popullsisë së një qarku, kanë të drejtë të kërkojnë zhvillimin e një referendumi për një çështje të qeverisjes vendore në nivel qarku.

3. Referendumi për të njëjtën çështje nuk mund të përsëritet në të njëjtën njësi të qeverisjes vendore pa kaluar tre vjet nga zhvillimi i tij.

4. Për zhvillimin e referendumit vendor zbatohen, për aq sa është e mundur ose e nevojshme, dispozitat e parashikuara për referendumin e përgjithshëm në pikat 2 dhe 5 të nenit 126, nenin 127 dhe në pikën 2 të nenit 128 të këtij Kodi.”

Nga analiza e vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit si dhe shpjegimeve të përfaqesueses të këshillit bashkiak e thirur nga KQZ për këtë qëllim, rezulton se, çështja që shtrohet për referendum vendor, në Bashkinë e Tiranës në kërkesën e grupit nismëtar, është një çështje e cila përfshin:

1. Zonën e çështjes me rëndësi kombëtare, në planifikimin e territorit, identifikuar si Kurora e Gjelbër e Tiranës, Parkun e Liqenit, përcaktuar me vendimin nr. 4, datë 29.12.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për përcaktimin e çështjes dhe zonës me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, identifikuar si Kurora e Gjelbër e Tiranës”;
2. Hartimin e Planit të Detajuar dhe projekteve zhvillimore në një territor të cilësuar si zonë me rëndësi kombëtare, të miratuar me vendin nr. 11, datë 16.02.2015, të Këshillit Kombëtar të Territorit “ Për miratimin e zonimit funksional të hyrjes së parkut të liqenit të Tiranës, pjesë e zonës me rëndësi kombëtare, si dhe marrjen e nismës për hartimin e planit të detajuar dhe projekteve zhvillimore brenda këtij territori”.
3. Miratimin e Lejes së ndërtimit të një objekti (Këndi Lojrash për fëmijë) me vendimin nr. 1, datë 12.02.2016, “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin “Kënd i Lojrave për fëmijë, projekti pilot 4, në kuadër të rehabilitimit të Parkut Të Liqenit, Bashkia Tiranë”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se miratimi për ndërtimin e kompleksit të objekteve është bërë me Vendime të Këshillit Kombëtar të Territorit. Aktet nënligjore të mësipërme shprehin qartë se çështja për të cilën kërkohet referendum në nivel bazë të njësisë së qeverisjes vendore nuk është çështje e qeverisjes vendore.

Vendimi nr.4, datë datë 29.12.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit, Parkun e Liqenit Tiranë e përcakton si një çështje më rëndësi

kombëtare. Nuk ka asnjë vendim të Këshillit të Bashkisë Tiranë të cilat të kenë lidhje me ceshtjen që shtrohet për referendum vendor. Objektet të cilat janë miratuar për ndertim kanë karakter kombëtar dhe jo vendor, sepse janë përcaktuar si të tilla dhe miratuar me akte të qeverisjes qendrore dhe jo me akte të qeverisjes vendore.

Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor i miratuar me ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003 kanë përcaktuar disa lloje referendumesh, duke përfshirë referendum të përgjithshëm për një çështje të rëndësishme së vecantë me karakter kombëtar (neni 150, pika e kushtetutes, neni 126, pika 1 e ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003) dhe referendum vendosur për çështje të qeverisjes vendore (neni 108, i Kushtetutës dhe neni 132, pika i ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003. Karakteri i çështjes kombëtare apo lokale bën ndryshimin ndërmjet këtyre dy llojeve të referendumeve.

Referuar dispozitave të sipërcituara, duke qene se KQZ-ja ka të drejtën dhe detyrimin për të shqyrtuar kërkesën e nismëtarëve për sa i përket lloji i referendumit për të cilin kërkohet fillimi i procedurave, vlerëson se referuar në objektin e saj çështja “A jeni dakord që të ndërtohet kënd lojrash duke betonizuar zemrën e Parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë? është një çështje e cila mund të shtrohet vetëm për referendum të përgjithshëm.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Neni 23, pika 1, germa a, i ligjit nr 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 126, pika 2 dhe 5, neni 127, pika 1, neni 132, pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 21, pika 1, nenin 126 pika 2, dhe 4, nenin 127, pika 1 të ligjit Nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

V E N D O S I

1. Rrëzimin e kërkesës së 12 nismëtarëve për paisjen me fletë-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për referendum vendor për çështjen e qeverisjes vendore të Bashkisë Tiranë. “A jeni dakord që të ndërtohet kënd lojrash duke betonizuar zemrën e Parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë?”
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INDEKS¹

A

- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (KZ V.3/2016, fq. 201)
- akt administrativ (GjK V.25/2009, fq. 36)
- alternativë (GjK V.44/1997, fq. 21)
- amendament kushtetues (KQZ V.47/2008, fq. 252)

B

- bashki (GjK V.19/2015, fq. 79)
- boshllëk ligjor (GjK V.44/1997, fq. 21)

C

- census (GjK V.19/2015, fq. 79)

Ç

- çështje e një rëndësie të veçantë (GjK V.5/2011, fq. 52; KZ V.2/2016, fq. 183; KQZ V.26/2010, fq. 257; KQZ V.6/2016, fq. 279; KQZ V.7/2016, fq. 301; KQZ V.8/2016, fq. 320)
- çështje e qeverisjes:
 - qendrore (KZ V.4/2016, fq. 216)
 - vendore (KZ V.4/2016, fq. 216; KQZ V.1876/2007, fq. 247)
- çështje me rëndësi kombëtare (KQZ V.7/2016, fq. 301)

D

- demokraci:
 - direkte (GjK V.31/2003, fq. 30)
 - përfaqësuese (GjK V.31/2003, fq. 30; GjK V.25/2009, fq. 36)
- dëgjesë publike (KZ V.4/2016, fq. 216)
- Direktiva 2008/98/KE “Për mbetjet” e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian (GjK V.8/2013, fq. 55)
- dokument identifikues (KQZ V.10/2012, fq. 265)

F

- firma të falsifikuara (GjK V.8/2013, fq. 55)
- firmëtar (KQZ V.609/2003, fq. 241)

1 Vendimet e Gjykatës Kushtetuese referohen si “GjK V.(numër)/(viti)”, vendimet e Kolegjit Zgjedhor referohen si “KZ V.(numër)/(viti)” dhe vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve referohen si “KQZ V.(numër)/(viti)”.

- fleta-tip për mbledhjen e nënshkrimeve (KQZ V.25/2003, fq. 233; KQZ V.37/2003, fq. 236; KQZ V.505/2003, fq. 238; KQZ V.609/2003, fq. 241; KQZ V.47/2008, fq. 252; KQZ V.26/2010, fq. 257; KQZ V.1236/2011, fq. 262)
- formë e qeverisjes (GjK V.44/1997, fq. 21)

G

- garanci institucionale/objektive/subjektive (GjK V.19/2015, fq. 79)
- *Gerrymandering* (GjK V.19/2015, fq. 79)
- grup nismëtar (KZ V.1/2015, fq. 125; KQZ V.47/2008, fq. 252; KQZ V.26/2010, fq. 257; KQZ V.1236/2011, fq. 262)

I

- Instituti i Policisë Shkencore (GjK V.8/2013, fq. 55; KQZ V.10/2012, fq. 265)
- interes publik (GjK V.19/2015, fq. 79)

J

- juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese/Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ V.6/2016, fq. 279)

K

- Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore (GjK V.19/2015, fq. 79; KZ V.1/2015, fq. 125)
- kartë identiteti (KQZ V.10/2012, fq. 265)
- kërkesë fillestare (KQZ V.7/2016, fq. 301)
- këshill bashkiak (KZ V.2/2016, fq. 183; KZ V.3/2016, fq. 201; KZ V.4/2016, fq. 216; KQZ V.6/2016, fq. 279)
- Këshilli Kombëtar i Territorit (KZ V.3/2016, fq. 201; KZ V.4/2016, fq. 216; KQZ V.7/2016, fq. 301; KQZ V.8/2016, fq. 320)
- Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venecias (GjK V.19/2015, fq. 79)
- Kodi i Praktikës së Mirë për Referendumet i Komisionit të Venecias (GjK V.8/2013, fq. 55)
- Komisioni i Posaçëm Parlamentar (GjK V.19/2015, fq. 79)
- komunë (GjK V.19/2015, fq. 79)
- konsultime me publikun (KZ V.2/2016, fq. 183)

- kontratë koncesionare (KZ V.2/2016, fq. 183; KQZ V.6/2016, fq. 279)
- kontribute (GjK V.31/2003, fq. 30)
- kushtetueshmëria e kërkesës për referendum (KZ V.1/2015, fq. 125)
- kuti votimi (GjK V.5/2011, fq. 52)

L

- legjitimiteti i nismëtarëve (KZ V.1/2015, fq. 125)
- leje ndërtimi (KQZ V.8/2016, fq. 320)
- ligj kushtetues/organik (GjK V.3/1995, fq. 13)
- ligjshmëria e kërkesës (KZ V.1/2015, fq. 125; KQZ V.6/2016, fq. 279; KQZ V.7/2016, fq. 301)
- lista e zgjedhësve (KQZ V.609/2003, fq. 241; KQZ V.1688/2005, fq. 245)
- lloji i objektit të kërkesës (KQZ V.6/2016, fq. 279; KQZ V.7/2016, fq. 301)
- lloji i referendumit (KZ V.1/2015, fq. 125; KQZ V.6/2016, fq. 279; KQZ V.7/2016, fq. 301)

M

- materiale zgjedhore (GjK V.5/2011, fq. 52)
- mbetje jo të rrezikshme/të rrezikshme (GjK V.8/2013, fq. 55)
- menaxhim i integruar i mbetjeve (GjK V.8/2013, fq. 55; KQZ V.1236/2011, fq. 262; KQZ V.10/2012, fq. 265)
- mjete juridike (GjK V.25/2009, fq. 36)
- monarki kushtetuese (GjK V.44/1997, fq. 21)

N

- ndarje administrative-territoriale (GjK V.19/2015, fq. 79; KZ V.1/2015, fq. 125)
- nënshkrime të falsifikuara (KQZ V.10/2012, fq. 265)
- nënshkrimet e zgjedhësve (GjK V.8/2013, fq. 55)
- nismëtarë (KQZ V.25/2003, fq. 233)
- numërim i votave (GjK V.44/1997, fq. 21)

NJ

- njësi e qeverisjes vendore (GjK V.19/2015, fq. 79)

O

- objekti ligjor i referendumit (KQZ V.26/2010, fq. 257)
- organe të pushtetit vendor (KZ V.1/2015, fq. 125)

P

- parimi i:
 - barazisë së votës (GjK V.19/2015, fq. 79)
 - sigurisë juridike (GjK V.31/2003, fq. 30; GjK V.8/2013, fq. 55)
 - subsidiaritetit (GjK V.19/2015, fq. 79)
 - vetëqeverisjes (GjK V.19/2015, fq. 79)
- park:
 - industrial-energjitik (KQZ V.1688/2005, fq. 245; KQZ V.1876/2007, fq. 247)
 - lojrash (KQZ V.8/2016, fq. 320)
- parkim nëntokësor (KZ V.2/2016, fq. 183; KQZ V.6/2016, fq. 279)
- pension i pjeshëm/pleqërisë (GjK V.31/2003, fq. 30)
- përfaqësues i subjektit zgjedhor (KZ V.1/2015, fq. 125)
- prerogativë (GjK V.3/1995, fq. 13)
- *prima facie* (GjK V.8/2013, fq. 55)
- procedurë e përshpejtuar (GjK V.19/2015, fq. 79)
- proces ligjvënës (GjK V.25/2009, fq. 36)
- projekt zhvillimor (KQZ V.8/2016, fq. 320)
- projektkushtetuta (GjK V.3/1995, fq. 13)
- pyetje referendare (KQZ V.6/2016, fq. 279; KQZ V.7/2016, fq. 301)

Q

- qartësi e çështjes (KQZ V.6/2016, fq. 279; KQZ V.8/2016, fq. 320)
- *quorum* (GjK V.3/1995, fq. 13)

R

- referendum:
 - i përgjithshëm (GjK V.44/1997, fq. 21; KQZ V.25/2003, fq. 233; KQZ V.505/2003, fq. 238; KQZ V.47/2008, fq. 252; KQZ V.10/2012, fq. 265; KQZ V.7/2016, fq. 301)
 - konsultativ (GjK V.25/2009, fq. 36)
 - kushtetues (KQZ V.47/2008, fq. 252)
 - pezullues (GjK V.3/1995, fq. 13)

- ratifikues (GjK V.3/1995, fq. 13; GjK V.25/2009, fq. 36)
- shfuqizues (GjK V.3/1995, fq. 13; GjK V.31/2003, fq. 30; KQZ V.6/2016, fq. 279; KQZ V.7/2016, fq. 301; KQZ V.8/2016, fq. 320)
- vendor (GjK V.19/2015, fq. 79; KZ V.1/2015, fq. 125; KZ V.2/2016, fq. 183; KQZ V.37/2003, fq. 236; KQZ V.609/2003, fq. 241; KQZ V.1688/2005, fq. 245; KQZ V.1876/2007, fq. 247; KQZ V.24/2014, fq. 271; KQZ V.156/2014, fq. 276; KQZ V.6/2016, fq. 279)
- reformë:
 - e decentralizimit (GjK V.19/2015, fq. 79)
 - territoriale (KZ V.1/2015, fq. 125)
- Regjistri Kombëtar i Zgjedhësve (KQZ V.47/2008, fq. 252)
- Regjistri Themeltar i Gjendjes Civile (GjK V.19/2015, fq. 79)
- republikë (GjK V.44/1997, fq. 21)
- rezultat përfundimtar (GjK V.44/1997, fq. 21)
- rinumërim i fletëve të votimit (GjK V.5/2011, fq. 52; KQZ V.47/2008, fq. 252)
- rishikim i Kushtetutës (KQZ V.47/2008, fq. 252)

S

- saktësim i:
 - çështjes (KQZ V.8/2016, fq. 320)
 - kërkesës (KQZ V.6/2016, fq. 279)
- seancë dëgjimore (GjK V.19/2015, fq. 79)
- sigurimet shoqërore (GjK V.31/2003, fq. 30)
- sovraniteti i popullit (GjK V.3/1995, fq. 13; KZ V.1/2015, fq. 125)
- *suprema potestas* (GjK V.8/2013, fq. 55)

SH

- shfuqizim:
 - i ligjit (GjK V.25/2009, fq. 36)
 - i një pjese të ligjit (GjK V.31/2003, fq. 30; KQZ V.1236/2011, fq. 262; KQZ V.10/2012, fq. 265)
- shtrirje territoriale (GjK V.19/2015, fq. 79)

T

- tarifë koncesionare (KZ V.2/2016, fq. 183; KQZ V.6/2016, fq. 279)
- tender (KQZ V.8/2016, fq. 320)

U

- *ultra vires* (GjK V.25/2009, fq. 36)

V

- vendbanim (KQZ V.24/2014, fq. 271)
- verifikim i dokumentacionit /nënshkrimeve (KQZ V.10/2012, fq. 265)
- vlefshmëria formale/materiale e çështjes (GjK V.8/2013, fq. 55)
- vlerësim mjedisor (KZ V.2/2016, fq. 183; KZ V.3/2016, fq. 201; KZ V.4/2016, fq. 216; KQZ V.6/2016, fq. 279)

Z

- zgjedhës (KQZ V.156/2014, fq. 276)
- zgjedhje parlamentare (GjK V.5/2011, fq. 52)
- zonë:
 - e çështjes me rëndësi kombëtare (KQZ V.8/2016, fq. 320)
 - funksionale (GjK V.19/2015, fq. 79)
 - me rëndësi kombëtare (KZ V.3/2016, fq. 201; KZ V.4/2016, fq. 216; KQZ V.7/2016, fq. 301)
- zonim funksional (KZ V.3/2016, fq. 201; KZ V.4/2016, fq. 216; KQZ V.7/2016, fq. 301)

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

OSBE

Vendime për referendumet : vendime të Gjykatës Kushtetuese,

Kolegjit Zgjedhor dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve :

1992-2016 / OSCE. –

Tiranë : **Graphic line-01, 2016**

346 f. ; 26 X 17 cm.

ISBN 978-9928-4311-8-9

1.Gjykata Kushtetuese 2.Vendime gjyqësore 3.Zgjedhje

4.Referendume

342.565.2(496.5) “1992/2016”

342.8(496.5) “1992/2016”